KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

4 vjet Auditim i Jashtëm Publik

2012-2015

BUJAR LESKAJ

Seria: botime KLSH-11/2016/62

Tiranë 2016

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

BUJAR LESKAJ

4 vjet Auditim i Jashtëm Publik

(Dokumente 2012-2015)

Bujar Leskaj

4 vjet Auditim i Jashtëm Publik

(Dokumente të Kryetarit 2012-2015)

Seria: Botime KLSH

11/2016/62

ISBN: 978-9928-159-48-9

Tiranë, 2016

Titulli:

4 vjet Auditim i Jashtëm Publik (2012-2015)

Bujar Leskaj

Realizoi në kompjuter:

Yrjada Jahja

Redaktorë: Fatos Çoçoli

Irena Islami

©Copyright KLSH

Shtypur në Shtypshkronjën "ILAR"

Tiranë, 2016

Gjatë vitit 2016, KLSH ka publikuar 16 botime, me tirazh mesatar prej 250 kopje për botim, me një numër prej 1 307 250 faqesh dhe me vlerë totale 2,353,050 lekë. Për shkak të tejkalimit të numrit maksimal të faqeve të botimeve të KLSH-së të parashikuara për t'u botuar gjatë këtij viti, sipas kontratës së lidhur me subjektin fitues të tenderit të botimeve, kompaninë "ILAR", 474 faqe të këtij botimi nga 862 faqe gjithsej, janë botuar me kontributin financiar personal të Kryetarit të KLSH-së, z. Bujar Leskaj. Libri është botuar në 250 kopje dhe kontributi i z.Leskaj është 177,750 lekë.

Në vitet në vijim, do të botohen dokumente të institucionit të Kryetarit të KLSH, nisur që nga viti i themelimit 1925, duke shfrytëzuar materiale nga arkivat dhe shtypi i kohës, në respekt të kontributit të drejtuesve të mëparshëm të KLSH, sidomos të periudhës 1925-1939.

PËRMBAJTJA

I. Projekt Ide: KLSH, Institucioni më i lartë i kontrollit ekonomiko-financiar të vendit

Platformë e paraqitur në cilësinë e kandidatit për Kryetar të KLSH-së në Komisionin për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë, 14 dhjetor 2011..... 14

II. Raportimet e Kryetarit të KLSH-së në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave

Rezoluta e Kuvendit dhe reflektimi në veprimtarinë e KLSH-së (*Prezantimi i Raportit të Performancës së KLSH-së për vitin 2011)*..... 30

Të përcaktohet kufiri për totalin e borxhit shtetëror dhe borxhit të garantuar *(Prezantimi i Raportit të Zbatimit të Buxhetit Faktik të vitit 2011)*..... 50

Zhvillimi i KLSH sipas drejtimeve strategjike të EUROSAI-t *(Prezantimi i Raportit të Performancës së KLSH-së për vitin 2012)*..... 68

Vendosja në Kushtetutë e një kufiri për Borxhin Publik dhe shlyerja e detyrimeve ndaj biznesit (*Prezantimi i Raportit të Zbatimit të Buxhetit Faktik të vitit 2012)* 80

Auditimi Kombëtar në shërbim të qeverisjes kombëtare (*Prezantim i Raportit të Performancës së KLSH-së për vitin 2013*)..... 93

Ngritja e një Këshilli të Pavarur Fiskal–detyrë imperative e kohës (*Prezantim i Raporti të Zbatimit të Buxhetit Faktik të vitit 2013*)..... 104

Korniza e Matjes së Performancës së një SAI dhe palët e interesit (*Prezantim i Raportit të Performancës së KLSH-së për vitin 2014*)..... 138

Për një respektim rigoroz të treguesve të Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020 (*Prezantim i Raportit të Zbatimit të Buxhetit Faktik të vitit 2014*) 155

SAI nuk harton politika, por auditon zbatimin e tyre *(Prezantim i Raportit të Performancës së KLSH-së për vitin 2015)*..... 177

Rritja ekonomike më e ulët është pasojë dhe jo arsyeja e mosrealizimit të të ardhurave buxhetore *(Prezantim i Raportit të Zbatimit të Buxhetit Faktik të vitit 2015)* 191

III. Ligji i ri organik në përputhje të plotë me standardet e INTOSAI-t

Prezantimi i projektligjit në takime me ekspertë të fushës juridike dhe të financave publike, me akademikë, shoqërinë civile dhe median..... 214
Relacion mbi Projekt Ligjin, i përcjellë për Kuvendin e Shqipërisë..... 221
Ligji i ri e sjell auditimin e jashtëm publik në një linjë me standardet ndërkombëtare, Diskutim në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave, *17 mars 2014*..... 241
Kufizimi i qasjes në informacion të KLSH-së i shkon ndesh standardeve ndërkombëtare të fushës, Diskutim në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, *2 prill 2014*..... 249
Ligji duhet të shohë nga Brukseli, jo nga Zimbabve, Diskutim në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, *21 prill 2014*..... 253
Ligji i ri për KLSH-në, kontribut i qartë në integrimin e vendit, Diskutim në Komisionin e Integrimit Evropian, *7 prill 2014*..... 260
Cënimi i qasjes së pakufizuar të KLSH-së në informacion shkon në kundërshtim të hapur me Bashkimin Europian, Diskutim në Komisionin e Integrimit Evropian, *22 prill 2014*..... 269
Projektligji i ri i KLSH-së - zhvillim i mandatit të tij kushtetues në kushtet e sotme (*Gazeta Ekonomia, 19 prill 2014*)..... 273

IV. Artikuj të botuar në shtypin shqiptar

Korrupsioni nuk është as i kuq, as blu, por i zi (*Gazeta 'SOT', 21 janar 2012*)..... 285
Lufta ime (*Intervistë, revista "Klan", Nr. 753 10 shkurt 2012*)..... 289
Ku bashkohen KLSH me Autoritetin e Konkurrencës (*Gazeta 'Ekonomia', 25 mars 2012)*..... 295
Eksperienca e përbashkët u shërben të gjithëve (*Revista 'Monitor', 8 prill 2012)*..... 297
KLSH drejt standardeve të INTOSAI-t (*Gazeta "Ekonomia", 21 nëntor 2012*)..... 307
87 vjet KLSH në 100 vjet Shtet (*Gazeta "Ekonomia",16 janar 2013*)..... 315
Llogaridhënia dhe transparenca (*Gazeta "Koha Jonë", 4 shkurt 2013*)..... 320
Auditimi dhe këshillimi nga KLSH (*Gazeta"Panorama", 8 maj 2013*)..... 327
Prof. As. Dr. Recai Akyel, një personalitet i shquar i auditimit suprem europian (*Gazeta "Ekonomia", 5 qershor 2013*)..... 331
Rritja e përgjegjshmërisë institucionale (*Gazeta "Panorama", 26 qershor 2013*)..... 336
Mbi zbatimin e Buxhetit të Shtetit të vitit 2012 (*Gazeta "Rilindja Demokratike", 13 tetor 2013*) 341

KLSH dhe administrimi i Buxhetit të Shtetit (*Gazeta "Telegraf", 14 nëntor 2013*)..... 342
60 vjet INTOSAI-Zhvillimi i organizatës nga Lima në Pekin (*Gazeta "Ekonomia", 5 numra të gazetës, 19-23 nëntor 2013*)..... 348
Për një projekt kombëtar në luftën kundër korrupsionit (*Gazeta "Panorama", 27 nëntor 2013*)..... 383
Auditimi kombëtar në shërbim të mirëqeverisjes (*Intervistë, revista "Klan", 24 dhjetor 2013*)..... 387
Tri paralajmërimet e KLSH: Borxhi Publik, Borxhi ndaj Biznesit, Ndarja Administrative (*Gazeta "Ekonomia", 29 janar 2014*)..... 393
300 Vjetori i Gjykatës së Auditimit të Gjermanisë (*Gazeta "Ekonomia", 9 mars 2014)*..... 399
Nisma e re ligjore për KLSH-në (*Gazeta "Ekonomia" dhe Gazeta "Koha Jonë", 18 mars 2014*)..... 404
Jo, KLSH nuk kërkon të auditojë subjektet private! (*Gazeta "Panorama", 31 mars 2014*)..... 412
Cenimi me ligj i së drejtës së KLSH për informacion do të ishte regres (*Gazeta "Shqiptarja.com", 6 prill 2014*)..... 416
Detyrimet e MSA-së dhe ligji i ri i KLSH-së (*Gazeta"Koha Jonë", 8 prill 2014*)..... 419
Auditimi Kombëtar të vihet në shërbim të qeverisjes kombëtare (*Gazeta "Ekonomia", dy numra, 16-17 tetor 2014*)..... 425
Menaxhimi i financave publike dhe BE (*Gazeta "Shqiptarja.com", 28 dhjetor 2014)*..... 426
Për një llogaridhënie dhe transparencë të financave publike (*Gazeta "Panorama", 25 janar 2015*)..... 429
Për një lexim të vëmendshëm të raporteve të ndërkombëtarëve për ekonominë (*Gazeta "Shqip", 6 maj 2015*)..... 434
90 vjet KLSH (*Gazeta "Panorama", 27 maj 2015*)..... 439
Gjetjet e KLSH sipas Kornizës së Matjes së Performancës së SAI-ve (*Gazeta "Shqip", 29 qershor 2015*)..... 445
A duhet të shqetësohemi për ekonominë shqiptare? (*Revista "Monitor", 2 korrik 2015*)..... 446
EUROSAI-OLACEFS: Frytet e një bashkëpunimi 25 vjeçar (*Gazeta "Telegraf", 4 korrik 2015*)..... 452
KLSH dhe sfida e llogaridhënies publike (*Gazeta "Shqip", 15 korrik 2015*)..... 455
Korrupsioni sistematik dhe informaliteti (*Gazeta "Panorama", 11 tetor 2015*)..... 459

Për një zbatim koherent të strategjisë së menaxhimit të financave publike (*Gazeta "Shqip", 2 dhjetor 2015*)..... 465
Borxhi publik dhe nevoja e rritjes ekonomike (*Gazeta "Panorama", 4 dhjetor 2015*)..... 470
Për rritjen e besueshmërisë së Buxhetit të Shtetit (*Gazeta "Gazeta Shqiptare", 6 dhjetor 2015*)..... 473
Transparenca, institucionet dhe lufta kundër korrupsionit (*Gazeta "Sot", 16 dhjetor 2015*)..... 478

V. Shkrime në Revistën Shkencore "Auditimi Publik" dhe Revistën "INTOSAI Journal"

Sfidat drejt një institucioni modern të auditimit të jashtëm publik *(Revista Shkencore "Auditimi Publik" Nr. 1, viti 2012)*..... 485
Niveli i borxhit publik dhe Kushtetuta *(Revista Shkencore "Auditimi Publik" Nr.2, viti 2012*)..... 486
Llogaridhënia, transparenca dhe përgjegjësia jonë si SAI *(Revista Shkencore "Auditimi Publik" Nr. 3, viti 2012)*..... 495
Performanca e KLSH 2012 drejt një Institucioni Modern Auditimi Publik *(Revista Shkencore "Auditimi Publik" Nr.4, viti 2013)*..... 505
Mirëqeverisja- Paradigma e re në administrimin publik *(Revista Shkencore "Auditimi Publik" Nr. 5, viti 2013)*..... 517
Analiza vjetore e Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2014 në frymën e IntoSAINT (*Revista Shkencore "Auditimi Publik" Nr. 10, viti 2015)*..... 524
Vendimmarrja dhe Teknologjia Inteligjente *(Revista Shkencore "Auditimi Publik" Nr. 11, viti 2015*)..... 534
ALSAI innovative approaches in connecting with citizens (Qasjet inovative të KLSH në lidhjen me qytetarët) (*Shkrim në anglisht, Revista "INTOSAI Journal", Nr. 21, shtator-dhjetor 2014*)..... 551

VI. Diskutime në Analizat Vjetore të KLSH dhe të ZKA të Kosovës

Të largojmë auditimin nga hija e gjobëvënësit, *Analiza e KLSH për vitin 2011, janar 2012*..... 556
Dituria në Auditim, armë për mbrojtjen e pavarësisë institucionale, *Analiza e KLSH-së për 6-mujorit të parë të vitit 2012, korrik 2012* 564
Cilësi në Auditim do të thotë të fitosh besimin e qytetarëve, *Analiza e KLSH për vitin 2012, janar 2013*..... 581
KLSH si institucion që përmirëson menaxhimin publik të parave të shqiptarëve, *Analiza e KLSH për vitin 2013, janar 2014*..... 590
Auditimi Kombëtar, në shërbim të qeverisjes kombëtare, *Analiza e KLSH për vitin 2014, janar 2015*..... 598

Të ndryshosh për mirë opinionin publik mbi një shërbim apo veprim shtetëror, ke ndryshuar për mirë qeverinë, *Analiza e KLSH për vitin 2015, shkurt 2016*..... 609
Konferenca e IV-të e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës, *Analiza Vjetore, korrik 2012*..... 615
Konferenca e V-të e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës, *Analiza Vjetore, korrik 2013*..... 616
Diskutim në Konferencën e VI-të të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës, *Analiza Vjetore, korrik 2014*..... 617
Diskutim në Konferencën e VII-të të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës, *Analiza Vjetore, korrik 2015*..... 627

VII. Prezantime dhe kumtesa në Konferenca Shkencore

Konferenca e I-rë Shkencore "87 vjet KLSH në 100 vjet Shtet shqiptar", *28 dhjetor 2012*..... 642
Konferenca e II-të Shkencore "Roli i SAI-ve për një menaxhim publik të përgjegjshëm në sfidat e sotme", *12-13 dhjetor 2013*..... 645
Profil mbi menaxhimin e sistemit të kontrollit të integritetit në KLSH 2012-2013..... 650
Konferenca e III-të Shkencore "Auditimi Kombëtar në shërbim të Qeverisjes Kombëtare", *29-30 tetor 2014*..... 655
Zvogëlimi i riskut: një potencial i mundshëm i zhvillimit të vendit..... 661

VIII. KLSH, shtëpi e librit, Universitet për audituesit e rinj, partner i shoqatave profesionale të fushës

Promovimi i botimeve të KLSH-së në Bibliotekën Kombëtare, 2013..... 688
Një frymë e re mes audituesve jo-publikë dhe audituesve më të lartë publikë..... 692
Veprimtaria e KLSH përmes "lenteve" të të drejtave të njeriut..... 694
Seminar i Departamentit të Auditimit të Performancës..... 699
Konferenca Young KLSH "Unë, KLSH dhe EUROSAI"..... 706
Kongresi i III-të i Shoqatës së Kontabilistëve dhe Financierëve të Shqipërisë..... 711
Hyrjet në botimet e KLSH *(Përmbledhje e paratheniev nga disa prej 51 titujve të Kolanës së Botimeve KLSH 2012-2015)*..... 714

IX. Partneritetet me Institucionet Supreme të Auditimit, shoqërinë civile dhe shoqatat profesionale të fushës

Marrëveshjet e Bashkëpunimit me SAI-t homologë..... 798
Marrëveshjet e Bashkëpunimit me shoqërinë civile..... 807

Pjesëmarrja e SAI-ve në aktivitetet e zhvilluara nga KLSH..... 816
Pjesëmarrja e Kryetarit të KLSH në aktivitetet ndërkombëtare..... 825
Fjala e Kryetarit të KLSH në Këshillin e NIK..... 838
Fjala e Kryetarit të KLSH në Gjykatën e Auditimit të Austrisë..... 840

Në vend të Pasthënies:
Ambicia jonë- KLSH institucioni më i përgatitur për integrim
(*Intervista e z. Jacek Jezierski, ish-President i Institucionit Suprem të Auditimit të Polonisë (NIK), dhënë Televizionit Publik Shqiptar më datën 30 Nëntor 2016***)**.... 847

Parathënie

Vitet 2012-2015, të karakterizuara nga zbatimi i motos "*Experentia mutua Omnibus Prodest (Eksperienca e përbashkët u shërben të gjithëve*)" të Organizatës Botërore të Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI-ve) INTOSAI, përfaqësojnë për Kontrollin e Lartë të Shtetit një progres të vrullshëm cilësor. Si një SAI që kërkon të zhvillohet me parametrat e SAI-ve të përparuara europiane, duke patur parasysh thënien e ish-Presidentit të INTOSAI-t, z. Terence Nombembe se "*Dija në auditim është arma që askush nuk do të guxojë të na e marrë, e cila na pajis me mendim dhe analizë të pavarur*", kemi audituar gjatë këtyre viteve, në përputhje me standardet e INTOSAI-t, duke ndjekur qasjen e re këshillimore të auditimit suprem publik në botë, sikurse e ka përcaktuar Dr. Josef Moser, ish-Sekretar i Përgjithshëm i INTOSAI-t dhe ish-President i Gjykatës Austriake të Auditimit, në fjalën e tij në Simpoziumin e 22-të të Kombeve të Bashkuara dhe të INTOSAI-t, më 5 mars 2013 në Vjenë: "*Auditimi dhe këshillimi nga SAI-t janë dy anë të së njëjtës monedhë. Institucionet supreme të auditimit duhet dhe mund të rrokin mundësitë që qytetarët të angazhohen, duke shfrytëzuar potencialin e tyre të plotë në përpjekjet për përmirësimin e qeverisjes së mirë publike, vetëm nëse ata zhvillojnë një qasje këshillimi në bazë të punës së tyre audituese, e cila ofron rekomandime specifike si për subjektet e audituara, ashtu dhe për menaxherët qeveritarë, rekomandime që mund të zbatohen praktikisht në sferat e tyre përkatëse të veprimit*".

Bazuar në këtë qasje të re dhe përgjegjësi të rritur kombëtare, vizioni i KLSH ka qenë shndërrimi i audituesve të tij në një trupë moderne auditimi, që zbaton standardet ndërkombëtare ISSAI të INTOSAI-t në kushtet dhe specifikat e Shqipërisë, e aftë të përballojë sfidat e kohës për shëndoshjen e plotë dhe qëndrueshmërinë e financave publike, të luftojë në thellësi dhe në sistem korrupsionin, si dhe të bashkëpunojë me efektivitet dhe efiçiencë me partnerët brenda vendit, me institucionet simotra në Europë dhe më gjerë, dhe me partnerët ndërkombëtarë.

Nëpërmjet raportimeve në Kuvend, fjalës, argumentimeve dhe gjetjeve në analizat vjetore dhe periodike të institucionit, mesazheve të përmbajtura në prezantimet në konferenca shkencore dhe përshëndetjeve në aktivitete të ndryshme promovimi e bashkëpunimi dhe partneritete të realizuara, si dhe nëpërmjet opinioneve dhe intervistave në median e shkruar të vendit, ky botim përbën një dëshmi të faktit se shndërrimi i KLSH-së nuk ndodhi në mënyrë spontane dhe të fragmentuar, por ishte fryt i një plani strategjik të përgatitur që në fillim, i cili synonte reforma të thella në shtatë vitet e një mandati Kushtetues (2012-2018), në dobi të forcimit dhe modernizimit të auditimit suprem publik, si dhe rritjes së përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies në administratën tonë publike.

Ndryshimet e thella përfshinë të gjithë aktivitetin auditues, duke u pasqyruar në hartimin dhe miratimin e ligjit të ri integral dhe strategjisë së KLSH-së, misionit, vizionit,

objektivave, planeve dhe programeve të auditimit, ndryshimeve strukturore, të ndjekura nga ngritja e strukturave që janë më funksionale përmes Departamenteve dhe Drejtorive, me qëllim përmbushjen e misionit dhe përshtatjen me kushtet e reja. Modernizimi i institucionit me shtimin e nivelit të njohurive dhe zbatimit të ISSAI-ve, duke rritur numrin e trajnimeve dhe të menaxhimit dhe kontrollit mbi nivelin e asimilimit të njohurive, rritja e bashkëpunimit, marrëveshjet me SAI-t Europiane, bashkëpunimi me institucionet shkencore, universitetet, organizimi i konferencave shkencore që shërbejnë për përmirësimin e cilësisë së auditimeve, të gjitha këto sollën rritjen e imazhit dhe të besimit qytetar tek Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Filozofia jonë e punës dhe qasja në auditim ishin krejtësisht të reja, të përqendruara në njohjen e thellë të standardeve të pranuara ndërkombëtarisht të INTOSAI-t, në rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe partneritetit në funksion të shtimit të kapaciteteve audituese dhe në krijimin e sinergjisë për rritjen e përgjegjshmërisë publike dhe thellimin e luftës kundër korrupsionit, nëpërmjet partneritetit me institucionet e tjera të pavarura kushtetuese, me organizatat profesionale brenda vendit dhe me shoqërinë civile.

Transparenca dhe komunikimi me qytetarët dhe me të gjithë aktorët e shoqërisë shqiptare e shndërruan KLSH-në, në pak muaj të vitit të parë të ndryshimit, vitit 2012, nga një strukturë gati hermetike që prodhonte vetëm njoftime shtypi për dëme hipotetike, në një organizatë të hapur e bashkëpunuese me mediat dhe publikun.

Raportet kryesore drejtuar Kuvendit, ai i realizimit të Buxhetit Faktik të Shtetit për vitin paraardhës dhe raporti i performancës së KLSH, në rolin e institucionit agjent i Kuvendit për mirëmenaxhimin e parasë publike, njohën thellësinë e argumentit dhe gjetjes audituese, dobinë e plotë të rekomandimit në përmirësim konkret të menaxhimit të fondeve publike, sipas orientimeve të standardeve ISSAI, duke siguruar drejtpërdrejtshmëri dhe lexueshmëri nga anëtarët e Kuvendit.

Ndërkohë, ndryshimet në mënyrën e organizimit dhe funksionimit të institucionit kishin nevojë për një kuadër të ri ligjor, i kërkuar dhe nga Progres-Raportet e Bashkimit Europian të viteve 2008-2013. Ky kuadër u plotësua me miratimin nga Kuvendi në nëntor 2014 të ligjit të ri integral të KLSH, i cili u përshëndet nga Delegacioni i BE në Tiranë si një akt në dobi të ndjeshme të procesit të integrimit të vendit. Ligji është tërësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare të INTOSAI-t dhe i hap rrugën mbështetjes së BE-së për Buxhetin e Shtetit Shqiptar.

Një përmasë tjetër e transformimeve në KLSH gjatë viteve 2012-2015, që ka theksuar dhe garantuar profilin e fituar profesional të institucionit, është organizimi i konferencave shkencore, për thithjen e mendimit të përparuar për çështje të sotme të

auditimit publik dhe të financave publike, mendim i ardhur nga institucionet partnere të KLSH në rajon dhe më gjerë në Evropë, nga përfaqësuesit më aktivë e cilësorë të akademikëve dhe profesoratit shqiptar, si dhe nga përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe nga radhët e audituesve të institucionit.

Nga vetëm 12 botime në të gjithë periudhën 1991-2011 për institucionin, kolana e botimeve KLSH 2012-2015 kap shifrën e 51 librave që variojnë nga përmbledhje dhe përshtatje në shqip të standardeve ISSAI, në manuale të auditimeve të përputhshmërisë, financiare, të performancës, të teknologjisë së informacionit, përmbledhje të raporteve të performancës së institucionit dhe të zbatimit të Buxhetit të Konsoliduar të Shtetit, analiza vjetore e deri në botime historike dhe përmbledhje të kumtesave të konferencave shkencore dhe të shkrimeve të audituesve të KLSH-së. Për t'u theksuar janë botimet si Historiku i KLSH-së dhe Kremtimi i 90-Vjetorit të Institucionit.

Libri paraqet parathëniet dhe hyrjet e disa prej botimeve më domethënëse të kolanës. Këto botime deri në fund të vitit 2016 po shkojnë në mbi 70 tituj dhe premtojmë se në shtatë vitet 2012-2018 të këtij mandati kushtetues, ato do të arrijnë 100 tituj, duke e dhënë në të gjitha parametrat, si dhe në gjerësinë dhe thellësinë e tij progresin dhe shndërrimin e institucionit në një strukturë europiane tërësisht të përgatitur për integrimin e plotë të enteve tona publike në familjen e madhe të Bashkimit Europian.

Në tërësi, ky libër e projekton KLSH-në përpara lexuesit shqiptar në të gjitha përmasat e transformimeve drejt një organizate model të auditimit suprem, e cila udhëheq nëpërmjet shembullit që jep, në përputhje me orientimin Strategjik të INTOSAI-t dhe EUROSAI-t.

Sot institucioni gëzon partneritetin dhe kontributin e gjithë veprimtarëve të shoqërisë sonë, nga institucionet e tjera të pavarura tek OJF-të, vlerësimin dhe përkrahjen e institucioneve simotra partnere të KLSH-së, një raport frytdhënës dhe të projektuar drejt një të ardhme të sigurt KLSH-Kuvend dhe përmbi të gjitha, besimin e rritur të qytetarëve dhe taksapaguesve shqiptarë në misionin dhe rezultatet e KLSH-së, besim i fituar me punë dhe përkushtim ndaj vlerave, standardeve dhe integritetit të auditimit më të lartë publik evropian.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, kjo strukturë jetike për të ardhmen e miradministrimit të parasë së taksapaguesit shqiptar, është si organizim i natyrës monokratike, sikurse janë shumica e institucioneve supreme europiane të auditimit. Duke qenë i tillë, veprimtaria, rezultatet, mesazhet, gjetjet dhe rekomandimet e tij pasqyrohen kryesisht nëpërmjet dokumenteve të drejtuesit të institucionit. Përmes këtyre dokumenteve, si raporte, analiza, fjalime, përshëndetje, adresime, si dhe editoriale dhe intervista për shtypin shqiptar, institucioni komunikon me veprimtarët kryesorë partnerë të tij, si me

Kuvendin, organizatat simotra, shoqatat profesioniste të fushës, organizatat e shoqërisë civile, mediat, por sidomos me qytetarin dhe taksapaguesin e vendit tonë.

Ky botim kërkon të shpalosë përpara lexuesit të thjeshtë dhe atij të interesuar shqiptar, përmes dokumenteve të Kryetarit të KLSH-së, ndryshimin dhe evoluimin e kësaj strukture, në radhë të parë në mendësinë e punës audituese dhe në rritjen e cilësisë së gjetjeve dhe rekomandimeve të saj.

Sikurse përgatitëm në këto vite Historikun(Konferenca e Parë Shkencore, botimi përkatës), Mini-Muzeumin e KLSH, Kremtimin e 90-Vjetorit të Institucionit, do të hulumtojmë në arkivat dhe shtypin e kohës dhe do të përgatisim Dokumentet e Kryetarëve të KLSH për të gjitha periudhat, duke filluar nga viti i themelimit të institucionit, 1925.

Me krenarinë e ligjshme që të jep puna e realizuar, dua të falënderoj në këtë bilanc katërvjeçar që vjen nëpërmjet këtij botimi, të gjithë trupën e audituesve të KLSH dhe të personelit ndihmës, të cilët kanë kontribuar me përkushtim, ndershmëri e profesionalizëm për të sjellë institucionin tonë në këtë fazë zhvillimi me të ardhme të qartë e të garantuar. Të gjitha materialet (duke përjashtuar dokumentin Nr. 1, Projekt-Idenë për Zhvillimin e KLSH) janë fryt i punës së palodhur të të gjithë audituesve të Institucionit. Ju faleminderit!

BUJAR LESKAJ

KREU I.

Projekt Ide: KLSH, Institucioni më i lartë i kontrollit ekonomiko-financiar të vendit

- **Platformë e paraqitur në cilësinë e kandidatit për Kryetar të KLSH-së në Komisionin për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë,** ***14 Dhjetor 2011***

Projekt Ide: KLSH, Institucioni më i lartë i kontrollit ekonomiko-financiar të vendit [1]

datë 14 dhjetor 2011

Sfidat e kohës së sotme janë tejet kërkuese dhe e vendosin një institucion auditimi, specifikisht Kontrollin e Lartë të Shtetit (KLSH), përballë një sprove të madhe. Në mbarë vendet me ekonomi tregu është bërë përparësi absolute disiplina buxhetore dhe financiare e administrimit publik. KLSH në rolin e tij si institucioni më i lartë i kontrollit ekonomiko-financiar në vend, sidomos i kontrollit të performancës së administrimit dhe financave publike, mbart një përgjegjësi të spikatur për miradministrimin e pronës shtetërore dhe zbatimin e buxhetit të shtetit, nëpërmjet një kontrolli të përdorimit të burimeve në mënyrë ekonomike, me efektivitet dhe eficiencë.

Ndryshimet ekonomiko-politike që ndodhën pas vitit 1990 mundësuan krijimin e një institucioni të auditimit të financave publike sipas formateve që ekzistojnë në vendet me ekonomi tregu. Në kushtet aktuale ku tranzicioni në një ekonomi tregu është në përfundim, në kushtet e një krize ekonomiko-financiare në vendet europiane si dhe në ndjekje të standardeve ndërkombëtare të auditimit, të cilat evoluojnë vazhdimisht, është i domosdoshëm avancimi në një vizion të ri modern për një institucion suprem auditimi.

1. Vizion koherent për KLSH, mbi bazën e eksperiencave më të mira të vendeve të BE-së dhe respektimit rigoroz të standardeve ndërkombëtare të auditimit, INTOSAI.

KLSH duhet të synojë formatimin e punës duke e organizuar atë sipas parimeve të deklaratave të Meksikos (2007) dhe të Johanesburgut (2010), sipas praktikave më të mira të institucioneve simotra në vendet më të përparuara të Bashkimit Europian dhe e mbështetur tërësisht në kornizën e plotë kushtetuese dhe ligjore të vendit. Në punën e tij, KLSH mund dhe duhet të pasqyrojë pesë parimet kryesore të një qeverisjeje të mirë, specifikisht: transparencën, përgjegjshmërinë, efektivitetin, pjesëmarrjen dhe koherencën në veprime. Për ta kryer këtë, ky institucion suprem auditimi (SAI) mund dhe duhet të realizojë më fuqimisht standardet ndërkombëtare të kontrollit, si dhe deklaratat më të fundit të miratuara nga INTOSAI në dy kongreset e saj në Meksikë 2007 dhe në Afrikën e Jugut 2010, duke thelluar përmbajtjen e Deklaratës së Limës të

[1] Ky punim është shkëputur nga materiali i paraqitur nga z. Bujar Leskaj, në cilësinë e kandidatit për Kryetar të KLSH-së, pranë Komisionit për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë, datë 14 Dhjetor 2011, nominuar nga Presidenti i Republikës me dekretin nr. 7163 datë 17 nëntor 2011. Platforma u punua me audituesit e KLSH-së nga Kryetari Bujar Leskaj në ditën e parë të punës më 23 dhjetor 2011.

vitit 1977. Deklarata e Meksikos konsolidoi tetë parimet e pavarësisë së Institucioneve të Larta të Kontrollit si më poshtë:

1. Ekzistenca e një kuadri të përshtatshëm dhe efektiv kushtetues/statutor/ligjor dhe zbatimi "de facto" i tij;
2. Pavarësia e drejtuesve dhe anëtarëve të Institucionit Suprem të Auditimit (SAI), duke përfshirë sigurinë e rezidencës dhe imunitetin ligjor në ushtrimin normal të detyrave të tyre;
3. Një mandat mjaftueshmërisht të gjatë dhe liri e plotë në kryerjen e funksioneve të SAI;
4. Akses të pakufizuar ndaj informacionit;
5. E drejta dhe detyra të raportojnë për punën e tyre;
6. Liria për të vendosur për përmbajtjen dhe kohën e raporteve të auditimit dhe për t'i publikuar dhe shpërndarë ato;
7. Ekzistencën e mekanizmave efektivë që ndjekin rekomandimet e SAI;
8. Autonomi financiare, menaxheriale/administrative dhe pasja e burimeve të duhura njerëzore, materiale dhe monetare.

Në një këndvështrim të tillë, Audituesi Publik duhet të tregojë profesionalizëm dhe integritet në respektimin e këtyre standardeve bazë ndërkombëtare. Ai duhet të thellohet sidomos në zbatimin e kërkesave të Nenit 163 të Kushtetutës dhe në zbatimin e Parimit të Tretë të Deklaratës së Meksikos, i cili kërkon që SAI-t të fuqizohen për të kontrolluar:

- përdorimin e parasë publike, të burimeve ose aseteve nga një mbajtës ose përfitues i tyre, pavarësisht nga natyra ligjore e tyre;
- mbledhjen e të ardhurave nga qeveria ose institucionet e tjera publike;
- ligjshmërinë dhe rregullsinë e llogarive të qeverisë ose institucioneve të tjera publike;
- cilësinë e menaxhimit dhe raportimit financiar; si dhe
- përdorimin e burimeve ne mënyrë ekonomike, efiçiencën dhe efektivitetin e qeverisë ose institucioneve të tjera publike.

FMN, në Kodin e tij të Praktikave të Mira mbi Transparencën Fiskale në vitin 2007, kërkon që politikat dhe rolet menaxheriale të sektorit publik të jenë të qarta dhe të njohura nga publiku. "Financat dhe politikat publike duhet gjithashtu të jenë subjekt i

kontrollit nga një strukturë kombëtare auditimi, e pavarur nga ekzekutivi" (Pika 4.3.1 e Kodit). Nga ana tjetër, Marrëveshjet e Johanesburgut (të njohura edhe si Deklarata e Afrikës së Jugut mbi Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Lartë) në Kongresin e nëntorit 2010 të INTOSAI janë njësoj të rëndësishme për KLSH-në, sepse përqendrohen në vlerën dhe përfitimet nga Institucionet e Larta të Kontrollit, si dhe në sfidat e kohës. INTOSAI ka miratuar në këtë kongres një plan strategjik 2011-2016 me 6 përparësi:

1. Siguro pavarësinë e Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI);
2. Zbato standardet ndërkombëtare, të përmirësuara, të miratuara në Kongresin e 2010-ës;
3. Fuqizo ndërtimin e kapaciteteve të SAI;
4. Trego vlerën dhe përfitimet nga SAI;
5. Çoje më tej luftën kundër korrupsionit;
6. Rrit komunikimin mes vendeve anëtare të INTOSAI-t "(Deklarata e Afrikës së Jugut, nëntor 2010), përparësi të cilat mund dhe duhet të jenë pjesë e planeve strategjike të një institucioni suprem auditimi.

KLSH duhet të përsosë metodologjinë e punës së tij drejt realizimit të një metode auditimi të bazuar gjithnjë e më shumë në vlerësimin e riskut, ç'ka do të rriste efiçiencën dhe do të kursente burimet që aktualisht shpenzohen gjatë auditimeve tradicionale. Është i domosdoshëm përqendrimi në kualifikimin dhe specializimin e audituesve (specializim sipas llojeve të auditimeve dhe sipas sektorëve) duke përmirësuar trajnimin dhe duke vendosur një sistem të edukimit të vijueshëm në vendin e punës. Kërkesat e Ligjit organik të Buxhetit dhe të Ligjit për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, si dhe ligje të tjera, të cilat plotësojnë procedurat e administrimit të pronës shtetërore dhe të raportimit financiar, do ta fokusojnë më mirë punën e KLSH-së në vlerësimin e mënyrës së administrimit dhe të përdorimit të burimeve. Objektivat e një plani zhvillimi duhet të ndërtohet mbi përparësitë e rezolutave më të fundit të INTOSAI në Meksiko dhe në Afrikën e Jugut, duke realizuar Prioritetin e Tete të 12 Rekomandimeve të Komisionit Europian ndaj Shqipërisë, të përmbajtura në Progres Raportin e KE-së për vitin 2011 për thellimin e luftës ndaj korrupsionit, sipas të cilit "kërkohet të tregohet një zbatim efiçient i strategjisë dhe planit të veprimit antikorrupsion" (Progres Raporti i KE-së për Shqipërinë 2011, f. 28).

Nga ana tjetër, Marrëveshja e Stabilizim Asocimit me BE shtron detyrën: "Bashkëpunimi mes Palëve do të përqendrohet në fushat prioritare që lidhen me

legjislacionin e Komunitetit në fushat e kontrollit të brendshëm financiar publik (KFBP) dhe auditimit të jashtëm. Palët do të bashkëpunojnë në mënyrë të veçantë për të zhvilluar një sistem efikas të KFBP (Kontrolli Financiar i Brendshëm Publik) dhe sisteme të auditimit të jashtëm në Shqipëri, në përputhje me standardet dhe metodologjitë e pranuara botërisht si edhe me praktikat më të mira të BE-së" (Neni 90 i MSA). Në këtë drejtim, KLSH do të forcojë bashkëpunimin dhe ndërveprimin me institucionet e BE-së dhe partnerë të rëndësishëm si SIGMA, duke synuar të përfitojë maksimalisht nga mbështetja e tyre, për ta përputhur në mënyrë të plotë aktivitetin e institucionit me standardet e kërkuara nga BE për një institucion suprem auditimi. Një rëndësi të veçantë në performancën e auditimit publik ka rritja e bashkëpunimit me SIGMA-n, me qëllim që nëpërmjet proceseve të asistencës dhe rishikimit të jashtëm (Peer Review) të ndihmohet zhvillimi strategjik i KLSH-së me vektor praktikat më të mira të vendeve anëtare të BE-së.

2. Thellim i misionit të KLSH-së në luftën kundër korrupsionit dhe abuzimeve në administrimin e pronës publike

KLSH gjatë viteve të fundit është përpjekur të japë kontributin e tij për zbulimin dhe evidentimin e korrupsionit dhe abuzimeve në shumë nga institucionet shtetërore të kontrolluara. Megjithatë, të gjithë jemi të ndërgjegjshëm se jo gjithmonë janë arritur rezultatet e synuara, si për dobësi të vetë Institucionit, ashtu dhe për faktorë të tjerë jashtë tij. Në këtë aspekt, mbetet ende shumë për të bërë. Funksioni parandalues i KLSH-së ndaj korrupsionit dhe abuzimit, nëpërmjet analizës së riskut dhe kontrolleve të bazuara mbi këtë analizë, si dhe auditim i performancës kanë lënë gjithashtu shpesh herë për të dëshiruar. Për kushtet ku sot zhvillohet ekonomia, mes presioneve të forta nga kriza dhe vështirësitë ekonomike të vendeve përreth, misioni parandalues ndaj korrupsionit dhe abuzimeve ndaj ekonomisë shtetërore merr një rol të rëndësishëm, duke ditur masën e madhe të dëmit që shkakton mashtrimi financiar dhe korrupsioni, si dhe fokusin që ka marrë sot lufta kundër korrupsionit. Luftën pa kompromis ndaj korrupsionit e shtron edhe parimi Nr. 5 (Çoje më tej luftën kundër korrupsionit) i Deklaratës së INTOSAI në Johanesburg në vitin 2010, si dhe Rekomandimi nr. 8, i Komisionit Evropian për integrimin e Shqipërisë. Kjo përpjekje ka përparësi edhe në vendet më të zhvilluara dhe demokratike të Evropës. Kështu, sipas Zyrës Kombëtare të Auditimit(NAO) në Britaninë e Madhe "Puna jonë me luftën ndaj mashtrimit financiar na lejon të përgatisim një perspektivë unike në uljen e kostos së korrupsionit për ekonominë e Britanisë së Madhe. Ne e vlerësojmë koston e korrupsionit dhe mashtrimit financiar në më shumë se 30 miliardë paund në vit. Ne inkurajojmë përhapjen e praktikave më të mira dhe një kuptim më të gjerë të rreziqeve të këtyre dukurive mbi ekonominë, si një mënyrë të punuari për të ulur dëmin që sjellin këto dukuri" (NAO,

Botimi "Praktika të mira në trajtimin e korrupsionit dhe mashtrimit financiar", f. 4, 2008).

Konferenca Ndërkombëtare e AntiKorrupsionit, e zhvilluar në Afrikën e Jugut, 12 vite më parë (tetor 1999), hodhi bazat e një përafrimi efektiv në punën parandaluese të institucioneve të auditimit të lartë ndaj korrupsionit dhe abuzimeve. Në dokumentin e saj kryesor, të titulluar "Roli i Institucioneve Supreme të Auditimit në Luftën kundër Korrupsionit", thuhet se "Institucionet Supreme të Auditimit (SAI) ranë dakord se është e vështirë të zbulosh format e shumta të korrupsionit, duke qenë se humbja dhe dëmi i shtetit nuk del domosdoshmërish në regjistrat e llogarive ose në deklaratat financiare të subjektit që kontrollohet". Megjithatë, treguesit statistikorë dëshmojnë për një lidhje mes treguesve të ndryshëm të financave publike dhe nivelit të perceptuar të korrupsionit. Prandaj dhe ISA bien dakord që ligjet dhe rregullimet, së bashku me kontrollin e duhur, mund të parandalojnë dhe zvogëlojnë mashtrimin financiar dhe korrupsionin. Shembuj të sektorëve veçanërisht të ekspozuar ndaj korrupsionit janë:

- mbledhja e taksave dhe e burimeve të tjera të të ardhurave;
- administrimi i tenderëve, prokurimeve dhe kontratave;
- koncesionet, lejet dhe liçensat;
- marrja në punë e personelit të administratës;
- doganat; dhe
- procesi i privatizimit ("Roli i Institucioneve Supreme të Auditimit në Luftën kundër Korrupsionit", f. 4, 1999). KLSH duhet të thellojë analizën e vet të riskut në auditimin financiar pikërisht në këta sektorë, duke e fuqizuar dhe e kombinuar rolin e tij luftues ndaj korrupsionit me rolin parandalues, të cilin duhet ta ushtrojë fuqimisht.

Magnus Borge, drejtor i Iniciativës së Zhvillimit të INTOSAI dhe botues i dokumentit të mësipërm, shprehet në qershor 2008 se "roli qendror i ISA në luftën ndaj korrupsionit është promocioni i menaxhimit financiar të shëndoshë dhe inkurajimi i mekanizmave të fortë të kontrollit të brendshëm në strukturat publike. Në veçanti, sisteme të fuqishëm të menaxhimit financiar, të bazuar në raportimin financiar efektiv dhe në publikimin e çdo deviacioni kanë një efekt ndalues tek ata që tentojnë të kryejnë korrupsion". Sipas Konferencës Ndërkombëtare të Anti-Korrupsionit në Afrikën e Jugut, "Institucionet Supreme të Auditimit (SAI) ndjekin disa praktika në identifikimin e fushave me rrezik të lartë korrupsioni dhe abuzimi, që nga rishikimi i punës së auditit të vitit të kaluar tek vlerësime sistematike të dobësisë së programeve, projekteve apo

institucioneve, të bazuara nga histori abuzimi të së kaluarës, nga dobësia menaxheriale ose nga denoncimet e mediave. Këto dy përafrime përfaqësojnë koncepte të ndryshme të vlerësimit të riskut. Në përafrimin e parë, programet, projektet dhe institucionet renditen me risk të ulët, të mesëm dhe të lartë për të përcaktuar një plan auditimi. Kjo i lejon institucionit të auditimit suprem të alokojë burime tek institucioni apo programi vulnerabël, duke ndërtuar edhe procedura auditimi shtesë, nëse do të ishte e nevojshme. Pothuajse gjithnjë auditimet në subjekte me risk të lartë kanë identifikuar aktivitet korruptiv dhe abuziv domethënës.

Përafrimi i dytë përqendrohet në sektorë e fusha veprimtarie, më shumë se sa në institucione e projekte të veçanta qeveritare dhe shtetërore. Ai bëhet baza e një strategjie për të targetuar sektorin që u jep një kërcënim të fortë burimeve publike dhe për të synuar pakësimin ose eliminimin e këtij kërcënimi“ (Magnus Borge, “Roli i Institucioneve Supreme të Auditimit në luftën ndaj korrupsionit”, dokumente përmbledhëse të Konferencës Ndërkombëtare të AntiKorrupsionit në Afrikën e Jugut, f. 16, 1999). Mendoj se këto përafrime kanë vlerë aktuale për veprimtarinë e KLSH-së dhe duhet të përqendrojnë vëmendjen e stafit të saj. Lufta ndaj korrupsionit dhe roli parandalues i KLSH-së ndaj veprimeve korruptive dhe abuzive me pronën shtetërore do të jenë politika dhe veprime qendrore në Strategjinë e zhvillimit të institucionit 2012-2015, vijim i strategjisë së tanishme 2009- 2012, duke përsosur metodologjinë e kontrollit.

3. Kthim i vëmendjes tek auditimi i performancës, krahas konsolidimit të auditimit financiar

Deri tani audituesi publik në Shqipëri ka prevaluar auditimin financiar, duke u përqendruar me shumë në kontrollin e mbajtjeve të llogarive dhe në disiplinën financiare, pa konsideruar me përparësi treguesit e efektivitetit, efiçiencës dhe rezultatin ekonomik të institucionit shtetëror objekt i kontrollit.

Sipas INTOSAI, auditimi i performancës përkufizohet si:

a) auditimi i përdorimit ekonomik të burimeve në aktivitetet administrative, në përputhje me parime dhe praktika administrative të shëndosha, si dhe me politikat e duhura menaxheriale;

b) auditimi i efiçiencës së përdorimit të burimeve njerëzore dhe financiare, si dhe të burimeve të tjera, duke përfshirë ekzaminimin e sistemeve të informacionit, treguesve të performancës dhe të sistemit të monitorimit, dhe

c) auditimi i efektivitetit të performancës në lidhje me përmbushjen e objektivave të subjektit të kontrolluar, si dhe auditimi i impaktit aktual të aktiviteteve, i

krahasuar me impaktin e synuar"(INTOSAI, "Manual Zbatimi për Auditimin e Performancës", f. 3, 2004).

Sipas eksperiencës britanike, "matja e performancës është kuptimi i asaj çfarë marrim për paranë që shpenzojmë". Punonjësi, audituesi i performancës duhet të jetë i gatshëm të ndihmojë kolegët e institucionit qeveritar që kontrollon për t'i orientuar në:

- zhvillimin e planeve dhe treguesve të performancës;
- përmirësimin e cilësisë së të dhënave;
- regjistrimin e performancës dhe raportimin ndaj drejtuesve dhe publikut;
- përdorimin e masave të performancës për të përmirësuar apo motivuar performancën;
- lidhjen e performancës me vendimet e alokimit të burimeve;
- kryerjen e vlerësimeve organizative (Manual i NAO "Matja e performancës qeverisëse, 2010", f. 28, qershor 2010). Sipas z. Amyas Morse, Kryetar i Zyrës Kombëtare të Auditimit (NAO), Britani e Madhe, "Matja e performancës së qeverisë është jetësore. Tregon nëse taksapaguesi po merr vlerë për paranë dhe i lejon njësive qeveritare të mësojnë nga eksperienca dhe të përmirësojnë performancën. Çdo tregues matjeje performance duhet të jetë i qartë, i matshëm dhe drejtpërsëdrejti i lidhur me burimet e përdorura për të siguruar shërbimet apo produktet e performancës" (nga fjala e z. Morse mbajtur më 14 korrik 2010 përpara Dhomës së Lordëve). Ky aspekt i matjes së performancës së institucioneve që kontrollon mund të shndërrohet në dobinë kryesore të punës së KLSH-së, krahas parandalimit të korrupsionit dhe abuzimeve.

Ndarja e detyrave në të mund të çojë në të ardhmen e afërt dhe në një specializim të një pjese të inspektorëve të KLSH në auditues performance, ku roli korrigjues, orientues dhe këshillues mbizotëron.

Auditimi, nëse aktivitetet administrative janë bërë në mënyrë ekonomike ka për qëllim të vlerësojë nëse ato janë në pajtim me parimet bazë dhe praktikat me të mira të administrimit dhe në pajtim me politikat e pranuara te drejtimit në ekonomi.

Auditimi i efiçiences, ka për qëllim të vlerësojë përdorimin eficent të burimeve financiare dhe burimeve të tjera; ai përfshin edhe ekzaminimin e sistemeve të informacionit, vlerësimin e matësve të performancës dhe sistemet e monitorimit dhe procedurat që duhet të ndjekin entitetet e audituara për të korrigjuar mangësitë e vërejtura. Auditimi i efektivitetit ka për qëllim të vlerësojë efektivitetin e performancës,

në lidhje me arritjen e objektivave të entitetit të audituar dhe gjithashtu, edhe ndikimin (impaktin) aktual të aktiviteteve krahasuar me ndikimin e parashikuar.

Auditimi i performancës nuk është një auditim i rregullt (pra që kryhet me procedura e standarde të përcaktuara) dhe që përfundon me një opinion të formalizuar. Rrënjët e tij nuk lidhen me auditimin e entiteteve private. Ai konsiderohet një ekzaminim i pavarur që nuk bëhet mbi një bazë që ripërsëritet. Për nga natyra, ky auditim është më i gjerë dhe i hapur për gjykime dhe interpretime. Në dispozicion të tij ka një varg metodash të zgjedhjes për investigimin dhe vlerësimin dhe nga ana tjetër ai kërkon një varietet të madh të njohurive, krahasuar me ato që kërkohen për auditimin tradicional. Thënë ndryshe, auditimi i performancës i shërben vlerësimit të përgjegjshmërisë publike, e cila nënkupton faktin që individët që janë përgjegjës për zbatimin e programeve qeveritare ose drejtimin e ministrive kanë përgjegjësinë për drejtimin e tyre me efektivitet dhe efiçiencë. Auditimi i performancës është një mënyrë për ushtrimin e kontrollit dhe marrjen e informacionit mbi mënyrën e drejtimit dhe rezultatet e aktiviteteve të ndryshme qeveritare nga veprimtarët kyçë, ku përfshihen: taksapaguesit, Parlamenti, drejtuesit ekzekutivë, qytetarët e zakonshëm, shoqëria civile dhe media.

Auditimi i performancës shërben për t`ju dhënë përgjigje pyetjeve si: A merret shërbimi më i mirë nga paratë e shpenzuara? A është e mundur që paratë të shpenzohen më mirë ose në një mënyrë më të zgjuar?

Auditimi i performancës është i lidhur ngushte me mirëqeverisjen. Kriteri kryesor i qeverisjes së mirë është pikërisht fakti që të gjitha shërbimet publike (ose programet qeveritare) t'i nënshtrohen auditimit.

KLSH është përpara një sfide të fortë për ta përqendruar punën tek auditimi i performancës, pse ai i shërben vlerësimit të përgjegjshmërisë publike. Përqendrimi i vëmendjes tek auditimi i performancës do të jetë ndër shtyllat kryesore të planit të ri strategjik 2012- 2015 të KLSH. Në të, manuali i auditimit të performancës do të zbatohet jo thjesht si një procedurë, por do të konceptohet si një filozofi e të menduarit dhe vepruarit nga i gjithë stafi i KLSH. Një filozofi pune që konsideron se kontrolli nuk është një qëllim në vetvete, por në radhë të parë një instrument parandalimi ndaj korrupsionit dhe abuzimit me pronën shtetërore, një instrument korrigjimi dhe këshillimi të institucionit që kontrollohet. Së bashku me audituesit e brendshëm të institucioneve shtetërore, në bazë të Ligjit Nr. 9720 dt. 23.04.2007 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik" , si dhe me inspektorët financiarë publikë të Ministrisë së Financave, në bazë të Ligjit Nr. 10294 dt. 01.07.2010 "Për Inspektimin Financiar Publik", KLSH do të koordinojë punën e auditimit financiar, për të mos patur dublime të panevojshme, duke u përqendruar vetë si institucion tek auditimi financiar, dhe shumë herë më tepër se sa tani, tek auditimi i performancës.

4. Realizim i sinergjizimit të politikave dhe veprimeve me strukturat e tjera shtetërore të së njëjtës fushë, si me Departamentin e Anti-Korrupsionit pranë Kryeministrisë, me Drejtorinë e Përgjithshme të Auditimit dhe me Drejtorinë e Inspektimit Financiar Publik pranë Ministrisë së Financave dhe në veçanti me Prokurorinë e Shtetit, duke ruajtur pavarësinë e KLSH, si organi më i lartë i kontrollit ekonomiko-financiar.

Praktika e deritanishme ka dëshmuar se KLSH ka humbur efektivitetin e ndërhyrjeve të tij në rastet kur ka vepruar i vetëm, ose kur e ka konceptuar veprimtarinë e tij veçmas nga institucionet e tjera të ngjashme me të. Prej kohësh tashmë ka lindur nevoja e një bashkëveprimi konkret dhe intensiv me struktura shtetërore që kryejnë detyra të afërta me një pjesë të detyrave të KLSH, si Departamenti për Luftën ndaj Korrupsionit në Këshillin e Ministrave, Drejtoria e Përgjithshme e Auditimit dhe Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik pranë Ministrisë së Financave, apo edhe që vijojnë punën pas propozimeve të KLSH, sikurse është Prokuroria e Shtetit, si organ qendror i akuzës së Shtetit.

Strategjia Anti-Korrupsion 2008-2013 e qeverisë Berisha kërkon një bashkëpunim më të ngushtë të institucioneve kryesore që e luftojnë korrupsionin, të bazuar në angazhime të përbashkëta të institucionalizuara dhe pikërisht: "Shkëmbimin e informacionit, jo vetëm ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit, por të çdo organi shtetëror që luan rol dhe ka përgjegjësi në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, i cili synon shkëmbimin e informacionit jo si pjesë e detyrimit e përgjegjësisë ligjore e institucionale të zakonshme, por mbi baza funksionale, proaktive dhe me periodicitet më të shpejtë" (f. 16, Strategjia Ndërsektoriale e Parandalimit, Luftës kundër Korrupsionit dhe Qeverisjes Transparente 2008-2013).

Duhet theksuar se KLSH nuk i cenohet pavarësia kur sinergjizon politikat dhe veprimet e tij me institucionet e lart përmendura, por përkundrazi i rritet efektiviteti dhe efiçienca e tij, në përmbushjen e detyrimeve kushtetuese.

Unë, në rast se votëbesohem nga Ju, do të propozoj dhe do të kërkoj menjëherë realizimin e një bashkëveprimi institucional, nëpërmjet Memorandumeve të Bashkëpunimit me të katër strukturat e lartpërmendura. Për këtë ekziston baza ligjore e duhur. Për shembull, Neni 26 i Ligjit Nr. 9720, datë 23.04.2007 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik" e kërkon shprehimisht bashkëpunimin me KLSH, si dhe po ashtu edhe Neni 8, pika "d" e Ligjit Nr. 10294, datë 01.07.2010 "Për Inspektimin Financiar Publik". Në këto marrëveshje, krahas shkëmbimit reciprok të

informacionit, nëse do të gjykohet në dobi të punës, mund të planifikohen dhe ndërhyje e kontrolle të përbashkëta(sidomos për tre strukturat e para), për të rritur efektivitetin dhe efiçiencën e auditimit.

Një përqasje e tillë është një praktikë pune e hasur dendur në vendet më të zhvilluara të BE-së anëtare të INTOSAI (p.sh., Zyra Kombëtare e Auditimit në Britaninë e Madhe për parandalimin e korrupsionit dhe mashtrimit financiar bashkëpunon me Autoritetin Kombëtar të Parandalimit të Mashtrimit Financiar dhe me Komisionin Britanik të Auditimit. Të njëjtin bashkëpunim realizon *Bundesrechnungshof*-i gjerman, organi suprem i auditimit në Republikën Federale të Gjermanisë, me gjykatat rajonale gjermane).

Një bashkëpunim i veçantë lypset të jetë ai i KLSH me organin e Prokurorisë së Shtetit, duke parë rastet shumë të rralla të deritanishme, kur denoncimet dhe rekomandimet e KLSH kanë gjetur jehonë në punën e Prokurorisë. Një aktmarrëveshje, një memorandum bashkëveprimi me këtë institucion do t'i hapte rrugë jo vetëm thellimit të njohjes reciproke mes të dyja institucioneve, por edhe kuptimit më të mirë të natyrës së punës së njëra-tjetrës dhe rritjes së informacionit dhe kanaleve të komunikimit dhe bashkëpunimit. Shpesh mungesa e informacionit dhe e komunikimit në nivelet e duhura, ka bërë të dështojnë përpjekjet për bashkëpunim. Ju garantoj se nëse ka ndonjë draft apo marrëveshje me Prokurorinë, ai do të shpluroset dhe do të marrë formën e duhur të një bashkëpunimi konkret dhe intensiv në të ardhmen e afërt. Nëse nuk ka, kjo marrëveshje do të jetë ndër veprimet e para që do të ndërmerren.

Nga ana tjetër, rezultatet e kontrolleve të kryera nga grupe të përbashkëta me institucionet e lartpërmendura, ose të mbikëqyrura apo konfirmuara nga ekspertë të institucioneve paralele janë të mirëpritura dhe pse mbartin një peshë më të madhe në publik dhe japin mesazhin e fuqishëm të angazhimit të përbashkët të të gjitha strukturave shtetërore për luftën ndaj korrupsionit dhe abuzimeve me administrimin e pronës shtetërore.

5. Intensifikim i konsultimeve me Komisionin për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë për përafrimet strategjike të KLSH 2011-2018, në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimit ndaj Kuvendit, si një detyrim kushtetues.

Në zbatim të neneve 162 dhe 164 të Kushtetutës dhe të detyrave të lëna nga Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë, datë 02.06.2011 për konsolidimin e bashkëpunimit me Kuvendin, në përmirësimin e akteve ligjore e nënligjore, veçanërisht të ligjit për Kontrollin e Lartë të Shtetit, në përmirësimin e administrimit të vlerave materiale e monetare dhe rritjen e shkallës së zbatimit të rekomandimeve të institucionit, KLSH do të organizojë dhe mbajë gjithnjë operativ një kalendar takimesh e konsultimesh me përfaqësues të Kuvendit, sidomos me Ju, anëtarë të Komisionit për Ekonominë dhe

Financat. Bazuar në përvojën tuaj si legjislatorë dhe profesionistë të fushës, KLSH do t'ju adresohet në vijimësi për ide dhe sugjerime lidhur me përpilimin dhe zbatimin e planit të tij strategjik të zhvillimit 2012-2015. Ky plan do të vlerësojë përpjekjet e Planit Strategjik 2009-2012 në drejtim të përmirësimit të kuadrit ligjor, të përsosjes së metodologjisë së kontrollit, të rritjes së burimeve njerëzore dhe të mbështetjes administrative, përfshirë teknologjinë e informacionit, por do të thellohet në rekomandimet e kongreseve të fundit të INTOSAI, të cilat mendoj se nuk njihen sa duhet(duke u nisur dhe nga pasqyrimi në website-in e KLSH).

Në zbatim të detyrimit kushtetues, KLSH do të shërbejë tërësisht si struktura numër një dhe më e besueshme e informimit të Kuvendit për miradministrimin e pronës shtetërore, si për shumicën ashtu dhe për pakicën parlamentare, nëpërmjet raporteve periodike të saj dhe takimeve e konsultimeve të herëpashershme me anëtarët e Kuvendit, por sidomos të Komisionit tuaj. Informimi kushtetues dhe ligjor ndaj Kuvendit do të shtrihet me efektivitet dhe profesionalizëm edhe drejt publikut.

6. Intensifikim i bashkëpunimit me ekspertët universitarë dhe akademikë të auditimit të financave publike, si dhe me organizata të kontabilitetit dhe të fushave të tjera të ekonomisë

Mbështetur në nenin 15 të Ligjit organik të KLSH-së, i cili shprehet se ky institucion mund të kontraktojë ekspertë të përkohshëm. KLSH, për vete sfidat qe e presin ka nevojë të grumbullojë pranë vetes ekspertizën më të mirë të fushës, duke forcuar lidhjet dhe madje duke i vendosur ato në baza institucionale me organizatat e kontabilistëve, me ekspertët dhe profesoratin e financave publike në universitetet kryesore të vendit dhe me akademikët e kësaj fushe. KLSH duhet të ketë lidhje dhe të zhvillojë konsultime të herëpashershme për veprimtarinë e saj me IEKA dhe me organizatat e tjera profesionale të fushës. Kjo nuk përbën aspak nënvleftësim ndaj ekspertizës së vetë institucionit, por do të jetë në dobi të rritjes së profesionalizmit të stafit të KLSH, për të përballuar me efektivitet auditimet e rëndësishme, në veçanti atë të performancës. Bashkëpunimi mund të jetë shumëformësh, duke i ftuar këta ekspertë si lektorë në trajnimet e stafit të KLSH, duke i angazhuar në grupet e kontrollit, apo në kontrollet e performancës së sektorëve të caktuar të ekonomisë, me risk të lartë, si dhe për testimin e vetë stafit të KLSH. Ekspertiza e fituar prej tyre ka vlerë si mendim i pavarur dhe i një niveli të lartë profesional. Një përqasje të tillë e rekomandon edhe FMN në Kodin e tij të Praktikave të Mira mbi Transparencën Fiskale (Pika 4.3.4 faqe 4 e Kodit), kur thotë se "ekspertë të pavarur duhet të ftohen për të vlerësuar parashikimet fiskale...".

Sfidat e reja e bëjnë të domosdoshëm rritjen e kapaciteteve të audituesve të KLSH. Të gjithë jemi të ndërgjegjshëm se niveli i tyre profesional nuk është ai i duhuri, pavarësisht nga përpjekjet e bëra, duke u nisur që nga viti 1992.

7. Intensifikimi i bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare INTOSAI dhe EUROSAI, me institucionet e larta të auditimit të vendeve të BE-së, të vendeve të rajonit dhe në veçanti me Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës

Deklarata e Johanesburgut(2010) e INTOSAI-t i ka kushtuar një pikë të veçantë të saj(pika 6) bashkëpunimit mes Institucioneve Supreme të Auditimit të vendeve anëtare. Është për t'u vlerësuar bashkëpunimi i deritanishëm i KLSH me Zyrën Kombëtare të Auditimit në Britaninë e Madhe dhe me Gjykatën Holandeze të Auditimit në përgatitjen e planeve strategjike. Ky bashkëpunim duhet vijuar dhe thelluar edhe më tej, në formën e vizitave të shkëmbimit të eksperiencës dhe/ose të trajnimeve që ekspertë të SAI-ve të këtyre vendeve dhe të shteteve të tjera të zhvilluara në BE, ose të Komitetit të Trajnimeve në EUROSAI, mund të zhvillojnë për stafin e KLSH.

Do të intensifikohen kontaktet dhe mundësitë e bashkëpunimit me Institutin e Zhvillimit të INTOSAI dhe me strukturat e EUROSAI, sidomos për luftën kundër korrupsionit. Do shihen mundësitë e bashkëpunimit me Gjykatën Europiane të Audituesve, e cila mbikëqyr auditin e jashtëm të vendeve të BE-së, sidomos për rritjen e nivelit të audituesve të performancës. Gjykata ka fuqinë të kontrollojë çdo person ose organizatë që përdor fonde të Bashkimit Evropian, duke përfshirë autoritetet kombëtare në vendet anëtare të BE, institucione të tjera të BE dhe madje edhe vende të tjera jashtë BE që përfitojnë nga fondet e BE. Sipas Vitor Caldeira, President i Gjykatës Europiane te Audituesve, "Gjykata kryen auditime, nëpërmjet te cilave ajo vlerëson mbledhjen dhe shpenzimin e fondeve te BE-së. Ajo ekzaminon nëse veprimet financiare janë regjistruar si duhet dhe deklaruar, nëse ato janë kryer në mënyrë ligjore dhe në bazë të rregullave dhe nëse janë menaxhuar për të siguruar përdorimin me ekonomi te fondeve, efiçiencën dhe efektivitetin e tyre. Gjykata promovon përgjegjësinë dhe transparencën duke ndihmuar Parlamentin Europian dhe Këshillin e Europës që ata të mbikëqyrin zbatimin e buxhetit te BE-së...Ajo i sjell vlerë të shtuar menaxhimit financiar të BE-së nëpërmjet raporteve dhe opinioneve të saj. ...Kjo Gjykatë njihet për integritetin dhe paanësinë, për profesionalizmin, efiçiencën dhe cilësinë e auditimeve dhe opinioneve të saj. Hyrja ne fuqi e Traktatit te Lisbonës riafirmoi mandatin e Gjykatës dhe statusin si një institucion qendror i BE-se"(nga fjala e mirëseardhjes marrë në website-in e Gjykatës, 2010).

Gjykata Europiane e Audituesve, krahas raporteve të saj të kontrollit financiar, jep mendime dhe rreth legjislacionit financiar të BE dhe veprimit të BE për të luftuar korrupsionin dhe mashtrimin financiar, duke bashkëpunuar me Zyrën Evropiane të Antikrimit Financiar. Në rajon, KLSH do të zhvillojë më tej kontaktet rajonale me

strukturat homologe të rajonit, si dhe do të thellohet marrëdhënia me Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës(deri tani në website-in e KLSH gjendet vetëm një vizitë e kësaj Zyre në mars 2008), duke dhënë dhe shkëmbyer eksperiencë, si dhe duke kryer trajnime të përbashkëta. Mendoj se krahas marrjes së eksperiencës nga SAI të vendeve më të zhvilluara të BE-së dhe nga ato të vendeve të rajonit, kemi shumë për të bashkëpunuar reciprokisht me strukturën e re të auditimit suprem të Kosovës.

8. Zhvillim i burimeve njerëzore të KLSH në nivelin e parametrave të kërkuar nga standardet e INTOSAI (Rezoluta e Meksikos 2007 dhe e Afrikës se Jugut 2010) dhe në përputhje me sfidat për të luftuar me efektivitet korrupsionin

Rezoluta e Kryetarëve të Institucioneve të Auditimit Suprem të vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore, si dhe të Gjykatës Europiane të Audituesve në takimin e tyre në Pragë në tetor 1999, në Rekomandimin e saj të Shtatë shprehet: "Institucionet e Larta të Kontrollit(SAI) duhet të sigurojnë se burimet e tyre njerëzore dhe financiare përdoren në mënyrë efiçiente për të mundësuar ushtrimin më efektiv të mandatit të tyre. Për këtë qëllim, SAI-t kanë nevojë të zhvillojnë dhe institucionalizojnë politika dhe masa të duhura për të garantuar që Institucioni Suprem i Auditimit të jetë tërësisht i organizuar për të prodhuar punë auditi dhe raporte efektive profesionale dhe të një cilësie të lartë". Cilësia dhe profesionalizmi do të jenë fjalët kyçe të punës së çdo anëtari të stafit të KLSH, mbas integritetit dhe pavarësisë. Audituesi i KLSH do t'i largohet klishesë së gjobëvënësit apo deklarimeve për bujë, një formatim ky i hasur shpesh, për fat të keq, në të shkuarën. Ç'ka është më e rëndësishme, KLSH do t'i largohet "zbulimeve" të shpërdorimeve hipotetike. Çdo nëpunës i KLSH do të vlerësohet për punën e tij/saj mbi kritere të sakta dhe të qarta profesionale dhe integrale, duke respektuar kërkesat e Ligjit Nr. 8549, datë 11.11.1999 "Për Statusin e Nëpunësit Civil", Ligjin 9131 datë 08.09.2003 "Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike" dhe Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike".

Do të realizohet përshkrimi i ri i punës së secilit, i bazuar mbi standardet INTOSAI për punonjësit e institucioneve supreme të auditimit, të përmbajtura në dy Deklaratat e fundit Meksiko 2007 dhe Johanesburg 2010, me synimin e sigurimit të audituesve dhe nëpunësve me integritet të lartë moral dhe profesional, të varur vetëm nga Kushtetuta, ligji dhe Kodi i Etikës i KLSH. Në bashkëpunim me Fakultetin e Ekonomisë së Universitetit të Tiranës dhe me universitetet e tjera të vendit, KLSH do të organizojë një konferencë vjetore për të sjellë mendimin më të avancuar në fushën e auditimit financiar dhe atij të performancës, mbi bazën dhe të eksperiencave konkrete, duke promovuar specialistët më të zotë dhe rezultativë të tij. Mbi bazën e Nenit 20 të Ligjit organik të

KLSH për trajnimin e audituesve, të gjithë audituesit e institucionit do të trajnohen në vijimësi për të përmbushur detyrat e tyre në mënyrë profesionale dhe duhet ta gjejnë veten në respektimin rigoroz të standarteve të etikës së audituesit dhe të standardeve ndërkombëtare INTOSAI.

9. Përmirësim i transparencës në marrëdhëniet me publikun, nëpërmjet një partneriteti të gjerë me median dhe me organizatat jo-fitimprurëse që luftojnë korrupsionin

Sipas Magnus Borge, Drejtori i Institutit të Zhvillimit të INTOSAI, roli luftues dhe parandalues ndaj korrupsionit për SAI-t rritet shumë dhe me bashkëpunimin e tyre efikas me mediat. "SAI-t mund të luajnë një rol të madh në luftën ndaj korrupsionit, duke komunikuar dhe bërë publike rreziqet e korrupsionit dhe rastet e praktikave korruptive, kur këto janë identifikuar. Ky rol përfshin rritjen e ndërgjegjësimit publik për rëndësinë e transparencës dhe të përgjegjësisë së mbajtjes së llogarive, duke prodhuar raporte auditimi me vlerë dhe në kohën e duhur, të cilat aksesohen nga publiku ("Roli i SAI në luftën kundër korrupsionit", broshurë e përbashkët e INTOSAI me Transparency International, 2008). Borge po ashtu vëren se disa SAI kanë vendosur lidhje me mediat për të deklaruar në publik rastet e mashtrimit financiar dhe korrupsionit. Ky përafrim duhet të jetë në fokus të punës së përditshme të KLSH me mediat dhe organizatat jo-fitimprurëse që luftojnë korrupsionin. KLSH ka nevojë të fitojë akses në publik dhe për këtë i duhet:

a) të transformojë rrënjësisht faqen e saj në internet, duke vendosur lidhje(links) me strukturat e tjera shtetërore që luftojnë korrupsionin dhe pse jo, dhe me OJF-të aktive në këtë fushë;

b) të furnizojë periodikisht me informacion rrjetet e mediave elektronike dhe të shtypit të përditshëm, të interesuara për mirëmenaxhimin e pronës publike;

c) të bashkëpunojë si partner në botimin e revistave profesionale të fushës, duke kontribuar me kumtesa dhe ese nga anëtarët më aktivë të stafit të tij;

d) të rrisë aksesin e buletinit periodik të KLSH në aktorët kryesorë të opinionit publik, si mediat, opinionistët dhe OJF-të e angazhuara kundër korrupsionit dhe/ose të interesuara për bashkëpunim.

KLSH ka nevojë parësore për një investim të plotë në kuptimin e tërësishëm nga publiku të misionit të tij dhe të aktiviteteve që kryen, si dhe në përmirësimin e imazhit aktual. Për këtë do të përgatisim një strategji komunikimi 2012-2015, që të synojë rritjen e aksesit dhe kuptimin e plotë në publik të misionit dhe rolit të KLSH, si luftues dhe parandalues i korrupsionit dhe i abuzimeve me pronën shtetërore, si dhe të rolit të tij

orientues dhe ndreqës në performancën e institucioneve publike që kontrollon. Një strategji e tillë do të pajiset me një plan konkret veprimi 2012-2015, duke mundësuar tryeza të rrumbullakëta informacioni dhe konsultimi me OJF-të që luftojnë korrupsionin dhe/ose të interesuara për bashkëpunim, si dhe me media.

KREU II.

Raportimet e Kryetarit të KLSH-së në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave

- Rezoluta e Kuvendit dhe reflektimi në veprimtarinë e KLSH-së *(Prezantimi i Raportit të Performancës së KLSH-së për vitin 2011)*
- Të përcaktohet kufiri për totalin e borxhit shtetëror dhe borxhit të garantuar *(Prezantimi i Raportit të Zbatimit të Buxhetit Faktik të vitit 2011)*
- Zhvillimi i KLSH sipas drejtimeve strategjike të EUROSAI-t *(Prezantimi i Raportit të Performancës së KLSH-së për vitin 2012)*
- Vendosja ne Kushtetutë e një kufiri për Borxhin Publik dhe shlyerja e detyrimeve ndaj biznesit *(Prezantimi i Raportit të Zbatimit të Buxhetit Faktik të vitit 2012)*
- Auditimi Kombëtar në shërbim të qeverisjes kombëtare *(Prezantimi i Raportit të Performancës së KLSH-së për vitin 2013)*
- Ngritja e një Këshilli të Pavarur Fiskal-detyrë imperative e kohës *(Prezantimi i Raportit të Zbatimit të Buxhetit Faktik të vitit 2013)*
- Korniza e Matjes së Performancës së një SAI dhe palët e interesit *(Prezantimi i Raportit të Performancës së KLSH-së për vitin 2014)*
- Për një respektim rigoroz të treguesve të Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020 (*Prezantimi i Raportit të Zbatimit të Buxhetit Faktik të vitit 2014)*
- SAI nuk harton politika, por auditon zbatimin e tyre *(Prezantimi i Raportit të Performancës së KLSH-së për vitin 2015)*
- Rritja ekonomike më e ulët është pasojë dhe jo arsyeja e mosrealizimit të të ardhurave buxhetore *(Prezantimi i Raportit të Zbatimit të Buxhetit Faktik të vitit 2015)*

Rezoluta e Kuvendit dhe reflektimi në veprimtarinë e KLSH-së

- *Prezantimi i Raportit të Performancës së KLSH për vitin 2011*

20 mars 2012

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, Kuvendi i Shqipërisë

Deputetët pjesëmarrës

1. Edmond Spaho
2. Erion Braçe
3. Florjon Mima
4. Ervin Koçi
5. Sybi Hida
6. Mimi Kodheli
7. Selami Xhepa
8. Arben Ahmetaj
9. Albana Vokshi
10. Adriana Gjonaj
11. Arben Malaj
12. Lefter Koka
13. Sherefedin Shehu
14. Ledina Aliolli
15. Igli Cara
16. Gjoke Uldedaj
17. Luan Skuqi
18. Gjovalin Kadeli

Të nderuar deputetë të Komisionit për Ekonominë dhe Financat,

Duke ju falënderuar për mbështetjen që i keni dhënë institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit gjatë vitit 2011, të shprehur qartë në Rezolutën e Kuvendit datë 2 qershor 2011, më lejoni t'Ju paraqes një Raport të shkurtër për veprimtarinë e KLSH për vitin 2011. Ky raport përqendrohet në përgjigjen e institucionit ndaj rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit, në performancën e tij vjetore, duke përfshirë problematikën e konstatuar dhe në objektivat e vitit në vazhdim 2012.

I. Marrëdhëniet me Kuvendin

1. Në Rezolutën e Kuvendit datë 2 qershor 2011 "Për vlerësimin e veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2010", ju keni kërkuar përdorimin më gjerësisht të metodologjisë bashkëkohore të kontrollit, mbështetur në standardet ndërkombëtare të INTOSAI dhe praktikat më të mira të vendeve të tjera. Eksperienca e fituar nga KLSH

nga zbatimi gjatë viteve 2007-2008 i Projektit të Binjakëzimit me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Britanisë së Madhe dhe me Gjykatën e Auditimit të Holandës ka prodhuar materiale udhëzuese të vlefshme dhe dy manuale, një i auditimit financiar dhe një i auditimit të performancës, por që janë përdorur dhe referuar pak nga audituesit tanë gjatë auditimeve të vitit 2011. Megjithatë, krahas materialeve udhëzuese dhe manualeve, KLSH në drejtim të zhvillimit të metodologjisë ka mundur të realizojë:

a) Rishikimin e udhëzimeve dhe standardeve ndërkombëtare të kontrollit të miratuara nga INTOSAI, ndonëse ende nuk ka përfunduar përditësimin e tyre; dhe

b) Rishikimin dhe përmirësimin e draft/dokumentit për auditimin e certifikimit të pasqyrave financiare dhe hartimin e formularëve standard për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare për institucionet buxhetore, i cili është shpërndarë për vlerësim.

KLSH me vështirësi po orientohet drejt auditimeve sipas praktikave bashkëkohore, ndërkohë që është kërkesë e kohës shtimi i ritmit dhe përmirësimi cilësor i kryerjes së këtyre auditimeve, veçanërisht auditimeve të performancës, duke patur parasysh që në vitin 2011 u realizua vetëm një i tillë.

Edhe pse institucioni ka përpunuar dhe përgatitur udhëzime dhe metodika për ushtrimin e kontrolleve, bazuar në rekomandimet dhe udhëzuesit zbatues të standardeve të auditimit të hartuar nga INTOSAI, njohja, përditësimi dhe zbatimi i tyre , si element thelbësor i teknikës profesionale (edhe pse ka qenë një kërkesë e stafit drejtues të KLSH-së) nuk është plotësuar gjatë vitit të kaluar. Për këtë vit ne kemi përcaktuar objektivat për metodologjinë, të cilat përmblidhen në përditësimin e standardeve të auditimit dhe të formularëve standard, si dhe në kontrollin dhe sigurimin e cilësisë gjatë auditimit.

2. Në Rezolutë, ju keni kërkuar zhvillimin e burimeve njerëzore, me synim rritjen e kapaciteteve profesionale të stafit, veçanërisht të atij kontrollues. KLSH në Planin e Zhvillimit Strategjik 2009-2012 dhe në programin e veprimtarisë të vitit 2011 kishte përcaktuar drejtimet dhe aktivitetet.

Programi është njëra anë dhe ka rëndësinë e tij, por kryesorja dhe më e vështira është ndjekja e zbatimit të aktiviteteve të programuara, shkalla dhe cilësia e zbatimit të tyre, të cilat kanë lënë për të dëshiruar. Aplikimi i produkteve të përftuara nga Projekti i Binjakëzimit i viteve 2008-2009 dhe trajnimi e kualifikimi i punonjësve të cilët nuk kanë marrë pjesë të drejtpërdrejtë në këtë projekt është konsideruar prioritar. Megjithatë, në praktikë në vitin 2011 ka munguar asistenca konkrete e huaj dhe treguesi i trajnimit dhe kualifikimit të personelit prej 2.1 ditë trajnim në vit për punonjës është shumë i ulët. Kryerja me cilësi e auditimeve financiare dhe të performancës kërkon

domosdoshmërish rritjen e kapaciteteve të stafit. Politikat e përftimit të stafit cilësor gjatë vitit të kaluar kanë qenë të mangëta. Në KLSH nuk janë bërë rekrutime me shpallje, me procedura konkurrimi, por kanë qenë të punësuar 22 punonjës me kontrata të përkohshme pune pa afat ose me afat deri në 31.12.2011. Të gjithë këta punonjës, më datën 28 dhjetor 2011, iu nënshtruan një testimi të aftësive profesionale, për të vlerësuar përshtatshmërinë ose jo të tyre për të vijuar marrëdhëniet e punës me KLSH. Testimi rezultoi në vlerësime të dobëta për 15 prej tyre. Ky fakt flet qartë se rekrutimi jo mbi baza transparence dhe konkurrence prodhon staf cilësisht të dobët, për pasojë dëmton në tërësi punën e institucionit, pasi duke qenë natyra e punës audituese, punë në ekip, mangësitë e këtij stafi rrezikojnë të kompromet ojnë edhe cilësinë e punës së stafit ekzistues. Duke filluar nga 1 Janari 2012, procedurat për plotësimin e vendeve të lira kanë filluar të shpallen rregullisht dhe rekrutimi të realizohet nëpërmjet konkurrimit me anë të testimit të njohurive dhe përzgjedhjes mbi kritere objektive.

Duke konsideruar një lidhje të forte mes shtimit të kapaciteteve dhe rritjes së vëllimit të trajnimeve të stafit, në shkurt 2012 kemi nxjerrë një urdhër të brendshëm ku përcaktojmë një limit të poshtëm prej 10 ditësh trajnimi në vit për punonjës të KLSH dhe 25 ditësh trajnimi për punonjësit e rinj. Mirëpo, po hasim shumë vështirësi në gjetjen e trajnuesve të përshtatshëm dhe thithjen e ekspertizës jashtë institucionit, ngaqë mungon fondi për pagesat e ekspertëve të jashtëm për vitin 2012. Minimumi nevojiten 10 milionë lekë.

Ndërkohë, edhe pse e kufizuar, për vitin 2011 duhet nënvizuar pjesëmarrja e punonjësve të KLSH për shkëmbimin e përvojave dhe përftimin e njohurive në trajnimet e zhvilluar nga ITAP-i, nga Agjencia e Prokurimit Publik, nga institucione si përfaqësia e BB në Tiranë, nga organizmat ndërkombëtarë të kontrollit në programet e trajnimit në distancë (IDI, INTOSAI) dhe nga institucionet homologe. Eksperienca e përftuar nga këta punonjës të kufizuar të trajnuar mund të shfrytëzohet dhe këta punonjës të kthehen në trajnerë për pjesën e gjerë të stafit të KLSH që nuk ka marrë kualifikim, gjatë këtij viti dhe në vitet në vijim.

3. Ju keni kërkuar rritjen e cilësisë në kontrollin e përdorimit të fondeve të Buxhetit të Shtetit, fondeve të projekteve të financuara nga BE dhe nga institucionet financiare ndërkombëtare. KLSH ka punuar për njohjen dhe përditësimin në vijimësi të kontrollorëve me dispozitat ligjore e nënligjore, si kusht i domosdoshëm për njohjen dhe vlerësimin e veprimtarisë së subjekteve të audituara, argumentimin e zbulimeve, nxjerrjen e konkluzioneve, përgjegjësive dhe rekomandimeve përkatëse. Krahas sigurimit të legjislacionit nëpërmjet fletoreve zyrtare, shfrytëzimit të internetit dhe sistemit kompjuterik të institucionit, institucioni ka bërë përditësim të paketës me

dispozitat ligjore e nënligjore më kryesore. Megjithatë, njohja e audituesve me të rejat e dispozitave ligjore e nënligjore më kryesore është e pakët dhe lë shumë për të dëshiruar.

Kontrolli i përdorimit të fondeve të Buxhetit të Shtetit është detyrim kushtetues për KLSH dhe nga 152 subjekte të kontrolluara gjatë vitit të kaluar, auditimi për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2010 u krye në 94 subjekte, si ministri dhe institucione qendrore, njësi të pushtetit vendor, agjenci apo projekte që operojnë me fonde buxhetore. Institucioni kontrolloi në këto auditime realizimin e fondeve buxhetore sipas politikave të programeve, shkallën e realizimit të produkteve dhe kostove përkatëse dhe dha opinionet e tij mbi raportet e monitorimit te ministrive të kontrolluara dhe të Ministrisë së Financave.

Gjatë vitit 2011 janë kontrolluar 9 projekte me fonde të huazuara nga institucionet financiare ndërkombëtare si Banka Botërore, Banka Evropiane e Investimeve, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Banka Gjermane (KfW) etj., në fusha të ndryshme si infrastrukturën rrugore, në energjitikë, në arsim dhe shëndetësi dhe në sektorin e ujësjellës kanalizimeve. Në kontrollet e ushtruar, përgjithësisht është konstatuar se konsumohet një kohë e gjatë për procesin e negociatave, për hartimin e nënshkrimin e marrëveshjeve dhe bërjen efektive të tyre, duke sjellë jo vetëm pasoja në rritjen e kostos së projekteve, por edhe mangësi në plotësimin e objektivave.

Rritja e efektivitetit të investimeve me financime të huaja nga KLSH është trajtuar e lidhur ngushtë me plotësimin në sasi, cilësi dhe afat të objektivave dhe të komponentëve të projektit. Ndonëse, gjatë ushtrimit të kontrolleve institucioni ka konstatuar edhe dëme ekonomike, të evidentuara kryesisht në fushën e pagave, shpërblimeve dhe prokurimeve në vlerën rreth 64,7 milionë lekë, si në Projektin "Ndërtimi i rrugës Lushnjë-Fier, vlera e dëmit 28,8 milionë lekë" dhe "Menaxhimi i burimeve ujore, 24,7 milionë lekë"; ato nuk janë parë si qëllim në vetvete.

Kohët e fundit, kapitali dhe fondet e huazuara nga institucionet financiare ndërkombëtare, po kontrollohen dhe në një këndvështrim tjetër, në atë mbi vlerësimin e parimeve të përdorura për kontabilitetin dhe çmuarjet e bëra nga menaxhimi, si dhe vlerësimin e prezantimit të përgjithshëm të pasqyrave financiare, ku sipas situatës konkrete përgatiten dhe dërgohen për zbatim rekomandimet përkatëse.

Në kontekstin e kërkesës së Kuvendit për rritjen e cilësisë së kontrollit, bëj me dije se veprimtaria audituese e KLSH-së për vitin 2011 është bazuar në planifikimin strategjik të kontrolleve të përcaktuara për atë vit, produkt i ndërthurjes së përvojës shumëvjeçare të KLSH-së në fushën e planifikimit, me materialet e trajnimit dhe përvojën e mirë të

Zyrës Kombëtare të Auditimit (NAO) të Britanisë së Madhe. Ndonëse kontrollet si numër janë realizuar dhe tejkaluar, në strukturë ato nuk janë realizuar sipas programit të veprimtarisë të miratuar në fillim të vitit. Krahas kësaj mangësie, shqetësim përbën cilësia e zhvillimit dhe përgatitjes së materialeve të auditimeve financiare e të performancës, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në manualet e këtyre dy auditimeve, sidomos të atij të performancës. Sfida për rritjen e cilësisë së auditimeve na ka shtyrë që në shkurt të vitit 2012 të krijojmë Departamentin e Kërkimit Shkencor, Zhvillimit dhe Kontrollit të Brendshëm.

4. Në Rezolutë, ju keni kërkuar zhvillimin e teknologjisë së informacionit dhe intensifikimin e trajnimit të punonjësve. Me gjithë masat e marra, kryesisht në blerjen e pajisjeve kompjuterike, gjatë vitit 2011 KLSH nuk ka njohur progres, si rezultat i zhvillimit me hope dhe jo harmonik të burimeve njerëzore dhe infrastrukturës së teknologjisë së informacionit. Ambienti në të cilin zhvillohet kjo teknologji informacioni, për mungesë totale të hapësirave të punës, ndrydh dhe deformon edhe ato investime që janë kryer vite më pare. Pasja e një rrjeti kompjuterik të amortizuar fizikisht dhe moralisht (i para 10 vitesh) dhe pa parametrat e standardet e përcaktuara nga AKSHI përbëjnë një pengesë të pakompensueshme. **Mungesa e një godine të re për KLSH na detyron që dhe investimi në sistemin e teknologjisë së informacionit të mos jetë i duhuri.** Kjo çështje është një kërkesë vazhdueshme e ekipeve të SIGMA-s, e cila që nga viti 2007 e ka evidentuar në raportet e saj të vlerësimit që adreson për ekonominë, qeverinë dhe institucionet shqiptare. Kështu, në raportin e saj të vitit 2008, thuhet se "...KLSH është vendosur në ndërtesën e administratës së Kuvendit, por i duhet të lëvizë në një vendndodhje të re. Që nga fillimi i vitit 2007...po pritet për një vendim të Këshillit të Ministrave në cilën ndërtesë do të vendoset...Kjo vonesë në zhvendosje ka pasoja negative në zhvillimin e teknologjisë së informacionit brenda KLSH". Në raportin e SIGMA për vitin 2011 sërish cilësohet se "...KLSH ende vuan nga ambiente pune të papërshtatshme, të cilat, ndër problemet e tjera, pengojnë investimin e domosdoshëm në infrastrukturën e IT". Në takimin e datës 19 janar 2012 me Kryetarin e KLSH, Kryeministri Berisha premtoi t'i jepte një zgjidhje sa më të shpejtë dhe të përshtatshme sistemimit të institucionit me ambiente zyrash që mund të hapin rrugë për investimet dhe përmirësimet e nevojshme në infrastrukturën e teknologjisë së informacionit.

Në tërësi, rezulton se zhvillimi i burimeve njerëzore në KLSH në fushën e IT gjatë vitit 2011 lë mjaft për të dëshiruar. Sasia e trajnimeve për stafin e IT ka qenë e pakët, dhe ato pak trajnime që janë organizuar nga institucionet homologe dhe ato të përfituara nga suporti i dhënë nga qeveria në kontekstin e e-gov nuk janë shfrytëzuar si dhe sa duhet. KLSH ka programuar trajnime të posaçme për të fituar e zhvilluar këto aftësi, siç janë

trajnimet për njohjen me teknologjinë e informacionit, programin IDEA, si dhe programet "Financa 5", "Alpha" dhe "Oracle", por këto programe nuk u realizuan gjatë vitit 2011. Ne patjetër do t'i realizojmë këtë vit.

5. Ju keni kërkuar harmonizimin e veprimtarisë audituese të kontrollit të jashtëm me atë të brendshëm dhe rritjen e rolit mbikëqyrës ndaj strukturave të auditimit të brendshëm. Krahas Njësisë Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm, Njësisë Qendrore të Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, KLSH ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi dhe me Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm në MF-ve, Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm në MB-me, kohët e fundit me Drejtorinë e Inspektimit Financiar Publik etj. Megjithëse këto marrëdhënie janë vendosur formalisht, shkëmbimi i informacionit mes palëve nuk ka njohur vijimësi dhe rreziku i mbivendosjes në kontrolle ngelet sërish i lartë. KLSH vlerëson shumë pozitivisht punën e këtyre njësive profesionale dhe shpreson që në të ardhmen e afërt bashkëpunimi me to të jetë konkret, në të mirë të rritjes së efiçiencës së auditimit të brendshëm. Përsa i përket punës me auditimin e brendshëm, gjatë vitit analizues KLSH ka ushtruar:

- Mbikëqyrjen e funksionimit të auditimit të brendshëm në 17 subjekte në nivel qendror si: ministri, universitete shtetërore, drejtori të Përgjithshme, institute etj.,
- Vlerësimin e mjedisit të kontrollit të brendshëm në 7 institucione qendrore,
- Mbikëqyrjen e organizimit dhe funksionimin e njësive të auditimit në qeverisjen vendore, në 18 bashki, një komunë dhe një ndërmarrje; si dhe
- Mbikëqyrjen e funksionimit të auditimit të brendshëm në 14 ndërmarrje dhe shoqëri tregtare (me kapital shtetëror).

Procesi i vlerësimeve dhe mbikëqyrjeve, arritjet dhe dobësitë apo shkeljet ligjore të vërejtura, janë pasqyruar në Raportet Përfundimtare të Kontrollit, të cilat u janë përcjellë së bashku me rekomandimet përmirësuese përkatëse subjekteve të audituara.

6. Në Rezolutë, ju keni kërkuar konsolidimin e bashkëpunimit me Kuvendin dhe Këshillin e Ministrave për përmirësimin e akteve ligjore dhe nënligjore, veçanërisht të ligjit për Kontrollin e Lartë të Shtetit, përmirësimin e administrimit të vlerave materiale e monetare dhe rritjen e shkallës së zbatimit të rekomandimeve të institucionit.

Marrëdhëniet me Kuvendin burojnë nga Kushtetuta dhe Ligji Organik i KLSH-së. Këto marrëdhënie nga njëri vit në tjetrin janë fuqizuar dhe konsoliduar më tej. Kuvendi me Komisionet e tij, në veçanti Komisioni i Ekonomisë dhe Financës, në vijimësi ka mbështetur dhe inkurajuar veprimtarinë e institucionit. Në këtë këndvështrim, përmendim kontaktet apo shkëmbimin e opinioneve për kontrollet më të rëndësishme dhe rezolutat e viteve të fundit për veprimtarinë e KLSH.

Institucioni është përpjekur për të përmbushur në kohë detyrimet kushtetuese, si nëpërmjet informimit dhe raportimit në vijimësi për rezultatet e kontrolleve, ashtu dhe për përgatitjen dhe dërgimin në kohë në Kuvend të raporteve të parashikuara në Kushtetutë dhe në Ligjin Organik të tij, të buletinit 3-mujor për rezultatet e kontrolleve të ushtruara për periudhën respektive dhe të një numri materialesh të ndryshëm, me interes në fushën e veprimtarisë audituese.

Bashkëpunimi i KLSH me Këshillin e Ministrave dhe institucionet e tjera qendrore ka qenë i rregullt dhe gjithëvjetor gjatë 2011-ës, por përmasa e tij për thellimin e luftës dhe për parandalimin e korrupsionit nuk ka qenë e zhvilluar në nivel të pritshmërive të publikut.

Institucioni ka dhënë kontribut real në diskutimin dhe përgatitjen e projekt-akteve të ndryshme ligjore, si ai për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH, për prokurimin publik, për menaxhimin financiar dhe kontrollin, inspektimin financiar publik, etj.

Lidhur me përmirësimin e Ligjit Organik të KLSH, drafti i përgatitur në konsultim me ekspertët e Gjykatës së Auditimit të Holandës dhe NAO të Britanisë së Madhe nuk është paraqitur në Kuvend, për arsye subjektive. Amendimet që institucioni ka përgatitur janë bërë në përputhje me përcaktimet në Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit dhe drafti u është shpërndarë për konsultim institucioneve ndërkombëtare të kontrollit dhe të Evropës, përfshirë Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit të BE dhe SIGMA. Në këto muaj të parë të 2012-ës kemi intensifikuar punën për plotësimin përfundimtar të draftit. Fushat kryesore të përmirësimit të Ligjit organik te KLSH janë rregullimi në mënyrë përfundimtare i pavarësisë së institucionit, konceptimi modern i të drejtave dhe detyrave të KLSH, rritja e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të tij, rritja e kapaciteteve administrative, saktësimi i së drejtës së KLSH të auditojë fondet e akorduara nga BE për Shqipërinë, deri tek përdoruesi i fundit dhe saktësimi i së drejtës të certifikojë llogaritë financiare. Mendojmë që brenda muajit prill 2012 ta paraqesim në Kuvend për shqyrtim.

7. Në Rezolutë ju keni kërkuar rritjen e bashkëpunimit me organet e drejtësisë për shlyerjen e dëmeve dhe ndëshkimin e personave përgjegjës. Me keqardhje konstatoj se marrëdhëniet e bashkëpunimit dypalësh me organet e prokurorisë gjatë vitit 2011 kanë munguar. Ato kanë ekzistuar formale në ndjekjen dhe plotësimin e angazhimeve të përcaktuara në Memorandumin e Bashkëpunimit për ngritjen e njësive të përbashkëta të hetimit rajonal, të nënshkruar në kuadër të Programit të USAID dhe Departamentit të Drejtësisë të SHBA, Pragu i Mijëvjeçarit II-të, më datë 6 maj 2009, nga 6 (gjashtë) institucione të vendit, si Prokuroria e Përgjithshme, MB, MF, SHISH, KLSH dhe ILKDP.

Aktiviteti kontrollues i KLSH-së në vitin 2011, ka evidentuar si fusha me rrezikshmëri më të lartë për shfaqjen e krimit ekonomik dhe korrupsionit: investimet publike, përfshirë prokurimet dhe zbatimin e projekteve me fonde publike; koncesionet dhe administrimin e investimeve me financime të huaja; mbledhjen e të ardhurave tatimore dhe doganore; rregullimin e territorit; regjistrimin e pronës, etj. Këtë e dëshmon fakti se ato pak kallëzime që KLSH ka depozituar vitet e fundit në Prokurori janë bërë për zbulime të shkeljeve me pasojë dëm ekonomik pikërisht në këto fusha dhe kryesisht për konsumim të veprave penale si "Shpërdorimi i detyrës", "Shkelje të barazisë së pjesëmarrësve në tendera e ankande publikë", "Vepra penale në fushën e tatimeve" dhe "Falsifikimi i dokumenteve". Gjatë vitit 2011 janë bërë gjithsej 6 kallëzime penale për 13 persona, për një vlerë tërësore dëmi prej 367 milionë e 657 mijë lekësh. Pak, shumë pak për një institucion si KLSH. Numri i kallëzimeve, që ka arritur maksimumin e vet në vitet 2005-2006, ka ardhur në rënie duke përfunduar në vitet 2010 -2011 në një rënie drastike në nivel minimal. Ky është një numër shumë i vogël kallëzimesh, ndërkohë që niveli i zbulimeve të KLSH në terma financiarë nuk ka pësuar një rënie të ngjashme. Kjo tregon se përpjekjet e KLSH nuk kanë qenë të mjaftueshme në drejtim të dhënies rrugë për hetime të mëtejshme nga organet e Prokurorisë, për zbulimet e kontrollit që shoqërohen me efekte të mëdha financiare të fondeve dhe pasurisë publike. Shkëmbimet e ndërsjella mes KLSH dhe organeve të Prokurorisë kanë qenë të vakëta dhe të kufizuara vetëm në komunikime formale në kufijtë e kërkesave minimale të ligjit. Ka patur gjatë vitit 2011 një përgjumjeje të KLSH në drejtim të ndërveprimit me organet e prokurorisë. Në fund të vitit 2011, u bë një studim për nivelin sasior të kallëzimeve penale që KLSH ka depozituar në organet e prokurorisë për periudhën 2000–2011(Shihni për më shumë fq. 47 të Raportit Vjetor të KLSH dhe grafikun në fq. 47). Ky studim tregoi se ka një rënie të cilësisë së ndërveprimit mes institucioneve dhe shkaqet për rënien e këtij niveli të ndërveprimit, nga ana jonë duhen kërkuar fillimisht tek mungesa e vullnetit dhe mangësitë në përformancën e KLSH, por edhe një indiferencë nga ana e organeve të Prokurorisë, e cila ka konsideruar vetëm 10% të rasteve të sjella nga KLSH gjatë viteve 2000-2011. Situata po ndryshon nga ana jonë gjatë këtij viti. Vetëm në këto tre muaj të parë në Prokurori janë kryer 5 kallëzime penalë për shpërdorim detyre për 26 persona në Porti Detar Vlorë Sh.a., në ALUIZNI qendror dhe ALUIZNI Durrës, në komunën Petrelë dhe në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Në drejtim të auditimit të brendshëm të vetë institucionit, është shumë e rëndësishme që, duke qenë KLSH institucioni që kontrollon të gjithë administratën publike, duke vlerësuar edhe përgjegjshmërinë dhe transparencën e saj, duhet së pari që këto vlera dhe detyrime ligjore ky institucion t'i kërkojë tek vetja. Në rrethanat kur Kuvendi që nga viti 2001 nuk ka realizuar kontrollin e llogarive të institucionit, jemi përpjekur ta mbushim

në një farë mënyre këtë boshllëk, duke paraqitur rezultatet e auditimit të brendshëm të institucionit në raportin vjetor që ju kemi dërguar. Sipas ligjit organik të KLSH, neni 3 përcaktohet se llogaritë vjetore të KLSH përgatiten në përputhje me Ligjin për Buxhetin dhe kontrollohen nga një organizëm i pavarur, i caktuar nga Kuvendi dhe që raporton tek ai. Me shkresën nr. 208 datë 02.02.2012 i kemi kërkuar Kryesisë së Kuvendit të realizohet detyrimi ligjor për auditimin sa më parë të llogarive të KLSH për periudhën 2002-2011. Auditimin tonë nga jashtë e kanë kërkuar dhe këshilluar edhe ekspertët e SIGMA-s, në vlerësimet e tyre të përvitshme dhe në atë të ardhur gjatë këtyre ditëve të marsit 2012. Personalisht do ta vlerësoja së tepërmi angazhimin tuaj si deputetë të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave për të ndihmuar në auditimin e KLSH-së.

Të nderuar deputetë,

Ky ka qenë reagimi i institucionit ndaj rekomandimeve që ju keni dhënë në qershor të vitit të kaluar. E quajta parësore raportimin për realizimin e këtyre rekomandimeve, jo vetëm në respekt të opinioneve tuaja të shprehura në këtë Rezolutë, por për lidhjen organike që institucioni që drejtoj duhet të ketë me Kuvendin në tërësi dhe me ju si Komision në veçanti.

II. Performanca e KLSH

Më lejoni në vijim t'ju informoj për performancën vjetore të institucionit dhe realizimin e objektivave të Planit të tij Strategjik të Zhvillimit 2009-2012 për vitin raportues 2011. Më konkretisht:

a) KLSH është përpjekur të zhvillojë dhe praktikojë një metodologji bashkëkohore, bazuar në standardet ndërkombëtare për kontrollin dhe praktikat e mira audituese të vendeve të BE, të asimiluara nga institucioni. Për këtë, ka përgatitur dhe nxjerrë në Intranet për përdorim nga punonjësit mjaft materiale, përfshirë standardet e kontrollit, rregullat bazë dhe procedurat për kryerjen e kontrolleve nga strukturat respektive në KLSH, manualet e auditimit, materiali udhëzues për sigurimin e cilësisë së kontrollit etj.

Mirëpo, ndonëse KLSH ka punuar dhe është përpjekur të zbatojë Rregulloren e tij të Brendshme, Standardet e veta të Kontrollit, Metodikat, Manualet e Auditimit Financiar e të Performancës dhe Kodin Etik, nuk ia ka arritur qëllimit për implementimin e tyre dhe të standardeve të përditësuara të INTOSAI, në përputhje me përcaktimet e parashtruara në këto akte. Audituesit, në jo pak raste, janë mjaftuar me dokumentacionet e ofruara nga subjektet e kontrolluara dhe ka munguar vullneti ose aftësia profesionale për implementimin e materialeve të sipërcituar, në zbulim të mashtrimit financiar dhe të korrupsionit;

b) Institucioni gjatë vitit 2011 ka pasur ecuri pozitive të veprimtarisë kontrolluese, si rrjedhojë e përcaktimit të kërkesave për kontrollin e cilësisë, përfshirë zbatimin me rigorozitet të rregullave procedurale për vlerësimin e sistemit të sigurimit të cilësisë dhe ndjekjes së zbatimit të tij, duke përdorur vlerësimin objektiv të 10% të dosjeve të kontrollit të përfunduara;

c) Sikurse kam përmendur më lart, gjatë periudhës ushtrimore janë realizuar dhe tejkaluar detyrat e përcaktuara për veprimtarinë kontrolluese, përkatësisht nga 150 kontrolle gjithsej të programuara janë realizuar 152 kontrolle.

d) Në auditimet financiare të realizuara, përfshirë certifikimin e pasqyrave financiare (ndonëse nga 15 të programuara, janë kryer vetëm 10 prej tyre), veprimtaria audituese e kontrollorit është mbështetur deri diku në manualin e auditimit financiar, përfshirë vlerësimin dhe përcaktimin e materialitetit dhe të riskut.

e) Në auditimet e performancës, rezultatet kanë qenë shumë të dobëta. Nga 5 auditime të tilla të programuara është realizuar vetëm një auditim dhe një tjetër është në proces. Shumë pak për një vit, gjë që tregon se ka munguar vëmendja e duhur nga institucioni për këtë lloj auditimi.

f) Veprimtaria për kontrollin e zbatimit të legjislacionit në fuqi dhe evidentimin e hapësirave apo mospërputhjeve eventuale që mund të ekzistojnë, është shoqëruar me rritje të cilësisë së përgatitjes të propozimeve për ndryshime dhe përmirësime të dispozitave ligjore. Më konkretisht, gjatë vitit 2011 janë përgatitur dhe dërguar në organet respektive 45 propozime për ndryshime dhe përmirësime ligjore, nga të cilat 22 prej tyre janë zbatuar, ndërkohë që 13 propozime të tjera janë në proces zbatimi.

g) Dobia e rezultateve të kontrollit (impakti i kontrollit), rezulton në shumën totale 7,027 milionë lekë (ose rreth 70 milionë dollarë) dhe përfaqëson vlerën totale të zbulimeve të dëmit ekonomik të konstatuar, evidentuar dhe të raportuar në përfundim të kontrolleve të kryer gjatë vitit 2011.

Më konkretisht, sipas fushave dhe sektorëve ku janë konstatuar dëmet ekonomike, rezulton:

Në milionë/lekë

A.1	Në shitjen dhe dhënien me qira të pasurisë shtetërore	352.2
A.2	Në prokurimet publike	210.3
A.3	Në sektorin doganor	184.0
A.4	Në fushën e shpërblimeve	149.3
A.5	Në urbanistikë	87.6
A.6	Në sektorin e tatimeve dhe taksave	49.0
A.7	Në sistemin e pagave	36.6
A.8	Në shpenzimet operative	25.0
A.9	Në fusha dhe sektorë të tjerë	5,933.0

Institucioni ka rekomanduar shpërblimin e këtij dëmi ekonomik në masën njëqind për qind në arkën e Shtetit, si dhe ka rekomanduar dhe masa korrigjuese administrative e disiplinore, ndonëse në tërësi ato duhet të ishin më të forta.

Nga vlera e dëmit prej mbi 7 miliardë lekë, peshën dërmuese me rreth 83.4% e zënë dëmet e evidentuara në dy shoqëri anonime, përkatësisht Albpetrol sh.a. Fier në vlerën 3,936,800 mijë lekë (shkaktuar nga moslikujdimi i detyrimeve prej 3,578,690 mijë lekë të rrjedhura nga furnizimi me naftë bruto, gaz natyror dhe hollues deri më datë 31.12.2010 nga kompania ARMO sh.a (ARMO Oil) dhe 358,110 mijë lekë nga moslikujdimi në afat i faturave të shitjes së naftës po nga kjo kompani) dhe Operatori i Sistemit të Transmetimit të Energjisë Tiranë në vlerën 1,924,209 mijë lekë (moslikujdim i shërbimit të kryer për transmetimin e energjisë elektrike për periudhën nga privatizimi i OSSH deri më 15.12.2010), gjithsej 5,861,009 mijë lekë (Për më shumë, shihni fq. 65 e në vijim të Raportit Vjetor 2011 të KLSH).

Deri tani niveli i arkëtimit të shumës së dëmit total është shumë i ulët, vetëm 9.5 përqind i saj, ose 667 milionë lekë. Në këtë nivel të ulët realizimi ka ndikuar puna e pamjaftueshme e kryer nga strukturat përgjegjëse në KLSH për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të tyre, si dhe përgjegjshmëria e pakët e stafit drejtues apo bordeve të subjekteve të kontrolluara ku janë adresuar rekomandimet për shpërblimin e dëmit ekonomik të shkaktuar.

h) Raporti ndërmjet vlerës së dëmeve ekonomike të konstatuara dhe evidentuara gjatë vitit kalendarik 2011, si dhe të kërkuar për shpërblimin e dëmit në shumën 7,027 milionë lekë dhe vlerës të raportuar me situacionin përfundimtar të shpenzimeve të KLSH-së për këtë vit në shumën 253 milionë lekë tregon për shkallën e efektivitetit të veprimtarisë kontrolluese të KLSH-së; dhe konkretisht, për çdo lek të investuar në KLSH gjatë vitit 2011, janë kërkuar për t'ju kthyer arkës së Shtetit 27.76 lekë.

Tregues tjetër i efektivitetit të veprimtarisë kontrolluese të KLSH-së është vlera e shkeljeve financiare me pasojë dëm ekonomik të zbuluar mesatarisht në vitin 2011 nga një i punësuar në KLSH, përkatësisht 45 milionë lekë/për punonjës (7,027 milionë lekë: 156 punonjës në organikë), nga 1,6 milionë lekë të harxhuar mesatarisht gjatë vitit 2011 për çdo punonjës në organikë (253 milionë lekë : 156 punonjës në organikë).

Këta dy tregues dhe analiza të tjera (si p.sh. nevoja për auditimin e IT, te rritjes së auditimeve te performancës, etj.) do t'i paraqesim tek Ju, kur të kërkojmë shtimin e numrit te personelit kontrollor në KLSH.

i) Krahas konsideratave të shprehura nga mjaft drejtues të subjekteve objekt kontrolli dhe specialistë të fushës së financës e të auditimit, për dobinë e kontrolleve të ushtruar dhe cilësinë e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, konkludojmë se niveli i zbatimit të masave të rekomanduara nga ana e KLSH gjatë vitit 2011 paraqitet relativisht mirë.

Në drejtim të rritjes së nivelit të zbatimit të masave përmirësuese të rekomanduara nga KLSH, ka ndikuar ndjeshëm Urdhri i Kryeministrit nr. 70, datë 18.4.2006 "Për masat në zbatim të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Auditit të Brendshëm dhe Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Administrativ e Antikorrupsion në Këshillin e Ministrave, në institucionet në varësi të Kryeministrit e të Ministrive". Qëllimi kryesor i këtij Urdhri është rritja e shkallës së zbatimit të ligjit. Sikurse thuhet shprehimisht në Pikën 1 të tij:"Të gjitha institucionet qendrore, në vartësi të Kryeministrit apo ministrave, përfshi dhe ndërmarrjet me kapital shtetëror a organizatat jofitimprurëse të subvencionuara nga shteti, që i nënshtrohen auditimit sipas legjislacionit në fuqi, që të marrin masat sipas afateve të përcaktuara në ligj e në këtë urdhër për zbatimin e rekomandimeve, të propozimeve, masave disiplinore dhe sugjerimeve që përcaktohen në raportet e:

- Kontrollit të Lartë të Shtetit, në përputhje me nenet 2, 7, 15, 16 dhe 17 të ligjit organik të tij".

Niveli i zbatimit të Urdhrit është gjithashtu tregues për mënyrën e reagimit të institucioneve të kontrolluara ndaj rekomandimeve dhe masave të propozuara. Më konkretisht:

j.1. Masat organizative janë realizuar në masën 69% (në këtë nivel realizimi përfshihen dhe masat e realizuara pjesërisht, gjithsej 15). Nga 1605 masa të rekomanduara gjithsej, janë zbatuar plotësisht 1093 prej tyre, pjesërisht 15, në proces 184 dhe nuk janë zbatuar 278 masa, ndërkohë që 35 nuk janë verifikuar nga KLSH. Në krahasim me një vit më parë, ndonëse numri i masave të rekomanduara është rritur me 80 rekomandime (1605-1525), niveli i realizimit të tyre ka pësuar rënie. Kështu, nga 82.3% niveli i realizimit të rezultuar në vitin 2010, në vitin analizues 2011 ky nivel ka rezultuar në masën 69%, pra

me një diferencë në ulje prej 13.3 pikë përqindje. (Për më shumë, shihni fq. 65 të Raportit Vjetor 2011 të KLSH).

Ndër institucionet që kanë nivelin më të ulët të zbatimit të këtyre rekomandimeve janë: MTKRS me 4 rekomandime të tilla të pazbatuara nga 8 të rekomanduara, Drejtoria e Përgjithshme e Peshkimit me 8 rekomandime të tilla të pazbatuara nga 14, MBUMK me 3 masa organizative të pazbatuara nga 11, MF me 2 rekomandime të tilla të pazbatuara nga 4, dhe QSU "Nënë Tereza" Tiranë me 2 rekomandime të tilla të pazbatuara nga 11 të rekomanduara.

j.2 Masat për shpërblimin e dëmit ekonomik janë tejet të pakta. Nga vlera e përgjithshme e dëmit ekonomik prej 7,027 milionë lekë rekomanduar për shpërblimin e dëmit të evidentuar, deri në fund të vitit 2011 janë nxjerrë urdhrat përkatës për shpërblimin e dëmit dhe janë në proces arkëtimi rreth 667 milionë lekë, ose në masën 9.5% të vlerës gjithsej të rekomanduar për shpërblim dëmi.

Sikurse e përmendëm dhe më lart, treguesi shumë i ulët i arkëtimit të shpërblimit të dëmit dëshmon për një përqendrim të pakët të vëmendjes dhe punës së KLSH në këtë drejtim. Peshën kryesore në mosarkëtimin e vlerës së demit ekonomik të shkaktuar e zënë Albpetrol sh.a me një dëm të konstatuar në vlerën 3,937 milionë lekë dhe OST Energji Tiranë me 1,924 milionë lekë, në total 5,861 milionë lekë, gjë që dëshmon për vështirësitë që ndeshin këto dy shoqëri në arkëtimin e dëmit efektiv. Nga krahasimi i vlerave absolute të raportuara për shpërblimin e dëmit në vitin 2010 përkatësisht 787 milionë lekë, kundrejt 667 milionë lekë në vitin 2011, rezulton se në vitin 2011 janë dëmshpërblyer 120 milionë lekë më pak.

j.3 Masat administrative dhe disiplinore. Bazuar në përcaktimet në Ligjin Organik të KLSH i ndryshuar, ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", në "Kodin e punës", ligjin për prokurimin publik, për urbanistikën, për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit, për kontabilitetin etj., për parregullsitë dhe shkeljet e ndryshme të konstatuara me apo pa dëm ekonomik, KLSH, u ka rekomanduar subjekteve të kontrolluar dhe organeve respektive të emërtesës, shqyrtimin dhe marrjen e masave administrative dhe disiplinore ndaj punonjësve shkaktarë përgjegjës. Nga 720 masa të rekomanduara gjithsej, janë zbatuar 536 prej tyre, ose në masën 74.4%. Duhet theksuar që masat e rekomanduara nga KLSH për vitin 2011 janë në tërësi dytësore dhe jo parandaluese ndaj shkeljeve të ardhshme.

Në krahasim me një vit më parë, numri i masave të rekomanduara është ulur me 127 masa rekomanduese, gjithashtu niveli i realizimit ka pësuar rënie. Kështu, nga 80.8% niveli i realizimit të rezultuar në vitin 2010, në vitin analizues 2011 ky nivel ka rezultuar

në masën 74.4%, pra me një diferencë në ulje prej 6.4 pikë përqindje. Ndër masat administrative, nga 206 të rekomanduara gjithsej, janë zbatuar 140 prej tyre ose në masën 67.9%, ndërkohë që rezultojnë të pazbatuara 66 masa të rekomanduara.

Ndër masat disiplinore, nga 514 të rekomanduara gjithsej, janë zbatuar 396 prej tyre ose në masën rreth 77%, ndërkohë që janë pa përgjigje (të pazbatuara) 118 masa të rekomanduara.

Institucionet që kanë nivelin më të ulët të zbatimit të këtyre rekomandimeve janë MTKRS me 4 rekomandime të tilla të pazbatuara nga 13 të rekomanduara, Fondi Shqiptar i Zhvillimit 0 të zbatuara nga 17 të rekomanduara, Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan 0 nga 10, Dega e Doganës Qafë Thanë 0 nga 10, Dega e Doganës Durrës 0 nga 9 etj.

Për vitin 2011, numri i masave të rekomanduara nuk i përgjigjet nivelit të konstatimeve dhe shkallës së përgjegjësisë të punonjësve shkaktarë përgjegjës. Më konkretisht, janë shumë pak masat për largimin nga puna të personave shkaktare përgjegjës të dëmeve të konstatuara. Konstatimet dhe masat e propozuara nga KLSH duhet të jenë të efektshme dhe të ndihen në publik. Duhet të heqim dorë nga zbulimi i vjedhjeve hipotetike, që s'ekzistojnë, për faktin se këto "zbulime" i shërbejnë mbulimit të korrupsionit të vërtetë. Një libër gri për nëpunësit abuzues do ta dorëzojmë çdo vit pranë Departamentit të Administratës Publike, institucioneve qendrore dhe më gjerë.

j.4 Propozimet për ndryshime apo përmirësime ligjore. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë kontrolluese në vitin 2011, KLSH ka përgatitur dhe dërguar në strukturat respektive 45 propozime për ndryshim apo përmirësim të dispozitave ligjore në fuqi. Nga totali i propozimeve të rekomanduara, janë zbatuar plotësisht 22 prej tyre, 13 janë në proces zbatimi, 9 rezultojnë të pazbatuara, kurse 1 propozim nuk është verifikuar.

Institucionet që rezultojnë me nivelin më të ulët të zbatimit të këtyre rekomandimeve janë: MTKRS me 3 rekomandime të pazbatuara dhe Drejtoria e Përgjithshme e Peshkimit me 2, ndërkohë që MF, DPRMSH, DPT dhe KESH Sh.a. rezultojnë me nga 1 rekomandim të pazbatuar;

k) Shpenzimet buxhetore të KLSH-së për vitin 2011 janë kryer në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi, duke respektuar me rigorozitet kuotat e planifikuara të zërave të buxhetit, përfshirë pakësimet e bëra me ligj, respektivisht në shpenzimet operative 3 milionë lekë dhe në investime 7 milionë lekë, gjithsej 10 milionë lekë. Bëjmë me dije se institucioni vitin e kaluar kishte 155 punonjës dhe shpenzoi 253 milionë;

l) Marrëdhëniet e bashkëpunimit me organizmat ndërkombëtarë të kontrollit, si me INTOSAI, EUROSAI, Gjykatën e Llogarive të BE dhe me institucionet homologe të kontrollit, ndonëse kanë pasur vijimësi, nuk janë shfrytëzuar siç duhet dhe nuk kanë qenë shumë dobiprurëse për institucionin. Duhet theksuar se pozicioni i institucionit në këto marrëdhënie ka qenë statik, pritës, pa ndërmarrë vetë nisma konkrete;

m) Marrëdhëniet me Institucionin e Presidentit, Kryeministrinë, ministritë dhe institucionet qendrore, kanë qenë institucionale dhe të fokusuara në zbatimin e detyrimeve kushtetuese dhe ligjore në fushën e administrimit të vlerave materiale dhe monetare.

Kontaktet me organet e drejtësisë, ndonëse kanë pasur vijimësi, nuk kanë qenë frutdhënëse, sidomos me organin e prokurorisë. Marrëveshja e lidhur ndërmjet Kryetarit të KLSH dhe Prokurorit të Përgjithshëm në 6 maj 2005, nuk ka kënaqur pritshmëritë dhe nuk ka arritur në nivelin e kërkuar nga të gjithë aktorët, grupet e interesit dhe publiku i gjerë.

n) Në fushën e komunikimit me median, grupet e interesit dhe publikun e gjerë, KLSH megjithëse në vijimësi ka dhënë informacione të vlefshme e të sakta, kryesisht për rezultatet e veprimtarisë kontrolluese, ka ende rrugë përpara për të bërë, për të siguruar përgjegjshmërinë dhe transparencën e duhur. Media e shkruar nga fillimi i muajit janar 2011 deri ne fund të muajit dhjetor 2011 ka prodhuar gjithsej në faqet e saj 280 artikuj, editoriale si dhe komente analitike, nga të cilat vetëm 37 prej tyre ishin nga mesi i muajit Nëntor deri në fund të Dhjetorit, çka përkon përkon me procesin e zgjedhjes së Kryetarit të Ri. Mediat audiovizive gjatë vitit 2011 kanë transmetuar 100 sekuenca filmike, edicione informative, apo kronika të ndryshme televizive për KLSH.

Ndërkohë që për periudhën 11 janar-19 mars 2012 vetëm artikuj, editorialë dhe komente analitike në median e shkruar janë rreth 120, ndërsa kronika televizive mbi 40.

III. Objektivat e vitit në vijim

Programi i veprimtarisë i KLSH për këtë vit synon tejkalimin e mangësive të vërejtura gjatë vitit 2011 dhe fuqizimin e mëtejshëm të rezultateve dhe arritjeve të derisotme të institucionit. Këtij qëllimi i shërben dhe hartimi e ndjekja e zbatimit të programit të objektivave dhe aktiviteteve brenda 100 ditëve, nga data 03 Janar deri në 15 Prill 2012, një pjesë e mirë e të cilave në momentin kur raportojmë është konkretizuar në përputhje me programin.

Më konkretisht, puna ka nisur intensive dhe do të përqendrohet në vijimësi në:

1. Thellimin e realizimit të misionit kushtetues të KLSH në parandalimin e korrupsionit dhe abuzimeve në administrimin e pronës publike. Për këtë, krahas punës për zbatimin e standardeve të përditësuara INTOSAI, kemi lidhur ne muajin shkurt marrëveshje bashkëpunimi me ILDKP dhe kemi marre kontaktet e para me organizatat me aktive te shoqërisë civile kundër korrupsionit, për të koordinuar punën me to. Nga ana tjetër, po përpiqemi për bashkëpunim konkret me Prokurorinë e Përgjithshme, me Drejtorinë Antikorrupsion pranë Kryeministrisë, me Avokaturën e Shtetit dhe me te gjitha institucionet e tjera shtetërore që luftojnë korrupsionin. Këto ditë do të nënshkruajmë një marrëveshje bashkëpunimi me Autoritetin e Konkurrencës, për të shkëmbyer eksperienca me vlere ne parandalimin e konfliktit te interesit dhe abuzimet me tenderët shtetërore.

2. Përmirësimin e metodologjisë së kontrollit, duke kthyer vëmendjen tek auditimi i performancës dhe auditimi i certifikimit të pasqyrave financiare, krahas rritjes së efiçiencës së auditimit financiar. Kryerja me cilësi e auditimeve të performancës kërkon rritjen e kualifikimeve profesionale të stafit dhe për këtë vit. Sikurse e përmendëm në fillim, po hasim shumë vështirësi në gjetjen e trajnuesve të përshtatshëm dhe thithjen e ekspertizës jashtë institucionit, ngaqë mungon fondi për pagesat e ekspertëve të jashtëm për vitin 2012. Kur diskutohej buxheti i vitit 2012 ne muajt tetor-nëntor 2011, KLSH nuk u paraqit ne Komisionin e Ekonomisë dhe Financave dhe nuk kërkoi që ky fond minimalisht të ishte sa vitet e kaluara. Kjo mungesë po ndikon negativisht në punën tonë të këtij viti. Shpresojmë që duke e shpjeguar më gjerë këtë në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave, të mund të gjejmë dashamirësinë tuaj dhe mbështetjen e qeverisë për çeljen e këtij fondi.

3. Organizimin dhe sigurimin e kontrolleve me cilësi të lartë dhe efektivitet në përdorimin e fondeve të buxhetit të shtetit, fondeve të huazuara nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe ato të kapitalit të BE-së të alokuar për Shqipërinë, si dhe kryerja e tyre me objektivitet dhe profesionalizëm.

Hapja e institucionit ndaj praktikave më të mira ndërkombëtare të auditimit të jashtëm, të përditësuara në çdo kongres të fundit të INTOSAI dhe respektimi i orientimeve të MSA të Shqipërisë me Bashkimin Evropian është detyrë dhe sfidë për institucionin. Kjo bëhet akoma dhe më e rëndësishme për fatet e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm të vendit, sidomos në ditët tona të përjetimit të krizës në Eurozonë, kur disiplina buxhetore dhe financiare e administrimit publik është bërë përparësi absolute për përballimin e pasojave të kësaj krize.

KLSH, si strukturë e auditimit të jashtëm në sektorin publik ka një rol të rëndësishëm në drejtim të zhvillimit dhe forcimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm në subjektet e kontrollit. Për vitin 2012, gjatë ushtrimit të veprimtarisë kontrolluese që në fazën e programimit të kontrollit, KLSH ka parashikuar të përfshijë në programin e kontrollit një drejtim të veçantë kontrolli "Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit", i detajuar në nënpika, në drejtim të vlerësimit të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Gjatë këtij viti, në kuadër të bashkëpunimit me Njësinë Qendrore të Harmonizimit në Ministrinë e Financave, do të ndërmarrim një cikël trajnimesh të kontrollorëve në përgjithësi dhe në veçanti, të audituesve që do të kryejnë kontrolle dhe specializohen për këtë fushë auditimi.

Është kërkesë e re e kohës dhe e zhvillimeve në fushën e menaxhimit financiar publik që KLSH të përfshijë si objekt të punës së tij vlerësimin e veprimtarisë së MF për zbatimin e letër politikave 2010-2014 për kontrollin e brendshëm financiar publik. Në këtë drejtim, kemi vendosur si prioritet trajnimin e kontrollorëve në këtë fushë, duke u asistuar dhe financuar edhe nga organizmat ndërkombëtare.

4. Komunikimin dhe ndërveprimin më aktiv me Kuvendin, Qeverinë dhe partnerët e tjerë institucionalë, sidomos intensifikimin e konsultimeve me Komisionin për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë për përafrimet strategjike të KLSH 2013-2018, në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimit ndaj Kuvendit, si një detyrim kushtetues. Brenda gjysmës së dytë të këtij viti do të përgatisim Planin Afatmesëm Strategjik të Zhvillimit të institucionit për vitet 2013-2015, për të cilin i kemi kërkuar asistencë teknike SIGMA-s.

5. Programimin dhe konsolidimin e bashkëpunimit me ekspertët universitarë dhe akademikë të auditimit të financave publike, si dhe me organizata profesionale të kontabilitetit dhe të fushave të tjera të ekonomisë. Këto ditë nënshkruajmë marrëveshjen e bashkëpunimit me Fakultetin Ekonomik të Universitetit Shtetëror të Tiranës dhe jemi në bisedime për bashkëpunim konkret me institucione profesionale si IEKA, etj.

6. Intensifikimin e bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare të auditimit si INTOSAI dhe EUROSAI, me institucionet e larta të kontrollit të BE-së, si SIGMA dhe Gjykata Europiane e Audituesve, me institucionet homologe të vendeve të BE dhe të rajonit, dhe në veçanti me Zyrën e Audituesit të Përgjithshëm të Kosovës. Sfida jonë për vitet në vijim do të jetë partneriteti me Delegacionin e BE në Tiranë (edhe pse për këtë vit nuk arrijmë dot të përfitojmë programet IPA, për shkak të mungesës së aplikimeve tona gjatë vitit 2011), me Gjykatën Evropiane të Audituesve dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit të KE në Bruksel. Do të synojmë të marrim pjesë në

programet e kontrollit të Gjykatës Evropiane të Audituesve për vendet që aspirojnë për në BE dhe që përfitojnë nga programet e asistencës së BE-së, përfshirë vendin tonë. Për thellimin e dijeve në auditimin e performancës, do të vazhdojmë partneritetin me institucione homologe që na kanë ndihmuar në të kaluarën, si Zyra Kombëtare e Auditimit e Britanisë së Madhe apo Gjykata Hollandeze e Auditimit, por njëkohësisht duke kërkuar partneritet edhe nga institucioni homolog gjerman, suedez apo i vendeve të tjera të fuqishme të EUROSAI. Sikurse e thotë me mprehtësi z. Terence Nombembe, kryetar i Bordit Drejtues të INTOSAI-t dhe Auditor i Përgjithshëm i Afrikës së Jugut, "*Ne do ta forcojmë pavarësinë tonë me një armë që askush s'do guxonte të na e merrte: diturinë mbi auditimin, që na pajis me ide ose mendime të pavarura dhe analizë".*

Ne si KLSH jemi futur në procesin vullnetar të rishikimit mes kolegëve (Peer Review) në komunitetin e drejtuesve të SAI-ve evropiane në EUROSAI dhe presim asistencë nga Komiteti përkatës i EUROSAI.

Rëndësi të veçantë po i kushtojmë marrëdhënieve të bashkëpunimit me SIGMA, në mënyrë që të asistohemi nga kjo organizatë për të siguruar trajnimet aq shumë të nevojshme për stafin e KLSH që këtë vit. U kemi dërguar kërkesat tona konkrete për asistencë teknike dhe jemi në pritje të reagimit të tyre. Kemi ftuar për bashkëpunim Zyrën e Bankës Botërore në Shqipëri dhe kemi marre interesimin e saj për te hulumtuar mundësitë e një programi te gjere asistence nëpërmjet një grandi nga ana e Bankës. Po ashtu, kemi marrë një përgjigje të parë pozitive edhe prej SAI-t suedez për mundësi projekti partneriteti me të.

Ne do t'i kushtojmë gjatë këtij viti e më tej rëndësinë e duhur bashkëpunimit me Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës, me të cilin nënshkruam një marrëveshje bashkëpunimi në shkurt 2012. Kjo marrëveshje parashikon vizita të ndërsjellta dhe trajnime, ku KLSH mund të përfitojë nga kontributi cilësor që kjo Zyrë e Kosovës ka marrë nga drejtimi i saj prej një autoriteti të njohur të komunitetit ndërkombëtar të auditimit të jashtëm publik. Të dyja institucionet e kontrollit të lartë kanë vendosur të unifikojnë terminologjinë e auditimit në gjuhën shqipe.

Jemi të vendosur të ecim drejt përmirësimit të standardeve tona të auditimit me moton e INTOSAI "*Experentia mutual ominibus prodest*" (Eksperienca e përbashkët u shërben të gjithëve).

7. <u>Zhvillimin e burimeve njerëzore të KLSH</u> në nivelin e parametrave të kërkuar nga institucionet ndërkombëtare të auditimit dhe në përputhje me sfidat integruese të vendit. Në këtë kontekst, do të përshtaten më mirë cilësitë profesionale dhe aftësitë e secilit punonjës, me strukturën organike të institucionit, duke bashkuar strukturat

ekzistuese apo krijuar struktura të reja. Do të ketë rritje cilësore dhe të numrit të kontrollorëve të trajnuar brenda dhe jashtë institucionit, mbi bazën e listës së nevojave reale të stafit për ngritjen profesionale dhe të kërkesave të shtruara për institucionet supreme të kontrollit në Rezolutën e Kombeve të Bashkuara të datës 22 dhjetor 2011 për rritjen e efiçiencës së SAI dhe të kërkesave në Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit të Shqipërisë me BE. Sipas Rezolutës së OKB-së, "*Vendet anëtare të Kombeve të Bashkuara theksojnë vlerësimin e tyre për punën e INTOSAI për promovimin e një efiçience, përgjegjshmërie, efektiviteti dhe transparence më të madhe në marrjen e duhur dhe përdorimin e burimeve publike në përfitim të qytetarëve. Rezoluta po ashtu shpreh vlerësim për Deklaratat e Meksikos dhe të Limës dhe i nxit vendet anëtare që të aplikojnë, në përputhje me strukturat e tyre institucionale kombëtare, parimet e vendosura në këto deklarata*".

8. Ngritjen e kapaciteteve të nevojshme për parandalimin dhe zbulimin e krimit ekonomik në teknologjinë e informacionit. Qeverisja elektronike po fiton gjithnjë e më shumë terren në administrimin e pasurisë publike dhe ofrimin e shërbimeve publike në Shqipëri dhe është e kuptueshme që përdorimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit të shoqërohet edhe me forma të reja të krimit ekonomik. Kjo është edhe një nga sfidat më të rëndësishme të KLSH në një periudhë afatshkurtër.

9. Përmirësimin e transparencës në marrëdhëniet me publikun, nëpërmjet një partneriteti të gjerë me median dhe me organizatat jo-fitimprurëse të interesuara për bashkëpunim. Vend të veçantë do të zërë partneriteti i KLSH me shoqërinë civile të angazhuar në luftën për parandalimin e mashtrimit financiar dhe korrupsionit.

Për t'i dhënë një impuls, përmbajtje dhe formë krejtësisht të re këtyre marrëdhënieve, brenda programit të 100 ditëve kemi miratuar një udhëzues të veçantë për mënyrën e administrimit të kërkesë/ankesave të publikut, që nga momenti i mbërritjes së tyre dhe deri në dhënien e zgjidhjeve të mundshme brenda kuadrit ligjor në fuqi dhe burimeve njerëzore që disponon KLSH.

Për këtë vit, ndër objektivat kryesorë të KLSH në marrëdhënien me publikun renditet rritja e impaktit në komunikim, njoftime tërësisht transparente, shpërndarja më e gjerë e raporteve të veprimtarisë kontrolluese, si dhe forcimi i kontakteve me të gjithë aktorët dhe faktorët mediatike të vendit tonë, si analistë të njohur, OJF të angazhuara në luftën kundër korrupsionit, etj. Synimi është përcjellja sa më e shpejtë dhe me vërtetësi e të gjithë veprimtarisë kontrolluese të KLSH tek publiku i gjerë, duke shërbyer si një mjet efikas denoncimi dhe parandalimi të korrupsionit.

Në mbyllje, dua t'ju garantoj se do të punojmë për një institucion të lartë auditimi që siguron një komunitet të angazhuar që ka interes ta mbajë qeverisjen qendrore dhe

vendore përgjegjëse. Për këtë do të fuqizojmë rolin e pazëvendësueshëm kushtetues të KLSH si institucioni kryesor ekonomiko-financiar, për ekonominë dhe shoqërinë tonë, me detyrë kontrollin e mirë administrimit të pronës publike dhe shëndoshjen e financave publike, duke i shërbyer me devotshmëri Kuvendit dhe duke rritur pjesëmarrjen e opinionit publik në kontrollin e realizimit të Buxhetit te Shtetit.

Vërejtjet, mendimet dhe propozimet që mund të parashtroni në diskutimet tuaja, do të plotësojnë më së miri drejtimet dhe objektivat e punës sonë.

Ju faleminderit!

Të përcaktohet kufiri për totalin e borxhit shtetëror dhe borxhit të garantuar

- *Prezantimi i Raportit Zbatimit të Buxhetit Faktik të vitit 2011*

13 tetor 2012

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, Kuvendi i Shqipërisë

Deputetët pjesëmarrës

1. Edmond Spaho
2. Erion Braçe
3. Florjon Mima
4. Ervin Koçi
5. Sybi Hida
6. Albert Çaçi
7. Selami Xhepa
8. Arben Ahmetaj
9. Albana Vokshi
10. Adriana Gjonaj
11. Arben Malaj
12. Lefter Koka
13. Sherefedin Shehu
14. Ledina Aliolli
15. Igli Cara
16. Gjoke Uldedaj
17. Gjovalin Kadeli
18. Mimi Kodheli

Të nderuar deputetë,

Në zbatim të ligjit nr. 8417, datë 21/10/1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", neni 164, pika 1, germat a-b; ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, neni 18, pika 1, germat a-b; dhe të ligjit nr. 9936, datë 26/6/2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", nenet 62 e 63; Kontrolli i Lartë i Shtetit paraqet në Kuvendin e Shqipërisë Raportin "Për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2011.

Theksojmë se si arritjet, ashtu dhe parregullsitë dhe dëmet ekonomike që përbëjnë ose jo vepër penale, rekomandimet e dërguara për përmirësimin e gjendjes, vlerësimet për menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditimin e brendshëm, si dhe niveli i zbatimit të masave të rekomanduara, të pasqyruara dhe trajtuara në këtë Raport, janë produkt i

shqyrtimit dhe nxjerrjes së konkluzioneve nga raportet përfundimtare të auditimeve të kryera e të evaduara për llogari të buxhetit faktik të vitit 2011.
Auditimi për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2011, ka përfshirë fushën e ekonomisë, të industrisë, bujqësisë, shëndetësisë, arsimit, rendit publik, transportit dhe telekomunikacionit, mbrojtjes së ambientit, dhënies me qira të objekteve shtetërore, administrimit të pronës dhe një sërë aktivitetesh të tjera ekonomike e sociale.
Objekt auditimi kanë qenë institucionet qendrore dhe vendore, disa sipërmarrje publike ku shteti zotëron mbi 50% të aksioneve, si dhe një numër subjektesh (institucionesh) të pavarur.

Objektivi i Raportit

Objektivi kryesor është dhënia e opinionit për raportin që Ministri i Financave dhe Këshilli i Ministrave paraqet në Kuvend "Për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2011", i formuluar si rezultante e të gjithë auditimeve të kryera për llogari të buxhetit të vitit 2011, mbi rregullaritetin dhe ligjshmërinë e transaksioneve, saktësinë e raportimeve në lidhje me zbatimin e buxhetit, raportimin e borxhit publik, realizimin e të ardhurave dhe administrimin e shpenzimeve, përdorimin e fondit rezervë të KM, funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe organizimin dhe funksionimin e auditimit të brendshëm në sektorin publik.

Opinioni i përgjithshëm mbi zbatimin e Buxhetit të Shtetit 2011

Referuar rezultateve përfundimtare të auditimeve të evaduara dhe raportuara, me objekt zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2011, përfshirë mendimet për raportin e Këshillit të Ministrave për shpenzimet e vitit financiar 2011, para se të miratohet nga Kuvendi i Shqipërisë, opinioni i përgjithshëm i KLSH, është se

- përgatitja, shqyrtimi dhe miratimi i buxhetit të vitit 2011;
- zbatimi, ndjekja dhe rishikimi tij;
- të drejtat dhe kufizimet për huamarrjen, garancitë dhe format e tjera të rrjedhura prej tyre;
- kontrolli, kontabiliteti, raportimi dhe auditimi i këtij buxheti;

Janë kryer në respektim të kërkesave të ligjit nr. 9936, datë 26/6/2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"; ligjit nr. 10355, date 2/12/2010 "Për buxhetin e vitit 2011", ndryshuar me ligjin nr. 10450, date 14/7/2011; ligjit nr. 10496, datë 22/12/2011 "Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit", nr. 4, datë 14/12/2011 të Këshillit të Ministrave "Për një ndryshim në ligjin nr. 10355, datë 2/12/2010 "Për buxhetin e vitit 2011" të ndryshuar; dhe ligjit nr. 10296, datë 8/7/2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".
KLSH vlerëson pozitivisht punën e bërë nga Qeveria dhe veçanërisht nga ana e Ministrisë së Financave në drejtim të konsolidimit të mëtejshëm të reformave të ndërmarra për menaxhimin efektiv të financave

publike, të ruajtjes së qëndrueshmërisë së treguesve makroekonomikë dhe fiskalë. Gjithashtu, dhe në ministritë, institucionet e tjera qendrore dhe vendore, si dhe entet publike të audituara, janë bërë përpjekje serioze për përmbushjen e objektivave dhe realizimin e detyrave të marra përsipër për zbatimin e buxhetit të vitit 2011, si dhe për kryerjen e reformave të ndërmarra në kuadër të "Planit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit.

Treguesit, gjetjet dhe rekomandimet kryesore

Më poshtë paraqesim konstatimet, gjetjet dhe rekomandimet më kryesore të verifikuara dhe të dërguara subjekteve të audituara për llogari të zbatimit të buxhetit të vitit 2011, dhe konkretisht:

Treguesit e konsoliduar fiskalë të buxhetit të shtetit të vitit 2011 janë realizuar përsa vijon:

- Të ardhurat e përgjithshme të buxhetit të shtetit janë realizuar në vlerën 330,475 milionë lekë dhe përfaqësojnë 25.14 të PBB-së të vitit 2011, nga 26.22% të PBB-së që rezultoi në vitin 2010. Në krahasim me të ardhurat e realizuara në vitin paraardhës, ato rezultojnë me rritje në shumën 5,754 milionë lekë.
- Shpenzimet e përgjithshme buxhetore janë realizuar në vlerën 376,652 milionë lekë dhe përfaqësojnë 28.63% të PBB-së të vitit 2011. Në krahasim me shpenzimet e realizuara në vitin 2010, ato paraqiten me rritje në shumën 13,600 milionë lekë. Ndërkohë që, shpenzimet për investime kapitale janë realizuar në vlerën 70,679 milionë lekë duke zënë 5.38% të PBB-së të vitit 2011, nga 67,492 milionë lekë të shpenzuara në vitin 2010 ose në nivelin 5.45% të PBB-së të rezultuar në vitin 2010.
- Deficiti i përgjithshëm i buxhetit në fund të vitit 2011 rezultoi në vlerën 45,877 milionë lekë nga 46,812 milionë lekë të programuara ose në masën 98%, kundrejt përcaktimit vjetor. Kundrejt PBB-së të vitit 2011, niveli i deficitit këtë vit arriti në 3.49%, nga 3.07% të rezultuar në vitin 2010, me një rritje prej 0.42 pikë përqindje.
- Borxhi publik në total, në fund të vitit 2011 rezultoi në vlerën 772,581.5 milionë lekë ose në masën 58.76% kundrejt PBB-së të këtij viti, nga 715,518.5 milionë lekë që rezultoi në vitin 2010 dhe që përfaqësonte 57.79% të PBB-së të vitit 2010. Nga ky borxh, borxhi publik i qeverisjes qendrore rezultoi 772,364 milionë lekë dhe borxhi i qeverisjes vendore 217.8 milionë lekë.
- Stoku i borxhit të brendshëm në fund të vitit 2011 rezultoi me rritje kundrejt vitit 2011 në shumën 31,210 milionë lekë, nga 407,372 milionë lekë në vitin 2010 në 438,582 milionë lekë në vitin 2011, ose në masën 7.66% më shumë. Në raport me PBB-në e vitit 2011, ai rezultoi në masën 33.36%, nga 32.90% të PBB-së që zinte një vit më parë, me një rritje prej 0.46%.

  Ndërsa, stoku i borxhit të jashtëm shtetëror në fund të vitit 2011 arriti në 333,782 milionë lekë ose në masën 25.39% të PBB-së të këtij viti, kundrejt 307,999 milionë

lekë rezultuar në fund të vitit 2010, ose në masën 24.88% të PBB-së të vitit 2010, me një rritje në vitin 2011 kundrejt vitit 2010 në shumën 25,783 milionë lekë ose në masën 8.38% më tepër.

- Borxhi i qeverisjes vendore në fund të vitit 2011 rezultoi 217.8 milionë lekë ose 0.016% të PBB-së, nga 147.5 milionë lekë ose 0.012% të PBB-së që rezultoi në vitin 2010.

Mbi menaxhimin e borxhit publik

Nga analiza e treguesit të borxhit publik kundrejt PBB-së, në harkun kohor të tre viteve të fundit 2009-2011, rezulton se ky tregues varion në nivelet 57.78%-59.30% të PBB-së, pra shumë afër kufirit ligjor prej 60% (zona e rrezikut). Me synim marrjen e masave parandaluese për ndryshimin e dinamikës së borxhit, me tendencë uljen e nivelit të tij, referuar praktikave të disa vendeve të Eurozonës, KLSH i ka rekomanduar MF që:

a) Brenda dy viteve në vijim, të ndërmerret nisma për hartimin e një plani veprimi për të propozuar amendime kushtetuese, ku të përcaktohet që: "***Borxhi total publik nuk duhet të tejkalojë kufirin limit prej 60% të PBB-së***".

Gjithashtu, me qëllim mostejkalimin e këtij niveli, të studiohet mundësia e parashikimit të vendosjes së një pragu të nivelit të borxhit publik kundrejt PBB-së, pas të cilit (nëse ky prag kalohet) Qeveria duhet të marrë masa për balancimin e buxheteve.

Në këtë Raport, ne si KLSH vlerësojmë përgjegjshmërinë dhe profesionalizmin e treguar nga ana e MF me dakordësinë e shprehur për rekomandimet e dhëna nga institucioni ynë. Kështu, me shkresën nr. 4637/17, datë 14/9/2012 "Mbi rekomandimet e raportit përfundimtar të auditimit dhe rekomandimet", të nënshkruar nga Ministri i Financave në lidhje me rekomandimin e mësipërm cilësohet: - shprehemi dakord me ndërmarrjen e kësaj iniciative ligjore".

b) Nga auditimi në MF kemi konstatuar se në ligjet për buxhetin e vitit 2011, nuk janë vendosur kufijtë në lidhje me totalin e borxhit shtetëror dhe totalin e shumës së garancive, sikurse përcakton neni 58 "Kufijtë e borxhit publik" i ligjit nr. 9936 datë 26/06/2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH". Nga MF argumentohet se: "Në lidhje me përcaktimin e kufijve të totalit të stokut të borxhit, përsëri jemi të mendimit se në kushtet e ndryshimit të kursit të këmbimit, rezultatet e stokut të borxhit janë të ndryshme dhe mund të sjellin pasoja negative për tregun e jashtëm dhe të brendshëm, si dhe në perceptimin e kreditorëve për Shqipërinë".

Përsa sipër, vlerësojmë si objektive komentet e bëra nga MF, por meqenëse përcaktimi i kufijve të borxhit është detyrim ligjor, KLSH ka rekomanduar që: Në ligjin "Për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2013", të përcaktohet kufiri për totalin e borxhit shtetëror dhe borxhit të garantuar, ndërkohë MF të ngrejë një grup pune për rishikimin e nenit 58 "Kufijtë e borxhit publik", të ligjit nr. 9936 datë 26/06/2008.

Reagimi është pozitiv. Në shkresën nr. 4637/17, datë 14/9/2012 të Ministrit të Financave theksohet: - "***jemi dakord me ndërmarrjen e kësaj iniciative ligjore dhe rishikimin e kuadrit ekzistues***".

Mbi garancitë shtetërore

a) Në drejtim të borxhit të garantuar, kemi konstatuar se mungojnë memorandumet e mirëkuptimit për marrëveshjet e garancive të lidhura nga MF.

Me synim domosdoshmërinë e vendosjes së procedurave për realizimin e marrëdhënieve në funksion të zbatimit të nenit 38 "Dhënia e garancisë shtetërore të huas" dhe nenit 43 "Kthimi i garancisë shtetërore të huas", të ligjit nr. 9665, datë 18/12/2006 "Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në RSH", KLSH ka rekomanduar që:

MF (Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit) të përgatisë dhe t'i propozojë Këshillit të Ministrave përmirësimin e ligjit nr. 9665, datë 18/12/2006, ku në një nen të veçantë të përcaktohen kushtet dhe kriteret e specifikuara të marrëdhënieve të mirëkuptimit midis MF dhe përfituesit të garancisë, duke i kthyer këto në detyrime ligjore dhe duke eliminuar në këtë mënyrë nënshkrimin e marrëveshjeve të veçanta, për të lehtësuar procesin e realizimit të marrëveshjeve të garancive, referuar zbatimit të këtyre detyrimeve ligjore.

Në shkresën e Ministrit të Financave nr. 4637/17, datë 14/9/2012 cilësohet se: "Ministria e Financave në procesin e rishikimit të ligjit të borxhit do të vlerësojë përmirësimet dhe në aspektin e garancive".

b) Duke u nisur nga shuma e konsiderueshme e papaguar nga huamarrësit dhe përfituesit e garancive, detyrime këto që deri në fund të vitit 2011 arrijnë në shumën 1.69 miliard lekë, referuar dhe problematikës së shfaqur nga ujësjellësit, të rezultuara në vijimësi këto vitet e fundit, të konkluduara në raportet e përvitshme të paraqitura nga KLSH; gjithashtu, nga mungesa e zgjidhjes së kësaj problematike, pavarësisht takimeve të shumta nga struktura përkatëse e MF me institucionet përgjegjëse, kemi rekomanduar që:

- Mbështetur në ligjin nr. 10294, datë 1/7/2010 "Për Inspektimin Financiar Publik", Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik të nisë kryerjen e inspektimeve financiare në ndërmarrjet e ujësjellësve përfituese të nënhuave dhe garancive, me synim zgjidhjen e problematikave në lidhje me:
  - Dokumentacionin, inventarizimin dhe kontabilizimin e përfitimeve nga projektet.
  - Menaxhimin e fondeve publike në drejtim të përmirësimit të rezultateve financiare, të cilat deri tani kanë rezultuar në paaftësi paguese të njësisë në shuma të konsiderueshme.

Në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit Nr. 191/5 dt. 08.05.2012 ndërmjet KLSH dhe MF, nëse MF e gjykon të arsyeshme dhe të nevojshme, mund të kontribuojë dhe KLSH në këtë drejtim.
Në shkresën e Ministrit të Financave nr. 4637/17, datë 14/9/2012 cilësohet se: "***shprehemi dakord***".

Mbi menaxhimin e investimeve publike
Me synim rritjen e efektivitetit të menaxhimit të fondeve për shpenzime publike, KLSH ka rekomanduar që:
a) Në Udhëzimin plotësues që Ministri i Financave nxjerr çdo vit për zbatimin e buxhetit vjetor, Kapitulli I "Procedura specifike shtesë për zbatimin e buxhetit të shtetit "Detajimi i fondeve buxhetore", të shtohet si detyrim përfshirja në financimin e vitit "në radhë të parë", jo vetëm si detyrim ligjor dhe ekonomik, por edhe si dëshmi e bashkëpunimit të sinqertë dhe të drejtpërdrejtë Qeveri-Biznes:

- E të gjitha investimeve të kontraktuara, për punime të cilat rezultojnë të realizuara dhe nuk janë financuar për vitin ushtrimor, si dhe atyre të cilave u mbaron afati kontraktual i punimeve në vitin që po programohet, për diferencën e punimeve të mbetura.
- Për projektet e investimeve "objekte të reja", të synohet në financimin e projekteve në vlerën e plotë të projektit, kur vlera e tyre është e realizueshme brenda vitit buxhetor.

b) Nga shqyrtimi i vendimeve të miratuara nga Komiteti i Zhvillimit të Rajoneve "Për shpërndarjen e fondeve të zhvillimit të rajoneve" është konstatuar që vendimet përmbajnë vetëm vlerën e alokuar në nivel projekti, dhe nuk japin një pamje të qartë të fondeve, sa është vlera e plotë, sa janë alokuar progresivisht deri në vitin buxhetor korrent, si dhe sa mbetet për t'u alokuar në vitet e ardhshme". Për këtë, KLSH ka rekomanduar që:

- Në aneksin nr. 3 të ligjit "Për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2013", të vendoset detyrimi që: "Vendimi i Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve për detajimin e grandeve konkurruese në nivel projekti duhet të përmbajë:
  a) Vlerën e plotë të projektit për objektet e reja apo vlerën e kontratës së lidhur për objektet në proces.
  b) Vlerën e fondeve të alokuara dhe të realizuara deri në vitin korrent buxhetor.
  c) Alokimin e fondit në vitin korrent.
  d) Vlerën e mbetur për buxhetim në periudhën pasardhëse".

Në shkresën e Ministrit të Financave nr. 4637/17, datë 14/9/2012 cilësohet se: "Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve i ngritur pranë Zyrës së Kryeministrit, në detyrat funksionale të tij të sanksionuara edhe sipas germës g, të pikës IX, të aneksit 3 të ligjit për buxhetin e çdo viti, në dokumentacionin e marrë nga

sekretariatet teknike të ministrive të linjës përfituese nga këto fonde, ka të evidentuar dhe analizuar informacionin që propozohet për t'u shtuar në Aneksin 3 nga ana e KLSH-së. ***Nisur nga ky fakt, e gjykojmë të drejtë rekomandimin tuaj që ky informacion të bëhet pjesë e Aneksit 3 të ligjit të buxhetit 2013".***

Sa më sipër, në shkresën e Ministrit të Financave nr. 4637/17, datë 14/9/2012 cilësohet se: " rekomandimi ka gjetur pasqyrim në pikën 65 të udhëzimit nr. 2, date 6/2/2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, por do të gjejë pasqyrim në udhëzimin plotësues të zbatimit të buxhetit për vitin 2013".

Mbi fondet e kontigjencave

Kemi konstatuar se fondi i subvencionit i MF është alokuar nga fondi i kontigjencës për ruajtjen e defiçitit, që në 6/mujorin e parë të vitit 2011. Mbështetur në përcaktimet në Ligjin Organik të Buxhetit dhe në ligjin vjetor të buxhetit, KLSH ka rekomanduar: Planifikimin në ligjin vjetor të buxhetit të vitit 2013 dhe në vazhdim, nga MF të fondeve kontigjencë për ruajtjen e deficitit buxhetor, me të drejtë të përdorimit nga Kuvendi i Shqipërisë. E drejta e rialokimit të këtij fondi të përcaktohet nga Kuvendi, për përdorim nga KM vetëm në fund të periudhës vjetore buxhetore, atëherë kur realizimet e të ardhurave dhe shpenzimeve janë progresivisht, konform treguesve buxhetorë të miratuar të vitit.

Në shkresën e Ministrit të Financave nr. 4637/17, datë 14/9/2012 cilësohet se: "Përcaktimi i propozuar nga ana e ekspertëve të KLSH është i drejtë dhe mund të bëhet pjesë e ligjit të buxhetit të vitit 2013".

Mbi monitorimin e Buxhetit të Shtetit

Duke marrë shkas nga konstatimi që në raportin "Mbi monitorimin e realizimit të shpenzimeve të vitit 2011", i cili është pjesë e raportit që MF ka dërguar në KM "Për miratimin e buxhetit faktik të vitit 2011", treguesit e realizimit të shpenzimeve të ministrisë së linjës nuk përmbajnë shpenzimet faktike të financuara nga të ardhurat jashtë limitit apo edhe nga financimi i huaj, si dhe që për rrjedhojë këto raporte nuk rakordojnë me raportet e konsoliduara të MF për shpenzimet faktike, KLSH ka rekomanduar që: Nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit t'i kërkohet ministrive të linjës që në raportet e monitorimit në një rubrikë të veçantë të trajtohen shpenzimet faktike të kryera për të ardhurat jashtë limitit apo edhe mospërputhjet e financimit të huaj.

Në shkresën e Ministrit të Financave nr. 4637/17, datë 14/9/2012, ndër të tjera cilësohet se: "kjo kërkesë do të jetë pjesë e udhëzimit të monitorimit, i cili është në proces".

Mbi zbatimin e vendimeve gjyqësore

Gjatë auditimeve në disa ministri, institucione të tjera qendrore dhe vendore, kemi konstatuar pagesa të detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë për kthimin e nëpunësve civilë në vendin e punës me impakte negative financiare të konsiderueshme. Në disa raste specifike, kemi vërejtur pagesa njëkohësisht të dy punonjësve në një vend pune, si p.sh. pagesën e vendimeve gjyqësore në administratën tatimore për vitin 2011 me rreth 35 milionë lekë.

Theksojmë që si KLSH do të kryejmë vitin që vjen auditim të performancës për një vlerësim tërësor të marrjes së vendimeve gjyqësore për njësitë publike, duke u përqendruar në analizën e shkaqeve që çuan në këto vendime. Jemi të vetëdijshëm dhe nuk duam kurrsesi të cenojmë pavarësinë dhe padiskutueshmërinë e vendimeve të gjyqësorit, por përballë shumë vendimeve arbitrare që kanë sjellë dëm të konsiderueshëm financiar në Buxhetin e Shtetit, në bashkëpunim me organet e Drejtësisë dhe me struktura të tjera specializuara, do të përpiqemi të identifikojmë përgjegjësitë institucionale duke dhënë rekomandimet përkatëse dhe duke informuar Kuvendin e Shqipërisë, Presidentin, Kryeministrin, Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe Gjykatën e Lartë.

Kemi rekomanduar që institucionet respektive të marrin masa për zbatimin e vendimeve gjyqësore, njëkohësisht të analizojnë gjendjen dhe të përcaktojnë përgjegjësinë ndaj personave shkaktarë përgjegjës, duke kërkuar shpërblimin e dëmit ekonomik shkaktuar Buxhetit të Shtetit.

Mbi administrimin e të ardhurave buxhetore nga organet tatimore

Në vlerësim të performancës së administratës tatimore, theksojmë punën dhe përpjekjet për realizimin e të ardhurave për vitin 2011, me impakt dinamikën në rritje të të ardhurave nga njëra periudhë në tjetrën.

Megjithatë, konstatojmë që në vlerë nominale të ardhurat nuk janë realizuar kundrejt parashikimit. Konkretisht, realizimi i të ardhurave është 94 përqind kundrejt parashikimit, me impakt defiçitar prej 9,085 milionë lekë.

Ndër faktorët që kanë ndikuar negativisht në nivelin e të ardhurave tatimore kundrejt parashikimit për vitin 2011, rendisim:

- mosrritja e të ardhurave tatimore në proporcion me rritjen e numrit të subjekteve;
- niveli i ulët i pagesës së TVSH-së;
- rritja e subjekteve kreditore për TVSH-në dhe Tatimin mbi Fitimin;
- rritja e subjekteve me aktivitet me humbje;
- ulja e nivelit të arkëtimeve nga njëra periudhë në tjetrën, për TVSH-në, lojërat e fatit, taksën e qarkullimit dhe taksën e karburantit;
- rritja e numrit të subjekteve debitore nga njëra periudhë në tjetrën;

- mosevidentimi dhe moskontrolli i subjekteve me risk të lartë, referuar treguesve negativë që ata kanë;
- mungesa e luftës kundër informalitetit dhe konkurrencës së pandershme në evidentimin dhe regjistrimin e subjekteve të paregjistruara;
- moskryerja e kontrolleve nga struktura të DPT-së në Drejtoritë Rajonale Tatimore mbi ekzistencën e numrit të subjekteve mosdeklarues;
- mosvlerësimi dhe mosndjekja nga strukturat përkatëse të DPT-së të deklarimit të numrit të kontribuesve nga subjekte të ndryshëm, ku realisht ekzistojnë
- mundësi dhe rezerva për rritjen e numrit të tyre dhe uljen e evazionit;
- mosbashkëpunimi në nivelin e duhur i DPT me institucionet e auditimit të
- jashtëm.

❖ Borxhi tatimor, për vitin 2011 rezultoi 64,734 milionë lekë dhe përfaqësoi 38.2% të planit të të ardhurave të këtij viti. Me synim uljen e nivelit te borxhit, kemi rekomanduar qe nga administrata tatimore të merren të gjitha hapat ligjore për pakësimin e gjendjes së borxhit nëpërmjet zbatimit në kohë dhe me rigorozitet të procedurave ligjore të vjeljes së tij, me qëllim që subjekteve debitore të mos ju parashkruhet borxhi, madje cilësia dhe shpejtësia në mbledhjen e borxhit duhet të
jetë një faktor kyç në realizimin e të ardhurave të programuara të DPT.

❖ Përsa i përket efektivitetit të masave shtrënguese konstatohet se ato janë aplikuar ne 42 përqind të subjekteve dhe në vlerë nga 58,565 milionë lekë borxhi, janë marrë masa për vlerën 41,717 milionë leke. Ne lidhje me nivelin e arkëtimeve nga aplikimi i masave shtrënguese, rezultoi që vetëm 9.4 përqind e numrit të subjekteve kanë derdhur detyrimet në favor të Buxhetit te Shtetit, ose 4.8% të vlerës për arkëtim.

❖ Kemi konstatuar një rritje të nivelit kreditor për kategoritë e të Ardhurave tatimore nga Tatimi mbi Fitimin dhe TVSH, te cilat rezultojnë ne nivele me te larta se pagesat e kryera për to. Kemi rekomanduar që strukturat përgjegjëse të bëjnë analiza të veçanta ku të evidentohen prirjet dhe në bashkëpunim me strukturat e kontrollit tatimor të ushtrohen kontrolle sipas vlerësimit që do të bëhet.

❖ Për kontributin e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, u konstatua se të ardhurat nga kontributet janë pothuajse të barabarta si nga sektori publik dhe nga sektori privat, megjithëse numri i kontribuuesve në sektorin privat është dukshëm më i madh krahasuar me sektorin shtetëror. Për vitin 2011 është rritur numri i subjekteve që nuk deklarojnë kontribuues për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Mbi administrimin e të ardhurave buxhetore nga organet doganore

KLSH vlerëson se për vitin 2011 administrata doganore ka ndërmarrë përpjekje serioze për reformim dhe modernizim, duke përmirësuar Kodin Doganor dhe thelluar dixhitalizimin e regjistrimit të të dhënave doganore. Ajo ka realizuar dhe tejkaluar të ardhurat e programuara për vitin 2011. Të ardhurat tatimore nga sistemi doganor për

vitin 2011 janë realizuar në masën 101,2%, me një tejkalim në vlerë prej 1,486 milionë lekë.

Borxhi doganor është ulur. Për vitin 2011 ai rezultoi në 2,959 mijë lekë, nga 12,298 milionë lekë në fund të vitit 2010. Pas shumë vitesh, ky borxh paraqitet me ulje, madje ulje të madhe, si në vlerë dhe në numër subjektesh. Kundrejt të ardhurave doganore të realizuara në vitin 2011, vlera e borxhit doganor zë rreth 2.3% nga 10.3% që zinte një vit më pare.

Krahas performancës së mirë, kemi konstatuar parregullsi dhe shkelje në disa degë doganore. Si pasojë e moszbatimit korrekt të dispozitave të legjislacionit doganor (Kodi Doganor dhe dispozitat zbatuese të tij) nga ana e administratës doganore, është akumuluar një efekt negativ financiar në të ardhurat e buxhetit të vitit 2011 në formën e të ardhurës së munguar në shumën 50,323 mijë lekë.

Ndër masat që kemi rekomanduar veçojmë rritjen e rolin mbikëqyrës të DPD mbi degët doganore, nëpërmjet kontrolleve të ndryshme të strukturave të saj të specializuara, sidomos për funksionimin e regjimeve ekonomike, duke shfrytëzuar të gjithë bazën ligjore fiskale për maksimizimin e të ardhurave doganore.

KLSH ka rekomanduar gjithashtu që DPD nëpërmjet strukturave të saj të specializuara të marrë masa për rikuperimin e borxhit në vlerën 2,959 milionë lekë.

Me synim rritjen e efektivitetit të Auditimit të Brendshëm, veprimtaria e kësaj strukture duhet të fokusohet në vlerësimin e funksionimit mbi bazë sistemesh, veçanërisht të sistemit të kontrollit të brendshëm, vlerësimin e riskut dhe performancës së monitorimit, në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit për DPD-në.

Mbi zbatimin e buxhetit të pushtetit vendor

Për vitin 2011, të ardhurat e grumbulluara nga vetë pushteti vendor janë realizuar në masën 77.1%, me një impakt deficitar në vlerë prej 3,508 milionë lekë. Kundrejt të ardhurave të realizuara në vitin 2010, përkatësisht në shumën 11,898 milionë lekë, ato paraqiten me ulje për 106 milionë lekë.

Sipas llojit të të ardhurave vendore, rezulton se:

- Taksa lokale paraqitet me mosrealizim të theksuar, etëm në masën 66.6% kundrejt planit, me një mosrealizim në vlerë prej 3,650 milionë lekë.
- Taksa mbi pasurinë në masën 105%, me një tejkalim në vlerë prej 92 milionë lekë.
- Të ardhurat nga tatimi mbi biznesin e vogël në masën 102%, me një tejkalim në vlerë prej 50 milionë lekë.

Nga analizimi i punës dhe nivelit të realizimit të të ardhurave të bashkive dhe të komunave nxjerrim konkluzionin se ato gjenden para një mosrealizimi të thellë, pasi pothuajse në të gjitha bashkitë dhe komunat niveli i të ardhurave luhatet nga 50-80%.

Arsyet e mosrealizimit janë të shumta, por ndër to veçojmë:

a) Mosndjekjen dhe moszbatimin me rigorozitet të përcaktimeve në kuadrin ligjor që rregullon grumbullimin e të ardhurave vendore, përfshirë udhëzimet e përbashkëta, ndërmjet MF me MB dhe DPT-në, me pasojë mosrealizimin e detyrave të planifikuara.
b) Mangësitë në bashkëpunimin dhe rakordimin me organet tatimore dhe agjentet tatimor, konkretisht ndërmjet zyrave të taksave në njësitë vendore, me Drejtoritë Rajonale Tatimore në qarqe dhe qytete, zyrat e gjendjes civile, të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, zyrave të kadastrës dhe të urbanistikës, gjë që ka ndikuar si në planifikimin jo real ashtu dhe në realizimin në nivele të ulëta të taksave dhe tarifave vendore.
c) Moskryerjen periodikisht të kontrollit fiskal dhe mosmarrjen e masave ndëshkimore ndaj subjekteve të parregullta, konform dispozitave ligjore në fuqi. KLSH në bashkitë e audituara ka konstatuar subjekte të parregullt të cilët ushtrojnë aktivitet pa leje dhe nuk paguajnë detyrimet për taksat vendore. Ndërkohë, nga zyrat e taksave vendore në Bashki nuk zbatohen procedurat e nevojshme ligjore për arkëtimin e detyrimeve vendore.
d) Mangësitë në dokumentimin e taksave dhe tarifave vendore.
e) Shkeljet e ndryshme ekonomiko-financiare me pasojë mosarkëtimin e të ardhurave nga burime të parashikuara me dispozita ligjore në vlerën 155,8 milionë lekë, konkretisht:
- Në fushën administrimit të aseteve për shitjen dhe dhënien me qira të tyre.
- Në fushën e urbanistikës, si rezultat i mospagesës së detyrimeve nga subjektet për marrjen e lejes së ndërtimit; mosarkëtimit të detyrimeve nga financimi i studimeve urbanistike dhe i taksës së ndikimit në infrastrukturë nga subjektet që janë pajisur me leje ndërtimi.
- Në fushën e legalizimeve të ndërtimeve pa leje, ku nga auditimi në Drejtorinë Qendrore të AUIZNI-t dhe Drejtoritë Rajonale të ALUIZNI Tiranë, Durrës dhe Vlorë, në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 3/4/2006 janë miratuar legalizime dhe arkëtuar më pak të ardhura. Gjithashtu, mosrealizimi i të ardhurave ka ardhur dhe si pasojë e mospërputhjes në zbatim ndërmjet ligjit nr. 9482, datë 3/4/2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" i ndryshuar; dhe vendimit të KM nr. 1180, datë 5/8/2008 "Për përcaktimin e vlerës së shërbimit për legalizim dhe mbledhjen e administrimin e të ardhurave të procesit të legalizimit".
Krahas propozimeve për ndryshime për përmirësimin e legjislacionit në fuqi, KLSH i ka rekomanduar njësive të ALUIZNI-t një sërë masash të karakterit organizativ e disiplinor, si dhe shpërblim të dëmit të shkaktuar në vlerën 127,7 milionë lekë.

- Shpenzimet faktike të pushtetit vendor për vitin 2011 rezultuan në masën 95.9% kundrejt planit, me një mosshpenzim në vlerë prej 1,195 milionë lekë. Krahasuar me nivelin e shpenzimeve të realizuara në vitin 2010 (30,764 milionë lekë), ato

rezultojnë në masën 8% më të ulëta, e barabartë me 2,645 milionë lekë fond shpenzimesh në pak.

Auditimet e ushtruara nga KLSH në këtë fushë janë përqendruar në zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare, lidhur me administrimin dhe përdorimin e fondeve buxhetore, në përfundim të të cilave krahas punës së bërë, janë konstatuar edhe mjaft parregullsi dhe shkelje të dispozitave ligjore në fuqi, me dëm ekonomik në shumën 24,7 milionë lekë.

- Krahas sa më sipër, gjatë auditimeve në njësitë e pushtetit vendor janë konstatuar probleme dhe në drejtim të zbatimit të vendimit të KM nr. 396, date 21/6/2006 "Për kriteret e transferimit dhe të përdorimit të pyjeve nga njësitë e qeverisjes vendore", kur aktualisht rreth 70% e pyjeve dhe kullotave i janë transferuar njësive të pushtetit vendor (komunave) në pronësi.

Kemi konstatuar se kuadri ligjor mbi pyjet dhe kullotat rezulton përgjithësisht i kompletuar, por megjithë përmirësimet dhe plotësimet, përsëri ngelet ende për të bërë. Shkalla më e lartë e dëmeve në pronat komunale në krahasim me ato shtetërore e vërteton këtë fakt.

Në DSHP-të e audituara ka rezultuar se dëmtimi i pyjeve dhe kullotave, sidomos nga zjarret mbeten problemi kryesor dhe më shqetësuesi. Problematika në shuarjen e zjarreve është mjaft e gjerë. Pamjaftueshmëria e mjeteve teknike e lëvizëse që disponon Policia Pyjore dhe Shërbimi Zjarrfikës, si dhe gjendja teknike e tyre, në shumë raste nuk lejojnë përdorimin e tyre në terrenet e vështira pyjore.

Mbi zbatimin e Buxhetit të Sigurimeve Shoqërore

- Plani i të ardhurave për fondin e sigurimeve shoqërore, nga 50,010 milionë lekë të programuara, është realizuar në shumën 48,396 milionë lekë, në masën 96.8%, me një mosrealizim në vlerë prej 1,614 milionë lekë.
- Nga ISSH janë ndjekur dhe respektuar çdo muaj kufijtë e programuar të fondeve për transfertat në buxhetet familjare sipas programit të përcaktuar me ligjin për buxhetin e shtetit të vitit 2011 dhe me vendime të veçanta të KM. Shpenzimet janë mbajtur nën kontroll për të gjitha skemat.
- Gjatë vitit analizues, janë përmirësuar rregullat dhe procedurat e administrimit të shpenzimeve, sidomos të drejtim të minimizimit të informalitetit në pensionet dhe trajtimet e veçanta financiare dhe të zbatimit të masave më efektive për bllokimin e shpenzimeve të tepërta, tërheqjen e rregullt të financimeve shtetërore dhe shmangien e tejkalimeve.

Janë përmirësuar procedurat e shërbimeve ndaj përfituesve, sidomos afatet e caktimit të pensioneve të reja dhe janë ulur ditët e qëndrimit të një pensioni në proces të verifikimit të dokumentacionit për caktimin e tij.

Gjatë auditimit në ISSH, vend i veçantë i është kushtuar vlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe vlerësimit të efektivitetit të tij, për realizimin e objektivave dhe performancës të tij.

Ndonëse objektivat, në përgjithësi janë realizuar në aspektet e parashikuara, njëkohësisht me to paraqesim dhe disa nga gjetjet më kryesore si vijon:

a) Në fushën e përfitimeve afatgjata: nga auditimi i ushtruar në dosjet e pensioneve që paguhen nga fondet e DRSSH-ve Tiranë, Durrës, Elbasan, Lezhë dhe Kukës, janë konstatuar shkelje të ligjit nr. 7703, datë 11/5/1993 "Për sigurimet shoqërore" dhe të kërkesave të Rregullores nr.1, datë 21/1/2008 "Për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve", në 35 raste, me një efekt financiar negativ për arkën e shtetit në shumën prej 8,8 milionë lekë. Më konkretisht, nga ballafaqimi dhe kryqëzimi i informacioneve dhe të dhënave në Regjistrin Elektronik të Pensioneve të ISSH dhe Regjistrin Kombëtar të Shtetasve, janë vërtetuar pasaktësi në hedhjen e të dhënave të përfituesve; janë përfituar njëkohësisht nga të njëjtët persona dy pensione; gabime në përllogaritjen e vjetërsisë së punës për efekt pensioni, (pasaktësi në hedhjen e viteve apo kategorive të punës së kryer); përfitime në mënyrë të parregullt me anë të mashtrimit dhe përdorimit të dokumentacionit fiktiv; si dhe mungesë të të dhënave të përfituesve në Regjistrin Kombëtar të Shtetasve.

b) Të meta dhe mangësi në realizimin e objektivave të parashikuara në programin vjetor të të ardhurave nga kontributet e fermerit, si pasojë e mangësive në kuadrin rregullativ dhe moszbatimin me efektivitet të masave shtrënguese në luftën kundër informalitetit dhe derdhjes së detyrimeve për kontributet e detyrueshme nga të vetëpunësuari në bujqësi, duke i ndjekur çështjet deri në Zyrën e Përmbarimit.

Përsa më sipër, KLSH i ka rekomanduar ISSH-së një sërë masash, duke filluar nga shqyrtimi i kuadrit rregullues legjislativ, ndërmarrja e veprimeve efektive dhe deri në ndjekjen e të gjitha rrugëve ligjore për vënien në arkëtim të vlerave të dëmeve që i janë shkaktuar arkës së shtetit për të gjithë përfitimet e paligjshme.

Është e domosdoshme që ISSH të përcaktojë një Strategji të Përgjithshme për reformimin e sistemit aktual të sigurimeve shoqërore, nëpërmjet marrjes së mendimit të aktorëve të interesuar, si atyre privatë dhe publikë.

Mbi zbatimin e Buxhetit të Sigurimeve Shëndetësore

Kemi konstatuar se nga stafi i ISKSH niveli i punës së menaxhimit dhe administrimit të fondeve të vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit, ka ardhur në rritje. Vlen të pasqyrohen arritjet e veprimtarisë kontrolluese dhe audituese të Drejtorisë së Kontrollit Farmaceutik dhe Parësor dhe Drejtorisë së Kontrollit Spitalor, si dhe Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, në drejtim të rritjes së forcës së zbatimit të ligjit, përfshirë zbatimin e detyrave për arkëtimin e vlerave të rekomanduara për shpërblim dëmi.

Duhet përmendur puna menaxhuese në drejtim të vendosjes dhe heqjes së barnave nga lista, duke ruajtur balancat e kushtëzuara nga disponibiliteti i buxhetit të akorduar për barnat. Futja e metodave bashkëkohore në sistemin farmaceutik është arritje e vlerësueshme dhe ka sjellë rezultate pozitive në mënyrën e dokumentimit të barnave që rimbursohen dhe minimizimin e abuzimeve nga kontraktuesit.

Krahas arritjeve dhe vlerësimit të punës së bërë, u konstatuan mangësitë e mëposhtme:

a) Gjatë zbatimit të kontratave me farmacitë dhe agjencitë në DRSKSH Tiranë është konstatuar se në 27 kontrata me vlerë rimbursimi të kryer në shumën 44,5 milionë lekë, kjo shumë është përdorur pa u zbatuar kriteret e caktuara në kontratat dypalëshe dhe në legjislacionin përkatës në fuqi. Këto farmaci kanë kryer aktivitet tregtimi ilaçesh rimbursimi pa dokumentacion të rregullt ligjor në marrëdhënie me DRSKSH Tiranë, pa plotësuar kriteret e vendosura në kontratë dhe udhëzimin përkatës të Këshillit Administrativ, pa kontrata shtesë, madje me veprime jo ligjore në nënshkrimin e kontratës, si dhe pa dokumente licencimi.

b) Mungesë bashkëpunimi ndërmjet drejtorive të kontrollit dhe të përcaktimit qartë të detyrave të tyre.

Vlerësimi i situatës së menaxhimit financiar e kontrollit dhe auditimit të brendshëm.

Konstatimet, gjetjet dhe rekomandimet për vlerësimin e situatës së menaxhimit financiar e kontrollit si dhe rezultatet e mbikëqyrjes që KLSH ka kryer mbi organizimin dhe funksionimin e auditimit të brendshëm në sektorin publik janë trajtuar në pjesën e tretë të Raportit "Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin si dhe auditimin e brendshëm".

Disa mendime për Raportin e Këshillit të Ministrave për shpenzimet e vitit financiar 2011

Referuar të dhënave të raportuara të realizimit të treguesve të vitit 2011 në nivel makroekonomik dhe nga analizimi i tyre, konkludojmë se ekonomia shqiptare ndonëse me ritme më të ngadalta mundi t'í përballojë efekteve të krizës ekonomike që ka përfshirë vendet e Eurozonës, madje arriti të sigurojë një rritje pozitive të zhvillimit ekonomik të vendit dhe të ruaj ekuilibrat kryesorë makroekonomikë, nëpërmjet respektimit të kufirit të borxhit publik nën 60% të PBB-së dhe ruajtjes të niveleve të ulëta për deficitin buxhetor vjetor.

Pasqyrojmë se normat e rritjes ekonomike të vitit 2011, rezultojnë përafërsisht në nivelin e realizimit të një viti më parë. Për sigurimin e një niveli të tillë, krahas masave për zhvillimin dhe transformimin ekonomik, si dhe politikat makroekonomike të ndjekura, duhen vlerësuar përpjekjet dhe politika monetare e ndjekur nga Banka e Shqipërisë për kontrollin e inflacionit dhe ruajtjen e stabilitetit financiar.

Niveli i treguesve fiskalë të realizuar gjatë vitit 2011, u bë i mundur me miratimin e rishikimit të buxhetit gjatë këtij viti, duke kombinuar ruajtjen e ritmit të realizimit të të ardhurave buxhetore të programuara me pakësimin e shpenzimeve. Në shifra konkrete, sipas të dhënave të siguruara gjatë kontrolleve të ushtruar në MF dhe BSH, treguesit kryesorë makroekonomikë dhe ata fiskalë të buxhetit të shtetit të vitit 2011, paraqiten:

- Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) si një nga treguesit kryesorë (me çmimet korrente) ka arritur në kuotën e 1,314,700 milionë lekë.

Politika monetare e ndjekur nga BSH ka bërë të mundur përmbushjen e objektivit kryesor të saj, mbajtjen nën kontroll të inflacionit, brenda kufirit për një inflacion vjetor 2-4%. Në vitin 2011, niveli mesatar vjetor i inflacionit ka rezultuar 3.5%, pothuajse i përafërt me atë të një viti më parë, duke ndihmuar favorshëm mjedisin ekonomik të vendit tonë.

Për vitin 2011, shpenzimet e përgjithshme të buxhetit të shtetit janë realizuar në masën 96.3%, me një mosshpenzim në vlerë prej 14,507 milionë lekë ndaj planifikimit, kurse kundrejt realizimit të një viti më parë, paraqiten me rritje në masën rreth 3.75% dhe në vlerë 13,600 milionë lekë më shumë.

Në strukturë, shpenzimet korrente dhe kapitale, janë realizuar në masën 97.1% dhe 93.2% dhe ato zënë përkatësisht: 81.2% dhe 18.8% të totalit të shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit të shtetit të këtij viti.

Konstatohet se, shpenzimet korrente janë realizuar në një përqindje më të madhe se sa niveli i realizimit të shpenzimeve kapitale. Rezulton se fondet e shpenzuara në zërin "Shpenzime korrente" në vitin 2011 krahasuar me një vit më parë, paraqiten me ritëm rritjeje më të ulët se sa fondet e përdorura për shpenzimet kapitale në vitin 2011 kundrejt vitit 2010.

Analizuar sipas zërave të shpenzimeve korrente rezulton se:

1. Shpenzimet për personelin zënë rreth 22.06% të totalit të shpenzimeve korrente dhe kundrejt PBB-së të vitit 2011, shpenzimet e personelit zënë 5.13%, nga 5.31% të PBB-së të rezultuar në vitin 2010. Shpenzimet për paga të realizuara në vitin 2011, kundrejt atyre të realizuara një vit më parë, rezultojnë me rritje në masën 2.54%, nga 56,951 milionë lekë të shpenzuara në vitin 2010, në 58,398 milionë lekë në vitin 2011, me një rritje në vlerë prej 1,447 milionë lekë.

2. Shpenzimet operative mirëmbajtje, zënë rreth 10.4% të totalit të shpenzimeve korrente të realizuara në vitin 2011, nga 11.4% që përfaqësonin në vitin 2010.

3. Shpenzimet për interesat zënë rreth 13.45% të totalit të shpenzimeve korrente të realizuara në vitin 2011, nga 13.82% që zinin një vit më parë.

4. Shpenzimet për subvencione, zënë rreth 1.07% të totalit të shpenzimeve korrente të realizuara në vitin 2011, nga 1.2% që zinin një vit më parë. Kundrejt kuotës së planifikuar, ato janë realizuar në masën 100.3%, me një tejkalim në vlerë prej 9 milionë lekë. Shpenzimet për subvencione të realizuara në vitin 2011, krahasuar me ato të

realizuara në vitin 2010, rezultojnë me ulje në masën rreth 6.6% ose në shumën 234 milionë lekë më tepër.

Referuar raporteve të konsoliduara rezulton se fondet e subvencioneve kanë ndryshuar nga buxheti fillestar në sasi të konsiderueshme nga 1,830.6 milionë lekë lekë në fillim viti në 3,372 milionë lekë, pra me një rritje prej 1,541 milionë lekë ose 84%. Kjo rritje konstatohet kryesisht në Ministrinë e Financave ku nuk ka pasur të pasqyruar subvencion në planin e fillimit të vitit. Nga auditim rezultoi se, me vendime të KM, MF-ve i është çelur fond subvencion (artikull 603) për "Kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e pajisjeve fiskale dhe taksimetrave tek njësitë e qeverisjes vendore" në shumën 1,524,395,812 lekë (sipas situacionit të shpenzimeve) të konfirmuar nga thesari.

5. Shpenzimet për fonde speciale (sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe fondi i kompensimit në vlerë të pronarëve), zënë rreth 37.28% të totalit të shpenzimeve korrente të realizuara në vitin 2011, nga 35.30% që zinin në vitin 2010.

6. Shpenzimet për buxhetin vendor zënë rreth 9.2% të totalit të shpenzimeve korrente të realizuara në vitin 2011, nga 10.2% që zinin në vitin 2010, pra me një ulje prej 1%. Në vitin 2011, këto shpenzime zënë 2.14% të PBB-së të këtij viti, nga 2.48% të PBB-së që zinin në vitin 2010, pra konstatohet një ulje prej 0.34%. Shpenzimet për buxhetin vendor të realizuara në vitin 2011, krahasuar me ato të realizuara në vitin 2010, rezultojnë me ulje në masën rreth 8.6% dhe në vlerë 2,645 milionë lekë më pak.

7. Shpenzime të tjera sociale (pagesa e papunësisë, ndihma ekonomike dhe fondi i kompensimit për ish të përndjekurit politikë) zënë rreth 6.13% të totalit të shpenzimeve korrente të realizuara në vitin 2011. Në vitin 2011, këto shpenzime zënë 1.43% të PBB-së të këtij viti, nga 1.51% të PBB-së që zinin në vitin 2010. Në strukturë, shpenzimet për pagesën e papunësisë, ndihmën ekonomike dhe fondin e kompensimit për ish të përndjekurit politikë, janë realizuar respektivisht 93.2%, 98% dhe 83.3%, dhe në vlerë 64 milionë lekë, 336 milionë lekë dhe 400 milionë lekë, më pak se sa kuotat e planifikuara.

Shpenzimet për kompensimin e ish të përndjekurve politikë rezultojnë me rritje të ndjeshme nga 1,000 milionë lekë të shpenzuara në vitin 2010, në vitin 2011 janë shpenzuar 1,500 milionë lekë, me një rritje në masën 50% dhe në vlerë 500 milionë lekë më tepër. Pavarësisht tendencës në rritje të buxhetimit të kësaj kategorie shpenzimesh, theksojmë që nevojat dhe detyrimet ligjore e morale për këtë shtresë sociale kërkojnë planifikimin e shifrave shumë më te larta se këto.

- Shpenzimet kapitale (me financim të brendshëm dhe të jashtëm), zenë rreth 18.8% të totalit të përgjithshëm të shpenzimeve të realizuara në vitin 2011, nga 18.6% që zinin në vitin 2010.

Në vitin 2011, krahasuar me vitin 2010, ka një ulje të peshës specifike të shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm me 11%.

Kundrejt PBB-së të vitit 2011, shpenzimet kapitale me financim të brendshëm dhe të huaj zënë përkatësisht 3.13% dhe 2.13%, nga 3.77% dhe 1.68%të PBB-së të rezultuar në vitin 2010.

Krahas mendimeve dhe rekomandimeve të parashtruara më sipër, me synim miradministrimin dhe rritjen e efektivitetit të përdorimit të fondeve publike për shpenzime, gjatë vitit të ardhshëm buxhetor sugjerojmë:

- Konsolidimin dhe mirëfunksionimin e strukturave të menaxhimit financiar dhe kontrollit në përgjithësi, në përputhje me kërkesat e legjislacionit të miratuar për sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe në përputhje me kërkesat e parashtruara nga BE për vendin tonë në kuadër të Kontrollit të Brendshëm Financiar të Sektorit Publik (KBFSP).

Në këtë kontekst, për miradministrimin e shpenzimeve publike, krahas kuadrit ligjor rregullator i cili tashmë është konfiguruar dhe plotësuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit të vendit tonë në BE, kërkohet thellimi dhe përmirësimi cilësor i veprimtarisë së kontrollit brendshëm, auditimit të brendshëm, madje dhe auditimit të jashtëm.

- Referuar strukturës së shpenzimeve dhe gjetjeve të KLSH të pasqyruara në këtë raport, ka vend për të riparë kuotimin dhe përdorimin e fondeve të shpenzimeve brenda zërave të shpenzimeve korrente. Madje, ka vend për rishikim dhe brendapërbrenda zërave kryesorë të shpenzimeve, si të disa nënzërave të llogariten 602, siç u veprua me shpenzimet për mirëmbajtjen dhe përdorimin e autoveturave me daljen e ligjit nr. 10160, datë 15/10/2009 "Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë".
- Në lidhje me shpenzimet për interesa, ato priren drejt rritjes, sidomos në kushtet e bërjes efektive të kredive apo huave të marra, ndaj kërkohet përcaktimi i masave më të efektshme në pagesën e tyre, sidomos në reduktimin e deficitit buxhetor dhe zgjatjen e afateve të maturimit.
- Përdorimin më me efektivitet të fondeve për investime publike, nëpërmjet rritjes së përgjegjshmërisë të nëpunësve të administratës publike, të nivelit teknik dhe profesional të tyre, si dhe të kërkesës të institucioneve të ngritur me ligj për monitorimin dhe respektimin e dispozitave ligjore në fuqi në fushën e prokurimit publik të fondeve publike për investime.

Krahas rritjes së borxhit publik dhe masave që duhen marrë në këtë drejtim, sikurse e trajtuam me sipër, shqetësim për ekonominë tonë përbëjnë borxhet që Buxheti i Shtetit ka kundrejt sipërmarrësve private. Në kushtet aktuale sugjerojmë shqyrtimin me realizëm të gjendjes së borxheve, përcaktimi i masave për tí dhënë mundësi dhe për të lehtësuar sa të jetë e mundur kompanitë private nga kosto e kredive që ato mund të kenë marrë për përmirësimin e situatës së tyre financiare, nëpërmjet ndërhyrjes për

ristrukturimin e kredive dhe ndërkohë mbledhjen e borxheve të këqija. Gjithashtu duhet kërkuar nga sistemi bankar të inkurajojë dhënien e kredive.

- Në programin buxhetor të vitit 2013, krahas dhënies përparësi me fonde buxhetore sektorëve prioritarë të ekonomisë, si shëndetësisë, arsimit, investimet në infrastrukturë dhe shërbimet sociale; kujdes duhet t'i kushtohet mbështetjes së sektorëve që punojnë për eksport si bujqësia, industria minerale, prodhimi agroindustrial, industria që punon me material porositësi etj.

Po t'í referohemi strukturës së PBB-së sipas sektorëve për periudhën 2006-1011, të raportuar nga MF-ve, sektorët e bujqësisë dhe industrisë me përjashtim të vitit 2009, në 5 vitet e tjerë kanë kontribuar mesatarisht çdo vit bujqësia 17.46% të PBB-së dhe industria 9.68% të PBB-së.

Për hartimin e buxhetit të vitit 2013 rekomandojmë që nga ana e strukturave përgjegjëse të kryhet një analizë dhe vlerësim real i ndikimeve të krizës në Eurozone, si dhe i situatës në vend, me impakt reflektimin në këtë buxhet të parashikimeve realiste të treguesve në nivele agregate me synim shmangien e praktikave të rishikimit të buxhetit gjatë ekzekutimit të tij.

Zhvillimi i KLSH sipas drejtimeve strategjike të EUROSAI-t

- *Prezantimi i Raportit të Performancës së KLSH për vitin 2012*

19 mars 2013

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, Kuvendi i Shqipërisë

Deputetët pjesëmarrës

1. Edmond Spaho
2. Erion Braçe
3. Florjon Mima
4. Ervin Koçi
5. Sybi Hida
6. Mimi Kodheli
7. Selami Xhepa
8. Arben Ahmetaj
9. Albana Vokshi
10. Adriana Gjonaj
11. Ilir Bejtja
12. Lefter Koka
13. Sherefedin Shehu
14. Ledina Aliolli
15. Igli Cara
16. Gjoke Uldedaj
17. Gjovalin Kadeli
18. Albert Çaçi

Të nderuar deputetë,

Filozofia jonë e punës bazohet në katër shtyllat e Strategjisë së Zhvillimit 2011-2017 të EUROSAI-t (komunitetit të institucioneve më të larta të auditimit të jashtëm publik-SAI- të Evropës). Këto drejtime themelore janë: (1) Ndërtimi i kapaciteteve audituese; (2) Respektimi rigoroz i Standardeve profesionale të INTOSAI; (3) Shkëmbimi i njohurive dhe eksperiencave mes SAI-ve dhe (4) Menaxhimi në përputhje me parimet e qeverisjes së mirë dhe komunikimit efektiv.

Në vitin 2012 plotësuam të gjitha ato detyra të Strategjisë sonë të Zhvillimit 2009-2012, të cilat kishin mbetur pezull, të tilla si:

- përgatitja e amendimeve të Ligjit tonë organik;
- zhvillimi i auditimit të performancës;
- përsosja e metodologjisë së auditimit, si dhe

- rritja, nëpërmjet trajnimeve, e kapaciteteve audituese të institucionit.

Korniza e re ligjore për KLSH, Ju është dorëzuar në Kuvendin e Shqipërisë, në fund të Nëntorit 2012. Gjate vitit të kaluar, auditimet e performancës u katërfishuan, duke u nisur nga një bazë shumë e vogël. Manuali i Auditimit të Performancës u rikonceptua tërësisht i ri dhe numri i ditëve të trajnimit për punonjës të KLSH u nëntëfishua, në krahasim me vitin 2011.

Raporti Vjetor i Performancës i KLSH që Ju kemi paraqitur në zbatim të detyrimit kushtetues, përmbledh rezultatet që institucioni ka arritur gjatë 2012-ës, duke i krahasuar me ato të një viti të mëparshëm buxhetor, si dhe me realizimin e rekomandimeve që Ju na keni dhënë, për të përmirësuar punën tonë. Me konkretisht:

1. Në Rezolutën e Kuvendit "Për Vlerësimin e Veprimtarisë së KLSH për vitin 2011", të datës 26 prill 2012, Ju na keni rekomanduar për "*Kryerjen e kontrolleve ndaj përdorimit të fondeve të Buxhetit të Shtetit, si dhe fondeve të projekteve të financuara nga BE-ja e nga institucionet financiare ndërkombëtare me objektivitet, profesionalizëm, cilësi dhe efektivitet të lartë". Këto kërkesa janë në në një linjë me drejtimin e katërt themelor të Strategjisë së EUROSAI-t, menaxhimit në përputhje me parimet e qeverisjes së mirë.*

Gjykojmë se e kemi zbatuar këtë rekomandim Tuajin, duke realizuar gjatë 2012-ës **177 auditime** nga **153 të planifikuara** dhe duke **përfunduar plotësisht 158 auditime.**

Këto auditime i kemi kryer në 40 institucione qendrore, në 64 njësi vendore, 12 drejtori dhe degë tatimesh e doganash, 12 shoqëri anonime dhe me kapital të përbashkët, 11 njësi dhe projekte me financim të huaj, 11 njësi të administrimit dhe regjistrimit të pronës dhe 8 institucione të mbrojtjes së mjedisit.

Duke zbatuar kërkesat e Deklaratës së Simpoziumit të 22-të të INTOSAI -t në mars 2013 në Vjenë, e cila nënvizon se "*Institucionet supreme të auditimit publik duhet t'i kryejnë auditimet e tyre në një mënyrë që lejon ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese, për të marrë kompensim, ose për të ndërmarrë hapa për të parandaluar-ose të paktën të bëjnë më të vështirë-shkeljet financiare*", si KLSH gjatë auditimeve të kryera në vitin 2012 (me periudhë 2-3 vjeçare aktiviteti të njësisë që auditohet), **kemi vërejtur parregullsi dhe shkelje financiare në të ardhurat e mbledhura dhe në shpenzimet e kryera nga njësitë publike të audituara, institucione të Pushtetit Qendror dhe Vendor, me dëm[2] ndaj Buxhetit të Shtetit në shumën 13,522,392,000 lekë, ose 97.3 milionë euro. Kemi rekomanduar që kjo shumë të zhdëmtohet në masën 100 përqind.**

[2] Dëm ekonomik ndaj Buxhetit të Shtetit është dëmtimi i pronës apo fondeve publike, me pasojë uljen e vlerës në treg të pronës dhe pakësimin e fonde ve publike

Vlera e dëmit ekonomik të zbuluar për periudhën 5-vjeçare (2008-2012), paraqit et si më poshtë:

Grafiku Nr. 1:



Në totalin e dëmit ekonomik të konstatuar, subjekti AlbPetrol Sh.a. ka 68 përqind të tij, ndërsa KESH Sh.a. 18 përqind.

Dëmi ekonomik, përfshirë moslikujdimin e detyrimeve kontraktore ndaj Albpetrol dhe KESH sh.a. për vitin 201 2, paraqitet si vijon:

Grafiku Nr. 2:

Kemi zbuluar po ashtu shkelje të disiplinës financiare[3] me ndikim negativ në perfomancën e subjekteve të audituara, në shumën e përgjithshme 1,842,998,000 lekë, ose 13.2 milionë euro.

Në totalin e shkeljeve të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancë, shkeljet në koncesionet e dhëna nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës përbëjnë 60.4 përqind.

[3] Shkelje e disiplinës financiare me ndikim negativ në performancë është e ardhura e munguar në Buxhetin e Shtetit, e cila do të ishte arkëtuar në rast se nuk do të kishte ndodhur shkelja.

Shkeljet financiare janë vërejtur kryesisht në prokurimet publike, në shitjen dhe dhënien me qira të pasurisë shtetërore, në urbanistikë, në shpenzimet operative, në doganat, në tatimet e taksat, etj.

Impakti, dobia e auditimit përfaqëson vlerën totale të zbulimeve të konstatuara, evidentuara e të raportuara, në përfundim të auditimeve të evaduara nga data 1 janar 2012 deri më 31 dhjetor 2012, gjithsej 158 auditime, *në shumën totale 13,522,392,000 lekë (rreth 13.5 miliardë lekë).* Në këtë shumë janë përfshirë të gjitha vlerat e parregullsive dhe shkeljeve financiare me dëm ekonomik, përfshirë mos-likujdimin e detyrimeve kontraktore ndaj Albpetrol dhe KESH sh.a. në shumat respektive 9.1 miliardë lekë dhe 2.4 miliardë lekë, të cilat zenë rreth 86% të totalit të zbulimeve të konstatuara gjatë vitit 2012.

Raporti ndërmjet vlerës së dëmit ekonomik gjithsej të konstatuar dhe evidentuar gjatë vitit 2012, *në shumën totale 13,522,392,000 lekë të kërkuar për zhdëmtim,* dhe vlerës të raportuar me situacionin përfundimtar të shpenzimeve të KLSH-së për këtë vit *në shumën 261,461,000 lekë,* tregon për shkallën e efektivitetit të veprimtarisë audituese të KLSH, dhe konkretisht:

"Për çdo lek të investuar në KLSH gjatë vitit 2012, janë kërkuar për t'u zhdëmtuar 51.7 lekë" .

Krahasuar me një vit më parë ku ky raport ka rezultuar 27.7 lekë, konstatohet *një rritje prej 24 lekë ose në masën 87% më shumë*. Tregues tjetër është vlera e shkeljeve financiare me pasojë dëm ekonomik të zbuluar mesatarisht nga 1 (një) punonjës i KLSH-së, në raport me vlerën që harxhon shteti për 156 punonjës gjithsej, *përkatësisht rreth 86.7 milionë lekë/për çdo punonjës (13,522 milionë lekë/156 punonjës); nga rreth 1.7 milionë lekë të harxhuar mesatarisht për çdo punonjës në organikë (261 milionë lekë/156 punonjës).*

2. Duke zbatuar kërkesat e Deklaratës së Tbilisit në Konferencën e VII-të të EUROSAI dhe OLACEF, në shtator 2012 që" *Institucionet supreme te auditimit publik të kontribuojnë ndjeshëm për arritjen e një qeverisjeje të mirë, duke dhënë rekomandime me qëllim përforcimin e menaxhimit publik"* dhe në zbatim të rekomandimit Tuaj të Rezolutës së 26 Prillit për "*përmirësimin e akteve ligjore e nënligjore dhe rritjen e shkallës së zbatimit të rekomandimeve të KLSH*", në vitin 2012 kemi sjellë **58 propozime për përmirësim të legjislacionit**, përfshi dhe kërkesën për një ndryshim në Kushtetutë, nga të cilat **25** propozime janë zbatuar, ndërsa **16** janë në proces zbatimi.

Kemi rekomanduar **2194 masa organizative**, nga të cilat janë zbatuar **1659 ose 76 përqind** e tyre, si dhe kemi rekomanduar **1221 masa disiplinore dhe administrative**, nga të cilat **860** ose **70 përqind** janë realizuar që gjatë vitit 2012. Ndërsa niveli i

përmbushjes s ë rekomandimeve tona për përmirësime ligjore, masa organizative, ato disiplinore dhe administrative është i mirë, masat për largime nga puna të punonjësve të gjetur me shkelje, veçanërisht të drejtuesve të rangut të lartë, janë në nivel mjaft të ulët (kemi propozuar 120 largime nga puna dhe vetëm 53 janë kryer). Ky nivel i ulët ka ardhur nga serioziteti i pakët i njësive të audituara në ndështkimin e shkelësve të ligjit brenda stafit të tyre, sidomos për shkelës të nivelit të lartë. Na del një detyrë e rëndësishme për këtë vit që të ngremë në një nivel të pranueshëm këtë tregues shumë të rëndësishëm për formimin e kulturës së ndështkueshmërisë në administratën publike.

Grafiku Nr.3



3. Ne Rezolutën e 26 Prillit, Ju na keni re komanduar përmirësimin e ligjit tone integral. E kemi zbatuar këtë rekomandim Tuajin, si dhe rekomandimin e Progres Raportit 2012 të BE-së për Shqipërinë, i cili thekson se: "*Auditimi i jashtëm duhet të vijë në nivel me standardet e INTOSAI.... Pas disa viteve në ngecje, projekt-ndryshimet në Ligjin për KLSH për ta sjellë atë në përputhje të plotë me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) janë përgatitur dhe janë dorëzuar në procedurë të miratimit*". Sikurse e përmenda, gjatë vitit 2012 plotësuam përgatitjen e draft-amendimeve të ligjit tonë organik, në bashkëpunim intensiv me Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në BE (DG-Budget), me SIGMA-n dhe me ambientet akademike e shoqërinë civile të vendit. Nga tryezat e punës që organizuam, rezultuan sugjerime të vlefshme që u reflektuan në draftin përfundimtar, dorëzuar Kuvendit të Shqipërisë më 30 nëntor 2012 me shkresën nr. 945/4, datë 26.11.2012. Sipas vlerësimit të DG-Budget, ky draft është "*tërësisht në përputhje me standardet INTOSAI (*Letër me Nr. Prot. 1354284 (2012) e z. Robert Gielisse, Drejtor i Njësisë së Tatimit të Vlerës se Shtuar dhe Kontrollit Financiar te Brendshëm Publik në DG- Budget, drejtuar KLSH më datën 16 nëntor 2012).

Amendimet sjellin një konceptim bashkë kohor, si simotrat tona evropiane, të të drejtave dhe detyrave që kemi. Ato do të ndihmojnë në:

- rritjen e nivelit të zbatimit të rekomandimeve tona;
- shtimin e kapaciteteve administrative;

- saktësimin e së drejtës që të auditojmë fondet e akorduara nga BE për Shqipërinë deri tek përdoruesi i fundit dhe;
- saktësimin e së drejtës të certifikojmë llogaritë financiare të njësive të audituara.

Amendimet forcojnë pavarësinë tonë funksionale, duke e shndërruar KLSH në një strukturë tërësisht të integruar dhe në përputhje me standardet e veprimit të SAI-ve të vendeve të Bashkimit Evropian, si dhe mundësojnë që të kemi Auditues Publikë (të jashtëm) të certifikuar. Ne besojmë se Ju do të na mbështesni.

Ne mendonim që këtë draft-ligj Ju do ta vendosnit në axhendën e fillim-vitit të Kuvendit. Kërkoj nga Ju të na ndihmoni që amendimet e ligjit tonë të shqyrtohen në një kohë sa më të afërt nga Kuvendi.

4. Duke zbatuar rekomandimin Tuaj, të përmbajtur në Rezolutën e 26 Prillit për "*Rritjen e efiçiencës së veprimtarisë audituese, nëpërmjet fuqizimit të auditimit financiar dhe hedhjes së hapave më të shpejtë drejt auditimit të performancës*", si dhe detyrën e planit strategjik te KLSH 2009-2012, të papërmbushur ne vitet 2009-2011, si KLSH vitin e kaluar rritëm numrin e auditimeve financiare të mirëfillta dhe shtuam ndjeshëm numrin e auditimeve të performancës. Sikurse e thekson një personalitet i auditimit suprem europian, z. Jacek Jezierski, President i Zyrës Kombëtare të Auditimit (NIK) të Polonisë, "*SAI-t nuk janë qeveri që të propozojnë dhe të vënë në zbatim linja veprimi, por mbasi një linjë veprimi është propozuar dhe zbatuar dhe mbasi fondet publike janë shpenzuar, SAI-t veprojnë për të dhënë informacione të besueshme mbi atë që po ndodh*". Në shtator 2012, ngritëm Departamentin e Auditimit të Performancës, me në krye një studiues të doktoruar në menaxhimin e riskut, si dhe me 16 auditues ndër ata më me përvojë dhe me auditues të rinj me perspektivë. Edhe pse e kemi katërfishuar numrin e këtyre auditimeve vitin e kaluar, sikurse e përmenda, nisur nga një bazë shumë e vogël, na ngelet ende shumë për të bërë. Ndajmë bindjen se duke shtuar auditimet e performancës, do të arrijmë të ndikojmë me gjetjet dhe rekomandimet tona në planifikimin më efikas te politikave dhe programeve qeveritare për shërbimet ndaj qytetarëve.

5. Duke zbatuar rekomandimin Tuaj, të përmbajtur në Rezolutën e Kuvendit dhe detyrën në Planin tonë Strategjik të Zhvillimit 2009-2012 për "*Përmirësimin e metodologjisë së kontrollit, mbështetur në standardet ndërkombëtare e praktikat më të mira të vendeve të tjera", si dhe n*ë bazë të standardit ISSAI 20, kemi përditësuar Manualin e Auditimit të Performancës, të ndërtuar tërësisht mbi rezultatet dhe udhëzimet e Grupit të Punës së INTOSAI. Me qëllim përmirësimin e metodologjisë së auditimit dhe te raportimeve tona, ngritëm në shkurt 2012 Departamentin e Kërkimit Shkencor, Zhvillimit dhe Teknologjisë së Informacionit. Gjatë vitit 2012 institucioni aplikoi dhe fitoi një projekt binjakëzimi për zhvillimin e metodologjisë dhe kapaciteteve të tij audituese, në kuadër të financimeve IPA 2013, me vlerë 2.11 milionë euro, i cili do të bëhet veprues në fillim të

vitit 2014. Ky projekt fitohet pas gjashtë vitesh që institucioni nuk kishte marrë asistencë teknike të huaj. Ndihmë në fitimin e këtij projekti na dha dhe Qeveria shqiptare, veçanërisht Kryeministri dhe Ministria e Integrimit, Delegacioni i BE në Shqipëri dhe SIGMA, partneri ynë permanent.

6. Ekziston një perceptim negativ i publikut në lidhje me nivelin aktual të korrupsionit në administratën publike. Ky perceptim vjen nga moszbulimi dhe mosndëshkimi i korrupsionit në nivel të mjaftueshëm nga ana e organeve shtetërore përgjegjëse për ta luftuar këtë dukuri. Sikurse e ka nënvizuar një tjetër personalitet i auditimit publik, Prof. Assoc. Dr. Rejai Akyel, President i Gjykatës së Llogarive të Turqisë në fjalën e tij në Konferencën e EUROSAI-OLACEF në Tbilisi, *"Përgjegjësia kryesore e institucioneve supreme të auditimit është që të kontribuojnë në transparencën dhe llogaridhënien në menaxhimin e fondeve publike*". Detyrat për institucionet publike shqiptare janë të veprojnë si institucione të forta dhe të pavarura dhe të thellojnë luftën kundër korrupsionit. Kjo për ne si institucion suprem auditimi merr kuptim krejt të veçantë. Si KLSH, gjatë vitit 2012 kemi kryer **40 kallëzime penale për 125 punonjës** të administratës shtetërore të niveleve të ndryshme, ose pothuajse 2 herë më tepër se sa 3 vitet 2009 (9 kallëzime)-2010 (5 kallëzime) dhe 2011 (6 kallëzime) të marra së bashku.

Grafiku Nr.4



Në këto kallëzime ka Drejtues të Lartë si Drejtor Kabineti në Ministri, Drejtorë të Përgjithshëm në Ministri, Kryetar të Komisionit të Prokurimeve Publike, Kryetarë apo ish-Kryetarë Bashkish, drejtues të lartë në institucionet në rrethe, etj, por jemi të ndërgjegjshëm që kemi ende shumë për të bërë për të luftuar aktet abuzive dhe korruptive të çdo niveli.

Puna jonë shkon në sinkron me Strategjinë Ndërsektoriale të Parandalimit, Luftës kundër Korrupsionit dhe Qeverisjes Transparente 2008-2013 të qeverisë Berisha, e cila kërkon një bashkëpunim më të ngushtë të institucioneve kryesore që e luftojnë korrupsionin, të bazuar në angazhime të përbashkëta të institucionalizuara. Urdhri nr. 70, datë 18.04.2006 i Kryeministrit për Zbatimin nga ekzekutivi të masave të propozuara nga KLSH na ka ndihmuar së tepërmi, megjithëse ai duhet të zbatohet më saktë dhe i

plotë nga institucionet e audituara.

Gjatë vitit 2012 jemi përpjekur të krijojmë sinergji institucionale për mirëqeverisjen, duke bashkëpunuar në sistem me institucionet e tjera shtetërore. Në mars 2012, nënshkruam një marrëveshje bashkëpunimi me Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive të funksionarëve të lartë të shtetit dhe një me Autoritetin Shqiptar të Konkurrencës, me synimin e zhbirimit të çdo rasti pasurimi të shpejtë të funksionarëve, si dhe të rasteve të prishjes së konkurrencës në tenderat shtetërorë. Në qershor 2012, nënshkruam marrëveshjen e bashkëpunimit me Prokurorinë e Përgjithshme. Prokuroria ka nisur hetimet për të gjitha kallëzimet tona, duke treguar seriozitet ndaj denoncimeve tona, gjë që prodhon përgjegjshmëri dhe shton transparencën, si dhe, sikurse e ka theksuar Presidenti i Republikës, SHTZ. Bujar Nishani ne adresimin ne Analizën Vjetore 2012 të KLSH: "*Ky bashkëpunim, ky përkushtim, kjo dëshirë dhe ky vizion i shprehur tashmë në sy të opinionit publik për një bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet institucionit tuaj dhe Prokurorisë së Përgjithshme, do të sjellë shembuj konkretë në sytë e opinionit publik*".

7. Në zbatim të rekomandimit Tuaj, të përmbajtur në Rezolutën e Kuvendit për "*Harmonizimin e veprimtarisë së kontrollit të jashtëm me atë të brendshëm, si dhe zhvillimin dhe forcimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit*", kemi iniciuar në maj 2012 marrëveshjen e bashkëpunimit me Ministrinë e Financave, sidomos me strukturat e saj të auditimit të brendshëm. Kjo marrëveshje është në veprim dhe do të realizohet e plotë gjatë këtij viti në objektivat e saj kryesore, në bazë të standardeve ISSAI 9150 për "Koordinimin dhe bashkëpunimin midis SAI-ve dhe Audituesve te brendshëm në Sektorin Publik" dhe 1240 për "Përgjegjësitë e audituesit lidhur me mashtrimin në auditimin e deklaratave financiare". Një funksionim i konsoliduar i Auditimit te Brendshëm ndihmon shumë realizimin e misionit të KLSH. Puna në sistem me strukturën e Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik (PIFC), me Auditin e Brendshëm nëpërmjet këshillimeve të vazhdueshme, shkëmbimit të planeve të punës, zhvillimit të metodologjive, trajnimeve dhe kryerjes së veprimtarive të përbashkëta e deri në përdorimin e gjetjeve të tij, kur kjo punë cilësohet se është kryer në përputhje me standardet profesionale, gjykojmë se është rruga e duhur për të mbështetur maksimalisht rritjen e përgjegjshmërisë, transparencës dhe ndershmërisë në qeverisje.

Sfida jonë kryesore, modernizimi i institucionit, realizohet duke koordinuar si duhet punën me institucionet e tjera, publike dhe jo-publike të fushës. Në përmbushje të objektivit të platformës strategjike të caktuar në dhjetor 2011 për institucionin, kemi siguruar bashkëpunim profesional me Institutin e Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA) dhe me Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit, me të cilët kemi nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi, për të na ndihmuar në kryerjen e analizës së riskut në planifikimin e auditimeve, në rritjen e cilësisë gjatë procesit auditues dhe në raportimin

cilësor të gjetjeve të auditimit. Pse jo, në të ardhmen, nëse Ju si Kuvend nuk do të keni mundësi, këto institucione të pavarura ekspertësh do të auditojnë fondet tona si institucion, që të realizohet detyrimi ligjor për një auditues të jashtëm të veprimtarisë së KLSH.

8. Në zbatim të rekomandimit Tuaj për "*Zhvillimin e burimeve njerëzore, duke i dhënë përparësi zgjerimit dhe përmirësimit cilësor të veprimtarisë trajnuese*", gjatë vitit 2012 kemi rekrutuar sipas të gjitha rregullave të punësimit në administratën publike rreth 30 punonjës të rinj, ndër të cilët pesë me gradën shkencore Doktor i Shkencave dhe tetë me nivel pasuniversitar të Programit Master, në vazhdim të doktoraturës. Kemi lidhur, duke filluar nga muaji shkurt 2012 e në vijim, marrëveshje bashkëpunimi me institucionet simotra të zhvilluara të auditimit më të lartë publik. Si rezultat i zbatimit të këtyre marrëveshjeve, gjatë vitit 2012 u trajnuan jashtë shtetit një numër audituesish të KLSH i barabartë me numrin e punonjësve të institucionit të dërguar jashtë gjatë shtatë viteve 2004-2011 të marra së bashku. Duke realizuar edhe trajnime me ekspertë të SIGMA në Tiranë për auditimin e performancës, auditimin financiar dhe auditimin e teknologjisë së informacionit dhe trajnime me burime të brendshme, vitin 2012 e mbyllëm me **19.4 ditë trajnimi** për audituesë në KLSH (nga vetëm 2.1 ditë trajnimi në vit për audituesë, që kishim trashëguar nga viti 2011), tregues në nivel me treguesit e ditëve të trajnimit në vit për audituesë të SAI-ve më të zhvilluara në kontinent.

Grafiku Nr.5



Grafiku Nr.6



9. Në zbatim të rekomandimit Tuaj, të përmbajtur në Rezolutën e Kuvendit për " *Rritjen e transparencës ndaj medias dhe shoqëri së civile, si dhe rritjen e bashkëpunimit me botën akademike*", kemi trajtuar **358 letra dhe ankesa nga qytetarët** për probleme të ndryshme, nga të cilat **111 i kemi konstatuar jashtë kompetencave dhe juridiksionit të KLSH,** kurse nga **247 kërkesa dhe ankime në kompetencë të institucionit**, **171** prej tyre i kemi verifikuar dhe u kemi dhënë përgjigjen përkatëse, ndërsa 76 janë në vijim të verifikimit. Ndërsa për vitin 2011 institucioni ka regjistrime, të dhëna tejet të ulëta në shifra për letrat dhe ankesat e ardhura nga qytetarët. Si rezultat i këtyre ankesave të marra dhe të trajtuara gjatë vitit 2012, KLSH ka larguar katër auditues të tij, dy nga të cilët i ka paditur në Prokurori për shpërdorim detyre.

Mbi bazën e parimit të 8-të të ISSAI 20, i cili thekson se :" *SAI-t komunikojnë në kohë dhe gjerësisht për aktivitetet e tyre dhe rezultatet e auditimeve nëpërmjet medias, faqeve ne internet dhe mjeteve të tjera të komunikimit masiv*", kemi qenë tërësisht të hapur ndaj mediave dhe kemi bashkëpunuar me to, duke dyfishuar numrin e editorialeve, njoftimeve për shtyp dhe artikujve dhe rritur me 3.5 herë numrin e sekuencave filmike televizive, në krahasim me vitin 2011. I falënderojmë ne mënyrë të veçante mediat dhe shoqërinë civile, aleatët tanë më potentë. Sikurse e ka nënvizuar Simpoziumi i 22-të i INTOSAI-t i mbajtur në Mars 2013 në Vjenë "*SAI-t të komunikojnë dhe promovojnë ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe mediave rreth gjetjeve dhe rekomandimeve të SAI-ve*", duke realizuar jo vetëm njoftime për shtyp, por bashkëpunime konkrete.

KLSH gjatë 2012-ës ka bashkëpunuar intensivisht me botën akademike, sidomos me profesoratin e Fakultetit Ekonomik dhe Fakultetit Juridik të Universitetit Shtetëror të Tiranës në tryeza pune, takime konsultative, etj., bashkëpunim i cili është i mirë, por ende nuk po institucionalizohet për arsye procedurale burokratike.

Për rritjen e transparencës dhe efiçiencës në auditim, institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me disa nga OJF-të më të spikatura për transparencën dhe luftën kundër korrupsionit, si Transparency Internacional në Shqipëri, lëvizja Alternativa Civile, Qendra për Transparencë dhe Informim të Lirë, Instituti i Studimeve Bashkëkohore, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Lëvizja Evropiane Shqipëri dhe Instituti "G&G Group". Nga OJF-të kërkojmë jo vetëm bashkëpunim për transparencë, por edhe të marrin pjesë aktive në auditimet tona në çdo fazë të procesit të auditimit, që ato do ta mendojnë.

Po në zbatim të parimit 8-të të ISSAI 20 për komunikimin aktiv e profesional të një SAI edhe nëpërmjet publikimeve, gjatë vitit 2012 institucioni përgatiti dhe publikoi 10 botime informative dhe profesionale, si: "KLSH-Analiza Vjetore 2011", "KLSH në Kuvend", "KLSH-Analiza 6-mujore 2012", "EUROSAI dhe SAI-t Evropiane", "Standardet ISSAI 1, 10, 11, 20, 30, 40, 100 dhe 200", "Historiku i KLSH 1925-2012",

tre numra të revistës shkencore "Auditimi Publik" dhe Manualin e përditësuar të Auditimit të Performancës.

Më 28 dhjetor 2012, KLSH zhvilloi Konferencën e tij të parë Shkencore, duke ju referuar historikut të institucionit dhe punës shumëvjeçare të të gjithë personave që kanë kontribuar për ngritjen dhe mbarëvajtjen e tij në periudha kohore të ndryshme, me rastin e 100 Vjetorit të Pavarësisë. Konferenca dha mesazhin e ruajtjes së identitetit dhe vlerave të institucioneve kryesore të Shtetit, si bazë për formësimin e kulturës së konsoliduar shtetërore. Ky aktivitet për këtë vit dhe vitet në vijim synon të kthehet në një traditë dhe forum profesional përqasjesh eksperiencash auditimi, si për auditimin e jashtëm dhe atë të brendshëm publik, duke sjellë edhe përvojën audituese të institucioneve homologe të zhvilluara në rajon dhe më gjerë.

Si përfundim, theksoj se jemi përpjekur gjatë vitit 2012 të realizojmë rekomandimet Tuaja, thellësisht të bindur në dobishmërinë e tyre dhe përputhjen me objektivat tona strategjikë. Natyrisht, jemi të vetëdijshëm se duhet të punojmë më shumë. Në bashkëpunim me ekspertë të SIGMA, kemi përgatitur Planin e Zhvillimit Strategjik të KLSH për vitet 2013-2016, i cili përmban objektivat kryesorë, si:

- përmirësimi i bazës ligjore dhe rregullatore të KLSH, në përputhje me standardet INTOSAI dhe praktikat më të mira evropiane;
- përmirësimi i metodologjisë dhe rritja e cilësisë në auditim;
- përmirësimi i cilësisë dhe shtimi i numrit të auditimeve të performancës, krahas konsolidimit të auditimeve të përputhshmërisë dhe atyre financiarë;
- sigurimi i mirëqeverisjes, si dhe rritja e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies për një menaxhim të shëndoshë financiar.

Bashkëpunimi i gjerë dhe i thellë me Ju, Kuvendin e Shqipërisë, me qytetarët dhe shoqërinë civile, me Qeverinë dhe me të gjithë partnerët e tjerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, mbi bazën e motos së INTOSAI "*Experentia mutua Omnibus prodest* " (Eksperienca e përbashkët u shërben të gjithëve), përbën për ne garancinë më të plotë në suksesin e objektivave dhe përpjekjeve tona edhe gjatë vitit 2013.

Si KLSH, një nga përparësitë tona për vitet në vijim është të garantojmë që korniza e re ligjore e jona do të zbatohet si duhet, kur të miratohet nga Ju, Kuvendi i Shqipërisë. Duke Ju falënderuar për mbështetjen që i keni dhënë institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit gjatë vitit 2012, shpresojmë që ky Raport të kontribuojë jo vetëm në forcimin e llogaridhënies tonë, por edhe në rritjen e ndërgjegjësimit Tuaj, të Kuvendit në tërësi për dobinë e auditimeve të KLSH dhe rolin e pazëvendësueshëm parandalues ndaj korrupsionit dhe mashtrimit financiar që institucioni luan, në një linjë me Rezolutën e Kombeve të Bashkuara të 22 Dhjetorit 2011 për Fuqizimin e SAI-ve, e cila u kërkon

shteteve anëtare të OKB-së dhe parlamenteve të tyre "*të mbështesin SAI-t të kryejnë detyrat e tyre në mënyrë objektive dhe efektive, duke qenë të pavarura nga subjekti i audituar dhe të mbrojtura nga ndikimet e jashtme*", si dhe "*të intensifikojnë bashkëpunimin me SAI-t, duke përfshirë ndërtimin e kapaciteteve me qëllim nxitjen e qeverisjes së mirë, duke siguruar përgjegjshmëri, eficiencë, efektivitet dhe transparencë".*

Vendosja në Kushtetutë e një kufiri për Borxhin Publik dhe shlyerja e detyrimeve ndaj biznesit

- *Prezantimi i Raportit të Zbatimit të Buxhetit Faktik të vitit 2012*

14 nëntor 2013

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, Kuvendi i Shqipërisë

Deputetët pjesëmarrës

1. Erion Braçe
2. Ridvan Bode
3. Anastas Angjeli
4. Florjon Mima
5. Ervin Koçi
6. Andrea Marto
7. Arben Çuko
8. Blerina Gjylameti
9. Albana Vokshi
10. Luan Duzha
11. Sherefedin Shehu
12. Dashamir Shehi
13. Ilir Xhakolli
14. Liljana Elmazi
15. Edmond Spaho
16. Igli Cara
17. Gjovalin Kadeli
18. Jorida Tabaku
19. Agron Çela
20. Ervin Bushati

Të nderuar deputetë të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave,

Objektivi ynë kryesor në Raportin e KLSH 'Për zbatimin e Buxhetit të Shtetit të vitit 2012', në respektim të detyrimit kushtetues, është dhënia e opinionit për raportin që Ministri i Financave dhe Këshilli i Ministrave paraqet në Kuvend 'Për zbatimin e Buxhetit të Shtetit të vitit 2012'.

Opinioni ynë i Përgjithshëm: Në përputhje të plotë me Standardin ISSAI 1700 të auditimit suprem, për Zbatimin e Buxhetit të Shtetit për vitin 2012, para miratimit të tij nga Kuvendi i Shqipërisë, është se **përgatitja, shqyrtimi dhe miratimi i buxhetit të vitit 2012, zbatimi, ndjekja dhe rishikimi i tij, të drejtat dhe kufizimet për huamarrjen, garancitë dhe format e tjera të rrjedhura prej tyre si dhe kontrolli,**

kontabiliteti, raportimi dhe auditimi i këtij buxheti, janë kryer në respektim të kërkesave të ligjit "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"; të ligjit "Për buxhetin e Shtetit të vitit 2012", të ndryshuar, si dhe të ligjit "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin".

Duke patur parasysh mjedisin tejet të pafavorshëm në të cilin u realizua Buxheti i vitit 2012, si pasojë e ndikimit në rritje të elementëve të krizës ekonomike dhe financiare botërore dhe sidomos në Eurozonë, **vlerësojmë pozitivisht punën e bërë nga Qeveria, Ministria e Financave, Ministritë e tjera, Institucionet e tjera qendrore dhe vendore, si dhe entet e tjera publike të audituara, për përmbushjen e objektivave të Buxhetit të vitit 2012, si dhe për zbatimin e masave të programuara, në kuadër të Planit Kombëtar të Zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit Shqipëri-BE.**

Treguesit makroekonomikë

KLSH konstaton se treguesit fiskalë të konsoliduar të Buxhetit të Shtetit për vitin 2012, në tërësi janë realizuar. **Të ardhurat e përgjithshme të Buxhetit të Shtetit** janë 330,4 miliardë lekë. **Shpenzimet e përgjithshme buxhetore** janë 376,2 miliardë lekë. **Deficiti i Përgjithshëm i Buxhetit të Shtetit** është 45,9 miliardë lekë, duke u mbajtur nën kontroll për vitin 2012. **Borxhi publik** arriti në 828,3 miliardë lekë (5.9 miliardë euro duke përfaqësuar 61.5 % të PBB-së).

Borxhi publik

Në bazë të standardit ISSAI 5440 për auditimin e Borxhit Publik 'Udhëzim për planifikimin dhe kryerjen e nj auditimi mbi Borxhin Publik', u përqendruam në auditimin e ligjshmërisë së menaxhimit të borxhit publik për vitin 2012. Theksojmë se me ligjin nr. 114, datë 07/12/2012, te hyrë në fuqi me 3 Janar të vitit 2013, është hequr kufiri ligjor i borxhit prej 60% të PBB-së. Borxhi ngeli pa një tavan të përcaktuar, duke krijuar premisa për rritje të vazhdueshme të tij në periudhat në vijim.

Në vijim dhe të rekomandimit të lënë prej nesh në vitin 2012, i **kemi rekomanduar** Ministrisë se Financave të ngrejë një grup pune me ekspertët më të mirë të fushës, për përgatitjen dhe paraqitjen e një nisme ligjore për vendosjen në Kushtetutë dhe në Ligjin "Për menaxhimin e sistemit buxhetor" të treguesit të borxhit publik ndaj PBB-së. Në të parashikohet që: "Përjashtim nga ky rregull të bëjnë rastet e katastrofave natyrore dhe krizave ekonomike". Në momentin e kalimit të pragut të borxhit publik kundrejt PBB-së, Qeveria duhet të marrë masa për balancimin e Buxhetit.

Nga auditimi, konstatuam se ligji "Për menaxhimin e sistemit buxhetor" është i ndryshueshëm me vendimmarrje të thjeshtë në Kuvend. Me synim zvogëlimin e risqeve

potenciale ndaj këtij ligji themeltar për menaxhimin e financave publike, kemi **rekomanduar** që ligji të ndryshohet vetëm me shumicë të cilësuar parlamentare.

Detyrimet ndaj sipërmarrjes private

Krahas rritjes së borxhit publik, shqetësim për ekonominë tonë përbëjnë dhe **detyrimet që Buxheti i Shtetit ka kundrejt sipërmarrësve privatë**. Në raportin "Për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2011", kemi rekomanduar "*saktësimin dhe shqyrtimin me realizëm të gjendjes së këtyre borxheve, si dhe përcaktimin e masave për të lehtësuar sa të jetë e mundur sipërmarrjen private nga kosto e kredive që ajo mund të ketë marrë për përmirësimin e situatës së saj financiare, nëpërmjet ndërhyrjes për ristrukturimin e kredive dhe mbledhjen e borxheve të këqija"*. Nga auditimi, konstatuam një përkeqësim të situatës dhe mos angazhim për të zbatuar rekomandimin tonë.

Kemi konstatuar praktika buxhetimi të çeljes së fondeve në mënyrë pjesore, apo realizim të investimeve të reja, pa mbuluar me fonde investimet në proces. Ministria e Financave nuk i ka të evidentuara detyrimet ndaj operatorëve ekonomikë për punë publike, mallra ose shërbime të kryera. **Kemi rekomanduar** që në Ligjin "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2014" të parashikohet që të ardhurat nga privatizimet duhet të përdoren së pari dhe kryesisht për të ulur borxhin publik, ku 50% të jetë kufiri i poshtëm, dhe pjesa tjetër të shkojë për uljen e detyrimeve për faturat e papaguara ndaj sipërmarrësve privatë për punët publike të realizuara. Të parashikohet që institucionet buxhetore, gjatë detajimit të fondeve të investimeve publike të kenë detyrimin e përfshirjes në financimin e vitit "në radhë të parë" të të gjitha investimeve të kontraktuara, apo punimeve të cilat rezultojnë të realizuara dhe nuk janë financuar për vitin ushtrimor. Këto procedura të përfshihen në udhëzimin specifik për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2014.

Për shkak të ndjeshmërisë së madhe që ka fenomeni i detyrimeve të Buxhetit të Shtetit ndaj kontraktorëve privatë, fokusuam auditimin edhe në mënyrën e regjistrimit në sistemin e tij informatik. Nga auditimi i kryer në disa degë thesari, rezultoi se për kontratat shumëvjeçare, regjistrimi në sistem kryhet për vlerën totale dhe për vitin korrent. Për vitin buxhetor 2013 evidentohet vlera e mbetur e kontratës, duke mos marrë në konsideratë afatet e realizimit të këtyre kontratave në vite dhe nevojën për financime sipas këtyre afateve. **Kemi rekomanduar** që në Udhëzimin standard të zbatimit të Buxhetit të shtohet përcaktimi që: "Degët e thesarit në rrethe, në rastin e kontratave shumëvjeçare, të regjistrojnë në sistem kontratat në shtrirje sipas viteve të parashikuara".

Korrektimi i buxhetit

Kemi rikonstatuar rishikimin e treguesve buxhetorë gjatë zbatimit të buxhetit, i shkaktuar, në gjykimin tonë, nga parashikimi optimist i performancës së të ardhurave

buxhetore në fillim të vitit. Kjo situatë ka sjellë reduktimin e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit, gjë që u shoqërua me efekte negative në ruajtjen dhe mbajtjen e një disipline fiskale efektive. Për vitin 2012, konstatuam se të ardhurat buxhetore u korrektuan me rreth 23 miliardë lekë dhe shpenzimet me rreth 14 miliardë lekë. Defiçiti buxhetor u korrektua me rritje me 8 miliardë lekë.

Duke e konsideruar një situatë të tillë të papranueshme, **kemi rekomanduar** që Ministria e Financave të marrë masa për realizimin e proceseve të planifikimit buxhetor mbi baza realiste, duke forcuar kapacitetet planifikuese, me synim që të ndërpriten praktikat e korrektimit të buxhetit gjatë zbatimit të tij.

Konsolidimi i pasqyrave financiare.

Në vijimësi, *në raportet tona kemi evidentuar problematikën e mungesës së pasqyrave financiare të konsoliduara të Shtetit*, situatë që është përsëritur edhe këtë vit. **Kemi rekomanduar** që Ministria e Financave të marrë masa të menjëhershme për përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara të shtetit për vitin 2012, dhe në vijim të realizohet rishikimi brenda një kohe të shkurtër i kuadrit të plotë rregullator të raportimit financiar në sektorin publik, duke mbajtur parasysh Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit.

Hartimi i bilancit të shtetit, në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit publik është një objektiv për të cilin është parashikuar realizim gradual. Duke vlerësuar si të domosdoshme pasqyrat financiare të konsoliduara të Shtetit në marrjen e një pamje të qartë të situatës financiare të Shtetit, por edhe duke njohur rëndësinë e tyre për të siguruar një qeverisje më të mirë, **kemi rekomanduar** që Ministria e Financave (Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit) të marrë masa të menjëhershme për përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara të Shtetit për vitin 2012, dhe në vijim të realizohet rishikimi brenda një kohe të shkurtër i kuadrit të plotë rregullator të raportimit financiar në sektorin publik, duke mbajtur parasysh Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik, si dhe duke i dhënë rëndësinë e duhur fuqizimit të sektorit të kontabilitetit dhe raportimit financiar në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit.

Fondi rezervë i Këshillit të Ministrave dhe i kontigjencave

Nga auditimi i përdorimit të Fondit Rezervë të Këshillit të Ministrave për vitin 2012, në shumë nga projektet u konstatua përdorimi korrekt, ekonomik dhe ligjor i këtij fondi nga Këshilli i Ministrave.

Gjatë auditimit të përdorimit të Fondit të Kontigjencës, konstatuam përdorimin e tij me Vendim të Këshillit të Ministrave për qëllime të tjera. **Kemi rekomanduar** që në planifikim, në ligjin vjetor të buxhetit, Ministria e Financave të kërkojë që përdorimi i Fondit të Kontigjencës për ruajtjen e defiçitit buxhetor, të bëhet me miratim nga Kuvendi i Shqipërisë.

Garancitë shtetërore në dobi të palëve të treta

Gjatë auditimit të garancive shtetërore në dobi të palëve të treta, rishtas konstatuam shuma të konsiderueshme të papaguara nga huamarrësit dhe përfituesit e garancive shtetërore, kryesisht ndërmarrjet e ujësjellësit. Detyrime e tyre u rritën në 5.6 miliardë lekë në fund të vitit 2012, nga 1.7 miliardë lekë qe ishin në vitin 2011. Edhe njëherë, **kemi rekomanduar** kryerjen e inspektimeve financiare për ndërmarrjet e ujësjellësve përfituese të nënhuave dhe garancive, ne lidhje me mënyrën e menaxhimit të fondeve publike dhe dokumentimin, inventarizimin dhe kontabilizimin e drejtë të përfitimeve të tyre nga projektet.

Financimi me përparësi për dëmshpërblimin e të përndjekurve politikë:

Me ndjeshmërinë e të gjithë shoqërisë për përparësinë që duhet të ketë trajtimi financiar i shtresës së ish të përndjekurve politikë, si dhe nga situata aktuale jo në përmirësim, **kemi rekomanduar** që të shqyrtohet mundësia që në Ligjin "Për buxhetin e shtetit të vitit 2014" të parashikohet financimi me përparësi nga të ardhurat e privatizimit të dëmshpërblimit ligjor të ish të përndjekurve politikë. Ndoshta 20 përqind e këtyre të ardhurave duhet të përdoret për këtë dëmshpërblim.

Auditimi i kryer në Bankën e Shqipërisë

Duke vlerësuar maksimalisht rolin e rëndësishëm që ka pasur Banka e Shqipërisë në ruajtjen e stabilitetit monetar dhe krijimin e një klime sa më garantuese për biznesin ne vend, si dhe duke patur parasysh gjendjen e ekonomisë të prekur ndjeshëm nga pasojat e krizës globale, gjendje e cila nuk kish si të mos ndikonte në politikat monetare të Institucionit, theksojmë se konstatimet e auditimit nuk mund të zhvlerësojnë përpjekjet e mëdha që Banka e Shqipërisë ka bërë për të arritur objektivat e saj.

Vërejtëm se sipas ligjit "Për Bankën e Shqipërisë" të vitit 1997, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës ka të drejtën për të përcaktuar nivelin e pagave dhe të shpërblimeve të stafit të Bankës së Shqipërisë. Nga auditimi rezultoi rregullshmëria ligjore e pagesave të mbështetura në vendimet e këtij Këshilli, por konstatuam mosrespektim të ndjeshmërisë qytetare në lidhje me nivelet shumë të larta të pagesave për drejtuesit, si pagë dhe shpërblime të ndryshme, të trajtimeve dhe për udhëtime e dieta, krahasuar me nivelin e pagës dhe trajtimet e punonjësve të institucioneve të tjera kushtetuese. **Kemi rekomanduar** që të fillojë nisma ligjore për rishikimin e Ligjit për Bankën e Shqipërisë, në frymën e minimizimit të riskut potencial të abuzimit me pavarësinë dhe shmangies së konfliktit të interesit, që evidentohet në praktikat e përcaktimit të pagave dhe shpërblimeve për nivelet drejtuese. **Kërkuam** që te përcaktohet një kornizë e kujdesshme rregullatore në lidhje me nivelin e pagës së Guvernatorit, e cila duhet të ndjekë trendin e pagave të tregut bankar, por gjithmonë duhet të jetë në raporte të

pranueshme, krahasuar me pagën e Presidentit të Republikës, bazuar kjo në përvojat dhe praktikat më të mira të vendeve të ngjashme, por pa harruar përshtatshmërinë me realitetin shqiptar. Kërkuam gjithashtu, të vendosen nivele të arsyeshme për shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës te Bankës, qe këto paga të mos jenë më shumë se sa paga e anëtarëve të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

Konstatuam edhe se, sipas ligjit "Për Bankën e Shqipërisë" të vitit 1997, Këshilli Mbikëqyrës i saj ka të drejtën të caktojë audituesin e jashtëm të Bankës nga institucionet audituese të njohura në arenën ndërkombëtare. **Rekomanduam** ndryshimin e mënyrës së përzgjedhjes së audituesit të pasqyrave financiare te Bankës, për të shmangur konfliktin e interesit në përzgjedhjen e tij, duke ia kaluar këtë kompetencë Kuvendit të Shqipërisë, referuar edhe praktikave më të mira botërore. **Kërkuam** që Kuvendi të përzgjedhë vetëm audituesin ndërkombëtar të pavarur, ndërsa pagesa e shërbimit të mbulohet nga Banka e Shqipërisë.

Ne, si Institucion Suprem Auditimi mendojmë që Komisioni i Ekonomisë, Komisioni i Ligjeve dhe Kuvendi duhet ta trajtojnë këtë problematikë në thellësi, në mënyrë që, duke mos cënuar pavarësinë e këtij Institucioni të rëndësishëm dhe në kujdes të ruajtjes së qëndrueshmërisë së burimeve njerëzore cilësore të tij, të bëhen ndryshimet e nevojshme ligjore, në bashkëpunim dhe në respekt të Bankës së Shqipërisë dhe drejtuesve të saj, por mbi të gjitha, në respekt të ndjeshmërisë qytetare.

Të ardhurat buxhetore nga tatimet

Për vitin 2012, strukturat e tatimeve mblodhën **3.2% më pak** se viti 2011. Ne kushtet kur ekonomia rritet, edhe pse në mënyre modeste, kjo dëshmon punë të pamjaftueshme dhe jo efiçiente të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe njësive të saj vartëse. Konstatuam se Njësia e Tatimpaguesve të Mëdhenj krijon rreth 46% të të ardhurave tatimore, ndërkohë që ajo ka një strukturë me 140 punonjës. 1,279 punonjës të tjerë realizojnë 54% të të ardhurave tatimore, pa përmendur strukturën e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me 187 punonjës. Këto zhbalancime kërkojnë një ristrukturim të kujdesshëm të tatimeve, për t'i bërë ato efiçiente.

Për vitin 2012, **borxhi tatimor rezultoi në një nivel shumë të lartë**, me rreth 70 miliardë lekë, me një rritje 8% nga viti 2011. Megjithë pakësimin e debitorëve si pasojë e zbatimit të ligjit "Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të Borxhit Tatimor dhe Doganor", rritja e borxhit tatimor thekson **paaftësinë e administratës tatimore në mbledhjen e borxhit tatimor.**

Konflikti i kompetencave me DPT

Një problem tepër shqetësues dhe tejet pengues për KLSH-në në ushtrimin e detyrave të tij kushtetuese dhe ligjore, i cili vazhdon prej vitesh dhe kërkon zgjidhje të menjëhershme, është konflikti i kompetencave, i krijuar artificialisht, ndërmjet KLSH-së dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. DPT, aktualisht është i vetmi institucion shtetëror që nuk i nënshtrohet procesit të auditimit të të ardhurave, siç përcaktohet në Deklaratën e Limës ose ndryshe Kushtetuta e Institucioneve Supreme të Auditimit, në Kushtetutën e Shqipërisë, ne Ligjin Organik të KLSH dhe në standardet ndërkombëtare të auditimit. Kjo çështje po shkon drejt zgjidhjes, me vendimin e fundit të Gjykatës së Apelit, që i ka dhënë të drejtë KLSH.

Të ardhurat buxhetore nga organet doganore

> Nga auditimi konstatuam një punë te vlerësueshme nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në realizimin e të ardhurave tatimore nga sistemi doganor për vitin 2012. Këto të ardhura janë ne rritje në krahasim me një vit më parë.

Gjatë vitit 2012, borxhi doganor rezulton me rritje, duke u shtuar në subjekte dhe në vlerë. Konstatuam përpjekje të pafinalizuara të autoriteteve doganore kompetente dhe strukturave të specializuara të Administratës Doganore, për rikuperimin e borxhit doganor, qoftë dhe me forcë, ndërkohë që gjatë auditiveve në gjashtë degë doganore, kemi konstatuar dëm ekonomik.

Buxheti i pushtetit vendor

Për të mundësuar dhënien e një opinioni të bazuar për zbatimin e ligjshmërisë nga njësitë e pushtetit vendor, kemi audituar 40 subjekte, nga të cilat 22 bashki, 11 komuna, 2 këshilla qarqesh, 2 prefektura dhe 3 ndërmarrje në varësi të Bashkisë Tiranë.

Nga auditimi ka rezultuar se, të ardhurat në total në pushtetin vendor janë realizuar në masën 98.1%. Kundrejt të ardhurave të realizuara në vitin 2011, të ardhurat e realizuara në vitin 2012 janë ulur me 9.2 përqind. Shpenzimet faktike të vitit 2012 rezultuan në masën 101.1% kundrejt planit, dhe në ulje me 2.8% kundrejt një viti më parë.

Kemi rekomanduar marrjen e masave urgjente nga organet e pushtetit vendor, për përmirësimin e gjendjes dhe shpërblimin e dëmit ekonomik të konstatuar.

Buxheti i Sigurimeve Shoqërore

Sigurimet shoqërore sigurojnë 15% të të ardhurave të Buxhetit të Shtetit. Për vitin 2012, ato grumbulluan 49,3 miliardë lekë, duke mos realizuar me 2.8 % planin vjetor. Konstatuam mosrealizim të të ardhurave të programuara. **Kemi rekomanduar** marrjen e masave të menjëhershme nga ISSH, Ministria e Financave dhe DPT dhe hartimin e një udhëzimi të Ministrit të Financave, ku të përcaktohet mënyra e raportimit dhe

evidentimit të kontributeve, mënyra e raportimit të të dhënave mujore dhe progresive për detyrimet e kontributeve të papaguara në afat dhe për kamatë-vonesat e tyre, si dhe sanksione më të ashpra për mosdorëzim të listëpagesave brenda afateve.

Konstatuam se deficiti i pensioneve është rritur ndjeshëm dhe vetëm për vitin 2012, krahasuar me PBB-në, zë rreth **1,5% të tij**. Me qëllim uljen e deficitit, i **kemi rekomanduar** ISSH, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe DPT, që të studiojnë dhe propozojnë ndërmarrjen e një reforme të plotë për të gjithë sistemin e sigurimeve shoqërore për nivelin e personave të siguruar; sistemin e pensioneve; formulën aktuale të pensionit; evazionin fiskal; mënyrën dhe rregullat e indeksimit të pensioneve, si dhe skemat shtetërore të veçanta dhe suplementare të pensioneve, etj.

Investimet dhe projektet me financim të huaj dhe shoqëritë tregtare

Kemi audituar 7 projekte me financime të huaja, të cilat kanë pasur disbursime gjatë vitit 2012, ku kemi evidentuar mangësi dhe probleme të shoqëruara dhe me dëm ekonomik, kryesisht evazion fiskal si pasojë e mosderdhjes së detyrimeve të tatimit mbi të ardhurat.

Auditimi i kryer në 9 shoqëri aksionere ka identifikuar mjaft të meta dhe parregullsi në menaxhimin e tyre, madje dhe shkelje të ligjshmërisë në fushën e shpenzimeve në vlerën 524.1 milionë lekë. **Kemi rekomanduar** që për shoqëritë aksionere të audituara, Ministria e Ekonomisë dhe ministritë e tjera respektive të marrin masa të menjëhershme për mënjanimin e shkeljeve të disiplinës financiare.

Problem mjaft serioz vazhdon të mbetet gjendja e shoqërisë "**Albpetrol" sh.a. Fier.** Edhe në auditimin e përfunduar në ditët e para të muajit shtator 2013, përsëri kemi evidentuar mjaft parregullsi dhe shkelje të legjislacionit me pasojë dëm ekonomik. Kemi kërkuar arkëtimin në rrugë ligjore të vlerës **prej rreth 5,4 miliardë lekë që Shoqëria "Armo" sh.a. Fier, i detyrohet shoqërisë "Albpetrol" sh.a. Fier,** detyrim ky që i përket vitit 2011. Për këtë detyrim, është bërë kërkesë padi në gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në qershor të këtij viti, me paditës shoqëria "Albpetrol" sh.a. Fier dhe i paditur Shoqëria "Armo" sh.a. Fier.

Kërkuam gjithashtu arkëtimin e vlerës prej **rreth 2,2 miliardë** lekë për shlyerjen e detyrimit të furnizimit me naftë dhe gaz qe tre kompani private që operojnë në fushën e naftës dhe të gazit i kanë Albpetrol.

Auditimi i garancisë së ofertës në privatizimin e shoqërisë "Albpetrol"sha, Patos

Nga auditimi i ushtruar në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, me objekt: "Auditim mbi ecurinë e arkëtimit të garancisë së ofertës së paraqitur nga shoqëria "Vetro Energy PTE Ltd" për privatizimin e shoqërisë "Albpetrol"sh.a, Patos", konstatuam se garancia e ofertës që duhej të tërhiqej në rastin e një kandidati fitues, kur

ai nuk arrin, që brenda afatit kohor të parashikuar në dokumentet standarte të tenderit të nënshkruajë marrëveshjen ose të dorëzojë garancinë e kontratës, të kërkuar nga marrëveshja, nuk është bërë e mundur të realizohej. Garancia e ofertës ishte 10% e çmimit total, që kandidati fitues ofroi për blerjen e aksioneve të shoqërisë "Albpetrol" sh.a, pra 85 milionë Euro.

Duke qenë se nuk u arrit, nga kandidati fitues, që brenda afatit kohor të parashikuar në dokumentet standarde të tenderit, të nënshkruhej marrëveshja, garancia e ofertës **duhej të ishte arkëtuar në Buxhetin e Shtetit**. Nga ana e Ministrisë janë bërë komunikime elektronike për procesin dhe garancinë e ofertës, *por edhe pas mbylljes së procedurave të privatizimit e deri më tani, nuk është arkëtuar garancia bankare në* ***shumën 85,000,000 euro, ose rreth 12 miliardë lekë, duke i shkaktuar dëm ekonomik Buxhetit të Shtetit në këtë shumë.***

Arkëtimi i kësaj shume duhet të vazhdojë të ndiqet me përparësi nga të gjithë institucionet përgjegjëse shtetërore. Gjithashtu rekomandojmë që METE, në bashkëpunim me Avokatin e Shtetit, të kryejnë ndërhyrjet e duhura në aktet ligjore dhe nënligjore, për të përfshirë në formularët e garancive të ofertave dhe kontratave shtesë, që do ta bënin më të detyrueshëm zbatimin e garancisë së ofertës apo kontratës së nënshkruar nga kandidatët fitues, duke e detyruar subjektin përkatës të respektojë kushtet e tenderit dhe të gjitha detyrimet referuar kuadrit rregullator vendas e të huaj.

Koncesionet në fushën e bakrit, kromit dhe energjetikës

Auditimi i koncesioneve në fushën e bakrit, kromit dhe energjetikës nga ne ka filluar nga muaji qershor 2013. Ky auditim nuk është përfunduar, pasi për një periudhë prej një muaj e gjysme grupi i auditimit u pengua të realizojë misionin e tij nga ish Sekretari i Përgjithshëm Dardan Domi. Falë ndërhyrjes së ish ministrit, aktualisht Deputet i Kuvendit z. Florjon Mima, kjo situatë jo normale u kalua dhe puna audituese është ne proces.

Tregu informal i punës

Nga auditimi i Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, rezulton n*ga të dhënat zyrtare,* se niveli i informalitetit paraqitet shumë i ulët. Nëse kjo do të ishte gjendja reale, arritjet e Ministrisë Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore do të ishin madhore, duke na renditur ndër vendet me informalitet më të ulët në botë. Ne fakt, për gjendjen e informalitetit të përhapur tek ne kanë paraqitur shqetësim edhe organizmat ndërkombëtare si Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore. Nga studimet e kryera prej tyre ose organizmave të tjerë, informaliteti paraqitet në nivele të larta. Konstatuam se inspektorët nuk e njohin situatën e subjekteve që zhvillojnë aktivitet në territorin që mbulojnë. Mungesa e të dhënave të dixhitalizuara në nivel kombëtar ka

bërë që drejtoritë rajonale të kryejnë inspektime në një numër të vogël subjektesh. Për të ulur subjektivizmin e strukturave inspektuese, kemi rekomanduar inspektime me grupe të përbashkëta, ku të përfshihen Inspektorati Shtetëror i Punës, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Inspektorati i Ndërtimit dhe veçanërisht Instituti i Sigurimeve Shoqërore, i cili është përfituesi direkt nga minimizimi i punës së zezë. Ky Institut me legjislacionin ekzistues është përjashtuar nga kjo e drejtë.

Menaxhimi financiar dhe kontrolli, performanca e auditimit të brendshëm në sektorin publik

Gjatë auditimit te kryer në njësitë shpenzuese të institucioneve buxhetore, konstatuam mjaft probleme të dokumentimit të veprimeve ekonomike; mbajtjes së kontabilitetit; caktimit të nëpunësit zbatues të njësive publike; përcaktimit të përgjegjësive materiale të punonjësve që shkaktojnë dëme ekonomike; si dhe të sanksioneve që duhen aplikuar për parregullsitë financiare, etj.

Ministria e Financave ka zbatuar rregullat e përcaktuara në Ligjin "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", por nga zbatimi në praktikë i këtij ligji konstatuam se ka mjaft probleme me menaxhimin financiar të fondeve publike. **Kemi rekomanduar** që Ministria e Financave të ndërmarrë procedurat e duhura ligjore për përmirësimin e ligjit "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", duke kërkuar që të shtohen nene për dokumentet standarde vertetues të veprimeve ekonomike,që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative, të standardizohen programe kompjuterike të çertifikuara që duhet të përdorin të gjitha njësitë e qeverisjes për mbajtjen e kontabilitetit dhe plotësimin e pasqyrave financiare, si dhe të përcaktohet përgjegjësia financiare e punonjësve të njësive publike për dëmet ekonomike të shkaktuara qëllimisht apo nga neglizhenca gjatë ose në lidhje me procesin e ekzekutimit të detyrave zyrtare.

Lidhur me perfomancen e auditimit te brendshëm, konstatuam se, pavarësisht kritereve të përcaktuara në VKM "Për ngritjen e njësive të auditimit të brendshëm", në këtë vendim nuk janë përcaktuar kritere të matshme për ngritjen e këtyre njësive në raport me rëndësinë dhe madhësinë sipas llojeve të institucionit dhe fondeve buxhetore që menaxhojnë këto institucione. **Kemi rekomanduar** qe Njësia Qendrore e Harmonizuar e Auditimit te Brendshëm ne Ministrinë e Financave të nisë procedurat ligjore për përmirësimin e VKM-së, me qëllim përcaktimin e kritereve të matshme për ngritjen e njësive të auditimit të brendshëm në institucionet buxhetore. Këto kritere të vendosen, duke mbajtur parasysh rëndësinë, madhësinë, strukturat vartëse, treguesit vjetorë buxhetorë, numrin e punonjësve të punësuar në këto njësi, si dhe tregues të tjerë.

Nga të dhënat e audituara, verifikohet një gjendje potenciale me rreth 1,100 auditues për t'u punësuar. Në këto kushte *rekrutimi i punonjësve të pacertifikuar, nga titullarët e institucioneve,*

është në kundërshtim me nenin 19 pika 2, gërma "a" e ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007, ndryshuar me ligjin nr. 10318, datë 16.06.2010 'Për auditimin e brendshëm në sektorin publik'.

Nga auditimet e kryera nga KLSH, kanë rezultuar raste kur rekomandimet e dhëna nga Audituesi i Brendshëm nuk zbatohen. Në njësi të veçanta gjendja paraqitet tepër alarmante. P.sh. në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, nga 12 auditime të kryera janë lënë 69 rekomandime, nga të cilat nuk është zbatuar asnjë prej tyre, në Prefekturën Fier, nga 22 auditime të kryera janë lënë 339 rekomandime, nga të cilat nuk është zbatuar asnjë prej tyre.

Referuar dobisë ekonomike të auditimeve të KLSH-së, sjellim në vëmendjen Tuaj një tregues mjaft domethënës për shkallën e efektivitetit të veprimtarisë. Për vitin 2012, për çdo lek të Buxhetit të Shtetit të investuar në KLSH, janë kërkuar për t'u zhdëmtuar 51,7 lekë, ose 87 përqind më shumë se një vit më parë.

Mbi bazën e të dhënave të mësipërme të realizimit të treguesve makroekonomike të vitit 2012 dhe nga analizimi i tyre, konkludojmë se ekonomia shqiptare mundi te rritej gjate këtij viti, ndonëse me ritme më të ngadalta. Ajo arriti te përballojë efektet e krizës ekonomike dhe financiare të Eurozonës, por pa ruajtur tërësisht ekuilibrat kryesorë makroekonomikë. Kështu, edhe pse niveli i defiçitit buxhetor vjetor u mbajt i ulur(3.4 përqind e PBB-së), Kuvendi, me propozim të Qeverisë, u shtrëngua të heqë tavanin e borxhit publik prej 60% të PBB-së. Ne gjendjen aktuale, Borxhi është veshtirësisht i menaxhueshëm, pse nuk ka kufi të sipërm limit.

Inflacioni u mbajt nën kontroll (sipas BSH, lëviz ne kufijtë 2.8-2.9 përqind) dhe për ketë duhen vlerësuar përpjekjet dhe politika monetare e ndjekur nga Banka e Shqipërisë.

Treguesit fiskalë shënuan ulje. Kështu, të ardhurat nga tatimet, në raport me PBB-në, ranë me një përqind, ndërsa të ardhurat doganore njohën vetëm një rritje të lehtë në vlerën monetare, por jo në raport me PBB-në, në krahasim me një vit më parë.

Shpenzimet buxhetore po ashtu shënuan ulje me rreth një përqind të PBB-së, në krahasim me një vit më parë, duke përfshirë dhe shpenzimet për investime kapitale. Ne përgjithësi, ato u mbajtën nën kontroll.

Krahas mendimeve dhe rekomandimeve të parashtruara më sipër, me synim miradministrimin e fondeve publike gjatë vitit të ardhshëm buxhetor 2014, duke patur parasysh porosinë e përmbajtur në Deklaratën e Pekinit të Kongresit të XXI-të të INTOSAI, se duhet *'Të zhvillohet aftësia për të audituar fazat e planifikimit të financave publike, me qëllim që të nxitet ekzekutivi dhe legjislativi të vlerësojë projektet afatmesme dhe afatgjata, të cilët janë të lidhura me zhvillimet e mundshme të cikleve të ekonomisë, borxhit, programeve publike, si dhe angazhime të tjera si siguria sociale, pensionet, arsimi dhe kujdesi publik'* dhe nën këndvështrimin

e rekomandimeve të Kongresit të V-të te EUROSAI-t për rritjen e rolit të Parlamentit në përgatitjen e Buxhetit të Shtetit, duke përdorur me efektivitet SAI-n, sugjerojmë:

- *Përgatitjen e një Buxheti realist, duke shmangur praktikën e vërejtur vitet e fundit të korrigjimit të Buxhetit në gjysmën e vitit financiar;*

- *Vendosjen e një tavani kushtetues për borxhin publik në nivelin 60 përqind të PBB-së, me kusht që ai të tejkalohet vetëm në rastet e emergjencave, katastrofave natyrore, dhe krizave ekonomike. Në rastet e tejkalimit të kufirit, Qeveria të marrë masa për balancimin e Buxhetit. Të vendoset në ligjin "Për Menaxhimin e Buxhetit një nen që të ardhurat nga privatizimi të përdoren në radhë të parë dhe jo më pak se 50 përqind, për uljen e Borxhit;*

- *Për borxhin e Qeverisë ndaj kontraktorëve privatë, vendosjen në Ligjin "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2014" të një neni që në të ardhurat nga privatizimet, pjesa e mbetur pas përdorimit të 50 përqind e lartë të fondeve për të ulur borxhin publik, të shkojë për uljen e detyrimeve për faturat e papaguara ndaj sipërmarrësve privatë për punët publike të realizuara. Kërkesën ndaj sistemit bankar që të mos bllokojë dhënien e kredive për kompanitë, të cilave Shteti u ka borxh;*

- *Vendosjen ne Ligjin "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2014" të një neni që përdorimi i Fondit të Kontigjencës për ruajtjen e deficitit buxhetor, të bëhet me miratim nga Kuvendi i Shqipërisë;*

- *Zvogëlimin deri ne arkëtimin e plotë të vlerës së borxhit tatimor dhe doganor;*

- *Konsolidimin dhe mirëfunksionimin e strukturave të menaxhimit financiar, kontrollit dhe auditimit të brendshëm, në përputhje me kërkesat e legjislacionit të miratuar dhe me kërkesat e parashtruara nga BE për vendin tonë, në kuadër të Kontrollit të Brendshëm Financiar të Sektorit Publik.*

Të nderuar deputetë,

Në deklaratën e Pekinit të Kongresit të XXI-të të INOTSAI-t të datës 31 tetor 2013, në kapitullin Ruajtja e Qëndrueshmërisë Afatgjatë të Financave Publike, theksohet se '*Mësimet që rrodhën nga kriza ekonomike dhe globale e fillimit të shekullit të XXI, kanë nënvizuar rëndësinë strategjike të qeverive në mbajtjen e financave publike të shëndosha, për të krijuar kushtet për rritje ekonomike, punësim dhe mirëqenie sociale. Nëpërmjet auditimeve të pavarura dhe të shëndosha, institucionet supreme të auditimit kontribuojnë në mbajtjen e qëndrueshmërisë afatmesme dhe afatgjatë të financave publike, në mbrojtje të interesit publik dhe forcimit të qeverisjes kombëtare në çdo vend*'.

Kongresi i V-të i EUROSAI-t, komuniteti i institucioneve supreme të auditimit publik të Evropës, në Rezolutën e tij afirmon se '*Eksperienca e gjerë e institucioneve supreme të auditimit (SAI-ve) dhe njohuritë e akumuluara ndërsa auditojnë zbatimin e Buxhetit të Shtetit, përbëjnë një potencial të rëndësishëm, i cili mund të përdoret përgjatë përgatitjes dhe zbatimit të Buxhetit*'. Po kjo Rezolutë thekson se '*Të specifikosh objektiva dhe rezultate në një Buxhet është*

një mjet shtesë i menaxhimit dhe kontrollit, për ta bërë atë një Buxhet final të orientuar nga rezultati dhe për të lejuar më shumë influencë të Parlamentit mbi Buxhetin'.

Bazuar në rekomandimet e Deklaratës së Pekinit dhe Rezolutën e Kongresit të V-të të EUROSAI-t për rolin e SAI-t në përgatitjen e Buxhetit dhe të ndërgjegjshëm që përgatitja e Projekt-Buxhetit te Shtetit për vitin 2014 është një sfidë e madhe, jemi të gatshëm që të kontribuojmë në përgatitjen e tij, pa cënuar pavarësinë tonë në auditimin e zbatimit të Buxhetit, në rast se Ju do ta gjykoni të arsyeshme.

Auditimi Kombëtar në shërbim të qeverisjes kombëtare

- *Prezantimi i Raportit të Performancës së KLSH për vitin 2013*

16 qershor 2014

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, Kuvendi i Shqipërisë

Deputetët pjesëmarrës

1.	Erion Braçe	11.	Sherefedin Shehu
2.	Ridvan Bode	12.	Perparim Spahiu
3.	Anastas Angjeli	13.	Ervin Bushati
4.	Florjon Mima	14.	Liljana Elmazi
5.	Ervin Koçi	15.	Edmond Spaho
6.	Andrea Marto	16.	Igli Cara
7.	Evis Kushi	17.	Gjovalin Kadeli
8.	Blerina Gjylameti	18.	Jorida Tabaku
9.	Albana Vokshi	19.	Agron Çela
10.	Luan Duzha		

I nderuar zoti Kryetar, të nderuar deputetë,

Mbështetur në drejtimet e zhvillimit të Planeve Strategjike 2011-2017, të organizatave profesionale të fushës INTOSAI dhe EUROSAI, Kontrolli i Lartë i Shtetit, në fillim të vitit 2013, finalizoi, në bashkëpunim me ekspertë të SIGMA (Programi i BE dhe OECD "Mbështetje për Përmirësim në Qeverisje dhe Menaxhim"), strategjinë e tij të zhvillimit 2013-2017 dhe planin e veprimit, me vizionin që të jetë një trupë profesionale, që i kontribuon shtimit dhe kursimit të vlerës së parave publike, duke dhënë siguri për llogaritë financiare të përdoruesve të tyre dhe duke ndihmuar në përmirësimin e menaxhimit të qeverisë e të enteve të tjera publike nëpërmjet auditimit, duke fituar në këtë mënyrë besim të plotë te qytetarët shqiptarë dhe institucionet e audituara.

Në përputhje me katër boshtet strategjike të zhvillimit të INTOSAI-t dhe EUROSAI-t për këto vite për zbatimin e standardeve profesionale ISSAI, ndërtimin e kapaciteteve institucionale, shkëmbimin e njohurive audituese dhe mirëqeverisjen e komunikimin, duke reflektuar moton e INTOSAI-t "*Experentia mutua Omnibus prodest*" (Eksperienca e përbashkët u shërben të gjithëve), si dhe në zbatim të rekomandimit të Raportit të Progresit të Shqipërisë të Komisionit Europian të tetorit 2012, që kërkon që: "Auditimi i jashtëm duhet të vijë në nivel me standardet e INTOSAI-t"", KLSH-ja ka punuar në drejtimet e mëposhtme, duke qenë viti 2013, viti i parë i zbatimit të strategjinë së tij të zhvillimit 2013-2017, strategji e cila synon sjelljen e veprimtarisë audituese të institucionit në parametrat e institucioneve të zhvilluara simotra të Bashkimit Europian, në përputhje të plotë me mandatin kushtetues të KLSH-së dhe me pritshmëritë e Kuvendit dhe të qytetarëve.

1. Përmirësimi i rezultateve në auditim

Në zbatim të motos së Kongresit të XXI-të INTOSAI-t, të zhvilluar në Pekin vitin e kaluar, që "auditimi kombëtar të vihet në shërbim të qeverisjes kombëtare, për përmirësimin e menaxhimit financiar publik të vendit", duke përditësuar manualet ekzistuese të auditimit, të bazuar në analizën e riskut, kemi përfunduar 164 auditime, nga 147 të planifikuara ose 11 për qind më shumë, duke zbuluar parregullsi dhe shkelje financiare në nivelin e 12,5 miliardëve lekëve në të ardhurat e buxhetit të shtetit, si dhe 2,6 miliardë lekë në shpenzimet e kryera, me dëm efektiv të përgjithshëm, të konstatuar në vlerën 15,1 miliardë lekë, ose rreth 108 milionë euro. Kemi rekomanduar shpërblimin e këtij dëmi në masën 99,9%. Vërejmë se dëmi ekonomik i zbuluar nga KLSH-ja në të dy vitet 2012 dhe 2013, që siç dihet KLSH-ja në këto vite është drejtuar prej meje, është rreth dy herë më i madh se vlera e dëmit të zbuluar prej tij në tri vitet 2009, 2010 dhe 2011, të marra së bashku.

Krahas zbulimeve me dëm ekonomik, gjatë vitit 2013, si KLSH kemi konstatuar shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e institucioneve të audituara, në nivelin e 4, 4 miliardë lekëve (mbi 31 milionë euro), ose 2.5 miliardë lekë më shumë nga shkeljet e konstatuara gjatë vitit 2012.

KLSH-ja ka kryer 63 auditime në ministri dhe institucione të tjera të pushtetit qendror, 57 auditime në institucione të pushtetit vendor, 27 auditime në institucione financiare, shoqëri me kapital të përbashkët, njësi dhe projekte me financime të huaja, si dhe 6 auditime në institucione të mbrojtjes së mjedisit.

Një tregues i rëndësishëm që përdoret sot në SAI-t perëndimore në institucionet supreme të auditimit, treguesi i dobisë së rezultateve të auditimit (raporti i shpenzimeve të një SAI me fondet e kërkuara për zhdëmtim nga dëmi i konstatuar në buxhetin e shtetit), i përdorur gjerësisht nga institucionet moderne të auditimit, flet qartë për punën

tonë. Për vitin e kaluar ai rezultoi 52.3 lekë të kërkuar për t'u zhdëmtuar, për çdo 1 lek të shpenzuar për KLSH-në. Gjatë viteve 2009-2011, për 1 lek të shpenzuar nga buxheti i shtetit, KLSH-ja ka kërkuar për zhdëmtim 21 lekë, ndërsa për vitin 2013, ashtu si dhe në vitin 2012, për çdo 1 lek të shpenzuar, institucioni ka kërkuar për zhdëmtim 52 lekë, ose rreth 31 lekë më shumë.

Si institucion suprem i auditimit publik (SAI), kemi propozuar disa ndryshime të rëndësishme kushtetuese dhe ligjore, të cilat kanë dhe do të kenë impakt të drejtpërdrejtë në mirëqeverisjen e financave publike. Unë po i përmend shkurtimisht, ndërsa në raport janë të sqaruara më në detaje.

Së pari, kemi kërkuar vendosjen e kufirit të borxhit publik në Kushtetutë (propozim i paraqitur në dy vite radhazi nga auditimi i zbatimit të buxhetit faktik të shtetit për vitin 2011 dhe 2012), duke rekomanduar që Ministria e Financave të ngrejë një grup pune me ekspertët më të mirë të fushës, për përgatitjen dhe paraqitjen e një nisme ligjore për fiksimin në Kushtetutë të treguesit të nivelit të borxhit publik ndaj produktit të brendshëm bruto të vendit.

Së dyti, për dy vite radhazi 2012 dhe 2013, institucioni ka rekomanduar saktësimin dhe shqyrtimin me realizëm të gjendjes së borxheve qe buxheti i shtetit ka ndaj sipërmarrësve private, si dhe përcaktimin e masave për të lehtësuar sa të jetë e mundur sipërmarrjen private nga gjendja e vështirë ku ndodhet.

Së treti, nga auditimi i performancës për ndarjen administrative të vendit, i kryer në muajt shkurt-tetor 2013, i përcjellë në subjekte në nëntor 2013, kemi rekomanduar një ndarje të re administrative territoriale, për të realizuar reduktimin e ndjeshëm të numrit të bashkive dhe të komunave, duke synuar një shërbim më cilësor ndaj komunitetit, por në respekt maksimal të konsensusit politik mes partive, si dhe të atij social, kulturor dhe historik të zonave të ndryshme të vendit, sipas kërkesave të Kushtetutës, neni 108, pika 2, dhe të Kartës Europiane të Autonomisë Vendore.

Sikurse e ka theksuar në Pekin, në tetor 2013 presidenti i INTOSAI-t, Audituesi i Përgjithshëm i Kinës Liu Jayi, "Ne SAI-t duhet të fokusohemi në faktorët e përgjithshëm apo ata sistemikë që ndikojnë fuqishëm në zbatimin e politikave dhe në qëndrueshmërinë financiare afatgjatë të vendeve tona, duke kontribuar në krijimin e politikave publike të shëndosha financiare dhe monetare".

Në këtë këndvështrim jemi të ndërgjegjshëm që mund të arrijmë një progres real dhe modernizim të institucionit vetëm duke zbatuar strategjinë tonë të zhvillimit 2013-2017, dhe, natyrisht, ligjin e ri organik të institucionit, që do të miratohet dhe do të na shërbejë jo vetëm për të vendosur veprimtarinë tonë audituese të bazuar në standardet

ndërkombëtare të auditimit, por edhe për të shtuar kontributin në përmirësimin e qeverisjes dhe të menaxhimit të fondeve publike.

Në drejtim të luftës kundër korrupsionit dhe përmirësimit të qeverisjes, për vitin 2013, KLSH-ja ka bërë 38 kallëzime penale ndaj 94 punonjësve publikë, kryesisht nëpunës të lartë dhe të mesëm të administratës. Numri i kallëzimeve penale të viteve 2012 dhe 2013 është rreth katër herë më i lartë se kallëzimet penale të kryera në tri vitet e marra së bashku, 2009, 2010 dhe 2011 ose, shprehur ndryshme, kallëzimet penale vetëm për vitin 2013 janë dy herë më shumë se të tre viteve 2009, 2010 dhe 2011, të marra së bashku.

Gjetjet tona mund të ishin edhe më të larta, nëse nuk do të pengoheshim dhe do të na krijohej mundësia të auditonim strukturat tatimore. Gjatë vitit 2013, sikurse edhe gjatë viteve fund i 2009-ës, 2010, 2011 dhe 2012, auditimet tona në organet tatimore kanë dështuar, për mosdhënien e informacionit të kërkuar nga ne, nga drejtuesit e tyre. Por në rast se deri në tetor 2013, administrata tatimore e justifikonte mosdhënien e informacionit me vendimin nr. 98, datë 20.10.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë, pas vendimit nr. 83, datë 20.10.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë, që i jep të drejtë KLSH-së të kërkojë informacionin që i nevojitet, çdo pengesë e mëtejshme është në kundërshtim flagrant me ligjin.

2. Zhvillimi i kapaciteteve audituese

Në Deklaratën e Pekinit të Kongresit XXI të INTOSAI-t, theksohet se: "INTOSAI njeh se është e rëndësishme që metodat e auditimit të SAI-ve të bazohen në njohuritë teknike dhe shkencore aktuale dhe që audituesit të kenë kualifikime të përshtatshme, si dhe integritet moral". Në zbatim të parimeve të përmbajtura në ISSAI 12 "Vlerat dhe dobitë e institucioneve supreme te auditimit", të tilla si:

1) Forcimi i përgjegjshmërisë, transparencës dhe integritetit të qeverisë dhe enteve të sektorit publik;

2) demonstrimi i vazhdueshëm i rëndësisë që ka SAI për qytetarët, parlamentin dhe aktorët e tjerë;

3) të qenit një institucion model që drejton përmes shembullit, kemi punuar të zhvillojmë aftësitë tona audituese, duke kthyer vëmendjen drejt auditimit të performancës, krahas konsolidimit të auditimit financiar dhe thellimit të luftës kundër korrupsionit, në sinergji me institucionet e tjera publike.

Jemi përpjekur të menaxhojmë me eficiencë dhe efektivitet burimet tona njerëzore. Kemi konsoliduar dy departamentet e krijuara gjatë vitit 2012, atë të Auditimit të Performancës dhe Departamentin e Kërkimit Shkencor dhe Zhvillimit, të cilat nga pikëpamja strukturore përbëjnë shtyllat e modernizimit të institucionit. Ndryshimet

strukturore sollën zhvendosjen e një pjesë të punonjësve që kryenin funksione administrative mbështetëse në detyra audituese, duke realizuar shtimin e "trupës audituese" dhe të "trupës së kontrollit të cilësisë", në dobi të veprimtarisë sonë kryesore, që është kryerja e auditimeve.

Nëpërmjet një procesi të vazhdueshëm kualifikimi, kryerjes së trajnimeve të thelluara dhe gërshetimit të ngritjes arsimore me veprimtarinë praktike audituese, struktura e punonjësve në KLSH për vitin e kaluar ka vijuar të përmirësohet jo vetëm thjesht në favor të stafit auditues me arsim të lartë, por edhe të stafit me kualifikime profesionale, akademike dhe grada shkencore, si dhe me kualifikim në fusha të dyta ekspertize. Në fund të vitit 2013 rreth 10% e stafit, ose 15 punonjës kishin më shumë se një diplomë universitare në ekonomi, jurisprudencë, si dhe në fusha auditimi, 5 punonjës ishin me grada shkencore doktor dhe profesor, 3 punonjës zotëronin certifikim ndërkombëtar nga Instituti i Ekspertëve të Certifikuar të Auditimit Publik (CITFA) të Britanisë së Madhe, ndërsa 5 audituesë të lartë u certifikuan dhe diplomuan nga Nisma për Zhvillim IDI e INTOSAI-t për auditimin e borxhit publik, të teknologjisë së informacionit dhe për analizën e riskut, dhe 4 të tjerë ishin në proces certifikimi dhe e përfunduan këtë vit, si dhe 26 audituesë të tjerë zotërojnë certifikatën e audituesit të brendshëm të sektorit publik. I gjithë ky staf është angazhuar në nivelet e mesme dhe të larta drejtuese të institucionit.

Në zbatim të standardit ndërkombëtar ISSAI 40 "Për Kontrollin e Cilësisë", të standardit ISSAI 1220 "Kontrolli i Cilësisë për Auditimin Financiar" dhe të rekomandimeve të SIGMA-s, procesi i sigurimit të cilësisë tashmë jo në të nxehtë që kryhet përgjatë punës së veprimtarisë audituese, por "Shqyrtimet e Ftohta", siç quhen në gjuhën profesionale, janë realizuar nga një strukturë e përkohshme e krijuar brenda KLSH-së, pas evadimit e arkivimit të dosjeve të auditimeve. Grupi i shqyrtimit, i përbërë nga 10 audituesë dhe nga dy drejtues grupi, përzgjodhi në mënyrë rastësore 24 dosje auditimi ose 15% të auditimeve të kryera dhe të evaduara brenda muajit dhjetor 2013, në krahasim me 13 % të dosjeve të shqyrtuara në vitin 2012.

Në vitin 2013 KLSH-ja ka denoncuar në Prokurori për abuzim me detyrën dy ish-audituesë të tij, bazuar në kontrollet e cilësisë sipas standardit ISSAI 40. Auditimi i brendshëm në institucion është fuqizuar dhe ka marrë rëndësinë e duhur, duke synuar administrimin sa më efiçient të fondeve dhe të burimeve tona njerëzore.

Në përputhje me fjalët e ish-Presidentit të INTOSAI-t, zotit Terence Nombembe, Audituesit të Përgjithshëm të Afrikës së Jugut, në Kongresin XXI të INTOSAI-t në Pekin, tetor 2013, se "SAI-t duhet të vazhdojnë me trajnimet për të ruajtur superioritetin e tyre në mjedisin e auditimit të sektorit publik. Këto trajnime do të pajisin stafin e SAI-ve me pushtetin e mendimit dhe të analizës së pavarur", duke e

konsideruar zhvillimin e burimeve njerëzore si investimin më parësor në KLSH, çdo pjesëtar i stafit u trajnua vitin e kaluar për më shumë se 22 ditë. Ky tregues, i ngjashëm me atë të SAI-ve të zhvilluara, po të krahasohet me tri vitet 2009, 2010 dhe 2011, kur janë kryer respektivisht 2, 3.1 dhe 2.1 ditë trajnimi/punonjës në vit, rezulton 10 herë më i lartë se mesatarja e viteve 2009, 2010 dhe 2011 ose sa 5 fishi i dy viteve të fundit të marra së bashku.

Të nderuar deputetë, dua t'ju sjell në vëmendje se duke realizuar afërsisht një muaj pune si ditë trajnimi, pra mbi 22 ditë për audituesi në secilin prej viteve 2012, 2013, si dhe duke kryer njëkohësisht të njëjtin numër auditimesh apo edhe pak më tepër, në raport me vitet 2009, 2010, 2011, të marra veçmas, shihet qartë se institucioni ka rritur eficiencën dhe efektivitetin e punës audituese, duke pasur parasysh se audituesit ishin "të zënë" me vetëm dy ose tre ditë trajnimi në vit, në vitet e kaluara.

Si KLSH, për vitin 2013 realizuam 3,090 ditë trajnimi, nga 227 ditë në vitin 2011. Kemi trajnuar 120 punonjës jashtë vendit, me një mesatare 5,3 ditë trajnimi jashtë vendit për punonjës.

Në funksion të objektivit strategjik të rritjes se kapaciteteve audituese, KLSH-ja aplikoi pranë Delegacionit të BE-së në Tiranë dhe fitoi Projektin e Binjakëzimit, në kuadër të fondeve IPA 2013, për "Forcimin e kapaciteteve të Auditimit të Jashtëm", në vlerën prej 2,11 milionë Euro. Ky projekt nis në fund të këtij viti, mbas gjetjes së dakordësisë më të fundit midis delegacionit të BE-së në Tiranë dhe Ministrisë së Financave, pasi të gjitha procedurat kanë përfunduar dhe besojmë se do të forcojë kapacitetet audituese të KLSH-së, përmes zhvillimit dhe zbatimit të metodologjive moderne të auditimit, kualifikimit të mëtejshëm të burimeve njerëzore dhe përmirësimit të raporteve të auditimit dhe të skemave për ndjekjen e rekomandimeve të institucionit. Gjithashtu nga ky projekt ne presim një partneritet konstruktiv në institucione moderne auditimi të vendeve anëtare të BE-së.

3. Marrëdhëniet me Kuvendin

Strategjia e zhvillimit të KLSH-së për vitet 2013-2017 nuk mund të realizohet pa një bashkëpunim efektiv dhe konstruktiv me Kuvendin e Shqipërisë. Me mandat kushtetues dhe si SAI, në baze të nenit 8 të standardit ISSAI 1, KLSH-ja vepron si një agjent i Kuvendit dhe i publikut, për sigurimin e mirëqeverisjes së fondeve publike.

Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve te Bashkuara A66/209 e 22 dhjetorit të vitit 2011, njeh rolin e rëndësishëm te institucioneve te auditimit të jashtëm publik (SAI-t) në promovimin e efiçiencës, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës së administratës publike, rol i cili kontribuon në arritjen e objektivave të zhvillimit kombëtar. Asambleja e OKB-së i inkurajon vendet anëtare dhe parlamentet e

tyre që të zbatojnë në përputhje me strukturat e tyre institucionale kombëtare parimet e përcaktuara në Deklaratat e Limës dhe Meksikos".

Në këtë këndvështrim, falënderojmë Kuvendin dhe të gjithë Ju deputetët, për interesimin e treguar ndaj veprimtarisë sonë gjatë vitit të kaluar dhe për mirëkuptimin ndaj nesh. Ne, nga ana jonë, ju kemi ftuar në çdo analizë dhe aktivitet tjetër të rëndësishëm tonin edhe gjatë vitit 2013, të vetëdijshëm se duke ju informuar totalisht dhe duke shkëmbyer mendime dhe eksperienca me ju, i shërbejmë me efektivitet misionit tonë.

Vlerësojmë mbështetjen financiare të dhënë nga Kuvendi, e cila, dhe pse modeste, garanton funksionimin normal të aktivitetit tonë auditues. Vlerësojmë përkrahjen e Kryetarit të Kuvendit, të deputetëve anëtarë të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, si dhe vullnetin dhe gatishmërinë e Kuvendit, që me vendimin nr. 64 "Për fillimin e procedurave parlamentare për auditimin e veprimtarisë ekonomike të KLSH-së", i ka siguruar institucionit auditimin e jashtëm të fondeve të tij, duke mbështetur prirjen tonë për një SAI të hapur dhe transparent ndaj Kuvendit, institucioneve të audituara dhe qytetarëve. Jemi në pritje të audituesit të jashtëm të pavarur, që do të përzgjidhet nga Kuvendi, si dhe të miratimit të ligjit organik të institucionit.

4. Partnerët e jashtëm

Gjatë vitit 2013, në zbatim të nenit 15 "Për shkëmbimin ndërkombëtar të eksperiencave" të standardit ISSAI 1 dhe të standardit ISSAI 30 "Kodi i Etikës i SAI-ve", KLSH-ja aplikoi dhe u pranua anëtar i Task Forcës së Organizatës Evropiane të Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAI) "Mbi auditimin e etikës". Kjo është pjesëmarrja e parë në këto komisione. Nëpërmjet anëtarësimit dhe pjesëmarrjes aktive në këtë organizëm, si dhe aplikimit të Instrumentit të vetëvlerësimit të integritetit, të ashtuquajturit INTOSAINT, jemi përpjekur të forcojmë infrastrukturën etike si brenda institucionit, ashtu dhe të promovojmë integritetin dhe etikën në institucionet e sektorit publik që auditojmë, duke u përpjekur "të udhëheqim nëpërmjet shembullit", kërkesë kjo e përmbajtur në Parimin 8 "Sigurimi i Transparencës dhe i llogaridhënies së duhur nga SAI-t", të standardit ISSAI 12 "Vlerat dhe dobitë e institucioneve Supreme te Auditimit".

Viti 2013 është viti i konsolidimit të marrëdhënieve të KLSH-së me institucionet ndërkombëtare të auditimit si organizatat ndërkombëtare të profesionit, INTOSAI dhe EUROSAI, ku Kontrolli i Lartë i Shtetit është anëtar aktiv. Kemi marrë pjesë në Programin "3i" "Nisma e Zbatimit të ISSAI-ve", të INTOSAI-t, duke nënshkruar në mars 2013 *Marrëveshjen e Angazhimit me përfaqësues të Nismës së INTOSAI-t për Zhvillim (IDI) dhe me EUROSAI*. Në zbatim të një prej drejtimeve themelore të Strategjisë së Zhvillimit të KLSH-së 2013-2017 për zbatimin me efektivitet të standardeve ISSAI,

ngritëm grupin e punës me mbështetjen e SIGMA, duke plotësuar të gjitha detyrimet që rrjedhin nga kjo marrëveshje.

Në vitin 2013, krahas përfundimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me Gjykatën Austriake të Auditimit, me Institucionin Shtetëror të Auditimit të Malit të Zi, me Zyrën e Auditimit të Institucioneve të Bosnjës dhe Hercegovinës dhe me SAI-n e Maqedonisë, KLSH-ja nisi negociata për përfundimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe me SAI-t e Greqisë, Bullgarisë dhe Serbisë, duke synuar fuqizimin e një rrjeti të vendeve të Evropës Juglindore të institucioneve më të larta të auditimit, nën shembullin dhe eksperiencën e rrjeteve të ngjashme të krijuara në Evropë.

Marrëveshjet e nënshkruara gjate vitit 2012 me SAI-t e zhvilluara të Polonisë dhe Turqisë, gjate vitit 2013 janë zbatuar më së miri, duke mundësuar për çdo auditues të KLSH-së që të trajnohet për një periudhë kohore 7-14 ditë pranë këtyre SAI-ve me eksperiencë, ndërkohë që dhe me SAI-t e Kroacisë, Sllovenisë dhe të Kosovës ka vazhduar bashkëpunimi.

Kemi vijuar në një marrëdhënie intensive me SIGMA-n, ekspertët e të cilës e kanë mbështetur institucionin me programe trajnimi, në fusha me interes të lartë, si auditimi financiar, auditimi i përputhshmërisë, auditimi i performancës, auditimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit, etj.

Në zbatim të standardit ISSAI 5600 për "Marrjen e Eksperiencës dhe Rishikimin e Punës mes Kolegëve (Peer Review)", kemi përkthyer standardin, i kemi njohur të gjithë audituesit me të dhe kemi përgatitur platformën për nisjen e procesit "Peer Review" për këtë vit, duke ftuar një SAI të zhvilluar dhe partner me KLSH-në. Këtë nismë do ta ndërmarrim pas përfundimit të auditimit të jashtëm të llogarive tona, nga ekspertë të caktuar nga Kuvendi, pasi edhe kjo e fundit është një vlerë e shtuar për ne.

Gjatë vitit 2013 duam të theksojmë partneritetin e konsoliduar mes KLSH-së dhe DG Budget të Komisionit Evropian, sidomos në drejtim të bashkëpunimit për sigurimin e një draftligji organik për institucionin, në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare ISSAI.

Viti 2013 shënoi dhe fillimin e një praktike të re për KLSH-në, si SAI organizator i konferencave apo seminareve të ndryshme rajonale dhe ndërkombëtare për zhvillimin e auditimit të jashtëm publik. Përmendim dy aktivitete kryesore te zhvilluara:

a. Konferenca e II-të shkencore e KLSH-së në Tiranë, dhjetor 2013, me temë "Roli i Institucioneve Supreme të Auditimit në Menaxhimin e Përgjegjshëm Publik përballë sfidave aktuale", Konferenca e dytë Shkencore u organizua me mbështetjen modeste financiare edhe të Programit SIGMA. Në të morën pjesë rreth 120 pjesëmarrës nga SAI-t e zhvilluara partnere të KLSH-së, si nga Gjykata Evropiane e

Audituesve, nga SAI polak, turk, nga SAI-t e rajonit, nga DG-Budget, përfaqësues të institucioneve te tjera shtetërore, të botës akademike, të shoqatave të profesionistëve të fushës, të shoqërisë civile dhe mediave në Shqipëri, etj. Konferenca trajtoi 26 tema, ndër të cilat spikatën temat për krizën financiare dhe rritjen e rolit mbikëqyrës të auditimit publik mbi financat e shtetit, shtimi i transparencës dhe cilësisë së informacionit për publikun, përmirësimi i ndjeshëm i ndërveprimit të auditimit të jashtëm me auditimin e brendshëm publik, etj.

b. Seminari "Mbi vijimësinë e bashkëpunimit rajonal për auditimin e performancës", i zhvilluar në shtator 2013, në Tiranë, i organizuar bashkë me TAIEX dhe Grupin e Punës së EUROSAI për Aktivitetet e Përbashkëta në Auditim.

Në aktivitetin e organizuar nga Gjykata Evropiane e Llogarive në bashkëpunim me SIGMA-n në nëntor të vitit 2013 në Mal të Zi , KLSH-ja ndërmori nismën që për vitin 2014 të organizojë konferencën rajonale mbi "Auditimin bazuar në limitin e materialitetit dhe modelimin", si dhe për dy konferenca të tjera të jetë bashkë-organizatore me SAI-t e Malit të Zi dhe të Serbisë.

Rritja e transparencës dhe e komunikimit me qytetarin

Bazuar në standardin ISSAI 12, Parimi 4 "Raportimi mbi rezultatet e auditimit" dhe Parimi 6 "Komunikimi në mënyrë efektive me palët e interesuara", si dhe në ISSAI 20, Parimi 8, jemi përpjekur të zbatojmë një strategji komunikimi në funksion të rritjes së nivelit të llogaridhënies publike dhe transparencës, duke intensifikuar marrëdhëniet me publikun dhe vetë qytetarin.

Kemi trajtuar 401 letra dhe ankesa nga qytetarët për probleme të ndryshme, në krahasim me një numër të papërfillshëm të letrave dhe ankesave të trajtuara në vitin 2011.

Krahas shtimit të vrullshëm të pranisë se rezultateve dhe gjetjeve të auditimeve të institucionit në median e shkruar dhe elektronike, të vërejtur edhe gjatë vitit 2012, risi e vitit 2013 ishte angazhimi i drejtpërdrejtë i 42 punonjësve të KLSH-së, kryesisht kryeauditues dhe auditues të lartë, në përgatitjen dhe botimin e mbi 140 shkrimeve, analizave dhe opinioneve në të gjitha gazetat e vendit. Ndërkohë, pasqyrimi në media i rezultateve të auditimeve të KLSH-së, të përcjella nëpërmjet njoftimeve për shtyp të institucionit, sikurse dhe gjatë vitit 2012, ka një rritje rreth mbi tre herë, në krahasim me pasqyrimin e vitit 2011. Përfitoj nga ky rast të falënderoj të gjitha mediat.

Ky vit është i treti radhazi, ku, në zbatim te Parimit 8 "Sigurimi i transparencës dhe i llogaridhënies së duhur nga SAI-t", analizat vjetore në nivel departamenti auditimi zhvillohen krejtësisht të hapura, në prani të përfaqësuesve të medias përgjatë disa ditëve dhe finalizohen me analizën e përgjithshme të KLSH-së.

Në zbatim të Parimit 8-të të ISSAI 20 për komunikimin aktiv e profesional të një SAI nëpërmjet publikimeve, gjatë vitit 2013 institucioni ka vijuar punën e nisur në vitin 2012 dhe 10 botimeve të realizuara gjatë vitit 2012 u janë shtuar edhe 12 botimet e vitit 2013. Kolana e botimeve të KLSH-së ka arritur në 22 tituj në dy vitet e fundit.

Personalitete të shquara të financave dhe auditimit publik, përfaqësues të botës akademike kanë dhënë një kontribut cilësor për revistën shkencore "Auditimi Publik" të KLSH-së. Për të dytin vit radhazi, në 2013-ën, KLSH-ja botoi tre numrat e radhës të revistës, e cila është njohur ndërkombëtarisht me numrin ISSN, si dhe ne vend me vendim të Ministrit të Arsimit "Për akordimin e statusit Revistë Shkencore revistës së KLSH-së "Auditimi Publik".

Botimet kanë ndihmuar në rritjen e kapaciteteve audituese, sidomos botimet e vitit 2013, si "Udhëzuesi i Auditimit Financiar (ISSAI 1000-2999)", "Udhëzuesi i Auditimit të Përputhshmërisë (ISSAI 4000-4200)" dhe "Standardet e Auditimit të Borxhit Publik (ISSAI 5410-5440)". Njëkohësisht, ato e kanë bërë më transparente të gjithë veprimtarinë e institucionit.

Në këtë frymë transparence dhe mision komunikimi, do të përpiqemi të japim në vijimësi kontributin tonë si KLSH, në punën në sistem për përmirësimin e qeverisjes dhe rritjen e përgjegjësisë dhe llogaridhënies së institucioneve publike, ku përfshihen: qeveria, opozita, Kuvendi, institucionet e pavarura, shoqëria civile dhe mediat.

Në zbatim të parimeve 8 (Sigurimi i transparencës dhe i llogaridhënies së duhur nga SAI-t), 9 (Sigurimi i qeverisjes së mirë nga SAI-t) dhe 10 (Pajtueshmëria me Kodin e Etikës së SAI-ve) të standardit ISSAI 12, ne si KLSH synojmë të jemi një institucion që "drejton përmes shembullit". Natyrisht, shembull më të mirë kemi deputetët e Kuvendit të Shqipërisë.

Vlerësime për performancën e KLSH-së për vitin 2013

Performanca e KLSH-së është vlerësuar nga Presidenti i Republikës, zoti Bujar Nishani, me rastin e analizës vjetore të institucionit, në janar 2014, nga Kryetari i Kuvendit, zoti Ilir Meta në përshëndetjen e tij në Konferencën e Dytë Shkencore të KLSH-së, si dhe nga përfaqësuesi i delegacionit të Bashkimit Evropian në Tiranë, zoti Ettore Sequi dhe përfaqësuesi i OSBE-së në Shqipëri, zoti Robert Ëilton, nga deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, të cilët gjej rastin t'i falënderoj.

Ecuria e performancës së KLSH-së u pasqyrua edhe në vlerësimet e raport-progresit të Shqipërisë të Komisionit Europian në tetor 2013, ku ndër të tjera, theksohet: "*Aktivitetet e trajnimit dhe të marrëdhënieve me publikun janë rritur dhe bashkëpunimi dypalësh me SAI-t e vendeve te tjera është zgjeruar. Auditimi i performancës ka rifilluar...Kontrolli i Lartë i Shtetit e ka*

përmirësuar performancën e tij, duke adoptuar një manual të ri për auditimin dhe duke kryer më shumë auditime".

Vlerësime për punën e tij gjatë vitit 2013, KLSH-ja ka marrë edhe nga zoti Robert Gielisse, Këshilltar Kryesor i Drejtorit të Përgjithshëm të DG-Budget, nga z. Joop Vrolijk, këshilltar i lartë i SIGMA-s, si dhe nga presidentet e SAI-ve partnere, si SAI austriak, polak, turk dhe nga Audituesi i Përgjithshëm i Kosovës.

Nën këndvështrimin e Deklaratës së Pekinit të Kongresit INCOSAI XXI, ku theksohet se "SAI-t do të vazhdojnë të shërbejnë për shoqërinë dhe publikun, duke promovuar zhvillimin e qëndrueshëm dhe përmirësimin e qeverisjes kombëtare, forcimin e demokracisë, përmirësimin e shtetit ligjor, duke luftuar korrupsionin, ruajtur sigurinë kombëtare dhe duke nxitur reforma", vlerësimi më i rëndësishëm për ne është vëmendja dhe reagimet e qytetarëve dhe të opinionit publik ndaj njoftimeve për shtyp të KLSH-së dhe shkrimeve të audituesve të lartë për rezultatet e auditimeve, vëmendje dhe reagime të cilat janë rritur dukshëm gjatë vitit 2013, por asnjëherë nuk na bëjnë ne të jemi të kënaqur me punën tonë.

Në përfundim, meqenëse u zgjata, rezervoj të drejtën që mbas pyetjeve tuaja të bëj edhe një analizë të shkurtër të arritjeve të institucionit tonë, të kapaciteteve të tij, të forcës, të dobësive dhe të kërcënime që i vijnë ose që mund t'i vijnë institucionit gjatë zhvillimit të veprimtarisë për vitin 2014.

Ngritja e një Këshilli të Pavarur Fiskal – detyrë imperative e kohës

- *Prezantimi i Raportit të Zbatimit të Buxhetit Faktik të vitit 2013*

14 tetor 2014

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, Kuvendi i Shqipërisë

Deputetët pjesëmarrës

1. Erion Braçe
2. Ridvan Bode
3. Anastas Angjeli
4. Florjon Mima
5. Ervin Koçi
6. Andrea Marto
7. Evis Kushi
8. Blerina Gjylameti
9. Gledjon Rehovica
10. Majlinda Bufi
11. Perparim Spahiu
12. Ervin Bushati
13. Liljana Elmazi
14. Edmond Spaho
15. Luan Duzha
16. Gjovalin Kadeli
17. Jorida Tabaku

I nderuar zoti Kryetar, të nderuar deputetë,

Raporti "Për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2013" është përgatitur në zbatim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 164, pika 1, germat a-b; ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr.8599, datë 1/6/2000, neni 18, pika 1, germat a-b dhe të ligjit nr. 9936, datë 26/6/2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", nenet 62 e 63; si dhe të ligjit nr. 119/2012 , "Për Buxhetin e vitit 2013", i ndryshuar. KLSH në funksion të përmbushjes së detyrimit kushtetues dhe ligjor ka orientuar veprimtarinë e tij audituese në konvergjencë dhe në zbatim të plotë të direktivës kryesore të shprehur në Kongresin e XXI të INTOSAI, "***Auditimi kombëtar të vihet në shërbim të qeverisjes kombëtare, për përmirësimin e menaxhimit publik financiar të vendit"***.

Opinioni ynë i përgjithshëm

Mbi bazën e 124 auditimeve të kryera nga KLSH për buxhetin faktik të vitit 2013, në institucione të qeverisjes qendrore (ministri, ente të tjera qendrore, shoqëri aksionere, projekte me financime të huaja, etj), si dhe në njësi të qeverisjes vendore, kombinuar me vlerësimin e sistemeve të menaxhimit financiar, kontrollit dhe auditimit të brendshëm, si dhe vlerësimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve tona gjatë auditimit te zbatimit të Buxhetit për vitin 2012, **opinioni ynë i përgjithshëm**, në përputhje të plotë me Standardin ISSAI 1700 të auditimit suprem, për Zbatimin e Buxhetit të Shtetit për vitin 2013, para miratimit të tij nga Kuvendi i Shqipërisë, **është se *përgatitja, shqyrtimi dhe miratimi i buxhetit të vitit 2013, zbatimi, ndjekja dhe rishikimi i tij, të drejtat dhe kufizimet për huamarrjen, garancitë dhe format e tjera të rrjedhura prej tyre si dhe kontrolli, kontabiliteti, raportimi dhe auditimi i këtij buxheti, janë kryer në respektim të kërkesave të ligjit "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"; të ligjit "Për buxhetin e Shtetit të vitit 2013", të ndryshuar, si dhe të ligjit "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin".***

Duke patur parasysh mjedisin e vështirë në të cilin u realizua Buxheti i vitit 2013, *KLSH, **vlerëson pozitivisht punën e bërë nga Qeveria, Ministria e Financave, Ministritë, Institucionet e tjera qendrore dhe vendore, si dhe entet publike të audituara, përgjatë vitit 2013 në drejtim të adresimit dhe konsolidimit të mëtejshëm të reformave drejt një menaxhimi sa më efektiv të financave publike si dhe përpjekjet për përmirësimin e kuadrit rregullator me synim orientimin drejt objektivit themelor të përafrimit të legjislacionit shqiptar me direktivat e BE, si një nga prioritetet kyçe të rrugës së nisur drejt integrimit europian.***

Mbi bazën e të dhënave të realizimit të treguesve makroekonomikë të vitit 2013 dhe nga analizimi i tyre, konkludojmë se ekonomia shqiptare ka arritur të përballojë efektet e krizës ekonomike dhe financiare të Eurozonës, por pa ruajtur tërësisht ekuilibrat kryesorë makroekonomikë. *KLSH nëpërmjet këtij raporti sjell në vëmendje të Kuvendit disa prej rekomandimeve kryesore, të cilat synojnë përmirësimin e kuadrit rregullator dhe reflektojnë praktikat më të mira të standardeve ndërkombëtare në menaxhimin e financave publike.*

Buxheti i shtetit për vitin 2013, është bazuar në aktet e mëposhtme ligjore:

1. Ligji nr. 119/2012 "Për buxhetin e vitit 2013".
2. Ligji nr. 166/2013 "Për miratimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 6, datë 4.10.2013 të Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 119/2012 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2013".

3. Ligji nr.1/2014 "Për miratimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 7, datë 14.12.2013, të Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 119/2012 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2013", të ndryshuar.

Realizimi i treguesve të konsoliduar fiskalë të Buxhetit të Shtetit për vitin 2013 paraqitet si vijon:

Të ardhurat e përgjithshme të buxhetit të shtetit rezultuan në 24.1 % të PBB-së kundrejt 24. % të PBB-se të planifikuara, duke reflektuar një tejkalim të lehtë prej 0.1 % të PBB-së. Të ardhurat janë realizuar, rreth 327,18 miliardë lekë nga 325,92 miliardë lekë të planifikuara, me një tejkalim prej 1,26 miliardë lekë në të ardhurat e përgjithshme buxhetore.

Për vitin 2013, **shpenzimet e përgjithshme të buxhetit të shtetit** përfaqësonin 29 % të PBB-së dhe në terma nominalë shpenzimet e përgjithshme rezultuan 394,118 milionë lekë kundrejt 409,408 milionë lekë qe ishte niveli i planifikuar i shpenzimeve duke reflektuar një mos shpenzim të fondeve buxhetore në rreth 15,2 miliardë lekë.

Duke i analizuar nga pikëpamja strukturore sipas dy kategorive kryesore shpenzimet korrente dhe kapitale, konstatohet se shpenzimet korrente për vitin 2013 janë realizuar në vlerën 328,461 milionë lekëve, kundrejt nivelit të planifikuar prej 331,004 milionë lekë, me një mos shpenzim prej rreth 2,4 miliardë lekë.

Gjithashtu, konstatohet se **shpenzimet korrente janë realizuar në një përqindje më të madhe se sa niveli i realizimit të shpenzimeve kapitale, respektivisht 99.3% dhe 83.7 %.** *Në krahasim me një vit më parë* rezulton se *fondet e shpenzuara në zërin "Shpenzime korrente" në vitin 2013, paraqiten me rritje në krahasim me një vit më pare, me 4.47 %, nga 314,585 milionë lekë në vitin 2012, në 328,641 milionë lekë në vitin 2013, ndërkohë që edhe fondet e përdorura për shpenzimet kapitale në vitin 2013 kundrejt vitit 2012, paraqiten me rritje, por në masën 6.2 %, nga 61,656 milionë lekë të shpenzuara në vitin 2012, në 65,479 milionë lekë në vitin 2013.*

Analizuar sipas zërave të shpenzimeve korrente, rezulton se:

1. *Shpenzimet për personelin për vitin 2013* zënë rreth 5.2% të PBB-së, pra janë në një nivel me vitin 2012, 5.2 % PBB-së. Shpenzimet për personelin përfaqësojnë 21.52 % të shpenzimeve korrente dhe janë realizuar në vlerën 70,716 milionë lekë kundrejt 71,538 milionë lekë të planifikuar.

2. *Shpenzimet operative mirëmbajtje për vitin 2013,* përfaqësojnë 2.4 % të PBB-së dhe përfaqësojnë të njëjtin nivel ndaj PBB-së si dhe për vitin 2012. Shpenzimet operative dhe mirëmbajtjes zënë 9.9 % të shpenzimeve korrente dhe janë realizuar në vlerën 32,424 milionë lekë kundrejt 34,035 milionë lekë të planifikuar.

3. *Shpenzimet për interesat* për vitin 2013, përfaqësojnë 3.2 % të PBB-së dhe paraqiten me një rritje të lehtë kundrejt nivelit 3.1% të PBB-së të vitit 2012. Shpenzimet për interesa zënë 13.2 % të shpenzimeve korrente dhe janë realizuar në vlerën 43,336 milionë lekë kundrejt 43,900 milionë lekë të planifikuar.

4. *Shpenzimet për subvencione,* zënë rreth 0.48% të totalit të shpenzimeve korrente të realizuara në vitin 2013, nga 0.6 % që zinin një vit më parë. Kundrejt kuotës së planifikuar, ato janë realizuar në masën 100.3 % ose nga 1,569 milionë lekë në 1,574 milionë lekë. Shpenzimet për subvencion qëndrojnë në të njëjtin nivel kundrejt PBB (rreth 0.1%) si për vitin 2013 ashtu dhe për vitin 2012.

5. *Shpenzimet për fonde speciale (sigurimet shoqërore, shëndetësore, politika të reja pensionesh dhe fondi i kompensimit në vlerë të pronarëve),* paraqiten me një rritje prej rreth 0.4 % kundrejt vitit 2012. Shpenzimet për fondet speciale zënë 38.8 % të shpenzimeve korrente dhe janë realizuar në vlerën 127,643 milionë lekë kundrejt 128,120 milionë lekë të planifikuar.

6. *Shpenzimet për buxhetin vendor* përfaqësojnë 2.2 % të PBB-së për vitin 2013 dhe paraqiten me një rritje kundrejt vitit 2012, që përfaqësonin 2.1% të PBB-së. Shpenzimet për Buxhetin vendor zënë 9.1 % të shpenzimeve korrente dhe janë realizuar në vlerën 29,787 milionë lekë kundrejt 28,580 milionë lekë të planifikuar, ose 104.2 %.

7. *Shpenzime të tjera sociale (pagesa e papunësisë, ndihma ekonomike dhe fondi i kompensimit për ish të përndjekurit politikë)* zënë 7.1 % të shpenzimeve korrente dhe janë realizuar në vlerën 23,161 milionë lekë kundrejt 223,262 milionë lekë të planifikuar, ose 99.6 %.

Në strukturë, shpenzimet për pagesën e papunësisë, ndihmën ekonomike dhe fondin e kompensimit për ish të përndjekurit politikë janë realizuar respektivisht 93 %, 99.8% dhe 99.7%, dhe në vlerë përkatësisht 800 milionë lekë, 19,370 milionë lekë dhe 2,991 milionë lekë.

Shpenzimet kapitale (me financim të brendshëm dhe të huaj), zënë rreth 16.61% të totalit të përgjithshëm të shpenzimeve të realizuara në vitin 2013, nga 16.39 % që zinin në vitin 2012. *Në strukturë, shpenzimet kapitale me financim të brendshëm* janë realizuar në masën 97.9 %, ndërsa ato me financim të huaj janë realizuar në masën 72.1%.

Krahasuar me vitin 2012*, ka një rritje të fondeve të shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm, konkretisht me 9,303 milionë lekë më shumë,* nga 27,398 milionë lekë të shpenzuara në vitin 2012, në 36,701milionë lekë, të shpenzuara gjatë vitit 2013. Për financimin e huaj konstatohet një ulje e shpenzimeve kapitale nga 34,257 milionë lekë të shpenzuara në vitin 2012, në 28,776 milionë lekë të shpenzuar në vitin 2013, *pra me një rënie në vlerë prej 5,481 milionë lekë.*

Kundrejt PBB-së të vitit 2013, shpenzimet kapitale me financim të brendshëm dhe të huaj zënë përkatësisht 2.7% dhe 2.1%, nga 2.1% dhe 2.6% të PBB-së të rezultuar në vitin 2012.

Deficiti i përgjithshëm i buxhetit për vitin 2013 përfaqëson 4.9% të PBB-së kundrejt 3.5% të PBB-së që përfaqësonte në vitin 2012. Deficiti në fund të vitit 2013 rezultoi në vlerën 70,413 milionë lekë nga 83,490 milionë lekë të programuara me ndryshime.

Borxhit Publik për vitin 2013, rezultoi në vlerën 885,083 milionë lekë ose 65.18% të PBB-së kundrejt 828,275 milionë lekë në vitin 2012 dhe që përfaqësonte 61.53 % të PBB-së. Borxhi Publik përbëhet nga:

A. Borxhi publik i qeverisjes qendrore, rezultoi në vlerën 884,692 milionë lekë, nga 827,981 milionë lekë që rezultoi në fund të vitit 2012, ose e shprehur në përqindje kundrejt PBB-së rezultoi përkatësisht 65.15 % nga 62.44 % që rezultoi në fund të vitit 2012, pra me një rritje prej 2.71 % të PBB-së. Ky borxh i rezultuar në vitin 2013, përbëhet nga:

- *Borxhi i brendshëm*, i cili rezulton në vlerën 520,786 milionë lekë ose 38,35 % të PBB-së, nga 470,359 milionë lekë ose 35.47 % të PBB-së që rezultoi në vitin 2012 ose me një rritje prej 2.88 % te PBB-së.

- *Borxhi i jashtëm,* i cili rezulton 363,906 milionë lekë ose 26,8 % të PBB-së nga 357,622 milionë lekë ose 26.97% të PBB-së, duke reflektuar një ulje të lehtë ndaj vitit të kaluar prej 0.17 % të PBB-së.

B. Borxhi i qeverisjes vendore në vitin 2013, **rezultoi 390,9 milionë lekë ose 0.028 % e GDP**, nga 288 milionë lekë ose 0.021% të PBB-së që rezultoi në vitin 2012.

Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB), si një nga treguesit kryesorë (me çmimet korrente) bazuar në evidencat e Ministrisë së Financave ka arritur në kuotën e 1,358,000 milionë lekë.

KLSH nëpërmjet këtij raporti sjell në vëmendje të Kuvendit disa prej rekomandimeve kryesore, të cilat synojnë përmirësimin e kuadrit rregullator dhe reflektojnë praktikat më të mira të standardeve ndërkombëtare në menaxhimin e financave publike.

1. Në drejtim të marrjes së masave për sigurimin e qëndrueshmërisë, kredibilitetit të financave publike dhe konsolidimin e një kuadri, rregulli fiskal si dhe me synim:

Promovimin e një qëndrueshmërie dhe kredibiliteti të financave publike;

Vlerësimin e planifikimit dhe performancës fiskale, të projeksioneve makroekonomike dhe parashikimeve buxhetore,

Kemi rekomanduar:

- Ministria e Financave të ndërmarrë nismën ligjore për ngritjen e një Këshilli Fiskal, pasi në gjykimin tonë, vende si i yni kanë nevojë për oponenca të politikave fiskale, që të jenë thellësisht teknike dhe të pavarura.

- Ministria e Financave të ndërmarrë të gjitha masat për hartimin e një kuadri rregullator fiskal, i cili të synojë reduktimin e nivelit të borxhit publik në një periudhë të përcaktuar kohore dhe sigurimin e një qëndrueshmërie afatgjatë të borxhit publik si dhe

- Përgatitjen dhe paraqitjen e një iniciative ligjore për vendosjen në Kushtetutë dhe në Ligjin "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të indikatorit të borxhit publik ndaj PBB-së, në nivelin tavan 60 % dhe arritjen e këtij niveli në terma afat afatgjatë.

2. Në drejtim të fuqizimit të ligjit "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", nisur nga konstatimi që ligji bazë themeltar për menaxhimin e financave publike në vend "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", rezulton me një rezistencë të ulët, pra është lehtësisht i thyeshëm nga pikëpamja e vendimmarrjes parlamentare, **Kemi rekomanduar:**

- *Shqyrtimi i ndryshimeve të parashikuara në Strategjinë për Menaxhimin e Financave Publike 2014-2020 të ligjit "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe miratimi i tij në Kuvend të bëhet me një shumicë të cilësuar parlamentare.*

3. Në funksion të hartimit të një strategjie efektive të menaxhimit të financave publike si dhe me synim arritjen e pritshmërive të projektuara, bazuar në shtyllat kryesore që kanë të bëjnë me:

- Hartimin e një kuadri fiskal të qëndrueshëm e realist;
- Planifikimin e buxhetimin e integruar dhe efiçient të shpenzimeve publike;
- Rritjen e përgjegjshmërisë në nivel menaxherial;
- Përmirësimin dhe rritjen e transparencës së raportimit financiar të qeverisë;
- Forcimin e kontrollit të brendshëm në sektorin publik;
- Mbikëqyrjen efektive parlamentare.

Kemi rekomanduar:

- *Gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e KLSH-së, të jenë pjesë përbërëse dhe të skedulohen në Planin e Veprimit dhe në aktivitet kyçe që do të ndërmerren në kuadrin e implementimit të strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020. Grupi i punës i ngritur ne kuadrin e bashkërendimit, hartimit dhe ndjekjes se zbatimit të strategjisë me synim përmbushjen e*

objektivit për rishikimin e kuadrit rregullator ligjor të Menaxhimit të Financave Publike të shqyrtojë, analizojë, adresojë dhe integrojë rekomandimet e KLSH-së në Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020.

4. Në funksion të një menaxhimi efektiv të borxhit publik i kemi adresuar një sërë rekomandimesh Ministrisë së Financave:

a. Me synim një menaxhim efektiv të borxhit publik, kemi rekomanduar që:

- Të punohet për të patur një menaxhim të borxhit publik në koordinim të plotë me Politikat Makroekonomike. Politikat fiskale deri vjet kishin për qëllim që të mbanin kufirin e borxhit nën kontroll, por për sa kohë ky kufi nuk është më një detyrim ligjor i fiksuar, risku i mungesës së koordinimit midis menaxhimit të borxhit publik me politikat fiskale do të jetë në rritje.

- Kemi kërkuar po ashtu një koordinim më të mirë me politikën monetare, ose saktësime ligjore në Marrëveshjen midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave, të cilat lidhen me kreditimin afatshkurtër.

- Në kuadër të mirëorganizimit të proceseve që lidhen me menaxhimin e borxhit publik, cilësojmë nevojën për një Manual të Borxhit Publik, ku në referencë të standardeve dhe praktikave më të mira, të përcaktohet metodologjia për parashikimin, zhvillimin e aktivitetit të huamarrjes, të shërbimit, monitorimit dhe raportimit të borxhit, procedurat dhe teknikat për vlerësimin e risqeve si dhe treguesit e matjes së performacës së veprimtarisë së huamarrjes publike.

- Referuar faktit që Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave, analizojnë në mënyrë të ndryshme borxhin e jashtëm (megjithëse të dhënat janë ato të Ministrisë së Financave) e gjykojmë të nevojshme që të ketë një Marrëveshje për mënyrën e raportimit të borxhit të jashtëm, në mënyrë që të ketë të paktën krahasueshmëri të pjesshme në analizat e dy institucioneve.

- Nisur nga konstatimi se Drejtorisë së Menaxhimit të Borxhit Publik i është pakësuar ndjeshëm numri i punonjësve të saj, e pa shoqëruar kjo ulje me ndonjë përmirësim të infrastrukturës së informacionit, gjë që e ka ekspozuar këtë funksion ndaj një risku të lartë, lidhur me sigurinë dhe saktësinë e deklarimit të të dhënave mbi borxhin, **kemi rekomanduar që të kthehen strukturat në gjendjen e mëparshme.** Të merren masa për të siguruar përpunimin e informatizuar të të gjithë të dhënave të borxhit publik. Të punohet për ngritjen e kapaciteteve të kësaj strukture me rëndësi në menaxhimin e financave publike, me trajnime e kualifikime të vazhdueshme.

b. Mbi përcaktimin ligjor për dhënien e garancive shtetërore mbi stokun e përcaktuar me ligj:

- Kemi kërkuar që në ligjet vjetore të buxhetit të *mos vendosen përcaktime të cilat i adresojnë* Këshillit të Ministrave të drejtën për rritjen e stokut të borxhit përtej limiteve të përcaktuara me ligj.

c. Në drejtim të saktësisë së evidentimit të shpenzimeve kapitale me financim të huaj, kemi rekomanduar:

- Ministria e Financave t'u tërheqë vëmendjen njësive të zbatimit të projekteve dhe të procedojë me masat përkatëse administrative në përputhje me ligjin "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", jo vetëm për vonesat në raportime, po edhe për rregullshmërinë e tyre.

5. Me synim përdorimin efektiv të fondit rezervë të Këshillit të Ministrave dhe të fondit kontigjencë dhe mos përsëritjes së problematikave lidhur me mungesa në dokumentacion, në relacionet shpjeguese dhe në preventiva shpenzimesh, apo në trajtimin e tij si shtesë buxheti për institucionet përfituese,

Kemi rekomanduar :

- Në Ligjin Organik të Buxhetit që do të rishikohet, të përcaktohet që Vendimet e Këshillit të Ministrave për përdorimin e fondit rezervë të Buxhetit të Shtetit, të merren pas miratimit paraprak me shkrim të Ministrit të Financave, duke shmangur në këtë mënyrë përdorimin e këtyre fondeve nga institucionet përfituese pa relacion shpjegues, pa preventiv shpenzimesh, apo përdorimin e këtyre fondeve si "shtesë buxheti".

- Të përcaktohen në ligjin vjetor të buxhetit drejtimet e përdorimit të Fondit të Kontigjencës, i cili është fond i pashpërndarë, që krijohet për të mbuluar risqet e mundshme për të ardhurat dhe shpenzimet gjatë zbatimit të buxhetit. Në këtë ligj duhet të përcaktohet sasia e fondit përkatës sipas tre drejtimeve: **për të përballuar efektet e mosrealizimit të ardhurave**, **për financime të reja** dhe **për shtimin e financimeve mbi fondet e miratuara të programeve ekzistuese.**

6. Në drejtim të përdorimit të të ardhurave nga privatizimi për uljen e borxhit publik, për investime kapitale dhe dëmshpërblimin e ish të përndjekurve politikë,

Kemi rekomanduar:

- Në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të përcaktohet që të ardhurat nga privatizimet duhet të përdoren së pari dhe kryesisht për

të ulur borxhin publik, ku 50% të jetë kufiri i poshtëm, dhe pjesa tjetër prej 30 % të përdoret për financimin e investimeve kapitale si dhe 20% për dëmshpërblimin ligjor të ish të përndjekurve politikë.

7. Në drejtim të përgatitjes së pasqyrave të konsoliduara financiare të shtetit, referuar faktit që problematika e mungesës së pasqyrave financiare të konsoliduara të shtetit, vazhdon edhe në këtë vit, pra Ministria e Financës nuk arritur të nxjerrë përmbledhësen e llogarive të konsoliduara vjetore, por vetëm mbylljen e llogarive vjetore të buxhetit të vitit 2013, k**emi theksuar:**

- Domosdoshmërinë e ndërhyrjeve të menjëhershme për hartimin e pasqyrave financiare të konsoliduara të shtetit, si dhe ndërmarrjen e veprime konkrete për hartimin e një kuadri të plotë rregullator të kontabilitetit dhe raportimit financiar në sektorin publik.

8. Në drejtim të hartimit dhe forcimit të një kuadri rregullator "Për përgjegjësinë materiale" nisur nga faktet se:

1. KLSH ka konstatuar mjaft probleme dhe shkelje të dispozitave ligjore në fonde të konsiderueshme publike, që kanë sjellë harxhimin e tyre pa kriter dhe efiçiencë, ose edhe më keq, shkuarjen dëm të një pjese të tyre, nga keqmenaxhimi financiar.

2. Keqpërdorimi i fondeve publike dhe përgjegjësitë materiale të nëpunësve publikë që kanë kontribuar në këto, dënohen kryesisht me sanksione administrative

3. Vendimmarrjet e gabuara në administrimin e pronës shtetërore, me pasoja ekonomike të konsiderueshme po kthehen në një fenomen normal të aktivitetit të administratës publike.

4. Pamundësisë sonë për të adresuar qartësisht shpërblimin e këtyre dëmeve nga personat përgjegjës,

Kemi rekomanduar

Ministria e Financave të ngrejë një grup pune për hartimin e një ligjit "Mbi përgjegjësinë materiale", në të cilin të trajtohet përgjegjësia financiare e punonjësve të njësive publike (zyrtarët e lartë dhe punonjësit e të gjithë niveleve) për dëmet ekonomike të shkaktuara qëllimisht apo nga neglizhenca, gjatë ose në lidhje me procesin e ekzekutimit të detyrave zyrtare.

9. Në drejtim të vlerësimit të funksionimit të menaxhimit financiar e kontrollit dhe performancën e auditimit të brendshëm.

« Auditimi i brendshëm dhe ai i jashtëm publik luajnë një rol kyç në mekanizmin e mbrojtjes së financave publike. Ata kanë objektiv të përgjithshëm të njëjtë-Menaxhimin e shëndoshë të financave publike, por ndryshojnë në qëllimet e auditimit, në mënyrën e funksionimit dhe të raportimit » (marrë

nga fjala e z. Robert Gielisse, këshilltar kryesor i Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Buxhetit në BE).

Duke qenë të bindur se auditimi i brendshëm publik ka një rol të rëndësishëm për një sistem të shëndetshëm në menaxhimin e financave publike, vlerësimi i veprimtarisë së strukturave të auditimit të brendshëm në sektorin publik ka qenë një nga objektivat kryesore të veprimtarisë së KLSH.

- Kemi konstatuar se sipas Urdhrit të Kryeministrit nr. 179, datë 18.10.2013 "Për miratimin e Strukturës dhe organikës së Ministrisë së Financave", është ndryshuar varësia dhe struktura e Njësisë, duke u organizuar në nivel Drejtorie në vartësi të Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore dhe Kontrolluese.

- Është pakësuar me mbi 3 herë numri i punonjësve, dhe kjo, pa ndonjë analizë të thelluar për veprimtarinë e kësaj njësie dhe pa marrë parasysh detyrimet që rrjedhin nga ligji, duke rrezikuar realizimin e funksioneve në mënyrë efektive.

- Kemi konstatuar proces planifikimi me elementë të theksuar formaliteti, i cili miratohet në procedura formale nga një strukturë jo e përshtatshme lidhur me funksionin dhe detyrimet që i jep ligji, përfshirjen e audituesve në auditime tematike jashtë planeve vjetore, si dhe problematika të planifikimit të burimeve njerëzore dhe kostove për audituesi.

Në kuadrin e përmirësimeve ligjore që aktualisht po ndërmerr Ministria e Financave, mendojmë se duhet të synohet në radhë të parë konsolidimi i pavarësisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik.

Kemi rekomanduar:

1. Një Komitet Auditimi (jo më shumë se 5 vetë me kohë të plotë), në varësi të dyfishtë nga Kryeministri dhe Ministri i Financave, i cili do të siguronte një nivel pavarësie që do të plotësonte objektivat e këtij funksioni. Me këto ndryshime të synohet pavarësia e Njësisë Qendrore të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, duke përcaktuar me kujdes varësinë, strukturën dhe përzgjedhjen e stafit në mënyrë të tillë që të jenë në funksion të realizimit sa më të efektshëm të funksioneve harmonizuese, monitoruese, vlerësuese të cilësisë dhe asistencës teknike për të gjitha strukturat e auditit të brendshëm. Edhe në këtë rast, sugjerojmë varësi dyfishe nga Komiteti i Auditimit dhe Ministri i Financave.

- Duke vlerësuar se përmirësimet ligjore duhet të jenë procese të cilat paraprihen nga një skanim i plotë i situatës dhe zonave me risk real, diskutime të gjëra me ekspertë të brendshëm dhe të huaj, **kemi rekomanduar** që ndërhyrjet të ndërmerren të menduara, në drejtim të saktësimit të funksioneve të çdo pjesëmarrësi (Ministri i Financave,

Komiteti i Auditimit, Njësia Qendrore e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm) dhe rolit të tyre në forcimin e auditimit të brendshëm në sektorin publik.

- Duke ju referuar faktit që bordet dhe komisionet part-time nuk kanë rezultuar funksionale në kontekstin e vendit, gjykojmë që **Komiteti i Auditimit, si një instrument i rëndësishëm në monitorimin dhe mbikëqyrjen e auditimit të brendshëm në sektorin publik të jetë një komitet me kohë të plotë, duke sanksionuar kështu edhe predispozicionin për të rritur rolin e strukturave të auditimit të brendshëm në mirëqeverisjen e fondeve publike.**

Theksojmë se bazuar në formalitetin e konstatuar në rolin e komiteteve të deritanishme, gjykojmë se në kontekstin shqiptar duhet të hiqet dorë nga struktura që shpenzojnë paratë e taksapaguesve me nivel të ulët përgjegjshmërie dhe përgjegjësie.

2. Kemi konstatuar se **Manuali i Auditimit** nuk ka përcaktim për auditimet e plota, duke sjellë problematikën e mos përcaktimit të saktë mbi llojet e auditimeve që do të planifikohen dhe raportohen si auditime të plota. Raportet e Veprimtarisë të NJAB dhe Raporti Përmbledhës i Konsoliduar, nuk evidentojnë se sa nga vlera e gjetjeve me ndikim financiar është ngarkuar për zhdëmtim.

Kemi rekomanduar:

- Të punohet për rishikimin e plotë të Manualit të Auditimit, për t'i dhënë plotësinë si në parime dhe në metodologjitë e planifikimit dhe vlerësimit të riskut, në formate raportimi që do të mundësonin lexim të njëjtë të gjetjeve dhe konstatimeve pavarësisht në cilën strukturë raportohen.

- Manuali duhet të plotësohet me elementët bazë të parandalimit dhe zbulimit të skemave të mashtrimit nga audituesit e brendshëm.

3. Duke u nisur nga problematika e konstatuar lidhur me nivelet e kualifikimit të audituesve të brendshëm që punojnë në këto struktura si dhe kompetencave të Njësisë QH/AB, lidhur me procesin e kualifikimit, certifikimit dhe trajnimit të vijueshëm të detyrueshëm, si strukturë përgjegjëse për administrimin e këtyre proceseve,

Kemi rekomanduar:

- Ministria e Financave të ndërmarrë nismën ligjore për përmirësimin e ligjit "Për Auditimin e brendshëm në Sektorin Publik", duke patur në fokus edhe kriteret për ngritjen e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik, autoritetin që do të përcaktojë nivelin e këtyre strukturave dhe monitorimin e tyre. Sanksionimi i këtyre kritereve në ligj do të mundësojë përgjegjshmëri më të lartë në plotësimin e kritereve dhe do të rrisë përgjegjësinë për shkelësit e ligjit.

- Nga Ministria e Financave t'u kërkohet njësive të qeverisjes së përgjithshme ndërprerja

e menjëhershme e marrëdhënieve të punësimit për të gjithë punonjësit (drejtorë njësie auditimi dhe auditues), të cilët rezultojnë të pacertifikuar, apo që arsimimi i tyre nuk përputhet me veprimtarinë e institucionit që auditojnë.

4. Me synim implementimin e një sistemi modern të menaxhimit financiar dhe kontrollit, KLSH ka mbikëqyrur dhe vlerësuar kryesisht kontrollin e brendshëm dhe menaxhimin financiar në administratën e institucioneve më të larta shtetërore, në ministri dhe institucione të pavarura, në organet e pushtetit vendor dhe në organet doganore. Mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, aktivitetet e kontrollit, informimi, komunikimi dhe monitorimi janë vlerësuar nga KLSH dhe në opinion të përgjithshëm, **Administrata jonë publike, me gjithë përpjekjet, është ende larg standardeve dhe praktikave më të mira të fushës, në drejtim të menaxhimit financiar dhe kontrollit.**

Kemi rekomanduar:

- Me ndarjen e re administrative, e cila do të mundësojë eliminimin e një sërë komunave, Ministria e Financave në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike duhet të marrin masa në lidhje me zbatimin e kërkesave Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" në drejtim të përmbushjes së kriterit të arsimimit dhe të linjës së raportimit.

- Nga Ministria e Financave të mos aprovohet në asnjë rast konfirmimi i kryerjes së veprimeve në thesar për Nëpunësit Zbatues të Njësisë Qendrore të Prokurimit, të cilët rezultojnë në kundërshtim me kriteret e kuadrit rregullator.

Nga auditimi për zbatimin e buxhetit vjetor 2013, në disa nga institucionet më të rëndësishme kemi konstatuar:

Vlerësimi i të ardhurave nga organet tatimore dhe doganore

Të ardhurat nga tatimet dhe doganat, referuar treguesve të planifikuar dhe të rezultuar në fund të vitit janë realizuar 102.2 %, me një realizim prej 4.9 miliardë lekë më shumë kundrejt planit të korrektuar, ndërsa kundrejt planit fillestar rezultojnë me nje mosrealizim prej 26.1 miliardë lekë. Ky tregues kundrejt PBB-së, gjatë këtij viti shënoi nivelin prej 16.9 %. Në grupin e të ardhurave **nga tatimet dhe doganat** peshën më të madhe e kanë **të ardhurat nga TVSH,** të cilat përfaqësojnë 48.8 % të totalit të këtij grupi dhe që në raport me PBB-në rezultojnë me një nivel prej 8.2 %.Ato paraqiten me një realizim 102.6 % dhe me një tejkalim prej 2.8 miliardë lekë.

Mbi administrimin e të ardhurave buxhetore nga organet tatimore

Për vitin 2013 konstatohet një realizim i planit të të ardhurave të administratës tatimore ne nivelin 105.7 %. Ndërsa kundrejt të ardhurave faktike të vitit 2012 konstatohet një

rënie në totalin e të ardhurave me 9 miliard lekë. Për vitin 2013 konstatohet se buxhetit fillestar është korrektuar dy herë gjatë vitit dhe me aktin normativ të Tetorit 2013, plani i të ardhurave u ul me 14.8 miliardë lekë, ndërsa rishikimi në fund të vitit i të ardhurave nga tatimet rezulton me një rritje të planit prej 2.1 miliardë lekë. Realizimi faktik i të ardhurave kundrejt planit fillestar rezulton me rreth 8 miliardë lekë më pak.

Mbi realizimin e të ardhurave tatimore sipas strukturës

Kontribut më të madh në realizimin e planit në të ardhurat e mbledhura nga administrata tatimore kanë treguesit e tatimeve me 105 % dhe me mosrealizim në treguesit e sigurimeve me 99.5%. Në këtë realizim të treguesve të tatimeve ndikim më të madh kanë patur treguesit e taksave nacionale. Nëse analizojmë strukturën e të ardhurave tatimore për vitin 2013 kemi përsëri një peshë të lartë të tatimit mbi të ardhurat personale, ndërkohë që TVSH, vazhdon të mbetet me peshën më të lartë në të ardhura.

Borxhi Tatimor

Borxhi tatimor është rritur nga 69.9 miliardë në fillim të vitit 2013 në 79.2 miliardë në fund të vitit 2013. Përveç faktit se ka një rritje të nivelit të borxhit ka dhe një rritje të ritmit të rritjes së tij. Në vitin 2012 borxhi është rritur me 5,201 milion lekë, në krahasim me rritjen e borxhit për vitin 2013 prej 9,298 milion lekë. Gjithashtu, vihet re një rënie e numrit të subjekteve me borxh, gjë që nënkupton një rritje të mesatares së borxhit për secilin tatimpagues.

*Në zbatim të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit: ISSAI 4100 (*149.b*), mbështetur në rezultatet e auditimit për arsye të kufizimit në shkallë të gjerë të qëllimit dhe evidencave të auditimit, si dhe në mungesë të dhënies së informacionit,* ***Kontrolli i Lartë i Shtetit e kishte të pamundur të jepte një opinion të kualifikuar mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për vitin 2013, me kërkesat dhe kriteret e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, kryesisht, si dhe legjislacionit tjetër në fuqi.***

Me qëllim që të mos bllokojmë miratimin e buxhetit faktik 2013, KLSH në përmbushje të detyrimeve kushtetuese, e paraqet raportin për zbatimin e buxhetit faktik të vitit 2013, ***duke theksuar mosdhënien e opinionit të kualifikuar në lidhje me Administratën Tatimore për vitin 2013, por duke njohur dhe vlerësuar rezultatet e Auditimit të Brendshëm të Ministrisë së Financave në DPT të ushtruar në Tetor-Nëntor të vitit 2013,*** **bazuar në standardin ISSAI 1610 "Auditimi i jashtëm përdor punën e auditimit të brendshëm" dhe në Marrëveshjen e bashkëpunimit me Ministrinë e Financave, nënshkruar më 08.05.2012.**

KLSH, me synim vazhdimin e procesit të miratimit të buxhetit faktik nga Kuvendi, shpreh bindjen se vitin e ardhshëm nga ana e Ministrisë së Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, do të mundësohet lejimi i KLSH-së të kryejë auditim të plotë dhe pa kufizim konform Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ***duke mundësuar në këtë mënyrë një mbikëqyrje efektive parlamentare në menaxhimin e financave publike. Theksojmë se qëllimi ynë nuk është të auditojmë subjektet private, pra të kontrollojmë vetëvlerësimin tatimor të tyre por të auditojmë punën e administratës tatimore për vetëvlerësimin tatimor, gjithmonë duke mos kryer vizita fiskale në subjektet private.***

Mbi administrimin e të ardhurave buxhetore nga organet doganore

KLSH për vitin 2013 në bazë të programeve të miratuara të auditimit ka ushtruar auditime ligjshmërie/rregullshmërie, në 10 degë doganore, si dhe një auditim ligjshmërie-rregullshmërie në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave. KLSH ka gjetur mirëkuptimin dhe gatishmërinë e plotë të Drejtuesve të DP të Doganave për vënien në dispozicion të të dhënave dhe aksesit të nevojshëm në sistem duke kontribuar në rritjen e efiçiencës dhe efektivitetit jo vetëm të auditimeve, por dhe të cilësisë së rekomandimeve duke vlerësuar maksimalisht dobishmërinë e sistemit doganor në vend, nga përmirësimet e vazhdueshme.

Realizimi i planit të të ardhurave doganore në vitin 2013, paraqitet me tre nivele:

- në krahasim me planin fillestar ai është realizuar në masën 89.4 %, me një diferencë (-) në vlerën 16,481 milionë lekë,
- në krahasim me planin e korrigjuar në muajin tetor, është realizuar në masën 102,7 %, me një diferencë (+) në vlerë 3,751 milionë lekë,
- në krahasim me planin e korrigjuar në dhjetor 2013 është realizuar në masën 101.5 % ose 2,053 milionë lekë më shumë,
- ndërsa në krahasim me faktin e vitit 2012, ai është realizuar në masën 107.5 %.

Mbi realizimin e të ardhurave doganore sipas strukturës

Duke patur parasysh ndryshimet vjetore të planit sipas strukturës rezulton se të ardhurat nga taksat doganore janë realizuar në masën 103.8 %, me një tejkalim prej 6,118 milionë lekë, të ardhurat nga akciza janë realizuar në masën 101.2 %, me një tejkalim prej 24,553 milionë lekë dhe të ardhurat nga TVSH-ja në doganë janë realizuar në masën 102.1 %, me një tejkalim prej 91,772 milionë lekë.

Nga auditimi rezulton se të ardhurat dytësore të realizuara në vitin 2013 janë në vlerë 412,662 mijë lekë dhe janë derdhur në buxhetin e shtetit në masën 100 % të tyre.

Detyrimet doganore (borxhi doganor)

Gjatë vitit 2013, borxhi doganor është shtuar me 1813 subjekte në vlerë 5,657 milionë lekë, është pakësuar me 1219 subjekte në vlerë 881 milionë lekë dhe në total paraqitet me 504 subjekte më shumë dhe në vlerë 4,776 milionë lekë më tepër, krahasuar me fundin e vitit 2012. Raporti i borxhit të shtuar me atë të pakësuar është rreth 6 herë më i lartë (5,657 milionë lekë/881 milionë lekë), i cili tregon se edhe për periudhën analizuese 2013 nga administrata doganore, veçanërisht nga strukturat e specializuara të saj, nuk është punuar me përgjegjshmëri në drejtim të zbatimit të legjislacionit për rikuperimin e borxhit doganor dhe minimizimin e krijimit të borxhit të ri.

Vlera e debitorëve në fund të vitit 2013 krahasuar me fillimin e vitit është në masën 216 % dhe numri i subjekteve debitore në masën 150 %. Në zbatim të Ligjit nr. 10418, datë 21.04.2011 "Për Legalizimin e Kapitalit dhe Faljen e një pjese të Borxhit Tatimor dhe Doganor" me ndryshime, rezulton që sipas nenit 26 të jenë falur shuma 12,970 milionë lekë për 3752 raste.

Nga auditimi i dhjetë degëve doganore për vitin 2013, **rezultuan shkelje të legjislacionit doganor** me pasojë mungesë të ardhurash në buxhetin e shtetit në shumën prej 818,9 milionë lekë, të cilat përbëhen nga: detyrime doganore të pallogaritura dhe të papaguara për mos zbatim të procedurave të zhdoganimeve të kryera në importimin e disa artikujve të ndryshëm, detyrime dhe penalitete të pavendosura për subjekte që operojnë me Regjim Përpunimi Aktiv, detyrime doganore të papaguara për diferencë në peshë me atë të deklaratës doganore, detyrime dhe penalitete të pavendosura për mospagim të TVSH, detyrime të pallogaritura dhe të papaguara për rentën minerare, detyrime doganore të papaguara në zhdoganimin e automjeteve, etj.

Mbi auditimin e zbatimit të buxhetit të pushtetit vendor

Gjatë vitit 2013, krahas auditimit të fondeve të pushtetit qendror, jemi përqendruar edhe në vlerësimin e punës të njësive të qeverisjes vendore, në mbledhjen e të ardhurave dhe përdorimin e fondeve në dispozicion të tyre. Për aktivitetin financiar, administrimin e pronës shtetërore dhe procesin e legalizimeve, kemi audituar njësi të pushtetit vendor, nga të cilat 10 bashki, 18 komuna, 2 këshilla qarqesh dhe 1 prefekturë.

Nga auditimi ka rezultuar se, të ardhurat në total në pushtetin vendor janë realizuar në masën 98.1%. Kundrejt të ardhurave të realizuara në vitin 2012, të ardhurat e realizuara në vitin 2013 janë ulur me 9.2 përqind.

Kemi konstatuar mangësi dhe rezerva në administrimin e të ardhurave. Ndër arsyet kryesore që kanë ndikuar në mosrealizimin e të ardhurave në njësitë e qeverisjes vendore, përmendim:

1. Megjithëse janë hartuar udhëzime të përbashkëta ndërmjet Ministrisë së Financave me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në disa raste ato nuk kanë gjetur zbatim të plotë. Për pasojë, janë pakësuar ndjeshëm të ardhurat e njësive të qeverisjes vendore.

2. Mangësi në rakordimin dhe bashkëpunimin ndërmjet Zyrave të Taksave në Bashki dhe Drejtorive Rajonale të Tatim-Taksave në rreth, Zyrave të Gjendjes Civile, si dhe Zyrave të Regjistrimit të Pasurive, Zyrat e kadastrës, zyrës urbanistikës, duke reflektuar planifikim jo të saktë dhe në nivele të ulëta të taksave dhe tarifave vendore.

3. Edhe pse në vitin 2011, **u amnistuan detyrimet e papaguara, nga puna e pamjaftueshme e administratave tatimore të pushtetit vendor**, ende ka subjekte të parregullta, të cilët ushtrojnë aktivitet pa leje dhe nuk paguajnë detyrimet për taksat vendore. Ndërkohë nga zyrat e taksave vendore në bashki apo komuna, nuk kërkohet në të gjitha rastet ndëshkimi i tyre sipas legjislacionit në fuqi, si, vendosje gjobe, mbyllje e veprimtarisë, masë e konfiskimit, apo deri në kallëzim penal në prokurori, për subjekte të cilat fshehin apo nuk paguajnë detyrimet tatimore.

4. Ende nuk ka një menaxhim dhe miradministrim të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, pasi në disa bashki edhe komuna nuk janë pasqyruar në kontabilitet detyrimet tatimore vendore, në kundërshtim me ligjin, duke mos ndjekur në vazhdimësi arkëtimin e debitorëve dhe lënë shteg për abuzime.

5. Edhe pse subjekteve të pushtetit vendor (biznesi i vogël) u është rimbursuar vlera e kasave fiskale, ato nuk përdoren, duke mos i shërbyer qëllimit të vendosur për pasqyrimin e xhiros dhe ritjen e pagesës së detyrimeve fiskale, ndërkohë ndaj subjekteve nuk zbatohen sanksionet e parashikuara në legjislacionin në fuqi.

6. Nga mungesa e strukturave dhe pamundësia praktike e mbledhjes nga popullata të taksës së ndërtesave, tarifës së pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit, për çdo familje, rezulton se në mjaft prej tyre (në mbi 80% të bashkive dhe komunave), qytetarët nuk paguajnë taksat dhe tarifat vendore.

Theksojmë se dukuria e mospagesës së taksave të pastrimit dhe të ndërtesave nga popullata, konstatohet pothuajse në të gjitha bashkitë. Nga KLSH në përfundim të auditimeve me synim derdhjen në buxhet të të gjitha detyrimeve për këtë kategori taksash vendore, kemi rekomanduar **lidhjen e kontratave në cilësinë e agjentit tatimor me Ndërmarrjet e Ujësjellësve Sh.a., apo me Operatorët e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.**

Në fushën e shpenzimeve, auditimet u përqendruan në zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare të administrimit dhe përdorimit të fondeve buxhetore, në përfundim të të cilave, krahas punë së bërë, janë konstatuar dhe mjaft parregullsi dhe shkelje të dispozitave ligjore në fuqi, si në fushën e pagave dhe shpërblimeve, në

shpenzimet operative, në fushën e prokurimeve publike, zbatimit të punimeve, etj. **Vlera e dëmit ekonomik të rezultuar si rrjedhojë e shkeljeve të dispozitave ligjore në fuqi, në 42 subjektet e audituara, llogaritet në shumën 685 milionë lekë ose 4,9 milionë euro.**

Në legalizimet e ndërtimeve informale, janë evidentuar parregullsi dhe shkelje ligjore që kanë sjellë si pasojë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit, të destinuara për fondin e kompensimit të ish-pronarëve në vlerën totale prej **1,15 miliardë lekë, ose rreth 8,2 milionë euro**. Gjithashtu janë evidentuar dhe **512 raste**, ku legalizimi i ndërtimeve informale është bërë në zona, të cilat nuk duhej të bëhej legalizimi, në kundërshtim me ligjin.

Mbi auditimin e kryer në Bankën e Shqipërisë

KLSH vlerëson politikat monetare të Bankës së Shqipërisë në ruajtjen e stabilitetit financiar, në kushtet e një krize të gjerë globale, me pasoja edhe për vendin tonë. Nga ana tjetër Kontrolli i Lartë i Shtetit e gjykon të rëndësishëm, ruajtjen e pacenuar të pavarësisë organizative dhe vepruese të Bankës Qendrore në përmbushjen e misionit të saj kushtetues, duke vijuar me konsolidimin e arritjeve në fushën e politikës monetare, krahas shikimit me një sy tejet kritik të mangësive në mbikëqyrje dhe administrimin e fondeve në dispozicion. Kemi nënvizuar gjithashtu se përmirësimet ligjore të synuara duhet të zhvillohen në konsultim të ngushtë me institucionet e rëndësishme financiare ndërkombëtare si Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore si edhe Bankës Qendrore Europiane.

1. Nisur nga funksionet që Ligji nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar, i ka atribuuar Këshillit Mbikëqyrës në politikbërje, mbikëqyrje dhe administrimin e këtij institucioni por dhe raporteve të përfaqësimit të administrimit në Këshill sipas përcaktimeve në këtë ligj, duke vlerësuar si të rrezikuar vendimmarrjen sidomos në rastet kur Inspektori i Përgjithshëm vlerëson negativisht performancën e Bankës, tërësore ose pjesore, atëherë ka mundësi në masë të konsiderueshme që të mos realizohet kuorumi i nevojshëm brenda këtij Këshilli për përmirësime të situatës,

Kemi rekomanduar:

- **Përfaqësimi i administrimit në Këshillin Mbikëqyrës të bëhet vetëm nga Guvernatori, për t'i dhënë hapësirën e nevojshme Këshillit Mbikëqyrës për të kryer saktësisht funksionet mbikëqyrëse që atij i atribuohen me ligj dhe shmangur pozitën e sotme "dominuese" të administrimit në Këshillin Mbikëqyrës** (3 anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës janë ligjërisht në nivelin më të lartë të administrimit). Eksperienca e bankave qendrore të vendeve të zhvilluara ka dëshmuar se prania vetëm e Guvernatorit në nivele të tilla vendimmarrëse është mëse e mjaftueshme

dhe ndarja e funksioneve të administrimit nga politikëbërja dhe mbikëqyrja sjellin efekte pozitive në nivelin e transparencës dhe llogaridhënies.

- **Saktësimin e detyrave funksionale të Këshillit Mbikëqyrës dhe administratorëve të Bankës**, për të shmangur dualizmin e funksioneve, konfliktin e kompetencave dhe për të siguruar një nivel të dëshirueshëm llogaridhënie, transparence dhe mbikëqyrjeje.

Në përgjigjen për qëndrimin e saj ndaj Raportit Përfundimtar të Auditimit, Banka nuk shprehet për këtë rekomandim.

2. Nisur nga fakti se Këshilli i Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë është një bord specifik me detyra të rëndësishme dhe komplekse të lidhura me drejtimin dhe monitorimin e një tregu të rëndësishëm si ai monetar, me reflektime të qarta dhe të mprehta në gjithë sektorët e tjerë të ekonomisë, faktit që bazuar në rregullat e brendshme të Bankës, konfliktit të interesit për anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nuk mund ti jepet një kuptim më i gjerë se në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", **kemi sugjeruar:**

- Vendosjen e kufizimit të plotë të pjesëmarrjes së tyre në këshilla dhe borde të tjerë përveç atyre të fushës akademike dhe shkencore.

- Të kërkohet mospërdorimi i figurës në aktivitete apo promovime që cënojnë integritetin e figurës së anëtarit të një bordi kaq të rëndësishëm.

- Kufizimi i daljeve publike dhe mbajtjes së qëndrimeve individuale mbi aspekte të politikës monetare në një kohë që paraqitet një qëndrim i Këshillit Mbikëqyrës në deklaratën për shtyp të Guvernatorit, pasi kjo mund të nxisë refleksione dhe reagime jokorrekte të operatorëve në treg.

- Ndërkohë, duke vlerësuar maksimalisht kontributin e tyre në jetën publike dhe ekonomike të vendit, dhe vetë sfidat që ka përpara ky Institucion i rëndësisë së veçantë, për t'u përballuar me realitete të mbartura nga e kaluara, i kërkojmë anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të japin dorëheqje nga bordet dhe pjesëmarrjet e tjera publike dhe politike dhe aq më tepër përdorimit të figurës së tyre, në dobi të bizneseve private, përfshirë dhe ato të reklamimit të sistemit universitar privat në vend.

Në përgjigjen e saj, Banka thekson se këto rekomandime nuk pranohen. Sipas saj ky rekomandim mund të adresohet pranë Kuvendit të Shqipërisë si institucion ligjvënës i ngarkuar nga Kushtetuta për të realizuar veprimtarinë legjislative në Republikën e Shqipërisë, pasi në kuadrin ligjor ekzistues nuk ka asnjë kufizim ligjor për pjesëmarrje në borde të ndryshme profesionale apo të shoqërisë civile. I vetmi

kufizim ligjor për anëtarët e Këshillit është pjesëmarrja në aktivitete politike, sipas nenit 47 të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar.

3. Banka e Shqipërisë është përpjekur për një politikë monetare lehtësuese të ndjekur edhe gjatë vitit 2013, duke reduktuar normën bazë të interesit me 1 pikë përqindje në krahasim me vitin 2012, nëpërmjet katër vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës. Kemi konstatuar se kjo politikë është shoqëruar me rënien e ndjeshme të normave të interesit për depozitat e kursimit dhe uljen e kostos së bankave. Nga ana tjetër, konstatimet mbi gjendjen aktuale të tregut, trendin e kanalizimit të fondeve dhe ndikimi në kreditim, kanë treguar se **tregu financiar shqiptar ka patur një ndjeshmëri të ulët ndaj normave të interesit.** Duke dashur të jemi të kujdesshëm dhe të mos ndërhyjmë dhe cenojmë sado pak pavarësinë e saj në zbatimin e politikës monetare sugjerojmë që **Banka e Shqipërisë të vlerësojë me kujdes instrumentet që do të përdorë në të ardhmen për plotësimin me efektivitet të objektivave kryesorë të saj.**

Nga ana e Bankës, ky rekomandim qubet i papranueshëm, për faktin se e drejta dhe detyrimi i Bankës së Shqipërisë për zbatimin në mënyrë të pavarur të politikës monetare është një e drejtë e njohur në Kushtetutë.

Theksojmë se Institucionet Supreme të Auditimit nuk mund të gjykojnë dhe auditojnë politikat, por vlerësimi i efektivitetit dhe rezultatet e politikave janë funksionet e tyre kryesore në ditët e sotme. Vlerësimi i performacës është misioni që kërkohet të përmbushet nga një institucion i auditimit të jashtëm i standardeve europiane dhe drejt të cilit ne po mundohemi të zhvendosemi me shpejtësi. Gjithsesi, duke vlerësuar maksimalisht kapacitetet profesionale të Bankës së Shqipërisë në këtë fushë, rekomandimet tona kanë qenë të kujdesshme dhe modeste.

4. Nga auditimi i rregullshmërisë së zhvillimit të ankandeve të bonove të thesarit dhe obligacioneve të organizuara nga Banka e Shqipërisë, në zbatim të marrëveshjeve të lidhura midis Ministrisë së Financave dhe Bankës së Shqipërisë, kemi konstatuar se Banka e Shqipërisë është pjesëmarrëse në ankandet që zhvillohen për bono thesari, *me të drejtën e rezervimit të shumës së kërkuar prej saj*, pavarësisht nëse kërkesat jokonkuruese nga ana e individëve mund të jenë të larta. Niveli i pjesëmarrjes së individëve nëpërmjet kërkesave jokonkurruese në ankandet e obligacioneve është mjaft i ulët, vetëm 1 % të shumës totale të emetuar gjatë vitit 2013.

Kemi rekomanduar:

Banka e Shqipërisë, në rolin e saj këshillimor për qeverinë, të ndikojë në marrjen në konsideratë të mekanizmave më të efektshëm, **më qëllim që jo vetëm të mos ulet, por të nxitet pjesëmarrja më e gjerë e individëve në tregun e instrumenteve të emetuar nga qeveria, gjithashtu të ndikojë për rritjen e shkallës së informimit të publikut mbi këtë treg**.

Ky rekomandim nga ana e Bankës quhet i papranueshëm, pasi sipas saj marketingu për një letër borxhi bëhet vetëm nga emetuesi. Instrumentet e politikës monetare kanë si objektiv të drejtpërdrejtë dhe të vetëm zbatimin e politikës monetare. Theksojmë si KLSH se rekomandimi nuk i kërkon Bankës të bëjë marketingun e letrave të qeverisë, por i kemi kërkuar të këshillojë qeverinë për një marketing më të mirë të instrumenteve afatshkurtër, apo mekanizmave që do të sillnin që niveli i pjesëmarrjes së individëve në këto instrumenta të rritet.

5. Ligji nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" përcakton se Banka e Shqipërisë është e pavarur në përcaktimin e shpërblimeve të stafit të saj, pavarësi që sipas nenit 45 i njeh të drejtën Këshillit Mbikëqyrës që të vendosë për llojin, nivelin e pagave dhe shpërblimeve. Shpenzimet e personelit kanë patur një rritje të lehtë për vitin 2013 dhe kjo tregon një trend të konsoliduar rritës të këtij zëri që zë 35% të totalit të shpenzimeve të Bankës. Nga Banka mbrohet me fanatizëm fakti që pagat janë të larta për të mundësuar mbajtjen e stafit të kualifikuar por pamundësia për të patur akses në të dhënat mbi kapacitet profesionale të këtij stafi (dosjet e personelit nuk na u vunë në dispozicion nga ana e bankës nën arsyetimin e konfidencialitetit) nuk na lejon të gjykojmë mbi këtë pretendim të ngritur nga Banka.

Kemi rekomanduar: - Rishikimin e ligjit, në frymën e minimizimit të riskut potencial të abuzimit me pavarësinë dhe shmangies së konfliktit të interesit që evidentohet në praktikat e përcaktimit të pagave dhe shpërblimeve për nivelet drejtuese.

- Përcaktimi i një kornize të kujdesshme rregullatore në lidhje me nivelin e pagës së Guvernatorit, e cila duhet të ndjekë trendin e pagave të tregut bankar, por gjithmonë duhet të jetë në raporte të pranueshme, krahasuar me pagën e Presidentit të Republikës, bazuar kjo jo vetëm në përvojat dhe praktikat më të mira të vendeve të ngjashme, por edhe në përshtatshmërinë me realitetin shqiptar (rekomandim i mëparshëm).

- Kërkesën për një transparencë të detyrueshme ligjore për çdo vendim të lidhur me pagat dhe shpërblimet e stafit dhe jo vetëm, çka presupozon informimin e vazhdueshëm të opinionit të gjerë publik në lidhje me çdo përfitim financiar dhe monetar.

Banka, në përgjigjen e saj nuk pranon rekomandimin, pasi sipas tyre rekomandimi del jashtë objektit të veprimtarisë së KLSH, por gjykohet edhe i pabazuar, pasi në bazë të dispozitave në fuqi këto janë kompetenca të Këshillit Mbikëqyrës. Çdo ndryshim i tyre realizohet nga Kuvendi i Shqipërisë.

6. Auditimi konstatoi se pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me politikat kontabël të përshtatura në Manualin e Kontabilitetit të Bankës, miratuar nga Këshilli i Ministrave me Vendimin Nr. 50, datë 26 janar 2001 por dhe politika të tjera të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës duke tentuar një pajtueshmëri të përgjithshme me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të aprovuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit. Pavarësisht këtij përafrimi të synuar,

theksojmë se baza e pasqyrave janë ato të Manualit të Kontabilitetit të vetë Bankës. Bazuar në këtë konstatim por edhe në funksion të rritjes së cilësisë së informacionit të publikueshëm nga ana e Bankës për të gjithë përdoruesit e brendshëm dhe të jashtëm,

Kemi rekomanduar:

- Banka **të kalojë në përgatitjen e pasqyrave në përputhje të plotë me standardet e raportimit financiar (SNRF),** të bëjë rishikimin e Manualit të Kontabilitetit të Bankës në të cilin të jenë të shpjeguara gjerësisht deviacionet që mund të ketë implementimi i plotë i SNRF në kushtet reale të vendit dhe duke zvogëluar ndërhyrjet e Këshillit Mbikëqyrës në këtë drejtim.

- Në funksion të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies, të jepet një nivel i tillë shënimesh shpjeguese që lejon lexuesin të krijojë bindje objektive për politikën kontabël të përdorur për zëra të veçantë dhe impaktin e kësaj politike kontabël në pasqyrat e paraqitura nga Banka.

- Banka të stimulojë me një politikë të kujdesshme ngritjen e kapaciteteve njerëzore të përfshira në këtë proces sa kompleks dhe të rëndësishëm për rritjen e besueshmërisë së informacionit për pozicionin financiar të bankës.

Banka në përgjigjen e saj shpreh dakordësinë për këtë rekomandim dhe thekson se po merren masa për zbatimin e tij.

7. Nga auditimi i funksionit të Departamentit të Kontrollit, nisur nga raporti vjetor i aktivitetit të këtij funksioni për vitin 2013, intervistimi i inspektorit të përgjithshëm si dhe pyetësori i plotësuar mbi aktivitetin e auditit të brendshëm në Bankën e Shqipërisë arritëm në konkluzionin se **pavarësia e funksionimit të auditimit të brendshëm të Bankës së Shqipërisë, nuk mund të inkurajohet nga ana e administratorëve nëse ata përcaktojnë strukturën dhe buxhetin e këtij funksioni.** Gjithashtu e kemi konsideruar si cenim të pavarësisë, mënyrën e planifikimit të misioneve të auditimit por dhe moszbatueshmërinë e rekomandimeve të lëna nga këto misione audituese.

- Bazuar në gjetjet e këtij auditimi, në funksion të rritjes së pavarësisë, efektivitetit dhe përgjegjshmërisë së strukturës së auditimit kemi rekomanduar **që të bëhen përmirësime ligjore duke transformuar funksionin e Inspektorit të Përgjithshëm në një Komitet Auditimi** të përbërë nga tre anëtarë, të zgjedhur nga Kuvendi.

- Ndërkohë, Bankës i kemi kërkuar të rishikohet baza e brendshme rregullative lidhur me këtë funksion kryesisht lidhur me **forcimin e pavarësisë së kësaj njësie në planifikim dhe në mënyrën e raportimit**. Të **shikohet mundësia e ndryshimit të mënyrës së rekrutimit dhe shpërblimit të stafit në përbërje të Drejtorisë së Kontrollit të Bankës së Shqipërisë**, të punohet për ngritje të mëtejshme të

kapaciteteve brenda tij. Kemi cilësuar nevojën për përmirësim në drejtim të monitorimit të kuadrit të centralizuar të riskut si edhe në aspektet e vlerësimit të brendshëm të cilësisë së punës së audituesve dhe funksionit në përgjithësi. **Vendosja e mekanizmave që do të përshpejtojnë zbatimin e rekomandimeve të lëna nga departamenti i kontrollit**.

Buxheti i Sigurimeve Shoqërore

Kemi konstatuar sërish se skema aktuale e sigurimeve shoqërore shfaq problematika si në procesin e realizimit të të ardhurave dhe në realizimin e shpenzimeve, të shoqëruara me rritje nga viti në vit të subvencionimeve buxhetore.

Konstatohet një nivel kontributiv më i ulët, fakt që ka sjellë që plani vjetor fillestar i të ardhurave prej 48,918 milion lekë të realizohet vetëm 98.73 % duke krijuar një difiçit në të ardhura me 622 milion lekë.

Ndër faktorët kryesor të këtij mosrealizimi janë mosrealizimi i numrit të kontribuesve, numri i ulët i kontribuesve për një subjekt si dhe rritje e numrit të punonjësve me pagë minimale. Mjafton të përmendim një fakt të thjeshtë nga konstatimet tona, subjektet e pajisura me leje për shfrytëzim mineral rezultojnë të kenë prodhuar sasi të konsiderueshme në mijëra tonë mineral, por numri i punëtorëve në këto subjekte varion nga 2-4 punonjës.

Gjithashtu, konstatohet rritje e detyrimeve të papaguara ndaj skemës së sigurimeve vetëm për vitin 2013, me rreth 1,9 miliardë lekë, kjo ka sjellë që stoku i detyrimeve kontributive të papaguara nga subjektet juridikë dhe fizikë në fund të vitit 2013 të arrijë në 10 miliardë lekë, detyrimeve që përfaqësojnë, kontribute, interesat dhe gjobat e papaguara, të pa mbledhura nga organet tatimore.

Plani i të ardhurave të planifikuara për t'u mbledhur nga vetë ISSH *është realizuar 100.1%, pavarësisht* tendencës në rënie të numrit fizik të kontribuesve si të vetëpunësuar në bujqësi. Skemës së sigurimeve shoqërore në fshat i mungon një numër relativisht i lartë personash, që vlerësohet të jetë 113,377 kontribues.

Nga auditimi i shpenzimeve për buxhetin e Sigurimeve Shoqërore, rezultoi se programi përfundimtar i shpenzimeve, i miratuar me ligjin për buxhetin e vitit 2013, nga 95,395 milionë lekë të programuara, është realizuar në shumën 95,596.6 milionë lekë, pra konstatohet një tejkalim prej + 201.6 milionë lekësh.

Konstatohet se defiçiti i degës së pensioneve po thellohet nga viti në vit dhe, bazuar në treguesit e buxhetit afatmesëm, parashikohet të thellohet edhe në tre vitet e ardhshme, duke bërë të domosdoshme marrjen e masave konkrete dhe reformimin e thellë të Sistemit të Sigurimeve Shoqërore.

Kemi rekomanduar një sërë masash për përmirësimin e gjendjes, por theksojmë se është i rëndësishëm dhe i domosdoshëm miratimi i ndryshimeve ligjore për skemën e sigurimeve shoqërore (nismë tashmë realizuar pjesërisht), si dhe marrja e masave shtrënguese në detyrimin e subjekteve publike dhe private, për derdhjen e detyrimeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, të cilat së bashku do të përmirësojnë situatën për deficitin e krijuar.

Rekomandimet e KLSH, të lëna si në drejtim të përmirësimeve ligjore të akteve në fuqi, ashtu dhe për hartimin e marrëveshjeve ndërinstitucionale dhe masat organizative brenda ISSH, nëse zbatohen, mund të përmirësojnë skemën e Sigurimeve Shoqërore dhe ndalojnë "hemorragjinë" e deficitit të pensioneve.

Buxheti i Sigurimeve Shëndetësore

Nga auditimi i ushtruar në Fondin e Kujdesit Shëndetësor, konstatuam të ardhurat gjithsej, janë realizuar në masën 7,3 miliardë lekë nga kontributet ndërsa *pjesa tjetër janë transferta të buxhetit të shtetit 23,2 miliardë lekë.* Përsa u përket të ardhurave nga kontributet shëndetësore të fermerëve, janë realizuar në masën 66%.

Shpenzimet faktike gjatë vitit 2013 në krahasim me faktin e vitit 2012 janë rritur në vlerën 864 milionë lekë, ose niveli i realizimit është 105.6 %, pasi nga 15,446 milionë lekë të shpenzuara gjatë vitit 2012, evidentohet se në vitin 2013 janë shpenzuar 16,310 milionë lekë.

Kemi konstatuar se ka patur mangësi në mënyrën e planifikimit të shërbimit shëndetësor, referuar mënyrës së llogaritjes dhe vlerësimit të kostos së shërbimeve spitalore, problem i cili nuk ka gjetur zgjidhje *duke sjellë si pasojë që buxheti i vitit 2014, por edhe projektbuxheti i vitit 2015 për shërbimin spitalor të hartohet bazuar vetëm në të dhëna historike. Kemi rekomanduar të intensifikohet puna e nisur gjatë vitit 2014 nga* Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, *në lidhje me hartimin dhe miratimin e kostos së shërbimeve kryesore spitalore me efekte financiare për buxhetin e kujdesit shëndetësor.*

Të sigurohet që pacientët të marrin paketa të përcaktuara dhe të kontraktuara midis blerësit të shërbimit dhe qendrës shëndetësore, apo ofruesit tjetër të shërbimit që mund të jetë spitali publik, ose spitali privat. Transparencën e konsiderojmë të rëndësishme në këtë proces.

Kemi rekomanduar po ashtu, **që të përcaktohet një mënyrë më efektive për të saktësuar ngarkesën e mjekut të familjes**, kjo pasi rezulton se ngarkesa faktike banorë/për mjek familje është duke arritur kufijtë maksimalë, krahasuar me normën dhe maksimumin e normës, të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë. Kemi kërkuar pastrimin në vazhdimësi të regjistrit elektronik të banorëve nga dublimet dhe bashkëpunimin me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile për përcaktimin e saktë

të banorëve, kjo pasi kemi konstatuar se institucioni administron një regjistër elektronik të banorëve, me mbi 4 milion banorë në total në rang vendi.

Për të siguruar zbulimin dhe dënimin e fenomeneve abuzuese me skemën e sigurimeve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor, duke u përqendruar të veprimtaria e mjekut të familjes, mjekut specialist, farmacistët dhe të siguruarit nga skema, kemi rekomanduar të ushtrohet kontroll më i hollësishëm në QSUT dhe KMCAP, në lidhje me rekomandimet e dhënies së barnave për trajtimin e të siguruarve, të harmonizohen kontrollet e plota me kontrollet tematike për rajonet që kanë tejkalim të planit të rimbursimit gjatë vitit.

Bazuar në evidencat e FSDKSH-së, konstatohet se për vitin 2013, vazhdon të mbetet i palikuiduar detyrimi i prapambetur i vitit 2012, i ISSH ndaj FSDKSH në shumën 215.4 milionë lekë, ku për arkëtimin e kësaj vlere duhet të negociohet midis Ministrisë së Financave dhe ISSH (që nga prilli i vitit 2013 nuk ka më marrëdhënie midis ISSH e FSDKSH për shumën e transfertës së kontributeve nga TSA).

Mbi auditimin e kryer për menaxhimin e burimeve natyrore

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi **Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore** (e cila auditohet për herë të parë që nga krijimi në vitin 2006) në drejtim të transaksioneve financiare dhe në zbatimin e procedurave ligjore si dhe përmbushjen e detyrave funksionale të kësaj Agjencie për periudhën e aktivitetit të vitit 2013**,** ku duhet theksuar fakti që audituesit e KLSH patën qasje të kufizuar në dokumentacionin e marrëveshjeve hidrokarbure, duke e shtyrë auditimin e plotë të këtij sektori për periudhën në vijim.

Nga auditimi i AKBN, rezultoi si vijon:

1. Kjo Agjenci në veprimtarinë e saj administrativo-ligjore është vetëpërjashtuar nga rregullat për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore duke funksionar me një status "hibrid", pa përcaktime të sakta ligjore të cilat rregullojnë veprimtarinë e saj. Kjo ka sjellë dhe shpenzime të pajustifikuara apo dëme në mënyrën e administrimit të fondeve në dispozicion, ku vetëm për vitin 2013 ky keqpërdorim arrin në vlerën prej rreth **34,5 milionë lekë**.

2. Në funksionimin e AKBN është konstatuar mungesë rakordimi të veprimeve me Autoritetin Kontraktor (Ministria e Energjetikes dhe Industrisë-MEI) për monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të kontratave. Veçanërisht mbi dokumentacionin ekonomiko-financiar që duhet të paraqesin koncesionarët për zbatimin e kontratës në faza të ndryshme të ndërtimit (bilance, fatura, etj), të cilat në shumë raste mungojnë, ose nuk janë të firmosura sipas bazës ligjore, mungesa e dokumentacionit ka bërë të pamundur vlerësimin real të investimeve të kryera, duke sjellë edhe pamundësinë e llogaritjes së penaliteteve nga Autoriteti Kontraktor. Një shkak për gjendjen e krijuar në fushën e

dokumentacionit për monitorimin është nënshkrimi i kontratave ndërmjet ish METE dhe koncesionarëve, pa përfshirë AKBN, si institucioni monitorues.

3. Nga auditimi konstatohet se, për HEC-et që kanë filluar prodhimin e energjisë elektrike, nuk ndiqen detyrimet e koncesionarit për kryerjen e testimit të veprës energjetike, vlerësimin e investimit, detyrimet e koncesionarit për derdhjen në vlerë në arkën e MEI të tarifës koncesionare sipas kontratës, dhe rakordimet vjetore, për të përcaktuar përmbushjen e detyrimit për prodhimin e energjisë elektrike vjetore sipas kontratës.

4. Nga auditimi i dokumentacionit (që nuk është i plotë), ka rezultuar se KESH sh.a., që në bazë të një kontrate me koncesionarin, merr në dorëzim për llogari të MEI sasinë e energjisë elektrike të prodhuar, me fatura mujore, ka mbajtur tarifën koncesionare sipas energjisë elektrike të prodhuar dhe sipas tarifës në përqindje. **KESH sh.a. detyrohet që vlerën e tarifës koncesionare, ta derdhë në arkën e Ministrisë të Energjisë dhe Industrisë, por që me argumentin e vështirësive financiare, nuk e ka derdhur**. Përveç tarifës koncesionare, koncesionari për mosrealizimin e prodhimit vjetor të energjisë elektrike për faj të tij, penalizohet me 5 % të vlerës të energjisë elektrike të parealizuar, duke llogaritur të plotë edhe tarifën koncesionare, dhe jo sipas prodhimit faktik të realizuar. Këto llogaritje nuk janë bërë nga Autoriteti Kontraktor.

5. Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se për vitin 2013, nuk është kryer testimi i HEC-eve që janë vënë në punë, duke mos zbatuar procedurat e përcaktuara në Kontratës Koncesionare. Moskryerja e këtyre procedurave në prani të përfaqësuesve të Autoritetit Kontraktor dhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, nuk ka dhënë mundësi të përcaktohet nëse janë plotësuar kushtet e përcaktuara për fuqinë e vendosur, makineritë e vëna në HEC, llojet, origjina e tyre, etj.

Në lidhje me auditimin për **monitorimin e lejeve e liçensave të shfrytëzimit të burimeve natyrore minerare** rezultoi se:

1. Agjencia kombëtare e burimeve natyrore (AKBN) nuk ka hartuar asnjë raport monitorimi për të dy gjashtëmujorët e vitit 2012 bazuar mbi mbikëqyrjen që duhet të kryenin gjatë kësaj periudhe në subjektet që ushtrojnë veprimtari të shfrytëzimit minerar, duke mospërmbushur detyrimin ligjor të saj, megjithëse **ka kryer shpenzime dhe përdorur fonde për hartimin e raporteve të monitorimit.**

2. Në raportin e vitit 2013, shumë nga treguesit e monitorimit të lejeve minerare nuk janë koherentë duke humbur besueshmërinë e gjendjes reale të treguesve të aktivitetit të lejeve minerare, pasi bazohen në raportet dhe akt konstatimet e viteve të mëparshme apo vetëdeklarimet e vetë subjekteve. Mënyra e trajtimit nga ana e specialistëve dhe masat e propozuara nga drejtuesit e AKBN gjatë vitit 2013 nuk kanë qenë në mbrojtje

të interesave të shtetit. Mos aplikimi i masave administrativo-ligjore nga ky institucion, ka lejuar abuzimin nga ana e shoqërive koncesionare, të cilat gëzojnë leje shfrytëzimi të bëjnë një shfrytëzim gati barbar të burimeve nëntokësore, duke shkatërruar në shumicën e rasteve zonat mjedisore në të cilat ata operojnë.

3. Nga auditimi u konstatua se në shumë rrethe të vendit zhvillohet **aktivitet minerar** nga ana e subjekteve të palicencuara, të cilat jo vetëm zhvillojnë veprimtari të paligjshme, por sjellin edhe një dëm mjedisor si nga pikëpamja vizive, por edhe nga emetimet në atmosferën përreth të gazrave të dëmshëm. Nga strukturat përgjegjëse nuk merren masa që në bashkëpunim me pushtetin lokal të kërkohet dhe ndihma e Policisë së Shtetit, duke bërë evidentimin dhe ndalimin e subjekteve të palicensuar, që zhvillojnë aktivitet privat minerar të paligjshëm. Në zona të ndryshme konstatohen **raste të tjetërsimit të lejes minerare të shfrytëzimit** te persona të tjerë në mënyrë të paligjshme dhe deri në ushtrimin e aktivitetit prodhues minerar në zona të paliçensuara.

5. Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga sektori i Garancive dhe Rehabilitimit Mjedisor rezulton se nga **741** subjekte të regjistruara me leje minerare rreth **393** subjekte nuk kanë depozituar asnjë vlerë monetare, si **garanci për rehabilitimin e zonës**, në shkelje të ligjit minerar. **AKBN ka lejuar që këto subjekte të mos e zbatojnë këtë detyrim ligjor, mungesa e kësaj garancie rrezikon dhe shuan mundësinë e rikthimit të këtyre zonave në gjendjen mjedisore të mëparshme, duke i shkatërruar përfundimisht ato.** Rreth 121 subjekteve për të cilat është propozuar **revokimi i lejes minerare,** rezulton të kenë garanci financiare të padepozituara për vitin 2011 dhe vitin 2012 në vlerë të përllogaritur në shumën **88.6 milionë lekë**, të cilat duhet të kalonin në favor të buxhetit të shtetit dhe **të përdoreshin për rehabilitimin e zonave ku është kryer veprimtaria minerare.**

Pavarësisht se gjendja paraqitet tejet e rëndë dhe jashtë çdo autoriteti të shtetit mbi pasuritë kombëtare, të cilat vazhdojnë të përdoren në mënyrë të jashtëligjshme,shkatërrohet mjedisi në mënyrën më barbare dhe shfrytëzohen njerëz si në mesjetë, autoritet shtetërore përgjegjëse për të marrë masa dhe ndëshkuar cilindo që dhunon e cenon pasurinë kombëtare mjaftohen me raporte të vazhdueshme të cilat në shumicën e rasteve mbeten në sirtarët apo arkivat e institucioneve si dëshmi e shkatërrimit, përballë apatisë së instancave shtetërore, kryesisht për mungesë vullneti dhe bashkëpunimi.

KLSH vlerëson nismën për ndryshime ligjore në ligjin Minerar, ndryshime të miratuara nga Kuvendi me datë 8 tetor 2014, të cilat ndihmojnë në përmirësimin e situatës së rënde në aktivitetin minerar të vendit.

Mbi auditimin e saktësisë se detyrimeve të prapambetura të deklaruara si borxh deri në datën 31.12.2013 ne ARSH dhe QSUT.

Në respekt të kërkesës së Fondit Monetar Ndërkombëtar, është ndërmarrë një auditim tematik lidhur me saktësinë e detyrimeve të prapambetura të deklaruara si borxh deri në datën 31.12.2013, bazuar në materialin e përgatitur nga eksperti ndërkombëtar i kontraktuar nga qeveria. Ky mision u realizua në respekt të kërkesës së misionit të FMN dhe në kushtet kur nuk u arrit të nënshkruhej memorandumi i bashkëpunimit me Ministrinë e Financave, pavarësisht mirëkuptimit dhe dakordësisë së MoF me KLSH, për shkak të problematikës së auditimit të detyrimeve për TVSH. Auditimi u realizua mbi listën e detyrimeve për investimet në infrastrukturën rrugore deklaruar nga ARrSH dhe në detyrimet e mallrave dhe shërbimeve të QSUT.

Mbi auditimin e borxhit në ARRSH

Nga auditimi i kësaj liste në Autoritetin Rrugor Shqiptar rezultoi se raportimi zyrtar i detyrimeve të prapambetura, të njohura, por të papaguara nga ARrSH datë 31.12.2013, me vlerë 14,419 milionë lekë**, nuk është i saktë dhe duhet të saktësohet duke zbritur vlerën 880 milionë lekë.**

Nr.	EMËRTIMI	Vlera e papaguar dhe paraqitur si borxh deri 31.12.2013	Vlera e papaguar dhe paraqitur si borxh pas konstatimeve KLSH	Devijimi (në ulje) 000/lekë
1	*Zhvillimi i projekteve të brendshme*	*11,415,349*	*11,054,949*	*360,400*
2	*Studime projektime (brendshme, huaja)*	*451,666*	*408,101*	*43,565*
3	*Shpronësime*	*1,105,971*	*752,360*	*353,611*
4	*Vendime gjyqësore*	*426,217*	*426,217*	-
5	*Kosto lokale dhe TVSH*	*1,020,635*	*897,980*	*122,655*
6	***Shuma***	***14,419,838***	***13,539,607***	***880,231***

1/a. Zhvillimi i projekteve të brendshme, është paraqitur me **360 milionë lekë më tepër**, për shkak të rritjes së padrejtë të vlerës së detyrimit të prapambetur në projektet ose veprimet e pasakta financiare të konstatuara nga auditimi i KLSH.

1/b. Shpronësimet, janë paraqitur me **353,6 milionë lekë më tepër**, si rezultat i gabimeve në klasifikimin e bërë nga personat përgjegjës.

1/c. Studim projektim, është paraqitur më tepër **43,6 milionë lekë**, si rezultat i mos rakordimit në vazhdimësi të likuidimeve midis Sektorit të Projekteve dhe Sektorit të Financës.

1/d. TVSH dhe kosto lokale paraqitur më tepër **122,7 milionë lekë** si rezultat i interpretimit të gabuar për garanci punimesh.

I kemi kërkuar ARrSH, të njoftojë Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, si dhe Ministrinë e Financave, për ndryshimin në zbritje të vlerës reale të detyrimeve të prapambetura datë 31.12.2013, me 880 milion lekë, me qëllim reflektimin e tij për detyrimet në vijim.

Gjithashtu kemi lënë rekomandime të cilat i shërbejnë mirëadministrimit të këtyre kontratave në të ardhmen, në mënyrë që të sigurohet saktësia e të dhënave dhe detyrimeve, që të ndiqen me përgjegjshmëri më të madhe.

Mbi auditimin e borxhit në QSUT

Nga auditimi në QSUT ka rezultuar se sipas bilancit të datës 31.12.2013, vlera totale e detyrimeve të krijuara gjatë viteve për barnat farmaceutike është 2 miliardë lekë, ndërsa për ato jo farmaceutike, investime, shpenzime për ujë, shpenzime për vendime gjyqi, blerje gazi dhe karburanti, etj., janë 1,5 miliardë lekë. Pra detyrimi i prapambetur për t'u likuiduar është në vlerën totale prej **3,56 miliardë lekë**. Auditimi konstatoi parregullsi në rastin e detyrimeve të paguara për konsum të medikamentit "Cerezyne". Kjo parregullsi i referohet mos dokumentimit të sasisë së medikamentit të përfituar si donacion dhe atij që duhej të përballohej nga fonde buxhetore. Konstatuam që në total me praktika të gabuara, dhe të padokumentuara plotësisht, janë njohur si detyrim buxhetor dhe likuiduar **111 milionë lekë**. Kemi *rekomanduar që të investigohet nga auditi i brendshëm i MSH, praktika e plotë (duke filluar nga viti 2012 deri qershor 2014), për barnat e përfituara me donacion, lidhur me evidentimin e saktë të pacientëve të trajtuar dhe sasisë së konsumuar nga ata sipas protokolleve mjekësore. Nisur nga ky konstatim kemi kërkuar të njëjtën procedurë auditimi për të gjitha barnat që QSUT, ka përfituar me donacione të ndryshme. Kërkohet të hartohet një rregullore e plotë e evidentimit, kontabilizimit dhe përdorimit të tyre në këtë institucion.*

Në praktikat e likuidimeve të barnave, u konstatua marrja e mallrave me metodën e "borxhit", madje kryerjet e këtij veprimi ishin në metodën e punës (praktikë që vepron akoma), veprime që kishin miratimin e titullarit të institucionit duke caktuar edhe një komision të veçantë për marrjen e mallrave (barnave) si borxh. *Për këtë kemi rekomanduar të pritet menjëherë praktika e marrjes së mallrave "borxh", para se të lidhet kontrata ose marrja e mallrave pjesore nga furnizuesi me argumentimin se nuk e disponon të gjithë sasinë e barnave të caktuar në kontratë.*

Për të parandaluar krijimin e detyrimeve të reja i rekomandojmë institucionit që të ndiqet praktika e pagesave të mallrave bazuar me datën e hyrjes së tyre në magazinë, gjithashtu asnjë likuidim nuk duhet të bëhet pa praktikën e plotë dokumentare dhe kontratën përkatëse.

Mbi zbatimin e ligjshmërisë në administrimin e të ardhurave dhe shpenzimeve në shoqëritë aksionere

Rezulton se KLSH gjatë veprimtarisë audituese të ushtruar në Shoqëritë aksionere, ka evidentuar shkelje dhe mangësi si rrjedhoje e moszbatimit të ligjshmërisë me pasojë dëm ekonomik prej 8,1 miliardë lekë. Rezultatet e disa nga auditimeve kryesore janë:

Mbi auditimin e ushtruar në Albpetrol Sh.a

Nga auditimi i radhës në shoqërinë Albpetrol sha, u konstatua që kjo shoqëri ka funksionuar si një kompani shtetërore tërësisht në dobi të interesave të kompanive koncensionare private dhe interesave të drejtuesve më të lartë të saj, duke shmangur në mënyrë flagrante vendimmarrjen e Këshillit të Ministrave, Këshillit Mbikëqyrës, Drejtorisë së Auditit të Brendshëm dhe drejtorive të tjera të Albpetrol, si dhe duke krijuar e konsoliduar struktura paralele drejtuese në brendësi të shoqërisë. Më konkretisht, shkeljet kryesore që kanë rezultuar nga auditimi i Albpetrol janë:

1. Nënshkrimi me të njëjtën kompani koncensionare i dy akt-marrëveshje hidrokarbure, tërësisht në kundërshtim me procedurat e parashikuara ligjore dhe në tejkalim të plotë të kompetencave të Administratorit të Albpetrol Sh.a.;

2. Shlyerja e detyrimit të Albpetrol ndaj shoqërive koncesionare, me dhënien e naftës direkt nga vendburimi, dhe jo nëpërmjet Qendrës së Administrimit dhe Shitjes së Naftës dhe Gazit në Patos;

3. **Zbritja nga nafta e prodhuar, e sasisë së holluesit të përdorur**, v**eprime të cilat kanë shkaktuar uljen e padrejtë të detyrimeve që shoqëri koncesionare i kanë** Albpetrol. Dëmi i shkaktuar **rreth 7.2 milionë euro;**

4. Pasaktësi në llogaritje të bilancit të naftës së prodhuar, me efekte të mëdha financiare në rezultatin e shoqërisë;

5. **Krijimi i strukturave paralele për të dubluar veprimtarinë e Albpetrol sh.a, si në rastin e** organizimit të Drejtorisë së Marrëveshjeve dhe Hidrokarbureve. Nga 150 punonjës që është personeli i administratës së Albpetrol, 63 prej tyre i përkasin Drejtorisë së Marrëveshjeve dhe Hidrokarbureve;

6. Probleme të mprehta sociale, të mbartura në vite, në trajtimin e ish-punonjësve dhe punonjësve aktualë të Albpertrol Sh.a., të ngritura nga Sindikata e Nxjerrjes së Naftës.

Çështjet dhe problematikat e mësipërme të trajtuara më hollësisht edhe në raportin e auditimit të Albpetrol sha, kërkojnë angazhimin dhe bashkëveprimin e një sërë institucioneve shtetërore, kryesisht Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, Këshillit Mbikëqyrës të Albpetrol si dhe AKBN, por pavarësisht punës së këtyre institucioneve,

mendojmë që **për problematikat disavjeçare të ngritura nga Sindikata e Nxjerrjes së Naftës, Patos dhe për të cilat kjo shoqatë i është drejtuar vazhdimisht institucioneve më të larta në vend, Kuvendi duhet të ndërmarrë nismën për të ngritur një komision të posaçëm parlamentar për shqyrtimin e tyre.**

Ne si KLSH kemi rekomanduar auditimin jo vetëm aktivitetin e shoqërisë por edhe kompanitë koncensionare, pa cënuar në asnjë rast në rrugë joligjore, të drejtat e këtyre kompanive. Vetëm pas kësaj, mendojmë se Kuvendi dhe opinioni i gjerë publik do të informohet me saktësi në lidhje me realitetin dhe përmasat e vërteta të këtij dëmi të konsiderueshëm, jo vetëm ekonomik, i cili është disa fish më tepër.

Dëmi ekonomik i zbuluar nga KLSH gjatë vitit 2013 është në vlerën 12,673.6 milionë lekë ose mbi 90,5 milionë euro dhe detyrimet debitore në fund të vitit 2013 janë në total në vlerën 98,064 milionë lekë ose mbi 70 milionë dollarë. Më konkretisht:

I. Vlera e shkeljeve me dëm ekonomik në të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit të shtetit, në shumën 12,548 milionë lekë e detajuar paraqitet :

- Vlera e dëmit ekonomik në të ardhurat e buxhetit të shtetit në vlerën 3,901.2 milionë lekë;
- Vlera e dëmit ekonomik në shpenzimet e buxhetit të shtetit në vlerën 665.9 milionë lekë;
- Vlera e demit ekonomik te shkaktuar në shoqëritë anonime në total 8106.5 milionë lekë;

  nga e cila :

  1. Vlera prej 5,566.8 milionë lekë e Albpetrol sh.a. Fier për mosarkëtim të ardhurash si pasojë e moszbatimit të detyrimeve kontraktore.
  2. Vlera prej 2,242.8 milionë lekë e Autoritetit Portual Durrës.
  3. Vlera prej 296.9 milionë lekë e demit ekonomik të evidentuar në shoqëritë anonime në fushën e shpenzimeve.

Theksojmë se në dëmin ekonomik të evidentuar për Albpetrol Sh.a prej 5,566.8 milionë lekë nuk është përfshirë:

*-Vlera e detyrimit prej **314,93** milionë lekë që përfaqëson dëmin ekonomik të shkaktuar nga kompania koncesionare B.... i përket vitit 2014.*

*-Vlera e detyrimit prej **5,374** milionë lekë që Shoqëria "Armo" sh.a. Fier, i ka shoqërisë "Albpetrol" sh.a Fier, që i përket detyrimit të vitit 2011. Për këtë vlerë KLSH ka kërkuar arkëtimin në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative të vlerës prej 5 374 .4 milionë që shoqëria "Armo"sh.a Fier, i ka shoqërisë "Albpetrol" sh.a Fier. Nga Alb Petrol Sha kërkesë padia*

ishte bërë për vlerën 1,949,693 mijë lekë por pas mbajtjes nga KLSH të procesverbalit datë 07.08.2014, Albpetrol bëri kërkesë padi në datë 08.08.2014 në vlerën prej 3,424,756 mijë lekë.

II. Vlera e detyrimeve debitore në shumën 98, 064 milionë lekë

Gjithsej (I+II) =110, 737.6 milionë lekë.

Vlerat e mësipërme sipas fushave dhe sektorëve ku janë konstatuar paraqiten në aneksin nr. 2 bashkëlidhur këtij raporti.



Mbi auditimet e performancës

Gjatë periudhës, KLSH ka realizuar dhe evaduar 6 auditime performance, ka realizuar dhe dërguar në subjekte 5 projekt-raporte në pritje të observacioneve, si edhe ka iniciuar 4 auditime të reja. Ecuria e auditimeve të performancës ka ardhur në rritje, si në terma të cilësisë, ashtu edhe të sasisë. Rezultatet e disa auditimeve të rëndësishme të realizuara gjatë vitit 2013, përmendim:

Ndarja administrative-territoriale në Republikën e Shqipërisë

Auditimi tregoi se ndarja aktuale administrative-territoriale ka sjellë ngadalësim në zhvillimin vendor dhe vartësi të NJQV ndaj të ardhurave nga buxheti i shtetit. Shqipërisë i nevojitet ndarje e re administrative-territoriale duke u bazuar në kritere të qarta, me synim rritjen e efiçiencës dhe efektivitetit të NJQV në realizimin e objektivave për rritjen e shërbimeve në mënyrë sa më cilësore ndaj komunitetit. Bazuar në konstatimet tona kemi rekomanduar që realizimi i ndarjes së re territoriale administrative-tokësore të bazohet në ekonomicitetin, efiçiencën dhe efektivitetin e programeve qeveritare. Rekomandohet procesi i "bashkimit vullnetar", por ndërkohë theksojmë se është shumë e nevojshme një marrëveshjeje ndërmjet forcave kryesore politike për të realizuar ribashkimin e NjQV me një kufi minimal prej 10.000 banorësh për Komuna dhe 15.000 banorësh për Bashki, duke negociuar dhe vendosur edhe kufijtë e rinj ndërmjet njësive të reja lokale.

Realizimi i ndarjes së re territoriale administrative-tokësore të bazohet në një studim të plotë nga Ministria e Çështjeve Vendore, Ministria e Brendshme, Ministria e Financave

dhe ekspertë të fushës për ndarjen e re administrativo-territoriale, që të vazhdojë më pas me procedurat për hartimin dhe propozimin e projekt-ligjit të nevojshëm, duke respektuar Kushtetutën, dispozitat e ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore dhe Kartën e Autonomisë Vendore.

Censusi 2011

Auditimi tregoi pavarësisht punës së mirë në realizimin e objektivave kryesore dhe vështirësive të hasura nisur nga kompleksiteti i procesit të Census 2011, regjistrimi i popullsisë dhe i banesave nuk ka mbuluar të gjithë zonën e regjistrimit të RSH, si dhe nuk ka qenë i orientuar në përqasjen kosto-efektivitet. Nga auditimi ka rezultuar:

- Mungesa e një analize paraprake të detajuar për të gjitha aktivitetet e procesit të Census, që në fazën e planifikimit për përcaktimin e kostos dhe burimet e financimit, ka çuar në rritjen e kostos totale të këtij procesi.
- Censusi nuk e ka përmbushur misionin e tij për pasqyrimin e nivelit të punësimit në vend, duke e bërë jo efektiv modulin përkatës të përfshirë në pyetësor.
- Për çështje me ndjeshmëri publike, sikurse është feja, regjistrimi i informacionit të bëhet rigorozisht. Kjo duke marrë shkas edhe nga pakënaqësitë apo kontestimet që mund të bëjnë me të drejtë komunitetet fetare.
- Ndryshe nga marzhi i gabimit të publikuar nga INSTAT në intervalin 3-5% popullsi e paregjistruar, KLSH vlerëson se mosregjistrimi shkon deri në nivelin 30% të popullsisë totale.
- Shërbimi ushqimor spitalor
- Auditimi tregoi se ofrimi i shërbimit të ushqimit në spitalet e qytetit të Tiranës lë të për dëshiruar në drejtim të planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të tij.
- Kemi konstatuar se performanca e shërbimit të ushqimit, pra kontrolli cilësisë së ushqimit të servirur tek pacienti, nuk është bërë në asnjë nga spitalet publike të Tiranës, pasi nuk ekzistojnë mjetet e duhura për të realizuar kontrollin e cilësisë së ushqimit dhe as vullneti i spitaleve për të realizuar këtë kontroll.
- Në të gjitha spitalet, nuk ekzistonin kritere apo udhëzime formale për monitorimin e cilësisë, dhe megjithëse në kontratë, nuk ka klauzola për këto procedura, vihet re se ka pasur raportime për performancë jo të mirë nga kontraktori.
- Edhe pse QSUT-së, nuk i ka munguar eksperienca e mëparshme për planifikimin e fondeve për ushqimin, ajo kishte planifikuar dhe llogaritur vlerën e kontratës

vetëm për një vit dhe jo në shumën e plotë të pagueshme pa TVSH, për gjithë periudhën e zgjatjes së saj prej 7 vjetësh.

Në fund të këtij misioni kemi arritur në konkluzionin se zgjidhja e problematikës së hasur në spitalet tona në lidhje me planifikimin, çmimet e ndryshme të ushqimit të ofruar dhe zgjatja pafund e procedurave të prokurimit, do ishte Marrëveshja kuadër qëllimi i së cilës është të vendosë kushtet e kontratave, që do të prokurohen gjatë një periudhe të caktuar kohore, veçanërisht ato që kanë lidhje me çmimin dhe aty ku është e përshtatshme, me sasitë e parashikuara.

Performanca e KESH sh.a, liberalizimi i tregut të energjisë elektrike (fazë projekt raporti)

Auditimi tregoi se ngarkimi me funksionin e prodhuesit publik të energjisë, garantimi i blerjes së energjisë së prodhuar nga HEC-et e dhëna me koncesion, si dhe ndërtimi i marrëdhënieve kontraktuale me çmime të rregulluara (të diktuara ose nga ERE, ose nga qeveria në marrëveshjet koncesionare), sigurimi i importit (blerjes) të energjisë elektrike për llogari të CEZ Shpërndarje (aktualisht OSHEE), jo vetëm që e kanë denatyruar funksionin themelor të një shoqërie publike (sigurimin e fitimit dhe rritjen e efektivitetit), por e kanë zhytur atë në detyrime financiare ndaj klientëve, duke e bërë domosdoshmëri ndryshimin e mënyrës se funksionimit, administrimit dhe menaxhimit, nëpërmjet ndarjes së përgjegjësive (prodhimi nga blerja: importi dhe/ose blerja e energjisë nga HEC-et e dhëna me koncesion), si dhe hapjen e tregut të energjisë elektrike, të cilat do të reflektohen në fund të fundit në cilësinë dhe koston e furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve.
Kemi rekomanduar ndryshimin e modelit të tregut të energjisë elektrike në funksion të kalimit gradual në një treg të liberalizuar, me synim rritjen e konkurrencës; zhvillimin e një reforme tarifore me interes për mbrojtjen e konsumatoreve; mundësimin për ndërhyrje me strategji dhe politika afatgjata; integrimin e këtij tregu në Tregun Rajonal dhe atë Evropian të Energjisë Elektrike, duke siguruar qëndrueshmëri dhe shërbim cilësor në furnizimin me energji elektrike.
Ndarjen e Divizionit të Furnizimit Publik me Shumicë nga KESH sh.a, si strukturë më vete, duke e vendosur shoqërinë (KESH) si operator në treg në cilësinë e prodhuesit dhe tregtuesit të energjisë elektrike, duke bërë të mundur fuqizimin ekonomik dhe financiar të KESH ShA në funksion të rritjes së efektivitetit të përdorimit të burimeve hidrike në kaskadën e Drinit (e vetmja publike aktualisht); përmirësimi i teknologjisë ekzistuese dhe për pasojë uljen e kostos, si dhe mundësimin e burimeve të tjera për rritjen e prodhimit dhe diversifikimin e burimeve elektrike;

Në kushtet aktuale të modelit ekzistues të tregut dhe pozicionimit të operatorëve në këtë sistem, si edhe në perspektivën e ndryshimeve të mundshme, rekomandojmë

ruajtjen e çmimeve aktuale të energjisë elektrike për konsumatorët familjarë. Arsyet e mungesës së efiçiensës në këtë sektor nuk kanë lidhje me çmimin, por mosarkëtimin dhe rregullat e tregut në përgjithësi. Po kështu, rritja e çmimit të energjisë penalizon konsumatorët korrektë dhe favorizon vjedhësit e energjisë, duke sjellë komplikime sociale. Rritja e çmimit rrit gjithashtu presionin inflacionist për ekonominë si të tërë, gërryen fuqinë blerëse dhe madje mund të shpjerë në rënie të ritmit të rritjes. Përfundimisht, rritja e çmimit të energjisë duhet të konsiderohet nga MEI si alternativë e fundit e përmirësimeve në këtë sektor dhe shoqërinë në përgjithësi; kjo pasi humbjet të jenë reduktuar në nivele të pranueshme, pasi tregu të jetë liberalizuar dhe konkurrenca të veprojë normalisht dhe pasi të jetë bërë një studim i plotë dhe i kujdesshëm i efekteve e risqeve në ekonomi dhe harmonizimit me politikat monetare, fiskale e sociale.

Sikurse është theksuar dhe në Deklaratën e Pekinit të Kongresit të XXI-të të INTOSAI-t në tetor 2013, : "*Institucionet e auditimit te jashtëm publik, nëpërmjet auditimit të pavarur profesional të Buxhetit të Shtetit, mund të ndihmojnë ligjvënësit dhe vendimmarrësit e Qeverisë, për të ruajtur qëndrueshmërinë afatgjatë të politikave financiare, duke rritur transparencën, raportimin mbi performancën e financave publike, si dhe duke theksuar risqet sistematike"* (Deklarata e Pekinit, paragrafi 4).

Ne frymën e masave për të zbutur pasojat e krizës botërore ekonomike dhe financiare, Deklarata e Pekinit kërkon nga institucionet e auditimit te jashtëm publik që të rrisin qëndrueshmërinë e financave publike të vendeve të tyre, duke:

- *Vlerësuar supozimet e planifikimit qeverisës, në lidhje me ekonominë, financat publike dhe borxhin publik, duke identifikuar rreziqet potenciale dhe dhënë rekomandime konstruktive;*
- *Rritur auditimin e përputhshmërisë me rregullat fiskale, me rregullimin financiar dhe standardet e pranuara të mbikëqyrjes, si dhe duke mbikëqyrur të gjithë procesin buxhetor të qeverisë. Objektivi është sigurimi i llogaridhënies gjatë gjithë fazave të planifikimit, ekzekutimit dhe vlerësimit të performancës dhe rezultateve të arritura nga Buxheti.* (Deklarata e Pekinit, paragrafi 1 dhe 2).

Në zbatim të këtyre orientimeve thelbësore të INTOSAI-t, Organizatës ndërkombëtare të institucioneve të auditimit të jashtëm publik, ne si KLSH jemi gati **të ndihmojmë në përgatitjen dhe zbatimin e Projekt-Buxhetit të vitit 2015, të ndërgjegjshëm se mund të japim kontributin tonë modest në stabilitetin e politikave financiare publike dhe në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.**

Korniza e Matjes së Performancës së një SAI dhe palët e interesit

- *Prezantimi i Raportit të Performancës së KLSH për vitin 2014*

15 korrik 2015

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, Kuvendi i Shqipërisë

Deputetët pjesëmarrës

1. Erion Braçe
2. Ridvan Bode
3. Anastas Angjeli
4. Florjon Mima
5. Ervin Koçi
6. Andrea Marto
7. Evis Kushi
8. Blerina Gjylameti
9. Gledion Rehovica
10. Majlinda Bufi
11. Perparim Spahiu
12. Ervin Bushati
13. Liljana Elmazi
15. Edmond Spaho
16. Igli Cara
17. Gjovalin Kadeli
18. Jorida Tabaku
19. Luan Duzha

Të nderuar deputetë të Komisionit të Ekonomisë,

Matja e performancës së një institucioni publik ka rëndësi parësorë për të vlerësuar kontributin e institucionit, si dhe për t'i garantuar atij një zhvillim të qëndrueshëm në të ardhmen. Ky proces merr peshë edhe më të madhe, kur parashtrohet përpara Komisionit të Ekonomisë së Kuvendit.

Në Kongresin e fundit të INTOSAI-t, INCOSAI XXI në Pekin, në tetor 2013, një version pilot i Dokumentit Standard të Matjes së Performancës së një institucioni suprem auditimi (SAI) u prezantua dhe u shpërnda, duke u kthyer prej atëherë gradualisht format pune për çdo SAI të zhvilluar, që paraqet performancën e tij përpara partnerevë kryesore. Në respekt të rekomandimit Tuaj, herës së fundit që paraqita raportin e performancës së KLSH, si dhe në zbatim të direktivës së Kongresit INCOSAI XXI të INTOSAI-t dhe të orientimit të Kongresit Young EUROSAI për inovacionin, që në Hagë vitin e kaluar na sfidonte të gjithëve se "kur ka qenë hera e

fundit që keni bërë një gjë për herën e parë?", si KLSH jemi përpjekur të përgatisim një raportim sa më të qartë, të strukturuar dhe të vlefshëm për vlerësimin Tuaj, për punën tonë, mbi bazën e këtij Dokumenti Standard dhe qasjes IntoSAINT (auditimi i vetëvlerësimit).

Matja e standardizuar e performancës së një SAI siguron një bazë objektive për të treguar lidhjen e tij të vazhdueshme me Parlamentin, qytetarët dhe veprimtarët e tjerë. Kjo matje synon të vlerësojë kontributin e SAI-ve në menaxhimin financiar publik, në qeverisjen e mirë dhe llogaridhënien, si dhe në përpjekjet për të luftuar korrupsionin. Një matje e tillë e performancës, e punës së bërë, i jep mundësinë SAI-t për të qenë organizatë model, duke u udhëhequr nga promovimi i transparencës dhe llogaridhënies, përmes raportimit publik të performancës së tij.

Përdorimi i dokumentit pilot të matjes së performancës, edhe pse i rekomanduar nga Kongresi i fundit i INTOSAI-t, është fakultativ. Vendimi për t'ju nënshtruar një vlerësimi të tillë i takon drejtuesit të SAI-t. Vlerësimi mund të kryhet si një vetëvlerësim nga vetë SAI, si një vlerësim i kolegëve nga një tjetër SAI apo organ i INTOSAI-t, ose si një vlerësim nga konsulentë të jashtëm, donatorë apo ekspertë të tjerë. Ne e kemi vlerësuar sipas kësaj metode dhe sipas qasjes IntoSAINT, ndërkohë që kemi kërkuar vlerësim nga SAI-t partnere të zhvilluara dhe shumë shpejt këtë vlerësim do ta kemi. Jemi të hapur dhe mirëpresim çdo vlerësim ose vërejtje që mund të vijë nga Ju.

Matja e performancës nëpërmjet dokumentit pilot jep një pasqyrë të të gjitha fushave më të rëndësishme të aktivitetit dhe rezultateve të një SAI. Ajo përfshin si proceset e brendshme të institucionit (mënyrën e organizimit, zbatimin e rregullores së brendshme, zhvillimin e burimeve njerëzore, etj.), ashtu si dhe komunikimet me jashtë (partneritetet, komunikimin me qytetarët dhe publikun, etj.) dhe rezultatet.

Për këtë arsye, raportimin para Jush e kemi menduar në tri boshte kryesore:

- Në dhënien e treguesve të ecurisë së institucionit,
- Në ballafaqimin me rekomandimet Tuaja të qershorit 2014, dhe
- Në analizën SWOT e sfidat e së ardhmes për KLSH-në, në zbatimin e IntoSAINT.

Dokumenti standard të cilit i jemi referuar synon të masë performancën e SAI-t kundrejt standardeve ISSAI dhe praktikave të tjera më të mira të përcaktuara nga INTOSAI, si dhe kundrejt kornizave ligjore të brendshme që lidhen me SAI-n. Shtrirja e tij e standardizuar dhe matjet objektive të performancës në formën e treguesve, e bëjnë atë të përshtatshëm edhe për krahasimin e performancës së aktivitetit të KLSH në intervale të dhëna kohe.

Dokumenti standard ka një grup prej 22 treguesish për të matur performancën e SAI-ve kundrejt praktikave më të mira ndërkombëtare në shtatë fusha:

1. Performanca e SAI-ve;
2. Pavarësia dhe Korniza Ligjore;
3. Strategjia për Zhvillimin Organizativ;
4. Standardet e Auditimit dhe Metodologjia;
5. Menaxhimi dhe Strukturat Mbështetëse;
6. Burimet Njerëzore dhe Komunikimi, si dhe
7. Menaxhimi i Palëve të Interesuara.

Duke i përshtatur me mjedisin dhe kushtet tona specifike, si dhe për t'i bërë sa më të drejtpërdrejtë dhe të kuptueshëm, si KLSH kemi përshtatur 13 tregues kryesore që janë:

1. Auditimet dhe ecuria e tyre;
2. Dëmi ekonomik i zbuluar dhe dobishmëria;
3. Rekomandimet me impakt të lartë;
4. Numri i rekomandimeve;
5. Niveli i zbatimit të rekomandimeve;
6. Kallëzimet penale;
7. Auditimet e performancës;
8. Zhvillimi i burimeve njerëzore;
9. Kontrolli i cilësisë;
10. Transparenca dhe komunikimi;
11. Aftësia për partneritet (me partnerë vendas dhe të huaj);
12. Botimet dhe kërkimi shkencor;
13. Përmirësimi i metodologjisë dhe instrumenti IntoSAINT.

Kemi gjykuar se në tërësi, për këta tregues do të ishte më e udhës të japim shifra të konsoliduara, për periudhën janar 2014-qershor 2015, duke qenë së raportojmë pas gjysmës së parë të vitit 2015 dhe ky konsolidim i shërben Kuvendit (dhe jo vetëm atij) për të matur dhe vlerësuar ecurinë e institucionit deri në momentin e raportimit, duke i krahasuar me periudhën dyvjeçare 2012-2013 dhe me një grupim të tretë, periudhën katërvjeçare vitet 2008, 2009, 2010 dhe 2011. Çdo tregues sasior shoqërohet me grafikët përkatës të ilustruar.

I. Treguesit kryesorë të performancës së KLSH janar 2014-qershor 2015

1. Auditimet

Për vitin 2014, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka kryer 160 auditime, ose 10.5 % më shumë se viti 2013. Për periudhën 6 mujore të 2015, numri i auditimeve shkon në 71. Auditimet e përputhshmërisë dhe ato të performancës shënojnë rritje përkatësisht me 11 % dhe 33 %, duke e krahasuar vitin 2014 me vitin 2013, ndërsa si numër në total për periudhën janar 2014-qershor 2015, janë përkatësisht 191 dhe 11 auditime. Edhe pse në një numër ende të vogël, por të nisur nga një bazë e papërfillshme në vitin 2011, në vitet 2012-2013 janë realizuar 10 auditime performance dhe për periudhën 2014 - gjashtëmujori i

parë 2015 janë realizuar 13 të tilla, duke njohur një rritje të ngadaltë por të sigurtë gjatë tre viteve të fundit.

2.a. Dëmi ekonomik i zbuluar

Nga auditimet e ushtruara përgjatë periudhës janar 2014 - gjashtëmujori i parë 2015, janë zbuluar:

A. Parregullsi dhe shkelje financiare, në të ardhurat dhe në shpenzimet e kryera**, <u>me dëm ekonomik të përgjithshëm</u> në shumën totale prej 27,889,456 mijë lekë** (për vitin 2014, në shumën 11,198,404 mijë lekë dhe për gjashtëmujorin e parë 2015, në vlerën 16,691,052 mijë lekë).

B. Shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në perfomancën e subjekteve të audituara, në shumën e përgjithshme prej **20,483,919 mijë lekë** (për vitin 2014, në shumën 13 293 014 mijë lekë dhe për gjashtëmujorin e parë 2015, në vlerën 7,190,905 mijë lekë).





Nga një analizë krahasuese të periudhave katërvjeçare 2008-2011 me periudhën trevjeçare 2012-2014 konstatohet se dëmi ekonomik i zbuluar për periudhën tre vjeçare 2012-2014 është rreth dy herë më i madh se vlera e dëmit të zbuluar për periudhën e katër viteve së bashku 2008, 2009, 2010 dhe 2011.





2.b. Dobishmëria

Treguesi i dobisë së rezultateve të auditimit, i cili vë në raport shpenzimet buxhetore të KLSH me sasinë e fondeve të kërkuara për zhdëmtim nga KLSH, një nga treguesit kryesorë të performancës së SAI-eve të zhvilluara sot në botë, paraqitet për periudhën janar 2014-qershor 2015 për çdo një lek të shpenzuar për institucionin e KLSH **janë kërkuar për t'u zhdëmtuar mesatarisht 78 lekë në Buxhetin e Shtetit**.

Nga një analizë krahasuese, konstatohet: për vitet 2009, 2010, 2011, për një lek të shpenzuar nga buxheti i KLSH janë kërkuar për zhdëmtim **27 lekë**, për vitet 2012 dhe 2013 janë kërkuar **52 lekë**, që do të thotë **25 lekë** më shumë krahasuar me periudhën 2009-2011. Për periudhën 2014 - gjashtë mujori i parë 2015 për një lek të shpenzuar nga buxheti i shtetit janë kërkuar për zhdëmtim **77.5 lekë**, që do të thotë **25.5 lekë** (shifër kjo e konsiderueshme duke pasur parasysh qe i referohemi vetëm gjashtë mujorit të parë të vitit 2015) më shumë krahasuar me periudhën paraardhëse 2012-2013.





3. Rekomandimet më impakt të lartë për periudhën janar 2014-qershor 2015

3.1. Në përmbushjen e detyrimit kushtetues për paraqitjen në Kuvend të Raportit "Mbi ekzekutimin e buxhetit të shtetit të vitit të kaluar financiar", në vijim të rekomandimeve të dhëna nga KLSH si në vitin 2012 dhe 2013, në Tetor 2014 i paraqitëm Kuvendit rekomandimin për ndërmarrjen e të gjitha masave për hartimin e një rregulli fiskal, i cili të synojë në reduktimin e nivelit të borxhit publik në një periudhë të përcaktuar kohore

dhe sigurimin e një qëndrueshmërie afatgjatë të borxhit publik, nëpërmjet përgatitjes dhe paraqitjes së një iniciative ligjore për vendosjen në Kushtetutë dhe në Ligjin "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të indikatorit të borxhit publik ndaj PBB-së, në nivelin 60 % dhe arritjen e këtij niveli në terma afat afatgjatë.

Po kështu, në funksion të promovimit të një qëndrueshmërie dhe kredibiliteti të financave publike, të përmirësimit të planifikimit të performancës fiskale, të projeksioneve makroekonomike dhe parashikimeve buxhetore; kemi rekomanduar ndërmarrjen e nismës ligjore për ngritjen e një Këshilli Fiskal, i cili duhet të gëzojë statusin e një institucioni publik të pavarur dhe të ketë një pavarësi operacionale shumë strikte e rigoroze nga politika.

3.2. Për fuqizimin e ligjit "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i cili rezulton me një rezistencë të ulët, kemi rekomanduar që shqyrtimi i ndryshimeve të parashikuara në Strategjinë për Menaxhimin e Financave Publike 2014-2020 të ligjit "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe miratimi i tij në Kuvend të bëhet me një shumicë të cilësuar parlamentare.

3.3. Në kushtet e përgjegjësisë financiare të ulët të zyrtarëve publikë, i kemi rekomanduar Kuvendit hartimin e ligjit "Për përgjegjësinë materiale", në të cilin të trajtohet përgjegjësia financiare e punonjësve të njësive publike (zyrtarët e lartë dhe punonjësit e të gjithë niveleve) për dëmet ekonomike të shkaktuara qëllimisht apo nga neglizhenca, gjatë ose në lidhje me procesin e ekzekutimit të detyrave zyrtare.

3.4. Në drejtim të përcaktimit në Ligjin Organik të Buxhetit të përdorimit të të ardhurave nga privatizimi, në vijim të rekomandimit të dhënë gjatë vitit 2013 në kuadrin e rishikimit të Ligjit Organik të Buxhetit, i kemi rekomanduar Kuvendit që në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të përcaktohet që të ardhurat nga privatizimet të përdoren së pari dhe kryesisht për të ulur borxhin publik, ku 50% të jetë kufiri i poshtëm, dhe pjesa tjetër prej 30 % të përdoret për financimin e investimeve kapitale si dhe 20% për dëmshperblimin ligjor të ish të përndjekurve politikë.

3.5. Duke qenë se vlerësimi i veprimtarisë së strukturave të auditimit të brendshëm në sektorin publik përbën një prej objektivave kryesore të veprimtarisë tonë, përgjatë vitit 2014 kemi dhëne një sërë rekomandimesh që synojnë përmirësimin e kuadrit rregullator ligjor me impakt konsolidimin dhe modernizimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, dhe të auditimit të brendshëm në sektorin publik.

3.6. Nga auditimi në Bankën e Shqipërisë, bazuar në konstatimet mbi mënyrën e administrimit të Bankës, nevojës emergjente për përmirësime, të cilat në vetvete varen edhe nga mënyra e funksionimit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës e kemi konsideruar të

rëndësishme mirëqeverisjen brenda këtij organi duke rekomanduar ndër të tjera që të *saktësohen më mirë detyrat funksionale të Këshillit Mbikëqyrës dhe administratorëve të Bankës me synimin për të shmangur dualizmin e funksioneve, konfliktin e kompetencave dhe për të siguruar një nivel të dëshirueshëm llogaridhënie, transparence dhe mbikëqyrjeje. Transformimin e funksionit të Inspektorit të Përgjithshëm në një Komitet Auditimi të përbërë nga tre anëtarë, të zgjedhur nga Kuvendi duke synuar kështu rritje të pavarësisë dhe rritje të efektshmërisë së këtij funksioni*. Kemi rekomanduar *rishikimin e ligjit, në frymën e minimizimit të riskut potencial të abuzimit me pavarësinë dhe shmangies së konfliktit të interesit që evidentohet në praktikat e trajtimit të burimeve njerëzore si dhe kërkesën për një transparencë të detyrueshme ligjore lidhur me këtë aspekt. Kemi nënvizuar, që çdo ndryshim i ligjit organik të Bankës së Shqipërisë duhet të realizohet në bashkëpunim dhe konsultim të ngushtë me Fondin Monetar Ndërkombëtar, me Bankën Botërore dhe me Bankën Qendrore Evropiane.*

3.7 Nga auditimi mbi marrëveshjet hidrokarbure u konstatua se lidhjet e ndërsjella difektoze rregullatore, institucionale ndërmjet MEI, AKBN dhe Albpetrol sh.a., kanë kontribuar në krijimin e një trekëndëshi për pasimin e përgjegjësive institucionale duke ndikuar në dështimin e plotë të misionit mbikëqyrës të procesit të administrimit të pasurive natyrore e ato hidrokarbure në veçanti. Konstatuam ndryshime të Planeve të Zhvillimit kohë mbas kohe, treguesit ekonomiko–financiarë të arritur nga veprimtaria e kompanisë kanë patur mospërputhje, krahasuar me parashikimet e miratuara në Planet Afatgjatë të Zhvillimit (PZH) si dhe Planet dhe Buxhetet e Punës vjetore (PP&B). Në rast se nuk do të kishim ndryshim të Planeve të Zhvillimit, Planeve të Punës dhe Buxhetit të kryer, Shteti Shqiptar do të kishte përfituar deri në fund të vitit 2014, përveç rentës minerare prej 199,4 milion USD edhe një shumë prej afro 504.55 milion USD, vetëm nga kompania kryesore që vepron në këtë fushë. Nga auditimi rezultoi se konfirmimet e AKBN-së (përgjatë vitit 2012-2013) për përjashtim nga Akciza dhe t.v.sh. të gazoilit 10 PPM dhe 1000 PPM, janë marrë në kundërshtim me sasitë e planifikuara në Programet e Punës dhe Buxhetit, në kundërshtim me përqindjen e përdorimit të gazoilit si hollues, teorikisht i pranuar në këto raste, në mungesë të një dokumentacioni të plotë dhe argumentues, duke sjellë një dëm të vlerësuar për buxhetin e shtetit në shumën 11 miliardë lekë.

Procesi monitorues i institucioneve përkatëse shtetërore (MEI, AKBN dhe Albpetrol sh.a.), në drejtim të monitorimit të të gjithave operacioneve teknike, konform planeve të miratuara dhe rezultateve financiare të lidhura me aktivitetin hidrokarbur, ka qenë pothuajse inekzistent, duke u mjaftuar vetëm me vëzhgime vizuale, sporadike, pa u orientuar në kontrollin ligjor, financiar dhe tekniko-shkencor të implementimit të këtyre marrëveshjeve. Pikërisht, inekzistenca e këtij monitorimi institucional, duke mos kryer siç duhet detyrat dhe funksionet e ngarkuara me ligj, ka çuar në mospërfitimin e shtetit gjatë gjithë këtyre viteve të pjesës që i takon sipas marrëveshjeve përkatëse me

kompanitë koncensionare. Dhe kjo në një kohë që sasia e naftës që është nxjerrë deri më sot, në vendburime të caktuara, ka qenë aq e madhe sa i ka çuar këto vendburime në fazën e tyre shteruese ose siç cilësohet në gjuhën teknike, në fazë Depliti.

Nisur nga këto konstatime kemi kërkuar ringritjen e Institutit Shkencor të Naftës, si një institut i mirëfilltë shkencor, i cili të mbështetë të gjitha vendimmarrjet e lidhura me zhvillimet e sektorit të hidrokarbureve në vendin tonë si dhe të bashkëpunojë me Kuvendin dhe Qeverinë lidhur me hartimin e strategjive afatmesme dhe afatgjatë të zhvillimeve në këtë sektor duke bërë dhe rolin e oponentit teknik gjatë negocimit të marrëveshjeve, shqyrtimit të propozimeve dhe zhvillimit të operacioneve hidrokarbure, si dhe orientues dhe oponencë e kërkimeve shkencore që lidhen me burimet hidrokarbure. Nga ana tjetër nga ne janë rekomanduar edhe masa organizative (7 të tilla) të cilat në gjykimin tonë janë të karakterit imediat. Ato kanë vlerë vetëm po të kombinohen me fillimin e menjëhershëm të punës nga ana e MEI dhe institucioneve më të larta të shtetit si Kuvendi e Kryeministria, për hartimin e miratimin e ndryshimeve ligjore të propozuara. Kemi theksuar se këto masa organizative nuk janë shteruese por që gjykohen të domosdoshme për kohën.

3.8 Nga auditimi i Institutit të Sigurimeve Shoqërore kemi konstatuar defektet e skemës së sigurimeve shoqërore lidhur me realizimin e të ardhurave duke çuar në rritje të subvencionioneve buxhetore nga viti në vit. Kjo situatë ka çuar në thellim të deficitit të skemës së pensioneve deri në masën 622 miliardë lekë (fundi i vitit 2013), si pasojë e mosrealizimit të numrit të kontribuuesve të programuar, numrit të ulët të kontribuuesve për një subjekt si dhe numrit të lartë të punonjësve me pagë minimale. Nga ana tjetër, detyrimet kontributive të papaguara nga subjektet juridike dhe fizike rezultojnë të jenë rreth 10 miliardë lekë. E cilësojmë këtë fakt pasi rritja e detyrimeve mbart një problem të madh social, duke nënkuptuar një numër të konsiderueshëm kontribuesish të pasiguruar, të cilët përjashtohen nga të qenit subjekt i ligjit të sigurimeve shoqërore. Marrëdhënia difektoze me Drejtoritë e Tatimeve reflektohet në numrin e lartë të listëpagesave të padorëzuara dhe pamundësinë për të siguruar informacionin në kohë reale. *Në këto kushte i kemi përkrahur dhe inkurajuar ndërhyrjet në Ligjin për Sigurimet shoqërore, shoqëruar kjo me marrjen e masave shtrënguese në detyrimin e subjekteve publike për derdhjen e detyrimeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, faktorë që do të përmirësonin situatën për deficitin e lartë të konstatuar. Vëmendje dhe ndërhyrje kemi kërkuar edhe në Marrëveshjen e lidhur me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, sidomos për mënyrën dhe kohën e sigurimit të informacionit.*

4. Numri i rekomandimeve

Rritje ka pësuar numri i rekomandimeve në të gjitha kategoritë, si ato për ndryshime në legjislacion, për masa organizative, masa administrative, disiplinore dhe ato për zhdëmtim dëmi. Në tërësi, vetëm për vitin 2014, KLSH ka prodhuar 882 rekomandime më shumë se një vit më parë. Ndonëse ky tregues nuk jep shkallën e efektivitetit dhe të cilësisë në punën rekomanduese, ai mat sasinë e punës së kryer.





5. Zbatimi i Rekomandimeve

Niveli i zbatimit të rekomandimeve përfaqëson një tregues shumë të rëndësishëm për të matur efektivitetin e një SAI. Ky nivel për vitin 2014 (zbatimi i rekomandimeve të këtij viti ende nuk mund të përcaktohet) është rreth 70 % dhe përfaqëson një shifër të krahasueshme me performancën e SAI-ve të zhvilluara. Shqetësim përben për ne niveli i ulët i zbatueshmërisë së masave të propozuara nga ne për largim nga detyra apo nga shërbimi civil për zyrtare të lartë të Shtetit, që është shprehje e antikulturës së pandëshkueshmërisë, e cila qëndron ende e ngulitur në administratën tonë publike dhe duhet luftuar pa asnjë kompromis.

6. Kallëzimet penale

Kallëzimet penale përbejnë një tregues të rëndësishëm të luftës ndaj korrupsionit dhe shfaqjeve që rrezikojnë standardet e qeverisjes së vendit.

Për periudhën janar 2014 - qershor 2015, kallëzimet penale kanë qenë 67. Janë kallëzuar zyrtare të rangut të lartë dhe të mesëm të administratës publike. KLSH ka rritur cilësinë e përgatitjes së dosjeve për kallëzim penal dhe ka shkurtuar kohën e përgatitjes së kallëzimeve. Krahasuar me periudhën dy vjeçare 2012-2013, kallëzimet për periudhën 2014-gjashtë mujori i parë 2015 përfaqësojnë 87% të vlerës, krahasuar me periudhën katër vjeçare 2008-2011, kallëzimet janë rritur me 1.3 herë më shumë.



	2008, 2009, 2010, 2011	2012, 2013	2014 dhe 6-mujori i parë 2015
Numri i Kallëzimeve Penale	52	48	67
Persona te Kallëzuar Penalisht	134	219	223
Dëmi i shkaktuar në Kallëzimet Penale	4162724	2532750	5402347



	2008	2009	2010	2011	12	2013	2014	6 mujori 2015
Numri i Kallëzimeve Penale	32	9	5	6	40	38	41	26
Persona te Kallëzuar Penalisht	81	27	13	13	125	94	149	76
Dëmi i shkaktuar në Kallëzimet Penale	1793382	1912434	89251	367657	1366689	1166061	5069494	332853



7. Auditimet e performancës

Gjatë vitit 2014 dhe gjysmës së parë të vitit 2015, veprimtaria audituese reflektoi vijimësinë e filozofisë menaxheriale, sipas së cilës auditimi i performancës do të vijojë të jetë një nga shtyllat e zhvillimit dhe modernizimit të KLSH-së.

Për këtë periudhë u hodhën hapa të rëndësishëm në raport me vitet paraardhëse, duke reflektuar një rritje të numrit të Auditimeve të Performancës. Në fokus të veprimtarisë audituese ka qenë adresimi nga institucioni i KLSH-se të çështjeve jetike dhe të rëndësishme për taksapaguesin, jo thjesht në aspektin mediatik, afatshkurtër apo për të kënaqur interesat e ngushta të grupeve të interesit, por në drejtim të rritjes së mirëqenies, përmirësimit të parametrave të shërbimeve publike dhe interesave të gjera të popullatës.

Për vitin 2014, auditimet e performancës janë:

- "Performanca e KESH sh.a.", në drejtim të liberalizimit të tregut të energjisë elektrike;
- "Performanca e shërbimit bibliotekar kombëtar", në drejtim të hapësirave fizike në dobi të lexuesit, librit dhe bibliotekës;
- "Siguria rrugore", e orientuar nga përdoruesi i rrugës si element kyç i kësaj sigurie;
- "Performanca e RTSH-së", me fokus projektin e digjitalizimit institucional;
- "Censusi 2011", për të vlerësuar nivelin e saktësisë së këtij projekti;
- "Menaxhimi i pajisjeve mjekësore spitalore në QSUT";
- "Shërbimi parashkollor", me fokus cilësinë e shërbimit në çerdhet dhe kopshtet e Tiranës;
- "Laboratori kimik doganor".

Këtyre tetë temave të auditimeve të performancës për vitin e kaluar u shtohen edhe 3 auditime të evaduara për këtë vit dhe tre të tjera që janë në mbyllje e sipër, duke dëshmuar për një rritje të ngadaltë, por të sigurt të këtij sektori në KLSH.

8. Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore

Mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të INTOSAI-t, KLSH synon të ruajë dhe të zhvillojë një fuqi audituese dinamike, duke përfshirë nxitjen dhe lehtësimin e stafit duke u krijuar mundësi për promovimin dhe për integrimin e stafit ekzistues ashtu dhe atij të ri. Për këtë qëllim gjatë vitit 2014 dhe në gjysmën e parë të vitit 2015 janë zhvilluar 8 testime dhe janë miratuar 30 vendime për ngritje në kategori, krahasuar me vitin 2013, gjatë së cilit u zhvilluan 3 testime dhe janë realizuar 23 ndryshime në kategori, duke ju dhënë në këtë mënyrë mundësinë zhvillimit të karrierave profesionale brenda institucionit, nëpërmjet konkurrimit. Ndërkohë që numërohen 6 raste të uljes në kategori.

9. Kontrolli dhe sigurimi i cilësisë

Çdo vit ushtrimor, kërkojmë vlerësimin e kontrollit të cilësisë së punës audituese, nëpërmjet të cilit një numër i caktuar i dosjeve (për vitin 2014 janë shqyrtuar 20 % e tyre) shqyrtohen nga një grup ekspertësh të jashtëm dhe brenda institucionit, me qëllim identifikimin e dobësive dhe marrjen e masave për përmirësime të mëtejshme në cilësinë e auditimit. Kontrolli i sigurimit të cilësisë, bazuar në ISSAI 40, synon të garantojë një përmirësim të vazhdueshëm të punës audituese, që konfirmon faktin se institucioni në procesin auditues zbaton standardet kombëtare dhe ato ndërkombëtare të auditimit. Pikërisht për këto arsye, sigurimi i cilësisë ka qenë dhe mbetet në vazhdimësi objektiv kryesor i veprimtarisë së KLSH. Risi e vitit 2015 ishte angazhimi i shqyrtimit të dosjeve tërësisht nga ekspertë të jashtëm të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, me profesionalizëm dhe paanësi të plotë.

10. Transparenca dhe komunikimi

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka trajtuar gjatë 2014, 394 ***letra dhe ankesa,*** për probleme të ndryshme, nga të cilat 170 ***rezultuan jashtë kompetencave dhe juridiksionit të institucionit.*** Nga 224 kërkesa dhe ankesa në kompetencë të KLSH, 121 prej tyre janë verifikuar dhe u është dhënë përgjigja përkatëse, ndërsa 103 janë në procesin e verifikimit.

Gjatë 2014, shtypi i shkruar ka pasqyruar raportet dhe deklaratat tona për shtyp me një numër prej 867 artikuj, njoftime, editorialë dhe komente analitike, përkundrejt 690 gjithsej përgjatë 2013, ose 26% më shumë. Për gjashtë mujorin e parë të vitit 2015 shtypi i shkruar ka paraqitur punën dhe aktivitetet e KLSH-së me 285 materiale, duke informuar dhe sensibilizuar opinionin publik për rezultatet e auditimeve të

ushtruara nga KLSH dhe aktivitetet e ndryshme lidhur me veprimtarinë e KLSH-së, si marrëveshjet me institucione homologe, brenda dhe jashtë vendit, me shoqatat e profesionistëve të fushës së financave dhe të auditimit, organizatat e shoqërisë civile aktive në luftën kundër korrupsionit, etj.

Institucioni ka rritur praninë e audituesve në median e shkruar, me qëllim rritjen e transparencës së punës audituese për publikun e gjerë. Gjatë vitit 2014, audituesit tanë kanë qenë të pranishëm pothuajse në të gjitha gazetat e vendit me qarkullim kombëtar me 134 shkrime, të shkruara nga 51 auditues, përkundrejt 124 shkrimeve në vitin 2013 të 42 audituesve. Gjatë periudhës janar-qershor 2015, 38 auditues të KLSH kanë kontribuar me 62 shkrime.

11. Aftësia për partneritet (me partnerë vendas dhe të huaj)

Kemi kërkuar bashkëpunim konkret me strukturat e auditimit të brendshëm në Ministrinë e Financave, në bazë të Marrëveshjes së Bashkëpunimit të 8 majit të 2012, mes Ministrisë së Financave dhe KLSH, kemi thelluar bashkëpunimin me Autoritetin e Konkurrencës, me Institutin e Administratës Publike, si dhe me shoqatat e shoqërisë civile, me të cilat KLSH ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi ne vitet 2012-2013.

Institucioni ka vazhduar dhe thelluar bashkëpunimin me organizatat INTOSAI dhe EUROSAI, si dhe me SAI-t partnere si SAI i Polonisë, Turqisë, Kroacisë, Sllovenisë, ZAP-i i Kosovës, SAI i Austrisë dhe SAI-t e vendeve të tjera ballkanike, duke lidhur dhe marrëveshjeve të reja bashkëpunimi. Risi e vitit 2014 ka qenë nisja dhe thellimi i bashkëpunimit me ECA, Gjykatën Europiane të Audituesve ose SAI i Bashkimit Evropian. KLSH ka përfituar nga përvoja më e mirë e një prej institucioneve më prestigjioze të auditimit publik evropian dhe në botë. Për herë të parë, auditues të KLSH-së janë pjesë përbërëse e strukturave të Gjykatës Europiane të Audituesve, duke përfituar nga programet e internshipit të këtij institucioni të drejtën për të kontribuar pranë departamenteve dhe drejtorive të ndryshme të ECA-s.

12. Botimet dhe kërkimi shkencor

Në përputhje me Nenin 12 te ISSAI 1, Deklarata e Limës mbi të drejtën e SAI-t për t'i bërë publike gjetjet e tij, si dhe në përputhje me Parimin 4, pika 1 dhe 3 të ISSAI 12 "Vlerat dhe dobitë e SAI-ve: të bësh diferencën në jetën e qytetarëve" mbi të drejtën e SAI-ve për të përdorur mjetet e duhura të komunikimit, institucioni ka realizuar 14 botime të KLSH-së (kundrejt një fondi modest) për vitin 2014 dhe 6 botime për gjysmën e parë të vitit 2015. Botimet e vitit 2014 janë:

1. Analiza vjetore e punës 2013;
2. Performanca e KLSH-së 2013 (shqip/anglisht);
3. Revista "Auditimi Publik" nr. 6,7, 8 (shqip/anglisht);

4. Audituesit e KLSH në shtypin e përditshëm, janar-qershor 2014, volumi i II-të;
5. Konferenca e Tretë Shkencore e KLSH-së, *"Auditimi Kombëtar në Shërbim të Qeverisjes Kombëtare";*
6. 60 Vjet INTOSAI, 50 Vjet Sekretariat i Përgjithshëm;
7. Numri special i INTOSAI Journal për Kongresin e Pekinit;
8. Standardet INTOSAI mbi mjedisin (ISSAI 5110-5140);
9. Etika në SAI dhe në Institucionet e tjera Publike;
10. IntoSAINT;
11. ISSAI 5220 dhe Kodi i Transparencës Fiskale;
12. Auditimi mjet për një qeverisje më të mirë: rasti i Shqipërisë.

Botimet e gjysmës së parë të vitit 2015 janë:

1. Konferenca e III-të Shkencore (botimi në gjuhën angleze);
2. Revista "Auditimi publik" nr. 9 (shtator-dhjetor 2014);
3. Standardet e GAO-s;
4. Analiza vjetore, 2014;
5. Indikatorët e Performancës;
6. Manuali i Departamentit të Auditimit të Performancës.

Në vijim të traditës pozitive të krijuar nga KLSH gjatë tre viteve të fundit, në 29-30 tetor 2014 u organizua në Tiranë, Konferenca e Tretë Shkencore e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Kjo konferencë strukturoi, thelloi dhe konsolidoi më tej natyrën e saj kërkuese shkencore, hulumtuese e të dhënies së rekomandimeve, duke shtjelluar temën e saj qendrore: ***Auditimi kombëtar në shërbim të qeverisjes kombëtare***.

Përmirësimi i cilësisë së menaxhimit të financave publike, si një mjet për të optimizuar arritjen e objektivave kombëtarë të zhvillimit strategjik, u prezantua si sfida kryesore në shumë vende. Konferenca dha tezën se, duke përmirësuar proceset dhe institucionet buxhetore, cilësia e financave publike rritet, ndërkohë që eficienca, efektiviteti dhe transparenca përbëjnë sot tre objektivat themelorë të buxhetimit modern.

Përmirësimi i metodologjisë dhe Instrumenti i vetëvlerësimit IntoSAINT

Në kuadrin e përpjekjeve të bëra gjatë dekadave të fundit, në nivel global për zhvillimin e institucioneve, sistemeve dhe mekanizmave për promovimin e integritetit dhe parandalimin e korrupsionit në sektorin publik, KLSH ka adoptuar metodologjinë e vetëvlerësimit të integritetit në Institucionet Supreme të Auditimit (IntoSAINT), e konsideruar si një nga metodat inovative dhe të efektshme, me impakt rritjen e pritshmërive në zhvillimin e politikave të integritetit.

KLSH zhvilloi analizën vjetore nën frymën e vetëvlerësimit, e cila ofroi një pamje mjaft reale të performancës së arritur nga KLSH gjatë vitit 2014, duke pasqyruar krahas arritjeve dhe identifikimin e fushave vulnerabël, vlerësimin e maturisë së kontrolleve dhe fokusin drejt së ardhmes.

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) *aplikon qasjen* sipas se cilës përmirësimi i qeverisjes publike arrihet nëpërmjet rritjes së transparencës dhe përgjegjshmërisë, duke luftuar me efektshmëri korrupsionin, si brenda institucionit, ashtu dhe tek institucionet publike që KLSH auditon.

Lufta parandaluese, krijimi i mjedisit me integritet të lartë, është arma më e mirë për të goditur korrupsionin.

Zbatimi i IntoSAINT gjatë analizës vjetore 2014 të KLSH, u realizua në bashkëpunim me pedagogët dhe studentët e Universitetit Shtetëror "Ismail Qemali" të Vlorës (risia e dytë e procesit), si dhe të shumë ekspertëve, analistëve dhe profesorëve të njohur nga shoqëria civile e vendit(risia e tretë), që garantuan paanshmërinë dhe transparencën e plotë të analizës.

Konkluzionet dhe rekomandimet e rezultuara nga procesi i aplikimit të instrumentit IntoSAINT paraqiten si vijon:

Konkluzion i përgjithshëm

1. Në analizën e faktorëve që u realizua nëpërmjet IntoSAINT, si metodologji vetëvlerësimi dhe vetëdiagnostifikimi. Konkludohet se aplikimi i këtij instrumenti **rezulton tepër i dobishëm** në drejtim të matjes së nivelit të maturisë së kontrolleve të përgjithshme dhe të integritetit në veçanti, qasje e cila thekson trajtimin e çështjeve jo thjesht **si pengesa** por më tepër si **mundësi** për të fokusuar zhvillimet drejt së ardhmes.

2. Rezultatet e arritura treguan **për një përmbushje të kënaqshme të objektivave**, por të analizuara nën frymën IntoSAINT, ato nxorën në pah vështirësi dhe fusha vulnerabël, të cilat në raportin e vetëvlerësimit janë trajtuar me kujdes duke u analizuar nën dritën e perspektivës, duke u mbështetur fort në çfarë kemi bërë mirë, por nga ana tjetër reflektojnë rritjen e përpjekjeve se si mund ta çojmë dhe më përpara zhvillimin e këtij institucioni.

Politikat Menaxheriale Institucionale

3. KLSH si institucioni më i lartë audites në vend, ka përgjegjësinë për të qenë transparent dhe profesional ndaj publikut të gjerë për të vlerësuar e më pas raportuar mbi shkallën e përgjegjshmërisë që qeveria dhe organet e saj kanë treguar në përdorimin e parave publike, proces ky që ka në thelb të çështjes integritetin. Në funksion sa më

sipër nga aplikimi i qasjes IntoSAINT rezultoi se KLSH **ka hartuar, vendosur dhe zbaton politika** që i shërbejnë përmbushjes së detyrimeve të saj kushtetuese dhe të cilat i monitoron dhe i përditëson në vijimësi duke reflektuar në to praktikat më të mira të fushës.

4. Nga procesi i vetëvlerësimit rezultoi se **"cilësia e auditimit"** mbetet një element nga më të rëndësishmit në përmbushjen e këtyre përgjegjësive, ndaj zbatimi në pajtueshmëri të plotë të ISSAI 40 sipas të cilit "*SAI duhet të vendosë politika dhe procedura të projektuara për të nxitur një kulturë të brendshme e cila pranon se cilësia është esenciale për të gjithë punën e vet*", tregon angazhimin real të këtij institucioni në drejtim ***të politikave institucionale me fokus në cilësi***.

5. Rezultatet e aplikimit të IntoSAINT nxorën në pah stilin dhe filozofinë e menaxhimit "Tone at the Top", sipas të cilit ky Institucion në tre vitet e fundit është menaxhuar në mënyrë strategjike, ku vendimet janë marrë nën optikën e realizimit dhe impakteve afatgjatë, duke vlerësuar dhe trajtuar me efektivitet risqet dhe trajtimin e tyre nën fokusin e mundësisë së zhvillimit për të ardhmen. Sa më sipër konkludohet se objektivat e vendosura në Strategjinë e Zhvillimit për periudhën 2013-2017, janë në interpretim në përputhje të plotë të Objektivave Strategjikë të INTOSAI-t të përshtatura këto me kushtet dhe fazën e zhvillimit të KLSH.

Frekuenca e aplikimit të Instrumentit IntoSAINT

6. Vetëvlerësimi i integritetit nëpërmjet aplikimit të instrumentit IntoSAINT **do të jetë i përhershëm** dhe do të aplikohet në mënyrë periodike (çdo fund viti), në nivel institucional dhe individual, pasi vetëm duke u trajtuar në këtë mënyrë do të arrihen rezultatet e pritshme dhe të kërkuara për mbajtjen e **një niveli të lartë integriteti** në institucionin e KLSH-së dhe krijimin e profilit të audituesit profesional dhe me integritet jo vetëm brenda institucionit por edhe ne optiken e palëve të treta – parlamentit, medias dhe publikut.

Për një respektim rigoroz të treguesve të Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020

- *Prezantimi i Raportit të Zbatimit të Buxhetit Faktik të vitit 2014*

2 nëntor 2015

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, Kuvendi i Shqipërisë

Deputetët pjesëmarrës

1. Erion Braçe
2. Ridvan Bode
3. Anastas Angjeli
4. Florjon Mima
5. Ervin Koçi
6. Andrea Marto
7. Evis Kushi
8. Blerina Gjylameti
9. Albana Vokshi
10. Luan Duzha
11. Sherefedin Shehu
12. Perparim Spahiu
13. Ervin Bushati
14. Liljana Elmazi
15. Edmond Spaho
16. Igli Cara
17. Gjovalin Kadeli
18. Jorida Tabaku
19. Agron Çela

Të nderuar deputetë,

Po paraqes shumë shkurt karakteristikat dhe treguesit kryesorë të zbatimit të Buxhetit të Shtetit 2014, sipas tre kolonave baze të një buxheti modern dhe koherent: besueshmërisë, transparencës dhe përgjegjshmërisë.

Transparenca dhe përgjegjësia e lartë në zbatimin e një buxheti Shteti përbejnë shtyllat kryesore për ruajtjen e besueshmërisë së qeverisë në sytë e qytetarëve. Në këto drejtime kemi nevojë të përmirësohemi të gjithë: ekzekutivi, legjislativi dhe institucionet e pavarura kushtetuese.

Me synim rritjen e kredibilitetit të buxhetit, paraqesim përpara Jush opinionin, gjetjet dhe rekomandimet tona në lidhje me zbatimin e Buxhetit të vitit 2014, në përputhje me

mandatin tonë kushtetues, ligjin organik të KLSH-së miratuar nga Kuvendi vitin e kaluar, standardet e auditimit publik suprem ISSAI, me kërkesat e Manualit të Fondit Monetar Ndërkombëtar "Për Menaxhimin e Shpenzimeve Publike"[4], me Kodin e Transparencës Fiskale të FMN[5] dhe me të Dhjete Parimet e Buxhetimit Publik të OECD[6].

Opinioni i përgjithshëm *(Shih Përmbledhjen faqe 4, Raportin faqe 277)*

Kontrolli i Lartë i Shtetit, për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2014, para miratimit të tij nga Kuvendi i Shqipërisë, shpreh opinionin e përgjithshëm se *përgatitja, shqyrtimi dhe miratimi i Buxhetit, zbatimi, ndjekja dhe rishikimi i tij, të drejtat dhe kufizimet për huamarrjen, garancitë dhe format e tjera të rrjedhura prej tyre si dhe kontrolli, kontabiliteti, raportimi, përgjithësisht janë kryer në respektim të kërkesave të Kushtetutës dhe ligjeve.*

Përgjatë këtij Raporti, kemi shprehur vlerësim për përpjekjet e qeverisë, shoqëruar me kërkesën për ndërhyrje dhe ndjekje të rekomandimeve të KLSH-së, të cilat synojnë ngritjen dhe konsolidimin e një sistemi modern dhe të integruar të menaxhimit financiar, rritjen e përgjegjshmërisë, transparencës dhe qëndrueshmërisë afatgjatë të financave publike në përputhje me direktivat e integrimit të Bashkimit Evropian.

Raporti u përgatit, duke u bazuar në orientimet e Strategjisë "Për Menaxhimin e Financave Publike 2014-2020", sipas të cilës "*Ndërsa përgjegjësia e përgjithshme për mbikëqyrjen e zbatimit të reformave i takon Ministrisë së Financave, Strategjia e MFP-së përfshin të gjithë sektorin qeveritar, Kontrollin e Lartë të Shtetit dhe Parlamentin. Kështu, përgjegjësia e përgjithshme për zbatimin e suksesshëm të Strategjisë ndahet midis të gjithë aktorëve të sektorit publik*"[7].

Për zbatimin e buxhetit 2014, janë audituar 129 institucione shtetërore dhe ndërmarrje me pronësi shtetërore si dhe është audituar performanca e 38 institucioneve shtetërore. Si rezultat i këtyre auditimeve, kemi konstatuar një dëm ekonomik në shumën prej **108,8 miliardë lek** ose **777 milionë euro**, ndërsa të dhënat për detyrimet debitore në fund të vitit 2014 arrijnë në vlerën **110,6 miliardë lek** ose **790 milionë euro**. Kemi evidentuar

[4] Autoret Barry Potter dhe Jack Diamond, Manuali "Per menaxhimin e Shpenzimeve Publike", Pjesa e 4-t, Ekzekutimi i Buxhetit", FMN, ribotim, viti 2012;

http://www.imf.org/external/pubs/ft/expend/guide4.htm

[5] Kodi i Transparencës Fiskale, FMN, 2014, http://blog-pfm.imf.org/files/ft-code.pdf

[6] "Parimet e Qeverisjes Buxhetore", OECD, Paris, 2014, http://www.oecd.org/gov/budgeting/Draft-PrinciplesBudgetary-Governance.pdf

[7] Strategjia "Për Menaxhimin e Financave Publike 2014-2020", faqe 79

shkelje të ligjshmërisë jo në përputhje me parimet e 3 E (ekonomicitetit, efiçiencës dhe efektivitetit), të cila kanë sjellë efekt negativ financiar në të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit në vlerën **27,4 miliardë lekë** ose **195 milionë euro** (të gjitha shifrat e mësipërme do të kërkonin shumë me tepër se 20 minuta kohë për t"u analizuar). *(Shih Raportin faqe 273-274, Aneks 2 dhe Aneks 3).*

1 – Besueshmëria

A - Mbi ndërhyrjet gjatë zbatimit të Buxhetit

Buxheti është një kontratë midis qytetarëve dhe qeverisë, besueshmëria e të cilit bazohet mbi qëndrueshmërinë e tij. Gjykojmë, se referuar parimeve të FMN dhe OECD, ndryshimet që reflektohen nga miratimi i Akteve Normative e cënojnë kredibilitetin e buxhetit. Shkak i këtyre ndërhyrjeve është praktika e programimit me tregues tejet optimistë, pa një proces të kujdesshëm dhe pa monitorimin e duhur nga strukturat në qendër dhe në bazë. Ndryshimi në zërat buxhetorë, niveli i lartë i detyrimeve si dhe mundësia e qeverisë për të shkurtuar zëra të caktuar janë tregues të kredibilitetit të ulët. Kemi kërkuar përmirësimin e procesit të programimit të buxhetit në drejtim të garantimit të kredibilitetit të tij, nëpërmjet edhe një politikë fiskale të qëndrueshme, në respekt të plotë të objektivave fiskalë afat mesëm. Duhet të përcaktohen objektiva fiskalë të qartë, që u lehtësojnë njerëzve të kuptuarit e kursit të qeverisë për politikat fiskale në të gjithë ciklin ekonomik. Vetëm kështu buxhetimi shndërrohet në gur themeli në arkitekturën e besimit mes Shtetit dhe qytetarëve të tij. Konsultimi me shoqërinë civile e ndihmon procesin dhe e përshpejton arritjen e një buxheti kredibël.

B - Mbi defiçitin buxhetor

Sinjal alarmi për Qeverinë por dhe për këtë Komision të nderuar, duhet të jetë niveli i lartë i Defiçitit Buxhetor. Për vitin 2014, defiçiti buxhetor rezultoi 72,1 miliardë lek, kundrejt 66,9 miliardë lek të një viti më parë, pra me rritje 5,2 miliardë lek. Ky nivel defiçiti rezultoi më i lartë se shpenzimet kapitale për 13,6 miliardë lek, duke shkelur rregullin e artë të buxhetit, sipas të cilit masa e defiçitit buxhetor nuk mund të kalojë masën e shpenzimeve kapitale të parashikuara në Ligjin e Buxhetit Vjetor. Duke pasur parasysh ndikimin negativ që ka një nivel në rritje i defiçitit buxhetor në ecurinë ekonomike, veçanërisht në rritjen e borxhit në periudhën afatgjatë, kemi kërkuar nga Ministria e Financave një përqasje të kujdesshme dhe vëmendje maksimale, për të gjetur vazhdimisht në këto vite mënyrën për mbajtjen e defiçitit në nivele të kontrollueshme. Si qasje propozojmë tkurrjen e kujdesshme të shpenzimeve buxhetore, duke synuar eliminimin e shpenzimeve që nuk përbëjnë vlerë të shtuar për financat publike, shoqëruar me masa për përmirësim të ndjeshëm të administrimit tatimor dhe doganor.

C - Mbi menaxhimin e borxhit publik

Auditimi i treguesve të borxhit publik dhe menaxhimit të tij është një nga drejtimet kryesore të auditimit për zbatimin e buxhetit faktik. Për vitin 2014 konstatojmë se borxhi publik në fund të vitit 2014 rezultoi në 69.16 % të PBB-së dhe, duke shtuar edhe mbështetjen buxhetore me kredi nga Banka Botërore dhe FMN, ky borxh arrin në 71.76% të PBB-së.

Si KLSH, në përputhje me kërkesat e Strategjisë "Për Menaxhimin e Financave Publike 2014-2020", i kemi rekomanduar në mënyrë të përsëritur Ministrisë së Financave dhe Kuvendit marrjen e masave për hartimin e një kuadri rregullator fiskal, i cili të synojë reduktimin e nivelit të borxhit publik në nivele të përcaktuara qartë, në mënyrë që brenda një periudhë 3 vjeçare të sigurohet që treguesi i borxhit publik të arrijë në nivelin 60% të PBB-së. Kjo kërkon paraqitjen e një nisme ligjore për vendosjen në Kushtetutë dhe në Ligjin "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të niveleve të pranueshëm të borxhit publik ndaj PBB-së, bazuar në kushtet makroekonomike të vendit.

Për një menaxhim efektiv të borxhit, kemi rekomanduar që:

a) Ministri i Financave në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, të kryejë një analizë të thelluar të situatës, me synim evitimin e humbjes së besueshmërisë së vendit ndër kreditorët e huaj.

b) vendimmarrjet për marrjen përsipër të detyrimeve financiare nga Republika e Shqipërisë, të jenë vendimmarrje politike që sigurohen nëpërmjet ratifikimit të tyre në Kuvendin e Shqipërisë.

Kemi kërkuar po ashtu orientimin në drejtim të titujve qeveritarë me afat të gjatë maturimi, të cilët përmirësojnë strukturën e borxhit të brendshëm dhe reduktojnë riskun e rifinancimit.

Me synim kontrollin e risqeve të portofolit dhe mirëmenaxhimin e riskut të kursit të këmbimit, kemi rekomanduar që prioritet të jetë mbajtja nën kontroll e borxhit të jashtëm duke vendosur një tavan vjetor për totalin e borxhit të jashtëm brenda borxhit publik, në përputhje me strategjinë afatmesme të menaxhimit të borxhit publik.

D - Investimet kapitale dhe përdorimi i Letër Kredisë (LC) në realizimin e tyre

Investimet kapitale janë realizuar në shumën 60,7 miliardë lek, ose 92% të planit, duke regjistruar 4,7 miliardë lek investime më pak se një vit më parë. Si investimet e brendshme dhe ato me financim të huaj janë realizuar më pak se plani.

Në çeljen e fondeve për investime kapitale në fillim të vitit (me shkresën nr.2112, datë 18.02.2014) ka ndodhur një ngurtësim nga Ministria e Financave, shkak për të cilin

investimet me financim të brendshëm u zhvendosën në 3 muajt e fundit të vitit, duke arritur nivelin më të lartë në muajin dhjetor.

Kjo situatë është shoqëruar edhe me përdorimin e Letër Kredisë, si një formë e realizimit të investimeve publike. Letër Kredia ka sjellë ngurtësimin e fondeve në llogarinë e institucioneve shtetërore, në një bankë të nivelit të dytë, për llogari të operatorëve ekonomikë. Ky ngurtësim që kap vlerën e 3,4 miliardë lekëve, në masën e plotë të shpenzimit/investimit dhe në kushtet kur punimet/shërbimet dhe mallrat nuk janë realizuar, është jo vetëm përdorim i një instrumenti të parregulluar në praktikat buxhetore, por dhe në shkelje të parimeve të anualitetit, transparencës dhe besueshmërisë, pasi janë referuar në treguesit fiskalë. Arsyetimi i këtij parapagimi me "mos-djegien" e fondeve, në favorizim të operatorëve privatë, duke krijuar hapësira për zbehje të kontrollit buxhetor dhe rregullave të menaxhimit dhe kontrollit financiar, është një përpjekje për të ndryshuar realitetin.

Në lidhje me ketë dhe instrumentet e tjerë financiarë/bankarë që përdoren nga sektori publik, kemi rekomanduar që Ministria e Financave të bëjë rregullimet e tyre, duke përcaktuar qartë përdorimin dhe duke mos lënë hapësira interpretimi. Deri në një rregullim të plotë ligjor të tyre, përdorimi i këtyre instrumenteve bankare në zbatimin e buxhetit(duke patur parasysh edhe koston e 3 përqind te interesit) duhet të minimizohet.

Konstatuam se shpenzimet kapitale si fonde të kushtëzuara, nëpërmjet Fondit të Zhvillimit të Rajoneve, për vitin 2014, janë realizuar në shumën e 8.4 miliardë lek me një rritje prej 6.4 miliardë lek krahasuar me vitin 2013. Nëse do të vijohet me një rritje të fondeve të programuara nën këtë zë, duke pasur parasysh përdorimin e tyre me një shtrirje më të gjatë se viti buxhetor, si dhe faktin e një monitorimi të vështirë për shkak të natyrës dhe ndarjes së përgjegjësive në disa institucioneve të përfshira në këtë proces, kjo kategori duhet të trajtohet konform kritereve të alokimit dhe ndjekjes së shpenzimeve kapitale. Sjell në vëmendje shqetësimin edhe të Ambasadorit të SHBA-ve Donald Lu, i cili pak ditë më parë u shpreh: "*I kemi kërkuar qeverisë qendrore të investojë drejtpërdrejtë tek qeveritë vendore, në vend të fondeve rajonale të zhvillimit, të cilat ndeshen me rrezikun e përdorimit për financimin e kryetarëve të bashkive të PS-së dhe LSI-së dhe mohimin e fondeve për kryetarët e bashkive të opozitës*".[8]

[8] Donald Lu, fjala e mbajtur në Konferencën Kombëtare të Qeverisjes Vendore, tetor 2015, http://www.oranews.tv/vendi/lu-fondet-rajonale-te-zhvillimit-ndeshen-me-rrezikun-e-financimit-te-bashkive-pslsi/

E - Mbi pasqyrat financiare të konsoliduara të shtetit

Nga auditimi në Ministrinë e Financës konstatohet mungesë e një baze të unifikuar të mbajtjes së kontabilitetit, adresime të ndryshme të përgjegjësisë, si dhe pasqyra financiare që nuk pasqyrojnë gjendjen reale të pasurisë së shtetit. Mungesa e pasqyrave të konsoliduara të shtetit, ndikon jo vetëm në nivelin e transparencën, por është e lidhur ngushtësisht me ndjekjen e kujdesshme të financave publike dhe analizën e treguesve makroekonomikë.

Në "Strategjinë për Menaxhimin e Financave publike 2014-2020" theksohet se: *"Një parakusht për raportim të mirë është kontabilizimi i saktë. Gjatë periudhës së planifikuar 7-vjeçare, standardet e kontabilitetit do të rishikohen [..] drejt IPSAS, pasi këto të jenë miratuar përfundimisht,çka mund të ndodhë vetëm në periudhën e ardhshme të planifikimit"*, ndërkohë që në vijim të po kësaj strategjie flitet për EPSAS[9] jo për IPSAS[10].

Nisur nga situata reale, ku regjistrimet kontabël bazohen mbi gjykime individuale të pakontrolluara dhe të pa orientuara nga specifika të lidhura me sektorin publik, kur nuk ka programe të njëjta kontabël në përpunimin e të dhënave dhe përpunimin e informacionit kontabël, kur niveli i kapaciteteve që regjistrojnë transaksionet financiare është larg kërkesave të një administrate të zhvilluar, strategjia për të kaluar në EPSAS, standarde të patestuara akoma në vende ku kontabiliteti publik është i konsoliduar, mund të cilësohet pa frikë një sipërmarrje jo realiste, për të mos thënë futuriste. Kemi kërkuar disa ndërhyrje në këtë drejtim, që të publikohen menjëherë nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit Publik IPSAS, si baza kryesore metodologjike mbi të cilën do të hartohen pasqyrat financiare të shtetit. Kemi rekomanduar të ngrihet një drejtori e veçantë, brenda Drejtorisë së Thesarit, që të mundësojë përshtatjen e pasqyrave të nxjerra nga sistemi i integruar në formën e Pasqyrave të Konsoliduara të Shtetit. Kjo drejtori duhet të ketë si funksion edhe kontrollin e saktësisë së pasqyrave të përgatitura nga institucionet publike, për të vënë nën monitorim këtë proces të rëndësishëm.

Ministria e Financave të hedhë për diskutim në nivele teknike draft-ligin "Për Kontabilitetin Publik", duke plotësuar kuadrin rregullator të nevojshëm për të arritur në një cilësi të caktuar të raportimit financiar në sektorin publik. Duke vlerësuar faktin se përqendrimi i reformave vetëm në sistemet kontabël rrit riskun e limitimit të përfitimeve që këto reforma ofrojnë, kërkohet që paralelisht të ndërmerren edhe reforma në procesin e buxhetimit.

[9] EPSAS - Standardet Europiane të Kontabilitetit të Sektorit Publik

[10] Strategjia është miratuar me VKM nr.50 datë 05.2.2014

F - Mbi auditimin e detyrimeve të prapambetura

Kemi vlerësuar dhe mbështetur vendimmarrjen e qeverisë, në fillim të vitit 2014 "*Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit*"[11], vendimmarrje që i është përgjigjur shqetësimit në rritje që ky nivel detyrimesh impaktonte frenimin e zhvillimit ekonomik si dhe reflektonte rekomandimet e KLSH në dy vitet e fundit. Nga auditimi i realizuar për ekzekutimin e kësaj strategjie, kemi konstatuar shifra të ndryshme në raportime të ndryshme duke vënë ndonjëherë, në diskutim vetë vlerën e deklaruar si borxh i fshehur ndaj biznesit dhe duke na çuar në opinionin se për hartimin e Strategjisë Qeveria Shqiptare ka marrë në konsideratë një shifër jo reale, e cila nuk është saktësuar dhe vazhdon të jetë akoma e paqartë.

Konstatuam se mungon një bazë e plotë të dhënash dhe mënyra e mbajtjes ka ekspozuar këtë database nga risku operacional, gjithashtu mungon gjurma e monitorimit të këtij procesi si dhe nuk janë ruajtur prioritetet e pagesave sipas përcaktimeve të strategjisë, kurse përllogaritja e stokut të detyrimeve të prapambetura mbeti pa një shifër të konfirmuar. Për vitin 2014 FMN ka disbursuar vlerën totale prej 7.4 miliard lek, për të ulur detyrimet e prapambetura, ndërkohë që shlyerja e detyrimeve është realizuar në fund të vitit 2014 në vlerën 33 miliardë lek. Vetëm 29% e totalit të fondeve është alokuar për shlyerje të detyrimeve të prapambetura lidhur me kontrata investimesh, 38% ka lidhje me uljen e borxhit tatimor (TVSH dhe Tatim Fitimi), ndërsa 33% janë detyrime të lidhura me mallra dhe shërbime apo vendime gjyqësore, detyrime për personat me aftësi të kufizuar. Përfshirja e detyrimeve për vendime gjyqësore për largime nga puna në strategjinë e detyrimeve të prapambetura nuk i shërben objektivit për të cilin kjo strategji u hartua. Procesi i shlyerjes së detyrimeve të prapambetura ka ndjekur një linjë të shpërndarjes së përgjegjësisë deri në nivelin më të ulët manaxherial ndërsa kontrolli dhe monitorimi ka qenë përgjithësisht një formalitet pa gjurmë auditimi. Nuk është zbatuar parimi FIFO[12], pasi likuidimet e detyrimeve janë kryer në renditje rastësore. Kemi rekomanduar që Ministria e Financave të nisë një mision verifikimi, për saktësimin e detyrimeve të klasifikuara dhe të raportuara si detyrime të prapambetura, shoqëruar me masa konkrete për të përcaktuar shumën e detyrimeve që do të përfitojnë nga strategjia e hartuar nga Qeveria Shqiptare në mënyrë të saktë, transparente, të besueshme dhe të përcaktohet gjurma e auditimit. Nga ana e Komitetit të Detyrimeve të Prapambetura duhet të rritet niveli i mbikëqyrjes, duke marrë përsipër përgjegjësitë për kontrollin dhe monitorimin e procesit të shlyerjes së detyrimeve të prapambetura.

[11] Strategjia është miratuar me VKM nr.50 datë 05.2.2014

[12] Parimi "I pari në hyrje, i pari në dalje"

H. Mbi krijimin e një administrate qendrore fiskale

Nisur nga konstatimet por dhe pamundësia e ndjekjes së detyrimeve të subjekteve për shkak të mos bashkëpunimit ndërinstitucional midis Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, por edhe për shkak të pamundësisë së vlerësimit të drejtë të vetë deklarimeve për nivelin e aktivitetit të realizuar nga ana e subjekteve private, për shkak të ndjekjes dhe kontrollit të veçuar nga dy administrata të ndryshme, rekomandojmë që Qeveria, t'i kthehet idesë që debatohet si në praktikat botërore por edhe në ekspertizën brenda vendit, për krijimin e një Administrate Qendrore Fiskale (shkrirjen nën një administrim të tatimeve dhe doganave), duke synuar edhe një kontroll të përqendruar lidhur me sigurimin e të ardhurave tatimore të shtetit. Një administrim i përbashkët gjykojmë se do të ketë edhe efekte kursimi në kostot operacionale, sidomos në Drejtoritë Rajonale, kontributi i të cilave nuk është i lartë, krahasuar me kostot e aktivitetit të tyre. Ne si KLSH, do të synojmë që brenda 6 mujorit të parë të vitit 2016 të kryejmë një auditim performance në këtë drejtim.

I. Mbi performancën e Auditimit të Brendshëm

Standardi i auditimit publik suprem te jashtëm INTOSAI GOV 9150 "Koordinimi dhe bashkëpunimi mes institucioneve supreme të auditimit dhe audituesve të Brendshëm në sektorin publik" e kërkon në mënyrë eksplicite forcimin e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit mes auditimit të brendshëm dhe atij të jashtëm publik, si "dy kahe të të njëjtit skud mbrojtës të financave publike[13]".

Miratimi i Ligjit të ri "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" dhe kuadrit sekondar rregullativ do të ketë një efekt rivitalizues në funksionet e auditimit të brendshëm. Theksojmë se modernizimi i funksioneve të auditimit të brendshëm është një nevojë imediate, kjo për faktin se sa më efektive të jenë strukturat e auditimit të brendshëm aq më shumë i jepet mundësia Kontrollit të Lartë të Shtetit të orientoje dhe fokusojë veprimtarinë audituese drejt auditimeve të performancës. Përmirësimet ligjore të realizuara i konsiderojmë të rëndësishme por kërkojmë që ato të jenë të qëndrueshme, në mënyrë që kjo bazë të mos preket sa herë kërkohet nga politika.

Konstatojmë, në opinion të përgjithshëm, se pavarësisht përpjekjeve të bëra për reformimin në drejtim të forcimit dhe aftësimit profesional të burimeve audituese, njësitë e Auditimit të Brendshëm, janë ende larg pozicionimit të tyre si partnerë të

[13] Standardi INTOSAI GOV 9150 "Koordinimi dhe bashkëpunimi mes SAI-ve dhe Audituesve të Brendshëm", INTOSAI, http://www.intosai.org/issai-executive-summaries/view/article/intosai-gov-9150-coordination-andcooperation-between-sais-and-internal-auditors-in-the-public-s.html

besueshëm. Auditimi i brendshëm kryen auditim "bazuar në transaksione" dhe i duhet shumë punë për t'u orientuar drejt metodave dhe teknikave moderne të auditimit, sikurse është qasja e auditimit "bazuar në sisteme". Rekomandojmë si domosdoshmëri, kalimin e punës së Auditimit të Brendshëm drejt qasjes "bazuar në sisteme", duke e shoqëruar me Programin e zhvillimit të vazhdueshëm profesional, me synim forcimin e kapaciteteve dhe rritjen e cilësisë së veprimtarisë.

2 – Përgjegjshmëria

Mbi auditimin e sektorit energjetik

Sektori energjetik, si një prej sektorëve strategjikë në vend ka qenë në fokus të veprimtarisë dhe angazhimit të burimeve të auditimit nga KLSH, në funksion të dhënies së opinionit për menaxhimin e këtij sektori nga qeveria dhe adresimit njëherazi të rekomandimeve dhe masave për përmirësimin e situatës. Opinioni ynë është bazuar në auditimet në Ministrinë e Industrisë dhe Energjetikës, në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), në Korporatën Energjetike Shqiptare (KESH) sh.a, në Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë (OSHEE) sh.a, dhe në Albpetrol sh.a.

Për auditimin e ushtruar nga KLSH mbi procedurën e ndjekur në dakordësimin e kushteve të marrëveshjes *"Për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë CEZ a.s"*. Grupi i punës i kryesuar nga Z.Ministër, më datë 23.6.2014, arriti të nënshkruajë marrëveshjen e zgjidhjes me mirëkuptim d*uke u dakordësuar për marrëveshjen, angazhimet dhe premtimet e Palëve në këtë Marrëveshje:*

- *Transferimin e aksioneve të CEZ a.s, Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga MZHETS, për 1/euro;*
- *CEZ Shpërndarje sh.a, do t'i paguajë CEZ a.s, shumën totale prej 94,999,999 euro, shumë që do të përdoret për të shlyer Huat e Arkëtueshme të BERZH/KFN dhe Kërkesat e Arkëtueshme që anëtarët e Grupit CEZ, pretendojnë.*

Kemi audituar vetëm procedurat e ndjekura dhe negociatat që sollën në përgatitjen e marrëveshjes së nënshkruar më datë 23.06.2014, nga Grupi i Punës i ngritur në bazë të VKM nr.969 dt. 25.10.2013 *"Për ngritje e grupit të punës për zgjidhjen me mirëkuptim të mosmarrëveshjes ndërmjet Shtetit Shqiptar dhe CEZ a.s",* përcjelljen për miratim në Këshillin e Ministrave dhe Kuvendin e Shqipërisë. Përfundimet tona janë bazuar në vlerësime dhe referenca në dokumente të institucioneve të ndryshme të Shtetit Shqiptar, korrespondenca ndërmjet institucioneve shtetërore, raporte të audituesit të pavarur ndërkombëtar apo të konsulentit ligjor të kontraktuar nga Shteti Shqiptar, kjo bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI 400, ISSAI 300, ISSAI 1500, ISSAI 200, ISSAI 1610, ISSAI 1620. Auditimi mbi të dhëna dytësore (pra jo burimi primar i

informacionit), vjen si rezultat i pamundësisë që kishte KLSH për të audituar dokumentacion financiar dhe ligjor të kompanive me kapital aksioner private (76% e aksioneve të CEZ Shpërndarje sh.a, kishin pronësi private) apo kompanive private të cilat u krijuan gjatë aktivitetit të CEZ a.s, në Shqipëri (CEZ Trade dhe CEZ Albania), pasi në referencë të Kushtetutës të nenit 163/germa c *"Kontrolli i Lartë i Shtetit kontrollon veprimtarinë ekonomike të personave juridikë, në të cilët shteti ka më shumë se gjysmën e pjesëve ose të aksioneve, ose kur huat, kreditë dhe detyrimet e tyre garantohen nga shteti".*

Kemi konstatuar se nuk ka asnjë dokumentacion financiar apo dhe juridik (kontrata), provë shkresore që do të na krijonte bindje të arsyeshme që nga grupi negociator është vepruar në mbrojtje të interesave të Shtetit, dhe përmbushja e pretendimeve të mësipërme është bazuar në fakte dhe dokumente. Mënyra se si u arrit në këtë vendimmarrje, mbledhjet e zhvilluara prej tij në Shqipëri, diskutimet në to si dhe arsyetimet e kundërshtimet në lidhje me pretendimet apo kundër pretendimet e palës shqiptare përballë asaj të CEZ a.s, nuk evidentohen në asnjë dokumentacion si procesverbal mbledhjeje të këtij grupi pune, apo ndonjë formë tjetër të përcaktuar nga grupi i punës. Për rrjedhojë, në kushtet kur ky grup negocimi, nuk ka dokumentuar asgjë në lidhje me punën dhe negociatat e zhvilluara prej tij me përfaqësuesit e CEZ a.s, vihen në diskutim negociatat që ky grup ka bërë (për rreth 6 muaj) në mbrojtje të interesave dhe pretendimeve të Shtetit Shqiptar. Në këto kushte Detyrimi i marrë përsipër nga shteti, në kushtet kur nuk ka evidenca dhe mungon dokumentimi i plotë i shpenzimit për llogari të CEZ Shpërndarjes sh.a, si dhe në kushtet kur konstatohet se në marrëveshje është theksuar fakti se "Blerësi pranon dhe bie dakord që Shitësi nuk jep asnjë siguri ose garanci, të shprehur ose të nënkuptuar, në lidhje me ndonjë çështje që lind në lidhje me Shoqërinë dhe/ose Aksionet dhe/ose transaksionet e referuara këtu, duke përfshirë vlerën e Shoqërisë, gjendjen e saj financiare, lejet, përbën dëm ekonomik, vlerësuar në shumën 479 milionë euro i përbërë:

Në vlerën 95 milionë euro për pagesë e dakordësuar në marrëveshje, të pabazuar në dokumentacion financiar për përdorimin e kredive dhe huave dytësore, apo njohje të drejtash nga CEZ Shpërndarje sh.a.

Në vlerën 352 milionë euro, si marrje përsipër të mbulimit të diferencës midis detyrimeve afat-shkurtra të njohura dhe të drejtave afat-shkurtra të pranuara (mungesa në kapitalin qarkullues) të shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a, bazuar në raportin financiar të ekspertit ndërkombëtar të kontraktuar nga shteti.

Në vlerën 32 milionë euro, për zerimin në vlerë të 24% të aksioneve shtet në CEZ Shpërndarje sh.a. Ky pretendim do të ishte për diferencën ndërmjet vlerës së aksioneve të Qeverisë Shqiptare gjatë privatizimit (CEZ A.S ka paguar 102 milionë euro për të kontrolluar 76% të paketës së operatorit të shpërndarjes, moment kur vlera e 24% të

aksioneve të shteti shqiptar ishte 32 milionë euro) dhe vlerës zero të aksioneve të saj më 21 janar 2013.

Në këtë vlerësim dëmi, janë marrë parasysh shumat saktësisht të përcaktuara dhe është abstraguar nga kosto shtesë e nevojshme për të rivitalizuar dhe kthyer në parametra normalë aktivitetin dhe rrjetin e keqadministruar nga CEZ a.s.

Në Marrëveshjen për Zgjidhjen me Mirëkuptim, të propozuar për miratim, janë parashikuan dhe dakordësuar edhe çështje të tjera, nëpërmjet të cilave evidentohet qartazi pabarazia dhe favorizimi i interesave të CEZ a.s. në shpërfillje të plotë të interesave dhe pretendimeve të ligjshme të Shtetit Shqiptar, por për këtë, bazuar në kërkesën dërguar Kuvendit me shkresën Nr. 118/14 Prot, datë 17.10.2015, presim të flasim në Kuvendin e Shqipërisë.

Mbas kallëzimit penal për shpërdorim detyre ndaj Ministrit të MEI dhe Avokatit te Shtetit, rekomandimi ynë është ngritja e një komisioni ad-hoc të pavarur, me ekspertë teknikë dhe ekonomikë, të cilët do të vlerësojnë me saktësi dëmin nga aktiviteti nën administrimin e CEZ a.s dhe do të përcaktonin rrugët për rimëkëmbjen e OSHEE-s.

Ne i kemi rekomanduar Kuvendit të Shqipërisë:

Ngritjen e një komisioni ad-hoc të pavarur, me ekspertë teknikë dhe ekonomikë, të cilët do të vlerësonin realisht dhe me saktësi dëmin nga aktiviteti nën administrimin e CEZ a.s, si dhe do të përcaktonin mundësinë më të mirë për një rimëkëmbje të Operatorit të Shpërndarjes mbi baza të monitorimit të kujdesshëm të të gjithë treguesve për periudhën e tanishme, duke përcaktuar në çdo rast përgjegjësitë individuale dhe institucionale për të gjithë aktorët që lejuan këtë situatë me të cilën financave publike u shtohet një dëm me efekte në periudhë afatshkurtër dhe afatgjatë. Të kërkohet një disiplinë e fortë financiare dhe një kontroll i vazhdueshëm nga Kuvendi, për çdo investim dhe vendimmarrje strategjike lidhur me Operatorin e Shpërndarjes, për të mundësuar me hapa konkretë përmirësimin e gjendjes së verifikuar.

Rekomandojmë që auditimi i shoqërisë në vijimësi të bëhet nga një auditues i përcaktuar nga Kuvendi, duke shtuar edhe detyrimin që të raportojë në një seancë publike për gjetjet dhe konkluzionet e misioneve të përfunduara.

Nga auditimi në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) dhe në Albpetrol, kemi konstatuar dështimin e misionit mbikëqyrës të MEI, AKBN dhe AlbPetrol në miradministrimin e burimeve të naftës, një prej pasurive kryesore natyrore që kemi. Evidentuam faktin që gjendja paraqitet e rëndë dhe jashtë kontrollit shtetëror, ndërkohë që burimet e naftës përdoren pa kriter dhe pasojat në ekonomi dhe në jetën e banorëve të zonave në shfrytëzim, janë të rënda dhe të pamatshme.

Kemi vërejtur se kompanitë koncesionare që zbatojnë marrëveshjet hidrokarbure (MH) dhe lejet e marrëveshjeve hidrokarbure (LMH), kanë mbajtur Faktorin "R" (raportin midis të ardhurave dhe shpenzimeve) gjithnjë në tejkalim të shpenzimeve(pra "R" më e vogël se 1), ndonëse sasia e naftës së nxjerrë ka qenë në rritje dhe rrjedhimisht të ardhurat duhet të tejkalojnë shpenzimet. Kjo ka ndikuar drejtpërsëdrejti në uljen drastike të detyrimeve financiare që këto kompani koncensionare kanë ndaj Shtetit Shqiptar.

Nga auditimi i MH dhe LMH për vendburimin Patos – Marinëz, (i cili jep rreth 97% të prodhimit të naftës në vendin tonë, dhe për rrjedhojë ka ndikim në ekonominë dhe financat e Shtetit), nga fillimi i aktivitetit të kompanisë koncesionare deri më sot (gati 8 vjet), Faktori R është mbajtur gjithnjë në nivelet R<1. Kemi evidentuar se për shkak të operacioneve të caktuara hidrokarbure[14], si rezultat i mosdeklarimit të të ardhurave, janë krijuar hapësira për evazion fiskal**,** pa llogaritur ndikimin e këtij evazioni në tregun brenda vendit dhe në deformimin e tij.

Nga ana tjetër, janë konstatuar shpenzime të pajustifikuara, të cilat kanë rënduar në mënyrë fiktive kostot e operacioneve hidrokarbure. Pas rillogaritjeve të kryera, referuar raportit të ardhura-shpenzime, rezulton se të ardhurat tejkalojnë shpenzimet, pra R>1, me efekt dëmin ekonomik në rreth **15 miliardë lek** (ose 120 milionë USD), shumë për të cilën KLSH ka kërkuar marrjen e masave për të derdhur detyrimet në favor të financave të Shtetit.

Duke pasur parasysh rëndësinë e sektorit te hidrokarbureve për ekonominë e vendit dhe sigurinë kombëtare, i kemi paraqitur strukturave më të larta shtetërore një platformë me rekomandime për reformimin dhe forcimin e kontrollit shtetëror në këtë sektor. Kemi kërkuar që, në rast të riaktivizimit të procedurave të privatizimit të AlbPetrol apo dhe në procedura të tilla të ngjashme në sektorin e hidrokarbureve, autoritetet shtetërore përgjegjëse të sigurohen të përfshijnë në këto procese, me përparësi të lartë, kompani me potenciale dhe kredenciale të larta profesionale nga aleatët strategjikë të vendit tonë (veçanërisht kompani me traditë të konsoliduar në këtë sektor, si nga SHBA, Mbretëria e Bashkuar apo Gjermania), si dhe të mundësojnë arritjen e transparencës reale të kompanive ofertuese pjesëmarrëse në garë. Në këtë mënyrë, vendi ynë do të siguronte jo vetëm përfitime ekonomike dhe financiare, por edhe politike.

Kemi rekomanduar dëmshpërblimin e banorëve të fshatit Marinzë për dëmet nga shpërthimi i fontanës, si dhe ringritjen e Institutit Shkencor të Naftës, si një institut i mirëfilltë shkencor, i cili të mbështesë të gjitha vendimmarrjet e lidhura me zhvillimin e

[14] Përdorim holluesi i pakonvertuar si naftë.

sektorit të hidrokarbureve në vendin tonë si dhe të bashkëpunojë me Kuvendin dhe qeverinë lidhur me hartimin e strategjive afatmesme dhe afatgjata të zhvillimeve në këtë sektor, duke bërë dhe rolin e oponentit teknik gjatë negocimit të marrëveshjeve, shqyrtimit të propozimeve dhe zhvillimit të operacioneve hidrokarbure.

• Ndërsa nga auditimet e kryera në KESH sh.a, KLSH ka evidentuar shkelje të akteve ligjore dhe nënligjore me një dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën rreth 139.8 milionë lek dhe një të ardhur të munguar për shoqërinë në vlerën 5,7 miliardë lek. Gjithashtu, kemi konstatuar se gjatë vitit 2014, kompania KESH sha. nuk ka shlyer asnjë detyrim për marrëveshjet e nënhuasë. Theksohet se problematika e shlyerjes së detyrimeve vazhdon të jetë për shkak të situatës së rënduar financiare dhe mungesës së likuiditeteve (nuk shlyen detyrimet ndaj Ministrisë së Financave duke filluar nga 6/mujori i dytë i vitit 2011 e në vijim). Vetëm për kompaninë KESH sh.a. gjatë vitit 2014 janë paguar nga buxheti i shtetit 23.5 milionë euro dhe janë rimbursuar rreth 5.7 milionë euro, duke bërë që detyrimet neto të kompanisë të jenë 17.7 milionë euro. KESH-sh.a ka të çelura rreth 190.5 milionë euro linja overdrafti me garanci shtetërore në bankat e nivelit të dytë dhe 73 milionë euro linja kredie pa garanci shtetërore. Në vlerësimin tonë, kemi rekomanduar që mbulimi i nevojave financiare të KESH sh.a. për blerje energjie nuk duhet të vazhdojë të jetë huamarrja, ashtu siç është vepruar deri tani, por të synohet rregullimi i marrëdhënieve financiare brenda sektorit të energjisë dhe shlyerja e detyrimeve ndërmjet tyre. Ministria e Financave mund të nisë dhe ndihmojë në një proces negocimi me kreditorët për rishikimin e termave dhe kushteve të portofolit të overdrafteve.

• Nga auditimi në Shoqërinë "Operatori i shpërndarjes së energjisë elektrike (OSHEE) sh.a, Tiranë, për periudhën nën administrimin e përkohshëm, u konstatuan shkelje të akteve ligjore dhe nënligjore me një dëm ekonomik në vlerën 4.5 miliardë lek, ose 32 milionë euro, si dhe të ardhura të munguara për shoqërinë OSHEE, në vlerën 124 milionë lek, ose 891 mijë euro.

Dëmi i konstatuar ka rezultuar nga blerja e energjisë elektrike me çmime më të larta se ato të tregut, në vlerën 1,357 milionë lek ose 9,7 milionë euro. Kemi konstatuar mbifaturim të konsumatorëve me pasojë uljen artificiale të humbjeve teknike. Nëpërmjet uljes artificiale të humbjeve teknike, është shkaktuar një dëmtim i interesave të ligjshme të shoqërisë "KESH" sh.a dhe Buxhetit të Shtetit për 2014, në vlerën 1,547 milionë lek, ose 11 milionë euro. Konkretisht, për vitin 2014 u konstatua se në mënyrë artificiale janë ulur humbjet teknike, veprim i cili është kryer me fatura të dyshimta (mbifaturim, keqfaturim, faturim të abonentëve pa adresë si dhe abonentë që nuk kanë arkëtuar asnjëherë, etj).

Nga auditimi i blerjes së materialeve dhe pajisjeve elektrike nga shoqëria ÇEZ Shpërndarje, përgjatë vitit 2014, rezultoi që është shkaktuar një dëm ekonomik në vlerën 609 milionë lek ose 4,4 milionë euro, si rrjedhojë e shkeljeve të procedurave të tenderimit të vendosura nga ERE në "Rregullore e Prokurimeve të CEZ Shpërndarje sh.a", lidhur me trajtimin e procedurave si raste emergjente, realizimit të tyre me një fazë negocimi, kryerjes së shtesave të kontratave në vlera të konsiderueshme që arrinin deri në 50% apo 70 % të vlerës së kontratës bazë, si dhe blerjes në disa raste të materialeve dhe pajisjeve elektrike pa zhvilluar procedura tenderimi.

Nga auditimi i pjesshëm për shkak të dokumentacionit të mangët ekonomiko-financiar, i disa prej kompanive të mbledhjes së borxhit të energjisë elektrike, rezultoi që këto kompani kanë përfituar padrejtësisht nga CEZ Shpërndarje Sh.a, së paku në vlerën 848 milionë lek ose 6 milionë euro.

Megjithëse kanë kaluar rreth dy vjet, konstatohet se nga ana e METE, sot MZHETS, ende nuk është ndërmarrë asnjë hap konkret për zbatimin e rekomandimit të KLSH për **arkëtimin e garancisë së ofertës** së paraqitur nga shoqëria "Vetro Energy PTE Ltd" në procedurat e privatizimit të shoqërisë "Albpetrol"sha, Patos" në vlerën 85 milionë Euro. Efekti në këtë rast është se rrezikohet seriozisht dhe në mënyrë të pajustifikueshme tejkalimi i afateve përkatëse procedurale të kërkimit dhe arkëtimit të garancisë prej 85 milionë Euro.

Mbi prokurimet publike

Prokurimet publike janë aspekti me vulnerabël dhe një nga fushat me risk të lartë të menaxhimit, dhe ku shkeljet e ligjshmërisë rezultojnë në nivele mjaft të larta. Për këtë arsye, si KLSH kemi investuar në ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve dhe certifikimin e audituesve tanë në Auditimin e Teknologjive të Informacionit dhe në përdorimin e Teknikave kompjuterike në Auditim. Në këtë kontekst, në kuadër të bashkëpunimit me organizatën INTOSAI dhe Nismën për Zhvillim (IDI), KLSH u përfshi gjatë viteve 2014 dhe 2015 në programin "Auditimet Speciale", duke aplikuar njohuritë në auditimin e kryer në APP dhe përdorur për herë të parë teknikat inovative të analizimit dhe vizualizimit të të dhënave.

Nga auditimi pilot i teknologjisë se informacionit, kryer pranë Agjencisë së Prokurimit Publik, por edhe nga gjetjet e konstatuara gjatë auditimeve në zbatim të buxhetit të vitit 2014, konstatuam problematika që kanë cenuar jo vetëm parimet e prokurimit publik, bazuar në rregullat e tregut dhe konkurrencën e lirë dhe të drejtë, por edhe efektivitetin e synuar nga aplikimi i këtij sistemi on-line. Kemi konstatuar se gjatë vitit 2014, janë zhvilluar 4,605 procedura prokurimi për blerjet e mëdha për vlerën e fondit limit prej 43,3 miliardë lek dhe janë shpallur fitues e kanë lidhur kontrata 1,081 operatorë ekonomikë vendas dhe të huaj me vlerën totale të ofertës prej 39,5 miliardë lek.

Panorama e prokurimeve për vitin 2014 e analizuar me teknikat CAAT, nga shtresëzimi i të dhënave sipas kriterit 50% të fondit limit, rezulton se vetëm 3% e prokurimeve zënë 50% të fondit limit (52% të fondit të prokuruar) e sjellin një efektivitet me pak se gjysma e diferencës prej 97% të numrit të prokurimeve me fond limit të njëjtë. Ky indikator tregon se ka përdorim jo efektiv të konkurrencës e jo në çdo rast është arritur vlera më e mirë e parasë, duke ruajtur standardet e ndershmërisë, integritetit, paanshmërisë dhe objektivitetit. Ky fakt dhe analiza e zhvilluar më pas për identifikimin e zonave me risk të lartë, tregon se procedurat e prokurimit publik dhe sistemi i prokurimit elektronik si mjet për realizimin e tyre kanë shumë mangësi dhe zhvillohen nën presionin e interesave për përfitime abuzive. Nga të 481 tenderat e audituar, në 399 prej tyre janë konstatuar 1,254 shkelje të procedurave të prokurimit, duke shkaktuar një dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit në shumën 939 milionë lek ose 6.7 milionë Euro. Nga auditimi i procedurave të prokurimit evidentuam se efektiviteti nga procedurat e prokurimit është i ulët dhe kjo edhe për faktin e mungesës së konkurrencës, ndërkohë që konstatohen raste të marrëveshjeve të fshehta, ku procedura e tenderave të hapur realizohet vetëm me një operator ekonomik.

Nga auditimi i kryer në Drejtorinë e Prokurimeve të Përqendruara pranë Ministrisë së Brendshme, janë evidentuar një sërë parregullsish dhe shkeljesh në procedurat e prokurimeve publike të realizuara, të cilat kanë sjellë një **dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në vlerën 85 milionë lek.** Konstatuam që në procesin e vlerësimit dhe kualifikimit të dokumentacionit të operatorëve ekonomikë (OE) është përdorur standard i dyfishtë në vlerësimin e pjesëmarrësve në tender. Për të njëjtat parregullsi në dokumentacion, KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE me ofertë më të lartë ekonomike dhe ka skualifikuar OE me ofertë më të ulët, ndërkohë që bazuar në kërkesat ligjore duhet të anulonte dhe të përsëriste procedurën e tenderit. Gjithashtu në disa prej procedurave të tenderimit të audituara, Njësia e Prokurimit, në formulimin e kritereve për cilësinë dhe origjinën e mallrave, ka lënë vend për interpretime të gabuara nga KVO. Në procedura të caktuara prokurimi ishin vendosur kritere diskriminuese, duke paracaktuar kështu dhe OE fituese në tender. Në këtë kontekst kemi konstatuar se kjo Drejtori nuk ka arritur të përmbushë objektivat në lidhje me efektivitetin dhe efiçiencën në prokurimin e mallrave dhe shërbimeve.

Nga auditimi në Ministrinë e Arsimit dhe të Sporteve, rezultoi se vetëm për një procedurë prokurimi me objekt "Ndërtimi i objektit, Tirana Olimpik Park" Sekretari i Përgjithshëm i MAS ka ndikuar në vendosjen e kritereve diskriminuese, në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit, duke paracaktuar fituesin e garës, duke i shkaktuar shtetit një kosto shtesë në *vlerën prej 79 milionë lek,* vetëm nga një procedurë.

Në Ministrinë e Mbrojtjes, si rezultat i moszbatimit të kritereve ligjore gjatë zhvillimit të procedurave u konstatua një dëm ekonomik prej rreth 130 milionë lek.

Mbi auditimin në organet e pushtetit vendor

Fushat kryesore të auditimit kanë qenë regjistrimi i pasurive të paluajtshme, legalizimi i ndërtimeve informale dhe dhënia me koncesion e menaxhimi i hapësirave për parkim. Kemi konstatuar një sërë shkeljesh me potencial të lartë korruptiv në trajtimin ligjor të regjistrimit të titujve të pronësisë. Vlera e dëmit ekonomik të rezultuar si rrjedhojë e shkeljeve të dispozitave ligjore në fuqi, në 64 subjektet e audituara të pushtetit vendor, llogaritet në shumën 446 milionë lek ose 3,2 milionë euro, nga të cilat vlera 255 milionë lek ose 1,8 milionë euro përfaqëson mungesë në të ardhura nga qiratë, taksa e ndikimit në infrastrukturë, dhe 191 milionë lek, ose 1,4 milionë euro, në fushën e shpenzimeve buxhetore për investimet.

Mbi antikulturën e papërgjegjshmërisë

Efektshmëria dhe dobishmëria e auditimeve të KLSH-së, qëndron pikërisht në zbatimin korrekt dhe në kohë të rekomandimeve të auditimit nga ana e institucioneve përkatëse shtetërore. Për këtë arsye, jo vetëm Ligji nr. 154/2014 „Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" por edhe Progres Raportet e Komisionit Europian për Shqipërinë, i japin një rëndësi të veçantë rolit të mëpasshëm të Parlamentit, në drejtim të ndjekjes sistematike të auditimeve të KLSH dhe shkallës së zbatimit të rekomandimeve nga ana e institucioneve shtetërore. Paralelisht me këtë opinion, kemi theksuar nevojën imediate të ndërhyrjes dhe ndjekjes së rekomandimeve të KLSH-së, të cilat synojnë ngritjen dhe konsolidimin e një sistemi modern dhe të integruar të menaxhimit financiar, rritjen e përgjegjshmërisë, transparencës dhe qëndrueshmërisë afatgjatë të financave publike në përputhje me direktivat e integrimit të Bashkimit Evropian. Për këtë çështje është shprehur shqetësim dhe në Progres Raportin 2014 të BE-së për Shqipërinë, në të cilin cilësohet se: "Shqyrtimi i raporteve të KLSH mbetet i kufizuar; nuk ka ndjekje sistematike të raporteve të KLSH" [15].

Në dhënien e rekomandimeve tona pas auditimit, ne marrim në analizë jo vetëm proporcionalitetin e tyre me gjetjet dhe konstatimet por edhe mundësinë reale të realizimit të këtyre rekomandimeve nga ana e institucioneve.

Konstatojmë se sot po i vihet theks përpjekjeve qeveritare për të kufizuar informalitetin, por kemi gjithnjë e më pak referime të luftës kundër korrupsionit, e cila e përfshin betejën anti-informalitet dhe është kushti "sine qua non" për një ndërtimin e një shoqërie tërësisht demokratike dhe të një shteti ligjor.

Angazhimi ynë institucional në luftën kundër korrupsionit, i kërkuar dhe i vlerësuar

[15] Progres Raporti 2014 për Shqipërinë, faqe 71, paragrafi i dyte, http://www.integrimi.gov.al/al/dokumente/progres-raporte/progres-raporti-2014

vazhdimisht gjatë këtyre viteve, sidomos nga faktori ndërkombëtar, ka hasur në një rezistencë të paarsyeshme të vetë institucioneve shtetërore, përsa i përket moslargimit nga detyra të nëpunësve të nivelit të lartë në administratën shtetërore, për të cilët ne si KLSH kemi konstatuar dhe evidentuar shkelje tepër të rënda në drejtim të kryerjes së detyrës së tyre funksionale, duke depozituar për ta edhe kallëzim penal në Prokurori. Lista e tyre është:

1. Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.
2. Drejtor i Agjencisë së Shërbimit të Sporteve në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.
3. Drejtor i Shërbimeve Juridike në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.
4. Drejtor i Drejtorisë Arsimore Rajonale, Qarku Fier.
5. Drejtor Ekzekutiv i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore.
6. Zv. Drejtor Ekzekutiv i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore.
7. Zv. Drejtor Ekzekutiv i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore.
8. Drejtor i Drejtorisë së Prokurimeve Publike në Ministrinë e Punëve të Brendshme.
9. Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Turizmit.
10. Administrator i Albpetrol sha.
11. Drejtor i Drejtorisë së Marrëveshjeve në Albpetrol sh.a.
12. Drejtor i Qendrës së Administrimit Shitjes së Naftës dhe Gazit, Patos.
13. Drejtor i Drejtorisë Rajonale Tatimore, Berat.
14. Drejtor i Drejtorisë Rajonale, ALUIZNI, Fier.
15. Administrator i Shtypshkronjës së Letrave me Vlerë sh.a.
16. Drejtore e IT në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
17. Drejtor i Portit Detar, Sarandë.
18. Ish-Drejtor i Përgjithshëm i Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, etj.
19. Sekretar i Përgjithshëm, Prefektura Vlorë.

Në këto raste nuk bëhet më fjalë për paaftësi dhe pamundësi institucionale, por për mungesë vullneti kundrejt luftës kundër korrupsionit dhe ndërtimit të një shteti ligjor. Ne shprehim keqardhje për papërgjegjshmërinë institucionale edhe në referencë të moszbatimit me dashje të rekomandimet tona në lidhje me largimin e zyrtarëve të cilët janë kapur me shkelje, duke u shndërruar në kontribues dhe garantët kryesor të antikulturës së pandëshkueshmërisë. Këtë zhgënjim e kemi shprehur edhe në komunikimin tonë me Kryeministrin, në shkresën nr. 739 datë 31.07.2015.

Mbi domosdoshmërinë e hartimit të ligjit "Për përgjegjësinë materiale"

Nga auditimet e kryera, KLSH ka konstatuar mjaft probleme dhe shkelje të dispozitave ligjore në fonde të konsiderueshme publike, që kanë sjellë shpenzimin e tyre pa kriter dhe efiçiencë, ose edhe më keq, shkuarjen dëm të një pjese të tyre, nga keq menaxhimi financiar.

Jemi përpjekur të përcaktojmë përgjegjësitë materiale të nëpunësve publikë që kanë kontribuar në këto keqpërdorime të fondeve publike, duke propozuar masa në formën e sanksioneve, kundrejt parregullsive financiare të shkaktuara prej tyre dhe të konstatuara. Theksojmë se vlerësimi dhe matja e dëmit dhe adresimi i përgjegjësisë materiale kërkon procedura më konkrete, të detajuara.

Kemi rekomanduar ngritjen e një grupi pune me specialistë dhe përfaqësues të legjislativit, që do të vlerësojë dhe punojë për hartimin e Ligjit "Mbi përgjegjësinë materiale", në të cilën të trajtohet përgjegjësia financiare e punonjësve të njësive publike (zyrtarët e lartë dhe punonjësit e të gjithë niveleve) për dëmet ekonomike të shkaktuara qëllimisht apo nga neglizhenca, gjatë ose në lidhje me procesin e ekzekutimit të detyrave zyrtare.

Gjykojmë se një ligj i tillë do të jetë një mjet efektiv dhe efiçient në përmirësimin e qeverisjes publike, rritjen e përgjegjshmërisë dhe kufizimin e korrupsionit.

3 – Transparenca

Sipas Manualit të FMN-së "Për Menaxhimin e Shpenzimeve Publike"[16] saktësohet se *çështjet kyçe në zbatimin e një buxheti publik janë transparenca, niveli i ndarjes së linjave të përgjegjësisë; sa koherent është informacioni mbi ekzekutimin e buxhetit; sa i saktë dhe i besueshëm është ky informacion; dhe a zbatohet buxheti në përputhje me parimet e qeverisjes së mirë*?[17]

Përgjegjësia në zbatimin e Buxhetit të Shtetit, po sipas këtij Manuali, realizohet e plotë, nëse"...*(i) çdo veprim është transparent, (ii) çdo pjesëmarrës është përgjegjës; (iii) çdo veprim është i dokumentuar si duhet dhe i raportuar; dhe (iv) çdo veprim duhet të jetë subjekt i auditimit të pavarur, profesional dhe të paanshëm"*[18].

Një tjetër institucion i besueshëm ndërkombëtar, OECD, ndër parimet kryesore që rendit në procesin e zbatimit të Buxhetit, veçon: qartësinë e treguesve dhe objektivave të Buxhetit, integriteti i parashikimeve dhe planeve fiskale, lidhja e ngushte me përparësitë

[16] Autoret Barry Potter and Jack Diamond

[17] (Pjesa e 4-t, "Ekzekutimi i Buxhetit", ribotim, viti 2012, faqe 102)

[18] Manuali i FMN-së "Për Menaxhimin e Shpenzimeve Publike" Pjesa e 4-t, "Ekzekutimi i Buxhetit", ribotim, viti 2012, faqe 122.

strategjike afatmesme të zhvillimit të vendit, efektiviteti, sigurimi i vlerës për paranë publike të harxhuar, ekonomiciteti, si dhe qëndrueshmëria financiare afatgjatë.

Sot, shoqëria civile në botë, por edhe grupe të tjera interesi, si dhe shumë qeveri të vendeve të zhvilluara, janë të bindur se sa më transparent dhe me pjesëmarrje të qytetarëve të jetë një buxhet shteti, aq më pranë tyre ndodhet ai dhe aq më shumë përgjegjësi ndjen qeveria në zbatimin e buxhetit.

Sipas organizatës jo qeveritare me qendër në Uashington "Partneriteti Ndërkombëtar për Buxhetin"[19], në vrojtimin e saj "Treguesi i Buxhetit të Hapur 2015", në shtator 2015, të kryer në 102 vende të botës ku përfshihet dhe vendi ynë, Shqipëria renditet ndër vendet e fundit ne Ballkan. Ne duhet të ndihmojmë të gjithë Ministrinë e Financës. Kemi të gjithë shumë punë për të bërë, si qeveria, ashtu dhe Kuvendi dhe ne si KLSH, për të rritur transparencën e buxhetit.

4 – Opinion përmbyllës

Bazuar në auditimin e buxhetit faktik të vitit 2014, problemeve dhe fenomeneve që janë ndeshur gjatë këtij procesi, situatës ekonomike dhe risqeve ndaj të cilave ekspozohen financat publike dhe ekonomia shqiptare, do të listoja disa opinione të institucionit të KLSH.

Së pari, e gjykoj të rëndësishëm zbatimin e parimeve të anualitetit, transparencës dhe besueshmërisë. Zbatimi i këtyre parimeve jo vetëm ndikon në mirëmenaximin e fondeve publike por në të njëjtën kohë ndihmon të rritet besimi publik. Krijimi i një klime besimi shtet-tatimpagues ndihmon jo vetëm punën kundër informalitetit por dhe në krijimin e një besimi të ndërsjelltë dhe produktiv mes subjekteve tatimpagues institucionale dhe individuale nga njëra anë, dhe institucioneve publike të cilave u janë besuar fondet e tyre, nga ana tjetër.

Së dyti, duhet shtuar vëmendja ndaj parametrave të borxhit. Bazuar në të dhënat e konstatuara gjatë proceseve audituese që lidhen me buxhetin faktik të vitit 2014 si dhe tendencave të të dhënave buxhetore dhe ekonomike gjatë viteve të fundit, do të tërhiqja vëmendjen për një kujdes të shtuar për nivelin e deficitit dhe të borxhit publik. Pa dashur të heq paralele me ndonjë vend në krizë borxhi, do të sugjeroja të nxirrnim mësime nga vende që janë gjendur përballë situatave të pamundësisë së menaxhimit të borxhit publik, siç është Greqia. Thellimi i borxhit publik dhe rritja e peshës së borxhit të jashtëm e pa shoqëruar me një rritje të investimeve publike, ul potencialin e shtetit për të shlyer huat. Situata të tilla janë të rrezikshme, pasi i shtyjnë qeveritë të gjejnë si

[19] Titulli origjinal në anglisht "International Budget Partnership".

zgjidhje shlyerjen e borxhit me borxh më të madh, duke e rënduar akoma më shumë këtë parametër.

Së treti, institucioni i KLSH ndjek vit pas viti nivelin e riskut financiar ndaj të cilit janë ekspozuar financat publike në veçanti dhe ekonomia në tërësi. Për të pasur një gjykim sa më objektiv, vitet e fundit jemi mbështetur tek Treguesit e Cenueshmërisë mbi bazën e të cilëve Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) mbikëqyr dhe këshillon vendet anëtare dhe sidomos vendet me ekonomi në zhvillim siç është Shqipëria. Treguesit (indikatorët) bazë që përdor ky institucion dhe ecuria e këtyre treguesve bazuar në vëzhgimin e KLSH rezultojnë si më poshtë:

Indikatori i cënueshmërisë i FMN	*Shqipëria 2010-2014*
Investimet e huaja	*Përkeqësim - Në rënie*
Borxhi i jashtëm/Eksporte	*Përkeqësim - Në rritje*
Borxhi i jashtëm/PBB	*Përkeqësim - Në rritje*
Borxhi i jashtëm/Të ardhurave tatimore	*Përkeqësim - Në rritje*
Rezerva valutore/Borxhi i jashtëm afatshkurtër	*Përkeqësim - Në rënie*

Duke e ritheksuar që nuk duam të heqim paralele me ekonominë Greke, nga analiza e vazhduar e institucionit të KLSH kemi gjetur që të gjithë këta tregues kanë pësuar përkeqësim në vitet 2010-2014 njësoj si ekonomia Greke në vitet e parakrizës 2005-2009. Në këtë kontekst gjykojmë se nevojitet një angazhim dhe vëmendje e shtuar e krejt politikbërësve dhe menaxherëve publikë në Shqipëri për të gjykuar mbi riskun shtesë që financat publike dhe ekonomia shqiptare merr në çdo vendim që ata marrin.

Gjithashtu, bazuar në tkurrjen e investimeve të huaja gjatë vitit 2014 si dhe duke pasur parasysh ngjarjet e vitit 2015, KLSH *tërheq vëmendjen për të pasur kujdes në ndërtimin e paketës fiskale të vitit 2016*. Synimi për të mbledhur më shumë të ardhura tatimore mund të bëjë vendin më pak tërheqës në raport me vendet e tjera të rajonit duke dëmtuar jo vetëm sektorë të caktuar të ekonomisë por dhe vetë të hyrat publike.

Së katërti, në respekt të zbatimit të qëllimit të çdo ligji, gjykoj se mund të ndërtohen praktika dhe procedura që çojnë në një përdorim më efiçient të fondeve publike si dhe në të njëjtën kohë të ndërpriten praktika të cilat i vlerësojmë si jo efiçiente, të tilla siç është rasti i përdorimit të Letër Kredive. Nëpërmjet mënyrës së tanishme të aplikimit të Letër Kredive, Qeveria Shqiptare vendos si depozitë në banka me normë interesi pothuaj 0% fonde të cilat ia ka marrë hua po bankave duke u shitur bono thesari për të cilat u ka paguar një normë interesi mbi 3%. E thënë më thjesht, qeveria ka paguar një interes mbi 3% për hua që "de facto" nuk i ka përdorur.

Gjithsesi, kam besimin se mund të gjenden mënyra më efektive për garantimin e kontratave të nënshkruara nga entet publike apo mund të gjenden mënyrat për një kontraktim më efektiv me bankat. Ekzistojnë të gjitha rrethanat ekonomike që entet publike të kërkojnë nga bankat më shumë të drejta të një klienti preferencial, ashtu sikundër bëjnë dhe kompanitë private me qarkullim të madh të fondeve nëpër banka.

Së pesti, mendoj se është e domosdoshme rritja e përgjegjshmërisë e administratës publike lidhur me pasojat ekonomike të veprimeve të tyre. Fshehja mbas kompetencave që jep detyra publike nuk duhet të shërbejë më për të lënë pa autor dëmet ekonomike dhe financiare që i shkaktohen në mënyrë të pajustifikueshme shtetit. Vetëm kostot e vendimeve politike nuk mund të auditohen. Çdo veprim dhe vendim tjetër duhet tí nënshtrohet kontrollit dhe përgjegjësisë. Siç nënvizova më lart, KLSH ka marrë iniciativën dhe po punon që çdo specialist dhe menaxher i cili shërben në administratën publike të mbajë përgjegjësi materiale për kostot financiare dhe ekonomike që i shkakton shtetit me vendimet e tij individuale apo dhe kolegjiale.

Kjo iniciativë përputhet dhe me Strategjinë "Për Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020". Në faqen 31 të Strategjisë përcaktohet si mundësi "*Ndryshimi i Ligjit Organik të Buxhetit, me qëllim përcaktimin e qartë të përgjegjësisë së secilit Ministër ose Drejtuesi të Institucionit Qendror Buxhetor gjatë të gjithë fazës së ciklit të menaxhimit të shpenzimeve publike*".

Së gjashti, praktikat e prokurimit publik vazhdojnë me shkelje në pjesën dërrmuese të tyre duke dekurajuar konkurrencën në garën për ofrimin e shërbimeve publike. Kjo jo vetëm dëmton financat publike por jep mesazh të gabuar tek operatorët ekonomikë si dhe nuk i shërben rolit që shteti duhet të luaj në një ekonomi, si operator dhe rregullator tregu.

Së shtati, dëmet në sektorin energjetik kapin vlera të konsiderueshme, jo vetëm për financat publike por dhe për ekonominë shqiptare në tërësi. Nën fokusin e kësaj rëndësie, duhet të shtohet vëmendja dhe përgjegjshmëria ndaj zbatimit më korrektësi të të gjitha kontratave që janë nënshkruar. Gabimet që janë zbuluar për kontratat e nënshkruara tashmë duhet të shërbejnë për të qenë më të kujdesshëm në kontratat e ardhshme.

Së teti, institucionet publike duhet të rrisin përgjegjshmërinë në raportimin me saktësi, në kohë reale dhe konform standardeve të kontabilitetit të të dhënave të tyre ekonomike dhe financiare. Në kushtet kur bëhet një punë intensive për të përmirësuar cilësinë e raportimit për biznesin privat, është e mundur dhe e nevojshme që paralelisht të kërkohet e njëjta gjë dhe për raportimin e institucioneve publike. Përveçse do të rriste transparencën dhe përgjegjshmërinë publike, kjo do të përfaqësonte një demonstrim nxitës për krijimin e një kulture të raportimit të saktë dhe në kohë reale për të gjitha subjektet ekonomike, publike apo private qofshin.

Së nënti, duhet të nënvizoj se armiku më i madh i ekonomisë dhe shtetit është korrupsioni i nivelit të lartë dhe jo informaliteti. Mbledhja e të ardhurave publike dhe menaxhimi i tyre janë një sfidë e vazhduar e administratës publike në një ekonomi tregu. Në funksion të qëllimit të përbashkët për mirëmenaxhimin e fondeve publike, do të vazhdojmë të kërkojmë që të shqyrtohen me më përgjegjshmëri dhe vëmendje rekomandimet e KLSH-së, në drejtim të përmirësimeve të rëndësishme ligjore, shpërblimit të dëmit, largimit nga puna të nëpunësve të lartë dhe të mesëm të gjetur në shkelje, etj.

Dhe së fundmi:

Konstatojmë se buxheti mbetet larg karakteristikave të një buxheti kredibël. Në treguesit fiskalë të realizimit të buxhetit të vitit 2014, kemi konstatuar aspekte mbi të cilat ne shprehemi me rezervë, por në përfundim, nisur nga niveli i materialitetit, nuk mendojmë se këto aspekte cenojnë shifrat e buxhetit faktik të vitit 2014. Përpjekjet pozitive që ka bërë Ministria e Financave në drejtim të formulimit të një strategjie moderne të menaxhimit të financave publike, janë larg situatës që konstatohet në praktikë.

Viti 2014 ishte viti i parë i zbatimit të Strategjisë "Për Menaxhimin e Financave Publike 2014-2020". Kjo strategji bart një rëndësi të dyfishtë, pasi jo vetëm përcakton rrugën për rivendosjen e financave publike në trajektoren e qëndrueshmërisë afatgjatë, duke krijuar kështu parakushtet për rritjen ekonomike, por përbën edhe një detyrim që rrjedh nga marrëveshjet me partneret ndërkombëtarë, në veçanti me Bankën Botërore, Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bashkimin Europian. Vizioni i saj është garantimi i një sistemi të financave publike që nxit transparencën, përgjegjshmërinë, disiplinën fiskale dhe efiçiencën në menaxhimin dhe përdorimin e burimeve publike. Viti 2014 njohu arritje në zbatimin e strategjisë, por edhe sfida ende të paplotësuara. Prandaj ne të gjithëve, Kuvendit, qeverisë dhe institucioneve të pavarura na del për detyrë të punojmë më me angazhim dhe seriozitet për zbatimin e plotë të Strategjisë "Për Menaxhimin e Financave Publike 2014-2020".

SAI nuk harton politika, por auditon zbatimin e tyre

- *Prezantim i Raportit të Performancës së KLSH-së për vitin 2015*

28 qershor 2016[20]

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, Kuvendi i Shqipërisë

Deputetët pjesëmarrës

1. Erion Braçe
2. Ridvan Bode
3. Anastas Angjeli
4. Florjon Mima
5. Ervin Koçi
6. Andrea Marto
7. Evis Kushi
8. Blerina Gjylameti
9. Gledjon Rehovica
10. Luan Duzha
11. Igli Cara
12. Perparim Spahiu
13. Ervin Bushati
14. Liljana Elmazi
15. Edmond Spaho
16. Luan Duzha
17. Gjovalin Kadeli
18. Jorida Tabaku
19. Majlinda Bufi
20. Sherefedin Shehu

Të nderuar deputetë,

Raportojmë për aktivitetin e KLSH gjatë vitit 2015, në bazë të strukturës së standardizuar të Kornizës së Matjes së Performancës së Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI-t), dokument i cili përbën një projekt-pilot të INTOSAI-t, që do të miratohet si standard ISSAI në Kongresin INCOSAI XXII në dhjetor të këtij viti.

Korniza është e bazuar në ISSAI 12 "Vlerat dhe Përfitimet nga Institucionet Supreme të Auditimit – Të bësh ndryshimin në jetën e qytetarëve ", i cili thekson se "*Të vepruarit në*

[20] Megjithëse i prezantuar në vitin 2016, ky Raport përfshihet në këtë libër, pasi përshkruan aktivitetin e KLSH-së gjatë vitit 2015.

interes të publikut i vendos SAI-t me një përgjegjësi të mëtejshme për të demonstruar rëndësinë e aktivitetit të tyre përpara qytetarëve, Parlamentit dhe veprimtarëve të tjerë[21]"

Ky dokument përdoret nga shumica e SAI-ve të zhvilluara në matjen dhe interpretimin e rezultateve të tyre përpara Parlamenteve përkatëse dhe qytetarëve.

I. Kolona e Parë e Kornizës është " Performanca e SAI-t". Brenda kësaj kolone janë rezultatet e Auditimit Financiar, të Përputhshmerisë, të Performancës dhe shërbimet që i japin vlerë të shtuar institucionit.

I.1 Auditimet

Për vitin 2015, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka përfunduar dhe evaduar 158 auditime, ose 8.8 % përqind më shumë nga viti 2014. Ne punën tonë audituese, ne po orientohemi gjithnjë e më fort drejt auditimeve të performancës, të cilat njohën një rritje me 25 përqind, në krahasim me 2014-ën, por ende kemi shumë për të bërë për të arritur 15 përqind të totalit të auditimeve të zhvilluara përgjatë një viti, objektiv të cilin mendojmë ta arrijmë në vitin 2018. Sot jemi në 8 përqind auditime të performancës kundrejt totalit.

Për periudhën 2012-2015, Auditimet e Performancës u shtuan si numër 3 herë në krahasim me periudhën 2008-2011 dhe afro 4 herë për nga numri i institucioneve të mbuluara me këtë lloj auditimi. Zhvillimi i tyre është në përputhje të plotë me objektivat e planit strategjik të KLSH 2013-2017, i rishikuar. Gjithnjë duke e mbajtur vëmendjen tek shtimi dhe rritja e cilësisë së auditimeve financiare dhe auditimeve të përputhshmërisë, auditimet e performancës po shndërrohen në një nga shtyllat e zhvillimit dhe modernizimit të institucionit. KLSH po përballet çdo ditë me një sfidë të fortë për ta përqendruar punën tek auditimi i performancës, për arsye se ai i shërben vlerësimit të përgjegjshmërisë publike. Sfida më e madhe me këtë lloj auditimi është që ai mos të zbatohet thjesht si procedurë, por të konceptohet si një filozofi e të menduarit dhe vepruarit nga i gjithë stafi i KLSH-së. Një filozofi pune që konsideron se auditimi nuk është një qëllim në vetvete, por në radhë të parë një instrument parandalimi, instrument korrigjimi dhe këshillimi për institucionin që auditohet, në mënyrë që ai të kuptojë ku i ka mangësitë kryesore dhe t'i plotësojë ato, duke përmirësuar menaxhimin dhe shtuar performancën.

Gjatë vitit 2015, kemi realizuar 12 auditime performance në reformat qeveritare, në projektet dhe shërbimet social-ekonomike, në projektet infrastrukturore, projektet energjetike dhe mjedisore, si dhe projektet dhe shërbimet social-kulturore. Për këtë vit do t'i përqendrojmë auditimet e performancës në marrëveshjet koncesionare, në partneritetet publik-privat, në performancën e borxhit publik, etj.

[21] ISSAI 12, faqe 4, paragrafi i parafundit, http://www.issai.org/media/84539/issai-12-e.pdf

Auditimet e Përputhshmërisë (kemi evaduar 120 auditime te tilla gjatë vitit 2015) arritën të plotësonin kriteret metodologjike ndërkombëtare, duke garantuar siguri sipas standardeve ISSAI 400, 4000 dhe 4100 të INTOSAI-t.

Për herë të parë në vitin 2015, gjatë auditimeve financiare(u realizuan 12 të tilla), KLSH dha opinion për pasqyrat financiare të përgatitura nga institucionet publike, pavarësisht se opinioni u dha në disa njësi varësie dhe jo në Institucione qëndrore, per të minimizuar riskun operacional në realizimin e këtij lloj auditimi pilot. Ky opinion i shton besueshmërinë pozicionit financiar të raportuar nga institucionet buxhetore dhe shëndosh më tej financat e Shtetit.

Institucioni realizoi po për herë të parë dy Auditime të Teknologjisë së Informacionit (njërin auditim pilot me ndihmën e Institutit të Zhvillimit IDI të INTOSAI-t). Edhe pse në hapat e para në këtë fushë auditimi, KLSH ka ngritur Drejtorinë e Auditimit të T.I. dhe investuar në përmirësimin e infrastrukturës së T.I.

I.2 Dëmi ekonomik i zbuluar dhe dobishmëria

Institucioni ka zbuluar gjatë vitit 2015:

A. Parregullsi dhe shkelje financiare, në të ardhurat dhe në shpenzimet e kryera**, *me dëm ekonomik të përgjithshëm* *në shumën totale prej 125,8 miliardë lekë ose 919.9 milionë euro***.

B. ***Shkelje të disiplinës financiare*** me ndikim negativ në perfomancën e subjekteve të audituara, në shumën e përgjithshme ***35,3 miliardë lekë ose 257.7 milionë euro***. Dëmi ekonomik i zbuluar për periudhën 2012-2015 është **8 herë më i madh** se vlera e dëmit të zbuluar për periudhën e katër viteve 2008-2011.

Një pasqyre të mirëfilltë të nivelit të performancës e përbën efiçienca në auditim, një nga treguesit kryesore të performancës së SAI-eve të zhvilluara sot në botë. Ky tregues **i eficiences, dobisë së rezultateve të auditimit** ve në raport sasinë e fondeve te kërkuara per zhdëmtim në Buxhetin e Shtetit nga KLSH me shpenzimet buxhetore të vetë institucionit(pra sa ai u ka kushtuar taksapaguesve), paraqitet për vitin 2015: për çdo një lek të shpenzuar për institucionin, kemi kërkuar për t'u zhdëmtuar në Buxhetin e Shtetit **180 Leke** (këtu nuk është përfshirë dëmi i konstatuar në Ministrinë e Energjitikës dhe Industrisë), ose në vlerë totale **58,7 miliardë lekë,** apo **428,4 milionë euro.** Kjo shifër dëshmon për efiçiencën, dobinë e lartë të aktivitetit auditues dhe renditet në nivele të ngjashëm me treguesit e efiçiencës së SAI-ve të zhvilluara.

Krahasuar në vite, mesatarja e treguesit të efiçiencës (dobishmërisë) së institucionit për vitet 2012-2015 është **4.2 herë më e lartë** se mesatarja e viteve 2008-2011. Dëmi mesatar i kërkuar për t'u zhdëmtuar në Buxhetin e Shtetit për dyvjeçarin 2010-2011

është 19.1 Lek, për dyvjeçarin 2012-2013 52.1 Lek dhe për 2014-2015 109.5 Lek (*Shih grafikun në Raportin e Performancës KLSH 2015).* Thënë ndryshe, në katër vitet e fundit, për çdo lek të takspaguesit shqiptar që harxhohet për KLSH kemi zbuluar dhe kërkuar për zhdëmtim dhe arkëtim në Buxhet mbi 4 herë më shumë fonde se sa në katër vitet 2008-2011.

Raporti vjetor i KLSH mbi Zbatimin e Buxhetit të Konsoliduar të Shtetit për vitin 2014, përgatitur në 2015 dhe paraqitur përpara Komisionit Tuaj në tetor 2015, dha një sërë rekomandimesh me impakt të lartë. Një performancë institucioni nuk mund të kuptohet plotësisht pa impaktin e punës së tij. Shifrat mund të tregojnë shumë, por edhe pak ose asgjë, në rast se nuk lidhen me impaktin e rezultateve. Për këtë arsye, Kolona "A. Performanca e SAI-t" është e bashkëngjitur në Kornizën e Matjes së Performancës së SAI-t, **me nenkolonen e "Impaktit",** në formën e **kontributeve të SAI-t në Disiplinën Fiskale, Ndarjen Efikase të Burimeve, Qeverisjen e Mirë, Përgjegjshmërinë dhe Luftën kundër Korrupsionit.**

Në Simpoziumin e 22-të të OKB-INTOSAI të vitit 2013, Dr. Josef Moser, Sekretari i Përgjithshëm i INTOSAIT ka cilësuar se "*SAI-t mund të shfrytëzojnë plotësisht potencialin e tyre për të kontribuar në qeverisjen e mirë publike vetëm nëse, duke u bazuar në punën e tyre të auditimit, ata gjithashtu angazhohen në veprimtari këshillimore dhe ofrojnë rekomandime specifike për subjektet e audituara dhe për vendim-marrësit*".

Për vitin 2015, përpjekja jonë për **rekomandime konstruktive dhe me impakt të lartë** ka rezultuar në:

a. Për të realizuar një qëndrueshmëri dhe kredibilitet të financave publike, për të përmirësuar planifikimin e treguesve makroekonomikë dhe të parashikimeve buxhetore, të ndërgjegjshëm për risqet fiskale që kalon vendi, kemi rekomanduar marrjen e nismës ligjore për ngritjen e një Këshilli Fiskal, i cili të gëzojë statusin e nje institucioni publik të pavarur dhe të ketë një pavarësi operacionale të qartë e rigoroze nga politika. Një rekomandim të tillë, i cili do tí sigurojë vendit atë oponencë të pavarur dhe profesionale të munguar në politikat tona fiskale, e dha në janar 2016 edhe Fondi Monetar Ndërkombëtar, në Raportin e tij "Country Report" Nr. 16/5 për Vlerësimin e Transparencës Fiskale.

b. Për të disiplinuar financat publike dhe rritur kredibilietin financiar të vendit, kemi dhënë për të tretin vit në vijimësi rekomandimin që Ministria e Finances të paraqesë në Kuvend një nismë ligjore për vendosjen në Kushtetutë dhe në Ligjin "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të treguesit të **borxhit publik në nivelin tavan 60 % ndaj PBB-së**, si dhe arritjen e këtij niveli gradualisht, në përputhje me objektivat dhe fazat e reduktimit të borxhit të përcaktuara në Strategjinë "Për Menaxhimin e Financave Publike 2014-2020". Ky rekomandim gjykojmë se ka shërbyer

si presion pozitiv në këto tri vitet e fundit, duke nxitur ndryshimet e propozuara kohët e fundit nga Ministria e Financave në Ligjin organik të Buxhetit, me nenin që i detyron të gjitha qeveritë të ulin borxhin publik. Megjithë ndryshimin e propozuar, mendojmë se nuk është mjaftueshëm dhe do të vazhdojmë të insistojmë për këtë nisme që e konsiderojmë thelbësore për të përmirësuar imazhin dhe seriozitetin e reformës në financat publike të vendit.

c. Në kushtet e përgjegjësisë së ulet financiare të zyrtarëve publikë, i kemi rekomanduar Qeverisë dhe Kuvendit për të dytin vit në vijimësi hartimin e ligjit "Për Përgjegjësinë Materiale", në të cilin të trajtohet përgjegjësia financiare e punonjësve të njësive publike (zyrtarët e lartë dhe punonjësit e të gjithë niveleve) për dëmet ekonomike të shkaktuara qëllimisht apo nga neglizhenca, gjatë ose në lidhje me kryerjen e detyrave zyrtare. Mungesën e theksuar të përgjegjshmërisë financiare në vend e kanë evidentuar edhe Progres Raportet e Bashkimit Evropian të viteve 2014 dhe 2015. Jemi të sigurtë se me hapat për realizimin e plotë të reformës në drejtësi, kjo përgjegjësi do të shtohet, pasi reforma duhet të vijojë edhe në këtë drejtim. Gjykojmë se ka ardhur koha që Komisioni i Ekonomisë të marrë nismën për hartimin e këtij ligji kyç në rritjen e përgjegjësisë, llogaridhënies dhe në disiplinimin e vendim-marrësve dhe menaxherëve kryesorë të financave tona publike.

d. Me qëllim rritjen e cilësisë dhe profesionalizmit në përgatitjen dhe dhënien e informacionit financiar dhe fiskal, duke synuar uljen e risqeve fiskale, kemi kërkuar pranë Komisionit të Ekonomisë në tetor 2015, që të publikohen menjëherë nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit Publik IPSAS, si baza kryesore metodologjike mbi të cilën do të hartohen pasqyrat financiare të Shtetit. Kemi rekomanduar që të ngrihet një sektor i veçantë, brenda Drejtorisë së Thesarit në Ministrinë e Financave, i cili të mundësojë përshtatjen e pasqyrave të nxjerra nga sistemi i integruar në formën e Pasqyrave të Konsoliduara të Shtetit. Ky sektor duhet të ketë si funksion edhe kontrollin e saktësisë së pasqyrave të përgatitura nga institucionet publike, për ta vënë nën monitorim dhe kontroll profesional këtë proces të rëndësishëm, per mbarëvajtjen e të cilit ka ngritur shqetësim edhe FMN në Raportin e sipërpërmendur.

e. Kemi kërkuar që privatizimi i Albpetrol të realizohet, duke ftuar kompani me potenciale dhe kredenciale të larta profesionale nga aleatët strategjikë të vendit tonë (veçanërisht ato me traditë të konsoliduar në sektorin e naftës, si SHBA, Mbretëria e Bashkuar apo Gjermania).

g. Kemi rekomanduar po ashtu që të ringrihet Instituti i Kerkimeve të Naftës, si një institut shkencor, i cili të mbështesë të gjitha vendimmarrjet për zhvillimet e sektorit të

hidrokarbureve në vendin tonë dhe të bashkëpunojë me Kuvendin dhe Qeverinë për hartimin e strategjive afatmesme dhe afatgjata në këtë sektor.

h. Kemi rekomanduar ngritjen e një komisioni ad-hoc të pavarur, me ekspertë teknikë dhe ekonomikë, i cili të mund të vlerësojë realisht dhe saktësisht dëmin nga aktiviteti nën administrimin e CEZ a.s., si edhe mundësinë më të mirë për një rimëkëmbje të OSHEE-së mbi baza të monitorimit të kujdesshëm të të gjithë treguesve. Kemi kërkuar një disiplinë të fortë financiare dhe një kontroll të vazhdueshëm nga Kuvendi, për çdo investim dhe vendim-marrje strategjike për OSHEE-në.

i. Kemi kërkuar nga Avokatura e Shtetit të veprojë me shpejtësi në drejtim të ndjekjes së arkëtimit të garancisë nga shoqëria "Vetro Energy PTE Ltd", pas dështimit të procedurave të privatizimit të shoqërisë "Albpetrol sh.a. Patos". Shtyrja e mëtejshme e koordinimit të institucioneve shtetërore apo krijimi i vonesave artificiale rrezikon seriozisht dhe në mënyrë të pajustifikueshme tejkalimin e afateve përkatëse procedurale të kërkimit dhe arkëtimit të garancisë prej 85 milionë Euro.

j. Kemi konstatuar se kompanitë hidrokarbure kanë hartuar e lidhur kontrata në vlera të konsiderueshme me nënkontraktorë të ndryshëm, vendas dhe të huaj, për shërbime për procese teknologjike hidrokarbure, shërbime konsulence teknike ose juridike, për shërbime pune ndërtime civile (rrugë për sheshe ose godina), etj., të cilat janë përfshirë më pas në Cost Recovery (Rekuperimin e Kostos), duke e larguar Faktorin R nga vlera 1. Pas gjetjeve të përsëritura nga auditimet tona të vitit 2013 dhe 2014 që dëshmonin evazionin e qartë fiskal, përshëndesim vendimin e Drejtorisë së Përgjithshme te Tatimeve që e konsideroi vitin 2011 me Faktorin R më të madh se 1 për koncesionarin kryesor në shfrytëzimin e naftës, duke e detyruar të paguante 57 milionë USD detyrime ndaj Buxhetit të Shtetit dhe besojmë që puna do të vazhdoje për zbulimin e rasteve te tjera flagrante të evazionit në zbatimin e marrëveshjeve dhe licencave hidrokarbure.

Pasojat e krizës ekonomike e financiare botërore të viteve 2008-2012 dhe rastet e dukurive abuzive deri në skandale në përdorimin e fondeve publike në institucione, kompani e korporata shtetërore, të evidentuara dhe nga Samiti i Londrës i 12 majit 2016 për një Aleancë Ndërkombëtare kundër Korrupsionit, kanë sjelle një rënie të ndjeshme të besimit të qytetareve ndaj qeverive. Si KLSH ndajmë shqetësimin e partnerëve tanë ndërkombëtarë dhe të shoqërisë civile se besimi i qytetarëve shqiptarë në politikat qeveritare anti-korrupsion është shume i ulët. Nga shkeljet ligjore dhe abuzimet e konstatuara në auditimet tona për vitin 2015, kemi dërguar në Prokurori 51 kallëzime penale për 159 punonjës te administratës shtetërore (krahasuar me 41 kallëzime për 149 punonjës për vitin 2014), ose afërsisht një kallëzim në çdo tre auditime dhe në çdo javë kalendarike, duke vazhduar me të njëjtin trend dhe ritëm si institucion, në këto katër vite. **Dëmi ekonomik për 51 kallëzimet penale të bëra gjatë vitit 2015**

është 85,837,736.000 lekë. Kemi kallëzuar zyrtare të rangut të lartë dhe të mesëm. Si KLSH kemi rritur cilësinë e përgatitjes së dosjes për kallëzim penal dhe shkurtuar kohën e përgatitjes se kallëzimit. Kjo është e rëndësishme për ne. Krahasuar me periudhën katërvjeçare 2008-2011, kur kemi patur 52 kallëzime penale, kallëzimet e katër viteve 2012-2015 janë 170, ose 3.2 herë më shumë.

Shqetësim kryesor për ne është **niveli i ulët i zbatueshmërisë së masave të propozuara nga KLSH për largim nga detyra apo nga shërbimi civil për zyrtarë të lartë të Shtetit, të cilët janë kallëzuar në Prokurori.**

Numri i tyre është i konsiderueshëm. Mbasi i kemi përcjellë dhe ripërcjellë listat me emrat dhe pozicionet e këtyre zyrtarëve të lartë që ende mbahen në punë në Ministritë përkatëse dhe në Departamentin e Administratës Publike, do t'i paraqesim listat pranë Komisioneve të Kuvendit. Nisur nga moto e Kongresit INCOSAI XXI "Auditimi kombëtar në shërbim të Qeverisjes kombëtare" dhe obligimit ndaj mandatit tonë kushtetues e ligjor për kontributin që pritet prej nesh në mirëqeverisjen e vendit dhe në forcimin e përgjegjshmërisë dhe transparencës në qeverisje, do të punojmë fort që anti-kultura e pandëshkueshmërisë në vend të goditet dhe çrrënjoset. Në rekomandimet e tij në Progres Raportet e fundit për Shqipërinë, Komisioni Evropian i mëshon ndjekjes sistematike dhe zbatimit të rekomandimeve të institucionit më të lartë të auditimit. Mund të themi me keqardhje se ndjekja e rekomandimeve të KLSH vijon të mbetet një proces formal, i bazuar në përpilim urdhrash dhe planesh veprimi nga titullari, por pa konkretizim final, sidomos në largimin e drejtuesve të lartë të kapur në shkelje dhe abuzim. Ndjekja jo-efektive e derisotme e rekomandimeve sjell mbi të gjitha fatura financiare të pashlyera në Buxhetin e Shtetit në shuma të konsiderueshme. Ligji "Për Përgjegjësine Materiale të Nëpunësit Publik", apo edhe një Urdhër i Ekzekutivit për largimin nga detyra të atyre që rezultojnë, pas auditimeve tona, me shkelje flagrante të ligjeve dhe dëmtim të ndjeshëm të interesave financiare të Shtetit, do të mund t'i kthenin efektivitetin rekomandimeve të KLSH.

II. Kolona e Dytë e Kornizës së Performancës së SAI-t **"Pavarësia dhe Kuadri Ligjor",** e cila perceptohet si mjedisi ligjor, i krijuar nga Legjislativi dhe Ekzekutivi, ku vepron SAI dhe që përfshin 1. Pavarësinë e SAI-t, 2. Pavarësinë e Kreut dhe të punonjësve të SAI-t dhe 3. Mandatin e SAI-t, është sot më e plotë se kurrë ndonjëherë më parë, në sajë të mbështetjes së dhënë nga Kuvendi me miratimin e ligjit të ri organik të KLSH-së, në radhë të parë në sajë të mirëkuptimit dhe ndihmës Suaj, të deputetëve të Komisionit të Ekonomisë, gjë për të cilën Ju falënderojmë.

Menjëherë pas miratimit të ligjit, ngritëm grupet e punës për përgatitjen dhe finalizimin e dokumenteve bazë të veprimtarisë së institucionit, për zbatimin në praktike të Ligjit organik. Në kuadër të zbatimit të Strategjisë së Menaxhimit institucional 2013-2017 (të

ripunuar), të Strategjisë së Implementimit të ISSAI-ve dhe të aktiviteteve të parashikuara në Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020, Shtylla 6, si dhe në përmbushje të kërkesave të Programit Buxhetor "Triger Matrix", hartuam Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë dhe Manualin e Auditimit Financiar, Rregulloren e re të Brendshme të institucionit dhe Indikatorët e Performancës të Auditimit të Performancës. Draft-manualet iu dërguan Delegacionit Europian dhe SIGMA-s për dhënie mendimi. KLSH ka marrë vlerësimin nga Delegacioni Europian dhe SIGMA qe këto manuale janë hartuar ne përputhje me kërkesat e Standarteve ISSAI dhe praktikat më të mira te fushës. Do të vijojmë t'i përmirësojmë këto manuale, duke i testuar në praktike nëpërmjet auditimeve pilot.

Mandatin më të gjere audites që na ka garantuar ligji i ri, gjatë vitit 2015 jemi përpjekur ta konkretizojmë, duke diversifikuar llojet e auditimeve, duke e zgjeruar aktivitetin edhe në certifikimin e pasqyrave financiare të përgatitura nga institucionet publike, apo në auditimet e sistemeve të informacionit, që kanë marrë një shtrirje të gjerë në ofrimin e shërbimeve publike, si dhe duke minimizuar pengesat që hasim në auditim. Me këtë ligj të institucionit, pothuajse tërësisht në linjë me standardet INTOSAI, fokusi i ri, që përbën dhe një nga sfidat tona kryesore në të ardhmen, është dhënia e një sigurie të arsyeshme mbi besueshmërinë dhe vërtetësinë e raportimeve financiare të qeverisë dhe dhënia e rekomandimeve të vlefshme në drejtim të vendosjes së rregullave të qarta të raportimit financiar publik.

Kryesore në punën tonë ka qenë dhe është profesionalizmi, mosqenia pjesë e politikës, sikurse e thekson edhe Gene L. Dodaro, Audites i Përgjithshëm i GAO-s Amerikane në përshëndetjen e tij drejtuar KLSH me rastin e 90 vjetorit të institucionit, "*Institucionet Supreme të auditimit sot janë pozicionuar si kurrë më parë, për të bërë diferencën... Ne nuk bëjmë politika. Ato i ka Kongresi. Ne auditojmë realizimin e politikave dhe programeve të Qeverisë*".

Kolona e Tretë e Kornizës ka të bëjë me aftësinë e SAI-t, me menaxhimin institucional të tij dhe përfshin "**Strategjinë për Menaxhim dhe Zhvillim**", "**Standardet e Auditimit dhe Metodologjinë**", **"Menaxhimin dhe Strukturat Ndihmëse**", "**Burimet Njerëzore dhe Lidershipin**", si dhe "**Komunikimin dhe Menaxhimin e Palëve të Interesuara**" , të cilat konsiderohen nën kontrollin e SAI-t.

Strategjia për Menaxhim dhe Zhvillim

Zgjerimi i fushës audituese me ligjin e ri organik të KLSH, lindi nevojën e rishikimit të Strategjisë së Zhvillimit Institucional 2013-2017 dhe Planit të Veprimit për periudhën 2015-2017. Rishikimi i Strategjisë, synoi vendosjen e prioriteteve dhe alokimin e drejtë e të përshtatshëm të burimeve, duke u fokusuar në arritjen e objektivave dhe menaxhimin e risqeve, në përputhje me detyrimet që burojnë nga Ligji Organik. Objektivat strategjike si zhvillimi i kapacitetit institucional të KLSH-së, rritja e kapaciteteve

audituese dhe e cilësisë së auditimit, shtimi i numrit dhe i cilësisë së auditimeve të performancës, forcimi i rolit antikorrupsion të institucionit, zhvillimi i komunikimit dhe bashkëpunimit me veprimtarë të tjerë brenda e jashtë vendit, etj. janë arritur në një nivel të kënaqshëm në këto tre vitet e para të zbatimit të Strategjisë. Gjatë viti 2015 kemi ecur më shumë me auditimet e përformances, si dhe me rritjen e kapaciteteve audituese dhe të cilësisë së auditimit.

Në unison me Strategjinë e Zhvillimit të institucionit, përgatitëm Strategjinë e Implementimit të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI-ve, mbi bazën e Marrëveshjes së nënshkruar me vullnetin tonë me 12 mars 2013 me IDI-n, institutin e zhvillimit të INTOSAI-t. Përdorimi i teknikave "iCAT"(teknikave të vlerësimit të përputhshmërisë) na mundësoi të identifikonim kërkesat e ISSAI-ve për çdo lloj auditimi, duke hapur kështu rrugën për një analize SËOT për secilin lloj auditimi që kryen KLSH. Në qershor të vitit 2015, raportuam pranë IDI-t mbi përmbushjen e detyrimeve të marrëveshjes së angazhimit, pjesë e së cilës është zhvillimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit të Implementimit të ISSAI-ve. Gjate viteve 2012-2015, institucioni ka fituar një filozofi të re pune. Standardet e organizatës INTOSAI janë futur në KLSH jo vetëm si tema të trajnimeve profesionale të trupës audituese, por shërbejnë si referime të qëndrueshme të përditshme në gjetjet, vlerësimet dhe rekomandimet e secilit grup auditues dhe audituesi të veçantë.

Standardet e Auditimit dhe Metodologjia

Implementimi i ISSAI-ve është një proces i gjatë dhe ndërthuret dhe me veprimtaritë dhe aktivitetet e KLSH që po kryhen në kuadër të zbatimit të projektit IPA 2013 "Forcimi i kapaciteteve të auditimit të jashtëm".

Një nga faktorët që ka ndikuar pozitivisht në sigurimin e cilësisë së punës audituese për vitin 2015, është edhe përmirësimi i Metodologjisë, përgatitja e studiuar e programit vjetor të veprimtarisë së KLSH-së që lidhet me përcaktimin e prioriteteve të mundshme, argumentimin dhe përfshirjen në programin e auditimit të subjekteve të auditimit mbi bazën e vlerësimit të riskut dhe përcaktimit të materialitetit, duke i kombinuar këto auditime edhe me detyrimet kushtetuese e ligjore që ka KLSH, për auditimin periodik të tyre.

Gjate vitit 2015, kërkuam nga SAI-t e zhvilluara të EUROSAI-t dhe INTOSAI-t të ishim pjesë e procesit "Peer Review"(Rishikim mes kolegëve) të INTOSAI-t dhe Gjykata e Auditimit e Austrisë pranoi të na vlerësonte sipas këtij procesi mbi nivelin e pavarësisë sonë në vendim-marrje dhe në auditim. Bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit të nënshkruar, një grup përfaqësuesish nga Gjykata Austriake e Auditimit ndërmori në shkurt 2016 një proces vlerësimi "Peer Review" dhe aktualisht jemi në pritje të rezultateve të këtij vlerësimi.

Po në vitin 2015 "Qendra për Transparencë dhe Informim të Lirë» (QTIL), në bashkëpunim me USAID-in kanë realizuar projektin « Forcimi i Ligjit përmes zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së », i cili mund të konsiderohet pa dyshim një Mini Peer Revieë e mirëfilltë. Raporti Final i këtij projekti dhe rekomandimet e dhëna për KLSH-në në drejtim të përmirësimit të punës për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së janë profesionale dhe dobiprurëse për ne. Si institucion jemi duke hartuar një plan veprimi të detajuar për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga ana e QTIL.

Në zbatim të ISSAI-t 40 "Kontrolli i cilësisë", grupi i shqyrtimit të dosjeve të auditimit, përzgjodhi në mënyrë rastësore 44 dosje auditimi (shqyrtimi "në të ftohtë") ose 27 % të auditimeve të kryera dhe të evaduara brenda muajit dhjetor 2015, një rritje e konsiderueshme krahasuar me vitin 2014, ku u kontrolluan 32 dosje ose 20% e auditimeve. Ka një rritje të konsiderueshme të kontrolleve " në të ftohtë", krahasuar me periudhën deri në vitin 2012 kur shqyrtoheshin deri në 10 % e auditimeve të evaduara brenda një viti.

Në Grupin e Shqyrtimit të Cilësisë u përfshinë auditues me përvojë nga çdo departament auditimi si dhe u angazhuan ekspertë të jashtëm, të drejtuar nga Prof. Dr. Jorgji Bollano, Kryetar i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit. Nga kontrollet e kryera, në disa dosje auditimi ka rezultuar se nuk ka dokumente për metodat dhe teknikat e auditimit si vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, verifikimin e transaksioneve, informacione, pyetësorë etj, në përputhje me Rregulloren e Brendshme; në disa dosje të tjera auditimi janë konstatuar mangësi në procesin e planifikimit, që konsistojnë në faktin se në dosjen e auditimit nuk ka informacion paraprak, etj. Të gjitha mangësite, së bashku me rrugët për korrigjimin e tyre në të ardhmen, janë reflektuar në raportet e Grupit dhe nga KLSH po punohet për zbatimin e plotë të rekomandimeve të tij.

Menaxhimi

Viti 2015 përkoi me 90 vjetorin e krijimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, duke ndërthurur më mirë se në vitet e kaluara traditat dhe vlerat e përcjella në kohë të institucionit me qasjen moderne në auditim dhe zbatimin më efikas të standardeve ndërkombëtare të fushës ISSAI.

Filozofia e re menaxheriale e institucionit e shikon performancën e secilit auditues si të pandarë nga niveli i njohurive mbi standardet ndërkombëtare të auditimit, nivel i cili, krahas integritetit, aftësive profesionale dhe eksperiencës në punë, konsiderohet në institucion si përcaktues në cilësinë e gjetjeve që audituesi realizon dhe të rekomandimeve që jep.

Burimet Njerëzore dhe Lidershipi

Duke u mbështetur në udhëzimet e standardeve ISSAI dhe në praktikat më të mira të SAI-ve të zhvilluara për ndërtimin dhe zhvillimin e kapaciteteve, institucioni ka vijuar të investojë në zhvillimin e burimeve njerëzore, duke kryer zhvendosjen e strukturës së punonjësve në dobi të trupës audituese. Punonjësit me arsim të lartë jo vetëm që zënë rreth 95% të numrit total të punonjësve, por po shikojmë të rekrutojmë ata që zotërojnë gradën shkencore doktor i shkencave, që kanë dy diploma në fusha dhe specialitete të ndryshme, auditues të brendshëm të certifikuar, ekspertë kontabël, etj.

Trajnimi i stafit auditues brenda dhe jashtë vendit është parë nga institucioni si rruga më efektive për ngritjen e kapaciteteve. Treguesi i trajnimeve ka arritur në 27 ditë trajnimi për punonjës në vitin 2015. Për këtë vit u trajnuan jashtë vendit 136 persona, ose 83% e stafit auditues. Nëse në vitin 2011 treguesi i trajnimeve ishte 2.1. ditë trajnim në vit për punonjës, në vitin 2012 ky tregues u rrit ne 19.4 ditë trajnimi, ne vitin 2013 ne 22 ditë, në vitin 2014 26 ditë dhe në vitin 2015, 27 ditë trajnimi në vit. Për punonjësit e sapo-rekrutuar ky tregues është 30 ditë trajnimi në vit. Pjesëmarrja në trajnime e vendos KLSH-në në nivelet e SAI-ve të zhvilluara evropiane.

Janë realizuar tre forma të trajnimit profesional, 1-trajnimi përmes kurseve on-line, apo *e - learning*, 2- trajnimi "face-to face" me kontakt direkt me trajnuesin dhe trajnimi përmes shkëmbimit të eksperiencave të përbashkëta me ekspertë të SAI-ve partnere dhe SIGMA-s, nëpërmjet pjesëmarrjes në seminare dhe workshope.

Komunikimi dhe Menaxhimi i Palëve të Interesuara

<u>Strategjia e Komunikimit dhe komunikimi i brendshëm</u>

Strategjia e komunikimit na ndihmon të arrijmë objektivat tona të përgjithshme, duke u angazhuar në mënyrë efektive me palët e interesuara, duke demonstruar suksesin e punës tonë dhe duke u siguruar që partneret tanë strategjikë dhe qytetarët të kuptojnë atë që ne bëjmë. Në kuadër të Projektit IPA, kishim planifikuar në Strategjinë e përgjithshme të Zhvillimit të institucionit 2013-2015 që të zhvillonim strategjinë e komunikimit si produkt më vete, gjatë vitit 2015, por duke qenë se IPA startoi në mars 2016, kjo strategji do të zhvillohet gjatë këtij viti. Në zbatim të planit të Zhvillimit strategjik të institucionit dhe me mbështetjen e projektit IPA të BE-së, KLSH do të ripunojë strategjinë e tij të komunikimit për të qenë sa më pranë Kuvendit, publikut dhe medias, duke sjellë vazhdimisht ide të reja, të cilat janë domosdoshmëri për të qenë inovativë dhe atraktivë.

Si institucion jemi të ndërgjegjshëm se komunikimi efektiv është nxitësi më i rëndësishëm ndaj përkushtimit të punonjësve. Jemi përpjekur që informacioni të rrjedhë lirisht në rrugët vertikale dhe horizontale të komunikimit, duke i krijuar mundësi secilit

punonjës të KLSH të shprehet hapur për problemet që sheh në punën e tij dhe brenda institucionit.

Komunikimi me Palët Qeveritare

Gjatë vitit 2015, jemi përpjekur të bashkëpunojmë me Ministrinë e Financave, por megjithë përpjekjet tona, mbi bazën e Standardit ISSAI 9150 "Koordinimi dhe bashkëpunimi mes SAI-t dhe audituesve të brendshëm në Sektorin Publik", nuk kemi arritur të dalim nga pozicionet klasike të audituesit dhe të të audituarit. Gjatë këtij viti shohim një rigjallërim të kontakteve mes të dyja institucioneve tona dhe shpresojmë që marrëveshja e nënshkruar me 8 mars 2012 të zbatohet konkretisht në të ardhmen e afërt, si dhe ta zgjerojmë dhe në një bashkëpunim me Drejtorinë e Inspektimit Financiar në Ministrinë e Financave, sipas kërkesave të BE-së.

Komunikimi me Mediat, Qytetarët dhe Shoqërinë Civile

Në bazë të Standardit *ISSAI 12, "Vlerat dhe dobitë e SAI-ve-të bësh ndryshimin në jetën e qytetarëve",* Kontrolli i Lartë i Shtetit ka një qasje krejt të re ndaj komunikimit me publikun. Gjatë vitit 2015, kemi marrë 382 ankesa nga qytetarët. Nga këto, 252 kërkesa dhe ankesa kanë qenë në kompetencë të KLSH. 143 prej tyre janë verifikuar dhe u është dhënë përgjigja përkatëse, ndërsa 109 janë në procesin e verifikimit. Kujtojmë që në vitin 2011trajtoheshin vetëm 14 ankesa nga qytetarët.

Institucioni ka rritur gradualisht transparencën e veprimtarisë së tij, duke arritur në fund të vitit 2015 që të jetë i pranishëm 6.6 herë më shumë me informacione dhe mesazhe në median e shkruar, si dhe të pesëfishojë prezencën e tij në median audiovizive, krahasuar me vitin 2010.

Kemi vendosur vendimet e plota mbi auditimet në faqen tonë në internet www.klsh.org.al, që në thelb është raporti ekzekutiv dhe rekomandimet, të cilat janë vendosur në internet gjatë këtij viti.

Transparenca sjell besim te qytetari, sikurse e ka cilësuar edhe Standardi 12 "*Për të qenë në gjendje që të përmbushin funksionet e tyre dhe për të siguruar vlerën e tyre të mundshme për qytetarët, SAI-t duhet të jenë krejtësisht transparente, qe të shihen si te besueshëm. SAI-t meritojnë besim vetëm nëse ata vetë janë gjykuar objektivisht si të besueshëm, kompetentë dhe të pavarur dhe që mund të mbahen përgjegjës për veprimet e tyre*[22]".

Gjatë vitit te kaluar, shtypi i shkruar ka pasqyruar raportet dhe deklaratat për shtyp të KLSH me 922 artikuj, njoftime, editoriale dhe komente analitike, përkundrejt 867 të

[22] Po aty. ISSAI 12, faqe 4, paragrafi i parafundit, http://www.issai.org/media/84539/issai-12-e.pdf

vitit 2014, ose 7% më shumë. Audituesit e KLSH kanë qenë të pranishëm pothuajse në të gjitha gazetat me qarkullim kombëtar, me 116 shkrime, të shkruara nga 50 audites. Falënderojmë të gjitha mediat, të cilat kanë qenë të hapura ndaj shkrimeve të audituesve tanë.

Për vitin 2015, institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Komitetin Shqiptar të Helsinkit edhe me Organizatën "Integrimi Urban", duke e çuar në 18 numrin e partnerëve të shoqërisë civile, me të cilët ka marrëveshje bashkëpunimi.

Kemi marrë pjesë në shumë grupe pune dhe aktivitete të organizuara nga INTOSAI dhe EUROSAI. Me shumë vlerë ka qenë pjesëmarrja në Grupin e Punës për rishikimin e ISSAI 30 (Kodi i Etikës), ku institucioni ka qenë aktiv dhe ka paraqitur propozimet e tij ne 3 takimet e zhvilluara gjatë vitit 2015, si dhe në dy takime të grupit Task Force të EUROSAI-it për "*Auditimin dhe Etikën",* temë ndër më aktualet për administratën publike, e lidhur direkt me integritetin dhe për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.

Mbas një shkëputjeje që nga viti 2004, riaktivizuam bashkëpunimin me Gjykatën Europiane të Audituesve (ECA), duke përfituar nga përvoja e mirë e një prej institucioneve më prestigjioze evropiane të auditimit. Për herë të parë, katër audites të KLSH kanë qenë pjesë e strukturave të ECA-s për një periudhë 5 mujore internshipi.

KLSH ka rivendosur bashkëpunimin me GAO-n amerikane dhe në muajin Mars 2016 një audituese e KLSH-së nisi një felloëship 4 mujor pranë kësaj zyre, eksperiencë e cila do të jetë pozitive dhe dobiprurëse për ne.

Në vitin 2015, kolona e botimeve KLSH arriti në 51 tituj, duke i shtuar 16 tituj librash të 35 botimeve të publikuara në periudhën 2012-2014. Ndër titujt e 2015 veçojmë Standartet e Auditimit të Zyrës së Auditimit të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës (GAO), Manualin e Departamentit të Auditimit të Performancës "Indikatorët e Performancës", Manualin e Auditimit të IT, Kodi i Etikës së INTOSAI-t (ISSAI 30), Kodin e Etikës së Gjykatës Evropiane të Audituesve (ECA) dhe Kodin e Etikës së KLSH, botimin "90 Vjet KLSH", etj., si dhe tre numra të ***Revistës Shkencore "Auditimi Publik",*** e cila arriti në edicionin e 11-të të saj. Këtë vit kanë vijuar bashkëpunimin me ne për realizimin e Revistës personalitete të fushës së Ekonomisë nga vendi si dhe personalitete të njohura dhe me eksperiencë nga Institucionet Supreme të Auditimit (SAI) nga vende të rajonit e më gjerë, si Prof.Ass.Dr.Recai Akyel, Zv/President i EUROSAI-t dhe President i Gjykatës Turke të Logarive; z. László DOMOKOS, President i Zyrës Shtetërore të Auditimit të Hungarisë, audites nga SAI Kroat dhe nga Gjykata Gjermane e Auditimit.

Të nderuar deputetë,

1. Materiali i Performancës së KLSH që Ju kemi përcjelle në fund të Marsit 2016, hapet me një analize SËOT, që përfshin Fuqitë, Dobësitë, Mundësitë dhe Kërcënimet ndaj institucionit, duke e vënë theksit tek Dobësitë dhe Kërcënimet. Këtë analizë e kemi kryer me idenë që të tregojmë edhe mangësitë tona dhe bindjen që, bazuar në rekomandimet Tuaja në Rezolutë, do përmirësohemi, por, për arsye të kohës së kufizuar nuk po e paraqesim.

2. Mendojmë se është shumë e rëndësishme që marrëdhëniet e Kuvendit me KLSH të institucionalizohen dhe zhvillohen më tej, sikurse eksperiencat e shumë SAI-ve evropiane e dëshmojnë, ndoshta duke krijuar një Nënkomision që mund të trajtojë problematiken e auditimit të jashtëm publik, në strukturat e Kuvendit ose dhe brenda në Komisionin e Ekonomisë.

3. Ka ardhur koha që ne të paraqitemi disa herë gjate vitit para Komisionit të Ekonomisë. Ne si KLSH do ta vlerësonim shumë që Komisioni të merrte në konsiderate mundësinë e organizimit të një seance ku të raportonim për auditimet e performancës së KLSH gjatë këtyre katër viteve. Gjykojmë se periudha mars-prill 2017, pas miratimit të Rezolutës së Kuvendit për KLSH, do te ishte më e përshtatshmja, që të kemi kohë të reagojmë për Rezolutën Tuaj. Një auditim të rëndësishëm performancë (ate mbi liberalizimin e shërbimit të kontrollit fizik të automjeteve) e realizuam pas sugjerimit të marrë nga deputetet e Komisionit dhe do të donim që raste të tilla të shpeshtoheshin në të ardhmen.

4. Kërkojmë të zbatohet Vendimi i Kuvendit iniciuar me kërkesën e KLSH dhe Komisionit të Ekonomisë për auditimin e llogarive financiare të KLSH.

Rritja ekonomike më e ulët është pasojë dhe jo arsyeja e mosrealizimit të të ardhurave buxhetore

- *Prezantim i Raportit të Zbatimit të Buxhetit Faktik të vitit 2015*

17 tetor 2016

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, Kuvendi i Shqipërisë

Deputetët pjesëmarrës

1. Erion Braçe
2. Anastas Angjeli
3. Antoneta Dhima
4. Blerina Gjylameti
5. Ervin Koçi
6. Ridvan Bode
7. Andrea Marto
8. Evis Kushi
9. Ervin Bushati
11. Edmond Spaho
12. Florion Mima
13. Dhurata Çupi
14. Liljana Elmazi
15. Dashamir Shehi
16. Igli Cara
17. Jorida Tabaku
18. Shkëlqim Cani

Të nderuar deputetë!

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka përgatitur dhe paraqet raportin "Për zbatimin e Buxhetit të Shtetit të vitit 2015" në zbatim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit 154/2014 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit, ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", si dhe të ligjit nr.160/2014, datë 29.12.2014 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2015", i ndryshuar. Në mënyrë të sintetizuar po sjell përpara jush ato dimensione të planifikimit, implementimit e monitorimit të Buxhetit të Shtetit 2015, të cilat sipas optikës së KLSH-së kërkojnë një vëmendje të veçantë sot e në të ardhmen nga të gjitha palët e interesit dhe veçanërisht nga Ju.

KLSh, gjatë punës së saj për vlerësimin e realizimit të buxhetit të vitit 2015, ka përdorur një qasje pragmatiste, duke integruar auditimet e përputhshmërisë e ato financiare me

orientim normativ, si edhe auditimet e performancës e ato të IT me orientim kah rezultati e proceset, por gjithnjë duke e vënë theksin në identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e mirë të risqeve sistemike e me probabilitet të lartë materializimi.

Opinioni i përgjithshëm

KLSH, në këtë Raport që i paraqitet Kuvendit, shprehet qartë se vlerëson dhe inkurajon çdo reformë strukturore, përpjekjet e Ministrisë së Financave për të përafruar kornizat rregullative me praktikat europiane, në drejtim të krijimit të një sistemi efikas në menaxhimin e financave publike, por konstaton se jemi akoma larg objektivave të vendosur dhe kryesisht atyre të synuar për një stabilitet dhe qëndrueshmëri ekonomike. Në gjykimin tonë duhet të përshpejtohet puna e vendosjes dhe monitorimit të indikatorëve të performancës në financat publike dhe ecurinë e treguesve sipas shtyllave prioritare të planifikuara në Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020.

KLSH, shprehet po ashtu se, krahas vlerësimit të përpjekjeve dhe masave të marra nga Ministria e Financave, Ministritë, Institucionet e tjera qëndrore dhe vendore, si dhe entet publike të audituara, gjatë vitit 2015, në drejtim të menaxhimit të financave publike, është nevojë imediate adresimi i rekomandimeve të KLSH-së të cilat synojnë ngritjen dhe konsolidimin e një sistemi modern dhe të integruar të menaxhimit financiar, rritjen e përgjegjshmërisë, transparencës dhe qëndrueshmërisë afatgjatë të financave publike në përputhje me direktivat e integrimit europian.

Nëpërmjet këtij Raporti, KLSH sjell në vëmendje dhe adreson njëherazi Kuvendit një sërë rekomandimesh të orientuara drejt treguesve makroekonomikë që në gjykimin tonë pengojnë konsolidimin e financave publike. Këtu përmendim, kredibilitetin e buxhetit dhe konsolidimin fiskal të nevojshëm për financat, mbajtjen nën kontroll të borxhit publik dhe uljen e ekspozimit të tij me qëllim ruajtjen e stabilitetit makroekonomik të vendit, marrjen e masave për përmirësimin e rritjen e efektivitetit të menaxhimit të shpenzimeve publike, forcimin e disiplinës fiskale, etj.

Për zbatimin buxhetit të vitit 2015 janë audituar 137 institucione shtetërore dhe ndërmarrje me pronësi shtetërore, si edhe është audituar performanca e 73 institucioneve shtetërore. Nga auditimet e realizuara për efekte të implementimit të buxhetit të vitit 2015, u konstatuan dëme në shumën **8,041.4 milionë lekë ose 57,44 milionë euro**. Ndërkohë që në këto auditime janë konstatuar shkelje me efekte financiare jo efektive të cilat arrijnë në 19,984 milionë lekë ose 143 milionë euro. Efektet totale janë në shumën 200 milionë euro.

Shkeljet me dëm ekonomik në të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit të shtetit, në vlerën 8,041.4 milionë lekë ose 57.44 milionë euro detajohen si më poshtë:

- Dëmi ekonomik në të ardhurat e buxhetit të shtetit është në vlerën: 2,809.3 milionë lekë ose 20 milionë euro.
- Vlera e dëmit ekonomik në shpenzimet e buxhetit të shtetit arrin në 5,232.1 milionë lekë ose 37.44 milionë euro.
- Vetëm dëmi ekonomik i shkaktuar nga shoqëritë aksionere në total arrin vlerën 4,156.
- 4 milionë lekë ose 30 milionë euro.

Shkeljet me efekte financiare negative në buxhetin e shtetit për vitin 2015, kapin vlerën 19.984 milionë lekë ose rreth 143 milionë euro. Analiza e këtyre efekteve sipas niveleve të buxhetit, por edhe i analizuar në të ardhura dhe shpenzime jepet si në grafikun e prezantuar.

A - Risku në planifikimin e buxhetit 2015

Dështimi në planifikim është në fakt planifikim i dështimit. Edhe në vitin 2015 KLSh ka konstatuar problematika të theksuara në studimin e kujdesshëm të nevojave dhe planifikimin e mbulimit të tyre. Konkretisht:

A.1. PROGRAMIMI I PLANIT BUXHETOR AFATMESËM (PBA) 2015-2017 DHE PROGRAMIMI I BUXHETIT TË VITIT 2015

Gjatë auditimit të të gjithë procesit të PBA-së, u konstatuan tejkalime të afateve në realizimin e detyrave sipas fazave të parashikuara në ligjin organik të buxhetit të shtetit, dhe sipas akteve ligjore në funksion të tij. Referuar treguesve të parashikuar në kuadrin makro e të miratuar me bazën ligjore përkatëse konstatojmë se, totali i të ardhurave të parashikuara për vitin 2015 ka qenë me një shtesë prej 24,103 milionë lekë, në krahasim me realizimin faktik të vitit 2014. Kjo rritje rezulton të jetë më së shumti impakt i parashikimit në rritje të të ardhurave tatimore e doganore, planifikuar rreth 8% më shumë nga fakti 2014, por që në fund të vitit ushtrimor 2015 kanë rezultuar të realizuara 2% më shumë nga fakti 2014.

Ndër argumentet e përdorur për nënperformancën e tatimeve dhe doganave është edhe rritja ekonomike më e ulët se pritshmëritë, e cila në gjykimin tonë është pasoja dhe jo arsyeja e mos realizimit të të ardhurave, që do të thotë, nëse të ardhurat e parashikuara nuk realizohen, atëherë rritja ekonomike në vetvete nuk realizohet.

Ndërkohë, nëse analizojmë të ardhurat në raport me PBB-në, konstatojmë se u planifikua një rritje e të ardhurave me rreth 2% e PBB-së, në krahasim me treguesit

faktikë të vitit 2014, ndërkohë që treguesit faktikë të vitit 2015 treguan një raport Të ardhura / PBB pothuajse të pandryshuar si në vitin paraardhës.

Planet e mbivlerësuara riskojnë të inkurajojnë shpenzime jo realiste, të cilat gjatë vitit kanë rezultuar më pas të jenë rishikuar duke u shkurtuar.

Është konstatuar se, ndryshimet e buxhetit që kanë ndodhur gjatë vitit 2015 (si në ndryshimin e ligjit me akte normativ, ashtu edhe në nivelin e realizueshmërisë së tij), janë reflektuar edhe në treguesit e konsoliduar sipas kuadrit makro, duke bërë kështu që edhe pse programimi është për periudhën pas vitit 2015 (pra PBA 2016-2018), ka vijuar të ndryshohet edhe vetë viti 2015.

Me ekzistencën e nevojës, urgjencës për disa ndryshime në ligjin e buxhetit, Kuvendit i janë adresuar njëkohësisht edhe ndryshime jo domosdoshmërisht urgjente. **Në këto kushte, veprimi i më sipërm bën që kuadri makro të humbasë konceptin e të qenit instrument strategjik, pasi duke iu përshtatur kuadri makro ndryshimeve në buxhetin vjetor, ai nuk shërben më si pikë reference.**

Sa më sipër e konfirmojnë gjithashtu ndryshimet e shpeshta që kanë pësuar treguesit e buxhetit të vitit 2015 (4 herë), duke filluar nga kuadri makro e deri në ndryshimet e reflektuara në Aktin Normativ nr. 3 (pa përfshirë këtu edhe ndryshimet në PBA 2016-2018, të sqaruara më sipër).

Gjithashtu, nga auditimi vazhdojmë të konstatojmë se, ende nuk është krijuar një Këshill i Pavarur Fiskal që të kryejë vlerësimet e parashikimeve të qeverisë, në kushtet kur çdo parashikim ndryshon nga ai i mëparshmi. Problemi i parashikimeve jo realiste minon atë që në të kundërt do të ishte një sistem efektiv dhe transparent buxhetimi dhe planifikimi fiskal afatmesëm.

Edhe për këtë vit ka vijuar praktika e ndryshimit të buxhetit të shtetit me Akt Normativ, i cili gjatë viteve të fundit miratohet në Parlament pasi është mbyllur buxheti. Pasojat praktike të akteve normative janë të paqarta. Ato zakonisht miratohen nga qeveria në ditët e fundit të muajit dhjetor dhe ndryshojnë planin e të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit të shtetit për ta përshtatur me realizimin faktik të të ardhurave dhe shpenzimeve. Në disa raste, aktet normative shërbejnë për të mbuluar ligjërisht shpenzime të kryera që ndonjëherë mund të jenë edhe në kundërshtim me ligjin e buxhetit.

PBA si produkti më i rëndësishëm i shtyllës së dytë të Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike "Planifikim dhe buxhetim i mirëintegruar dhe efiçient i shpenzimeve publike", duhet të shërbejë si një udhërrëfyes i besueshëm në programimet e ardhshme të burimeve publike. Në mënyrë që të realizohet ky objektiv i rëndësishëm duhet që:

- ✓ Prioritetet e politikave buxhetore duhet të udhëhiqen nga planet kombëtare dhe sektoriale, të kufizuara tërësisht nga korniza makroekonomike dhe fiskale, si dhe plotësisht të integruara në kalendarin buxhetor;
- ✓ PBA të sigurojë tavane të detyrueshme për përgatitjen e detajuar të buxhetit, si dhe tavane indikative për vitet më tej;
- ✓ Edhe pse tashmë është bërë progres për vendosjen e një kuadri institucional për buxhetimin, me miratimin së fundmi (korrik, 2016) të Ligjit të Ri Organik për Buxhetin (dhe pse në Strategjinë për menaxhimin e Financave Publike ishte parashikuar si afat, viti 2015), nën gjykimin tonë e gjitha kjo duhet të shoqërohet me: (a) përforcim i rregullave dhe procedurave të reja; (b) më shumë transparencë dhe më pak rialokime në fazën ekzekutive të buxhetit, me qëllim ruajtjen e integritetit të proceseve vjetore dhe 6-mujore të buxhetimit; (c) më shumë monitorim dhe analizë për të përforcuar incentivat për përmirësimin e kualitetit të planeve afatmesme të buxhetit. Ministria e Financave duhet të forcojë sistemet e saj të menaxhimit të shpenzimeve, si forca shtytëse për politikat e saj fiskale dhe gjithashtu për implementimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim.
- ✓ Ngritja e Këshillit të pavarur Fiskal për te vlerësuar dhe analizuar parashikimet është kërkesë imediate. Këtë kërkesë KLSh e ka paraqitur pareshtur që nga viti 2014.

A.2. MBI MANAXHIMIN E BORXHIT PUBLIK

Niveli i borxhit publik (si % kundrejt PBB) nuk tenton drejt parametrave të synuar, pasi për vitin 2014 niveli i borxhit publik u rrit në nivelin (73.49%), kurse për vitin 2015 niveli i borxhit publik ka arritur në (73.86%) dhe është larg trendit që të çon në synimin strategjik të vitit 2017 prej 65.5%, i cili në këto kushte mund të konsiderohet praktikisht i paarritshëm. Në strategjinë afatmesme të menaxhimit të borxhit publik për vitet 2014-2016 mungon një analizë e treguesve mbi qëndrueshmërinë e borxhit të jashtëm, kurse në strategjinë afatmesme për vitet 2015-2017 është kryer një analizë e tillë, por gjykojmë se skenarët janë më shumë teorikë sesa në përshtatje me kushtet në të cilat manaxhohet borxhi në Shqipëri. Një gjë e tillë riskon të stimulojë masa të cilat nuk përshtaten me nivelet aktuale të borxhit publik.

Konkretisht, në strategjinë e menaxhimit të borxhit 2015-2017 synohen: 1. Zëvendësimi i stokut afatshkurtër të borxhit me stok afatgjatë, me argument kryesor shmangien e riskut të rifinancimit, dhe 2. Zëvendësimi i borxhit vendas me borxh të nominuar në valutë të huaj me argument kryesor daljen në tregjet e huaja të kapitalit dhe përmirësimin e mëtejshëm të strukturës aktuale të borxhit, ku risku i rifinancimit mbetet faktori kryesor. KLSh gjykon se një analizë e tillë është e pjesshme, sepse nuk vlerëson siç duhet një sërë karakteristikash apo risqesh të financimit me tituj me shpenzime fikse,

siç janë: 1. Kosto më e lartë e borxhit nëse zhvendosemi nga financimi me tituj afatshkurtër në financim me tituj afatgjatë; 2. Mospërputhje e maturiteteve midis financimit me tituj afatgjatë dhe përdorimit të parave që burojnë nga këta tituj në zëra afatshkurtër, kryesisht paga. Një mospërputhje e tillë shton barrën e shlyerjes së borxhit afatgjatë në të ardhmen, si edhe dëshmon për një ineficiensë në përdorimin e tij (zakonisht titujt afatgjatë përdoren për investime afatgjata); 3. Ekspozimit ndaj riskut të kursit të këmbimit; dhe 4. Rritje potenciale e riskut të riinvestimit.

Duke parë sjelljen dinamike të borxhit publik dhe rritjes ekonomike, vëmë re se prirja rënëse e rritjes ekonomike përkon me periudhën kur borxhi publik është në rritje. Nga paraqitja grafike e të dhënave dinamike të serisë së rritjes ekonomike dhe shtesës së borxhit publik real, konstatojmë një marrëdhënie negative, ndërkohë që eksperiencat dhe praktikat e mira tregojnë se shtesa e borxhit është e frytshme nëse vendi reflekton një rritje ekonomike, duke patur perspektiva pozitive të zhvillimit ekonomik dhe mirëqenies për qytetarët.

A.3.MBI PLANIFIKIMIN E SHPENZIMEVE KAPITALE

Konstatohet se, mungon një vlerësim i plotë i procesit vendimmarrës të investimeve publike në planifikimin e niveleve të qëndrueshme të investimeve në të gjithë sektorin publik; shpërndarjen e investimeve në sektorët dhe projektet e duhura; zbatimin e projekteve në kohë dhe brenda buxhetit të parashikuar, pasi përmirësimet në menaxhimin e investimeve publike mund të rrisin ndjeshëm efektivitetin dhe produktivitetin e tyre.

Mungon një veprim konkret për forcimin e kapaciteteve të administratës publike në lidhje me vlerësimin ekonomik të projekteve të investimeve kapitale, pra shoqërimi i analizave të përfitimeve sociale nga projektet respektive të cilat shoqëruar me të ardhurat financiare duhet që të tejkalojnë kostot e projektit. Këto kapacitete do të përdoren edhe për të vlerësuar, pas realizimit, kthimin social-ekonomik në projektet e realizuara të investimeve.

A.4.MBI LLOGARITË FINANCIARE TË KONSOLIDUARA TË SHTETIT

Konstatohet se edhe për vitin 2015, llogaritë e konsoliduara vjetore për transaksionet financiare të shtetit, vijojnë të mos jenë pjesë e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit. **Mungesa disavjeçare e pasqyrave të konsoliduara të shtetit, në gjykim tonë ndikon jo vetëm në nivelin e transparencës, por gjithashtu lidhet ngushtë me analizën e treguesve makro-ekonomikë.** Aktualisht, mbajtja e kontabilitetit në sektorin publik rregullohet mbi bazën e "Planit kontabël të Organeve të Pushtetit Lokal dhe Institucioneve Shtetërore Qendrore dhe Lokale dhe njësive që varen prej tyre", në një kohë që ky Plan Kontabël mbështetet mbi një bazë ligjore të shfuqizuar (konkretisht

mbi ligjin nr. 7661, datë 19.1.1993 "*Për kontabilitetin*"). Në vijim të sa më sipër, konstatohet mungesa e një manuali të kontabilitetit publik (apo udhërrëfyesi për mbajtjen e kontabilitetit në sektorin publik) i cili do të bënte të mundur vendosjen e rregullave dhe procedurave kontabël për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e Pasqyrave Financiare në mënyrë që të ketë konsistencë të trajtimit kontabël. Ndërsa rëndësia e konsolidimit të pasqyrave financiare është esenciale, Sektori i Raportimit Financiar dhe Kontabilitetit, në Drejtorinë e Operacioneve të Thesarit që parashikohet të mbulojë detyra që lidhen me procesin, ka vetëm dy specialistë, të cilët janë njëkohësisht përgjegjës edhe për një sërë detyrash të tjera. Mungesa e stafit, por edhe mbivendosja e funksioneve dhe përgjegjësive në një periodicitet të shtuar sjell një risk operacional të lartë dhe hapësira për të mos përmbushur misionin kryesor: atë të kujdesit për një raportim financiar sipas parimeve kryesore të kontabilitetit në sektorin publik. Kjo situatë që përsëritet me vite reflekton nënvlerësimin e rëndësisë që ka një raportim i saktë i financiar në llogaridhënien, planifikimin e shëndetshëm, por edhe transparencën e gjendjes në të cilën ndodhen financat e shtetit.

Në referencë të konstatimeve, arrijmë në përfundimin se pasqyrat financiare të konsoliduara (paraprake) të gjeneruara nga Sistemi Informativ Financiar i Qeverisë (SIFQ) nuk japin një pamje të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të mjeteve monetare të Qeverisë.

Gjithashtu kemi konstatuar ndryshime të vazhdueshme në bilancin e çeljes së vitit ushtrimor 2015, të printuar nga Sistemi Financiar i Qeverisë, përgjatë datave të ndryshme (respektivisht në muajt Qershor, Korrik të vitit 2016), që do të thotë se, edhe pse bilancet e njësive mbyllen më datë 28 shkurt, në Sistemin Financiar të Qeverisë vijohen të bëhën ndryshime edhe pas kësaj date, në kundërshtim me kërkesat e nenit 14, **të** ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"**,** ku citohet se: "Kohëzgjatja e ushtrimit kontabël është 12 muaj"; dhe se "Ushtrimi kontabël fillon më datën 01 janar dhe përfundon në datën 31 dhjetor". Nga auditimi financiar i realizuar në disa entitete kemi konstatuar se nuk hartohen pasqyrat financiare të konsolidura, si në rastin e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Ministrisë së Mjedisit. Konstatohet se, vëmendja për kontabilitetin dhe raportimin në sektorin publik është e pakët, shtuar kjo me mungesë të një kornize adekuate të kontabilitetit publik dhe raportimit financiar, mungesa e standardeve kontabël për këtë sektor dhe niveli i ulët i përgatitjes së punonjësve që mbulojnë kontabilitetin në sektorin publik (e theksuar kjo kryesisht në pushtetin vendor), reflektojnë një risk të lartë që ndikon në menaxhimin e financave publike. Kultura e ulët menaxheriale reflektohet në mungesë vëmendje ndaj informacionit kontabël që është në fakt duhet të jetë gjuha e komunikimit jo vetëm për Kuvendin, por edhe për publikun.

A.5.MBI PROKURIMET PUBLIKE

Një nga kërcënimet e financave publike është niveli i ulët i efektivitetit në prokurimin e mallrave, shërbimeve dhe realizimit të punimeve kryesisht në infrastrukturën rrugore. Ajo që nuk po arrihet të sigurohet përmes sistemit elektronik të prokurimit është vlera për paranë e shpenzuar, një tregues i rëndësishëm për një sistem efiçient prokurimi publik. Megjithë vëmendjen e shtuar të të gjithë aktorëve dhe faktorëve që përfshihen në menaxhimin e financave publik, në drejtim të përmirësimit dhe forcimit të sistemit të prokurimit publik ka aspekte të cilat adresojnë nevojën për ndërhyrje. Nga të dhënat e siguruara nga Agjensia e Prokurimit Publik por edhe bazuar në auditimet e realizuara për efekt të realizimit të buxhetit 2015 kemi konstatuar;

Gjatë vitit 2015, autoritetet kontraktore nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit kanë shpallur 4,630 procedura prokurimi për shërbime, mallra e punë për të cilat u akordua një fond limit prej 90,702 milionë lekë, vlerë kjo 33% më e madhe se ajo e alokuar përgjatë vitit 2014. Nga analiza konstatohet se rritjes së fondit të alokuar gjatë vitit 2015 i korrespondon një uljeje prej rreth 12% e numrit të procedurave të prokurimit. Nga këto procedura të publikuara janë shpallur fitues në 4,269 njoftime fituesish me një fond limit prej 70,811 milionë lekë dhe fond të prokuruar prej 64,325 milionë lekë.

Ajo që synohet nga një sistem modern prokurimi janë plotësimi i parimeve kryesore të konkurrencës, tregut të lirë dhe efektivitetit në prokurimin e mallrave, të shërbimeve dhe punimeve që përbëjnë dhe bazën kryesore të fondeve të prokuruara.

Shpërndarja e efektivitetit të fondeve të prokuruara

Meqenëse numri i faktorëve që ndikojnë në procedurat e prokurimit publik është i madh dhe pesha e tyre e vogël, KLSH analizoi të dhënat përmes supozimit të shpërndarjes normale. Numri total i procedurave të analizuara është 3,109 nga 4,630 dhe nga analizimi i kambanës vërejmë se:

- përqendrimi në zonën qendrore nuk është shumë i lartë, pasi kambana që tregon shpërndarjen e efektivitetit nuk është shumë e sheshtë.
- kulmi i grafikut përkon me një efektivitet prej 14% që do të thotë se shumica e prokurimeve kanë një kursim nga fondi limit mesatarisht 14%
- në zonën me efektivitet nga 7% deri me 21 % ndodhen 31.5 % të numrit të procedurave të prokurimit, që do të thotë se 1/3 e prokurimeve janë realizuar duke kursyer 7-21% të fondit limit.

Një diferencë e tillë përbën zonë me pak risk të vlerësuar, ku gjithashtu nga paraqitja grafike konstatohet lehtësisht se nuk kemi një shpërndarje normale të efektivitetit të prokurimeve përgjatë vitit 2015.



B - Risku i implementimit dhe monitorimit

Parimi 7-të i qeverisjes buxhetore të OECD-së kërkon një planifikim, menaxhim dhe monitorim efektiv të procesit të ekzekutimit të buxhetit. Ky proces, gjatë vitit 2015 ka paraqitur problematikë si pasojë e risqeve që lidhen me besueshmërinë e llogarive dhe rolin i kontabilitetit dhe raportimit financiar publik. Konkretisht mungesa e kuadrit të mire-rregulluar kontabël cenon jo vetëm raportimin financiar por edhe buxhetimin në vetvete. Megjithë këmbënguljen tonë në drejtim të nevojës për miratimin e ligjit "Për kontabilitetin në sektorin publik", përpjekjet e Ministrisë së Financave në këtë drejtim janë larg emergjencës që reflekton kjo situatë. **Praktikat e vendeve të tjera kanë treguar se, një procesi kontabilizimi që nuk ofron një pamje të plotë dhe të qartë të pozicionit financiar dhe ekonomik të vendit, padyshim riskon që ta udhëheqë procesin e buxhetimit drejt objektivave jo të sakta e të duhura, duke rezultuar në vendime jo efektive.** Dështimi për të integruar informacionin kontabël në procesin e buxhetimit, largon vendim-marrësit nga të dhëna thelbësore sa i takon vlerësimit të alternativave për alokimin e burimeve. Gjithashtu është gati e pamundur të masësh rezultatet e arritura kundrejt planeve, pa informacionin kontabël. Si pasojë, në mënyrë që këto politika për publikun të jenë efektive, procesi i buxhetimit dhe kontablizimit nevojitet të integrohen.

Në kuadër të raportimit jo korrekt, është konstatuar se shpenzimet e Fondit të Zhvillimit të Rajoneve janë regjistruar pjesërisht si shpenzime kapitale për qeverisjen qendrore, në një kohë që raportohen të planifikuara për qeverisjen vendore, duke ulur me pa të drejtë performancën e vendorit dhe rritur atë të qendrorit dhe duke denatyruar transfertën, nga e pakushtëzuar (si pjesë e tabelës 3, te Ligji organik i buxhetit "Shpërndarja e transfertës së pakushtëzuar për bashkitë) në transfertë të kushtëzuar (shpenzime për qeverisjen qendrore). Ndërkohë për të bërë analiza substantive (teste

thelbësore), sipas standardeve ndërkombëtare të auditimit publik, për të bërë krahasime, nevojitet që, "emëruesi të jetë i përbashkët", pasi në të kundërt paraqitja e buxhetit, duke denatyruar shpenzimet (sikundër ka ndodhur me shpenzimet kapitale) është çorientuese dhe nuk jep një pamje të qartë dhe transparente të shpenzimeve publike.

Gjithashtu në raportin e buxhetit faktik që Ministria e Financave ka dorëzuar në Kuvend, vlera e detyrimeve të prapambetura paraqitet rreth 81 milionë lekë më shumë nga raportimi sipas treguesve fiskalë të konsoliduar, duke treguar dhe njëherë mangësi në raportim dhe procese të cenuara të rakordimit sa i takon fondeve publike. Tabela e treguesve fiskalë të konsoliduar është produkti më i rëndësishëm, nga të dhënat e të cilit publiku pritet të marrë informacion rreth shpenzimeve dhe kostove publike. Raportimi jo i saktë dhe me gabime cenon besueshmërinë e këtij raporti dhe ofron informacion çorientues. Reflektimi i dy informacioneve të ndryshme për të njëjtin zë (atë të shpenzimeve të prapambetura), nga dy burime të ndryshme brenda të njëjtës Ministri (Drejtoria e Thesarit dhe ajo e Detyrimeve të Prapambetura) tregon jo vetëm mungesën e bashkëpunimit dhe koordinimit, por edhe mungesë përgjegjshmërie që cenon transparencën dhe besueshmërinë e informacionit se si janë shpenzuar paratë e taksa-paguesve

B.1. MBI DEFICITIN E PËRGJITHSHËM TË BUXHETIT TË SHTETIT TË VITIT 2015

Në treguesit fiskalë të vitin 2015 rezulton se është respektuar "rregulli i artë", pra deficiti në fund të vitit, nuk ka tejkaluar shpenzimet kapitale, madje nga auditimi i ecurisë së këtij zëri , kemi konstatuar një reflektim për të ulur nivelin mjaft të lartë të deficitit të rezultuar gjatë vitit 2014. Gjithashtu, një tregues i rëndësishëm i deficitit është raporti i tij ndaj PBB-së, për të cilin konstatohet se ka një përmirësim të situatës krahasuar me vitet 2013 dhe 2014. Pavarësisht sa më sipër, duhet treguar kujdes në cilësinë e raportimit të shpenzimeve kapitale, pasi një raportim i cenuar i tyre, sikundër u përmend më sipër, riskon të cenojë "rregullin e artë" në vetvete.

B.2. MENAXHIMI I BORXHIT PUBLIK

Nga auditimi i nënhuave, garancive shtetërore dhe huamarrjen vendore, u kostatua se: - Stoku për kreditë ekzistuese ka arritur në masën 507 milionë euro. Rreth 50% e shumës së investuar në sektorin publik nëpërmjet skemës së nënhuazimit i përket sektorit të energjisë, rreth 32% i përket sektorit të ujësjellësve dhe rreth 18% janë në sektorët transport, mikrokredi dhe për qëllime sociale. Stoku i nënhuasë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar rezulton i rritur në rreth 79 milion euro. Për vitin 2015 nga rreth 4,245 milion lekë që duhet të ishin hyrjet nga nënhuaja (ripagesat principal dhe interesa), janë arkëtuar vetëm 1,222 milion lekë, ose 29% e planit të arkëtimeve, me një impakt në buxhet prej 3.023 milion lekë të ardhura të munguara.

B.3. MBI ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AUDITIMIT TË BRENDSHËM DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

Megjithë vlerësimin lidhur me përpjekjet për të përafruar legjislacionin me praktikat më të mira europiane, konstatojmë se mënyra e zgjedhur për të rregulluar auditimin e brendshëm në sektorin publik, nuk është në unison me kulturën e drejtimit dhe mjedisin shqiptar ku vepron ky audit. Gjykojmë se kërkesat në ligjin e ri për auditimin e brendshëm në sektorin publik reflektojnë minimizim të rolit të strukturave përgjegjëse të auditimit të brendshëm në luftën ndaj krimit ekonomik dhe korrupsionit, pavarësisht se ka shumë nevojë për këtë rol nisur nga niveli i lartë i korrupsionit në Shqipëri.

Por kjo frymë e ligjit nuk është në unison me kulturën e drejtimit në institucionet publike në Shqipëri. Mungesa e kulturës drejtuese bën që strukturat e auditit të brendshëm, në varësi të drejtpërdrejtë të titullarit nuk qëndrojnë dot jashtë ndikimit të tij apo të strukturave të tjera të menaxhimit të lartë të njësisë publike që bëjnë rekrutimin. Kjo situatë mbart riskun që strukturat audituese në çdo kohë mund të cenohen dhe të ndikojnë në objektivitetin e procesit e veçanërisht në planifikimin dhe realizimin e shërbimeve të auditimit.

Sipas ligjit të ri, njësive ekzistuese të auditimit të brendshëm, në referencë të nenit 13, është futur koncepti i "Komiteti i Auditimit të Brendshëm", i përcaktuar si: "Komiteti i Auditimit të Brendshëm është organ i pavarur, monitorues e këshillues për titullarin e njësisë publike, si dhe mbështetës për NJAB", pavarësia e të cilit është e sanksionuar, por nuk cilësohet dhe argumentohet mënyra se si kjo sigurohet fillimisht e garantohet në vazhdimësi.

Nga auditimi konstatohet se, nga një numër i konsiderueshëm i titullarëve të njësive të qeverisjes së përgjithshme nuk është siguruar shërbimi i auditimit të brendshëm në njësitë e tyre, pasi në njësinë përgjegjëse për AB në Ministrinë e Financave, për Planin Strategjik 2016-2020, kanë raportuar treguesit e tyre vetëm 99 NJAB dhe për realizimin e programit të auditimit të brendshëm për vitin 2015 kanë paraqitur raportet e tyre 103 NJAB dhe nuk ka informacion se si është organizuar ky shërbim në mbi 70 njësi publike. Për këtë mbajnë përgjegjësi titullarët e njësive publike, por nga ana e Ministrit të Financave, si përgjegjës për bashkërendimin e përgjithshëm, harmonizimin dhe monitorimin e veprimtarisë së AB në njësitë e sektorit publik, përgjegjësi mbart edhe njësia përkatëse për harmonizimin e AB në Ministrinë e Financave, që zhvillon, administron dhe zbaton strategjinë e harmonizuar në fushën e ABP, si dhe e monitoron këtë veprimtari në nivel kombëtar. Të gjitha palët sa më sipër duhet të gjejnë formën e duhur që ky shërbim tepër i rëndësishëm, i cili jep mbështetje për titullarin në arritjen e objektivave të njësisë, të organizohet në njërën nga mënyrat e përcaktuara me ligj, nga të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme të përcaktuara në nenin 3, të këtij ligji.

Nga 99 NJAB që kanë paraqitur planet strategjike dhe vjetore janë evidentuar 1,596 objekte për t'u audituar, ose 252 objekte më pak se ato të planifikuara për vitin 2014 ndërsa për vitin 2016 janë planifikuar 1,637 auditime. Për kryerjen e këtyre auditimeve në këto njësi janë angazhuar 364 auditues të brendshëm, të cilët konstatohet të jenë rreth 3 herë më shumë në numër, krahasuar me audituesit e KLSH-së. Po kështu, vlen të theksohet se në fushën e auditimit publik angazhohen edhe ekspertë kontabël të cilat auditojnë pasqyrat e shoqërive aksionare publike. Këta ekspertë, në vlerësimin paraprak që KLSH ka bërë përmes auditimit të performancës në proces, kryejnë një auditim ineficient, duke u paguar në shuma mjaft të mëdha monetare për të njëjtën punë rutinore që shoqëria aksionare i kontrakton, madje jo përmes procedurave normale të prokurimit publik.

Së fundmi, KLSh thekson se një audit i brendshëm me pozita solide e profesionale është një vlerë e çmuar edhe për auditimin e jashtëm publik. Forcimi i strukturave të Auditit të Brendshëm merr rëndësi esenciale edhe për punën tonë si auditues të jashtëm. Një punë e mirë e auditimit të brendshëm përkthehet në evidenca më të besueshme, të mjaftueshme e rilevante për audituesit e KLSh-së, duke u bërë kështu burim i vlefshëm informacioni dhe duke na dhënë më tepër mundësi të fokusohemi në auditimet e performancës, si auditime më të thelluara në ekonomicitetin, efiçiencën dhe efektivitetin e përdorimit të fondeve publike, apo në auditimet financiare të cilat kërkojnë ndër të tjera sisteme të konsoliduara të auditit të brendshëm, mbi të cilat të mbështeten.

B.4. NGA AUDITIMI NË BANKËN E SHQIPËRISË

Në përfundim të auditimit të realizuar në Bankën e Shqipërisë, kemi rekomanduar dhe kemi kërkuar vëmendje të shtuar lidhur me ndërhyrjet që janë të domosdoshme të bëhen sa i takon amendimeve në Ligjin nr. 8269 datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", ndërhyrje që krahas synimit për të sjellë një përafrim me kërkesat e Bankës Qendrore Europiane, duhet të marrin në konsideratë edhe aspektet dhe kontekstin ku do të implementohet ky ligj. Edhe pse kemi vlerësuar përpjekjet dhe reformat institucionale që Banka ka ndërmarrë, në drejtim të krijimit të një kuadri ligjor sa më të plotë menaxhues, për forcimin e funksioneve monitoruese, ende ka punë për të bërë. Në planin e masave të aprovuar për vitin 2016 nga SAFEGUARD, (FMN) është parashikuar që propozimet për ndryshimet ligjore do të paraqiten pranë Kuvendit të Shqipërisë si institucioni ligjvënës i ngarkuar nga Kushtetuta për të realizuar veprimtarinë legjislative në Republikën e Shqipërisë brenda vitit 2016, megjithatë deri në fund të këtij auditimi konstatuam se propozimet për ndryshime ligjore jo vetëm nuk janë paraqitur pranë Komisionit të Ekonomisë, por edhe nuk janë hedhur në diskutim mes grupeve interesi dhe ekspertëve të fushës, proces vendimtar ky për një praktikë legjislative të suksesshme dhe të qëndrueshme. Nga Banka është parashikuar të realizohet një proces gjithëpërfshirës duke filluar që nga bashkëpunimi me institucionet

financiare ndërkombëtare, dhe deri në konsultime të ngushta me organet më të larta ekzekutive dhe legjislative në vend, por mungon një plan i detajuar për grupet që do të përfshihen në këtë proces dhe afatet konkrete që do të mundësonin ndjekjen e realizimit të kësaj iniciative ligjore.

B.5. NGA AUDITIMI NË INSTITUTIN E SIGURIMEVE SHOQËRORE

Me gjithë përpjekjet dhe punën e mirë të evidentuar gjatë këtij viti në administrimin e kujdesshëm të sistemit të sigurimeve shoqërore, u konstatuan përsëri problematika që kanë ndikuar negativisht në treguesit financiar dhe në qëndrueshmërinë fiskale të këtij sistemi. Edhe pse rezultati i vitit 2015 ka qenë me fitim në shumën 1,320 milion lekë, përsëri financimi nga buxheti i shtetit, me qëllim balancimin e buxhetit të përgjithshëm të sigurimeve shoqërore, ka vijuar të mbetet tepër i lartë.

B.6. MBI AUDITIMIN E ADMINISTRATËS TATIMORE DHE DOGANORE

Të ardhurat tatimore bruto për vitin 2015, janë planifikuar në shumën 126,293 milion lekë, dhe realizuar në vlerën 120,787 milion lekë, pra 5,506 milionë lekë (ose 4.4%) më pak se plani; ndërsa të ardhurat tatimore neto janë realizuar në vlerën 113,095 milion lekë, ose në masën 97.4 % kundrejt planit. Në nivelin e ulët të realizimit të të ardhurave tatimore kanë ndikuar zërat e mëposhtëm:

- Të ardhurat nga TVSH, me mosrealizim në vlerën 2,911 milion lekë më pak se plani, ose me realizim në masën 92.6 %.
- Të ardhurat nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale, me mosrealizim në vlerën 2,138 milion lekë më pak kundrejt planit, ose me realizim në masën 93.3 %
- Të ardhurat nga Taksat Kombëtare, me mosrealizim, në vlerën 1,898 milion lekë më pak kundrejt planit, ose me realizim në masën 93.9 %
- Të ardhurat tatimore nga tatimet sipas "Raportit për zbatimin e Buxhetit të Shtetit" janë në vlerën 114.7 miliard lekë, ndërsa sipas Aktrakordimit të mes Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Sistemit Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ), paraqiten në vlerën 113.1 miliard lekë.

C - Opinioni përmbyllës

Rekomandimet kryesore dhënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit:

C.1. Mbi <u>Programimin Buxhetor Afatmesëm (faqe 266 -269 e raportit),</u> kemi rekomanduar:

Me qëllim që PBA, si produkti më i rëndësishëm i shtyllës së dytë të Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike, të shërbejë si një udhërrëfyes i besueshëm në programimet e ardhshme të burimeve publike, duhet që:

- Prioritetet e politikave buxhetore të udhëhiqen nga planet kombëtare dhe sektoriale, të kufizuara tërësisht nga korniza makroekonomike dhe fiskale, si dhe plotësisht të integruara në kalendarin buxhetor;

- Propozimet për projektet e mëdha të investimeve publike të vlerësohen teknikisht dhe financiarisht, paraprakisht dhe përpara shqyrtimit dhe përfshirjes e tyre në buxhet. Për projektet e investimeve merr rëndësi kryerja e analizave ekonomike të avancuara, në përputhje me praktikat më të mira që ofron BE.

- PBA të sigurojë tavane të detyrueshme për përgatitjen e detajuar të buxhetit, si dhe tavane treguese për vitet më tej;

- Decentralizimi fiskal të përgatitet në një kuadër ligjor efektiv dhe realist.

- Procesi i programimit të buxhetit të synojë garantimin e kredibilitetit të tij nëpërmjet një politikë fiskale të qëndrueshme, në respekt të plotë të objektivave fiskalë afatmesëm dhe të shërbejë si një instrument efektiv për ta mbajtur qeverinë të përgjegjshme në arritjen e objektivave të saj. Qëndrueshmëria makro-fiskale dhe stabiliteti i sektorit financiar, konsiderohen si një ndër përparësitë më të mëdha, për shkak të ndikimit thelbësor mbi aftësinë e vendit për të kaluar në një model rritjeje të qëndrueshme. Në këto kushte iniciativa për krijimin e Këshillit të Pavarur Fiskal duhet të jetë prioritet.

- Objektivat fiskale të jenë të qarta dhe të verifikueshme dhe t'u lehtësohet njerëzve të kuptuarit e politikave fiskale dhe financiare në të gjithë ciklin ekonomik, mekanizmat institucionalë për të siguruar një perspektivë të pavarur në këtë drejtim, pra buxhetimi me qëllim që të jetë një urë lidhëse për llogaridhënie drejt qytetarëve.

- Konsultimi me grupet e punës në fazën përgatitore nuk duhet të jetë një proces formal dhe në letra, por një proces efektiv për të kuptuar nevojat dhe vlerësuar burimet në dispozicion, kjo do të ndihmojë procesin për të kaluar drejt një buxheti kredibël. Bashkëpunimi me shoqërinë civile do të shtonte vlerë në këtë proces të rëndësishëm.

C.2. Mbi saktësinë e raportimit të treguesve fiskalë (faqe 269-271 e raportit) kemi rekomanduar:

1. Në lidhje me raportimin e shpenzimeve kapitale**:**

- Nga Ministria e Financave të kërkohet përfshirja e Fondit të Zhvillimit të Rajoneve në procesin e PBA-së, duke konsideruar gjithashtu vlerën në rritje, që ky fond zë ndaj total shpenzimeve kapitale (aktualisht 14,979 milionë lekë, pra rritur 210% më shumë se viti 2014). Ngritja e strukturave monitoruese në Ministrinë e Financave

për investimet kapitale, jo vetëm të qeverisjes qendrore por edhe të vendores merr rëndësi në terma të raportimit financiar.

- Për të shmangur denatyrimin dhe raportimin e saktë të shpenzimeve, në tabelën e treguesve fiskalë të konsoliduar, të identifikohen si zë më vete "shpenzimet kapitale për pushtetin vendor", nën zërin e "shpenzimeve kapitale" dhe të mos vijohet më tej me raportimin e tyre nën zërin e "shpenzimeve korrente", në respekt edhe të parimit 7 dhe parimin 4 të qeverisjes buxhetore, sipas OECD-së.

2. Sa i takon pasaktësive dhe nevojës për sistemime të mëtejshme <u>në raportimin e treguesve fiskalë</u> si: diferenca në raportimin e "Detyrimeve të Prapambetura"; ose përdorimi i fondeve buxhetore për shlyerjen e detyrimeve të konsideruara si të prapambetura, por të pakontabilizuara dhe të panjohura si të tilla në pasqyrat financiare (respektivisht rasti i likuidimit të Albtelecom sha nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë apo rasti i konstatuar në Universitetin "Aleksandër Moisiu), **kemi rekomanduar:**

- Të merren masa jo vetëm organizative por edhe disiplinore për të gjitha rastet kur cenohet saktësia e treguesve të buxhetit, në mënyrë që të konsolidohet një praktikë e mirë drejt një buxheti që reflekton një llogari të financave publike, të besueshme, gjithëpërfshirëse, korrekte dhe të kujdesshme, ku koordinimi dhe bashkëpunimi mes njësive të ndryshme merr rëndësi esenciale dhe emergjente, në përputhje me kërkesat e parimit 5, të qeverisjes buxhetore të OECD-së.

- Strukturat drejtuese të Ministrisë së Financave, në mënyrë që të risin transparencën e përdorimit të këtyre fondeve, të iniciojnë inspektime financiare në institucione buxhetore, për të verifikuar ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e përdorimit të detyrimeve të prapambetura, në mënyrë që të mos përsëriten raste të likujdimit të detyrimeve të pa njohura në pasqyrat financiare të institucioneve, apo të pa kontabilizuara si shpenzime të njohura.

3. Sa i takon <u>Projekteve me Financim të Huaj</u> kemi rekomanduar:

- Nga Ministria e Financave të merren masat në drejtim të krijimit të një baze të dhënash, jo lehtësisht të modifikueshme për projektet me financim të huaj, me kontroll të shtuar shtetëror për ecurinë e tyre, në funksion të regjistrimit të saktë dhe të plotë të treguesve në lidhje me shpenzimet kapitale me financim të huaj. Në mënyrë që të mos ketë devijime të raportimit por edhe të shtohet kontrolli, duhet të orientohen projektet drejt skemës së plotë të thesarit, duke minimizuar grantet dhe projektet e skemës së pjesshme për të cilat humbet gjurma audituese duke ngritur një sistem raportimi mbi bazë të praktikave më të mira të kontabilizimit dhe raportimit të tyre si dhe domosdoshmërish të ndërpriten praktikat e alokimit të fondeve nga një projekt drejt tjetrit.

C.3. Sa i takon Menaxhimit të Borxhit Publik (faqe 271 – 275 e Raportit), kemi rekomanduar:

- Me qëllim minimizimin e risqeve operacionale të të vepruarit mbi një bazë rregullative, jo plotësisht dhe qartësisht të saktësuar, nga Ministria e Financave të veprohet me shpejtësi për të miratuar aktet normative të cilat plotësojnë dhe shpjegojnë frymën e ndryshimeve ligjore në drejtim të huamarrjes shtetërore, borxhit shtetëror dhe garancive shtetërore të huasë në vend. Veprimi bazuar në një kornizë rregullative jo të plotësuar, mbart një rrezik mjaft të lartë dhe në gjykimin tonë kërkon ndërhyrje të menduara mirë për të konkluduar në një bazë rregullative të qëndrueshme dhe larg modeleve eksperimentale, të cilat nuk janë një zgjidhje e përshtatshme për Shqipërinë.

- Të merren masa për monitorim të ecurisë të treguesve të parashikuar në Strategjitë e Menaxhimit të Financave Publike të lidhur me borxhin publik, të vendosen dhe monitorohen indikatorët kryesor të borxhit, indikatorë të cilët duhet të jenë të qëndrueshëm dhe të publikueshëm.

- Nga Drejtoria e Menaxhimit të Borxhit të meren masat për të kompozuar, ose adaptuar nga Banka Botërore dhe FMN mjetet analitike për analizimin e të dhënave të borxhit dhe parashikimin e treguesve të rrezikut, ndër të tjera duke hartuar dhe implementuar një manual të detajuar për Drejtorinë e Përgjithshme të Borxhit Publik, dhe krijimin e një baze të dhënash të integruar, bazë e cila të përfshijë borxhin e brendshëm dhe të jashtëm.

- Ministria e financave duhet të angazhohet në drejtim të thellimit dhe përmirësimit të analizave që lidhen me monitorimin e rrezikut sistemik në sistemin financiar, duke ndërtuar tregues të përshtatshëm për të identifikuar rrezikun sistemik në sistemin financiar.

- Të ketë një vëmendje maksimale nga ana e Ministrisë së Financave, lidhur me nivelet e larta të borxhit publik dhe trendit të tij, që nuk ndjek nivelin e shpenzimeve kapitale. E gjykojmë të nevojshme të ketë një karakter vlerësues të nivelit të borxhit publik korrent. Kjo do të thotë që të përcaktohen, analizohen faktorët që ndikojnë negativisht mbi të dhe të merren masat e duhura për të zbutur efektin e tyre. Duhet që parashikimi i efekteve të rritjes apo uljes së borxhit publik të lidhen me rritjen ekonomike, varfërinë, apo tregues të tjerë ekonomik. Ky element me efekte të rëndësishme në financat publike, por edhe zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm, duhet të bëhet me koordinim të Politikës Monetare dhe asaj Fiskale, duke tërhequr vëmendjen në bashkëpunimin ndërinstitucional midis Ministrisë së Financës dhe Bankës së Shqipërisë në rolin e këshilltarit të qeverisë.

- Nisur nga rritja e pjesës së borxhit të brendshëm ndaj totalit të borxhit, e cila mund të shkaktojë presione inflacioniste, rekomandojmë të synohet drejt rritjes së mundësive për investime në kushte të ndryshme, duke shtuar numrin e pjesëmarrësve dhe sqaruar strategjitë e tyre të investimit, duke siguruar një përputhje më të mirë midis ofertës dhe kërkesës dhe duke ofruar norma konkurruese interesi. Diversifikimi i pjesëmarrjes në ankandet e tregut primar për të rritur pjesëmarrjen e individëve në blerjen e obligacioneve duhet të jetë një nga synimet afatshkurtra dhe afatmesme. Synimi i borxhit të brendshëm duhet të jetë drejt tregjeve financiare për t'u zhvilluar dhe më shumë në pikëpamjen e rritjes së pjesëmarrësve dhe shumëllojshmërisë së produkteve kryesisht në krijimin e ndërmjetësuesve financiarë jo banka të cilët në fokus kryesor të veprimtarisë së tyre kanë kanalizimin e kursimeve drejt investimeve në letra me vlerë, duke e bërë tregun më konkurrues.

- Të ndiqet me prioritet mbajtja nën kontroll i stokut të borxhit të jashtëm duke u munduar të ulet niveli i tij ndaj totalit të borxhit për sa kohë, ai është nën efekte dhe risqe të cilat janë nën ndikimin e treguesve të jashtëm. Ekspozimi ndaj riskut të kurseve të këmbimit është i lartë dhe kërkon një analizë të kujdesshme në trend afatgjatë.

- Mbulimi i nevojave financiare të KESH sh.a. për blerje energjie nuk duhet të vazhdojë të jetë huamarrja, ashtu siç është vepruar deri tani, (rrjedhimisht shuarja e detyrimeve me kompensim) por të synohet rregullimi i marrëdhënieve financiare brenda sektorit të energjisë dhe shlyerja e detyrimeve ndërmjet tyre jo nëpërmjet të shuarjes të shumave me kompensim. Në rastet e mosshlyerjeve sidomos në marrëveshjet e vjetra në kohë të nënhuasë, rekomandojmë ri-skedulimin e huave, vendosjen e klauzolave në rast të mosshlyerjeve dhe për marrëveshjet e vjetra në kohë shuarjen e detyrimeve.

- Edhe për ujësjellës kanalizimet, në rastet e mosshlyerjeve sidomos në marrëveshjet e vjetra në kohë të nënhuasë, rekomandojmë riskedulimin e huave, vendosjen e klauzolave në rast të mosshlyerjeve dhe për marrëveshjet e vjetra në kohë shuarjen e detyrimeve.

C.4. Mbi përdorimin e Fondit Rezervë dhe Fondit të Kontigjencës (faqe 277 e raportit).

1. Sa i takon përdorimit të Fondit Rezervë, kemi rekomanduar:

- Përcaktimin, nga Ministria e Financës, në udhëzimin standard të zbatimit të buxhetit e procedurave për argumentimin e pamundësisë së financimit nga buxheti vjetor, dokumentacionin e domosdoshëm që të justifikojë kërkesën për përdorimin

e fondit rezervë, si dhe përcaktimin e një metodologji të standartizuar mbi llogaritjen e kostos për fondin e kërkuar, duke parashikuar afate të qarta të paraqitjes për mendim para shqyrtimit në Këshillin e Ministrave.

– Për institucionet kërkuese të Fondit Rezervë të Buxhetit të Shtetit, në udhëzim të përcaktohen klauzola shtrënguese në rast mosplotësimi të kërkesave ligjore për përfitimin e tij, duke lidhur alokimin e fondeve me plotësimin e kërkesave ligjore kjo do të eliminonte praktikat e deritanishme të anashkalimit të filtrit financiar të Ministrisë së Financave.

2. Sa i takon përdorimit të Fondit të Kontigjencës, kemi rekomanduar që**:**

– Ministria e Financës në udhëzimin standard të zbatimit të buxhetit të përcaktojë përdorimin e Fondit të Kontigjencës, vetëm në rastet e përcaktuara në ligjin organik të buxhetit të shtetit, pra për mbulim deficiti, për financime të reja dhe sa për shtim financimesh mbi programet ekzistuese, duke përshkruar qartësisht mënyrën e argumentimit të pamundësisë së financimit nga buxheti vjetor, si dhe dokumentacionin që duhet për të justifikuar kërkesën dhe përdorimin e tij.

C.5. Mbi Fondin e Zhvillimit të Rajoneve (faqe 277-280 e raportit), kemi rekomanduar:

– Ministria e Financave në Udhëzimin vjetor të zbatimit të buxhetit, në një seksion të veçantë, të përcaktojë qartë kriteret me të cilat do të alokojë fondet për FZHR, të evitojë rialokimin e mundshëm, si dhe pasi të ketë detajuar kushtet e trashëgimit të fondeve, të përcaktojë qartësisht mënyrën e trashëgimit të tyre pas mbylljes së vitit buxhetor, të krijojë rregulla të shkruara, si vendime të mirëfillta në fundvit mbi vlerën e fondit që do të dalë jashtë ciklit normal buxhetor, si dhe afate të mëtejshme, në një datë të fiksuar të mëvonshme të vitit të ardhshëm, për monitorimin e tij, dhe në rast se gjykohet pamundësi në përdorim, të procedohet me fshirjen e fondeve konkrete dhe moslejimin e mbartjes së mëtejshme, duke parandaluar parregullsitë dhe në funksion të krijimit të një procesi të standardizuar të projektimit dhe implementimit të FZHR.

C.6. Mbi llogaritë e konsoliduara vjetore (**faqe 280-282 e raportit**), **kemi rekomanduar:**

– Ministria e Financave të marrë të gjitha masat për pasqyrimin në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë të gjendjes së llogarive speciale në Bankës së Shqipërisë, para implementimit të sistemit Oracle (gjendje llogarie bankare më 31.12.2011), të gjendjes së llogarisë së borxhit, të gjendjes së llogarisë së nënhuasë dhe llogarisë së ISSH, para implementimit të sistemit Oracle.

- Ministria e Financave të marrë të gjitha masat për krijimin e një drejtorie të veçantë për kontabilitetin dhe raportimin financiar, e cila të merret me hartimin dhe zbatimin e metodologjive të nevojshme për Kontabilitetin Publik dhe Raportimin Financiar.

- Ripërsërisim rekomandimin që Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit të publikojë, menjëherë Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit Publik IPSAS, si baza kryesore metodologjike mbi të cilën do të hartohen pasqyrat financiare të shtetit, edhe për të familjarizuar punonjësit e administratës publike me kërkesat e reja.

- Duke parë hezitimin dhe indiferencën e treguar në lidhje me përgatitjen dhe hedhjen për diskutim në nivele teknike të draft-ligjit "Për Kontabilitetin Publik", KLSH ka përgatitur një draft të këtij ligji të rëndësishëm të cilin do ta prezantojë në Kuvend si një iniciativë ligjore në ndihmë të forcimit dhe fuqizimit të sistemit të manaxhimit të financave publike.

C.7. Mbi organizimin dhe funksionimin e Auditimit të Brendshëm dhe Menaxhimit Financiar (faqe 282-285 e raportit), kemi rekomanduar:

- Njësitë e auditimit të qeverisjes qendrore dhe institucioneve të pavarura të kenë detyrim të raportojnë dhe të jenë në varësi funksionale nga Njësia e rekomanduar, me funksione të përqëndruara, ndërkohë që të gjitha njësitë e auditimit në nivel më të ulët të kenë varësi funksionale nga strukturat e auditit të brendshëm në qendër, pasi nën gjykimin tonë kjo mënyrë varësie funksionale jo vetëm krijon kushte të favorshme për pavarësi dhe profesionalizëm, por dhe garanton një nivel raportimi në kohë reale duke inkurajuar dhe masa për përmirësim të problematikave, përmes bërjes së zbatueshme të rekomandimeve të dhëna nga këto struktura.

- Me qëllim hartimin e një plani strategjik sa më gjithëpërfshirës, Struktura Përgjegjëse Për Harmonizimin e Auditit të Brendshëm (SPHAB): (a) të kërkojë nga të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme që të raportojnë pranë kësaj strukture çdo vit mbi masat e marra për organizimin e shërbimit të auditimit të brendshëm; (b) Në funksion të sa më sipër, SPHAB të përgatisë një udhëzim mbi raportimin e treguesve të njësive të auditit të brendshëm, ku të unifikohet paraqitja e objekteve që do të auditohen: (c) të marrë masat e duhura për përmirësimin e pasqyrave statistikore me të gjithë treguesit e nevojshëm, në mënyrë që t'ju shërbejnë më mirë titullarëve të njësive publike për përmirësimin e veprimtarisë dhe rritjen e efektivitetit të sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë e sektorit publik; (d) nisur nga niveli i ulët i zbatimit të rekomandimeve, SPHAB të kërkojë përfshirjen mandatore të zbatimit të rekomandimeve, në planet vjetore të auditimit, si detyrim ligjor i përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm Publik.

C.8. Mbi Auditimet e Performancës (faqe 286-292 e raportit)

10. Sa i takon performancës së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, kemi dhënë mesazhin se:

"AMF, në përmirësim të performacës së vet për arritjen e objektivave ligjorë kah garantimit të aftësisë paguese të tregut të sigurimeve, duhet të ndërtojë:

1. një kuadër rregullativ më efektiv në vendosjen e kriterit të aftësisë paguese, në përputhje me Direktivat e BE-së, që siguron qëndrueshmëri dhe besueshmëri më të lartë të tregut, si dhe ndërhyrjen në kohë të rregullatorëve për eliminimin e problemeve.
2. një sistem efektiv mbikëqyrës në monitorimin dhe verifikimin e besueshmërisë dhe transparencës së shëndetit financiar të tregut, duke kaluar fokusin nga vlerësimi i përputhshmërisë tek profili dhe cilësia e menaxhimit të riskut të siguruesve,
3. skema më efektive dhe transparente në hetimin, vendim-marrjen dhe zbatimin e masave të zbatueshmërisë dhe që synojnë të japin siguri në respektimin e ligjit dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve."

11. Nga auditimi i performancës sa i takon programit të rehabilitimit të ish-të përndjekurve politikë në periudhën e tranzicionit (faqe 277 e Raportit), kemi rekomanduar:

- Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Ministria e Financave të kërkojnë shtimin e fondeve për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë, duke mundësuar shlyerjen e këtij detyrimi të shoqërisë brenda një kohe të shkurtër. Në këtë kontekst gjykojmë se 20% e të ardhurave nga privatizimi i sektorëve strategjikë të shkojnë për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë, rekomandim ky i lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit që në vitin 2012.
- Vlera e mësipërme përbën një detyrim bazë të shoqërisë, pa folur për shpërblimin për punën e papaguar. Është e kuptueshme që kosto e shoqërisë është shumë më e lartë për rehabilitimin e përgjithshëm të shtresës së ish-të dënuarve e të përndjekurve politikë.

Viti 2015 ishte viti i dytë i zbatimit të Strategjisë "Për Menaxhimin e Financave Publike 2014-2020". Kjo strategji bart një rëndësi të dyfishtë, pasi jo vetëm përcakton rrugën për rivendosjen e financave publike në trajektoren e qëndrueshmërisë afatgjatë, duke

krijuar kështu parakushtet për rritjen ekonomike, por përbën edhe një detyrim që rrjedh nga marrëveshjet me partneret ndërkombëtarë, në veçanti me Bankën Botërore, Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bashkimin Europian. Vizioni i saj është garantimi i një sistemi të financave publike që nxit transparencën, përgjegjshmërinë, disiplinën fiskale dhe efiçiencën në menaxhimin dhe përdorimin e burimeve publike. Viti 2015 njohu arritje në zbatimin e strategjisë, meritë kjo kryesisht e Ministrisë së Financave (dhe Ministrit Ahmetaj), por edhe sfida ende të paplotësuara. Prandaj ne të gjithëve, Kuvendit, qeverisë dhe institucioneve të pavarura na del për detyrë të punojmë më me angazhim dhe seriozitet për zbatimin e plotë të Strategjisë "Për Menaxhimin e Financave Publike 2014-2020".

Ju faleminderit!

KREU III.

Ligji i ri organik, në përputhje të plotë me standardet e INTOSAI-t

- Prezantimi i projektligjit në takime me ekspertë të fushës juridike dhe të financave publike, me akademikë, shoqërinë civile dhe median
- Relacion mbi Projekt Ligjin, i përcjellë për Kuvendin e Shqipërisë
- Ligji i ri e sjell auditimin e jashtëm publik në një linjë me standardet ndërkombëtare, Diskutim në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave, *17 mars 2014*
- Kufizimi i qasjes në informacion të KLSH-së i shkon ndesh standardeve ndërkombëtare të fushës, Diskutim në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, *2 prill 2014*
- Ligji duhet të shohë nga Brukseli, jo nga Zimbabve, Diskutim në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, *21 prill 2014*

- Ligji i ri për KLSH-në, kontribut i qartë në integrimin e vendit, Diskutim në Komisionin e Integrimit Europian, *7 prill 2014*

- Cënimi i qasjes së pakufizuar të KLSH-së në informacion shkon në kundërshtim të hapur me Bashkimin Europian, Diskutim në Komisionin e Integrimit Europian, *22 prill 2014*

- Projektligji i ri i KLSH-së - zhvillim i mandatit të tij kushtetues në kushtet e sotme, Gazeta Ekonomia, *19 prill 2014*

Prezantimi i projektligjit në takime me ekspertë të fushës juridike dhe të financave publike, me akademikë, shoqërinë civile dhe median[43]

Të nderuar miq dhe partnerë,

Gjatë këtyre javëve të fundit jam takuar me secilin prej jush dhe ju falënderoj për gatishmërinë për t'u takuar, por mbi të gjitha pse kam marrë shumë ide dhe sugjerime me vlerë nga ju.

Ju kërkoj ndjesë, nëse disa prej këtyre ideve dhe sugjerimeve po i përdor në këtë diskutim, por ne na lidhin shumë gjëra të përbashkëta: përgjegjësia si qytetarë dhe ndjeshmëria për pritshmëritë e publikut, misioni për t'i kontribuar realisht shoqërisë, duke luftuar korrupsionin dhe rritur transparencën.

E shoh bashkëpunimin me ju si thelbësor për institucionin që përfaqësoj. Kjo që po organizojmë sot nuk është as sprovë për show mediatik, as kërkesë për të sublimuar institucionin për vlerat që ai kërkon të promovojë. Ne jemi të gatshëm t'u vëmë në dispozicion organizatave tuaja raportet paraprake të kontrolleve, auditimeve tona.

E kemi nisur në janar të këtij viti, duke i kryer ndoshta për herë të parë në institucion, analizat vjetore të departamenteve të tij në prani të medias dhe duke ju ftuar edhe ju(me aq sa ju njihnim në atë kohë) në analizën tërësore që zhvilluam në Pallatin e Kongreseve në 20 janar. Duam ta vazhdojmë duke ju patur partnerë të përhershëm dhe të plotë.

Neni 15 i ligjit tonë organik na i jep të plota mundësitë ligjore që në ekipet tona të kontrollit të përfshihen edhe ekspertë të përkohshëm, të angazhuar nga organizatat tuaja. Për fat të keq, për këtë vit na mungon fondi nga Buxheti i Shtetit për ekspertët e jashtëm, por ndoshta nëpërmjet projekteve të përbashkëta do të mundësojmë kontributin tuaj dhe të ekspertëve që ju keni.

Ushqej bindjen se ne si KLSH nuk mund të gjejmë njohës më të mirë se sa ju vetë dhe ekspertët që ju angazhoni, kur bëhet fjalë për rritjen e transparencës së institucioneve publike, luftën ndaj korrupsionit dhe parandalimin efikas të tij në gjirin e këtyre

[43] Gjatë vitit 2012, KLSH punoi për përgatitjen e draft-ligjit të ri, në bashkëpunim të ngushtë me ekspertët e SIGMA. Në datat 6, 7 dhe 8 nëntor 2012, institucioni, në partneritet me Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në BE (DG-Budget) dhe me SIGMA-n, zhvilloi tre tryeza të rrumbullakëta me përfaqësues nga rrethet akademike të jurisprudencës dhe të financave publike shqiptare, si dhe me shoqërinë civile të vendit.

institucioneve. Për këtë, në platformën strategjike të institucionit, që paraqita si kandidat për Kryetar në dhjetor të vitit të kaluar përpara Komisionit për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit, theksova përmirësimin e transparencës në marrëdhëniet me publikun, nëpërmjet një partneriteti të gjerë me organizatat jo-fitimprurëse që luftojnë korrupsionin dhe me median.

1. KLSH dhe përditësimi i standardeve INTOSAI

Ju them me shumë sinqeritet se deri në janar të këtij viti në KLSH nuk njihej motoja e INTOSAI-t "*Experentia mutual ominibus prodest*" (Eksperienca e përbashkët u shërben të gjithëve). Unë vlerësoj lart punën e paraardhësve të mi, personaliteteve të jetës politike dhe ekonomike të vendit, si të ndjerin Alfred Karamuço, zotërinjtë Ylli Memisha, Blerim Çela, Mustafa Kërçuku dhe Robert Çeku.

Por sfidat e kohës që jetojmë, prania e krizës në eurozonë dhe kërkesat për një disiplinë të hekurt financiare dhe mbajtjen nën kontroll të deficitit buxhetor të Shtetit, kërkojnë me forcë një institucion modern, të aftë të përdorë me ekonomi, efektivitet dhe efiçiencë burimet e tij. Pritshmëritë e qytetarëve janë të larta, pse KLSH, në rolin e tij kushtetues si institucioni më i lartë i kontrollit është avokat i interesave të qytetarit për miradministrimin e pronës publike, për performancën e duhur të administratës shtetërore dhe për luftën efikase kundër korrupsionit.

Këtë mision dhe këto detyra institucioni mund t'i realizojë me sukses vetëm duke zbatuar me përkushtim e profesionalizëm standardet e përditësuara të INTOSAI-t, organizatës botërore të institucioneve supreme të auditimit.

Përgjegjësitë themelore të këtyre institucioneve(mes tyre edhe KLSH), sipas Deklaratës së Limës, të miratuar në Kongresin e 9-të të INTOSAI-t, në vitin 1977 janë sigurimi i përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret, sigurimi i përdorimit me ekonomi, efiçiencë dhe efektivitet të burimeve financiare, informimi i Parlamentit dhe publikut mbi ligjshmërinë e përdorimit të burimeve buxhetore dhe mbi menaxhimin financiar të qeverisë, monitorimi i zbatimit të rregullave mbi fondet publike dhe nxitja për përditësimin e rregulloreve përkatëse.

KLSH po përfundon këto ditë, në programin e 100 ditëve të para, përditësimin e rregullores së tij të brendshme dhe është në proces të përditësimeve të manualeve të auditimit financiar dhe të performancës. Institucioni po respekton rigorozisht nivelet 2,3 dhe 4 të standardeve të INTOSAI-t, përkatësisht kodet, parimet dhe standardet për menaxhimin e institucioneve supreme të auditimit, si Kodin e Pavarësisë të tyre(të përcaktuar në Kongresin dhe Deklaratën e Meksikos në vitin 2007), Kodin e Transparencës dhe Përgjegjshmërisë, si dhe Kodin e Etikës.

2. KLSH dhe rritja e përdorimit të 3 E-ve

Zbatim i parimeve dhe standardeve të mësipërme na vendos përpara një sfide të mirëfilltë, asaj të përdorimit me sa më shumë ekonomi të burimeve tona të kufizuara, për të arritur maksimumin e impaktit. Rezoluta e 22 dhjetorit 2011 e Asamblesë së Kombeve të Bashkuara njeh rolin e rëndësishëm të institucioneve supreme të kontrollit në promovimin e efiçiencës, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës së administratës publike.

Sigurimi i tre E-ve, ekonomi, efektivitet dhe efiçiencë është përparësia jonë. Po synojmë futjen e gjerë të teknologjisë së informacionit në kontrolle, për të kursyer kohën dhe burimet njerëzore në përdorim, si dhe për të rritur shkallën e saktësisë së gjetjeve dhe rekomandimeve tona. Do të ndërtojmë punën e auditimeve financiare, duke ngritur formate të standardizuara në mënyrë elektronike dhe do t'i vendosim në dispozicion për të gjithë kontrollorët. Përdorimi i dokumenteve standarde, krahas kursimit të kohës së punës, do të na sigurojë qëndrueshmëri të auditimeve financiare.

3. KLSH dhe përsosja e kontrollit mbi metodën e bazuar në risk

Po synojmë realizimin e një metode auditimi të bazuar gjithnjë e më shumë në vlerësimin e riskut. Kjo do të na rrisë efiçiencën dhe do të na kursejë burime që aktualisht shpenzohen gjatë auditimeve tradicionale.

KLSH po zhvendoset gradualisht drejt një metode të përbashkët të kontrollit financiar, kur përzgjedhja e subjekteve për kontroll do të bëhet vetëm dhe ekskluzivisht mbi të dhënat e riskut, të marra nga burime të ndryshme (jo vetëm nga kontrollet e mëparshme, statistikat, studimet e burimet shkresore formale, por edhe nga denoncimet e qytetarëve të thjeshtë, nga denoncimet e medias dhe tuajat, si organizata të shoqërisë civile).

Përfitimet kryesore nga aplikimi i metodës së kontrollit bazuar tek risku janë planifikimi më i mirë i punës së auditimit, si dhe përdorimi me ekonomi i burimeve audituese, duke u përqendruar tek institucionet dhe programet shtetërore me risk më të lartë për praninë e mashtrimit financiar dhe korrupsionit.

Një tregues shumë të përshtatshëm në analizën tonë të riskut e përbën shkalla e transparencës së institucioneve dhe programeve publike që kontrollojmë. Prandaj dhe çdo element apo informacion për një shkallë të ulët transparence të institucionit apo aktivitetit shtetëror që ju mund të konstatoni në projektet dhe vrojtimet tuaja, është i vyer për ne, për të përcaktuar riskun dhe ndërhyrë me kontrollet tona.

4. KLSH dhe lufta për parandalimin e korrupsionit

Gjykoj se tashmë, institucioni ka një vizion të qartë për të ardhmen e punës së tij dhe sfida qëndron në rritjen e aftësive të tij për zbulimin e rasteve të mashtrimit financiar dhe të korrupsionit. Sikurse e përmenda më lart, që në dhjetor të vitit të kaluar përpara Komisionit për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit, theksova nevojën e thellimit të realizimit të misionit kushtetues të KLSH në parandalimin e korrupsionit dhe abuzimeve në administrimin e pronës publike.

Për këtë, kemi lidhur në muajin shkurt të këtij viti marrëveshje bashkëpunimi me ILDKP dhe në mars marrëveshje me Autoritetin e Konkurrencës, për të shkëmbyer eksperienca në parandalimin e konfliktit të interesit dhe abuzimeve me tenderat shtetërore. Po përpiqemi për bashkëpunim konkret me Prokurorinë e Përgjithshme, me Drejtorinë Anti-korrupsion pranë Kryeministrisë, me Avokaturën e Shtetit dhe me të gjitha institucionet e tjera shtetërore që luftojnë korrupsionin.

Kemi shumë besim tek bashkëpunimi me ju për ta kufizuar dhe parandaluar këtë fenomen. Besoj me të gjitha forcat se korrupsioni luftohet dhe mposhtet me punë në sistem, në një rrjet aleancash të sinqerta, me struktura që punojnë kokulur dhe nuk prodhojnë vetëm fjalë dhe deklarata. Ju ftoj të angazhohemi në projekte të përbashkëta, në punë të përbashkët.

5. KLSH dhe transparenca

Transparenca është sot në fokus të punës së përditshme të KLSH me mediat dhe me organizatat jo-fitimprurëse. KLSH ka nevojë të fitojë akses te rritur në publik dhe për këtë po transformon faqen e saj në internet, duke vendosur lidhje (links) me strukturat e tjera shtetërore që luftojnë korrupsionin dhe edhe me OJF-të aktive në këtë fushë. Ajo po furnizon periodikisht me informacion rrjetet e mediave elektronike dhe të shtypit të përditshëm, të interesuara për mirëmenaxhimin e pronës publike.

Mendoj se një parakusht thelbësor për të kufizuar korrupsionin dhe për ta parandaluar atë e përbën të qenit tërësisht transparent në aktivitetin tënd si institucion shtetëror.

Për t'i dhënë një impuls, përmbajtje dhe formë krejtësisht të re marrëdhënieve të KLSH me publikun, brenda programit të 100 ditëve te para miratuam një udhëzues të veçantë për mënyrën e administrimit të kërkesë/ankesave të publikut, që nga momenti i mbërritjes së tyre dhe deri në dhënien e zgjidhjeve të mundshme brenda kuadrit ligjor në fuqi dhe burimeve njerëzore që disponon institucioni. Këto muaj të parë të këtij viti, raportet tona përfundimtare të kontrolleve tek ALUZNI dhe Drejtoria e Përgjithshme e Hekurudhave ua kemi shpërndarë mediave me njoftime tërësisht transparente.

Synimi është përcjellja sa më e shpejtë dhe me vërtetësi e të gjithë veprimtarisë kontrolluese të KLSH tek aleatët dhe partnerët tanë të natyrshëm në radhë të parë (Kuvendi, institucionet e tjera shtetërore, organizatat e shoqërisë civile, analistët e njohur, etj.), si dhe tek publiku i gjerë, duke shërbyer si një mjet efikas denoncimi dhe parandalimi të korrupsionit.

6. KLSH dhe OJF-të që luftojnë korrupsionin. 7. Pikat e përbashkëta. 8. Ku mund të operojmë së bashku

Sikurse e përmenda në fillim, ne si KLSH dhe ju kemi shumë pika të përbashkëta dhe prej këtej lind mundësia e bashkëpunimit në shumë nivele. Ju do të merrni të parët raportet tona paraprake të auditimit. Do të ndajmë me ju kalendarin e kontrolleve tona të shtrira gjatë vitit, për të marrë nga ju *feedback*, vërejtje me vlerë.

KLSH është e gatshme t'ju rekomandojë pranë niveleve më të larta të qeverisjes për projektet që ju do të keni për rritjen e transparencës dhe thellimin e luftës kundër korrupsionit, që të mundësohet mbështetja nga Fondi Shtetëror për OJF-të. Jemi gati të ndajmë me ju ide dhe përgatitje për projekte të përbashkëta në këto fusha. Të kërkojmë së bashku donatorë. T'ju rekomandojmë pranë donatorëve që keni ose atyre potencialë.

Në të kaluarën nuk kanë munguar, edhe pse shumë të pakta, rastet kur në marrëveshje me ne dhe mbi baza projekti, nga raportimet apo indikacionet tona ju ndërmerrnit investigimet tuaja të pavarura dhe ja përcillnit medias në formën e shkrimeve apo denoncimeve. Këtë mënyrë bashkëveprimi mund ta rivitalizojmë. Jemi gati të shkruajmë një projekt të ri të përbashkët për këtë, me cilëndo nga organizatat tuaja që mund të jetë e interesuar.

Nga ana tjetër, ju kryeni shumë vrojtime, ese dhe studime dhe përfshirja në to e audituesve tanë të rinj dhe me mundësi zhvillimi mund të jetë dobiprurëse për të dyja palët. Ne kemi krijuar në shkurt 2012 departamentin e Kërkimit Shkencor dhe Zhvillimit në KLSH dhe së bashku me punonjësit e rinj të këtij departamenti, me ju mund të realizojmë vrojtime, prognoza dhe studime të përbashkëta.

Jemi duke ngritur një revistë shkencore të auditimit të lartë publik dhe aty mund të prezantojmë rezultatet e vrojtimeve dhe nismave tuaja, si dhe të atyre të përbashkëta. Ju do të ftoheni në çdo aktivitet publik tonin, workshop, simpozium, konferencë, etj dhe shpresojmë që të kemi ftesat tuaja që edhe ne të marrim pjesë në aktivitetet që ju organizoni.

Mund të kemi ide për themelimin e një buletini anti-korrupsion (disa institucione homologe në Evropë e kanë si mjet informimi dhe ndërgjegjësimi), që të shërbejë si forum i ideve, opinioneve dhe sugjerimeve tuaja dhe tonave. Mund ta ngremë fillimisht

në mënyrë vullnetare, ose të aplikojmë në formën e një projekti të përbashkët pranë donatorëve të interesuar.

9. Dobia reciproke

Mendoj se dobia reciproke nga partneriteti ynë është e qartë. OJF-të fitojnë me praninë e një partneri serioz shtetëror, kurse KLSH merr shumë inpute për analizën e saj të riskut dhe orientimin e auditimeve në të ardhmen. Feedback-u i marrë nga OJF-të i shërben KLSH të korrigjojë dhe përmirësojë veten.

10. KLSH dhe e ardhmja e këtij bashkëpunimi

Vetëm puna jonë konkrete e përbashkët mund ta bëjë të funksionojë partneritetin që duam të krijojmë. E shoh me shumë besim të ardhmen e tij. Ne kemi gati një draft në formën e një marrëveshjeje tip bashkëpunimi me ju. Këtë po jua vëmë në dispozicion sot. Për të respektuar specifikat e gjithsecilit prej jush dhe organizatave që përfaqësoni, ndoshta mund të nënshkruajmë në një kohë të dytë marrëveshje të veçanta me secilën nga organizatat tuaja, ku të profilizohet bashkëpunimi. Ose mund të lidhim një marrëveshje me rrjetin tuaj. Bashkëpunimi institucional mund të jetë edhe duke formuar një sekretariat të përbashkët. Ju si ta vendosni vetë. Ne jemi të gatshëm dhe të hapur për çdo formë bashkëveprimi që për ju është më e përshtatshme.

Ju faleminderit!

Pjesëmarrësit në Tryezat e Rrumbullakta

Pjesëmarrës nga Fakulteti Juridik: Dr. Altin Shegani, Prof. As. Kestrin Katro, Dr. Jola Xhafo, MA. Besnik Cerekja, Prof. Dr. Kudret Çela, Prof. Ass. Argita Malltezi, Prof. Ass. Flutura Tafaj, Dr.Evis Alimehmeti, Prof. Dr. Skender Kacupi, Prof.As. Dr. Artan Hoxha, Prof.Dr. Aurela Anastasi, Prof.Dr.Ermir Dobjani, Dr.Enkelejda Olldashi, Dr.Eralda Methasani, Dr.Oriana Mucollari, Dr. Eneida Sema, Dr. Ilir Rusi, MA.Enkelejda Turkeshi, MA. Dorina Hoxha, Dr. Ilda Muçmataj, zj. Jonida Rustemaj, z. Erald Topi, zj. Juljana Bylykbashi, zj. Luljeta Ikonomi, zj. Mirela Bogdani, z. Erjon Muharremaj, z. Erlir Puto, zj. Fjoralba Caka, z. Fatmir Braka, etj.

Pjesëmarrës nga Fakulteti Ekonomik: Prof. Dr. Jorgji Bollano, Dr Sherif Bundo, Prof. Dr. Liljana Elmazi, Prof. Dr. Tonin Kola, Prof. Dr.Omer Stringa, Prof. Dr. Sotiraq Dhamo, Doc. Julian Naqellari, Prof.As.Dr. Manjola Naço, Prof. Dr. Lindita Lati, Dr.Rezarta Perri, Prof. Assoc. Dr. Andri Koxhaj, Doc. Oltion Rrumbullaku, Prof. Asoc. Dr. Adriatik Kotorri, Prof. Asoc. Dr. Etleva Bajrami, Prof. Asoc. Dr. Edlira Luci, Prof. Dr. Halit Xhafa, Prof. Dr. Lavdozh Zaho, Prof. Dr. Beshir Ciceri, z. Mustafa Kërçuku, z. Gjergji Buxhuku, Prof.Dr. Vjollca Karapici, Prof. Dr. Albert Qarri, Prof. Dr. Sulo Haderi, Prof. Dr. Fatmir Memaj, Prof. Dr. Shyqyri Llaci, Prof. Dr.Kozeta Sevrani, Prof. Dr. Albana Hashorva, Dr. Perseta Grabova, etj.

Pjesëmarrës nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar dhe nga Ministria e Financave: Prof. Asc. Dr. Hysen Çela, z. Berti Pashko, zj. Eleonora Olli, z. Paqsor Qato, z. Bujar Osmani, z. Kledian Kodra, z. Shkëlzen Margjeka, z. Xhorxhi Dema, z. Thoma Janku, z. Ramadan Ndreaj, zj. Hava Muçollari, zj. Mimoza Dhembi, z. Ilir Meçe, z. Ylber Bezo, z. Igli Stambolla, zj. Festime Trebicka etj.

Pjesëmarrës nga Organizata Jo-Fitimprurëse: z. Andi Dobrushi, zj. Norimasa Shimomura, zj. Evis Sulko, z. Remzi Lani, z. Ismail Beka, zj. Ledia Muço, z. Zef Preçi, z. Gentian Elezi, z. Gerti Shella, z. Gafur Luga, z. Ilir Rrembeci, z. Ilir Gedeshi, z. Sazan Guri, z. Mitro Çela, zj. Vjollca Meçaj, z. Lulezim Hana, z. Genti Ibrahimi, z. Sami Neza, z. Sotiraq Hroni, z. Lutfi Dervishi *dhez. Gledis Gjipali.*

Pjesëmarrës të tjerë:

Ina Rama, Ish-Prokurore e Përgjithshme

Adriatik Llalla, Inspektor i Përgjithshëm i ILDKP

Robert Gielisse, DG-Budget, Këshilltar i Lartë i Drejtorit të Përgjithshëm

Joop Vrolijk, Këshilltar i Lartë i SIGMA-s

Relacion mbi Projekt Ligjin, i përcjellë për Kuvendin e Shqipërisë

Më 26 nëntor 2012, KLSH i ka dërguar Projekt-Ligjin e ri të KLSH Kryetares së Kuvendit, zj. Jozefina Topalli, me shkresën me Nr. 945/4, dt. 26.11.2012 (më poshtë faksimile e shkresës) dhe më 26 Nëntor 2013 Kryetarit të Kuvendit, Ilir Meta (më poshtë faksimile e shkresës).

Relacion për Projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit" i ndryshuar", dërguar në Kuvendin e Shqipërisë me shkresën nr. 945/4 prot, datë 26 nëntor 2013[44]

1. Informacion i përgjithshëm

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në vijim të punës së tij reformuese dhe modernizuese dhe si pjesë e panit të tij strategjik për t'iu përafruar gjithnjë e më shumë standardeve ndërkombëtare të auditimit dhe legjislacionit bashkëkohor të institucioneve homologe në vendet Europiane, ka ndërmarrë nismën për ndryshimin e ligjit të tij organik nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, dhe vendimin nr. 212, datë 29.10.2002 të Gjykatës Kushtetuese, si dhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Puna për hartimin e këtij projektligji ka filluar që në vitin 2009 por për arsye të ndryshme subjektive ky ligj nuk është paraqitur në Kuvend dhe puna në lidhje me të kishte mbetur e papërfunduar.

Gjatë periudhës së hartimit të këtij projektligji, Kontrolli i Lartë i Shtetit është konsultuar vazhdimisht dhe në lidhje me çdo propozim apo ndryshim të projektligjit, me partnerët tanë ndërkombëtarë SIGMA dhe DG.Budget, mendimet dhe rekomandimet e të cilëve janë reflektuar në projektligj.

Si pjesë e planit të punës për hartimin e këtij projektligji, përveç marrjes dhe reflektimit të mendimit të dërguar nga Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Ministria e Integrimit; Kontrolli i Lartë i Shtetit gjatë muajit nëntor 2012 ka organizuar edhe katër tryeza pune me gazetarët dhe përfaqësuesit e medias; juristë të shquar, ekspertë të së drejtës dhe profesorë të Fakultetit të Drejtësisë; ekspertë kontabilistë dhe profesorë të Fakultetit Ekonomik, si dhe përfaqësues të shoqërisë civile, mendimet dhe sugjerimet e të cilëve kanë qenë një ndihmesë e madhe në hartimin e variantit përfundimtar të këtij projektligji.

Gjithashtu, për hartimin e këtij projektligji, një ndihmesë të madhe kanë dhënë edhe

[44] KLSH i ka dërguar Kryetares së Kuvendit, zj. Jozefina Topalli më 26 nëntor 2012 shkresën me Nr. 945/4, dt.26.11.2012, me Projekt-Ligjin e ri të KLSH.

ekspertët e institucioneve të tjera homologe të auditimit në vendet me të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit ka marrëdhënie dhe marrëveshje bashkëpunimi si Polonia, Sllovenia, Kroacia, Holanda, etj., të cilët përveç dhënies së praktikës së tyre legjislative kanë ofruar një sërë mendimesh dhe sugjerimesh në lidhje me dispozitat e këtij projektligji.

Filozofia e përdorur për hartimin e këtij projektligji dhe mendimeve që ai parashikon në raport me dispozitat e ligjit organik ekzistues është e dyanshme; pasi së pari është menduar që të realizohet një përafrim sa më i saktë dhe i plotë i dispozitave të këtij ligji me standardet ndërkombëtare të auditimit dhe legjislacionet më të përparuara të institucioneve të huaja homologe dhe së dyti është ndërhyrë në ato dispozita ekzistuese dhe në ato fusha për të cilat mendohet se nuk janë të plota dhe se kishin krijuar ose mund të krijonin probleme gjatë zbatimit të tyre në praktikë.

2. Historiku i shkurtër i ndryshimeve legjislative të viteve të fundit në lidhje me Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Aktualisht Kontrolli i Lartë i Shtetit e ushtron veprimtarinë e tij duke u bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në ligjin organik nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", i ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, dhe vendimin nr. 212, datë 29.10.2002 të Gjykatës Kushtetuese, si dhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Ligji organik nr. 8270, datë 23.12.1997, erdhi si domosdoshmëri e kërkesës për të ristrukturuar dhe riorganizuar KLSH-në e asaj kohe, dhe për t'iu përafruar sa më shumë legjislacioneve dhe standardeve të institucioneve të huaja homologe. Ky ligj u hartua me ndihmën dhe nën mbikëqyrjen e SIGMA-s dhe pasqyronte një sërë parimesh dhe standardesh ndërkombëtare të kontrollit të INTOSAI-t.

Në vitin 2000, bazuar dhe në parashikimet e bëra në nenet 162-165 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të miratuar me ligjin nr. nr. 8417, datë 21.10.1998, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit". Këto ndryshime synonin të theksonin akoma dhe më tej pavarësinë institucionale dhe ekonomike të KLSH-së, shmangien e ndikimit politik në veprimtarinë e tij si dhe përcaktimin e rregullave të qarta në lidhje me mandatin dhe kompetencat e Kryetarit të KLSH-së.

Me vendimin nr. 212, datë 29.10.2002, Gjykata Kushtetuese vendosi shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të nenit 14 të ligjit nr .8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me nenin 7 të ligjit nr. 8599, date 10.4.2000 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit" dhe që kishte të bënte me rastet e përfundimit para afatit të mandatit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

3. Qëllimi dhe objektivat e këtij projektligji

Ky projektligj synon:

- përafrimin e mëtejshëm dhe sa më të plotë të ligjit organik të KLSH-së me standardet ndërkombëtare të auditimit, praktikat më të mira të vendeve të BE-së si dhe përshtatjes me kushtet aktuale të vendit,
- forcimin e pavarësisë institucionale, organizative dhe ekonomike të KLSH-së,
- qartësimin dhe saktësimin e të drejtave, detyrave dhe kompetencave që KLSH ka në zbatim të funksionit të tij kushtetues, me subjektet e auditimit dhe institucionet e tjera shtetërore,
- saktësimin e të drejtave dhe detyrave që subjektet e audituara kanë në raport me procedurën e auditimit,
- modernizimin e ligjit organik të KLSH-së nëpërmjet parashikimit në të të eksperiencës më të fundit dhe më të mirë Europiane, si dhe
- përcaktimin dhe forcimin e statusit të personelit të KLSH-së.

4. Struktura e projektligjit

Projektligji përmban në tërësi 41 nene të sistemuara në 7 Krerë, në ndryshim nga ligji aktual organik i KLSH-së (i ndryshuar), i cili përmban 24 nene të sistemuara në 9 Krerë, pra në total 17 nene më shumë se ligji aktual.

Duhet të theksojmë faktin që jo të gjitha nenet e projektligjit mund të konsiderohen si nene të reja të paparashikuara më parë në ligjin organik ekzistues, pasi në shumicën e rasteve është bërë vetëm një risistemim, plotësim, saktësim i neneve ekzistuese apo paragrafë të veçantë të disa neneve janë shpërndarë në nene të tjera të projektligjit.

Në këtë projektligj është prekur disi struktura e ligjit organik aktual duke bërë një rirenditje të krerëve dhe neneve të veçanta me qëllim krijimin e një strukture sa më të qartë dhe më të logjikshme.

Në Kreun-I të projektligjit, "Dispozita të Përgjithshme", ku janë përfshirë 7 nene, trajtohen një sërë çështjesh bazë si: objekti dhe parimet e ushtrimit të veprimtarisë së KLSH-së, standardet e auditimit, pavarësia financiare, bashkëpunimi me institucionet e tjera dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve mbi kompetencat e KLSH-së.

Në Kreun-II "Kompetencat, të Drejtat dhe Detyrat" ku janë përfshirë 10 nene, përshkruhen në mënyrë mjaft të qartë objektivat, objekti dhe subjektet e auditimit, format e veçanta të auditimit si ai financiar, i përputhshmërisë, i performancës dhe auditimi IT, të drejtat dhe kompetencat e KLSH-së, raporti me auditin e brendshëm dhe sistemet e kontrollit, dhënia e mendimit nga KLSH për akte ligjore që kanë të bëjnë me veprimtarinë e tij si dhe propozimi në organet kompetente për ndryshimin, revokimin

apo shfuqizimin e atyre akteve që konsiderohen si në kundërshtim me Kushtetutën apo ligjet e vendit.

Në Kreun-III të projektligjit "Organizimi dhe Struktura" që përkon me Kreun-IV të ligjit organik aktual, dhe në të cilin janë përfshirë 7 nene, përcaktohen qartë një sërë çështjesh që kanë të bëjnë me strukturën, veprimtarinë organizative të KLSH-së, planin e veprimtarisë së tij audituese; mandatin, imunitetin dhe kompetencat e Kryetarit të KLSH-së.

Në Kreun-IV të projektligjit "E Drejta e Disponimit të Dokumenteve dhe Informacionit" që përkon me Kreun-V të ligjit organik aktual dhe në të cilin janë përfshirë 3 nene, përcaktohen të drejtat që ka KLSH në raport me subjektet e audituara për marrjen e informacionit dhe dokumentacionit i cili konsiderohet si i nevojshëm në kryerjen e punës së tij, si dhe mënyra e trajtimit të rasteve që kanë të bëjnë me sekretin shtetëror apo tregtar, apo informacione konfidenciale.

Në Kreun-V të projektligjit "Raportimi i Auditimit" ku përfshihen 5 nene, trajtohen çështje që kanë të bëjnë me të drejtat e subjekteve të auditimit për të paraqitur komentet dhe observacionet e tyre në lidhje me të gjitha fazat e auditimit, raportet që KLSH i paraqet Kuvendit dhe institucioneve të tjera shtetërore apo publikut, si dhe bashkëpunimi me institucionet universitare në organizimin e konferencave dhe botimin e revistave shkencore.

Në Kreun-VI të projektligjit "Statusi i Personelit" që përkon me Kreun-VII të ligjit aktual dhe që përbëhet nga 7 nene, trajtohen çështje që kanë të bëjnë me të drejtat dhe detyrat e punonjësve të KLSH-së, kriteret dhe procedurat e pranimit në punë të këtyre punonjësve dhe ato për marrjen e titullit "asistent audites" dhe "audites shtetëror i certifikuar", e drejta për të punësuar përkohësisht ekspertë të jashtëm vendas apo të huaj si dhe rregullat për shmangien e konfliktit të interesave.

Ne Kreun-VII të projektligjit "Dispozita të fundit" dhe që përbëhet nga 2 nene, trajtohet çështja e statusit të punonjësve aktualë të KLSH-së dhe detyrimi i tyre për t'iu nënshtruar procedurave për marrjen e titullit "audites shtetëror i certifikuar".

5. Të rejat që sjell ky projektligj

a) Terminologjia juridike

Në ligjin organik aktual të KLSH-së nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", i ndryshuar, përdoret gjerësisht termi "kontroll", term ky i cili është trashëguar nga legjislacioni dhe koncepti i mëparshëm në lidhje me rolin, funksionin dhe veprimtarinë e KLSH-së.

Që në hapat e para të hartimit të këtij projektligji, DG.Budget dhe SIGMA kanë

rekomanduar si domosdoshmëri zëvendësimin e termit "kontroll" me termin "auditim" dhe "auditues" pasi termi "kontroll" është një term i cili në vetvete përfaqëson dhe ka një konotacion paksa represiv dhe tepër autoritar ndërsa termi "auditim" është një term i cili përfaqëson më së miri natyrën, objektin dhe veprimtarinë e institucioneve të auditimit dhe ka një diapazon më të gjerë dhe me të saktë të fushës së veprimtarisë audituese.

Referuar standardeve ndërkombëtare të INTOSAI-t si dhe dokumenteve bazë të kësaj organizate që në njëfarë mënyre konsiderohen edhe si "Kushtetuta" e Institucioneve Supreme të Auditimit në të gjithë botën sic janë "Deklarata e Limës" dhe "Deklarata e Meksikos", termi i vetëm që përdoret për t'iu referuar si institucioneve të auditimit, por edhe aktivitetit që ato ushtrojnë është termi "auditim".

Termi "auditim" nuk është një term i ri për legjislacionin Shqiptar pasi ai aktualisht përdoret në ligjin nr. 9720, datë 23.04.2007 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik" madje termi "audit" përdoret edhe në emërtimin e vetë këtyre organeve duke e shndërruar këtë ligj në një ligj më të përparuar përsa i përket terminologjisë juridike sesa ligji aktual i Kontrollit të Lartë të Shtetit i cili përfaqëson të vetmin institucion publik të auditimit të jashtëm.

Meqenëse termi "kontroll" është një term i cili përdoret edhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë si përsa i përket emrit të vetë institucionit ashtu edhe aktivitetit që ai ushtron, në nenin 3 të projektligjit ku jepet përkufizimi i termit "auditim" përcaktohet fare qartë që ky term ka të njëjtin kuptim me termin "kontroll" të përdorur në nenet 162/pg.1, 163 dhe 164/pg.1/c të Kushtetutës.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, ka kohë që në praktikën e tij të përditshme e ka zëvendësuar termin "kontroll" me termin "auditim" dhe kjo reflektohet fare qartë dhe në dokumentet, shkresat, manualet, rregulloren e tij të brendshme, në raportet dhe vendimet e auditimeve si dhe në korrespodencën e këtij institucioni me institucione të tjera vendase apo të huaja, prandaj zëvendësimi i këtyre termave edhe në ligjin e tij organik thjesht do të pasqyronte atë çka tashmë ka kohë që aplikohet në realitet.

Sa më sipër, zëvendësimi në projektligj i termit "kontroll" me termin "auditim" nuk shpreh vetëm dëshirën për të modernizuar terminologjinë juridike të këtij projektligji por gjithashtu edhe detyrimin ligjor dhe profesional që Kontrolli i Lartë i shtetit ka për të qenë në përputhje të plotë dhe sinkronizim me standartet ndërkombëtare të auditimit dhe eksperiencën më të mirë të legjislacioneve të vendeve Europiane.

b) Përkufizimet e termave

DG Budget dhe SIGMA e kanë vlerësuar si diçka tepër pozitive faktin që në këtë projektligj është parashikuar vendosja e një neni të ri, në të cilin do të paraqiteshin

përkufizime në lidhje me disa prej termave të përdorur në dispozitat e tjera të tij dhe njëkohësisht kanë ofruar konsulencën e duhur juridike në lidhje me referimin dhe përshtatjen e këtyre përkufizimeve me standardet ndërkombëtare të auditimit dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

Kështu, si referencë në lidhje me disa prej përkufizimeve të dhëna në këtë projektligj, janë përdorur përkufizimet e pasqyruara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë; standardet ndërkombëtare të institucioneve supreme të auditimit, ISSAI[45], të miratuara nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit, INTOSAI[46] si ISSAI 1 - Deklarata e Limës, ISSAI 100, ISSAI 1003, dhe ISSAI 4000 – 4200; ligjin nr. 9720, datë 23.04.2007 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik"; ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë"; dhe ligjin nr. 10294, datë 01.07.2010 "Për Inspektimin Financiar Publik".

c) Referimi në standardet ndërkombëtare të auditimit

Ligji organik aktual nr. 8270, datë 23.12.1997, i ndryshuar, i referohet vetëm një herë në nenin 2 të tij standardeve ndërkombëtare të auditimit dhe pikërisht standardeve të INTOSAI-t, ndërsa neni 4 i projektligjit vendos detyrimin që Kontrolli i Lartë i Shtetit në veprimtarinë e tij, duhet të reflektojë jo vetëm shkallën më të lartë të standardeve ndërkombëtare të INTOSAI-t por edhe të atyre IFAC[47], si dhe rezolutat e Kongreseve të INTOSAI-t dhe EUROSAI-t, duke vendosur kështu një bazë më të gjerë dhe më të plotë të standardeve ndërkombëtare, të cilave KLSH duhet t'u përmbahet në ushtrimin e veprimtarisë së tij të përditshme.

d) Forcimi i pavarësisë financiare të KLSH-së

Pavarësia financiare e Kontrollit të Lartë të Shtetit aktualisht është e parashikuar në nenin 3 të ligjit organik aktual, por ajo çka përpiqet të përmirësojë ky projektligj në nenin 5 të tij është përshtatja e plotë me standardet e parashikuara në Deklaratën e Limës dhe vendimit nr. 19, datë 03.05.2007 të Gjykatës Kushtetuese.

Me sugjerimin e SIGMA-s, në nenin 5 të projektligjit është shtuar një paragraf i ri në të cilin përcaktohet që Kontrolli i Lartë i Shtetit zbaton në mënyrë të pavarur buxhetin e tij të aprovuar nga Kuvendi.

Bazuar në seksionin 7 të Deklaratën e Limës, i cili flet për pavarësinë financiare të

[45] ISSAI – Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit

[46] INTOSAI – Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit

[47] IFAC – Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve

institucioneve supreme të auditimit, këtyre institucioneve duhet t'u sigurohen mjetet e nevojshme financiare për përmbushjen e detyrave të tyre duke aplikuar direkt tek organet kompetente për buxhetin kombëtar dhe gjithashtu këto institucione mund të përdorin fondet e vëna në dispozicion, ashtu siç ato e gjykojnë të arsyeshme.

Të njëjtin qëndrim me seksionin 7 të Deklaratës së Limës, mban edhe Gjykata Kushtetuese, e cila në vendimin e saj nr. 19, datë 03.05.2007, ku trajtohet pavarësia financiare e institucioneve të pavarura kushtetuese shprehet si më poshtë:

"Mbështetur në sa u trajtua më sipër dhe duke u shprehur në terma të përgjithshëm, pavarësia financiare duhet kuptuar si një financim i tillë i organeve dhe institucioneve kushtetuese, i cili duhet t'u mundësojë atyre të ushtrojnë normalisht veprimtarinë për përmbushjen e funksioneve që Kushtetuta u ka ngarkuar, pa ndërhyrjen ose ndikimin e qeverisë, e politikës apo faktorëve të tjerë të jashtëm me këtë veprimtari, gjë që do të mund të cenonte rëndë ushtrimin e kompetencave tyre. Me fjalë të tjera, pavarësia financiare e këtyre organeve konsiston në të drejtën për të propozuar në Kuvend buxhetin e tyre vjetor, veçanërisht në të drejtën e menaxhimit të pavarur të këtij buxheti në përputhje me ligjin...

Nga ana tjetër, dispozitat kushtetuese dhe ligjet organike përkatëse përcaktojnë qartazi se menaxhimi i këtij buxheti në përputhje me ligjin duhet t'u lihet në dorë vetë këtyre organeve. Sigurisht, ato i dinë dhe i vlerësojnë më mirë se kushdo tjetër kërkesat dhe problemet e tyre, nevojat për investime, objektivat që synojnë të arrijnë, etj."

Gjithsesi, referuar dhe vendimit të mësipërm të Gjykatës Kushtetuese, pavarësia financiare e KLSH-së varet kryesisht nga mundësitë financiare të vet shtetit, të cilat reflektohen periodikisht në buxhetin vjetor të tij, buxhet që miratohet me ligj të veçantë nga Kuvendi, në bazë të projektit të hartuar nga Këshilli i Ministrave ku rol mjaft të rëndësishëm në këtë drejtim luajnë edhe planet për investime publike, politikat ekonomike e sociale, objektivat apo prioritetet e qeverisjes së vendit në periudha të ndryshme të saj.

Në këtë kuptim, pavarësia financiare e KLSH-së në këtë projektligj, nuk është konceptuar aspak si pavarësi absolute, fakt ky që evidentohet fare qartë edhe në paragrafët e fundit të nenit 5 ku është përcaktuar që llogaritë e KLSH-së auditohen nëpërmjet një komisioni të posaçëm dhe të pavarur, të caktuar nga Kuvendi, anëtarët e të cilit nuk duhet të jenë përfaqësues të partive politike.

e) Zgjidhja e mosmarrëveshjeve të kompetencave

Në ndryshim nga parashikimi i bërë në nenin 5 të ligjit organik aktual nr. 8270, datë 23.12.1997, i ndryshuar, ku përcaktohet që konfliktet e kompetencave midis Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe institucioneve te tjera shtetërore (publike) zgjidhen nga Gjykata e Apelit, është gjykuar që në nenin 7 të projektligjit të përcaktohet që gjykata kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tilla duhet të jetë Gjykata Kushtetuese, mendim ky

i mbështetur edhe nga ekspertët e së drejtës që kanë kontribuar në hartimin e këtij projektligji.

Ky ndryshim në gjykatën kompetente që do të angazhohet në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të mësipërme, mbështetet edhe nga fakti që sipas përcaktimeve kushtetuese dhe më konkretisht atyre të parashikuara në nenin 134, pika 1, germa ç); Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje edhe me kërkesë të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

f) Auditimi i përdoruesve të fondeve publike të ofruara nga BE dhe organizata të tjera ndërkombëtare

Bazuar në "Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së 2007-2012" dhe pikërisht në pjesën ku flitet për iniciativat ligjore të Kontrollit të Lartë të Shtetit, parashikohet që në amendimet e ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndër të tjera do të konsistojnë edhe në dhënien KLSH-së të së drejtës për të kontrolluar fondet e akorduara nga BE për Shqipërinë, deri tek përdoruesi i fundit.

Nisur nga parashikimi i mësipërm në nenin 9, gërma dh), të projektligjit është përcaktuar që Kontrolli i Lartë i Shtetit, në përputhje me funksionin e tij, ka për kompetencë të auditojë edhe përdoruesit e fondeve publike të ofruara nga Bashkimi Europian ose organizata të tjera ndërkombëtare.

Parashikime të tilla të ngjashme ekzistojnë edhe në legjislacionet e institucioneve të tjera homologe si psh., në nenin 2 të Ligjit për Zyrën Supreme të Auditimit të Republikës së Sllovakisë, në nenin 6 të Ligjit për Zyrën Shtetërore të Auditimit të Kroacisë dhe në nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Sllovene të Auditimit.

g) Dispozita të veçanta për llojet e auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit ashtu si institucionet e tjera homologe të auditimit, bazuar në standartet ndërkombëtare të auditimit, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre aplikojnë një sërë lloje auditimesh siç janë auditimi i përputhshmërisë, auditimi financiar, auditimi i performancës, etj.

Në këtë projektligj është menduar që katër llojet kryesore të auditimit që aplikohen aktualisht në institucionet e përparuara homologe, të përshkruhen secila në dispozita të veçanta dhe më konkretisht në nenet 10,11,12,13, duke përcaktuar në mënyrë të qartë dhe të plotë kompetencën e KLSH-së në ushtrimin e këtyre auditimeve.

Neni 12 i projektligjit, i cili parashikon auditimin e performancës, është rekomanduar nën sugjerimin e ekspertëve të DG Budget meqenëse ky lloj auditimi është më pak i njohur dhe si rrjedhojë ekzistenca e një neni të veçantë dhe të detajuar në lidhje me të do të shmangte çdo paqartësi dhe keqinterpretim nga ana e subjekteve të audituara.

Gjithashtu, bazuar në praktiken e institucioneve të huaja homologe dhe standardet ndërkombëtare të auditimit, në nenin 13 të projektligjit është parashikuar një nga format më të reja të auditimit që është auditimi i IT. Ndonëse në kushtet aktuale Kontrolli i Lartë i Shtetit mund ta ketë të vështirë ushtrimin e auditimit të IT, përsëri një parashikim i tillë në dispozitat e këtij ligji do të krijonte mundësinë që ky auditim të realizohej edhe me anë të sigurimit të ekspertizës dhe mbështetjes së institucioneve të tjera homologe dhe njëkohësisht do ta vendoste këtë projektligj në rangun e legjislacioneve më të përparuara përsa i përket institucioneve supreme të auditimit.

Deklarata e Limës, në Seksionin 13 të saj përcakton që metodat e auditimit duhet ti përshtaten gjithmonë progresit të shkencës dhe teknikave që lidhen me menaxhimin financiar, prandaj duke ju referuar këtij përcaktimi është mëse e domosdoshme pasqyrimi në projektligj i auditimit të IT si një dispozitë më vete.

h) Riformulim i të drejtave të KLSH-së

Me rekomandim te DG Budget dhe SIGMA-s është bërë një riformulim pothuajse tërësor i nenit 16 të ligjit organik aktual dhe që përkon me nenin 14 të projektligjit, duke shmangur në radhe të parë terminologjinë ekzistuese, e cila ka një karakter të fortë inspektimi më terma të tjerë si "informim", "rekomandim", "iu drejtohet", "propozon", etj.

Gjithashtu në nenin 14 të projektligjit, përveç riformulimit të pikave të nenit 16 ekzistues, janë shtuar për KLSH-në edhe një sërë të drejtash të tjera siç janë e drejta për të informuar drejtuesit e njësive të audituara apo institucioneve më të larta në lidhje me shkeljet materiale të akteve ligjore dhe t'u rekomandojë atyre shmangien e këtyre shkeljeve apo që të ndërmarrin masa strukturore dhe organizative duke përfshirë edhe nisjen e procedurave disiplinore apo administrative; e drejta për t'iu drejtuar organeve të ndjekjes penale apo gjykatës me padi; e drejta për ti propozuar inspektimit financiar dhe njësive të auditimit të brendshëm publik kryerjen e inspektimeve dhe auditime brenda kompetencave të tyre; e drejta për t'iu drejtuar organeve më të larta shtetërore të kompetencës, në rast të moszbatimeve të rekomandimeve të dhëna nga ana e KLSH si dhe e drejta për ti propozuar Komisionit Parlamentar të Ekonomisë dhe Financave ose ndonjë komisioni tjetër përkatës të Kuvendit, marrjen në shqyrtim të raporteve të veçanta të auditimit.

Me kërkesë të ekspertëve të së drejtës, në nenin 14 të projektligjit janë shtuar germa d) dhe dh), në të cilat përcaktohet që Kontrolli i Lartë i Shtetit ka të drejtë ti drejtohet organeve të ndjekjes penale në rastet kur ndjekja e mëtejshme e zbulimeve nga auditimi është kompetencë e tyre si dhe të bëjë padi në gjykatë. Parashikimi i qartë në dispozitë i këtyre të drejtave, e vendos automatikisht KLSH-në në sinkron me veprimtarinë e institucioneve të tjera shtetërore në luftën e përbashkët kundër korrupsionit dhe

njëkohësisht sanksionon dhe përforcon marrëveshjen aktuale që Kontrolli i Lartë i Shtetit ka me Prokurorinë e Përgjithshme në këtë fushë.

i) Raporti me auditin e brendshëm

Në nenin 15 të projektligjit që përkon me nenin 9 të ligjit organik aktual, është bërë riformulimi i paragrafit të parë të këtij neni duke ndjekur sugjerimet e kombinuara të SIGMA-s dhe DG Budget.

Ky nen pasqyron dhe sanksionon bashkëpunimin aktual ndërinstitucional të KLSH-së me Ministrinë e Financave, i cili është konkretizuar në marrëveshjen e bashkëpunimit që KLSH ka me këtë ministri.

Sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15 të projektligjit, KLSH në ushtrim të kompetencave të tij, vlerëson funksionimin e përgjithshëm të sistemeve të kontrollit dhe auditimit të brendshëm në organet subjekte të auditimit, duke dhënë sipas rastit opinionet dhe rekomandimet e duhura. Kontrolli i Lartë i Shtetit mund të përdorë gjetjet e auditimeve të kryera nga organe të tjera audituese por i merr në konsideratë këto gjetje, vetëm në rast se standardet e përdorura për këto auditime janë në përputhje me standardet e veta dhe ato ndërkombëtare të auditimit.

Përcaktimet e mësipërme të pasqyruara në nenin 15 të projektligjit janë në përputhje të plotë me Seksionin 3 të Deklaratës së Limës, në të cilin flitet për raportin dhe marrëdhënien që auditimi i jashtëm duhet të ketë me auditin e brendshëm.

j) Konsultimi me KLSH-në

Në nenin 16 të projektligjit përcaktohet që për çështje që kanë të bëjnë me hartimin e një projektligji dhe që lidhet me funksionin, veprimtarinë, detyrat dhe kompetencat e KLSH-së, organet shtetërore konsultohen paraprakisht me Kontrollin e Lartë të Shtetit, i cili mund të japë opinionet e tij, si dhe të bëjë propozime përsa i përket përmirësimit të legjislacionit në fushat brenda kompetencave të tij.

Gjithashtu, sipas këtij neni Kryetari i KLSH-së mund të ftohet të marrë pjesë dhe të flasë në mbledhjet e Këshillit të Ministrave, kur shqyrtohen çështje që lidhen me funksionet dhe veprimtarinë e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Përcaktimet e mësipërme vijnë si detyrim i zbatimit dhe janë në sinkron të plotë me Seksionin 12 të Deklaratës së Limës, ku flitet për dhënien e opinionit nga Institucionet Supreme të Auditimit dhe të drejtën për konsultimin e tyre.

Sipas SIGMA-s mendimet e propozuara ndihmojnë në parandalimin e situatave, në të cilat një ligj që hyn në fuqi provokon tension në lidhje me dispozitat ligjore ekzistuese dhe mandatin e SAI-t, prandaj do të ishte më e përshtatshme që të merrej opinioni i

KLSH-së përpara se këto akte ligjore të hynin në fuqi.

Në komentet e saj Ministria e Drejtësisë sugjeron heqjen e nenit 16 të projektligjit pasi bie në kundërshtim me dispozitat Kushtetuese por ky sugjerim është hedhur poshtë në unanimitet nga ekspertët e së drejtës, të cilët mendojnë që parashikimet e bëra në nenin 16 nuk janë aspak në kundërshtim me Kushtetutën, pasi sipas opinionit të tyre detyrimi që Ministrat kanë për t'u konsultuar paraprakisht me KLSH-në, shtrihet thjesht dhe vetëm në marrjen e një opinioni dhe nuk është detyrues për aq sa në dispozitë përdoret termi "konsultohen".

Sipas ekspertëve, marrja e një opinioni nga një institucion që ka ekspertizën për vlerësimin e pasojave financiare, apo të atyre që kanë të bëjmë me performancën, përputhshmërinë, rregullshmërinë, do të rrisnin efektivitetin e akteve ligjore apo nënligjore, dhe do të shmangnin pasojat negative ndërsa porsa i përket komenteve të Ministrisë në lidhje me paragrafin e dytë, të kësaj dispozite, ai është identik, siç është cituar në paragrafin e parë të nenit 165 të Kushtetutës, dhe për rrjedhojë nuk mund të bjerë në kundërshtim me Kushtetutën.

k) Pavarësia në lidhje me përcaktimin e planit të veprimtarisë

Në nenin 19 të projektligjit përcaktohet që Kontrolli i Lartë i Shtetit vendos në mënyrë të pavarur dhe në çdo kohë për planin e veprimtarisë së tij, por gjatë përcaktimit të planit të tij të auditimeve, mund të marrë në konsideratë edhe propozimet e bëra nga njësitë e tjera të qeverisjes së përgjithshme.

Qëllimi i përcaktimeve të mësipërme është sigurimi i pavarësisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit nga ndikimi dhe ndërhyrjet që mund të bëhen nga institucionet e tjera publike në axhendën e veprimtarive të KLSH-së. Këto institucione, në raste të veçanta mund ti drejtohen KLSH-së me anë të një kërkese për të marrë në konsideratë zhvillimin e një auditimi të caktuar, brenda kompetencave të saj ligjore.

Përcaktimet e bëra në nenin 19 të projektligjit janë në përputhje me Parimin 3 të Deklaratës së Meksikos "Për pavarësinë e Institucioneve Supreme të Auditimit", e cila shprehet:

"Duke respektuar ligjin, SAI-t janë të lirë nga ndërhyrje nga legjislativi ose ekzekutivi në:

- *Zgjedhjen e çështjeve të auditimit;*
- *Planifikimin, programimin, sjelljen, raportimin dhe ndjekjen e auditimeve të tyre;*
- *Organizimin dhe menaxhimin e funksionit të tyre; dhe*
- *Zbatimin e vendimeve të tyre, ku zbatimi i sanksioneve është pjesë e mandatit."*

- Shembuj të ngjashëm mund të gjenden edhe në rast se do ti referoheshim disa prej legjislacioneve të institucioneve të huaja homologe si p.sh., Ligjit për Gjykatën Sllovene të Auditimit, neni 25 apo Ligjit për Zyrën Shtetërore të Auditimit të Kroacisë, neni 12.

l) Lirimi dhe shkarkimi nga detyra i Kryetarit të KLSH-së

Aktualisht, i vetmi përcaktim ligjor në lidhje me shkarkimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit jepet në nenin 162, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë sipas së cilës Kryetari i KLSH-së shkarkohet nga Kuvendi me propozim të Presidentit të Republikës por pa dhënë asnjë parashikim tjetër në lidhje me rastet se kur mund të bëhet ky propozim.

Në ligjin nr. 8599, datë 10.4.2000 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", në nenin 7 të tij parashikohej ndryshimi i nenit 14, të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", i cili parashikonte rastet se kur mbaronte para kohe mandati i Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Gjithashtu në këtë nen parashikohej që me propozimin të Presidentit të Republikës, Kuvendi me dy të tretat e të gjithë anëtarëve të tij mund ta shkarkonte Kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit për shkelje të Kushtetutës, për paaftësi mendore ose fizike dhe për akte dhe sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Sipas këtij neni, vendimi i Kuvendit do të duhej të shqyrtohej nga Gjykata Kushtetuese, e cila kur të vërtetonte se ekzistonin shkaqet e mësipërme, deklaronte shkarkimin e tij nga detyra.

Neni 7 i ligjit nr. 8599, datë 10.4.2000, është shfuqizuar me vendimin nr. 212, datë 29.10.2002 të Gjykatës Kushtetuese me arsyetimin bazë që përcaktimi i bërë në këtë nen në lidhje me rolin e Gjykatës Kushtetuese në shkarkimin e Kryetarit të KLSH-së është në papajtueshmëri me Kushtetutën.

Deklarata e Meksikës, në Parimin 2 të saj ku i referohet standardeve ndërkombëtare mbi pavarësinë e Institucioneve Supreme të Auditimit, përcakton që:

"Legjislacioni zbatues përcakton kushtet për emërim, riemërim, punësim, largim nga detyra dhe daljen në pension të Kryetarit të SAI-t dhe anëtarëve të institucioneve kolegjiale, të cilët emërohen, ri-emërohen apo largohen nga detyra me anë të një procesi që siguron pavarësinë e tyre nga Ekzekutivi; emërimet me mandate të mjaftueshme të përcaktuara dhe me afat kohor të gjatë, që i lejon ata të kryejnë mandatet e tyre pa frike apo shpagime; dhe imunitet ndaj çdo lloj ndjekje penale për veprime, të shkuara apo aktuale, që rezultojnë nga kryerja e detyrave të tyre sipas rastit".

Si pasojë e detyrimeve që rrjedhin nga kërkesa për zbatim dhe aplikimin praktik në legjislacion të standardeve të mësipërme ndërkombëtare, SIGMA dhe DG Budget kanë

kërkuar që pavarësisht pengesave të mësipërme të parashikohej një dispozitë, në të cilën të përcaktoheshin rastet se kur mund të lirohej apo shkarkohej nga detyra Kryetari i KLSH-së, kërkesë kjo e përsëritur edhe në çdo Progres Raport për Shqipërinë.

Të ndodhur para kësaj situate legjislative, grupi i punës për hartimin e këtij projektligji si dhe ekspertët e së drejtës që kanë kontribuar në finalizimin e tij, kanë sugjeruar formulimin e nenit 23 të projektligjit në një mënyrë dhe me një terminologji te tillë e cila nuk pasqyron atë të nenit 7, të ligjit nr. 8599, datë 10.4.2000, të shfuqizuar me vendimin nr. 212, datë 29.10.2002 të Gjykatës Kushtetuese.

SIGMA ka sugjeruar që në këtë nen do të ishte e përshtatshme të përcaktohej edhe rasti që një person nuk mund të jetë në pozicionin e Kryetarit në qoftë se është mbi moshën 70 vjeçare por ky propozim nuk është reflektuar në nenin 23, pasi një përcaktim i tillë është rrëzuar si i papajtueshëm me Kushtetutën në vendimin e mësipërm nr. 212, datë 29.10.2002 të Gjykatës Kushtetuese.

m) E drejta e disponimit të dokumenteve dhe informacionit

Neni 25 i projektligjit i cili përkon me nenin 17 të ligjit organik aktual, synon të ezaurojë të gjithë problematikën e deritanishme që KLSH ka patur në lidhje me hasjen e pengesave apo mosdhënien e informacionit dhe dokumentacionit nga subjektet e audituara dhe ti japë KLSH-së kompetenca të plota për të patur akses në të gjitha dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, në bazat elektronike të të dhënave që konsiderohen prej tij si të nevojshme në funksion të ushtrimit të kompetencave dhe detyrave të tij ligjore.

Sipas komenteve të SIGMA-s, mundësia për të shfrytëzuar të gjithë bartësit e informacioneve dhe autoriteti i dhënë KLSH-së për të vendosur vetë për atë çka i nevojitet, është një përmirësim i rëndësishëm krahasuar me dispozitat ekzistuese ku jepet thjesht një përshkrim i ngushtë i asaj çfarë KLSH mund të kërkojë.

Ndryshimet e pasqyruara në nenin 25 të projektligjit janë në përputhje me Parimin 4 të Deklaratës së Meksikës, sipas të cilit SAI-t duhet të kenë kompetenca të mjaftueshme për të marrë në kohë dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë, të gjitha dokumentet dhe informacionet e nevojshme për ushtrimin e përgjegjësive të tyre ligjore.

Gjithashtu në këtë nen janë shtuar disa përcaktime të reja duke i dhënë të drejtë KLSH-së që të kontrollojë edhe informacionin apo dokumentacionin e ruajtur apo paraqitur në formë elektronike.

Në nenin 26 të projektligjit është parashikuar që në rastet kur Kontrolli i Lartë i Shtetit, gjatë kryerjes së funksioneve të tij, vjen në dijeni të informacioneve që përbëjnë sekret shtetëror, zyrtar, tregtar apo individual, ai është i detyruar që të ruajë dhe respektojë

karakterin konfidencial të informacioneve të tilla, si dhe rregulloren e brendshme të institucioneve duke ua zbuluar ato vetëm autoriteteve të interesuara kompetente.

Në nenin 27 të projektligjit parashikohet që veprimtaritë që përbëjnë sekret shtetëror duhet të auditohen vetëm nga auditues të autorizuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe të pajisur me certifikatën e sigurisë të lëshuar nga institucioni përkatës.

n) Të drejtat e subjektit të audituar

Në nenin 28 të projektligjit janë parashikuar një sërë të drejtash që subjektet e audituara kanë përsa i përket krijimit nga KLSH-ja të mundësisë për të komentuar apo paraqitur observacionet e tyre në çdo fazë të auditimit dhe përpara nxjerrjes së raportit përfundimtar, të cilat së bashku me qëndrimin e audituesve ndaj tyre duhet të pasqyrohen në raportin përfundimtar.

Përcaktimet e mësipërme janë në përputhje me Seksionin 17 të Deklaratës së Limës, sipas të cilit Institucionet Supreme të Auditimit duhet ti japin pikëpamjeve të subjekteve të audituara konsideratën e duhur në gjetjet e tyre.

o) Njoftimi dhe publikimi i raporteve të auditimit

Në nenin 30 të projektligjit është parashikuar e drejta që ka subjekti i audituar për tu njohur me raportin e auditimit. Sipas këtij neni, Kryetari vendos nëse është e nevojshme që t'i paraqiten këto raporte edhe Presidentit të Republikës, Kryeministrit, Kryetarit të Kuvendit, kryetarëve të grupeve parlamentare apo Ministrit të Financave.

Gjithashtu, në nenin 32 të projektligjit parashikohet që KLSH informon publikun nëpërmjet publikimit të raporteve të paraqitura nga KLSH në Kuvendin e Shqipërisë; publikimit të raporteve të auditimit në mënyrë elektronike; konferencave për shtyp dhe metodave të tjera të informimit në media; publikimit të njoftimeve për shtyp dhe çdo informacioni tjetër që përcaktohet nga Kryetari i KLSH-së me përjashtim të informacioneve dhe materialeve të cilat përbëjnë sekret shtetëror, tregtar apo konsiderohen si konfidenciale.

Praktika të tilla të ngjashme gjejnë edhe në legjislacionet e institucioneve të huaja homologe si p.sh., në nenin 48 të Ligjit për Gjykatën Sllovene të Auditimit.

p) Statusi i personelit

Në këtë projektligj janë parashikuar 8 nene në lidhje me statusin e personelit të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe më konkretisht nenet 33-40. Këto nene synojnë të rregullojnë në komponentët kryesorë, figurën dhe statusin juridik dhe profesional të audituesve shtetërorë të certifikuar.

KLSH është tashmë me vonesë në përcaktimin e një statusi të tillë në lidhje me punonjësit e saj, pasi një gjë e tillë është realizuar që në vitin 2003 në ligjin për auditin e brendshëm në sektorin publik.

Ekspertët holandezë të binjakëzimit kanë qenë promotorë të përfshirjes së këtyre dispozitave në ligjin e rishikuar dhe gjithashtu DG Budget edhe SIGMA kanë miratuar këtë rregullim të ri të figurës së audituesit shtetëror të certifikuar.

Në paragrafin e parë të nenit 33 të projektligjit, parashikohet që punonjësit e KLSH-së nuk lejohet të ekzekutojnë një mandat politik dhe as të jenë anëtarë aktivë të ndonjë organizate apo partie politike si dhe nuk duhet të marrin pjesë në veprimtari politike ose në ato me karakter tregtar me përjashtim të mësimdhënies, botimeve dhe veprimtarive kulturore apo sportive, me kusht që këto aktivitete nuk dëmtojnë dinjitetin e institucionit dhe nuk cenojnë paanshmërinë dhe pavarësinë e tij.

Porsa i përket këtij paragrafi, DG Budget ka propozuar heqjen e kufizimeve për anëtarësimin dhe pjesëmarrjen e punonjësve të KLSH-së në veprimtari dhe organizata politike, pasi një gjë e tillë do të binte ndesh me liritë dhe të drejtat politike të njeriut, prandaj varianti që është paraqitur në projektligj e kufizon këtë të drejtë vetëm në detyrimin për të mos ekzekutuar një mandat politik dhe për të mos qenë anëtar aktiv i ndonjë organizate apo partie politike.

Në nenin 34 të projektligjit parashtrohet ndarja e nëpunësve të KLSH-së në funksion të detyrave të auditimit, atyre mbështetëse të auditimit dhe shërbimeve të tjera ndihmëse. Sipas këtij neni, detyrat e auditimit dhe detyrat mbështetëse të auditimit do të realizohen nga audituesshtetërorë të certifikuar dhe asistentë audituesh, ndërsa shërbimet ndihmëse do të kryhen nga personeli, marrëdhëniet e punës së të cilëve rregullohen nga legjislacioni mbi shërbimin civil apo Kodi i Punës.

Në nenet 35 dhe 36 të projektligjit parashikohet në vija të përgjithshme procedurat e marrjes së titullit "auditues shtetëror i certifikuar" dhe "asistent auditues" duke vendosur përveç kritereve të përgjithshme të përcaktuara në legjislacionin mbi shërbimin civil edhe një sërë kërkesash të tjera si p.sh., të kenë mbaruar studimet e larta universitare dhe të kenë përvojë pune jo më pak se 3 vjet në auditim apo në fusha të tjera që konsiderohen si të rëndësishme për sektorin specifik të auditimit.

Në nenet 37 dhe 39 të projektligjit janë parashikuar një sërë të drejtash dhe detyrimesh në lidhje me audituesit shtetërorë të certifikuar dhe nëpunësit e KLSH-së të cilët gëzojnë të drejtën për të patur stabilitet dhe barazi në lidhje me emërimin, ngritjen e tyre në detyrë, si dhe përfshirjen e tyre në forma të ndryshme të trajnimit profesional të cilat përfshijnë shtimin dhe përditësimin e njohurive dhe aftësive të nevojshme për kryerjen e detyrave të auditimit.

Gjithashtu, audituesit shtetërorë të certifikuar dhe ekspertët e jashtëm të kontraktuar nga KLSH, duhet të jenë të pavarur dhe nuk duhet ti nënshtrohen asnjë kufizimi apo presioni në lidhje me opinionet e tyre, duke i bazuar marrëdhëniet e tyre profesionale me subjektet e audituara në përputhje me legjislacionin për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike.

q) Ekspertët e jashtëm

Sipas përcaktimeve të bëra në nenin 38 të projektligjit, KLSH në funksion të ushtrimit të veprimtarive të tij audituese dhe në varësi të nevojave, mund të kontraktojë përkohësisht ekspertë (të jashtëm), vendas apo të huaj, ku si të tillë mund të caktohen edhe shtetas të huaj të njohur në disiplinën e auditimit, organizata jo fitimprurëse, njësi universitare dhe akademike apo institute të ndryshme studimore shtetërore ose private.

Krijimi i hapësirës legjislative për të punësuar në KLSH ekspertë të ndryshëm krijon premisat për zhvillimin e auditimeve akoma dhe më profesionale, më gjithëpërfshirëse duke marrë dhe reflektuar në një kohë sa më të shpejtë eksperiencën më të mirë ndërkombëtare dhe akademike.

6. Efekti Financiar i Projektligjit

Nga pikëpamja e efektit financiar të mundshëm që buron nga amendimet e këtij ligji sqarojmë se nuk ka asnjë efekt financiar të menjëhershëm, dhe ato efekte financiare që mund të lindin nga zbatimi në praktikë i këtij ligji do të përllogariten dhe paraqiten ne projektbuxhetin e vitit 2013.

7. Referenca juridike për përgatitjen e projektligjit

Standardet ndërkombëtare të INTOSAI-t

ISSAI 1-Deklarata e Limës

ISSAI 10-Deklarata e Meksikës

ISSAI 11- Udhëzues dhe Praktikat e mira lidhur me Pavarësinë e SAI-ve

ISSAI 100- Parimet Themelore të Auditimit në Sektorin Publik

ISSAI 1003-Fjalor i termave te Udhëzuesit të Auditimit Financiar të INTOSAI-t

ISSAI 4000-4200, Udhëzues i Auditimit të përputhshmërisë.

Legjislacioni i huaj

Ligji për Zyrën Supreme të Auditimit të Republikës së Sllovakisë

Ligji për Zyrën Shtetërore të Auditimit të Kroacisë

Ligji për Gjykatën Sllovene të Auditimit.

Legjislacioni shqiptar

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

Ligji nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit".

Ligji nr. 8599, datë 01.06.2000, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit".

Vendimi nr. 212, datë 29.10.2002 i Gjykatës Kushtetuese.

Vendimi nr. 19, datë 03.05.2007 i Gjykatës Kushtetuese.

Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë".

Ligji nr. 10 294, datë 1.7.2010 "Për inspektimin financiar publik".

Ligji nr. 8503, datë 30.6.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare".

Referenca të tjera

Fjalor i termave në lidhje me udhëzimet e INTOSAI-t mbi auditimin financiar.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

KRYETARI

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë-Shqipëri, Tel&Fax 0422 71454

Nr. 945/4 Prot. Tiranë, më 26/11/2012

Lënda: **Dërgim relacioni për projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", i ndryshuar."**

Drejtuar: **Zj. Jozefina ÇOBA TOPALLI**
KRYETARE E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

TIRANË

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në zbatim të detyrimeve të tij kushtetuese, si dhe në bazë të standardeve INTOSAI dhe të "Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit", ka përgatitur ndryshimet ligjore në ligjin e tij organik Nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", i ndryshuar.

Puna për hartimin e këtij projektligji ka filluar që në vitin 2009, në zbatim të marrëveshjes së binjakëzimit midis Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe NAO-s (Zyrës Kombëtare të Auditimit të Britanisë së Madhe) dhe Gjykatës Holandeze të Llogarisë, por për arsye të ndryshme subjektive këto amendime në ligj nuk ishin paraqitur në Kuvend dhe drafti përfundimtar ishte i papërfunduar. Gjatë vitit 2012 rinisëm punën, duke siguruar mbështetjen me këshillime teknike nga DG-Budget (Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit e BE-së) dhe SIGMA (programi i OECD-së dhe BE-së për mirëqeverisjen).

Në rrugë jozyrtare, materialin ia kemi paraqitur edhe deputetëve të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit, si dhe jemi konsultuar me Ministrinë e Financave, Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Integrimit.

Gjithashtu, Kontrolli i Lartë i Shtetit gjatë muajit Nëntor 2012 ka organizuar edhe katër tryeza pune me gazetarë dhe përfaqësues te mediave; me juristë të shquar, ekspertë të së drejtës dhe profesorë të Fakultetit të Drejtësisë; me ekspertë kontabilistë dhe profesorë të Fakultetit Ekonomik, si dhe përfaqësues të shoqërisë civile në Shqipëri, në praninë e z. Robert Gielisse, Drejtor Njesie në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit të Bashkimit Evropian.

Në hartimin e këtyre amendimeve në ligj është marrë në konsideratë edhe përvoja e institucioneve të tjera homologe të auditimit në vendet me të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit ka marrëdhënie dhe marrëveshje bashkëpunimi si Holanda, Polonia, Sllovenia,

Kroacia, etj., të cilët përveç dhënies së praktikës së tyre legjislative kanë ofruar një sërë mendimesh dhe sugjerimesh në lidhje me dispozitat e këtij projektligji.

Referuar nenit 81 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe duke patur parasysh marrëdhënien ndërinstitucionale ndërmjet Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Kuvendit të Shqipërisë, po ju paraqesim për shqyrtim nga ana Juaj, të gjithë dokumentacionin e nevojshëm në lidhje me ndryshimet e propozuara duke Ju kërkuar njëkohësisht vazhdimin e mëtejshëm të procedurave ligjore për marrjen në shqyrtim dhe më tej miratimin e këtij projektligji.

Bashkëlidhur keni relacionin dhe projektligjin e propozuar, në dy forma, në formën e projekt-ligjit të ri dhe në formën e amendimeve të ligjit ekzistues, të vetëdijshëm që Ju takon Ju të vendosni për formën e duhur.

KRYETAR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË KONTROLLI I LARTË I SHTETIT TIRANË

Bujar LESKAJ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
K R Y E T A R I

Nr. 90/ Prot. Tiranë, më 27/11/ 2013

Z. Ilir META
Kryetar i Kuvendit të Republikës së Shqiperise

TIRANË

Lënda: Informim mbi çështjen e shtruar për KLSH në Takimin e pestë të Nënkomitetit Bashkimi Evropian-Shqipëri për "Çështjet Ekonomike, Financiare dhe të Statistikave"

Ju bëj me dije se në Takimin e pestë të Nënkomitetit Bashkimi Evropian-Shqipëri për "Çështjet Ekonomike, Financiare dhe të Statistikave", zhvilluar më 24 tetor 2013 në Bruksel, nga ana e Bashkimit Evropian, u kërkua që të qartësohet çështja e mos-aprovimit ende nga Kuvendi i Shqipërisë, i amendimeve të Ligjit Organik të KLSH-së, depozituar në këtë institucion, në 26 Nëntor 2012.

Sikurse është përmendur në letrën që Ju kemi drejtuar në datën 18 tetor 2013 me Nr.851Prot., KLSH në kuadër edhe të përmbushjes së rekomandimeve të Progres Raporteve të BE-së dhe avancimit në procesin e integrimit europian, ka ndërmarrë nismën për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.8270 datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", i ndryshuar, të cilat i ka depozituar në Kuvendin e Shqipërisë në datën 26 Nëntor 2012.

Në respekt të Institucionit dhe personalisht Tuajin, duke patur parasysh edhe ndjeshmërinë e Komisionit Evropian për këtë çështje, lutemi të mund të ushtroni ndikimin Tuaj për futjen e amendimeve të ligjit të KLSH në axhendën e punimeve të Kuvendit të Shqipërisë në një kohë sa më të shpejtë, si një veprim që përshpejton integrimin e vendit në fushën e auditimit të jashtëm publik.

Duke Ju siguruar se KLSH do të vazhdojë të përmbushë misionin e tij si agjent i publikut dhe i Kuvendit të Shqipërisë për mirëadministrimin e parasë publike, në përputhje me praktikat më të mira të BE dhe me standartet ndërkombëtare të INTOSAI.

Duke Ju shprehur konsideratat e mia më të larta,

Bujar LESKAJ

KRYETAR

Ligji i ri e sjell auditimin e jashtëm publik në një linjë me standardet ndërkombëtare

Diskutim në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave

17 mars 2014

Të pranishëm: z. Erion Braçe, z. Ridvan Bode, z. Anastas Angjeli, z. Andrea Marto, z. Arben Çuko, zj. Majlinda Bufi, z. Ervin Koçi, zj. Evis Kushi, z. Dashamir Shehi, z. Florion Mima, zj. Blerina Gjylameti, z. Sherefedin Shehu, z. Ilir Xhakolli, z. Igli Cara, z. Paulin Sterkaj, z. Pjerin Ndreu dhe zj. Liljana Elmazi.

Qysh në fillim të prezantimit të këtij projektligji të përgatitur nga KLSH-ja, më lejoni, të nderuar deputetë, të shpreh falënderimin për dashamirësinë dhe mirësinë që keni treguar ndaj këtij ligji, i cili më së fundi futet në agjendën e Kuvendit. KLSH-ja, në vijim të përpjekjeve për të përputhur veprimtarinë e vet me standardet ndërkombëtare të auditimit INTOSAI dhe me legjislacionin bashkëkohor të 3 institucioneve homologe dhe të zhvilluara, si dhe në zbatim të kërkesave e rekomandimeve të progres-raporteve të fundit të Komisionit Europian ka përgatitur amendimet e ligjit të tij organik nr. 8270, datë 23.12.1997, i ndryshuar, me ndihmën teknike të Drejtorisë së Përgjithshme të DG Budget të buxhetit të Komisionit Europian dhe të projektit SIGMA të BE-së dhe të OSBE-së. Nga ana tjetër, brenda vendit, ky proces është konsultuar me institucione të ndryshme shtetërore, më përfaqësues të shoqërisë civile. Në rrugë informale është diskutuar dhe me deputetë të Komisionit të Ekonomisë, me grupe të ndryshme interesi, duke përfshirë në veçanti qarqet akademike të fushës juridike dhe ekonomike.

Përfitoj nga ky rast që nga ky Komision i nderuar të falënderoj të gjithë ata përfaqësues, vendas dhe të huaj, që kanë kontribuar në përgatitjen e këtij projektligji. Do të lejoni që në fillim të fjalës sime të citoj një vlerësim nga drejtori i Përgjithshëm i DG Budget, me 18 tetor 2012. Pasi siguron për mbështetjen maksimale teknike të Komisionit Europian për amendimet e ligjit të KLSH-së, shprehet se: "Amendimet e sjellin institucionin e KLSH-së tërësisht në linjë me standardet INTOSAI". Kujtoj këtu se këto amendime janë sjellë në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë me 29 nëntor 2012 dhe janë risjellë në legjislaturën e re. Zoti Robert Gielisse, drejtor njësie në DG Budget, i cili ka ardhur personalisht dy herë për ligjin e ri të KLSH-së, në tetor të vitit 2012, ku mori pjesë në tryezat e punës të organizuara me këtë rast, si dhe në dhjetor të vitit 2013, kur u takua me Kryetarin e Parlamentit, zotin Ilir Meta, gjatë konsultimeve me palët e interesit në nëntor të vitit 2013 ka cilësuar se: "*Projektligji i ri jep një strukturë të qartë dhe terminologji të standardeve ndërkombëtare. Ai ka referenca të qarta për auditimet e performancës dhe përkufizim më të fortë të rolit dhe të të drejtave të KLSH-së*".

Amendimet e ligjit të KLSH-së janë një përparim i madh. Ato e sjellin auditimin e jashtëm publik në Shqipëri në një linjë me standardet ndërkombëtare. Domosdoshmëria e kryerjes së ndryshimeve në ligjin organik të mëparshëm të KLSH-së ka ardhur si rezultat i një sërë faktorësh të brendshëm dhe të jashtëm, ku më kryesorët, më lejoni të citoj, kërkesat dhe angazhimet e Shqipërisë të përcaktuara në MSA. Sipas nenit 90 të MSA-së, bashkëpunimi mes palëve do të përqendrohet në fushat prioritare që lidhen me të drejtën e komunitetit, në fushën financiare, në fushat e kontrollit financiar të brendshëm publik e të auditimit të jashtëm. Palët bashkëpunojnë në mënyrë të veçantë për të zhvilluar një sistem efikas të kontrollit financiar të brendshëm publik dhe sistemet e auditimit të jashtëm në Shqipëri në përputhje me standardet dhe metodologjitë e pranuara botërisht, si dhe me praktikat më të mira të BE-së. Bazuar në këto përcaktime të MSA-së dhe në këto kërkesa të saj, progres-raportet e viteve 2010, 2011, 2012 dhe 2013 të Komisionit Europian për Shqipërinë kanë theksuar vazhdimisht kërkesat për kryerjen e llojeve të reja të auditimit, auditim performance dhe certifikimi, për forcimin e kapaciteteve të performancës së KLSH-së, për ndjekjen sistematike parlamentare të raporteve të KLSHsë, për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së dhe së fundi miratimin e projektligjit të ri "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit". Më konkretisht, po citoj pjesë të shkëputura në progres-raportin e vitit 2011 për Shqipërinë. Komisioni Europian shprehet se: "Progres i limituar është bërë në llojet e reja të auditimit, të tilla si certifikimi dhe auditimi i performancës". Amendimet në ligjin për institucionin suprem shtetëror të auditimit SAI, për ta sjellë atë plotësisht në linjë me standardet e tij INTOSAI, janë duke u përgatitur. Amendimet duhet të adoptohen në mënyrë që kuadri ligjor të sillet plotësisht në linjë me standardet INTOSAI. Ka akoma pak progres në fushat që lidhen me mbrojtjen e interesave financiare të BE-së. Në progres-raportin e vitit 2012 për Shqipërinë, Komisioni Europian, ndër të tjera, shprehet: "Pas vitesh nevojiten përpjekje të konsiderueshme për të forcuar kapacitetet e performancës së KLSH-së". Pas disa vitesh në pezullim janë përgatitur dhe janë dërguar për miratim ndryshimet e ligjit të SAI-t për ta sjellë në përputhje të plotë me standardet e INTOSAI-t. Në progres-raportin e vitit 2013 për Shqipërinë, Komisioni Europian shprehet: "Ndryshimet në ligjin e KLSH-së janë në pritje dhe nevojitet përfshirja e një performance të qëndrueshme auditimi". Janë ndërmarrë ndryshime organizative dhe procedura të reja për të rritur efiçiencën e KLSH-së. Megjithatë, ndryshimet në ligjin për KLSH-së janë duke u shqyrtuar në parlament që në vitin 2012 dhe mbetet të miratohen me një shumicë prej 3/5. Aktualisht, nuk ka ndjekje sistematike parlamentare të raporteve të KLSH-së.

Në standardet ndërkombëtare INTOSAI, dy prej tyre konsiderohen si më kryesoret: ISSAI 1, Deklarata e Limës, e quajtur ndryshe Kushtetuta e Komuniteteve Supreme të Auditimit dhe ISSAI 10, Deklarata e Meksikës, e cila flet për pavarësinë e SAI-ve.

Projektligji i ri mbështetet plotësisht në këto standarde si dhe në standarde të tjera ndërkombëtare si ato të IFAC-ut dhe në rezolutat e kongreseve të INTOSAI-t dhe EUROSAI-it. Në këtë këndvështrim, miratimi i një ligji të ri për KLSH-në është i domosdoshëm në funksion të përqasjes së plotë me standardet ndërkombëtare të auditimit, gjë që ka ndodhur me shumicën e legjislacioneve të institucioneve homologe të auditimit.

Së dyti, përshtatja e legjislacionit të KLSH-së si institucion i auditimit të jashtëm me ndryshimet e bëra në legjislacionin për auditimin e brendshëm në sektorin publik. Ligji nr. 9720, datë 23.04.2007. "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" në përmbajtjen dhe terminologjinë juridike mbetet një ligj bashkëkohor në krahasim me ligjin organik ekzistues të KLSH-së. Miratimi i një projektligji të ri për KLSH-në, në vazhdim të punës së bërë për ligjin "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" si dhe asimilimin në ligj të standardeve ndërkombëtare të auditimit plotëson në tërësi kuadrin e nevojshëm ligjor për sa i përket auditimit të brendshëm dhe të jashtëm në sektorin publik.

Së treti, zëvendësimi i terminologjisë së vjetër juridike të ligjit ekzistues me terminologjinë bashkëkohore. Ligji organik i KLSH-së nr. 8270, datë 23.12.1997, vazhdon të mishërojë terminologji të vjetër juridike dhe financiare të një periudhe kur ky institucion konsiderohej si një institucion i kontroll-revizionit të pasqyrave financiare. Kjo terminologji aktualisht nuk përdoret më në legjislacionet e institucioneve homologe. Madje, as në legjislacionin tonë mbi auditin e brendshëm në sektorin publik. Kështu, për shembull, termi "kontroll" nuk i përshtatet kërkesave të standardeve ndërkombëtare dhe nuk përputhet plotësisht me konceptin dhe përmbajtjen e termit "auditim", i cili ka fituar qytetari edhe në vendin tonë.

Risitë e projektligjit të paraqitur:

1. *Zgjerimi i objektit të veprimtarisë audituese*

Në projektligjin e ri janë përcaktuar dhe përkufizuar, krahas auditimit të përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare edhe kryerja e auditimit të performancës, auditimit të IT-së dhe certifikimit të llogarive financiare. Përcaktimi në ligj i të gjitha llojeve të auditimit është i domosdoshëm dhe e vendos KLSH-në në një nivel zhvillimi dhe performance me institucione moderne. Më lejoni të citoj këtu një personalitet të INTOSAI-t, dr. Moser, president i Gjykatës së Auditimit të Austrisë: *"Auditimi dhe këshillimi janë dy fytyra të së njëjtës monedhë"*. Nga njëra anë, problemet dhe mundësitë për përmirësim janë analizuar dhe identifikuar gjatë retrospektivës, pra auditimeve të bazuara në fakte dhe, nga ana tjetër, ato plotësojnë me qasjen e këshillimit largpamës me rekomandime për të përmirësuar dhe rritur ekonominë, si dhe efektivitetin e qeverisjes publike. Ligji i ri jep këtë mandat të zgjeruar auditimi, duke

futur konceptin dhe veprimin e auditimit të performancës. Një risi është që auditimi në KLSH, në mbrojtje të kërkesave financiare të BE-së dhe zbatim të MSA-së duhet të zhvillohet ndaj përdoruesve të fondeve të ofruara nga BE ose organizatave të tjera ndërkombëtare. BE-ja, gjatë periudhës 2014- 2020, ka vendosur rregulla të forta të kontrollit financiar. Ato bazohen në direktivat e Komisionit Europian për sistemet e kontrollit efektiv dhe auditimit të fondeve të BE-së si një nga çështjet kyçe. Administratat në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal kanë më shumë përgjegjësi për të ndërtuar një sistem efektiv të kontrollit. Politika e kohezionit, e zbatuar kohët e fundit nga BE, u kërkon organizmave kombëtarë të vendeve përfituese të fondeve të BE-së një rol më të madh në monitorimin dhe kontrollin financiar të projekteve. Zgjerimi i mandatit audites të KLSH-së nëpërmjet përfshirjes në ligjin e ri të së drejtës për të audituar fondet e BE-së, përkon me praktikat e mira në menaxhimin, kontrollin financiar dhe procedurat e fondeve strukturore të shteteve të ndryshme të BE-së. Ai përfshin menaxhimin e buxhetit të fondit, raportimin si dhe kërkesat e kontrollit financiar dhe të auditimit.

2. *Auditimi dhe certifikimi i pasqyrave financiare vjetore për njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe dhënia e opinionit për to*

Kjo ka qenë edhe një kërkesë e vetë ligjit organik, të neneve 62 dhe 63, të buxhetit. Në projektligjin e ri ato trajtohen respektivisht në nenet 9 dhe 10. Në nenin 9 parashikohet kompetenca e KLSH-së për auditimin e llogarive vjetore të institucioneve. Konkretisht: KLSH-ja ka kompetencë të auditojë zbatimin e buxhetit nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, si dhe nga personat e tjerë juridikë, duke përfshirë llogaritë vjetore. KLSH-ja çdo vit jep opinionin për raportin e konsoliduar vjetor të zbatimit të buxhetit, i cili përfshin dhe vlerësimin e bërë bazuar në nenin 15, paragrafi 1. Terminologjia është përshtatur me atë të përdorur në ligjin organik të buxhetit. Paragrafi i fundit i këtij neni është shtuar me sugjerimin e SIGMA-s, në mënyrë që të harmonizohet me ligjin organik të buxhetit, nenet 62 dhe 63. Referuar nenit 62 të ligjit organik të buxhetit të shtetit përcaktohet që: një kopje e raportit vjetor të konsoliduar të buxhetit të shtetit, të cilin ministri i Financave e paraqet brenda muajit maj në Këshillin e Ministrave i dërgohet edhe KLSH-së, që auditon llogaritë vjetore të buxhetit.

Gjithashtu, në nenin 10 të projektligjit të ri përcaktohet qëllimi i kryerjes së këtij lloj auditimi, sipas të cilit nga auditimet financiare KLSH-ja duhet të përcaktojë nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar. Vendosja e këtyre përcaktimeve garanton kryerjen e auditimeve financiare, pra dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, të njësive të qeverisjes së përgjithshme. Në standardin ndërkombëtar të auditimit të SAI-ve, ISSAI 2/200, në standardet e IFAC-ut,

objektivi dhe parimet e përgjithshme që drejtojnë auditimin e pasqyrave financiare, paragrafi i tretë, përcaktohet se qëllimi i një auditimi është rritja e shkallës së besimit për përdoruesit e caktuar të pasqyrave financiare. Kredibiliteti i pasqyrave financiare të përgatitura nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme do të rritet nëse opinionet e auditimit janë paraqitur në mënyrë të saktë dhe në përputhje të plotë me kërkesat e standardeve ndërkombëtare.

Deklarata e Limës gjithashtu përcakton se koncepti i realizimit të auditimit është i qenësishëm në administrimin publik financiar, pasi menaxhimi i fondeve publike nënkupton besim. Këto i kemi parashikuar edhe në planin strategjik të zhvillimit institucional nën objektivin 2/2 "Zhvillimi i kompetencave të auditimit financiar dhe të kapaciteteve, për periudhën 2013-2017. KLSH-ja duhet të përgatisë veten për lëshimin e një opinioni mbi raportin e ekzekutimit të buxhetit të konsoliduar dhe dhënien e opinioneve mbi pasqyrat financiare të subjekteve të audituara. Kjo nënkupton një rishikim të një manuali të auditimit financiar, duke përfshirë edhe udhëzime mbi opinione të auditimit dhe të raportimit. KLSH do të angazhohet në ndërtimin e kapaciteteve audituese për kryerjen e këtij auditimi.

Jeni në dijeni, që ne kemi fituar nga fondet e projektit IPA 2013. Në këtë aspekt kemi parashikuar një kuadër të plotë skemash operacionale, të cilat synojnë zhvillimin e metodologjive apo të kuadrit rregullator, manuale, udhëzime etj., për implementimin e amendimeve ligjore për sa i përket kryerjes së certifikimit të llogarive vjetore.

3. *Përmirësimi i marrëdhënieve me subjektet e audituara*

Projektligji i ri fuqizon të drejtën e KLSH-së për sigurimin prej subjekteve të audituara të të gjithë informacionit dhe dokumentacionit shkresor dhe elektronik që ajo i konsideron të nevojshme për realizimin e detyrave audituese. Parashikohet që këto subjekte jo vetëm që do të sigurojnë të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar brenda një afati, qoftë edhe kur ai përbën një sekret shtetëror apo konsiderohet si konfidencial, por këto subjekte duhet që brenda një afati të caktuar kohor të raportojnë edhe në lidhje me marrjen e masave dhe ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të bëra nga KLSH-ja pas përfundimit të auditimit. Neni 25 synon të ezaurojë të gjithë problematikën e deritashme në lidhje me mosdhënien e informacionit apo dokumentacionit nga subjektet apo pengimi i detyrës. Sipas komenteve të SIGMA-s mundësia për të shfrytëzuar të gjithë bartësit e informacioneve dhe autoriteti i KLSH-së për të vendosur vetë për çka i nevojitet, është një përmirësim i rëndësishëm krahasuar me ligjin në fuqi, ku jepet një përshkrim i ngushtë i asaj çka KLSH-ja mund të kërkojë. Për këtë shprehet qartë edhe Parimi 4 i Deklaratës së Meksikos, ku thuhet se: "SAI duhet të ketë kompetenca të mjaftueshme për të marrë në kohë dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë të gjitha dokumentet e nevojshme dhe informacionet për ushtrimin e

përgjegjësive. Gjithashtu, në projektligj shprehet qartazi një qasje akoma dhe më miqësore kundrejt subjekteve të audituara, si në lidhje me të drejtën e këtyre subjekteve për t'u njohur me planin e auditimit, ashtu edhe me të drejtën për t'u informuar dhe dhënë shpjegimet në lidhje me gjetjet e pasqyruara në procesverbalet dhe projektraportet e auditimit, të cilat bazuar në projektligjin e ri, janë të detyrueshme për t'u evidentuar në raportin përfundimtar.

4. *Transparenca e rritur e veprimtarisë së KLSH-së ndaj publikut*

Është parashikuar një dispozitë e veçantë në lidhje me informimin e publikut, neni 32, e dalë kjo nga tryezat me organizatat e shoqërisë civile, sipas të cilës KLSH-ja siguron natyrën publike të veprimtarisë së vet nëpërmjet raporteve të paraqitura në Kuvend, publikimit të raporteve të auditimit në mënyrë elektronike, zhvillimit të konferencave për shtyp dhe metodave të tjera të informimit në media, sigurisht në respekt me dispozitat ligjore përkatëse në lidhje me sekretin shtetëror, tregtar apo konfidencial. Ligji i ri siguron transparencë të plotë të institucionit me publikun, në bazë të direktivave të drejtimit të katërt strategjik të EUROSAI për vitet 2011-2017, i cili është qeverisja dhe komunikimi. Nga ana tjetër, sjell në vëmendjen tuaj që Deklarata e Pekinit në Kongresin XXI të INTOSAI-t, ka theksuar se: "SAI ndihmoi në ndërtimin e komunikimit dhe besimit midis sektorit publik dhe qytetarëve, duke promovuar qeverisje të hapur dhe duke mundësuar që qytetarët të marrin pjesë aktive në proceset e vendimmarrjes publike.

5. *Certifikimi i audituesve të KLSH-së*

Projektligji realizon përcaktimin e qartë dhe të plotë të statusit të nëpunësve të KLSH-së, duke parashikuar një sërë dispozitash ku evidentohen të drejtat, detyrimet dhe kushtet që duhet të plotësojnë punonjësit e KLSH-së, sidomos ata me detyra audituese. Më lejoni të citoj përsëri Robert Gielisse, drejtor njësie në DG Budget, cili thekson se: "Certifikimi i audituesit është dëshmi e kompetencës mbi standardet e auditimit dhe lejon komunikim të standardizuar profesional". Gjithmonë, kjo është në vlerësim të projektligjit tonë. Në dispozitat e fundit të këtij projektligji është parashikuar procedura ligjore për marrjen e statusit si auditues i jashtëm publik i certifikuar, status ky që do të siguronte një qëndrueshmëri dhe siguri të stafit të KLSH-së në ushtrimin e detyrës dhe kompetencave të tij ligjore.

6. *Pavarësia financiare e KLSH –së*

Pavarësia financiare u garanton SAI-ve pavarësinë e funksionimit normal ligjor, duke u dhënë mundësinë për të realizuar detyrat e tyre kushtetuese dhe ligjore, bazuar në deklaratën e Limës, neni 7 i saj, si dhe në deklaratën e Meksikos të vitit 2007, që i përkushtohej tërësisht pavarësisë së institucioneve supreme të auditimit.

Sigurimi i pavarësisë financiare dhe vepruese është ndër objektivat kryesore të përfshira në drejtimin e parë strategjik të strategjisë EUROSAI 2011-2016 për ndërtimin e kapaciteteve, si dhe në drejtimin e katërt të strategjisë INTOSAI 2011-2016 për një SAI të fortë dhe model.

Neni 5 i projektligjit të ri për KLSH-në e forcon pavarësinë financiare të institucionit, në vijim të ligjit të mëparshëm, pasi kjo pavarësi, në një farë forme, ka ekzistuar deri më sot. Mjetet financiare të KLSH-së përballohen nga buxheti i shtetit, me një kapitull të veçantë. Në ligjin e ri parashikojmë që KLSH-ja të propozojë çdo vit projektbuxhetin e saj në Komisionin për Ekonominë dhe Financat, i cili e paraqet për miratim në Kuvend. KLSH-ja zbaton në mënyrë të pavarur buxhetin e saj të aprovuar nga Kuvendi. KLSH-ja përgatit çdo vit llogaritë e saj financiare në përputhje me legjislacionin për buxhetin. Llogaritë auditohen nëpërmjet një komisioni të posaçëm dhe të pavarur, i caktuar nga Kuvendi dhe që raporton te ky i fundit ose te Komisioni i Ekonomisë.

Këto ishin në mënyrë të përmbledhur risitë e këtij projektligj.

Të nderuar deputetë,

Për të qenë të ndërgjegjshëm dhe koherentë me profilin që duam të ndërtojmë si institucion suprem auditimi (SAI), kemi lënë edhe disa çështje për të cilat ne mendojmë se është, natyrisht, e drejta juaj, pa dyshim, për t'i vënë pikat mbi I. Më konkretisht, si "mangësi" të këtij projektligji mund të përmendim: mospërfshirjen sa duhet dhe në një mënyrë shumë eksplicite të rritjes së nivelit të zbatueshmërisë së rekomandimeve të KLSH-së, detyrimin e njësive të qeverisjes së përgjithshme dhe vendore për këtë gjë, pavarësisht se ne tani kemi një nivel të zbatimit të rekomandimeve tona në masën 75%. Më duhet t'ju rikujtoj se për masën disiplinore "Largim nga detyra" për drejtuesit e lartë asnjëherë nuk kemi shkuar mbi 50%. Trajtimin e veçantë të së drejtës që ka KLSH-ja në drejtim të auditimit të koncesioneve. Ne do t'ju sjellim edhe praktikat më të mira të institucioneve homologe të rajonit apo edhe më gjerë.

Trajtimin e të drejtës që KLSH-ja ka në administrimin e të ardhurave dytësore, që institucioni mund të krijojë nga bashkëpunimi dhe angazhimi në auditime të ndryshme, nga botime të ndryshme, etj. Përmirësimin e trajtimit financiar të punonjësve të KLSH-së si garanci e pavarësisë së tyre audituese.

Trajtimin juridik të statusit të kryetarit të KLSH-së, pas mbarimit të mandatit, si dhe rastet e mbarimit të këtij mandati, duke pasur parasysh se pavarësisht sugjerimeve të SIGMA-s dhe të BE-së, që kërkojnë një përcaktim të fortë dhe strikt se kur përfundon mandati, kemi një vendim të Gjykatës Kushtetuese dhe jemi përpjekur në projektligjin tonë t'i referohemi dhe ta respektojmë këtë vendim të Gjykatës Kushtetuese.

Edhe një herë, unë ju falënderoj jo thjesht për vëmendjen që treguat gjatë prezantimit të këtij projektligji, por edhe për dëshirën dhe vullnetin e mirë politik, qytetar që po tregoni si ligjvënës dhe keni treguar në vijimësi ndaj KLSH-së.

Ju faleminderit!

Kufizimi i qasjes në informacion të KLSH-se i shkon ndesh standardeve ndërkombëtare të fushës

Diskutim në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

2 prill 2014

Të pranishëm: z. Fatmir Xhafaj, z. Armando Subashi, z. Bashkim Fino, z. Ulsi Manja, z.Petrit Vasili, z. Spartak Braho, z. Pandeli Majko, z. Piro Lutaj, zj. Silva Caka, z. Nard Ndoka, z. Tahir Muhedini, z. Oerd Bylykbashi, z. Armando Prenga, z.Kastriot Islami, z. Xhemal Qefalia, z. Fatmir Mediu, z. Dashamir Peza, zj.Ermonela Felaj, zj. Vasilika Hysi, z. Tom Doshi, z. Vexhi Muçmataj, z. Mhill Fufi, z. Edi Paloka dhe z. Eduard Halimi.

Të nderuar deputetë,

Së pari, do më lejoni të shpreh falënderimet e mia për anëtarët e Komisionit të Ekonomisë për punën konstruktive dhe rekomandimet që ata kanë dhënë për përmirësimin e këtij projektligji dhe njëherazi duke shprehur falënderimet për ju, do t' ju lutem të më mirëkuptoni që në këtë fjalë timen hyrëse të përqendrohem jo thjeshtë në ata argumente që ne kemi dhënë në relacionin shoqërues bashkuar projektligjit, jo thjesht në ato fjalë apo mendime që unë kam shprehur në komision e Ekonomisë, por të përqendrohem edhe tek ajo problematikë që ndeshëm ne gjatë diskutimeve të amendimeve të projektligjit "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit".

Unë dëshiroj që në fillim t'ju bëj me dije në variantin më të mirë, apo të tërheq vëmendjen tuaj, në faktin se ky ligj nuk ndihmon vetëm institucionin e Auditimit të Jashtëm Publik në Republikën e Shqipërisë të modernizohet dhe fuqizohet pra, KLSH-në, por sikurse e ka theksuar më së miri edhe zoti Robert Xhelis, drejtor i Njësisë së Kontrollit në Drejtorinë e Përgjithshme të Zgjerimit të Buxhetit në Komisionin Europian, në letrën e tij më të fundit të datës 28 mars 2014 drejtuar KLSH-së, "duhet të kihet parasysh se një ligj i KLSH-së në përputhje me standardet INTOSAI-t është një nga kërkesat themelore të kapitullit 32 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit Shqipëri-BE, e cila duhet plotësuar me qëllim anëtarësimin e mundshëm të Shqipërisë në BE".

Ligji që ju keni sot bazohet plotësisht në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë në standardet ndërkombëtare INTOSAI, përkatësisht Deklaratën e Limës, nenet 5,6,7,10,11 dhe 20 të saj si dhe në Deklaratën e Meksikos, të vitit 2007, parimet 3,4 dhe 8 "Për pavarësinë e institucioneve të auditimit të jashtëm publik". Domosdoshmëri për amendimet në ligjin ekzistues pra, domosdoshmëri për këtë ligj të Kontrollit të Lartë të Shtetit në Shqipëri e bën edhe fakti që ne kishim nevojë për të përshtatim legjislacionin

e institucionit Suprem të Auditimit të Jashtëm me ndryshimet e bëra në legjislacionin "Për auditimin e brendshëm publik në Republikën e Shqipërisë". Dhe së fundi natyrisht zëvendësimi i terminologjisë vjetër, arkaike, juridike, të ligjit ekzistues me terminologjinë bashkëkohore.

Ky ligj, në se do të miratohet sipas draftit të rënë dakord me Digi Budget dhe Sigma, rregullon përfundimisht pavarësinë e institucionit financiar dhe veprues, konceptimin modern të të drejtave dhe detyrave të KLSH-së, zgjerim të objektit të veprimtarisë audituese konform standardeve ndërkombëtare, rritjen e nivelit të zbatimeve të rekomandimeve të tij duke përmirësuar ndjeshëm marrëdhëniet me subjektet e audituara, saktësimin e së drejtës së KLSH-së për të audituar fondet e akorduara nga BE-ja, për Shqipërinë, deri te përfituesi përfundimtar, përcaktimin e së drejtës për të nxjerrë opinion mbi llogaritë financiare të institucionit të audituar, si dhe certifikimin e audituesve të KLSH-së dhe në këtë tërësi, mbi të gjitha, në këtë ligj kemi një transparencë të rritur të veprimtarisë së KLSH-së ndaj publikut, çka është shqetësuese sot për të gjitha institucionet shqiptare. Dhe do të më lejoni të citoj përsëri drejtorin e përgjithshëm të Digi Budget, i cili thekson se "amendimet e sjellin institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit të Shqipërisë tërësisht në një linjë me standardet INTOSAI". Duke qenë të gjithë të ndërgjegjshëm se me një ligj të ri modern dhe europian për KLSH-në ndihmojmë vendin për në rrugën e integrimit në BE jam i bindur se asnjë nga ju nuk do to donte ta shmangte këtë ligj nga standardet ndërkombëtare INTOSAI, duke bërë të papranueshëm për Komisionin Europian dhe për të gjithë komunitetin e SAI-ve, Institucioneve Supreme të Auditimit Europiane.

Ky ligj, të nderuar zotërinj deputetë, bëhet shumë lehtë i papranueshëm në rast se cenohet pavarësia e institucionit të Auditimit të Jashtëm Publik, në rast se cenohet e drejta e tij për të marrë informacion dhe pavarësia organizative. Kjo pavarësi e sanksionuar edhe në Deklaratën e Limës të vitit 1977, e konsideruar Kushtetuta e Institucioneve të Auditimit të Jashtëm Publik dhe në Deklaratën e Meksikos të vitit 2007 është e shenjtë për SAI-et e zhvilluara evropiane dhe kudo në botë.

Kjo pavarësi, dhe këto raporte, kanë shtyrë edhe OKB-në që në 22 dhjetor 2011 të miratojë Rezolutën A/66442 "Mbi pavarësinë e Institucioneve të Auditimit të Jashtëm Publik". "Duke njohur se, po citoj nga deklarata; Institucionet e Auditimit të Jashtëm Publik, mund të kryejnë detyrat e tyre objektivisht dhe në mënyrë efektive vetëm nëse ato janë të pavarura dhe janë të mbrojtura nga ndikimi i jashtëm".

Nga ana e tij, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara Ban Ki Mun, më 22 tetor 2013, në përshëndetjen e tij drejtuar Kongresit të 21-të INTOSAI-t, mbajtur në Pekin, ka theksuar se "Institucionet Supreme të Auditimit janë watchdog, roje besnike që ndihmojnë për të nxitur përdorimin efikas dhe efektiv të burimeve publike, duke

ruajtur të plotë pavarësinë e tyre ata do të luajnë një rol kritik në mbështetje të zbatimit të agjendës së re të Kombeve të Bashkuara, për zhvillim të qëndrueshëm që mbështetet mbi qeverisjen e mirë, transparente, përgjegjshmërinë dhe financat inovative"

Sikurse e ka theksuar edhe sekretari i përgjithshëm i INTOSAI-it presidenti i Gjykatës Austriake, Mosset, "Pavarësia e një institucioni të Auditimit të Jashtëm Publik nënkupton, ruajtjen e plotë të pavarësisë financiare, organizative dhe veprueset tij si kushte si ne qua non të ekzistencës dhe dobishmërisë së tyre për qytetarët".

Në respekt të komisionit, por në respekt edhe të punës që ne kemi bërë, në atë ç'ka presim ne nga ky projektligj i ri, për të qenë më efecient në diskutimet tona, në mënyrë modeste në një broshurë kemi përmbledhur dokumente kryesore që janë; SAI-1,10, Deklarata e Limës dhe e Meksikos dhe Rezoluta e Kombeve të Bashkuara, e vitit 2012, të cilën ju e keni përpara. Cenimi me ligj i pavarësisë së KLSH-së do të përbënte një regres dhe jo një hap përpara. Në diskutimet në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave në javët e shkuara, dua me këtë rast të përsëris falënderimet e mia për të gjithë deputetët e komisionit, për qëndrimin e tyre konstruktiv dhe mirëdashës ndaj KLSh-së, pavarësisht ndonjë keqkuptimi, pavarësia financiare u ruajt e plotë, ndërsa pavarësia organizative u prek së bashku me të drejtën për KLSH-në për qasje të pakufizuar në informacion. Theksoj se me përgjegjshmëri se nëse këto cenime do të ruhen deri në variantin përfundimtar që ju si përfaqësuese të popullit do të miratoni në Kuvend, do të ishte më mirë të mbanim ende në fuqi ligjin e vjetër, të vitit 1997, i cili të paktën të drejtën për akses në informacion të KLSH-s nuk e kufizon dhe e ruan të paprekur pavarësinë e tij organizative.

Gjatë diskutimeve në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave aksesi i KLSH-së në informacionin e organeve tatimore mbeti i paqartë. Disa deputetë shprehën mendimin se qasja e pakufizuar e KLSH-së në të dhënat e organeve tatimore mund të dëmtojë interesat e tatimpaguesve privatë. Ne gjykojmë se ky është një keqkuptim dhe për respekt të deputetëve nuk duam ta analizojmë, apo të thellohemi, se kjo nuk është detyra jonë për më tepër e imja si kryetar i KLSH-së. Dua të theksoj këtu, te Komisioni i Ligjeve, komisioni më i lartë i Kuvendit të Shqipërisë se, si institucioni publik më i lartë auditues në vend KLSH-ja gëzon me kushtetutë të drejtën për të audituar mënyrën se si vilen të ardhurat publike. Ne kërkojmë të auditojmë vlerësimin tatimor, i cili kryhet nga administrata tatimore dhe nuk kërkojmë të auditojmë vetëdeklarimin tatimor, i cili kryhet nga tatimpaguesit privatë. Ju garantojmë se në asnjë rast nuk do të merremi me subjektet private, nuk do të kërkojmë shikojmë, ndërhyjmë në to, pasi është kjo shkelje flagrante e standardeve tona profesionale dhe e Kodit Etik. Ne auditojmë performancën e administratës tatimore, auditojmë vlerësimin tatimor, natyrisht edhe duke u njohur me dosjen pra, me vetëdeklarimin tatimor të subjekteve private, sikurse veprojnë të gjitha

institucionet simotra evropiane,por ne do ta ruajmë të shenjtë konfidencialitetin e kësaj dosje dhe duke mos ndërhyrë për verifikime në të konform dhe standardeve tona ndërkombëtare INTOSAI.

Dëshiroj t'ju sjell në vëmendje se refuzimi kategorik i organeve tatimore për t'i dhënë KLSH-së informacion është në kundërshtim edhe me kërkesat e parimit të 4-t "Për një qasje të kufizuar në informacion të deklaratës së Meksikos për pavarësinë e Institucioneve Supreme të Auditimit", qe thotë se "Institucionet supreme të Auditimit duhet të kenë një qasje të drejtpërdrejt dhe të lirë në të gjitha dokumentet dhe informatat e nevojshme për kryerjen e duhur të përgjegjësive të tyre statuore. Pavarësisht debatit për çështjen e sigurisë, për të cituar, duke ju falënderuar sërish për qëndrimin tuaj konstruktiv, shpreh bindjen se projektligji i ri do të miratohet këtu në komision mbështetur plotësisht në Kushtetutën e vendit dhe në standardet ndërkombëtare të auditimit veçanërisht në Deklaratën e Limës dhe të Meksikos.

Dua t'ju tërheq vëmendjen edhe për një gjë, që është lehtësisht e kuptueshme për publikun: në rast se KLSH-ja do të pengohet të auditojë administratën tatimore, atëherë të nderuar zotërinj deputetë, kush do t'i auditojë, kush do t'i kontrollojë drejtorin e Përgjithshëm të Tatimeve, drejtorët rajonalë në rrethe?

Më lejoni ta mbyll këtë fjalë, sikurse e hapa me opinionin e zotit Robert Gielisse drejtor i Njësisë së Kontrollit të Brendshëm Publik në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit, opinion, i cili është më i freskët i ardhur këto ditë, i cili na ka ndihmuar shumë në përgatitjen e projektligjit. "*Komisioni Europian u jep rëndësi të madhe reformave aktualisht në proces në sektorin publik në Republikën e Shqipërisë. Reformat e kontrollit të brendshëm publik financiar synojnë të rrisin efektivitetin mbrojtjes së interesave financiare të Republikës së Shqipërisë dhe DG-Budget njeh si shumë thelbësor rolin e institucionit suprem të auditimit të Shqipërisë pra, KLSH-në në këtë drejtim. Ne, si DG-Budget jemi të mendimit se duke kufizuar qasjen e pakufizuar për informacion të KLSH-së sikurse është propozuar tani, do të shkohet në mënyrë të qartë kundër standardeve ndërkombëtare, në çështjen e informacionit të mbajtur nga autoritete tatimore. Palët e interesuara duhet të mos kenë shqetësime në lidhje me konfidencialitetin që ruajnë SAI-et, pasi është parim dhe INTOSAI-it ta marrë atë parasysh duke përfshirë një kod të detyrueshëm të sjelljes për të mbrojtur konfidencialitetin e informacionit në lidhje me individët, i kufizuar në përdorim nga kërkesat penale. Është e rëndësishme të nënvizohet që qasja e pakufizuar në informacion është një aspekt themelor i pavarësisë funksionale të një institucioni suprem auditimi, KLSH-ja, e cila është thelbësore për të lejuar Kontrollin e Lartë të Shtetit të bëjë punën e tij në mënyrë më efektive në mbrojtje të interesave financiare të shtetit*".

Faleminderit!

Ligji duhet të shohë nga Brukseli, jo nga Zimbabve

Diskutim në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

21 prill 2014

Të pranishëm: z. Fatmir Xhafaj, z. Armando Subashi, z. Blendi Klosi, z. Bashkim Fino, zj. Ermonela Felaj, z. Ulsi Manja, z. Xhemal Qefalia, z. Edi Paloka, z. Kastriot Islami, z. Petrit Vasili, z. Dashamir Peza, z. Armando Prenga, zj. Vasilika Hysi, z. Pandeli Majko, z. Piro Lutaj, z. Vexhi Muçmataj, z. Oerd Bylykbashi, z. Spartak Braho, z. Fatmir Mediu, z. Arben Ristani, z. Tahir Muhedini, z. Gjovalin Bzheta, z. Nard Ndoka, zj. Silva Caka, z. Mhill Fufi, z. Keltis Kruja dhe z. Gent Strazimiri.

Të ftuar: z. Bujar Leskaj, Kryetar i KLSH-së; z. Ermal Yzeiraj, Drejtor Juridik në KLSH; zj. Luljeta Nano, Sekretare e Përgjithshme e KLSH-së.

Të nderuar deputetë,

Për shkak të pozitës asimetrike që ndodhem unë dhe çdo drejtues institucioni, duhet të jem i kujdesshëm. Shpjegimet e bëra në relacionin tuaj reflektojnë paaftësi totale juridike, për të goditur një institucion të pavarur si KLSH-ja, por duke u përpjekur dhe duke pasur besim në përballimin e këtyre dy problemeve, që, edhe pse nuk janë shumë të lehta, reflektojnë një frymë antieuropiane me ligjet që ne duam të miratojmë.

Zoti kryetar, është e drejta ime si qytetar i Shqipërisë dhe si drejtues i një institucioni të shtroj një pyetje retorike. Ju dëshironi dhe i reflektoni rekomandimet e progres-raporteve të BE-së për të plotësuar atë ambicie të madhe që e gjithë Shqipëria pret nga ju dhe klasa politike ka, gjë që unë s'dua ta vë në dyshim. Ju i reflektoni progres-raportet e BE-së?

Të paktën gjatë viteve 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2013, këto raporte, këto progres-raporte kërkojnë nga klasa politike shqiptare, kërkojnë nga Kuvendi i Shqipërisë, kërkojnë nga institucioni i lartë i auditimit të jashtëm publik në Shqipëri, të përgatitet një ligj në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare të INTOSAI-t.

E pra, zoti kryetar, në rast se ju do të kaloni ato propozime, bazuar mbi ato sqarime që kanë dhënë specialistët e këtij komisioni[48], ju këtë ligj e ktheni me kokëposhtë, ju këtë ligj, zoti kryetar, më vjen keq ta them, nuk e çoni nga Brukseli, por e çoni nga Zimbabveja. Nuk e di, në është Republika e Zimbabvesë, nuk e di në është Republika Popullore e Zimbabvesë, apo Republika Popullore Socialiste e Zimbabvesë. Ju them me përgjegjësi të plotë dhe jam gati të mbaj çdo lloj përgjegjësie për këtë që po them. Në rast se ju do të cenoni të drejtën e informacionit të KLSH-së, në rast se ju do të cenoni të drejtën e KLSH-së për të përmbushur detyrimin kushtetues për të audituar të ardhurat publike, në rast se ju do të arrini deri aty sa edhe termat europianë të mos i lejoni në këtë ligj, në rast se ju do të arrini deri aty sa në keqinterpretim të Kushtetutës të mos lejoni auditimet e performancës apo auditimet e IT-së, atëherë më vjen keq, zoti kryetar, më vjen keq për ju, më vjen keq për veten, por më shumë më vjen keq për Shqipërinë. Ju bëni një ligj në përputhje me standardet e Zimbabvesë, jo me të BE-së.

Këtë nuk jua them unë. Sot po jua them unë, po e deklaroj me përgjegjësi dhe meqë mbaj përgjegjësi për çfarëdo gjë në të ardhmen, por jam i bindur se këtë do t'jua thonë specialistët e BE-së. Dëgjojeni atë propozimin e matur të zotit Braho, pasi është deputet me përvojë. Do të ishte mirë që ju të qetësoheshit. Të lexonit argumentet juridike që ka dhënë stafi i komisionit tuaj, jam i bindur, zoti kryetar, se stafi i komisionit tuaj, për sa u përket problemeve të auditimit, më falni për shprehjen, kanë një injorancë totalisht të madhe. Jam i bindur se nuk dinë as A-në e auditimit, nuk dinë standardet ndërkombëtare të auditimit, nuk dinë një SAI, nuk dinë INTOSAI-n e shumë e shumë të tjera. Jam shumë i bindur për këtë, zoti kryetar. Dhe bindja më shtohet me këto pseudo-argumente që ju keni dhënë.

Te pika 1, analiza e projektligjit nga pikëpamja kushtetuese dhe ligjore, përmbajtja dhe qëllimi i projektligjit. Në lidhje me përmbajtjen, çështjen e projektligjit, lidhur me përputhjen në Kushtetutë të termit "auditim sipas projektligjit" me termin "kontroll sipas Kushtetutës", ne në materialin që ju kemi dërguar, këtu arrihet madje deri aty sa vihet në dyshim e drejta e KLSH-së për auditimin e IT-së dhe auditimin e performancës, nuk e mbaj mend në latinisht, nuk e shqiptoj dot, shprehet se injoranca nuk është argument, zoti kryetar. Kur thuhet në Kushtetutë se Kontrolli i Lartë i Shtetit është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomiko-financiar, Kontrolli i Lartë i Shtetit kontrollon veprimtarinë ekonomike të institucioneve shtetërore e të personave të tjerë

[48] Sqarim: Relatori z. Armando Subashi në mënyrë provokative hodhi poshtë draft-ligjin e ri të KLSH, duke sulmuar pjesë thelbësore të tij, si qasja e pakufizuar në informacion, e garantuar nga standardet ndërkombëtare të INTOSAI-t, por edhe mohoi përfshirjen në ligj të llojeve të auditimeve, si atë të Performancës, të Teknologjisë së Informacionit, etj.

juridikë e shtetërorë, një nga format e kontrollit të veprimtarisë ekonomike, bazuar në standardet ndërkombëtare të auditimit, është auditimi i performancës, që bota e përparuar ka tash 30 vjet që e zhvillon. Ka 30 vjet dhe në veçanti këto 20 vjetët e fundit ka ecur me shpejtësi dhe ka qenë dhe insistimi i specialistëve të DGBudget e të SIGMA-s, që kjo të përfshihet në mënyrë eksplicite në ligjin tonë. Flasim për auditim performance, për atë çka ne kërkojmë në Shqipëri: përdorim me efektivitet e efiçencë të parasë publike. Këto janë të rejat e famshme që kërkohen dhe ne kemi dhënë përkufizimet. Për të shmangur atë "mospërputhje", do të thosha unë, për sa u përket termave "kontroll" dhe "auditim", ne jemi shprehur shumë qartë në përkufizimet tona në nenin 3, ku themi: "auditimi nënkupton veprimtarinë e auditimit të kryer nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, i cili përfshin kryesisht auditimin e përputhshmërisë financiare, auditimin e performancave, auditimin e IT-së, si dhe auditimin e kombinuar të tyre.

Në këtë ligj, theksoj, termi "auditim" ka të njëjtin kuptim me termin "kontroll", të përdorur në nenet 162, paragrafi 1, 163 dhe 164, paragrafi 1, germa "c" të Kushtetutës. Çfarë ka këtu që ne duhet t'i kthehemi asaj dhe të zëvendësoni termin "kontroll" me "auditim". Nuk e pranoni? Unë nuk e kuptoj, si do të thoni ju që ne kërkojmë të vemi në BE. Në rast se ju e filloni që këtu, te themeli, e filloni që tek objekti, që ne mund të zhvillojmë auditime-performanca apo auditime IT-je, unë mendoj, zoti kryetar, nuk kemi progres, kemi regres. Unë mendoj se mund të jetë në nderin e të gjithëve ne të tërhiqemi e të kthehemi në ligjin e vitit 1997, në rast se nuk kemi guxim, nuk kemi atë mendim që ta kuptojmë e të jemi koshientë se ky ligj është tërësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe me çfarë kërkon BE-ja. Çfarë kërkon specifikisht neni 90 i MSA-së? Nuk ka ligj sot në Europë, madje as në atë kontinent që përmenda unë, nuk ka ligj ku të mos citohen auditimet e performancës dhe auditimi i IT-së, sepse, ashtu siç ecën administrata, me atë shpejtësi që ecën administrata, duhet të ecin edhe organet audituese. Nuk ka kuptim që ne po fusim, dhe ju flisni gjerësisht për e-government dhe ne të mos kemi të drejtën e e-auditimit, të auditimit të IT-së. Jo vetëm pengesë në auditimin e IT-së, por edhe te mosdhënia e informacionit në mënyrë elektronike. Çfarë është kjo?

Le të vazhdojmë me tjetrën. Në përputhje me përkufizimin e termit "fonde publike", në rast se ju do të ktheheni mbrapa, do të ktheheni te termi "fonde shtetërore", ju vetë e specifikuat dhe mendoj se pjesa më e madhe juaja ka qenë kontribuuese në Kushtetutën e vitit 1997-1998, atëherë ne nuk do të kemi të drejtë të auditojmë fondet e BE-së, kur vetë BE-ja e kërkon këtë. Rekomandimi që SAI-et e vendeve anëtare, e vendeve kandidate, e vendeve që aspirojnë për në BE, të auditojnë fondet e BE-së, është nga BE-ja, nga Bashkimi Europian. Ata, ashtu si i japin këto fonde, në një shumë të

konsiderueshme, ashtu edhe kërkojnë të auditohen nga institucionet e jashtme, jo nga institucione qeveritare.

Çështja e tretë: mosmarrëveshjet e kompetencat ndërmjet Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe institucioneve të tjera shtetërore, publike zgjidhen nga Gjykata Kushtetuese. Edhe këtu nuk tolerojnë specialistët tuaj shumë të nderuar. Urdhëro, po citoj nenin 131, që na e përmendi edhe relatori: Gjykata Kushtetuese vendos për: a, b, c, ç, mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve, si dhe ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore. Urdhëroni një vendim të Gjykatës Kushtetuese, vendimi nr. 20, datë 04, 05. 2007, në të cilin shprehet: "zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet pushteteve, si një ndër drejtimet kryesore të drejtësisë kushtetuese është trajtuar në jurisprudencën kushtetuese shqiptare." Nëpërmjet disa vendimeve, Gjykata Kushtetuese ka zhvilluar këtë doktrinë, duke konsoliduar njëkohësisht qëndrimin e saj se dispozita e germës "ç" të nenit 131 të Kushtetutës, çka unë e citova më parë, përfshin jo vetëm mosmarrëveshjet që lindin në sferën e ndarjes klasike të pushteteve ligjvënës, ekzekutiv e gjyqësor, si dhe pushtet qendror e qeverisje vendore, por edhe ato që mund të lindin midis organesh a subjektesh që nuk bëjnë pjesë në mënyrë të përcaktuar e kategorike në secilin prej tyre.

Vendim i cili i referohet nenit 49 të ligjit të vitit 2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese." I citoj, pasi këto janë ligje që janë miratuar mbas miratimit të ligjit "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit". Jemi në vitin 2000, jo më në vitin 1997 apo 1998. Për shqyrtimin e pajtueshmërisë së ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshje ndërkombëtare, Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të Presidentit të Republikës, të Kryeministrit, të jo më pak se një të pestës së deputetëve dhe të kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Ka qenë më i mirë, më i bukur, më i zoti se unë, apo më i ditur Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit në vitin 2000?

Çështja e katërt. Propozoj të shtohet një dispozitë me këtë përmbajtje: "Raportet dhe rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit nuk kontestohen në gjykatë. Padija në gjykatë bëhet për vendimet e subjekteve të audituara." Për një moment u mendua në Komisionin e Ekonomisë se nga maxhoranca kishim dashamirësi dhe cituam përvojat më të mira të Kroacisë dhe të Hungarisë. Natyrisht do të ketë qenë ndonjë nga ato minigrackat e vogla. Unë tërhiqem totalisht nga kjo. As nuk më shqetëson fare.

Çështja e pestë. Kontrolli i Lartë ka propozuar të shtohet një dispozitë, ku të parashikohen sanksione ndaj subjekteve që nuk japin informacion, apo nuk zbatojnë planin e masave të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Edhe kjo u propozua në Komisionin e Ekonomisë nga deputetë të maxhorancës. Unë nuk dua të bëj insinuata, nuk dua të

hedh dyshime. Edhe nga kjo tërhiqem. Ne jemi auditues të jashtëm publik dhe e kam shprehur në Komisionin e Ekonomisë. Në bazë të parimeve të standardeve ndërkombëtare të auditimit, kur institucioni është në formë monokratike, ne nuk mund të kërkojmë zbatimin patjetër të rekomandimeve tona. Ama është vullneti politik dhe për situatën ku ndodhet Shqipëria, që zgjidhet kjo gjë. Unë jam shprehur dhe e falënderoj kryeministrin Berisha për urdhrin nr. 70 të vitit 2006, kur KLSH-ja nuk drejtohej prej meje, i cili i detyronte të gjithë drejtuesit e institucioneve qendrore që të zbatonin vendimet e KLSH-së dhe masat. Dhe ky ishte një kontribut në luftën kundër korrupsionit. Në përgjithësi, këto rekomandime janë zbatuar në masën 70%. Kjo ishte kërkesë. Në rast se ju si maxhorancë e vlerësoni, vendoseni një nen; në rast se nuk e vlerësoni, mund të mos e vendosni fare, është problemi juaj.

Çështja e gjashtë. " Propozoj - thotë relatori - të përcaktohet në projektligj parashikimi i shumicës së kërkuar, për shkarkimin nga detyra të kryetarit, rregullat për trajtimin e kryetarit të KLSH-së pas përfundimit të mandatit."

Nuk kam nevojë fare për këto. Lërini zero imunitetin, rregullat gjatë veprimtarisë dhe pas veprimtarisë. Nuk kam nevojë për asnjë gjë. Bëni një nen me zero kompetenca, zero trajtim, zero benefite.

Çështja e shtatë! Këtu vemi te thembra e Akilit, e keni ju, zoti kryetar: "E drejta e KLSH-së për të audituar administratën tatimore." Ju i bëni të gjitha këto të mëparshmet dhe më vjen keq që e çuat në këtë situatë diskutimin për këtë projektligj. Ju i keni futur të gjitha këto çështjet përpara për të tërhequr vëmendjen. Për të tërhequr vëmendjen edhe te publiku. Tani vijmë te çështja, te dilema hamletiane: "To be or not to be". Ju, zoti kryetar, a jeni i qartë se administrata tatimore të auditohet, të kontrollohet nga jashtë? Apo jeni që administrata tatimore të qëndrojë si ishull i izoluar?

Jo, ligji e pengon. Dhe pikërisht ju keni bërë një formulim të tillë. Ligji lejon një auditim, një kontroll të pjesshëm. Ju keni lënë një formulim të tillë, për t'i lenë ata të qetë. Këtu është gjithë çështja. Dhe për këtë ju cenoni edhe të drejta të tjera. Parimi i katërt i ISSAI 10, zoti kryetar, që është standardi i Meksikos, e thotë qartë: "qasje e pakufizuar në informacion për institucionet supreme të auditimit". Ky parim zbatohet në të gjithë botën demokratike, në të gjithë botën evropiane, në BE, ku duam ne të shkojmë.

Zoti kryetar, nuk zbatohet, prandaj e përmenda. Ka vetëm një shtet: Zimbabvea, ku e ka në mënyrë eksplicite, që kryetari i institucionit suprem të auditimit të Zimbabvesë nuk lejohet të auditojë taksambledhësin e Zimbabvesë. Këtu e keni ju gjithë problemin, ndaj po bëni tërë këtë kakofoni dhe vetë po cenoni raportet tuaja, sa nuk është shprehur në këtë relacion për problematikën që u ngrit në Komisionin e Ekonomisë. A do t'i

auditojmë koncesionet edhe në fazën e ekzekutimit, si institucion i jashtëm publik? Ju jeni për të thelluar luftën kundër korrupsionit, apo jo?

Unë kërkoj të krijojmë së bashku një bashkëpunim konstruktiv dhe ky nen, ky bllokim që kërkohet të bëhet për KLSH-në, nuk bëhet për të mbrojtur interesat tuaja, por bëhet për të mbrojtur interesat qeveritare. Ka mbi një muaj që nuk po kthen përgjigje ministri i Financave, që e ka detyrim profesional dhe ministrat e tjerë të kësaj qeverie, për pyetjen, në ka të drejtë institucioni i jashtëm publik të ketë qasje të pakufizuar në informacion apo jo, te kjo BE, ku ne duam të shkojmë.

Në Komisionin e Ekonomisë është vënë një pikëpyetje dhe për pikën d, që flet për aksesin që kemi ne për auditimin te Banka e Shqipërisë dhe te bankat e nivelit të dytë. Relatorët tuaj nuk janë shprehur. Mesa duket, duan të na e heqin edhe këtë. Komisioni i Ekonomisë, ka kërkuar që të shpreheni ju zoti kryetar, të shpreheni si komision.

Për sa i përket statusit të punonjësve, ne po flasim që ky është një ligj me format tërësisht perëndimor dhe evropian, i cili do të realizojë dhe certifikimet e audituesve. Pra, do të kemi auditues të jashtëm publik të certifikuar. Natyrisht, auditues i jashtëm publik, i certifikuar, ashtu si audituesi i brendshëm në sektorin publik, s'mund të jetë kushdo.

Në rast se nuk do të ketë ndërveprim mes dy ligjeve: ligjit që ju keni miratuar me konsensus me 3/5 "Për statusin e nëpunësit civil" dhe ligjit organik për KLSH-në, si do ta zgjidhim ne këtë problem?

Edhe këtu, z. kryetar, është një fakt flagrant i dashakeqësisë. Kjo është më e pakta që mund të them, në respektimin tuaj dhe të deputetëve të tjerë, të nderuar të maxhorancës.

Edhe këtu vërehet një dashakeqësi, sepse nuk ka asnjë problem, në rast se do të kishim dashamirësi. Ligjet ju i kini bërë, ligjet me 3/5, që u vlerësuan nga të gjithë shqiptarët. Në mos gaboj tek neni 3, ashtu siç flitet për një status të ndërmjetëm të punonjësve të shërbimit diplomatik dhe të policisë, të shtoheshin dhe punonjësit e auditimit të jashtëm publik. Në rast se nuk doni ta bëni këtë, mos e bëni. Edhe kjo nuk më shqetëson.

Unë zoti kryetar, dua të kthehem te problemi kryesor. Unë nuk kam problem me ju si deputetë të Komisionit të Ligjeve dhe as me deputetët e Komisionit të Ekonomisë, madje në parim kam ndjerë dashamirësi, por kjo që doni të bëni ju si maxhorancë është një atentat i rëndë ndaj KLSH-së. Dhe nuk është thjeshtë atentat ndaj KLSH-së, pasi institucioni do të vazhdojë të funksionojë edhe i gjymtuar. Unë nuk dua të kaloj në përsëritje, por ky është një provokim i rëndë, një gabim që ju si klasë politike bëni në një

kohë kur në qershor, ne presim të marrim atë statusin shumë të dëshiruar nga të gjithë ne. Unë kam vazhduar korrespondencat në nivel teknik. Ata s'mund t'ju lejojnë dhe në progres-raport kjo do të pasqyrohet qartë, nuk mund t'u japin atë status për të cilin ju aspironi e punoni me ndershmëri, kur ju bëni një ligj antieuropian. Ndoshta kjo që po them është e rëndë. Unë ju kërkoj ndjesë. Ndoshta kam gabuar dhe kam besuar më shumë se ç'duhej te ju si maxhorancë, ndoshta duhej të isha treguar më i kujdesshëm.

Në rast se s'keni guxim të ngriheni mbi ato lartësi, do t'ju këshilloja të konsultoheni dhe me deputetin që e ka sjellë nismën në Kuvend, dhe me Kryetarin e Kuvendit, edhe me Kryeministrin dhe tërhiqeni këtë nismë. Më mirë të vazhdojmë me ligjin e vjetër, sesa të miratoni një ligj në vitin 2014, i cili vetëm me qasjen e kufizuar në informacion, jo me këto të tjerat që tha relatori i komisionit tuaj, është një ligj, për të cilin do të hasni kundërshtime.

Si shqiptar i mirë dhe i ndershëm, nuk më vjen mirë të përgojohet institucioni im, për raportet me maxhorancën, për raportet me opozitën, për raportet me Kuvendin. Është shumë e rëndësishme. Unë do ju ftoj me qetësi për të parë materialet që ka përgatitur relatori i komisionit tuaj. Relatori është organ nga koka tek këmbet. Në rast se nuk keni mundësi, t'i përgatisim ne me oponencën tonë, me materialet që ne ju kemi dërguar si KLSH. Unë punoj me ekipin tim dhe në fakt, i përgatis vetë materialet dhe prandaj përgjigjem kështu në komision dhe do të përgjigjem deri në ditën e fundit.

Ju mund të keni ide të ndryshme, ide pozitive, ide trysnuese. Unë nuk shqetësohem, nëse ju vendosni si klasë politike për ta kthyer KLSH-në në gjykatë llogarish, por dhe ajo do studime, do strategji, do punë. Jam shumë i hapur. Interesat e KLSH-së, janë shumë herë më të larta se interesat e Bujar Leskajt.

Faleminderit!

Ligji i ri për KLSH-në, kontribut i qartë në integrimin e vendit

Diskutim në Komisionin e Integrimit Evropian

7 prill 2014

Të pranishëm: zj. Majlinda Bregu, z. Taulant Balla, z. Gramoz Ruçi, zj. Arta Dade, z. Namik Dokle, zj. Jorida Tabaku, zj. Monika Kryemadhi, z. Genc Ruli dhe z. Ben Blushi.

Të ftuar: zj. Xhoana Lilaj, Drejtoreshë e Sektorit të Përafrimit të Legjislacionit në Ministrinë e Integrimit Europian; zj. Elda Zenelaj, Përgjegjëse e Sektorit të Përafrimit të Legjislacionit në Ministrinë e Integrimit Europian; z. Bujar Leskaj, Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit; zj. Luljeta Nano, Sekretare e Përgjithshme e Kontrollit të Lartë të Shtetit; z. Ermal Yzeiraj, Drejtor i Drejtorisë Juridike i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Të nderuar deputetë,

Në fakt, pas diskutimeve në Komisionin e Ligjeve dhe në Komisionin e Ekonomisë, unë vërtet do të kisha dëshirë që këtu në Komisionin e Integrimit të flisja shkurt, por fakti që për këtë ligj ne kemi hasur, njëherazi do të shprehesha, në një mirëkuptim të të gjithë anëtarëve ose të deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë të komisioneve që përmenda më sipër, dhe në një keqkuptim, më shtyjnë që këtu në Komisionin e Integrimit të shpreh pikëpamjet tona si Kontroll i Lartë i Shtetit në lidhje me përgatitjen dhe me punën që kemi bërë për këtë projektligj, gjithmonë duke e lidhur edhe me fushën që mbulon komisioni juaj.

Natyrisht, do të përpiqem të jem konciz, i saktë dhe të citoj dokumentet referuese të Bashkimit Europian atje ku ne duhet dhe duam të gjithë të shkojmë.

Projektligji që paraqitet ka shumë risi. Ai fut koncepte bashkëkohore të auditimit në kontrollin e jashtëm publik të vendit, zgjeron gamën e auditimeve me auditime të reja të përfshira në ligj, si ato të performancës, të përdorimit të fondeve të BE-së, të teknologjisë së informacionit, lejon dhënien e opinionit për llogaritë e shtetit, forcon pavarësinë e institucionit kushtetues të KLSH-së dhe certifikon audituesit e tij. Por ai mund të kthehet shumë shpejt dhe lehtë në një histori dështimi dhe dëmtimi të interesave të integrimit europian të shtetit shqiptar, nëse cenohet pavarësia e KLSH-së.

Dua të theksoj se Shqipëria, vendi ynë ka një angazhim madhor për të respektuar Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit me Bashkimin Europian, e cila në nenin 90 të saj përcakton se "Palët bashkëpunojnë në mënyrë të veçantë për të zhvilluar sistemet e auditimit të jashtëm në Shqipëri në përputhje me standardet dhe metodologjitë e

pranuara botërisht, si dhe me praktikat më të mira të BE-së". Pra, sot në botë standardet dhe metodologjitë e pranuara botërisht në fushën e auditimit të jashtëm publik janë standardet INTOSAI. Në rast se këto standarde të pranuara botërisht dhe praktikat më të mira të BE-së shkelen me ligjin e ri "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", atëherë kapitulli 32 i progres-raportit të BE-së për Shqipërinë, i cili fokusohet në katër fusha: në fushën e kontrollit financiar të brendshëm publik, në fushën e kontrollit të jashtëm publik, në fushën e mbrojtjes së interesave financiare të BE-së dhe në fushën e mbrojtjes kundrejt falsifikimit të euros, në rast se do të përdorja një shprehje të specialistëve të BE-së, as nuk kapet, as nuk mbyllet nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit e Komisionit Europian DG Budget.

Ky kapitull është themeltar në sigurimin e përgjegjshmërisë maksimale për administrimin e fondeve publike të një vendi anëtar kandidat dhe potencialisht kandidat për në Bashkimin Europian. Komisioni Europian frenon vlerësimin e tij për një vend në rast se ky kapitull nuk funksionon.

Drejtoria përkatëse DG Budget që përpunon këtë kapitull në Komisionin Europian, në letrën e saj të datës 28.03.2014, drejtuar Kontrollit të Lartë të Shtetit, shprehet: "Duhet të kihet parasysh se një ligj i KLSH-së në përputhje me standardet INTOSAI është një nga kërkesat themelore të kapitullit 32 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit Shqipëri-BE, e cila duhet plotësuar. Këto kërkesa eksplicite të nenit 90 të MSA-së dhe të kapitullit 32 të progres-raportit të Bashkimit Europian për vendet kandidate dhe potencialisht kandidate për anëtarësim në BE ka rrezik të shkelen dhe neni të mos zbatohet prej nesh, në rast se projektligji i ri për KLSH-në, i paraqitur në Kuvend, miratohet me disa ndryshime, me disa ndërhyrje të propozuara dhe të bëra në Komisionin e Ekonomisë, të cilat nuk e bëjnë këtë projektligj të jetë në përputhje me standardet dhe metodologjitë e pranuara botërisht, si dhe me praktikat më të mira të BE-së."

Ju e dini më mirë se mua se për Bashkimin Europian nuk ka kuptim dhe rëndësi ana sasiore, pra një ligj thjesht i ri për KLSH-në, por një ligj në përputhje të plotë me standardet e pranuara botërisht, që janë standardet e Organizatës Botërore të Institucioneve të Auditimit të Jashtëm Publik, e quajtur INTOSAI, dhe që zbatohen rigorozisht nga Gjykata Europiane e Audituesve, që është KLSH-ja e BE-së dhe nga të gjitha institucionet supreme të auditimit të vendeve anëtare, qofshin zyra kombëtare auditimi, kolegje auditimi apo gjykata llogarie. Sa herë që BE-ja ka kërkuar amendime për ligjin e KLSH-së dhe e ka nisur ta bëjë këtë gjë 6 vjet më parë që në vitin 2008, rekomandimi ka qenë i qartë që ligji të amendohet për t'u bërë tërësisht në përputhje me standardet e INTOSAI-it. Po sjell në vëmendjen tuaj rekomandimet e përsëritura të BE-së për amendimin e ligjit të KLSH-së të vitit 1997 të ndryshuar në vitin 2000, në

progresraportin e KE-së për Shqipërinë për vitin 2008, faqe 43, paragrafi i dytë, BEja është shprehur: "Ligji i KLSH-së ende nuk është plotësisht në përputhje me standardet e INTOSAI-it dhe ka nevojë të amendohet". E njëjta kërkesë u përsërit nga BE-ja në progres-raportin e vitit 2009, faqe 42, paragrafi i dytë, ndërsa në progres-raportin e vitit 2010, kërkesa shtohet edhe me kushtin për sigurimin e pavarësisë së KLSH-së: "Pavarësia e KLSH-së ka nevojë të sigurohet. Ligji i tij ka nevojë të amendohet për ta sjellë në përputhje të plotë me standardet e INTOSAI-it", faqja 119, paragrafi i parë.

Në progres-raportin e vitit 2011 për Shqipërinë, Komisioni Europian shprehet: "Amendimet në ligjin për institucionin shtetëror të auditimit të saj, për KLSH-në, për ta sjellë atë plotësisht në linjë me standardet e INTOSAI-it janë duke u përgatitur. Amendimet në ligjin e saj duhet të adaptohen në mënyrë që kuadri ligjor të sillet plotësisht në linjë me standardet e INTOSAI-it, faqja 67, paragrafët 1 dhe 4.

Në progres-raportin e vitit 2012 për Shqipërinë, BE-ja thekson: "Pas disa vitesh në pezullim, janë përgatitur dhe janë dërguar për procedurën e miratimit draft-amendimet e ligjit të KLSH-së për ta sjellë atë në përputhje të plotë me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve të Kontrollit të Lartë-INTOSAI-it, faqe 66, paragrafi i parë.

Në progres-raportin e vitit 2013 për Shqipërinë, përsëri theksi është te ligji për KLSH-në duke theksuar: "Në fushën e auditimit të jashtëm janë ndërmarrë ndryshime organizative dhe procedurat e reja për të rritur efiçiencën e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Megjithatë ndryshimet në ligjin për KLSH-në janë duke u shqyrtuar në parlament që në vitin 2012 dhe mbetet të miratohen me shumicën prej tre të pestave. Nevojitet miratimi i ndryshimeve në ligjin për KLSH-në. Në tërësi përgatitjet kanë avancuar në masë të moderuar", faqe 56, paragrafi 7 dhe faqe 57, paragrafi 3.

Nuk janë vetëm progres-raportet e Komisionit Europian që kanë kërkuar me forcë një ligj koherent dhe në përputhje të potë me standardet e INTOSA-it që të garantojë pavarësinë e KLSH-së. Vetë dokumenti themeltar i BE-së, traktati mbi funksionimin e BE-së, më 1 dhjetor 2009, në mënyrë specifike neni 287 i tij, rregullon pavarësinë e plotë, qasjen e pakushtëzuar në informacion dhe kompetencat e Gjykatës Europiane të Audituesve. Më konkretisht po citoj fragmente nga pjesa e gjashtë. Dispozitat institucionale dhe financiare të nenit 287: "Gjykata Europiane do të ekzaminojë llogaritë e të gjitha të ardhurave dhe shpenzimet e BE-së. Ajo do të ekzaminojë llogaritë dhe të ardhurat e të gjitha trupave, zyrave apo agjencive të krijuara nga BE-ja. Do të ekzaminojë nëse janë marrë të gjitha të ardhurat dhe të gjitha shpenzimet kanë ndodhur në mënyrë të ligjshme dhe të rregullt dhe nëse menaxhimi financiar ka qenë i shëndetshëm. Auditimi do të bazohet në të dhëna dhe, nëse është e nevojshme, do të

kryhet në vendet dhe në institucionet e tjera të BE-së, në mjediset e çdo trupi, zyre, apo agjencie, përfshirë edhe në mjediset e çdo personi fizik apo juridik që merr pagesa nga buxheti. Institucionet e tjera të BE-së, çdo trupë, zyra ose agjenci që menaxhon të ardhurat apo shpenzimet në emër të BE-së, çdo person fizik apo juridik që pranon pagesa nga buxheti dhe nga organet kombëtare të auditimit, ose nëse këto nuk kanë kompetencat e nevojshme, departamentet kompetente kombëtare, i dërgojnë gjykatës së auditimit me kërkesën e saj çdo dokument apo informacion të nevojshëm për të kryer detyrën e saj".

Sikurse u vu re nga fragmentet e mësipërme, neni 287 përmend qasjen e pakufizuar në informacion gjatë auditimit si praktikë e zbatuar gjerësisht në BE. Nëse do të citonim direktivën 2006/43 të Parlamentit Europian dhe të KE-së mbi auditimet e ligjshme të llogarive vjetore dhe të atyre të konsoliduara, auditime statusore e amenduar më vonë në direktivën e 11 marsit të vitit 2008 shprehen: "Të gjitha auditimet duhet të kryhen në bazë të standardeve ndërkombëtare të auditimit. Pavarësia e audituesve është një nga kërkesat më thelbësore të kësaj direktive. Ajo thekson se audituesit duhet të jenë të pavarur gjatë ushtrimit të detyrës së tyre audituese. Sipas saj nëse ata përballen me një situatë, në të cilën cenohet pavarësia e tyre, ata duhet të japin dorëheqjen nga përfshirja në auditim, pra të mos e kryejnë atë. Po sipas kësaj direktive, auditimi ligjor kërkon njohuri të përshtatshme mbi çështjet të tilla si: legjislacioni i kompanive, ai fiskal e kështu me radhë. Në bazë të këtyre direktivave dhe të legjislacioneve kombëtare, në dijeninë tonë në të gjitha ligjet organike të institucioneve supreme të auditimit të Europës, pra të simotrave tona të Kontrollit të Lartë të Shtetit, të formës: Zyrë Kombëtare Auditimi, siç e kemi ne, Kolegj Auditimi apo Gjykatë e Llogarive, qasja e saj në informacionin e përmbajtur nga administrata, përfshi edhe atë tatimor, nuk kufizohet. Këtë nuk e themi vetëm ne, nuk e theksoj vetëm unë, por e thotë qartë edhe një program si SIGMA me eksperiencë të pasur disa vjeçare në vlerësimin e auditimit të jashtëm publik dhe jo vetëm të tij, në shumë vende të Europës, përfshi edhe Shqipërinë. Vlerësimi më i fundit i SIGMA-s është që parime të rëndësishme si pavarësia funksionale operacionale dhe administrative e KLSH-së, një mandat i gjerë, duke përfshirë auditimin e të gjitha shpenzimeve të të ardhurave, të organizatave të caktuara të sektorit publik, si edhe qasja e pakufizuar në informacionin e këtyre organizatave, duhet të jenë të garantuara.

Në përvojën tonë me institucione të tjera supreme të auditimit, në përputhje me INTOSAI-n, nuk kemi njohur precedentë të kufizimeve të parimeve të mësipërme. Procesi i përgatitjeve për këtë projektligj, përgatitje këto të nisura që në vitin 2009-2010, por të bllokuara për arsye të pakuptueshme në fillim për mua nga paraardhësi im, por ndoshta tani i kuptoj më mirë, kanë njohur një monitorim rigoroz dhe kujdes parësor

nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit të Komisionit Europian dhe të programit SIGMA të BE-së. Pas një viti harrese nga vetë KLSH-ja ky projektligj me amendimet u rimor nga ne gjatë vitit 2012, u përditësua dhe u punua me një sërë faktorësh në vend dhe u kalua sërish për konsultim partnerëve tanë ndërkombëtarë. Drafti është parë dhe është miratuar nga DG Budget dhe nga SIGMA nen për nen, nëse çdo nen i veçantë i tij është në përputhje të plotë me standardet INTOSAI apo jo dhe vetëm në fund të vitit 2012, nëntor 2012 vjen miratimi nga DG Budget duke theksuar se sipas mendimit tonë versioni që na është dorëzuar më 15 nëntor 2012 marrë në lidhje me dispozitat e aplikueshme të Kushtetutës së Shqipërisë mund të konsiderohet si në përputhje të plotë me parimet, standardet dhe udhëzimet e INTOSAI-t, duke përfshirë deklaratën e Limës dhe të Meksikos. Sapo kjo garanci erdhi, ne e dërguam projektligjin për shqyrtim në Kuvend në 26 nëntor të vitit 2012.

Për të qenë më konstruktiv në diskutimet, pyetjet apo debatet, natyrisht është e drejta juaj, nuk kam unë të drejtë të ndërhyj, ne ju kemi përgatitur një botim modest ku janë dokumentet themelore të organizatave, institucioneve supreme të auditimit të INTOSAI-t, deklarata e Limës, që është standardi ndërkombëtar numër një, e vitit 1977, ndryshe quhet kushtetuta jonë ndërkombëtare, deklarata e Meksikos e vitit 2007, e cila bën fjalë për pavarësinë, por unë kam vendosur edhe një rezolutë mbështetëse të Kombeve të Bashkuara të bërë më 22 dhjetor të vitit 2011, në të cilën Kombet e Bashkuara njëherazi kërkojnë dhe inkurajojnë të plotësojnë detyrat e tyre në mënyrë të pavarur dhe kërkojnë nga asambletë nacionale të vendeve anëtare të Kombeve të Bashkuara në të cilën Shqipëria aderon me sukses prej vitesh e vitesh të zbatojnë kërkesat e kësaj rezolute. Pra, të përkrahin pavarësinë e institucioneve supreme të auditimit.

Duke qenë të gjithë të ndërgjegjshëm se me një ligj të ri modern dhe evropian për KLSH-në ndihmojmë vendin në rrugën e tij të integrimit në BE, unë jam tërësisht i bindur dhe nuk kam asnjë dyshim se asnjë nga ju nuk do të donte ta shmangte këtë ligj nga standardet ndërkombëtare INTOSAI dhe nga praktikat më të mira evropiane, ku përfshihen Traktati i Funksionimit të BE-së dhe direktivat e Këshillit të Europës, duke e bërë atë të papranueshëm për DG Budget dhe për gjithë Komunitetin e saj Europian.

Më duhet të pohoj këtu atë që pohova edhe te Komisioni i Ligjeve, por edhe ta ritheksoj për të dy komisionet, në përgjithësi fryma e mirëkuptimit dhe dashamirësia ndaj institucionit të KLSH-së është shprehur qartë tek të gjitha diskutimet e deputetëve, anëtarë të komisioneve përkatëse, por natyrisht, për sa i përket aksesit tonë për informacion apo qëllimit për të ruajtur "të paprekur" administratën tatimore, duket tamam sikur komandohet nga një dorë e padukshme. Por, natyrisht, nuk kam të drejtë të bëj insinuata.

Ndryshimi kryesor i propozuar nga Komisioni i Ekonomisë është që KLSH-së t'i mohohet aksesi në të dhënat e administratës tatimore për dosjet individuale të tatimpaguesve me justifikimin se qasja e pakufizuar e KLSH-së në të dhënat e organeve tatimore mund të dëmtojë interesat e tatimpaguesve privatë.

Cenimi i së drejtës së KLSH-së për informacion është shkelje e standardeve themelore të INTOSAI-t, e deklaratës së Limës dhe e deklaratës së Meksikos, përkatësisht e neneve 4, 10 dhe 20 të deklaratës së Limës, dhe e kërkesave të parimit 4 për një qasje të pakufizuar në një informacion të deklaratës së Meksikos për pavarësinë e institucioneve supreme të auditimit që thotë se: "Institucionet supreme të auditimit duhet të kenë një qasje të drejtpërdrejtë dhe të lirë në të gjitha dokumentet dhe informatat e nevojshme për kryerjen e duhur të përgjegjësive të tyre statusore". Në bazë të standardeve tona profesionale INTOSAI, por edhe eksperiencave evropiane të sipërcituara, ne gjykojmë se kufizimi i së drejtës për qasje të pakufizuar në informacion të KLSH-së në auditimin e administratës tatimore është një keqkuptim. Madje ai rrezikon të krijojë moszbatueshmëri të vetë ligjit të ri për KLSH-në, që Kuvendi po përgatitet të miratojë.

Sipas amendimeve të propozuara të ligjit të KLSH-së dhe të miratuara nga Komisioni për Ekonominë, KLSH-ja ka për të dhënë një opinion vjetor mbi llogarinë e shtetit, certifikimin e këtyre llogarive. Në parim gjithë buxheti i shtetit, të gjithë e dinë shumë mirë dhe nxënësit e shkollës të mesme, ndoshta tani kanë shkuar dhe në 9-vjeçare, llogaritë përbëhen nga deklarata mbi shpenzimet dhe të ardhurat. Nëse KLSH-ja nuk do të lejohet t'i auditojë të ardhurat kryesore, ato tatimore, atëherë institucioni nuk do të jetë në gjendje të japë një mendim të saktë për llogaritë e shtetit për çdo vit që do të vijë. Kjo është antikushtetuese, sepse bie në kundërshtim dhe me nenin 164 të Kushtetutës, në të cilin, në paragrafin e parë thuhet se Kontrolli i Lartë i Shtetit i paraqet Kuvendit raport për zbatimin e buxhetit të shtetit. E si mund të paraqitet ky raport i plotë kur KLSH-së, dhe të pretendojmë se do të jetë i saktë dhe tejet profesionalisht i lartë, i mohohet auditimi i mënyrës sesi mblidhen të ardhurat kryesore të buxhetit, të ardhurat tatimore? Mos ndoshta fakti që ka me dhjetëra kompani të mëdha që rezultojnë me humbje dhe nuk kontribuojnë për shtetin, nuk duhet të përbëjë një shqetësim për ne si institucion suprem auditimi, apo për ju si deputetë? Ne duhet të auditojmë nëse Ministria e Financave i ka marrë masat e mjaftueshme për të ndaluar, për të luftuar korrupsionin brenda zyrave të taksave të administratës tatimore qendrore.

Sikurse e dini fare mirë, nëpunësit tatimorë mund të joshen për të pranuar deklarata tatimore, të cilat janë të pasakta, nëse ata mund të përfitojnë prej këtyre deklaratave. Ministria e Financave është sigurisht e vetëdijshme për këtë rrezik dhe bën analizën e saj të riskut dhe zbaton një politikë të luftës kundër korrupsionit. Ne kemi për detyrë ta auditojmë këtë analizë risku dhe këtë politikë se sa efiçiente është. Për këtë ne mund të

përdorim edhe paketa të ndryshme që përdoren nga INTOSAI, për shembull që përdoren gjerësisht dhe për sistemin e taksave dhe ne dëshirojmë të kontribuojmë realisht në luftën kundër mashtrimit financiar dhe korrupsionit në tatime. Por këtë nuk do ta bëjmë nëse institucioni i KLSH-së nuk do të ketë kompetencë të auditojë të ardhurat nga taksat.

Dua të theksoj këtu që në asnjë rast, e kam theksuar edhe në Komisionin e Ekonomisë, e kam bërë edhe publike, dëshiroj ta pohoj edhe këtu në Komisionin e Integrimit, ne si KLSH nuk kërkojmë të auditojmë kompanitë apo personat privatë, nuk kërkojmë të kryejmë vizita fiskale në subjekte, nuk kërkojmë t'i rëndojmë ato, përkundrazi, kjo shkon kundër standardeve tona profesionale, kundër etikës sonë, dhe nuk do ta bëjmë këtë kurrë. Sigurisht, në qoftë se ka dyshime të evazionit dhe korrupsionit me taksa, KLSH-ja duhet të jetë në gjendje për t'i audituar ato raste dhe pastaj të dorëzojë dosjet me gjetjet e tij në prokurori për shkeljet e administratës tatimore.

Mohimi i së drejtës së institucionit për të analizuar mënyrën e mbledhjes së të ardhurave kryesore buxhetore do të ndodhë në kohën kur direktiva nr. 85 e Bashkimit Europian e vitit 2011 "Mbi kërkesat për kufizimet buxheteve të shteteve anëtare" në kapitullin e IV, përmend cilësinë dhe formatin, dhe kërkon monitorim efektiv dhe në kohë të përputhshmërisë me ligjet, të bazuar në një analizë të pavarur dhe të besueshme të kryera nga njësi të pavarura auditimi dhe njësi që gëzojnë pavarësi funksionale ndaj autoriteteve fiskale të shteteve anëtare.

Unë mendoj që cenimi me ligj i së drejtës të pakufizuar të KLSH-së për informacion në këtë rast do të përbënte një regres dhe jo një hap përpara. Mbi bazën e amendimeve të propozuara, KLSH-ja fiton të drejtën për të audituar zbatimin e fondeve të BE-së. Për Gjykatën Europiane të Audituesve kjo do të ishte një situatë e shkëlqyer, sepse ata pastaj mund të përdorin gjetjet e KLSH-s çka ata e bëjnë në vende të tjera duke përdorur materialet e institucioneve si motra të KLSH-së. Mirëpo, sigurisht, kjo mund të ndodhë vetëm nëse KLSH-ja ka të njëjtat kompetenca sikurse Gjykata Europiane e Audituesve i gëzon sipas nenit 287, të traktatit "Mbi funksionimin e Bashkimit Europian".

Për mendimin tim cenimi i KLSH-së në të drejtën për qasje të pakufizuar në informacion, për hir të së vërtetës në rast se edhe në këto vite ka pasur bllokime, po me vendime gjykate, jo me ligjin aktual të vitit 1997, do të ishte aq i rende sa, nëse ai do të ruhej deri në variantin përfundimtar, të nderuar zotërinj deputetë, do të ishte më mirë të mbanim ende në fuqi ligjin e vjetër të vitit 1997, i cili të paktën të drejtën për akses në informacion të KLSH-së nuk e kufizon. Dua të theksoj, gjithashtu, ky kufizim është në kundërshtim me të gjitha ligjet organike të institucioneve të Auditimit të Jashtëm Publik

të Europës. Mjafton të marrim si shembull ligjin organik të Gjykatës së Auditimit të Holandës, që ka preferim të plotë përqasjen e pakufizuar të kësaj gjykate në informacionin e administratës tatimore apo edhe ligjin organik të Zyrës Shtetërore të Auditimit të Kroacisë, vendi i pranuar tani si fundi në Bashkimin Europian, i cili ka një paragraf të plotë për të drejtat e kësaj zyre; të shqyrtojë dosjet individuale tatimore për kryerjen e vlerësimit tatimor, e theksoj për kryerjen e vlerësimit tatimor, jo të vetëvlerësimit tatimor. Për të gjetur një shembull të ngjashëm të mohimit të së drejtës të Institucioneve Supreme të Auditimit, për të audituar pa kufizim administratën tatimore, me thënë të drejtën këtu në Europë u përpoqën shumë, nuk gjetëm shembuj. Kemi gjetur një shembull nga Zimbabveja, nuk e di a është Republikë Popullore, a Republikë Socialiste e Zimbabvesë, apo Republikë Popullore Socialiste. Republika e Zimbabvesë, në legjislacionin e saj nuk lejon që të auditohen dokumentet të tilla që janë subjekt i vendimmarrjes së komisionerit të tatimeve të çdo shume dhe çdo takse sipas ligjit "Mbi taksën e të ardhurave" kapitulli 23. 06 i ligjit "Mbi auditimin publik".

Pra, cenimi ndaj qasjes së pakufizuar në informacion të KLSH-s, është në kundërshtim dhe me deklaratat dhe orientimet nga Kongreset EUROSAI-t, komunitetit të KLSH-ve të Europës.

Kështu, për shembull, dhe jam drejt mbylljes, kam dëshirë t'ju sjell në vëmendje Kongresin e 6-të të EUROSAI-t, mbajtur në Bon, maj-qershor të vitit 2005, kongres, i cili trajtoi auditimin e të ardhurave publike nga SAI. Marrja dhe ruajtja e një baze të mirë të të ardhurave është e një rëndësie të veçantë, themelore për një politikëbërje të efektshme qeveritare. Duke pasur parasysh rëndësinë e një sistemi efektiv të grumbullimi të të ardhurave, SAI-t e kanë zhvilluar grumbullimin e të ardhurave brenda një fushe specifike dhe teknike të punës së tyre. Në qendër të vëmendjes së kongresi ishin tri nëntema :

1. Rëndësia e të ardhurave publike për menaxherët financiarë publikë dhe për autoritetin buxhetor-legjislativ
2. Roli i SAI-t në ciklin buxhetor
3. Metodat e auditimit dhe ndikimi i auditimit.

Deklarata e Bonit e vitit 2005, e Kongresit të 6-të të EUROSAI-t në mënyrë eksplicite i referohet auditimit të të ardhurave tatimore. Ajo rikonfirmon se kompetencat e Institucioneve Supreme të Auditimit për të audituar të gjitha veprimet financiare publike janë theksuar në Deklaratën e Limës të miratuar në vitin 1977, dhe për sa i përket të ardhurave tatimore, deklarata bën thirrje që ato të auditohen sa më gjerësisht të jetë mundur. "Parimet dhe standardet e përcaktuara në Deklaratën e Limës, aplikohen njësoj si për shpenzimet publike ashtu edhe për të ardhurat publike". Janë citime nga

Deklarata e Bonit. Komuniteti ERUROSAI-t i njeh tatimet dhe kontributet shoqërore si një kategori të rëndësishme të ardhurave publike.

Kongresi i 4-t i Bonit udhëzoi që SAI-et të kryenin analiza të mëpasshme, të hollësishme e të vlerësimeve mbi të ardhurat sidomos ato tatimore duke inkurajuar parashikime të arsyeshme të këtyre të ardhurave.

Në fund të kësaj përmbledhjeje, dëshiroj t'ju sjell në vëmendje edhe Deklaratën e Lisbonës, të kongresit të 8-të të EUROSAI-t, të mbajtur në Lisbonë në 2011, deklaratë, e cila soli shqetësimin e disa SAI-jeve anëtare të organizatës, për ndërhyrjet që kanë pasur për të kufizuar pavarësinë e tyre, apo efektiviteti i mandatit të tyre nëpërmjet amendimeve thelbësore apo injorimit të kompetencave është në rrezik. Prandaj, edhe kjo deklaratë shprehu angazhimin e plotë të EUROSAI-t në mbështetjen dhe forcimin e pavarësisë së SAI-eve duke ndërmarrë hapa konkretë për të si një element kyç i strategjisë së tij, duke nxitur një shpërndarje më të gjerë të tyre parimeve dhe duke kontribuuar në shtrirjen dhe zbatimin rezolutave dhe të përpjekjeve të INTOSAI-t në rajonin evropian, si dhe të tregojë gatishmërinë e komunitetit për të ruajtur linja të hapura komunikimi me parlamentet, pushtetet publike, mediet dhe qytetarët, në mënyrë që të përballen me efektivitet dhe si duhet sfidat, si dhe t'u përgjigjen pritshmërie të tyre për qeverisje të mirë.

Duke ju falënderuar, edhe një herë për respektin dhe vëmendjen, unë dëshiroj të shpreh bindjen se te projektligji i ri që do të miratohet, apo rekomandimet që do të bëjë Komisioni i Integrimit i mbështetur plotësisht në Kushtetutën e vendit, në standardet ndërkombëtare të auditimit INTOSAI, dhe në praktikat më të mira europiane do të merren në konsideratë në mënyrë që zbatimi i nenit 90, shumë i rëndësishëm për MSA-në, të jetë një histori suksesi dhe për ne do të jenë të rëndësishme për Komisionin e Ekonomisë dhe Komisionin e Ligjeve dhe më gjerë për Kuvendin e Shqipërisë.

Cënimi i qasjes së pakufizuar të KLSH-së në informacion shkon në kundërshtim të hapur me Bashkimin Europian

Diskutim në Komisionin e Integrimit Evropian

22 prill 2014

Të pranishëm: zj. Majlinda Bregu, z. Gramoz Ruçi, z. Namik Dokle, zj. Jorida Tabaku dhe z. Ben Blushi.

Të ftuar: z. Bujar Leskaj, Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit; zj. Luljeta Nano, Sekretare e Përgjithshme e KLSH; z. Ermal Yzeiraj, Drejtor i Drejtorisë Juridike i KLSH.

Të nderuar deputetë,

Do të përpiqem të flas shumë shkurt dhe të bëj një përmbledhje të situatës ku jemi sot.

Ne, si Kontroll i Lartë i Shtetit, pas një pune disavjeçare në bashkëpunim me partnerët tanë të DG Budget dhe SIGMA-s, paraqitëm një projektligj në Kuvendin e Shqipërisë. Në zbatim të neneve të Kushtetutës ky projektligj u paraqit nga një deputet i Kuvendit të Shqipërisë, deputet i maxhorancës, me bindjen e plotë se relatori ishte në sinkron të plotë me atë çka ne si institucion dhe partnerët tanë kërkonim të arrinim.

Për fat të keq, për orientime që kuptohen, por që mua nuk më lejohen t'i komentoj, pjesërisht në Komisionin e Ekonomisë, por në mënyrë më flagrante në Komisionin e Ligjeve, kemi një situatë të përmbysur, të cilën unë në Komisionin e Ligjeve e quajta "se ligji u kthye me kokëposhtë" ose, thënë ndryshe, nga ligj kthehet në antiligj. Pse e them këtë? Ne dhe ju, më saktë, deputetët e Kuvendit të Shqipërisë, klasa politike shqiptare ka orientimin nga progres-raportet e BE-së (citoj këtu progres-raportet e viteve 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2013), të cilat nuk dua t'i përsëris, që të miratojnë një ligj për auditimin e jashtëm publik në Republikën e Shqipërisë, pra për Kontrollin e Lartë të Shtetit, në përputhje me standardet ndërkombëtare INTOSAI. Varianti që ne kemi përgatitur, që kemi paraqitur në Kuvend, në muajt e fundit të maxhorancës së kaluar dhe në muajt e parë të maxhorancës së re, mbas zgjedhjeve të vitit 2013, kuptohet është një variant i cili ka marrë edhe miratimin zyrtar të strukturave më të larta të BE-së. Pra, është një variant në përputhje të plotë me standardet INTOSAI, çka kërkohet... Unë nuk dua të përsëris këtu Deklaratën e Limës, Deklaratën e Meksikos ose për më tepër Deklaratën e Kombeve të Bashkuara.

Unë kam paraqitur material edhe te komisioni juaj, edhe te Komisioni i Ligjeve dhe te Komisioni i Ekonomisë. Ndërhyrjet flagrante, ndërhyrjet joprofesionale, kjo është më e pakta që mund të jap vlerësim, ndoshta edhe në respekt të Komisionit tuaj, që u tentuan të kalojnë dje dhe morën një miratim formal, me thënë të drejtën ishte një votim disi i pakuptimtë, por nuk më takon mua të gjykoj, e kthejnë këtë ligj nga një ligj në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit që kërkon BE-ja, në një ligj në kundërshtim të plotë me standardet ndërkombëtare të auditimit. Këtu nuk është vetëm problemi i qasjes në informacion, pra i të drejtës që kemi ne për të marrë informacion, por problem është, populli ynë thotë: "Zullumi me të trashur këputet", marazi i atyre për t'iu kundërvënë projektligjit të paraqitur prej nesh, konsiston deri në atë që nuk pranohen as termat standarde ndërkombëtare. Kërkohet nga "auditim" në "kontroll", nuk pranohet auditimi i performancës, nuk pranohet auditimi i IT-së dhe të tjera. Është njësoj sikur një personaliteti t'i kërkosh llogari mbasi ka bërë disa romane "pse ke shkruar një vepër që është ndërmjet romanit dhe analizës letrare ose/dhe esesë", apo të thuash që ti je shkrimtar, por mund të shkruash vetëm ese, romane dhe nuk mund të bësh novela, tregime, drama ose edhe komedi.

Në fakt, këtu ka dy këndvështrime. Si gjithmonë, përgjithësisht proceset në Shqipëri që kanë një qasje tragjikomike. E para është normale, sepse këtu cenohet një institucion kushtetues, cenohet nga një maxhorancë që ka shpalosur parime krejt të tjera dhe cenohet në atë pikë që shkon në kundërshtim të hapur me atë çfarë kërkon BE-ja.

E dyta, komedia është që injoranca shkon deri në atë farë feje që nuk ka, jo kryetar të Kontrollit të Lartë të Shtetit, jo jurist, jo specialist që ta shpjegojë, por unë jam i bindur që nuk ka një qytetar normal të Republikës së Shqipërisë që t'i shpjegojë këto gjëra. Pra, në rast se ju si Kuvend i Shqipërisë do të vendosni që ligjin "Për rregullimin e veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit" ta kaloni duke e votuar, është një votim me tre të pestat, me ato ndërhyrje arbitrare, me ato ndërhyrje arrogante, me ato ndërhyrje antiprofesionale që janë bërë në Komisionin e Ligjeve, atëherë unë zyrtarisht si kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit ju kërkoj që ta tërheqim këtë ligj. Le të vazhdojmë ta zhvillojmë veprimtarinë tonë me ligjin e vitit 1997.

Me sa duket, maxhoranca e viteve 1997 dhe 2000, kur është amenduar ligji, ka qenë më e emancipuar për raportet midis qeverisjes, menaxhimit qeveritar dhe auditimit financiar. Le të vazhdojmë të punojmë me ligjin e vjetër. Për mua nuk është e rëndësishme një pavarësi financiare që jepet, kur me ligjin e ri ju kërkoni të cenoni veprimtarinë audituese të KLSH-së.

Më e rëndësishme për funksionimin e një institucioni suprem auditimi është zhvillimi normal i veprimtarisë së tij audituese. Të paktën në 190 vende, që marrin pjesë në

organizatën ndërkombëtare INTOSAI, ky është zhvillim bazuar mbi parimet dhe standardet ndërkombëtare INTOSAI, çka e specifikojnë edhe progres-raportet e BE-së.

Pse e kërkoj unë tërheqjen? E kërkoj tërheqjen, sepse, në thelb, unë kam një respekt për të gjithë deputetët e Kuvendit të Shqipërisë, të krahut të djathtë, të majtë dhe të qendrës, por në rast se ju në vitin 2014, të dashur deputetë, në këto momente kur Shqipëria pret për të marrë statusin, do të kaloni një ligj tërësisht dhe qartësisht në kundërshtim me ato çfarë kërkon BE-ja në progres-raportet e saj, atëherë unë druaj që ky ligj do të bëhet shkak, pra KLSH-ja do të bëhet shkak indirekt për marrjen e ndonjë vendimi negativ për Shqipërinë. Në këtë drejtim, sado që të jetë, unë ndiej një përgjegjësi morale qytetare. Le ta lëmë më mirë që ju nuk e keni shqyrtuar këtë ligj ose e keni në fazë diskutimi. Mbas ndryshimeve kushtetuese e të tjera, mund të jepni sqarime si të doni, se sa të kaloni një ligj tërësisht në kundërshtim me atë çfarë kërkon BE-ja.

Nuk më mungon guximi të theksoj edhe këtu, por do të kem rast ta shtjelloj edhe në komisione të tjera apo edhe në ambiente të tjera, që të gjitha këto pengesa që i vihen KLSH-së nuk vendosen nga deputetët e maxhorancës të Kuvendit të Shqipërisë. Janë pengesa që orientohen nga qeveritarët. Këtë unë e them me përgjegjësi të plotë dhe me kohë do të kem rast ta argumentoj.

Në rast se ne do të miratojmë një ligj që KLSH-ja pengohet të auditojë IT-në, KLSH-ja pengohet të hyjë në sistemet e informacionit, KLSH-ja pengohet në kërkimin e mbledhjes së informacioneve, KLSH-ja pengohet në auditimin e tatimeve, dhe këtu e theksoj: ne kërkojmë të auditojmë vlerësimin tatimor, jo vetëvlerësimin tatimor. Nëse KLSH-ja nuk mund të auditojë koncesionet se si implementohen ato, atëherë ky është thjesht për t'u lënë shteg qeveritarëve të jenë të lirë në veprime të ndryshme antiligjore që ata mund të kryejnë. Cilado maxhorancë ose cilido deputet që voton një ligj të tillë, unë mendoj se në kushtet që është Shqipëria, merr një përgjegjësi të madhe.

Unë dua t'ju deklaroj një gjë me sinqeritet: në këtë ligj të ri ne marrim shumë përsipër si Kontroll i Lartë i Shtetit edhe në raport me resurset njerëzore të institucionit. Natyrisht na pret të gjithëve një punë e madhe, edhe mua personalisht, çka është e vështirë. Unë në detyrën time mund t'i zhvilloj ato përgjegjësi të cunguara që ju mund të më jepni, por unë mendoj se nuk do të plotësoj kërkesat e Kushtetutës dhe mbi çdo gjë mbi interesat e deputetëve, mbi interesat e kryetarit të KLSH-së, mbi interesat e ministrit të Financave, të drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, si dhe të Kryeministrit unë mendoj se janë interesat e qytetarëve shqiptarë, e taksapaguesve shqiptarë.

Fati im personal nuk më shqetëson, e kam shprehur edhe në komisione të tjera. Në rast se mendoni që me ndonjë skemë, duke e kthyer KLSH-në në Gjykatë Llogarie, mund të

mendoni edhe shmangien time, bujrum, realizojeni, hajde ta realizojmë së bashku. Por në çfarëdo forme qoftë institucioni suprem i auditimit si institucion monokratik, që jemi në rastin tonë me auditorë të përgjithshëm ose në Gjykatë Llogarish, ne do të kërkojmë të punohet sipas standardeve ndërkombëtare të auditimit INTOSAI. Në rast se nuk do të ketë audituesë që janë të aftë profesionalisht, asnjëherë nuk do të kemi auditim të jashtëm publik, asnjëherë nuk do ta kemi atë çka ne të gjithë kërkojmë.

Këtu jemi në Komisionin e Integrimit Europian dhe është e drejta ime t'jua rikujtoj Deklaratën e Kombeve të Bashkuara. Ndoshta mund të ketë individë edhe në parlamentin shqiptar që këtë deklaratë e marrin në mënyrë qesharake. Kjo deklaratë është miratuar në fund-dhjetorin e vitit 2011. Ajo inkurajon dhe u kërkon të gjitha asambleve të vendeve anëtare, në të cilat Shqipëria nuk ka qenë anëtare në kohën e Enver Hoxhës, por ka qenë anëtare në kohën e Zogut, madje ka lobuar edhe për anëtarë të tjerë, që janë të detyruara të zbatojnë rezolutat e Asamblesë së Kombeve të Bashkuara.

Ju mund të studioni shpjegimet që janë dhënë nga relatori në Komisionin e Ligjeve dhe do të shikoni sa varfëri ka në to, sa cektësi ka, sa joprofesionalizëm ka. Në rast se në Komisionin e Ekonomisë, në Komisionin e Ligjeve dhe në Komisionin e Integrimit të gjitha paraqitjet që kemi bërë, ajo punë profesionale që kemi bërë, të gjitha shpjegimet që kemi dhënë, të gjitha materialet që ju kemi paraqitur, duke filluar nga standardet ndërkombëtare të auditimit deri te rezoluta e Kombeve të Bashkuara, duke filluar nga përvoja e vendeve europiane, duke ju paraqitur ligje të ndryshme të të gjitha simotrave në Europë, nuk kanë tërhequr vëmendjen tuaj si deputetë, natyrisht është e drejta juaj, mua nuk më takon të gjykoj, unë kam një respekt për të gjithë ju dhe do të vazhdoj ta kem, të paktën duhet të keni respekt dhe dashuri, gjë që ju e keni, madje me tepricë për Shqipërinë. Shtyheni këtë ligj në një periudhë tjetër kur ju vetë të jeni të ndërgjegjshëm, se mos ndoshta edhe ne si institucion suprem auditimi duhet të vazhdojmë të shfaqim aspekte të punës sonë, të vendosmërisë sonë për të zbatuar standardet profesionale të auditimit, të vendosmërisë sonë për të thelluar luftën kundër korrupsionit e të tjera.

Faleminderit!

Projektligji i ri i KLSH-së - zhvillim i mandatit të tij kushtetues në kushtet e sotme

Gazeta Ekonomia, 19 prill 2014[49]

Me këtë shkrim, duam t'u japim përgjigje disa pyetjeve që natyrshëm mund t'i lindin kujtdo, kur mëson ose ka në duar projektligjin e ri të Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH).

Pyetja 1: Kushtetuta përmend vetëm termin "kontroll ekonomik dhe financiar". Pse në projektligj përdoret termi "auditim"?

Në hartimin e projektligjit të ri, DG-Budget dhe SIGMA kanë propozuar zëvendësimin e termit "kontroll ekonomik dhe financiar", term ky i përdorur në Kushtetutë si dhe në ligjin aktual organik të KLSH, me termin "auditim".

Termi "auditim" dhe për rrjedhojë edhe termi "audituesë", janë terma të cilët përdoren në pothuajse të gjitha legjislacionet e institucioneve të tjera homologe europiane dhe më gjerë, madje edhe Ligji nr. 9720, datë 23.04.2007 *"Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"* përdor termin *"auditim"*. Gjithashtu, termi *"auditim"* është termi profesional i fushës dhe i kudopërdorur për përkufizimin e veprimtarisë e Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI-ve), term me të cilin operojnë të gjitha institucionet e auditimit të jashtëm publik në Europë dhe në botë.

Në përmbajtjen e tij, termi "auditim" përfaqëson më së miri natyrën, objektin dhe veprimtarinë e institucioneve të auditimit. Termi "kontroll", i përdorur në Kushtetutë mund të shkaktojë në përdorim, keqkuptime të panevojshme në lidhje me veprimtarinë dhe rolin e KLSH, në raport me auditimet që ai kryen.

Termi "kontroll" ka dy kuptime. I pari ka konotacion represiv dhe nënkupton ushtrimin nga KLSH-ja të një pushteti kontrollues dhe vendimmarrës mbi subjektet që ajo auditon, ndërsa i dyti ka konotacion pozitiv dhe miqësor, që konsiston në shqyrtimin dhe vlerësimin e veprimtarisë së subjekteve të audituara dhe dhënien më pas të rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes së konstatuar.

Ky dualizëm i termit "kontroll" i përdorur në Kushtetutë, që mund të shkaktojë në praktikë keqkuptime përsa i përket veprimtarisë së KLSH, zgjidhet shumë mirë nëpërmjet përdorimit të termit "auditim", i cili është në përputhje të plotë më kuptimin e dytë të termit "kontroll", të përdorur në Kushtetutë. Përdorimi i termit "auditim" në

[49] Shkrim i botuar në gazetën "Ekonomia", më 19 prill 2014, nga z. Bujar Leskaj, Kryetar i KLSH-së dhe z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës në KLSH, si kundërpërgjigje e presionit të një pjese të shumicës parlamentare për të penguar miratimin e ligjit të ri të KLSH tërësisht në përputhje me standardet e INTOSAI-t.

projektligjin e KLSH, e harmonizon këtë projektligj me standardet ndërkombëtare të auditimit, ligjin tonë për auditimin e brendshëm, legjislacionin e BE-së, si dhe legjislacionet e institucioneve të huaja homologe.
Bazuar në këtë analizë, në nenin 3 të projektligjit, në përkufizimin e termit *"auditim"* është vendosur një paragraf me përmbajtjen si më poshtë:
"Në këtë ligj termi "auditim" ka të njëjtin kuptim me termin "kontroll" të përdorur në nenet 162/pg.1, 163 dhe 164/pg.1/c të Kushtetutës".

Pyetja 2: Kushtetuta nuk përmban kontrolle të performances dhe të teknologjisë së informacionit. Përse duhet t'i ketë ligji i ri i KLSH-së?

Duke pasur parasysh stadin e ri të zhvillimit të vendit tonë, përsa i përket vënies në përdorim nga administrata shtetërore të sistemeve të teknologjisë së informacionit (TI), të cilat mbulojnë sektorë tepër të rëndësishëm dhe kompleksë të administrimit financiar si psh., sistemet e TI në prokurimet publike, thesarit, organet e administratës tatimore, dogana, etj., KLSH, ashtu si dhe çdo institucion tjetër homolog duhet të auditojë edhe efektivitetin, efiçiencën dhe ekonomicitetin e këtyre sistemeve, sigurinë dhe besueshmërinë e tyre.
Auditimet e TI dhe performancës, të parashikuara në mënyrë specifike në projektligjin e ri të KLSH janë auditime të cilat vendet e tjera europiane, standardet e të cilave KLSH synon të arrijë, kanë vite që i kryejnë. Kërkesa e vendosjes së këtyre auditimeve në projektligjin e ri të KLSH ka disa vite që theksohet nga ana e faktorit ndërkombëtar, të cilët e konsiderojnë veprimtarinë e KLSH si mjaft të vonuar në këtë drejtim.
Më konkretisht, në Progres-Raportin e vitit 2011 për Shqipërinë, Komisioni Europian shprehet: *"Progres i limituar është bërë në llojet e reja të auditimit, të tilla si certifikimi dhe auditimi i performancës, të cilat po zhvillohen gradualisht nga institucioni suprem i auditimit (SAI)".* Ndërsa, në Progres Raportin e vitit 2012 për Shqipërinë, Komisioni Europian shprehet: "*KLSH kryen të gjitha llojet kryesore të auditimeve, por auditimet e llojit të inspektimit të rregullsisë/përputhshmërisë përbëjnë ende shumicën dërrmuese të auditimeve të tij(afërsisht 90% në 2011-ën").*
Fakti që Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë nuk shprehet në mënyrë eksplicite në lidhje me Auditimin e TI ose Auditimin e Performancës, nuk do të thotë që këto dy lloje auditimi bien ndesh me përcaktimet e dispozitave Kushtetuese, për më tepër që ato janë në përputhje me të tre përcaktimet e bëra në nenin 163 të Kushtetutës.
Gjithashtu, në projektligjin e ri të KLSH-së një nga risitë e tij është edhe fakti i marrjes përsipër të detyrimit për të audituar fondet e BE-së (neni 9, germa "dh" e projektligjit), kërkesë kjo e theksuar edhe në Progres-Raportin e vitit 2011 për Shqipërinë, në të cilin Komisioni Europian shprehet:*"… Amendimet në Ligjin e SAI-it duhet të adoptohen në mënyrë që kuadri ligjor të sillet plotësisht në linjë me standardet e INTOSAI-t. Ka akoma pak progres në fushat që lidhen me mbrojtjen e interesave financiare të BE-së".*

Pyetja 3: A janë standardet ndërkombëtare të auditimit të detyrueshme për t'u zbatuar?

Në nenin 3 të projektligjit janë dhënë përkufizimet në lidhje me INTOSAI-in, EUROSAI-in dhe IFAC. Arsyeja e dhënies së përkufizimeve të këtyre organizatave është se në nenin 4 të projektligjit, janë parashikuar standardet në të cilat duhet të bazohet veprimtaria e KLSH, duke u shprehur:

"Kontrolli i Lartë i Shtetit, auditon në përputhje me Kushtetutën, ligjet, aktet nënligjore, manualet në fuqi si dhe standardet ndërkombëtare të auditimit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në veprimtarinë e tij, duhet të reflektojë shkallën më të lartë të standardeve ndërkombëtare të INTOSAI-t dhe IFAC, si dhe rezolutat e Kongreseve të INTOSAI-t dhe EUROSAI-t."

"Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit" (INTOSAI) përfshin institucionet supreme të auditimit të shteteve anëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, e cila ka si funksion kryesor nxjerrjen e metodave dhe standardeve të auditimit dhe ofrimin e trajnimeve ndaj institucioneve të auditimit publik".

"Organizata Europiane e Institucioneve Supreme të Auditimit" (EUROSAI) është një organizatë e pavarur, jo politike e cila promovon bashkëpunimin dhe nxit shkëmbimin e ideve, eksperiencave dhe teknikave ndërmjet Institucioneve Supreme të Auditimit".

"Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve" (IFAC) është një organizatë ndërkombëtare e cila ka për mision dhënien e ndihmesës në zhvillimin, adoptimin dhe implementimin e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit".

Në asnjë rast këto standarde, të miratuara nga organizmat ndërkombëtar të sipërcituar, nuk transmetojnë në mënyrë direkte asnjë forcë detyruese ndaj veprimtarisë së KLSH. Referenca ndaj standardeve ndërkombëtare të auditimit është përdorur edhe në ligjin organik aktual të KLSH me Nr. 8270, datë 23.12.1997, i ndryshuar, i cili në nenin 2 të tij shprehet:

"Kontrolli i Lartë i Shtetit, në përputhje me legjislacionin dhe standardet ndërkombëtare të kontrollit të përpunuar nga INTOSAI kontrollon administrimin e pronës shtetërore dhe zbatimin e buxhetit të shtetit në subjektet e përcaktuara me këtë ligj."

Gjithashtu, standardet ndërkombëtare të auditimit aktualisht përmenden edhe në ligje të tjera si Ligji nr. 10091, datë 5.3.2009, "Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar" dhe Ligjin nr. 9720, datë 23.4.2007, "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik".

Referuar, Direktivës 2006/43/EC të Parlamentit Europian dhe Këshillit, e 17 Majit 2006, *"Mbi auditimet statutore të llogarive vjetore dhe llogarive të konsoliduara"*, direktivë kjo e amenduar me Direktivën 2008/30/EC, të 11 Marsit 2008, ajo ka si objektiv që t'i kërkojë vendeve anëtare aplikimin e një grupi të vetëm të standardeve ndërkombëtare të auditimit, përditësimin e kërkesave kualifikuese për audituesit, përcaktimin e etikës profesionale, zbatimin teknik të bashkëpunimit midis autoriteteve kompetente në

fushën e auditimit në Shtetet Anëtare, si dhe forcimin e besimit në institucionet e auditimit.

Vendosja në projektligj e standardeve ndërkombëtare të auditimit si referencë për veprimtarinë audituese të KLSH-së, është një praktikë e cila përdoret edhe në legjislacionet e tjera të huaja të institucioneve homologe.

Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të OKB me Nr. 66/209 *"Për promovimin e efiçiencës, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës së administratës publike duke forcuar institucionet supreme të auditimit"*, përcakton se OKB:

"Vlerëson punën e INTOSAI-t në promovimin e efiçiencës, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës, si dhe përdorimin me eficiencë dhe efektivitet të burimeve publike, në të mirë të qytetarëve. Gjithashtu, vlerëson Deklaratën e Limës, Udhëzuesit mbi rregullat e Auditimit të vitit 1977 dhe Deklaratën e Meksikos mbi pavarësinë e SAI-ve, në vitin 2007 dhe inkurajon shtetet anëtare, të aplikojnë këto deklarata, në përputhje me strukturat e tyre kombëtare".

Pyetja 4: Përse duhet të auditojë koncesionet KLSH?

KLSH, bazuar në ligjin organik aktual, auditon koncesionet e dhëna nga institucione të ndryshme shtetërore (qendrore apo vendore) dhe kjo nëpërmjet auditimeve që KLSH ushtron në këto institucione dhe njësitë e tjera në varësi të tyre.

Aktualisht, auditimi i KLSH në lidhje me koncesionet përqendrohet vetëm në auditimin e ligjshmërisë së dhënies së këtyre koncesioneve dhe monitorimin që institucionet përkatëse i kanë bërë kontratave koncensionare. Në këtë kuptim, KLSH auditon aktualisht vetëm veprimtarinë e institucioneve shtetërore në lidhje me koncesionet si dhe vetëm dokumentacionin që këto institucione disponojnë.

Referuar praktikave më të mira, të hasura në legjislacionet e institucioneve të tjera homologe, SAI-t kanë për kompetencë që në fushën e koncesioneve të auditojnë, krahas veprimtarisë së subjekteve shtetërore në procedurat e dhënies së koncesioneve edhe zbatueshmërinë e kontratave nga ana e subjekteve koncensionare si dhe të monitorimit që subjektet përkatëse shtetërore i bëjnë zbatimit të kushteve të kontratës.

Zgjerimi i gamës së auditimit të KLSH-së në auditimin e plotë të koncesioneve, argumentohet me faktin që:

- Pasuria shtetërore apo shërbimi publik i dhënë me koncesion, gjenerojnë të ardhura të konsiderueshme për buxhetin e shtetit;
- Lloji i pasurisë apo i shërbimeve të dhëna me koncesion, janë të një rëndësie të veçantë për ekonominë e vendit (minierat, energjia, hidrokarburet, shërbimet portale, shërbimet doganore, etj);
- Kuvendi ka nevojë për raportim të pavarur dhe të plotë të auditimit të jashtëm në lidhje me këto koncesione, krahas raportimit apo kontrollit që auditimi i brendshëm apo institucione të tjera shtetërore (p.sh., Ministria e Financave, ministritë e linjës,

ATRAKO, AKBN, etj);

Institucionet Supreme të Auditimit në botë, por sidomos ato europiane, standardet e të cilave ne kërkojmë të arrijmë, e bazojnë auditimin e tyre në fushën e koncesioneve në Standardin Ndërkombëtar të Auditimit ISSAI 5220 "Udhëzues mbi praktikat më të mira të auditimit të financimeve private/publike dhe koncesioneve".

Referuar këtij standardi, SAI-t duhet të auditojnë:

1. Veprimet përgatitore për dhënien e koncesionit;
2. Procedurate prokurimit;
3. Fazën operacionale.

Për rrjedhojë, standardi i sipërcituar përcakton që SAI-t kanë të drejtë të auditojnë hapat e ndjekur nga subjekti i audituar dhe të japin opinionet e tyre, nëse kontrata e koncesionit është duke u zbatuar në përputhje me qëllimin dhe objektin për të cilin është lidhur.

Në marrëveshjet koncensionare midis shtetit dhe subjektit privat, ku shteti i jep atij në përdorim një pronë apo pasuri shtetërore ose publike dhe subjekti privat në zbatim të kontratës koncensionare përveç të drejtave ka edhe detyrime në lidhje me përdorimin e kësaj pasurie, e cila në shumicën e rasteve shoqërohet edhe me detyrimin e kryerjes së investimeve në faza të përcaktuara kohore, marrjen përsipër të punësimit të njerëzve, si dhe derdhjen në buxhetin e shtetit të detyrimeve përkatëse, etj.

Pikërisht, KLSH në mbrojtje të pronës dhe pasurisë shtetërore e publike të shtetit, si dhe të interesave ekonomiko-financiare të tij mbi këto prona apo pasuri, duhet që në rastin e auditimeve koncensioanre të pasqyrojë në raportet e tij të auditimit një tablo të plotë dhe të qartë të dhënies dhe zbatimit të këtyre kontratave koncensionare.

Qëllimi i kryerjes së këtij lloj auditimi është dhënia e sigurisë Kuvendit dhe qytetarëve, se procedurat koncesionare dhe kontratat e koncesionit janë kryer në përputhje me procedurat ligjore, (auditimi i përputhshmërisë) dhe/ose prona publike është përdorur me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet (auditimi i performances).

Kryerja e auditimeve nga KLSH me objekt koncesionet, rrit nivelin e transparencës dhe llogaridhënies mbi përdorimin e pronës publike nga shoqëritë koncesionare.

Problematika që parashtron kërkesa e domosdoshme për shtrirjen e auditimeve dhe marrjen e informacioneve të nevojshme në terren nga ana e audituesve të KLSH-së, mund të zgjidhet fare mirë në projektligj, duke parashikuar në një nen të veçantë kryerjen e këtyre fazave të auditimit nëpërmjet bashkëpunimit me organin kompetent shtetëror përgjegjës për kontrollin e zbatimit të kontratave koncensionare.

Është e vërtetë që Autoriteti Kontraktor shtetëror i autorizuar kryen kontrollin në bazë të ligjit për koncesionet dhe bazuar në kontratën tip, por ky autoritet ka varësi dhe raporton tek Ministri përkatës, ndërsa KLSH, si organ auditimi i pavarur raporton tek Kuvendi.

Në rastin e konstatimit të detyrimeve kontraktore nga ana e KLSH në përfundim të auditimeve të tij, KLSH ia drejton konstatimet dhe rekomandimet e tij në lidhje me këto detyrime subjektit shtetëror të audituar dhe jo subjektit privat koncensionar. Subjekti shtetëror i audituar, përgjegjës për ndjekjen e procedurave përkatëse, pasi merr në shqyrtim rekomandimin e KLSH-së në lidhje me këto detyrime është plotësisht i lirë të vendosë për zbatimin ose jo të këtyre rekomandimeve. Në këtë kuptim, detyrimet për subjektin privat koncensionar lindin vetëm si pasojë e akteve dhe vendimmarrjes së institucionit përkatës shtetëror dhe jo KLSH-së, i cili në çdo rast rekomandon dhe nuk vendos.

Pyetja 5: A nuk është qasja e KLSH-së mbi dosjet individuale tatimore, cenim i konfidencialitetit të të dhenave të subjekteve private që paguajnë tatimet?

KLSH do të shqyrtojë çdo dokumentacion që aktualisht e shqyrton auditimi i brendshëm dhe KLSH do të kryejë të njëjtat auditime që kryen dhe auditimi i brendshëm. Ajo ç'ka i lejohet auditimit të brendshëm, nuk ka se si dhe përse t'i mohohet auditimit të jashtëm. Të dy auditimet, për nga rëndësia, misioni, rezultati dhe pavarësia profesionale janë të pakrahasueshëm me njëri-tjetrin.

Në rast se realisht do të ekzistonte ndonjë problem ligjor, juridik apo parimor në lidhje me konfidencialitetin, vendimmarrjen e KLSH e cila prek vendimmarrjen e organeve të administratës tatimore, mbrojtjen e tatimpaguesit dhe abuzimit të audituesve të KLSH me detyrën dhe informacionin, atëherë këto probleme do të duhet t'i atribuoheshin edhe auditimit të brendshëm.

Ndërmjet ligjit aktual të KLSH-së dhe projektligjit të ri nuk ka asnjë ndryshim, përsa i përket të drejtës së KLSH për të pasur akses në informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për kryerjen e auditimit dhe nuk ka asnjë ndryshim në lidhje me kompetencën e KLSH-së për të audituar organet e administratës tatimore. Tejzgjatja në kohë e pengimit të KLSH për të audituar organet tatimore, ka shkaktuar në mbarë institucionet shtetërore humbjen e kujtesës institucionale, kur këto organe të administratës shtetërore auditoheshin nga KLSH. Për rrjedhojë, ripërsëritja e të njëjtave kompetenca që KLSH tashmë i ka me ligjin aktual (të përforcuara këto dhe me një vendim gjykate) për të audituar organet e administratës tatimore, nuk konsiderohet më si përsëritje, por si një kërkesë e re dhe e jashtëligjshme, për të cilën, si rast unik në veprimtarinë shtetërore, po kërkohet të zbatohet praktika (pra e drejta zakonore) dhe jo ligji dhe vendimet e gjykatës në bazë të tij.

Roli i KLSH-së, jo vetëm në raport me organet e administratës tatimore, por edhe në raport me çdo subjekt tjetër auditimi, përfshin tre elementë bazë:

1. konstatimin;
2. informimin;
3. rekomandimin.

Ky mision kushtetues shndërrohet në mision të pavlerë dhe për më tepër çorientues, në rast se konstatimi, informimi dhe rekomandimi i KLSH nuk është i plotë dhe i saktë. Kërkesa që për këto tre elementë bazë të veprimtarisë së tij, KLSH të garantojë saktësinë dhe vërtetësinë e tyre, nuk mund të plotësohet në rast se KLSH-së nuk i garantohet e drejta për moskufizim në marrjen e informacionit dhe dokumentacionit të nevojshëm. Pengimi në dhënien e informacionit dhe dokumentacionit të nevojshëm, sjell si pasojë mungesë në konstatim, mungesë në informim dhe më pas mungesë në rekomandim. Për rrjedhojë, mungesa e informacionit dhe dokumentacionit ndikon automatikisht në moskryerjen e misionit të KLSH. Dhënia KLSH e të drejtës për të mos u kufizuar në informacion dhe dokumentacion, mbart në vetvete një përgjegjësi shumë të madhe institucionale dhe personale për çdo auditues. Për këtë arsye, nisur nga rëndësia e informacionit apo dokumentacionit me natyrë konfidenciale, personale, tregtare, hetimore (rasti i veprave penale) apo sekret shtetëror, ndaj audituesve që abuzojnë me detyrën e tyre në mosruajtjen dhe mosadministrimin siç duhet të këtyre informacioneve apo dokumentacioneve, duhet të aplikohen sanksione tepër të rënda administrative, deri dhe penale. Detyrimi i mbrojtjes së konfidencialitetit (themi konfidencialiteti, sepse deri më sot në lidhje me sekretin shtetëror KLSH nuk ka patur ndonjë problem në dhënien e informacionit) nuk mund të jetë më i madh se detyrimi i çdo organi shtetëror për të bërë transparencën e veprimtarisë së tij apo e drejta e Shtetit për të ditur se çfarë është bërë me shpenzimet dhe si qëndron e vërteta në lidhje me të ardhurat e tij. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit të tatimpaguesit është një detyrim i përbashkët, si i administratës tatimore ashtu dhe i KLSH.

Nga ana tjetër, KLSH nuk dublon dhe nuk krijon konflikt me punën, veprimtarinë dhe vendimmarrjen e asnjë institucioni, të cilin KLSH auditon dhe kjo për faktin që KLSH rekomandon dhe nuk vendos në lidhje me atë se çfarë institucionet e audituara duhet të kryejnë. Rekomandimet e KLSH, dërguar këtyre institucioneve e kanë të pamundur të prodhojnë efekte juridike, për aq kohë sa vendimmarrja i takon organeve përkatëse dhe jo KLSH-së. Forca detyruese e rekomandimeve të KLSH-së dhe arsyeja e vërtetë se përse institucionet e audituara pranojnë t'i zbatojnë ato, qëndron në vërtetësinë dhe saktësinë e konstatimeve si dhe ndikimin që shkakton informimi në publik dhe në organet eprore të këtyre institucioneve.

Së fundmi, veprimtaria e çdo organi shtetëror që shpenzon fondet e buxhetit të shtetit dhe që administron/mbledh të ardhurat e tij duhet të auditohet. Auditimi kryhet së pari nga sistemet e kontrollit të brendshëm dhe së dyti nga auditimi i jashtëm, i cili vlerëson edhe sistemet e kontrollit të brendshëm. Të dyja sistemet e kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm përbëjnë një garanci për miradministrimin e të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore. Nga ky sistem i kontrollit ekonomiko-financiar nuk mund të shkëputet si rast i veçantë asnjë institucion shtetëror, për më tepër administrata tatimore. Mosauditimi i administratës tatimore sjell rritjen e korrupsionit brenda radhëve të

administratës tatimore, mosrikuperimin e shmangieve të kryera, mosbesimin në sistemin e administrimit financiar të vendit, mosdhënien e një opinioni të plotë dhe të besueshëm në lidhje me raportin e buxhetit, mosdhënien e një garancie të plotë në lidhje me statistikat zyrtare ekonomiko- financiare të vendit, mosbesimin e investitorëve të huaj në një sistem ekonomiko-financiar të paauditуar, si dhe mosbesimin e faktorit ndërkombëtar në kapacitetet miradministruese të vendit tonë përsa i përket fondeve ndërkombëtare. Pra, në rast se mungon një opinion i pavarur, i saktë dhe i plotë audites mbi të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit të vendit tonë, faktori ndërkombëtar nuk ka asnjë garanci në lidhje me miradministrimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të fondeve të BE-së.

Në rast se do ta trajtonim çështjen e auditimit të organeve të administratës tatimore në një nivel më teknik, e drejta e KLSH për të shqyrtuar çdo informacion që KLSH e konsideron si të nevojshëm në drejtim të kryerjes së auditimeve, parashikohet aktualisht në Ligjin nr. 8270, datë 23.12.1997 *"Për Kontrollin e Lartë të Shtetit".*

Referuar nenit 17 të Ligjit nr.8270, datë 23.12.1997 *"Për Kontrollin e Lartë të Shtetit":*

"I gjithë dokumentacioni, që Kontrolli i Lartë i Shtetit e gjykon të nevojshëm për kryerjen e detyrave të tij, duhet t'u sigurohet dhe t'u paraqitet nga subjektet e kontrolluara përfaqësuesve të autorizuar të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Kur është e nevojshme, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka të drejtë:

a) të pyesë me shkrim ose verbalisht subjektet e kontrolluara ose punonjësit e tyre, të cilët janë të detyruar t'i përgjigjen me shkrim ose verbalisht sipas kërkesës së Kontrollit të Lartë të Shtetit, brenda një jave nga kërkesa e bërë;

b) të kërkojë nga subjektet e kontrolluara t'i sigurohen menjëherë ambientet dhe pajisjet e punës në përputhje me këtë ligj;

c) të kërkojë nga subjektet e kontrolluara në nenin 6 të këtij ligji t'i vihet në dispozicion brenda një jave i gjithë dokumentacioni për vlerat materiale e financiare, si dhe dokumentacioni për veprimtarinë ekonomike dhe financiare;

d) të kërkojë nga Banka e Shqipërisë, bankat e nivelit të dytë e bankat e tjera të përbashkëta, t'i vihen në dispozicion brenda një javë të dhënat për llogaritë e subjekteve që i nënshtrohen kontrollit në bazë të këtij ligji;

e) *Gjatë kontrollit, Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas nenit 6, paragrafi 2, dërgon raportin e kontrollit tek subjektet e kontrolluara. Këta të fundit janë të detyruar të japin shpegimet e tyre brenda një muaji".*

Në fund të vitit 2009, Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve nxori urdhrin nr. 2, datë 6 gusht 2009. Në bazë të këtij urdhri audituesve të KLSH-së nuk mund t'u vihej në dispozicion informacioni mbi tatimpaguesin që dispononte administrata tatimore, i konsideruar si konfidencial, pasi kjo binte në kundërshtim me përcaktimet e neneve 24 dhe 25 të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *"Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë".*

Në fund të vitit 2012, me konstatimin e kësaj situate penguese ndaj veprimtarisë audituese KLSH ndërmori iniciativën që këtë konflikt institucional ta zgjidhte me anë të një marrëveshjeje mirëkuptimi.

Fatkeqësisht, përpjekjet e vazhdueshme me Ministrinë e Financave për arritjen e kësaj marrëveshjeje me organet e administratës tatimore, u venitën nën premtimet e rreme të titullarit të DPT-së për nënshkrimin e saj. Duke mos e parë më realizimin e kësaj marrëveshjeje ndërinstitucionale si rrugëzgjidhjen e këtij konflikti KLSH, në muajin korrik të 2013 vendosi t'i drejtohet sërish Gjykatës së Apelit Tiranë nëpërmjet kërkesë-padisë nr. 655/1 prot., datë 31korrik 2013, në të cilën ripërsëriti kërkesën për zgjidhjen e konfliktit të kompetencave, konfirmimin nga gjykata të së drejtës ligjore që KLSH ka në drejtim të aksesit të plotë në dokumentacionin, e konsideruar prej tij si të nevojshëm për kryerjen e auditimeve, si dhe shpalljen e pavlefshmërisë juridike të urdhrit nr. 2, datë 06.08.2009.

Këtë herë, Kontrolli i Lartë i Shtetit, në kërkesë-padinë e tij drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë, si dhe gjatë seancave të procesit gjyqësor arriti të shpjegojë me fakte konkrete nga veprimtaria e organeve të administratës publike se si këto organe kishin refuzuar të zbatonin detyrimin e tyre ligjor për vënin në dispozicion të audituesve tanë të dokumentacionit të kërkuar.

Në përfundim të procesit gjyqësor, Gjykata e Apelit Tiranë në vendimin e saj nr. 83, datë 29 tetor 2013 vendosi pranimin e kërkesë-padisë së KLSH-së, detyrimin e DPT-së që të lejojë dhe vërë në dispozicion të KLSH-së dokumentacionin e nevojshëm për realizimin e auditimeve në përputhje me ligjin, si dhe moszbatimin dhe eliminimin e pengesave të vëna nga urdhri nr. 2, datë 06 gusht 2009.

Në nenin 25 të projektligjit të ri për KLSH, pas konsultimit dhe miratimit edhe nga SIGMA dhe DG-Budget, ishte parashikuar e drejta e aksesit të KLSH-së në informacion.

Neni 25 i projektligjit është një përmirësim i nenit 17 të ligjit aktual të KLSH-së dhe reflekton më së miri standardet baze të INTOSAI, Deklaratën e Limës dhe Deklaratën e Meksikës.

Përcaktimi në këtë nen i një aksesi të plotë të KLSH në dokumentacionin e konsideruar si të nevojshëm për kryerjen e auditimit, nuk do të thotë që nga ana e KLSH nuk do të zbatohen dispozitat përkatëse ligjore (si në ligjin e KLSH, ashtu dhe në ligje të tjera) në lidhje me ruajtjen e sekretit shtetëror, sekretit tregtar apo edhe atë të konsideruar si konfidencial.

Aktualisht, gjatë gjithë këtyre viteve, KLSH ka shqyrtuar dhe ka audituar mbi dokumentacionin apo informacionin e klasifikuar si sekret shtetëror apo konfidencial. Më konkretisht, auditues të certifikuar të KLSH, kanë audituar vazhdimisht institucione si Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, SHISH, etj., ku në jo pak raste kanë shqyrtuar dokumente që përbëjnë sekret shtetëror dhe kanë audituar gjithashtu organet

e administratës doganore si dhe procedurat e prokurimit publik të zhvilluara nga shumë institucione, ku vazhdimisht janë njohur dhe kanë punuar mbi dokumenta, të cilat konsiderohen konfidenciale. I vetmi përjashtim, nga 2009 deri më sot, ka qenë veprimtaria e organeve të administratës tatimore.

Sipas variantit të propozuar nga Komisioni i Ekonomisë dhe Financave, neni 25 i projektligjit duhet të ndryshojë si më poshtë:

"Kontrolli i Lartë i Shtetit ka të drejtë për të patur akses në të gjitha dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, në bazat elektronike të të dhënave si dhe në çdo informacion apo dokumentacion që nuk bien ndesh me legjislacionin për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror, mbrojtjen e te dhënave personale, procedurat tatimore që konsiderohen të nevojshme në funksion të ushtrimit të kompetencave dhe detyrave të tij ligjore."

Ky përcaktim ligjor i bërë në nenin 25 të projektligjit, do ta rihapte edhe njëherë debatin në lidhje me detyrimin që organet e administratës tatimore kanë përsa i përket ruajtjes së konfidencialitetit. Tashmë ky debat duhet të konsiderohet i përfunduar, për shkak të interpretimit që Gjykata e Apelit Tiranë i ka bërë neneve 24 dhe 25 të Ligjit nr. 9920 datë 19.05.*2008 "Për procedurat tatimore në RSH"* dhe neni 25 i projektligjit duhet të reflektojë në përmbajtjen e tij edhe këtë vendim gjyqësor.

E drejta për të marrë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për kryerjen e auditimeve (sigurisht duke e ruajtur atë në rastin e informacionit apo dokumentacionit që përbën sekret shtetëror apo konfidencial) duhet të mbetet një e drejtë e pakufizuar, pasi është e pamundur që një auditues të japë një mendim të saktë dhe objektiv pa patur në dispozicion të gjithë dokumentacionin e nevojshëm.

Kufizimi i KLSH-së nuk duhet të qëndrojë në qasjen e tij në informacionin apo dokumentacionin e kërkuar, por në rrezen e subjekteve të cilat i nënshtrohen auditimit të saj. Në këtë kuptim KLSH nuk mund të auditojë subjektet private dhe as të shkojë fizikisht tek ato. KLSH duhet të auditojë vetëm veprimtarinë e organeve të administratës shtetërore.

E drejta e KLSH-së për të kërkuar informacion e lidhur kjo me të drejtën e çdo subjekti për të dhënë informacion dhe për t'u marrë në konsideratë si palë, janë dhe duhet të mbeten të drejta të pakufizuara. E drejta e KLSH për të kërkuar informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm duhet të mbrohet me dispozita të veçanta, të cilat përmbajnë sanksione ndaj institucioneve shtetërore apo nëpunësve përkatës të cilët refuzojnë t'i japin ato, ndërsa në rastin e subjekteve të tjera jo shtetërore, por që janë palë në këtë proces dhe disponojnë informacionin apo dokumentacionin e nevojshëm, këto subjekte kanë të drejtën e refuzimit të kërkesës së KLSH, pra nuk janë të detyruara që t'i përgjigjen pozitivisht kërkesës për dhënie informacioni apo dokumentacioni.

KREU IV.

Artikuj të botuar në shtypin shqiptar

- Korrupsioni nuk është as i kuq, as blu, por i zi *(Gazeta 'Sot", 21 janar 2012)*
- Lufta ime *(Intervistë, Revista "Klan", 10 shkurt 2012)*
- Ku bashkohen KLSH me Autoritetin e Konkurrencës (*Gazeta 'Ekonomia', 25 mars 2012)*
- Eksperienca e përbashkët u shërben të gjithëve *(Revista 'Monitor', 8 prill 2012)*
- KLSH drejt standardeve të INTOSAI-t *(Gazeta "Ekonomia", 21 nëntor 2012)*
- 87 vjet KLSH në 100 vjet Shtet (*Gazeta "Ekonomia",* 16 janar 2013)
- Llogaridhënia dhe transparenca (*Gazeta "Koha Jonë",* 4 shkurt 2013)
- Auditimi dhe këshillimi nga KLSH *(Gazeta"Panorama", 8 maj 2013)*
- Prof. As. Dr. Recai Akyel, një personalitet i shquar i auditimit suprem europian *(Gazeta "Ekonomia", 5 qershor 2013)*
- Rritja e përgjegjshmërisë institucionale (*Gazeta"Panorama",* 26 qershor 2013)
- Mbi zbatimin e Buxhetit të Shtetit të vitit 2012 *(Gazeta "Rilindja Demokratike", 13 tetor 2013)*
- KLSH dhe administrimi i Buxhetit të Shtetit *(Gazeta "Telegraf", 14 nëntor 2013)*
- 60 vjet INTOSAI- Zhvillimi i organizatës nga Lima në Pekin *(Gazeta "Ekonomia", 5 numra të gazetës, 19-23 nëntor 2013)*
- Për një projekt kombëtar në luftën kundër korrupsionit, *(Gazeta"Panorama", 27 nëntor 2013)*
- Auditimi kombëtar në shërbim të mirëqeverisjes *(Intervistë, Revista "Klan", 24 dhjetor 2013)*
- Tri paralajmërimet e KLSH: Borxhi Publik, Borxhi ndaj Biznesit, Ndarja Administrative *(Gazeta "Ekonomia", 29 janar 2014)*

- 300 vjetori i Gjykatës së Auditimit të Gjermanisë (*Gazeta "Ekonomia",* 9 mars 2014)
- Nisma e re ligjore për KLSH-në *(Gazeta "Ekonomia" dhe Gazeta "Koha Jonë", 18* mars 2014)
- Jo, KLSH nuk kërkon të auditojë subjektet private! (*Gazeta"Panorama",* 31 mars 2014)
- Cënimi me ligj i së drejtës së KLSH-së për informacion do të ishte regres (*Gazeta "Shqiptarja.com", 6* prill 2014)
- Detyrimet e MSA-së dhe ligji i ri i KLSH-së (*Gazeta "Koha Jonë",* 8 prill 2014)
- Auditimi Kombëtar të vihet në shërbim të qeverisjes kombëtare *(Gazeta "Ekonomia", dy numra,* 16-17 tetor 2014)
- Menaxhimi i financave publike dhe BE (*Gazeta "Shqiptarja.com",* 28 dhjetor 2014)
- Për një llogaridhënie dhe transparencë të financave publike *(Gazeta"Panorama",* 25 janar 2015)
- Për një lexim të vëmendshëm të raporteve të ndërkombëtarëve për ekonominë (*Gazeta "Shqip", 6* maj 2015)
- 90 vjet KLSH *(Gazeta"Panorama",* 27 maj 2015)
- Gjetjet e KLSH 2015, sipas Kornizës së Matjes së Performancës së SAI-ve (*Gazeta "Shqip",* 29 qershor 2015)
- A duhet të shqetësohemi për ekonominë shqiptare? *(Revista 'Monitor',* 2 korrik 2015)
- EUROSAI-OLACEFS: Frytet e një bashkëpunimi 25 vjeçar *(Gazeta "Telegraf",* datë 4 korrik 2015)
- KLSH dhe sfida e llogaridhënies publike (*Gazeta "Shqip",* 15 korrik 2015)
- Korrupsioni sistematik dhe informaliteti *(Gazeta"Panorama",* 11 tetor 2015)
- Për një zbatim koherent të strategjisë së menaxhimit të financave publike *(Gazeta "Shqip", 2 dhjetor 2015)*
- Borxhi publik dhe nevoja e rritjes ekonomike *(Gazeta"Panorama",* 4 dhjetor 2015)
- Për rritjen e besueshmërisë së Buxhetit të Shtetit *(Gazeta "Gazeta Shqiptare",6 dhjetor 2015)*
- Transparenca, institucionet dhe lufta kundër korrupsionit (Gazeta 'Sot", 16 dhjetor 2015)

KORRUPSIONI NUK ËSHTË AS I KUQ, AS BLU, POR I ZI

Botuar në Gazetën 'Sot', më 21 janar 2012

Vitin që porsa përfundoi, duke respektuar punën e të gjithë kontrollorëve të KLSH, e vlerësoj një vit pune në zbatim të rekomandimeve të Rezolutës së 2 qershorit 2011 të Kuvendit të Shqipërisë dhe të objektivave të Planit Strategjik të Zhvillimit 2009-2012. Gjatë këtij viti, KLSH ka kryer 152 kontrolle, ku janë konstatuar shkelje financiare me dëm të konsiderueshëm ekonomik dhe ka rekomanduar shpërblimin e këtij dëmi ekonomik në nivel të lartë financiar në arkën e Shtetit. Janë propozuar 1,605 masa korrigjuese administrative, nga të cilat 1,108 janë zbatuar. Nga 720 masa disiplinore dhe administrative të rekomanduara, janë zbatuar 536 prej tyre. Përgjithësisht më duhet të pohoj se janë masa relativisht të lehta. Gjithashtu, KLSH ka kryer kallëzim penal gjate vitit 2011 pranë organeve të Prokurorisë në 6 raste dhe për 13 persona.

Pak! Shumë pak! Dobët për të gjithë ne.

Duke vlerësuar punën gjatë vitit 2011, analizat vjetore të departamenteve në këtë muaj të parë të vitit 2012 dhe përpjekjet e shumta prej jush në auditivet e kryera dhe në raportimet e dhëna, më duhet të pohoj se kemi ende shumë për të bërë, për të qenë konform standardeve ndërkombëtare të auditimit, sidomos me Strategjinë e INTOSAI për vitet n vazhdim (2012-2016), të titulluar 'Për promovimin e përgjegjshmërisë, transparencës dhe qeverisjes së mirë'. Kjo strategji, e miratuar në Kongresin e INTOSAI në Johansburg në vitin 2010 përmban objektivin e 'Vazhdimit të luftës ndaj korrupsionit'.

Ne duhet ta denoncojmë korrupsionin edhe kur ai është në një njësi vendore që drejtohet nga socialistët apo demokratët, edhe kur është ushtruar në institucione qendrore, pra në çdo vend dhe kohë. Ne do të kërkojmë riaktivizimin potencial të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Financave, Prokurorisë, Shërbimit Informativ Shtetëror, Inspektoratit të Deklarimit të Pasurive dhe KLSH, me synim maksimizimin e dobisë së vlerave të saj për çdo departament. Do të punojmë për një bashkëpunim intensiv me Departamentin e Antikorrupsionit në Këshillin e Ministrave dhe për një rivendosje të marrëdhënieve me Prokurorinë, të shkëputura prej disa vitesh.

Të gjithë duhet të kuptojmë se, nuk ka kontroll pa ndëshkim. Është e rëndësishme që ne të largojmë hijen e kontrolluesit gjobëvënës dhe të atij që abuzon me detyrën. Deri tani janë shumë pak masat për largimin nga puna të personave shkaktarë përgjegjës të dëmeve të konstatuara.

Pavarësia dhe integriteti i institucionit duhet të na bëjë të ndërgjegjshëm se korrupsioni nuk ka ngjyrë, nuk është as i kuq, as blu, por është i zi. Konstatoj se brenda strukturave të brendshme të KLSH mungon koordinimi në nivelin e duhur. Ka ndodhur që në një subjekt nën kontroll të shkojë një grup auditimi i njërës drejtori dhe pas disa muajsh një grup tjetër nga një departament tjetër, duke ia ulur seriozitetin dhe imazhin institucionit. Informacioni për kontrollet e kryera dhe rezultatet e marra nuk qarkullon elektronikisht mes departamenteve dhe shumë pak punonjës kanë njohuri të mjaftueshme për atë çfarë ndodh në departamentin fqinj.

Sfida jonë për vitet në vijim do të jetë partneriteti me Gjykatën Evropiane të Audituesve. Do të synojmë të marrim pjesë në programet e tyre të kontrollit për vendet që aspirojnë për në Bashkimin Evropian dhe që përfitojnë nga programet e asistencës së BE-së, përfshirë vendin tonë. Për thellimin e dijeve në auditimin e performancës, do të vazhdojmë partneritetin me institucione homologe që na kanë ndihmuar në të kaluarën, si Zyra Kombëtare e Auditimit e Britanisë së Madhe apo Gjykata Holandeze e Auditimit, por njëkohësisht duke kërkuar partneritet edhe nga institucioni homolog gjerman, suedez apo i vendeve të tjera të fuqishme të EUROSAI. Ne do të nisim të kryejmë auditime të performancës për kreditë që strukturat publike qendrore dhe vendore marrin nga institucione dhe organizata të huaja, duke parë tendencën në rritje të këtyre financimeve për ekonominë dhe shërbimet publike të vendit. Vlerësimi i performancës së kredive kërkon dije të zgjeruara dhe specifike dhe për këtë do të kryejmë trajnimet e duhura.

Në fillimin e vitit 2012 e organizuam duke analizuar gjerësisht punën e departamenteve, arritjet, mosarritjet, dobësitë tonat dhe të partnerëve tanë e të institucioneve të tjera në Shqipëri. Gjatë kësaj jave takimesh me secilin prej jush në analizën vjetore të drejtorive përkatëse, kemi mundur të ridimensionojmë objektivat tona si auditues të lartë dhe të dimë se ç'kërkohet nga ne. Këtë vit i kemi kryer ndoshta për herë të parë këto takime krejtësisht të hapura. Njerëzit e medias dhe të shoqërisë civile janë ftuar të qëndrojnë në ballafaqimet tona dhe të na njohin e kuptojnë deri në fund, me mundësitë, dobësitë dhe përparësitë tona, si në një libër të hapur. E kemi kërkuar dhe gjithnjë do ta kërkojmë këtë partneritet me median dhe shoqërinë civile, pse janë aleatët tanë më të vlefshëm për të ndërgjegjësuar publikun dhe nëpërmjet tij vendim-marrësit publikë për rolin dhe detyrat tona në të ardhmen.

Programi i veprimtarisë i KLSH për vitin që sapo kemi hyrë, synon tejkalimin e mangësive të cituara më sipër dhe fuqizimin e mëtejshëm të rezultateve dhe arritjeve të derisotme të institucionit. Në vijim po përqendrohem në disa nga drejtimet më kryesore, ku mendoj se duhet të intensifikojmë punën për shndërrimin e KLSH në një strukturë profesionale që përdor në mënyrë ekonomike burimet e saj dhe që funksionon me

efiçiencë dhe efektivitet, drejtime të cilat ia kam paraqitur në fund të vitit të kaluar Komisionit për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë dhe që janë thelluar më tej pas konsultimeve të deritanishme me ju. Më konkretisht:

1- Vizion koherent për KLSH, mbi bazën e eksperiencave më të mira të vendeve të BE-së dhe respektimit rigoroz të standardeve ndërkombëtare të kontrollit INTOSAI.

2- Thellim i realizimit të misionit të KLSH në luftën kundër korrupsionit dhe abuzimeve në administrimin e pronës publike. Ky obligim do të jetë përparësia jonë madhore gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimeve për këtë vit dhe në vijimësi.

3- Përmirësim i metodologjisë së kontrollit, duke kthyer vëmendjen tek auditimi i performancës dhe auditimi i certifikimit të pasqyrave financiare, krahas rritjes së efiçiencës së auditimit financiar.

4- Realizim i sinergjizimit të politikave dhe veprimeve me strukturat e tjera shtetërore të së njëjtës fushë, si me Departamentin e AntiKorrupsionit pranë Kryeministrisë, me Njësinë Qendrore të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, me Drejtorinë e Inspektimit Financiar Publik pranë Ministrisë së Financave dhe, në veçanti me organet e Prokurorisë, duke ruajtur pavarësinë e KLSH si organi më i lartë i kontrollit ekonomiko-financiar.

5- Komunikim dhe ndërveprim me Kuvendin, Qeverinë dhe partnerë të tjerë institucionalë, sidomos intensifikim i konsultimeve me Komisionin për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë për përafrimet strategjike të KLSH 2013- 2018, në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimit ndaj Kuvendit, si një detyrim kushtetues. Brenda gjysmës së dytë të këtij viti, do të përgatisim Planin Afatmesëm Strategjik të Zhvillimit të institucionit për vitet 2013-2015.

6- Programim dhe konsolidim e bashkëpunimit me ekspertët universitarë dhe akademikë të auditimit të financave publike, si dhe me organizata profesionale të kontabilitetit dhe të fushave të tjera të ekonomisë. Unë sapo vij në këtë analizë pas një takimi të vyer me profesorin gjerman, ekspertin e financave publike Hans Ditrich Wenzel.

7- Intensifikimi i bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare të auditimit si INTOSAI dhe EUROSAI, me institucionet e larta të kontrollit të BE-së, si SIGMA dhe Gjykata Europiane e Audituesve, me institucionet homologe të vendeve të BE- së dhe të rajonit dhe në veçanti me Zyrën e Audituesit të Përgjithshëm të Kosovës.

8- Zhvillim i burimeve njerëzore të KLSH në nivelin e parametrave të kërkuar nga institucionet ndërkombëtare të auditimit dhe në përputhje me sfidat integruese të vendit. Në këtë kontekst, do të përshtaten më mirë cilësitë profesionale dhe aftësitë e

secilit punonjës, me strukturën organike të institucionit, duke bashkuar apo krijuar struktura të reja (si për shembull Vendimi i ditëve të para në ushtrimin e detyrës sime për krijimin e Drejtorisë për Kërkimin, Zhvillimin dhe Kontrollin e Brendshëm), të afta të përballojnë sfidat e kohës dhe kërkesat e standardeve të miratuara nga INTOSAI. Do të ketë rritje cilësore dhe të numrit të kontrollorëve të trajnuar brenda dhe jashtë institucionit, mbi bazën e listës së nevojave reale të stafit për ngritjen profesionale dhe të kërkesave të shtruara për institucionet supreme të kontrollit në Rezolutën e Kombeve të Bashkuara të datës 22 dhjetor 2011 dhe kërkesave në Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit të Shqipërisë me BE.

9- Ngritje e kapaciteteve të nevojshme për parandalimin dhe zbulimin e krimit ekonomik në teknologjinë e informacionit. Qeverisja elektronike po fiton gjithnjë e më shumë terren në administrimin e pasurisë publike dhe ofrimin e shërbimeve publike në Shqipëri dhe është e kuptueshme që 12 përdorimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit të shoqërohet edhe me forma të reja të krimit ekonomik. Kjo është edhe një nga sfidat më të rëndësishme të KLSH-së në një periudhë afatshkurtër.

10- Përmirësim i transparencës në marrëdhëniet me publikun, nëpërmjet një partneriteti të gjerë me median dhe me organizatat jo-fitimprurëse të interesuara për bashkëpunim. Vend të veçantë do të zërë partneriteti i KLSH me shoqërinë civile të angazhuar në luftën për parandalimin e mashtrimit financiar dhe korrupsionit. Në përgjigje të ndjeshmërisë dhe pritshmërisë së publikut, kam realizuar me shkresën zyrtare Nr. 92 datë 19.01.2012 dorëheqjen nga imuniteti si Kryetar i KLSH.

Në mbyllje dua të jap mesazhin se do të punojmë për një institucion të lartë auditimi që siguron një komunitet të angazhuar që ka interes ta mbajë qeverisjen qendrore dhe vendore përgjegjëse. Për këtë do të fuqizojmë rolin e pazëvendësueshëm kushtetues te KLSH si institucioni kryesor ekonomiko-financiar, për ekonominë dhe shoqërinë tonë, me detyrë kontrollin e miradministrimit të pronës publike dhe shëndoshjen e financave publike, duke i shërbyer me devotshmëri Kuvendit dhe duke rritur pjesëmarrjen e opinionit publik në realizimin e Buxhetit te Shtetit dhe të auditimit në tërësi.

LUFTA IME

Intervistë botuar në Revistën "Klan" Nr. 753, më 10 shkurt 2012

Në rrëfimin e tij të parë në media pas emërimit në krye të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Bujar Leskaj, flet për projektet që do t'i japin një tjetër hov punës së këtij institucioni dhe si e priti propozimin e Presidentit Bamir Topi

**Në zyrën e Bujar Leskajt je i rrethuar nga gjithfarë pikturash origjinale, a thua se aty nuk punon Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, por ndonjë dashamirës i artit, çka e ka shfaqur edhe kur mbante postin e Ministrit të Kulturës, në vitet 2005-2007. Në veçanti, i pikturës dhe skulpturës. Emra të njohur varen në katër muret e zyrës: Ali Oseku, Zihni Veshi, Ardian Isufi dhe Genc Përmeti. Në tavolinë mban një skulpturë të Ibrahim Rugovës, ndërsa në njërin cep atë të Ismail Qemalit, të dyja punë të skulptorit kosovar Luan Mulliqi. Por, kur bëhet fjalë për detyrën e re që i është ngarkuar, Bujar Leskaj nuk heziton të të përgjigjet me dashamirësi për ato çfarë je përgatitur ta pyesësh. Ndonëse ka pak ditë që ka mbushur muajin në krye të KLSH-së e nis rrëfimin me qetësi, me tonin e zërit dhe theksin prej vlonjati, duke këmbëngulur fort kur bëhet fjalë për luftën ndaj korrupsionit. "Çdo hap mbrapa që do të bëjë Shqipëria në renditjen për nivelin e korrupsionit, unë e kam konsideruar dhe do ta konsideroj si punë të dobët të institucionit që tani drejtoj", thotë ai.

- **Zoti Leskaj, ende nuk janë plotësuar dy muaj nga marrja e detyrës tuaj të re si Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit. A e prisnit t'ju besohej një post i tillë pas tërheqjes nga jeta aktive politike në 2009 dhe si po i përjetoni javët e para në këtë detyrë?**

Mendoj se kam përcjellë aktivisht jetën politike, ekonomike dhe shoqërore të vendit, edhe pas vitit 2009, kur nuk isha deputet. Në aktivitetet të ndryshme të zhvilluara në Vlorë me Institutin e Studimeve Politike "Ismail Qemal Vlora", me disa libra dhe leksione të botuara në fushën e financave publike dhe në histori, si dhe në pozicionin e pedagogut në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tiranës, asnjëherë nuk e kam pushuar kontributin tim. Gjykoj se detyra e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit që më është besuar kërkon, para së gjithash, një formim të plotë profesional. Në këtë këndvështrim, kandidaturën time e konsiderova si kurorëzimin e një kontributi të shtrirë në kohë, veçanërisht në fushën profesionale.

Dita e parë e punës dhe javët në vijim kanë ecur me punë normale, duke vlerësuar arritjet më të mira të institucionit, por edhe duke u përpjekur me kujdes të kurojmë mangësitë. Në ditën e parë të punës përpara specialistëve të KLSH-së, punova platformën që kisha paraqitur në Komisionin për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit

dhe këto javë po vazhdojmë zbatimin dhe plotësimin e kësaj platforme, krahas ndjekjes së praktikave të ndryshme që ishin dhe janë në proces.

- **Pozicioni i Kryetarit të KLSH-së nuk është dhe aq i lehtë, sepse do t'u bëni kontrollin institucioneve të shtetit dhe rrjedhimisht edhe ekzekutivit që udhëhiqet nga mazhoranca që ju zgjodhi. Si e shihni Bujar Leskajn në shtatë vitet e mandatit?**

Në zbatim të Kushtetutës dhe ligjit duke zbatuar KLSH, si institucioni më i lartë i kontrollit ekonomiko-financiar të Shtetit, është e natyrshme që pjesë thelbësore e punës sime të jetë edhe kontrolli i institucioneve të larta shtetërore, kontroll të cilin do ta kryejmë të plotë dhe të mbështetur në praktikat më të mira të auditimit financiar, të auditimit të performancës dhe të certifikimit të llogarive, me qëllim miradministrimin e pasurisë publike. Kontrolli mbi të gjitha institucionet qendrore publike do të jetë dhe i bazuar në standardet e përditësuara të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve të Auditimit Suprem , të quajtur INTOSAI. Por, ky kontroll i plotë nuk do të na ndalojë që me maxhorancën të sinergjizojmë politikat për të luftuar me efektivitet korrupsionin. Besoj se kjo detyrë vjen në sintoni me qëllimet e kësaj maxhorance, të shpalosura në Strategjinë Anti-Korrupsion 2008-2013, e cila kërkon një bashkëpunim më të ngushtë të institucioneve kryesore që e luftojnë korrupsionin, të bazuar në angazhime të përbashkëta të institucionalizuar. Prandaj, dhe mbi bazat ligjore të ligjeve përkatëse, duke ruajtur dhe forcuar pavarësinë e KLSH-së si institucion kushtetues përgjegjës për kontroll, besoj se ne do të arrijmë të punojmë ngushtë me Departamentin për Luftën ndaj Korrupsionit në Këshillin e Ministrave. Theksoj se KLSH-së nuk i cenohet pavarësia kur sinergjizon politikat dhe veprimet e tij me institucionet e lartpërmendura. Përkundrazi, i rritet efektiviteti dhe efiçienca e tij, në përmbushjen e detyrimeve kushtetuese që ka, si institucioni kryesor i kontrollit ekonomiko-financiar të vendit.

Si shoh veten në këto shtatë vite?Mendoj se kohëzgjatja e mandatit është shumë e plotë për të ndërtuar një institucion modern, të pavarur, të depolitizuar dhe që i përdor burimet e veta në mënyrë ekonomike, me efektivitet dhe efiçiencë. Ne, i gjithë stafi i KLSH do ta arrijmë këtë. Çdo hap mbrapa që do të bëjë Shqipëria në renditjen e vendeve të ndryshme të botës për nivelin e korrupsionit, unë e kam konsideruar dhe do ta konsideroj si punë të dobët të institucionit që tani drejtoj.

- **A keni një plan ose më saktë një program tuajin, të cilin do të mundoheni ta vini në zbatim për performancën e KLSH-së gjatë mandatit tuaj? Ku konsiston ai?**

Në 3-4 javët e para, pas nominimit nga Presidenti si kandidat për Kryetar të KLSH-së, përgatita një projekt-ide që e paraqita në Komisionin parlamentar për Ekonominë dhe

Financat. Pas votimit dhe betimit në Kuvend, në ditën e parë të punës në KLSH, më 23 dhjetor 2011, unë ia paraqita këtë projekt stafit të KLSH-së, si bazë e hartimit të strategjisë afatmesme të punës për tre vitet e ardhshme. Ky program konsiston në një vizion koherent për KLSH-në, mbi bazën e eksperiencave më të mira të vendeve të BE-së dhe respektimit rigoroz të standardeve ndërkombëtare të kontrollit INTOSAI, në një përmirësim të metodologjisë së kontrollit, duke kthyer vëmendjen tek auditivi i performancës, krahas rritjes së efiçiencës së auditimit financiar dhe në një thellim të realizimit të misionit të KLSH-së në luftën kundër korrupsionit dhe abuzimeve në administrimin e pronës publike. Po ashtu, projekt-ideja kërkon realizimin e sinergjizimit të politikave dhe veprimeve me strukturat e tjera shtetërore të së njëjtës fushë, intensifikimin e konsultimeve me Komisionin për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë për përafrimet strategjike të KLSH-së, intensifikimin e bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare INTOSAI, EUROSAI, SIGMA dhe me institucionet e larta të kontrollit të vendeve të BE-së për rritjen e cilësisë së punës, si dhe përmirësimin e transparencës në marrëdhëniet me publikun, nëpërmjet një partneriteti të gjerë me median dhe me organizatat jo-fitimprurëse.

Forcimi i kapaciteteve të SAI-t (Institucioneve të Kontrollit të Lartë) është dhe një nga parimet themelore të Deklaratës dhe Marrëveshjeve të Johanesburgut në Afrikën e Jugut në nëntor 2010, të hartuara gjatë Kongresit të 20-të të INTOSAI. Po ashtu, do të ngremë dhe thellojmë bashkëpunimin edhe me institucionet e auditimit suprem të vendeve më të përparuara të BE-së, në formën e projekteve të binjakëzimit (një ose disa) dhe në forma të tjera, në kuadër të INTOSAI dhe EUROSAI. Forcimi i kapaciteteve të institucionit, duke zbatuar standardet e përditësuara të INTOSAI dhe në bashkëpunim me institucionet ndërkombëtare të fushës, për një auditim sa më cilësor dhe efikas, si dhe lufta totale ndaj korrupsionit do të jenë motorët më të fuqishëm me të cilët do të ecë përpara KLSH-ja gjatë shtatë viteve të ardhshme. Për këtë, këto ditë po përfundojmë me përfaqësuesit e SIGMA-s (nisma e përbashkët të OECD dhe Bashkimit Evropian, e quajtur "Mbështetje për Përmirësimin në Qeverisje dhe Menaxhim") jo vetëm për të na monitoruar dhe vlerësuar, (ç'ka është detyra e tyre për raportet e BE-së), por edhe për dhënie asistence teknike në vijimësi. Takimet e punës së këtyre ditëve me këshilltarët auditues z. Joop Vrojlik dhe z. Jan Pieter Lingen po rezultojnë shumë të dobishme për ne.

- **Ardhja juaj në krye të KLSH-së përkoi me analizën vjetore të institucionit, gjatë së cilës kërkuat mbështetjen e Prokurorisë, qeverisë dhe çdo institucioni që vepron në luftën kundër korrupsionit. Çfarë duhet tjetër, përveç bashkëpunimit me këto institucione, për të ulur nivelin e korrupsionit në Shqipëri?**

Këtë vit, analiza vjetore në rang departamentesh dhe në nivel të të gjithë institucionit, u bë, mbas disa vitesh, në praninë e mediave dhe të OJF-ve që luftojnë korrupsionin, të cilat unë i falënderoj për ndjekjen dhe bashkëpunimin. Këtë bashkëpunim ne do ta thellojmë në të ardhmen. Por, bashkëpunimi me institucionet që ju përmendet është thelbësor, për të ulur nivelin e korrupsionit në vend, mbi të luftojmë për parandalimin e korrupsionit. Paralelisht me rritjen e profesionalizmit është e rëndësishme që të largojmë hijen e kontrolluesit gjobëvënës dhe të atij që abuzon me detyrën. Deri tani, janë shumë pak masat për largimin nga puna të personave shkaktarë përgjegjës të dëmeve të konstatuara. Konstatimet dhe masat e propozuara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit duhen të jenë të efektshme dhe të ndihen në publik. Ne duhet të heqim dorë nga zbulimi i shpërdorimeve hipotetike, që s'ekzistojnë, sepse duke bërë zhurmë për këto mbulohet korrupsioni i vërtetë. Duhet të rifreskohet praktika e dërgimit të evidencave të sakta pranë Departamentit të Administratës Publike (DAP) për masat administrative dhe disiplinore të propozuara. Një libër gri për nëpunësit abuzues ne do ta dorëzojmë çdo vit pranë DAP-it. Pavarësia dhe integriteti i institucionit do të na bëjë të ndërgjegjshëm se korrupsioni nuk ka ngjyrë, nuk është as i kuq, as blu, por është i zi.

Ne do të thellojmë bashkëpunimin me Prokurorinë. Gjatë viteve të fundit ka rënie drastike të numrit të kallëzimeve penale nga ana e KLSH-së. Bashkëpunimi me organet e Prokurorisë në ndjekjen e kallëzimeve penale nuk ka qenë në nivelin e kërkuar, për pasojë të punës sonë të dobët dhe po ashtu nënvleftësimit apo injorimit nga Prokuroria. Kemi një marrëveshje ndërmjet të dy institucioneve, të nënshkruar që në vitin 2005, të cilën do ta shpluhuros, pse gjatë këtyre viteve ka qenë inekzistente.

- **Ndonëse keni pak kohë në drejtimin e KLSH-së, a keni piketuar ndonjë pikë të dobët të institucionit, e cila ka nevojë të përmirësohet në vijim?**

E vlerësoj punën e paraardhësit tim z. Robert Çeku, si dhe të drejtuesve të tjerë të mëparshëm të KLSH-së pas vitit 1992, z. Blerim Çela dhe z. Mustafa Kërçuku. Ky institucion sot është i aftë të mbulojë me kontroll 50 përqind të institucioneve shtetërore. Nga ana tjetër, natyrisht që kam konstatuar shumë pika të dobëta, të cilat vërtet do t'i kuroj me kujdes, por edhe me dinamizëm. Sikurse theksohet në një vlerësim të SIGMA-s të disa viteve më parë: "KLSH duhet të luajë një rol kryesor si një agjent ndryshimi, aktiv dhe i rëndësishëm, dhe rolin e një spirance që tërhiqet zvarrë". Detyrimi i nenit 3 të Ligjit integral të KLSH-së më ka shtyrë t'i kërkoj Kuvendit të dërgojë një komision për auditivin e vetë KLSH-së. Ka mbi tetë vjet që KLSH-ja nuk auditohet. Po ashtu, Raporti vjetor mbi zbatimin e Buxhetit të Shtetit duhet të freskohet, si dhe Raporti Vjetor për veprimtarinë e KLSH-së që paraqitet në Kuvend. Po ashtu, duhet të vazhdojë puna e ndërprerë me proceset e binjakëzimit me institucione të zhvilluara të auditimit suprem në vendet e BE-së. Niveli profesional i

kontrollorëve duhet të rritet, për të mos përmendur këtu atë pjesë kontrollorësh, niveli i të cilëve lë për të dëshiruar.

- **Jeni shprehur se do të siguroheni që puna të bëhet dhe jo të kryhet formalisht. Çfarë keni pasur parasysh me këtë?**

Duhet të heqim dorë nga formalizimi në kryerjen e auditiveve, pse ai deri tani ka qënë shumë i përhapur. Analiza e riskut dhe përcaktimi i saktë i materialitetit duhet dhe do të sjellin përzgjedhjen e subjekteve për kontroll. Për këtë, orientimi ynë do të jetë i qartë: standardet e INTOSAI, të përditësuara në kongreset e fundit të kësaj organizate prestigjioze. Do të fillojmë nga përmirësimi i metodologjisë, duke rritur ndershmërinë e punonjësve dhe thelluar luftën pa kompromis ndaj korrupsionit, si kushte të nevojshme, por jo të mjaftueshme. Për më tej na nevojitet profesionalizëm i lartë. Në drejtimin e sigurimit të burimeve njerëzore me integritet e profesionalizëm të lartë, duhet të punojmë për të përballuar sfidat e së ardhmes, si auditivi i performancës apo auditimi i prokurimeve që kryhen elektronikisht, auditivi IT.

- **Në analizën vjetore të punës ju deklaruat se KLSH-ja do t'i rikthehet dosjeve të vjetra, mes të cilave edhe Bashkia e Tiranës. A ka edhe institucione të tjera që do t'i nënshtrohen kontrollit tuaj?**

Duhet të kuptojmë se institucione të tilla si KLSH-ja mund dhe duhet t'i kthehen dhe ti rikthehen dosjeve si të para 1 viti, ashtu edhe para 10 viteve. Kjo praktikë pune zbatohet nga institucionet supreme të auditimit dhe në vendet e tjera të botës. Ajo është në standardet ndërkombëtare INTOSAI dhe rekomandohet në zbulimin e rasteve të abuzimit, mashtrimit financiar dhe korrupsionit, ose kur kontrollet e mëparshme janë kryer të dobëta dhe pa efektivitet. Në rast se burimet tona njerëzore do ta përballojnë, të gjitha institucionet shtetërore, ato qendrore dhe ato vendore që kanë rezultuar problematike do të kontrollohen nga ne, duke zbatuar këto standarde të pranuara botërisht dhe që përditësohen, natyrisht, larg çdo lloj paragjykimi.

- **Në media është folur jo pak se arsyeja kryesore e përzgjedhjes së Bashkisë së Tiranës për kontroll në vitet 2005-06 lidhet me faktin se kështu po i "ktheni reston" kryeministrit Berisha për zgjedhjen tuaj në KLSH... Sa e vërtetë është kjo?**

Me ligj ne kontrollojmë veprimtarinë financiare të institucioneve qendrore dhe të organeve të pushtetit vendor dhe këtë detyrë do ta kryejmë sa më mirë. Por, duke e realizuar atë, unë nuk e shkoj ndërmend të kontrolloj as Kryetarin e Partisë Ekologjike, apo cilindo me emër të veçantë. Por për kryebashkiakët, ish-kryekomunarët pa dallim përkatësie politike, në rast se ne si KLSH (pra specialistë, departamenti, Kryetari) në analizat e punës, konstatojmë p.sh. se në këto 10-15 vitet e fundit, bashkia e Tiranës apo

ndonjë institucion tjetër (qendror apo vendor) është kontrolluar me teleskop, natyrisht ne do të rikontrollojmë. Por , për vetë ngarkesën e punës korrente , mund t'ju them se këto kontrolle nuk janë në planet tona të tanishme.

Sa për pyetjen e "restos", nuk e mendoj që një burrë shteti si Kryeministri Berisha ka nevojë për "resto". Dhe në takimin shumë të dobishëm që unë pata para pak ditësh me të, Kryeministri, në respekt të institucionit që drejtoj, kërkoi zbatimin vetëm të Kushtetutës dhe të ligjit. Të njëjtin respekt korrekt të Kushtetutës dhe ligjit kërkoi dhe Presidenti Topi që më kandidoi. Për të qenë i sinqertë deri në fund, vlerësoj edhe opozitën për shqetësimin e saj për fatet e institucionit qe unë drejtoj dhe do t'i përgjigjem asaj me punë, profesionalizëm, ndershmëri dhe korrektesë si drejtues i një institucioni të depolitizuar.

- **Zgjedhja juaj në KLSH erdhi në një çast të turbullt mosmarrëveshjeje mes mazhorancës dhe Presidentit Topi, i cili ishte njeriu që ju kandidoi për këtë post. Ndërkaq, sapo ishte rrëzuar kandidatura e parë e Presidentit, ajo e z. Sali Shehu. Keni menduar për një çast, para votimit në Parlament, se edhe kandidatura juaj mund të kishte të njëjtin fat si ajo e z. Shehu meqenëse edhe ju ishit propozuar nga Presidenti Topi?**

Nuk është as ligjore dhe as etike që unë të komentoj këto mosmarrëveshje dhe asnjëherë nuk e kam menduar këtë situatë që ju më pyetët.

- **Meqenëse ju ishit larguar prej kohësh nga postet që mbanit në PD, jo pak herë ju kanë futur në listën e njerëzve mbështetës të Presidentit Topi dhe rrjedhimisht edhe pjesë të partisë që ai mendon të krijojë pas përfundimit të mandatit. Si i keni pritur këto qëndrime?**

Me shumë qetësi dhe kthjelltësi! Mbas dy vitesh pune, në nëntor të vitit 2011, pak kohë përpara kandidimit për Kryetar të KLSH, unë përgatita një botim për veprën e një pjese të autoreve të letërsisë së burgut (25 autorë), të titulluar "Muzat e Qëndresës". Në hyrje të këtij libri kam vendosur vargjet lapidare të Vilson Blloshmit, të pushkatuar nga diktatura më 1977: "Nëse nuk munda brengës t'i bëj ballë; Zjarr përsëri unë kam në shpirt të djegur; Nëse më i vdekur jam se çdo i gjallë; Mirë pra, m'i gjallë jam se çdo i vdekur".

KU BASHKOHEN KLSH ME AUTORITETIN E KONKURRENCËS

Botuar në Gazetën 'Ekonomia', më 25 mars 2012

Autoriteti i Konkurrencës ka shumë gjera të përbashkëta me Kontrollin e Lartë të Shtetit. Të dyja këto institucione të pavarura, që i japin llogari vetëm Kuvendit dhe u shërbejnë interesave të publikut, të qytetarëve shqiptarë. Edhe pse këndvështrimet tona nuk anë të njëjta (AK i sheh qytetarët si konsumatorë, KLSH si taksapagues), interesat publike që mbrojnë janë të përbashkëta. Nëse AK e koncepton funksionin e tij si nxitës dhe avokat i konkurrencës dhe i interesave të konsumatorit, KLSH në rolin e tij kushtetues si institucioni më i lartë i kontrollit ekonomiko-financiar, është avokat i Kuvendit dhe i interesave të qytetarit për miradministrimin e pronës publike dhe performancën e duhur të administratës shtetërore, duke respektuar përdorimin me ekonomi, efektivitet dhe efiçiencë të burimeve publike.

Në këtë këndvështrim, Marrëveshja që nënshkruam me Autoritetin e Konkurrencës është e veçantë jo vetëm pse të dyja institucionet tona nisen nga interesi dhe ndjeshmëria e qytetarëve si taksapagues dhe konsumatorë për efiçiencën e përgjegjshmëri maksimale të administratës publike në shpenzimin e fondeve publike. Të dyja institucionet tona po zhvillojnë gradualisht ekspertizën për të mbrojtur me efektivitet interesat e qytetarëve që preken ndjeshëm nga deformimet e kontratave publike në proceset e prokurimeve, ankandeve, koncesioneve, apo çdo forme tjetër të partneritetit publik-privat.

Kam shumë besim në angazhimin konkret të institucioneve tona në organizimin e aktiviteteve të përbashkëta për rritjen e ndërgjegjësimit të administratës publike në parandalimin dhe shmangien e praktikave të kundërligjshme dhe abuzive në dëm të taksapaguesve dhe konsumatorëve, si dhe shkëmbimin e ekspertizës dhe trajnimit për fushat respektive të veprimtarisë.

Prandaj dhe ne si KLSH, me qëllim përmirësimin e kontrollit të përdorimit efektiv të fondeve publike dhe të miradministrimit financiar, si dhe mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, marrim përsipër në këtë Marrëveshje të njoftojmë në një kohë sa më të shpejtë Autoritetin e Konkurrencës për rastet kur gjatë auditimeve tona konstatohen praktika të administratës publike, ose kontrata administrative si prokurime, ankande, koncesione, etj. që mund të ndikojnë negativisht në shkallën e konkurrencës. Edhe Autoriteti i Konkurrencës do të na ndihmojë që në përfundim të kontrolleve apo hetimeve të tij, në rast zbulimi të praktikave abuzive apo arbitrare që cenojnë interesat pasurore të shtetit, të na dërgojë sa më shpejtë një kopje të dokumenteve të nevojshme.

Ne jemi të ndërgjegjshëm që korrupsioni, abuzimet me tenderat publike, prokurimet, ankandet dhe koncesionet nuk mund të luftohem me fjalë, as me fushata dhe as me deklarime për dëme hipotetike ndaj arkës së Shtetit. Korrupsioni dhe deformimet e konkurrencës për përfitime të padrejta në kurriz të konsumatorit shqiptar luftohen me punë të përbashkët në sistem.

Për këtë arsye kam kërkuar që në ditët e para të mandatit tim bashkëpunim e mirëkuptim me të gjitha institucionet shtetërore dhe me shoqërinë civile, për të bashkuar forcat në luftën kundër korrupsionit. Ne si KLSH po sinergjizojmë përpjekjet me institucionet që mund ta luftojnë me shumë rezultat korrupsionin, si me Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, me Prokurorinë e Përgjithshme, me Departamentin Antikorrupsion pranë Kryeministrisë, me Drejtorinë e Auditit të Brendshëm dhe Drejtorinë e Inspektimit Financiar Publik në Ministrinë e Financave, me Avokaturën e Shtetit dhe me të gjitha institucionet e tjera shtetërore në vijën e parë të luftës kundër këtij fenomeni që minon demokracinë tonë.

EKSPERIENCA E PËRBASHKËT U SHËRBEN TË GJITHËVE[50]

Botuar në revistën "Monitor", më 8 prill 2012

Intervistë ekskluzive me Kryetarin e KLSH-së, Dr. Bujar Leskaj

Z. Leskaj, u mbushën tre muaj nga koha kur keni marrë detyrën si Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit. Moment i një bilanci të parë, apo jo?

Më 23 dhjetor 2011 ndava me stafin e KLSH vizionin tim për institucionin, në formën e një platformeje, një projekt-ide të cilën e kisha paraqitur përpara Komisionit për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit. Ky projekt është përgatitur mbi bazën e eksperiencave më të mira të organizimit dhe funksionimit të institucioneve të auditimit suprem në vendet e BE-së, në respektimin rigoroz të standardeve ndërkombëtare të kontrollit, si dhe në thellimin e realizimit të misionit të KLSH në luftën kundër korrupsionit dhe abuzimeve në administrimin e pronës dhe financave publike. Në projekt vihet theksi në kthimin e vëmendjes drejt auditimit të performancës, krahas punës me auditimin financiar, në intensifikimin e bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare të fushës INTOSAI dhe EUROSAI, me institucionet e larta të auditimit të BE-së, të vendeve të rajonit dhe në veçanti me Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës. Paraqitet nevoja për një përmirësim të mëtejshëm të transparencës të KLSH në marrëdhëniet me publikun, nëpërmjet një partneriteti të gjerë me median dhe organizatat jo-qeveritare të interesuara për bashkëpunim. Çdo bilanc përpiqem ta shikoj dhe do ta shikoj në këtë këndvështrim.

Ky vit është viti pararendës i 60 vjetorit të themelimit të INTOSAI dhe në këtë vigjilje, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara shpalli më 22 dhjetor 2011 Rezolutën e saj "Për promovimin e efiçiencës, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës së administratës publike, duke fuqizuar institucionet e auditimit suprem", ku në pikën 5 të saj thuhet "Asambleja inkurajon Shtetet Anëtare dhe institucionet përkatëse të Kombeve të Bashkuara që të vazhdojnë dhe të intensifikojnë bashkëpunimin e tyre, duke u përfshirë në ngritjen e kapaciteteve INTOSAI-n, në mënyrë që të promovohet qeverisja e mirë, duke siguruar efiçiencë, përgjegjshmëri, efektivitet dhe transparencë nëpërmjet forcimit të institucioneve përgjegjëse të kontrollit" (Rezoluta A/66/209, faqe 1).

[50] Moto e organizatës botërore të institucioneve supreme të auditimit, INTOSAI

A mund të na jepni shembuj konkretë në lidhje me praktikat e kryera gjatë kësaj periudhe?

Po, po ju jap dy shembuj të praktikave të evaduara në këtë periudhë. Në këta tre muaj të parë, kemi thelluar auditimin e performancës, të vetëdijshëm se ndihma më e çmuar për institucionet shtetërore që auditojmë është t'u japim mundësi të përmirësojnë menaxhimin e tyre. Kështu, gjatë muajit mars 2012 përfunduam materialet e auditimit të ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Hekurudhave Sh.a. Durrës për periudhën dyvjeçare 2009-2011. Zbulimet dhe konkluzionet kryesore të këtij auditimi treguan se keqmenaxhimi dhe keqadministrimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Hekurudhave është pasojë direkte e mosrespektimit dhe moszbatimit të akteve ligjore dhe e rezultateve te dobëta në treguesit ekonomiko -financiarë dhe teknikë. Nga ana tjetër, Drejtoria nuk ka reduktuar stafin për të arritur një nivel të pranueshëm në kostot e operimeve. Nëpërmjet 20 masave organizative që propozuam, kërkuam që Drejtoria e Përgjithshme e Hekurudhave të jetë më reaguese ndaj kërkesave të tregut, për të futur shërbime të përmirësuara midis Tiranës dhe Durrësit, të bëjë studime mbi konservimin e linjave jo rentabile (Fier dhe Vlorë), të përmirësojë sistemet e kontrollit të sinjalizimit për të përmirësuar sigurinë, të bëjë zëvendësimin e parkut të vagonëve, dhe të kombinojë reformat në subjekt me ndërhyrjen e shtetit në drejtimet më imediate, etj..

Në auditimin që përfunduam në shkurt për drejtorinë qendrore të ALUIZNI dhe drejtoritë rajonale Tiranë, Durrës dhe Fier, konstatuam se nga 270 000 aplikime për legalizim, 240 000 prej tyre kishin paguar tarifën e shërbimit, por nga të cilat vetëm 8,712 dosje ose 4 për qind ishin dërguar në Drejtorinë Qendrore të ALUIZNI-t për miratim leje legalizimi dhe për 7,039 prej tyre, ishte kryer ky proces. Ky fakt tregon për një nivel shumë të ulët performance nga drejtuesit dhe punonjësit e Drejtorisë Qendrore dhe Drejtorive Rajonale të këtij institucioni dhe propozuam masa për përmirësimin e menjëhershëm të menaxhimit të ALUIZNI.

Por keni kryer dhe kallëzime penale, apo jo? Në dy muajt e fundit mediat kanë reflektuar njoftime tuajat për kallëzime të shumta penale në kontrollet që keni ushtruar. Po e ashpërsoni dorën?

Gjatë gjithë vitit 2011 institucioni kishte bërë gjithsej 6 kallëzime penale për 13 persona. Në fund të vitit 2011 kryem një studim për nivelin sasior të kallëzimeve penale që KLSH kishte depozituar në organet e prokurorisë për periudhën 2000–2011. Ai tregoi se kishte një rënie të cilësisë së ndërveprimit mes institucioneve dhe shkaqet për rënien e këtij niveli të ndërveprimit duhen kërkuar fillimisht tek mungesa e vullnetit dhe mangësitë në performancën e KLSH, por edhe tek një indiferencë nga ana e organeve të Prokurorisë, e cila ka konsideruar vetëm 10% të rasteve të sjella nga KLSH gjatë viteve 2000-2011. Situata po ndryshon nga ana jonë gjatë këtij viti. Vetëm në këto tre muaj të parë janar-

mars 2012, në Prokurori janë kryer 5 kallëzime penale për shpërdorim detyre për 26 persona në Porti Detar Vlorë Sh.a., në ALUIZNI qendror dhe ALUIZNI Durrës, në komunën Petrelë dhe në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Kallëzimet nuk janë qëllim në vetvete, qëllimi ynë madhor është modernizimi i punës audituese të institucionit, dhënia e rekomandimeve profesionale, rritja e kapaciteteve të stafit të tij. Mirëpo në kushtet e një korrupsioni të pranishëm në administratën tonë shtetërore, kallëzimet shërbejnë për të goditur dhe frenuar këtë fenomen shumë shqetësues dhe të dëmshëm për ekonominë dhe shoqërinë tonë dhe ne do t'i kryejmë sa herë vërejmë veprime korruptive apo të mashtrimit financiar në të gjitha nivelet e institucioneve shtetërore që auditojmë.

Dhe çfarë keni bërë konkretisht për përmirësimin e kapaciteteve?

Krahas punës për të luftuar dhe parandaluar korrupsionin, ne sfidën më të fortë e kemi formimin e kapaciteteve moderne audituese për stafin e KLSH. Gjatë viteve të fundit në institucion nuk ishin kryer rekrutime të stafit me shpallje, me procedura konkurrimi, por ishin punësuar 22 auditues me kontrata të përkohshme pune pa afat ose me afat deri në 31 dhjetor 2011. Të gjithë këta punonjës më datën 28 dhjetor 2011 iu nënshtruan një testimi të aftësive profesionale, për të vlerësuar përshtatshmërinë ose jo të tyre për të vijuar marrëdhëniet e punës me KLSH. Testimi rezultoi në vlerësime të dobëta për 15 prej tyre. Ky fakt flet qartë se rekrutimi jo mbi baza transparence dhe konkurrence prodhon staf cilësisht të dobët, për pasojë dëmton në tërësi punën e institucionit, pasi duke qenë natyra e punës audituese, punë në ekip, mangësitë e këtij stafi rrezikojnë të kompromet ojnë edhe cilësinë e punës së stafit të aftë ekzistues. Duke filluar nga 1 Janari 2012, proçedurat për plotësimin e vendeve të lira janë shpallur rregullisht dhe rekrutimi po realizohet nëpërmjet konkurrimit me anë të testimit të njohurive dhe përzgjedhjes mbi kritere objektive. Mbështetur mbi kërkesat e Rregullores së Brendshme të institucionit, në fund të marsit të këtij viti realizuam testimin e audituesve tanë të nivelit më të lartë (6 kryekontrollorëve dhe 18 kontrollorëve të lartë të KLSH). Katër kryekontrollorë dhe tetë kontrollorë të lartë e kaluan testin, kurse pjesa tjetër zbriti në gradë, në gradën kontrollor i parë. Testimet vjetore për të gjithë stafin do t'i shndërrojmë në një traditë të punës në KLSH. Ruajtja në nivelin e duhur dhe madje freskimi, rritja e dijeve të audituesve tanë do të jetë motoja jonë për këtë vit dhe vitet në vijim, në përputhje me moton e INTOSAI-t(organizatës ndërkombëtare të institucioneve të auditimit publik suprem), "*Experentia mutual ominibus prodest*" (Eksperienca e përbashkët u shërben të gjithëve -Kjo moto profesionale mund të shërbejë si titull i kësaj interviste në këtë revistë të fushës). Për të rritur cilësinë e punës, kemi vendosur të punojmë me dy drejtorë të përgjithshëm, duke shtuar një nga fusha e jurisprudencës, si dhe kemi krijuar Departamentin e Kërkimit Shkencor dhe Zhvillimit dhe Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm dhe Mbikëqyrjes.

Ndërkohë, vitin e kaluar treguesi i trajnimit dhe kualifikimit të personelit prej 2.1 ditë trajnim në vit për punonjës ishte shumë i ulët. Duke konsideruar një lidhje të fortë mes shtimit të kapaciteteve dhe rritjes së vëllimit të trajnimeve të stafit, në mars 2012 kemi nxjerrë një urdhër të brendshëm ku përcaktojmë një limit të poshtëm prej 10 ditësh trajnimi në vit për punonjës me përvojë të KLSH dhe 25 ditësh trajnimi për punonjësit e rinj.

Nga ana tjetër, do të rrisim edhe kapacitetet e audituesve tanë në përdorimin e teknologjisë së informacionit. Kemi programuar për këtë vit trajnime të posaçme për të fituar e zhvilluar aftësitë e ushtrimit të auditimit duke përdorur IT, siç janë trajnimet për njohjen me programin IDEA, i cili përdoret nga institucionet tona homologe në Evropë, si dhe programet "Financa 5", "Alpha" dhe "Oracle", të cilat përdoren nga drejtoritë e tatimeve dhe të doganave të Shtetit.

A ndiheni mirë me kornizën ligjore që keni?

Korniza ligjore është e përshtatshme, por ka nevojë për përmirësim. Amendimi i Ligjit Organik të KLSH është një sfidë me të cilën po përballemi. Në fakt, një draft i përmirësuar ishte përgatitur në konsultim me ekspertët e Gjykatës së Auditimit të Holandës dhe NAO të Britanisë së Madhe që dy vjet më parë, por nuk u paraqit në Kuvend, për arsye subjektive të vetë institucionit. Në këto muaj të parë të 2012-ës kemi intensifikuar punën për plotësimin përfundimtar të draftit. Amendimet janë bërë në përputhje me kërkesat e Marrëveshjes se Stabilizim-Asociimit (Neni 90) dhe me kornizat ligjore të institucioneve supreme të auditimit(SAI) të vendeve të zhvilluara të BE-së. Drafti tashmë u është shpërndarë për konsultim institucioneve ndërkombëtare të kontrollit dhe të Evropës, përfshirë Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit të BE dhe SIGMA.

Fushat kryesore të përmirësimit të Ligjit organik të KLSH janë rregullimi në mënyrë përfundimtare i pavarësisë së institucionit, konceptimi modern i të drejtave dhe detyrave të KLSH, rritja e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të tij, rritja e kapaciteteve administrative, saktësimi i së drejtës së KLSH që të auditojë fondet e akorduara nga BE për Shqipërinë, deri tek përdoruesi i fundit dhe saktësimi i së drejtës që të certifikojë llogaritë financiare. Po shikojmë mundësinë që me këto përmirësime të mund të certifikojmë audituesit e jashtëm (ndoshta dhe në bashkëpunim me Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tiranës dhe me IEKA), ç'ka do ta vendoste këtë veprimtari në një bazament standardi ndërkombëtar. Mendojmë që draftin e amendimeve të Ligjit brenda këtij muaji ta paraqesim në Komisionet e Kuvendit(atë të Ekonomisë dhe Financave dhe atë të Ligjeve) për shqyrtim.

Jeni shprehur se inspektorët e KLSH nuk duhet të luajnë më rolin e gjobëvënësit për institucionet shtetërore që kontrollojnë. Çfarë keni patur parasysh? Çfarë do të realizoni konkretisht?

Sikurse e përmenda dhe më lart, një nga detyrat themelore të qasjes sonë strategjike është thellimi i realizimit të misionit kushtetues të KLSH në parandalimin e korrupsionit dhe abuzimeve në administrimin e pronës publike. Por krahas punës intensive për zbulimin dhe goditjen e korrupsionit në njësitë publike që auditon, institucioni duhet të ruhet dhe të luftojë me vendosmëri dhe ashpërsi maksimale rastet korruptive në radhët e vetë auditorëve të tij. Ia kam bërë të qartë stafit që ditën e parë që kam ardhur. Cilësitë bazë të audituesit janë integriteti moral, ndershmëria në punë, profesionalizmi dhe korrektesa. Në KLSH nuk ka vend për kontrollorë që kanë luajtur apo do të provojnë të luajnë rolin e gjobëvënësit në institucionin që kanë audituar, po vijojnë auditimin apo do ta fillojnë atë. Ndërkohë, duke krijuar një ambient mbytës, antibiotik për gjobëvënësit, ne jemi të përqendruar të luftojmë korrupsionin në çdo rast dhe nivel që ai do të paraqitet apo zbulohet. Këto ditë do të dërgojmë një pyetësor në një rreth të gjerë subjektesh të audituara, gazetarësh, analistësh dhe pedagogësh, për të ekzaminuar më qartë këtë dhe probleme të tjera të profilit në publik të KLSH, dhe veçanërisht të audituesve të tij.

Faktor potent për sinergjizimin e përpjekjeve tona për parandalimin e korrupsionit, ndëshkimin e tij apo për propozimet për përmirësime aktesh ligjore e nënligjore përbën dhe Strategjia Ndërsektoriale e Qeverisë Berisha e "Parandalimit, Luftës kundër Korrupsionit dhe e Qeverisjes Transparente 2008-2013". Kemi kërkuar me intensitet këto muaj ndërlidhje veprimesh me institucionet e tjera që luftojnë korrupsionin. Në shkurt lidhëm marrëveshje bashkëpunimi me ILDKP dhe në mars me Autoritetin e Konkurrencës, për të përftuar nga këto institucione eksperienca me vlerë në parandalimin e konfliktit të interesit dhe abuzimet me tenderat shtetërore, por duke i ndihmuar edhe ato me materialet tona, në realizimin e funksioneve të tyre luftuese dhe parandaluese të korrupsionit. Po punojmë për bashkëpunim konkret me Prokurorinë e Përgjithshme, me Drejtorinë Antikorrupsion pranë Kryeministrisë, me Avokaturën e Shtetit dhe me të gjitha institucionet e tjera shtetërore që luftojnë korrupsionin. Jemi në përfundim të bisedimeve për një bashkëpunim të ngushtë institucional me Ministrinë e Financave, konkretisht me Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm dhe me Drejtorinë e Inspektimit Financiar. Po zhvillojmë gjithashtu kontaktet me organizatat më aktive të shoqërisë civile kundër korrupsionit, për të koordinuar punën me to.

Z. Leskaj, kur ishit deputet i maxhorancës keni theksuar disa herë rëndësinë e kontrollit edhe ndaj sh.a-ve, duke patur parasysh CEZ, ARMO, etj, ku pavarësisht se shteti është në minorancë aksionesh, duhet të jenë në optikën e inspektimit nga ana e KLSH.

Në bazë të nenit 163 të Kushtetutës, ne auditojmë veprimtarinë ekonomike të njësive ku Shteti ka më shumë se gjysmën e aksioneve. Megjithatë, në optikën e auditimit nga ana jonë janë institucionet qendrore që i mbikëqyrin interesat e Shtetit në njësitë ku ai ka minorancë aksionesh. Konkretisht, ne auditojmë ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës për mbikëqyrjen e kompanive të tilla si ato që ju përmendni në pyetjen tuaj dhe këtë auditim do ta kryejmë me të gjithë vëmendjen dhe profesionalizmin që kërkon mbrojtja e interesave publike dhe në entet ku Shteti është në minorancë aksionesh, sidomos në ato që ofrojnë shërbime utilitare për qytetarët.

Bashkë me auditin e brendshëm është shtuar së fundmi edhe inspektimi financiar, në varësi të Ministrit të Financave. Mos ju duket se po shtohen rastet e mbivendosjes së kontrolleve dhe një dublim të punës së KLSH?

Jo aspak, nuk mendoj se rrezikohet dublimi i punës së KLSH. Kuvendi i Shqipërisë në Rezolutën e tij të 2 qershorit 2011 i ka kërkuar KLSH-së harmonizimin e veprimtarisë audituese të kontrollit të jashtëm me atë të brendshëm dhe rritjen e rolit mbikëqyrës ndaj strukturave të auditimit të brendshëm. Mbikëqyrjen e auditimit të brendshëm ne e kemi detyrë ligjore, është në ligjin tonë organik. Krahas Njësisë Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm, Njësisë Qendrore të Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, kemi vendosur marrëdhënie bashkëpunimi dhe me Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave, me Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme; kohët e fundit dhe me Drejtorinë e Inspektimit Financiar Publik. Ne po punojmë që shkëmbimi i informacionit mes palëve në këto marrëveshje të njohë vijimësi, ngaqë rreziku i mbivendosjes në auditime duhet minimizuar. KLSH vlerëson shumë pozitivisht punën e këtyre njësive profesionale dhe shpreson që në të ardhmen e afërt bashkëpunimi me to të jetë sa më konkret, në të mirë të rritjes së efiçiencës së auditimit të brendshëm. Kemi rënë dakord për bashkëpunime profesionale, duke mos cenuar pavarësinë e institucioneve tona dhe standardet e auditimit. Bashkëpunimi me Ministrinë e Financave nënshkruhet në këtë periudhë dhe specialistët e të dyja institucioneve e përgatitën me profesionalizëm, duke respektuar standardet dhe normat për të dyja institucionet, gjë që me jep rast të falënderoj Ministrin Bode.

Në kohë krizash financiare dhe ekonomike si kjo e sotmja, mbajtja e një disipline të rreptë buxhetore përbën përparësi. E shihni ju këtë si një sfidë tuajën, duke qenë se ju e keni detyrë kushtetuese kontrollin e realizimit faktik të Buxhetit të Shtetit?

Me Ligjin tonë organik, ne japim mendime për raportin e Këshillit të Ministrave për shpenzimet e vitit të kaluar financiar, përpara se sa ai të miratohet në Kuvend. Struktura e raportit që KLSH paraqet në Kuvend në përgjigje të detyrimit ligjor përmban vlerësim dhe opinion për raportin vjetor te konsoliduar të zbatimit të buxhetit. Në pjesën e tretë të këtij raporti, ne japim rekomandime për përmirësimin dhe menaxhimin efektiv të fondeve shtetërore. Dua ta theksoj se hapja e institucionit ndaj praktikave më të mira ndërkombëtare të auditimit të jashtëm, të përditësuara në çdo kongres të fundit të INTOSAI dhe respektimi i orientimeve të MSA të Shqipërisë me Bashkimin Evropian është detyrë dhe sfidë për KLSH-në. Kjo bëhet akoma dhe më e rëndësishme për fatet e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm të vendit, sidomos në ditët tona të përjetimit të krizës në Eurozonë, kur disiplina buxhetore dhe financiare e administrimit publik është bërë përparësi absolute për përballimin e pasojave të kësaj krize. Konstatoj se është bërë një punë serioze në mbajtjen nën kontroll të treguesve kryesorë makroekonomikë të Buxhetit të Shtetit, si borxhi publik i cili për vitin e kaluar qëndroi nën kufirin e 60 përqind të Prodhimit të Brendshëm bruto të vendit, deficiti buxhetor, i cili u mbyll në nivelin 3 përqind të këtij Prodhimi dhe inflacioni brenda kufijve 2-4 përqind të objektivave të Bankës së Shqipërisë. Në këtë periudhë që kalojmë, problem të mprehtë për ekonominë kemi inflacionin tejet mase të ulët dhe gjykoj se ndoshta mund të rishikohen disa politika brenda realizimit të Buxhetit të Shtetit të këtij viti, për të nxitur më shumë investimet publike dhe konsumin në vend.

Si struktura më e lartë e auditimit të jashtëm në sektorin publik, KLSH luan një rol të rëndësishëm në forcimin e disiplinës financiare të strukturave publike dhe për këtë vit kemi parashikuar të përfshijmë në programin e auditimit një drejtim të veçantë auditimi *"Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit"*. Në kuadër të bashkëpunimit me Njësinë Qendrore të Harmonizimit në Ministrinë e Financave, do të ndërmarrim një cikël trajnimesh të audituesve në përgjithësi dhe në veçanti, të audituesve që do të kryejnë kontrolle dhe specializohen për këtë fushë auditimi, duke kërkuar asistencë dhe financim edhe nga organizmat ndërkombëtare.

Sa i kursen KLSH fonde ekonomisë shqiptare në një vit?

Nga të dhënat statistikore të punës së deritanishme, për çdo një lek të investuar nga Buxheti i Shtetit në KLSH, ne kryejmë 28 lekë zbulime dëmi ekonomik dhe rekomandojmë shpërblimin e këtij demi në masën 100 përqind. Shprehur në shifra absolute, raporti ndërmjet vlerës së dëmeve ekonomike të konstatuara dhe evidentuara

gjatë vitit 2011, si dhe të kërkuar për shpërblimin e dëmit në shumën 7,027 milionë lekë dhe vlerës të raportuar me situacionin përfundimtar të shpenzimeve të KLSH për po këtë vit në shumën 253 milionë lekë tregon për shkallën e efektivitetit të veprimtarisë audituese të institucionit. Nga vlera e dëmit prej mbi 7 miliardë lekë, peshën dërmuese me rreth 83.4% e zënë dëmet e evidentuara në dy shoqëri anonime, përkatësisht Albpetrol sh.a. Fier në vlerën 3,936,800 mijë lekë (shkaktuar nga moslikujdimi i detyrimeve prej 3,578,690 mijë lekë të rrjedhura nga furnizimi me naftë bruto, gaz natyror dhe hollues deri më datë 31.12.2010 nga kompania ARMO sh.a (ARMO Oil) dhe 358,110 mijë lekë nga moslikujdimi në afat i faturave të shitjes së naftës po nga kjo kompani) dhe Operatori i Sistemit të Transmetimit të Energjisë Tiranë në vlerën 1,924,209 mijë lekë (moslikujdim i shërbimit të kryer për transmetimin e energjisë elektrike për periudhën nga privatizimi i OSSH deri më 15.12.2010). Vlera e shkeljeve financiare me dëm ekonomik në sektorin doganor ishte 184,1 milionë lekë, ndërsa në sistemin e tatimeve dhe taksave 49 milionë lekë. Gjatë vitit të kaluar, përqindja e realizimit të masave të propozuara nga KLSH për shpërblimin e dëmit ekonomik ka qenë shumë e ulët (nga vlera e përgjithshme e dëmit ekonomik, deri në fund të 2011 ishin nxjerrë urdhrat përkatës për shpërblimin e dëmit dhe ishin në proces arkëtimi vetëm 667 milionë lekë, ose në masën 9.5 perqind të vlerës gjithsej të rekomanduar për shpërblim dëmi), ndaj jemi të vendosur të ndjekim realizimin e propozimeve tona deri në fund, duke kryer edhe ri-auditime, po të jetë e nevojshme.

Si e shikoni bashkëpunimin me homologët tuaj? Si keni ecur në këtë drejtim?

Një nga pikat kryesore në platformën, projekt-idenë që parashtrova në Komisionin për Ekonominë dhe Financat në Kuvend e përbënte intensifikimi i bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare të auditimit si INTOSAI dhe EUROSAI, me institucionet e larta të kontrollit të BE-së, si SIGMA dhe Gjykata Europiane e Audituesve, me institucionet homologe të vendeve të BE dhe të rajonit, dhe në veçanti me Zyrën e Audituesit të Përgjithshëm të Kosovës. Bashkëpunimi nuk është qëllim në vetvete, por na ndihmon të marrim praktikat më të mira të këtyre institucioneve në parandalimin e mashtrimit financiar dhe të keqmenaxhimit të projekteve dhe fondeve publike. Kemi shumë besim në këtë bashkëpunim dhe sfida jonë për vitet në vijim do të jetë partneriteti me Delegacionin e BE në Tiranë (edhe pse për këtë vit nuk arrijmë dot të përfitojmë programet IPA, për shkak të mungesës së aplikimeve tona gjatë vitit 2011), me Gjykatën Evropiane të Audituesve dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit të KE në Bruksel. Do të synojmë të marrim pjesë në programet e kontrollit të Gjykatës Evropiane të Audituesve për vendet që aspirojnë për në BE dhe që përfitojnë nga programet e asistencës së BE-së, përfshirë vendin tonë. Për thellimin e dijeve në auditimin e performancës, do të vazhdojmë partneritetin me institucione homologe që

na kanë ndihmuar në të kaluarën, si Zyra Kombëtare e Auditimit e Britanisë së Madhe, të cilën ju e përmendni ne pyetjen tuaj, apo Gjykata Holandeze e Auditimit.

Ne si KLSH jemi futur në procesin vullnetar të rishikimit mes kolegëve (Peer Review) në komunitetin e drejtuesve të SAI-ve evropiane në EUROSAI dhe presim asistencë nga Komiteti përkatës i EUROSAI. Rëndësi të veçantë po i kushtojmë marrëdhënieve të bashkëpunimit me SIGMA, në mënyrë që të asistohemi nga kjo organizatë për të siguruar trajnimet aq shumë të nevojshme për stafin e KLSH që këtë vit. U kemi dërguar kërkesat tona konkrete për asistencë teknike dhe jemi në pritje të reagimit të tyre. Kemi ftuar për bashkëpunim Zyrën e Bankës Botërore në Shqipëri dhe kemi marrë interesimin e saj për të hulumtuar mundësitë e një programi të gjerë asistence nëpërmjet një grandi nga ana e Bankës. Po ashtu, kemi marrë një përgjigje të parë pozitive edhe prej SAI-t suedez për mundësi projekti partneriteti me të. Do t'i kushtojmë gjatë këtij viti e më tej rëndësinë e duhur bashkëpunimit me Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës, me të cilin nënshkruam një marrëveshje bashkëpunimi në shkurt te këtij viti. Kjo marrëveshje parashikon vizita të ndërsjellta dhe trajnime, ku KLSH mund të përfitojë nga kontributi cilësor që kjo Zyrë e Kosovës ka marrë nga drejtimi i saj prej një autoriteti të njohur të komunitetit ndërkombëtar të auditimit të jashtëm publik, zotit Lars Lage Olofsson. Të dyja institucionet e auditimit të lartë kanë vendosur të unifikojnë terminologjinë e auditimit në gjuhën shqipe.

Po ashtu, sikurse shprehet z. Terence Nombembe, kryetar i Bordit Drejtues të INTOSAI-t dhe Auditor i Përgjithshëm i Afrikës së Jugut, *"Ne do ta forcojmë pavarësinë tonë me një armë që askush s'do guxonte të na e merrte: diturinë mbi auditimin, që na pajis me ide ose mendime të pavarura dhe analizë*". Gjykoj se sa më shumë të thellohemi në shkencën e auditimit të jashtëm publik, sa më tepër të përdorim metodat moderne të auditimit, të përftojmë praktikat më të mira dhe standardet e përditësuara të INTOSAI, aq më efektive do të jenë propozimet tona për masa dhe rekomandimet për përmirësimin e performancës së njësive shtetërore që auditojmë. Prej këtej, vlera e punës sonë do të matet jo vetëm me dëmin ekonomik të konstatuar, për të cilin rekomandojmë shpërblim të tij (sikurse në sytë e publikut del sot), por edhe me shkallën e uljes së nivelit të korrupsionit dhe kryesorja, të përmirësimit të drejtimit dhe performancës së institucioneve kryesore shtetërore që u shërbejnë qytetarëve në ekonomi, shëndetësi, arsim e kudo. Vetëm kur këto sfida, këto drejtime të punës sonë të plotësohen dukshëm, mund të masim me plotësi sasinë e kontributit real që KLSH jep në ekonominë e vendit.

Një pyetje të fundit, a e ndjeni se jo vetëm media, por edhe publiku po ju ndjek më me vëmendje kohët e fundit?

KLSH nuk mund ta kryejë si duhet detyrën e saj për të informuar pa përmirësimin e transparencës në marrëdhëniet me publikun, nëpërmjet një partneriteti të gjerë me çdo qytetar, me median dhe me organizatat jo-fitimprurëse të interesuara. për bashkëpunim. Me kënaqësi pohoj se organet e medias na kanë mbështetur në punën tonë dhe dua t'i falënderoj të gjitha ato. Për t'i dhënë një impuls, përmbajtje dhe formë krejtësisht të re këtyre marrëdhënieve, në veçanti përgjigjes ndaj publikut, brenda progamit të 100 ditëve të para kemi miratuar *një udhëzues të veçantë për mënyrën e administrimit të kërkesë/ankesave të publikut,* që nga momenti i mbërritjes së tyre dhe deri në dhënien e zgjidhjeve të mundshme brenda kuadrit ligjor në fuqi dhe burimeve njerëzore që disponon institucioni. Ne do të na udhëheqë në punën tonë si auditues motoja e të madhit Mit'hat Frashëri dhënë në Dekalogun e përgatitur në vitet tridhjetë të shekullit të kaluar: "Në punë kijeni për lavdi të jeni shërbestarë", pra shërbestarë të interesave të publikut.

Gjate këtij viti synojmë rritjen e impaktit në komunikim, njoftime tërësisht transparente, shpërndarjen sa më gjerë e raporteve të veprimtarisë kontrolluese, si dhe forcimin e kontakteve me të gjithë aktorët dhe faktorët mediatike të vendit tonë. Sikurse e keni vene re edhe ju, media e shkruar gjate vitit 2011 kishte prodhuar gjithsej në faqet e saj 280 artikuj, editoriale si dhe komente analitike, ndërsa media audiovizive kishte transmetuar 100 sekuenca filmike, edicione informative, apo kronika të ndryshme televizive për KLSH. Ndërkohë që për periudhën 11 janar-27 mars 2012 vetëm artikuj, editorialë dhe komente analitike në median e shkruar janë 141, ndërsa kronika televizive janë 62. Synimi është përcjellja sa më e shpejtë dhe me vërtetësi e të gjithë veprimtarisë audituese të KLSH tek publiku i gjerë, duke shërbyer si një mjet efikas denoncimi dhe parandalimi të korrupsionit, si dhe tregues i performancës sonë drejt zhvillimit të KLSH si një SAI modern.

Ju faleminderit!

KLSH DREJT STANDARDEVE TË INTOSAI-t

Shkrimi është botuar në Gazetën "Ekonomia", më 21nëntor 2012

Kontrolli i Lartë i Shtetit, shumë shpejt do t'i paraqesë Kuvendit amendimet e përgatitura për ligjin e tij organik. Përmirësimet ligjore në të janë vështruar nën prizmin e objektivave të Planit Strategjik të Zhvillimit të EUROSAI 2013-2017, që janë ndërtimi i kapaciteteve, sigurimi i standardeve profesionale, shkëmbim eksperience dhe mirëqeverisje përmes komunikimit. KLSH, ky institucion jetik për ruajtjen e interesave të pronës publike dhe qytetarit si taksapagues, e ka të domosdoshme shkëputjen përfundimtare nga tipi i punës kontroll-revizion, për të funksionuar si audituesi i plotë, në bazë të orientimeve të standardeve INTOSAI. Ky audituesi duhet të kërkojë Ekonomicitetin, Efiçiencën dhe Efektivitetin e përdorimit të fondeve publike. Sfidat themelore të KLSH, si institucioni më i lartë i auditimit në vend dhe anëtar i INTOSAI dhe EUROSAI janë dy: modernizimi i institucionit, duke zbatuar tërësisht standardet ndërkombëtare të auditimit INTOSAI dhe thellimi i luftës kundër korrupsionit dhe për parandalimin e tij, duke realizuar kërkesat e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit, Nenit 90-të të saj, si dhe duke respektuar sensibilitetin popullor.

Në Shqipëri, auditimi i jashtëm publik përfaqësohet nga KLSH dhe është një përbërës i rëndësishëm i një sistemi rregullator në të cilin rol po ashtu të rëndësishëm luan edhe auditimi i brendshëm. KLSH po zhvillon përpjekjet e tij si institucion për të arritur ndarjen më të përshtatshme të detyrave dhe bashkëpunimin intensiv mes një institucioni të auditimit më të lartë (SAI) dhe auditimit të brendshëm, sipas standardit ISSAI 9150. Në maj 2012, institucioni lidhi një marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Financave, për koordinim pune me Njësinë Qendrore të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm dhe me Drejtorinë e Inspektimit Financiar Publik në këtë ministri. Marrëveshja parashikon komunikimin e ndërjselltë të planeve dhe strategjive të auditimit, dokumentimin e proceseve operacionale dhe sistemeve të enteve të audituara, zhvillimin dhe kryerjen e procedurave të koordinuara të auditimit; si dhe investigimin e përbashkët të rasteve të dyshuara si mashtrim financiar apo korrupsion.

Objektivat e auditimit

Objektivat kryesore të auditimit të KLSH, sikurse theksohet dhe në Deklaratën e Limës, e quajtur ndryshe Kushtetuta e institucioneve më të larta të auditimit të jashtëm publik, ose ISSAI 1, janë përdorimi i duhur dhe efektiv i fondeve publike, zhvillimi i menaxhimit të shëndoshë financiar, ekzekutimi i duhur i aktiviteteve administrative, si dhe komunikimi i informacionit nëpërmjet publikimit të raporteve tek autoritetet dhe publiku i gjerë. Sipas Rezolutës së Kombeve të Bashkuara të 22 dhjetorit 2011 për institucionet e auditimit më të lartë, pika 2, "Kombet e Bashkuara njohin rolin e rëndësishëm të institucioneve supreme të auditimit në promovimin e efektivitetit,

përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës së administratës publike, gjë që është e domosdoshme për arritjen e objektivave dhe prioriteteve të zhvillimit kombëtar, si dhe të qëllimeve të zhvillimit të pranuara ndërkombëtarisht, duke përfshirë Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit". Këto objektiva auditimi: ligjshmëria, rregullshmëria, ekonomiciteti, eficienca dhe efektiviteti i menaxhimit publik financiar kanë rëndësi të barabartë, sipas nenit 4 të Deklaratës së Limës. Realizimi i këtyre objektivave për KLSH-në nuk mund të realizohet pa mbështetjen e një kuadri modern ligjor.

Ligji i tanishëm i vitit 1997, i amenduar në vitin 2000 ka nevojë për përmirësime të ndjeshme. Amendimet e tij duhet të:

1. Reflektojnë praktikën e legjislacionit të institucioneve homologe në Evropë, si dhe propozimet e DG-Budget dhe SIGMA.
2. Përcaktojnë më qartë rolin, të drejtat, kompetencat dhe detyrimet e KLSH në raport me institucionet e tjera.
3. Theksojnë pavarësinë financiare dhe ekonomike të institucionit.
4. Përcaktojnë më saktë dhe në mënyrë më të plotë fushat e auditimit të Performancës, të Teknologjisë së Informacionit, si dhe të auditimit të fondeve të BE-së.
5. Përcaktojnë më saktë standardet INTOSAI dhe rolin e tyre në auditim.
6. Dhe të certifikojnë audituesit e KLSH.

Për ti diskutuar sa më gjerë dhe me profesionalizëm këto mendime, institucioni organizoi në fillim të nëntorit një sërë tryezash pine me ekspertë ligjorë, juristë, dhe pedagogë të Fakultetit të Drejtësisë, me kontabilistë dhe akademikë nga fusha e financave publike dhe ekspertë të njohur të auditimit, me përfaqësues nga shoqëria civile dhe OJF-të, si dhe me gazetarë dhe përfaqësues të medias. Drejtori i Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Publik Financiar në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit (DG-Budget) Të komisionit Evropian, z. Robert Gielisse ishte i pranishëm në këto tryeza. Çështjet e trajtuara nga amendimet u konsideruan nga ana e pjesëmarrësve si shumë të rëndësishme për forcimin e mëtejshëm të pavarësisë së KLSH dhe modernizimin e tij në përputhje me kërkesat e standardet e INTOSAI-t.

Sfidat madhore të KLSH

Gjatë këtij viti dhe në vijim, KLSH është përqendruar tërësisht në dy sfidat e tij madhore, modernizimi i institucionit duke zbatuar konkretisht dhe me intensitet standardet e INTOSAI-t, si dhe thellimi i luftës kundër korrupsionit dhe për parandalimin e tij. Këto drejtime, krahas të tjerave (për KLSH-në), janë edhe rekomandimet e Progres Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë të viteve 2009, 2010, 2011 dhe 2012, të cilat theksojnë nevojën e mendimeve për ligjin organik të KLSH. Kështu, Progres Raporti i vitit 2010 nënvizon: "Edhe pse ligji aktual për

Kontrollin e Lartë të Shtetit mbulon objektivat, detyrat, organizimin dhe kompetencat e institucionit, kërkohen ndryshime në ligj. Në vitin 2009 KLSH ka hartuar propozime konkrete për ndryshimin e ligjit". (Progres Raporti 2010, faqe 56). Për arsye subjektive, këto mendime nuk u paraqitën në Kuvend nga KLSH në vitet 2010-2011. Ndërsa Progres Raporti për vitin 2012 cilëson: "Ka pasur progres në fushën e auditimit të jashtëm. Pas disa viteve ngecje, projekt-ndryshimet në Ligjin për KLSH për ta sjellë atë në përputhje të plotë me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) janë përgatitur dhe janë dorëzuar në procedurë të miratimit". Në konkluzionet e po këtij Raporti theksohet: "Përpjeke të konsiderueshme janë ende të nevojshme për të adresuar mangësitë ekzistuese në sjelljen e auditimit të jashtëm në nivel të standardeve të INTOSAI-t". Përmirësimi i ligjit të KLSH-së, si mjet për të realizuar sfidat e institucionit, është rekomanduar me forcë edhe në përfundimet e Nënkomitetit BE-Shqipëri për Çështjet Ekonomike dhe Financiare të datës 26 tetor 2012, ku shprehimisht nënvizohet: "Komisioni Evropian mirëpriti projektligjin e KLSH-së, i cili është në përputhje me standardet e aplikueshme ndërkombëtare. DG Budget do të japë këshillat teknike të kërkuara në fillim të nëntorit, për të ndihmuar KLSH-në në përfundimin e procesit të rishikimit, në mënyrë që diskutimet parlamentare të projektligjit të fillojnë nga fundi i nëntorit. Shqipëria do të raportojë për zhvillimet në lidhje me miratimin e ligjit të KLSH-së nga Parlamenti, ku një shumicë prej 3/5 është e nevojshme për miratimin e ligjit. Komisioni theksoi nevojën për rritjen e zbatimit të masave të propozuara nga ana e KLSH-së dhe nevojën për përmirësimin cilësor në përgatitjen e dosjeve dërguar Prokurorisë. Komisioni gjithashtu vuri në dukje nevojën për KLSH-në, për investime në pajisje të Teknologjisë së Informacionit dhe për trajnimin e audituesve".

Ndërtimi i kapaciteteve në KLSH

Ndërtimi i kapaciteteve është sfida më madhore e institucionit. KLSH ka dërguar audituesi për trajnim jashtë shtetit në periudhën janar-tetor 2012 sa kanë shkuar nga KLSH për krejt periudhën 7 vjeçare 2004-2011. Në raport vetëm me vitin 2011, është gjashtëfishuar numri i ditëve trajnim për çdo audituesi, duke arritur tashmë nivelet e institucioneve homologe, me 10-15 ditë trajnimi për audituesi në vit. Kapacitetet profesionale nuk mund të nderohen pa një bashkëpunim dhe shkëmbim profesional eksperiencash mes homologëve. Në zbatim të orientimeve të Nenit 15 të Deklaratës së Limës, Kushtetutës së Institucioneve supreme të auditimit publik, si dhe të drejtimit të dytë dhe të tretë të Strategjisë së EUROSAI 2011-2017 për standardet profesionale dhe shkëmbimin e eksperiencave, KLSH ka iniciuar dhe lidhur marrëveshje bashkëpunimi, shkëmbimi të ndërsjelltë eksperience dhe trajnimi me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Polonisë (NIK), me Gjykatën e Auditimit të Sllovenisë, me Zyrën e Audituesit të Përgjithshëm të Kosovës, si dhe më datën 17 nëntor nënshkroi marrëveshjen me

Gjykatën e Llogarive të Turqisë. Më datën 27 nëntor, KLSH do të nënshkruajë në Vlorë marrëveshjen e bashkëpunimit me Zyrën Shtetërore të Auditimit të Kroacisë. Përmes këtyre marrëveshjeve, institucioni ka mundur të dërgojë për trajnim vetëm për auditimin e performancës në Varshave dhe Ljubjanë mbi 30 auditues, ndërkohë që 14 të tjerë do të trajnohen për auditimin financiar po në Varshave në fund të këtij muaji dhe në javën e tretë të dhjetorit një grup prej 15 audituesish do të trajnohet në Ankara të Turqisë. Në tërësi, numri i të trajnuarve jashtë shtetit shkon deri tani rreth 70 auditues për këtë vit.

Luta kundër korrupsionit, përparësia tjetër madhore e KLSH

Në drejtimin tjetër kryesor strategjik të KLSH për thellimin e luftës kundër korrupsionit dhe për parandalimin e tij, institucioni ka gjetur rezonancë të plotë dhe sinergji me Strategjinë Ndërsektoriale të Qeverisë Berisha për "Parandalimin, Luftën kundër Korrupsionit dhe Qeverisjen Transparente 2008-2013". Referuar kësaj Strategjie, një orientim i saj thelbësor është: "Shkëmbimi i informacionit duhet të realizohet jo vetëm ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit, por të çdo organi shtetëror që luan rol dhe ka përgjegjësi në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, i cili synon shkëmbimin e informacionit jo si pjesë e detyrimit dhe përgjegjësisë ligjore e institucionale të zakonshme, por mbi baza funksionale, proaktive dhe me periodicitet më të shpejtë" (faqe 22, paragrafi 3-të, Strategjia Ndërsektoriale). Në këtë drejtim, KLSH ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi e shkëmbimi intensiv informacionesh me Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, me Autoritetin Shqiptar të Konkurrencës, me Prokurorinë e Përgjithshme dhe me gjashtë nga organizatat më aktive të shoqërisë civile në luftën kundër korrupsionit dhe për rritjen e transparencës së administrimit publik. Kallëzimi penal nuk është qëllim në vetvete për institucionin, por në kushtet e një anti-kulture të pandëshkueshmërisë në Shqipëri për nëpunësit e mesëm dhe të lartë të Shtetit, duke patur parasysh orientimin e thellimit të luftës kundër korrupsionit, për rastet e abuzimit ekstrem me pronën shtetërore dhe me interesat e taksapaguesve shqiptar, gjatë periudhës janar-tetor 2012 KLSH ka kryer 31 kallëzime penale, ose një numër një herë e gjysmë më shumë me ato të kryera gjatë tre viteve të fundit së bashku, nga institucioni.

KLSH vlerëson orientimin që dha Sekretarja e Shtetit e SHBA-ve, zonja Hillary Clinton në fjalën e saj përpara Kuvendit të Shqipërisë: "Ju nxis të përballeni me problemin që ndikon aq shumë demokracinë në botë sot, dhe pikërisht korrupsioni. Kjo është një luftë që çdo vend duhet ta kryejë dhe të fitojë dhe të fitojë sepse në mbarë botën korrupsioni është një kancer që gërryen shoqëritë. Shteron burimet, bllokon rritjen ekonomike, është mburojë për udhëheqës të paaftë dhe jo-etikë, dhe ndoshta më e keqja, krijon një kulturë pandëshkueshmërie që ju gërryen njerëzve vullnetin për të përmirësuar jetët dhe komunitetet e tyre. Për këtë nuk ka përgjigje të lehtë. Është po aq i

vjetër sa natyra njerëzore. Jam e sigurte që nëse do të kishte një përgjigje të lehtë, bota do ta kishte zgjidhur këtë problem kohë më parë. Çrrënjosja e korrupsionit kërkon përpjekje të pandalshme dhe një përkushtim të përbashkët".

KLSH po synon pikërisht këtë përpjekje të përbashkët, punën në sistem më institucionet e tjera të pavarura dhe qeveritare, por edhe me shoqëritë civile, për ta parandaluar korrupsionin dhe për ta luftuar me efektivitet atë dhe është kryesorja të jetë gjenerator i luftës kundër anti-kulturës së pandëshkueshmërisë. Institucioni do të vijojë edhe më intensivisht bashkëpunimin e nisur këtë vit me Prokurorinë e Përgjithshme , në mënyrë që ashtu si Komisioni Europian e rekomandon, cilësia e dosjeve anti-korrupsion të KLSH të rritet dhe elementët korruptues dhe abuzues në administratën publike të ndiqen penalisht.

Gjithashtu, Urdhri Nr. 70 datë 18.04.2006 i Kryeministrit "Për masat në zbatim të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Auditit të Brendshëm dhe Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Administrativ e Antikorrupsionit në Këshillin e Ministrave, ne institucionet në varësi të Kryeministrit dhe Ministrive" është një shtyllë e fortë në punën e KLSH në respektimin dhe realizimin e rekomandimeve të tij. Institucioni ka përmirësuar strukturës e auditimeve të performancës, duke rritur ndjeshëm numrin e tyre për këtë vit.

Kolona e botimeve KLSH

Në zbatim të orientimit strategjik të EUROSAI për mirëqeverisjen dhe komunikim, si dhe të ISSAI 20, Parimi 8. KLSH ka publikuar librat "KLSH Analiza Vjetore 2011", "KLSH në Kuvend 2011", "KLSH Analiza Gjashtëmujore Janar-Qershor 2012", si dhe numrin e parë të revistës së tij shkencore katërmujore "Auditimi Publik". Numri i dytë i revistës është në përfundim e sipër, për t'u shpërndarë me rastin e 100 Vjetorit të Pavarësisë. Revista po realizohet në bashkëpunim me akademik të njohur të fushës, me lëvrues të shkencës së financave publike dhe jurisprudencës në vendin tonë dhe me ekspertë të auditimit në institucione qendrore publike, si Prof. Dr. Omer Stringa, Prof. Dr. Jorgji Bollani, Prof. Dr. Ardian Nuri, Prof. Dr. Sotiraq Dhamo, Prof. Dr. Aurela Anastasi, Prof. Dr. argita Berisha, Prof. Dr. Lindita Lati, Prof. Dr. Tonin Kola, Prof. Asoc. Dr. Edlira Luçi, Prof. Asoc. Dr. CPA Hysen Çela, Prof. Asc. Dr. flutura kola, Prof. Asc. Dr. Manjola Naço dhe Gjon Ndreja. Krahas personaliteteve shqiptare, në Bordin e revistës do të kontribuojnë në të ardhmen si anëtarë personalitete të tila të huaja si Dr. Igol Shotles, President i Gjykatës së Auditimit të Sllovenisë, Prof. Dr. Heinz-Dieter Wenzel, profesor i shquar i financave publike pranë Universitetit të Bambergut, Gjermani dhe Prof. Dr. Iraj Hashi, Drejtor i Qendrës për Kërkim mbi Ekonominë në Ngritje, pranë Shkollës së Biznesit në universitetin Staffordshire në Britaninë e Madhe.

Revista përbën një forum të mendimit më të përparuar akademik dhe shkencor të vendit në auditimin publik, por edhe një arenë të debatit të shëndetshëm profesional për zgjedhjet e strukturave drejtuese dhe përqasjet e auditimeve të brendshme dhe të jashtme që kryhen në auditimin publik shqiptar. Ajo promovon auditimin e performancës, të integritetit dhe të pajtueshmërisë, që konsiderohen si ndër më të rëndësishmet sot në botë në auditimin publik. Krahas eksperiencave nga vendi , revista shërben edhe si burim informacioni dhe platformë e ideve dhe praktikave të reja të auditimit më të lartë, që lançojnë periodikisht organizata si INTOSAI dhe EUROSAI, por edhe SAI të veçanta që ndodhen në pararojë të mendimit shkencor. Nga ana tjetër, bashkëpunimi në veçanti me Profesoriatin e Fakultetit të Drejtësisë dhe të Fakultetit të Ekonomisë së Universitetit Shtetëror të Tiranës, si dhe me Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit dhe me IEKA i jep besim KLSH se revista do ta realizojë tërësisht misionin për të cilin është krijuar.

KLSH drejt standardeve ndërkombëtare të fushës

Zhvillimet e mësipërme dhe shumë të tjera në KLSH sot e kanë domosdoshmëri që të mbështeten nga një kuadër ligjor modern, i bazuar tërësisht në kërkesat e standardeve INTOSAI. Ligji organik aktual i KLSH i vitit 1997, i ndryshuar në vitin 2000 ka realisht nevojë për përmirësim, edhe në kushtet kur sipas përcaktimit nga Përmbledhja e Sistemeve të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në shtetet anëtare të BE-së. "Po jetojmë në një kohë kur në Evropë mbizotëron një presion i konsiderueshëm në financat publike, në të gjitha nivelet.

Më shumë së kurrë, autoritetet publike pritet të sigurojnë që burimet e përbashkëta janë shpenzuar në mënyrë efikase dhe arrijnë synimet e nevojshme". Kjo përbën një sfidë edhe për KLSH. Sfidë e pranuar nga institucionet dhe që do të realizohet risitë që sjellin amendimet e propozuara prej tij.

Së pari, amendimet e ligjit të KLSH reflektojnë praktikën më të mirë të legjislacionit të institucioneve homologe në Evropë, si dhe të gjitha komentet, propozimet dhe sugjerimet e DG-Budget dhe SIGMA. Gjatë gjithë kësaj periudhe, konsultimi me partnerët tanë ndërkombëtar ka qenë intensiv dhe i pandërprerë, jo vetëm duke marrë sugjerimet e tyre, por edhe duke u përcjellë atyre të gjitha komentet dhe sugjerimet e aktorëve të tjerë në vend. Këto ndryshime u janë dërguar për mendim profesional Ministrisë së Integrimit, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Drejtësisë si dhe në mënyrë jo-formale Deputetëve të Komisionit Parlamentar të Ekonomisë dhe Financave, disa prej të cilëve kanë sjellë mendimet e tyre zyrtare në lidhje me propozimet e bëra nga KLSH. Tryezat që institucioni ka organizuar me juristë të njohur, akademik dhe pedagogë të Fakultetit Juridik të UT, kontabilistë, ekspertë të financave publike dhe pedagogë të Fakultetit Ekonomik UT, me përfaqësues aktivë të shoqërisë civile dhe me

mediat e kanë ndihmuar shumë KLSH më ide dhe sugjerime konkrete për t'i përmirësuar edhe më tej amendimet.

Së dyti, si institucion monokratit i auditimit, variant legjislativ ky i përdorur në shumicën e vendeve europiane, përcaktimi sa më i saktë i rolit, të drejtave, kompetencave, përgjegjësive dhe marrëdhënieve të KLSH-së me institucionet e tjera ndikon automatikisht në veprimtarinë, pavarësinë dhe efektivitetin e këtij institucioni. Roli dhe rëndësia e pazëvendësueshme, që duhet të ketë në realitet Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe stafi i tij audituesi janë të lidhura ngushtësisht me përcaktime të qarta dhe të sakta ligjore dhe që nuk lënë vend për ekuivokë, në lidhje dhe me pengesat që mund t'i krijohen nga subjektet e ndryshme të audituara.

Së treti, në lidhje me pavarësinë e funksionimit të institucionit, dhe më konkretisht atë që ka të bëjë me pavarësinë financiare dhe ekonomike të tij, është riformuluar me një përcaktim më të plotë dhe më të saktë. Autonomia financiare, është një element kyç dhe i domosdoshëm i këtij institucioni që i garanton atij pavarësinë dhe funksionimin normal ligjor, duke i dhënë mundësinë për të realizuar detyrat e tij kushtetuese dhe ligjore, bazuar edhe në Deklaratën e Limës, "Mbi udhëzimet për rregullat e auditimit", miratuar në Kongresin e IX-të të INTOSAI, dhe më konkretisht në Nenin 7 të kësaj deklarate që flet për pavarësinë financiarisht, po ka nevojë për më shumë fonde për të realizuar objektivat e tij ambiciozë.

Së katërti, risi përbën futja në amendimet e auditimit të performancës, të IT, auditimi i programeve dhe projekteve me fonde nga BE dhe donatorët e tjerë. Kështu, bazuar në nenin 90 të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit, bashkëpunimi për auditimin dhe kontrollin financiar mes Palëve, do të përqendrohet në fushat prioritare që lidhen me legjislacionin e BE-së. Sipas këtij neni, Palët bashkëpunojnë në mënyrë të veçantë për të zhvilluar një sistem efikas të kontrollit të brendshëm financiar dhe të sistemeve të auditimit të jashtëm në Shqipëri, në përputhje me standardet dhe metodologjitë e pranuara botërisht si dhe me praktikat më të mira të BE-së. Në këtë drejtim, sipas përcaktimit nga Përmbledhja e Sistemeve të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në shtetet anëtare të BE-së, "...elementët kryesorë të kontrollit të brendshëm, përgjegjshmëria menaxheriale dhe auditimi i brendshëm i pavarur do të kryesojnë listën e çështjeve që duhet të përmirësohen ose zhvillohen më tej" dhe në këtë drejtim kontributi i KLSH si audituesi i jashtëm pritet të jetë konsistent. Bazuar në detyrimin e këtij Nenin, në projektligjin e ri dhe pikërisht në Nenin 9, pika (d), institucioni ka parashikuar që Kontrolli i Lartë i Shtetit ka për kompetencë të auditojë edhe përdoruesit e fondeve të ofruara nga Bashkimi Europian ose organizata të tjera ndërkombëtare.

Së pesti, në projektligjin e paraqitur, KLSH ka evidentuar një përcaktim më të qartë të standardeve ndërkombëtare të INTOSAI-t dhe EUROSAI-t dhe rolit të tyre në raport me organizimin dhe funksionimin e procesit audituesi (Neni 4 i Projektligjit).

Së gjashti, në lidhje me raportin dhe marrëdhëniet e Kontrollit të Lartë të Shtetit me subjektet të cilat ai auditon, në projektligjin e ri kemi parashikuar që këto subjekte duhet që brenda një afati të caktuar kohor të raportojnë, jo vetëm fillimin e marrjes së masave (si e kemi deri tani pas 20 ditësh), por edhe mbas 6 muajsh në lidhje me marrjen e masave dhe ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të bëra nga KLSH.

Gjithashtu në projektligjin e ri, shprehet qartazi një qasje akoma dhe më miqësore kundrejt subjekteve të audituara si në lidhje me të drejtën e këtyre subjekteve për tu njohur që në fillim me programin dhe planin e auditimit ashtu dhe me të drejtën e tyre për tu informuar dhe dhënë shpjegimet dhe observacionet e tyre në lidhje me gjetjet e pasqyruara në procesverbalet dhe projekt-raportet e auditimit. Këto shpjegime dhe observacione, bazuar në projektligjin e ri, janë të detyrueshme për tu evidentuar në raportin përfundimtar. Një risi në këtë projektligj është edhe përcaktimi i raportimit të auditimit në lidhje me transparencën që ky proces duhet të sigurojë dhe qasjen e duhur ndaj publikut. Së shtati, nenet 33, 34, 35, 36 dhe 37 janë shtuar të reja dhe rregullojnë në detaje figurën profesionale të audituesve të KLSH-së duke parashikuar certifikimin e tyre si "Auditues Shtetërorë i Certifikuar". Ato forcojnë statusin e punonjësve të KLH-së që kryejnë detyra auditimi, duke vendosur kritere dhe procedura shtesë për certifikimin e tyre. Këto dispozita shtojnë vlerë për formimin profesional të audituesve të jashtëm, pasi parashikojnë një program të detyrueshëm për formimin profesional, të ndjekur nga provimi përkatës, në përputhje me kërkesat e standardeve INTOSAI.

Sugjerimet dhe mendimet e marra nga tryezat e punës të zhvilluara u përfshinë në një variant përfundimtar të mendimeve dhe u dërguan nga KLSH edhe njëherë për mendim në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit (DG-Budget) të Komisionit Evropian.

Më datën 16 nëntor erdhi përgjigja si më poshtë: "Në opinionin tonë, versioni që na keni dërguar më 15 nëntor 2012, duke marrë parasysh nenet aplikuese të Kushtetutës së Shqipërisë, mund të konsiderohet si tërësisht në përputhje me Parimet, Standardet dhe Udhëzimet e LIMËS dhe MEKSIKOS", nënshkruar nga Drejtori i Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Publik Financiar në Drejtorinë e e Përgjithshme të Buxhetit (DG-Budget) të Komisionit Evropian. Ky pohim përfaqëson konfirmimin më të plotë të rrugës së modernizimit intensiv të KLSH drejt standardeve INTOSAI.

87 VJET KLSH NË 100 VJET SHTET

Botuar në Gazetën "Ekonomia", më 16 janar 2013

Në mbyllje të vitit Jubilar të 100 vjetorit të Shtetit Shqiptar, më 28 dhjetor 2012, Kontrolli i Lartë i Shtetit organizoi Konferencën e tij të Parë Shkencore vjetore, të përqendruar në evidentimin e vlerave të historisë së institucionit dhe të punës shumë-vjeçare të të gjithë punonjësve dhe drejtuesve që kanë kontribuar me përkushtim për ngritjen dhe mbarëvajtjen e tij në periudha kohore të ndryshme.

Hedhja e shikimit nga historia na ndihmon të kuptojmë jo vetëm rrënjët nga vijmë dhe bazën e krijuar, por edhe vlerat dhe forcat që mbartim me vete në përballimin e sfidave të së ardhmes. Këto vlera ia vlen t'ia shpalosim jo vetëm vetes, por edhe opinionit dhe perceptimit qytetar, që aq shumë pret nga ne. Për këtë arsye, krahas disa botimeve të tjera profesionale, finalizuam historikun e KLSH 1925-2012, një libër që doli këto ditë nga shtypshkronja dhe i vihet në dispozicion mediave dhe qytetarit. Prezantimet në këtë konferencë ju mundësuan pjesëmarrësve, por më vonë edhe publikut të gjerë nëpërmjet historikut që po del, kohën dhe kushtet kur dhe si ka lindur KLSH, institucioni suprem i kontrollit, jetik për mbrojtjen e interesave të qytetarëve dhe të Kuvendit në administrimin e parasë publike. Institucioni mori forma të ndryshme në rrjedha të ndryshme të historisë së shtetit shqiptar, provoi mungesën e plotë të pavarësisë dhe deformimin gjatë diktaturës, si dhe zhvillimet e vrullshme në periudhën e tranzicionit 1992 e deri më sot. Vlen të theksohen përpjekjet e punonjësve të tij profesionistë për të realizuar një mëvetësi funksionale, pavarësisht nga kornizat e kohës.

Si institucion i pavarur, nëpërmjet këtij aktiviteti dëshirojmë të krijojmë traditën e mirë të vlerësimit institucional të veprimtarisë, duke kontribuar në kulturën e vlerave dhe të përgjegjësisë publike në vend, për t'ia kundërvënë anti-kulturës së indiferencës dhe harresës, por edhe duke shpresuar që kjo traditë të ndiqet nga institucionet e tjera publike të pavarura dhe të pasurohet vit pas viti. Krahas botimeve gjatë këtij viti të Revistës Profesionale "Auditimi Publik", të botimit "EUROSAI", të Standardeve ISSAI dhe të Manualit të Performancës, të Analizave Gjashtëmujore dhe Njëvjeçare të hapura të institucionit, ne shtojmë një forum të ri të përvitshëm në mozaikun e produktit tonë profesional dhe institucional.

Kontrolli i Lartë i Shtetit është në një proces reformimi dhe marrëveshjet me institucione dhe OJF të tilla si Agjencia e Prokurimit Publik, Departamenti i Administratës Publike, Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe Instituti "G&G Group", të nënshkruara po më 28 dhjetor 2012 janë thelbësore për institucionin, sepse mundësojnë kalimin e tij të natyrshëm nga veprimtari

bazuar në standarde të përgjithshme në veprimtari bazuar në respektimin e plotë të standardeve profesionale INTOSAI, si dhe në bashkëpunimin me partnerë profesionalë, duke përdorur me efiçiencë, efektivitet dhe ekonomicitet burimet tona njerëzore. Këta partnerë do të na ndihmojnë për t'u orientuar më mirë në sfidën kryesore, që është modernizimi i institucionit, orientimi dhe veprimtaria e tij brenda kornizave profesioniste të standardeve ndërkombëtare të auditimit INTOSAI dhe IFAC.

Të tillë partnerë jemi të bindur se do t'i gjejmë në Institutin e Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA), në Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit apo në Agjencinë e Prokurimeve Publike, sikurse i kemi gjetur gjatë këtij viti në bashkëpunimin e frytshëm me Autoritetin e Konkurrencës apo me partnerët tanë ndërkombëtarë, institucionet supreme të auditimit të Polonisë, Sllovenisë, Turqisë, Kosovës dhe Kroacisë. Të gjithë këta, përpos të tjerash, do të jenë bashkëpunëtorët tanë në Konferencën e II-të shkencore të KLSH, që do të organizohet në vitin 2013 në muajt tetor apo nëntor dhe kumtesat e së cilës do të përqendrohen vetëm në standardet dhe metodologjinë profesionale të auditimit.

Thellimi i orientimit dhe i respektimit të standardeve të fushës është thelbësor për ne. Kjo na ka shtyrë që në fillim të kërkojmë rikthimin e vëmendjes tek auditimi i performancës, krahas konsolidimit të auditimit financiar dhe të pajtueshmërisë.

Qëllimi ynë është që të jemi një institucion modern i auditimit më të lartë publik, që mbështetet në standardet INTOSAI dhe që ecën përpara me moton e kësaj organizate, e cila është "Eksperienca e përbashkët u shërben të gjithëve", duke u bazuar në eksperiencat ndërkombëtare të institucioneve homologe, por pa dyshim edhe në eksperiencën shumëvjeçare të vetë Institucionit dhe në burimet e tij njerëzore cilësore në vite.

Ndajmë bindjen që dhe në kohën e teknologjisë së informacionit, kapitali njerëzor bën dallimin dhe diferencën e institucioneve të suksesshme. Prandaj dhe investimi ynë parësor dhe thelbësor është dhe mbetet rritja e kapaciteteve audituese të audituesve tanë. Brenda vitit 2012 kemi dërguar audites për trajnim jashtë shtetit një numër të barabartë me atë që institucioni ynë ka çuar në të shtatë vitet 2004-2011 të marra së bashku. Ne arritëm një numër të konsiderueshëm të trajnimeve për çdo audites në mesatarisht 18 ditë trajnimi në vit, nga 2 ose 3 ditë që ishte në vitet 2009, 2010 dhe 2011. Rritja e kapaciteteve profesionale dhe e integritetit të audituesit më të lartë publik do të jenë konstante të vëmendjes dhe veprimtarisë sonë në vitet që vijnë. Marrëveshjet që kemi nënshkruar gjatë këtij viti me institucionet homologe si SAI polak, slloven, turk e kroat do të vazhdojnë të jenë operacionale dhe në vitet në vijim dhe do të pasohen nga marrëveshje të tjera që do të nënshkruajmë me SAI të tjera të zhvilluara, nga ku mund të marrim eksperiencë të vyer dhe të fitojmë shprehitë që na duhen. Konferencat

e ardhshme vjetore do të përqendrohen pikërisht në zbatimin e standardeve INTOSAI në punën tonë, në përqasjen e eksperiencave me homologët tanë, duke sjellë risi dhe përsiatje nga eksperiencat e huaja, por dhe duke marrë më të mirën e traditës sonë dhe të auditimeve të suksesshme që kryejmë sot.

Le t'i lejojmë kujtesës historike të KLSH-së, historikut të denjë të këtij institucioni të na drejtojë në rritjen e vetëdijes dhe përgjegjësisë ndaj rolit tonë dhe sfidave që kemi përpara dhe me vlerësimin maksimal qytetar të përkulemi përpara figurave dhe personaliteteve që kanë drejtuar këtë institucion, veçanërisht në vitet 1925-1944, si Kol Thaçi, Fejzi Alizoti, Lac Gera, Llambi Aleksi, Lame Kareco, Eqerem Libohova, Xhafer Ypi, Rrok Gera, Izedin Beshiri dhe të tjerë më tej.

Ndërkohë që njohim dhe vlerësojmë të kaluarën e institucionit, vëmendjen e kemi të përqendruar tek e ardhmja. Raporti i Progresit të Shqipërisë i Komisionit Evropian i Tetorit të vitit 2012 ka nënvizuar se: "Auditimi i jashtëm duhet të vijë në nivel me standardet e INTOSAI"[51]. Synimi strategjik i KLSH për vitet 2013-2016 është modernizimi i institucionit për të sjellë veprimtarinë e tij në përputhje të plotë me standardet INTOSAI dhe me objektivat strategjikë të Strategjisë së EUROSAI 2011-2017, të cilat janë: 1-ndërtimi i kapaciteteve, 2-forcimi i zbatimit të Standardeve profesionale, 3-shkëmbimi i eksperiencave në auditim dhe më gjerë dhe 4- mirëqeverisja dhe komunikimi.

Duke respektuar sensibilitetin popullor, KLSH ka si objektiv strategjik të vetin dhe luftën pa kompromis dhe në sistem ndaj korrupsionit dhe parandalimin e tij. Për këtë, institucioni do të sinergjizojë përpjekjet për luftën ndaj korrupsionit dhe për parandalimin e tij, në përputhje me Strategjinë Ndërsektoriale të Parandalimit, Luftës kundër Korrupsionit dhe Qeverisjes Transparente 2008-2013 të qeverisë Berisha, e cila kërkon një bashkëpunim më të ngushtë të institucioneve kryesore që e luftojnë korrupsionin, të bazuar në angazhime të përbashkëta të institucionalizuar, si dhe me institucionin e Prokurorisë, pa lënë jashtë vëmendjes bashkëpunimin me organizatat profesionale që janë aktive në këtë fushë.
Më në detaje, objektivat tanë strategjikë, të përpunuar dhe me mbështetjen e SIGMA-s, programit për "Përmirësim në Menaxhim dhe Qeverisje" të BE-së, janë:
1- Sjellja dhe mbajtja e bazës ligjore dhe rregullatore të KLSH në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikat e mira evropiane. Zhvillimi institucional i KLSH i referohet forcimit të kapaciteteve institucionale, duke u shndërruar në një institucion model të qeverisjes së mirë në sektorin publik. KLSH synon të krijoje një model të qeverisjes së mirë brenda institucionit, nëpërmjet rritjes së transparencës së

[51] Progres Raporti i Komisionit Evropian per Shqipërinë 2012, faqe 66 -67.

veprimtarisë së tij, pjesëmarrjes së grupeve të interesit, përdorimit me ekonomicitet, efiçience dhe efektivitet të burimeve, promovimit të përgjegjshmërisë individuale dhe institucionale, krijimit të një kulture jo tolerante ndaj konfliktit të interesit dhe mashtrimit e parregullsive. Nga ana tjetër, institucioni do të aplikoje një qasje fleksibël ndaj interesave të mjedisit të jashtëm, duke marrë në konsideratë kërkesat e faktorëve të këtij mjedisi ndaj KLSH.

2- Përmirësimi i kapaciteteve, cilësisë dhe produktivitetit të auditimit. KLSH do t'i përmirësojë kapacitetet, cilësinë dhe produktivitetin e auditimeve të saj në kushtet e një veprimtarie me burime të kufizuara dhe të angazhimit për t'ju përmbajtur standardeve profesionale ndërkombëtare INTOSAI dhe IFAC. Institucioni do të përfitojë nga potenciali i auditimit të performancës, duke realizuar rritjen e kontributit dhe të profilit të tij në menaxhimin e fondeve publike. Ai do të përballet me sfidën e detyrimit të ri për të dhënë një opinion të auditimit mbi raportin e ekzekutimit të buxhetit të konsoliduar të Shtetit.

3- Përmirësimi i cilësisë dhe shtimi i numrit të auditimeve të performancës. Përmirësimi i cilësisë dhe shtimi i numrit të auditimeve të performancës përbën një nga sfidat më madhore të KLSH. Auditimi i performancës i institucionit në vitin 2017 do të jetë një veprimtari e konsoliduar, me një vëllim të katërfishuar të numrit aktual të auditimeve të performancës(të vitit 2012), me një staf të mirëtrajnuar që ka demonstruar aftësi të spikatura në kryerjen e këtij lloji auditimi me ndikim në administratën publike shqiptare. Departamenti i Auditimit të Performancës do të jetë një nga dy departamentet më të rëndësishme në gjithë veprimtarinë e institucionit. KLSH do të ristrukturoje departamentin duke ngritur njësi të auditimit të performancës, si dhe duke përzgjedhur temat e auditimit që potencialisht kanë ndikim të madh.

4- Zhvillimi dhe konsolidimi i auditimeve të Teknologjisë së Informacionit dhe përdorimi i T.I. në auditim.

5- Forcimi i rolit antikorrupsion të KLSH-së për sigurimin e mirëqeverisjes. Situata e korrupsionit në vendin tonë dikton nevojën e angazhimit të të gjithë institucioneve dhe shoqërisë për të krijuar një front unik kundër këtij fenomeni që kërcënon seriozisht progresin e Shqipërisë.

6- Nxitja e qeverisjes së mirë dhe menaxhimi i shëndoshë financiar. Vizioni i KLSH-së për shtimin dhe kursimin e vlerës së parave publike kërkon që institucioni të ndikojë mbi përdoruesit e parave për t'i përdorur ato me ekonomicitet, efektivitet dhe efiçiencë. Sigurisht që kjo është përgjegjësi e përdoruesve të parave, por KLSH ka një rol me rendësi për t'i ndikuar dhe këshilluar ata që të përmirësojnë përdorimin e tyre.

7- Zhvillimi i komunikimit dhe bashkëpunimi me aktorë të tjerë brenda e jashtë vendit.

KLSH realizoi gjatë vitit 2012 marrëveshje bashkëpunimi me gjashtë nga OJF-të më

aktive në luftën kundër korrupsionit dhe për më shumë transparencë në administrimin publik, dhe konkretisht me Transparency Internacional në Shqipëri, me lëvizjen Alternativa Civile, me Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë, me Institutin e Studimeve Bashkëkohore, me Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim dhe me Lëvizjen Evropiane Shqipëri. Institucioni nënshkroi edhe me organizatën për mbrojtjen e mjedisit, Institutin "G&G Group", si dhe me Institutin e Ekspertëve Kontabël të Autorizuar dhe Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit. Po gjatë vitit 2012 (deri në fund të nëntorit), KLSH mundësoi 468 editoriale, shkrime, raportime dhe njoftime në median e shkruar dhe mbi 282 sekuenca televizive. U shtuan editorialet dhe shkrimet problematike nga Kryetari i KLSH. Për herë të parë, në janar 2012 u zhvilluan analizat vjetore në nivel departamenti dhe analiza e përgjithshme me praninë e medias dhe të përfaqësuesve nga shoqëria civile.

Në zbatim të parimit 8-të të ISSAI 20 për komunikimin aktiv të një SAI nëpërmjet publikimeve, gjatë vitit 2012, institucioni përgatiti dhe botoi "KLSH-Analiza Vjetore 2011", "KLSH në Kuvend", "KLSH-Analiza 6-mujore 2012", "EUROSAI dhe SAI-t Evropiane", "Standardet ISSAI 1, 10, 11, 20, 30, 40, 100 dhe 200", "Historiku i KLSH 1925-2012", tre numra të revistës shkencore "Auditimi Publik" dhe në formë tërësisht të përditësuar Manualin e Auditimit të Performancës.

LLOGARIDHËNIA DHE TRANSPARENCA

Botuar në Gazetën "Koha Jonë", më 4 shkurt 2013

Llogaridhënia dhe transparenca janë dy parimet kryesore të qeverisjes së mirë në sektorin publik dhe përgjegjësia e Kontrollit të Lartë të Shtetit(KLSH) si institucioni me i larte i auditimit të jashtëm publik është që të kontribuojë në transparencën dhe llogaridhënien e menaxhimit të fondeve publike. Këtë kontribut institucioni e ka patur në fokus të çdo auditimi. Gjatë vitit 2012, ka realizuar 177 auditime nga 153 të planifikuara dhe ka përfunduar plotësisht 158 auditime. Çështja kryesore dhe me e rëndësishme për KLSH është të mbajë një cilësi të lartë në aktivitetet e auditimit dhe ta ruaje këtë cilësi. Institucioni duhet t'i përmbahet standardeve te cilësisë dhe në të njëjtën kohe audituesit e tij duhet të mbajnë flamurin e pavarësisë, objektivitetit, skepticizmit profesional dhe llogaridhënies ndaj publikut. Gjate auditimeve te kryera ne vitin 2012 (me periudhe 2-3 vjeçare aktiviteti te entit shtetëror që auditohej), KLSH ka vërejtur parregullsi dhe shkelje financiare ne te ardhurat e mbledhura dhe ne shpenzimet e kryera nga entet publike të audituara, institucione të Pushtetit Qendror dhe Vendor, me dëm ndaj Buxhetit të Shtetit në shumën 13, 522, 392, 000 leke, ose 97.3 milion euro. Institucioni ka rekomanduar qe kjo shume të zhdëmtohet në masën 100 përqind.

KLSH ka shumë palë të interesuara në realizimin e misionit të tij: qytetarët, Parlamentin, entet e audituara dhe organizatat e shoqërisë civile. Besimi i palëve të interesuara në KLSH do të thotë besim i Parlamentit dhe publikut, në përgjithësi, për rezultatet e tij. Misioni i KLSH është informimi i publikut dhe i Kuvendit të Shqipërisë në lidhje me përgjegjshmërinë e qeverisë dhe të enteve të tjera publike për përdorimin e burimeve publike sipas ligjit, me ekonomicitet, efektivitet dhe efiçiencë dhe nxitja e kësaj përgjegjshmërie në të gjithë sektorin publik, në përputhje me praktikat më të mira të BE-së, me standardet ndërkombëtare të INTOSAI dhe me ndjeshmërinë popullore për shtimin e luftës kundër korrupsionit. Në sektorin privat, aftësia e një kompanie për të ndërtuar dhe për të ruajtur besimin e aktorëve të saj është shumë e rëndësishme për biznesin. Kjo ndodh edhe për institucionet publike. Për KLSH, si një institucion publik që punon në emër të Kuvendit, aftësia për të krijuar besimin në palët e interesuara është e një rëndësie vendimtare. Institucioni ka zbuluar shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në perfomancën e subjekteve te audituara, në shumën e përgjithshme 1, 842, 998, 000 leke, ose 13.2 milion euro. Shkeljet financiare janë vërejtur kryesisht ne prokurimet publike, në shitjen dhe dhënien me qira të pasurisë shtetërore, në urbanistike, në shpenzimet operative, në doganat, në tatimet e taksat, etj.

Integriteti i menaxhimit të auditimit paraqitet shumë i rëndësishëm për KLSH-në, në drejtim të rritjes së besimit të palëve të interesuara. Qytetaret duan të dinë se si shpenzohen fondet publike nga institucionet publike dhe se si institucionet i kryejnë detyrat e tyre. KLSH punon si një ndërmjetës në këtë kontekst, auditon institucionet dhe raporton ne lidhje me llogaritë dhe transaksionet e tyre në Parlament dhe tek qytetarët. Integriteti i menaxhimit të auditimit nënkupton kryerjen e këtyre auditimeve me staf kompetent dhe te pavarur, i cili përdor një kod sjelljeje të mire provuar dhe i kryen auditimet në përputhje me ligjet dhe standardet profesionale INTOSAI. Pra, duhen përmbushur disa kushte për të siguruar integritetin e menaxhimit të auditimit: audituesit duhet të jenë të kualifikuar, kodi i etikës duhet të jetë i qartë, procedurat e auditimit duhet të jenë të hapura dhe të mirëpërcaktuara, lidershipi i KLSH-së duhet të sigurohet që monitorimi për të vlerësuar procesin e auditimit dhe raportet e auditimit është i rregullt.

Në bazë të standardit profesional ISSAI 20, "...përgjegjshmëria për institucionin suprem te auditimit(SAI) qëndron në përgjegjësinë e treguar për planifikimin dhe kryerjen e punës se tij audituese, duke përdorur metodologjitë dhe standardet e duhura për të siguruar llogaridhënien dhe transparencën mbi aktivitetet publike, duke përmbushur përgjegjësitë e tij në mënyrë të plotë dhe objektive" (ISSAI 20, botim i vitit 2010, fq. 3). Në kontekstin e përgjegjshmërisë, proceset e punës, aktivitetet dhe produktet duhet të jenë transparente dhe SAI-t duhet të komunikojnë hapur me aktorët e tyre. Përgjegjësia ndahet në përgjegjësinë e lidershipit dhe të stafit të një SAI. Përafrimi i njohur ne literaturën botërore me shprehjen "Tone at the top"(theksi ne maje) ka të bëjë me përgjegjësitë e lidershipit për të siguruar cilësinë e produkteve apo shërbimeve që ofron institucioni. Termi është përcaktuar nga IFAC si vijon: "Standardi i vendosur nga lidershipi i një organizate në të cilin është matur performanca; kultura brenda së cilës veprojnë anëtarët e organizatës, mënyra e veprimit e vendosur nga lidershipi, pavarësisht strategjive të dokumentuara për drejtimin dhe politikat, ajo është forca që drejton profesionistet individuale; dora e padukshme qe drejton pavarësisht rregulloreve" (IFAC, Komiteti i Audituesve Ndërkombëtarë, botim i vitit 2007, fq. 8).

Siç thuhet në Raportin e Komitetit të Audituesve Ndërkombëtare, "kultura brenda SAI-ve është çelësi për auditime cilësore, pasi ajo krijon një mjedis ku arritja e cilësisë në çdo aspekt të procesit të auditimit vlerësohet dhe shpërblehet. Brenda SAI-t arritja e cilësisë është shumë më e domosdoshme se në institucionet e tjera, për vete rolin qe SAI ka si gjykues i punës së të tjerëve. (Raporti i Grupit të punës së EUROSAI-t, botim i vitit 2010, fq. 7). Për këtë arsye ruajtja e një niveli të caktuar të cilësisë behet gjithnjë e më e rëndësishme për SAI-t. Reputacioni ynë bazohet në cilësinë e prodhimit tone. Si KLSH jemi te përqendruar për sigurimin e nivelit te duhur te llogaridhënies dhe të cilësisë në

auditim, duke zbatuar rekomandimin e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë për "Kryerjen e auditimeve ndaj përdorimit te fondeve te Buxhetit te Shtetit, si dhe fondeve te projekteve te financuara nga BE-ja e nga institucionet financiare ndërkombëtare me objektivitet, profesionalizëm, cilësi dhe efektivitet të larte". Kemi sjelle ne vitin 2012 58 propozime për përmirësim të legjislacionit, nga te cilat 15 janë zbatuar tashme, ndërsa 24 janë në proces zbatimi. Kemi rekomanduar 2, 194 masa organizative, nga te cilat janë zbatuar 1, 659 ose 76 për qind e tyre. KLSH ka rekomanduar 1, 221 masa disiplinore dhe administrative, nga te cilat 802 ose 66 për qind janë realizuar që gjate këtij viti. Duhet pohuar se ndërsa në përmbushjen e rekomandime vetë institucionit për masat organizative, disiplinore dhe administrative ka nivel te mire zbatueshmërie, masat për largime nga puna te punonjësve te gjetur me shkelje janë në nivel shumë të ulët. Ky mosrealizim ka ardhur nga serioziteti i paket i enteve të audituara në ndështkimin e shkelësve të ligjit brenda stafit të tyre. KLSH-se i del një detyrë e rëndësishme për këtë vit që të ngrejë në një nivel të pranueshëm këtë tregues shume të rëndësishëm për kulturën e ndështkueshmerisë në administratën publike.

Ekziston një perceptim negativ i publikut ne lidhje me nivelin aktual të korrupsionit në administratën publike. Ky perceptim vjen nga moszbulimi dhe mosndështkimi i korrupsionit në nivel të mjaftueshëm nga ana e organeve shtetërore përgjegjëse për ta luftuar këtë dukuri. Në këtë këndvështrim, mirëqeverisja është antidoti më i mirë ndaj korrupsionit. Fondi Monetar Ndërkombëtar është shprehur se "të promovosh mirëqeverisjen në të gjitha aspektet e saj, duke siguruar sundimin e ligjit, duke përmirësuar efiçiencën dhe përgjegjësinë e sektorit publik dhe duke luftuar korrupsionin, janë elemente thelbësore të një kuadri ku ekonomitë mund të prosperojnë" (Udhëzues, "Qasja e FMN-se në promovimin e mirëqeverisjes dhe në luftën ndaj korrupsionit", ribotim i vitit 2011, fq. 18).

Përpara audituesve të KLSH duhet të qëndrojnë gjithnjë fjalët e çmuara të ish-Sekretares së Shtetit, Hilari Klinton, në adresimin e saj në Kuvendin e Shqipërisë vitin e kaluar: "Është gjithmonë e rëndësishme t'i kujtojmë vetes se konsolidimi i demokracisë kërkon më shumë se vetëm zgjedhje. Kërkon studim logjik. Kërkon institucione të forta ... Kërkon që qeveria të jetë e hapur në mënyrë që njerëzit të na pyesin në menaxhereve të llogarive publike. Unë kërkoj me ngulm që ju të përballeni me problemin që ndikon ne kaq shume demokraci sot në bote, pikërisht me korrupsionin ... Kjo është një luftë që secili vend duhet ta kryejë dhe të fitojë në të gjithë botën, sepse korrupsioni është një kancer që gërryen shoqëritë ... Zhdukja e korrupsionit kërkon përpjekje të pandalshme dhe një angazhim të përbashkët". Si KLSH gjate vitit 2012 kemi kryer 40 kallëzime penale për 125 punonjës te administratës shtetërore të niveleve të ndryshme, ose 2 herë me shume kallëzime nga sa institucioni ka bërë në tre vitet 2009-2011 të marra se

bashku. Puna jone shkon ne sinkron me Strategjinë Ndërsektoriale të Parandalimit, Luftës kundër Korrupsionit dhe Qeverisjes Transparente 2008-2013 të qeverisë Berisha, e cila kërkon një bashkëpunim me të ngushtë të institucioneve kryesore që e luftojnë korrupsionin, te bazuar ne angazhime të përbashkëta të institucionalizuar. Është vërejtur botërisht se rritja e përgjegjësisë së menaxherëve publike ndikon menjëherë në uljen e korrupsionit. Gjatë vitit të kaluar, jemi përpjekur të krijojmë sinergji për mirëqeverisjen, duke bashkëpunuar në sistem me institucionet e tjera shtetërore. Në mars 2012, nënshkruam një marrëveshje bashkëpunimi me Inspektoratin e Larte të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive të funksionareve të lartë të shtetit dhe një me Autoritetin Shqiptar të Konkurrencës, me synimin e zhbirimit te çdo rasti pasurimi të shpejtë të ndonjë funksionari publik, si dhe te rasteve të prishjes së konkurrencës në tenderat dhe ankandet shtetërore. Ne qershor 2012 nënshkruam marrëveshjen e bashkëpunimit me Prokurorinë e Përgjithshme. Nga kallëzimet e institucionit vetëm në muajin Dhjetor 2012, institucioni i Prokurorisë ka nisur hetimet për 35 punonjes publikë të kapur me shkelje nga KLSH në bashkitë Vlorë, Sarandë, Himarë, Pogradec dhe Përmet, si dhe ne Ndërmarrjen e Ujësjellës-Kanalizimeve Mat. Kjo është parësore në ndërgjegjësimin e strukturave dhe enteve publike për përgjegjësitë që ato kanë në administrimin e pronës shtetërore. Bashkëpunimi efiçient i institucioneve si KLSH dhe Prokuroria e Shtetit ne zbulimin dhe hetimin e abuzimeve me pronën shtetërore prodhon përgjegjshmëri. Dhe një shkalle më e lartë përgjegjësie ndaj disiplinës së rreptë financiare dhe detyrave te tjera publike ul korrupsionin. Nga ana tjetër, sfida jonë kryesore, modernizimi i institucionit, realizohet duke koordinuar si duhet punën me institucionet e tjera. Në përmbushje të objektivit të platformës strategjike të caktuar në dhjetor 2011 për institucionin, kemi siguruar bashkëpunim profesional me Institutin e Eksperteve Kontabël te Autorizuar (IEKA) dhe me Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit. Kemi iniciuar ne maj 2012 marrëveshjen e bashkëpunimit me Ministrinë e Financave, sidomos me strukturat e saj te auditimit të brendshëm. Kjo marrëveshje është ne veprim dhe do te realizohet e plote gjate këtij viti në objektivat e saj kryesore, në baze të standardeve ISSAI 9150 dhe 1240. Ndajmë mendimin që forcimi i kapaciteteve të auditimit, si atij të brendshëm dhe te jashtëm publik, është rruga e duhur për të mbështetur maksimalisht rritjen e përgjegjshmërisë, transparencës dhe ndershmërisë ne qeverisje.

Përmirësimi i qeverisjes duke luftuar korrupsionin dhe antikulturën e pandëshkueshmërisë, nëpërmjet transparencës së plotë dhe funksionale me publikun, ka përberë një nga përparësitë e veprimtarisë sonë gjatë vitit të kaluar. Ai është njëkohësisht shprehje e filozofisë dhe përqasjes sonë për të vendosur në plan të parë interesat e qytetarit. Kemi trajtuar 358 letra dhe ankesa nga qytetarët për probleme të ndryshme, nga te cilat 111 i kemi konstatuar jashtë kompetencave dhe juridiksionit te KLSH, kurse nga 247 kërkesa dhe ankime ne kompetence te institucionit, 171 prej tyre i

kemi verifikuar dhe u kemi dhënë përgjigjen përkatëse, ndërsa 76 janë në vijim të verifikimit. Për rritjen e transparencës dhe eficiences në auditim, KLSH ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me disa nga OJF-të më të spikatura ne promovimin e transparencës në administratën publike dhe në luftën kundër korrupsionit, dhe konkretisht me Transparency Internacional në Shqipëri, me lëvizjen Alternativa Civile, me Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë, me Institutin e Studimeve Bashkëkohore, me Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim, me Lëvizjen Europiane Shqipëri dhe me Institutin "G&G Group". Këto nuk janë marrëveshje sa për numër. Marrëveshjet shprehin filozofinë e punës sonë, realizimin e veprimtarisë me ekonomicitet, efektivitet dhe eficience, duke realizuar sinergji me bashkëpunimet. Nga OJF-te kërkojmë jo vetëm bashkëpunim për transparencë, por edhe të marrin pjesë aktive në auditimet tona dhe ato të na auditojnë ne.

Në zbatim të parimit 8-te te ISSAI 20 për komunikimin aktiv të një SAI nëpërmjet publikimeve, gjate vitit 2012 institucioni përgatiti dhe botoi "KLSH-Analiza Vjetore 2011", "KLSH ne Kuvend", "KLSH-Analiza 6-mujore 2012", "EUROSAI dhe SAI-t Evropiane", "Standardet ISSAI 1, 10, 11, 20, 30, 40, 100 dhe 200", "Historiku i KLSH", dy numra të revistës shkencore "Auditimi Publik" dhe Manualin e përditësuar të Auditimit të Performances. Me datën 28 dhjetor 2012, KLSH zhvilloi Konferencën e tij të parë Shkencore, duke ju referuar historikut te institucionit dhe punës shumëvjeçare të të gjithë personave qe kane kontribuar për ngritjen dhe mbarëvajtjen e tij në periudha kohore të ndryshme, me rastin e 100 Vjetorit të Pavarësisë. Kjo konference për këtë vit dhe vitet në vijim synon të kthehet në një traditë dhe një forum përqasjesh eksperiencash auditimi si për auditimin e jashtëm dhe atë të brendshëm publik, duke sjelle edhe përvojën audituese te institucioneve homologe te zhvilluara ne rajon dhe me gjere.

Puna në sistem për mirëqeverisjen, përgjegjësia jonë për transparencë dhe llogaridhënie mbartin ne vetvete një përgjegjësi ligjore, profesionale dhe morale tepër të lartë. Për të qenë sa më efektiv dhe për të modernizuar kapacitetet e tij audituese dhe gjithë aktivitetin, ne zbatim dhe të rekomandimit të Progres Raportit 2012 te BE-se për Shqipërinë, i cili ka nënvizuar se: "Auditimi i jashtëm duhet të vijë në nivel me standardet e INTOSAI", gjate vitit 2012 KLSH plotësoi përgatitjen e draft-amendimeve të ligjit organik të KLSH, në bashkëpunim intensiv me Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në BE, DG-Budget dhe me SIGMA. Gjatë ditëve të para të Nëntorit 2012 u organizuan katër tryeza pune me pedagogë të Universitetit Shtetëror të Tiranës dhe ekspertëve të njohur ligjore, kontabël dhe të financave publike, si dhe me përfaqësues të shoqërisë civile dhe të mediave. Në këto tryeza mori pjese dhe nje Drejtor Njesie ne DG-Budget, specialist i fushës. Nga tryezat rezultuan sugjerime te vlefshme qe u

reflektuan ne draftin përfundimtar te Projekt-Ligjit me Amendimet, i dorëzuar Kuvendit te Shqipërisë me 30 nëntor 2012 dhe sipas DG-Budget, "tërësisht në përputhje me standardet INTOSAI". Amendimet sjellin një konceptim modern të të drejtave dhe detyrave të KLSH. Ato do të ndihmojnë në rritjen e nivelit të zbatimit te rekomandimeve te tij, në rritjen e kapaciteteve administrative, në saktësimin e së drejtës së KLSH të auditoje fondet e akorduara nga BE për Shqipërinë deri tek përdoruesi i fundit dhe në saktësimin e së drejtës të certifikojë llogaritë financiare të enteve të audituara. Ne besojmë se Kuvendi do të na mbështesë si gjithmonë. Për më tepër, vetë Rezoluta e Kombeve të Bashkuara e 22 Dhjetorit 2011 "Për nxitjen e eficiencës, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës së administratës publike duke fuqizuar institucionet supreme të auditimit" i inkurajon Shtetet Anëtare të OKB-së dhe parlamentet e tyre të "mbështesin SAI-t të kryejnë detyrat e tyre në mënyrë objektive dhe efektive, duke qenë të pavarura nga subjekti i audituar dhe të mbrojtura nga ndikimet e jashtme". U drejtohem të gjithë zotërinjve deputetë të Kuvendit që të shqyrtojnë amendimet e ligjit të KLSH, pse nëpërmjet tyre përmirësohet qeverisja dhe rritet ndjenja e përgjegjësisë dhe llogaridhënia në administratën publike.

Ndikimi i KLSH-se në mirëqeverisjen publike është tërësisht në funksion të nivelit të kapaciteteve te tij. Gjate vitit 2012, institucioni ka rekrutuar sipas te gjitha rregullave të punësimit në administratën publike shumë punonjës të rinj, ndër të cilët katër me gradën shkencore Doktor i Shkencave dhe tetë me nivel pasuniversitar te Programit Master. Ka pare si mjetin kryesor te forcimit te kapaciteteve audituese të institucionit trajnimet intensive te stafit, si atij me përvoje edhe atij të ri, në përvetësimin e standardeve INTOSAI. Për këtë, ka lidhur, duke filluar nga muaji shkurt 2012 e në vijim, marrëveshje bashkëpunimi me institucionet simotra të zhvilluara të auditimit me të larte publik, si Zyra e Audituesit të Përgjithshëm të Kosovës, Zyra Kombëtare e Auditimit(NIK) e Polonisë, Gjykata e Auditimit e Sllovenisë, Gjykata e Llogarive e Turqisë dhe Institucioni i Auditimit Shtetëror të Kroacisë. Si rezultat i zbatimit të këtyre marrëveshjeve, gjate vitit 2012 u trajnuan jashtë shtetit një numër audituesish të KLSH i barabarte me numrin e punonjësve të institucionit të dërguar jashtë gjatë shtate viteve 2004-2011 të marra së bashku. U realizua në gjysmën e dytë të vitit 2012 me ekspertë të SIGMA në Tiranë një program intensiv trajnimesh për auditimin e performances, auditimin financiar dhe auditimin e teknologjisë së informacionit, program i cili do ta vijojë edhe këtë vit. Vitin 2012 KLSH e mbylli me një tregues 19.4 ditë trajnimi për auditues ne KLSH, nga vetëm 2.1 dite trajnimi në vit për auditues, që kishte trashëguar nga viti 2011. Ky tregues i sotëm është në nivel me treguesit e ditëve të trajnimit në vit për auditues të institucioneve të auditimit suprem më të zhvilluara në kontinent.

Gjatë vitit 2012, institucioni katërfishoi numrin e auditimeve të performances, në krahasim me një vit me pare(duke u nisur nga një baze shume e dobët) dhe përditësoi Manualin e Auditimit të Performances, që ai t'u shërbeje me konkretisht audituesve të vet. Ne shtator 2012, KLSH ngriti Departamentin e Auditimit të Performances, me ne krye një nga studiuesit më premtues të makroekonomisë shqiptarë dhe Doktor i Shkencave ne financat publike, si dhe me 16 auditues ndër ata me më përvojë dhe auditues të rinj me perspektivë të qartë për ngritje profesionale. Institucioni aplikoi dhe fitoi një projekt binjakëzimi për zhvillimin e metodologjisë dhe kapaciteteve te tij audituese, në kuadër të financimeve IPA 2012, me vlerë 2.11 milionë euro, i cili do te behet veprues në fund të këtij viti. Në bashkëpunim me ekspertë të SIGMA, kemi përgatitur Planin e Zhvillimit Strategjik të KLSH për vitet 2013-2016, i cili përmban objektivat kryesore si përmirësimi i bazës ligjore dhe rregullatorë të KLSH, në përputhje me standardet INTOSAI dhe praktikat më të mira europiane, përmirësimi i metodologjisë dhe rritja e cilësisë ne auditim, përmirësimi i cilësisë dhe shtimi i numrit të auditimeve të performances, krahas konsolidimit të auditimeve të përputhshmërisë dhe atyre financiare, sigurimi i mirëqeverisjes, si dhe rritja e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies për një menaxhim të shëndoshë financiar. Bashkëpunimi i gjerë dhe i thellë me qytetarët, me Kuvendin e Shqipërisë, me Institucionin e Presidencës, me Qeverinë dhe me të gjithë partnerët e tij në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar është për KLSH garancia më e plotë në suksesin e objektivave edhe gjatë këtij viti.

Ne besojmë fort në punën në sistem për përmirësimin e qeverisjes dhe rritjen e përgjegjësisë dhe llogaridhënies së institucioneve publike. Ndaj bindjen që rezultatet nuk do të mungojnë, ashtu sikurse ato erdhën edhe gjatë vitit të kaluar, nëse vullneti dhe predispozicioni në rritjen e kapaciteteve profesionale të audituesve, por edhe vullneti dhe predispozicioni për bashkëpunim i të gjitha institucioneve shtetërore dhe i gjithë aktorëve të tjerë të përfshirë, do të jenë në nivelin e duhur.

AUDITIMI DHE KËSHILLIMI NGA KLSH

Botuar në Gazetën "Panorama", më 8 maj 2013

Në kushtet e kufizimeve në rritje të burimeve ekonomike, e veçanërisht atyre publike, taksapaguesit në çdo vend shtrojnë me të drejtë pyetjen: Si mund të dizenjohet në mënyrë më efiçiente dhe ekonomike menaxhimi i pasurive publike? Për punonjësit e institucioneve supreme të auditimit sot në botë, kjo pyetje është tashmë në rend në ditës, sepse auditimi i funksioneve publike është parakushti për të përpunuar propozime e zgjidhje që synojnë rritjen e efiçiencës dhe efektivitetit të menaxhimit qeverisës. Pikërisht me këto fjalë e nisi diskutimin në Simpoziumin e 22-të INTOSAI, mbajtur në Vjenë, sekretari i Përgjithshëm i kësaj Organizate, z. Josef Moser. Qasja moderne dhe efektive e Kontrollit të Lartë të Shtetit kah qeverisjes së mirë nuk kufizohet vetëm në funksionin auditues. Thjesht identifikimi i shkeljeve dhe mangësive nuk i mjafton më një institucioni suprem auditimi për t'u perceptuar si një mekanizëm efektiv kontrolli. Institucione të tilla mund ta realizojnë plotësisht potencialin e tyre vetëm nëse zhvillojnë një qasje këshillimore të mbështetur në punën e tyre audituese, duke u ofruar rekomandime specifike, të detajuara dhe shkencore menaxherëve qeveritarë, rekomandime praktike që mund dhe duhen implementuar në sferat përkatëse të ekonomisë publike. Në fakt, standardet INTOSAI e theksojnë në mënyrë eksplicite ofrimin e rekomandimeve për të përmirësuar funksionet publike, por pa ndërhyrë në formulimin e objektivave, strategjive dhe politikave. Për ta vënë në jetë këtë model dual auditimi dhe këshillimi, duhen përmbushur një sërë kushtesh, dhe konkretisht:

1. Përzgjedhja e subjekteve audituese duhet të orientohet nga impakti që ato kanë mbi të ardhmen ekonomike dhe sociale, mbi potencialin e këtyre subjekteve për të përmirësuar mirëqenien publike.

2. Auditimi nuk duhet të jetë pjesë e operacioneve të përditshme qeveritare, por duhet të marrë formën e një auditimi *ex-ante* ose *ex-post.*

3. Rekomandimet e dhëna duhet të kenë vlerë praktike, të ofrojnë zgjidhje të problemeve duke u orientuar nga e ardhmja dhe të përmirësojnë efiçiencën dhe efektivitetin e qeverisjes publike.

Duke adresuar tema audituese me impakt mbi të ardhmen e vendit, një institucion suprem auditimi duhet të mbulojë të gjitha sferat e rëndësishme ekonomike, përfshirë dobinë financiare të përdorimit të fondeve publike, sistemet arsimore, shëndetësore dhe pensionet, ruajtjen e mjedisit, reduktimin e varfërisë, zhvillimin e qëndrueshëm të vendit, etj. Është detyrë e KLSH-së të sigurojë transparencë dhe llogaridhënie përmes auditimeve të saj, sikurse të promovojë efektivitet dhe demokraci përmes

rekomandimeve që jep. Sipas të dhënave të Bankës Botërore, mbi një triliard dollarë në vit humbasin nga korrupsioni në mbarë botën. Në Shqipëri, kjo shifër për vitin 2012 i kaloi 90 milionë eurot, sipas statistikave të KLSH-së. Në gjykimin tim dhe të institucionit që unë drejtoj, kosto e korrupsionit nuk është thjesht vjedhja e fondeve publike; kosto e vërtetë është sabotimi i së ardhmes, që shprehet në më pak spitale, shkolla, ujë, rrugë, energji. Por jo vetëm kaq, aftësia e një vendi për të thithur investime të huaja, ndërtuar kapacitete njerëzore profesionale, lehtësuar tregtinë dhe shtuar pasurinë e mirëqenien varet në mënyrë kritike nga transparenca, efiçienca dhe efektiviteti i institucioneve publike. Parametri kyç i qeverisjes së mirë prej këtyre institucioneve është pikërisht rritja e pjesëmarrjes qytetare në zhvillim dhe vendimmarrje. Në ekonominë e tregut dhe të sipërmarrjes së lirë, qeveria nuk i ka të gjitha përgjigjet. Ajo duhet të bashkëpunojë me sektorin privat dhe qytetarët për të identifikuar problemet, përkufizuar drejt ato dhe gjeneruar zgjidhjen më optimale të mundshme. Tri shtyllat e zhvillimit të qëndrueshëm janë rritja ekonomike, zhvillimi shoqëror dhe ruajtja e mjedisit. Nuk është e tepërt, madje e domosdoshme, që këtyre tri shtyllave t'u shtohet edhe një e katërt, ajo e qeverisjes së mirë. Kjo e fundit fuqizon lidhjen mes tri shtyllave të para dhe siguron se e ardhmja që duam mund të bëhet realitet. Pikërisht kësaj shtylle i përket Kontrolli i Lartë i Shtetit. Përmes tri llojeve të auditimit që kryhen, dy tradicionale dhe një i konsoliduar rishtas, KLSH garanton zbatimin e ligjit, drejtësinë dhe saktësinë e pasqyrave financiare dhe menaxhimin me ekonomicitet, efiçiencë dhe efektivitet të fondeve publike. Në të ardhmen, axhendës së institucionit mund t'u bashkëngjiten edhe lloje të tjera auditimesh, siç mund të jetë ai i auditimit të sistemeve të informacionit.

Sigurimi i impaktit pozitiv përmes këshillimit. Nocioni që dua të parashtroj në këtë paragraf është sigurimi i impaktit, sepse besoj se qëllimi i ekzistencës së një institucioni suprem auditimi, madje do të thosha i çdo institucioni publik, është sigurimi i impaktit pozitiv në funksionimin e qeverisjes në përgjithësi, dhe i shërbimeve publike në veçanti. Kjo është një sfidë, po aq sa edhe një mundësi e madhe. Risku potencial që ndeshet në raste të tilla është ai i një institucioni suprem auditimi që gjeneron rekomandime brilante, por që nuk dëgjohet nga askush. KLSH ruan distancën, synon të jetë objektive, nuk dëshiron të bëhet pjesë e implementimit apo dizenjimit të politikave… dhe e gjitha kjo sepse duam të jemi sa më të besueshëm dhe të paanshëm që të jetë e mundur. Por përsëri, si mund ta realizojmë impaktin? Pikësëpari duke mbajtur parasysh se institucionet supreme të auditimit, duke mos qenë vendimmarrëse në politikë, mbeten ende "pronare" të llogaridhënies. Për të qenë më të saktë, "bashkëpronare", së bashku me autoritetet e tjera publike. Problemi që ndeshin institucione të tilla jo vetëm në Shqipëri, por edhe në mbarë botën, është se nuk dëgjohen mjaftueshëm. Në KLSH bëhen auditime të mira, nxirren konkluzione të përshtatshme dhe jepen rekomandime

me vlera praktike. E megjithatë, impakti nuk është në nivelet e synuara. Ndoshta është koha të reformojmë mënyrën e komunikimit me palët e interesit. Aktualisht në KLSH ekzistojnë dy kanale të jashtme komunikimi: i pari është ai me subjektet e audituara, administratën publike, i cili është më procedural dhe formal, i dyti është ai me publikun dhe Parlamentin. Në të dyja këto kanale, KLSH ndjek një model tradicional, që nënkupton shkëmbimin e letrave dhe raporteve të gjata me subjektet e audituara, publikimin e raporteve në faqen e internetit, organizimin e konferencave për shtyp dhe prezantimin e raportit tonë vjetor në Parlament. E megjithatë, duhet të mbajmë parasysh se komunikimi është një "rrugë me dy sense lëvizjeje". Nuk mjafton vetëm të informojmë, por duhet edhe të sigurojmë feedback-un e bashkëpunëtorëve tanë. Jetojmë në epokën e informacionit dhe komunikimi është me rëndësi jetike për një SAI që synon të informojë pareshtur qytetarët e vet mbi gjendjen e shërbimeve publike. Komunikimi midis institucioneve publike dhe shoqërisë është një nga shtyllat e demokracisë. Qytetarët që bashkëqeverisin me qeverinë e tyre duhet të jenë të informuar për të marrë vendimet e duhura. Në një shoqëri demokratike janë qytetarët që qeverisin përmes zyrtarëve të vet. Informacioni nga rezultatet audituese dhe funksionimi i KLSH-së është një paketë të dhënash që i nevojitet shoqërisë për vendimmarrje të suksesshme. Ne duhet të përpiqemi të kemi impakt në një shoqëri demokratike, duke i bërë subjektet e audituara bashkëpunëtore në punën tonë audituese. Nëse ia arrijmë që përmes punës sonë t'i bëjmë grupet e interesit të njehsohen me rezultatet e auditimeve tona, atëherë ato do të jenë më të gatshme për t'i brendësuar rekomandimet që ne japim në punën e tyre të përditshme. Parimi është i thjeshtë: Njerëzit përfshihen me të vërtetë atëherë kur ndiejnë se po ndihmohen dhe jo vetëm penalizohen në punën e tyre. Si një ilustrim nga realiteti shqiptar, le të sjellim auditimin më të fundit të kryer nga Departamenti i Auditimit të Performancës mbi shërbimin e ofruar nga Hekurudha Shqiptare. Gjetjet e këtij auditimi tregojnë qartë se pritshmëria e përdoruesve të këtij lloj transporti është në kah të kundërt me shërbimin dhe politikat e zhvillimit të sistemit hekurudhor ofruar sot nga strukturat menaxhuese të tij. Burimet e akorduara për mirëmbajtjen e infrastrukturës hekurudhore janë të pamjaftueshme dhe po çojnë në degradimin e mëtejshëm të rrjetit. Mirëmbajtja e infrastrukturës hekurudhore kërkon më shumë fonde, asnjë masë nuk është ndërmarrë për rehabilitimin e rrjetit hekurudhor, sektori i transportit hekurudhor është i pazhvilluar dhe pa investime thelbësore për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës. Në formën e saj aktuale, hekurudha nuk mund të ketë një të ardhme, ku të ardhurat e gjeneruara nuk mund të mbulojnë koston e nevojshme për të vënë në funksionim hekurudhën. Në përballje me një rast si ky, KLSH ofroi rekomandime këshillimore, të cilat synojnë të përmirësojnë shërbimin e ofruar nga ky lloj transporti. Konkretisht, ndër më të rëndësishmet:

1. Ministria e Punëve Publike dhe Transportit t'i propozojë Këshillit të Ministrave marrjen e vendimit që Hekurudha Shqiptare të jetë një korporatë e veçantë, e cila të luajë një rol efikas për zgjidhjen e problemit të transportit në Shqipëri, duke rritur të ardhurat, ulur koston, siguruar sisteme që lejojnë një formë më të sigurt të funksionimit, zhvilluar aftësitë komerciale dhe të marketingut, çka do ta mundësojë hekurudhën të rivalizojë përkundrejt mënyrave më pak të qëndrueshme të transportit dhe më të ndjeshme ndaj kërkesave të tregut;

2. Drejtoria e Përgjithshme e Hekurudhave të bëjë ndarjen e qartë të llogarive për transportin e mallrave, transportin e udhëtarëve dhe infrastrukturën, në mënyrë që t'u japë mundësi operatorëve ta llogarisin produktivitetin e personelit në bazë të formulave specifike për secilin aktivitet tregtar, pasi kjo ndarje e llogarive deri në këto momente ka qenë formale;

3. DPH të heqë ose të japë për skrap aktivet joekonomike. HSH është e ngarkuar nga barra e aktiveve jo-ekonomike, të cilat kanë dalë tepër nga ndryshimi i kërkesës për transport hekurudhor. Inventari i mjeteve lëvizëse që shfrytëzohen është një përqindje e vogël e aktiveve gjithsej, çka përbën një barrë të konsiderueshme për nivelet e produktivitetit dhe ndotjen e mjedisit. Në dhënien e rekomandimeve të mësipërme, KLSH gjeti mirëkuptimin e drejtuesve të Hekurudhës. Këshillimi i ofruar prej nesh do të kontribuojë në tërheqjen e vëmendjes dhe stimulimin e një sektori të lënë pothuajse në harresë nga vendimmarrja aktuale.

PROF. AS. DR. RECAI AKYEL, NJË PERSONALITET I SHQUAR I AUDITIMIT SUPREM EUROPIAN

Botuar në Gazetën "Ekonomia", më 6 qershor 2013

Në datën 4 qershor, Presidenti i Republikës, SHTZ. Bujar Nishani i akordoi **"Medaljen e Mirënjohjes",** vlerësimin më të lartë për një të huaj, Prof. As. Dr. Recai Akyel, President i Gjykatës së Llogarive të Republikës së Turqisë, me motivacionin: ***"Për kontributin dhe ndihmesën e çmuar në përparimin e Institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit".*** Po dje, në një ceremoni të veçantë, në Universitetin Politeknik të Tiranës, Rektori i këtij Universiteti, Akademik Prof. Dr.Jorgaq Kaçani, në emër të Senatit të Universitetit, i dha titullin "Honoris Causa" Presidentit të Gjykatës së Llogarive të Republikës së Turqisë, Prof.As.Dr.Recai Akyel, për kontributin e tij të qenësishëm në zhvillimin e praktikave moderne të auditimit suprem në nivel evropian dhe botëror, nëpërmjet bashkëpunimeve të frytshme dhe ndihmesës profesionale dhe për shumë institucione supreme auditimi, ndërmjet tyre edhe me KLSH.

Prof. Akyel përfaqëson një personalitet shumëdimensional të auditimit suprem ndërkombëtar dhe ndër partnerët e huaj më me kontribute për Kontrollin e Lartë të Shtetit(KLSH). Ky kontribut ka sjellë rritjen e dukshme të kapaciteteve profesionale të audituesve të KLSH dhe modernizimin e Institucionit, në nivel me standardet e INTOSAI-it (Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme te Auditimit).

Prof. Akyel, në cilësinë e Presidentit të Gjykatës Turke të Llogarive, ka vlerësuar dhe i ka dhënë përparësi marrëdhënieve me KLSH, të cilat janë të hapura, të drejtpërdrejta, me vlerë të shtuar dhe me përfitime te ndjeshme, sidomos nga ana e KLSH. Në sajë të impenjimit të lartë dhe vullnetit të tij për bashkëpunim, kjo marrëdhënie mes dy institucioneve erdhi duke u forcuar dhe u formalizua në muajin nëntor të vitit 2012, me nënshkrimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Kontrollit të Larte të Shtetit dhe Gjykatës Turke të Llogarive. Rezultat konkret i Marrëveshjes ka qenë trajnimi i dhjetëra audituesve të KLSH-së në Ankara, të cilët nën përkujdesjen e drejtpërdrejtë të Prof. Akyel, por edhe të një stafi te përkushtuar dhe të lektorëve profesionistë të Gjykatës Turke të Llogarive, janë trajnuar në fushën e Auditimit të Performancës, të Auditimit Financiar dhe të Auditimit të Prokurimeve Publike, duke përmirësuar dhe përforcuar ndjeshëm dijet e tyre në këto fusha dhe, për rrjedhojë, duke kontribuar në rritjen e cilësisë së punës audituese të KLSH në tërësi.

Personaliteti i Prof. Akyel

Prof. As. Dr. Recai Akyel është një figurë poliedrike e auditimit suprem publik, jo vetëm në mbarë Turqinë, por edhe në komunitetin e organizatave përkatëse botërore të institucioneve të auditimit suprem, si INTOSAI, EUROSAI, AFROSAI, etj. Kontributi i tij me kumtesa, prezantime, broshura dhe realizime marrëveshjesh dypalëshe e shumëpalëshe në dobi të zhvillimit të këtyre institucioneve, është i jashtëzakonshëm. Prof. Akyel ka përfunduar studimet e larta në Fakultetin e Shkencave Politike të Universitetit të Ankarasë. Menjëherë pas diplomimit, ai u specializua në degën e Administratës Publike të Institutit të Shkencave Sociale të Universitetit Gazi. Ai ka kryer trajnime jashtë Turqisë, si në Mbretërinë e Bashkuar dhe në Japoni, ku është specializuar për menaxhimin e katastrofave natyrore. Prof. Akyel mban gradën shkencore Doktor i Shkencave, në Administrim-Biznes dhe titullin e Profesorit të Asociuar. Ai ka një aktivitet te gjerë akademik si profesor i Menaxhimit Strategjik në fushën e Administrimit të Biznesit. Mbështetur në formimin e tij, ai ka ushtruar aktivitetin e tij profesional në administratën publike si Guvernator i qarkut të Eskisehir dhe më pas si Guvernator i një province që përmbledh disa qarqe. Gjatë punës së tij në këto detyra është evidentuar

si administrator i spikatur dhe për kontributin e dhënë është dekoruar në vitin 2008 me titullin *"Guvernator i Vitit"*.

Prof. Akyel është një intelektual i njohur në Republikën e Turqisë dhe një administrator me eksperiencë, që ka ditur të sinkronizojë në mënyrë optimale këto vlera pozitive dhe të nderohet në vitin 2011 nga Qendra Turke Aziatike për Studime Strategjike (TASAM) me "*Çmimin për Vizionin Strategjik*".

Kontributi në komunitetin INTOSAI

Prof. Akyel drejton Gjykatën Turke të Llogarive që nga muaji prill i vitit 2007. Kontributi i tij është vlerësuar edhe ndërkombëtarisht, duke qenë anëtar i Bordeve Drejtues të Organizatës Aziatike të Institucioneve Supreme të Auditimit (ASOSAI), Organizata e Bashkëpunimit Ekonomik të Institucioneve Supreme të Auditimit (ECOSAI) dhe Organizata Evropiane e Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAI). Ndihmesa e tij për organizatat simotra dhe partnere të SAI-t turk ka qenë e jashtëzakonshme, me lidhje marrëveshjesh, aktivitete të përbashkëta, broshura, kumtesa, prezantime.

Dua të përmend këtu prezantimin shumë kuptimplotë të tij në Konferencen e VII-të të EUROSAI-OLACEFS, në Tbilisi, Gjeorgji(ku mori pjesë edhe një delegacion i KLSH i kryesuar prej meje), në shtator 2012, me titull "*Rritja e besimit të partnerëve tanë: integriteti i menaxhimit të auditimit, përgjegjësia dhe theksi tek lidershipi*", ku shtjellon, ndër të tjera, sfidat e institucioneve të auditimit suprem në drejtim të përmirësimit të menaxhimit në nivelin më të lartë, të rritjes së cilësisë së auditimeve dhe rekomandimeve të tyre. Cilësimet kryesore në këtë prezantim përbëjnë një udhërrëfyes të saktë për çdo reformator në fushën e auditimit publik. Këtë prezantim ne e kemi publikuar të plotë në Revistën "Auditimi Publik" Nr. 3 të KLSH.

Me shumë rëndësi ka qenë edhe broshura e prezantuar nga Prof. Akyel në Konferencën e IV-t të EUROSAI-ARABOSAI, në Baku, Azerbajxhan, në prill 2013, mbi "*Rëndësinë e specifikimit të kufijve dhe objektivave të auditimit të jashtëm dhe të brendshëm financiar në përmirësimin e menaxhimit financiar publik*". Në sajë të eksperiencës së tij të fituar në administrimin publik të shumë krahinave në Turqi(duke qenë guvernator i tyre), Prof. Akyel është një njohës i mirë i auditimit të brendshëm publik dhe gjykimet e tij mbi specifikat e dy lloj auditimeve publike, të prezantuara me mjeshtëri në këtë broshurë, ndihmojnë vendim-marrësit e institucioneve më të larta të auditimit publik në dhënien e opinioneve cilësore për punën e auditimit të brendshëm.

Në Konferencën e Parë EUROSAI-ASOSAI, në Stamboll, Turqi, në shtator 2011, në sesionin me temë "Qasjet dhe sfidat bazë për sigurimin e transparencës dhe përgjegjësisë", Prof. Akyel prezantoi kumtesën me titull "*Rëndësia e kapaciteteve të komunikimit të institucioneve të auditimit suprem në rritjen e efektivitetit të tyre*". Sot ka dalë në pah më shumë se kurrë sfida e institucioneve të auditimit suprem për të komunikuar në mënyrë sa më transparente me partnerët e tyre kryesorë: publiku, shoqëria civile dhe qeveritë, në forcimin e disiplinës financiare. Eksperienca e sjellë nga Prof. Akyel është unike dhe me vlerë universale.

Prof. Akyel është autor i disa librave për menaxhimin publik. Në to, ai ka sjellë eksperiencën e fituar me një punë dhe aktivitet shembullor. Ai është specialist i menaxhimit publik të katastrofave natyrore. Në librin e tij "Tërmet në Golyaka", ai përshkruan përvojën e administrimit shtetëror në ditët e vështira të tërmeteve në gusht dhe nëntor të vitit 1999 në këtë krahinë. Qasjet strategjike, mendimet, vërejtjet dhe konkluzionet e tij për mënyrën e organizimit dhe etikën e menaxhimit shtetëror në shërbimet publike për popullsinë në kohë emergjencash civile janë shumë të vlefshme për cilindo menaxhues shtetëror.

Kontributi i Prof. Akyel në Revistën e KLSH dhe e ardhmja e dy institucioneve tona

Prof. Akyel ka një kontribut të rëndësishëm në realizimin e botimit të revistës shkencore 4-mujore të KLSH me titull "Auditimi Publik", me shkrime dhe orientime cilësore për të ardhmen e saj. Po ashtu, ai ka dhënë miratimin e tij që çdo botim me interes për KLSH, i Revistës shkencore të Gjykatës Turke të Llogarive të mund të botohet në revistën tonë, duke sjellë eksperienca interesante dhe tejet të vlefshme dhe realizuar kështu mundësinë e shkëmbimit edhe virtual të eksperiencave dhe vlerave pozitive midis Institucioneve Supreme të Auditimit. Ky shkëmbim është pa dyshim një formë me vlerë në marrëdhëniet tona dypalëshe, duke pasur parasysh zhvillimet e sotme të auditimit ndërkombëtar, gjithnjë e më të ndërthurura me teknologjinë e informacionit dhe botën e internetit.

E ardhmja e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit mes KLSH dhe Gjykatës së Llogarive të Turqisë është e shkëlqyer. Projektimi i këtyre marrëdhënieve në të ardhmen e afërt është shume konkret dhe me impakt tejet pozitiv për modernizimin e KLSH. Gjatë këtij viti dhe në vijim do të vazhdojnë trajnimet e audituesve të KLSH në Qendrën e Trajnimeve të Gjykatës Turke të Llogarive në Ankara. Këto dite zhvilluam me Presidentin Akyel idenë qe TCA te ndihmoje me trajnime edhe Zyrën e Auditorit te Përgjithshëm te Kosovës, për çka ai ra dakort tërësisht me ne si KLSH. Një grup audituesish dhe specialistësh të KLSH po përgatitet të shkojë këtë muaj. Specialistë dhe ekspertë të

Gjykatës Turke do të vinë në të ardhmen të trajnojnë dhe japin kumtesa për aspekte të ndryshme të auditimit suprem publik dhe në Tiranë, duke ndarë me ne, por edhe me audituesit tanë të brendshëm, përvojën e vyer të kësaj Gjykate. Mund të parashikojmë edhe auditime të përbashkëta, të cilat do të jenë me shumë interes. Mbi bazën e raporteve tona, krahas dashamirësisë, ndjenjës tradicionale të miqësisë dhe marrëdhënieve mes kolegësh që respektojnë njeri-tjetrin, qëndron moto e INTOSAI "Experentia Mutua Omnibus Prodest" (Eksperienca e përbashkët u shërben të gjithëve).

RRITJA E PËRGJEGJSHMËRISË INSTITUCIONALE

Botuar në Gazetën "Panorama", më 26 qershor 2013

Përgjegjshmëria institucionale e qeverisjes është një formë e kontrollit mbi institucionet dhe agjencitë publike, duke bërë që ato të japin llogari për kontabilitetin dhe veprimet e tyre. Si e tillë, ajo përbën një koncept thelbësor në një administratë publike të një vendi demokratik. Sot, kudo në botë, por sidomos në Europë, pas shpërthimit të krizës në eurozonë vërehet një kërkesë e shtuar për përgjegjësi institucionale të qarta në përballimin e krizës. Ka po ashtu një presion të konsiderueshëm mbi Institucionet Supreme të Auditimit (quhen shkurt "SAI", janë KLSH-të e vendeve të tjera europiane) për të luajtur një rol më aktiv, në përputhje me mandatin e tyre.

Kjo kërkesë lind nga një pritshmëri në rritje ndaj tyre, që vjen nga partnerët e tyre të natyrshëm, si qytetarët, organizatat e shoqërisë civile, investitorët, por edhe qeveritë. Pritet që këto institucione të ndihmojnë konkretisht në daljen nga kriza te vendet që janë të mbërthyera në darën e saj, ose në zbutjen e pasojave të krizës, te vendet që po i përjetojnë këto pasoja. Për shkak të krizës financiare dhe ekonomike në eurozonë dhe të goditjeve të paparashikuara të saj, në të gjitha vendet europiane, por edhe më tej, ndihet një nevojë në rritje për sigurimin e një qeverisjeje të mirë dhe shpenzimin efektiv të parave publike. Institucioni Suprem i Auditimit (SAI), si audituesi i jashtëm i pavarur i buxhetit të shtetit, synon të arrijë nivelin e duhur të ndikimit të auditimit. Ky ndikim mund të rezultojë në shpenzime qeveritare më të ulëta, si dhe në menaxhim më efektiv të financave publike.

Ai mund të sjellë rritjen e transparencës, besimit dhe të llogaridhënies. Dimensioni i llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë së institucioneve publike është parësor në vende në zhvillim që synojnë hyrjen në grupin e vendeve të zhvilluara, sikurse është vendi ynë, për të siguruar mirëqeverisjen. Prandaj ia vlen ta shikojmë këtë dimension më në detaje. Qeverisja e mirë e forcon aftësinë ekzekutive të qeverisë, e bën këtë të fundit më të përgjegjshme dhe rrit besimin e publikut tek ajo. Në një demokraci, qytetarët ua besojnë administrimin e burimeve publike të vendit përfaqësuesve të zgjedhur të tyre, anëtarëve të Parlamentit. Këta përfaqësues nga ana e tyre ia besojnë funksionin e menaxhimit të burimeve publike krahut ekzekutiv, qeverisë. Çdo vit Parlamenti miraton një buxhet për Ekzekutivin, për administrimin e punëve shtetërore. Në fund të vitit fiskal, qeveria është e detyruar të japë llogari për administrimin e burimeve publike në Parlament.

Ngaqë Kuvendi nuk mund t'i verifikojë vetë llogaritë e paraqitura nga Ekzekutivi, SAI është i mandatuar nga Kushtetuta e vendit për të audituar këto llogari dhe për të raportuar gjetjet e tij në Kuvend. Kuvendi sheh nëse ky raportim është në përputhje me

synimet e Parlamentit. Roli e SAI-t për këtë arsye është një element i rëndësishëm për të ndihmuar integritetin dhe përgjegjshmërinë e çdo sistemi të qeverisjes. SAI siguron që Kuvendi ka qasje të plotë në informacionin e pavarur të auditimit për përgjegjshmërinë dhe efektivitetin e menaxhimit të burimeve publike nga Ekzekutivi. Që kjo qasje realisht të jetë sa më e plotë dhe Kuvendi ta marrë të gjithë informacionin që i intereson, për rastin tonë, ndoshta do të ishte me vend që brenda Komisionit të Kuvendit për Ekonominë dhe Financat të funksiononte një nënkomision për Auditimin Suprem të Shtetit, i cili fillimisht mund të mos ketë më shumë se tre apo pesë anëtarë të Kuvendit, por roli i të cilit do të ishte shumë efikas.

Kjo, sepse raporti i SAI-t mbi arsyeshmërinë dhe drejtësinë e llogarive financiare qeveritare i siguron qytetarët që burimet publike të miratuara nga përfaqësuesit e tyre kanë qenë shfrytëzuar për qëllimet e synuara. SAI gjithashtu ndërmerr auditime për të matur vlerën e parave publike të shpenzuara, për të informuar Kuvendin dhe qytetarët në lidhje me ekonomicitetin, eficiencën dhe efektivitetin me të cilat kjo para publike është shpenzuar. Këto auditime i japin qeverisë mundësinë për të përmirësuar performancën e saj. Ndërsa qeveria ushtron fuqinë e menaxhimin e ekonomisë publike dhe shoqërisë në emër të qytetarëve, ajo duhet të respektojë ligjet financiare dhe parimin e funksionimit ligjor të administratës publike. Auditimi suprem si institucion, si një pjesë e rëndësishme e sistemit të mbikëqyrjes publike, luan një rol të rëndësishëm në realizimin e përgjegjshmërisë administrative dhe publike dhe në funksionimin e një qeverie të sunduar nga ligji. Ndërtimi i një qeverie me kosto të ulët dhe efektivitet të lartë është një objektiv i rëndësishëm dhe kërkesë parësore nga publiku sot.

Si përgjigje ndaj kësaj kërkese, ne si KLSH kemi intensifikuar auditimet mbi qeverinë dhe shpenzimet e të ardhurat financiare, duke promovuar, ndërkohë, auditimin e performancës në një mënyrë graduale. Në vitet e fundit, për hir të së vërtetës, duhet pohuar se qeveria ka ndërmarrë një sërë hapash për të reduktuar administratën publike dhe për të përmirësuar efektivitetin e saj. Por, duke iu përgjigjur sfidave të reja, kushteve gjithnjë në ndryshim, ne si KLSH duhet të përdorim dhe aktivizojmë burime jo-konvencionale, të tilla si njohuri dhe kapital shoqëror, për të qenë sa më të përshtatshëm, efektivë dhe për të arritur qëllimin tonë strategjik, që është administrimi sa më i mirë dhe modern i parasë publike. Dua ta shtjelloj më shumë këtë rol të ri, duke sjellë edhe eksperiencën e SAI-ve të vendeve të Bashkimit Europian. SAI-t kanë mandat (shpesh edhe kushtetues, sikurse është rasti i Kontrollit të Lartë të Shtetit) në nivel kombëtar për të kryer auditime të jashtme, që t'iu shërbejnë sa më mirë taksapaguesve dhe qytetarëve për sigurimin e shpenzimit racional, efiçient, efektiv dhe ligjor të parasë publike. SAI-et, në sajë të pavarësisë, profesionalizmit dhe ndershmërisë së tyre, të sanksionuar në standardet e fushës INTOSAI, kanë sot një pozicion unik për të kthyer besimin në publik ndaj institucioneve buxhetore, të tronditur disi nga pasojat e krizës së

përbotshme ekonomike dhe financiare. SAI-t e vendeve të Bashkimit Europian gjatë këtyre viteve të krizës(2009-2013) në Eurozonë, janë treguar shumë aktive për të marrë përsipër përgjegjësi të reja në një ambient ekonomik dhe shoqëror në ndryshim të shpejtë.

Institucionet dhe tipi i ndërhyrjeve	**Ndërhyrjet**
Banka qendrore	Ulja e normës së interesit Injektimi i likuiditetit Zgjatja e maturitetit të kredive të dhëna Zgjerimi i gamës së kolateralit Zgjerimi i grupit të partnerëve(palëve) Dhënie aksesi institucioneve financiare për huadhënës të pakufizuar të fundit (unlimited lender of last resort)
Qeveria	Rritja e garancisë për depozituesit dhe kreditorët e bankave Dhënia e mundësive për kredi ndaj institucioneve jo-financiare Skema sigurimi për mbrojtjen e bankave nga asete toksike
Stimuli fiskal i qeverisë	Subvencione Investime qeveritare Konsum qeveritar Ulja e taksës së punës dhe taksës së fitimit të korporatave
Ekonomia reale e ndihmuar nga qeveria-tregu i punës	Ulja e shpenzimeve të fuqisë punëtore për të mbështetur punësimin Mbështetja e fuqisë blerëse të shtëpiakeve Mbajtja dhe fuqizimi i mbështetjes sociale Zbutja e impaktit të krizës financiare mbi individët
Ekonomia reale e ndihmuar nga qeveria-investimet	Rritja e efi-çiencës së energjisë Ndërtimi i infrastrukturës fizike Mbështetja e aktiviteteve të Kërkimit Shkencor dhe Zhvillimit Promovimi i inovacionit
Ekonomia reale e ndihmuar nga qeveria- mbështetja e biznesit	Mbështetje sektoriale (sidomos eksportet) Lehtësimi i aksesit në kredi

Ato kanë ndihmuar me auditimin e sistemit të ri rregullator të ngritur në BE për përballimin e krizës, të përbërë nga Banka Qendrore Europiane, bankat qendrore të vendeve anëtare, institucionet qeveritare dhe institucionet e tjera rregullatore. SAI-t e BE-së dhe Gjykata Europiane e Audituesve kanë përcaktuar qartë pesë faza të reagimit ndaj krizës: fazën përgatitore, përgjigjen e menjëhershme, menaxhimin e krizës (ose pasojave të saj), strategjitë e daljes prej saj dhe sistemin e ri të rregullave. Qasja e auditimit të sistemit financiar rregullator mund të zbatohet edhe te ne, vendet në periferi të krizës së eurozonës, por që kemi ndier dukshëm pasojat e saj, të vërejtura sidomos me ndalimin ose uljen e ndjeshme të rritjes ekonomike, si në Maqedoni, Mal të Zi, Bosnjë- Hercegovinë dhe Shqipëri (në vendin tonë pasojat kanë sjellë uljen e rritjes ekonomike). Në rast se ky sistem financiar rregullator nuk është vendosur, ai duhet të krijohet. Tek ne, edhe pse jo me një emërtim apo formulim të plotë, ai ka funksionuar, me konsultimet e herëpashershme mes Ministrisë së Financës dhe Bankës së Shqipërisë. Por gjykoj se koha ka ardhur që këto konsultime dhe ky bashkëveprim të institucionalizohen më tej, duke përfshirë edhe agjenci të tjera shtetërore, si Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Autoriteti i Konkurrencës, INSTAT, KLSH, etj. Objektivi kryesor i një SAI në përballimin e pasojave të krizës së sotme është që të ketë një funksion të përmirësuar ruajtës (watchdog) mbi shpenzimin publik, duke siguruar aspektet e tij të ligjshmërisë, pajtueshmërisë dhe mirëqeverisjes. Ne si KLSH do të kryejmë auditime dhe japim rekomandime për ekzistencën, veprimin dhe përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit të riskut dhe të kontrollit. Ne do të kryejmë sidomos auditime performance mbi sistemin financiar rregullator të vendit. Do të bashkëveprojmë me SAI-t e tjera në rajon për marrjen e eksperiencave të dobishme në auditimin e këtij sistemi, duke siguruar cilësinë dhe besueshmërinë e informacionit kryesor financiar. Vetëm kështu mund të garantojmë veprimin e një sistemi financiar rregullator fleksibël dhe efikas. Askush nuk ka kohë të humbasë dhe, edhe pse në teori, fazat e ndërhyrjes dhe përballimit të pasojave të krizës janë të ndara, në praktikë ato ndërthuren me njëra-tjetrën. Mendoj se për ne është koha të angazhohemi në fazën e përgjigjes së menjëhershme. Kjo fazë mbulon politikën monetare të bankës qendrore dhe veprimet financiare dhe fiskale të qeverisë për të kufizuar shtrirjen e pasojave të krizës dhe për të parandaluar rëndim të treguesve në sistemin financiar (si për shembull, në rastin tonë, rritjen e mëtejshme të nivelit të kredive të këqija, etj.). Për ndërhyrje efektive është thelbësore kuptimi i gjerë dhe i thellë i situatës së shpalosur, karakteristikat dhe shtrirja e veprimeve përmirësuese që duhen të ndërmerren. Kjo kërkon disponueshmëri të një informacioni të saktë e të besueshëm, role dhe përgjegjësi të qarta të strukturave që ndërhyjnë dhe një koordinim të mirë-projektuar, si dhe mekanizma efektivë raportimi për masat e marra.

Për të kuptuar më mirë funksionimin e përgjigjes së menjëhershme ndaj pasojave të krizës, na shërben tabela e mësipërme. SAI duhet të vlerësojë rreziqet për qytetarët në lidhje me strategjitë e daljes nga kriza apo të zbutjes së pasojave të krizës. Këtë vlerësim po e kryejmë me seriozitet dhe përgjegjësi edhe ne si KLSH. Detyrë e re auditimi është vlerësimi i shitjes së aseteve publike në kohë krize apo kur ekonomia vuan pasojat e krizës. Mekanizmi i auditimit mbi strategjitë e daljes apo zbutjes së pasojave të krizës kërkon raporte shumë cilësore të performancës dhe aftësi të veçanta.

SAI duhet të ofrojë përvoja dhe mësime për institucionet publike që auditon, duke theksuar rolin e tij këshillues dhe parandalues, sikurse e kam përmendur në një shkrim të mëparshëm. Ai duhet të përgatitet për sfidat e ardhshme. Dua të siguroj të gjithë qytetarët se KLSH është plotësisht e gatshme ta marrë përsipër këtë rol dhe përgjegjësi të re, për rritjen efektive të përgjegjshmërisë institucionale në Shqipëri.

MBI ZBATIMIN E BUXHETIT TE SHTETIT TE VITIT 2012

Botuar në Gazetën "Rilindja Demokratike", 13 tetor 2013

(Ky shkrim është përmbledhje e Raportit të KLSH për Buxhetin Faktik 2012, shih në këtë libër faqet 80-93)

KLSH DHE ADMINISTRIMI I BUXHETIT TE SHTETIT

Botuar në Gazetën "Telegraf", më 14 nëntor 2013

Objektivi ynë kryesor në Raportin e KLSH "Për Zbatimin e Buxhetit të Shtetit të vitit 2012", në respektim të detyrimit kushtetues, është dhënia e opinionit për raportin që Ministri i Financave dhe Këshilli i Ministrave paraqet në Kuvend "Për zbatimin e Buxhetit të Shtetit të vitit 2012". Opinioni i përgjithshëm i KLSH, në përputhje të plotë me Standardin ISSAI 1700 të auditimit suprem, për Zbatimin e Buxhetit të Shtetit për vitin 2012, para miratimit të tij nga Kuvendi i Shqipërisë, është se përgatitja, shqyrtimi dhe miratimi i buxhetit të vitit 2012, zbatimi, ndjekja dhe rishikimi i tij, të drejtat dhe kufizimet për huamarrjen, garancitë dhe format e tjera të rrjedhura prej tyre si dhe kontrolli, kontabiliteti, raportimi dhe auditimi i këtij buxheti, janë kryer në respektim të kërkesave të ligjit "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ligjit "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2012", të ndryshuar, si dhe të ligjit "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin".

Duke patur parasysh mjedisin e pafavorshëm në të cilin u realizua Buxheti i vitit 2012, si pasojë e ndikimit në rritje të elementëve të krizës ekonomike dhe financiare botërore dhe sidomos në Eurozonë, vlerësojmë pozitivisht punën e bërë nga Qeveria Berisha në tërësi, nga Ministria e Financave, Ministritë e tjera, Institucionet e tjera qendrore dhe vendore, si dhe entet e tjera publike të audituara, për përmbushjen e objektivave të Buxhetit të vitit 2012 dhe për zbatimin e masave të programuara, në kuadër të Planit Kombëtar të Zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit Shqipëri-BE.

Konstatojmë se treguesit fiskalë të konsoliduar të Buxhetit të Shtetit për vitin 2012, në tërësi janë realizuar.

Borxhi publik

Në bazë të standardit ISSAI 5440 për Auditimin e Borxhit Publik "Udhëzim për planifikimin dhe kryerjen e nje auditimi mbi Borxhin Publik", u përqëndruam në auditimin e ligjshmërisë së menaxhimit te borxhit publik për vitin 2012. Theksojmë se me ligjin nr. 114, datë 07/12/2012, të hyrë në fuqi në 3 Janar të vitit 2013, është hequr kufiri ligjor i borxhit prej 60% të PBB-së. Borxhi publik ka ngelur pa një tavan të përcaktuar dhe kjo ka krijuar premisa për rritje të vazhdueshme të tij në periudhat në vijim.

Në vijim dhe të rekomandimit të lënë prej nesh në vitin 2012, i kemi rekomanduar Ministrisë se Financave të ngrejë një grup pune me ekspertët më të mirë të fushës, për përgatitjen dhe paraqitjen e një nisme ligjore për vendosjen në Kushtetutë dhe në Ligjin

"Për menaxhimin e sistemit buxhetor" të pragut të treguesit të borxhit publik ndaj PBB-së. Në të, të parashikohet që: "Përjashtim nga ky rregull të bëjnë rastet e emergjencave, katastrofave natyrore dhe krizave ekonomike". Ne momentin e kalimit të pragut të borxhit publik kundrejt PBB-së, nga situatat e parashikuara, Qeveria duhet të marrë masa për balancimin e Buxhetit.

Nga auditimi, konstatuam se ligji "Për menaxhimin e sistemit buxhetor" është i ndryshueshëm me vendimmarrje të thjeshtë në Kuvend. Me synim zvogëlimin e risqeve potenciale ndaj këtij ligji themeltar për menaxhimin e financave publike, kemi rekomanduar që ligji te ndryshohet vetëm me shumicë të cilësuar parlamentare.

Detyrimet ndaj sipërmarrjes private

Krahas rritjes së borxhit publik, shqetësim për ekonominë tonë përbëjnë dhe detyrimet që Buxheti i Shtetit ka kundrejt sipërmarrësve privatë. Në raportin "Për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2011", kemi rekomanduar "saktësimin dhe shqyrtimin me realizëm të gjendjes së këtyre borxheve, si dhe përcaktimin e masave për të lehtësuar sa të jetë e mundur sipërmarrjen private nga kosto e kredive që ajo mund të ketë marrë për përmirësimin e situatës së saj financiare, nëpërmjet ndërhyrjes për ristrukturimin e kredive dhe ndërkohë mbledhjen e borxheve të këqija".

Kemi konstatuar mos angazhim për të zbatuar rekomandimin tonë dhe një përkeqësim të situatës, si rrjedhojë e çeljes së fondeve në mënyrë pjesore, apo realizim të investimeve të reja, pa mbuluar me fonde investimet në proces. Kemi rekomanduar që në Ligjin "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2014" të parashikohet që të ardhurat nga privatizimet duhet të përdoren së pari dhe kryesisht për të ulur borxhin publik, ku 50% të jetë kufiri i poshtëm, dhe pjesa tjetër të shkojë për uljen e detyrimeve për faturat e papaguara ndaj sipërmarrësve privatë për punët publike të realizuara. Të parashikohet që institucionet buxhetore, gjatë detajimit të fondeve të investimeve publike, të kenë detyrimin e përfshirjes në financimin e vitit "në radhë të parë" të të gjitha investimeve të kontraktuara, apo punimeve, të cilat rezultojnë të realizuara dhe nuk janë financuar për vitin ushtrimor. Këto procedura të përfshihen në udhëzimin specifik për zbatimin e Buxhetit të Shtetit të vitit 2014 dhe të jenë pjesë e Ligjit "Për menaxhimin e sistemit buxhetor".

Për shkak të ndjeshmërisë së madhe që ka fenomeni i detyrimeve të Buxhetit të Shtetit ndaj kontraktorëve privatë, fokusuam auditimin edhe në mënyrën e regjistrimit në sistemin informatik. Nga auditimi i kryer në disa degë thesari, rezultoi se për kontratat shumëvjeçare, regjistrimi në sistem kryhet për vlerën totale dhe për vitin korrent, duke mos marrë në konsideratë afatet e realizimit të këtyre kontratave në vite dhe nevojën për financime sipas këtyre afateve. Kemi rekomanduar që në Udhëzimin standard të zbatimit të Buxhetit te vitit 2014, të shtohet përcaktimi që: "Degët e thesarit në rrethe,

në rastin e kontratave shumëvjeçare, të regjistrojnë në sistem kontratat në shtrirje sipas viteve të parashikuara".

Konsolidimi i pasqyrave financiare

Në vijimësi, në raportet tona kemi evidentuar problematikën e mungesës së pasqyrave financiare të konsoliduara të Shtetit, situatë që është përsëritur edhe për vitin 2012. Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit, që në bazë të ligjit është përgjegjëse për raportimin financiar, nuk ka bërë të mundur hartimin e këtyre pasqyrave në përputhje me të gjitha kërkesat ligjore dhe rregullatore që lidhen me raportimin financiar. Informacioni i plotë, i përgjegjshëm dhe profesional për llogarite e Shtetit kërkon përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara.

Hartimi i bilancit pasuror të shtetit, në përputhje me standartet ndërkombëtare të kontabilitetit publik është një objektiv strategjik për të cilin është parashikuar realizim gradual. Duke vlerësuar si të domosdoshme pasqyrat financiare të konsoliduara të Shtetit në marrjen e një pamje të qartë të situatës financiare të Shtetit, por dhe duke njohur rëndësinë e tyre për të siguruar një qeverisje më të mirë, kemi rekomanduar që Ministria e Financave (Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit) të marrë masa të menjëhershme për përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara të Shtetit për vitin 2012, dhe në vijim të realizohet rishikimi brenda një kohe të shkurtër i kuadrit të plotë rregullator të raportimit financiar në sektorin publik, duke mbajtur parasysh Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik, si dhe duke i dhënë rëndësinë e duhur fuqizimit të sektorit të kontabilitetit dhe raportimit financiar në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit.

Fondi rezervë i Këshillit të Ministrave dhe ai i kontigjencave

Nga auditimi i përdorimit të Fondit Rezervë të Këshillit të Ministrave për vitin 2012, në shumë nga projektet u konstatua përdorimi korrekt, ekonomik dhe ligjor i këtij fondi nga Këshilli i Ministrave. Gjatë auditimit të përdorimit të Fondit të Kontigjencës për ruajtjen e deficitit, konstatuam përdorimin e tij me Vendim te Këshillit te Ministrave, për qëllime te tjera. Kemi rekomanduar që në Ligjin për Buxhetin e Shtetit te vitit 2014, Ministria e Financave të kërkojë që përdorimi i Fondit të Kontigjencës për ruajtjen e deficitit buxhetor, të bëhet me miratim nga Kuvendi i Shqipërisë.

Auditimi i kryer në Bankën e Shqipërisë

Duke vlerësuar maksimalisht rolin e rëndësishëm që ka patur Banka e Shqipërisë në ruajtjen e stabilitetit monetar, si dhe duke patur parasysh gjendjen e ekonomisë të prekur ndjeshëm nga pasojat e krizës globale, theksojmë se konstatimet e auditimit nuk mund të zhvlerësojnë përpjekjet e mëdha që Banka e Shqipërisë ka bërë për të arritur objektivat e saj.

Vërejtëm se sipas ligjit "Për Bankën e Shqipërisë" të vitit 1997, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës ka të drejtën për të përcaktuar nivelin e pagave dhe të shpërblimeve të stafit të Bankës së Shqipërisë. Nga auditimi rezultoi rregullshmëria ligjore e pagesave të mbështetura në vendimet e këtij Këshilli, por konstatuam mosrespektim të ndjeshmërisë qytetare në lidhje me nivelet shumë të larta të pagesave për drejtuesit, krahasuar me nivelin e pagës dhe trajtimet e punonjësve të institucioneve të tjera kushtetuese. Kemi rekomanduar që të fillojë nisma ligjore për rishikimin e Ligjit për Bankën e Shqipërisë, në frymën e minimizimit të riskut potencial të abuzimit me pavarësinë dhe shmangies së konfliktit të interesit, që evidentohet në praktikat e përcaktimit të pagave dhe shpërblimeve për nivelet drejtuese. Kërkuam që të përcaktohet një kornizë e kujdesshme rregullatore në lidhje me nivelin e pagës së Guvernatorit, e cila duhet të ndjekë trendin e pagave të tregut bankar, por gjithmonë duhet të jetë në raporte të pranueshme, krahasuar me pagën e Presidentit të Republikës, bazuar kjo në përvojat dhe praktikat më të mira të vendeve të ngjashme, por pa harruar përshtatshmërinë me realitetin shqiptar. Kërkuam gjithashtu, të vendosen nivele të arsyeshme për shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës, në mënyrë që pagat e tyre së bashku me shpërblimin në BSH, të mos jenë më shumë se sa paga e anëtarëve të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

Ne, si Institucion Suprem Auditimi mendojmë që Komisioni i Ekonomisë, Komisioni i Ligjeve dhe Kuvendi duhet ta trajtojnë këtë problematikë në thellësi, në mënyrë që, duke mos cenuar pavarësinë e këtij Institucioni të rëndësishëm dhe në kujdes të ruajtjes së qëndrueshmërisë së burimeve njerëzore cilësore të tij, të bëhen ndryshimet e nevojshme ligjore, në bashkëpunim dhe në respekt të Bankës së Shqipërisë dhe drejtuesve të saj, por mbi të gjitha, në respekt të ndjeshmërisë qytetare.

Të ardhurat buxhetore nga tatimet

Për vitin 2012, borxhi tatimor rezultoi në një nivel shumë të lartë, me rreth 70 miliardë lekë, ose 500 milionë euro, me një rritje 8% nga viti 2011. Rritja e borxhit tatimor, megjithë pakësimin e debitorëve, si pasojë e zbatimit të ligjit "Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të Borxhit Tatimor dhe Doganor", thekson paaftësinë e administratës tatimore në mbledhjen e borxhit tatimor.

Të ardhurat buxhetore nga organet doganore

Gjatë vitit 2012, borxhi doganor rezulton me rritje, i shtuar ne subjekte dhe në vlerë. Konstatuam përpjekje të pafinalizuara të autoriteteve doganore kompetente dhe strukturave të specializuara të Administratës Doganore, për rikuperimin e borxhit doganor, qoftë dhe me forcë, ndërkohë që gjatë auditimeve në gjashtë degë doganore, kemi konstatuar dëm ekonomik.

Buxheti i pushtetit vendor

Për të mundësuar dhënien e një opinioni të bazuar për zbatimin e ligjshmërisë nga njësitë e pushtetit vendor, kemi audituar 40 subjekte, nga të cilat 22 bashki, 11 komuna, 2 këshilla qarqesh, 2 prefektura dhe 3 ndërmarrje në varësi të Bashkisë Tiranë.

Nga auditimi ka rezultuar se, të ardhurat në total në pushtetin vendor janë realizuar me ulje 9.2 përqind nga viti 2011. Kemi rekomanduar marrjen e masave urgjente nga organet e pushtetit vendor, për përmirësimin e gjendjes dhe shpërblimin e dëmit ekonomik të konstatuar.

Buxheti i Sigurimeve Shoqërore

Sigurimet shoqërore sigurojnë 15% të të ardhurave të Buxhetit të Shtetit. Per vitin 2012, ato grumbulluan 49,3 miliardë lekë, ose 2.8 % me pak se plani vjetor. Konstatuam mosrealizim te të ardhurave të programuara. Kemi rekomanduar marrjen e masave të menjëhershme nga ISSH, Ministria e Financave dhe DPT dhe hartimin e një udhëzimi të Ministrit të Financave, ku të përcaktohet mënyra e raportimit dhe evidentimit të kontributeve, mënyra e raportimit të të dhënave mujore dhe progresive për detyrimet e kontributeve të papaguara në afat dhe për kamatë-vonesat e tyre, si dhe sanksione më të ashpra për mosdorëzim të listë-pagesave brenda afateve.

Tregu informal i punës

Nga auditimi i Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, rezulton nga të dhënat zyrtare se niveli i informalitetit paraqitet shumë i ulët. Nëse kjo do të ishte gjendja reale, arritjet e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore do të ishin madhore, duke na renditur ndër vendet me informalitet më të ulët në botë. Ne fakt, për gjendjen e informalitetit të përhapur tek ne kanë paraqitur shqetësim edhe organizmat ndërkombëtare si Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore, etj. Nga studimet e kryera prej tyre ose organizmave të tjerë, informaliteti paraqitet në nivele të larta. Konstatuam se inspektorët nuk e njohin situatën e subjekteve që zhvillojnë aktivitet në territorin që mbulojnë. Inspektorati Shtetëror i Punës ka 57 mijë subjekte më pak(kompani të regjistruara) se sa Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Mungesa e të dhënave te dixhitalizuara në nivel kombëtar ka bërë që drejtoritë rajonale të kryejnë inspektime në një numër të vogël subjektesh. Për të ulur subjektivizmin e strukturave inspektuese, kemi rekomanduar inspektime me grupe të përbashkëta, ku të përfshihen Inspektorati Shtetëror i Punës, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe veçanërisht Instituti i Sigurimeve Shoqërore, i cili është përfituesi direkt nga minimizimi i punës së zezë. Ky Institut, me legjislacionin ekzistues është përjashtuar nga kjo e drejtë.

Referuar dobisë ekonomike të auditimeve të KLSH, për vitin 2012, për çdo lek të

Buxhetit të Shtetit të investuar në KLSH, ky institucion ka kërkuar për t'u zhdëmtuar 51.7 lekë, ose 87 përqind më shumë se një vit më parë.

Disa mendime për Raportin e Këshillit të Ministrave për të ardhurat dhe shpenzimet e vitit financiar 2012, si dhe për përgatitjen e projekt-Buxhetit të vitit 2014.

Me synim miradministrimin e fondeve publike gjatë vitit të ardhshëm buxhetor 2014, duke patur parasysh porosinë e përmbajtur në Deklaratën e Pekinit të Kongresit të XXI-të të INTOSAI dhe nën këndvështrimin e rekomandimeve të Kongresit të V-të të EUROSAI-t për rritjen e rolit të Parlamentit në përgatitjen e Buxhetit të Shtetit, duke përdorur me efektivitet SAI-n, sugjerojmë:

- Përgatitjen e një Buxheti realist, duke shmangur praktikën e vërejtur vitet e fundit të korrigjimit të Buxhetit në gjysmën e vitit financiar;

- Vendosjen e një tavani kushtetues për borxhin publik në përqindje të PBB-së, me kusht që ai të tejkalohet vetëm në rastet e emergjencave, katastrofave natyrore dhe krizave ekonomike. Në rastet e tejkalimit të kufirit, Qeveria të marrë masa për balancimin e Buxhetit. Të vendoset në ligjin "Për Menaxhimin e Buxhetit një nen që të ardhurat nga privatizimi të përdoren në radhë të parë dhe jo më pak se 50 përqind, për uljen e Borxhit;

- Për borxhin e Qeverisë ndaj kontraktorëve privatë, vendosjen në Ligjin "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2014" të një neni që në të ardhurat nga privatizimet, pjesa e mbetur pas përdorimit të 50 përqind e lartë të fondeve për të ulur borxhin publik, të shkojë për uljen e detyrimeve për faturat e papaguara ndaj sipërmarrësve privatë për punët publike të realizuara. Kërkesën ndaj sistemit bankar që të mos bllokojë dhënien e kredive për kompanitë, të cilave Shteti u ka borxh;
- Vendosjen në Ligjin "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2014" të një neni që përdorimi i Fondit të Kontigjencës për ruajtjen e deficitit buxhetor, të bëhet me miratim nga Kuvendi i Shqipërisë;
- Zvogëlimin deri në arkëtimin e plotë të vlerës së borxhit tatimor dhe doganor;
- Konsolidimin dhe mirëfunksionimin e strukturave të menaxhimit financiar, kontrollit dhe auditimit të brendshëm, në përputhje me kërkesat e legjislacionit të miratuar dhe me kërkesat e parashtruara nga BE për vendin tonë, në kuadër të Kontrollit të Brendshëm Financiar të Sektorit Publik.

Bazuar në Rekomandimet e Deklaratës së Pekinit dhe Rezolutën e Kongresit të V-të të EUROSAI-t për rolin e SAI-t në përgatitjen e Buxhetit dhe të ndërgjegjshëm që përgatitja e Projekt-Buxhetit të Shtetit për vitin 2014 është një sfidë e madhe, jemi të gatshëm që të kontribuojmë në përgatitjen e tij, në rast se Kuvendi do ta gjykojë të arsyeshme.

60 VJET INTOSAI[52]-Zhvillimi i organizatës nga Lima në Pekin

Botuar në Gazetën "Ekonomia", 5 numra të gazetës, 19-23 nëntor 2013

Zhvillimi i organizatës nga Lima në Pekin

PJESA E PARË: PROFILI I ORGANIZATËS

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara Ban Ki Mun, më 22 tetor në Pekin, në përshëndetjen e tij drejtuar Kongresit të XXI-të të INTOSAI, ka theksuar se: "*Institucionet supreme të auditimit janë "watchdog", roje besnike që ndihmojnë për të nxitur përdorimin efikas dhe efektiv të burimeve publike. Ato do të luajnë një rol kritik në mbështetje të zbatimit të axhendës së re të Kombeve të Bashkuara për zhvillim të qëndrueshëm, që mbështetet mbi qeverisjen e mirë, transparencën, përgjegjshmërinë dhe financat inovative*".

Dua te pohoj se institucionet supreme te auditimit(SAI), që në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar kanë qenë të ndërgjegjshme për rolin dhe misionin e tyre në shoqëri dhe në zhvillimin ekonomik të vendeve përkatëse. Duke ndjerë nevojën e një mjedisi dhe strukture të përbashkët, ku te paraqisnin dhe debatonin mendimet e tyre, ne vitin 1953, 34 SAI u mblodhën në Kubë dhe në Kongresin e parë themeluan organizatën e tyre profesionale, INTOSAI. Historia e INTOSAI-t fillon këtu dhe është një histori 60 vjeçare suksesi dhe rritjeje e institucioneve supreme te auditimit.

Profili i INTOSAI

Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) sot përfaqëson komunitetin e192 SAI-ve anëtare me të drejta të plota dhe 5 SAI anëtare të asociuara. Ka pësuar një zhvillim të paprecedent për organizata të ngjashme ndërkombëtare, me një rritje anëtarësie nga 34 në 192 në vetëm 6 dekada. Është ndër organizatat ndërkombëtare më aktive, me 7 struktura rajonale(ku përfshihet edhe EUROSAI), me 4 komitete zhvillimi, ku spikasin Komiteti i Standardeve Profesionale, Komiteti i Ndërtimit te Kapaciteteve dhe Komiteti i Shpërndarjes së Njohurive, krahas Iniciativës për Zhvillimit(IDI). INTOSAI ka me dhjetëra grupe pune dhe task forca në të gjitha fushat e auditimit publik suprem.

Që prej vitit te themelimit 1953, organizata ka punuar me vitalitet dhe inovacion, në përputhje me moton e saj "*Mutual experience benefits all(Eksperienca e përbashkët u shërben të gjithëve)*", duke përhapur ide dhe standarde kombëtare të auditimit, nëpërmjet shkëmbimit të ideve dhe bashkëpunimit në komunitetin ndërkombëtar të auditimit.

Si një organizatë jo politike, profesionale, e pavarur dhe autonome, INTOSAI u ka dhënë mbështetje konkrete SAI-ve, ka nxitur shkëmbimin e ideve, njohurisë dhe eksperiencave, ka vepruar si një zë i njohur i institucioneve supreme të auditimit (SAI-

[52] Ky studim është përgatitur nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Dr. Bujar Leskaj me rastin e 60 vjetorit të themelimit të organizatës botërore të institucioneve supreme të auditimit, INTOSAI dhe përshkruan arritjet, aktivitetet dhe dokumentet themelore të saj.

ve) në komunitetin ndërkombëtar dhe ka promovuar vazhdimisht përmirësimin midis SAI-ve anëtare. INTOSAI ka promovuar qeverisjen e mirë, duke mundësuar që SAI-t të ndihmojnë qeveritë përkatëse të përmirësojnë performancën, të rrisin transparencën, të sigurojnë përgjegjshmërinë, të ruajnë besueshmërinë, të luftojnë korrupsionin, të promovojnë besimin e publikut dhe të mbrojnë interesat e qytetarëve të tyre.

Që prej themelimit në vitin 1953 deri tek Kongresi i XXI-të në Kinë në vitin 2013, INTOSAI ka pasur zhvillime pozitive të shumëfishta, si edhe ndryshime dhe progres të konsiderueshëm. Puna e organizatës është bazuar në përkushtimin vullnetar të domosdoshëm dhe kontributin e çdo SAI anëtar. Ky institucion modern, global, i strukturuar dhe i orientuar drejt rezultateve, e ka treguar ne praktike dobine e tij per anetaret. INTOSAI, ka arritur të zhvillohet me sukses, në një organizatë autonome, të pavarur, profesionale dhe jo politike, të njohur si zëri prestigjioz i institucioneve supreme të auditimit në komunitetin ndërkombëtar dhe promovimin e vazhdueshëm të përmirësimeve mes anëtarëve të tij të ndryshëm.

Shtatë Grupet e Punës Rajonale të INTOSAI-t – AFROSAI, ARABOSAI, ASOSAI, CAROSAI, EUROSAI, OLACEFS dhe PASAI jane teresisht operacionale, duke marre parasysh diferencat rajonale dhe nevojat heterogjene. Si organe ekzekutuese të punës tematike dhe profesionale të INTOSAI-t, Komisionet, Grupet e Punës dhe Task Forcat të saj kanë prekur një varietet të gjerë temash të organizuara sipas katër qëllimeve strategjike te organizatës: vendosja e standardeve; ndërtimi i kapaciteteve; ndarja e njohurive dhe zhvillimi i një organizate ndërkombëtare model.

Profili i EUROSAI

EUROSAI (Organizata Evropiane e Institucioneve Supreme të Auditimit) është një nga grupet rajonale, pjesë e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve të Larta të Auditimit (INTOSAI). Institucionet Supreme të Auditimit (SAI) të 190 vendeve anëtare të plota dhe katër vendeve anëtare të asociuara të INTOSAI-t, pjese e një organizatë mbështetëse te Kombeve të Bashkuara.

Gupet e tjera rajonale të INTOSAI-t janë OLACEFS, AFROSAI, ARABOSAI, ASOSAI, PASAI dhe CAROSAI.

Edhe pse EUROSAI është institucioni më i ri nga shtatë grupet rajonale të INTOSAI-t, ideja e një organizate evropiane të SAI-ve daton që nga themelimi i INTOSAI në vitin 1953. Hapat e para aktive në drejtim të krijimit të EUROSAI-t u zhvilluan në vitin 1974 gjatë Kongresit të VIII të INTOSAI-t në Madrid (1974). Ndërmjet viteve 1975 dhe 1989, SAI-t e Italisë dhe Spanjës me mbështetjen e Komiteti të Kontaktit të Kryetarëve të SAI-ve të vendeve të Komunitetit Ekonomik Evropian hapën rrugën për krijimin e EUROSAI-t, duke përgatitur projektet fillestare për statutin e EUROSAI-t. Në qershor të 1989, në Kongresin e XIII-të të INTOSAI-t, mbajtur në Berlin, u miratua "Deklarata e Berlinit" për krijimin e Organizatës Evropiane të SAI-ve.

Në nëntor të vitit 1990, në Madrid u zhvillua Konferenca Themeluese dhe Kongresi i EUROSAI-t. EUROSAI u themelua nga 30 anëtarë (SAI-t e 29 shteteve evropiane dhe Gjykata Evropiane e

Audituesve). Tani numri i vendeve të anëtarësuara është 50 (SAI-t e 49 shteteve evropiane dhe Gjykata Europiane e Audituesve). Objektivat e organizatës, të përcaktuara në nenin 1 të statutit të saj, kanë të bëjnë me nxitjen e bashkëpunimit profesional midis vendeve anëtare të EUROSAI-t, për të inkurajuar shkëmbimin e informacionit dhe dokumentacionit. Kjo gjë çoi në zhvillimin e auditimit të sektorit publik dhe stimuloi krijimin e një partneriteti me akademikët e universiteteve, në lidhje me këtë temë, për të punuar në drejtim të harmonizimit të terminologjisë në fushën e auditimit publik.

EUROSAI ka për qëllim, brenda INTOSAI-t, që:

1. *Të nxisë mirëkuptimin profesional dhe teknik të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve anëtare të EUROSAI-t dhe grupeve të tjera rajonale të INTOSAI-t, duke shkëmbyer ide dhe eksperienca mes tyre për auditimin e financave publike.*

2. *Të ruajë marrëdhëniet me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare të specializuara për problemet që ndikojnë në auditimin e të ardhurave dhe shpenzimeve publike.*

3. *Të mbajë të informuara të gjitha institucionet anëtare të EUROSAI-t për ndryshimet në legjislacionin e çdo shteti në çështjet e kontrollit të financave publike dhe të organizimit, si dhe funksionimin e institucioneve përkatëse.*

4. *Të promovojë studimin teorik dhe praktik të problemeve dhe çështjeve që lidhen me auditimin e disiplinave të ngjashme.*

5. *Të bashkëpunojë në shkëmbimin e teknikave dhe të njohurive që konsiderohen me interes, si dhe të inkurajojë mbajtjen e seminareve dhe kurseve të trajnimit për zyrtarët e institucioneve anëtare të EUROSAI-t, si dhe te institucioneve te tjera anëtare të INTOSAI-t.*
6. *Të promovojë dhe lehtësojë shkëmbimin e informacionit dhe dokumentacionit ndërmjet vendeve anëtare të EUROSAI-t, si dhe shpërndarjen e publikimeve mbi çështjet që janë brenda kompetencave të tyre.*
7. *Të nxisë krijimin e instituteve e të qendrave të specializuara, si dhe bashkëpunimin me Universitetet në lidhje me auditimin e të ardhurave publike dhe shpenzimet.*
8. *Të nxisë zbatimin e konkluzioneve dhe rekomandimeve të miratuara nga Kongresi i EUROSAI-t.*

9. *Të sigurojë harmonizimin e terminologjisë teknike dhe unifikimin e termave në sferën e kontrollit të financave publike.*

10. *Të bëjë çdo përpjekje për të arritur mirëkuptim të problemeve dhe të çështjeve që lidhen me auditimin e financave publike.*

KLSH, në vitin 2012 ka publikuar botimin "EUROSAI" (Institucionet Supreme Europiane të Auditimit), Seria "Botime KLSH" Nr. 07/2012, ku jep një historik dhe përshkrim te detajuar të organizatës.

INTOSAI– së bashku me Komisionet, Grupet e Punës, Task Force dhe Grupet e Punës Rajonale – përfaqëson forumin botëror për shkëmbimin ndërkombëtar të njohurive në fushën e auditimit publik suprem; është organizata që vendos Standardet e Auditimit në sektorin publik dhe zëri ndërkombëtar i auditimit publik suprem.

Organizata ofron forume për audituesit supremë nga e gjithë bota. Është një platformë e madhe diskutimi çështjesh me interes të përbashkët dhe ku çdo auditues mund të informohet për zhvillimet më të fundit rreth auditimit, standardeve profesionale dhe praktikave më të mira.

Ndërtimi i kapacitete ka qenë dhe mbetet një nga fushat më të rëndësishme të INTOSAI-t. Kjo fushë përfshin zhvillimin e strukturave të reja për përfitimin e njohurive dhe trajnimin profesional dhe zhvillimin organizativ për SAI-t. Aktualisht ka shumë aktivitete për ndërtimin e kapaciteteve dhe ndarjen e njohurive në INTOSAI, me qëllim forcimin e kapaciteteve dhe performancës së SAI-ve, si në fushën e auditimit të integritetit (paketa INTO-SAINT), të auditimit të performances, të auditimit mjedisor, të teknologjisë së informacionit, etj.

Organizata ka pesë gjuhë zyrtare: arabisht, anglisht, frëngjisht, gjermanisht dhe spanjisht. INTOSAI është një grup vullnetar, suksesi i të cilit varet nga mbështetja e vazhdueshme profesionale dhe financiare e anëtarëve të tij. Pika me e forte e tij qëndron në diversitetin kulturor, gjuhësor dhe ne vullnetin e anëtarëve së tij. Organizata respekton një përfaqësim të balancuar të rajoneve dhe sistemeve të auditimit. INTOSAI operon nëpërmjet konsultimeve dhe konsensusit, pavarësisht nga madhësia gjeografike apo fuqitë ekonomike, si dhe e ka te shenjte respektin për sovranitetin kombëtar dhe për barazinë e anëtarëve të tij.

INCOSAI, kongresi që mbahet çdo 3 vjet në vende të ndryshme, është organi më i lartë i INTOSAI-t, i cili përfshin të gjithë anëtarësinë. Çdo vend ka një votë, dhe asnjë prej tyre nuk ka të drejtën e vetos. Bordi Drejtues, i përbërë nga 18 SAI-anëtare, është përgjegjës për anëtarësinë.

Aktiviteti i INTOSAI-t në periudhën mes dy kongrese te tij, drejtohet nga Bordi Drejtues i INTOSAI dhe nga Sekretariati i Përgjithshëm. Sipas Statutit të INTOSAI-t, Sekretari i Përgjithshëm i tij është Audituesi i Përgjithshëm i Austrisë dhe selia e tij është në Vjenë. Drejtori i Planifikimit Strategjik i raporton drejtpërdrejt Sekretarit të Përgjithshëm dhe në konsultim me të, siguron arritjen e objektivave strategjike. Detyrat kryesore të Sekretariatit të Përgjithshëm janë të veprojë si një urë lidhëse, si brenda INTOSAI-t, ashtu dhe me partnerët e jashtëm, për të vënë në dukje punën dhe cilësinë e INTOSAI-t dhe anëtarëve të tij. Gjithashtu, Sekretariati i Përgjithshëm, punon për të rritur rolin e INTOSAI-t dhe anëtarëve të tij, si institucione auditimi të pavarur, kompetentë dhe efektivë, duke rritur transparencën, përgjegjshmërinë dhe besueshmërinë për të mirën e të gjithëve. Në vitin 2001, SAI Norvegjez, ndërmori nismën "Iniciativa për Zhvillim" e INTOSAI-t, ndërsa Zyra e Auditimit të Qeverisë së SHBA, publikon Gazetën Ndërkombëtare të Auditimit Suprem.

Organizimi

INTOSAI e realizon misionin e tij përmes një shumëllojshmërie organesh, programesh dhe aktivitetesh.

Organet kryesore janë:

• Kongresi;

• Bordi Drejtues;

• Sekretariati i Përgjithshëm, dhe

• Grupet rajonale të punës.

Komisioni i Administrimit dhe Financave, përgatit vendimet të cilat miratohen nga Bordi Drejtues. Drejtori i Planifikimit Strategjik, siguron koordinim efektiv dhe zbatimin e Planit Strategjik.

Bordi Drejtues

Bordi Drejtues i INTOSAI-t përbëhet nga 18 anëtarë. Si rregull, ai mblidhet çdo vit, mes Kongreseve. Për të siguruar përfaqësim të balancuar të të gjitha vendeve anëtare, çdo grup pune rajonal i INTOSAI-t dhe llojet kryesore të sistemeve të tyre të auditimit publik, janë të përfaqësuar në Bord.

Nisma për Zhvillimin e INTOSAI-t dhe Gazeta Ndërkombëtare e Auditimit të Qeverisë, gjithashtu janë të përfaqësuara në Bordin Drejtues.

Kryetari i Bordit është kreu i SAI-t që organizon kongresin e fundit.

KLSH dhe INTOSAI

Delegacione të KLSH-së të kryesuara nga Kryetari morën pjesë në të gjithë kongreset e INTOSAI-t dhe EUROSAI-t, duke filluar nga Kongresi i XIV-të i organizatës në Uashington ne tetor të vitit 1992, në Kongresin e XVI-të në Montevideo, Uruguai, në Nëntor 1998; Kongresi i XVII-të i INTOSAI-t Seul të Koresë së Jugut zhvilluar në Tetor 2001 dhe Kongresi i XVIII-të i INTOSAI-t në Budapest të Hungarisë, Tetor 2004. Gjithashtu KLSH-së mori pjesë në Kongresin i IV i EUROSAI-t në Paris, në vitin 1999 dhe Kongresin e V-të EUROSAI-t të zhvilluar në Moskë, Rusi në vitin 2002.

Në vitin 2005, një delegacion i KLSH prej 3 vetash, kryesuar nga Drejtori i Përgjithshëm mori pjesë në Kongresin e VI-të EUROSAI-t, në Bon te Gjermanisë. Në vitin 2006, KLSH mori pjesë në Konferencën e EUROSAI-t me temë "Roli i SAI-ve në luftën kundër korrupsionit". Në nëntor 2007, një delegacion i KLSH-së merr pjesë në Kongresin e XIX të INTOSAI-t, të zhvilluar në Meksikë. Në qershor 2008, KLSH merr pjesë në Kongresin VII të EUROSAI-t, në Krakov, Poloni. Për fat të keq, KLSH nuk mori pjesë në punimet e Kongresit te XX te INTOSAI në Afrikën e Jugut. Gjithashtu, është i vetmi institucion i auditimit suprem i Europës që, megjithëse i ftuar, nuk mori pjesë në Kongresin e VIII të EUROSAI-t, mbajtur në Lisbonë në vitin 2011.

Në Tetor 2013, Kontrolli i Lartë i Shtetit mori pjesë në punimet e Kongresit të XXI të INTOSAI-t në Pekin, Kinë. Gjatë punimeve të Kongresit, Kryetari i KLSH-së zhvilloi biseda pune dhe takime me homologë të SAI-ve partnere dhe të SAI-ve të tjerë pjesëmarrës në Kongres. U realizuan biseda pune me Dr. Josef Moser, President i ACA-s, njëkohësisht edhe Sekretar i Përgjithshëm i INTOSAI-t, me z.Liu Jiayi, Kryetar i SAI-t të Kinës, njëkohësisht edhe Kryetari i ri i Bordit Drejtues të INTOSAI-t, me z. Gene Dodaro, Auditues i Përgjithshëm i GAO-s së SHBA, me z.Recai Akyel, President i TCA-së, me z.Krzysztof Kwiatkowski, President i NIK-ut të Polonisë, me z. Ioannis Karavokiris, President i SAI-t të Greqisë, si dhe me z. Magnus Lindell, zv/Auditues i Përgjithshëm i SAI-t të Suedisë.

Kryetari i KLSH zhvilloi takime pune edhe me homologë të tjetër partnerë të KLSH-së, me të cilët janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi, si z.Ivan Klesic, Auditues i Përgjithshëm i SAI-t të Kroacisë, z.Milenko Sego, Auditues i Përgjithshëm i SAI-t të Bosnje dhe Hercegovinës, z.Milan Dabovic, President i SAI-t të Malit të Zi, zj.Tanja Tanevska, Audituese e Përgjithshme e SAI-t të Maqedonisë dhe z.Naser Ademi, zv/Auditues i Përgjithshëm i SAI-t të Maqedonisë, etj.

Gjatë bisedave me homologët u theksua bashkëpunimi i suksesshëm i deritanishëm në fushat e trajnimit dhe shkëmbimit të informacionit si dhe u shpreh vullneti i përgjithshëm për t'i konkretizuar edhe më tej në të ardhmen e afërt këto marrëdhënie, duke u drejtuar edhe në fusha të tjera, si auditime të përbashkëta, etj.

PJESA E DYTË: STANDARDET INTOSAI

Aktiviteti i INTOSAI

Reputacioni ndërkombëtar i INTOSAI-t është themeluar mbi disa gurë kilometrikë në rrugën e tij dhe arritjet përfshijnë kryesisht:

- Njohjen e rëndësisë së SAI-ve nga Kombet e Bashkuara
- Përcaktimin e një kuadri gjithëpërfshirës të standardeve profesionale bazuar në procesin auditues
- Ndërtimin e një marrëdhënie produktive me donatorët ndërkombëtarë, për të promovuar ngritjen e kapaciteteve në SAI-et anëtare
- Ndërtimin e një rrjeti efektiv global për përhapjen e njohurive dhe praktikave më të mira
- Bashkëpunimin e mëtejshëm me organizatat ndërkombëtare dhe rajonale
- Përmirësimin e vazhdueshëm të marrëveshjeve publike përmes statusit të modelit të organizatës ndërkombëtare

Standardet INTOSAI

Një nga arritjet më të mëdha të INTOSAI-t dhe ndihmesa më konkrete e tij për audituesit është përgatitja e standardeve ISSAI të auditimit publik suprem. Këto standarde janë përgatitur dhe botuar në vijimësi nga Komiteti i Standardeve të Auditimit i INTOSAI, duke filluar nga qershori 1992. Kodi i Etikës i INTOSAI është miratuar në Kongresin e XVI-të mbajtur në Montevideo në vitin 1998, ndërsa standardet ISSAI 3000 dhe ISSAI 3100 të Auditimit të Performances janë miratuar në vitin 2004. Çdo kongres INCOSAI i INTOSAI-t miraton standarde të reja auditimi, të cilat në periudhën mes dy kongreseve janë në proces të përgatitjes dhe marrjes së komenteve nga të gjitha SAI-t anëtare të INTOSAI.

Standardet e Auditimit ISSAI përmbajnë postulatet themelore dhe parimet për kryerjen e punës së auditimit nga institucionet supreme të auditimit. Është përgjegjësi e secilit SAI për të gjykuar shkallën në të cilën standardet janë në përputhje me arritjen e mandatit të tij, duke konsideruar rrethanat kushtetuese ligjore dhe të tjera të SAI-t. Njëri prej parimeve të përmbajtura në Kodin e Etikës të INTOSAI përcakton se detyrimi i audituesit suprem është të aplikojë standardet ndërkombëtarisht të pranuara të auditimit, pra standardet ISSAI .

Standardet ISSAI përbëhen nga katër nivele: nga Parimet Themelore, Standardet e Përgjithshme, Standardet e Fushës dhe Standardet e Raportimit.

Parimet themelore janë supozimet themelore, parimet logjike dhe kërkesat e nevojshme të dizajnuara për të mbështetur zhvillimin e standardeve të auditimit. Ata janë të dizajnuara për t'i shërbyer audituesit në formulimin e mendimeve dhe gjykimeve të tij/saj në raportet që përgatit, sidomos në rastet kur ka standarde specifike që zbatohen. Çdo SAI duhet të konsiderojë përputhjen me Standardet e Auditimit të INTOSAI në të gjitha çështjet të cilat trajtohen në auditime, edhe pse kjo varet dhe nga kushtet lokale të plotësimi të mandatit të vet të veçantë të auditimit si SAI.

Në bazë të Parimeve Themelore qëndron Deklarata e Limës për Udhëzimet mbi Parimet e Auditimit e tetorit 1977, miratuar në kongresin e IX-të të INCOSAI në Lima të Perusë. Deklarata e Limës konsiderohet si Magna Carta (Kushtetuta) e auditimit publik suprem. Parimet e përmbajtura në Deklarate nuk kanë kohë dhe janë vlera themelore. Suksesi i Deklaratës i dedikohet faktit që përmbledh një listë objektivash dhe çështjesh për auditimin suprem publik, duke ngelur në të njëjtën kohë domethënëse dhe koncize, e lehte për t'u përdorur dhe me një gjuhë të qartë.

Ndërkohe që deklarata e Limës vendos parimet themelore, Deklarata e Meksikos mbi Pavarësinë e SAI-t, e miratuar ne Kongresin XIX-të të INTOSAI në vitin 2007 forcon pavarësinë e institucioneve më të larta të auditimit. Ajo prezanton tetë parimet themelore për Pavarësinë, të cilat burojnë nga fryma e Deklaratës së Limës, si një kërkesë thelbësore për te siguruar efektivitetin dhe efiçiencën e auditimit publik suprem.

Çdo SAI duhet të krijojë një politikë të tijin, në të cilën standardet INTOSAI duhet të respektohen në kryerjen e llojeve të ndryshme të auditimit, për të siguruar që puna audituese dhe produktet e auditimit (gjetjet, raportet, rekomandimet) të jenë të cilësisë më të lartë.

KLSH i ka përkthyer në shqip dhe botuar të dyja deklaratat, si të Limës dhe të Meksikos, në publikimin "Standardet e Auditimit INTOSAI" (ISSAI), Seria "Botime KLSH" Nr. 08/2012.

Standardet e përgjithshme merren me nivelin dhe kualifikimet e audituesit ose të institucionit të auditimit, në mënyrë që ata të mund të kryejnë detyrat që lidhen me fushën e standardeve dhe raportimit në mënyrë kompetente dhe efektive. Ato trajtojnë çështje të tilla si rekrutimin e audituesve, trajnimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore të SAI-t, ofrimin e udhëzimeve të përshtatshme, planifikimin dhe mbikëqyrjen e kontrolleve të brendshme, si dhe rishikimin e eficiencës dhe efektivitetit të standardeve dhe procedurave të brendshme të SAI-t.

Standardet e përgjithshme merren gjithashtu me pavarësinë e SAI-t, konfliktet e interesit dhe kompetencat e tij. Marrë në tërësi, këto standarde japin udhëzime efektive për çdo SAI për procedurat e kontrollit të brendshëm dhe të cilësisë.

Standardet e Përgjithshme janë po ashtu përkthyer në shqip dhe botuar nga KLSH në publikimin "Standardet e Auditimit INTOSAI" (ISSAI), Seria "Botime KLSH" Nr. 08/2012.

Standardet e Fushës janë të dizajnuara për të krijuar kornizën për zhvillimin dhe menaxhimin e punës së auditimit. Ato kanë të bëjnë me nevojën për të planifikuar, shqyrtuar, mbikëqyrur, studiuar dhe vlerësuar kontrollin e brendshëm, si dhe ofrojnë këshilla dhe udhëzime mbi auditimin e rregullsisë, provat e auditimit dhe analizën e pasqyrave financiare. Standardet e fushës, nëpërmjet udhëzimeve të hollësishme sigurojnë një kornizë reference për audituesin.

Standardet e Raportimit trajtojnë mendimin zyrtar të audituesit dhe ofrojnë udhëzime në lidhje me formatin e raportimit dhe opinionet e shprehura. Standardet gjithashtu i referohen raporteve të tjera që audituesi mund të bëjë, të tilla si raporti per auditimin e rregullsisë dhe të performancës. Theksi i standardeve të raportimit është ofrimi i një kornize të nevojshme, brenda të cilit auditorët duhet të përmbushin përgjegjësitë e tyre të raportimit. Si rezultat, këto standarde nuk përmbajnë shkallën e detajuar që gjendet në Standardet përkatëse Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (IFAC).

Standardet e raportimit INTOSAI, sidomos Shënimet Praktike të Auditimit Financiar(*këto shënime janë trajtuar në mënyre të detajuar në botimin e KLSH "Udhëzuesi i Auditimit Financiar", viti 2013*) bazohen në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA), pse auditimi, si në sektorin privat ashtu dhe në sektorin publik, është një shkencë e konsoliduar dhe IFAC, Federata ndërkombëtare e Kontabilisteve ka bërë një punë të lavdërueshme ne unifikimin e ISA-ve.

Një pjesë e veçantë e standardeve të raportimit përbehen nga **standardet e auditimit t**ë **performances ISSAI 3000 dhe 3100**. Auditimi i performancës është një nga mënyrat kryesore përmes të cilit taksapaguesit, financierët, vendim-marrësit, ekzekutuesit, media dhe shoqëria në përgjithësi "ushtrojnë kontroll" dhe penetrojnë në mënyrën se si kryhen punët dhe si arrihen rezultatet. Kriteret e këtij lloji auditimi janë të shumta dhe përmenden: vlera e shtuar, zinxhirët kompleksë të politikave, prania e risqeve, ndërhyrjet strukturore, obligimet ndërkombëtare,
emergjenca sociale, materialiteti financiar, vizibiliteti i programit, mundësia për auditim, etj. Funksioni i auditimit të performancës nga institucionet supreme të auditit nisi të aplikohej në fundin e viteve '60 nga GAO amerikane. Ky lloj auditimi në SHBA është shtrirë që prej atëherë në nivelet shtetërore dhe lokale të vendim-marrjes financiare. Shumë vende të tjera kanë sot një ekspertizë të pasur në auditet e performancës. Mund të përmenden NAO britanike, SAI-n gjerman dhe ate austriak, Gjykaten e Auditimit te Hollandes apo dhe Gjykata Sllovene e Auditimit. Në secilin e prej këtyre vendeve, auditimi i performancës së institucioneve publike siguron jo vetëm rritjen dhe përmirësimin ekonomik të vendit, por është një formë e shprehjes së zbatimit të ligjit, rritjes së transparencës, përfshirjes sociale në vendim-marrje, pra tek e fundit një formë e aplikimit të demokracisë. Në Shqipëri, pavarësisht se ligji aktual i KLSH-së nuk e specifikon në mënyrë eksplicite fushën e auditimit të performancës, të tilla auditime kanë filluar të kryhen në këtë institucion që nga viti 2008, përmes një projekti pilot në bashkëpunim me NAO-n britanike dhe Gjykatën Holandeze të Llogarive.
U kryen disa auditime të performances me asistencë të huaj dhe kryesisht holandeze, duke rezultuar kështu në një punë të mirë dhe me vlera për kërkime dhe thellime të mëtejshme në to. Gjithsesi, konceptimi i auditimeve të performancës në kaluarën ka qenë ai i auditimit derivat, njohës dhe pjesor, si pjesë rutinore e procesit të punës dhe jo si risi, punë krijuese e mirëfilltë, bashkëkohore dhe integrale. Auditimi i performancës duhet shndërruar në një nga shtyllat e zhvillimit dhe modernizimit të KLSH-së. Institucioni ynë është përpara një sfide të fortë për ta përqendruar punën tek auditimi i performancës, pse ai i shërben vlerësimit të përgjegjshmërisë publike. Ky vit po dëshmon një ritëm dhe cilësi të rritur të auditimeve të performances. Institucioni botoi në fund të vitit 2012 publikimin "Udhëzuesi i Auditimit të Performancës", Seria "Botime KLSH" 10/2012, i cili përbën një orientim efikas për audituesit tanë të performances.

Standardet e Auditimit të Borxhit Publik ISSAI 5410-5440 marrin një rendësi dhe domethënie te veçante në periudhën që po kalojmë dhe zbatimi me rigorozitet i tyre e pajis SAI-n me dijet e duhura për të ndihmuar me auditimet e tij në shëndoshjen e financave publike. Ato janë:

- ISSAI 5410 "Udhëzim për Planifikimin dhe Kryerjen e një Auditimi të Kontrolleve të Brendshme të Borxhit Publik"

Roli i SAI-t: Në fillim të një auditimi të borxhit publik, SAI duhet të vendosë se cilat komponentë të kontrolleve të brendshme do të shqyrtojë dhe thellësinë e analizës së çdo komponenti. Gjerësia e auditimit dhe thellësia e tij do të varen te mandati ligjor i SAI-t, puna audituese e mëparshme dhe burimet në dispozicion për të kryer atë. Disa SAI kanë një mandat të kufizuar ligjor për të audituar borxhin sovran. SAI të tjerë mund të kenë një mandat më të gjerë për të rishikuar çështjet e borxhit publik, por u mungon ekspertiza teknike e nevojshme për të shqyrtuar transaksionet komplekse të borxhit publik që kanë lidhje të rëndësishme me operacionet monetare dhe fiskale.

- ISSAI 5411 "Treguesit e Borxhit"
  Roli i SAI-t në uljen e vulnerabilitetit fiskal të qeverisë mund të konsistojë në promovimin e praktikave më të mira në politikat e menaxhimit të borxhit publik. Këto përfshijnë gjenerimin e informacionit të përshtatshëm dhe përdorimin e treguesve si ata të konsideruar në këtë analizë.

- ISSAI 5421 "Udhëzues mbi Përkufizimin dhe Publikimin e Borxhit Publik"
  SAI-t mund të mos kenë asnjë rol të drejtpërdrejtë në përcaktimin e nivelit të borxhit publik, megjithatë ata mund të luajnë një rol duke ndihmuar për të siguruar që vendimet në lidhje me borxhin publik të bazohen në publikimin për të gjitha palët e interesuara të një informacioni të plotë dhe të besueshëm mbi efektet e mundshme të huamarrjes së propozuar.
- ISSAI 5422 "Përdorimi i Termave të Referencës në Kryerjen e Auditimit të Performancës të Borxhit Publik"
- ISSAI 5430 "Ekspozimet Fiskale: Implikimet për Menaxhimin e Borxheve dhe roli i SAI-ve"
  SAI-t mund të dëshirojnë, brenda kufijve të kompetencave dhe përgjegjësive të tyre, të inkurajojnë qeveritë e tyre të miratojnë praktikat e shëndosha për vlerësimin ,raportimin financiar, buxhetimin, dhe mbikëqyrjen e ekspozimeve fiskale të një vendi. SAI-t gjithashtu janë të vetëdijshëm për të mbështetur miratimin e "praktikave të mira" për ballafaqimin me rrezikun.

- ISSAI 5440 "Udhëzim për Kryerjen e Auditimit të Borxhit Publik – Përdorimi i Testeve të Pavarur në Auditimin Financiar"

Standardet e Auditimit te Borxhit Publik janë përkthyer ne shqip dhe do te botohen nga KLSH brenda këtij viti.

Partneret e INTOSAI

INTOSAI ka partneritet me shumë organizata të tjera: Bashkimi NdërParlamentar (IPU), Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (IFAC), Instituti i Audituesve të Brendshëm (IIA), Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), si dhe Banka Botërore dhe komunitete të tjerë donatorësh. Gjithashtu, INTOSAI

bashkëpunon edhe me OKB-në, në promovimin e mirëqeverisjes dhe luftën kundër korrupsionit.

Bashkëpunimi i INTOSAI-t, veçanërisht me Kombet e Bashkuara dhe me organizata ndërkombëtare si Banka Botërore, OECD, IPU, IFAC dhe IIA, ka rritur në mënyrë të konsiderueshme reputacionin, dukshmërinë globale dhe vlerësimin ndaj saj si një organizatë profesionale e nivelit të lartë. Që prej vitit 1970, te 22 Simpoziumet dhe Seminaret UN – INTOSAI janë organizuar në mënyrë të përbashkët nga INTOSAI dhe Kombet e Bashkuara. Këto përhapën njohuri dhe materiale për trajnime mbi një sërë temash të interesit të lartë, në lidhje me auditimin e jashtëm suprem.

INTOSAI ka firmosur një Memorandum Mirëkuptimi me 21 donatorë. Kjo marrëveshje historike me 15 organizata, duke përfshirë institucionet ndërkombëtare të donatorëve dhe agjencitë ndërkombëtare të zhvillimit, u përgatit për të rritur kapacitetin e zhvillimit të SAI-ve në botë. Ky Memorandum Mirëkuptimi, i nënshkruar në Tetor të vitit 2009, përbën themelet për forcimin e kapaciteteve të SAI-ve, për të rritur efektivitetin e tyre si instrumente të përgjegjshmërisë, transparencës, mirë qeverisjes dhe anti-korrupsionit, në vendet e tyre.
Organizata ka kryer një seri aktivitetesh bashkëpunuese me komunitetin e donatorëve, nëpërmjet të cilave janë arritur qëllimet e përbashkëta të deklaruara, është siguruar zbatimi i Suksesshëm i Kornizës së Standardeve Profesionale të INTOSAI-t (ISSAI-t) dhe i Udhëzimeve të INTOSAI-t për Qeverisjen e Mirë (INTOSAI GOVs), si edhe është rritur njohja e rëndësisë së SAI-ve dhe të INTOSAI-t në komunitetin e zhvillimit global. Tradita e INTOSAI-t është dhënia e çmimeve vlerësuese dhe inkurajuese per SAI-t anëtare. Janë dy çmime që akordohen çdo tre vjet në secilin Kongres, Çmimi "Jorge Kandutsch" i jepet SAI-t te dalluar për arritjet e tij në auditim dhe kontributin ne komunitetin INTOSAI. Çmimi "Elmer B. Staats" i jepet autorit të artikullit më të mirë të botuar në Gazetën Ndërkombëtare të Auditimit.

PJESA E TRETE: KONGRESET INTOSAI

Momentet kyçe te veprimtarisë së INTOSAI

Kongresi INCOSAI I i Havanës, Kubë, 1953

INTOSAI është përballur me shumë sfida në këtë skenar kompleks pas Kongresit të Parë Ndërkombëtar të Institucioneve Supreme të Auditimit (INCOSAI) të mbajtur në nëntor të vitit 1953 në Havanë, Kubë. Ne takimin themelues merrnin pjese 34 SAI. Angazhimi i INTOSAI-t që në fillesat e tij, për të nxitur pjesëmarrjen aktive të SAI-ve në kontrollin e burimeve publike, duke promovuar integritetin e punonjësve të qeverisë, për të ndihmuar shoqëritë tona në përmirësimin e performancës dhe efektivitetin e veprimeve të kryera nga qeveritë, është provë e kapacitetit të admirueshëm të organizatës.

Si një organizatë e njohur ndërkombëtare në fushën e auditimit të sektorit publik, INTOSAI ka nxitur shkëmbimin e informacionit dhe përvojës mes vendeve anëtarëve, duke përforcuar konformitetin me ligjin dhe rregullsinë e operacioneve, besueshmërinë e regjistrave kontabël, përgjegjshmërinë dhe transparencën. Me zgjerimin e qëllimit për të mbuluar edhe aktivitete të tjera, të tilla si lufta kundër korrupsionit dhe auditimin mjedisor, INTOSAI ka shtuar një vlerë të re në arsyen e ekzistencës së SAI-ve.

Kongresi INCOSAI IX në Lima, Peru 1977

INCOSAI i 9-të, i mbajtur në Lima, në tetor 1977, mblodhi së bashku 235 përfaqësues nga 95 SAI të botës dhe nga të gjitha kontinentet.

Kongresi njihet në veçanti për shkak të nënshkrimit të Deklaratës së Limës, e cila sot konsiderohet si Kushtetuta e SAI-ve dhe përmban udhëzimet themelore mbi parimet e auditimit.

Temat teknike të mbuluara nga Kongresi ishin (1) Deklarata e udhëzimeve mbi normat e auditimit, (2) kontrolli i institucioneve të decentralizuara të administratës publike, (3) roli dhe kërkesat e kontrollit financiar në kuadër të reformës administrative, dhe (4) auditimi i shëndetësisë publike dhe i agjencive të mbrojtjes së mjedisit.

Kongresi INCOSAI VIV në Uashington, 1992

Ne tetor 1992, Zyra Amerikane e Llogarive Qeveritare (GAO) organizoi kongresin e katërmbëdhjetë në Uashington, DC. Në këtë kongres pati seminare, takime dhe seanca plenare të shumta, të cilat u ndoqën nga rreth 400 delegatë nga 120 SAI anëtare dhe 10 organizata ndërkombëtare. Temat e këtij kongresi ishin auditimi i një mjedisi në ndryshim, roli i SAI-ve dhe përmirësimi i menaxhimit financiar përmes komisioneve të ngritura nga INTOSAI. Kongresi miratoi Standardet dhe udhëzimet për auditimin dhe kontrollin e brendshëm, si dhe punën e tre komiteteve të INTOSAI-t në lidhje me kontabilitetin, borxhin publik dhe mirëqeverisjen e financave publike.

Pjesëmarrja e një numri të madh anëtarësh në këtë Kongres, ishte një arritje shumë e madhe për INTOSAI-n. Takimi i 37-të i Bordit drejtues menjëherë pas kongresit, prezantoi një numër të madh tiparesh të reja në formatin dhe projektimin e kongresit. Programi zyrtar u mbyll me sukses pas një jave dhe u pasua nga një simpozium praktik 3-ditor mbi teknologjinë, i cili ofroi një shkëmbim shtesë të pikëpamjeve dhe informatave. Përveç kësaj, komisionet e INTOSAI-t u integruan plotësisht në punën e kongresit për temën e dytë, duke i dhënë kështu të gjithë delegatëve mundësinë për të marrë Një tipar i veçantë ishte një vizitë fakultative në Zyrat Amerikane të Llogarive Qeveritare të vendosura në qytete te ndryshme. Këto tradita u pasuan edhe në kongreset në vazhdim.

Kongresi i 14-të pati ndikim edhe për vetë GAO-n. Mbi 300 vetë nga personeli i GAO-s dhanë ndihmesën e tyre në marrëveshjet e kongresit. Kjo mundësi për të bashkëvepruar me kolegët nga e gjithë bota u dha atyre një kuptim më të gjerë në

kontekstin ndërkombëtar të auditimit të qeverisë dhe ndihmoi për të hedhur bazat për krijimin e marrëdhënieve reciprokisht të dobishme në nivele personale dhe institucionale.

Kongresi INCOSAI XVII në Seul, 2001

Nën moton e INTOSAI-t "Eksperienca e përbashkët u shërben të gjithëve", Kongresi i shtatëmbëdhjetë i organizuar në Seul në tetor 2001, shënoi një pjesëmarrje prej 471 delegatësh nga 152 SAI dhe shume institucione ndërkombëtare. Pjesëmarrja e plotë e delegatëve menjëherë pas ngjarjeve tragjike të 11 shtatorit, ishte prova më e qartë e angazhimit të anëtarëve të INTOSAI-t për sukses. Në këtë kongres u diskutuan dy tema të rëndësishme:

- Auditimi i institucioneve ndërkombëtare dhe multinacionale
- Kontributet e SAI-ve për reformën administrative dhe qeveritare.

Delegatët theksuan se SAI-t kanë interes në qeverisjen e mirë, përgjegjshmërinë dhe transparencën në institucionet ndërkombëtare, duke kontribuar kështu në eficiencën, efektivitetin, dhe ekonominë e tyre. Ata gjithashtu vunë në dukje, se SAI-t duhet të marrin në konsideratë që mandatet e tyre të pavarura të auditimit sigurojnë një bazë për zgjerimin dhe zhvillim e roleve gjatë planifikimit dhe zbatimit te reformave administrative dhe qeveritare. Për të bërë me të mirën me mandatet e dhëna, të gjithë pjesëmarrësit e Kongresit duhet të njohin rëndësinë e dijeve, shkathtësive dhe aftësive të stafit të SAI-t.

Kongresi INCOSAI XVII në Meksiko, 2007

INCOSAI i nëntëmbëdhjetë u mbajt në Meksiko, më nëntor 2007. Mblodhi 480 delegatë nga 145 SAI, si dhe 21 vëzhgues nga 10 institucione ndërkombëtare.

Edhe në Meksikë, motoja e INTOSAI-it, "Experientia Mutua omnibus prodest", ishte sërish tema kryesore e diskutimit, që ka të bëjë me shkëmbimin e njohurive, përvojës, gjetjeve dhe praktikave më të mira mes anëtarëve të INTOSAI-it.

Numri i vendeve anëtare të INTOSAI-t shkoi në 188, me pranimin e SAI-t të Malit të Zi dhe Singaporit. Në këtë kongres u miratuan Marrëveshjet Meksikos. Marrëveshjet mbuluan diskutimet, përfundimet dhe rekomandimet nga tema e parë (menaxhimi, llogaridhënia dhe kontrolli i borxhit publik) dhe tema e dytë (sistemet e vlerësimit të performancës, të bazuara në pranimin e treguesve kryesorë).

U miratuan tetëmbëdhjetë dokumente zyrtare të INTOSAI-t, duke përfshirë edhe Deklaratën e Meksikos mbi Pavarësinë e SAI-ve, dokumenti më i rëndësishëm nga i cili njihet ky Kongres, si dhe standardet, udhëzimet dhe praktikat më të mira në fusha të tilla si auditimi financiar dhe i performancës, auditimi mjedisor, si dhe auditimi i borxhit publik.

U bënë disa ndryshime në 3 grupet e punës:

- U krijua një grup pune mbi treguesit kombëtare, për të ndjekur rekomandimet e temës së dytë.

- Task Forca për Luftën Kundër Pastrimit të Parave u shndërrua në Grupin e Punës për Luftën Kundër Pastrimit të Parave dhe Korrupsionit Ndërkombëtar.

- Grupi i Punës për Privatizimin u shndërrua në Grupin e Punës për Privatizimin, Rregullimin ekonomik dhe Partneritetet publike-private, për të pasqyruar një gamë më të gjerë të punës së tij.

Kongresi INCOSAI XX në Johanesburg, Afrika e Jugut, 2010

INCOSAI XX u mbajt në Johanesburg të Afrikës së Jugut në nëntor 2010. U prezantua Plani Strategjik 2011-2016, i cili u miratua nga kongresi. INTOSAI identifikoi prioritetet strategjike të mëposhtme për vitet e ardhshme: duke ndihmuar në sigurimin e pavarësisë së SAI-t, zbatimin e Standardeve Ndërkombëtare për Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI), duke forcuar ndërtimin e kapaciteteve të SAI-ve, komunikimin e vlerave dhe përfitimeve të SAI-ve, si dhe luftën kundër korrupsionit.

Në këtë kongres u miratua Marrëveshja e Johanesburgut. Marrëveshja mbuloi diskutimet, përfundimet dhe rekomandimet e temës së parë (Vlerat dhe përfitimet e SAI-ve) dhe të temës së dytë (Auditimi mjedisor dhe zhvillimi i qëndrueshëm).

Progres pati gjithashtu edhe Iniciativa e Donatorëve, një përpjekje e rëndësishme ndërkombëtare për të rritur aftësitë e SAI-ve në vendet në zhvillim. Në një takim të mbajtur disa ditë para fillimit të kongresit, Komiteti Drejtues i Donatorëve të INTOSAI-t hartoi plane afatshkurtra dhe afatgjata për të zbatuar mandatin e tyre.

Kongresi miratoi 35 Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI) dhe 2 Udhëzues të INTOSAI-t për mirëqeverisjen (INTOSAI GOV), të paraqitura nga Komiteti i Standardeve Profesionale.

Kongresi XXI i INTOSAI-Pekin 2013

Me datat 22-26 tetor 2013 në Pekin të Kinës u zhvillua Kongresi i INTOSAI-t, INCOSAI XXI, me pjesëmarrjen e 192 institucioneve supreme të auditimit, përfaqësuar nga më shumë se 600 delegatë nga të gjithë SAI-t anëtare të INTOSAI-t, te drejtuar nga Kryetaret e SAI-ve.

Delegatet në Pekin rikujtuan zhvillimin e INTOSAI-t në gjashtë dekadat e fundit dhe duke përmbledhur eksperiencën praktike të anëtarëve të saj, deklaruan se:

Në shoqërinë e shekullit të XXI, informacioni dhe globalizimi janë transformuar në një dallgë të madhe, me SAI-t që përballojnë sfida të reja për të përmirësuar qeverisjen kombëtare dhe me INTOSAI-n që përballet me mundësi të reja për të trajtuar tematika globale.

SAI-t pranojnë se qeverisja kombëtare efektive është kryesore për ruajtjen e një zhvillimi ekonomik të qëndrueshëm dhe progresit social, për përmirësimin e jetës së qytetarëve, si dhe ata janë të gatshëm të kontribuojnë në përmbushjen e përgjegjësive të përcaktuara në Deklaratën e Mijëvjeçarit të Kombeve të Bashkuara. Kjo Deklarate thekson për vendet anëtare të OKB-së se: "*Ne nuk do të kursejmë asnjë përpjekje për të liruar shokët tanë burra, gra dhe fëmijë nga kushtet e mjerueshme dhe jo humane të varfërisë ekstreme, në të cilat ndodhen aktualisht më shumë se një miliardë prej tyre... Ne vendosim për këtë arsye të krijojmë një mjedis - në nivel kombëtar dhe global - i cili të jetë i favorshëm për zhvillim dhe për eliminimin e varfërisë. Suksesi në përmbushjen e këtyre objektivave varet tërësisht nga qeverisja e mirë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe nga transparenca në sistemet financiare, monetare dhe tregtare*"

- SAI-t mund të ndihmojnë duke:
  1) rritur transparencën;
  2) siguruar përgjegjshmërinë;
  3) promovuar performancën; dhe
  4) duke luftuar korrupsionin.

  Kështu ata përmirësojnë:

  A) qeverisjen e mirë kombëtare dhe
  B) rrisin paanshmërinë.

Qëndrueshmëria afatgjatë e politikave financiare është një parakusht i pamohueshëm për qeverisjen e mirë qeveritare. SAI-t, nëpërmjet auditimit të pavarur profesional, mund të ndihmojnë vendimmarrësit të ruajnë qëndrueshmërinë dhe zbatimin e politikave financiare duke rritur transparencën, duke raportuar mbi performancën e financave publike dhe duke nënvizuar risqet e sistemit.

Në një botë me globalizim intensiv, asnjë vend nuk mund të përmirësojë me sukses qeverisjen kombëtare, pa kuptuar më parë se si kjo mund të influencohet nga faktorët e jashtëm. Duke promovuar qeverisjen e mirë në vend, SAI-t duhet t'i dedikohen përmirësimit të qeverisjes globalisht përmes bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar. Në përmbushjen e sfidave globale, SAI-t do të vazhdojnë të ndërtojnë forcën e tyre për të ndërmarrë përgjegjësi të përbashkëta, të menaxhojnë risqe të përbashkëta, të ndërmarrin veprime të përbashkëta dhe të japin një mendim të njohur dhe të respektuar nën patronazhin e INTOSAI-t dhe Grupeve të Punës Rajonale.

Si një organizatë me përfaqësim të gjerë, një pozicion të pavarur të fortë dhe standarde profesionale të larta, INTOSAI do të vazhdojë të bashkëpunojë me Grupet e Punës Rajonale dhe SAI-t për të vendosur përdorimin e ISSAI-ve në përputhje me kornizat

ligjore përkatëse, për të promovuar qeverisjen e mirë, duke mbetur të pavarur, si dhe për të rritur performancën.

Ky Kongres, temat dhe mesazhet e tij, tejet të rëndësishme për komunitetin INTOSAI, do të përshkruhen në hollësi në Pjesën e Pestë dhe të Gjashte të këtij studimi.

PJESA E KATËRT: DOKUMENTET THEMELORE TË INTOSAI

Deklarata e Limës

Kur Deklarata e Limës "Udhëzuesit për rregullat e Auditimit" u miratua me aklamacione nga delegatët e Kongresit te IX-te te INTOSAI në tetor 1977 në Peru, kishte shpresa të mëdha nga SAI-t se ajo do te rregullonte disi veprimtarinë e tyre në nivel ndërkombëtar, por asnjë nga delegatet nuk mund ta imagjinonte se ajo do të arrinte një sukses të tille të gjerë botëror, i cili vazhdon akoma.

Përmbajtja

Pjesa e parë e Deklaratës së Limës përcakton qëllimin e auditimit, para dhe pas faktit, auditimi i brendshëm dhe auditimi i jashtëm, auditimet formale dhe ato të performancës.

Ajo kërkon pavarësinë e SAI-ve, anëtarëve të tyre, dhe zyrtarëve të tyre; gjithashtu kërkon pavarësinë financiare të SAI-t.

Deklarata gjithashtu mbulon marrëdhëniet në parlament, qeverinë dhe administratën. Për sa u përket pushteteve, ajo trajton rëndësinë e hetimit, zbatimin e gjetjeve të SAI-t, ekspertizat, si dhe forma të tjera të konsultimit. Ajo përfshin gjithashtu çështje që kanë të bëjnë me metodat e auditimit, personelin e auditimit, si dhe shkëmbimin e përvojave ndërkombëtare. Në të përfshihen aspekte të raportimit në Parlament, për publikun e gjerë, si dhe metoda e raportimit.

Së fundi, për sa i përket kompetencave të auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit, përcaktohet baza kushtetuese për fushat e auditimit, auditimi i menaxhimit të financave publike, auditimi i autoriteteve publike dhe institucioneve të tjera jashtë vendit, auditimi tatimor, kontratat publike dhe punët publike, auditimi i të dhënave elektronike të përpunuara, auditimi i ndërmarrjeve tregtare me pjesëmarrje publike, auditimi i institucioneve të subvencionuara, si dhe auditimi i institucioneve ndërkombëtare dhe mbikombëtare.

Rëndësia e Deklaratës

Përvojat me Deklaratën e Limës kanë tejkaluar edhe pritshmëritë më të larta dhe kanë provuar se si ajo ndikon në mënyrë vendimtare në zhvillimin e auditimit suprem publik, në kontekstin e dhënë individual të secilit vend. Deklarata e Limës ka trajtuar njëlloj çështje të rëndësishme për të gjitha Institucionet Supreme të Auditimit të grupuara në INTOSAI , pavarësisht nga cili rajon SAI-t i përkasin, çfarë zhvillimi ata kanë patur, si janë të integruar në sistemin publik apo mënyrën se si janë organizuar.

Suksesi i Deklaratës qëndron, mbi të gjitha, në faktin se ajo përmban një listë të plotë të të gjitha qëllimeve dhe çështjeve që lidhen me auditimin suprem publik, ndërsa që dokumenti ngelet jashtëzakonisht i rëndësishëm dhe konciz , duke e bërë të lehtë për t'u përdorur, me gjuhën e tij të qartë e të fokusuar tek elementet kryesore. Qëllimi kryesor i Deklaratës së Limës është thirrja për një auditim te pavarur publik. Një Institucioni Suprem i Auditimit nuk mund të ekzistojë pa pavarësi dhe në rast se kjo kërkesë nuk kthehet në standard. Duke ditur problemet e pavarësisë së shumë SAI-ve, nuk është për t'u habitur pse çështja e pavarësisë së Institucioneve Supreme të Auditimit vazhdon të jetë një temë e diskutuar në mënyrë të përsëritur brenda komunitetit te INTOSAI-t.

Kërkesat e Deklaratës së Limës nuk mbarojnë vetëm me arritjen e pavarësisë nga një SAI. Që kjo pavarësi te funksionoje, është e nevojshme që ajo te ankorohet, fiksohet në legjislacion. Për këtë, duhet të ekzistojnë institucionet e sigurisë juridike, dhe këto gjenden vetëm në një demokraci të bazuar në sundimin e ligjit.

Sundimi i ligjit dhe demokracia janë premisat thelbësore për të pasur pavarësi te vërtetë në auditimin e qeverisë dhe janë shtyllat mbi të cilat Deklarata e Limës është krijuar. Parimet dhe orientimet që përmbahen në Deklaratën janë vlera të përjetshme dhe thelbësore, të cilat kanë ruajtur aktualitetin e tyre që nga vitet kur u miratuan rreth katër dekada më parë. Fakti që INTOSAI e ka ribotuar Deklaratën disa herë, dëshmon për vërtetësinë e ideve, cilësinë dhe largpamësinë e autorëve të saj.

Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, Ban Ki-moon, ka deklaruar më 15 tetor 2013 gjatë takimit me Sekretarin e Përgjithshëm të INTOSAI-t, Dr. Josef Moser, se: "*Deklaratat e Limës dhe të Meksikos kanë kontribuar në forcimin e një pavarësie reale të institucioneve supreme të auditimit në të gjithë botën"*, ndërsa Henrik Otbo, Kryetar i Komitetit të Standardeve profesionale të INTOSAI-t dhe Auditues i Përgjithshëm i Danimarkës është shprehur për Deklaratën e Limës në numrin special të janarit 2011 të Gazetës së INTOSAI-t "INTOSAI Journal" se "*Kjo Deklarat*ë *e vendos pavarësinë e SAI-ve si një parakusht "sine qua non" q*ë *SAI-t të kryejnë detyrat e tyre; në këtë kuptim, ajo është gjithashtu një parakusht për punën profesionale të Komitetit t*ë *Standardeve Ndërkombëtare t*ë *INTOSAI-t. Plani strategjik*

INTOSAI-së thekson gjithashtu rëndësinë e pavarësisë së SAI-ve në objektivin e përgjithshëm Nr. 1 "për të promovuar SAI të forta, të pavarura dhe shumë-disiplinore".

Deklarata e Meksikos

Kongresi INCOSAI i XIX i INTOSAI-t, i mbajtur në Meksiko në tetor 2007, me Deklaratën e Meksikos vendosi tetë parimet bazë të pavarësisë së SAI-ve. Ato janë:

1. Ekzistenca e një kuadri të përshtatshëm dhe efektiv kushtetues / statutor / ligjor dhe të dispozitave të aplikimit në praktikë të këtij kuadri, si dhe te një legjislacioni që parashikon në detaje shkallën e pavarësisë së kërkuar nga SAI;
2. Pavarësia e drejtuesve të SAI-t dhe pjesëtarëve (të institucioneve kolegjiale), duke përfshirë sigurinë e mandatit dhe imunitetin ligjor në kryerjen normale të detyrave të tyre;
3. Një mandat mjaft i gjerë dhe i plotë, në kryerjen e funksioneve të SAI-t;

   Është pikërisht një mandat i tillë më i gjerë që ne si KLSH po kërkojmë sot me amendamentet ndaj ligjit tonë organik;

4. Qasje e pakufizuar në informacion;
5. E drejta dhe detyrimi për të raportuar mbi punën e SAI-t;
6. Liria për të vendosur përmbajtjen dhe kohën e raporteve të auditimit dhe për t'i publikuar dhe shpërndarë ato;
7. Ekzistenca e mekanizmave efektivë ndjekës në rekomandimet e SAI-ve;
8. Autonomia financiare dhe menaxheriale / administrative dhe disponueshmëria e burimeve njerëzore, materiale dhe monetare të përshtatshme.

Këto parime burojnë nga përmbajtja e Deklaratës së Limës, kushtetutës së SAI-ve dhe forcojnë kërkesat e SAI-ve kombëtare për garantimin e pavarësisë së tyre të plotë në ushtrimin e mandatit të tyre. Ky forcim erdhi si kërkesë e natyrshme e SAI-ve të ndryshme për t'u mbrojtur nga metodat e sofistifikuara të përdorura nga disa qeveri edhe të vendeve të zhvilluara, për të ndërhyrë dhe kushtëzuar veprimtarinë e SAI-ve kombëtare. Deklarata e Meksikos sanksionon pavarësinë reale të SAI-ve dhe përforcon përmbajtjen e Deklaratës së Limës. Të dyja këto Deklarata kanë shërbyer gjatë historisë së dy dekadave të fundit të INTOSAI-t, si rrufepritës të fuqishëm kundrejt çdo orvatje të qeverive apo segmenteve te caktuara të tyre për të ndërhyrë në pavarësinë financiare dhe operacionale të SAI-ve. Me to, SAI-t janë ndjerë më të mbrojtura, duke e ngritur solidaritetin e komunitetit INTOSAI në një nivel të paprecedent.

Rezoluta A/66/2009 e Kombeve te Bashkuara

Njohja e arritjeve të komunitetit të SAI-ve nga Kombet e Bashkuara me rezolutën e Asamblesë të Përgjithshme A/66/209 të 22 dhjetorit 2011, është rezultat logjik i punës

së vështirë dhe të suksesshme të INTOSAI-t gjatë viteve të fundit. Ajo e vendos INTOSAI-n – duke përfshirë punën e tij në vendosjen e standardeve dhe në auditimin e sektorit publik - në fokusin e shqetësimeve të komunitetit ndërkombëtar. Institucionet e auditimit të sektorit publik, me karakterin e tyre të pavarur, konsiderohen si një pjesë e rëndësishme e qeverisjes së mirë. SAI-t tani kanë një mjet efektiv në dorë për të kërkuar që qeveritë kombëtare të njohin dhe zbatojnë parimet bazë të pavarësisë së SAI-ve nga pushteti ekzekutiv dhe legjislativ. Sukseset konkrete janë raportuar tashmë nga SAI-t e të gjitha rajoneve të INTOSAI-t.

Kjo Rezolutë promovon llogaridhënien , efektshmërinë, eficiencën dhe transparencën e administratës publike, duke forcuar Institucionet Supreme të Auditimit. Duke theksuar nevojën për ndërtimin e kapaciteteve si një mjet për të promovuar zhvillimin dhe duke mirëpritur bashkëpunimin e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit me Kombet e Bashkuara në këtë drejtim , Rezoluta pranon se Institucionet Supreme të Auditimit mund të kryejnë detyrat e tyre objektivisht dhe në mënyrë efektive vetëm nëse ato janë të pavarura nga entiteti i audituar dhe janë të mbrojtura kundër ndikimit të jashtëm. Ajo njeh rolin e rëndësishëm të Institucioneve Supreme të Auditimit në promovimin e llogaridhënies , efektshmërisë, eficiencës dhe transparencës së administrates publike, për arritjen e objektivave dhe prioriteteve kombëtare të zhvillimit.

Rezoluta vlerëson Deklaratën e Limës dhe Deklaratën e Meksikos dhe fton e inkurajon Shtetet Anëtare te OKB, për të aplikuar në mënyrë konsistente me strukturat e tyre kombëtare institucionale, parimet e parashtruara në këto deklarata. Ajo gjithashtu i nxit Shtetet Anëtare dhe institucionet perkatese të Kombeve të Bashkuara për te vazhduar dhe intensifikuar bashkëpunimin e tyre me SAI-t, duke përfshirë ndërtimin e kapaciteteve, si dhe duke siguruar efiçiencë, përgjegjshmëri dhe transparencë nëpërmjet forcimit të SAI-ve.

Me Rezolutën e OKB-së , SAI-t kanë një mjet efektiv për të kërkuar që qeveritë kombëtare të njohin dhe zbatojnë parimet bazë të pavarësisë së SAI-ve. INTOSAI i ka këshilluar SAI-t t'i zbërthejnë mesazhet qendrore të Rezolutës dhe t'i ndajnë ato me strukturat që bashkëveprojnë në Parlamentet kombëtare, për të siguruar përkrahje ne rritje për aktivitetin e tyre.

KLSH e ka përkthyer Rezolutën dhe e ka vendosur në faqen e saj ne internet. Idetë dhe mesazhet e saj përmbahen në çdo dokument të rëndësishëm të institucionit.

PJESA E PESTË: KONGRESI I PEKINIT, TEMA E PARË

Kongresi i INTOSAI-t, INCOSAI XXI, në Pekin në tetor 2013 është ndër kongreset më të rëndësishme të INTOSAI-t, duke patur parasysh kushtet e vështira ekonomike të pasojave të krizës botërore ekonomike dhe financiare. Kongresi rishikoi progresin e Planit Strategjik të INTOSAI-t për vitet 2011 – 2016. Ai prezantoi dy tema kryesore, "Auditimi Kombëtar dhe Qeverisja Kombëtare", si dhe "Roli i SAI-ve në Ruajtjen e Qëndrueshmërisë së Politikave Financiare".

Tema I: Promovimi i Qeverisjes së Mirë Kombëtare nga SAI-t

Qe ne krijimin e tij, qëllimi kryesor i INTOSAI-t ishte promovimi i qeverisjes së mirë. SAI-t mund të kryejnë mirë këtë detyrë vetëm nëse ata janë të pavarur nga agjencitë që ata auditojnë dhe janë të mbrojtur nga influencat e jashtme të çdo forme. INTOSAI njeh se është e rëndësishme që metodat e auditimit të SAI-ve të bazohen në njohuritë teknike dhe shkencore aktuale dhe që audituesit të kenë kualifikime të përshtatshme profesionale, si edhe integritet moral.

Për këto arsye, në vitin 1977, INTOSAI aprovoi Deklaratën e Limës dhe me Deklaratën e Meksikës të vitit 2007, vendosi tetë parimet e pavarësisë të auditimit suprem publik në aspektet e tij metodologjike dhe profesionale.

Gjatë viteve të fundit, eksperienca e pa precedent, komplekse dhe e pasigurt në ekonominë globale ka sjellë sfida të reja për çdo shtet në përpjekjen e tyre për të promovuar një qeverisje më të mirë kombëtare.

Promovimi i mirë qeverisjes në sektorin publik ka qenë një nga prioritetet kryesore të komunitetit INTOSAI për një kohë të gjatë. Takimi i 62-të i Bordit Qeverisës të INTOSAI-t, i mbajtur në tetor 2011, aprovoi në mënyrë unanime propozimin e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kinës (CNAO) për të pasur "Auditim Kombëtar dhe Qeverisje Kombëtare" si tema e parë për diskutim në INCOSAI-n e XXI.

Lidhja mes auditimit kombëtar dhe qeverisjes kombëtare

Auditimi kombëtar luan një rol të rëndësishëm, si dhe i bën qeveritë të japin llogari. Shumë SAI e përshkruajnë funksionin kryesor të auditimit kombëtar si një funksion sigurimi, i kryer nga një institucion i pavarur dhe i specializuar, si dhe kjo gjë është e përcaktuar me ligj. Roli i një SAI në sistemin e qeverisjes kombëtare është i ngjashëm me "sistemin imunitar" të trupit të njeriut.

Shumë shtete në botë kanë pranuar nevojën për një institucion të pavarur auditimi me autoritetin/fuqinë e nevojshme konform kushtetutës së tyre. Megjithatë, duhet të

pranohet që ekzistenca e institucioneve të pavarura të auditimit varet shumë nga një qeverisje e mirë.

Roli i rëndësishëm i auditimit kombëtar në përmirësimin e qeverisjes kombëtare

Me kalimin e viteve, në një linjë me parimet e Deklaratës së Limës dhe Meksikos, SAI-t kanë luajtur një rol aktiv në promovimin e përmirësimit të qeverisjes kombëtare. Rolet e mëposhtme janë identifikuar si të rëndësishme në ndikimin e auditimit kombëtar në qeverisjen kombëtare:

Ndërgjegjësimi dhe mbrojtja e demokracisë dhe shtetit të së drejtës

Auditimi kombëtar është një forcë e rëndësishme në demokraci dhe në shtetin e së drejtës:

- Mbrojtja e interesit publik, duke raportuar mbi përdorimin e burimeve publike,
- Promovimi i zbatimit të ligjit dhe rregulloreve,
- Raportimi në përputhje me ligjet dhe rregulloret, dhe
- Vendosja e sanksioneve, kur ka një mandat të tillë.

Rritja e performancës së qeverisë

Auditimi kombëtar luan një rol të rëndësishëm në promovimin e performancës së qeverisë, veçanërisht përmes:

- Rritjes së ekonomicitetit, efektivitetit dhe efiçiencës së fondeve publike,
- Përmirësimit të mekanizmit operacional të organizatave qeveritare,
- Promovimit të integritetit, përgjegjshmërisë dhe transparencës së administratës, dhe
- Promovimit të praktikave më të mira të sektorit publik, duke shkëmbyer eksperienca, metoda dhe informacion.

Promovimi i një administrate të pastër dhe të ndershme

Auditimet kombëtare kontribuojnë për ta bërë më të pastër dhe të ndershme administratën nëpërmjet:

- Zhvillimit të auditimeve për të siguruar që qeveria është e përgjegjshme për administrimin dhe përdorimin e burimeve publike,
- Zbulimit të mashtrimit dhe parregullsive,
- Vendosjes së sanksioneve kur institucionet e auditimit kanë funksione juridike,

- Dakordësimit mbi përcaktimin e përgjithshëm të INTOSAI-t mbi mashtrimin dhe korrupsionin dhe përfshirjen e kësaj në kuadrin e ISSAI-ve, dhe
- Vlerësimit të kontrolleve të brendshme të sektorit publik, duke zbutur riskun për mashtrime.

Promovimi i përmirësimit të jetës së qytetarëve

Një pjesë e madhe e fondeve publike shkon për përmirësimin e jetesës së njerëzve. Institucionet e auditimit kontribuojnë duke:

- Audituar shërbimet primare të fushave të shpërndarjes si arsimimi, kujdesi shëndetësor, parandalimi i sëmundjeve dhe kontrolli, shëndeti, varfëria, siguria shoqërore, punësimi, strehimi, transporti publik, mbrojtja e mjedisit, parashikimi i fatkeqësive/katastrofave dhe kontrolli si dhe rimëkëmbja prej tyre, dhe
- Fokusuar auditimet në alokimin dhe/ose përdorimin e burimeve për interesin publik.

Sfidat që ndeshin SAI-t dhe përgjigjet e mundshme

Kompleksiteti i qeverisjes kombëtare dhe ndryshimi i shpejtë i mjedisit të auditimit kërkojnë që SAI-t të përgjigjen ndaj tyre në mënyrë që të mbeten domethënës. Kompleksiteti në rritje i qeverisjes kërkon që auditimet kombëtare duhet të përshtaten dhe të përtërihen, përtej njohurive ekzistuese dhe praktikave. SAI-t duhet të identifikojnë dëmet që këto kushte sjellin ndaj mandatit dhe/ose funksioneve të tyre. Kjo shtrihet në procesin e vendosjes së standardeve për të siguruar vazhdimësinë ndaj kuadrit të ISSAI-ve.

SAI-t në Kongres identifikuan çështjet në vijim për t'u adresuar:

Kryerja e auditimeve me vizionin e auditimit kombëtar që shërben ndaj qeverisjes kombëtare

- Të sigurojë praktika të auditimit financiar që mbeten të rëndësishme duke iu përgjigjur sfidave aktuale,
- Rregullisht, të identifikojë dhe të caktojë prioritetet e pritshmërive të grupeve të interesit,
- Të ketë vëmendje të veçantë ndaj sfidave ekonomike dhe shoqërore për të rritur rëndësinë, afër dhe larg auditimit,
- Të forcojë mbikëqyrjen ndaj keqpërdorimit të pushtetit,
- Të përgjigjet ndaj shqetësimeve të qytetarëve mbi mashtrimin dhe korrupsionin,

- Të fokusohet në përmirësimin e sistemeve të menaxhimit, mekanizmave dhe institucioneve,
- Të ofrojë informacione të besueshme, në kohë dhe objektive tek grupet e interesit për të marrë vendime nga mirë-informimi, dhe
- Të ndjekë zbatimin e gjetjeve të auditimeve dhe rekomandimeve.

Vazhdimësia e përpjekjeve që SAI-t të jenë të pavarur:

- Të sigurojë që SAI-t kanë mandatin e nevojshëm dhe pavarësi;
- Të krijojë njohuri rreth rezolutave të Kombeve të Bashkuara mbi pavarësinë e SAI-ve, dhe
- Të ndajë njohuritë dhe mënyrat sesi mund të arrihet pavarësia e plotë siç theksohet në Deklaratat e Limës dhe Meksikos.

Krijimi i një mjedisi profesional dhe kushteve për auditim financiar:

- Të promovojë përshtatjen e kuadrit financiar përgjithësisht të pranuar për sektorin publik;
- Të aplikojë ISSAI-t dhe standarde të tjera të rëndësishme për të rritur kredibilitetin e raportimit;
- Të përmirësojë kompetencat e institucioneve të auditimit dhe personelit nëpërmjet mësimit dhe ndarjes së njohurive, dhe
- Të komunikojë rezultatet e auditimit në mënyrë profesionale.

Forcimi i kapaciteteve të institucioneve të auditimit

- Vazhdimësia e ngritjes së kapaciteteve institucionale të SAI-ve;
- Përdorimi i iniciativave të ngritjes së kapaciteteve të IDI-t;
- Ndarja e njohurive dhe eksperiencave për të rritur efektivitetin e auditimeve;
- Të përpiqet të jetë një organizatë model për institucionet e tjera publike.

Komunikimi dhe bashkëpunimi me grupet e interesit

- Forcimi i bashkëpunimit me grupet e interesit;
- Aplikimi i parimeve të ISSAI-t 12 "Vlera dhe Përfitime të SAI-ve – të bësh diferencën për jetën e qytetarëve dhe përdorimi i udhëzuesve përkatës mbi "Komunikimin dhe Promovimin e Vlerave dhe Përfitimeve të SAI-ve: Një Udhëzues i INTOSAI-t";
- Përdorimi i "Udhëzuesve të INTOSAI-t për Komunikimin";
- Lehtësimi për qytetarët, që të përfshihen në proceset e auditimit dhe shpërndarja e rezultateve të auditimit.

Roli i INTOSAI-t në promovimin e përmirësimit të Qeverisjes Kombëtare dhe asaj Globale

INTOSAI si të gjitha organizatat e tjera nëpër botë, sfidohet nga globalizimi dhe ndesh nevojën për modernizim në procedurat e veta të punës dhe metodat në mënyrë që të mbetet i rëndësishëm ndaj grupeve të interesit.

Për këtë, INTOSAI përshtati në 2004, Planin e tij Strategjik, nëpërmjet të cilit strukturat e punës të INTOSAI-t u modernizuan. INTOSAI ka përcaktuar procedurat për zhvillim, duke nxjerrë standardet e ruajtjes profesionale. Këto procedura janë të përfshira në Procesin Përkatës të INTOSAI-t për Standardet Profesionale.

INTOSAI synon të pozicionojë komunikimin e jashtëm dhe të brendshëm si një funksion strategjik, i cili kontribuon për një ecuri normale të qeverisjes së jashtme të komunitetit të auditimit.

Në vitet e fundit, INTOSAI ka zhvilluar gjithashtu marrëdhënie konstruktive pune me organizatat të ndryshme ndërkombëtare, si Kombet e Bashkuara, IPU dhe OSBE.

Më tej, INTOSAI ka përcaktuar një Komitet të qëndrueshëm Mbikëqyrjeje mbi Çështjet që Dalin në Pah.

Të gjitha SAI-t unanimisht, ranë dakord së INTOSAI ka një detyrë të rëndësishme për të vazhduar promovimin e qeverisjes së mirë. INTOSAI ka nevojë për të vazhduar përmirësimin e qeverisjes së tij për t'u bërë një organizatë model. Kjo do t'i udhëheqë dhe promovojë SAI-t në përmirësimin e qeverisjes kombëtare në përputhje me parimet e "Eksperienca e përbashkët u shërben të gjithëve". Si një organizatë ndërkombëtare, INTOSAI duhet të marrë pjesë në mënyrë aktive në iniciativat globale të qeverisjes dhe në mënyrë aktive të influencojë qeverisjen globale.

INTOSAI duhet gjithashtu të luajë një rol më efektiv në promovimin e përmirësimit të qeverisjes kombëtare dhe globale, dhe si përfundim duhet të **udhëheqë dhe inkurajojë SAI-t të luajnë një rol më efektiv në promovimin e qeverisjes kombëtare.**

INTOSAI duhet të vazhdojë të:

- Formulojë udhëzues për qeverisjen e mirë;
- Bashkëpunojë me organizatat ndërkombëtare apo institucionet akademike;
- Ndjekë zhvillimet ndërkombëtare lidhur me qeverisjen e mirë;
- Rrisë vetëdijen e publikut mbi rolin e institucioneve të auditimit në promovimin e përmirësimit të qeverisjes kombëtare;
- Ngrejë platformë komunikimi dhe shkëmbimi ndërmjet SAI-ve nëpërmjet grupeve të punës ekzistuese dhe organizatave rajonale;

- Inkurajojë auditimet e përbashkëta në fusha me interes të përbashkët dhe të ofrojë mbështetje teknike, dhe
- Forcojë bashkëpunimin e tij me organizata të tjera ndërkombëtare, institucione rajonale, forume dhe median.

Promovojë përmirësimin e qeverisjes globale

Si një organizatë e njohur ndërkombëtarisht, INTOSAI duhet të shtrijë qeverisjen e mirë nga niveli kombëtar në atë global, duke:

- Shpërndarë idenë e qeverisjes së mirë;
- Inkurajuar SAI-et t'u ofrojnë organizatave ndërkombëtare dhe trans-rajonale shërbime auditimi të pavarura;
- Ndarë praktikat e mira në qeverisjen globale;
- Përcaktuar një mekanizëm për promovimin e qeverisjes së mirë;
- Forcuar zbatimin e Strategjisë dhe Politikës së Komunikimit të INTOSAI-t;
- Promovuar aktivisht qeverisjen globale në komunitetin ndërkombëtar, dhe kontributin e INTOSAI-t;
- Shpërndarë punën e nën-komiteteve të ndryshme, grupeve të punës, task forcave dhe projekt-grupeve të INTOSAI-t për t'u marrë me konceptin e qeverisjes globale;
- Inkurajuar auditime të përbashkëta në fushat lidhur me krizën financiare globale dhe mbrojtjen e mjedisit,
- Forcuar komunikimin, koordinimin dhe dialogun me KB, agjenci të tjera ndërkombëtare, subjekte profesionale dhe institucione kërkimore.

Qeveritë dhe qytetarët e të gjitha shteteve kërkojnë promovimin dhe përmirësimin e qeverisjes kombëtare në mënyrë që të mundësohet zhvillimi i qëndrueshëm i shoqërisë, ekonomisë dhe ambientit. Si një pjesë e pandashme e qeverisjes kombëtare, auditimi kombëtar kryen funksionet e tij në përputhje me ligjin dhe rregullat dhe jep, në mënyrë objektive, auditim mbikëqyrës, verifikim, vlerësim dhe rekomandime që vendimmarrësit përdorin për të hartuar politika dhe programe vendimmarrjeje. SAI-t duhet të përpiqen të jenë kampionë të së vërtetës, ndershmërisë dhe integritetit në jetën publike.

Rekomandimet për Temën I

Së fundi, Anëtarët e Kongresit:

<u>Njohin</u> rolin e rëndësishëm që SAI-t mund të luajnë në forcimin e qeverisjes kombëtare, duke krijuar kështu bazat për zhvillimin e qëndrueshëm dhe siguruar "një jetë dinjitoze" për qytetarët;

Ritheksojnë vlerën e pavarësisë të përcaktuar në Deklaratën e Limës dhe të Meksikos, pa të cilat, SAI-t do të ishin të kufizuar në kontributin e tyre ndaj qeverisjes kombëtare,

Konfirmojnë se, në plotësimin e përgjegjësive të tyre, SAI-t kanë nevojë të kontribuojnë në:

- Promovimin e ndershëm dhe të pastër të qeverisjes dhe administratës;
- Rritjen e efektivitetit, efiçiencës dhe ekonomicitetit të qeverisjes si dhe të kenë një përdorim të njëtrajtshëm të burimeve publike;
- Rritjen e transparencës dhe përgjegjshmërisë në sektorin publik;
- Krijimin e vetëdijes për mbrojtjen e demokracisë dhe shtetit ligjor;
- Mbrojtjen e interesave publikë, dhe
- Promovimin e përmirësimit të jetesës së qytetarëve.

Konfirmojnë, vlerat në vazhdim, të komunikimit të strukturuar dhe angazhimit me grupet e interesit për t'i dhënë rëndësi të kuptuarit të nevojave të qytetarëve në terma të qeverisjes kombëtare,

Propozojnë që proceset e vendosjes së standardeve të INTOSAI-t:

- T'i japin prioritet zhvillimit të mëtejshëm të standardeve dhe udhëzuesve për çështje lidhur me auditimin në sektorin publik dhe qeverisjes kombëtare;
- Të rishikojnë kuadrin ekzistues të ISSAI-ve dhe INTOSAI GOV për të siguruar që metodologjia e auditimit të kontribuojë në qeverisjen kombëtare; dhe
- Të bien dakord mbi një përcaktim të unifikuar të INTOSAI-t për mashtrimin dhe korrupsionin.

Inkurajojnë, miratimin pro-aktiv dhe të gjithanshëm të kuadrit të ISSAI-ve nga të gjithë anëtarët e INTOSAI-t,

Kërkojnë, vazhdimësi dhe aktivitete të ngritjes së kapaciteteve të mirë-koordinuara në INTOSAI, duke e vënë theksin në krijimin e "komuniteteve të praktikave të mira" për të forcuar pavarësinë, profesionalizimin e zyrave të auditimit dhe shkëmbimit të eksperiencave dhe njohurive, për të mundësuar të gjitha SAI-t të japin një kontribut domethënës në qeverisjen kombëtare të vendeve të tyre,

Kërkojnë, finalizimin urgjent të Kuadrit të Matshmërisë së Performancës së SAI-ve, për të lejuar SAI-t të masin funksionimin e tyre, si dhe të fokusohen në proceset strategjike të kontributit në qeverisjen kombëtare,

Njohin rolin e rëndësishëm të komunitetit të donatorëve në mundësimin dhe mbështetjen e proceseve të vazhdueshme të ngritjes së kapaciteteve dhe inovacionit,

Njohin vlerën e punës së bërë në nivel nën-komitetesh të INTOSAI-t, grupeve të punës dhe task forcave për të siguruar që SAI-t të mbeten të rëndësishëm, **përdorin** parimet kryesore të zhvilluara së fundi të auditimit në fushat e auditimeve financiare, të përputhshmërisë dhe performancës (ISSAI 100-400) për të forcuar më tej këto praktika auditimi dhe **nxisin** zhvillimin e mëtejshëm të mekanizmave të reagimit ndaj mjedisit gjithnjë e në ndryshim të auditimit dhe nevojave të qytetarëve.

PJESA E GJASHTË: KONGRESI I PEKINIT, TEMA E DYTË DHE KONKLUZIONET

Kongresi i INTOSAI-t, INCOSAI XXI, në Pekin në tetor 2013 zhvilloi një temë të dytë qendrore, e cila ishte: "Roli i SAI-ve në Ruajtjen e Qëndrueshmërisë së Politikave Financiare".

Tema II: Ruajtja e Qëndrueshmërisë Afatgjatë të Financave Publike

Siç thuhet gjerësisht, financat publike të qëndrueshme janë ato që plotësojnë detyrimet aktuale dhe të ardhshme pa kaluar në nivele të tejkaluara të borxhit ndaj brezave të ardhshëm.

Qëndrueshmëria afat-gjatë e politikave financiare është e nevojshme për të çuar më tej zhvillimin shoqëror dhe ekonomik të vendeve.

Diskutimi mbi Temën, në mënyrë të përmbledhur trajton rëndësinë e kombeve për të ruajtur financa publike të shëndosha, për të ruajtur dhe shtuar rritjen ekonomike, punësimin dhe standardet e jetesës. Më tej, duke parë globalizimin ekonomik, qëndrueshmëria e financave publike nëpërmjet miratimit të politikave të shëndosha nga qeveria, është gjithashtu e rëndësishme në të gjithë botën.

Masa dhe struktura si e borxhit publik ashtu edhe e deficitit publik, si edhe niveli dhe struktura e të ardhurave dhe shpenzimeve, kanë një ndikim të rëndësishëm në rritjen ekonomike dhe qëndrueshmërinë.

Financat publike të shëndosha dhe një politikë monetare e duhur, përbëjnë një kontribut thelbësor drejt arritjes së qëllimeve për inflacion të ulët dhe terma të përshtatshëm financimi, të cilët me kohë, lehtësojnë planifikimin afat-gjatë dhe investimet.

Qëndrueshmëria e financave publike ka qenë në axhendën e INTOSAI-t për shumë vite, deri më tani. Në 1991, Komiteti i Borxhit Publik i INTOSAI-t, filloi punën e tij dhe u njoh si Grup Pune, në 2007. Në 2008, INTOSAI, themeloi si kundërpërgjigje të

menjëhershme ndaj krizës financiare: Task Forcën për Krizën Globale Financiare, i cili u njoh në 2012, si Grup Pune mbi Reformën Rregullatore dhe Modernizimin Financiar.
Më tej, një seri Standartesh Ndërkombëtare të SAI-ve, ISSAI-t (ISSAI, 5410-5450), mbi borxhin publik, u botuan. Megjithatë, kriza financiare, buxhetore dhe ekonomike vendosi përpara SAI-ve sfida të veçanta, të cilat në interes të publikut, mund t'i adresohen nga SAI-t si pjesë e funksioneve të tyre audituese.
Duke kuptuar disekuilibrat makro-ekonomikë dhe risqet që burojnë nga sistemi financiar si në rang kombëtar ashtu edhe global, dhe një vështrim efektiv i çështjeve ekonomike dhe fiskale, ndihmon të informojë qeveritë për vendimet që kontribuojnë në qëndrueshmërinë afat-gjatë të politikave qeverisëse.
Mësimet që dalin nga kriza globale financiare dhe ekonomike në fillim të shekullit XXI, kanë theksuar rëndësinë strategjike të mbajtjes nga qeveritë të financave publike të shëndosha, në mënyrë që të krijohen kushtet për rritjen ekonomike, punësimin dhe mirëqenien shoqërore.
Nëpërmjet auditimeve të pavarura dhe të shëndosha, SAI-t kontribuojnë në mbajtjen e qëndrueshmërisë afatmesme dhe afatgjatë të financave publike, në mbrojtje të interesit publik dhe forcimit të qeverisjes kombëtare në çdo vend. Duke pranuar mandatin e çdo SAI anëtar të INTOSAI-t për të përcaktuar qasjen e tij në përputhje me legjislacionin kombëtar përkatës, aspektet për tu marrë në konsideratë kur trajtohet çështja e qëndrueshmërisë financiare janë:
Forcimi i auditimeve të deklaratave financiare qeveritare me qëllim vendosjen dhe përmirësimin e kornizës financiare institucionale dhe standardeve të raportimit financiare, në mënyrë që të paraqiten me drejtësi performanca financiare dhe pozicioni i qeverisë.
Përmirësimi i auditimeve publike të performances, në mënyrë që të inkurajohet mbështetja fiskale afat mesme dhe afat gjatë, si dhe mirë qeverisja.
Përforcimi i auditimeve për borxhin publik, duke marrë në konsideratë angazhimet e drejtpërdrejta, sikurse edhe detyrimet dhe kontigjentët financiarë me objektivin për të identifikuar çështjet dhe riskun në menaxhim, si dhe zhvillimet e pritshme të borxhit dhe defiçitit financiar.
Të zhvillohet aftësia për të audituar fazat e planifikimit të financave publike, me qëllim që të nxisë ekzekutivin dhe legjislativin të vlerësojë projektet afat mesme dhe afat gjatë, të cilët janë të lidhura me zhvillimet e mundshme e cikleve të ekonomisë, borxhit, programeve publike, si dhe angazhime të tjera si siguria sociale, pensionet, arsimi dhe kujdesi publik, sikundër edhe rastet si fatkeqësitë natyrore, ndryshimet klimaterike dhe shoku financiar.
Vlerësimi i planifikimit të qeverisë lidhur me ekonominë, financat publike dhe borxhin publik, do të bëjë të mundur identifikimin e risqeve të mundshme, si dhe do të jepen rekomandime konstruktive.

Të rritet numri i auditimeve të përputhshmërisë me rregullat fiskale, rregulloret financiare dhe standardet e pranuara, si dhe zbatimin e gjithë proceseve buxhetore të qeverisë. Objektivi është sigurimi i përgjegjshmërisë gjatë fazave të planifikimit, zbatimit, zhvillimit dhe rezultatit të arritur. Mbi të gjitha, kontrollet e brendshme efektive duhet të përmirësohen në lidhje me sistemin e menaxhimit të riskut.

Adoptimin e politikave për zhvillimin e financave publike. SAI-t duhet të vazhdojnë të kryejnë auditime përtej saktësisë, efektivitetit dhe mbështetjes së politikave publike, në mënyrë që të promovohet zhvillimi ekonomik dhe mirëqenia sociale në çdo shtet.

Për më tepër, për sa i përket saktësisë dhe mbështetjes fiskale, si dhe roli që duhet të luhet, SAI-t duhet të inkurajojnë transparencën në lidhje me përdorimin e burimeve të publike financiare dhe qasjet ndaj menaxhimit fiskal.

Rëndësia e Deklaratës së Limës dhe Meksikos, rezolutës së OKB-së për të forcuar rolin e SAI-ve, si dhe mbështetja e secili shtet u përshëndet. Kur duhet të kryhen auditime në lidhje me qëndrueshmërinë e politikave financiare, duhet të rritet roli i mandatit të SAI-t.

U pranua se SAI-t nuk duhet të komentojnë mbi meritat e politikave specifike të qeverisë apo politikave monetare, por në shumë vende, pritet të tërhiqet vëmendja ndaj çdo çështje agregate apo sistemike që janë me kaq rëndësi sa mund të kenë impakt në qëndrueshmërinë afat-gjatë të politikave të qeverisë dhe financat. Për rrjedhojë, SAI-t duhet të inkurajojnë transparencën e informimit, për të informuar më mirë publikun dhe grupet e interesit kyçe si dhe përgjegjshmërinë, lidhur me kuadrin e financave publike në mënyrë që të bëjë publik pozicionin dhe ekzistencën e ndonjë pengese, risku dhe sfide që mund të kërkojë vëmendje nga qeveria.

Disa SAI shprehën shqetësimin e tyre pë auditimin e proceseve të lidhura me pozicionet buxhetore apo parashikimet lidhur me qëndrueshmërinë e financave të qeverisë, ndërsa të tjerë, njohën përfitimet e kryerjes së këtyre lloj auditimesh, në theksimin e mundësive për përmirësime të sistemit.

Rëndësia e Deklaratave të Limës dhe Meksikos, dhe Rezolutës së KB për forcimin e SAI-ve, si dhe mbështetja ndërkombëtare ndaj njëri-tjetrit, u njoh. Kështu, kur auditimet lidhur me qëndrueshmërinë e politikave financiare do të bëhen nga SAI-t, mandatet e tyre mund të kenë nevojë për përmirësime.

Kur mandati i tyre është i duhuri dhe qëndrueshmëria financiare është një prioritet për qeverinë, SAI-t janë në gjendje të shtojnë vlera nëpërmjet rolit të tyre të jashtëm dhe të raportimit mbi çështje që ndikojnë qëndrueshmërinë afat-gjatë të politikave dhe financave qeverisëse. Ky rol strategjik, fokusohet në arritjen dhe ruajtjen e financave publike të shëndosha në mënyrë që të krijohen kushtet për rritje ekonomike, punësim dhe mirëqenie sociale.

Gjatë vendosjes nëse duhet të ndërmerren auditime të politikave financiare të qëndrueshme, SAI-t njohin nevojën që kanë për të marrë në konsideratë mundësinë e

aftësive të duhura dhe burimeve brenda institucioneve. Për rrjedhojë, njihet që risqet për këto auditime, mund të jenë më të larta dhe kërkojnë menaxhim më nga afër.
Nëpërmjet auditimeve të sakta dhe të pavarura, SAI-t kontribuojnë në arritjen e qëndrueshmërisë afat-mesme dhe afat-gjata të politikave financiare, ruajtjes së interesit publik dhe rritjes së qeverisjes kombëtare sipas mandateve të tyre dhe situatave të tyre praktike.
Të kuptuarit nga SAI-t të qëndrueshmërisë të financave të qeverisë do të bazohet nga të kuptuarit në brendësi të administrimit qeverisës dhe auditimeve të pasqyrave financiare të subjekteve të qeverisë, auditimet e përputhshmërisë me kuadrin ligjor dhe kur është e mundur, të auditimeve të performancës mbi tema kryesore siç janë rregullimi dhe mbikëqyrja e industrisë financiare, integriteti i taksimit të administratës kombëtare dhe menaxhimi i borxhit publik.
Është e njohur se, nëpërmjet auditimeve të pavarura dhe të sakta, SAI-t kontribuojnë në pasjen e një qëndrueshmërie afat-mesme dhe afat-gjatë të politikave financiare, duke mbrojtur interesin publik dhe duke rritur qeverisjen kombëtare sipas mandateve të tyre dhe situatave të tyre praktike.
Vitet e ardhshme do të ofrojnë mundësinë për INTOSAI-n dhe grupet e tij rajonalë, të forcojnë kontributet e tyre në zhvillimin e qëllimeve dhe prioriteteve kombëtare dhe ndërkombëtare duke theksuar kontributet dhe inkurajuar perspektivën e SAI-ve nga Qëndrueshmërisë Publike Financiare. Më tej, u theksua rëndësia e qeverive transparente dhe të përgjegjshme dhe në këtë kontekst, u njoh edhe roli i SAI-ve.
U sugjerua që INTOSAI, mund të marrë parasysh të ndërmarrë kërkime për të zhvilluar një përqasje model të qëndrueshmërisë së auditimit financiar, duke promovuar kështu një kuadër të përbashkët për SAI-t, për të rritur kapacitetet e tyre institucionale. Ky model, mund të mbartë edhe praktika më të mira të metodave të auditimit të elementëve kyç të administratës që bien mbi qëndrueshmërinë, si taksimi dhe të ardhura të tjera, menaxhimi i borxhit publik, si edhe etapat e pranuara ndërkombëtarisht për të vlerësuar performancën.
Më tej, INTOSAI u inkurajua të përdorë influencën e tij për të vazhduar të promovojë zhvillimin e kuadrit të raportimit financiar të harmonizuar brenda sektorit publik për të dhënë transparencë më të madhe në respekt të veprimeve të qeverisë, veçanërisht në lidhje me borxhin e qeverisë.

Rekomandimet per Temen II

Kongresi pati konsensus se, vendimet e SAI-ve në ndërmarrjen e auditimeve të fokusuara në qëndrueshmërinë e financave të qeverisë, do të ndikoheshin nga pozita financiare dhe ekonomike e secilit vend si dhe nga prioritetet fiskale, nga çdo risk domethënës apo ekspozim në qeverisjen kombëtare dhe nga prioritetet dhe kapaciteti i SAI-ve.

Kur adresojnë çështjet mbi qëndrueshmërinë financiare, SAI-t duhet të marrin në konsideratë sa vijon:

- Ngritjen e aftësive për të audituar fazën e planifikimit të financave publike, me qëllim të nxisin degët Ekzekutive dhe Legjislative të vlerësojnë perspektivat afat-mesme dhe afat-gjata ose projektimet e lidhura me zhvillimet e pritshme të ciklit ekonomik, shërbimit të borxhit, programeve publike dhe angazhimeve të tjera si siguria shoqërore, pensionet, arsimimi dhe kujdesi për shëndetin, ashtu edhe pasiguritë, si fatkeqësitë natyrore, ndryshimet në klimë apo goditjet financiare.
- Vlerësimin e parashikimeve të qeverive lidhur me ekonominë, financat publike dhe borxhin publik, duke identifikuar kështu risqet dhe duke dhënë rekomandime konstruktive.
- Rritjen e rregullave të përputhshmërisë me ato fiskale, rregulloret financiare dhe standardet e pranuara, ashtu si edhe aderimin në të gjitha proceset buxhetore të qeverisë. Objektivi është të sigurohet përgjegjshmëria nëpërmjet fazave të planifikimit, ekzekutimit, vlerësimit të performancës dhe rezultateve të arritura. Më tej, kontrollet e brendshme efektive duhet të përmirësohen me një sistem të menaxhimit të riskut.
- Rritjen e vlerësimit të politikave financiare publike. SAI-t do të vazhdojnë të kryejnë auditime mbi pozitivitetin, efektivitetin dhe qëndrueshmërinë e politikave financiare, në mënyrë që të promovohet zhvillimi ekonomik dhe mirëqenia sociale në kontekstin e secilit vend.
- Forcimin e auditimeve të pasqyrave financiare të qeverisë, me qëllim të përcaktohet dhe përmirësohet kuadri financiar institucional dhe standartet e raportimit financiar, kështu që të paraqitet drejt performanca financiare dhe pozita e qeverisë.
- Përmirësimi i auditimeve të performancës për financat publike, në mënyrë që të inkurajohet qëndrueshmëria fiskale afat-mesme dhe afat-gjatë e lidhur kjo me qeverisjen e mirë.
- Forcimi i auditimeve të borxhit publik, duke marrë në konsideratë angazhimet direkte ashtu si edhe detyrime të tjera të pasigurive financiare, me objektiv identifikimin e çështjeve dhe risqeve në menaxhimin dhe zhvillimet e pritshme të borxhit të lartë dhe deficitit financiar.

Arritja e Mirëqeverisjes Globale – Një qëllim i përbashkët

Kongresi diskutoi në thellësi lidhjet e brendshme mes dy temave qendrore të tij dhe përvijoi si qellim strategjik të përbashkët të INTOSAI ***arritjen e mirëqeverisjes globale***. INTOSAI ka pranuar se në një botë ku sfidat janë bërë globale dhe ka nevojë

për komunitetin ndërkombëtar të SAI-ve, duhet të bëhet bashkimi për dhënien e përgjigjeve kolektive, për të pasur rezultate pozitive për të gjithë. Historia e INTOSAI-t dhe themelet e fuqishme në bashkëpunimin ndërkombëtar mes SAI-ve do të thotë që është pozicionuar për të luajtur një rol në zhvillimin dhe shpërndarjen e zgjidhjeve për sfidat e rëndësishme të kohëve të fundit dhe çështjet tematike, si për shembull çekuilibri global i ekonomisë, krizat kombëtare të borxhit, sistemi monetar ndërkombëtar, reformat, kriza ekologjike, siguria botërore financiare dhe axhendat e anti- korrupsionit. INTOSAI dhe SAI-t kanë një kapacitet të provuar dhe kanë si detyrë të çojnë përpara mirë qeverisjen kombëtare dhe globale në përputhje me mandat e tyre respektove dhe kuadrin ligjor. Kongresi i XXI-te i inkurajon SAI-t:

- **Të pranojnë përgjegjësitë e përbashkëta:** Puna audituese e SAI-ve për angazhimet ndërkombëtare të qeverisë, si ato që kanë të bëjnë me ndryshimet klimaterike, rishikimi i barrierave tregtare, ruajtja e stabilitetit financiar, si dhe duke luftuar korrupsionin dhe pastrimin e parave, mund të shërbejnë për të inkurajuar përputhshmërinë e plotë me këto detyrime. INTOSAI gjithashtu i mundëson SAI-ve pjesëmarrjen në bashkëpunime ndërkombëtare, si dhe të luajnë një rol në marrëdhënie ndërkombëtare si zbatimi i disiplinave financiare, zbulimin e riskut ekonomik, lufta kundër korrupsionit dhe ruajtja e stabilitetit të ekonomisë botërore.
- **Menaxhimi i riskut të përbashkët:** SAI-t kanë një rol të vazhdueshëm në promovimin e identifikimit të riskut. INTOSAI do të vazhdojë ta përqendrojë vëmendjen në kërkimet, çështjet madhore globale dhe fenomenet rajonale, si dhe t'i mundësojë SAI-ve udhëzues efektive si referencë për përgjigje.
- **Ndërmarrja e veprimeve të përbashkëta:** SAI-t inkurajohen të vazhdojnë kryerjen e auditimeve të përbashkëta dhe paralele, në mënyrë që të trajtojë sfidat e përbashkëta dhe çështjet si ndryshimet klimaterike, ndotja rajonale dhe kriza financiare. SAI-t inkurajohen të marrin pjesë në aktivitete të tilla qeveritare si vlerësimi i programeve sociale, përfshirja e organizatave ndërkombëtare dhe rajonale në auditimin e jashtëm, auditimet e performancës duhet të kryhen në organizatë ndërkombëtare dhe rajonale, për të përmirësuar përgjegjshmërinë, transparencën dhe performancën. INTOSAI do të vazhdojë të punojë me organizata të tjera ndërkombëtare dhe shtetet sovrane për të fuqizuar bashkëpunimin në auditimin ndërkombëtar, si dhe për të identifikuar zgjidhjet më të mira për çështjet rajonale dhe globale.
- **Të flasin në një zë të përbashkët:** SAI-t dhe INTOSAI do të vazhdojnë të përshtaten me ndryshimet e kohëve që po jetojmë, si dhe do të përshtatin pozitivisht masa efektive për të bashkëpunuar me organizatat multilaterale si OKB-ja, Banka Botërore, OSBE-ja dhe G20-ta, për të ndjekur aktivitete

multilaterale, për të rritur auditimin ndërkombëtar dhe standardet e kontabilitetit për sektorin publik, për të përcaktuar treguesit kryesorë kombëtare për vlerësimin e progresit social, për të marrë pjesë në përmirësimin e vazhdueshëm të qeverisjes globale, si dhe të ketë një zë unanim dhe të pavarur mbi çështjet me tema ndërkombëtare dhe rajonale në komunitetin ndërkombëtarë.

Kongresi miratoi Planin Strategjik 2014-2018 të Iniciativës për Zhvillimin e INTOSAI(IDI) IDI, dhe rishikoi mandatin e IDI, si dhe prezantoi një numër publikimesh dhe manualesh.

Konkluzionet e Kongresit INCOSAI XXI

Kongresi dha konkluzionet e tij për standardet profesionale INTOSAI, për ngritjen e kapaciteteve, shkëmbimin e njohurive dhe çështje të tjera. Ai:

Ra dakord që duhet një parim udhëzues për filozofinë e INTOSAI-t, i cili duhet të jetë i orientuar nga e ardhmja. Organizata pati mundësinë të kontribuonte në axhendat globale dhe rajonale, duke u bazuar në ekspertizën dhe eksperiencën e mirëqeverisjes dhe auditimin e sektorit publik.

Vuri re punën e shkëlqyer të kryer nga të gjitha komisionet, grupet e punës dhe task forcat. U shpreh mirënjohje e thellë për të gjithë kryesuesit që kishin kryer detyrat e tyre, si dhe u përshëndetën ata që morën përgjegjësi të reja.

Fundi i vitit 2013 shënon gjysmën e parë të Planit Strategjik të dytë të INTOSAI-t, që mbulon periudhën 2011-2016. Gjatë diskutimeve të Kongresit, anëtarët e INTOSAI-t shprehën kënaqësinë në lidhje me progresin e organizatës.

Ne lidhje me **Standardet profesionale**, Kongresi u shpreh se:

- **Mirëpret** rritjen e kuadrit të standardeve (ISSAI) nga rishikimi i parimeve themelore të auditimit dhe standardeve të tjera (Aneksi II), si dhe një fokusim më i madh mbi nevojat e audituesve dhe përdoruesit që përfaqësojë këto arritje.
- **Miraton** mandatin e rishikuar të Komitetit dhe vendosmërinë për të gjetur zgjidhje të qëndrueshme që do të mundësojnë garanci të mjaftueshme, si dhe që kuadri dhe procesi i Standardeve Profesionale të INTOSAI-t të ruhen dhe zhvillohen në të ardhmen.

Ne lidhje me **Ngritjen e kapaciteteve,** Kongresi u shpreh se:

- **Përkrah** aftësinë e Organizatës për mbështetjen e dhënë për SAI-et në ngritjen e kapaciteteve të tyre dhe në veçanti progresi i bërë nga Sekretariatet Rajonale dhe Bashkëpunimi Donator i INTOSAI-t;

- **Vlerëson** kontributin e vazhdueshëm të IDI-t për INTOSAI-n në mbështetjen e anëtarëve të tij, në përpjekjet e tyre për të rritur përformancën në punë, pavarësinë dhe profesionalizmin; dhe
- **Miraton** planin strategjik të IDI-t, 2014-2018, si dhe mandatin e tij të rishikuar që reflekton rolin e tij, duke punuar paralel me synimet e INTOSAI-t.

Ne lidhje me **Shkëmbimin e njohurive,** Kongresi u shpreh se:

- **Lavdëron** punën që thekson vlerat dhe përfitimet e SAI-t: duke ndryshuar jetën e qytetarëve (Aneksi III) dhe kriterin që SAI-t duhet të angazhohen në punën e përgjegjshmërisë për auditimin e ndihmave lidhur me katastrofat (Aneksi II);
- **Inkurajon** SAI-t të zhvillojnë aftësitë për t'iu përgjigjur sfidave të kohëve të fundit, ekonomike dhe fiskale, në shumë pjesë të botës, për shembull duke rritur ose zgjeruar auditimin e tyre në mbikëqyrjen dhe mekanizmat rregullator; dhe
- **Inkurajon** anëtarët të aplikojnë strategjitë dhe udhëzuesit e INTOSAI-t, si dhe të përdorin në mënyrë aktive mjetet e hartuara dhe zhvilluara për këtë qëllim.

Ne fund te punimeve, Kongresi **mirëpriti** Planin për Zhvillimin Strategjik të INTOSAI-t për periudhën 2017-2022, si dhe për trajtimin e nevojave të Organizatës në të ardhmen dhe **theksoi** krijimin e një komiteti mbikëqyrës mbi çështjen e emergjencave. Kongresi ra dakord që INTOSAI duhet të ketë një rol në axhendën e zhvillimit 2015 të Kombeve të Bashkuara.

Kongresi u bëri thirrje anëtarëve të Organizatës për:

- **T'i dhënë prioritet** adoptimit dhe zbatimit të kuadrit të standardeve, si dhe Rezolutës së OKB-së, dhe i kërkon donatorëve dhe partnerëve të tjerë të zhvillimit t'i japin asaj të njëjtin status;
- **T'iu përgjigjur** pozitivisht thirrjes së dytë globale, për propozimet e botuara nga Bashkëpunimi Donator i INTOSAI-t;
- **Të promovuar** në mënyrë aktive vlerat dhe përfitimet e SAI-ve;
- **Të krijuar** mundësinë për të kontribuar plotësisht në përcaktimin e të ardhmes së Organizatës;
- **Të marrë në konsideratë** kontributin e mëtejshëm për resurset në dispozicion të Organizatës.

Në përfundim të INCOSAI XXI, Organizata dhe anëtarët e tij riafirmuan ambicien për ta shndërruar INTOSAI-n në një organizatë model, që paraqet programe cilësore, të cilat përforcohen nga standardet profesionale dhe nga idetë humanitare.

Ne si KLSH kemi përgatitur dhe po realizojmë një plan strategjik 2013-2017, në linjë me misionin, vizionin, qëllimet strategjike dhe vlerat e Planit të zhvillimit strategjik të INTOSAI-t. Misioni ynë është: ***Informimi i publikut dhe i Kuvendit të Shqipërisë në lidhje me përdorimin e burimeve me ekonomicitet, efektivitet dhe efiçiencë nga pushteti qendror dhe lokal dhe nga njësi të tjera publike, si dhe nxitja e përgjegjshmërisë në të gjithë sektorin publik, në përputhje me praktikat me të mira të BE dhe me standardet ndërkombëtare të INTOSAI, duke kontribuar për qeverisjen e mirë, nëpërmjet luftës kundër korrupsionit.***
Vizioni ynë është: ***të jemi një trupë profesionale që i kontribuon shtimit dhe kursimit të vlerës së parave publike, duke dhënë siguri mbi llogaritë financiare të përdoruesve të tyre dhe duke ndihmuar në përmirësimin e menaxhimit të Qeverisë e te enteve të tjera publike nëpërmjet auditimit, duke fituar në këtë mënyrë besim të plotë tek qytetarët shqiptarë dhe të audituarit.***

Ky studim ishte një udhëtim në kohë, duke përshkruar momentet kryesore të themelimit dhe zhvillimit të INTOSAI-t. Dua ta mbyll me fjalët e Dr. Jozef Mozer, Sekretar i Përgjithshëm i INTOSAI-t dhe President i Gjykatës Austriake të Auditimit në Simpoziumin e 21-të të OKB dhe INTOSAI mbi Auditimin Suprem në Vjenë :
"*Si SAI puna jonë do të njihet, vetëm nëse arrijmë të komunikojmë qartë te qytetarët se çfarë ne bëjmë dhe cila është vlera e shtuar ne të gjenerojmë për Shtetin dhe shoqërinë, në mënyrë që ne të perceptohemi si institucione të domosdoshme strategjike që u shërbejmë interesave të qytetarëve. Për të arritur këtë objektiv, SAI duhet të marrin parasysh shqetësimet e qytetarëve në punën e tyre dhe t'i komunikojnë këto në përputhje me rrethanat. Për më tepër, auditimet dhe gjetjet e auditimit duhet t'i komunikohen publikut, në mënyrë që qytetarët të aftësohen të kërkojnë zbatimin e gjetjeve dhe rekomandimeve të auditimit. Për të qenë në gjendje për ta bërë këtë, qytetarët duhet të marrin pjesë aktivisht në debatin politik dhe të kontribuojnë në zbatimin e rekomandimeve të auditimit. Është e një rëndësie kritike që t'u sigurojmë qytetarëve platformën e duhur për një angazhim të tillë. Kur qytetarët të kuptojnë se ata nuk janë të pafuqishëm, por mund të luajnë një rol aktiv dhe të mbrojnë interesat e tyre, ata do të jenë të gatshëm të angazhohen plotësisht*".

PËR NJË PROJEKT KOMBËTAR NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT

Botuar në Gazetën "Panorama", më 27 nëntor 2013

Korrupsioni është dhe mbetet një ndër shqetësimet kryesore të qeverive, organeve legjislative, atyre të Gjyqësorit dhe procedimit penal, si dhe, veçanërisht, i të gjitha institucioneve që operojnë në fushën e financave publike. Llogaridhënia dhe transparenca janë dy prej parimeve kryesore të mirëqeverisjes në sektorin publik, që, nëse zbatohen, mund ta luftojnë dhe kufizojnë me efektshmëri korrupsionin. Roli dhe përgjegjësia e Kontrollit të Lartë të Shtetit, si institucioni më i lartë i auditimit publik, është që të kontribuojë në transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve shtetërore, nëpërmjet auditimeve të tij. Auditimet e zhvilluara nga institucionet supreme të auditimit, të cilat përfshijnë vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, verifikimin e ekzistencës së praktikave të mirëmenaxhimit në respektim të parimeve të ekonomicitetit, efiçiencës dhe efektivitetit, si dhe ekzaminimin e pasqyrave financiare, për sigurimin e saktësisë dhe besueshmërisë së tyre, synojnë drejt parandalimit të fenomenit të korrupsionit. Praktika e ndjekur nga shumë Institucione Supreme të Auditimit në luftën e tyre kundër korrupsionit, është ajo e kryerjes së auditimeve të përputhshmërisë, të cilat në vetvete verifikojnë përputhshmërinë e veprimtarisë së subjekteve të auditimit me ligjet dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi. Përveç kësaj, roli dhe veprimtaria e Institucioneve Supreme të Auditimit shtrihet edhe në dhënien e rekomandimeve për ndryshime dhe përmirësime të akteve ligjore dhe nënligjore, duke synuar minimizimin e riskut të abuzimit me detyrën dhe fondet buxhetore, minimizimin e korrupsionit dhe tolerancës ndaj tij, shmangien e rasteve të konfliktit të interesit, etj.

Duke vështruar nga afër procesin e menaxhimit financiar, Institucionet Supreme të Auditimit dhe audituesit e tyre janë në një pozitë më të favorshme për të zbuluar anomalitë dhe deviacionet nga procedurat standarde, duke identifikuar kështu edhe ato parregullshmëri të cilat përbëjnë raste korrupsioni. Ndërsa Institucionet Supreme të Auditimit kanë më pak fuqi investigative se organet e Prokurorisë, ky disavantazh është mëse i kompensuar nga familjariteti më i madh i tyre me pasqyrat financiare të subjektit të audituar dhe njohuritë dhe ekspertizën e stafit audites. Referuar rezultateve të auditimeve që KLSH ka kryer gjatë vitit 2012 dhe nëntë-mujorit të vitit 2013, kemi konstatuar parregullsi dhe shkelje financiare në mbledhjen e të ardhurave dhe shpenzimeve të kryera nga institucionet e ndryshme shtetërore të audituara, me dëm ekonomik ndaj Buxhetit të Shtetit në vlerën 28.1 miliardë lekë, ose 201.6 milionë euro, nga të cilat 13.5 miliardë lekë për vitin 2012 dhe 14.6 miliardë lekë për 2013-n. Shkeljet financiare janë vërejtur kryesisht në prokurimet publike, në shitjen dhe dhënien me qira të pasurive shtetërore, në shpenzimet operative, në doganat, në tatimet e etj.

Ne si institucion suprem i auditimit kemi zgjedhur të marrim përsipër rolin tonë dhe të japim kontributin në luftën kundër korrupsionit, edhe nëpërmjet bërjes së kallëzimeve penale në të gjitha ato raste ku si KLSH kemi konstatuar shkelje të rënda, shpërdorim të detyrës me pasoja të konsiderueshme financiare, të kryera nga zyrtarët e administratës shtetërore të çfarëdo niveli. Gjatë periudhës 2012-2013, KLSH ka depozituar në organin e Prokurorisë 65 kallëzime penale ndaj 186 personave në funksione dhe pozicione të ndryshme të administratës shtetërore, ku vlera totale e dëmit të shkaktuar si pasojë e veprimeve të tyre të kundërligjshme është rreth 13.3 milionë euro. Nga totali i kallëzimeve penale të përgatitura dhe depozituara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në organin e Prokurorisë, mund të përmendim si më të rëndësishmet ato të bëra ndaj ish-kryetarit dhe disa prej anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik, kryetarit dhe dy nën-kryetarëve aktualë të Bashkisë Pogradec, ish-kryetarëve të bashkive Orikum, Himarë dhe Sarandë, nënkryetarëve të Bashkisë Durrës dhe disa kryetarë komunash, drejtorit të Agjencisë së Kërkimit Teknik dhe Inovacionit, disa prej punonjësve dhe ish-drejtuesve të lartë të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, ish-Drejtorit të Përgjithshëm të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, disa prej ish-punonjësve të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, ish-drejtorit Ekzekutiv dhe nëndrejtorit të Autoritetit të Aviacionit Civil, disa prej ish-punonjësve të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, ish-regjistruesve dhe kryeregjistruesve të ZVRPP Fier dhe Lushnjë, disa prej punonjësve dhe drejtuesve të ALUIZNI-t Tiranë, Durrës dhe Vlorë, kancelarit të Universitetit të Tiranës, drejtuesve të Albpetrolit, etj. Për fat të keq, një pjesë e mirë e këtyre zyrtarëve, ndaj të cilëve KLSH ka depozituar kallëzim penal, kanë vazhduar apo vazhdojnë të ushtrojnë funksionet e tyre publike, pavarësisht faktit që legjislacioni në të tilla raste parashikon pezullimin apo largimin e tyre nga detyra. Kjo dukuri ka ardhur nga mungesa e përgjegjshmërisë dhe vullnetit të institucioneve të audituara në ndështkimin e shkelësve të ligjit brenda stafit të tyre, duke ndikuar në perceptimin e natyrshëm negativ që opinioni publik ka ndaj angazhimit serioz të organeve shtetërore në luftën kundër korrupsionit. Si pjesë integrale e strategjisë së përgjithshme të institucionit dhe me vullnetin tonë për të kontribuar konkretisht në luftën kundër korrupsionit, KLSH gjatë periudhës 2012-2013 ka nënshkruar, me nismën e tij, një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me disa prej institucioneve kryesisht të angazhuara, si organi i Prokurorisë së Shtetit, Ministria e Financave, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, Autoriteti Shqiptar i Konkurrencës dhe disa nga OJF-të më aktive për sigurimin e transparencës së administratës publike.

Perceptimi negativ i opinionit publik në vendin tonë në lidhje me nivelin aktual të korrupsionit në administratën publike, vjen si pasojë e moszbulimit dhe mosndëshkimit të korrupsionit në nivel të mjaftueshëm nga ana e organeve shtetërore përgjegjëse për ta

luftuar këtë dukuri. Për sa kohë ky perceptim do vazhdojë të ekzistojë, asnjë institucion shtetëror, pavarësisht rolit të tij në luftën kundër korrupsionit, nuk mund të flasë për fitore apo rezultate pozitive në luftën kundër këtij fenomeni. Lufta kundër korrupsionit parashtron si domosdoshmëri forcimin dhe përmirësimin e bazës ligjore të cilitdo prej institucioneve shtetërore të angazhuara në të. Në këtë drejtim, projektligji i ri për KLSH, i paraqitur komisioneve përkatëse parlamentare në nëntor të vitit 2012, siguron forcimin e pavarësisë institucionale, organizative dhe ekonomike të tij, zgjerimin e aksesit në drejtim të disponimit të dokumentacionit dhe informacionit përkatës, si dhe rrit nivelin e zbatimit të rekomandimeve. Miratimi sa më parë i këtij projektligji do të fuqizonte kontributin e KLSH në luftën kundër korrupsionit.

Si KLSH, jemi bërë anëtarë të Task-Forcës së INTOSAI-t për integritetin, për zbatimin e paketës "INTOSAINT" të vetëvlerësimit të institucionit, të bindur që forcimi i integritetit, si një koncept i gjerë, që në thelb ka etikën dhe kulturën, ul korrupsionin, në radhë të parë brenda vetë institucionit. Gjatë dy viteve të fundit, në institucionin e KLSH jemi përpjekur të çrrënjosim antikulturën e mosndëshkueshmërisë, pasi për çdo shkelje të integritetit, të zbuluar dhe hetuar, kemi marrë masa ndëshkimore deri në ndjekje penale ndaj ish-audituesve të institucionit. Forcimi i integritetit institucional ul korrupsionin dhe do të ftoja të gjitha institucionet shtetërore të angazhuara ta përdornin këtë paketë vetëvlerësimi, si mjet efektiv për të kufizuar fenomenin brenda radhëve të tyre.

Sikurse dhe Deklarata e Pekinit e datës 26 tetor 2013 e Kongresit XXI të INTOSAI-t e ka theksuar, "Auditimi kombëtar duhet të vihet në shërbim të qeverisjes kombëtare për përmirësimin e menaxhimit publik financiar". Në bazë të Strategjisë sonë të Zhvillimit 2013-2017, KLSH do të angazhohet për krijimin e Institutit të Përgjegjësisë Materiale për vendimmarrjet e zyrtarëve publikë, si një ndër mekanizmat e rëndësishëm për të parandaluar shkeljet dhe abuzimin me pushtetin. Nuk do të mjaftohemi vetëm me veprimtarinë tonë si auditues të jashtëm, por do të inkurajojmë audituesit e brendshëm që të vendosin theksin në zbulimin e mashtrimit dhe korrupsionit, në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit. Ky inkurajim do të kryhet edhe përmes shkëmbimit të informacionit dhe programeve të auditimit. Në plotësimin e rekomandimeve tona, si dhe drejt thellimit të ndëshkueshmërisë së zyrtarëve me shkelje, urdhri i Kryeministrit Berisha nr. 70, datë 18.04.2006 "Për masat në zbatim të Rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Auditit të Brendshëm dhe Departamentit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsion" na ka shërbyer shumë. Gjykojmë dhe besojmë se ky urdhër duhet rifreskuar nga qeveria e re dhe Kryeministri Rama, për të mundësuar një përgjegjësi më të madhe të administratës shtetërore dhe efektshmëri të rritur të rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm publik.

Ka ardhur koha ta ngremë stekën në luftën kundër korrupsionit. Veçmas, asnjë institucion nuk maksimizon punën e vet. Edhe ekspertiza e vyer dhe kontributi i institucioneve donatore ndërkombëtare nuk arrin të maksimizohet, pa sinergjizimin e përpjekjeve të institucioneve publike dhe shoqërisë civile të vendit. Në këto momente nuk nevojiten projekte dhe strategji më vete të çdo institucioni, por një projekt kombëtar, një strategji kombëtare gjithëpërfshirëse në luftën kundër korrupsionit, ku të sinergjizohen dhe konkretizohen kontributet e secilit institucion. Më lejoni të citoj Profesorin e njohur Skënder Osmani, në studimin e tij "*Imazhe dhe vizione për menaxhimin dhe projektizimin"*, i cili thekson se "*Çdo politikë është projekt, politika ka një gjuhë dhe vetëm një gjuhë, që është projekti… Projekti kombëtar është gjuha e vetme gjithëpërfshirëse e zhvillimit të kombit"*. Lufta në sistem kundër korrupsionit nuk mund të mendohet e efektshme, pa bashkëveprimin strategjik të: (1) qeverisë, me të gjitha institucionet në vartësi të saj (Ministria e Brendshme, Ministria e Financave, në veçanti struktura e Inspektimit Financiar dhe ajo e Auditimit të Brendshëm); (2) opozitës, sepse një opozitë konstruktive gjeneron denoncimin e veprimeve korruptive të institucioneve pushtet-mbajtëse; (3) institucioneve të pavarura (Prokuroria e Shtetit, KLSH, ILDKP, Autoriteti i Konkurrencës etj.); (4) organizatave jofitimprurëse me impakt në këtë fushë. Përpjekje shumë pozitive për bashkëveprimin dhe një plan të përbashkët veprimi në luftën kundër korrupsionit ka pasur edhe nga qeveria e mëparshme. Përpjekje shumë pozitive po bëhen dhe nga qeveria aktuale, por domosdoshmëri e momentit është përqasja gjithëpërfshirëse e institucioneve kryesore të shtetit, si dhe e gjithë faktorëve të tjerë të fuqishëm, si opozita dhe shoqëria civile. Në cilësinë e kryetarit të KLSH, mendoj që maxhoranca e sotme, në Projektin Kombëtar që do të zhvillojë për një strukturë efektive kundër korrupsionit, të udhëheqë dhe të integrojë të gjithë faktorët. Kështu maksimalizohen jo vetëm përpjekjet tona, por edhe të komunitetit ndërkombëtar. Vetëm në këtë mënyrë do të arrijmë të fitojmë besimin e publikut dhe të ulim perceptimin negativ që qytetarët kanë sot lidhur me përpjekjet e institucioneve shtetërore për frenimin dhe kufizimin e korrupsionit. Ndërsa ne, drejtuesit e institucioneve të ndryshme publike dhe jopublike, në këtë luftë kundër korrupsionit, duke perifrazuar të madhin Mit'hat Frashëri, "të gjithë ne duhet ta kemi për nder të jemi shërbestarë".

AUDITIMI KOMBËTAR NË SHËRBIM TË MIRËQEVERISJES

Intervistë botuar në Revisten "Klan", 24 dhjetor 2013

- ***Zoti Leskaj, po e fillojmë një pyetje "provokative". Qeveria shqiptare ka pajtuar kompani ndërkombëtare auditimi për të zbardhur gjendjen financiare të vendit. KLSH, si një institucion suprem auditues, megjithëse me detyra të qarta sipas ligjit, a do të mund ta kryente këtë proces?***

Misioni dhe detyra jonë është të auditojmë me ekonomicitet, efektivitet dhe efiçiencë përdorimin e fondeve publike. Kjo është sanksionuar në Kushtetutën e vendit dhe ligjin tonë organik, por edhe në Deklaratën e Limës (Kushtetuta e institucioneve supreme të auditimit në botë) dhe në standardet e INTOSAI-t, që janë standardet profesionale të auditimit suprem. Detyra jonë parësore është të auditojmë zbatimin e Buxhetit të Shtetit. Si çdo vit, brenda afateve kushtetuese, në fund të muajit shtator 2013, ne dorëzuam në Kuvend raportin për zbatimin e Buxhetit të Shtetit të vitit 2012, fryt i 115 auditimeve të kryera. Gjykojmë se gjetjet e auditiveve tona dhe rekomandimet që përmbahen në raport, të vlerësuara tejet pozitivisht dhe të cituara nga deputetët e shumicës dhe pakicës, gjatë seancës së Kuvendit, do të ndihmojnë në përgatitjen e një Buxheti realist për vitin 2014, në ndihmë të ekonomisë dhe të gjithë shqiptarëve. Mbi bazën e standardeve INTOSAI, Deklaratës së Limës dhe Standardit ISSAI për përdorimin e punës së një eksperti të jashtëm, mendojmë se ekspertiza e huaj në auditimin e financave publike, kur është profesionale, përbën vlerë të shtuar në proceset audituese publike të vendit dhe është mëse e mirëpritur. Auditimi i borxheve që qeveria i ka biznesit nga një shoqëri ndërkombëtare private auditimi, është një vendim politik i qeverisë Rama. Por sikurse është një vendim politik dhe njëherazi edhe e drejtë e saj, edhe pse duke anashkaluar KLSH si institucion suprem auditimi, ai nuk cenon veprimtarinë tonë. Është detyra jonë profesionale dhe kushtetuese të auditojmë mënyrën sesi është përdorur paraja publike, pra zbatimin e politikave të qeverisë. Në bazë të mandatin tonë kushtetues dhe që buron edhe nga standardet ndërkombëtare INTOSAI, ne nuk realizojmë politika dhe nuk ndërhyjmë në politikat qeveritare. Me përgjegjësi theksoj se nuk jemi në gjendje të kryejmë çdo auditim që do të na kërkohet, më mirë sesa filialet e kompanive të huaja ndërkombëtare të auditimit në vendin tonë. Por jo vetëm ne, dhe një grup i zgjedhur prej audituesve të brendshëm të sektorit publik, në varësi të Ministrit të Financave dhe Kryeministrit, mund ta kryente. Përsa i përket borxheve që shteti i ka sipërmarrjes private, sipas vlerësimit më të fundit të anëtarëve të Komisionit të Ekonomisë, kemi qenë të parët si KLSH, përpara dhe institucioneve ndërkombëtare, që në raportin tonë për Zbatimin e Buxhetit të Shtetit të

vitit 2011, në tetor 2012, kemi rekomanduar: "Në kushtet aktuale sugjerojmë saktësimin dhe shqyrtimin me realizëm të gjendjes së këtyre borxheve, përcaktimin e masave për t'i dhënë mundësi dhe për të lehtësuar sa të jetë e mundur sipërmarrjen private nga kosto e kredive që ato mund të kenë marrë për përmirësimin e situatës së tyre financiare, nëpërmjet ndërhyrjes për ristrukturimin e kredive dhe ndërkohë mbledhjen e borxheve të këqija". Kjo ka ndodhur 7-8 muaj pasi mora mandatin si Kryetar i KLSH-së. Gjithashtu i kemi kërkuar Kuvendit ta vendosë në Kushtetutë kufirin e Borxhit Publik në masën 60% të PBB-së së vendit si dhe masat e tjera për përmirësimin e gjendjes.

- **Shumë raporte të institucionit që ju drejtoni, këto muajt e fundit janë bërë kryetituj në media për rezultatet që kanë shpalosur, nga fillimi i detyrës tuaj gati dy vjet më parë deri tek teprimi me shpenzimet dhe parregullsitë me prokurimet në Bankën e Shqipërisë së fundi. Megjithëse, raporti vjetor ka ende kohë për të dalë, a keni disa shifra për numrin e kallëzimeve dhe dëmin ekonomik të shkaktuar në total?**

Në respekt të pritshmërisë së madhe të qytetarëve, për të përmirësuar qeverisjen, duke theksuar luftën kundër korrupsionit, kemi shtuar ndjeshëm kallëzimet penale. Kemi bërë publike rastet e kallëzimeve penale ndaj nëpunësve të lartë publikë, për abuzimet e konstatuara me fondet publike dhe dëmin e shkaktuar arkës së shtetit, me idenë e madhe që të kontribuojmë për çrrënjosjen e anti-kulturës së pandëshkueshmërisë. Për vitin 2012, institucioni bëri 40 kallëzime penale, për 125 punonjës të administratës. Për vitin 2013, periudha janar-tetor 213, KLSH ka përgatitur dhe dërguar në Prokurori rreth 30 kallëzime penale. Me auditimet që kemi në proces, shumë shpejt numri i kallëzimeve penale për të dyja vitet që institucioni drejtohet prej meje, do të jetë sa dyfishi i numrit të kallëzimeve për katër vitet e fundit të marra së bashku, të paraardhësit tim në detyrë. Për 9-mujorin janar-shtator 2013, KLSH ka zbuluar një dëm ekonomik prej 14.6 miliardë lek (rreth 100.4 milionë euro), i rekomanduar për shpërblim në masën 100 për qind. Ndërsa vlera e dëmit ekonomik të evidentuar gjatë vitit 2012 rezulton 13.2 miliardë lekë (ose rreth 93 milionë euro) e cila po ashtu është rekomanduar për shpërblim në masën 100 për qind. Krahas kallëzimeve penale dhe masave për shpërblimin e dëmit ekonomik, për periudhën janar 2012-shtator 2013, kemi rekomanduar 123 masa për përmirësim legjislacioni, përfshirë dhe ndryshime kushtetuese si dhe 2,060 masa disiplinore dhe administrative dhe 3,676 masa organizative. Shifrat flasin vetë, flasin shumë.

- **Në këtë linjë, a keni dijeni se në sa raste institucionet e tjera, përfshi organin e akuzës, janë vënë në lëvizje? Në një takim tuajin me Kryeprokurorin në janar të këtij viti, u shpreh angazhimi i dyanshëm për bashkëpunimin të ngushtë kundër korrupsioni...**

Me Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm kemi një marrëveshje bashkëpunimi, të lidhur një vit e gjysmë më parë, e cila po funksionin mirë. Prokuroria i ka marrë në konsideratë kallëzimet tona dhe në mbi 90 për qind të rasteve ka nisur hetimet. Synimi ynë është përshpejtimi i procedurave që të shkurtohet koha e Prokurorisë në trajtimin e kallëzimeve, brenda afateve ligjore, si dhe të përmirësohet cilësia e materialit të kallëzimit, nga ana e audituesve të KLSH-së.

- **Zoti Leskaj, zhvillimet dhe ndryshimet politike në vende si Shqipëria ndikojnë edhe në përformancën e institucioneve të pavarura kushtetuese. Si e shihni perspektivën e mirëfunksionimit të KLSH dhe të bashkëpunimit me qeverinë Rama? Opozita e majtë atëherë nuk ju votoi në krye të institucionit...**

Standardet dhe rekomandimet e Bashkimit Europian të përmbajtura në Progres-Raportet e tij, na udhëheqin për një bashkëpunim të ngushtë me qeverinë, për të përmirësuar qeverisjen dhe kontribuar në luftën kundër korrupsionit. Ne e shohim pa asnjë kompleks bashkëpunimin e ngushtë edhe me struktura të veçanta të qeverisë, të angazhuar në përmirësimin e qeverisjes dhe luftën kundër korrupsionit, pavarësisht se në qeverinë e auditojmë dhe pavarësisht ngjyrimeve politike të saj. Sidomos bashkëpunimi me strukturën e auditimit të brendshëm në Ministrinë e Financave është një aset shumë i vyer, i rekomanduar edhe nga Raporti i Misionit Faktmbledhës të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit të Komisionit Europian në tetor 2012. Ne lidhëm një marrëveshje me Ministrinë e Financave në maj të vitit të kaluar. Si KLSH i kemi hedhur bazat e bashkëpunimit me qeverinë Berisha, me nismën për marrëveshjen e 8 majit të vitit të kaluar, me Ministrinë e Financave. Urojmë dhe besojmë se kjo marrëveshje do të zbatohet dhe nga qeverie e re Rama dhe të gjejmë një gjuhë të përbashkët për realizimin e objektivave të përbashkëta me sigurimin e mirëqeverisjes dhe luftën kundër korrupsionit. Bashkëpunimi auditim i jashtëm-auditim i brendshëm publik ul kostot e auditimit dhe rrit efektshmërinë e masave anti-korrupsion. Është një e vërtetë e pranuar botërisht se korrupsioni mund të luftohet vetëm në sistem, duke përfshirë aktivisht në këtë luftë, krahas angazhimit të qeverisë dhe institucioneve të pavarura kushtetuese, edhe shoqërinë civile dhe mediat. Përpjekje shumë pozitive për bashkëveprimin dhe një plan të përbashkët veprimi në luftën kundër korrupsionit ka pasur edhe nga qeveria e mëparshme. Përpjekje shumë pozitive po bëhen dhe nga qeveria aktuale, por domosdoshmëri e momentit është përqasja gjithëpërfshirëse e institucioneve kryesore të shtetit si dhe e gjithë faktorëve të tjerë të fuqishëm, si opozita dhe shoqëria civile. Në këtë drejtim, ne si KLSH do të japim kontributin tonë për mirëqeverisjen, si agjent i Kuvendit për mbrojtjen e interesave të taksapaguesve shqiptarë.

Lidhur me mbështetjen e mëparshme ndaj meje, mosbotimi mund të jetë një zgjedhje partiake e momentit, e motivuar dhe nga background-i im politik i mëparshëm. Kjo zgjedhje personalisht nuk më shqetëson. Ndaj bindjen time të palëkundur se lufta në sistem për sigurimin e një qeverisjeje të përgjegjshme dhe efikase është punë e përditshme e gjithsecilit anëtar të Kuvendit,të kabinetit qeveritar dhe të drejtuesve të institucioneve të pavarura kushtetuese. Shpreson në bashkëpunimin e secilit, për të siguruar mirëqeverisjen publike të vendit. Personalisht, në çdo kohë do të jap kontribut pozitiv. Në paraqitjen në Komisionin e Ekonomisë të raportit të KLSH-së për Buxhetin Faktit të Shtetit 2012, ndjeva mbështetjen dhe vlerësimin e të gjithë anëtarëve të Komisionit, si të shumicës dhe të pakicës, për punën e bërë.

- **Një nga çështjet që pati vëmendjen e opinionit publik ishte ajo e abuzimeve në Ministrinë e Punës. Por pati reagime nga të pandehurit, që ndorën edhe emrin tuaj në këtë histori, si "hakmarrës", pse nuk ju punësuan bashkëshorten. Cila është përgjigja juaj?**

KLSH përfundoi auditimin në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (sot Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë) në qershor të vitit të kaluar dhe menjëherë bëmë kallëzim penal (jo një, por disa) ndaj disa nëpunësve të lartë të kësaj ministrie, për abuzimet e shumta dhe flagrante të vërejtura aty dhe dëmin ekonomik të konsiderueshëm ndaj arkës së shtetit. Prokuroria hapi hetimin përkatës, i cili u pasurua nga dëshmi të reja, të cilat sollën në mandat arrestimet e kohëve të fundit. Kallëzimet tona evidentonin Drejtorin e Kabinetit të Ministrit, i cili ishte violinë e parë në një orkestër, së cilës është Prokuroria që, në bazë të ligjit do t'i gjejë dirigjentin. Në asnjë rast, rreth 70 kallëzimet tona në këto muaj nuk kanë ardhur nga motivime personale të ndonjë audituesi, qoftë dhe të titullarit të KLSH. Promovimi i abuzimit për gjoja hakmarrje personale të drejtuesit të KLSH është pjesë e budallallëkut mjeran të të kapurve në faj apo e pozitës së tyre të vështirë, aty ku abuzimi dhe korrupsioni prej shkelësve të ligjit shoqërohet me një teatralitet fallco prej tyre. Sa për humor, një teatralitet i tillë mund të shërbejë si lëndë e parë për Al-Pazarin e Agron Llakajt, Portokallinë apo për miqtë e mi "Parodistët e Vlorës". Madje, këta të fundit mund ta thellojnë edhe më tej dhe të gjejnë hakmarrje personale tek të 69 kallëzimet e tjera.

- **Në raportin e kaluar vjetor, keni deklaruar se "kultura e pandëshkueshmërisë" ka shënuar rritje. Çfarë tendence po shihni tek ekzekutivi i ri?**

Kultura (apo "antikultura", sepse është anti-vlerë" e pandëshkueshmërisë ka të bëjë me perceptimin e përgjithshëm në publik tek ne se "peshqit e mëdhenj" nuk bien asnjëherë në rrjetë. Ne si KLSH jemi përpjekur ta luftojmë këtë anti-kulturë, duke dërguar në Prokurori drejtues ose –ish-drejtues të lartë si Sekretar i Përgjithshëm, Drejtor Kabineti

në Ministri, Drejtorë të Përgjithshëm në Ministri, kryetarë apo ish-kryetarë bashkish e komunash, etj,. Kur këta janë evidentuar në shkelje flagrante të ligjeve në fuqi. Natyra e punës sonë është që zakonisht ne auditojmë *post factum* dhe kjo kohë e shkurtër nuk ka dhënë ende mundësi të auditojmë ekzekutivin e ri në performancën e tij. Por, pavarësisht se nuk jemi institucion inspektimi financiar, por institucion modern auditimi, jemi tejet të vëmendshëm ndaj çdo informacioni që vjen nga denoncimet e qytetarëve nëpërmjet letrave që na adresohen, kontakteve të tjera që kanë audituesit tanë si dhe nga denoncimet në media. Jemi në fazën e përgatitjes së planit të auditimeve për vitin e ardhshëm, një punë përgatitore tërësisht e bazuar në analizën e riskut, e cila merr parasysh të gjitha burimet e informacionit që përmenda më sipër, si dhe praktikën e deritanishme të punës. Është ende herët për ne të japim një opinion për tendencat e vërejtura tek qeveria e re.

- **Në intervistën e fundit për Revistën Klan, jeni përgjigjur (pas një pyetjeje mbi disa hetime të nisura për Bashkinë e Tiranës së epokës Rama), se kryeministri Berisha është burrë shteti (dhe s'ka nevojë për mesazhe të tërthorta falënderim që ju votoi në këtë post). Skena politike shqiptare ka pësuar ndryshme ndërkaq, Ju jeni në krye të një institucioni të pavarur, pa lidhje direkte me politikën e ditës. Por, a keni një vlerësim për tre personazhet tashmë dominuese: Rama, Meta, Basha kundrejt sfidave që ka vendi sot?**

Sigurisht që kam një vlerësim personal, përgjithësisht pozitiv, por përfaqësuesit e politikës që ju përmendet. Por, Kodi i Etikës së institucionit që përfaqësoj dhe përkatësia kushtetuese e KLSH si institucion i depolarizuar dhe i departizuar më kushtëzojnë të jem i kufizuar për dhënien e opinioneve personale. Mendoj që prej meje, taksapaguesit shqiptarë kërkojnë kryerjen e auditimeve profesionale të financave publike, dhe jo protagonizëm vlerësimesh.

Duke i falënderuar të tre drejtuesit e lartë të maxhorancës dhe opozitës, që përmendet, për mbështetjen institucionale që i japin KLSH-së në ushtrimin e funksioneve të tij, uroj që këta përfaqësues kryesorë të politikës sot, pikërisht pse janë përgjegjës të përballimit të sfidave kaq të forta që ka ekonomia dhe mbarë shoqëria jonë, të mund të gjejnë gjuhën e mirëkuptimit dhe bashkëpunimit institucional.

- **Më datë 26 nëntor, Kuvendi miratoi vendimin që të caktojë një audituesi të pavarur për të audituar KLSH. Përse pikërisht tani Kuvendi vendosi t'ju auditojë ju, audituesit supremë?**

Dua të falënderoj me këtë rast, lidhur me vendimin për auditimin e llogarive të KLSH, Kryetarin e Kuvendit, z.Ilir Meta. Duke u përpjekur t'i përgjigjem pyetjes: "Po audituesin, kush i auditon?", që në muajin e dytë në detyrë, në shkurt 2012, e deri tani në nëntor 2013, vazhdimisht i kam kërkuar Kuvendit caktimin e një audituesi

profesional e të pavarur, për të na audituar, kërkesë kjo e ligjit tonë organik. Institucioni ka mbi 10 vite që nuk auditohet. Reagimi i menjëhershëm i z.Meta, si dhe i Kryetarit të Komisionit të Ekonomisë, z.Erion Braçe për t'ia gjetur një auditues të tillë institucionit, mendoj që është mbështetje e madhe për ne. Ne nuk mund të kërkojmë llogari me transparencë të plotë për përdorimin e parasë publike tek institucionet e tjera publike, pa garancinë e mirëpërdorimit të fondeve publike që vetë ne menaxhojmë.

TRI PARALAJMERIMET E KLSH: BORXHI PUBLIK, BORXHI NDAJ BIZNESIT, NDARJA ADMINISTRATIVE

Botuar në Gazetën "Ekonomia", më 29 janar 2014

Gjatë vitit të kaluar, realizimin e misionit tonë auditues e kemi parë në dy kolona kryesore, në Strategjinë e Zhvillimit të KLSH-së 2013-2017, (2013-a ishte viti i parë i zbatimit të saj), si dhe në moton e Kongresit INCOSAI XXI të INTOSAI-t, të zhvilluar në Pekin në tetor 2013, që "***auditimi kombëtar të vihet në shërbim të qeverisjes kombëtare, për përmirësimin e menaxhimit publik financiar të vendit***".

Gjatë vitit 2013, zbatimi i qëllimit strategjik të KLSH **"*Ngritja e kapaciteteve audituese*"**, i njëjtë me **objektivin e parë të Strategjisë së INTOSAI-t, 2011-2016 dhe Strategjisë së EUROSAI-t, 2011-2017** ka nënkuptuar ***auditime në sasi dhe cilësi***.

Për vitin 2013, nga 147 auditime të planifikuara, KLSH ka kryer 164 auditime, ose 11 përqind më shumë, nga të cilat 153 auditime janë përfunduar dhe evaduar plotësisht, ndërsa 11 janë në fazën e evadimit.

Nga auditimet e vitit 2013, KLSH ka zbuluar parregullsi dhe shkelje financiare (në të ardhurat publike dhe shpenzimet e kryera) në nivelin **15. 1 miliardë lekë (ose rreth 108 milionë euro),** duke kërkuar shpërblimin e dëmit, pra arkëtimin në **99.9 përqind të tyre**. Dëmi ekonomik i zbuluar në vitet 2012 dhe 2013, është rreth **dy herë më i madh** se vlera e dëmit të zbuluar në vitet 2009, 2010 dhe 2011, të marra së bashku.

Pjesa më e madhe e dëmit të zbuluar është nga shitja e pasurisë dhe dhënia e objekteve me qira dhe e pasurive publike me koncesion. Krahas zbulimeve me dëm ekonomik, gjatë vitit 2013, KLSH ka konstatuar shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituara, në nivelin e 4, 4 miliardë lekëve (mbi 31 milionë euro), ose 2.5 miliardë lekë më shumë nga shkeljet e konstatuara gjatë vitit 2012.

Analiza e të dhënave (të ilustruara në grafikun në prezantimin elektronik) tregon se në vitin 2013, institucioni ka rekomanduar më shumë përmirësime ligjore, sesa masa organizative, ngaqë impakti i një përmirësimi ligjor është më i prekshëm në gjithë sistemin e menaxhimit të fondeve publike dhe e tejkalon vlerën e masës organizative të nivelit të një subjekti.

KLSH ka propozuar disa ndryshime të rëndësishme kushtetuese dhe ligjore. Së pari, KLSH ka kërkuar vendosjen e kufirit të Borxhit Publik në Kushtetutë (propozim i paraqitur në dy vite rresht nga auditimi i zbatimit të Buxhetit faktik të Shtetit për vitin 2011 dhe 2012), duke rekomanduar që Ministria e Financave të ngrejë një grup pune me ekspertët më të mirë të fushës, për përgatitjen dhe paraqitjen e një nisme ligjore për fiksimin në Kushtetutë të treguesit të borxhit publik ndaj PBB-së.

Së dyti, nga auditimi i performancës për ndarjen administrative, të kryer në muajt shkurt-tetor 2013, ka rekomanduar ndërhyrjen në Ligjin për Pushtetin Vendor, për reduktimin e ndjeshëm të numrit të bashkive dhe komunave, për një shërbim më cilësor ndaj komunitetit, por në respekt maksimal jo vetëm të konsensusit politik mes partive, por edhe të atij social, kulturor dhe historik të zonave të ndryshme të vendit, sipas Kërkesave të Kushtetutës, Neni 108/2.

Së treti, Institucioni ka rekomanduar saktësimin dhe shqyrtimin me realizëm të gjendjes së borxheve që Buxheti i Shtetit ka ndaj sipërmarrësve private, si dhe përcaktimin e masave për të lehtësuar sa të jetë e mundur sipërmarrjen private nga gjendja e vështirë ku ndodhet.

KLSH ka rritur propozimin e masave disiplinore, në mënyrë që çdo punonjës publik të jetë përgjegjës për atë që merr përsipër të realizojë me punën e tij. Kemi kërkuar **marrjen e 1161 masave disiplinore dhe administrative,** të cilat në masën rreth 75 përqind janë zbatuar, por tek masat për largim nga puna vërejmë një zbatueshmëri më të ulet, 38-50 përqind.

Në përputhje me objektivin e tij strategjik të përmirësimit të qeverisjes, nëpërmjet thellimit të luftës kundër korrupsionit, institucioni gjatë vitit 2013, për shkelje të dispozitave ligjore në fuqi, me pasojë shpërdorimin e fondeve publike dhe dëmtimin e pronës publike**, KLSH ka bërë 38 kallëzime penale ndaj 94 punonjësve publike, kryesisht nëpunës të lartë dhe të mesëm të administratës.**

Nga një analizë në vite, numri i kallëzimeve penale gjatë harkut kohor të dy viteve, 2012 dhe 2013 është rreth katër herë më shumë se kallëzimet penale të kryera në tre vitet e marra së bashku, 2009, 2010 dhe 2011. Kallëzimet penale vetëm për vitin 2013 janë dy herë më shumë se në vitet 2009, 2010 dhe 2011, të marra së bashku.

Në krahasim me vitin 2012 bashkëpunimi me Prokurorinë, ka njohur rritje dhe konsolidim gjatë vitit të kaluar dhe nuk mund të krahasohet me mungesën e bashkëpunimit gjatë viteve 2009, 2010 dhe 2011.

Për përmbushjen e rekomandimeve të KLSH-së nga institucionet e audituara, një rol tepër të rëndësishëm ka luajtur **Urdhri i Kryeministrit nr. 70, datë 18.04.2006** "*Për masat në zbatim të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, ..., në institucionet në varësi të Kryeministrit a të Ministrave",* i cili shpreh vullnetin institucional të qeverisë, për marrjen në konsideratë të rekomandimeve dhe propozimeve tona për marrjen e masave të ndryshme, me efekt parandalues e ndëshkues ndaj abuzimit dhe korrupsionit.

Me ndryshimet e reja në qeverisjen e vendit, e shikojmë të domosdoshëm që ky Urdhër **të përmirësohet dhe të ripërtërihet nga qeveria e sotme**, në kuadër të ridimensionimit dhe rikonceptimit të frontit të luftës ndërinstitucionale kundër korrupsionit. Ai mund të rikonceptohet, pse jo, edhe **në formën e një marrëveshjeje bashkëpunimi**, ku të transmetohet qartazi vullneti institucional për forcimin e kulturës

së ndëshkueshmërisë, ndaj abuzuesve me pronën dhe fondet publike, veçanërisht largimin nga detyra e drejtuesve të rangut të mesëm dhe të lartë, që rezultojnë me shkelje.

Gjatë vitit 2013, kemi përqendruar punën në përmbushjen e **drejtimit të dytë strategjik të INTOSAI-t dhe EUROSAI-t *"Zbatimi i standardeve profesionale ISSAI"***, i cili përmbahet dhe në Strategjinë e KLSH 2013-2017.

Gjatë vitit 2013, KLSH ka forcuar kapaciteteve audituese, nëpërmjet një procesi të vazhdueshëm kualifikimi, kryerjes së trajnimeve të thelluara dhe gërshetimit të ngritjes arsimore me veprimtarinë praktike audituese. Struktura e punonjësve ka vijuar të ndryshojë, jo vetëm thjesht në favor të stafit audites me arsim të lartë, por dhe të stafit me kualifikime profesionale, akademike dhe grada shkencore, si dhe me kualifikim në fusha të dyta ekspertize. Gjatë vitit të kaluar çdo audites i KLSH-së u trajnua për **22 ditë**, ose sa trefishi i viteve 2009, 2010 dhe 2011, të marra së bashku.

Në vitin 2013 u trajnuan 120 punonjës jashtë vendit, duke arritur një mestare trajnimi me 5,3 ditë trajnimi jashtë vendit për person**.** Në dy vitet e fundit, institucioni ka ndryshuar koncept në investimin për kapacitetet audituese. Nga një institucion i disa viteve më parë praktikisht pa trajnim, është kthyer në SAI me tregues perëndimorë trajnimi.

Gjithashtu, gjatë vitit të kaluar, KLSH aplikoi dhe u pranua anëtar i Task Forcës së Organizatës Europiane të Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAI) "*Mbi auditimin e etikës*", duke punuar për të ndërmarrë misione auditimi mbi rregullshmërinë dhe efiçiencën e Etikës dhe Integritetit në institucionet publike, duke konsideruar që lufta kundër korrupsionit dhe politikat për instalimin e një sistemi efektiv të integritetit, të jenë pjesë e menaxhimit të këtyre institucioneve.

Në mars 2013, KLSH nënshkroi Marrëveshjen e Angazhimit me përfaqësues të IDI-it dhe EUROSAI-it për Programin "*3i, Iniciativa e Implementimit të ISSAI-ve*". Për këtë qëllim është ngritur grupi i punës me mbështetjen e SIGMAs, duke plotësuar të gjitha detyrimet që rrjedhin nga kjo marrëveshje.

I përqendruar edhe në realizimin e **drejtimit të tretë strategjik të INTOSAI-t dhe EUROSAI-t *"Për shkëmbimin e njohurive dhe të përvojës me partnerët"***, institucioni gjatë vitit të kaluar njohu një partneritet në rritje me institucionet vendase dhe të huaja.
Audituesit e KLSH-s vlerësojnë së tepërmi dhe falënderojnë institucionin e Presidentit të Republikës për ndihmën e dhënë në këto dy vite, 2012 dhe 2013, për kuptimin, ndjeshmërinë e tij të thellë dhe përkrahjen pa rezerva ndaj misionit dhe vlerave që shpalos auditimi publik suprem.

Në zbatim të Rezolutës A66 të Asamblesë së Kombeve të Bashkuara të datës 22 dhjetor 2011 "*Promovimi i efiçiencës, llogaridhënies, efektivitetit dhe transparencës së administratës publike, duke fuqizuar institucionet supreme të auditimit*", KLSH, si agjent i Kuvendit për sigurimin e miradministrimit të fondeve publike, ka realizuar një bashkëpunim efikas me Parlamentin. Institucioni falënderon Kryetarin e Kuvendit dhe Kryetarin e Komisionit për Ekonominë dhe Financat, për mbështetjen financiare që i është dhënë KLSH-s, e cila, dhe pse modeste, garanton funksionimin normal të aktivitetit tonë auditues.

I jemi mirënjohës Kuvendit që, me kërkesë të KLSH, po i siguron institucionit për auditimin e fondeve të tij, një auditues të jashtëm të pavarur, si dhe për mbështetjen për miratimin gjatë vitit në vijim, të amendimeve të ligjit organik. Në nëntor të vitit 2012, në bashkëpunim me DG-Budget, të Komisionit Evropian dhe SIGMA-s, KLSH ka përgatitur dhe dërguar në Kuvend për miratim amendimet e ligjit organik, të cilat e modernizojnë institucionin, rrisin gamën e auditimeve dhe e sjellin veprimtarinë e KLSH-s në përputhje të plotë me standardet INTOSAI-t.

KLSH falënderon po ashtu Delegacionin e BE në Tiranë, për ndihmesën e tij në fitimin e Projektit të Binjakëzimit, në vlerën prej 2.1 milion Euro, të propozuar nga KLSH në kuadër të fondeve IPA 2013. Falënderojmë ish-Kryeministrin Berisha për mbështetjen e dhënë për këtë projekt, si dhe Kryeministrin dhe qeverinë e sotme për mundësimin e kësaj mbështetjeje, në momentin e finalizimit të projektit, për të cilin si KLSH kemi punuar dhe lobuar që nga fillimi i vitit 2012 e deri më sot.

Gjatë vitit 2013, KLSH konsolidoi zbatimin e marrëveshjeve të nënshkruara gjatë vitit 2012 dhe nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me Fakultetin e Gjeologji-Miniera të Universitetit Politeknik të Tiranës, me Shoqatën e Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës, me Institutin për Studime Publike dhe Ligjore dhe me gazetën "Ekonomia".

KLSH vlerëson efektivitetin e lartë të marrëveshjeve me SAI-t partnere gjatë vitit 2012, si me SAI-n polak, turk dhe slloven, të cilat mundësuan trajnime shumë cilësore të audituesve shqiptarë në këto institucione modern auditimi. Në vitin 2013, krahas përfundimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me Gjykatën Austriake të Auditimit, me Institucionin Shtetëror të Auditimit të Malit të Zi, me Zyrën e Auditimit të Institucioneve të Bosnjës dhe Hercegovinës dhe me SAI-n e Maqedonisë, KLSH nisi negociata për përfundimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe me SAI-t e Greqisë, Bullgarisë dhe Serbisë, duke synuar fuqizimin e rrjetit të vendeve të Evropës Juglindore të institucioneve supreme të auditimit, nën shembullin dhe eksperiencën e rrjeteve të ngjashme të krijuara në Evropë.

Duke jetësuar drejtimin e katërt strategjik të INTOSAI-t dhe EUROSAI-t "*Për menaxhim në përputhje me parimet e komunikimit transparent*", KLSH ka intensifikuar marrëdhëniet me publikun dhe qytetarët, duke i sjellë ato në një nivel të paarritur dhe të pakonceptuar më parë. Për të tretin vit radhazi analizat vjetore në nivel departamenti

auditimi zhvillohen krejtësisht të hapura, në prani të përfaqësuesve të medias, përgjatë disa ditëve dhe finalizohen me analizën e përgjithshme.

Pas një përmbysjeje reale të marrëdhënieve formale dhe hipotetike me qytetarin dhe median të vërejtura në vitet 2009, 2010 dhe 2011, gjatë vitit 2013, institucioni **ka trajtuar 401 letra dhe ankesa** të qytetarëve për probleme të ndryshme, në krahasim me një numër të papërfillshëm të letrave dhe ankesave të trajtuara në vitin 2011.

Krahas shtimit të vrullshëm të pranisë së rezultateve dhe gjetjeve të auditimeve të institucionit në median e shkruar dhe elektronike, të vërejtur edhe gjatë vitit 2012, risi e vitit 2013 ishte angazhimi i 42 punonjësve të KLSH, kryesisht kryeauditues dhe auditues të lartë, në përgatitjen dhe botimin e mbi 140 shkrimeve, analizave dhe opinioneve, në të gjitha gazetat e vendit. Me këtë rast, falënderojmë të gjitha mediat që i rezervuan, me mirëdashje dhe profesionalizëm, hapësira nismës së KLSH-së.

Në vitet 2012 dhe 2013, në zbatim të standardeve ISSAI për publikimin e gjetjeve dhe referencave të SAI-ve, institucioni ka botuar 22 tituj librash profesionale, udhëzuesish auditimi, si dhe me karakter informativ dhe historik. Personalitete të financave dhe auditimit publik kombëtar dhe ndërkombëtar kanë dhënë një kontribut cilësor me studime dhe artikuj për revistën "*Auditimi Publik*", e njohur si botim shkencor nga Ministria e Arsimit dhe ndërkombëtarisht me numrin identifikues ISSN. Botimet kanë ndihmuar, duke e bërë më transparente të gjithë veprimtarinë e KLSH-së dhe duke ndikuar në rritjen e kapaciteteve audituese, sidomos botimet e vitit 2013 si *"Udhëzuesi i Auditimit Financiar (ISSAI 1000-2999)", "Udhezuesi i Auditimit të Përputhshmërisë (ISSAI 4000-4200)"* dhe *"Standardet e Auditimit të Borxhit Publik (ISSAI 5410-5440)".*

Gjatë vitit, në ambientet e KLSH-s, kemi përuruar një mini-ekspozitë me foto, dokumente dhe botime nga historiku 89 vjeçar i KLSH-s,e cila pasurohet në vijimësi.

Në nëntor 2013, KLSH mori pjesë me një stendë modeste, në Panairin e Librit në Tiranë, ku ekspozoi 17 titujt e librave të botuar deri atëherë, ndërsa në dhjetor organizoi në Tiranë **Konferencën e dytë shkencore,** me temë *"Roli i Institucioneve Supreme të Auditimit për një menaxhim financiar të përgjegjshëm në sfidat e sotme",* ku morën pjesë rreth 120 pjesëmarrës nga SAI-t e zhvilluara partnere të KLSH dhe nga SAI-t e vendeve të rajonit, përfaqësues të institucioneve të tjera shtetërore, të botës akademike, të shoqatave të profesionistëve të fushës, të shoqërisë civile dhe mediave, auditues nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, etj.

Gjetjet e auditimeve të KLSH-s gjatë vitit 2013, krahasuar me fondet në dispozicion nga Buxheti i Shtetit për funksionimin e institucionit, kanë rritur treguesin e dobishmërisë, efektivitetit të institucionit, tregues ky i përdorur gjerësisht nga institucionet moderne të auditimit suprem.

Për vitin 2013, për një lek të harxhuar nga KLSH, institucioni ka theksuar dhe kërkuar

shpërblimin e dëmit ekonomik **për 52.4 lekë**, nga 17 lekë të kërkuara për çdo lek shpenzim, në dy vitet e marra së bashku 2010 (6 lekë) dhe 2011 (28 lekë). Shifrat flasin vetë.

Sikurse theksohet në Deklaratën e Pekinit të Kongresit INCOSAI XXI, *"SAI-t do të vazhdojnë t'i shërbejnë shoqërisë dhe publikun, duke promovuar zhvillimin e qëndrueshëm dhe përmirësimin e qeverisjes kombëtare, forcimin e demokracisë, përmirësimin e shtetit ligjor, duke luftuar korrupsionin, ruajtur sigurinë kombëtare dhe duke nxitur reformë*".

Në këtë frymë dhe mision, ne do të japim kontributin tonë si KLSH, në punën në sistem, ku përfshihen: Qeveria, Opozita, Kuvendi dhe Institucionet e Pavarura dhe Shoqëria Civile dhe Mediat, për përmirësimin e qeverisjes dhe rritjen e përgjegjësisë dhe llogaridhënies së institucioneve publike.

Viti 2014 do të konsolidojë objektivat e vendosura në Strategjinë e KLSH 2013-2017 dhe në Planin e saj të Veprimit.

300 VJETORI I GJYKATËS SË AUDITIMIT TË GJERMANISË

Botuar në Gazetën "Ekonomia", më 9 mars 2014

Gjykata Federale e Audituesve të Gjermanisë (në gjermanisht "Bundesrechnungshof") është ndër institucionet më të vjetra dhe më me tradita, të auditimit publik suprem në Evropë, dhe ndër më të zhvilluarat në botë. Ajo mbush këtë vit 300 vjet nga themelimi i saj. Janë vite që shënojnë progresin e saj drejt shndërrimit në një institucion model auditimi suprem, në shërbim të qeverisjes kombëtare gjermane, shembull i një profesionalizmi dhe integriteti të jashtëzakonshëm, për të gjithë komunitetin INTOSAI dhe EUROSAI. Institucioni i Auditimit Suprem (SAI) i Gjermanisë është institucion lider në fushën e vet, për aplikimin korrekt dhe me rigorozitet të standardeve ISSAI, për mbështetjen e zbatimit të ISSAI-ve kudo në botë, dhe për asistencën ndaj SAI-ve simotra më pak të zhvilluara.

SAI gjerman drejtohet nga Prof. Dr. Dieter Engels, një personalitet i auditimit suprem publik ndërkombëtar, kontributi i të cilit në zhvillimin e komuniteteve INTOSAI dhe EUROSAI dhe në bashkëpunimin me SAI të ndryshme në Evropë e më gjerë, është i spikatur.

Sipas mandatit kushtetues që ka, Gjykata Federale e Audituesve të Gjermanisë, shqyrton menaxhimin financiar federal. Neni 114, paragrafi i parë dhe i dytë i Kushtetutës Gjermane, përcakton se "*Bundesrechnungshof, anëtarët e të cilës do të gëzojnë pavarësinë e gjyqësorit, do të auditojë llogaritë dhe do të shqyrtojë performancën, rregullsinë dhe pajtueshmërinë e menaxhimit financiar publik. Bundesrechnungshof i raporton çdo vit direkt në dyja Dhomave te Parlamentit*".

Misionet e Auditimit të Gjykatës mbulojnë të ardhura dhe shpenzime vjetore federale që arrijnë në mbi 600 miliardë euro.

Bundesrechnungshof është një autoritet suprem federal. Në hierarkinë e autoriteteve federale, Gjykata ka të njëjtin status si të Zyrës së Presidentit Federal.

Si një organ i pavarur i auditimit publik, Bundesrechnungshof i nënshtrohet vetëm ligjit. Asnjë institucion nuk mund t'i diktoje asaj të kryejë auditime. Madje dhe Parlamenti Gjerman, Bundestag-u, nuk mund ta instruktojë Gjykatën. Parlamenti mund t'i kërkojë asaj të auditojë fusha ose institucione të caktuara.

Gjykata ka 1,300 punonjës, selinë në Berlin dhe nëntë zyra rajonale të auditimit.

Pak histori

Paraardhësi i Gjykatës Federale të Audituesve të Gjermanisë u themelua në Prusi, në vitin 1714, si Dhoma e Përgjithshme e Llogarive e Prusisë. Struktura e atëhershme i

përgjigjej mbretit. Në vitin 1848, Prusia bëhet monarki kushtetuese dhe mbikëqyrjet vjetore të institucionit i drejtoheshin Parlamentit. Kur në vitin 1871, me vullnet të vetë Prusisë, u kompletua bashkimi i Gjermanisë, ky organ u bë Institucioni më i Lartë i Auditimit në Gjermani.

Në vitin 1950, mbas miratimit dhe hyrjes në fuqi të Ligjit Themelor te saj, Gjykata Federale e Audituesve te Gjermanisë u quajt si pasardhësja e institucionit të pare, duke pasur të njëjtin status dhe të njëjtat funksione të specifikuara në Kushtetutë.

Në vitin 1969, reforma e Ligjit Buxhetor forcoi më shumë mandatin auditues të Gjykatës dhe e bëri atë organ këshillues të Bundestagut, Parlamentit Gjerman, duke i siguruar edhe akses të drejtpërdrejtë në Bundestag.

Në 1985, Ligji mbi Gjykatën Federale te Auditimit e njohu atë si gjykatë, duke i dhënë kështu edhe pavarësi kushtetuese. Qenia e saj "Gjykatë" reflekton më shumë natyrën e saj kolegjiale në procesin vendim-marrës, se sa natyrën e saj gjyqësore.

Në vitin 1998, u krijuan 9 zyra rajonale auditimi, me detyra ndihmëse kundrejt Gjykatës në misionin e saj audituesë të financave federale. Zyrat rajonale të auditimit i përgjigjen Gjykatës dhe ndjekin drejtimet e saj në kryerjen e detyrave audituese.

Organizimi dhe Struktura e Gjykatës

Ligji mbi Gjykatën Federale të Auditimit përcakton statusin kushtetues të Gjykatës, aspektet operative, si dhe caktimin e detyrave dhe proçesin e brendshëm vendim-marrës. Gjykata është e organizuar në 9 drejtori auditimi, të cilat janë po ashtu të ndara në 46 njësi audituese.

Gjykata ka 63 anëtarë: Presidentin (aktualisht Prof. Dr. Dieter Engels,), Zëvendës Presidentin, 9 Drejtues të Lartë Auditimi dhe 52 Drejtorë Auditimi. Ata kanë pavarësi gjyqësore dhe status kushtetues të ngjashëm me atë të gjykatësve. Ata nuk mund të shkarkohen nga puna dhe i nënshtrohen vetëm ligjit. Që nga viti 1985 Presidenti dhe Zëvendës Presidenti i Gjykatës zgjidhen me shumicë absolute dhe me ndërthurjen e përbashkët të qeverisë federale (me të drejtë aprovimi), të Bundestagut dhe Parlamentit Rajonal-Bundesratit apo Senatit (me të drejtë zgjedhjeje), si dhe të Presidentit të Republikës që bën emërimin. Emërimet për të dy postet kryesore bëhen për një periudhë 12 vjeçare ose deri në arritjen e moshës së pensionit (65 vjeç).

Anëtarët e tjerë të Gjykatës zgjidhen nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Presidentit të Gjykatës, zakonisht mbas një konsultimi me Komitetin e Përhershëm të Senatit.

Anëtarët e Gjykatës kanë një liri veprimi të konsiderueshme. Ata nuk kanë një metodë auditimi të përcaktuar, të cilën duhet ta ndjekin. Informacioni përfundimtar mbi auditimet individuale, vendoset praktikisht nga organi kolegjial përkatës.

Gjykata është përgjegjëse për auditimin e Ministrive të veçanta. Ajo mund të ndërmarrë edhe punë audituese ndër–dikasteriale si për shembull në programet mbi burimet njerëzore dhe shpenzimet, në trajtimin dhe përpunimin e të dhënave, në fushën e pensioneve dhe punëve publike.

Grupe auditimi *ad-hoc*(të përkohshme) mund të krijohen nga Gjykata për të vënë në punë projekte specifikë auditimi. Gjykata ka liri të plotë, përsa i përket natyrës dhe shtrirjes së punës audituese, rekrutimit, pagës dhe kualifikimeve të stafit të saj, si dhe burimeve të tjera.

Anëtarët e Gjykatës mbështeten nga audituesit. Në stafin e Gjykatës ka alternim konstant, sidomos të atyre që kanë diploma universitare. Stafi i Gjykatës bën pjesë në shërbimin civil kombëtar dhe trajtohet në mënyre ekuivalente. Pavarësia e funksionit auditues nga pushteti ekzekutiv përforcohet akoma më shumë nga metoda e përcaktimit të buxhetit të Gjykatës, i cili aprovohet në Parlament çdo vit, së bashku me grandet.

Objektivat, Roli dhe e Drejta e Aksesit e Gjykatës

Në Kushtetutën e vitit 1949 – amenduar nga reforma e ligjit buxhetor – Gjykatësit supremë auditojnë kontabilitetin shtetëror dhe ekzaminojnë performancën, rregullsinë dhe konformitetin e menaxhimit financiar. Kodi Buxhetor Federal i vitit 1969 thotë se funksionet e Gjykatës përfshijnë gjithë menaxhimin financiar të të gjithë qeverisë federale, duke futur këtu edhe fonde të veçuara.

Gjykata gjithashtu ekzaminon pjesëmarrjen e qeverisë federale në kompani private, në të cilat qeveria ka një interes direkt ose indirekt, si dhe në kooperativa industrial, në të cilat qeveria është pjesëtare. Gjykata auditon edhe në ato raste, kur qeveria ka pjesë në ndërmarrje publike të cilat ndodhen në fazën e parë të privatizimit.

Gjykata ekzaminon gjithashtu edhe subjekte private që marrin grande apo garanci shtetërore, kur ekziston një marrëveshje ose statuti i subjektit e lejon një ekzaminim të tillë.

Procesi i Auditimit- Këshillimi mbi Buxhetin e Shtetit

Që prej reformës së Ligjit mbi Buxhetin të vitit 1969, Gjykata është përfshirë në zhvillimin e buxheteve të departamenteve dhe në veçanti në takimet midis departamentet shpenzuese dhe Ministrisë së Financës, të cilët mbahen përpara nënshkrimit të buxhetit në Parlament.

Përqasja e Gjykatës mbi auditimin në përgjithësi është e përcaktuar në Kodin Buxhetor Federal, i cili kërkon që të ekzaminohet nëse janë respektuar parimet e financimit dhe menaxhimit të saktë, duke përfshirë këtu pajtueshmërinë me Ligjin mbi Buxhetin, vlerësimet dhe dokumentet mbështetës. Kodi kërkon gjithashtu që të kryhen kontrolle për të verifikuar nëse fondet janë administruar me efektivitet dhe ekonomicitet dhe nëse funksionet mund të zbatoheshin duke vënë në përdorim më pak fonde.

Përgjegjësia më madhore e Gjykatës është të sigurojë që marrja dhe shpenzimi i fondeve qendrorë, përputhet me kriteret ligjorë. Fokusi i veçantë mbi ligjshmërinë e shpenzimeve federale, shpjegon arsyen pse 1/3 e personelit të Gjykatës duhet të ketë kualifikim universitar ligjor.

Gjatë viteve tetëdhjetë (1980-të), fokusimi i Gjykatës u zhvendos drejt auditimit të performances dhe, për këtë arsye ajo filloi të punësonte personel me një gamë më të gjerë aftësish dhe arsimi, duke përfshirë këtu ekonominë, biznesin dhe inxhinierinë.

Zyra Rajonale Auditimi, që plotësojnë punën e Gjykatës saj në menaxhimin financiar, përputhshmërinë dhe vlerën e parasë(auditimi i performancës), janë ngritur në Berlin, Koblencë, Këln, Frankfurt, Hamburg, Hanover, Magdeburg, Mynih dhe Shtutgard. Ato zëvendësojnë sistemin para-auditues të mëparshëm në Gjermani.

Sistemi i ri është projektuar për të rritur eficiencën dhe efektivitetin. Gjykata dhe Zyrat e saj Rajonale të Auditimit kanë të drejtë të vëzhgojnë çdo dokument dhe dosje të nevojshme, për të kryer një auditim efektiv. Përveç auditimit ex-post(pas faktit) të projekteve dhe llogarive, Gjykata ka të drejtë të inspektojë edhe projektet dhe llogaritë, zhvillimi i të cilëve është në vazhdim. Gjithsesi në këto raste ajo merr në konsideratë vetëm ato vendime që janë marrë në momentin e auditimit. Këto programe auditimi bashkëveprues mund të identifikojnë hapësira të mundshme zhvillimi dhe kursimi. Për kontratat mbi ndërtimet, Gjykata ka të drejtë të shqyrtojë të gjithë dokumentet dhe të auditojë si fazën e tenderit, ashtu dhe fazën e planifikimit.

Gjykata përmbledh rezultatet e ekzaminimeve individuale dhe jep këshilla për përmirësim, nëpërmjet letra drejtuar menaxherëve të institucioneve të audituara. Në ndihmë të këtij proçesi është dhe Parlamenti, i cili nëpërmjet Komisionit të Zbatimit te Buxhetit, nën-komisioneve dhe Komisionit të Llogarive Publike, mundohet të sigurojë që nga raportet e Gjykatës të nxirren përfundimet e duhura.

Raporti Vjetor i Gjykatës, i ashtuquajtur "Vëzhgimet", luan një rol të rëndësishëm në procesin, gjatë të cilit Parlamenti aprovon llogaritë e Qeverisë. Komentet mbi menaxhimin financiar nuk kufizohen vetëm tek viti financiar për të cilin kërkohet miratimi parlamentar, por paraqesin gjetjet deri në datën e publikimit të raportit.

Komisioni Parlamentar i Llogarive Publike diskuton Vëzhgimet e Gjykatës, së bashku me Gjykatën dhe departamentet e saj. Komisioni Parlamentar i Llogarive Publike i kalon raportin Komisionit mbi Zbatimin e Buxhetit, i cili i rekomandon Parlamentit të konsiderojë Qeverinë lidhur me buxhetin që ajo ka mbaruar. Komisioni mbi Zbatimin e Buxhetit përpilon një draft rekomandimesh, mbi një rezolutë shumë të detajuar. Zbatimi i tyre monitorohet nga Gjykata.

Gjykata Federale e Audituesve të Gjermanisë mund të përpilojë raporte të tjerë në çdo kohë, mbi fusha interesi aktuale dhe çështje ndër-sektoriale. Këto raporte janë më të përditësuara dhe e shtyjnë Parlamentin të fokusohet në çështjet më shqetësuese financiare.

Që nga viti 1997, Gjykata ka paraqitur një raport shtesë informative(Raporti mbi Impaktin e Auditimit) për opinionit publik, për të vënë në dukje efektivitetin e punës së saj. Raporti mbi Impaktin e Auditimit ka qëllime parandaluese dhe vë në dukje përfundimet e arritura në Raportin Vjetor. Ky Raporti i paraqitet opinionit publik çdo Qershor.

Gjykata Federale e Audituesve të Gjermanisë dhe KLSH

Marrëdhëniet mes Gjykatës Gjermane dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit janë marrëdhënie shumë të mira, marrëdhënie partneriteti dhe mirëkuptimi reciprok. Ato bazohen në nenin 15 të Deklaratës së Limës, Kushtetutës së institucioneve supreme të auditimit. Një delegacion i KLSH, i kryesuar nga Kryetari, shkoi në Gjermani, për të marrë pjesë në Simpoziumin ndërkombëtar të Teknologjisë së Informacionit, i organizuar nga Gjykata Federale e Audituesve të Gjermanisë. Simpoziumi, krahas shkëmbimit të përvojave të mira në përdorimin e T.I. në certifikimin e llogarive vjetore të Buxhetit të Shtetit dhe të atyre individuale të institucioneve të audituara, nga SAI të ndryshme, do të përbëjë një takim jubilar, me rastin e 300 vjetorit të Gjykatës gjermane. Ai do të japë me forcë mesazhin kuptimplotë se edhe e ardhmja e institucioneve supreme të auditimit publik, sikurse e çdo strukture tjetër të përgjegjshme shtetërore, është investimi i thellë dhe i qenësishëm në teknologjinë e informacionit.

NISMA E RE LIGJORE PËR KLSH-NË

Botuar në Gazetën "Ekonomia" dhe në Gazetën "Koha jonë", më 18 mars 2014

Kontrolli i Lartë Shtetit, në vijim të perpjekjeve për të përputhur veprimtarinë e tij me standardet ndërkombëtare të auditimit të INTOSAI dhe me legjislacionin bashkëkohor të institucioneve homologe të zhvilluara, në zbatim dhe të kërkesave dhe rekomandimeve të Progres-Raporteve të fundit të Komisionit Europian, ka përgatitur amendimet e ligjit të tij organik nr. 8270, datë 23.12.1997 "*Për Kontrollin e Lartë të Shtetit",* i ndryshuar, me ndihmën teknike të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit të Komisionit Europian (DG-Budget) dhe të projektit SIGMA të BE dhe OSBE-së.

Amendimet u shqyrtuan me hollësi jo vetëm nga institucionet respektive shtetërore dhe ato ndërkombëtare, por edhe nga shoqëria civile e vendit dhe nga grupet e ndryshme të interesit, duke përfshirë edhe qarqet akademike të fushës juridike dhe ekonomike.

Në letrën e tij drejtuar KLSH në 18 tetor 2012, Drejtori i Përgjithshëm i DG-Budget, Z. Herve Jouanjean (Zhuanzhan), pasi siguron mbështetjen maksimale teknike të Komisionit Europian për amendimet e ligjit të KLSH-së, shprehet se amendimet "*e sjellin institucionin e KLSH tërësisht në linjë me standardet e INTOSAI*".

Z. Robert Gielisse, Drejtor Njësie në DG-Budget, i cili erdhi personalisht dy herë për ligjin e ri të KLSH dhe u takua në dhjetor 2013 dhe me Kryetarin e Parlamentit, z. Ilir Meta, gjatë konsultimeve me palët e interesit në nëntor 2012, theksoi se "*Projekt ligji i ri jep një strukturë të qartë dhe terminologji të standardeve ndërkombëtare. Ai ka referenca të qarta për Auditimet e Performancës dhe përkufizim më të fortë të rolit dhe të drejtave të KLSH".* Sipas z.Gielisse, *"Përputhja me standardet ndërkombëtare të INTOSAI prezanton një etapë të rëndësishme të vendit drejt integrimit në BE. Certifikimi i audituesit është dëshmi e kompetencës mbi standardet e auditimit dhe lejon komunikim të standardizuar profesional. Amendimet e ligjit të KLSH-së janë një përparim i madh: ato e sjellin Auditimin e Jashtëm publik në Shqipëri në një linjë me standardet ndërkombëtare".*

Domosdoshmëria e kryerjes së ndryshimeve dhe përmirësimeve ligjore në ligjin organik të KLSH-së, ka ardhur si rezultat i një sërë faktorësh të brendshëm dhe të jashtëm, ndër tëcilët më kryesorët janë:

1. ***Kërkesat dhe angazhimet e Shqipërisë, të përcaktuara në Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit.***

Sipas Nenit 90 të MSA-s, "*Bashkëpunimi mes palëve do të përqendrohet në fushat prioritare, që lidhen me acquis të Komunitetit në fushat e kontrollit financiar të brendshëm publik dhe auditimit të jashtëm. Palët bashkëpunojnë në mënyrë të veçantë për të zhvilluar një sistem efikas të Kontrollit Financiar të Brendshëm Publik dhe sisteme të auditimit të jashtëm në Shqipëri, në përputhje me*

standardet dhe metodologjitë e pranuara botërisht si edhe me praktikat më të mira të BE-së."
Bazuar në këto përcaktime të MSA-së, Progres-Raportet e viteve 2011, 2012 dhe 2013 të Komisionit Europian për Shqipërinë, kanë theksuar vazhdimisht kërkesat për kryerjen e llojeve të reja të auditimit (auditimi i performancës dhe certifikimi), për forcimin e kapaciteteve dhe performancës së KLSH-së, për ndjekjen sistematike parlamentare të raporteve të KLSH-së, mbrojtjen e interesave financiare të BE-së dhe miratimin e projektligjit të ri për Kontrollin e Lartë të Shtetit.
Më konkretisht, **në Progres-Raportin e vitit 2011** për Shqipërinë, Komisioni Europian shprehet:
"Progres i limituar është bërë në llojet e reja të auditimit, të tilla si certifikimi dhe auditimi i performancës. Amendimet në Ligjin për Institucionin Suprem Shtetëror të Auditimit (SAI) për ta sjellë atë plotësisht në linjë me standardet INTOSAI janë duke u përgatitur. SAI po largohet gradualisht nga puna audituese e llojit të inspektimit në auditimet financiare… Amendimet në Ligjin e SAI-it duhet të adoptohen, në mënyrë që kuadri ligjor të sillet plotësisht në linjë me standardet e INTOSAI. Ka akoma pak progres në fushat që lidhen me mbrojtjen e interesave financiare të BE-së."
Në Progres-Raportin e vitit 2012 për Shqipërinë, Komisioni Europian shprehet:

"... Nevojiten përpjekje të konsiderueshme për të forcuar kapacitetet dhe performancën e KLSH-së.... Pas disa vitesh në pezullim, janë përgatitur dhe dërguar për miratim ndryshimet e ligjit të SAI-t, për ta sjellë në përputhje të plotë me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI). KLSH kryen të gjitha llojet kryesore të auditimeve, por auditimet e llojit të inspektimit të rregullshmërisë/përputhshmërisë përbëjnë ende shumicën dërrmuese të auditimeve të tij (afërsisht 90% në 2011-ën). .... Duhet të përmirësohet efektiviteti i ndjekjes parlamentare, bazuar në raportet e auditimit të KLSH".

Ndërsa **në Progres-Raportin e vitit 2013** për Shqipërinë, Komisioni Europian shprehet:
"Ndryshimet në Ligjin e KLSH janë në pritje dhe nevojitet përfshirja e një performance të qëndrueshme auditimi...Janë ndërmarrë ndryshime organizative dhe procedura te reja për të rritur efiçiencën e Kontrollit të Lartë i Shtetit ... Megjithatë, ndryshimet në ligjin për KLSH janë duke u shqyrtuar në Parlament që në vitin 2012 dhe mbetet të miratohen me shumicë 3/5. Aktualisht, nuk ka ndjekje sistematike parlamentare të raporteve të KLSH".
Ndër standardet ndërkombëtare të INTOSAI-t, dy prej tyre konsiderohen si më kryesoret, ISSAI 1, *"Deklarata e Limës",* e quajtur ndryshe Kushtetuta e komunitetit të institucioneve supreme të auditimit (SAI-t) dhe ISSAI 10, "Deklarata e Meksikës për pavarësinëe SAI-ve".
Projektligji i ri për KLSH-n mbështetet plotësisht në këto standarde auditimi, si dhe në standardet e tjera ndërkombëtare, si ato të IFAC dhe në Rezolutat e Kongreseve të INTOSAI-t dhe EUROSAI-t.

Në këtë këndvështrim, miratimi i një ligji të ri për KLSH-në është i domosdoshëm, në funksion të qasjes së plotë me standardet ndërkombëtare të auditimit, qasje e cila ka ndodhur në shumicën e legjislacioneve të institucioneve homologe të auditimit, nivelin e të cilave KLSH synon të arrijë.

2. ***Përshtatja e legjislacionit të KLSH-së, si institucion i auditimit të jashtëm, me ndryshimet e bëra në legjislacionin për auditimin e brendshëm në sektorin publik.***

Ligji nr. 9720, datë 23.04.2007 *"Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"* në përmbajtjen e tij si dhe në terminologjinë juridike të, mbetet një ligj bashkohor në krahasim me ligjin organik ekzistues të KLSH-së.
Miratimi i një ligji të ri për KLSH-në, në vazhdim të punës së bërë për miratimin e ligjit për auditimin e brendshëm në sektorin publik si dhe asimilimit në ligj të standardeve ndërkombëtare të auditimit, plotëson në tërësi kuadrin e nevojshëm ligjor në Shqipëri, përsa i përket auditimit të brendshëm dhe të jashtëm në sektorin publik.

3. ***Zëvendësimi i terminologjisë së vjetër juridike të ligjit ekzistues me terminologjinë bashkëkohore në fushën e auditimit.***

Ligji organik i KLSH-së nr. 8270, datë 23.12.1997, vazhdon të mishërojë terminologji juridike dhe financiare të një periudhe ku ky institucion konsiderohej si një institucion i kontroll-revizionit të pasqyrave financiare. Kjo terminologji aktualisht nuk përdoret më në legjislacionet e huaja të institucioneve homologe, madje as edhe në legjislacionin tonë mbi auditimin e brendshëm në sektorin publik.
Kështu për shembull termi "kontroll" i përdorur në ligjin organik aktual të KLSH-së nuk i përshtatet kërkesave që standardet ndërkombëtare të auditimit imponojnë për zbatim nga ana e institucioneve supreme të auditimit dhe nuk përputhet tërësisht me konceptin dhe përmbajtjen e termit "auditim", të përdorur gjerësisht në fushën e auditimit.

Risitë e projekt-ligjit

1. ***Zgjerimi i objektit të veprimtarisë audituese.***

Në projektligjin e ri "*Për Kontrollin e Lartë të Shtetit*", janë përcaktuar dhe përkufizuar krahas auditimit të përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare edhe kryerja e auditimit të performancës, auditimit të IT-së dhe certifikimi i llogarive financiare.
Përcaktimi në ligj i të gjitha llojeve të auditimit është i domosdoshëm dhe e vendos KLSH në një nivel zhvillimi dhe performance me institucionet supreme moderne të auditimit publik.

Sipas Dr. Josef Moser, Sekretar i Përgjithshëm i INTOSAI-t dhe President i Gjykatës së Auditimit të Austrisë, në fjalën e tij në Simpoziumin e 22-të të OKB/INTOSAI-t, mbajtur në mars 2013 në Vjenë, "*Auditimi dhe këshillimi janë dy fytyrat e të njëjtës monedhë. Nga njëra anë, problemet dhe mundësitë për përmirësim janë analizuar dhe identifikuar gjatë retrospektivës, pra auditimeve të bazuara në fakte dhe nga ana tjetër, ato plotësohen me qasjen e këshillimit largpamës, me rekomandime për të përmirësuar dhe rritur ekonominë, si dhe efektivitetin e qeverisjes publike*". Ligji i ri për KLSH jep pikërisht këtë mandat të zgjeruar auditimi, duke futur konceptin dhe veprimin e auditimit të performancës.

Në projektligjin e ri të KLSH-së, një risi është edhe auditimi që KLSH, në mbrojtje të interesave financiare të BE-së dhe zbatim të MSA-së, duhet të zhvillojë ndaj përdoruesve të fondeve të ofruara nga Bashkimi Europian, ose nga organizata të tjera ndërkombëtare.

Bashkimi Evropian, për Programin e Fondeve Strukturore të periudhës 2014-2020, ka vendosur rregulla dhe kërkesa të forta të kontrollit financiar. Ato bazohen në direktivat e Komisionit Europian për sistemet e kontrollit efektiv dhe auditimit të fondeve të BE-së, si një nga çështjet kyçe në kuadër të të gjithë arkitekturës së zbatimit të politikës së kohezionit të BE-së. Administratat në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal kanë më shumë përgjegjësi për të ndërtuar një sistem efektiv kontrolli dhe për të siguruar shpenzimin siç duhet të parave publike. Politika e kohezionit e zbatuar vitet e fundit nga BE, u kërkon organizmave kombëtare të vendeve përfituese të fondeve të BE, një rol më të madh në monitorimin dhe kontrollin financiar të projekteve që përgatiten me ndihmën e fondeve strukturore të Bashkimit Europian.

Zgjerimi i mandatit auditues të KLSH nëpërmjet përfshirjes në ligjin e ri të së drejtës për të audituar fondet e BE përkon me praktikat e mira për menaxhimin financiar, kontrollin financiar dhe procedurat e auditimit të fondeve strukturore në shtetet e ndryshme anëtare të BE-së. Ai përfshin menaxhimin e buxhetit të fondit, raportimin, si dhe kërkesat e kontrollit financiar dhe të auditimit.

2. Auditimi dhe certifikimi i pasqyrave financiare vjetore për njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe dhënia e opinionit për to.

Auditimi dhe certifikimi i pasqyrave financiare vjetore për njësitë e qeverisjes si dhe dhënia e opinionit të KLSH-së në lidhje me to, ka qenë ndër të tjera edhe kërkesë e vetë Ministrisë së Financave për institucionin e KLSH-së, e cila pasqyrohet në kërkesat e neneve 62 dhe 63 të Ligjit Organik të Buxhetit.

Në projektligjin e ri për KLSH-në, auditimi financiar (certifikimi i llogarive) trajtohet respektivisht në nenet 9 e 10 të këtij projektligji.

Në nenin 9 të projektligjit parashikohet kompetenca e KLSH-së për auditimin e llogarive vjetore të institucioneve, e më konkretisht:

"Kontrolli i Lartë i Shtetit, në përputhje me funksionin e tij, ka kompetencë të audtojë zbatimin e

buxhetit nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, si dhe nga personat e tjerë juridik, duke përfshirë llogaritë vjetore; ... Kontrolli i Lartë i Shtetit, çdo vit, jep opinion për raportin e konsoliduar vjetor të zbatimit të buxhetit, i cili përfshin edhe vlerësimin e bërë bazuar në nenin 15 paragrafi 1 i këtij ligji."

Terminologjia e përdorur në këtë nen është përshtatur me atë të përdorur në ligjin organik të buxhetit dhe paragrafi i fundit i këtij neni është shtuar me sugjerimin e SIGMA-s, në mënyrë që të harmonizohet me ligjin organik të buxhetit (neni 62-63) dhe për t'iu referuar në mënyrë specifike këtij dokumenti kur përcaktohet se çfarë auditimi vjetor është i detyrueshëm për KLSH-në.

Referuar nenit 62 të ligjit organik të buxhetit të shtetit, përcaktohet se:

"Një kopje e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit të shtetit, të cilin Ministri i Financave e paraqet brenda muajit Maj në Këshillin e Ministrave i dërgohet edhe Kontrollit të Lartë të Shtetit, i cili auditon llogaritë vjetore të buxhetit."

Gjithashtu në nenin 10 të projektligjit të ri për KLSH-në, përcaktohet qëllimi i kryerjes së këtij lloj auditimi, sipas të cilit:

"Në auditimet financiare, Kontrolli i Lartë i Shtetit duhet të përcaktojë nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar."

Vendosja e këtyre përcaktimeve në projektligjin e ri të KLSH, garanton kryerjen e auditimeve financiare, pra dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare të njësive të qeverisjes së përgjithshme.

Në Standardin Ndërkombëtar të Auditimit, ISA 200 (IFAC Standard) "Objektivi dhe parimet e përgjithshme që drejtojnë auditimin e pasqyrave financiare" , paragrafi i tretë përcaktohet se: "*Qëllimi i një auditimi është rritja e shkallës së besimit për përdoruesit e caktuar të pasqyrave financiare".*

Besueshmëria e pasqyrave financiare të përgatitura nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme do të rritet, nëse opinionet e auditimit janë paraqitur në mënyrë të saktë dhe në referencë e përputhje të plotë me kërkesat e standardeve ndërkombëtarisht të pranuara.

Deklarata e Limës përcakton se *"Koncepti dhe realizimi i auditimit është i qenësishëm në administrimin publik financiar, pasi menaxhimi i fondeve publike* ***nënkupton besim"***. Në këtë aspekt përfshirja në projektligj e të drejtës së KLSH-së për kryerjen e auditimit financiar (certifikimit) është një hap më tej në rolin e tij në mbrojtjen e Financave Publike, objektiv i cili përmbahet në Planit Strategjik të KLSH-së, 2013-2017 (Nën-objektivi 2.2).

KLSH ka aplikuar dhe ka fituar një projekt binjakëzimi nga fondet IPA 2013. Në këtë aspekt, është parashikuar një **kuadër i plotë skemash operacionale,** të cilat synojnë zhvillimin e metodologjive apo të kuadrit rregullator (manual, rregullore udhëzime etj) për implementimin e amendimeve ligjore përsa i përket kryerjes së auditimit financiar (certifikimit të llogarive vjetore).

3. Përmirësimi i marrëdhënies me subjektet e audituara

Projektligji i ri fuqizon të drejtën e KLSH-së për sigurimin prej subjekteve të audituara të të gjithë informacionit dhe dokumentacionit, shkresor ose elektronik, që KLSH e konsideron të nevojshëm për realizimin e detyrave të tij audituese.

Në projektligj parashikohet që këto subjekte, jo vetëm që duhet t'i sigurojnë KLSH-së të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar brenda një afati dhe në mënyrën e kërkuar nga KLSH (qoftë dhe kur ai përbën sekret shtetëror apo konsiderohet si konfidencial), por këto subjekte duhet që brenda një afati të caktuar kohor, të raportojnë edhe në lidhje me marrjen e masave dhe ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të bëra nga KLSH pas përfundimit të auditimit.

Neni 25 i projektligjit të ri synon të ezaurojë të gjithë problematikën e deritanishme në lidhje me mosdhënien e informacionit apo dokumentacionit nga subjektet e audituara apo pengimin e kryerjes së detyrës së tij audituese nëpërmjet mosdhënies së këtyre dokumentacioneve.

Sipas komenteve të SIGMA-s, *"Mundësia për të shfrytëzuar të gjithë bartësit e informacioneve dhe autoritetin që i është dhënë KLSH-së për të vendosur vetë për atë çka i nevojitet, është një përmirësim i rëndësishëm krahasuar me ligjin e aktual, ku jepet një përshkrim i ngushtë i asaj çka KLSH mund të kërkojë."*

Për këtë shprehet qartë Parimi i 4-t i Deklaratës së Meksikos, në të cilin theksohet se: *"SAI duhet të ketë kompetenca të mjaftueshme për të marrë në kohë dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë, të gjitha dokumentet e nevojshme dhe informacionet për ushtrimin e përgjegjësive të tij ligjor".*

Gjithashtu në projektligjin e ri, konstatohet qartazi një qasje akoma dhe më miqësore kundrejt subjekteve të audituara, si në lidhje me të drejtën e këtyre subjekteve për t'u njohur që në fillim si me programin dhe planin e auditimit, ashtu dhe me të drejtën e tyre për t'u informuar dhe dhënë shpjegime e observacione në lidhje me gjetjet e pasqyruara në procesverbalet dhe projekt-raportet e auditimit, të cilat bazuar në projektligjin e ri janë të detyrueshme të evidentohen në raportin përfundimtar.

4. Transparenca e rritur e veprimtarisë së KLSH-së ndaj publikut

Në projektligjin e ri për KLSH-në është parashikuar një dispozitë e veçantë në lidhje me informimin e publikut (neni 32), sipas të cilës KLSH siguron natyrën publike të veprimtarisë së tij nëpërmjet publikimit të raporteve të paraqitura në Kuvend, publikimit të raporteve të auditimit në mënyrë elektronike, zhvillimit të konferencave për shtyp dhe metodave të tjera të informimit në media, sigurisht në respekt të dispozitave përkatëse ligjore në lidhje me sekretin shtetëror, tregtar apo atë konfidencial.

Ligji i ri i KLSH siguron transparencë të plotë të institucionit me publikun, në bazë të objektivave të Drejtimit të Katërt strategjik të EUROSAI-t për vitet 2011-2017, i cili është *"Qeverisja dhe Komunikimi"*. Në Deklaratën e Pekinit të tetorit 2013, në Kongresin e 21-të të INTOSAI, theksohet se: "*SAI-t ndihmojnë në ndërtimin e komunikimit dhe besimit*

midis sektorit publik dhe qytetarëve, duke promovuar qeverisje të hapur dhe bëjnë të mundur që qytetarët të marrin pjesë në mënyrë aktive në proceset e vendimmarrjes publike".

5. Certifikimi i audituesve të KLSH-së

Projektligji realizon përcaktimin e qartë dhe të plotë të statusit të nëpunësve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, duke parashikuar një sërë dispozitash, në të cilat evidentohen të drejtat, detyrimet dhe kushtet që duhet të plotësojnë punonjësit e KLSH, sidomos ata me detyrë "auditues". Sipas personalitetit të financave publike europiane, z. Robert Gielisse, "*Certifikimi i audituesit është dëshmi e kompetencës mbi standardet e auditimit dhe lejon komunikim të standardizuar profesional*"

Në dispozitat e fundit të këtij projektligji, është parashikuar procedura ligjore për marrjen e statusit si *"auditues (i jashtëm) publik i certifikuar",* status ky i cili do të siguronte një qëndrueshmëri dhe siguri të stafit të KLSH në ushtrimin e detyrës dhe kompetencave të tyre ligjore.

6. Pavarësia financiare e KLSH-së

Autonomia financiare, është një element kyç dhe i domosdoshëm i institucioneve supreme të auditimit publik (SAI-ve). Ajo i garanton SAI-t pavarësinë dhe funksionimin normal ligjor, duke i dhënë mundësinë të realizojë detyrat e tij kushtetuese dhe ligjore, bazuar në Deklaratën e Limës, (Neni 7), si dhe në Deklaratën e Meksikos të vitit 2007, që i përkushtohej tërësisht pavarësisë së SAI-ve. Sigurimi i pavarësisë financiare dhe vepruese është ndër objektivat kryesore të përmbajtura në drejtimin e Parë Strategjik të Strategjisë së EUROSAI-t, 2011-2016 për Ndërtimin e Kapaciteteve, si dhe në Drejtimin e Katërt të Strategjisë së INTOSAI-t, 2011-2016, për një SAI të fortë dhe model.

Neni 5 i projektligjit të ri për KLSH-n e forcon pavarësinë financiare të institucionit. Sipas tij:

"Mjetet financiare të Kontrollit të Lartë të Shtetit përballohen nga buxheti i shtetit, ku Kontrolli i Lartë i Shtetit ka një kapitull të veçantë.

Kontrolli i Lartë i Shtetit propozon çdo vit projekt-buxhetin e tij në Komisionin për Ekonominë dhe Financat, i cili e paraqet për miratim në Kuvend.

Kontrolli i Lartë i Shtetit zbaton në mënyrë të pavarur buxhetin e tij, të aprovuar nga Kuvendi.

Kontrolli i Lartë i Shtetit përgatit çdo vit llogaritë e tij financiare në përputhje me legjislacionin mbi buxhetin.

Llogaritë auditohen nëpërmjet një komisioni të posaçëm dhe të pavarur të caktuar nga Kuvendi dhe që raporton tek ky i fundit."

Çështje për diskutim

Në projektligjin e ri për KLSH-në, i cili në tërësinë e tij përmban një sërë ndryshimesh dhe përmirësimesh të rëndësishme, nuk janë përfshirë dhe nuk janë trajtuar një sërë çështjesh të tjera po aq të rëndësishme, të cilat meritojnë vëmendjen e Kuvendit, për të cilat kërkohet paraprakisht trajtimi i tyre nga ana e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave.

Në këtë kuptim, mund të themi që ky projektligj paraqet edhe disa "mangësi", në raport dhe me atë çka parashikojnë legjislacionet e shumë prej institucioneve të huaja homologe.

Më konkretisht, si mangësi të këtij projektligji përmendim mospërfshirjen e:

- Rritjes së nivelit të zbatueshmërisë së rekomandimeve të KLSH-së;
- Trajtimit të së drejtës që KLSH ka në drejtim të auditimit të koncesioneve. Aktualisht KLSH-ja e kryen auditimin e koncesioneve, por nuk auditon zhvillimin e tyre të mëtejshëm, me aq rëndësi për fatet e ekonomisë kombëtare;
- Trajtimit të së drejtës që KLSH ka në administrimin e të ardhurave dytësore që si institucion mund të krijojë nga bashkëpunimi dhe angazhimi në auditime të ndryshme ndërkombëtare, nga botimet e ndryshme, etj.
- Përmirësimin e trajtimit financiar të punonjësve të KLSH-së si garanci e pavarësisë së tyre audituese.

JO, KLSH NUK KËRKON TË AUDITOJË SUBJEKTET PRIVATE!

Botuar në Gazetën "Panorama", më 31 mars 2014

Duke theksuar që në fillim mbështetjen e madhe që të gjithë deputetët e Komisionit për Ekonominë dhe Financat i kanë dhënë projektligjit të ri për Kontrollin e Lartë të Shtetit(KLSH), një keqkuptim po aq i madh për një çështje thelbësore të auditimit të jashtëm publik, atë të aksesit në informacion, më shtyn të shkruaj këto rreshta. Duke pohuar që në fillim:

Jo! KLSH nuk kërkon të auditojë subjektet private!

Gjatë diskutimeve në Komision e Kuvendit për Ekonominë dhe Financat, aksesi i KLSH në informacionin e organeve tatimore mbeti i paqartë. Disa deputetë shprehën mendimin se qasja e pakufizuar e KLSH në të dhënat e organeve tatimore mund të dëmtojë interesat e tatimpaguesve privatë. Këto opinione u përcollën me te drejte nga mediat. U krijua përshtypja në një pjesë të opinionit publik se KLSH do të auditojë subjektet private.

Jo, ne nuk kërkojmë të auditojmë subjektet private! Ne gjykojmë se ky është një keqkuptim. Si institucioni publik më i lartë audites në vend, KLSH gëzon me Kushtetutë të drejtën për të audituar mënyrën se si vilen të ardhurat publike. Ne kërkojmë të auditojmë, sikurse u shpreh me plot të drejtë deputeti Florjon Mima, vlerësimin tatimor, i cili kryhet nga administrata tatimore, dhe nuk kërkojmë të auditojmë vetëdëklarimin tatimor, i cili kryhet nga tatimpaguesit privatë. E garantojmë opinionin publik, tatimpaguesit shqiptarë, Kuvendin dhe të gjithë partnerët tanë, se në asnjë rast nuk do të merremi me subjektet private, nuk do kërkojmë të shikojmë, ndërhyjmë në subjektet private, pasi kjo është shkelje flagrante e standardeve tona profesionale. Ne auditojmë performancën e administratës tatimore, auditojmë vlerësimin tatimor, natyrisht, edhe duke u njohur me dosjen, vetëdeklarimin tatimor të subjekteve private, sikurse veprojnë të gjitha institucionet simotra evropiane. Dhe natyrisht, duke ruajtur konfidencialitetin e kësaj dosjeje, duke mos ndërhyrë për verifikime në të dhe duke mos kryer ato qe me të drejtë ish-Ministri i Financave Ridvan Bode i quajti "vizita fiskale në subjekte".

E drejta e KLSH për të shqyrtuar çdo informacion dhe dokumentacion të nevojshëm për auditim, edhe në fushën e tatimeve, është e garantuar në ligjin aktual të institucionit. Kjo e drejtë u konfirmua së fundi edhe nga vendimi gjyqësor i Gjykatës së Apelit Tiranë i tetorit 2013, për zgjidhjen e konfliktit të kompetencave ndërmjet KLSH dhe organeve të administratës tatimore. Gjatë gjithë këtyre viteve, KLSH ka pasur akses të plotë në çdo informacion apo dokumentacion zyrtar, përfshirë këtu edhe ato që përbënin sekret shtetëror dhe konfidencial. I vetmi institucion që bënte përjashtim nga ky rregull, kanë qenë organet tatimore, të cilat e mbështesnin refuzimin për të dhënë informacion mbi një Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve të vitit 2009 dhe një Vendim të Gjykatës së Apelit të vitit 2009. Është e pajustifikueshme që institucioni suprem i auditimit publik në vend, që auditon dokumentacion që përbën sekret shtetëror të

Ministrisë së Rendit, Mbrojtjes dhe SHISH, të ndalohet tani me ligj që të mos njihet me dokumentacionin në lidhje me vlerësimin per tatimpaguesit. Kontrolli i Lartë i Shtetit, gjatë auditimeve të tij, njihet vazhdimisht me informacione konfidenciale të tatimpaguesve, sikurse ndodh rëndom në auditimet tona në dogana dhe në procedurat e prokurimit publik. Këto informacione janë të domosdoshme, për të kryer një auditim profesional dhe efikas, për interesat e vetë Kuvendit dhe qytetarëve. Kjo e drejte eshte e sanksionuar dhe ne Ligjin Nr. 9920 dt. 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republikën e Shqipërisë", Neni 24. Informacionin tatimor e kërkojnë me forcë që të jetë sa më i plotë edhe standardet ndërkombëtare te auditimit, dhe pikërisht Neni 20 "Auditimi tatimor", pika 1, i Deklaratës së Limës (e konsideruar Kushtetuta e institucioneve të auditimit të jashtëm shtetëror), që shprehet: "*Institucionet Supreme të Auditimit, kanë të drejtë të auditojnë mbledhjen e taksave sa me gjere qe te jete e mundur*".

Refuzimi kategorik i organeve tatimore për t'i dhënë KLSH informacion, është në kundërshtim dhe me kërkesat e Parimit 4 "Për një qasje të pakufizuar në informacion", të Deklaratës së Meksikos për Pavarësinë e Institucioneve Supreme të Auditimit, që thotë se:" *Institucionet Supreme të Auditimit duhet të kenë një qasje të drejtpërdrejtë dhe të lirë në të gjitha dokumentet dhe informatat e nevojshme, për kryerjen e duhur të përgjegjësive të tyre statutore*".

Auditimet e filluara nga ne gjatë këtyre pese viteve të fundit në organet tona tatimore, kanë dështuar pikërisht si rezultat i mosdhënies së këtij lloj informacioni. Organet e administratës tatimore, në interpretim të gabuar të detyrimit të tyre për ruajtjen e informacionit konfidencial, kanë zbatuar deri më sot një standard të dyfishtë, pasi këto informacione ia kanë kaluar strukturave të tyre të brendshme audituese, ndërsa ia kanë mohuar KLSH.

Për degradimin e raporteve organe tatimore-KLSH në vitet 2007-2009, si dhe për sjelljen e audituesve te KLSH në vitet e mëparshme 2005- 2011, natyrisht që nuk mbaj përgjegjësi dhe nuk mund te prononcohem për arsye etike, por duhet të theksoj se, në rast se që nga viti 2009 deri në tetor 2013, administrata jonë tatimore e justifikonte ligjërisht mosdhënien e informacionit të kërkuar nga ne, me Vendimin Nr. 98, datë 20.10.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë, tashmë çdo veprimi i tillë bie në kundërshtim të plotë me Vendimin Nr. 83, datë 20.10.2013 të po kësaj Gjykate. Krahas gjithë veprimtarisë së KLSH, për sjelljet dhe etiken e audituesve të institucionit mbaj dhe do të mbaj përgjegjësi të plote morale, ligjore dhe profesionale nga fillimi i vitit 2012 e me tej.

Rrjedhoje e keqkuptimit(nga disa) dhe e qëllimit "për të ruajtur" të paprekur administratën tatimore(nga disa të tjerë), deputetët në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave ishin të mendimit se neni 25 i projekt-ligjit të ri të KLSH, i cili ka të bëjë me të drejtën e KLSH për qasje të pakufizuar në të dhënat e institucionit që auditohet, duhet të reduktohet, pasi kjo qasje është në kundërshtim me Ligjin e Procedurave Tatimore dhe kërkesat e Ligjit mbi Sekretin Shtetëror. Megjithatë, ata vendosën t'i kërkojnë mendim Komisionit të Ligjeve të Kuvendit, për të qenë më të sigurtë në qasjen e tyre.

Theksojmë se, nëse Neni 25 i Ligjit të ri do të reduktohet, do të ndodhemi përpara një situate të rrezikshme, ku KLSH-së do t'i mohohet e drejta për të audituar ecurinë e të ardhurave kryesore të Shtetit, atyre tatimore. Janë mbi 700 milionë euro taksa të vjelura çdo vit nga organet tatimore(mesatarisht çdo vit mbi një të tretën e të ardhurave totale te Buxhetit te Shtetit), mbledhjen e të cilave, performancen e administratës tatimore, nuk po arrijmë ta auditojmë që nga viti 2009. Kjo duhet të jetë shqetësuese për të gjitha institucionet dhe forcat politike në Shqipëri.

Projekt-ligji i ri i Kontrollit te Larte të Shtetit ka njohur një punë intensive disavjeçare, me ekspertë të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit të Bashkimit Europian(DG-Budget, e cila mbulon dhe auditimin e jashtëm publik në vendet e BE-së) dhe të programit SIGMA(Mbështetje për Përmirësim në Qeverisje dhe Menaxhim) po të BE-se dhe OSBE-së. Pasi është marre miratimi i tyre si një draft ligj në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare INTOSAI të auditimit suprem publik, ne e dërguam në Kuvend për shqyrtim, në fund të muajit nëntor 2012.

Duam te falënderojmë Kryetarin e Kuvendit, z. Ilir Meta, per mbështetjen e veçante dhe te plote qe na dha, duke e shpluhurosur këtë projektligj, themeltar për ne, i cili priste prej afro një viti ne Kuvend. Projektligji i ri ka marrë mbështetje të gjerë nga deputetët e Komisionit për Ekonominë dhe Financat. Këtë e ndjemë gjatë gjithë kohës. Ne si KLSH, i falënderojmë ata për pozicionin e tyre konstruktiv. Falenderojme te gjithe anetaret e Komisionit për Ekonominë dhe Financat te Kuvendit, duke filluar nga Kryetari i Komisionit dhe relatori i Projektligjit, Erjon Braçe, deputetet Ridvan Bode, Anastas Angjeli, Florjon Mima, Dashamir Shehu, Edmond Spaho, Liljana Elmazi, Sherefedin Shehu, Paulin Sterkaj, Perparim Spahiu, Arben Çuko, Andrea Marto, Ervin Koçi, Albana Vokshi, Agron Çela, Jorida Tabaku, Evis Kushi, Ilir Xhakolli, Igli Cara, Majlinda Bufi, Blerina Gjylameti, Pjerin Ndreu, Gjovalin Kadeli, për mendimet, propozimet që sollën disa prej tyre, si dhe për qëndrimin tejet pozitiv të të gjithëve ndaj KLSH-së, pavarësisht debatit për çështjen e sipërcituar, e cila besoj se do të zgjidhet mbështetur në Kushtetutën e vendit dhe standardet ndërkombëtare të auditimit, veçanërisht Deklaratat e Limës dhe Meksikos.

Duke u kthyer tek qëllimi i këtij shkrimi dhe tek rikonfirmimi se:

Jo!, KLSH nuk kërkon të auditojë subjektet private!, dua te shtoj dhe një pyetje për diskutim: në rast se KLSH do të pengohet me ligj të auditojë administrimin tatimor për procesin e mbledhjes së të ardhurave, cili organ i jashtëm publik do ta audiojë këtë proces? Apo, me vullnet epror, administrata tatimore, drejtuesit e saj duhen konsideruar të paprekshëm, të pakontrollueshëm nga askush? Dhe ne duhet të shkojmë kundër standardeve ndërkombëtare në çështjen e auditimit të autoriteteve tatimore?!

Dëshiroj t'i mbyll këto rreshta me këndvështrimin e z. Robert Gielisse, Drejtor i Njësisë së Kontrollit të Brendshëm Publik në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit (DG-Budget) në Komisionin Evropian, përmbajtur ne nje leter drejtuar KLSH-se dy dite me pare: " *Komisioni Evropian i jep rëndësi të madhe reformave aktualisht në proces në sektorin publik në Republikën e Shqipërisë. Reformat Kontrollit te Brendshem Publik Financiar synojnë të rrisin*

efektivitetin e mbrojtjes së interesave financiare të Republikës së Shqipërisë dhe DG-Budget njeh si plotësisht thelbësor rolin e Institucionit Suprem të Auditimit të Shqipërisë (KLSH) ne kete drejtim."..." ***Ne jemi të mendimit se duke kufizuar qasjen e pakufizuar në informacion të KLSH-së, sikurse është propozuar tani, do të shkohet në mënyrë të qartë kundër standardeve ndërkombëtare, në çështjen e informacionit të mbajtur nga autoritetet tatimore. Neni 20 i Deklaratës së Limës është shumë i qartë:*** *një SAI (pra një KLSH - shënim i perkth.) është i autorizuar për të kryer në thellësi auditimet ne tatime, duke përfshirë shqyrtimin e dosjeve individuale ... Palët e interesuara duhet të mos kenë shqetësime në lidhje me konfidencialitetin qe ruajnë KLSH-të, pasi është rregull i INTOSAI-t ta marrë atë parasysh, duke përfshirë një Kod të detyrueshëm të Sjelljes për të mbrojtur konfidencialitetin e informacionit në lidhje me individët, i kufizuar në përdorim nga kërkesa penale.* ***Është e rëndësishme të nënvizohet që qasja e pakufizuar në informacion është një aspekt themelor i pavarësisë funksionale të një Institucioni Suprem Auditimi (SAI/KLSH-je , e cila është thelbësore për ta lejuar SAI-n të bëjë punën e tij në mënyrën më efektive, në mbrojtje të interesave financiare të Shtetit".***

CENIMI ME LIGJ I SË DREJTËS SË KLSH-së PËR INFORMACION DO TË ISHTE REGRES

Botuar në Gazetën "Shqiptarja.com", më 6 prill 2014

Projektligji i ri për KLSH ka ardhur si kërkesë e kohës për të modernizuar auditimin e jashtëm publik në Shqipëri, por edhe si plotësim i rekomandimeve të Komisionit Evropian në Progres-Raportet e tij për Shqipërinë në vitet e fundit, duke filluar nga viti 2008 e deri në vitin 2013. Projektligji bazohet plotësisht në standardet ndërkombëtare të INTOSAI-t, përkatësisht në Deklaratën e Limës (Nenet 5, 6, 7, 10, 11 dhe 20) dhe në Deklaratën e Meksikës (Parimet 3, 4 dhe 8) për pavarësinë e institucioneve të auditimit të jashtëm publik.

Nëse ai miratohet nga Kuvendi sipas draftit të paraqitur nga KLSH dhe të rënë dakord me Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit (DG-Budget) të BE-së dhe me programin SIGMA të BE dhe OSBE-së, ligji rregullon përfundimisht pavarësinë e institucionit dhe konceptimin modern të të drejtave dhe detyrave të KLSH-së. Kjo nismë ligjore sjell pavarësi të plotë të institucionit, si institucionet homologe evropiane, rritjen e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të institucionit, saktësimin e së drejtës së KLSH-së për të audituar fondet e akorduara nga BE-ja për Shqipërinë, deri tek përfituesi përfundimtar, përcaktimin e së drejtës për të hartua opinion mbi llogaritë financiare të institucionit të audituar, si dhe certifikimin e vetë audituesve. Duke qenë të gjithë të ndërgjegjshëm se me një ligj të ri modern dhe evropian për KLSH-në, ndihmojmë vendin në rrugën e tij të integrimit në BE, jam i bindur se asnjë nga deputetët e Kuvendit të Shqipërisë nuk do të donte ta shmangte këtë ligj nga standardet ndërkombëtare të INTOSAI, duke e bërë të papranueshëm për Komisionin Evropian, si dhe për të gjithë EUROSAI-n, komunitetin e SAI-ve (institucione homologe me KLSH-në) europiane.

Ecuria e deritanishme e konsultimeve në Kuvend për projektligjin ka qenë shumë e mirë. Mirëpo, në diskutimet në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave dhe në prezantimin e projektligjit në Komisionin e Ligjeve në javët e shkuara (dua me këtë rast të falënderoj të gjithë deputetët e Komisioneve për qëndrimin e tyre konstruktiv dhe mirëdashës ndaj KLSH), ndërsa deputetët ishin të kthjellët për pavarësinë financiare dhe pati një prekje të lehtë të pavarësisë organizative të institucionit, e drejta e KLSH për qasje të pakufizuar në informacion u prek rëndë. Për të qenë të sinqertë, kufizohet e drejta e KLSH për të mbledhur çdo informacion të nevojshëm, me qëllimin *"jo të mirë"* për të ruajtur tatimet dhe administratën tatimore. Nëse këto cenime do të ruhen deri në variantin përfundimtar, gjykoj do të ishte më mirë të mbanim ende në fuqi ligjin e vjetër të vitit 1997, i cili të paktën të drejtën për akses në informacion të KLSH-së nuk e kufizon dhe e ruan të paprekur pavarësinë e tij organizative.

Duhet të kuptojmë të gjithë se ky projektligj bëhet shumë lehtë i papranueshëm, jo vetëm për ne, por edhe për Bashkimin Evropian dhe të gjithë komunitetin e institucioneve të auditimit të jashtëm publik, në rast se cenohet pavarësia e institucionit, e drejta e tij për të marrë informacion dhe pavarësia organizative. Kjo e drejtë dhe kjo pavarësi, e sanksionuar në Deklaratën e Limës (e konsideruar si Kushtetuta e institucioneve të auditimit të jashtëm publik) dhe në Deklaratën e Meksikos, por edhe në Direktivat e Këshillit të Evropës të viteve 2006 dhe 2008, për auditimin statutor, është e shenjtë për SAI-t e zhvilluara evropiane dhe kudo në botë. Kjo e ka shtyrë Organizatën e Kombeve të Bashkuara që në 22 dhjetor 2011 të miratojë Rezolutën A/66/442 *"Mbi Pavarësinë e Institucioneve të Auditimit të Jashtëm Publik (SAI)",* duke njohur se *"Institucionet e auditimit të jashtëm publik mund të kryejnë detyrat e tyre objektivisht dhe në mënyrë efektive, vetëm nëse ato janë të pavarura dhe janë të mbrojtura nga ndikimi i jashtëm"*. Kjo Rezolutë i angazhon të gjitha Parlamentet e vendeve anëtare të punojnë për ruajtjen dhe forcimin e pavarësisë së SAI-ve. Nga ana e tij, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, z. Ban Ki Mun, në përshëndetjen e tij drejtuar Kongresit të XXI-të të INTOSAI-t, të mbajtur në Pekin më 22 tetor 2013, ka theksuar se*:" Institucionet supreme të auditimit janë "watchdog"*, roje besnike që ndihmojnë për të nxitur përdorimin efiçient dhe efektiv të burimeve publike. Duke ruajtur të plotë pavarësinë e tyre, ato do të luajnë një rol kritik në mbështetje të zbatimit të axhendës së re të Kombeve të Bashkuara për zhvillim të qëndrueshëm, që mbështetet mbi qeverisjen e mirë, transparencën, përgjegjshmërinë dhe financat inovative".

Ne si KLSH, gjykojmë se kërkesa për të kufizuar të drejtën tonë për informacion është një keqkuptim. Si institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik dhe financiar në vend, ne gëzojmë me Kushtetutë të drejtën për të audituar mënyrën se si arkëtohen të ardhurat publike dhe si kryhen shpenzimet.

Dihet nga të gjithë, edhe nga nxënësit e shkollave të mesme, se Buxheti i Shtetit ka dy kolona kryesore, të ardhurat dhe shpenzimet. Zëri kryesor i të ardhurave buxhetore janë të ardhurat e siguruara nga administrata tatimore.

Është e paimagjinueshme të kërkohet të pengohet auditimi i mënyrës se si arkëtohen të ardhurat tatimore, duke i kufizuar KLSH-së qasjen në informacionin e organeve tatimore. Ne kërkojmë të auditojmë vlerësimin tatimor, i cili kryhet nga administrata tatimore dhe nuk kërkojmë të auditojmë vetëdëklarimin tatimor, i cili kryhet nga tatimpaguesit privatë. Në diskutimet në Komisionet e Kuvendit, deputetëve të nderuar ju kam bërë pyetjen: Nëse nuk do ta auditojë KLSH administratën tatimore për veprimtarinë e saj, për vlerësimin tatimor, atëherë kush do ta auditojë këtë administrim për mbledhjen e të ardhurave tatimore, aq shumë të rëndësishëm për Buxhetin e Shtetit? Apo do të qëndrojë si "lule mos më prek"?! Nëse po, përse?!

Kështu si ne, gjykon edhe Bashkimi Evropian dhe SIGMA. Në letrën e tij të datës 28 mars 2014, drejtuar KLSH, z. Robert Gielisse, Drejtor i Njësisë së Kontrollit të

Brendshëm Publik në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit (DG-Budget) në Komisionin Evropian, thekson se "*Ne jemi të mendimit se, duke kufizuar qasjen e pakufizuar në informacion të KLSH-së, sikurse është propozuar tani, do të shkohet në mënyrë të qartë kundër standardeve ndërkombëtare, në çështjen e informacionit të mbajtur nga autoritetet tatimore*". Në letrën e tij dërguar KLSH-së më 1 prill 2014, z. Joop Vrolijk, Këshilltar i Lartë i Programit SIGMA-s të BE-së dhe OSBE-së për mbështetje në qeverisje dhe menaxhim, shprehet se *"Ligji i ri do të jetë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Parime të rëndësishme, të tilla si pavarësia funksionale, operacionale dhe administrative e KLSH, një mandat i gjerë, duke përfshirë auditimin e të gjitha shpenzimeve dhe të ardhurave të organizatave të caktuara të sektorit publik, si dhe qasja në informacionin e këtyre organizatave, janë të garantuara. Ne presim që karakteri plotësisht në përputhje me INTOSAI-n i draftit të ri të Ligjit të KLSH me amendimet e propozuara, nuk do të rrezikohet nga kufizime në këto parime"*.

INTOSAI, organizata ndërkombëtare e institucioneve të auditimit të jashtëm publik (INTOSAI), është e qartë dhe kategorike në mbrojtjen e pavarësisë së plotë të SAI-ve. Sikurse e ka theksuar Dr. Josef Moser, Sekretari i Përgjithshëm i INTOSAI-t, në Simpoziumin e përbashkët OKB-INTOSAI, të zhvilluar në Vjenë në mars 2013, *"Pavarësia e një institucioni të auditimit të jashtëm publik nënkupton ruajtjen e plotë të pavarësisë financiare, organizative dhe vepruese të tij, si kushte "sine kua non" të ekzistencës dhe dobishmërisë së tyre për qytetarët"*.

Pavarësisht debatit për çështjen e aksesit në informacion të KLSH dhe pavarësisë organizative të tij, apo edhe batutave reciproke, dua sërish të falënderoj deputetët e Kuvendit, si të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave dhe atij të Ligjeve, për qëndrimin e tyre konstruktiv deri tani.

Shpreh bindjen se projektligji i ri do të miratohet në Kuvend, i mbështetur plotësisht në Kushtetutën e vendit dhe në standardet ndërkombëtare të auditimit, veçanërisht në Deklaratat e Limës dhe Meksikos.

Në vend të mbylljes, dua të sjell në vëmendjen e opinionit tonë publik sigurinë e qasjes së pakufizuar në informacion të audituesve statutorë (audituesve të Bashkimit Europian, si Gjykatës Europiane të Audituesve në Luksemburg, ashtu dhe institucioneve supreme të auditimit të shteteve anëtare të BE-së), të dhënë nga Direktiva të veçanta të Këshillit të Europës.

Projektligji ynë duhet të shërbejë si një hap përpara për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian (këtë këndvështrim do ta shtjelloj, së bashku me direktivat e BE-së, në prezantimin e projektligjit në Komisionin e Integrimit të Kuvendit, dhe më tej në një shkrim tjetër në media). Ai nuk duhet kurrsesi të jetë një regres në të drejtën kushtetuese të KLSH-së për auditim dhe informacion për realizimin e auditimeve, me qëllimin jo të mirë për të ruajtur disa institucione të paprekura nga auditimi i jashtëm publik, pra për të dëmtuar transparencën, llogaridhënien dhe kontributin për mirëqeverisje.

DETYRIMET E MSA-SË DHE LIGJI I RI I KLSH-SË

Botuar në Gazetën "Koha jonë", më 8 prill 2014

Projektligji i ri për KLSH-në përfshin konceptet bashkëkohore të auditimit në kontrollin e jashtëm publik të vendit, zgjeron gamen e auditimeve me auditime të reja të përfshira në ligj, si ato të performancës, të përdorimit të fondeve të BE-së, të teknologjisë së informacionit, lejon dhënien e opinionit për llogaritë e Shtetit, forcon pavarësinë e institucionit kushtetues të KLSH-së dhe certifikon audituesit e tij. Por ai mund të kthehet shumë shpejt dhe lehtë në një histori dështimi dhe të dëmtimi të interesave të integrimit evropian të Shtetit shqiptar, nëse cenohet pavarësia e KLSH-së.

Vendi ynë, ka një angazhim madhor për të respektuar, Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (MSA) me Bashkimin Evropian. Neni 90-të i MSA-së thekson se: *"Palët bashkëpunojnë në mënyrë të veçantë për të zhvilluar sisteme të auditimit të jashtëm në Shqipëri, në përputhje me standardet dhe metodologjitë e pranuara botërisht, si edhe me praktikat më të mira të BE-së".*

Në rast se këto standarde të pranuara botërisht dhe praktikat më të mira të BE-së, shkelen me ligjin e ri për KLSH-në, kapitulli i 32-të i Progres-Raportit të BE-së për Shqipërinë, i cili fokusohet në katër fusha:

- në fushën e kontrollit financiar të brendshëm publik;
- në fushën e kontrollit të jashtëm publik;
- në fushën e mbrojtjes së interesave financiare të BE-së;
- në fushën e mbrojtjes kundrejt falsifikimit të euros.

as nuk hapet, as edhe mbyllet nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit e Komisionit Evropian (DG-Budget). Ky kapitull është themeltar në sigurimin e përgjegjshmërisë maksimale për administrimin e fondeve publike të një vendi anëtar kandidat dhe potencialisht kandidat për në BE. Komisioni Evropian frenon vlerësimin e tij për një vend, në rast se ky Kapitull nuk funksionon. Drejtoria përkatëse që përpunon këtë Kapitull në Komisionin Evropian, DG-Budget, në letrën e saj të datës 28 mars 2014, drejtuar KLSH-së, shprehet: *"Duhet të mbahet parasysh se një ligj i KLSH-së në përputhje me standardet INTOSAI, është një nga kërkesat themelore të Kapitullit 32 të Marrëveshjes së Stabilizim- Asocimit Shqipëri-BE, e cila duhet plotësuar".* Këto kërkesa eksplicite të nenit 90-të të MSA-së dhe të Kapitullit 32 të Progres-Raporteve të Bashkimit Evropian për vendet kandidate dhe potencialisht kandidate për anëtarësim në BE, kanë rrezik të shkelen dhe neni të mos zbatohet prej nesh, në rast se projektligji i ri për KLSH-në, i paraqitur në Kuvend, miratohet me disa ndryshime të propozuara në Komisionin e Ekonomisë, që nuk e bëjnë këtë projektligj të jetë në përputhje me standardet dhe metodologjitë e pranuara botërisht, si edhe me praktikat më të mira të BE-së.

Duhet të kuptojmë se për Bashkimin Evropian nuk ka kuptim dhe rëndësi një ligj thjesht i ri për KLSH-në, por një ligj në përputhje të plotë me standardet e pranuara botërisht, që janë standardet e organizatës botërore të institucioneve të auditimit të jashtëm publik, e quajtur INTOSAI dhe që zbatohen rigorozisht nga Gjykata Evropiane e Audituesve (KLSH-ja e Bashkimit Europian) dhe nga të gjitha institucionet homologe të KLSH-së të vendeve anëtare, qofshin zyra kombëtare auditimi, gjykata auditimi apo gjykata të llogarive. Sa herë BE-ja ka kërkuar amendime për ligjin e KLSH-së (dhe ka nisur ta bëjë këtë që 6 vite më parë, pra qysh në vitin 2008), rekomandimi ka qenë gjithnjë që ligji të amendohet, për të qenë tërësisht në përputhje me standardet e INTOSAI-t. Ky rekomandim është përsëritur shtatë herë radhazi, deri në Progres-Raportin e vitit 2013. Në Progres-Raportin e vitit 2012 për Shqipërinë, BE thekson:"...Pas disa vitesh në pezullim, janë përgatitur dhe janë dërguar për procedurën e miratimit draft-amendimet e ligjit të SAI-t, për ta sjellë në përputhje të plotë me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve të Kontrollit të Lartë (INTOSAI) (faqe 66, fragmenti i parë). Kurse në Progres-Raportin e vitit 2013 për Shqipërinë, sërish theksi është tek ligji i ri për KLSH-në : "*... Në fushën e auditimit të jashtëm, janë ndërmarrë ndryshime organizative dhe procedura të reja për të rritur eficencën e Kontrollit të Lartë i Shtetit (KLSH) ... Megjithatë, ndryshimet në ligjin për KLSH-në janë duke u shqyrtuar në Parlamenti që në vitin 2012 dhe mbetet të miratohen me shumicë 3/5.. ... Nevojitet miratimi i ndryshimeve në Ligjin për KLSH-në. Në tërësi, përgatitjet kanë avancuar në masë të moderuar*(faqe 56, fragmenti i shtatë dhe faqe 57, fragmenti i tretë)*"*.

Por nuk janë vetëm Progres-Raportet e Komisionit Evropian që kanë kërkuar me forcë një ligj bashkëkohor dhe në përputhje të plotë me standardet e INTOSAI-t, që të garantojë pavarësinë e KLSH-së. Vetë dokumenti themelor i Bashkimit Evropian, Traktati mbi Funksionimin e BE-së, i 1 dhjetorit 2009 dhe në mënyrë specifike, neni 287 i tij, rregullon pavarësinë e plotë, qasjen e pakufizuar në informacion dhe kompetencat e Gjykatës Evropiane të Audituesve. Më konkretisht, po citoj fragmente nga Pjesa e Gjashtë *"Dispozitat institucionale dhe financiare"* e nenit 287:

"*1. Gjykata Evropiane e Audituesve ekzaminon llogaritë dhe të gjitha të ardhurave e shpenzimet të Bashkimit. Ajo ekzaminon gjithashtu llogaritë e të gjitha të ardhurave dhe shpenzimeve të të gjithë trupave, zyrave apo agjencive të krijuara nga Bashkimi në masën që instrumenti relevant përbërës nuk pengon një shqyrtim të tillë.*

Auditimi bazohet në të dhënat dhe nëse është e nevojshme, kryhet në vend në institucionet e tjera të Bashkimit, në mjediset e çdo trupi, zyre apo agjencie që menaxhon të ardhurat ose shpenzimet në emër të Bashkimit dhe në Shtetet Anëtare, përfshirë në mjediset e çdo personi fizik apo juridik që merr pagesa nga buxheti.

Institucionet e tjera të Bashkimit, çdo trup, zyrë ose agjenci që menaxhon të ardhurat ose shpenzimet në emër të Bashkimit, çdo person fizik apo juridik (natural or legal person) që pranon pagesa nga buxheti

dhe organet kombëtare të auditimit ose, nëse këto nuk kanë kompetencat e nevojshme, departamentet kompetente kombëtare, i dërgojnë Gjykatës së Auditimit, me kërkesën e saj, çdo dokument apo informacion të nevojshëm për të kryer detyrën e saj."

Sikurse vihet re nga fragmentet e mësipërme, neni 287 përmend qasjen e pakufizuar në informacion gjatë auditimit, si praktikë e zbatuar gjerësisht në BE. Gjykata Evropiane e Audituesve, në bazë të këtij neni, mund të auditojë madje edhe shpenzimin e parave në vend (në terren) me përfituesit e fundit (p.sh. fermerët privatë) të subvencioneve të BE-së, por ajo auditon njëkohësisht dhe në thellësi edhe mbledhjen e TVSH-së, të ardhurës kryesore tatimore në vendet e BE-së. Në direktivën nr. 85 të vitit 2011 të BE-së, të datës 8 Nëntor 2011, "*Mbi kërkesat për kufizimet buxhetore të Shteteve Anëtare",* Komisioni Evropian u kërkon vendeve anëtare që në raportimin mbi të dhënat kombëtare mbi defiçitet buxhetore dhe të ardhurat fiskale e shpenzimet e qeverive, në Kapitullin 6, Neni 6, ku përmendet cilësia dhe formati i të dhënave, të përfshihet edhe një analizë e pavarur dhe e besueshme, e kryer nga njësi të pavarura auditimi, si Gjykatat e Llogarive dhe njësi që gëzojnë pavarësi funksionale ndaj autoriteteve fiskale të Shteteve Anëtare. Ndërsa Direktiva 2006/43/EC e Parlamentit Europian dhe e Këshillit të Europës, e 17 Majit 2006, *"Mbi auditimet statutore të llogarive vjetore dhe llogarive të konsoliduara"*, e amenduar më vonë me Direktivën 2008/30/EC, të 11 Marsit 2008, shprehet se "*të gjitha auditimet duhet të kryhen në bazë të standardeve ndërkombëtare të auditimit".* Pavarësia e audituesve është një nga kërkesat më thelbësore të kësaj direktive. Në bazë të këtyre direktivave dhe të legjislacioneve kombëtare, në dijeninë tonë, në të gjitha ligjet organike të institucioneve supreme të auditimit të Europës, të formës zyrë kombëtare auditimi, gjykatë auditimi apo gjykatë llogarish, qasja e SAI-t në informacionin e administruar nga administrata tatimore nuk kufizohet. Këtë nuk e themi vetëm ne, por e thotë qartë një program si SIGMA-s, me eksperiencë të pasur disa dhjetë-vjeçare në vlerësimin e auditimit të jashtëm publik në shumë vende të Evropës.

Në letrën e saj dërguar KLSH-së më 1 prill 2014, SIGMA, programi i njohur tek ne i BE-së dhe OSBE-së për mbështetje në qeverisje dhe menaxhim, shprehet se *"Parime të rëndësishme, të tilla si pavarësia funksionale, operacionale dhe administrative e KLSH-së, një mandat i gjerë, duke përfshirë auditimin e të gjitha shpenzimeve dhe të ardhurave të organizatave të caktuara të sektorit publik, si dhe qasja e pakufizuar në informacionin e këtyre organizatave, duhet të jenë të garantuara... Në përvojën tonë me institucione të tjera supreme të auditimit në përputhje me INTOSAI-n, nuk kemi njohur precedentë të kufizimeve të parimeve të mësipërme".*

Procesi i përgatitjeve për këtë projektligj, përgatitje të nisura që në vitin 2010, ka njohur një monitorim rigoroz dhe kujdes parësor nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit të Komisionit Evropian (DG-Budget) dhe programit SIGMA-s të BE dhe OSBE-së. Vetëm në fund të vitit 2012, me letrën me nr. reference 2012-1354284, datë 16 nëntor 2012, erdhi miratimi nga ana e DG-Budget se projektligji është i gjithi në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare të INTOSAI-t. Në të theksohet se :

"Sipas mendimit tonë, versioni që na është dorëzuar më 15 nëntor 2012, marrë në lidhje me dispozitat e aplikueshme të Kushtetutës së Shqipërisë, mund të konsiderohet si në përputhje të plotë me parimet, standardet dhe udhëzimet e INTOSAI-t, duke përfshirë Deklaratat e Limës dhe të Meksikos".

Sapo erdhi kjo garanci, ne e dërguam projekt-ligjin për shqyrtim në Kuvend. Ndryshimi kryesor i propozuar nga Komisioni i Ekonomisë është që KLSH-së t'i mohohet aksesi në të dhënat e administratës tatimore për dosjet individuale të tatimpaguesve, me justifikimin se qasja e pakufizuar e KLSH-së në të dhënat e organeve tatimore, mund të dëmtojë interesat e tatimpaguesve privatë. Cenimi i së drejtës së KLSH-së për informacion është shkelje e standardeve themelore të INTOSAI-t, i Deklaratës së Limës dhe Deklaratës së Meksikos. Konkretesh cenohen nenet 4, 10 dhe 20 të Deklaratës së Limës dhe kërkesat e Parimit 4 *"Për një qasje të pakufizuar në informacion"*, të Deklaratës së Meksikos për Pavarësinë e Institucioneve Supreme të Auditimit, në të cilën theksohet se: *"Institucionet Supreme të Auditimit duhet të kenë një qasje të drejtpërdrejtë dhe të lirë në të gjitha dokumentet dhe informatat e nevojshme, për kryerjen e duhur të përgjegjësive të tyre statutore"*. Në bazë të standardeve tona profesionale të INTOSAI-t, por edhe të eksperiencave evropiane të sipërcituara, ne gjykojmë se kufizimi i së drejtës për qasje të pakufizuar në informacion i KLSH-së, në auditimin e administratës tatimore, është një keqkuptim. Ai madje rrezikon të krijojë moszbatueshmëri të vetë ligjit të ri për KLSH-në, që Kuvendi po përgatitet të miratojë. Sipas amendimeve të propozuara të ligjit të KLSH-së dhe të miratuara nga Komisioni për Ekonominë, KLSH-ja ka për të dhënë një opinion vjetor mbi llogaritë e Shtetit (Certifikimin e këtyre Llogarive). Në parim, llogaritë përbëhen nga deklaratat mbi shpenzimet dhe të ardhurat. Nëse KLSH-së nuk do t'i lejohet të auditojë të ardhurat kryesore (ato tatimore), atëherë institucioni nuk do të jetë në gjendje të japë një mendim për llogaritë e Shtetit për çdo vit që do të vijë. Kjo është antikushtetuese, sepse bie në kundërshtim me nenin 164 të Kushtetutës, në Piken 1 të të cilit përcaktohet se *"Kontrolli i Lartë i Shtetit i paraqet Kuvendit raport për zbatimin e Buxhetit të Shtetit"*. E si mund të paraqitet ky raport i plotë, kur KLSH-së i mohohet auditimi i mënyrës se si mblidhen të ardhurat kryesore të Buxhetit, të ardhurat tatimore?! Mos ndoshta fakti që ka me dhjetëra kompani të mëdha që rezultojnë me humbje dhe nuk kontribuojnë për Shtetin, nuk duhet të përbëjë një shqetësim për KLSH-në?

Ne duhet të auditojmë nëse Ministria e Financave i ka marrë masat e mjaftueshme për të luftuar korrupsionin brenda zyrave të taksave dhe administratës tatimore qendrore. Sikurse e dini fare mirë, nëpunësit tatimorë mund të joshen për të pranuar deklarata tatimore, të cilat janë të pasakta, nëse ata mund të përfitojnë prej këtyre deklaratave. Ministria e Financave është sigurisht e vetëdijshme për këtë rrezik dhe bën analizën e saj të riskut dhe zbaton një politikë të luftës kundër korrupsionit. Ne kemi për detyrë ta auditojmë këtë analizë risku dhe këtë politikë se sa efiçiente është. Për këtë mund të përdorim paketën IntoSAINT të Gjykatës së Auditimit të Holandës, e cila përdoret gjerësisht nga SAI-t evropiane dhe më tej në botë, për të analizuar se ku janë dobësitë

(rreziqet për korrupsion) edhe në sistemin e mbledhjes së taksave. Me të, mund të kontribuojmë realisht në luftën kundër mashtrimit financiar dhe korrupsionit në administratën tatime, por këtë nuk do të mund ta bëjmë, nëse institucioni i KLSH-së do të ketë kompetenca të auditojë të ardhurat nga taksat.

Ky mohim i së drejtës së institucionit për të analizuar mënyrën e mbledhjes së të ardhurave kryesore buxhetore, do të ndodhë, në kohën kur Direktiva Nr. 85 e Bashkimit Evropian e vitit 2011 *"Mbi kërkesat për kufizimet buxhetore të Shteteve Anëtare",* në kapitullin e katërt, në nenin 6 të saj, përmend cilësinë dhe formatin e të dhënave numerike mbi rregullat fiskale (niveli i deficitit dhe i buxhetit të vendeve anëtare) dhe përcakton *: "Pa paragjykim për pavarësinë e parashikuar nga nenet 290-291 dhe 317-319 të Traktatit mbi Funksionimin e BE-së, në lidhje me aparatin ligjor mbikëqyrës të Bashkimit Evropian, raportimi numerik i rregullsisë fiskale të vendeve specifike duhet të ketë specifikime në elementet e mëposhtëm:*

- *Përcaktimin e qëllimit dhe qëllimin e rregullave;*
- *Monitorimin efektiv dhe në kohë të përputhshmërisë me ligjet, të bazuar në një analizë të pavarur dhe të besueshme të kryer nga njësi të pavarura auditimi dhe njësi që gëzojnë pavarësi funksionale ndaj autoriteteve fiskale të Shteteve Anëtare;*
- *Informacionin mbi konsekuencat, në rastet e mospërputhshmërisë".*

Kështu, vetë Bashkimi Evropian dhe Komisioni Evropian u kërkojnë vendeve anëtare që të dhënat për deficitin, të ardhurat fiskale dhe shpenzimet qeveritare të kenë gjithashtu të bashkangjitur dhe rezultatet e auditimeve nga monitorues të jashtëm. Sipas specifikimeve të Direktivës, këto institucione janë njësitë supreme të auditimit, që gëzojnë mundësi funksionimi të pavarur nga Administrata Shtetërore.

Ne si KLSH, në asnjë rast nuk do të donim të auditonim kompanitë apo personat privatë. Kjo shkon kundër standardeve tona profesionale, kundër etikës sonë dhe nuk do ta bëjmë kurrë! Sigurisht, në qoftë se ka dyshime të evazionit dhe korrupsionit me taksa, KLSH duhet të jetë në gjendje t'i auditojë këto raste dhe pastaj të dorëzojë dosjet me gjetjet e tij në Prokurori. Por këto janë kryesisht raste të jashtëzakonshme.

Roli i KLSH-së nuk është shqyrtimi i sjelljes fiskale të firmave apo personave private dhe ne nuk do ta bëjmë atë. Por, si institucioni publik më i lartë audites në vend, KLSH-ja gëzon me Kushtetutë të drejtën për të audituar mënyrën se si arkëtohen të ardhurat publike. Cenimi me ligj i të drejtës së pakufizuar të KLSH për informacion, do të përbënte një regres dhe jo hap përpara. Po mbi bazën e amendimeve të propozuara, KLSH-ja fiton të drejtën për të audituar zbatimin e fondeve të BE-së. Për Gjykatën Europiane të Audituesve, kjo do të ishte një situate e shkëlqyer, sepse ata pastaj mund të përdorin gjetjet e KLSH-së. Sigurisht, kjo mund të ndodhë, vetëm nëse KLSH ka të njëjtat kompetenca sikurse gëzon Gjykata Europiane e Audituesve, sipas nenit 287 të Traktatit mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian. Nëse KLSH mund të punojë së

bashku me Gjykatën Evropiane të Audituesve, atëherë KLSH-ja do të jetë në gjendje të mbrojë interesat shqiptare, në rast se institucioni provon se parregullsitë nuk ishin të qëllimshme dhe një korrigjim financiar nga ana e Gjykatës Europiane të Audituesve (ulje apo anulim i fondeve për Shqipërinë), për pasojë mund të reduktohet. Pra, është në interes të Shtetit tonë, Kuvendit dhe Qeverisë shqiptare që KLSH-ja të mund të punojë së bashku me Gjykatën Evropiane të Audituesve në të njëjtën bazë dhe të gëzojë të njëjtën qasje në informacion. Por me propozimet në Komisionin e Ekonomisë, kjo qasje mohohet. Cenimi në të drejtën tonë për qasje të pakufizuar në informacion, është aq i rëndë, sa nëse ai do të ruhej deri në variantin përfundimtar, do të ishte më mirë të mbanim ende në fuqi ligjin e vjetër të vitit 1997, i cili të paktën të drejtën për akses në informacion të KLSH-së nuk e kufizon. Dua ta theksoj se ai është në kundërshtim me të gjitha ligjet organike të institucioneve të auditimit të jashtëm publik të Evropës. Mjafton të marrim si shembull ligjin organik të Gjykatës së Auditimit të Holandës, që ka referim të plotë për qasjen e pakufizuar të kësaj gjykate në informacionin e administratës tatimore, apo edhe ligjin organik të Zyrës Shtetërore të Auditimit të Kroacisë, vend i pranuar në BE në vitin 2013, i cili ka një paragraf të plotë për të drejtën e kësaj Zyre të shqyrtojë dosjet individuale tatimore, për kryerjen e vlerësimit tatimor. Për të gjetur një shembull të ngjashëm të mohimit e së drejtës për auditim në tatime, duhet të shkojmë larg, në shtetin e Zimbabvesë, në legjislacionin e të cilit nuk lejohet që të auditohen dokumente të tilla, që janë subjekt i vendimmarrjes së Komisionerit të Tatimeve të çdo shume dhe çdo takse sipas Ligjit mbi Taksën e të Ardhurave [Kapitulli 23:06 i Ligjit mbi Auditimin Publik].

Jam i sigurt për qëndrimin konstruktiv të deputeteve të Komisioneve të Ekonomisë, Ligjeve dhe Integrimit, ku projektligji është paraqitur dhe po diskutohet. Shpreh bindjen se projektligji i ri do të miratohet nga Kuvendi, i mbështetur plotësisht në Kushtetutën e vendit, në standardet ndërkombëtare të auditimit të INTOSAI-t dhe në praktikat më të mira evropiane, në mënyrë që zbatimi i Nenit 90, shumë të rëndësishëm të MSA-së, të jetë një histori suksesi dhe jo dështimi, në përpjekjet tona për progres dhe integrim.

AUDITIMI KOMBËTAR TË VIHET NË SHËRBIM TË QEVERISJES KOMBËTARE

Botuar në gazetën "Ekonomia", dy numra, 16-17 tetor 2014

Ky shkrim është përmbledhje e Raportit të KLSH për Buxhetin Faktik 2013 (shihni në këtë libër faqet 104-138).

MENAXHIMI I FINANCAVE PUBLIKE DHE BE

Botuar në gazetën "Shqiptarja.com", më 28 dhjetor 2014

Sot, në të gjithë Europën, por edhe më gjerë në botë, me përjetimin e pasojave të rënda të krizës botërore ekonomike dhe financiare, menaxhimi i përgjegjshëm dhe efiçient i financave publike është bërë një domosdoshmëri dhe përparësi absolute e qeverisjes. Në koherencë me këtë kërkesë të FMN-së në Kodin e tij të Transparencës Fiskale dhe me sugjerimet e Bankës Botërore e institucioneve të tjera ndërkombëtare, është dhe Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike të Shqipërisë 2014-2020. Ajo synon krijimin e një sistemi efiçient dhe transparent, treguesit kyçë të të cilit janë promovimi i përgjegjshmërisë menaxheriale dhe fuqizimi i një sistemi kontrolli të brendshëm nga njësitë e qeverisjes lokale dhe qendrore, si dhe një auditim i pavarur, i brendshëm dhe i jashtëm. Kjo Strategji është në sinkron me standardin ISSAI 5220 të INTOSAI-t(standard i përkthyer në shqip dhe i botuar nga KLSH), ku në pikën 2.4 të tij, e cila lidhet me kredibilitetin e parashikimit fiskal dhe buxhetimit, kërkohet që "*Parashikimet ekonomike dhe fiskale të qeverisë dhe performanca e saj janë subjekt i vlerësimit të pavarur*", duke nënkuptuar një theksim të mëtejshëm të rolit të audituesit të jashtëm të pavarur si faktor determinat në drejtim të rritjes së transparencës fiskale, duke informuar publikun për performancën e qeverisë, jo vetëm përmes raportimit të Ministrit të Financave dhe qeverisë, por dhe përmes raportimit të audituesit të jashtëm publik të Shtetit.
KLSH si auditues i jashtem publik, është i gatshëm të rrisë rolin dhe kontributin në drejtim të miradministrimit të financave publike, në dy shtyllat e tyre, në krijimin e të ardhurave publike dhe në përdorimin, shpenzimin e tyre. Mendojmë se një auditim i plotë i krijimit dhe përdorimit të vlerave publike rrit transparencën dhe rrit vlerën e parasë publike. Sipas konkluzioneve të studimeve të kryera nga FMN, ekziston një lidhje pozitive mes transparencës me performancës fiskale. Sipas studimit "*Fiscal Transparency, Fiscal Performance and Credit Ratings"(Transparenca Fiskale, performance Fiskale dhe Vlresimi i Kredive),* 2012, kjo lidhje është më e fortë në vendet në zhvillim se sa në vendet e zhvilluara.
Ne, si auditues të Kontrollit të Lartë të Shtetit, përshëndesim mbështetjen e gjerë të akorduar nga Bashkimi Evropian, në nivel të 40 milionë eurove, të cilat do të disbursohen për një periudhë 3 vjeçare, në bazë të reformave të arritura në realizimin e kësaj strategjie. Roli i auditimit të jashtëm publik në performancën e duhur të strategjisë, është cilësuar si shumë i rëndësishëm, nga vetë përfaqësuesit e DG-Budget(Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit e Komisionit Evropian) dhe DG-Enlargement(Drejtoria e Përgjithshme për Zgjerimin). Miratimi më 27 nëntor 2014 nga Kuvendi i ligjit të ri të Kontrollit të Lartë të Shtetit, tërësisht në përputhje me standardet e INTOSAI-t, përkoi me miratimin e transhit të parë prej 14 milionë euro, të ndihmës së BE-së për realizimin e strategjisë. Sikurse e ka theksuar z. Christian Danielsson, Drejtor i Përgjithshëm për Zgjerimin i Komisionit Europian, që në korrik 2014 në Tiranë,"*Një menaxhim më i fortë i financave publike, transparenca në raportimet financiare dhe reformat në administrimin e taksave duhet të mbeten prioritet i qeverisë*".

Si KLSH jemi një nga shtyllat mbi të cilat mbështetet Strategjia 2014-2020 e menaxhimit të financave publike. Vetë strategjia afatmesme e zhvillimit e KLSH 2013-2017, e bazuar

në drejtimet strategjike të INTOSAI-t 2011-2016 dhe të EUROSAI-t 2011-2017, përqendrohet në rritjen e kapaciteteve audituese të institucionit, si dhe në modernizimin e kuadrit ligjor të tij, për një kontribut të shtuar në mirëqeverisje dhe në luftën kundër korrupsionit. Kjo strategji dhe vetë ligji i ri i KLSH, do të gjejnë zbatim intensiv dhe të thelluar, me mbështetjen edhe të Projektit të Binjakëzimit IPA 2013, që KLSH ka fituar nga BE, në vlerën 2.11 milionë euro.

Ia vlen të theksojmë se menaxhimi i financave publike në Shqipëri ka njohur përmirësime gjatë viteve të fundit. Megjithatë, progresi i deritanishëm ka qenë më shumë në aspektin teknik dhe ligjor, si ligji për auditimin e brendshëm në sektorin publik(viti 2007), ligji për inspektimin financiar publik(viti 2010), ligji për menaxhimin e sistemit buxhetor (viti 2008), ligji i prokurimeve publike, i ndryshuar (viti 2006), zbatimi i sistemit elektronik të thesarit, etj. Ndërsa puna e mirëfilltë kontrolluese dhe vlerësuese e menaxhimit të financave publike nga ana e auditimit të brendshëm, ka lënë për të dëshiruar. Tashmë, të gjithë veprimtarët e sistemit të financave publike dhe palët e interesit në Shqipëri dhe në BE, janë të ndërgjegjësuar se ende mbetet shumë për të bërë në forcimin e disiplinës së financave publike, të transparencës dhe llogaridhënies së tyre. Shqipëria renditet e 116-ta nga 177 vende, në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit të "Transparency International" duke marrë 31 pikë nga 100 të mundshme. Pika më e dobët për ne mbetet integriteti i financave tona publike, pra mundësia e lartë për kryerjen e mashtrimit financiar dhe korrupsionit. KLSH është e angazhuar të kryejë auditimin e integritetit, formën më të re të auditimit, nëpërmjet paketës INTOSAINT të Gjykatës Holandeze të Auditimit, e cila që nga viti 2012 po përdoret gjerësisht në institucionet e auditimit suprem kudo në botë, për të rritur integritetin e tyre dhe të institucioneve publike që auditojnë

Nga ana e tij, Bashkimi Evropian po ndihmon me zbatimin e një projekti të ri për modernizimin e menaxhimit financiar në Shqipëri dhe sistemin e kontrollit dhe inspektimit të financave publike në vend. Ky projekt financohet po në kuadrin e IPA II dhe synon të kontribuojë për një përdorim të dobishëm, efektiv, transparent e me përgjegjësi të fondeve publike, duke sjellë përvojën e përparuar austriake dhe franceze të inspektimit dhe auditimit të brendshëm. Rëndësinë e këtij projekti e ka vlerësuar edhe Këshilltari Kryesor i Drejtorit të Përgjithshëm të DG-Budget, z. Robert Gielisse në lançimin e projektit në 28 tetor 2014 në Tiranë, duke u shprehur se "... *implementimi i sistemit modern të menaxhimit financiar në institucionet publike lokale dhe qëndrore në Shqipëri, do të mbështetet në praktikat më të mira të zbatuara në vendet e BE-së*". Projekti do të mbështesë zbatimin e Strategjisë 2014-2020 për forcimin dhe modernizimin e financave publike, duke vënë theksin në forcimin e kontrollit të brendshëm, të llogaridhënies dhe të auditimit të brendshëm, si shtyllat kryesore për një planifikim dhe zbatim efiçient të Buxhetit të Shtetit, për të fituar stabilitet makroekonomik.

Duke synuar bashkërisht forcimin e kontrollit mbi financat publike dhe një auditim cilësor e sipas standardeve ndërkombëtare, si të brendshëm ashtu dhe të jashtëm publik, gjykojmë se Strategjia 2014-2020 e qeverisë për menaxhimin e financave publike dhe strategjia e zhvillimit e KLSH 2013-2017, si dhe projekti IPA II i Ministrisë së Financave dhe ai i KLSH, janë në përputhje të plotë me njeri-tjetrin. Si institucion kushtetues dhe të ndërgjegjshëm për rolin tonë në mirëqeverisje, të bindur se

mirëqeverisja e lufta efektive ndaj korrupsionit, mund të arrihen vetëm me punë në sistem e me krijimin e sinergjive, jemi të gatshëm të rrisim bashkëpunimin dhe partneritetin, si me qeverinë, ashtu dhe me institucionet e tjera të pavarura dhe me shoqërinë civile

Gjithnjë e kemi parë praninë dhe kontributin tonë në sistemin e menaxhimit të financave publike, tashmë në Strategjinë 2014-2020 dhe në projektin e mbështetur nga BE, si diçka të natyrshme dhe në zbatim të misionit dhe mandatit tonë kushtetues. Në të gjitha raportet tona për zbatimin e Buxhetit të konsoliduar të Shtetit për vitet 2011, 2012 dhe 2013, kemi theksuar shtimin e rolit dhe modernizimin e strukturave dhe të aftësive profesionale të audituesve të brendshëm, duke dhënë rekomandimet përkatëse, në bazë të auditimeve tona. Sipas Standardit ISSAI 9540 "Për bashkëpunimin mes auditimit të jashtëm dhe atij të brendshëm publik", në maj 2012 kemi marrë nismën dhe kemi lidhur marrëveshjen e Bashkëpunimit me Ministrinë e Financave, e cila parashikon trajnime të përbashkëta të audituesve të KLSH dhe audituesve të brendshëm, shkëmbimin e informacionit për auditimet e kryera, si dhe të planeve të auditimit, me qëllim shmangien e dublimit të punës audituese dhe rritjen e kapaciteteve audituese. Shpresojmë që me ekipin e sotëm në Ministrinë e Financave, të mund të bashkëpunojmë me efektshmëri, për zbatimin konkret të kësaj marrëveshjeje, në dobi të forcimit të menaxhimit dhe displinës së financave publike të vendit.
Nën moton e organizatës ndërkombëtare të institucioneve supreme të auditimit, INTOSAI "*Experentia mutua Omnibus prodest* (Eksperienca e përbashkët u shërben të gjithëve)" dhe drejtimin e dhënë nga Kongresi INCOSAI 21, i zhvilluar në Pekini në tetor 2013 që "Auditimi kombëtar të vihet në shërbim të qeverisjes kombëtare", në Raportin për zbatimin e Buxhetit të konsoliduar të Shtetit për vitin 2013, i kemi propozuar Kuvendit dhe jemi të gatshëm të marrim pjesë që në fazat fillestare të përgatitjes së Buxhetit të Shtetit për vitin pasardhës, me qëllim rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së financave publike. Këtë e bëjnë shumë institucione simotra në vendet e Bashkimit Evropian dhe jemi të gatshëm të angazhohemi edhe ne, në zbatim edhe të ligjit tonë të ri organik. Ky ligj është përshëndetur dhe vlerësuar nga Delegacioni i BE-së në Tiranë dhe nga DG-Budget, si tërësisht në përputhje me standardet e INTOSAI-t. Ai na pajis, njëlloj si vetë këto standarde, me dijet më bashkëkohore për auditimin suprem publik dhe me mundësinë konkrete për të kontribuar në shëndoshjen dhe qëndrueshmërinë e financave tona publike, duke rritur llogaridhënien dhe transparencën e tyre.
Ndajmë bindjen se do të krijohet sinergjia e duhur e punës me Ministrinë e Financave (ajo me shoqërinë civile dhe partnerët tanë ndërkombëtarë është krijuar tashmë), që llogaridhënia e rritur dhe transparenca e shtuar e sistemit të menaxhimit të financave publike, të mund të kufizojë dhe parandalojë korrupsionin e mashtrimin financiar, duke bërë që vendi ynë të ngjitet ndjeshëm më lart në renditjen e Transparency International, si vend që ka arritur t'i kufizojë dukshëm këto dukuri gërryese për demokracinë tonë të brishtë.

PËR NJË LLOGARIDHËNIE DHE TRANSPARENCË TË FINANCAVE PUBLIKE

Botuar në gazetën "Panorama", më 25 janar 2015

Menaxhimi i përgjegjshëm i financave publike sot paraqet një sfidë themelore në pjesën më të madhe të vendeve të botës. Sipas një vrojtimi të Fondit Monetar Ndërkombëtar të muajit prillit 2014, numri i vendeve me rregulla fiskale është rritur nga pesë shtete në vitin 1990, në 76 në vitin 2012. Numri i vendeve me këshilla fiskalë u rrit nga 6 në vitin 1990, në 25 në vitin 2013. Ndërsa numri i vendeve me plane afatmesme buxhetore u rrit nga 20 në 1990, në 130 në vitin 2008.

Sipas zv. Drejtorit të Përgjithshëm të FMN-së, z. Min Zhu, "*Kriza globale ka treguar se reformimi i menaxhimit të financave publike nuk është më një alternativë, por një domosdoshmëri. Nuk ka një zgjidhje që t'u përshtatet të gjitha vendeve njëlloj. Reformat duhet të përshtaten me rrethanat e veçanta të secilit vend*". Kriza financiare dhe ekonomike botërore nxori në pah rëndësinë e menaxhimit të shëndoshë financiar publik, për të siguruar që politikat e mirëprojektuara fiskale të zbatohen në mënyrë efektive.

Menaxhimi i shëndoshë i financave publike do të thotë mbajtja e një pozicioni të qëndrueshëm fiskal, caktimi i burimeve në mënyrë eficiente dhe ofrimi i mallrave dhe shërbimeve publike në mënyrë efektive.

Tashmë shumë vende janë duke u përpjekur të rivendosin financa publike të shëndosha dhe të qëndrueshme. Mënyra se si qeveritë menaxhojnë buxhetet e tyre sot do të ketë efekte të thella ekonomike në vitet e ardhshme.

Gjatë dy dekadave të fundit, qeveritë e shumë vendeve kanë ndërmarrë reforma për të përmirësuar menaxhimin e financave publike. Idetë e reja dhe reformat janë duke ndryshuar arkitekturën e financave publike dhe synojnë të reformojnë rrënjësisht mënyrën se si qeveritë menaxhojnë paratë publike. Në plan të parë sot del rritja e llogaridhënies dhe e transparencës qeveritare.

Reformat në menaxhimin e financave publike synojnë përdorimin e informacionit të ri, të proceseve dhe rregullave për të ndryshuar sjelljen e politikanëve dhe nëpunësve publikë, për të përballuar sfidat e vazhdueshme të menaxhimit të fondeve qeveritare. Shumë shpesh, tendenca e hartuesve te politikave është që të shpenzojnë më tepër sesa të kursejnë në kohë të mira; që të përqendrohen në interesa dhe plane afatshkurtra, duke injoruar kostot e ardhshme të politikave të reja, duke anashkaluar riskun fiskal dhe gjendjen e vërtetë të financave publike.

Menaxhimi financiar publik, arti i buxhetimit, i realizimit të shpenzimeve dhe i menaxhimit të parasë publike ka pësuar një evolucion të jashtëzakonshëm që nga fundi i viteve 80 të shekullit të shkuar. Risitë kryesore të këtij ndryshimi të thellë përfshijnë, ndër të tjera, rregulla të reja ligjore për të promovuar përgjegjësinë fiskale, rregulla fiskale, rregulla të buxhetimit afatmesëm, raportimin dhe kontabilitetin aktual, buxhetimin e performancës, këshillat fiskalë dhe teknikat e reja të menaxhimit të riskut fiskal.

Shumë qeveri, nën orientimin e ekspertëve të FMN-së, kanë krijuar kuadrin ligjor për të promovuar përgjegjësinë fiskale. Ato kanë miratuar ligje që synojnë të përmirësojnë disiplinën, transparencën dhe llogaridhënien qeveritare, duke e angazhuar veten me objektiva të një politike fiskale të qartë, e cila mund të monitorohet nëpërmjet kritereve të rrepta të raportimit dhe publikimit transparent. Një gamë e llojeve të ndryshme të legjislacionit dhe rregullave fiskale ekziston sot në botë, duke reflektuar kushtet e veçanta të vendeve të ndryshme.

Në disa vende, legjislacioni kërkon që qeveria të deklarojë parimet e politikës së saj fiskale dhe objektivat afatmesëm që ka, si dhe të raportojë nëse këto objektiva janë arritur. Në disa vende të tjera, legjislacioni i mbështet objektiva të tillë, duke imponuar kufizime numerike apo rregulla fiskale afatgjata edhe në Kushtetutë, për sa i përket deficitit buxhetor, borxhit publik, shpenzimeve ose të ardhurave publike. Të dy qasjet mund të jetë po aq efektive për të ndihmuar në menaxhimin e financave publike dhe të politikave të tyre themelore, në mënyrë të qëndrueshme me kalimin e kohës.

Për të siguruar suksesin e qasjes, nevojitet informacion i besueshëm, në kohë dhe gjithëpërfshirës, sfidë kjo ende në shumë vende. Nga ana tjetër, shpesh rregullat fiskale mund t'i lënë pak hapësirë qeverisë për të bërë ndryshime thelbësore të politikës fiskale, kur është e nevojshme për t'u përshtatur me ndryshimet në rrethanat ekonomike. Kështu që,kuadrot rregullatore fiskale të projektuara ashtu siç duhet, janë thelbësore.

Ndërkohë, përdorimi i planifikimit buxhetor afatmesëm ka nxitur një qasje më të disiplinuar për buxhetimin dhe i ka detyruar qeveritë të shohin përtej horizontit tradicional të buxhetit të një viti, si dhe të planifikojnë kostot e ardhshme të politikave të reja. Përveçse siguron pajtueshmëri me treguesit e tjerë makroekonomikë dhe objektiva të tillë, si rritja ekonomike, mbajtja nën kontroll e inflacionit dhe e kursit të këmbimit, planifikimi buxhetor afatmesëm siguron dhe parashikueshmërinë e agjencive të përfshira drejtpërdrejt në ofrimin e mallrave dhe shërbimeve publike.

Format e reja të kontabilitetit të aplikuar dhe raportimit fiskal, me ndihmën edhe të risive të teknologjisë së informacionit, po përshtaten dhe përdoren në menaxhimin e fondeve publike nga një numër në rritje qeverish. Pa informacion të saktë, të besueshëm, të thjeshtë për t'u kuptuar dhe në kohë, qeveritë nuk mund të marrin

vendime të drejta dhe të mira në lidhje me financat publike. Nga ana tjetër, në rast se nuk publikohet ky informacion, nuk ka gjasa që qeveritë të bëhen përgjegjëse për këto vendime. Raportimi i mangët fiskal i para krizës financiare dhe ekonomike globale 2008, krahas së qenët një nga shkaqet që gjeneroi krizën, na ka dhënë paralajmërime të mjaftueshme për problemet që i kanosen ekonomisë së një vendi, nga mungesa e cilësisë apo mangësia e qëllimshme në raportimin financiar dhe fiskal. Sot më shumë se kurrë është e dukshme domosdoshmëria për të përmirësuar raportimin fiskal.

Një tjetër ndryshim në peizazhin fiskal të shumë qeverive dhe qeverisjeve kudo në botë gjatë dy dekadave të fundit, e ka dhënë përqendrimi i vëmendjes në performancën e sektorit publik. Qeveritë janë përpjekur të përmirësojnë performancën e sektorit publik, duke aplikuar një numër reformash, si dhe duke përfshirë treguesit dhe mënyrat më të mira e të plota për të matur performancën.

Zhvillimi dhe konsolidimi i auditimeve të performancës nga ana e institucioneve supreme të auditimit (SAI-t) të vendeve të ndryshme i ka ndihmuar qeveritë e këtyre vendeve të kuptojnë më mirë rezultatet reale të politikave që ato ndërmarrin, si dhe të jenë më të përgjegjshme për efektin dhe efiçiencën e programeve që hartojnë në bazë të buxheteve afatshkurtra dhe afatmesme. Krahas ndihmës së ardhur nga SAI-t, është po ashtu mjaft e rëndësishme që informacioni buxhetor dhe fiskal i qeverive t'i nënshtrohet një shqyrtimi dhe vlerësimi të pavarur nga një grup ekspertësh me emër. Në vitet e fundit, kjo ka sjellë përhapjen e këshillave të pavarur fiskalë, me një mandat për të vlerësuar dhe monitoruar supozimet themelore në formulimin e buxhetit të shtetit, si dhe zbatimin e ndikimin e politikave fiskale, përballë objektivave të deklaruar. Kur rregullat fiskale janë pjesë e legjislacionit, këshilla të tillë mund të ndihmojnë të respektohen këto rregulla.

Në raportin për zbatimin e buxhetit të konsoliduar të shtetit për vitin 2013, një nga propozimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit ishte pikërisht ngritja e një këshilli të tillë edhe në Shqipëri. Ky institucion nevojitet të funksionojë i pavarur nga qeveria dhe të jetë nën kontrollin e Kuvendit, të cilit duhet t'i raportojë. Praktika e deritanishme në shumë vende të Europës dhe më gjerë kanë treguar efektivitetin e pranisë së këtyre këshillave të pavarur, në mbajtjen e qeverive të përgjegjshme për angazhimet dhe politikat e tyre buxhetore, si dhe në kuadrimin e objektivave të politikave qeveritare me fondet buxhetore në dispozicion, pa dëmtuar treguesit kryesorë makroekonomikë. Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të financave publike në vendet kandidate dhe aspirantë për anëtarësim në BE përbën një nga drejtimet themelore të Bashkimit Europian dhe Komisionit Europian, në strategjinë e tyre të zgjerimit për vitet 2015-2020. Në një linjë me këtë orientim shkojnë edhe Strategjia qeveritare e Menaxhimit të Financave Publike të Shqipërisë 2014-2020, si dhe Strategjia afatmesme e Zhvillimit e

KLSH 2013-2017, e bazuar në drejtimet strategjike të INTOSAI-t, 2011-2016 dhe të EUROSAI-t, 2011-2017.

Vendosja e një disipline të rreptë fiskale, nëpërmjet përcaktimit të rregullave të qarta fiskale, transparente dhe të përshtatshme për vendin tonë nga një këshill fiskal, me ekspertë të njohur të fushës së financave publike nga radhët e akademikëve, apo profesorë të shquar vendës apo të huaj, do të zvogëlonin risqet me të cilat janë përballur financat tona gjatë viteve të fundit. Ky risk u vu re edhe gjatë vitit 2014, ku ngrirja e përkohshme deri në maj 2014 e investimeve kapitale shkaktoi efektin e moskryerjes së këtyre investimeve publike në nivelin e dëshiruar.

Shpreh bindjen se sa më e thelluar, profesionale dhe jashtë ndikimeve të politikës të jetë vendimmarrja të jetë analiza e risqeve, aq më shpejt do të shkojmë drejt një konsolidimi fiskal aq të dëshirueshëm për financat tona publike. Sikurse ka theksuar një personalitet i padiskutueshëm i analizës së riskut tek ne, Prof. Dr. Skënder Osmani "*Baza e të dhënave është thelbësore për njehsimin e riskut. Duhet të përqendrohemi në analizën e riskut në sektorë të ndryshëm ekonomiko-socialë, si në burimet energjetike, drejtësi, financë, arsim, minerale, shëndetësi, rend, mjedis etj. Duhet të shohim mundësinë për ngritjen e një institucioni që të merret me standardet e burimeve njerëzore, natyrore, energjisë, mineraleve, etj., duke përfshirë rezervat, klasifikimin e tyre e deri në analizën e riskut, shfrytëzimin e rezervave, kontratat, etj. Në funksionimin e këtij institucioni duhet pasur parasysh edhe përvoja e vendeve të tjera*".

Kodi i Transparencës Fiskale i FMN-së, i përmirësuar në gusht 2014, kërkon nga vendet anëtare forcimin e mbikëqyrjes fiskale, duke përmirësuar llogaridhënien fiskale. Ai mbështetet në katër shtylla, të cilat janë:

1. Raportimi fiskal, i cili duhet të ofrojë informacione të rëndësishme, të plota, në kohë dhe të besueshme, për pozicionin financiar dhe performancën e qeverisë;
2. Parashikimi fiskal dhe buxhetimi, të cilët duhet të japin një panoramë të qartë të objektivave buxhetorë të qeverisë dhe të qëllimeve të politikave, së bashku me parashikime të plota, në kohë dhe të besueshme për evolucionin e financave publike;
3. Analiza dhe menaxhimi i riskut fiskal, të cilat duhet të sigurojnë që rreziqet për financat publike janë identifikuar, analizuar dhe menaxhuar, duke realizuar që vendimmarrja fiskale në sektorin publik të jetë e koordinuar në mënyrë efektive;
4. Menaxhimi i burimeve të të ardhurave, i cili duhet të ofrojë një kornizë transparente për pronësinë, kontraktimet, tatimet dhe përdorimin e burimeve natyrore.

Është realitet i punës së shumë SAI-ve (Institucioneve Supreme të Auditimit) sot në Europë dhe më gjerë, që të bashkëpunojnë ngushtësisht me qeveritë në vendet e tyre,

duke kontribuar qysh në fazat fillestare të buxhetimit me këshillim dhe orientim. Kjo, për ne si KLSH, vjen edhe si detyrë e obligim që ia kërkojmë vetes, në zbatim të Kushtetutës, standardeve ndërkombëtare të INTOSAI-t, por edhe të dispozitave të ligjit të ri të institucionit, i cili do të miratohet gjatë këtij viti 2015 dhe që do të na mundësojë certifikimin e pasqyrave financiare të institucioneve buxhetore që auditojmë, si dhe të vetë buxhetit të konsoliduar të shtetit. Transparenca e aktivitetit financiar publik në tërësi, por sidomos transparenca fiskale, si dhe llogaridhënia efektive, të cilat kryhen jo në formën e agjitprop-it dhe të paradës së sukseseve, por mbi bazën e një analize sa më të thelluar të risqeve dhe rrugëve që duhen zgjedhur për mënjanimin e tyre, janë mjetet e pakontestueshme për të arritur mirëqeverisjen e administrimit të fondeve publike, gjë të cilën e kërkojnë sot me ngulm të gjithë qytetarët në Shqipëri.

PËR NJË LEXIM TË VËMENDSHËM TË RAPORTEVE TË NDËRKOMBËTARËVE PËR EKONOMINË

Botuar në gazetën "Shqip", më 6 maj 2015

Problemet me rendin dhe reforma në drejtësi janë sfida tejet të rëndësishme për qeverisjen tonë publike. Por pa hequr asnjë presje nga rëndësia e tyre, sfida me administrimin e pronës publike dhe të parave të taksapaguesve sot rrezikon të dalë në plan të dytë, madje disi edhe po anashkalohet, pavarësisht se të gjithë jemi të ndërgjegjshëm për rëndësinë e saj. Është e stërkonsumuar në qindra artikuj shprehja "It's the Economy, stupid(Është ekonomia, o budalla!)" e këshilltarit Xhejms Karvil të Presidentit Bill Klinton në fushatën e suksesshme presidenciale të vitit 1992. Kjo nuk duhet lejuar të ndodhë me ne dhe për këtë duhet të jemi të gjithë syçelët dhe në pozita përgjegjshmërie: Kuvendi, Qeveria, institucionet e pavarura dhe shoqëria civile. Mjafton të kujtojmë shqetësimin e ngritur nga Departamenti Amerikan i Shtetit, i cili, në raportin e tij për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri për vitin 2015, publikuar në prill 2016, thekson se: "Ligji parashikon dënime penale për korrupsion nga ana e zyrtarëve, por qeveria nuk e ka zbatuar ligjin në mënyrë efektive dhe shpesh zyrtarët angazhohen në praktika korruptive pa u ndëshkuar… Korrupsioni është i përhapur në të gjitha strukturat e qeverisë"(faqe 16, paragrafi i dytë). Ky cilësim i Departamentit Amerikan të Shtetit duhet të përbëjë për Ne, politikanët dhe zyrtarët e lartë, një kambanë të fortë alarmi. Po bëjmë fare pak për ta luftuar me efektshmëri korrupsionin dhe të gjithë Ne, Drejtuesit e Institucioneve Shtetërore jemi shumë larg nga pritshmëritë e qytetarëve. Duhet ta pranojmë këtë fakt dhe realitet të hidhur për ne: jemi dobët me luftën efektive ndaj korrupsionit. Këtë fakt të pamohueshëm na e përmendin si Departamenti Amerikan i Shtetit ashtu dhe Bashkimi Evropian, nëpërmjet Progres Raporteve të tij për Shqipërinë. Për të avancuar në këtë luftë, dy veprime në dukje të thjeshta mund të jenë përcaktuese në vullnetin politik për ta kufizuar në burim korrupsionin.

Së pari, është thelbësore për të pasur një administratë të përgjegjshme shtetërore, që për rastet e dëmtimit të dukshëm të interesave të pronës publike dhe humbjes së konsiderueshme të të ardhurave të pritshme për Buxhetin e Shtetit, zyrtarët më të lartë dhe nëpunësit shtetërorë që e kanë shkaktuar këtë dëm apo humbje të mbajnë përgjegjësi materialisht(sa më lart të jenë në pozicioni hierarkike, aq më shumë duhet të përgjigjen). Për të tretin vit radhazi si KLSH, në Raportin për Zbatimin e Buxhetit të Konsoliduar të Shtetit, kemi rekomanduar hartimin e një ligji që të trajtojë në mënyrë të plotë rastet e përgjegjësive materiale të të punësuarve në sektorin shtetëror. Bëhet fjalë për ligjin për përgjegjësinë materiale të nëpunësit publik. Nuk kemi asnjë veprim në këtë drejtim, ndërkohë që jam i bindur do të ndryshonte katërcipërisht situata sapo ky ligj të miratohej. Kjo, për arsye se gjithkush që mban një detyrë shtetërore do të mendohej dhjetë herë, përpara se sa me vetëdije të plotë t'i hynte abuzimit dhe korrupsionit me detyrën, dhe nuk do të firmosnin zyrtarë të mesëm në komisionet e vlerësimit të ofertave(KVO). Deri tani, janë shumë ndër të korruptuarit dhe abuzuesit me pronën shtetërore që kryejnë abuzimin, marrin parasysh edhe kallëzimin penal, madje edhe përballjen me prokurorinë dhe me gjykatë, sepse mendojnë të investojnë një pjesë të

parave të përfituara padrejtësisht dhe që i përkasin Buxhetit të Shtetit, për të blerë prokurorë e gjykatës, pra edhe lirinë e tyre. Në ndihmë iu vijnë shembuj jo të pakët të realitetit shqiptar, të mbushur me kësi lloj lidhjesh okulte dhe mafioze. Do të jetë një situatë krejt tjetër, nëse, për pasojë të abuzimit dhe dëmtimit të provuar të pronës shtetërore, këta funksionarë(sidomos ata të lartë në piramidën shtetërore) abuzues apo të korruptuar, të vihen përpara përgjegjësisë së dëmshpërblimit material, duke paguar tërësisht apo një pjesë të dëmit të shkaktuar, qoftë edhe nëpërmjet konfiskimit të pasurisë vetjake. Nga kjo, jo vetëm që shtytja për abuzim dhe korrupsion dëmtohet rëndë, por rritet në progresion gjeometrik përgjegjësia e nëpunësve shtetërorë karshi detyrës që kryejnë. Rastet e zhdëmtimit të pronës publike nga dëmi prej abuzimeve të Drejtuesve të Lartë do të shkurajojnë ndjeshëm gjithsecilin që sot e sheh administratën publike si një hapësirë për të abuzuar dhe për të kryer korrupsion.

Së dyti, Departamenti Amerikan i Shtetit (DASH) në raportin e tij të vitit 2015 flet hapur për mosndëshkimin e zyrtarëve publikë që angazhohen në praktika korruptive. Si KLSH vërejmë me keqardhje se në vend është instaluar pikërisht anti-kultura e mosndëshkimit ndaj akteve korruptive. Gjatë periudhës janar 2012-dhjetor 2015, si institucioni suprem shtetëror i kontrollit të mënyrës se si menaxhohen fondet dhe prona shtetërore, jo vetëm kemi kryer 170 kallëzime penale, ose mbi 3 herë më tepër se katër vitet e mëparshme 2008-2011, për punonjësit që kanë abuzuar me pronën dhe me fondet publike, duke kallëzuar 527 punonjës deri në nivelin ministër, sekretar i përgjithshëm në ministri, drejtor i përgjithshëm, etj., por njëherazi kemi rekomanduar dhe largimin e menjëhershëm të tyre nga detyra. Mosveprimi i qeverisë për rastet e zyrtarëve të lartë të shtetit, të kapur në abuzim me pronën shtetërore dhe të denoncuar prej nesh pranë Prokurorisë së Shtetit, duke mos i larguar ata nga detyra apo nga shërbimi civil, për fat të keq ushqen përditë këtë anti-kulturë të mosndëshkimit, të vërejtur dhe nga DASH. Ky mosveprim ka përbërë qartazi dhe një presion ndaj Prokurorëve që kanë hetuar dosjet dhe rastet e sjella nga KLSH.

Ndjekja sistematike e zbatimit të rekomandimeve të KLSH ka qenë një shqetësim i përhershëm i Bashkimit Evropian, i shprehur me forcë edhe në të dy Progres Raportet e fundit për Shqipërinë të viteve 2014 dhe 2015. Në Progresin Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë të vitit 2015, në faqen 73, fragmenti i pestë (Kapitulli 32: "Kontrolli Financiar"), Bashkimi Evropian vëren se :"...ndjekja sistematike e rekomandimeve të KLSH ka nevojë të fuqizohet. Raporti vjetor i auditimeve të KLSH drejtuar Parlamentit diskutohet në Komisionin për Ekonominë dhe Financat, por sërish nuk ka ndjekje sistematike parlamentare".

Edhe pse gjatë vitit 2015, si KLSH kemi gjetur mirëkuptim dhe kemi marrë mbështetjen e duhur nga Komisioni i Kuvendit për Ekonominë dhe Financat, do të kërkojmë nga Kuvendi të ushtrojë ndikimin e tij mbi Qeverinë, duke e bërë të pranishme pranë komisioneve të Kuvendit listën katërvjeçare të zyrtarëve të lartë të denoncuar nga KLSH për abuzim e korrupsion, që ende mbahen në detyrat e tyre në administratën shtetërore, por edhe vetë Kuvendi duhet të marrë nisma konkrete.

Lufta efektive ndaj korrupsionit shkon në një linjë me rritjen e përgjegjshmërisë së administrimit publik dhe financave publike. Një kambanë tjetër e fortë alarmi që kërkon këtë rritje përgjegjshmërie është padyshim Raporti "Country Report" Nr. 16/5 i Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) për Vlerësimin e Transparencës Fiskale në Shqipëri, i janarit 2016. FMN në këtë raport jep një pasqyrë të financave publike dhe menaxhimit fiskal tek ne, të cilën duhet ta lexojmë si duhet dhe të reflektojmë të gjithë. Ende tërheqjet e vëmendjes së FMN për risqet e rritura fiskale të vendit nuk janë marrë parasysh sa duhet. Ekspertët e Fondit ngrenë shqetësimin në Raport se gjatë dekadës së fundit, buxhetet e qeverisë kanë parashikuar të ardhura mesatare të mbivlerësuara me 2 përqind të Produktit të Brendshëm Bruto, ose mbi 180 milionë euro. Një mbivlerësim i tillë na ka detyruar gjatë 8 viteve të fundit të rishikojmë buxhetin në mes apo edhe në fund të vitit, duke humbur ndjeshëm besimin ndaj tij. Buxheti i vitit 2016 është disi më realist se ai i dy viteve 2014 dhe 2015, por paralajmërimet e FMN për risqet e rritura fiskale në proceset e dhënies me koncesion dhe me partneritet publik-privat të pronës publike ose shërbimeve ndaj publikut, nuk janë marrë parasysh. Mjafton të kujtojmë një koncesion të kontraktuar dhe menaxhuar keq, ai i shfrytëzimit të naftës së bazenit Patos-Marinzë, vendburimit kryesor që kemi. Pas auditimit në AlbPetrol dhe në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), si KLSH kërkuam që detyrimet e paarkëtuara në Buxhetin e Shtetit, në formën e taksave të papaguara nga ana e koncesionarit(deri në nivelin e 200 milionë dollarëve), të arkëtohen sa më shpejt. Administrata jonë tatimore veproi drejt, duke i kërkuar kompanisë së huaj koncesionare pagimin e 57 milionë dollarëve në Buxhetit e Shtetit shqiptar, si detyrim i dalë nga rëndimi i pabazuar dhe artificial i shpenzimeve prodhuese nga ana e koncesionarit, duke nxjerrë Faktorin "R"(raportin midis të ardhurave dhe shpenzimeve prodhuese) më të vogël se 1 për vitin 2011. Deduksioni i administratës tatimore duke e konsideruar këtë raport më të madh se 1 dhe se rrjedhimisht koncesionari kishte kryer kështu evazion fiskal, ishte i saktë. Ne si KLSH presim që administrata jonë tatimore të prononcohet edhe për vitet 2009 dhe 2010, si dhe për një pjesë të mirë të vitit 2012, kohë kur çmimet e naftës bruto në tregjet ndërkombëtare kanë qenë të larta në shifra rekord. Duke vlerësuar më shumë vëmendje raportin të ardhura me shpenzime prodhuese, audituesit tanë janë të bindur se sërish Faktori "R" rezulton më i madh se 1 edhe për këto vite. Pavarësisht se tani koncesioni i përdorimit të vendburimit Patos-Marinzë ka kaluar në pronësi të një kompanie tjetër të huaj, gjykojmë se detyrimi ndaj Shtetit Shqiptar duhet paguar i plotë nga kompania e mëparshme, e cila ishte e regjistruar në disa nga ishujt parajsa fiskale, apo edhe nga kompania blerëse e huaj. Detyrimet fiskale të pashlyera, të cilat koncesionarët i kanë Shtetit Shqiptar, mund të shkojnë në miliona e qindra miliona euro(sikurse është rasti i koncesionarit të naftës në Patos-Marinzë) dhe është e domosdoshme që ato të rregullohen më mirë me ligj. Mendojmë se është e rëndësishme të fiksohet fort me ligj apo me vendim qeverie të veçantë që këto detyrime duhen shlyer, sa herë ndërrohet pronësia e koncesioneve të dhëna apo e shërbimeve të siguruara nga partneritetet publik-privat. Asnjë kalim pronësie në koncesionet dhe partneritetet e Shtetit shqiptar nuk duhet njohur ose lejuar, këtej e tutje, pa u siguruar që është kryer pagesa e detyrimeve që koncesionari apo partneri i mëparshëm i ka Buxhetit tonë të Shtetit.

Kjo dukuri, nën dritën edhe të fakteve të dala nga shpërthimi i skandalit "Panama Papers", duhet të shtyjë Qeverinë tonë të shikojë mundësitë që në dokumentet e prokurimeve publike për privatizime, koncesione dhe partneritete publik-privat të përfshihet një klauzolë që të vështirësojë pjesëmarrjen e kompanive fantazma apo kompanive thjesht seksere, të cilat janë të regjistruara në parajsat fiskale. Eksperienca e deritanishme ka treguar se shumë koncesione u janë dhënë kompanive pa ekspertizën dhe kapitalin e duhur, të cilat ose i kanë vonuar, ose në shumicën e rasteve, nuk kanë kryer investimet prodhuese të parashikuara në kontratë, në pasuritë publike, sidomos në burimet natyrore të vendit tonë, të cilat i kanë marrë me koncesion. Rezultati ka qenë, krahas shfrytëzimit pa kriter të tyre, edhe përkeqësimi i gjendjes së këtyre burimeve natyrore deri në shkatërrim të plotë. Po ashtu, si KLSH gjykojmë se kalimi i pronës apo shërbimit publik të dhënë me koncesion duhet të kryhet pasi pozicioni financiar i koncesionarit apo partnerit të mëparshëm të jetë qartësuar përfundimisht, ndoshta edhe nëpërmjet një deklarate sqaruese apo vërtetuese në lidhje me këtë, nga ana e strukturës përgjegjëse të Shtetit Shqiptar (ministrisë së Financave apo Ministrisë së linjës), duke e plotësuar Ligjin Nr. 125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", të ndryshuar. Nuk mund të lejohet më që një kompani koncesionare, qoftë kjo dhe e huaj, pasi ka përdorur lejen e dhënë dhe ka krijuar pasuri të regjistruara në parajsa fiskale duke shfrytëzuar vendburimet natyrore të Shqipërisë, t'i shmanget detyrimeve ndaj Shtetit Shqiptar, duke ia shitur koncesionin në momentin e fundit një kompanie tjetër. Në lojë janë me dhjetëra, në mos qindra milionë euro të taksapaguesve shqiptarë dhe për këtë Kuvendi duhet të diskutojë një ditë, një javë e pse jo, edhe një muaj. Drejtoritë Juridike në Ministritë e linjës duhet të punojnë urgjentisht për këtë. Duke theksuar domosdoshmërinë e të vepruarit sa më sipër, nuk përjashtoj nga përgjegjësia për veprim jo të shpejtë edhe vetë Institucionin që drejtoj, Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Konstatojmë me shqetësim se edhe me miratimin e ligjit të ri për koncesionet dhe partneritetet publik-privat me Nr. 77/2015"Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 125/2013 "Për Koncesionet dhe Partneritetin publik-privat, të ndryshuar", mungon oponenca reale ndaj zgjedhjes, përgatitjes së procedurave dhe dhënies së koncesionit apo partneritetit publik-privat. Komisioni i koncesionit/partneritetit publik privat që ky ligj krijon me nenin 18 të tij dhe që praktikisht jep koncesionin apo partneritetin, duke miratuar studimin e fizibilitetit, është krejtësisht në varësi të Ministrit të linjës. Gjykojmë se vlerësimi dhe oponenca për koncesionet dhe partneritetet publik-privat që jepen për një periudhë më shumë se një mandat qeverisës, duhet të jenë tagër e Kuvendit, nëpërmjet një strukture që caktohet, varet dhe i raporton atij, ku të jenë të përfshirë përfaqësues nga shoqëria civile dhe akademikë të fushës përkatëse.

Presidenti amerikan Teodor Ruzvelt, kur i referohej të korruptuarit në administratën publike, cilësonte se "Një njeri me pak klasë shkollë mund të të vjedhë një vagon mallrash, por në qoftë se ai ka arsim universitar, të vjedh tërë hekurudhën".

Qeveria duhet të shikojë mirë, mbështetur në konkluzionet e vrojtimeve dhe studimeve të FMN, Bankës Botërore dhe USAID, raportin kosto-përfitim nga koncesionet e

deritanishme apo dhe nga partneritetet publik-privat që synon të japë në të ardhmen. Kur këto marrëveshje nënshkruhen mbështetur në të gjitha rregullat dhe praktikat e mira ndërkombëtare, si dhe në një parashikim real të raportit kosto-përfitim, ato janë më shumë se të mirëpritura dhe i bëjnë shumë mirë ekonomisë sonë publike e private, por duke i monitoruar vazhdimisht dhe duke mos lejuar asnjë devijim të tyre nga kushtet dhe detyrimet e rëna dakord dhe të sigluara në Marrëveshje. Gjykojmë se ka vend për përmirësim si të procesit të kryerjes së studimit paraprak të leverdishmërisë për nisma të tilla, kryerjes së tenderimit përkatës, ashtu edhe të ndjekjes e monitorimit hap pas hapi të realizimit të koncesionit apo partneritetit publik-privat.

Fondi Monetar Ndërkombëtar ngre alarmin edhe për një rrezik të ri të shtuar për Buxhetin e Shtetit nga krijimi i një borxhi të ri nga ana e pushtetit vendor, nga bashkitë. Në raportin e FMN-se që do t'i kalohet për shqyrtim bordit ekzekutiv te tij, cilësohet se deri në mesin e vitit 2015, borxhet e bashkive zinin 0,6 për qind të prodhimit të brendshëm bruto te vendit, ose 56 milionë euro. FMN rekomandon që qeveria t'i kërkojë pushtetit vendor hartimin e planeve për mbledhjen e borxheve bashkiake dhe rishikimin e ligjit të financimit për njësitë vendore. Në këto 3 vitet e fundit, në shumicën e auditimeve tona në Njësitë e Qeverisjes Vendore, si KLSH kemi evidentuar rrezikun e borxheve të akumuluara të bashkive dhe komunave, si dhe të borxheve të Ndërmarrjeve të Ujësjellësve, duke i trajtuar me përgjegjshmëri këto dukuri dhe dhënë rekomandimet e duhura për shlyerjen e borxheve. Deri tani konstatojmë se është bërë shumë pak nga pushteti vendor për të zbatuar rekomandimet tona në këtë fushë. Sot më shumë se kurrë ka ardhur koha që këto rekomandime të dëgjohen dhe zbatohen, sepse krahas detyrimeve të rënda të 61 Kryebashkiakëve në lidhje me problematikat e mbartura të njësive vendore që trashëguan, programet e ardhshme ambicioze të partneriteteve publik-privat dhe në nivelin e bashkive të vendit, mbartin rrezikun e krijimit të detyrimeve akoma dhe më të mëdha nga këto partneritete në buxhetin e tyre, dhe për pasojë, edhe në Buxhetin e Shtetit.

Si KLSH, gjykojmë se ka ardhur koha që raportet dhe sinjalet e partnerëve ndërkombëtarë të mos i lexojmë vetëm me syze interesash afatshkurtra politike, por të marrim qartazi detyrat konkrete që na shtrohen përpara si për legjislativin dhe Kuvendin, ashtu dhe për Qeverinë dhe institucionet kushtetuese të pavarura. Strategjia "Për Menaxhimin e Financave Publike 2014-2020", e përgatitur nga Ministria e Financave, me ndihmën e ekspertëve të Bashkimit Evropian dhe tashmë në vitin e trete të zbatimit të saj, kërkon kontributin e të gjithëve. Sikurse e kam theksuar në Kuvend në nëntor 2015, me rastin e paraqitjes së Raportit të KLSH për zbatimin e Buxhetit të konsoliduar të Shtetit për vitin 2014, për implementimin me sukses të kësaj Strategjie duhet ta ndjejmë veten të gjithë përgjegjës(Kuvendi, Qeveria, KLSH dhe institucionet e tjera kushtetuese të pavarura), dhe jo vetëm Ministria i Financave apo Ministri i Financave.
Secili nga institucionet tona duhet të kryejë detyrën e tij dhe ta luftojmë korrupsionin aty ku ai paraqitet më i sofistikuar, galopant dhe i rrezikshëm: korrupsioni i kthyer në sistem në tenderat publike, në dhënien e koncesioneve apo partneriteteve publik-privat.

90 VJET KLSH[53]

Botuar në gazetën "Panorama", më 27 maj 2015

Ceremonia e 90 vjetorit të Kontrollit të Lartë të Shtetit në sallën e Seancave Plenare të Kuvendit të Shqipërisë, 26 Maj 2015

Në Kongresin e fundit të INTOSAI-t, INCOSAI XXI, në tetor 2013 të zhvilluar në Pekin, tema qendrore ishte *"Vendosja e auditimit kombëtar në shërbim të qeverisjes kombëtare"*. Në Kongresin e fundit të EUROSAI-t, zhvilluar në qershor 2014 në Hagë, Holandë, tema qendrore ishte inovacioni, ose *"Cila është hera e fundit që keni bërë një gjë për herë të parë"?*

Ne si KLSH, për herë të parë në historinë e institucionit, kremtojmë sot 90 vjetorin e krijimit të Institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, të bindur se në 100 Vjetorin e tij, do të kemi një trupë audituesisht akoma më profesioniste dhe se Shqipëria do të jetë vend anëtar i Bashkimit Evropian.

Misioni ynë, në dritën e orientimit themelor të Kongresit të Pekinit, sipas përcaktimeve kushtetuese në nenet 162-165 të Kushtetutës së Shqipërisë, por edhe në nenin 1 të

[53] Ky shkrim bazohet në fjalën e mbajtur në datën 26 maj 2015, në sallën e Seancave Plenare të Kuvendit të Shqipërisë, ku u zhvillua ceremonia e kremtimit të 90 Vjetorit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Deklaratës së Limës, *"Kushtetutës"* së mbi 192 institucioneve supreme të auditimit kudo në botë, është *"rritja e transparencës dhe përgjegjshmërisë në menaxhimin e fondeve publike, në një shkallë më të gjerë, për të gjithë komunitetin të cilit SAI i shërben: taksapaguesve, publikut, Parlamentit dhe organeve ekzekutive, duke kufizuar në maksimum abuzimet dhe duke siguruar përdorimin me ekonomicitet, efektivitet dhe efiçiencë të këtyre fondeve".*

Sikurse e ka theksuar edhe President i Gjykatës Europiane të Adituesve, z. Vitor Caldeira, në fjalën e tij përpara Komitetit të Kontrollit të Buxhetit në Parlamentin Evropian më 5 nëntor 2013: "*Qytetarët e Evropës kanë të drejtën të dinë se si paratë e tyre po shpenzohen dhe nëse ato po përdoren si duhet. Ata gjithashtu kanë të drejtën të dinë nëse këto para po japin vlerën e duhur, veçanërisht në një kohë kur ka një presion kaq të madh mbi financat publike*".

Si një SAI që kërkon të zhvillohet me parametrat e SAI-ve të përparuara europiane, KLSH është e gatshme të marrë përsipër këtë përgjegjësi, duke audituar në linjë me standardet e INTOSAI-t, duke ndjekur qasjen e re këshilluese të auditimit suprem publik, sikurse e ka përcaktuar aq qartë Dr. Josef Moser, Sekretar i Përgjithshëm i INTOSAI-t dhe President i Gjykatës Austriake të Auditimit, në fjalën e tij në Simpoziumin e XXII të Kombeve të Bashkuara dhe të INTOSAI-t, më 5 mars 2013 në Vjenë: "*Auditimi dhe këshillimi nga SAI-t janë dy anë të së njëjtës monedhë. Institucionet supreme të auditimit duhet dhe mund të rrokin mundësitë që qytetarët të angazhohen, duke shfrytëzuar potencialin e tyre të plotë në përpjekjet për përmirësimin e qeverisjes së mirë publike, vetëm nëse ata zhvillojnë një qasje këshillimi në bazë të punës së tyre audituese, e cila ofron rekomandime specifike si për subjektet e audituara, ashtu dhe për menaxherët qeveritarë, rekomandime që mund të zbatohen praktikisht në sferat e tyre përkatëse të veprimit*".

Me këtë qasje të re dhe përgjegjësi të rritur kombëtare, vizioni ynë është shndërrimi i adituesve të KLSH-së në një trupë moderne auditimi, që zbaton standardet ndërkombëtare ISSAI të INTOSAI-t në kushtet dhe specifikat e Shqipërisë, e aftë të përballojë sfidat e kohës për shëndoshjen e plotë dhe qëndrueshmërinë e financave publike, të luftojë në thellësi dhe në sistem korrupsionin, si dhe të bashkëpunojë me efektivitet dhe efiçiencë me institucionet homologe në Evropë dhe më gjerë, si dhe me partnerët ndërkombëtarë.

Në përballimin e sfidave të mësipërme, me moton e INTOSAI-t "*Experentia mutua Omnibus Prodest*" (Eksperienca e përbashkët u shërben të gjithëve), ne jemi të gatshëm të shfrytëzojmë mundësitë tona, ashtu sikurse e thekson edhe Auditues i Përgjithshëm i GAO-s Amerikane, z. Gene L. Dodaro, në fjalën e tij më 16 nëntor 2012 përpara audutiuesve të SAI-t të Kinës, "*E tashmja po tregon se institucionet supreme të auditimit kanë mundësi të pashoqe të ndihmojnë qeveritë e tyre për të planifikuar më parë dhe për të parandaluar risqet, duke i adresuar çështjet në një shkallë të gjerë*".

Ne jemi të vendosur të ruajmë dhe zhvillojmë vlerat e vërteta të punës profesionale audituese: pavarësinë, objektivitetin, integritetin, përgjegjshmërinë, profesionalizmin, bashkëpunimin, interesin publik dhe transparencën, duke përditësuar eksperiencën më të mirë dhe të vyer të audituesve tanë me të rejat më të fundit të auditimit suprem modern.

Duke kremtuar këtë 90 vjetor, promovojmë dhe sjellim në vëmendje të publikut, partnerëve tanë vendas e të huaj, si dhe komunitetit ndërkombëtar, historinë dhe trashëgiminë tonë institucionale, por edhe mesazhet për drejtimet dhe sfidat kryesore të misionit dhe punës sonë në të ardhmen.

Ceremonia e 90 vjetorit të Kontrollit të Lartë të Shtetit në sallën e Seancave Plenare të Kuvendit të Shqipërisë. Në radhën e parë nga e majta në të djathtë: Dr. Vitor Caldeira, President i Gjykatës Europiane të Audituesve; Ilir Meta, Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë; Prof. As. Dr. Recai Akyel, President i Gjykatës së Llogarive të Turqisë; Dr. Josef Moser, Sekretar i Përgjithshëm i INTOSAI-t, njëkohësisht President i Gjykatës së Auditimit të Austrisë; Prof. Dr. Bamir Topi, ish-President i Republikës së Shqipërisë dhe Bujar Leskaj, Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Të kërkosh identitetin institucional nëpërmjet hedhjes dritë dhe evidentimit të historisë së zhvillimit është mbi të gjitha përgjegjësi, por edhe ***shërbim për gjeneratat e ardhshme.***

Nga një hulumtim i historisë 90 vjeçare të KLSH-së, mund të konfirmohet se institucioni në mënyrë të pashmangshme, në evoluimin e tij ka ndjekur pashmangshmërisht progresin shoqëror dhe transformimet social-politike, ekonomike e diplomatike të Shqipërisë, që nga themelimi i shtetit modern dhe deri në ditët e sotme.

Ky institucion, i cili daton në vitin 1925, ka funksionuar gjatë gjithë kohës, pas miratimit të Statutit të Republikës, përgjatë Monarkisë Kushtetuese, përgjatë regjimit komunist

diktatorial e deri në ditët tona, duke iu përshtatur rrethanave historike, me rregullime të caktuara të kompetencave, të objektit të veprimtarisë, tipit të kontrollit dhe emërtesës.

Ismail Qemal bej Vlora, kreu aktin më të lartë në të gjithë historinë institucionale të Shqipërisë, duke themeluar shtetin modern shqiptar dhe përmes një sërë vendimesh politike e diplomatike, vendosi gurin e themelit të tij. Ai ngriti flamurin e Pavarësisë në Vlorë, më 28 Nëntor të vitit 1912 dhe shpalli Shqipërinë shtet të pavarur, duke u kërkuar fuqive ndërkombëtare ta njihnin këtë vendim. Në politikën dhe veprimtarinë ekonomike të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, pa dyshim një vend të rëndësishëm do të zinte problemi financiar.

Ismail Qemali deklaroi vendimet e para dhe të nevojshme që duhet të merrte kombi shqiptar, njëri ndër të cilat ishte "*Të zgjidhet një pleqësi për ndihmë e kontroll të qeverisë*".

Administrimi i kontrollit financiar në vitet 1920-1924, u sanksionua nëpërmjet Statutit të Zgjeruar të Lushnjës, i cili ngarkonte Këshillin Kontrollues të Financave me kontrollin e financave të shtetit.

Në Qeverinë e Fan.S.Nolit, megjithë kohën e shkurtër të qeverisjes dhe kushteve mjaft të vështira ekonomike dhe financiare, roli i Komisionit Kontrollues të Financave u orientua nga skema e kontrollit të llogarive të financave.

Nën qeverisjen e **Ahmet Zogut,** si Kryetar i Republikës dhe Mbret i Shqipërisë, Institucioni i Kontrollit më të lartë në vend shfaqet si Institucioni i Këshillit Kontrollues, Institucion Kushtetues dhe që në boshtin e veprimtarisë së tij kishte kontrollin e financave të shtetit dhe gëzonte atributet e një organizmi të pavarur pranë Parlamentit.

Në periudhën e pasluftës së Dytë Botërore, nën regjimin komunist, Këshilli Kontrollues i Financave iu nënshtrua një sërë riorganizimesh të njëpasnjëshme, duke humbur pavarësinë (strukturë nën varësinë e ekzekutivit dhe të partisë-shtet), në shërbim të politikës së shtetit totalitar.

Referuar formës së organizimit dhe funksionimit, si dhe raportimit të aktivitetit kontrollues, Këshilli Kontrollues ka qenë një organ i politizuar dhe represiv, duke mos patur mëvetësi në ushtrimin e veprimtarisë kontrolluese.

Me ardhjen e **Demokracisë,** zhvillimet pozitive u reflektuan dhe në fushën e auditimit të jashtëm publik. Me asistencën e Nismës Ligjore për Evropën Qendrore dhe Lindore (CEELI - Central and East European Initiative), një projekt ky i Qeverisë Amerikane, u ripunua dhe u paraqit projekt-ligji *"Për Shërbimin e Kontrollit të Shtetit"*, i cili u miratua nga Kuvendi në fund të muajit gusht 1992.

Pavarësia e këtij organi nga Qeveria u sanksionua me dispozitat kryesore kushtetuese dhe ligjin organik të lartpërmendur. U ndërtua një strukturë e re e organeve të kontrollit, në përshtatje me rolin e ri që merrnin financat publike në një shtet ligjor.

Në kuadër të proceseve integruese, gjatë viteve 1996–1997, ekspertët e SIGMA-s ndërmorën disa hapa seriozë për modernizimin e kontrollit të jashtëm në Shqipëri, duke kërkuar përafrimin e legjislacionit sa më shumë me standardet ndërkombëtare të auditimit.

Pavarësia e plotë, depolitizimi dhe departizimi i organit suprem të kontrollit u realizuan pas ngjarjeve të vitit 1997, me miratimin e ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit" dhe më pas të ligjit themelor të Shtetit nr. 8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", pjesa e katërmbëdhjetë "Kontrolli Lartë i Shtetit", nenet 162-165.

Këto akte mundësuan rikthimin e pavarësisë funksionale, organizative, financiare dhe operacionale të institucionit. KLSH operoi përgjatë viteve 1998-2011, duke gëzuar pavarësi dhe duke u përpjekur të bashkëpunonte me institucionet homologe dhe partnerët ndërkombëtarë.

Në pamundësi të përmendjes së të gjithë figurave të drejtuesve të KLSH-së ndër vite, të cilët janë të shumtë në numër, do të veçoja personalitetet e ndritura, veçanërisht në vitet 1925 -1944 si Kol Thaçi, Lac Gera, Llambi Aleksi, Fejzi Alizoti, Lame Kareco, Eqerem Libohova, Xhaferr Ypi, Rrok Gera, Izedin Beshiri dhe të tjerë. Dua po ashtu të vlerësoj punën reformuese të Kryetarëve të KLSH-së në vitet e demokracisë, sidomos të Prof. Dr. Blerim Çela, Mustafa Kërçuku, etj.

Nga ana tjetër, shpreh konsideratën, respektin dhe vlerësimin maksimal për të gjithë trupën e kontrollorëve, audituesve dhe punonjësve mbështetës të devotshëm, me integritet, punëtorë, korrektë dhe profesionalë, që kanë kontribuar dhe shërbyer në këtë institucion gjatë gjithë kësaj periudhë 90 vjeçare.

Festimi i përvjetorëve të themelimit të institucioneve bazë të Shtetit, orientimi drejt kujtesës historike për ta është i lidhur ngushtësisht me objektivin e Planit Strategjik të EUROSAIT 2011-2017, për shndërrimin në një organizatë model, të orientuar nga shkëmbimi profesional i eksperiencave në auditim dhe nga vlerat e punës audituese ndër vite.

Duke marrë shkas nga ky Përvjetor i 90-të dhe duke hedhur vështrimin pas në vite, duke kryer analizën mbi ecurinë e zhvillimeve progresive, por dhe të kthimeve pas, jemi të ndërgjegjshëm se kjo na shërben të projektojmë të ardhmen dhe të përballojmë sfidat e saj.

Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, Z. Ilir Meta, duke përshëndetur në Ceremoninë e 90 Vjetorit të Kontrollit të Lartë të Shtetit

Ligji i ri integral i KLSH-së, i miratuar nga Kuvendi në nëntor të vitit 2014, tërësisht në përputhje me standardet e INTOSAI-t dhe që ka njohur bashkëpunimin e ngushtë me ekspertët e Drejtorisë së Buxhetit të Komisionit Evropian dhe të SIGMA-s, synon modernizimin e plotë të institucionit, zgjerimin e veprimtarisë audituese në dimensione të afta për të përballuar sfidat e kohës, rritjen e standardeve profesionale të trupës audituese dhe një bashkëpunim edhe më të ngushtë me strukturat evropiane të auditimit suprem publik, si Gjykata Evropiane e Audituesve dhe SAI-t partnere.

Hapësirat që krijon ky ligj garantojnë synimin e KLSH-së që për periudhën në vijim të realizojë modernizimin e plotë të institucionit, për të sjellë veprimtarinë e tij në përputhje me Planet Strategjike, 2011-2016 të INTOSAI-t dhe 2011-2017 të EUROSAI-t. Sfida jonë për të ardhmen është sjellja e veprimtarisë audituese të institucionit në parametrat e institucioneve të zhvilluara homologe të Bashkimit Evropian, në respektim të plotë të mandatit kushtetues të KLSH dhe të pritshmërive të Kuvendit dhe qytetarëve.

Do të vijojmë me një ecuri të qëndrueshme të reformave të ndërmarra deri tani, duke shprehur bindjen se i gjithë ky proces do të shoqërohet me rezultate konkrete për përmirësimin e qeverisjes kombëtare, në sinergji dhe bashkëpunim të plotë me qytetarin, Kuvendin, shoqatat profesionale dhe shoqërinë civile.

GJETJET E KLSH SIPAS KORNIZËS SË MATJES SË PERFORMANCËS SË SAI-VE

Botuar në gazetën "Shqip", 29 qershor 2015

Shkrimi është përmbledhje e Raportit të Performancës së KLSH për vitin 2014 (shihni në këtë libër faqet 138-155).

A DUHET TË SHQETËSOHEMI PËR EKONOMINË SHQIPTARE?

Botuar në Revistën "Monitor", më 2 korrik 2015

Ka një ngjashmëri të ecurisë së treguesve bazë të cenueshmërisë mes Shqipërisë dhe Greqisë. Ndonëse niveli i përkeqësimit të këtyre treguesve në Shqipëri është dukshëm më i ulët se sa në rastin e Greqisë, kjo nuk na heq nga përgjegjësia për të riparë me kujdes kohë pas kohe këta tregues, me synim përmirësimin e tyre.

Tetë vjet pas shfaqjes së krizës bankare në SHBA dhe shndërrimit të saj në një krizë financiare dhe ekonomike globale, që preku ndjeshëm dhe vendet e kontinentit europian, ndihet ende prezenca e saj. Në pjesën më të madhe të ekonomive ndihen pasojat e saj, sidomos në sektorin bankar dhe financiar. Një pjesë tjetër, siç është Greqia, nuk kanë dalë ende krejtësisht prej saj dhe po përpiqet të stabilizojë financat e vendit dhe krejt ekonominë pas krizës së thellë të borxhit që ajo përjetoi.

Rrethanat ekonomike gjatë krizës

Sipas të dhënave statistikore të Bankës Botërore, që prej vitit 2007, ekonomitë e Bashkimit Europian ranë nga një nivel rritjeje prej 3.1% në një recesion -4.4% në vitin 2009, për t'u stabilizuar në një nivel 1.4% në vitin 2014. Ekonomia greke ra nga një nivel rritjeje ekonomike prej 3.5% në vitin 2007 në disa vite recesion, ku kulmin e arriti në vitin 2011, në një nivel prej -8.9% dhe vetëm në vitin 2014 shënoi për herë të parë rritje pozitive ekonomike në masën modeste prej 0.8%. Për të njëjtë periudhë, ecuria është më pozitive për ekonominë shqiptare. Për fat të mirë është ruajtur niveli pozitiv i rritjes ekonomike. Në vitin 2007, niveli i rritjes ekonomike ishte 5.9%, duke kapur dhe nivelin 7.5% në vitin 2008. Pas këtij viti, ritmi i rritjes ekonomike u stabilizua me shenja rënëse, duke arritur në nivelin 1.9% për vitin 2014.

Parë në këtë këndvështrim ka arsye për të qenë *"të qetë"* lidhur me të ardhmen e ekonomisë shqiptare. Por rreziqet janë gjithnjë prezentë. Të stabilizuara kanë qenë ekonomitë e BE-së para vitit 2007. Në dukje e stabilizuar ka qenë dhe ekonomia greke përgjatë asaj periudhe. Ajo çka duket në parametrat bazikë të rritjes ekonomike, duhet parë në detaje për të matur më mirë nivelin e riskut real për një ekonomi.

Treguesit e cenueshmërisë (FMN) – Shqipëria 2010-2014

Fondi Monetar Ndërkombëtar ka përcaktuar disa tregues ekonomikë, të cilët demonstrojnë nivelin e cenueshmërisë së një ekonomie nga krizat e mundshme. Sipas përcaktimeve të FMN-së, treguesit e cenueshmërisë janë një grup parametrash dhe raportesh, të cilët i shërbejnë këtij institucioni gjatë mbikëqyrjes dhe këshillimit të

vendeve anëtare dhe sidomos vendeve me ekonomi në zhvillim, siç është Shqipëria. Këta tregues lidhen me nivelin e investimeve në ekonomi, nivelin e borxhit të jashtëm dhe stokut të borxhit, të ardhurat tatimore, rezervës valutore, etj.

Në vijim janë paraqitur treguesit bazë të cenueshmërisë për 5 vitet e fundit 2010-2014, duke përdorur të dhënat bazë për ekonominë shqiptare të pasqyruara në Raportet Statistikore të Bankës së Shqipërisë. Këta tregues masin nivelin e ekspozimit të ekonomisë ndaj borxhit dhe në krizë të mundshme borxhi.



Treguesi i parë – Investimet e huaja

Dy burimet bazë të financimit të ekonomive të zhvilluara dhe sidomos atyre në zhvillim janë (1) ***huamarrja nga jashtë*** dhe (2) ***fondet që vijnë nëpërmjet investimeve të huaja***. Sipas FMN, frenimi i investitorëve të huaj vlerësohet si një dobësi e vendeve në zhvillim që i bën ata më të ekspozuar ndaj një krize të mundshme financiare dhe ekonomike. Investimet e huaja në ekonominë shqiptare për periudhën 2010-2014 kanë pësuar luhatje, duke shënuar rënie për dy vitet e fundit. Nga 923.2 milionë euro që ishin në vitin 2013, niveli i investimeve të huaja zbriti në 801.3 milionë euro për vitin 2014. Ky nivel i investimeve të huaja në vitin 2014 është pothuaj i barabartë me nivelin e vitit 2010. E thënë ndryshe, niveli i investimeve të huaja pothuaj nuk ka shënuar progres përgjatë 5 viteve të fundit. Përpos arsyeve që lidhen me krizën financiare dhe ekonomike mbarëbotërore, gjykoj se në nivelin e investimeve ndikon barra fiskale dhe ambienti investues në Shqipëri. Në këtë pikë, mendoj se duhet treguar një nivel i shtuar i përgjegjshmërisë për të llogaritur me kujdes pasojat që do të ketë në thithjen e investimeve të huaja zbatimi i paketës fiskale që miratoi Parlamenti për vitin 2016. Ekziston gjithnjë rreziku që synimi për të mbledhur më shumë të ardhura tatimore apo për të afruar nivelin e taksimit me vendet e zhvilluara mund ta bëjë vendin më pak

tërheqës në raport me vendet e tjera të rajonit, duke dëmtuar jo vetëm sektorë të caktuar të ekonomisë, por dhe vetë të ardhurat publike në një shtrirje afatgjatë.



Treguesi i dytë – Borxhi publik i jashtëm

Borxhi publik i jashtëm mat cenueshmërinë e ekonomisë së vendit nga flukset dalëse të fondeve. Për këtë parametër llogariten tre raporte, të cilët shërbejnë secili si një tregues sinjalizues për ekspozimin e ekonomisë ndaj risqeve të mundshme.

Raporti i parë është raporti i borxhit të jashtëm ndaj eksporteve (*Borxhi i jashtëm/Eksporte*). Sipas përcaktimeve të FMN-së, ky raport është tregues i dobishëm i tendencave të ekonomisë së një vendi lidhur me borxhet. Sa më i ulët është ky raport, aq më të vogla janë detyrimet e një vendi dhe më i ulët ekspozimi ndaj një krize te mundshme të borxhit. Ky parametër është përkeqësuar gjatë 5 viteve të fundit, duke u rritur nga 3.35 në vitin 2010 në 3.65 për vitin 2014. Përkeqësimi i këtij raporti ka ndodhur edhe pse eksportet janë rritur. Kjo ka ardhur si pasojë e rritjes më të lartë të borxhit të jashtëm, sidomos nga viti 2013 në vitin 2014, në masë 7.91% (nga 6,177.4 milionë euro në 2013 në 6666.0 milionë euro në 2014)

Raporti i dytë është raporti i borxhit të jashtëm ndaj Produktit të Brendshëm Bruto (*Borxhi i jashtëm/PBB*). Sipas FMN-së, ky është një tregues i dobishëm që mat kapacitetin e ekonomisë së një vendi për të shlyer borxhe. Një ekonomi me një nivel të lartë të këtij raporti ka më pak kapacitete për të shlyer detyrimet, rrjedhimisht është më e ekspozuar ndaj krizave të mundshme të borxhit.

Në rastin e Shqipërisë, ky raport ka pasur tendenca përkeqësimi me një ritëm të shtuar në dy vitet e fundit, duke u rritur nga 0.64 në 0.69. Kjo vjen për shkak se në vitin 2014, borxhi i jashtëm është rritur me një ritëm më të lartë se sa PBB. Kështu në vitin 2014, PBB ka një rritje të përllogaritur prej 1.04%, ndërkohë që borxhi i jashtëm është rritur me 7.91%.

Raporti i tretë është raporti i borxhit të jashtëm ndaj të ardhurave tatimore (*Borxhi i jashtëm/Të ardhura tatimore*). Sipas FMN-së, ky raport është veçanërisht i rëndësishëm për të vlerësuar kapacitetin e të ardhurave publike në riparimin e borxhit. Për ekonominë

shqiptare, ky raport ka shfaqur tendenca përkeqësimi përgjatë gjithë periudhës 2010-2013.

Të ardhurat tatimore kanë shënuar rritje të lehtë krahasuar me rritjen e borxhit të jashtëm, pasojë e së cilës është përkeqësimi i vazhduar i këtij treguesi, i cili është rritur nga 1.87 në vitin 2010 në 2.78 në vitin 2014. Edhe pse rritja ekonomike e Shqipërisë ka qenë pozitive dhe në nivele të kënaqshme krahasuar me vendet e rajonit, ky raport ka ardhur në rritje, për shkak të rritjes në nivele të larta të borxhit të jashtëm, sidomos gjatë tre viteve të fundit. Kjo natyrisht rrit ekspozimin e ekonomisë shqiptare dhe e bën atë më të cenueshme ndaj një krize borxhi.

Treguesi i tretë – Rezervat





Për një shtet në tërësi është i rëndësishëm niveli i rezervave valutore që disponon. Niveli i rezervave valutore jo domosdoshmërish është një parametër domethënës. Shtete të ndryshme, në varësi të nivelit të tregtisë dhe borxhit, mbajnë nivele të ndryshme të rezervave valutore në bankat e tyre qendrore. Ajo që është e



rëndësishme lidhet me nivelin e garancisë që rezervat valutore të një vendi ofrojnë për shlyerjen e borxhit të jashtëm afatshkurtër. Për këtë arsye llogaritet raporti i rezervave valutore ndaj borxhit të jashtëm afatshkurtër (*Rezerva valutore/Borxhi i jashtëm afatshkurtër).* Sipas FMN-së, ky raport është çelësi për të vlerësuar cenueshmërisë e vendeve me akses të rëndësishëm, por të pasigurt në tregjet e kapitalit. E tillë është dhe Shqipëria, si vend i vogël me stok borxhi në rritje. Nga të dhënat e pesë viteve të fundit vërej se ky raport ka shënuar rënie (përkeqësim) të dukshëm. Nga 4.63 herë që ishte në vitin 2010, ky raport ka rënë në 1.76 herë në vitin 2014. Shkak i kësaj rënieje ka qenë rritja me gati 3 herë e borxhit të jashtëm afatshkurtër përgjatë 5 viteve, edhe pse rezervat valutore kanë qenë në rritje gjatë kësaj periudhe.

Nga 1.9 miliardë euro që ka qenë borxhi i jashtëm afatshkurtër, marrë kryesisht nga bankat dhe institucione të tjera private në vitin 2010, ky parametër u rrit në mënyrë të vazhdueshme, duke arritur në rreth 2.2 miliardë euro në vitin 2014.

Skenari grek si një barrierë

Nga analiza e treguesve të cenueshmërisë së një ekonomie nga kriza, të përcaktuar nga FMN, vërehen tendenca, të cilat kanë ngjashmëri me ecurinë e të njëjtave parametra në vitet e krijimit të bazave për krizën greke. Niveli i borxhit në rritje dhe kapacitetet ekonomike për shlyerjen e borxhit në përkeqësim janë një e përbashkët mes Shqipërisë së viteve 2010-2014 me Greqinë e viteve 2005-2009. Nëse të njëjtat parametra të cenueshmërisë i analizojmë dhe për ekonominë greke për vitet 2005-2009, do të arrijmë rezultate të ngjashme. Për ekonominë greke kam zgjedhur këtë periudhë, për shkak se 2005-a është vlerësuar si viti i shfaqjes së shenjave të krizës dhe viti 2009 si vit i shpalljes së krizës së borxhit dhe krizën ekonomike në Greqi (stanjacion). Natyrisht që treguesit janë vënë përballë, jo për të hequr një paralele për pasoja të njëjta. Qëllimi është të vlerësojmë rëndësinë e treguesve të cenueshmërisë të FMN-së, përkeqësimi i të cilëve e ka paralajmëruar krizën greke që në vitin 2006.

Analiza e të njëjtëve tregues për ekonominë shqiptare vlerësojmë se duhet të shërbejë si një sinjal që tregon orientimin e ekonomisë ndaj një niveli në rritje të ekspozimit të një krize të mundshme. Shpresoj që këta tregues të shërbejnë sa më shumë në marrjen e masave të duhura për një riorientim të politikave ekonomike në shmangie të një krize të mundshme ekonomike.

Nga të dhënat për të dyja vendet në kohë të ndryshme mund të konstatojmë për një ngjashmëri të ecurisë së treguesve bazë të cenueshmërisë mes Shqipërisë dhe Greqisë. Për fat të mirë, niveli i përkeqësimit të këtyre treguesve në Shqipëri është dukshëm më i ulët se sa në rastin e Greqisë. Duke analizuar në veçanti disa tregues, mund të themi se:

Së pari, rënia e investimeve të huaja është një fenomen shqetësues për një ekonomi në zhvillim. Ndryshimet e shpeshta dhe në drejtimin rritës të tatimeve dhe taksave rrezikojnë të dekurajojnë investitorët e huaj, duke rritur mundësinë e përkeqësimit të këtij parametri ekonomik.

Së dyti, parametrat bazë të borxhit janë në përkeqësim njësoj si ekonomia greke e viteve 2005-2009. Niveli i përkeqësimit është dukshëm më i ulët, por kjo nuk na heq përgjegjësinë për të riparë me kujdes kohë pas kohe këta tregues, me synim përmirësimin e tyre.
Dhe së treti, borxhi i jashtëm është rritur vazhdimisht me një ritëm të shtuar në vitin 2014, kur u rrit me 488 milionë euro ose 7.51% më shumë se viti 2013. Ky zhvillim, nëse nuk ndërpritet dhe përmirësohet, mund të rrisë dukshëm riskun e borxhit të

jashtëm për ekonominë shqiptare. I vetëdijshëm se vlerat e këtyre treguesve në rastin e Shqipërisë janë larg vlerave të ekonomisë greke, ngre shqetësimin për një kujdes të shtuar lidhur me borxhin dhe veçanërisht me borxhin e jashtëm. Tendencat aktuale të këtyre parametrave janë shqetësuese, por më shqetësues do të ishte nëse kjo tendencë do të vazhdojë dhe në vitet e ardhshme, duke rritur ekspozimin e ekonomisë shqiptare ndaj një krize ekonomike apo/dhe krize borxhi. Gjithashtu, duke analizuar dhe parametrat e tjerë bazë të ekonomisë shqiptare, vërejmë se ekonomia ka nevojë për flukse likuiditeti, për shkak se ka shfaqur shenja të një rritjeje të ndjeshme të borxhit të jashtëm afatshkurtër të bankave dhe kompanive në sektorë të tjerë të ekonomisë. Së fundmi, një ekonomi e lodhur nga pamundësia e shlyerjes së taksave, shoqëruar me rritjen e nivelit të borxhit publik dhe stanjacionin e investimeve të huaja dhe vendase përbën një rrethanë, e cila nuk duhet përjashtuar. Një situatë e tillë do të ishte rrezik për një krizë të borxhit publik dhe krize ekonomike.

TABELA 1. TË DHËNAT NË MILION EURO

	2009	2010	2011	2012	2013
Treguesi/Vitet	2010	2011	2012	2013	2014
Rezervat valutore	1904.8	1912.5	1972.5	2015.3	2191.7
Borxhi i jashtëm afatshkurtër	411.3	662.1	1,114.6	1,151.9	1,244.6
Rezerva valutore/Borxhi i jashtëm afatshkurtër	4.63	2.89	1.77	1.75	1.76

Burimi: Banka e Shqipërisë, Raporti Statistikor, Qershor 2015

TABELA 2. TREGUESIT E CENUESHMËRISË PËR EKONOMINË SHQIPTARE 2010-2014

Treguesit	2010	2011	2012	2013	2014
Investimet e huaja (milion euro)	788.5	608.9	647.9	923.2	801.3
Borxhi i jashtëm/eksporte	3.35	3.23	3.61	3.54	3.65
Borxhi i jashtëm/PBB	0.44	0.49	0.57	0.64	0.69
Borxhi i jashtëm/Të ardhurave tatimore	1.87	2.09	2.55	2.89	2.78
Rezerva/Borxhi i jashtëm afatshkurtër	4.6	2.9	1.8	1.7	1.8

Burimi: BSH

EUROSAI-OLACEFS: FRYTET E NJË BASHKËPUNIMI 25 VJEÇAR

Botuar në gazetën "Telegraf", më 4 korrik 2015

Auditimin më të lartë publik të jashtëm, krahas standardeve të tij ISSAI, e përditëson dhe e mban të lidhur me sfidat e sotme ekonomike dhe shoqërore të globit, bashkëpunimi mes institucioneve kombëtare të auditimit (SAI-ve) dhe shkëmbimi i eksperiencave. Në vetë frymën dhe motivimin e organizatës së institucioneve supreme të auditimit publik (INTOSAI), që përmbledh 192 vende me status anëtari të plotë dhe 5 vende të asociuara, të shprehur në mënyrë të koncentruar në moton e organizatës "*Experentia mutua omnibus prodest - Eksperienca e përbashkët u shërben të gjithëve*", bashkëpunimi është parësor për freskimin e njohurive dhe praktikave të auditimit, si dhe sigurimin e pavarësisë.

Në planin e bashkëpunimit mes organizatave rajonale të INTOSAI-t, konferencat e përbashkëta janë forumet më të larta të shkëmbimit të eksperiencave mes SAI-ve të kontinenteve të ndryshme.

EUROSAI, si organizatë rajonale e Evropës, është themeluar në vitin 1990 me 30 anëtarë (29 SAI të shteteve anëtare evropiane dhe Gjykata Evropiane e Audituesve ECA). Tashmë EUROSAI numëron 49 SAI anëtarë të shteteve evropiane dhe Gjykata Evropiane e Audituesve. Këtë vit EUROSAI përkujton 25 vjetorin e themelimit të saj në Madrid. Organizata ka bërë një rrugë të gjatë që nga momenti i krijimit të saj, duke kryer aktivitete të shumta, duke ndërtuar kapacitete autituese nëpërmjet grupeve të saj të punës dhe organizimit të konferencave e seminareve të përbashkëta me organizatat e tjera rajonale, në zbatim të motos së INTOSAI-t.

Organizata rajonale OLACEFS është struktura e SAI-ve të Amerikës Latine dhe Karaibeve, e cila ka një traditë të gjatë që daton që nga viti 1963. Në atë vit ajo u themelua si Instituti i Shkencave të Auditimit të Amerikës Latine, dhe më vonë, në vitin 1990, mori emrin aktual OLACEFS. Vizioni konceptual i organizatës fokusohet në promovimin e pjesëmarrjes së SAI-ve të rajonit në zhvillimin e tyre të qëndrueshëm dhe përmirësimin profesional, nëpërmjet kryerjes së investigimit shkencor, zhvillimit të studimit, trajnimit dhe specializimit në fushat e ndryshme audituese dhe ofrimit të këshillave teknike, ndihmës dhe koordinimit për SAI-t e Amerikës Latine dhe Karaibeve.

Si EUROSAI dhe OLACEFS organizojnë konferenca të përbashkëta çdo tre vjet, që nga viti 2000. Konferencat janë forumet më të larta të të dy organizatave rajonale, për shkëmbimin e eksperiencave dhe ndërmarrjen e nismave të tjera të përbashkëta, si auditime të koordinuara apo pilote.

Në fund të qershorit, më 24-26 qershor 2015, u zhvillua në kryeqytetin Kuito të Ekuadorit, Konferenca e 8-të e përbashkët EUROSAI-OLACEFS, me pjesëmarrjen e 115 përfaqësuesve nga SAI të Evropës, të Amerikës Latine, të Afrikës dhe të Lindjes së Mesme, si dhe të organizatave ndërkombëtare donatore.

E veçanta e takimit ishte prania e shumë ekspertëve të jashtëm të fushave të ndryshme me rëndësi jetike për auditimin, si arsimi, qeverisja e hapur, kontrolli dhe e-learning (të mësuarit nga interneti), por edhe realizimi i një dialogu të hapur dhe dobiprurës. President i Gjykatës së Audituesve të Brazilit dhe njëkohësisht President i OLACEFS, Z.Aroldo Cedraz de Oliveira, , theksoi se "*integrimi dhe dialogu mes SAI-ve është një mundësi për të ndarë me njeri-tjetrin progresin e arritur dhe për të kombinuar eksperiencat e fituara lidhur me auditimet e koordinuara, mbështetjen për zhvillim, transparencën, etikën dhe të dhënat e hapura (Open Data)*".

Temat qendrore të konferencës ishin "*Auditimet e Koordinuara*" dhe "*Kontributet e SAI-ve në Mirëqeverisje*". Pjesëmarrësit u ndanë në katër grupe pune, ku prezantuan dhe këmbyen eksperiencat e e tyre, në lidhje me praktikat e auditimeve të përbashkëta. Auditimet e koordinuara, jo vetëm kombinojnë disa auditime me të njëjtën temë, të kryera nga SAI të ndryshme në vendet e tyre përkatëse, në bazë të një qasjeje të integruar, por ato kohët e fundit janë parë nga INTOSAI dhe struktura e tij shkencore *"Iniciativa për Zhvillim"(IDI)* si një mekanizëm i fuqishëm për ndërtimin e kapaciteteve. Këto auditime lejojnë njohuritë metodologjike dhe teknike që do të aplikohen për një problem të vërtetë të jetës dhe shoqërisë, duke rezultuar në një raport specifik auditimi për sektorin që auditohet dhe për rajonin. IDI sot po i përdor auditimet pilote të koordinuara si një komponent i një strategjie të mësimit të integruar. Auditimet e koordinuara sigurojnë avantazhe të dallueshme, sepse lehtësojnë bashkëpunimin e ngushtë afatgjatë midis SAI-ve dhe prodhimin e një raporti të konsoliduar auditimi për një çështje të madhe rajonale.

Konferenca theksoi rëndësinë e auditimeve të koordinuara dhe të përdorimit të mjeteve të multimedias e platformave të teknologjisë dixhitale. Diskutimet mes pjesëmarrësve, duke sjellë përvoja konkrete të punës së tyre audituese në vendet përkatëse, dëshmuan se auditimi i koordinuar ofron mundësi të shumta për ngritjen e kapaciteteve dhe që të dy organizatat rajonale, si EUROSAI dhe OLACEFS po punojnë ngushtësisht në këtë drejtim. Audituesit, krahas forcimit të dijeve dhe sigurisë që marrin në përdorimin e metodologjive aktuale të auditimit, thellojnë njohuritë e tyre për çështje specifike të auditimit (p.sh. auditimi i prokurimeve publike, etj.), përmes kombinimit të metodave të trajnimit, siç janë kurset online dhe seminaret. Gjatë fazave të kërkimit dhe të planifikimit, ekspertë të jashtëm të njohur me fushën dhe ndërveprimin rajonal, mund të luajnë një rol kyç për të dhënë siguri të arsyeshme se audituesit kanë informacionin dhe aftësitë që u duhen për të kryer punën e tyre.

Kjo qasje është me rëndësi të madhe edhe për ne si audituesë të KLSH-së, në sfidat tona në punën për përmirësimin e qeverisjes dhe thellimin e luftës kundër korrupsionit. Aty ne mësuam rëndësinë e madhe që i japin organizata si EUROSAI dhe OLACEFS kontributit në auditim të ekspertëve të jashtëm dhe në ngritjen e kapaciteteve audituese, në fusha nga më të ndryshmet.

Konferenca arriti të lidhë me efektshmëri dy temat qendrore të saj me praktikat e auditimit në Evropë, Amerikë Latine, Afrikë dhe Lindje të Mesme, duke trajtuar çështje madhore si ngritja e kapaciteteve të audituesve, etika, inovacioni, sfidat e zhvillimit të qëndrueshëm, transparenca dhe të dhënat e hapura.

Formati inovativ i takimit përfshiu ndërhyrjen para fillimit të sesioneve të punës, të ekspertëve të jashtëm të ftuar, duke sjellë një qasje të re në shkëmbimin e eksperiencave dhe këndvështrimeve të audituesve, të cilat u ballafaquan me opinionet dhe eksperiencat e ekspertëve të jashtëm.

Mesazhi kryesor që Konferenca e 8-të EUROSAI-OLACEFS dha, ishte se ***auditimet e koordinuara mund të ndikojnë pozitivisht në qeverisjen e çdo vendi pjesëmarrës në këto auditime***. Ato forcojnë rolin e secilit SAI në sigurimin e përgjegjshmërisë dhe transparencës në qeverisjen publike, duke përmirësuar mekanizmat e mbikëqyrjes dhe forcuar ndjekjen e rekomandimeve të SAI-ve. Konferenca theksoi se është e domosdoshme që raportet e auditimeve të koordinuara të ndahen me institucionet kryesore publike të një vendi pjesëmarrës në auditim, si dhe me publikun e këtij vendi, në një gjuhë të kuptueshme.

Mendoj se takimet e realizuara nga ne si KLSH në këtë konferencë dhe përvoja e fituar na shërbejnë me qartësi për të realizuar një qasje sa më efektive në fuqizimin e rolit tonë për rritjen e përgjegjshmërisë dhe transparencës së punës dhe rezultateve të administratës publike në Shqipëri.

KLSH DHE SFIDA E LLOGARIDHËNIES PUBLIKE

Botuar në gazetën "Shqip", më 15 korrik 2015

Viti 2014 për Kontrollin e Lartë të Shtetit mund të konsiderohet si viti i konsolidimit të reformës institucionale në përmbushje të objektivit kushtetues dhe ligjor të sigurimit të llogaridhënies publike.

Gjatë veprimtarisë audituese të këtij viti, KLSH reflektoi më së miri dhe është edhe vetëprodukt i ndryshimeve të thella rrënjësore në drejtim të implementimit të kërkesave të standardeve ndërkombëtare të auditimit gjatë ushtrimit të auditimit.

Gjatë këtyre viteve, Organizata e Kombeve të Bashkuara nën lobimin e INTOSAI-t ka miratuar dy rezoluta për Institucionet Supreme të Auditimit, të cilat janë një armë e rëndësishme në punën tonë.

Në përcjelljen e rezolutës së dytë të datës 19 dhjetor 2014, sekretari i përgjithshëm i INTOSAI-t dhe presidenti i Gjykatës Austriake të Auditimit, dr. Josef Moser, shkruan "Ju si SAI mund të ngrini diskutime se si Institucionet Supreme të Auditimit mund të ndihmojnë në progresin e auditimit, kundrejt qëllimeve kombëtare dhe të japin ide se si të matet suksesi, si dhe të identifikojnë dhe nëse ka vend për përmirësim. Për këtë ju kërkoj të intensifikoni përpjekjet për të nxitur qeveritë të rrisin pavarësinë e Institucioneve Supreme të Auditimit dhe të synojnë përfshirjen e tyre në monitorimin e zbatimeve dhe qëllimeve në nivele kombëtare, rajonale dhe globale"

Këtë mesazh të sekretarit të përgjithshëm të INTOSAI-t, ne jemi përpjekur ta përkthejmë në implementimin e plotë të reformave institucionale në institucionin tonë që kanë synuar:

Modernizimin e institucionit në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit; ndërmarrjen e politikave efektive për promovimin e një kulture etike dhe me integritet në institucionin e KLSH-së; implementimin e një strategjie të re komunikimi, duke vendosur në themel të saj transparencën dhe llogaridhënien; menaxhimin efektiv dhe eficent të burimeve njerëzore të KLSH; Forcimin e kapaciteteve institucionale.

Treguesi më i saktë, mendoj unë, është dobishmëria e një institucioni, pra sa lekë janë zbuluar për çdo lek të shpenzuar.

Nëse krahasojmë vitet 2008, 2009, 2010 dhe 2011, pra 4 vite të marra së bashku, me periudhën 2012-2014 konstatohet qartë se për 1 lek të shpenzuar, nga KLSH është zbuluat 47 lekë dëm ekonomik, ndërkohë që për periudhën 2009-2011, për 1 lek të shpenzuar është zbuluar 19 lekë dëm ekonomik.

Pra në drejtim të efektivitetit ne kemi një ecuri shumë të mirë po ta krahasojmë me vitet 2008, 2009, 2010, 2011, duke krijuar kështu një stabilitet në fushën tonë.

Sërish dua t'i referohem Sekretarit të Përgjithshëm të INTOSAI-t, Dr. Josef Moser, i cili në Simpoziumin e vitit 2013 të zhvilluar në Vjenë u shpreh se "Auditimet dhe këshillimet nga SAI janë dy anë të së njëjtës monedhë. Institucionet Supreme të Auditimit mund dhe duhet të rrokin mundësitë që qytetarët të angazhohen, duke shfrytëzuar potencialin e tyre të plotë në përpjekjet për përmirësimin e qeverisjes së mirë publike, vetëm nëse ata zhvillojnë një qasje zhvillimi në bazë të punës së tyre audituese, e cila ofron rekomandime specifike, si për subjektet e audituara, ashtu edhe për menaxherët qeveritarë, rekomandime të cilat mund të zbatohen praktikisht në sferat e tyre përkatëse të veprimit".

Në rast se u referohemi shifrave të auditimeve dhe bëjmë një krahasim midis vitit 2013 dhe 2014, duket qartë që ne kemi një progres të ngadaltë, por gjithsesi është progres në auditimet e performancës.

Kur unë e fillova detyrën tre vite e gjysmë më parë, vendosa si sfidë fillimin e auditimeve të performancës. Përvoja jonë në këtë fushë praktikisht ishte zero. Mbas një procesi binjakëzimi 2-vjeçar në vitet 2006- 2007 nga KLSH nuk ishin kryer më auditime performance.

KLSH, në këtë drejtim, ka ecur me hapa të ngadaltë, por të sigurt. Në vitin 2013 janë kryer 6 auditime performance, në 2014 janë kryer 8 auditime dhe në 2015 pretendojmë të kryejmë 10 auditime performance.

Gjatë vitit 2014, në 160 auditime të evaduara sipas planit, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka arritur të zbulojmë një dëm ekonomik prej rreth 91 milionë dollarësh ose 11.198.000.000 lekë. Vetëm në këtë 6-mujor, ne kemi zbuluar një dëm ekonomik prej 138 milionë dollarësh ose 16,975,000,000 lekë.

Natyrisht shifrat nuk janë qëllim në vetvete, por për mendimin tim janë treguesi më i mirë i punës. Shifrat konkrete të dala nga puna audituese e Institucionit Suprem të Auditimit i japin Kuvendit dhe taksapaguesve një panoramë të qartë për përdorimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike.

Ne e kemi ndarë dëmin ekonomik sipas fushave dhe gjetjet kryesore të auditimeve dhe vijmë tashmë tek rekomandimet. Natyrisht rëndësia kryesore e një Institucioni Suprem Auditimi është tek rekomandimet dhe sa këto rekomandime pranohen nga ai subjekt që ai auditon. Detyra jonë natyrisht është të luftojmë deri në fund për zbatimin e rekomandimeve. Ne përgjithësisht dëmin ekonomik të zbuluar e rekomandojmë tërësisht në masën 99% për t'u zhdëmtuar. Natyrisht këtu ka shumë për të bërë, pasi

zhdëmtimi i dëmit është pjesë e shqyrtimit administrativ nga subjekti dhe e shqyrtimit nga organet e gjyqësorit.

Megjithatë ne përpiqemi të jemi konsistent dhe rekomandimet tona janë edhe rekomandime përmirësime në fushën ligjore, rekomandime në fushat administrative dhe atë disiplinore, etj.

Kështu, KLSH ka propozuar 82 ndryshime legjislacioni në vitin 2013, 88 ndryshime në vitin 2014 dhe në këtë 6-mujor kemi propozuar 19 ndryshime legjislacioni.

Ndër rekomandimet kryesore që ne kemi dhënë dhe që mendoj se janë me interes është edhe rekomandimi për borxhin publik. Sa i përket borxhit publik, i cili është një problem madhor dhe shqetësues për të gjitha ekonomitë e vendeve si Shqipëria dhe Kosova apo dhe vendeve me më shumë traditë (përvoja e hidhur Greke flet shume në këtë drejtim), ne kemi propozuar që sipas përvojës polake të vendoset në Kushtetutë kufizimi i borxhit publik në masën 60% të PBB. Në Shqipëri, në këto vite, borxhi publik ka lëvizur shumë dhe tani mund të ketë kaluar deri te 70%. Ky borxh 5 ose 6 vite më parë ishte në kufijtë e 60%. Megjithatë, kjo nuk duhet të na pengojë ne që të vazhdojmë të insistojmë që brenda një 5-vjeçari apo 10-vjecari borxhi të kalojë në këto parametra. Borxhi publik është një rrezik i madh për financat publike në të ardhmen.

Rekomandimi i dytë që ne i kemi dhënë Kuvendit të Shqipërisë është ai për ngritjen e një Këshilli Fiskal, i cili duhet të gëzojë statusin e një institucioni publik të pavarur dhe që duhet të ketë pavarësi rigoroze dhe shumë strikte nga politika. Natyrisht, ky Këshill Fiskal do të jetë i zgjedhur nga Kuvendi, do të ketë përfaqësues të qeverisë dhe do të jetë mbi palët.

Një rekomandim tjetër që i kemi dhënë Kuvendit për gjatë këtyre dy viteve e insistojmë në vazhdim është rekomandimi që Kuvendi të ndërmarrë nismën për hartimin e Ligjit për Përgjegjësinë Materiale. Për të gjithë nëpunësit e administratës publike të nivelit të mesën, të lartë, shumë të lartë dhe titullarët e institucioneve duhet të ketë një ligj që ata të përgjigjen jo vetëm penalisht, por të përgjigjen dhe materialisht. Pra ligji duhet të trajtojë në mënyrë eksplicite këto përgjegjësi të nëpunësve të administratës. Këto përgjegjësi trajtohen edhe sot, por janë shumë të shpërndara dhe është shumë e vështirë për ne. Zbatimi i këtyre rekomandimeve paraqitet i vështirë.

Përveç të tjerave, ne përpiqemi të propozojmë edhe masa me karakter organizativ e masa me karakter disiplinore dhe te masat disiplinore dua të ngre një shqetësim.

Përgjithësisht, masat tona administrative dhe disiplinore zbatohen ne kufijtë 65-70% dhe ky është një tregues i kënaqshëm për sa i përket masës disiplinore "largim nga detyra". Por për drejtuesit e nivelit të lartë, zbatimi i kësaj mase është shumë i ulët, pra në nivelin 20-30%.

Kjo tregon që gradualisht në vendet tona, sa më lart ngjitesh, aq më shumë instalohet kultura e pandëshkueshmërisë. Të gjithë konstatojmë se në përfundim të një auditimi, kur subjektet përcjellin informacionin për zbatimin e rekomandimeve, evidentohet qartë se për nëpunësit e thjeshtë janë zbatuar masat, është zbatuar largimi nga detyra, kurse drejtuesi më i lartë, ai që ka dhënë dhe urdhrat, nuk cenohet, nuk preket. Madje, ndonjëherë këta drejtues edhe kur ne bëjmë kallëzim penal, duke qenë se nuk kanë firmosur nuk i përcjellim në prokurori.

Pavarësisht trysnive apo sfidave që ne kemi nga të gjitha anët, ne jemi në ecjen tonë midis ***Scylla and Charybdis***, ndaj duhet t'i qëndrojmë besnik parimit themelor të auditimit: Audituesi jep opinionin e tij të pavarur e profesional vetëm mbi ato që janë të shkruara. Ai nuk merret me fjalë, nuk merret me thashetheme. Ashtu siç e theksojnë dhe standardet, audituesi duhet të karakterizohet nga skepticizmi profesional, por audituesi nuk duhet të abuzojë me detyrën.

Sa u përket kallëzimeve penale, nga viti 2008 deri në vitin 2011 kemi një numër të ulët dhe në rast se e krahasojmë periudhën 2012-2014 me 4 vitet e mëparshme konstatohet se kemi një numër 2,2 herë më të lartë të subjekteve të kallëzuara penalisht nga ana jonë dhe 2,7 herë më shumë persona.

Për 6-mujorin e parë të vitit 2015, ne kemi 25 kallëzime penale, çka dëshmon punën intensive dhe profesionale të audituesve tanë për zbulimin e rasteve korruptive dhe abuzive të shpërdorimit të parasë publike.

Këtu dua të theksoj diçka mjaft të rëndësishme. Institucionet Supreme të Auditimit si në Shqipëri ashtu dhe në Kosovë e kanë detyrë të kryejnë kallëzimet penale. Vendet tona janë shumë të ndjeshme ndaj korrupsionit dhe korrupsioni nuk ka ngjyrë. Ai nuk është as i kuq, as blu, d.m.th nuk i përket asnjë partie. I përket asaj pjese të administratës së korruptuar apo asaj pjese të politikës së lartë të korruptuar që nga ana jonë si Institucione Supreme Auditimi, duhet luftuar, pasi në këtë mënyrë ne kontribuojmë në thellimin e llogaridhënies.

Gjithashtu ne jemi përpjekur dhe po mbajmë një ritëm mjaft të mirë me prezencën tonë në media, duke e konsideruar median aleaten tonë më të fortë. Gjatë vitit 2014, 50 audites kanë publikuar 134 shkrime në median e shkruar, nga 128 shkrime të publikuara në vitin 2013. Këto shkrime ne i përmbledhim në një botim 6-mujor "Audituesit e KLSH-së në shtypin e shkruar".

KORRUPSIONI SISTEMATIK DHE INFORMALITETI

Botuar në gazetën "Panorama", më 11 tetor 2015

Që në vitet e para të tranzicionit ekonomik dhe politik të Shqipërisë e deri në momentin aktual, korrupsioni dhe informaliteti kanë qenë fenomene shoqëruese dhe shqetësuese për ekonominë e vendit. Aktualisht publiku shqiptar, përpos ngjarjeve dhe mesazheve me natyrë politike, po përballet pikërisht me debate dhe akuza për korrupsionin, por të pashoqëruar me aksione të forta kundër tij. E vetmja luftë e paralajmëruar dhe tashmë e filluar është aksioni aktual kundër informalitetit shoqëruar me ndryshimet ligjore, të cilat rritën ndjeshëm gjobat për aktivitetet informale. Lidhur me këtë të fundit, e ndiej të nevojshme të theksoj se institucioni i KLSHsë, të cilin përfaqësoj, e përshëndet aksionin qeveritar kundër informalitetit dhe përkrah çdo përpjekje për të vendosur autoritetin e plotë të shtetit në detyrimet fiskale. Por, nga ana tjetër, gjykojmë se gjatë ushtrimit të disiplinës fiskale duhet bërë shumë kujdes. Mjeti duhet të jetë në funksion të qëllimit. Përpjekjet për kufizimin e informalitetit mund të sjellin një rezultat të kompromentuar. Teprimi i kontrolleve dhe presioneve tatimore mbi aktivitete modeste, por të shumtë në numër, të tillë si librashitësit, këpucarët, berberët, fermerë etj. rrezikon mos të japë kontributin e shpresuar në luftën kundër informalitetit. Biznesit të vogël dhe sidomos të vetëpunësuarve u duhet dhënë kohë e mjaftueshme të formalizohen. Jo vetëm pse janë me dhjetëra mijëra aktivitete, por edhe se përbejnë sektorin që siguron punësimin më të madh në vend. Vështirësitë me të cilat mund t'i përballë aksioni antiinformalitet rrezikon të shkaktojë kosto të rënda ekonomike dhe shoqërore. Për këtë arsye mendojmë se disiplinimi fiskal i kësaj kategorie nuk duhet të bazohet vetëm dhe thjesht me kontrolle, gjoba e sekuestrime malli në demonstrim të një agresiviteti të skajshëm. Është e lehtë të frikësosh biznesin e vogël dhe të vetëpunësuarit, por është e vështirë të rikthesh besimin e tyre tek ambienti ekonomik dhe sidomos të përballesh me pasojat. Mendojmë se duhen gjetur urat e komunikimit, fokusuar sidomos në mjetet e ndërgjegjësimit me synim arritjen e qëllimit të rritjes së të ardhurave publike. Ndryshimet ligjore me rritjen e gjobave për të gjitha kategoritë e bizneseve i vënë këta të fundit përballë riskut të falimentimit. Logjikisht, masat ndëshkimore duhet të synojnë zhdëmtimin e shtetit për dëmin e shkaktuar, si dhe të ndëshkojnë biznesin shkelës në mënyrë që ta nxisë drejt një aktiviteti të ligjshëm. Solidariteti ynë për ndëshkimin e aktiviteteve informale nuk mbetet i tillë për çdo nivel gjobe. Duhet treguar kujdes në përcaktimin e sanksioneve ligjore në mënyrë që të arrijmë synimet e rritjes së të ardhurat publike dhe njëkohësisht krijimin e një klime sa më të përshtatshme për të bërë biznes. Një ndëshkim në masën 500 mijë lekë për një biznes të vogël rrezikon të sjellë automatikisht falimentimin për një pjesë të tyre, të cilët as kapitalin nuk e kanë në këtë masë. Kjo gjobë në nivel të lartë dhe për më tepër joproporcionale me nivelin e evazionit, përveç dyshimeve rreth efektivitetit të saj, shkon si masë që shkakton

falimentimin e subjektit të gjobitur. Shqetësimet e Dhomës Amerikane të Tregtisë për pasojat negative që aksioni kundër informalitetit ka dhënë në më pak se një muaj nga miratimi i nivelit të ri të gjobave, duhen marrë në konsideratë si një sinjal paralajmërues.

LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT DUHET TË PREVALOJË MBI ATË KUNDËR INFORMALITETIT

Kur koncepti i informalitetit u prezantua për herë të parë në fillim të viteve '70 të shekullit të kaluar, ai u konsiderua si një fenomen i përkohshëm, që besohej se do të zhdukej në ekonomitë e zhvilluara. Por realiteti provoi të kundërtën. Paralelisht me rritjen ekonomike, ndërmarrjet informale, aktiviteti i pataksuar dhe punësimi informal vazhduan të jenë pjesë integrale e ekonomive të vendeve në zhvillim, duke përbërë (përfshirë edhe Shqipërinë) më shumë se një të tretën e produktit të brendshëm bruto. Sektori informal, i referuar nga literatura profesionale si "ekonomia hije" ose "e nëndheshme" (Shnaider dhe Enste, 2000) ose "aktivitet jozyrtar" (Friedman dhe të tjerë, 2000), qëndron si barrierë ndaj rritjes së të ardhurave fiskale dhe përmirësimit e shtimit të shërbimeve publike. Kufizimi i informalitetit ndikon në mënyrë direkte në përmirësimin e qeverisjes publike. Puna për minimizimit e tij mund të shihet si një e mirë publike. Por duhet të theksojmë se sektori informal nuk është armik i shoqërisë dhe ekonomisë. Armiku i mirëfilltë, kundërshtari më i madh, është korrupsioni. Ish-Sekretarja Amerikane e Shtetit, Hillary Clinton, në fjalën përpara Kuvendit të Shqipërisë (nëntor 2012) korrupsionin e ka përshkruar si "kanceri që gërryen shoqëritë, shteron burimet dhe bllokon rritjen ekonomike". Edhe Bashkimi Europian, në të gjitha raportet e progresit të Shqipërisë, thekson përpara politikanëve dhe vendimmarrësve tanë publikë nevojën parësore për ta luftuar në sistem dhe me efektshmëri korrupsionin, duke e listuar si një nga prioritetet kryesore. Kjo është një detyrë shtëpie që nuk mund të harrohet, vonohet apo anashkalohet për asnjë arsye apo të mbulohet me petkun e luftës ndaj informalitetit të prodhuar nga biznesi i vogël dhe i madh. Informaliteti dhe përpjekjet për ta kufizuar atë përfshihen natyrshëm në luftën totale kundër korrupsionit. Por e kundërta nuk është e vërtetë. Të kufizosh informalitetin nuk do të thotë se njëherazi ke luftuar me efektshmëri të gjithë korrupsionin. Nëse në inkurajimin e informalitetit në shkallë të lartë "kontribuojnë" zakonisht nëpunësit e mesëm dhe të vegjël të shtetit, korrupsionin që infekton sistemin e administrimit publik në tërësi dhe informalitetin në kompanitë e mëdha, e prodhojnë drejtuesit e lartë të korruptuar. Këta janë varrmihësit e vërtetë të besimit të qytetareve te shteti dhe autoriteti i tij, sidomos kur, edhe pasi denoncohen si abuzues nga institucione të ndryshme, vijojnë të qëndrojnë në detyrat e tyre. Të gjithë si drejtues të lartë të administratës, institucioneve dhe politikes, gjatë gjithë kësaj periudhe tranzicioni 25vjeçare, duhet të pranojmë gabimet në trajtimin e nëpunësve të lartë të korruptuar dhe mbajtjen gjallë e madje edhe lulëzimin e antikulturës së Kontrolli i Lartë i Shtetit, si institucioni suprem i auditimit

publik në vend, vëren me shqetësim se antikultura e pandëshkueshmërisë, jo thjesht është ende e pranishme, por mbi të gjitha po konsolidohet në gjirin e administratës publike. Gjatë kësaj kohe jemi përpjekur të japim kontributin tonë institucional në përmirësimin e qeverisjes publike, nëpërmjet rekomandimeve të dhëna në fund të raporteve tona të auditimit, kallëzimeve penale etj. Nëse për katërvjeçarin 20082011 numri i kallëzimeve penale të KLSHsë ishte 52, në tre vjet e gjysmë, janar 2012 gusht 2015, ky numër është 159, ose kemi dërguar ne Prokurori mbi tri herë më shumë kallëzime penale për qindra nëpunës të mesëm dhe të lartë të shtetit. Mes të tjerëve, janë kallëzuar drejtorë të përgjithshëm ministrish, sekretarë të përgjithshëm, drejtorë drejtorish etj. Njëkohësisht jemi përpjekur të rrisim cilësinë e dosjeve për kallëzim penal dhe shkurtuar kohën e përgatitjes së kallëzimit. Por, ndërsa jemi plotë sisht të ndërgjegjshëm se kemi shumë për të bërë, vërejmë se denoncimet tona nuk sigurojnë sensibilizimin dhe mbështetjen e duhur shtetërore. Krahas kallëzimit në Prokurori, për këta zyrtarë ne rekomandojmë dhe largimin e tyre nga detyra. Por këto rekomandime të KLSHsë për largim nga puna dhe shërbimi civil të zyrtarëve të lartë, të gjetur nga ne në abuzime dhe korrupsion, nuk zbatohen. Jemi vendosur, pa dashjen tonë, vetëm në pozicionin e fryrësit të bilbilit, si denoncues të abuzimeve, gjetës të gjurmës së korrupsionit dhe shpesh, madje, edhe të realizuesve të tij, por kemi shumë raste kur këta abuzues të lartë jo vetëm nuk janë larguar nga administrata publike, por kanë bërë karrierë po në këtë administratë edhe në pozicione më të larta. Këto veprime dekurajojnë edhe prokurorë të veçantë, të cilët hetojnë dosjen e dërguar nga ne. Kjo është një situatë e papranueshme në aspiratat tona për krijimin e një administrate publike të përgjegjshme që përpiqet të ndërtojë dhe forcojë shtetin ligjor.

LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT – SFIDË E QEVERISJES SË DREJTË DHE TË NDERSHME

Gjykojmë se sot më shumë se kurrë lufta kundër korrupsionit dhe rritja e përgjegjshmërisë dhe transparencës së administratës publike është sfida madhore e qeverisjes. Sipas studiuesit të njohur ndërkombëtar të korrupsionit dhe pasojave të tij në publik, Robert Klitgaard, në kuptim të gjerë, korrupsioni është keqpërdorimi i zyrës shtetërore për qëllime jozyrtare. Katalogu i akteve korruptive përfshin ryshfetin, detyrimin, ndikimin, nepotizmin, mashtrimin, përvetësimin dhe edhe më shumë. Korrupsioni përshkruhet kudo si një "kancer". Ai shkel besimin e publikut në shtet dhe rrezikon kohezionin social. Korrupsioni i madh (në shuma të mëdha) raportohet me frekuencë të rritur në vendet e pasura dhe të varfra njësoj. Korrupsioni në përmasa të vogla është më pak i raportuar. Ndërkohë në Shqipëri, po bëjmë të kundërtën. Trumbetojmë me të madhe korrupsionin te zyrtaret e rangut të ulët, si infermierë, policë ose punëtorë dhe "harrojmë" atë në gjirin e zyrtareve të lartë, që sjell abuzime në mijëra e miliona euro. Por a ka rrugëdalje? Sigurisht që ka. Nëse ekziston një vullnet i fortë nga

maxhoranca në pushtet, sistemi mund t'i rezistojë korrupsionit. Madje ka ndodhur që sisteme të shkatërruara janë ringritur dhe përmirësuar duke e pakësuar korrupsionin. Por, nga ana tjetër, kur debatet dhe sloganet politike kthehen qëllim në vetvete, korrupsioni rrezikon të rregullat e lojës. Kundër tij duhet të mobilizohemi të gjithë. BURIMET E KORRUPSIONIT Literatura botërore jep shembuj të shumtë teorikë dhe praktikë të ndërthurjes së korrupsionit me informalitetin, duke qenë se ky i fundit e ushqen vazhdimisht të parin. Në mënyrë metaforike, korrupsioni ndjek formulën e Klitgaard: K = M + S – P ku K është korrupsioni, M monopoli, S sasia që mund të përfitohet nga korrupsioni (e quajtur ndryshe fuqia diskrecionale e korrupsionit, liria e veprimit të tij) dhe P është përgjegjshmëria, llogaridhënia. Pra korrupsioni është i barabartë me monopolin, plus liri veprimi e tij dhe minus llogaridhënien. E thënë ndryshe, nëse aktiviteti është publik, privat, apo jofitimprurës, kudo ku ju të jeni, korrupsioni do të jetë shumë i mundshëm, kur dikush, duke filluar nga shtetari i lartë, ka fuqinë e monopolit mbi një mall apo shërbim, ka fuqinë për të vendosur nëse ju do ta përfitoni atë dhe sa do të përfitoni, si dhe nuk është i përgjegjshëm. Nuk duhet harruar se korrupsioni është një krim përllogaritjesh. Kur madhësia e ryshfetit është tepër e madhe, shanset për t'u kapur tepër të vogla dhe dënimi shumë i ulët, aq më i madh do të jetë tundimi për zyrtarët e administratës publike. Për këtë arsye, gjykoj se lufta kundër korrupsionit duhet të fillojë në themel. Krijimi gradualisht i një sistemi ligjor që dekurajon seriozisht korrupsionin shoqëruar nga ndërtimi i një administrate publike të përgjegjshme, do të zhdukte kulturën e pandëshkueshmërisë dhe incentivat për të abuzuar me fondet dhe detyrat publike.

LLOGARIDHËNIA DHE TRANSPARENCA, ARMIQTË E KORRUPSIONIT

Llogaridhënia dhe transparenca përfshijnë një gamë të gjerë çështjesh. Asnjë prej tyre nuk ndodhet në atë që shumica prej nesh mendojnë menjëherë kur përmendet korrupsioni: ligje të reja, kontrolle më të shumta, një ndryshim në mentalitet dhe një evolucion etik. Ligjet dhe kontrollet mund të jenë të pranishme, por janë sistemet ato që mungojnë për t'i zbatuar ligjet. Llogaridhënia dhe transparenca janë dy shtyllat e domosdoshme të qeverisjes së mirë. Pa fuqizuar njërën, nuk mund të qëndrojë në këmbë tjetra. Veprimtarët joqeveritarë që sigurojnë llogaridhënien dhe transparencën në një vend demokratik janë institucionet supreme të auditimit dhe shoqëria civile dhe, për kushtet specifike të vendit tonë, edhe partneret ndërkombëtare. Institucionet supreme të auditimit (SAI-t), me punën e tyre zvogëlojnë arbitraritetin në aplikimet e rregullave dhe ligjeve financiare e administrative, duke ndihmuar në thjeshtimin e procedurave administrative, veçanërisht kur ato pengojnë funksionimin normal të tregjeve. SAItë mund të ekspozojnë në publik vendimmarrjen qeveritare jotransparente, në rast se është e qartë që kjo e fundit shkon në dëm të interesit publik. Shumica e sondazheve në vendet e zhvilluara tregojnë se shumë qytetarë nuk besojnë se qeveritë e tyre veprojnë

gjithmonë në interes të publikut. SAI-t shihen gjerësisht si vëzhgues dhe ruajtës të pavarur të interesit publik dhe në këtë mënyrë janë të pozicionuara shumë mirë për të nxitur llogaridhënien, transparencën dhe sjelljen etike në administrimin publik. Nëse informacioni dhe pastaj transparenca e punës së SAIve lejojnë llogaridhënien të jetë efektive, raportimet në publik dhe disponueshmëria e informacionit e SAIve i bëjnë qeveritë më të dukshme në sytë e qytetarit. Në këtë kontekst, gjykojmë se maxhoranca dhe opozita duhet t'i krijojnë të gjitha bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë.

PLOTËSIMI I EKUACIONIT TË KLITGAARD

Duke realizuar këtë proces, SA-t mund ta rishkruajnë ekuacionin e Klitgaard si më poshtë: K = M + S – P(T, LL) ku vetë përgjegjshmëria "P" është një funksion i transparencës "T" dhe llogaridhënies "LL". Ne si shoqëri, dhe në radhë të parë si institucione publike, në bashkëveprim me shoqërinë civile dhe partnerët ndërkombëtarë, duhet të rrisim pikërisht këta dy faktorë, llogaridhënien "LL" dhe transparencën "T", me qëllim që të zvogëlojmë korrupsionin. Institucionet supreme të auditimit (SAItë) në vendet më të zhvilluara të Europës dhe në të gjithë botën, janë rreshtuar për një aleancë të gjerë efektive në luftën kundër korrupsionit, ku natyrshëm integrohen në një punë të përditshme (dhe jo vetëm me deklarime nëpër seminare dhe konferenca) shoqëria civile, opozita dhe institucionet e pavarura kushtetuese. Mendojmë se deri tani kjo aleancë te ne ka qëndruar thjesht në letër dhe ka qenë deklarative. Funksionimi real i aleancës nuk varet vetëm nga vullneti i institucioneve të pavarura për sinergjizim të veprimtarive (KLSH, Prokurori apo ILDKPP etj.), por nga vullneti i fortë dhe politikat e mira të prodhuara nga qeverisja shoqëruar me veprime të sinergjuara në këtë fushë dhe punë konkrete, duke lënë mënjanë deklaratat dhe frazat deklarative.

PËRVOJA GREKE SI MËSIM

Kriza e sotme nga e cila po përpiqet të dalë Greqia, më së shumti është njohur si krizë e borxhit. Në fakt e tillë është. Por si u gjend një vend i Bashkimit Europian në një situatë të tillë. Shkaktarët janë korrupsioni, informaliteti dhe sidomos keqmenaxhim i fondeve publike. Rritja e vazhdueshme e nivelit të borxhit pa rritur në të njëjtat nivele investimet, punësimin dhe të ardhurat publike e përballi Greqinë me pamundësinë financiare për të shlyer detyrimet në kohë. Njëkohësisht me këtë, politikat populiste nxitën informalitetin, duke e bërë të vështirë rikthimin e një regjimi fiskal në vend. Zyrtarët e lartë të qeverive të ndryshme, të cilët kanë qenë shkaktarët dhe shpesh përfituesit e huamarrjes në nivele të larta, pothuajse nuk u ndëshkuan. Ata që janë duke paguar gabimet e së shkuarës janë qytetarët, të cilët përballen me masat shtrënguese ekonomike. Çfarë mund të mësojë Shqipëria nga ajo çka ndodhi në Greqi? Së pari, duhet intensifikuar lufta kundër korrupsionit, sidomos në sferat e larta më së pari. Ka ardhur koha për një luftë të drejtpërdrejtë dhe të hapur ndaj tij. Luftës së zbehtë dhe frazave

deklarative u ka kaluar koha. Aferat e herëpashershme korruptive me dëme disa miliona euro në buxhetin e shtetit krijojnë një gropë gjithnjë e më thellë në ekonominë shqiptare. Dëmet që ky fenomen shkakton në financat publike pengojnë aspiratat tona për shërbime më të mira publike, ekonomi më të zhvilluar dhe integrim në Bashkimin Europian. Në këtë kontekst, do doja të citoja Zv.Presidentin e SHBA-ve, Joy Biden, i cili në Samitin Global të Sipërmarrjes (nëntor 2014) ka thënë: "Të luftosh korrupsionin nuk është thjesht një mirëqeverisje. Është vetëmbrojtje. Është akt patriotik" Së dyti, kërkohet një vëmendje e shtuar ndaj informalitetit në nivele të larta. Duke ritheksuar se rregulli vlen njësoj edhe për bizneset e vogla, kërkojmë të rrisim sensibilizimin drejt atyre niveleve të informalitetit të prodhuar nga bizneset e mëdha që dëmtojnë vërtet ekonominë në një periudhë afatgjatë. **Dhe së treti, është koha të rrisim përgjegjshmërinë dhe kujdesin në like dhe private rrezikon të dobësojë potencialin e ekonomisë për të shlyer borxhe.** Pa investime shtesë nuk ka të ardhura shtesë. Sado të përpiqemi të rrisim të ardhurat publike nëpërmjet aksioneve kundër informalitetit do të jetë gjithnjë e më e vështirë të kemi rezultat nëse ekonomia nuk do të rritet në nivelet e duhura. Korrigjimi i fundit i rritjes së parashikuar ekonomike nga FMN, e bën akoma më të rëndësishëm rritjen e përgjegjshmërisë qeverisëse.

PËR NJË ZBATIM KOHERENT TË STRATEGJISË SË MENAXHIMIT TË FINANCAVE PUBLIKE

Botuar në gazetën "Shqip", më 2 dhjetor 2015

Strategjia "Për Menaxhimin e Financave Publike 2014-2020", e përgatitur nga Ministria e Financave, me ndihmën e ekspertëve të Bashkimit Europian dhe e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 908 17 dhjetor 2014, përmban gjashtë shtylla kryesore: kuadër i qëndrueshëm dhe i matur fiskal; planifikim dhe buxhetim i mirintegruar dhe efikas i shpenzimeve publike; ekzekutim efikas i Buxhetit të Shtetit; raportim transparent financiar qeveritar; kontrolle të brendshme efektive, si dhe mbikëqyrje e jashtme efektive e financave publike.

Po përfundon viti i dytë dhe konstatojmë se janë bërë përpjekje pozitive nga Ministria e Financave për zbatimin në disa drejtime të strategjisë, por ende mbetet shumë për të realizuar. Nga ana tjetër, vërejmë mungesë koordinimi mes institucioneve të tjera për zbatimin e strategjisë. Përgjegjësia e mbarëvajtjes së saj nuk mund t'i lihet tërësisht ministrit të Financave dhe strukturës së tij. Ministria e Financave nuk ka pse të mbetet e vetme në këto përpjekje, por duhet ndihmuar nga të gjitha institucionet kryesore të shtetit.

Sikurse e thotë edhe vetë ky dokument strategjik: *"Ndërsa përgjegjësia e përgjithshme për mbikëqyrjen e zbatimit të reformave i takon Ministrisë së Financave, Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike përfshin të gjithë sektorin qeveritar, Kontrollin e Lartë të Shtetit dhe Parlamentin. Kështu, përgjegjësia e përgjithshme për zbatimin e suksesshëm të Strategjisë ndahet midis të gjithë aktorëve të sektorit publik".*

Sikurse e përmendëm më sipër, një nga shtyllat e strategjisë dhe kushti themelor për një zhvillim të bazuar ekonomik të vendit, është kuadri i qëndrueshëm dhe i matur fiskal. Në nëntor 2015, në raportimin përpara Komisionit të Ekonomisë për zbatimin e buxhetit të konsoliduar të shtetit për vitin 2014, si KLSH kemi kërkuar të mos ndërhyhet shpesh në buxhet. Ndërhyrjet e shpeshta (në tetë vitet e fundit, buxheti është rishikuar një deri dy herë çdo vit gjatë zbatimit të tij) sjellin konfuzion në veprimtaret ekonomike dhe dobësojnë qëndrueshmërinë dhe besueshmërinë e politikave fiskale e financiare të shtetit. Buxheti është një kontratë midis qytetarëve dhe qeverisë. Besueshmëria e tij bazohet në qëndrueshmërinë që tregon. Në shkelje të parimeve të FMN dhe OECD për një buxhet të qëndrueshëm, ndryshimet që reflektohen nga miratimi i Akteve Normative e cenojnë kredibilitetin e buxhetit. Shkak i këtyre ndërhyrjeve është praktika e programimit me tregues tejet optimistë, pa një proces të kujdesshëm dhe pa monitorimin e duhur nga strukturat në qendër dhe në bazë, apo, pse

jo, dhe parregullsitë në zbatimin e tij. Vërejmë me shqetësim se një situatë e tillë po përsëritet edhe në procesin e përgatitjes së buxhetit të shtetit për vitin 2016. Nuk ka një konsultim konkret, të hapur dhe të qëndrueshëm me veprimtaret kryesore të buxhetit, komunitetin e biznesit dhe shoqërinë civile. Çka shkon ndesh me shtyllën e dytë të Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike për planifikim dhe buxhetim të mirintegruar dhe efikas të shpenzimeve publike. Madje, nga shumë shoqata të konsoliduara të komunitetit të biznesit, nëpërmjet mediave kanë ardhur zhgënjime, krahas vërejtjeve të shumta, jo vetëm për përmbajtjen, por edhe për mënyrën se si është përgatitur draftbuxheti që tani po diskutohet në Komisionin e Ekonomisë të Kuvendit dhe shpejt do të marrë formë përfundimtare për t'u miratuar si ligj, për lënien e tyre totalisht jashtë procesit të konsultimit.

Si KLSH, në nëntor në Komisionin e Ekonomisë kërkuam përmirësimin e procesit të programimit të buxhetit, në drejtim të garantimit të kredibilitetit të tij, me anë të një politike fiskale të qëndrueshme, në respekt të plotë të objektivave fiskalë afatmesëm të përmbajtur në strategji. Kemi kërkuar objektiva fiskalë të qartë, që u lehtësojnë njerëzve dhe sipërmarrësve të kuptuarit e kursit të qeverisë për politikat fiskale në të gjithë ciklin ekonomik. Vetëm kështu buxhetimi shndërrohet në gur themeli në arkitekturën e besimit mes shtetit dhe qytetarëve të tij. Konsultimi i hapur dhe i vijueshëm me shoqërinë civile dhe me komunitetin e biznesit e ndihmon procesin dhe përshpejton arritjen e një buxheti kredibël. Vërejmë se edhe në procesin e përgatitjes se projektbuxhetit të shtetit për vitin 2016, këto kërkesa nuk janë marrë parasysh nga qeveria. Kemi më shumë një rendje për të fituar pike politike dhe zgjedhore, për të deklaruar një buxhet sërish tejet optimist, i cili, në fryrjen e treguesve të tij tej çdo parashikimi objektiv, parathotë sërish për vitin 2016 ndryshime në zërat buxhetorë, nivel të lartë të detyrimeve, si dhe mundësi e qeverisë për të shkurtuar zëra të caktuar, të cilët janë që të gjithë tregues të një kredibiliteti të ulët, sipas manualeve të FMN dhe OECD.

Konstatojmë po me shqetësim se, me gjithë parashikimin tejet optimist të qeverisë për uljen e borxhit publik brenda vitit 2016, situata me menaxhimin e tij është jo optimiste. Vetëm për vitin 2014, duke shtuar edhe mbështetjen buxhetore me kredi nga Banka Botërore dhe FMN, borxhi publik arriti në 71.76% të Produktit të Brendshëm Bruto. Në fund të këtij viti, ai parashikohet të rritet akoma dhe më shumë. Si KLSH i kemi rekomanduar në mënyrë të përsëritur Ministrisë së Financave dhe Kuvendit, marrjen e masave për hartimin e një kuadri rregullator fiskal, i cili të synojë reduktimin e borxhit publik në nivele të përcaktuara qartë, në mënyrë që brenda një periudhë 3-vjeçare, të sigurohet që treguesi i borxhit publik të arrijë në nivelin 60% të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) të vendit. Jemi të vetëdijshëm që kjo është e vështirë, por le të ecim sipas objektivave të përcaktuar në këtë strategji (pra, për vitin 2017 borxhi publik të

reduktohet në 65.5% të Produktit të Brendshëm Bruto dhe në vitin 2020 të jetë 56.7 për qind e PBB-së). Kjo kërkon marrjen e një nisme ligjore për vendosjen në Kushtetutë dhe në Ligjin "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të niveleve të pranueshme të borxhit publik ndaj PBB, sipas parashikimeve të strategjisë së mësipërme, duke u bazuar në kushtet makroekonomike të vendit. Vetëm me parashikime optimiste njëvjeçare për uljen e këtij borxhi, në momentin e përgatitjes së projektbuxhetit të vitit të ardhshëm, nuk mund të jemi efikase, dhe, sidomos, nuk mund të zbatojmë me sukses strategjinë e menaxhimit të financave publike 2014-2020. Kemi kërkuar që Ministria e Financave, në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, të kryejë një analizë të thelluar të situatës së menaxhimit të borxhit publik, me synim evitimin e humbjes së besueshmërisë së vendit ndër kreditorët e huaj. Kemi rekomanduar që vendimmarrjet për marrjen përsipër të detyrimeve financiare nga Republika e Shqipërisë, të jenë vendimmarrje politike që sigurohen nëpërmjet ratifikimit të tyre në Kuvendin e Shqipërisë, dhe jo vendime të Këshillit të Ministrave.

Me synim kontrollin e risqeve të portofolit të borxhit publik dhe mirëmenaxhimin e riskut të kursit të këmbimit, kemi rekomanduar që prioritet të jetë mbajtja nën kontroll e borxhit të jashtëm(i cili është në valutë), duke vendosur një tavan vjetor për totalin e borxhit të jashtëm brenda borxhit publik, si dhe orientimin në drejtim të titujve qeveritarë me afat të gjatë maturimi, të cilët përmirësojnë strukturën e borxhit të brendshëm dhe reduktojnë riskun e rifinancimit.

Në monitorim të zbatimit të shtyllës së katërt të Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020 për raportim transparent financiar qeveritar, kemi konstatuar ne dhe së bashku me Ministrinë e Financave, mungesë të një baze të unifikuar të mbajtjes së kontabilitetit, adresime të ndryshme të përgjegjësisë, si dhe pasqyra financiare që nuk pasqyrojnë gjendjen reale të pasurisë së shtetit. Mungesa e pasqyrave të konsoliduara të shtetit, ndikon jo vetëm në nivelin e transparencës, por është e lidhur ngushtësisht me ndjekjen e kujdesshme të financave publike dhe analizën e treguesve makroekonomikë. Në Strategjinë për Menaxhimin e Financave publike 2014-2020 theksohet se: *"Një parakusht për raportim të mirë është kontabilizimi i saktë. Gjatë periudhës së planifikuar 7-vjeçare, standardet e kontabilitetit do të rishikohen drejt IPSAS, pasi këto të jenë miratuar përfundimisht, çka mund të ndodhë vetëm në periudhën e ardhshme të planifikimit"***,** ndërkohë që në vijim të po kësaj strategjie flitet për EPSAS (Standardet Europiane të Kontabilitetit të Sektorit Publik), jo për IPSAS (Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik).

Nisur nga situata reale, ku regjistrimet kontabël bazohen mbi gjykime individuale të pakontrolluara dhe të paorientuara nga specifika të lidhura me sektorin publik, kur nuk ka programe të njëjta kontabël në përpunimin e të dhënave dhe përpunimin e

informacionit kontabël, kur niveli i kapaciteteve që regjistrojnë transaksionet financiare është larg kërkesave të një administrate të zhvilluar europiane, strategjia për të kaluar në EPSAS, standarde këto të patestuara akoma në vende ku kontabiliteti publik është i konsoliduar, mund të cilësohet pa frikë një sipërmarrje jo realiste, për të mos thënë futuriste. Si KLSH, në zbatim të Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020, në nëntor 2015 përpara Komisionit të Ekonomisë së Kuvendit kërkuam që të publikohen menjëherë nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit Publik IPSAS, si baza kryesore metodologjike, mbi të cilën do të hartohen pasqyrat financiare të Shtetit. Kemi rekomanduar të ngrihet një drejtori e veçantë, brenda Drejtorisë së Thesarit, që të mundësojë përshtatjen e pasqyrave të nxjerra nga sistemi i integruar në formën e Pasqyrave të Konsoliduara të Shtetit. Kjo drejtori duhet të ketë si funksion edhe kontrollin e saktësisë së pasqyrave të përgatitura nga institucionet publike, për të vënë nën monitorim këtë proces të rëndësishëm.

Vërejmë po ashtu me shqetësim se në projektbuxhetin për vitin 2016, mbi një të pestën e fondeve për pushtetin vendor i merr Fondi i Zhvillimit Rajonal (nga 47.9 miliardë lekë merr 10.05 miliardë ose mbi 70 milionë euro), ndërkohë që investimet e këtij fondi zgjasin më shumë se një vit, kriteret e zgjedhjeve të tij për investime nuk janë shumë të qarta dhe, sipas përcaktimit të ambasadorit amerikan, Donald Lu(nga fjala e tij në Konferencën Kombëtare për Pushtetin Vendor me 30 tetor 2015), ekziston rreziku që bashkitë e majta të përfitojnë shumë më tepër sesa krahasimisht ato të djathta.

Vendimmarrja për përdorimin e fondeve nga ana e Fondit të Zhvillimit Rajonal duhet të jetë sa më transparente dhe duhet parë mundësia që një pjesë e tyre të shkojë në favor të decentralizimit, të dhënies së fondeve drejtpërsëdrejti bashkive, dhe jo të ndodhë e kundërta, centralizimi i tyre në një strukturë jo fort transparente.

Ndoshta jemi ende në kohë që në diskutimet për projektbuxhetin e shtetit të vitit 2016 në Komisionet e Kuvendit, nga deputetët të përparësohen tregues objektivë të tij, larg të qenët tejet optimiste, duke u bazuar në praktikat e mira të buxhetimit modern, të dhëna aq qartë nga Manuali i Fondit Monetar Ndërkombëtar "Për Menaxhimin e Shpenzimeve Publike", nga Kodi i Transparencës Fiskale të FMN dhe nga të Dhjetë Parimet e Buxhetimit Publik të OECD, duke reflektuar kështu jo vetëm sugjerimet dhe rekomandimet e KLSH, por edhe kërkesat e strategjisë së menaxhimit të financave publike 2014-2020 dhe pritshmërie e shoqërisë civile, komunitetit të biznesit dhe gjithë qytetarëve të vendit. Në linjën e këtij shkrimi, mbi bazën e motos së INTOSAI-t, *Eksperientia mutua Omnibus prodest* (Eksperienca e përbashkët u shërben të gjithëve)", do të shprehemi dhe me shkrime të tjera në këtë gazetë dhe në gazeta të tjera.

Si KLSH, gjykojmë se ka ardhur koha që përgjegjësi të thellë e të plotë për menaxhimin e financave tona publike të mbajmë të gjithë në veprimtaret kryesore të sektorit publik: ministritë, institucionet e tjera qendrore me profil të lartë ekonomik, vetë institucioni që unë drejtoj, KLSH, dhe jo vetëm Ministria e Financave dhe ministri i Financave.

BORXHI PUBLIK DHE NEVOJA E RRITJES EKONOMIKE

Botuar në gazetën "Panorama", më 4 dhjetor 2015

Borxhi, kur orientohet apo menaxhohet nga objektiva të qartë ekonomikë, socialë e politikë, është një instrument kyç makroekonomik, por të gjithë jemi dëshmitarë të një konteksti shumë të ndryshëm të borxhit publik … atë që zgjeron në vend që të ngushtojë pabarazinë sociale".

Me këto fjalë do ta hapte Konferencën e 10-të të UNCTAD (nëntor 2015) mbi "Menaxhimin e Borxhit Publik", z. Majkëll D. Higgins, President i Republikës së Irlandës. Duke sjellë eksperiencën e dhimbshme, por të suksesshme të Irlandës në kapërcimin e krizës në menaxhimin e borxhit të saj publik, Higgins do të katalizonte një debat të gjerë mes pjesëmarrësve, kur u shpreh se: "Brenda një modeli të ngushtë ekonomik, ku vetë Shteti perceptohet si problematik dhe ku rritja e qëndrueshme ekonomike po bëhet gjithnjë e më e vështirë për t'u mbarëvajtur, borxhi kthehet në një mekanizëm që maskon politikat e dështuara fiskale dhe strukturore, duke realizuar të ashtuquajturin kapitalizëm pa demokraci".

Asnjëherë më shumë se sot, debati mbi borxhin publik dhe ndikimet e tij nuk ka qenë kaq shumëpërmasor. Duke e trajtuar atë të lidhur ngushtë me sovranitetin kombëtar, varfërinë, kohezionin social, kulturor e ekonomik (që dikush do ta quante thjesht "globalizim"), ndikimin në mjedis, shkencë e teknologji, strukturën institucionale të një vendi, rajoni e më gjerë, borxhi publik po i kapërcen kufijtë e një instrumenti makroekonomik thjesht dhe vetëm monetar e fiskal dhe po kthehet në një problem social brezash, një trashëgimi sa kulturore, aq edhe mjedisore.

Borxhi i sektorit publik, atëherë kur menaxhohet optimalisht, është një element i pazëvendësueshëm i çdo strategjie ekonomiko-financiare për zhvillim. Por ai mund të shndërrohet shumë shpejt në një barrë të rëndë kur huamarrja është e palidhur me investime në projekte frytdhënëse, apo edhe në rastet kur vendi goditet nga faktorë të jashtëm që destabilizojnë ekonominë vendëse. Në një ekonomi të integruar, menaxhimi efiçient dhe transparent i borxhit është një sfidë dinamike dhe komplekse. Nuk mjafton vetëm përqendrimi në matjen e qëndrueshmërisë së borxhit (në të gjitha drejtimet e tij: normë interesi, stok, proporcioni midis kreditorëve të huaj dhe atyre vendas, etj.), por duhen analizuar me kujdes, në thellësi dhe në afat të gjatë, pasojat që ka politika e borxhit në zhvillim, mjedis dhe barazi sociale.

Saga e krizës financiare globale dhe e Eurozonës ka prekur tashmë vendet në zhvillim, ku bën pjesë edhe Shqipëria. Rritja galopante e borxhit po shndërrohet në një kërcënim global për stabilitetin ekonomik. Tetë vjet pas nisjes së krizës dhe bota ende nuk po ndërron dot marshin drejt një zhvillimi të qëndrueshëm dhe integral ekonomik. Vendet

e zhvilluara po reagojnë ngadalë, ndërkohë që vendet në zhvillim, të cilat ishin motori kryesor i zhvillimit që nga viti 2011, tashmë kanë filluar të ngadalësojnë ritmet e rritjes dhe të kalojnë në stanjacion.

Në zemër të këtij sistemi të brishtë kulisash makro e mikroekonomike qëndron borxhi publik. Nga 21 miliardë USD, që përllogaritej niveli global i borxhit në vitin 1984, sot ai qëndron në 200 miliardë USD. Në rritje prej afro dhjetëfish, ndërkohë që popullsia e botës për të njëjtën periudhë është rritur 1,4 herë, ndërsa GDP-ja në terma realë ka qëndruar pothuajse e njëjtë.

Të gjitha sa më lart vlejnë edhe për vendin tonë, por Shqipëria shfaq një sërë karakteristikash unike lidhur me borxhin publik e konkretisht, te ne niveli i borxhit ndaj GDP-së deklarohet se është aktualisht në nivelin 72 për qind të Produktit të Brendshëm Bruto. E perceptuar fillimisht si një ekonomi e imunizuar ndaj goditjeve ekzogjene, për shkak të mosintegrimit me tregjet financiare europiane e ato botërore, borxhi publik u rrit gradualisht për të injektuar para në një sistem që kishte nevojë për investime vitale në infrastrukturë, arsim, shëndetësi, energji etj., pavarësisht potencialit të kufizuar prodhues që e disponojmë aktualisht. Fillimisht, qeveria synonte të zëvendësonte stokun afatshkurtër të borxhit me stok afatgjatë, ndërkohë që sot e ka plotësuar këtë politikë edhe me zëvendësimin e borxhit vendës me borxh të huaj. Nga ana tjetër, janë marrë masa shtrënguese në drejtim të reduktimit të shpenzimeve publike dhe rritjes së të ardhurave tatimore, duke zgjeruar horizontalisht dhe vertikalisht bazën dhe normat tatimore, me qëllim kurimin e deficitit buxhetor dhe uljen e nivelit të borxhit, edhe sipas udhëzimeve të FMN-së e organizmave të tjerë ndërkombëtarë. Të gjitha këto veprime dëshmojnë për ndjekjen e një modeli klasik në kapërcimin e vështirësive që sjell huamarrja e tepruar publike, një modeli që ka dhënë prova të suksesit, por që shoqërohet gjithashtu me kosto të larta sociale, ashtu siç dëshmon edhe rasti i Irlandës. Veprimet qeverisëse për uljen e borxhit janë gjithashtu në linjë edhe me udhëzimin e kahershëm të KLSH-së për fiksimin e nivelit të borxhit në 60%, jo vetëm në Ligjin organik të Buxhetit të Shtetit, por edhe në Kushtetutë. Sot ne jemi të ndërgjegjshëm që ky nivel nuk arrihet dot, por le të ecim sipas objektivave të përcaktuara në Strategjinë "Për Menaxhimin e Financave Publike 2014-2020", pra, për vitin 2017, borxhi publik të reduktohet në 65.5% të Produktit të Brendshëm Bruto dhe në vitin 2020 të jetë 56.7 për qind e PBB-së.

E megjithatë, menaxhimi i borxhit në Shqipëri ka ende vend për përmirësime thelbësore, siç është rasti i: 1) Analizave më të kujdesshme në ndërtimin e portofolit të borxhit lidhur me afatet, monedhën dhe risqet përkatëse. Të gjitha këto analiza duhen strukturuar e përmbledhur në një Manual të Borxhit Publik, ku në referencë të standardeve dhe praktikave më të mira të përcaktohet metodologjia për parashikimin,

zhvillimin e aktivitetit të huamarrjes, të shërbimit, monitorimit dhe raportimit të borxhit; përcaktimi i procedurave dhe teknikave për vlerësimin e risqeve, si dhe treguesit e matjes së performacës së veprimtarisë së huamarrjes publike; krijimi i një baze të dhënash e integruar të borxhit të brendshëm dhe të jashtëm. 2) Në kushtet e verifikimit të një mungese ekstreme të stafit për kryerjen e analizave dhe menaxhimin e portofolit të borxhit, si dhe kapaciteteve ligjore të nevojshme për garantimin e mirëmanaxhimit të borxhit, duhet të ndërmerren hapa konkretë për përmirësimin cilësor të menaxhimit të borxhit, duke u drejtuar drejt një menaxhimi strategjik për të arritur qëndrueshmërinë e borxhit publik, duke e kombinuar me minimizimin e riskut të normave të interesit, nëpërmjet orientimit drejt instrumenteve të borxhit që afrojnë norma të favorshme për jetëgjatësinë e tij. 3) Investimit të borxhit në projekte rentabël dhe jo përdorimit të tij për kryerjen e shpenzimeve korrente apo pagesës së borxheve të vjetra.

Në fjalë të fundit, për të gjithë ata që analizojnë problemet dhe çështjet ekonomike, përfshirë dhe borxhin publik, sfida është e karakterit moral. Çfarë kemi prioritet? Cilat janë supozimet që qëndrojnë në themel të modelit tonë të përbashkët social, akademik, politik, ekonomik e publik?

Teknikat e kujdesshme të menaxhimit të borxhit duhet të burojnë nga vendosja e prioriteteve dhe mënyrat që zgjedhim për t'i mbështetur ato. Të mos harrojmë se prioritet është e ardhmja e vendit dhe brezave që do të vijnë. Ne nuk e trashëgojmë botën nga të parët tanë, por e huazojmë për fëmijët tanë.

PËR RRITJEN E BESUESHMËRISË SË BUXHETIT TË SHTETIT

Botuar në "Gazeta Shqiptare", më 6 dhjetor 2015

Një Buxhet Shteti bëhet më i besueshëm për qytetarët, kur është transparent dhe mënyra e përgatitjes së tij është shumë e hapur, me konsultime të gjata e të thella me të gjithë veprimtarët e interesit (shoqërinë civile, komunitetin e biznesit, grupet e interesuara të qytetarëve, etj.). Sipas organizatës jo qeveritare me qendër në Uashington "Partneriteti Ndërkombëtar për Buxhetin"(ne anglisht ""International Budget Partnership (IBP)), në vrojtimin e saj "Treguesi i Buxhetit të Hapur 2015", në shtator 2015, të kryer në 102 vende të botes ku përfshihet dhe vendi ynë, Shqipëria renditet ndër vendet e fundit në Ballkan për transparencën e treguar në përgatitjen dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit. Ndërkohë që sa më transparent dhe me pjesëmarrje të qytetarëve të jetë një buxhet shteti, aq më pranë tyre ai ndodhet dhe aq më shumë përgjegjësi ndjen qeveria në zbatimin e buxhetit.

Në Manualin e FMN-së "Për Menaxhimin e Shpenzimeve Publike" saktësohet se "*Çështjet kyçe në zbatimin e një buxheti publik janë transparenca, niveli i ndarjes së linjave të përgjegjësisë; sa koherent është informacioni mbi ekzekutimin e buxhetit; sa i saktë dhe besueshëm është ky informacion; dhe a zbatohet buxheti në përputhje me parimet e qeverisjes së mirë*?" [34] . Përgjegjësia në zbatimin e Buxhetit të Shtetit, po sipas këtij Manuali, realizohet e plote, nëse "...(*i*) *çdo veprim është transparent, (ii) çdo pjesëmarrës është përgjegjës; (iii) çdo veprim është i dokumentuar si duhet dhe i raportuar; dhe (iv) çdo veprim duhet të jetë subjekt i auditimit të pavarur, profesional dhe të paanshëm"*[35]

Për fat të keq, Projekt Buxheti për vitin 2016 nuk gëzoi një diskutim të gjerë me grupet e interesit. Qeveria nuk mundi të organizonte shkëmbime idesh të hapura dhe të plota si me komunitetin e biznesit apo me shoqërinë civile, por u mjaftua me disa takime e tryeza pune të ngushta me disa përfaqësues të komunitetit të biznesit. Diskutime pati të gjera(dhe kjo është një praktikë shumë e dobishme që duhet nxitur për më shumë dhe edhe me dëgjesa publike, me pjesëmarrës si dëgjues apo edhe sugjerues dhe të përfaqësuesve nga biznesi dhe nga shoqëria civile) vetëm në komisionet e Kuvendit. Si KLSH, konstatojmë me shqetësim se Buxheti i Shtetit 2016, nga mënyra se si u prezantua në publik dhe me grupet e interesit, mbeti deficitar në qenien e tij i besueshëm dhe plotësisht transparent.

[34] Autorët Barry Potter and Jack Diamond, Manuali i FMN-së "Për Menaxhimin e Shpenzimeve Publike" Pjesa e 4-t, "Ekzekutimi i Buxhetit", ribotim, viti 2012, faqe 102

[35] Po aty, faqe 122

Një tjetër institucion ndërkombëtar me reputacion, OECD (Organizata për Bashkëpunimin Ekonomik dhe Zhvillim), ndër parimet kryesore që rendit në procesin e përgatitjes dhe zbatimit të Buxhetit, veçon: qartësinë e treguesve dhe objektivave të Buxhetit, integritetin e parashikimeve dhe planeve fiskale, lidhjen e ngushte me përparësitë strategjike afatmesme të zhvillimit të vendit, efektivitetin, si dhe qëndrueshmërinë financiare afatgjate.

Tani që projekt buxheti 2016 u miratua në Kuvend, e gjithë vëmendja duhet përqendruar në zbatimin e tij sipas kërkesave të Strategjisë së Shqipërisë "Për Menaxhimin e Financave Publike 2014-2020", si dhe të manualeve të FMN-së dhe OECD. Në mënyrë që të kemi një zbatim sa më efektiv dhe efiçient të buxhetit, është parësore që të evitohen situatat jo të përgjegjshme të konstatuara në zbatimin e buxhetit faktik 2014. Kështu, s*ë pari*, e gjykoj të rëndësishëm zbatimin e parimeve të anualitetit, transparencës dhe besueshmërisë se Buxhetit. Zbatimi i këtyre parimeve jo vetëm ndikon në mirëmenaximin e fondeve publike por në të njëjtën kohë ndihmon të rritet besimi publik. Krijimi i një klime besimi shtet-tatimpagues ndihmon jo vetëm punën kundër informalitetit por dhe në krijimin e një besimi të ndërsjellët dhe produktiv mes subjekteve tatimpagues institucionale dhe individuale nga njëra anë, dhe institucioneve publike të cilave i janë besuar fondet e tyre, nga ana tjetër.

Së dyti, duhet shtuar vëmendja ndaj parametrave të borxhit publik. Pa dashur të heq paralele me ndonjë vend në krizë borxhi, do të sugjeroja të nxirrnim mësime nga vende që janë gjendur përballë situatave të pamundësisë së menaxhimit të borxhit publik, siç është Greqia. Thellimi i borxhit publik dhe rritja e peshës së borxhit të jashtëm, e pa shoqëruar me një rritje të investimeve publike, ul potencialin e shtetit për të shlyer huatë. Situata të tilla janë të rrezikshme pasi i shtyjnë qeveritë të gjejnë si zgjidhje shlyerjen e borxhit me borxh më të madh, duke e rënduar akoma më shumë këtë parametër. Buxheti 2016 synon uljen e borxhit, nëpërmjet mbajtjes së një deficiti buxhetor vetëm 2.2 përqind të PBB. Si KLSH e përshëndesim këtë synim qeveritar, por konstatojmë se do të jetë shumë e vështirë të mbahet defiçiti në këtë nivel të ulët dhe duhet një bashkëpunim mes gjithë institucioneve zbatuese të buxhetit, për të rritur vjeljen e të ardhurave dhe koordinuar kryerjen e shpenzimeve sipas planit.

Së treti, institucioni i KLSH ndjek vit pas viti nivelin e riskut financiar ndaj të cilit janë ekspozuar financat publike në veçanti dhe ekonomia në tërësi. Për të pasur një gjykim sa më objektiv, vitet e fundit jemi mbështetur tek Treguesit e Cenueshmërisë mbi bazën e të cilëve Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) mbikëqyr dhe këshillon vendet anëtare dhe sidomos vendet me ekonomi në zhvillim siç është Shqipëria. Treguesit (indikatorët) bazë që përdor ky institucion dhe ecuria e këtyre treguesve bazuar në vëzhgimin e KLSH rezultojnë si më poshtë:

Indikatori i cenueshmërisë i FMN	Shqipëria 2010-2014
Investimet e huaja	Përkeqësim - Në rënie
Borxhi i jashtëm/Eksporte	Përkeqësim - Në rritje
Borxhi i jashtëm/PBB	Përkeqësim - Në rritje
Borxhi i jashtëm/Të ardhurave tatimore	Përkeqësim - Në rritje
Rezerva valutore/Borxhi i jashtëm afatshkurtër	Përkeqësim - Në rënie

Duke e ritheksuar që nuk duam të heqim paralele me ekonominë greke, nga analiza kemi gjetur që të gjithë këta tregues kanë pësuar përkeqësim në vitet 2010-2014, njësoj si ekonomia greke në vitet e parakrizës 2005-2009. Në këtë kontekst gjykojmë se nevojitet një angazhim dhe vëmendje e shtuar e krejt politikbërësve dhe menaxherëve publikë në Shqipëri për të gjykuar mbi riskun shtesë që financat publike dhe ekonomia shqiptare merr në çdo vendim që ata marrin.

Gjithashtu, bazuar në tkurrjen e investimeve të huaja gjatë vitit 2014 si dhe duke pasur parasysh ngjarjet e vitit 2015, që është duke u mbyllur, konstatojmë se synimi për të mbledhur më shumë të ardhura tatimore mund ta bëjë vendin më pak tërheqës në raport me vendet e tjera të rajonit, duke dëmtuar jo vetëm sektorë të caktuar të ekonomisë (si p.sh sektorin e industrisë fason, të turizmit, etj.), por dhe vetë të hyrat publike.

Së katërti, në respekt të zbatimit të qëllimit të çdo ligji, gjykoj se mund të ndërtohen praktika dhe procedura që çojnë në një përdorim më efiçient të fondeve publike si dhe në të njëjtën kohë të ndërpriten praktika të cilat i vlerësojmë si jo efiçente, të tilla siç ishte rasti i përdorimit të Letër Kredive në zbatimin e Buxhetit të vitit 2014.

Kam besimin se mund të gjenden mënyra më efektive për garantimin e kontratave të nënshkruara nga entet publike apo mund të gjenden mënyrat për një kontraktim më efektiv me bankat. Ekzistojnë të gjitha rrethanat ekonomike që entet publike të kërkojnë nga bankat më shumë të drejta të një klienti preferencial, ashtu sikundër bëjnë dhe kompanitë private me qarkullim të madh të fondeve nëpër banka.

Së pesti, mendoj se është e domosdoshme rritja e përgjegjshmërisë e administratës publike lidhur me pasojat ekonomike të veprimeve të tyre. Fshehja mbas kompetencave që jep detyra publike nuk duhet të shërbejë më për të lënë pa autor dëmet ekonomike dhe financiare që i shkaktohen në mënyrë të pajustifikueshme shtetit. Vetëm kostot e vendimeve politike nuk mund të auditohen. Çdo veprim dhe vendim tjetër duhet t'í nënshtrohet kontrollit dhe përgjegjësisë. Krahas propozimit për përgatitjen dhe miratimin nga Kuvendi të Ligjit për Përgjegjësinë Materiale të Nëpunësit Publik, edhe ne kushtet e sotme në mungesë të këtij ligji, si KLSH do të punojmë më fort që çdo specialist dhe menaxher i cili shërben në administratën publike, të mbajë përgjegjësi

materiale për kostot financiare dhe ekonomike që i shkakton Shtetit me vendimet e tij individuale apo dhe kolegjiale.

Kjo nismë e KLSH përputhet dhe me Strategjinë "Për Menaxhimin e Financave Publike 2014-2020", ku përcaktohet si mundësi "*Ndryshimi i Ligjit Organik të Buxhetit, me qëllim përcaktimin e qartë të përgjegjësisë së secilit Ministër ose Drejtuesi të Institucionit Qendror Buxhetor gjatë të gjithë fazës së ciklit të menaxhimit të shpenzimeve publike*" (faqe 31 e Strategjisë).

Së gjashti, dëmet në sektorin energjetik kapin vlera të konsiderueshme, jo vetëm për financat publike, por dhe për ekonominë shqiptare në tërësi. Prandaj duhet të shtohet vëmendja dhe përgjegjshmëria ndaj zbatimit më korrektësi të të gjitha kontratave që janë nënshkruar me kompanitë koncesionare. Gabimet që janë zbuluar për kontratat e nënshkruara tashmë duhet të shërbejnë për të qenë më të kujdesshëm në kontratat e ardhshme. Mbi një vit e dy muaj më parë, si KLSH, duke audituar veprimtarinë e AlbPetrol dhe të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore(AKBN), me Vendimin e Auditimit të datës 29 shtator 2014 për Albpetrol dhe me Vendimin e datës 6 maj 2015 për AKBN, kemi evidentuar problemet me zbatimin e kontratës me kompaninë Bankers. Kemi denoncuar një dëm ndaj Buxhetit të Shtetit në miliona euro, shumë herë më të madh se sa detyrimi fiskal i konstatuar nga organet tona tatimore në këtë fazë të parë, prej 57 milionë dollarë. Shumica e dëmit të konstatuar nga KLSH ka të bëjë me evazionin fiskal të realizuar nga kjo kompani. Përshëndesim dhe mbështesim veprimin e strukturave tatimore shqiptare, që kërkuan arkëtimin në Buxhetin e Shteti të 57 milionë dollarëve detyrim i papaguar, por theksojmë se ky është vetëm një pjesë e evazionit real dhe një pjesë e detyrimeve që kompania koncesionare i ka Shtetit tonë. Të gjithë, duke filluar nga deputetët e Kuvendit (duam të veçojmë deputetë të pozitës dhe opozitës, por sidomos z. Erion Braçe, Kryetar i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit, që ka qenë i qartë në deklarimet e tij), Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Avokatia e Shtetit, si dhe ne institucionet e pavarura, duhet të jemi në krah të tatimeve në veprimin e tyre për ta detyruar kompaninë koncesionare t'i kthejë Shtetit tonë detyrimet fiskale të papaguara. Duke e ditur se koncesionari do ta hedhë Shtetin tonë në gjyq ndërkombëtar, të gjitha forcat duhen përqendruar tani në përfaqësimin dinjitoz të Shtetit tonë në arbitrazhin ndërkombëtar, pse e gjykojmë se kemi ne të drejtë, edhe pse kontrata koncesionare ishte "qepur" vetëm për të mbrojtur interesat e koncesionarit.

Së shtati, institucionet publike duhet të rrisin përgjegjshmërinë në raportimin me saktësi, në kohë reale dhe konform standardeve të kontabilitetit të të dhënave të tyre ekonomike dhe financiare. Në kushtet kur bëhet një punë intensive për të përmirësuar cilësinë e raportimit për biznesin privat, është e mundur dhe e nevojshme që paralelisht të kërkohet e njëjta gjë dhe për raportimin e institucioneve publike. Përveçse do të rriste transparencën dhe përgjegjshmërinë publike, kjo do të përfaqësonte një demonstrim

nxitës për krijimin e një kulture të raportimit të saktë dhe në kohë reale për të gjitha subjektet ekonomike, publike apo private qofshin.

Së teti, duhet të nënvizoj se armiku më i madh i ekonomisë dhe shtetit është korrupsioni i nivelit të lartë dhe jo informaliteti. Mbledhja e të ardhurave publike dhe menaxhimi i tyre janë një sfidë e vazhdueshme e administriatës publike në një ekonomi tregu. Në funksion të qëllimit të përbashkët për mirëmenaxhimin e fondeve publike, do të vazhdojmë të kërkojmë që të shqyrtohen me më përgjegjshmëri dhe vëmendje rekomandimet e KLSH-së, në drejtim të përmirësimeve të rëndësishme ligjore, shpërblimit të dëmit, largimit nga puna të nëpunësve të lartë dhe të mesëm të gjetur në shkelje dhe korrupsion.

Së fundmi, vitet 2014 dhe 2015 janë dy vitet e para të zbatimit të Strategjisë "Për Menaxhimin e Financave Publike 2014-2020". Kjo strategji bart një rëndësi të dyfishtë, pasi jo vetëm përcakton rrugën për rivendosjen e financave publike në trajektoren e qëndrueshmërisë afatgjatë, duke krijuar kështu parakushtet për rritjen ekonomike, por përbën edhe një detyrim që rrjedh nga marrëveshjet me partneret ndërkombëtarë, në veçanti me Bankën Botërore, Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bashkimin Europian. Vizioni i saj është garantimi i një sistemi të financave publike që nxit transparencën, përgjegjshmërinë, disiplinën fiskale dhe efiçiencën në menaxhimin dhe përdorimin e burimeve publike. Vitet 2014-2015 njohën arritje në zbatimin e strategjisë, por edhe sfida ende të paplotësuara. Prandaj ne të gjithëve, Kuvendit, qeverisë dhe institucioneve të pavarura, na del për detyrë të punojmë më me angazhim dhe seriozitet për zbatimin e plotë të Strategjisë "Për Menaxhimin e Financave Publike 2014-2020", ashtu si na e kërkojnë edhe detyrat dhe rekomandimet e Progres Raportit 2015 të Bashkimit Evropian për Shqipërinë.

TRANSPARENCA, INSTITUCIONET DHE LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

Botuar në gazetën "Sot", më 16 dhjetor 2015

Në Ditën Botërore kundër Korrupsionit, më 9 dhjetor 2015, fjalët e Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara Bank Ki-Mun ishin të qarta: " *Nëse dikur ryshfeti, korrupsioni dhe flukset financiare të paligjshme konsideroheshin pjesë e kostos së të bërit biznes, sot korrupsioni shihet gjerësisht –dhe me të drejtë- si veprimtari kriminale dhe gërryese. ..Korrupsioni ka ndikime shkatërrimtare në zhvillimin e një vendi, kur fondet që duhet t'i kushtohen shkollave, klinikave publike shëndetësore dhe shërbimeve të tjera jetësore publike, devijohen dhe kalojnë në duart e kriminelëve apo zyrtarëve të pandershëm. Korrupsioni përshkallëzon dhunën dhe pasigurinë. Kjo mund të çojë në pakënaqësi me institucionet publike, në zhgënjim ndaj qeverinë në përgjithësi, dhe në spirale të zemërimit dhe paqëndrueshmërisë. Në Ditën Ndërkombëtare Kundër Korrupsionit, unë bëj thirrje për përpjekje të bashkuara për të dhënë një mesazh të fortë në të gjithë botën që hedh poshtë me vendosmëri korrupsionin dhe përqafon në vend të tij parimet e transparencës, llogaridhënies dhe qeverisjes së mirë*".

Rruga që duhet të ndjekim për të luftuar me efektshmëri të lartë korrupsionin është përcaktuar po ashtu qartë nga rekomandimet e Progres Raportit 2015 (faqe 15) të Komisionit Evropian për Shqipërinë, i cili konstaton se " *Megjithatë, korrupsioni është i përhapur dhe më shumë përpjekje janë të nevojshme për të krijuar një bazë solide të dhënash të hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve në të gjitha nivelet, në veçanti për rastet kur zyrtarë shtetërorë të nivelit të lartë janë të përfshirë. Pavarësia e institucioneve të përfshira në luftën kundër korrupsionit është e nevojshme të përmirësohet, pasi ata mbeten të pambrojtur ndaj presioneve politike dhe ndikimeve të tjera. Me qëllim të përmbushjes së prioritetit kyç në luftën kundër korrupsionit, në vitin e ardhshëm Shqipëria duhet në veçanti:*

→ *të demonstrojë përparim të mëtejshëm me qëllim krijimin e një baze solide të dhënash të hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve në luftën kundër korrupsionit në të gjitha nivelet;*

→ *të sigurojë ndjekjen e numrit të madh të rasteve të referuara në prokurori nga Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Parandalimin e Konfliktit të Interesit dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit;..."*

Lind pyetja: a po lëvizim si struktura shtetërore të përgjegjshme në përmbushjen e detyrave të luftës kundër korrupsionit? Këto mesazhe duhet të dëgjohen dhe vlerësohen si nga ligjvënësit, ashtu dhe nga qeveria dhe gjyqësori ynë.

Arsyeja pse Komisioni Evropian rekomandon me forcë në Progres Raport ndjekjen e rasteve të denoncuara nga KLSH apo ILDKPP, ka të bëjë me efektshmërinë e përpjekjeve anti-korrupsion. Ne si KLSH në periudhën janar 2012-nëntor 2015 kemi përgatitur 169 kallëzime penale drejtuar institucionit të Prokurorisë, në krahasim me 52

kallëzime gjithsej në katërvjeçarin 2008-2011, ose më shumë se trefishin. Kemi dërguar në prokurori 368 punonjës të administratës sonë publike, duke përfshirë edhe nivelet më të larta si Ministër, Drejtor i Përgjithshëm, Sekretar i Përgjithshëm në Ministri, etj. Mirëpo efekti i këtyre denoncimeve është shumë i pakët, për sa kohë konstatojmë me shumë shqetësim, se propozimet tona për largimin e këtyre personave nga administrata publike, të evidentuar prej nesh në abuzim dhe shpërdorim të pronës dhe fondeve publike, gjejnë vesh të shurdhër në qeveri. Aleanca anti-korrupsion, e cila duhet të zgjerohet duke përfshirë në të, krahas ligjvënësve, qeverisë, institucioneve të pavarura dhe shoqërisë civile, edhe opozitën, ka rrezik të ngelet në letër. Gjykojmë se kjo aleancë nuk mund të funksionojë me efektshmëri në rast se merret vetëm me fasadën, thjesht me organizimin e disa konferencave sensibilizuese, por duhet të gjenerojë një sinergji dhe punë të përbashkët të koordinuar mirë mes të gjithë anëtarëve të aleancës, si dhe me vëzhgues nga partnerët tanë ndërkombëtarë. Me qëllim që të shmanget çdo lloj hijeje për konflikt interesi dhe rendje pas butaforisë anti-korrupsion, do të ishte e udhës që këtë aleancë ta drejtonte shoqëria civile, ndoshta një grup me shoqatat më të spikatura që deri tani kanë kontribuar realisht në luftën kundër korrupsionit dhe për transparencën qeverisëse. Duke ja lënë në dorë ndjekjen e planit të veprimeve konkrete anti-korrupsion strukturave të konsoliduara të shoqërisë civile, vetë nisma dhe aleanca anti-korrupsion e qeverisë dhe e të gjitha institucioneve të tjera publike do të fitonte shumë në imazh dhe besueshmëri, jo vetëm tek ndërkombëtarët, por në radhë të parë në sytë e qytetarit shqiptar. Jam i sigurt se strukturat e përgjegjshme të shoqërisë civile menjëherë do të planifikonin aktivitete si dëgjesa publike në Kuvend, mbledhje me pjesëmarrjen e mediave, ku në mënyrë periodike të raportohet për aktivitetin e secilin pjesëtar të Aleancës, pa rendje pas marrjes së pikëve të një veprimtarie anti-korrupsion thjesht fasadë.

Drejtimi i aleancës anti-korrupsion nga shoqëria civile siguron dhe diçka tjetër me shumë rëndësi në luftën kundër korrupsionit-tejdukshmërinë e duhur. Lufta efektive kundër korrupsionit nuk mund të kuptohet pa transparencën e plotë të veprimtarisë dhe institucioneve publike. Sipas studjuesve Catharina Lindstedt dhe Daniel Naurin[36], nëse Nigeria, vendi më i korruptuar sot në botë, do të kishte transparencën e strukturave shtetërore dhe aksesin në informacion që ka, për shembull Norvegjia, niveli i korrupsionit në këtë vend do të kishte rënë në nivelet e vendeve perëndimore. Transparenca përkthehet në të drejtën e qytetarëve dhe të shoqërisë civile për të patur akses të pakufizuar në veprimtarinë dhe të dhënat e institucioneve kryesore publike, si

[36] Catharina Lindstedt & Daniel Naurin: "Transparenca kundër korrupsionit", faqe 13, viti 2012, http://www.qog.pol.gu.se/digitalAssets/1358/1358046_transparency-against-corruption-_accepted-version_.pdf

dhe në përcjelljen e këtij informacioni në publik. Tejdukshmëria e vërtetë duhet dalluar nga përpjekjet formale të vetë institucioneve shtetërore, për të dhënë vetëm atë informacion që ato duan t'i kalojë publikut. Ja përse është e rëndësishme që raportet e performancës të institucioneve si qeveria(për shembull performanca e Buxhetit të Shtetit të vlerësohet me raport nga shoqëria civile e pavarur, gjë që është dhe një nga kushtet për të patur një buxhet të hapur për qytetarët), institucionet e pavarura dhe vetë puna e Kuvendit, duhet të përgatiten nga shoqëria civile. Kjo e fundit të shërbejë si një pasqyrë ku institucionet publike shohin veten e tyre në raport me detyrat që kanë ndaj qytetarëve.

Në punën e tij në këto katër vite(2012-2015), KLSH është bazuar në partneritetin me shoqërinë civile të angazhuar në luftën kundër korrupsionit. Marrëveshjet e lidhura me shumë nga shoqatat e shoqërisë civile, të njohura për pavarësinë e tyre kanë qenë aktive, me informacion dhe ftesa për aktivitete të përbashkëta të shkëmbyera rregullisht në këto vite. Një pjesë e aktivitetit të përbashkët nga këto marrëveshje, është shndërruar në projekte, ndër të cilat ka edhe nga ato që vlerësojnë punën e KLSH, cilësinë dhe rezultatet e arritura nga auditimet e tij. Megjithë kontributet e vyera të shoqatave të shoqërisë civile partnere me KLSH, si në auditime me pjesëmarrjen e ekspertëve të tyre, ashtu dhe në vlerësimin e performancës së institucionit, e ndjejmë që kemi ende shumë për të bërë, sidomos në punën e përbashkët me këto shoqata, për të promovuar aleancën anti-korrupsion edhe me pjesëtarët e tjerë të aleancës.

Duhet të jemi të gjithë të ndërgjegjshëm se në funksionin e tyre të "gërmimit të fakteve", një shoqëri e lirë civile dhe mediat e pavarura mund të krijojnë transparencën e duhur, duke e vendosur informacionin e plotë të institucioneve shtetërore, në dispozicion të publikut. Për këtë lypset që aksesi i tyre në informacionin shtetëror të jetë i plotë(kuptohet ai informacion që nuk përbën sekret shtetëror. Në funksionin e tyre denoncues, shoqatat aktive anti-korrupsion, nga ana tjetër, krijojnë publicitet për këtë informacion, duke e përhapur atë tek opinioni publik dhe njerëzit. Është në dobi të të gjithë strukturave shtetërore që një informacion të tillë ta vënë në dispozicion të shoqërisë civile. Një shoqëri civile dhe media të lira dhe të pavarura, të gatshme dhe të afta për të hetuar dhe raportuar sjelljet korruptive nga ana e zyrtarëve të qeverisë, prodhojnë atë tip transparence që vetë ne institucionet publike nuk do ta arrijmë kurrë. Informacionin e besueshëm për publikun dhe qytetarët. Le ta quajmë transparencë jo të kontrolluar nga institucionet. Tipar dallues i këtij lloji të transparencës është se informacioni në lidhje me sjelljen e institucioneve publike jepet nga një palë e tretë, në vend të vetë institucionit. Në mungesë të sotme dhe deri në vendosjen e shoqërisë civile si vlerësuese dhe matëse e performancës së institucioneve shtetërore, ndoshta një rrugë e mesme mund të ketë efektshmëri në luftën kundër korrupsionit dhe për më shumë transparencë: ajo e nismës së punonjësve të lirë të një institucioni shtetëror, për të folur

në media për vetë institucionin dhe sfidat e tij, si dhe për rrugët e përmirësimit të qeverisjes publike. Në këtë qasje, mediat e pavarura luajnë një rol kyç. Nga eksperienca e deritanishme e KLSH, gjatë këtyre tre viteve janar 2013-nëntor 2015 janë mbi 360 shkrime, intervista, editoriale, analiza të botuara nga dhjetëra audituesë të institucionit(40 deri 50 audituesë çdo vit) në faqet e gazetave të qarkullimit kombëtar. Dua të falënderoj gazetat "Panorama", " Telegraf", "Koha Jonë", "Shqip", "Gazeta Shqiptare", "Sot", "Tirana Observer" e shumë të tjera që hapën faqet e tyre për mendimet dhe propozimet e audituesve të KLSH, si për përmirësimin e punës sonë audituese, ashtu dhe për, çka është më e rëndësishme, përmirësimin e administrimit në shumë sektorë kyç të ekonomisë dhe të administratës sonë publike. Falënderoj në veçanti të gjithë ata gazetarë të këtyre mediave, për punën dhe përkushtimin e tyre në daljen dinjitoze përpara publikut shqiptar të ideve dhe sugjerimeve të audituesve tanë. Ftoj të gjithë punonjësit e ndershëm dhe të përkushtuar në administratën tonë shtetërore, që t'u drejtohen mediave të pavarura, për të shprehur idetë e tyre lirshëm dhe me kurajo, pse do të kryenin një shërbim të jashtëzakonshëm për transparencën e qeverisjes së vendit.

Transparenca e pakushtëzuar nga propaganda institucionale pjell orë e çast përgjegjshmëri. Por kjo e fundit kërkon që nëpunësit publikë abuzues apo të korruptuar të vihen përpara përgjegjësisë jo vetëm ligjore, por edhe materiale. Si KLSH, kemi konstatuar se në fushën e përgjegjësisë materiale për nëpunësin publik, në legjislacionin tonë, procedurat për ta realizuar atë janë tërësisht të munguara. Kjo ka sjellë mungesën e përgjegjësisë materiale për nëpunësit publikë tek ne, arbitraritetin e menaxherëve publikë ndaj punëmarrësve, cenimin e interesave publike dhe ka shpënë ujë në mullirin e korrupsionit dhe abuzimeve me pronën shtetërore.

Gjykojmë se është i domosdoshëm hartimi i procedurave për të realizuar përgjegjësinë materiale në sektorin publik, me qëllim parësor për të parandaluar dukuritë që stimulojnë dëmtimin e interesave publike, në radhë të parë korrupsionin galopant dhe atë sistematik. Lufta ndaj tij nuk mund të zgjidhet me procedura të thjeshta, me urdhëresa ministrash apo dhe me dekrete të Këshillit të Ministrave (sado vullnetmirë të jenë si qeveria, edhe ministrat e veçantë), edhe për faktin se rrethi i interesave që preken është shumë i gjerë.

Për këto arsye dhe për të ofruar një mjet shumë efikas, madje thelbësor në luftën kundër korrupsionit, si KLSH e konsiderojmë të domosdoshëm hartimin e një ligji që të trajtojë në mënyrë të plotë rastet e përgjegjësive materiale të të punësuarve në sektorin publik. Prandaj dhe kemi rekomanduar përgatitjen e këtij ligji qysh vitin e kaluar, në Raportin për Zbatimin e Buxhetit të Konsoliduar të Shtetit për vitin 2013 dhe e kemi përsëritur këtë rekomandim edhe në Raportin për Zbatimin e Buxhetit të Konsoliduar të Shtetit për vitin 2014, drejtuar Kuvendit, në tetor 2015.

Duke ju kthyer raportit transparencë-institucione publike, ngremë pyetjen: përse disa institucione janë më transparente se të tjerat? Nga puna jonë audituese, kemi vërejtur se ka shumë institucione shtetërore, transparenca e të cilave është e ulët. Kjo nuk do të thotë se të gjitha këto institucione janë të zhytura në korrupsion, por se risku i rënies së tyre në korrupsion është i lartë, pikërisht për shkak të transparencës së pakët.

Nga eksperienca jonë si KLSH, mund të themi se faktorët kryesorë që rrisin transparencën e një institucioni publik janë dy. Nga njëra anë është bashkëpunimi i sinqertë dhe konstruktiv i institucionit shtetëror me organizata të shoqërisë civile, të interesuara për punën që ky institucion bën, duke i trajtuar shoqatat jo fitimprurëse si partnerë realë. Opinioni dhe "f*eedback*"(vështrimi kritik) i tyre për punën e institucionit ka një rëndësi shumë të madhe, pse është pasqyra e munguar nga ai mund të shohë një vlerësim të paanshëm për punën, rezultatet e arritura dhe të metat që ka. Nga ana tjetër, komunikimi i hapur dhe i përhershëm me mediat e pavarura të vendit. Marr shkas nga këto ditë të mbylljes së vitit, për t'u bërë një sugjerim modest institucioneve publike që zhvillojnë analizat e tyre vjetore, që të ftojnë sa më shumë media të pavarura dhe të mbajnë kontakte me gazetarë dhe analistë të njohur për integritetin e tyre. T'i ftosh ata në debatet e pacensuruara për arritjet dhe mangësitë e institucionit tënd, është një rrugë tejet e efektshme për të matur veten dhe mendimin e qytetarit për ty si institucion publik, pse gazetarët dhe analistët e pavarur janë ambasadorët më të mirë dhe kurajozë të interesave dhe opinionit të qytetarit të thjeshtë.

Në përshëndetjen drejtuar KLSH me rastin e 90 vjetorit të themelimit të tij, z. Gene L. Dodaro, Auditor i Përgjithshëm i Zyrës së Auditimit të Qeverisë i Shteteve të Bashkuara të Amerikës(GAO) theksoi: "*GAO është gjithashtu e vendosur për ta mbajtur publikun të informuar mbi punën e saj. Ne besojmë plotësisht në transparencën, në idenë se qytetarët duhet të jenë të informuar sa më shumë të jetë e mundur mbi rezultatet e performancës së qeverisë. Sipas mendimit tim, të kuptuarit nga publiku dhe mbështetja e tij, do të jenë thelbësore në adresimin e politikave të vështira që shtrihen përpara nesh* ».

Dua ta mbyll këtë shkrim për rëndësinë e transparencës së institucioneve të Shtetit tonë në luftën kundër korrupsionit, duke shfrytëzuar ndihmën dhe përvojat më të mira të institucioneve publike të SHBA-ve dhe Bashkimit Evropian, duke kujtuar fjalët e Kancelares gjermane Anxhela Merkel në vizitën e saj historike në Tiranë më 8 korrik 2015: "*Ne e mbështesim Shqipërinë për t'u bërë anëtare e Bashkimit Europian… Shqipëria ka mundësi të shfrytëzojë përvojat më të mira, sidomos në luftën kundër krimit dhe korrupsionit".*

KREU V.

Shkrime në Revistën Shkencore "Auditimi Publik" dhe Revistën "INTOSAI Journal"

- Sfidat drejt një institucioni modern të auditimit të jashtëm publik, ***Revista Shkencore "Auditimi Publik", Nr. 1, 2012***
- Niveli i borxhit publik dhe Kushtetuta, ***Revista Shkencore "Auditimi Publik", Nr. 2, 2012***
- Llogaridhënia, transparenca dhe përgjegjësia jonë si SAI, ***Revista Shkencore "Auditimi Publik", Nr. 3, viti 2012***
- Performanca e KLSH 2012 drejt një Institucioni Modern Auditimi Publik, ***Revista Shkencore "Auditimi Publik", Nr. 4, viti 2013***
- Mirëqeverisja - Paradigma e re në administrimin publik, ***Revista Shkencore "Auditimi Publik", Nr. 5, viti 2013***
- Analiza vjetore e Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2014 në frymën e IntoSAINT, ***Revista Shkencore "Auditimi Publik", Nr. 10, viti 2015***
- Vendimmarrja dhe Teknologjia Inteligjente, ***Revista Shkencore "Auditimi Publik", numri 11, viti 2015***
- **ALSAI innovative approaches in connecting with citizens (Qasjet inovative të KLSH në lidhjen me qytetarët)** *(Shkrim në anglisht, Revista "INTOSAI Journal", Nr. 21, shtator-dhjetor 2014)*

Shënim:

Revista "Auditimi Publik" është një revistë katërmujore shkencore, në gjuhët shqip dhe anglisht, botim i Kontrollit të Lartë të Shtetit, me numër rregjistrimi ndërkombëtar si revistë shkencore ISSN 2308-6106. Ajo ka nisur botimin në maj 2012 dhe ka vijuar pa ndërprerje deri sot.

Revista ofrohet si një periodik në fushën e kërkimit te aplikuar, shkencës dhe informacionit të auditimit publik dhe financave publike. Ajo synon të mbledhë mendimin më të përparuar, idetë dhe opinionet në fushën e auditimit, kontabilitetit dhe financave publike evropiane, duke i dhënë hapësirën më të gjerë specialistëve të enteve publike shqiptare dhe të huaja, akademikëve, profesionistëve të pavarur si dhe çdo lëvruesi dhe studjuesi të interesuar që gjen me vend trajtimin e një çështjeje të caktuar me interes publik në fushat e mësipërme, bazuar në moton e INTOSAI-t "Experentia mutua omnibus prodest (Eksperienca e përbashkët u shërben të gjithëve)".

Revista gjithashtu ka pasqyruar aktivitetet zyrtare të KLSH-së, duke ofruar në të njëjtën kohë informacione rreth zhvillimeve të fundit në fushën e auditimit publik në Shqipëri, në vendet e rajonit ballkanik, në BE dhe SHBA. Ajo ka dhënë dhe jep zhvillimet në institucionet kryesore ndërkombëtare të auditimit suprem publik si INTOSAI, EUROSAI OLACEFS, etj., duke ndjekur në veçanti të rejat dhe përditësimet e standardeve ndërkombëtare të auditimit publik ISSAI.

SFIDAT DREJT NJË INSTITUCIONI MODERN TË AUDITIMIT TË JASHTËM PUBLIK

nga Revista Shkencore "Auditimi Publik", Nr. 1, viti 2012

Sfidat e kohës së sotme janë tejet kërkuese dhe e vendosin një institucion auditimi, specifikisht Kontrollin e Lartë të Shtetit (KLSH), përballë një sprove të madhe. Në mbarë vendet me ekonomi tregut është bërë përparësi absolute disiplina buxhetore dhe financiare e administrimit publik. KLSH në rolin e tij si institucioni më i lartë i kontrollit ekonomiko-financiar në vend, sidomos i kontrollit të performancës së administrimit dhe financave publike, mbart një përgjegjësi të spikatur për miradministrimin e pronës shtetërore dhe zbatimin e buxhetit të shtetit, nëpërmjet një kontrolli të përdorimit të burimeve në mënyrë ekonomike, me efektivitet dhe efiçiencë.

Ndryshimet ekonomiko-politike që ndodhën pas vitit 1990 mundësuan krijimin e një institucioni të auditimit të financave publike sipas formateve që ekzistojnë në vendet me ekonomi tregu. në kushtet aktuale ku tranzicioni në një ekonomi tregu është në përfundim, në kushtet e një krize ekonomikofinanciare në vendet Europiane si dhe në ndjekje të standardeve ndërkombëtare të auditimit të cilat evoluojnë vazhdimisht, është i domosdoshëm avancimi në një vizion të ri modern për një institucion suprem auditimi.

1. Vizion koherent për KLSH, mbi bazën e eksperiencave më të mira të vendeve të BE-së dhe respektimit rigoroz të standarteve ndërkombëtare të kontrollit INTOSAI. KLSH duhet të synojë formatimin e punës duke e organizuar atë sipas parimeve të deklaratave INTOSAI të Meksikos (2007) dhe të Johanesburgut (2010), sipas praktikave më të mira të institucioneve simotra në vendet më të përparuara të Bashkimit Europian dhe e mbështetur tërësisht në kornizën e plotë kushtetuese dhe ligjore të vendit.

(Shënim: *Punimi në Revistë më tej vijon me një përmbledhje të Platformës Strategjike të paraqitur pranë Komisionit për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë më datë 14 Dhjetor 2011, në cilësinë e kandidatit për Kryetar të KLSH, nominuar nga Presidenti i Republikës me dekretin nr. 7163 datë 17 nëntor 2011*).

NIVELI I BORXHIT PUBLIK DHE KUSHTETUTA

nga Revista Shkencore "Auditimi Publik", Nr. 2, viti 2012

Borxhi publik i ngjan energjisë atomike. Ai duhet përdorur me kujdes dhe për qëllime frytdhënëse, në të kundërt mund të sjellë pasoja shkatërrimtare për ekonominë e një vendi ose të një rajoni.

Abstrakt

Ky artikull argumenton se pse niveli tavan i borxhit prej 60% konsiderohet optimal nën lupën e FMN-së, BB-së, legjislacionit të BE-së, KLSH-së dhe aktorëve të tjerë ekonomikë. Debati për këtë temë të nxehtë është sot më i ndezur se kurrë, për shkak të krizës financiare, pothuajse falimentimit ekonomik të Greqisë dhe klimës përgjithësisht jofavorizuese ekonomike në vendet e zhvilluara. Disa prej argumentave në favor të pëcaktimit të nivelit tavan të borxhit publik që identifikohen këtu janë: rritet siguria në kujdesin që tregon qeveria ndaj shpenzimeve të veta dhe po kështu rritet stabiliteti financiar dhe politik në vend dhe rajon, ulet probabiliteti i transferimit të riskut politik në risk vendi apo social, ruhet niveli i ulët i normës së interesit që stimulon rritjen e shpejtë ekonomike dhe punëzënie të kënaqshme, përmirësohet imazhi ekonomik dhe jo vetëm i Shqipërisë në arenën ndërkombëtare, Shqipëria nuk i ka aktualisht kapacitetet prodhuese për të suportuar nivel të lartë të borxhit publik.

Klasifikimet JEL: **E43, E62, G01, H63, H83 Fjalët Kyçe: borxh, publik, optimal, pemë binare, krizë financiare, kufi tavan.**

Hyrje

Në Traktatin e Maastrichtit specifikohet qartë, ndër të tjera, se financat qeveritare të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian nuk duhet të tejkalojnë limitin e defiçitit buxhetor 3 përqind ndaj Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) dhe borxhin qeveritar mbi 60 përqind ndaj PBB-së. Arsyet e fiksimit në atë kohë të këtyre limiteve synonin të krijonin stabilitet, besueshmëri dhe uniformitet mes shteteve anëtare dhe atyre që do të donin t'i bashkoheshin këtij Unioni. Sot, rreth 20 vjet më vonë nga nënshkrimi i Traktatit, pothuajse të gjitha vendet anëtare, përjashtuar Poloninë dhe Çekinë, nuk i janë përmbajtur këtyre kufizimeve-kushte. Gjermania, lokomotiva ekonomike e Bashkimit Evropian, ka një borxh publik në masën 84% të GDP-së. Në të njëjtat ujëra po noton edhe Franca (në Shtator të 2012, borxhi i saj publik kërceu në 91 përqind të PBB-së), ndërkohë që vende të tjera janë lëshuar"pa frena" në spiralen vicioze të borxhit. Banka Qendrore Evropiane, në një studim të saj të prillit 2012 me titull *"Analiza e*

qëndrueshmërisë së borxhit qeveritar në Eurozonë", pohonte se në kater vitet e krizës 2008-2011 niveli i borxhit publik në vendet e Eurozonës është rritur me 22 përqind, duke kapur një mesatare 88 përqind të PBB-së për secilin vend.

I amplifikuar edhe nga kriza financiare e vitit 2008 e në vijim dhe nga përshkallëzimi i problemeve të Eurozonës, kërcënimi i borxhit ka marrë përmasa të tilla, aq sa mjaft vende anëtare të BE-së po përpiqen të amendojnë Kushtetutën, për të përfshirë një ligj që do ta kufizojë përfundimisht nivelin e lejuar të borxhit publik. Ndërkohë mjaft vende të tjera e kanë bërë këtë. Polonia, Spanja, Italia, Gjermania, etj., po aplikojnë të ashtuquajturën *"Schuldenbremse"* – *"Freri i borxheve"* për të sjellë buxhetet dhe borxhet e tyre në ekuilibër.

Por a është borxhi publik epiqendra e rënies ekonomike së këtyre vendeve, apo thjesht një amplifikator i krizës? Disa nga argumentet në vija të trasha se pse niveli i borxhit duhet të fiksohet në vlerat 40% për vendet në zhvillim dhe 60% për vendet e zhvilluara janë si vijon[37]:

1.Limiti i sipërm i borxhit rrit sigurinë në kujdesin që tregon qeveria ndaj shpenzimeve të veta dhe po kështu rrit stabilitetin financiar dhe politik në vend dhe rajon

Le të sjellim si shembull rastin e Italisë, një pjesë e konsiderueshme e borxhit publik të së cilës mbahet nga Franca, rreth 20%. Borxhi publik italian shkon mbi 120% të GDP-së dhe nëse qeveria nuk do të ketë mundësi ta shlyejë, "stresi" financiar do të shtrihej edhe në Francë e më gjerë. Le të rikujtojmë gjithashtu se aktualisht Italia është nën drejtimin e një qeverie teknike, qëllimi primar i së cilës është dalja nga kriza financiare dhe vënia nën kontroll e treguesve makroekonomikë.

2. Ulet probabiliteti i transferimit të riskut politik në risk vendi apo social

Shpeshherë qeveritë priren të financojnë programet e tyre politike duke u mbështetur pa kriter në borxhin publik. Veçanërisht e vërtetë është kjo në fund të mandateve qeveritare, ku mund të vërehet një rritje e investimeve publike, ku si fond primar financimi shërben borxhi. Një veprim i tillë me borxhin ka kosto të madhe sociale dhe mund të kthehet në një model të keq të të bërit politikë.

3. Ruan nivelin e ulët të normës së interesit që stimulon rritjen e shpejtë ekonomike dhe punëzënie të kënaqshme

Nëse borxhi publik do të rritej në nivele të larta, kjo do të shoqërohej me rritje të normës së interesit në sektorin publik dhe atë privat. Rritja e normës do të ulte kredi-

[37] Shifrat i përkasin studimeve teknike të realizuara nga FMN.

dhënien duke penguar rritjen e sektorit financiar dhe atij real. Rrjedhimisht do të ulej punëzënia dhe do të përkeqësoheshin edhe me tej variablat makroekonomikëe financiarë si inflacioni, likuiditeti, risku politik, kursi valutor, etj.

4. Përmirëson imazhin ekonomik dhe jo vetëm të Shqipërisë në arenën ndërkombëtare

Le të rikujtojmë uljen e cilësisë së borxhit publik në disa vende nga agjensi të specializuara rating-u, si Moody's apo S&P. Ulja e rating për borxhin publik shkakton rritje të riskut të falimentimit, pamundësi për t'u financuar me borxh në të ardhmen, dalje të flukseve nga vendi dhe defiçit më të thelluar buxhetor.

5. Shqipëria nuk i ka aktualisht kapacitetet prodhuese për të suportuar nivel të lartë të borxhit publik (të ardhurat në buxhet gjenerohen nga tatimet dhe taksat, të cilat vetë gjenerohen nga niveli i prodhimit apo GDP) dhe **shtimi i borxhit në periudha krizash apo stanjacioni frenon edhe më tej rritjen e shpejtë të këtyre kapaciteteve.** Qëllimi i financimit me borxh publik është kryerja e shpenzimeve qeveritare. Këto shpenzime kanë përgjithësisht efekte indirekte dhe afatgjata në rentabilitetin financiar të sektorit privat, ndërkohë që shërbimi i borxhit publik kërkon flukse afatshkurtra. Në këtë drejtim, jo vetëm duhet kufizuar financimi me borxh publik si përqindje ndaj GDP, por edhe struktura e borxhit brenda këtij limiti duhet të jetë e tillë që të imunizohet sa të mundet ndaj shokut financiar dhe të ketë përputhje maturitetesh me shpenzimet prioritare qeveritare. Kjo arrihet duke emetuar borxh afatgjatë dhe qeveria shqiptare e ka realizuar këtë gjatë viteve të fundit, sepse e ka orientuar politikën e borxhit publik drejt rritjes sëstokut afatgjatë kundrejt atij afatshkurtër.

Gjithsesi, pavarësisht argumentave të mësipërm, duhet të jemi të qartë se **borxhi publik nuk është problematik në vetvete**. Ai thjesht amplifikon efektet e rritjes ekonomike apo krizave, pra e thënë ndryshe është "një thikë me dy presa". Është e vërtetë që në periudha krizash borxhi, dhe veçanërisht ai publik, dëmton më shumë sesa ndihmon, por në periudha rritjesh të shpejta borxhi është katalizatori i shumëfishimit të efekteve pozitive. Por edhe në periudha rritjesh, kufizimi i borxhit publik përsëri mbetet opsion i vlefshëm, sepse çliron fondet që mund të përdoren për kredi-dhënie dhe kredi-marrje nga sektori privat, i cili në një ekonomi të suksesshme tregu optimizon më mirë sesa sektori publik vendim-marrjen ekonomike dhe financiare.

Teoria e borxhit publik

Borxhi publik përkufizohet si borxhi i emetuar nga qeveria qendrore (megjithëse në mjaft raste këtu futet edhe borxhi i organeve vendore). Ky borxh për një vit të caktuar është i barabartë me deficitin buxhetor të atij viti, meqënëse diferenca midis të

ardhurave dhe shpenzimeve qeveritare, duhet financuar me burime të huazuara. Në varësi të faktit se kush e mban borxhin, ai ndahet në borxh të brendshëm kur zotërohet nga rezidentët vendas dhe borxh i jashtëm kur zotërohet nga të huajt. Për Shqipërinë, stoku i borxhit të brendshëm dhe të jashtëm për 6-mujorin e parë të 2012 ka qenë respektivisht 33,30% dhe 25,55% të GDP-së, për një total prej 58,85% të GDP-së.

Po kështu, në varësi të maturitetit të instrumentave me të cilat sigurohet borxhi, ai ndahet në afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë. Qeveria shqiptare ka synuar rritjen e peshës së stokut afatmesëm të borxhit kundrejt atij afatshkurtër. Për 6-mujorin e parë të 2012 pesha e borxhit afatmesëm ishte 67% ndaj totalit të borxhit[38]. Përgjithësisht, objektivi i qeverisë në lidhje me borxhin publik është *"përmbushja e nevojave financiare të qeverisë me koston më të ulët të mundshme përgjatë kohës"*. Por përveç kësaj, veçanërisht për vendet me ekonomi tregu në zhvillim, menaxhimi i borxhit publik nuk synon vetëm kostot dhe risqet e borxhit, por edhe qëndrueshmërinë e nivelit të borxhit qeveritar.

Studime të shumta adresojnë pikërisht nivelin optimal të borxhit qeveritar për të reflektuar apo vlerësuar qëndrueshmërinë e tij. Zakonisht në qendër të këtyre studimeve është Fondi Monetar Ndërkombëtar, si institucioni kyç i asistimit dhe monitorimit të performancës fiskale, monetare e financiare të vendeve anëtare. Këto studime theksojnë nivelin 60% të raportit borxh publik/GDP si kufirin e kujdesit për vendet e zhvilluara, ndërsa për vendet në zhvillim niveli 40% duket se është më i përshtatshëm, të paktën në afat të gjatë. Në raportin e 2010 publikuar nga Departamenti i Çështjeve Fiskale të Fondit, ofrohen "korrektime fiskale" që duhet të ndërmerren nga vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim për të konverguar drejt këtyre raporteve të sugjeruara borxh publik/GDP në 2030. Pra, literatura i trajton këto nivele si *"optimale",* në sensin që tejkalimi i tyre perben risk për qëndrueshmërinë e borxhit. Në fakt kjo është edhe në përputhje me modelin makroekonomik të Fondit, që i atribuon një rol dual politikës fiskale:

1) zbutjen e cikleve në biznesit në periudhë afatshkurtër;

2) arritjen e objektivave për qëndrueshmërinë e borxhit në afat të gjatë.

Por a është niveli 60% një nivel optimal në kuptimin teorik të fjalës? Kjo shifër në fakt është shkruar në mënyrë eksplicite në Traktatin e Maastrichtit, si parapërgatitje në atë kohë e vendeve europiane për të krijuar Bashkimin Europian dhe më pas Eurozonën.

[38] Përfshirë këtu edhe borxhin që maturohet brenda vitit, por që maturitetin fillestar e ka afatgjatë. Nëse përjashtohet kjo pjesë, atëherë pesha e borxhit afatmesëm bie në 58% të totalit të borxhit.

Asokohe nuk kishte një studim të mirëfilltë, shifra ishte vetëm mediana[39] e raportit borxh/GDP që kishin shumica e vendeve europiane. I vetmi studim fillestar ku përmendet kjo shifër është një artikull i titulluar *"Vlerësimi i qëndrueshmërisë",* përgatitur nga Departamenti i Politikave në bashkëpunim me Departamentet e Çështjeve Fiskale, Tregjeve Ndërkombëtare të Kapitalit, Çështjeve Monetare e Valutore dhe Kërkim-Zhvillimit brenda FMN-së. Studimi daton më 28 Maj 2002 dhe metoda që ai përdor për të konkluduar mbi nivelin *"optimal"* të borxhit është ajo CART[40] (specifikisht pema binare ripërsëritëse). Kjo metodë përcakton nivelin-prag të borxhit që diskriminon më mirë krizën nga jo-kriza, duke minimizuar gabimet statistikore të llojit 1 dhe 2. Nga aplikimi i metodës me këto të dhëna, niveli-prag rezulton 44,7% borxh publik/GDP. Për vendet me raport borxhi nën këtë prag, probabiliteti i krizës së borxhit është 2- 5%, ndërsa për vendet me raport më të lartë se pragu, probabiliteti i kushtëzuar shkon në 15-20%. E thënë ndryshe, edhe nëse vendet në zhvillim e tejkalojnë këtë prag, probabiliteti që shteti mos të bjerë në paaftësi paguese është 80%.

Nëse në model futet edhe një input shtesë, siç është raporti eksport/GDP, atëherë konkluzionet ndryshojnë. Futja e këtij indikatori shtesë në model justifikohet nga studimi me argumentin se vendi duhet të gjenerojë sufiçite tregtare për t'i shërbyer borxhit publik. Duke riaplikuar pemën binare, modeli konkludon se nëse raporti eksporte/GDP është 20-40%, atëherë pragu optimal i sipërm i borxhit është 60-80%.

Po kështu në artikullin e saj të Shtatorit 2010, *"Hapësira Fiskale"*[41], FMN-ja pohon se "*kufijtë e borxhit gjeneruar në studimet e saj nuk janë barriera absolute dhe të pandryshueshme. Po kështu, ky limit nuk duhet interpretuar si niveli optimal i borxhit publik*". Në këtë artikull që mbështetet mbi studimin e 23 vendeve të zhvilluara, kufijtë e regjistruara të borxhit, duke përdorur diferencën normë rritjeje ekonomike – normë interesi, shkojnë nga 150% në 260%, me medianë 192%. Duke supozuar se diferenca midis normës së rritjes dhe normës së interesit në të ardhmen nuk do të jetë aq e favorshme sa ka qenë në të kaluarën, studimi konkludon se limiti afatgjatë i borxhit duhet të konvergojë në 63%, ndërsa maksimumi deri në 183% e GDP-së.

Studiues të tjerë nuk duket se ndajnë të njëjtin mendim me FMN-në. Në 1944, Evsey Domar shprehej se: *"Problemi i borxhit është në thelb një problem i rritjes së të ardhurës*

[39] Vlera e mesit. Dallon nga mesatarja dhe moda.

[40] Classification and Regression Tree.

[41] "Hapësira Fiskale" përkufizohet nga autorët e artikullit si diferenca midis limitit maksimal të lejuar të borxhit publik, përcaktuar nga statistikat historike të korrektimit fiskal, me nivelin aktual të borxhit.

kombëtare". Të njëjtën gjë do të mbronte ai edhe 50 vjet më vonë kur shprehej se:*"Zgjidhja e duhur e problemit të borxhit nuk është të veshim këmishën e forcës, por të përshpejtojmë rritjen ekonomike"*.

Realiteti i borxhit publik

Pavarësisht niveleve të larta të borxhit publik në të kaluarën, nivele të cilat nuk janë shoqëruar me inflacion të lartë apo norma të fryra interesi, kriza financiare e viteve të fundit dhe dështimi i Greqisë ka rritur ndjeshmërinë e tregjeve financiare dhe qarqeve politike ndaj borxhit publik. Për të menaxhuar edhe politikisht borxhin publik, shumë vende po krijojnë ligje që adresojnë kryesisht deficitin buxhetor dhe indirekt edhe borxhin publik.

Zvicra e ka amenduar kushtetutën e saj që në 2001 për të frenuar nivelin e borxhit publik. Implementimi i këtij amendamenti hyri në fuqi në 2003. Sipas këtij ligji, buxheti duhet të jetë i balancuar, në përputhje me kushtet ekonomike. Korrektimi me kushtet ekonomike bëhet duke shumëzuar shpenzimet qeveritare me një faktor ciklik (raportin e trendit të GDP-reale me GDP-në e shpresuar). Në këtë mënyrë, lejohen deficitet gjatë periudhave të recesionit dhe kërkohen suficitet gjatë periudhave të bumit ekonomik. Në thelb, ligji synon balancë strukturore çdo vit dhe balancë absolute brenda një cikli ekonomik. Fillimisht ligji lejonte bërjen e "shpenzimeve të jashtëzakonshme" me aprovimin e një shumice të cilësuar parlamentare, por ndryshimet e kohëve të fundit i trajtojnë këto shpenzime si normale.

Gjermania në 2009 e amendoi kushtetutën për të futur *"frenën e borxhit"*. Ky ligj do të aplikohet si mbi qeverinë federale, ashtu edhe mbi Landet. Nga viti 2016 e në vijim qeveria federale ndalohet të ketë një deficit strukturor më shumë se 0,35% e GDP-së, ndërsa nga 2020 e tutje Landet nuk do të lejohen të kenë fare deficite strukturore[42] me përjashtim të rasteve të katastrofave apo krizave të rënda ekonomike. Lidhur me amendimin e kushtetutës nga Gjermania për problemin e borxhit publik, Noah Feldman, profesor i ligjit konstitucional dhe ndërkombëtar në Harvard, shprehet se gjermanët *"po sillen si Odiseja që e lidhi veten pas direkut të anijes për t'i shpëtuar tundimit të sirenave"*. Por në fakt, shou konstitucional i Merkelit dhe Sarkozisë synon t'ua bëjë të qartë anëtarëve më problematikë të Eurozonës se performanca e tyre e dobët ekonomike nuk do ta tërheqë poshtë gjithë Bashkimin Europian dhe pastaj të kërkojnë mbështetjene Gjermanisë dhe Francës për t'i nxjerrë nga kriza. Duke e fiksuar në kushtetutat e tyre, vendet anëtare tregojnë vullnet dhe disiplinë politike për të qenë zgjidhje dhe jo shkaktare të problemeve. Në një kontekst më të gjerë, kjo nënkupton

[42] Defiçiti strukturor është defiçiti buxhetor, pavarësisht ciklit ekonomik, pra defiçiti i shtrirë në kohë.

pikënisjen për unifikim të politikave fiskale, ashtu sikurse u unifikua politika monetare me futjen e euros në 1 Janar 2002. Pra politikisht, Gjermania dhe Franca po shfrytëzojnë për mirë krizën financiare duke krijuar një Bashkim të denjë për të konkurruar ekonominë amerikane në perëndim dhe atë japoneze në lindje.

Austria, Italia, Spanja, Polonia kanë ndërmarrë të gjitha hapat për të amenduar kushtetutat e tyre sipas modelit gjerman dhe në mënyrë implicite ose jo synojnë sjelljen e borxhit publik në nivelin e sugjeruar 60% të GDP-së. "Schuldenbremse" gjermane mbetet ende për t'u testuar në këto vende. Por tek e fundit të gjithë e dimë se sa performuese është inxhinjeria gjermane, qoftë edhe në ekonomi.

SHBA-të ka aplikuar historikisht një kufi mbi borxhin publik. Që nga viti 1917 Kongresi institucionalizoi *"tavanin e borxhit"*. Për ta ndryshuar këtë tavan kërkohet aprovimi i të dyja Dhomave të Kongresit. Që nga viti 1962 tavani i borxhit në SHBA është rritur 74 herë, ku rekordin e mban Ronald Reagan. Shumë shtete në Amerikë e kanë amenduar kushtetutën e tyre për të përfshirë buxhetet e balancuara, por kjo nuk është arritur në nivel federal. Në Kushtetutën Amerikane, Artikulli 1, Paragrafi 8 specifikohet qartë: *"The Congress shall have power . . .To borrow Money on the credit of the United States- Kongresi duhet të ketë fuqi... të marrë para hua në emër të Shteteve të Bashkuara të Amerikës"*.

Japonia aktualisht ka borxhin publik më të madh në botë, pothuajse sa dyfishi i ekonomisë së saj me GDP 5 trilionë dollarëshe. Legjislacioni japonez është më strikti në drejtim të borxhit publik. Kështu qeveria, sipas Ligjit të Financës Publike të vitit 1947, lejon vetëm *"obligacionet ndërtuese",* pra borxhin që emetohet me qëllim financimin e shpenzimeve që bëhen për krijim asetesh; e thënë ndryshe për investimet në infrastrukturë publike. Emetimi i borxhit për financim të defiçitit buxhetor, pra për të mbuluar konsumin apo mosarkëtimin e të ardhurave qeveritare, është i ndaluar. Megjithatë ky ligj aktualisht ka mbetur vetëm në letër.

Shqipëria dhe Borxhi Publik

Në ligjin nr. 9936 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"*, specifikohet në mënyrë eksplicite tek neni 58, pika c se: *"Borxhi total publik, përfshirë garancitë, nuk duhet të tejkalojë limitin 60 për qind të produktit të brendshëm bruto"*. Ky ligj është respektuar vazhdimisht nga Ministria e Financave. Si një ekonomi periferike dhe pjesërisht e integruar me atë europiane, ekonomia shqiptare ka qenë në një farë mase e paprekur nga kriza. Rrjedhimisht dhe mbajtja e nivelit të borxhit publik në kufirin e synuar ka qenë relativisht më e lehtë se në vendet e tjera të Eurozonës. Aktualisht borxhi publik afatgjatë i qeverisë shqiptare klasifikohet nga "Standard & Poors" si i klasës B+, ndërsa ai afatshkurtër si i klasës B. Arsyet e këtij klasifikimi janë si vijon:

1. Prosperitet relativisht i ulët mirëqënieje;

2. Nivel i lartë borxhi krahasuar me të ardhurat qeveritare;

3. Ekspozim i lartë ndaj faktorëve të ndryshëm, për shkak të deficiteve të mëdha në llogarinë korrente;

4. Mjedis i pasigurtë politik. Gjithsesi, rating-u mund të përmirësohet në të ardhmen si rrjedhojë e:

a) Performancës solide të rritjes ekonomike;

b) Potencialit të fuqishëm ekonomik në afat të gjatë;

c) Strukturës ligjore që i jep prioritet të lartë shërbimit të borxhit publik;

d) Perspektivës afatgjatë integruese në Bashkimin Europian.

Po kështu, S&P pohon se në afat të shkurtër rritja ekonomike do të jetë në nivelet 2-3%, ndërkohë që në afat të gjatë mund të shkojë në potencialin 5-6%. Kjo rritje ekonomike, rrjedhimisht dhe ulja e nivelit të borxhit e përmirësimi i klasifikimit të tij, mund të përforcohet duke përmirësuar konkurrueshmërinë, klimën e biznesit, uljen e burokracisë, zgjidhjen e problemeve pronësore, reduktimin e ekonomisë informale dhe zgjerimin e bazës tatimore.

Nëse Shqipëria do të dojë t'i bashkohet familjes europiane edhe në drejtim të unifikimit të politikave fiskale dhe veçanërisht në fushën e borxhit publik, atëherë duhet të ndërmerren studime të mirëfillta shkencore nga ana e Ministrisë së Financës, Bankës së Shqipërisë, Universiteteve dhe gjithë aktorëve të tjerë ekonomikë. Ekonomia shqiptare vitin e kaluar realizoi një defiçit buxhetor (diferenca mes shpenzimeve dhe të ardhurave shtetërore) prej 3.5 përqind të PBB-së, ndërkohë që ky defiçit në vitin 2010 ishte 3 përqind e PBB-së. Borxhi ynë publik gjatë vitit 2011 u shtua edhe më, për të kapur 58.8 përqind të PBB-së. Sfida e vitit zgjedhor 2013 që kemi përpara kërkon parashikimin e një disipline edhe më të kujdesshme buxhetore. Edhe pse, sikurse u theksua më lart, Ligji për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor tek ne e parashikon kufirin prej 60 përqind të PBB-së për borxhin publik, fiksimi i tij në Kushtetutëdo t'i shërbente pikërisht asaj disipline të kujdesshme buxhetore qëështë e domosdoshme për situatën ku jemi, por edhe zhvillimit afatgjatë ekonomik të vendit.

Janë këto arsyet pse Kontrolli i Lartë i Shtetit në Raportin e tij për zbatimin e Buxhetit të Shtetit të vitit 2011, i sugjeroi Qeverisë që të fiksohej në Kushtetutën e Shqipërisë për borxhin publik të vendit tavani prej 60 përqind e PBB-së, me besimin e plotë se brenda dy viteve pas diskutimit të gjerë me faktorët dhe aktorët ligjvënës, politikë dhe ekonomikë, kjo do të arrihet.

Referencat

1. *"Consolidated Version of the Treaty Establishing the European Community", Official Journal of the European Communities, 24.12.2002.*
2. *"Guidelines for Public Debt Management", IMF and World Bank Publications, 2003.*
3. *"Assessing Sustainability", International Monetary Fund, 28.05.2002.*
4. *"Analyzing Government Debt Sustainability in the Euro Area", European Central Bank, Monthly Bulletin, 04.2012.*
5. *"Public Debt Management and Fiscal Vulnerability: Potential Roles for SAIs", INTOSAI Public Debt Committee, 02.2003.*
6. *"Balanced Budget Acts as Dumb in Europe as in U.S", Prof. Noah Feldman, 22.08.2011*
7. *"S&P affirms rating on Albania Debt at 'B+/B': outlook is stable", 07.12.2012, http://noa.al/news/artikull.php?id=258 902.*

LLOGARIDHËNIA, TRANSPARENCA DHE PËRGJEGJËSIA JONË SI SAI

nga Revista Shkencore "Auditimi Publik", Nr.3, viti 2012

Transparenca dhe llogaridhënia janë dy parimet kryesore të qeverisjes së mirë në sektorin publik. Përgjegjësia jonë si SAI, si institucioni më i lartë i auditimit të jashtëm publik është që të kontribuojmë në llogaridhënien dhe transparencën e menaxhimit të fondeve publike

Abstrakt

Transparenca dhe llogaridhënia janë dy parimet kryesore të qeverisjes së mirë në sektorin publik. Përgjegjësia jonë si SAI, si institucioni më i lartë i auditimit të jashtëm publik është që të kontribuojmë në llogaridhënien dhe transparencën e menaxhimit të fondeve publike. Këtë kontribut Kontrolli i Lartë i Shtetit e ka pasur në fokus të çdo auditimi të kryer gjatë vitit 2012. Sikurse thekson me shumë mprehtësi President i Gjykatës së Llogarive të Turqisë, As. Prof. Dr. Rejai Akiel, *"Çështja kryesore dhe më e rëndësishme e SAI-t është që të ruaj një cilësi të lartë në aktivitetet e tij të auditimit, në mënyrë që të drejtohet nga shembujt e mirë dhe të mund të justifikojë arsyen e ekzistencës së tij*[43] *".*

Si institucion i auditimit të jashtëm, KLSH duhet t'i përmbahet standardeve të cilësisë dhe në të njëjtën kohë audituesit e tij duhet të mbajnë flamurin e pavarësisë, objektivitetit, skepticizmit profesional dhe llogaridhënies ndaj publikut, duke kryer punë cilësore auditimi.

Fjalët Kyçe: **llogaridhënie, transparencë, integritet menaxhimi, cilësi auditimi, mirëqeverisje, sinergji.**

[43] As. Prof. Dr. Recai Akyel, "Integriteti i menaxhimit të auditimit, llogaridhënia dhe Tone at the Top"; marrë nga nr.2 i Revistës Shkencore të KLSH-së "Auditimi publik", fq. 6.

Në punimin e tij *"Qeverisja e mirë, llogaridhënia dhe nepunesi publik",* Profesor Allan Rosenbaum[44], lëvruesi i njohur i financave publike shprehet se*:"Nuk ka çështje më qendrore për qeverisjen e mirë se sa të sigurohet që ata që i drejtojnë dhe menaxhojnë qeveritë të japin në menyrë konstante llogari përpara qytetarëve të tyre. Kjo është një çështje me të cilën të gjitha shoqëritë demokratike, në një mënyrë ose një tjetër, duhet të angazhohen"*.

Ne si SAI kemi shumë palë të interesuara në realizimin e misionit tonë të përmirësimit të qeverisjes: qytetarët, Parlamentin, entet e audituara dhe organizatat e shoqërisë civile. Besimi i palëve të interesuara për një SAI do të thotë besim i Parlamentit dhe publikut, në përgjithësi, për rezultatet e punës së SAI-t. Është e rëndësishme që puna e KLSHsë të mbetet relevante, e besueshme dhe e dobishme për palët e interesuara, veçanërisht për Kuvendin. Misioni ynë është informimi i publikut dhe i Kuvendit të Shqipërisë në lidhje me përgjegjshmërinë e qeverisë dhe të enteve të tjera publike për përdorimin e burimeve publike sipas ligjit, me ekonomicitet, efektivitet dhe efiçiencë dhe nxitja e kësaj përgjegjëshmërie në të gjithë sektorin publik, në përputhje me praktikat më të mira te BE-së, me standartet ndërkombëtare të INTOSAI dhe me ndjeshmërinë popullore për shtimin e luftës kundër korrupsionit. Në sektorin privat, aftësia e një kompanie për të ndërtuar dhe për të ruajtur besimin e aktorëve të saj është shumë e rëndësishme për biznesin. Kjo ndodh edhe për institucionet publike. Për KLSH-n, si një institucion publik që punon në emër të Kuvendit, aftësia për të krijuar besimin në palët e interesuara është e një rëndësie vendimtare.

Integriteti i menaxhimit të auditimit paraqitet shumë i rëndësishëm për ne, në drejtim të rritjes së besimit të palëve të interesuara. Qytetarët duan të dinë se si shpenzohen fondet publike nga institucionet publike dhe se si institucionet i kryejnë detyrat e tyre. SAI punon si një ndërmjetës në këtë kontekst, auditon institucionet dhe raporton në lidhje me llogaritë dhe transaksionet e tyre në Parlament dhe tek qytetarët. Sipas përcaktimit të Presidentit të Gjykatës së Llogarive të Turqisë, As. Prof. Dr. Rejai Akiel, "*integriteti i menaxhimit të auditimit nënkupton kryerjen e këtyre auditimeve me staf kompetent dhe të pavarur, i cili përdor një kod sjellje të mirëprovuar dhe i kryen auditimet në përputhje me ligjet dhe standardet profesionale INTOSAI. Pra, duhen përmbushur disa kushte për të siguruar integritetin e menaxhimit të auditimit: audituesit duhet të jenë të kualifikuar, kodi i etikës duhet të jetë i qartë, procedurat e*

[44] Prof. Allan Rosenbaum, Drejtor i Institutit per Menaxhim Publik dhe Sherbime Komunitare: "Qeverisja e mire, llogaridhënia dhe nepunesi publik", studim, fq. 7, Universiteti Nderkombetar i Floridas, SHBA,

auditimit duhet të jenë të hapura dhe të mirëpërcaktuara, lidershipi i SAI-t duhet të sigurohet që monitorimi për të vlerësuar procesin e auditimit dhe raportet e auditimit është i rregullt[45] *".*

Në bazë të standardit ISSAI 20, "... *përgjegjshmëria për SAI-n qëndron në përgjegjësinë e treguar për planifikimin dhe kryerjen e punës së tij audituese, duke përdorur metodologjitë dhe standardet e duhura për të siguruar llogaridhënien dhe transparencën mbi aktivitetet publike, duke përmbushur përgjegjësitë e tij në mënyrë të plotë dhe objektive*[46] *".* Në kontekstin e përgjegjshmërisë, proceset e punës, aktivitetet dhe produktet duhet të jenë transparente dhe SAI-t duhet të komunikojnë hapur me aktorët e tyre. Përgjegjësia ndahet në përgjegjësinë e lidershipit dhe të stafit të një SAI. Përafrimi i njohur në literaturën botërore me shprehjen "Tone at the top"(theksi në majë) ka të bëjë me përgjegjësitë e lidershipit për të siguruar cilësinë e produkteve apo shërbimeve që ofron institucioni. Termi është përcaktuar nga IFAC si vijon: *"Standardi i vendosur nga lidershipi i një organizate në të cilin është matur performanca; kultura brenda së cilës veprojnë anëtarët e organizatës, mënyra e veprimit e vendosur nga lidershipi, pavarësisht strategjive të dokumentuara për drejtimin dhe politikat, ajo është forca që drejton profesionistët individualë; dora e padukshme që drejton pavarësisht rregulloreve*[47] *".*

Ne si KLSH jemi përgjegjës për auditimin e institucioneve publike dhe shqyrtimin e llogarive, pasqyrave financiare dhe strukturës së auditimit të brendshëm të tyre, duke bërë sugjerime në mënyrë që ato të kontribuojnë në mirëqeverisjen e sektorit publik.

Po vetë funksionet e SAI-t dhe cilësia e veprimtarisë së tij? Sigurisht, si një institucion i jashtëm auditues, KLSH duhet të jetë shembull për ofrimin e një pune cilësore. Sikurse përmendet në raportin e EUROSAI-t, *"cilësia është e nevojshme si për punën profesionale të SAI-t, ashtu dhe për administrimin e tij*[48] *".*

Siç thuhet në Raportin e Komitetit të Audituesve Ndërkombëtarë, *"kultura brenda SAI-ve është çelësi për auditime cilësore, pasi ajo krijon një mjedis ku arritja e cilësisë në çdo aspekt të procesit të auditimit vlerësohet dhe shpërblehet. Brenda SAI-t arritja e cilësisë është shumë më e domosdoshme se në institucionet e tjera, për vetë rolin që SAI ka si gjykues i punës së të tjerëve*[49] *".* Për këtë arsye

[45] As. Prof. Dr. Recai Akyel, "Integriteti i menaxhimit të auditimit, llogaridhënia dhe Tone at the Top"; marre nga nr.2 i Revistes Shkencore te KLSh-se "Auditimi publik", fq. 9

[46] ISSAI 20, botim i vitit 2010, fq. 3

[47] IFAC, Komiteti i Audituesve Ndërkombëtarë, botim i vitit 2007, fq. 8.

[48] Raporti i Grupit të Punës së EUROSAI-t, botim i vitit 2010, fq. 18

[49] Raporti i Grupit të punës së EUROSAI-t, botim i vitit 2010, fq. 7

ruajtja e një niveli të caktuar të cilësisë bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm për SAI-t. Reputacioni i SAI-ve bazohet në cilësinë e prodhimit të tyre.

Nga ana tjetër, sipas përcaktimit të bërë nga Grupi i Punës i INTOSAI-t mbi Vlerat dhe Dobitë e SAI-ve: "*Një SAI duhet të jetë një organizatë model dhe të drejtojë nëpërmjet shembullit, p.sh., në qeverisjen e mirë, transparencën dhe llogaridhënien për performancën e SAI-t, duke ndjekur standardet etike, në promovimin e një kulture të cilësisë dhe përmirësimit të vazhdueshëm, si dhe në të mësuarit dhe shkëmbimin e njohurive*[50]*".*

Të përqëndruar për sigurimin e nivelit të duhur të llogaridhënies dhe të cilësisë në auditim, duke zbatuar rekomandimin e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë për *"Kryerjen e auditimeve ndaj përdorimit të fondeve të Buxhetit të Shtetit, si dhe fondeve të projekteve të financuara nga BE-ja e nga institucionet financiare ndërkombëtare me objektivitet, profesionalizëm, cilësi dhe efektivitet të lartë",* si KLSH kemi realizuar gjatë vitit të kaluar 177 auditime nga 153 të planifikuara dhe kemi përfunduar 158 auditime.

Gjatë auditimeve të kryera në vitin 2012 (me periudhe 2-3 vjeçare aktiviteti të entit që auditohet), KLSH ka vërejtur parregullsi dhe shkelje financiare në të ardhurat e mbledhura dhe në shpenzimet e kryera nga entet publike të audituara, institucione te Pushtetit Qendror dhe Vendor, me dëm ndaj Buxhetit të Shtetit në shumën 13, 522, 392, 000 lekë, ose 97.3 milione euro. Institucioni ka rekomanduar që kjo shumë të zhdëmtohet në masën 100 përqind.

Institucioni ka zbuluar shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në perfomancën e subjekteve të audituara, në shumën e përgjithshme 1, 842, 998, 000 lekë, ose 13.2 milione euro.

Shkeljet financiare janë vërejtur kryesisht në prokurimet publike, në shitjen dhe dhënien me qira të pasurisë shtetërore, në urbanistikë, në shpenzimet operative, në doganat, në tatimet e taksat, etj.

Ekziston një perceptim negativ i publikut në lidhje me nivelin aktual të korrupsionit në administratën publike. Ky perceptim vjen nga moszbulimi dhe mosndëshkimi i korrupsionit në nivel të mjaftueshëm nga ana e organeve shtetërore përgjegjëse për ta luftuar këtë dukuri. Në këtë këndvështrim, mirëqeverisja është antidoti më i mirë ndaj korrupsionit. Fondi Monetar Ndërkombëtar është shprehur se *"të promovosh mirëqeverisjen në të gjitha aspektet e saj, duke siguruar sundimin e ligjit, duke përmirësuar efiçiencën dhe përgjegjësinë*

[50] Botim i INTOSAI "Kuadri i Matjes së Performancës së SAI-ve", shtator 2012, fq. 11

sektorit publik dhe duke luftuar korrupsionin, janë elementë thelbësorë të një kuadri ku ekonomitë mund të prosperojnë[51]*".*

Mendoj se gjithnjë përpara nesh duhet të kemi fjalët e çmuara të Sekretares së Shtetit Hilari Klinton në adresimin e saj në Kuvendin e Shqipërisë. *"Është gjithmonë e rëndësishme t'i kujtojmë vetes se konsolidimi i demokracisë kërkon më shumë se vetëm zgjedhje. Kërkon studim logjik. Kërkon institucione të forta ... Kërkon që qeveria të jetë e hapur në mënyrë që njerëzit të na pyesin ne menaxherëve të llogarive publike. Unë kërkoj me ngulm që ju të përballeni me problemin që ndikon në kaq shumë demokraci sot në botë, pikërisht me korrupsionin ... Kjo është një luftë që secili vend duhet ta kryejë dhe të fitojë në të gjithë botën, sepse korrupsioni është një kancer që gërryen shoqëritë ... Zhdukja e korrupsionit kërkon përpjekje të pandalshme dhe një angazhim të përbashkët".*

Si KLSH gjatë vitit 2012 kemi kryer 40 kallëzime penale për 125 punonjës të administratës shtetërore të niveleve të ndryshme, ose 2 herë më shumë kallëzime nga sa institucioni ka bërë në vitet 2009-2011 të marra së bashku.

Senatori kanadez John Williams, Kryetar i Organizates Globale te Parlamentareve Kunder Korrupsionit (GOPAC) shprehet se *:"Qeverisja e mirë, qoftë në sektorin publik ose privat, është gjithmonë një sfidë. Ndërsa ne duam dhe presim që njerëzit të veprojnë me ndershmëri dhe integritet, në shumë raste, vetë interesi, lakmia, dhe mungesa e respektimit të të drejtave të të tjerëve kapërcen detyrimin themelor për të vepruar në mënyrë etike... Qeverisja e mirë kërkon vigjilencë të vazhdueshme nga drejtuesit për të siguruar llogaridhënie efektive. Njohja e problemit është e lehtë, zgjidhja është sfidë. Shumica e njerëzve nuk kanë dëshirë të japin llogari, por llogaridhënia është themeli mbi të cilin qeverisja efektive dhe një shoqëri e begatë mund të ndërtohen"*[52].

Është vërejtur botërisht se rritja e përgjegjësisë së menaxherëve publikë ndikon menjëherë në uljen e korrupsionit. Puna jonë shkon në sinkron me Strategjinë Ndërsektoriale të Parandalimit, Luftës kundër Korrupsionit dhe Qeverisjes Transparente 2008-2013 të qeverisë Berisha, e cila kërkon një bashkëpunim më të ngushtë të institucioneve kryesore që e luftojnë korrupsionin, të bazuar në angazhime të përbashkëta të institucionalizuara.

Gjatë vitit të kaluar, KLSH është përpjekur të krijojë sinergji për mirëqeverisjen, duke bashkëpunuar në sistem me institucionet e tjera shtetërore. Në mars 2012, nënshkruam një marrëveshje bashkëpunimi me Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive të funksionarëve të lartë të shtetit dhe një me Autoritetin Shqiptar të

[51] Udhëzues, "Qasja e FMN-së në promovimin e mirëqeverisjes dhe në luftën ndaj korrupsionit", ribotim i vitit 2011, fq. 18

[52] "Lllogaridhënia dhe Qeverisja e mire. Pa llogaridhënien, korrupsioni lulëzon", John Williams, artikull, Revista e Audituesve të Përgjithshëm të Çertifikuar (CGA), Nëntor-Dhjetor 2011, fq. 37

Konkurrencës, me synimin e zbulimit të çdo rasti të pasurimit të shpejtë të funksionarëve publik, si dhe të rasteve të prishjes së konkurrencës në tenderat dhe ankandet shtetërore. Në qershor 2012 nënshkruam marrëveshjen e bashkëpunimit me Prokurorinë e Përgjithshme. Nga kallëzimet e institucionit vetëm në muajin Dhjetor 2012, institucioni i Prokurorisë ka nisur hetimet për 35 punonjës publikë të kapur me shkelje nga KLSH në bashkitë Vlorë, Sarandë, Himarë, Pogradec dhe Përmet, si dhe në Ndërmarrjen e Ujësjellës Kanalizimeve Mat. Kjo është parësore në ndërgjegjësimin e strukturave dhe enteve publike për përgjegjësitë që ato kanë në administrimin e pronës shtetërore. Bashkëpunimi efiçient i institucioneve si KLSH dhe Prokuroria e Shtetit në zbulimin dhe hetimin e abuzimeve me pronën shtetërore prodhon përgjegjshmëri. Një shkallë më e lartë përgjegjësie ndaj disiplinës së rreptë financiare dhe detyrave të tjera publike ul korrupsionin. Nga ana tjetër, sfida jonë tjetër kryesore, modernizimi i institucionit, realizohet duke koordinuar si duhet punën me institucionet e tjera. Në përmbushje të objektivit të platformës strategjike të caktuar në dhjetor 2011 për institucionin, kemi siguruar bashkëpunim profesional me Institutin e Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA) dhe me Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit.

Kemi iniciuar në maj 2012 marrëveshjen e bashkëpunimit me Ministrinë e Financave, sidomos me strukturat e saj të auditimit të brendshëm. Kjo marrëveshje është në veprim dhe do të realizohet e plotë gjatë këtij viti në objektivat e saj kryesorë, në bazë të standardeve ISSAI 9150 dhe 1240. Ndajmë mendimin që forcimi i kapaciteteve të auditimit, si atij të brendshëm dhe të jashtëm publik, është rruga e duhur për të mbështetur maksimalisht rritjen e përgjegjshmërisë, transparencës dhe ndershmërisë në qeverisje.

KLSH ka sjellë në vitin 2012, 58 propozime për përmirësim të legjislacionit, nga të cilat 15 janë zbatuar tashmë, ndërsa 24 janë në proces zbatimi. Ka rekomanduar 2194 masa organizative, nga të cilat janë zbatuar 1659 ose 76 përqind e tyre.

Institucioni ka rekomanduar 1221 masa disiplinore dhe administrative, nga të cilat 802 ose 66 përqind janë realizuar që gjatë këtij viti. Ndërsa në përmbushjen e rekomandimeve tona për masat organizative, ato disiplinore dhe administrative kemi nivel të mirë zbatueshmërie, masat për largime nga puna të punonjësve të gjetur me shkelje janë në nivel shumë të ulët. Ky mosrealizim ka ardhur nga serioziteti i pakët i enteve të audituara në ndështkimin e shkelesve të ligjit brënda stafit të tyre. Na del një detyrë e rëndësishme për këtë vit që të ngremë në një nivel të pranueshëm këtë tregues shumë të rëndësishem për forcimin e kulturës së ndërshkueshmërisë, ose ndryshe të përgjegjësisë dhe llogaridhënies në administratën publike.

Përmirësimi i qeverisjes duke luftuar korrupsionin dhe antikulturën e pandë-shkueshmërisë, nëpërmjet transparencës së plotë dhe funksionale me publikun, ka

përbërë një nga përparësitë e veprimtarisë së KLSH gjatë vitit të kaluar. Ai është njëkohësisht shprehje e filozofisë dhe përqasjes sonë për të vendosur në plan të parë interesat e qytetarit. Kemi trajtuar 358 letra dhe ankesa nga qytetarët për probleme të ndryshme, nga të cilat 111 i kemi konstatuar jashtë kompetencave dhe juridiksionit të KLSH-së, kurse nga 247 kërkesa dhe ankime në kompetencë të institucionit, 171 prej tyre i kemi verifikuar dhe u kemi dhënë përgjigjen përkatëse, ndërsa 76 janë në vijim të verifikimit.

Për rritjen e transparencës dhe efiçiencës në auditim, KLSH ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me disa nga OJF-të më të spikatura në promovimin e transparencës në administratën publike dhe në luftën kundër korrupsionit dhe konkretisht me Transparency Internacional në Shqipëri, me lëvizjen Alternativa Civile, me Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë, me Institutin e Studimeve Bashkëkohore, me Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim, me Lëvizjen Evropiane Shqipëri dhe me Institutin "G&G Group". Këto nuk janë marrëveshje sa për numër. Marrëveshjet shprehin filozofinë e punës sonë, realizimin e veprimtarisë me ekonomicitet, efektivitet dhe efiçiencë, duke gjeneruar sinergji me bashkëpunimet. Nga OJF-të kërkojmë jo vetëm bashkëpunim për transparencë, por edhe të marrin pjesë aktive në auditimet tona dhe ato të na auditojnë ne.

Sikurse shprehet Grupi i Punës i INTOSAI-t mbi Vlerën dhe Dobitë e Institucioneve më të Larta të Auditimit (SAI-ve), *"Sigurimi i cilësisë tek performanca e SAI-t nënkupton se vlerësimi është rishikuar nga dikush, i cili nuk ishte i përfshirë drejtpërdrejt në punën e vlerësimit të hollësishëm, me qëllim sigurimin se cilësia është e mjaftueshme. Transparenca në lidhje me natyrën dhe procesin e sigurimit të cilësisë është thelbësore për besueshmërinë e vlerësimit në sytë e të gjithë aktorëve. Sigurimi i cilësisë duhet të ndërmerret nga individët dhe organizatat që janë të njohur me vendin dhe SAI-n*[53]*"*

Në zbatim të parimit 8-të të ISSAI 20 për komunikimin aktiv të një SAI nëpërmjet publikimeve, gjatë vitit 2012 institucioni përgatiti dhe botoi *"KLSH-Analiza Vjetore 2011", "KLSH në Kuvend", "KLSH-Analiza 6-mujore 2012", "EUROSAI dhe SAI-t Evropiane", "Standardet ISSAI 1, 10, 11, 20, 30, 40, 100 dhe 200", "Historiku i KLSH",* dy numra të revistës shkencore *"Auditimi Publik"* dhe *Manualin e përditësuar të Auditimit të Performancës.* Më datën 28 dhjetor 2012, me rastin e 100 Vjetorit të Pavarësisë, KLSH zhvilloi Konferencën e tij të parë Shkencore, duke ju referuar historikut të institucionit dhe punës shumëvjeçare të të gjithë individëve që kanë kontribuar për ngritjen dhe mbarëvajtjen e tij në periudha kohore të ndryshme. Kjo konferencë për këtë vit 2013 dhe vitet në vijim synon të kthehet në një traditë dhe një forum qasjesh dhe

[53] Botim i INTOSAI "Kuadri i matjes së performancës së SAI-ve", shtator 2012, fq. 16

eksperiencash auditimi si për auditimin e jashtëm dhe atë të brendshëm publik, duke sjellë edhe përvojën audituese të institucioneve homologe të zhvilluara në rajon dhe më gjerë.

Puna në sistem për mirëqeverisjen, përgjegjësia jonë për transparencë dhe llogaridhënie mbartin në vetvete një përgjegjësi ligjore, profesionale dhe morale tepër të lartë. Për të qenë sa më efektivë dhe për të modernizuar kapacitetet tona audituese dhe gjithë aktivitetin, në zbatim dhe të rekomandimit të Progres-Raportit 2012 të BE-së për Shqipërinë, i cili ka nënvizuar se: *"Auditimi i jashtëm duhet të vijë në nivel me standardet e INTOSAI*[54]*",* gjatë vitit 2012 plotësuam përgatitjen e draft-amendimeve të ligjit organik të KLSH, në bashkëpunim intensiv me Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në BE, DG-Budget dhe me SIGMA. Gjatë ditëve të para të Nëntorit 2012 organizuam katër tryeza pune me pedagogë të Universitetit Shtetëror të Tiranës dhe ekspertëve të njohur ligjorë, kontabël dhe të financave publike, si dhe me përfaqësues të shoqërisë civile dhe të mediave. Në këto tryeza mori pjesë dhe një Drejtor Njësie në DG-Budget, specialist i fushës. Nga tryezat rezultuan sugjerime të vlefshme që u reflektuan në draftin përfundimtar të projekt-ligjit me amendimet, i dorëzuar Kuvendit të Shqipërisë më 30 nëntor 2012 dhe sipas DG-Budget, *"tërësisht në përputhje me standardet INTOSAI"*. Amendimet sjellin një konceptim modern të të drejtave dhe detyrave të KLSH. Ato do të ndihmojnë në rritjen e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të tij, në rritjen e kapaciteteve administrative, në saktësimin e së drejtës së KLSH të auditojë fondet e akorduara nga BE për Shqipërinë deri tek përdoruesi i fundit dhe në saktësimin e së drejtës të çertifikojë llogaritë financiare të enteve të audituara. Ne besojmë se Kuvendi do të na mbështesë si gjithmonë. Për më tepër, vetë Rezoluta e Kombeve të Bashkuara e 22 Dhjetorit 2011 i inkurajon shtetet anëtare të OKB-së dhe parlamentet e tyre të *"mbështesin SAI-t të kryejnë detyrat e tyre në mënyrë objektive dhe efektive, duke qenë të pavarura nga subjekti i audituar dhe të mbrojtura nga ndikimet e jashtme*[55]*"*. Me amendimet e ligjit te KLSH përmirësohet qeverisja dhe rritet ndjenja e përgjegjësisë dhe llogaridhënia në administratën publike.

Në Projekt-Idenë e paraqitur më datë 14 Dhjetor 2011 në Komisionin e Ekonomisë dhe të Financës së Kuvendit, si kandidat i nominuar nga Presidenti i Republikës, theksova se : *"KLSH është përpara një sfide të fortë për ta përqëndruar punën tek auditimi i performancës, sepse ai i shërben vleresimit të përgjegjshmërisë publike. Përqëndrimi i vëmendjes tek auditimi i performancës do të jetë ndër shtyllat kryesore të planit të ri strategjik 2013-2016 të institucionit"*.

[54] Raport Progresi 2012 i Bashkimit Evropian për Shqipërinë, fq. 66

[55] Rezoluta e OKB-së "Për nxitjen e efiçiencës, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës së administratës publike duke fuqizuar institucionet supreme të auditimit", 22 dhjetor 2011, fq. 3

Gjatë vitit 2012, katërfishuam numrin e auditimeve të performancës, në krahasim me një vit më parë (duke u nisur nga një bazë shumë e dobët) dhe përditësuam Manualin e Auditimit të Performancës, që ai t'u shërbejë më konkretisht audituesve tanë. Në shtator 2012, institucioni ngriti Departamentin e Auditimit të Performancës, me në krye një nga studjuesit më premtues të makroekonomisë shqiptare dhe Doktor i Shkencave në financat publike, si dhe me 16 auditues ndër ata më me përvojë në KLSH dhe auditues të rinj me perspektivë të qartë për ngritje profesionale.

Me qëllim përmirësimin e medotologjisë së auditimit dhe raportimeve tona, ngritëm në shkurt 2012 Departamentin e Kërkimit Shkencor, Zhvillimit dhe Teknologjisë së Informacionit. Gjatë vitit 2012 institucioni aplikoi dhe fitoi një projekt binjakëzimi për zhvillimin e metodologjisë dhe kapaciteteve të tij audituese, në kuadër të financimeve IPA 2012, me vlerë 2.11 milionë euro, i cili do të bëhet veprues në fund të këtij viti. Falënderojmë me këtë rast Delegacionin e BE-së në Tiranë, Ministrinë e Integrimit dhe DG-Budget për mbështetjen e dhënë, pas 4 vitesh që institucioni nuk kishte perfituar asnjë asistence teknike nga donatoret. Jemi të bindur se ndikimi ynë në mirëqeverisjen publike është tërësisht në funksion të nivelit të kapaciteteve tona.

Gjatë vitit 2012, kemi rekrutuar sipas të gjitha rregullave të punësimit në administratën publike shumë punonjës të rinj, ndër të cilët katër me gradën shkencore Doktor i Shkencave dhe tetë me nivel pasuniversitar të Programit Master. Kemi parë si mjetin kryesor të forcimit të kapaciteteve audituese të institucionit trajnimet intensive të stafit, si atij me përvojë edhe atij të ri, në përvetësimin e standardeve INTOSAI. Për këtë, kemi lidhur, duke filluar nga muaji shkurt 2012 e në vijim, marrëveshje bashkëpunimi me institucionet simotra të zhvilluara të auditimit më të lartë publik, si Zyra e Audituesit të Përgjithshëm të Kosovës, Zyra Kombëtare e Auditimit(NIK) e Polonisë, Gjykata e Auditimit e Sllovenisë, Gjykata e Llogarive e Turqisë dhe Institucioni i Auditimit Shtetëror të Kroacisë. Si rezultat i zbatimit të këtyre marrëveshjeve, gjatë vitit 2012 u trajnuan jashtë shtetit një numër audituesish të KLSH-së i barabartë me numrin e punonjësve të institucionit të dërguar jashtë gjatë shtatë viteve 2004- 2011 të marra së bashku. Realizuam në gjysmën e dytë të vitit 2012 me ekspertë të SIGMA-s në Tiranë një program intensiv trajnimesh për auditimin e performancës, auditimin financiar dhe auditimin e teknologjisë së informacionit, program të cilin do ta vijojmë edhe këtë vit. Vitin 2012 e mbyllëm me një tregues 19.4 ditë trajnimi për auditues në KLSH, nga vetëm 2.1 ditë trajnimi në vit për auditues, që kishim trashëguar nga viti 2011. Ky tregues i sotëm është në nivel me treguesit e ditëve të trajnimit në vit për auditues të institucioneve të auditimit suprem më të zhvilluara në kontinent.

Në tërësi, gjykoj se masat e marra dhe puna e kryer gjatë vitit 2012 na lejojnë të jemi ambiciozë në objektivat tona për vitin në vijim. Në bashkëpunim me ekspertë të

SIGMA, kemi përgatitur Planin e Zhvillimit Strategjik të KLSH-së për vitet 2013-2016, i cili përmban objektivat kryesorë si: përmirësimi i bazës ligjore dhe rregullatore të KLSH-së, në përputhje me standardet e INTOSAI-t dhe praktikat më të mira europiane, përmirësimi i metodologjisë dhe rritja e cilësisë në auditim, përmirësimi i cilësisë dhe shtimi i numrit të auditimeve të performancës, krahas konsolidimit të auditimeve të përputhshmërisë dhe atyre financiarë, sigurimi i mirëqeverisjes, si dhe rritja e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies për një menaxhim të shëndoshë financiar. Këto objektiva do të jenë parësore për ne gjatë këtij viti dhe në vijim.

Bashkëpunimi i gjerë dhe i thellë me Kuvendin e Shqipërisë, me Institucionin e Presidencës, me Qeverinë dhe me të gjithë partnerët tanë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, është për ne garancia më e plotë në suksesin e objektivave dhe përpjekjeve tona për llogaridhënie efektive të enteve që auditojmë, për transparencë efiçiente dhe përgjegjshmëri në realizimin e misionit të KLSH-së.

Literatura

1. ISSAI 1, 10, 20, 40, 1240 dhe 9150
2. Prof.Ass.Dr. Recai Akyel, President i Gjykatës Turke të Llogarive, "Integriteti i menaxhimit të auditimit, llogaridhënia dhe Tone at the Top"; prezantim i mbajtur ne Konferencën VII EUROSAI-OLACEFS në Tbilisi, Gjeorgji, shtator 2012.
3. IFAC, "Komiteti i Audituesve Ndërkombëtarë", botim i vitit 2007 Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë për Vlerësimin e Aktivitetit të KLSH, 26 prill 2012
4. *Rezoluta e OKB "Për nxitjen e efiçiencës, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës së administratës publike duke fuqizuar institucionet supreme të auditimit", 22 dhjetor 2011*
5. *Raport Progresi 2012 i Bashkimit Evropian për Shqipërinë.Raport i Komitetit të Audituesve Ndërkombëtarë, botim i EUROSAI, 2010*
6. *Allan Rosenbaum, "Qeverisja e mirë, llogaridhënia dhe nëpunësi publik", 2009, Universiteti Ndërkombëtar i Floridas, SHBA*
7. *John Williams, "Llogaridhënia dhe Qeverisja e mirë", artikull, Revista e Audituesve të Përgjithshëm të Çertifikuar (CGA), Kanada, Nëntor-Dhjetor 2011*
8. *"Qasja e FMN-së në promovimin e mirëqeverisjes në luftën ndaj korrupsionit", Udhëzues, ribotim i vitit 2011*

PERFORMANCA E KLSH 2012 DREJT NJË INSTITUCIONI MODERN AUDITIMI PUBLIK

nga Revista Shkencore "Auditimi Publik", Nr. 4, viti 2013

Besimi i palëve të interesuara tek ne si SAI, do të thotë besim i Kuvendit dhe qytetarëve, në përgjithësi, për rezultatet tona në drejtim të auditimit të financave publike. Është e rëndësishme që puna e KLSH të mbetet profesionale, e besueshme dhe e dobishme për palët e interesuara, në rradhë të parë për qytetarët dhe Kuvendin.

Si institucioni më i lartë i auditimit të jashtëm publik, pra si SAI ("Supreme Audit Institution"-Institucioni Suprem i Auditimit), kemi shumë palë të interesuara në realizimin e misionit tonë: qytetarët, Kuvendin, njësitë e audituara, qeverinë dhe organizatat e shoqërisë civile. Besimi i palëve të interesuara tek ne si SAI do të thotë besim i Kuvendit dhe qytetarëve, në përgjithësi, për rezultatet tona në drejtim të auditimit të financave publike. Është e rëndësishme që puna e KLSH-sl të mbetet profesionale, e besueshme dhe e dobishme për palët e interesuara, në rradhë të parë për qytetarët dhe Kuvendin.

Raporti Vjetor i Performancës i KLSH-së për vitin 2012 është një përgjigje e rëndësishme drejtuar qytetarëve dhe Kuvendit, një llogaridhënie e plotë dhe e përgjegjshme ndaj pritshmërive të palëve të interesit. Ky raport përqendrohet në veçanti në mënyrën se si unë si Kryetar i kam shfrytëzuargjatë vitit të kaluar burimet njerëzore dhe financiare që Kuvendi më ka besuar. Ai përmbledh rezultatet që KLSH ka arritur gjatë 2012-ës, duke i krahasuar me ato të një viti të mëparshëm buxhetor.

Drejtimet strategjike të thelluara krijojnë mundësi të reja për ne si KLSH dhe palët tona kryesore të interesit, legjislativin dhe ekzekutivin. Ndryshimet e miratuara vitet e fundit në kornizën ligjore për menaxhimin financiar reflektojnë zotimin për të zhvilluar ekonomicitetin, efektivitetin dhe eficiencën në përdorimin e resurseve dhe ofrimin e shërbimeve për qytetarët. Zbatimi dhe auditimi i kësaj kornize të re ligjore në një mënyrë transparente dhe të përgjegjshme është sfidë për të gjithë ne në KLSH.

Pavarësia është një parakusht që një auditim i jashtëm publik të funksionojë mirë. Një kornizë e re ligjore për KLSH-n është dorëzuar tashmë në Kuvendin e Shqipërisë. Një nga përparësitë e mija për vitet në vijim është të garantoj që kjo kornizë, e cila është në pajtim me standardet e INTOSAIt të pranuara ndërkombëtarisht, do të zbatohet si duhet, kur të miratohet nga Kuvendi i Shqipërisë. Kjo reflektohet në punën tonë, si dhe në marrëveshjet e arritura me partnerët aktualë dhe ata të rinj, të cilët do të na

ndihmojnë për këtë në të ardhmen, mbi bazën e motos së INTOSAI-t *"Experentia mutua Omnibus prodest- Eksperienca e përbashkët u shërben të gjithëve "*.

Sipas mendimit tim, mund të them se i kemi përdorur mirë mjetet që Kuvendi na i ka vënë në dispozicion në formën e burimeve financiare. Cilësia dhe mbulimi i auditimit, ashtu si dhe ndikimi i punës sonë po përmirësohen në mënyrë të vazhdueshme.

Shpresojmë që ky Raport të kontribuojë jo vetëm në forcimin e llogaridhënies tonë, por edhe në rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve dhe Kuvendit për dobinë e auditimeve të KLSH dhe rolin e pazëvendësueshëm parandalues ndaj korrupsionit dhe mashtrimit financiar që institucioni luan, duke shtuar mirëkuptimin dhe mbështetjen e Kuvendit dhe qytetarëve për të përballuar sfidat tona.

Gjatë vitit të kaluar kemi punuar për zbatimin e rekomandimit të Kuvendit, të shprehur në Rezolutën e tij, datë 26 prill 2012 *"Për kryerjen e kontrolleve ndaj përdorimit të fondeve të Buxhetit të Shtetit, si dhe fondeve të projekteve të financuara nga BE-ja e nga institucionet financiare ndërkombëtare me objektivitet, profesionalizëm, cilësi dhe efektivitet të lartë"*.

Gjykojmë se e kemi zbatuar atë, duke realizuar gjatë 2012-ës 177 auditime nga 153 të planifikuara dhe duke përfunduar plotësisht 158 auditime.

Këto auditime janë zhvilluar në 40 institucione qendrore, në 64 njësi vendore, 12 drejtori dhe degë tatimesh e doganash, 12 shoqëri anonime dhe me kapital të përbashkët, 11 njësi dhe projekte me financim të huaj, 11 njësi të administrimit dhe regjistrimit të pronës dhe 8 institucione të mbrojtjes së mjedisit (shih grafikun më poshtë).

Transparenca dhe llogaridhënia janë dy parime kryesore të qeverisjes së mirë në sektorin publik dhe përgjegjësia jonë si SAI, është që të kontribuojmë në transparencën dhe llogaridhënien e menaxhimit të fondeve publike. Këtë kontribut e kemi pasur në fokus të çdo auditimi të kryer.

Çështja më e rëndësishme për ne ka qenë të sigurojmë dhe mbajmë një profesionalizëm dhe cilësi të lartë në aktivitetet e auditimit dhe ta ruajmë këtë cilësi, në mënyrë që të drejtohemi nga shembujt e mirë.

Si institucion i auditimit të jashtëm, jemi përpjekur t'u përmbahemi standardeve të cilësisë dhe në të njëjtën kohë audituesit tanë janë treguar të pavarur, objektivë, të paanshëm, me skepticizëm profesional dhe ndjenjë llogaridhënie ndaj publikut.

Gjatë auditimeve të kryera në vitin 2012 (me periudhë 2-3 vjeçare aktiviteti të njësisë që auditohet), **kemi vërejtur parregullsi dhe shkelje financiare në të ardhurat e mbledhura dhe në shpenzimet e kryera nga njësitë publike të audituara, institucione të Pushtetit Qendror dhe Vendor, me dëm ndaj Buxhetit të Shtetit në shumën 13,522,392,000 lekë, ose 97.3 milionë euro. KLSH ka rekomanduar që kjo shumë të zhdëmtohet në masën 100 përqind** *(shih grafikun më poshtë).*



Në totalin e dëmit ekonomik të konstatuar, subjekti AlbPetrol Sh.a. ka 68 përqind të tij, ndërsa KESH Sh.a. 18 përqind *(shih grafikun më poshtë).*

Gjithashtu, kemi zbuluar shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në perfomancën e subjekteve të audituara, në shumën e përgjithshme 1,842,998,000 lekë, ose 13.2 milionë euro.

Në totalin e shkeljeve të disiplinës financiare me ndikim negativ në perfomancë, shkeljet në koncesionet e dhëna nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës përbëjnë 60.4 përqind.

Shkeljet financiare janë vërejtur kryesisht në prokurimet publike, në shitjen dhe dhënien me qira të pasurisë shtetërore, në urbanistikë, në shpenzimet operative, në doganat, në tatimet e taksat, etj.

Në zbatim të rekomandimit të Rezolutës së Kuvendit për "*Konsolidimin e bashkëpunimit me Kuvendin dhe Këshilline Ministrave për përmirësimin e akte e akteve ligjore e nënligjore, veçanërisht të ligjit për Kontrollin e Lartë të Shtetit, përmirësimin e administrimit të vlerave materiale e monetare dhe rritjen e shkallës së zbatimit të rekomandimeve të institucionit",* kemi sjellë në vitin 2012 gjithsej 58 propozime për përmirësim të legjislacionit, përfshi dhe kërkesën për një ndryshim në Kushtetutë, nga të cilat 25 janë zbatuar tashmë, ndërsa 16 janë në proces zbatimi. Kemi rekomanduar 2,194 masa organizative, nga të cilat janë zbatuar 1,659 ose 76 përqind e tyre dhe kemi rekomanduar 1,221 masa disiplinore dhe administrative, nga të cilat 860 ose 70 përqind janë realizuar që gjatë vitit 2012 (*shih grafikun më poshtë*).



Duhet të pohojmë se ndërsa në përmbushjen e rekomandimeve tona për përmirësime ligjore, masat organizative, ato disiplinore dhe administrative kemi nivel të mirë zbatueshmërie, masat për largime nga puna të punonjësve të gjetur me shkelje, veçanërisht të drejtuesve të rangut të lartë, janë në nivel mjaft të ulët (kemi propozuar 120 largime nga puna dhe vetëm 53 janë kryer).

Ky nivel i ulët ka ardhur nga serioziteti i pakët i njësive të audituara në ndëshkimin e shkelësve të ligjit brenda stafit të tyre, veçanërisht kur bëhet fjalë për shkelës të nivelit të lartë. Për vitin 2013, na del një detyrë e rëndësishme që të ngremë në një nivel të

pranueshëm këtë tregues shumë të rëndësishëm për formimin e kulturës së ndëshkueshmërisë në administratën publike(*shih grafikun më poshtë*).



Në zbatim të rekomandimit të Rezolutës së Kuvendit për përmirësimin e ligjit për KLSH-në (të cituar në fragmentin e mësipërm) dhe në zbatim të rekomandimit të Progres-Raportit 2012 të BE-së për Shqipërinë, i cili ka nënvizuar se: *"Auditimi i jashtëm duhet të vijë në nivel me standardet e INTOSAI... Pas disa viteve në ngecje, projekt-ndryshimet në Ligjin për KLSH për ta sjellë atë në përputhje të plotë me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) janë përgatitur dhe janë dorëzuar në procedurë të miratimit",* gjatë vitit 2012 plotësuam përgatitjen e draft- amendimeve të ligjit organik të KLSH-së, në bashkëpunim intensiv me Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në BE (DG Budget), me SIGMA-n dhe me ambientet akademike e shoqërinë civile të vendit. Nga tryezat e punës të organizuara rezultuan sugjerime të vlefshme që u reflektuan në draftin përfundimtar të Projekt-Ligjit me Amendimet, i dorëzuar Kuvendit të Shqipërisë më 30 nëntor 2012 me shkresen nr. 945/4, datë 26.11.2012 dhe sipas vlerësimit të DGBudget*, "tërësisht në përputhje me standardet e INTOSAIt* [56]*".* Amendimet sjellin një konceptim bashkëkohor si institucionet homologe evropiane, të të drejtave dhe detyrave të KLSH-së. Ato do të ndihmojnë në rritjen e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të tij, në rritjen e kapaciteteve administrative, në saktësimin e së drejtës së KLSH-së të auditojë fondet e akorduara nga BE për Shqipërinë deri tek përdoruesi i fundit dhe në saktësimin e së drejtës të çertifikojë llogaritë financiare të njësive të audituara. Amendimet forcojnë pavarësinë funksionale dhe vepruese të institucionit, duke e shndërruar KLSH-n një strukturë tërësisht të integruar dhe në përputhje me standardet e funksionimit të SAI-ve të vendeve të Bashkimit Evropian, si dhe mundësojnë që të kemi Audituesë Publikë (të jashtëm) të çertifikuar. Ne besojmë se Kuvendi do të na mbështesë, si gjithmonë.

[56] Letër me Nr. Prot. 1354284 (2012) e z. Robert Gielisse, Drejtor i Njësisë së VAT dhe PIFC në DG-Budget, drejtuar KLSH më datën 16 nëntor 2012.

Për më tepër, vetë Rezoluta e Kombeve të Bashkuara e 22 Dhjetorit 2011 *"Për nxitjen e eficiencës, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës së administratës publike duke fuqizuar institucionet supreme të auditimit"* i inkurajon shtetet anëtare të OKB-së dhe parlamentet e tyre të *"mbështesin SAI-t të kryejnë detyrat e tyre në mënyrë objektive dhe efektive, duke qenë të pavarura nga subjekti i audituar dhe të mbrojtura nga ndikimet e jashtme"*. Ne mendonim që këtë draft-ligj Ju do ta vendosnit në axhendën e fillimvitit të Kuvendit. Tani jemi në muajin e tretë të vitit dhe ju drejtohem të gjithë Ju deputetë të Kuvendit, që t'i shqyrtoni amendimet e ligjit për KLSH në një kohë sa më të afërt, pse nëpërmjet zbatimit të tyre përmirësohet qeverisja e rritet ndjenja e përgjegjësisë e llogaridhënia në administratën publike dhe mbi të gjitha, kornizohet më tej puna e institucionit drejt standardeve të INTOSAIt.

Në zbatim të rekomandimit të Rezolutës së Kuvendit *"Për rritjen e efiçiencës së veprimtarisë audituese, nëpërmjet fuqizimit të auditimit financiar dhe hedhjes së hapave më të shpejtë drejt auditimit të performancës"*, gjatë vitit 2012 rritëm numrin e auditimeve financiare të mirëfillta dhe shtuam ndjeshëm numrin e auditimeve të performancës, në krahasim me një vit më parë (duke u nisur nga një bazë shumë e dobët). Në shtator 2012, institucioni ngriti Departamentin e Auditimit të Performancës, me në krye një studiues të doktoruar në menaxhimin e riskut, si dhe me 16 auditues ndër ata më me përvojë në KLSH dhe auditues të rinj me perspektivë të qartë për ngritje profesionale. Tendenca sot në botë është shtimi i auditimeve të performancës (p.sh. në Slloveni rreth një e pesta e auditimeve i takon këtij lloji, ndërsa në Hollandë 25 përqind), pse duke matur ekonomicitetin, efektivitetin dhe eficiencën e burimeve të harxhuara, gjetjet e këtyre auditimeve ndikojnë në planifikimin e politikave dhe programeve qeveritare për shërbimet më cilësore ndaj qytetarëve. Gjithashtu, këto lloj auditimesh i japin një fizionomi tejet qytetare dhe profesionale Institucioneve Supreme të Auditimit.

Në zbatim të rekomandimit të Rezolutës së Kuvendit për *"Përmirësimin e metodologjisë së kontrollit, mbështetur në standardet ndërkombëtare e praktikat më të mira të vendeve të tjera"*, në bazë të standardit ISSAI 20, i cili orienton se *"...përgjegjshmëria për SAI-n qëndron në përgjegjësinë e treguar për planifikimin dhe kryerjen e punës së tij audituese, duke përdorur metodologjitë dhe standardet e duhura për të siguruar llogaridhënien dhe transparencën mbi aktivitetet publike, duke përmbushur përgjegjësitë e tij në mënyrë të plotë dhe objektive*[57]", kemi përditësuar Manualin e Auditimit të Performancës, të ndërtuar tërësisht mbi rezultatet dhe udhëzimet e Grupit të Punës së INTOSAI-t. Me qëllim përmirësimin e metodologjisë së auditimit dhe raportimeve tona, ngritëm në shkurt 2012 Departamentin e Kërkimit Shkencor, Zhvillimit dhe Teknologjisë së Informacionit. Gjatë vitit 2012 institucioni

[57] ISSAI 20, botim i vitit 2010, fq. 3

aplikoi dhe fitoi një projekt binjakëzimi për zhvillimin e metodologjisë dhe kapaciteteve të tij audituese, në kuadër të financimeve IPA 2012, me vlerë 2.11 milionë euro, i cili do të bëhet veprues në fillim të vitit 2014. Ky projekt fiton pas gjashtë vitesh që institucioni nuk kishte marrë asistencë teknike. Ndihmë në fitimin e këtij projekti na ka dhënë Qeveria shqiptare, veçanërisht Kryeministri dhe Ministria e Integrimit, Delegacioni i BE-së në Shqipëri dhe SIGMA, partneri ynë permanent.

Ekziston një perceptim negativ i publikut në lidhje me nivelin aktual të korrupsionit në administratën publike. Ky perceptim vjen nga moszbulimi dhe mosndëshkimi i korrupsionit në nivel të mjaftueshëm nga ana e organeve shtetërore përgjegjëse për ta luftuar këtë dukuri. Në këtë këndvështrim, mirëqeverisja dhe kontributi konkret për mirëqeverisje janë antidoti më i mirë ndaj korrupsionit.

Fondi Monetar Ndërkombëtar është shprehur se *"të promovosh mirëqeverisjen në të gjitha aspektet e saj, duke siguruar sundimin e ligjit, duke përmirësuar efiçiencën dhe përgjegjësinë e sektorit publik dhe duke luftuar korrupsionin, janë elementë thelbësorë të një kuadri ku ekonomitë mund të prosperojnë*[58]*"*. Kështu, objektivi kryesore për institucionet publike shqiptare është të jenë institucione të forta dhe të pavarura dhe të thellojnë luftën kundër korrupsionit. Kjo për KLSH-në si institucion suprem auditimi merr kuptim krejt të veçantë.

KLSH, gjatë vitit 2012 ka kryer 40 kallëzime penale për 125 punonjës të administratës shtetërore të niveleve të ndryshme, ose 34 kallëzime më shumë, pothuajse 2 herë më tepër se sa 3 në vitet 2009 (9 kallëzime)-2010 (5 kallëzime) dhe 2011 (6 kallëzime) të marra së bashku (shih grafikun më poshtë).



Në këto kallëzime ka drejtues të lartë si Drejtor Kabineti në Ministri, Drejtorë të Përgjithshëm në Ministri, Kryetar të Komisionit të Prokurimeve Publike, Kryetarë apo ish Kryetarë Bashkish, drejtues të lartë në institucionet në rrethe, etj. Megjithatë ne jemi

[58] Udhëzues, "Qasja e FMN-së në promovimin e mirëqeverisjes dhe në luftën ndaj korrupsionit", ribotim i vitit 2011, faqe 18.

të ndërgjegjshëm që kemi shumë për të bërë për të luftuar aktet abuzive dhe korruptive të çdo niveli.

Puna jonë shkon në sinkron me Strategjinë Ndërsektoriale të Parandalimit, Luftës kundër Korrupsionit dhe Qeverisjes Transparente, 2008-2013 të qeverisë Berisha, e cila kërkon një bashkëpunim më të ngushtë të institucioneve kryesore që e luftojnë korrupsionin, të bazuar në angazhime të përbashkëta të institucionalizuara. Urdhëri nr. 70, datë 18 prill 2006 i Kryeministrit për zbatimin nga ekzekutivi të masave të propozuara nga Institucionet e Pavarura na ka ndihmuar së tepërmi, megjithëse ai duhet të zbatohet më saktë dhe i plotë nga institucionet e audituara.

Vërehet botërisht se rritja e përgjegjësisë së menaxherëve publikë ndikon menjëherë në uljen e korrupsionit. Gjatë vitit 2012 jemi përpjekur të krijojmë sinergji institucionale për mirëqeverisjen, duke bashkëpunuar në sistem me institucionet e tjera shtetërore. Në mars 2012, nënshkruam marrëveshje n e bashkëpunimit me Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive të funksionarëve të lartë të shtetit dhe me Autoritetin Shqiptar të Konkurrencës, me synimin e zbulimit të çdo rasti të pasurimit të shpejtë të funksionarëve publik, si dhe të rasteve të prishjes së konkurrencës në tenderat dhe ankandet shtetërore. Në qershor 2012 nënshkruam marrëveshjen e bashkëpunimit me Prokurorinë e Përgjithshme. Prokuroria ka nisur hetimet për të gjitha kallëzimet tona. Pas hetimit paraprak, ajo ka thelluar hetimet në 36 kallzime, duke pushuar vetëm 4 prej tyre. Serioziteti që Prokuroria ka treguar ndaj denoncimeve tona mendojmë se është parësor për ndërgjegjësimin e strukturave dhe njësive publike për përgjegjësitë që ato kanë në administrimin e pronës shtetërore. Bashkëpunimi eficient i institucioneve si KLSH dhe Prokuroria e Shtetit në zbulimin dhe hetimin e abuzimeve me pronën shtetërore, prodhon përgjegjshmëri dhe një shkallë më të lartë përgjegjësie ndaj disiplinës së rreptë financiare që duhet zbatuar, duke ulur kështu rastet korruptive.

Sikurse ka theksuar Presidenti i Republikes, z. Bujar Nishani në adresimin e Tij në Analizen Vjetore 2012 të KLSH: "*Ky bashkëpunim, ky përkushtim, kjo dëshirë dhe ky vizion i shprehur tashmë në sy të opinionit publik për një bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet institucionit tuaj dhe Prokurorisë së Përgjithshme, do të sjellë shembuj konkretë në sytë e opinionit publik*".

Në zbatim të rekomandimit të Rezolutës së Kuvendit *"Për harmonizimin e veprimtarisë së kontrollit të jashtëm me atë të brendshëm, si dhe zhvillimin dhe forcimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit*", kemi iniciuar në maj 2012 marrëveshjen e bashkëpunimit me Ministrinë e Financave, sidomos me strukturat e saj të auditimit të brendshëm. Kjo marrëveshje është në veprim dhe do të realizohet e plotë gjatë këtij viti me objektivat e saj kryesore, në bazuar në standardet ISSAI 9150 dhe 1240. Një funksionim i konsoliduar i Auditimit të Brendshëm do të lehtesojë shumë realizimin e misionit të KLSH. Institucioni bashkëpunon me Auditimin e Brendshëm nëpërmjet këshillimeve të

vazhdueshme, shkëmbimit të planeve të punës, zhvillimit të metodologjive, si dhe trajnimeve dhe kryerjes së veprimtarive të përbashkëta. Ky bashkëpunim shtrihet deri në përdorimin e punës së Auditimit të Brendshëm, kur kjo punë cilësohet se është kryer në përputhje me standartet profesionale. Si Auditimi i Brendshem ashtu edhe KLSH, përmes një Sekretariati të Përgjithshëm, janë të angazhuar të mbështesin rekomandimet respektive të dhëna prej tyre ndaj subjekteve dhe t'i asistojnë ato në zbatim. Ndajmë mendimin që forcimi i kapaciteteve të auditimit, si atij të brendshëm dhe të jashtëm publik, është rruga e duhur për të mbështetur maksimalisht rritjen e përgjegjshmërisë, transparencës dhe ndershmërisë në qeverisje.

Nga ana tjetër, sfida jonë kryesore, modernizimi i institucionit, realizohet duke koordinuar si duhet punën me institucionet e tjera, publike dhe jo-publike të fushës. Në përmbushje të objektivit të platformës strategjike të caktuar në dhjetor 2011 për institucionin, kemi siguruar bashkëpunim profesional me Institutin e Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA) dhe me Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit, me të cilët kemi nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi, për të na ndihmuar në kryerjen e analizës së riskut në planifikimin e auditimeve, në rritjen e cilësisë gjatë procesit audites dhe në raportimin cilësor të gjetjeve të auditimit. Pse jo, në të ardhmen, nëse Ju si Kuvend nuk do të keni mundësi, këto institucione të pavarura ekspertësh do të auditojnë fondet tona si institucion, pra fondet e KLSH. Në zbatim të rekomandimin Tuaj *"Për zhvillimin e burimeve njerëzore, duke i dhënë dhënë përparësi zgjerimit dhe përmirësimit cilësor të veprimtarisë trajnuese",* gjatë vitit 2012 kemi rekrutuar sipas të gjitha rregullave të punësimit në administratën publike rreth 30 punonjës të rinj, ndër të cilët pesë me gradën shkencore Doktor i Shkencave dhe tetë me nivel pasuniversitar të Programit Master, në vazhdim të doktoraturës (shih grafikun më poshtë).

Duke filluar nga muaji shkurt 2012 e në vijim kemi lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucionet homologe të zhvilluara të auditimit të lartë publik.

Si rezultat i zbatimit të këtyre marrëveshjeve, gjatë vitit 2012 u trajnuan jashtë vendit një numër audituesish të KLSH-së i barabartë me numrin e punonjësve të institucionit të dërguar jashtë gjatë shtatë viteve, 2004- 2011 të marra së bashku (shih grafikun më poshtë).

Duke realizuar edhe trajnime me ekspertë të SIGMA-s në Tiranë për auditimin e performancës, auditimin financiar dhe auditimin e teknologjisë së informacionit dhe trajnime me burime të brendshme, vitin 2012 e mbyllëm me 19.4 ditë trajnimi për audites, nga vetëm 2.1 ditë trajnimi në vit për audites, që kishim trashëguar nga viti 2011. Ky është një tregues i krahasueshëm me nivel e treguesve të ditëve të trajnimit në vit për çdo audites të SAI-ve më të zhvilluara në kontinent (shih grafikun më poshtë).



Në zbatim të rekomandimit të Rezolutës së Kuvendit për *"Rritjen e transparencës ndaj medias dhe shoqërisë civile, si dhe rritjen e bashkëpunimit me botën akademike"*, kemi trajtuar **358 letra dhe ankesa nga qytetarët** për probleme të ndryshme, nga të cilat 111 i kemi

konstatuar jashtë kompetencave dhe juridiksionit të KLSH, kurse nga 247 kërkesa dhe ankime në kompetencë të institucionit, 171 prej tyre i kemi verifikuar dhe u kemi dhënë përgjigjen përkatëse, ndërsa 76 janë në vijim të verifikimit.

Ndërsa për vitin 2011 institucioni ka të dhëna tejet të ulta në shifra për letrat dhe ankesat e ardhura nga qytetarët.

Si rezultat i ankesave të marra dhe të trajtuara gjatë vitit 2012, KLSH ka larguar nga detyra katër auditues të tij, dy prej të cilëve i ka paditur në Prokurori për shpërdorim detyre.

Institucioni ka qenë tërësisht i hapur ndaj mediave dhe ka bashkëpunuar me to, duke dyfishuar numrin e editorialeve, njoftimeve për shtyp dhe artikujve dhe rritur kështu me 3.5 herë numrin e sekuencave filmike televizive, në krahasim me vitin 2011.

KLSH gjatë 2012-ës ka bashkëpunuar intensivisht me botën akademike, sidomos me profesoratin e Fakultetit Ekonomik dhe Fakultetit Juridik të Universitetit Shtetëror të Tiranës në tryeza pune, takime konsultative, etj, bashkëpunim i cili është imire, por ende nuk po institucionalizohet për arsye procedurale burokratike.

Për rritjen e transparencës dhe eficiencës në auditim, institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me disa nga OJF-të më të spikatura në promovimin e transparencës në administratën publike dhe në luftën kundër korrupsionit,dhe konkretisht, me Transparency Internacional në Shqipëri, me lëvizjen Alternativa Civile, me Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë, me Institutin e Studimeve Bashkëkohore, me Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim, me Lëvizjen Evropiane Shqipëri dhe me Institutin "G&G Group". Nga këto OJF ne kërkojmë jo vetëm bashkëpunim për transparencë, por edhe të marrin pjesë aktive në auditimet tona dhe ato të na auditojnë ne.

Në zbatim të parimit 8-të të ISSAI 20 për komunikimin aktiv e profesional të një SAI nëpërmjet publikimeve, gjatë vitit 2012 institucioni përgatiti dhe publikuar 10 botime informative dhe profesionale, si: *"KLSH-Analiza Vjetore 2011", "KLSH në Kuvend", "KLSH-Analiza 6-mujore 2012", "EUROSAI dhe SAI-t Evropiane", "Standardet ISSAI 1, 10, 11, 20, 30, 40, 100 dhe 200", "Historiku i KLSH 1925-2012"*, tre numra të revistës shkencore *"Auditimi Publik"* dhe *Manualin e përditësuar të Auditimit të Performancës*.

Më datën 28 dhjetor 2012, me rastin e 100 Vjetorit të Pavarësisë, KLSH zhvilloi Konferencën e tij të parë Shkencore, duke ju referuar historikut të institucionit dhe punës shumëvjeçare të të gjithë individëve që kanë kontribuar për ngritjen dhe mbarëvajtjen e tij në periudha kohore të ndryshme. Konferenca dha mesazhin e ruajtjes së identitetit dhe vlerave të institucioneve kryesore të Shtetit, si bazë për formësimin e kulturës së konsoliduar shtetërore.

Ky aktivitet për vitin 2013 dhe vitet në vijim synon të kthehet në një traditë dhe një forum profesional për qasjet e eksperiencave të auditimit, si për auditimin e jashtëm dhe atë të brendshëm publik, duke sjellë edhe përvojën audituese të institucioneve homologe të zhvilluara në rajon dhe më gjerë.

Si përfundim, theksoj se gjatë vitit 2012 jemi përpjekur të realizojmë të gjitha rekomandimet e Kuvendit, orientimin nga letrat e qytetarëve dhe sugjerimet e shoqërisë civile, thellësisht të bindur në dobishmërinë e tyre dhe përputhjen me objektivat tona strategjikë. Natyrisht, jemi të vetëdijshëm se duhet të punojmë më shumë. Në bashkëpunim me ekspertë të SIGMA-s, kemi përgatitur Planin e Zhvillimit Strategjik të KLSH-së për vitet 2013-2016. Ky plan përmban objektivat kryesorë të institucionit të cilat janë:

- ✓ përmirësimi i bazës ligjore dhe rregullatore të KLSH-së, në përputhje me standardet e INTOSAI-t dhe praktikat më të mira evropiane;
- ✓ përmirësimi i metodologjisë dhe rritja e cilësisë në auditim;
- ✓ përmirësimi i cilësisë dhe shtimi i numrit të auditimeve të performancës, krahas konsolidimit të auditimeve të përputhshmërisë dhe atyre financiarë;
- ✓ sigurimi i mirëqeverisjes;
- ✓ rritja e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies për një menaxhim të shëndoshë financiar.

Këto objektiva janë në një linjë me katër drejtimet kryesore të Strategjisë së Zhvillimit të EUROSAI-t, të cilat janë:

- ✓ ndërtimi i kapaciteteve;
- ✓ zhvillimi i standardeve profesionale;
- ✓ shkëmbimi i njohurive dhe eksperiencave;
- ✓ menaxhimi në përputhje me parimet e qeverisjes së mirë dhe komunikimit efektiv.

Bashkëpunimi i gjerë dhe i thellë me Kuvendin e Shqipërisë, me qytetarët dhe shoqërinë civile, me Qeverinë dhe me të gjithë partnerët tanë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar është për ne garancia më e plotë në suksesin e objektivave dhe përpjekjeve tona edhe gjatë vitit 2013.

MIRËQEVERISJA- PARADIGMA E RE NË ADMINISTRIMIN PUBLIK

nga Revista Shkencore "Auditimi Publik", Nr. 5, viti 2013

KLSH do të vlerësojë rreziqet për qytetarët në lidhje me strategjitë e zbutjes së pasojave të krizës. Këtë vlerësim do ta kryejmë dhe kemi nisur ta kryejmë me profesionalizëm dhe përgjegjësi.

Abstrakt

"Në pothuajse të gjitha juridiksionet, sektori publik luan një rol të madh në shoqëri. Qeverisja efektive (mirëqeverisja) në sektorin publik mund të inkurajojë përdorimin eficient të burimeve, të inkurajojë përgjegjësinë për administrimin e këtyre burimeve, të përmirësojë menaxhimin dhe ofrimin ecshërbimeve, duke kontribuar këtë mënyrë në përmirësimin e jetës së qytetarëve. Qeverisja efektive është gjithashtu thelbësore për ndërtimin e besimit në subjektet e sektorit publik. Ajo është në vetvete e domosdoshme, nëse duam që entitetet e sektorit publik të jenë efektivë në përmbushjen e objektivave të tyre[59]".

Fjale Kyçe: **Mirëqeverisja, SAI, transparenca, transparenca fiskale, përgjegjshmëria, përgjegjësi e menaxhimit**

JEL[60]: E6, G3, H1, H4, H6, H7, O2

Hyrje

Përgjegjshmëria institucionale e qeverisjes është një formë e kontrollit mbi institucionet dhe agjencitë publike, duke bërë që ato të japin llogari për kontabilitetin dhe veprimet e tyre. Si e tillë, ajo përbën një koncept themelor në një administratë publike të një vendi demokratik. Sot, kudo në botë, por sidomos në Europë, pas shpërthimit të krizës në Eurozonë vërehet një kërkesë e shtuar për përgjegjshmëri institucionale të qarta në përballimin e krizës. Gjithëashtu ka po një presion të konsiderueshëm dhe pritshmëri në rritje ndaj Institucioneve Supreme të

[59] Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (IFAC): "Qeverisja Korporative në Sektorin Publik-Një perspektivë e Trupës Qeverisëse", 2011

[60] Journal of Economic Literature (JEL) Classification System (Klasifikimi i Terminologjisë Ekonomike)

Auditimit (SAI) për të luajtur një rol më aktiv, në përputhje me mandatin e tyre. Një nga detyrat thelbësore në rrugën drejt zhvillimit të demokracisë dhe sundimit të ligjit është qeverisja efektive, e cila do të forcojë aftësinë qeverisëse të ekzekutivit dhe besimin e publikut. Mirëqeverisja është kthyer në paradigmën e re për administrimin e shërbimeve publike. Qeverisja e mirë ka të bëjë me mënyrën më efektive dhe eficiente se si qeveria, shoqëria civile, sektori i biznesit dhe të gjitha institucionet e organet e tjera kushtetuese ndërlidhen për të menaxhuar punët dhe plotësuar përgjegjësitë e tyre[61].

Domosdoshmëria për mirëqeverisje publike

Në një demokraci, qytetarët me votën e tyre ia besojë administrimin e burimeve të vendit përfaqësuesve të tyre të zgjedhur. Këta përfaqësues nga ana e tyre, ia besojnë funksionin e menaxhimit të burimeve ekzekutivit, Qeverisë. Çdo vit, Parlamenti miraton një buxhet për Ekzekutivin për administrimin e biznesit shtetëror, pra të burimeve të vendit. Në fund të vitit fiskal, Ekzekutivi është i detyruar të japë llogari në Parlament për administrimin e këtyre burimeve. Duke qenë se Parlamenti vetë nuk mund të verifikojë llogaritë e paraqitura nga Ekzekutivi, Audituesi i Përgjithshëm është i mandatuar nga Kushtetuta e vendit për t'i audituar këto llogari dhe për të raportuar gjetjet e tij në Parlament. Parlamenti mbështetet Audituesin e Përgjithshëm që për llogari të tij të ofojë siguri të pavarur dhe që aktivitetet qeveritare janë kryer në përputhje me synimet e Parlamentit.

Për këtë arsye, roli i Audituesit të Përgjithshëm është një element shumë i rëndësishëm për të ndihmuar në ruajtjen e integritetit të çdo sistemi qeverisje.

Raporti i Audituesit të Përgjithshëm mbi mirëpërdorimin dhe drejtësinë e llogarive publike, ju siguron qytetareve që burimet e miratuara nga përfaqësuesit e tyre janë shfrytëzuar për qëllimet e synuara. Audituesi i Përgjithshëm gjithashtu ndërmerr auditime të vlerës së parave publike (auditimet e performancës), për të informuar Parlamentin dhe qytetaret në lidhje me ekonomicitetin, eficiensën dhe efektivitetin me të cilën janë kryer projektet qeveritare. Ky lloj auditim i ofron Qeverisë mundësinë për të përmirësuar performancën e saj. Ndërsa Qeveria ushtron mandatin e menaxhimit të ekonomisë publike dhe shoqërisë në emër të qytetarëve, ajo duhet të respektojë dhe t'u përmbahet ligjeve dhe parimeve të funksionimit të Administratës Publike. Auditimi suprem, si një pjesë shumë e rëndësishme e sistemit të mbikëqyrjes dhe kontrollit publik, luan një rol thelbësor në administrimin e duhur të parasë publike dhe në sigurimin që aktiviteti i Qeverisë sundohet nga ligji.

[61] FMN, FactSheet (Letër Faktesh): "Qeverisja e Mirë është Çelesi i Suksesit Ekonomik", Mars 2013

Realizimi i një qeverisje me kosto të ulët dhe efektivitet të lartë është një objektiv tepër i rëndësishëm i menaxhimit publik modern, që kthehet në një kërkesë primare në kushtet e austeritetit ekonomik[62]. Në vitet e fundit, qeveritë kanë ndërmarrë një sërë hapash për të reduktuar administraten publike dhe për të përmirësuar eficiencën e saj. Si përgjigje ndaj kërkesës së mësipërme, SAI-t kanë intensifikuar auditimet mbi të ardhurat dhe shpenzimet qeveritare, duke promovuar ndërkohë në mënyrë graduale auditimin e performancës.

Sinqeriteti dhe transparenca - piketat themelore të mirëqeverisjes

Përgjegjshmëria, transparenca dhe sistemet e hapura të informacionit janë një aspekt i rëndësishëm i mirëqeverisjes dhe vendimmarrjes publike. Llogaridhënia dhe sundimi i ligjit kërkojnë transparencë dhe informacion të plotë, në mënyrë që nivelet e larta të administratës, vrojtuesit e jashtëm dhe publiku i gjerë të mund të verifikojnë punën e Qeverisë dhe pajtueshmërinë e aktivitetit të saj me ligjin[63].

Parimet e qeverisjes së mirë: transparenca dhe llogaridhënia; drejtësia dhe barazia; standardet e larta etike; eficienca dhe efektiviteti; respekti për sundimin e ligjit dhe mirësjellja, paraqesin bazën mbi të cilën mund të ndërtohet një qeverisje e hapur. Publiku pret që ata që janë përgjegjës për trajtimin e parave publike, të bëhen tërësisht përgjegjës për përdorimin e këtyre parave[64]. Marrja e rezultateve të auditimeve transparente i mundëson publikut të kuptojë se si departamentet dhe institucionet e tjera qeveritare i kryejnë detyrat e tyre dhe nëse performanca e këtyre departamenteve vjen duke u përmirësuar. Ky është një kanal i rëndësishëm, ndoshta kryesori, përmes të cilit publiku shikon dhe monitoron të ardhurat dhe shpenzimet e qeverisë. SAI, si auditues i jashtëm i pavarur i Buxhetit të Shtetit, synon të arrijë nivelin e duhur të ndikimit të auditimit të tij. Ky ndikim mund të rezultojë në shpenzime qeveritare më të ulëta, si dhe në menaxhim më efektiv dhe transparent të financave publike.

---

[62] Deklarata e EUROSAI në Kongresin e Lisbonës: "Forcimi i Pavarësisë së Institucioneve Supreme të Auditimit", Qershor 2011.

[63] "Supreme Audit Institutions: Meeting Higher Expectations (SAI-t: duke plotësuar pritshmëritë më të mëdha)", material nga një Seminar i Bankës Botërore për ASOSAI, Gusht 2013

[64] Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) : "Modernizimi i Sektorit Publik-Një qeverisje e hapur", Policy Brief (Letër Politikash), 2008

Roli i SAI-t në sigurimin e qeverisjes së mire

Pritshmëritë e rritura ndaj Institucioneve Supreme të Auditimit vijnë nga partnerët e tyre të natyrshëm, si qytetarët, organizatat e shoqërisë civile, investitorët, por edhe qeveritë[65]. Pritet që këto institucione të ndihmojnë konkretisht në daljen nga kriza në vendet që janë të mbërthyera në darën e saj, ose në zbutjen e pasojave të krizës, në vendet që po i përjetojnë këto pasoja[66]. Për shkak të krizës financiare dhe ekonomike në eurozonë dhe të goditjeve të paparashikuara të saj, në të gjitha vendet europiane, por edhe më tej, ndihet një nevojë në rritje për sigurimin e një qeverisjeje të mirë dhe shpenzimin efektiv të parave publike. SAI-t, duke ofruar mbikëqyrje profesionale, depërtim të pavarur në informacionin shtetëror, shërbime si parashikime për performancën e institucioneve kyçe buxhetore dhe të shërbimeve publike bazë, ndihmojnë për të dhënë siguri të arsyeshme se Qeveria ka menaxhuar si duhet fondet publike, në mënyrë transparente, të drejtë dhe sinqerisht, me barazi dhe ndershmëri, duke kryer punën e saj dhe duke përdorur standarde të larta integritetit. Qeverisja e mirë kërkon mbikëqyrje të vazhdueshme, për të siguruar se politikat e miratuara janë zbatuar si qëllim, se strategjitë janë realizuar dhe performanca e përgjithshme e qeverisë ndodhet brenda ligjeve dhe rregulloreve të Shtetit. Është sot përgjegjësi në rritje e SAI-t të vlerësojnë ekonomicitetin, eficiciencën dhe efektivitetin në zbatimin e programeve dhe aktiviteteve të Qeverisë, si dhe për të siguruar përputhshmërinë me standardet e mjedisit.

SAI-t ofrojnë rekomandime cilësore për të asistuar entitetet dhe vendim- marrësit qeveritarë, duke vlerësuar cilat programe dhe politika po funksionojnë dhe cilat kanë probleme të dukshme që kërkojnë zgjidhje të shpejta, duke siguruar përmirësimet e duhura ligjore dhe politika më të rregulluara në shërbimet publike ndaj qytetarit, duke ndarë me të audituarit informacionin dhe eksperiencën e praktikave më të mira të komunitetit të tyre. Auditimet e bazuara në qasjen në risk fokusohen në auditimin e riskut të përgjithshëm të organizatës në kuadër të menaxhimit. Këto auditime ndihmojnë në identifikimin dhe shmangien e risqeve të papranueshme. Përmes auditimit të bazuar në risk, SAI-t ofrojnë informacione dhe rekomandime të dobishme dhe të rëndësishme, që u mundësojnë enteve qeveritare të menaxhojnë si duhet risqet e tyre. SAI gjithashtu ndihmojnë organizatat qeveritare që të shikojmë përpara, duke identifikuar trendet dhe duke sjellë në vëmendjen e tyre sfidat e reja, për të parandaluar

[65] Deklarata e EUROSAI në Kongresin e Lisbonës: "Forcimi i Pavarësisë së Institucioneve Supreme të Auditimit", Qershor 2011.

[66] Nagi Sandor: "Roli i SAI-ve në luftën kundër pasojave të krizës ekonomike dhe financiare", Qershor 2012

thellimin e krizës ose të shfaqjes së saj[67]. Institucione kushtetuese dhe të pavarura si SAI-t janë të domosdoshme, duke u angazhuar plotësisht në zbatimin e parimeve të integritetit, objektivitetit dhe ndershmërisë gjatë mbikqyrjes së qeverisjes publike, që të ngjallin besimin e publikut në aktivitetin qeveritar, kur ky aktivitet e meriton këtë besim[68].

Roli i KLSH-së në mirëqeverisjen e vendit

Për të siguruar mirëqeverisjen, dimensioni i llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë së institucioneve publike është parësor në vende në zhvillim, që synojnë hyrjen në grupin e vendeve të zhvilluara, sikurse është vendi ynë. Raporti vjetor i Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH) mbi mirëpërdorimin dhe drejtësinë e llogarive financiare të Qeverisë i siguron Kuvendin dhe qytetarët, që burimet publike të miratuara nga përfaqësuesit e tyre janë shfrytëzuar shfrytëzuar si duhet, me mangësitë e konstatuara dhe rekomandimet për përmirësim.

KLSH gjatë dy viteve të fundit ka intensifikuar auditimet për të matur vlerën e parave publike të shpenzuara, për të informuar Kuvendin dhe qytetarët në lidhje me ekonomicitetin, eficiencën dhe efektivitetin e shërbimeve publike. Në vitet e fundit, qeveria shqiptare ka ndërmarrë një sërë hapash për të reduktuar administratën publike dhe për të përmirësuar eficiencën e saj. Por, duke iu përgjigjur sfidave të reja, kushteve gjithnjë në ndryshim, ne si KLSH duhet të përdorim dhe aktivizojmë burime jo konvencionale, të tilla si njohuri dhe kapital shoqëror, për të qenë sa më të përshtatur, efektivë dhe për të arritur qëllimin tonë strategjik, që është administrimi sa më i mirë dhe modern i parasë publike.

Eksperienca e SAI-ve të vendeve të Bashkimit Europian jep mundësinë e shtjellimit më të gjerë të këtij roli të ri. SAI-et kanë mandat (shpesh edhe kushtetues, sikurse është rasti i Kontrollit të Lartë të Shtetit) në nivel kombëtar për të kryer auditime të jashtme, që t'iu shërbejnë sa më mirë taksapaguesve dhe qytetarëve për sigurimin e shpenzimit racional, eficient, efektiv dhe ligjor të parasë publike. SAI-et, në sajë të pavarësisë, profesionalizmit dhe ndershmërisë së tyre, të sanksionuar në standardet e fushës të INTOSAI-t, kanë sot një pozicion unik për të kthyer besimin e publikut ndaj institucioneve buxhetore, të tronditur disi nga pasojat e krizës botërore ekonomike dhe financiare. SAI-t e vendeve të Bashkimit Europian gjatë viteve të krizës(2009-2013) në

[67] Deklarata e EUROSAI në Kongresin e Lisbonës:"Forcimi i Pavarësisë së Institucioneve Supreme të Auditimit", Qershor 2011.

[68] Instituti i Audituesve të Brendshëm (THEIIA): "Auditimi dhe Qeverisja e Sektorit Publik", 2010 (www.theiia.org)

Eurozonë, janë treguar shumë aktive për të marrë përsipër përgjegjësi të reja në një ambient ekonomik dhe shoqëror në ndryshim të shpejtë[69]. Ato kanë ndihmuar me auditimin e sistemit të ri rregullator, të ngritur në BE për përballimin e krizës, të përbërë nga Banka Qendrore Europiane, bankat qendrore të vendeve anëtare, institucionet qeveritare dhe institucionet e tjera rregullatore. SAI-t e BE-së dhe Gjykata Europiane e Audituesve kanë përcaktuar qartë pesë faza të reagimit ndaj krizës: fazën përgatitore, përgjigjen e menjëhershme, menaxhimin e krizës (ose pasojave të saj), strategjitë e daljes prej saj dhe sistemin e ri të rregullave[70].

Qasja e auditimit të sistemit financiar rregullator mund të zbatohet edhe tek ne, vendet në periferi të krizës së Eurozonës, por që kemi ndjer dukshëm pasojat e saj, të vërejtura sidomos me ndalimin ose uljen e ndjeshme të rritjes ekonomike, si në Maqedoni, Mal të Zi, Bosnjë- Hercegovinë dhe Shqipëri. Në vendin tonë pasojat e krizës kanë sjellë uljen e rritjes ekonomike. Në rast se ky sistem financiar rregullator nuk është vendosur, ai duhet të krijohet. Tek ne, edhe pse jo me një emërtim apo formulim të plotë, ai ka funksionuar, me konsultimet e herëpashershme mes Ministrisë së Financës dhe Bankës së Shqipërisë. Gjykoj se ka ardhur koha që këto konsultime dhe ky bashkëveprim të institucionalizohen më tej, duke përfshirë edhe agjenci të tjera shtetërore, si Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Autoriteti i Konkurrencës, INSTAT, KLSH, etj.

Objektivi kryesor i një SAI në përballimin e pasojave të krizës së sotme është që të ketë një funksion të përmirësuar ruajtës (ëatchdog) mbi të ardhurat dhe shpenzimet publike, duke siguruar aspektet e tyre të ligjshmërisë, pajtueshmërisë dhe mirëqeverisjes. KLSH do të kryej auditime dhe japë rekomandime për ekzistencën, veprimin dhe përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit të riskut financiar dhe të kontrollit. KLSH do të kryejë sidomos auditime performance mbi sistemin financiar rregullator të vendit. Institucioni do të bashkëveprojë me SAI-t e tjera në rajon për marrjen e eksperiencave të dobishme në auditimin e këtij sistemi, duke siguruar cilësinë dhe besueshmërinë e informacionit kryesor financiar. Vetëm kështu mund të garantojë veprimin e një sistemi financiar rregullator fleksibël dhe efikas. Askush nuk ka kohë të humbasë edhe pse në teori, fazat e ndërhyrjes dhe përballimit të pasojave të krizës janë të ndara. Në praktikë ato ndërthuren me njëra-tjetrën. Mendoj se për ne është koha të angazhohemi në fazën e përgjigjes së menjëhershme.

[69] A.Van Zyl :"Duke iu përgjigjur sfidave të Institucioneve Supreme të Auditimit", 2009

[70] Nagi Sandor: "Roli i SAI-ve në luftën kundër pasojave të krizës ekonomike dhe financiare", Qershor 2012

Kjo fazë mbulon politikën monetare të bankës qendrore dhe veprimet financiare dhe fiskale të Qeverisë, për të kufizuar shtrirjen e pasojave të krizës dhe për të parandaluar rëndimin e treguesve në sistemin financiar (si për shembull, në rastin tonë, rritjen e mëtejshme të nivelit të Borxhit Publik, të kredive të këqija etj.). Për një ndërhyrje efektive është thelbësore kuptimi i gjerë dhe i thellë i situatës, karakteristikat dhe shtrirja e veprimeve përmirësuese që duhen të ndërmerren, të cilat kërkojnë një informacion të saktë e të besueshëm, role dhe përgjegjësi të qarta të strukturave që ndërhyjnë dhe një koordinim të mirëprojektuar, si dhe mekanizma efektivë raportimi për masat e marra.

Konkluzion

KLSH do të vlerësojë rreziqet për qytetarët në lidhje me strategjitë e zbutjes së pasojave të krizës. Këtë vlerësim kemi nisur ta kryejmë dhe do ta kryejmë me profesionalizëm dhe përgjegjësi. Detyrë e re auditimi për ne është vlerësimi i shitjes së aseteve publike në kohë krize apo kur ekonomia vuan pasojat e krizës. Mekanizmi i auditimit mbi strategjitë e zbutjes së pasojave të krizës kërkon raporte shumë cilësore të performancës dhe aftësi të veçanta. Duke ofruar përvojat dhe mësimet e partnerëve tanë më të zhvilluar, si Zyra Kombëtare e Auditimit (NIK) e Polonisë, Gjykata e Llogarive e Turqisë dhe e Austrisë, Gjykata e Auditimit e Sllovenisë, etj., për institucionet publike që auditojmë, duke theksuar rolin tonë këshillues dhe parandalues, kemi bindjen se do të kontribuojmë denjësisht në sigurimin e qeverisjes së mirë në vend.

Literatura

1. *FMN, FactSheet (Letër Faktesh): "Qeverisja e mirë është Çelesi i Suksesit Ekonomik", Mars 2013*
2. *Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (IFAC):"Qeverisja Korporative në Sektorin Publik - Një perspektivë e Trupës Qeverisëse", 2011*
3. *"Supreme Audit Institutions: Meeting Higher Expectations (SAI-t: Në plotësim të pritshmërive më të mëdha)", material nga një Seminar i Bankës Botërore për ASOSAI, Gusht 2013*
4. *Nagi Sandor: "Roli i SAI-ve në luftën kundër pasojave të krizës ekonomike dhe financiare", Qershor 2012*
5. *Deklaratë e EUROSAI në Kongresin e Lisbonës: "Forcimi i Pavarësisë së Institucioneve Supreme të Auditimit", Qershor 2011.*
6. *Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD): "Modernizimi i Sektorit Publik - Një qeverisje e hapur", Policy Brief (Letër Politikash), 2008.*
7. *Instituti i Audituesve të Brendshëm (THEIIA): "Auditimi dhe Qeverisja e Sektorit Publik", 2010 www.theiia.org)*
8. *A.Van Zyl: "Duke iu përgjigjur sfidave të Institucioneve Supreme të Auditimit", 2009*

ANALIZA VJETORE E KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT PËR VITIN 2014 NË FRYMËN E INTOSAINT

nga Revista Shkencore "Auditimi Publik", Nr. 10, viti 2015

Ne, si audituesi supremë publikë, kemi një përgjegjësi të madhe përpara qytetareve, Kuvendit dhe Kushtetutës. Jo thjeshtë të deklarojmë arritjet, por duhet të shikojmë thellë brenda vetes sonë, për të zbuluar mangësitë dhe dobësitë që kemi, për t'i shmangur ato në të ardhmen dhe përmirësuar në vijimësi performancen tonë. Kur përmirësojmë punën tonë, jemi të ndërgjegjshëm se rritet kontributi ndaj një çështjeje themelore për fatet e demokracisë tek ne:

MIRËQEVERISJA.

Analiza vjetore e Kontrollit të Lartë të Shtetit u zhvillua jo pa qëllim në mjediset e Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës, një prej universiteteve publike të vendit, me tradita dhe cilësi mësimdhënieje. Mjedisi akademik gjeneron ide, përqasje dhe metodika pune me shumë vlerë për auditimin suprem kombëtar.

Kjo përbënte risinë e parë të qasjes sonë për të njohur më mirë punën që kemi kryer gjatë vitit 2014, edhe si pjesë përbërëse e standardeve të INTOSAI-t (ISSAI 1, Deklarata e Limës-Neni 12, Opinioni i Ekspertit dhe e Drejta për Konsultim: bashkëpunimi me ambientet akademike).

Risinë e dytë e përbënte fakti që analiza u krye në frymën e kërkesave të integritetit dhe Programit të Vetëvlerësimit "IntoSAINT" të Gjykatës Holandeze të Auditimit, program i cili po zbatohet gjerësisht këto dy vitet e fundit nga dhjetëra Institucione Supreme të Auditimit (SAI) në Evropë dhe në të gjithë botën, për të matur rezultatet e punës së tyre me grilën e integritetit të përcaktuar nga Gjykata Holandeze e Auditimit, duke synuar rritjen e llogaridhënies dhe transparencës së vetë institucionit.

Ne, si audituesi supremë publikë, kemi një përgjegjësi të madhe përpara qytetareve, Kuvendit dhe Kushtetutës. Jo thjeshtë të deklarojmë arritjet, por duhet të shikojmë thellë brenda vetes sonë, për të zbuluar mangësitë dhe dobësitë që kemi, për t'i shmangur ato në të ardhmen dhe permirësuar në vijimësi performancën tonë.

Kur përmirësojmë punën tonë, jemi të ndërgjegjshëm se rritet kontributi ndaj një çështjeje themelore për fatet e demokracisë tek ne: MIRËQEVERISJA. Qeverisja përmirësohet kur luftohet në mënyrë të efektshme korrupsioni. Perceptimi i qytetarëve dhe përfundimet e sondazheve, vrojtimeve dhe studimeve të partnerëve tanë ndërkombëtare tregojnë se korrupsioni është ende mjaft i përhapur dhe galopant në

Shqipëri. Në këto kushte, asnjë institucion publik nuk duhet të mburret, por të ndihet përgjegjës për këtë situatë. Korrupsioni është një ndërtim pa leje, që legalizohet kur, si institucionet qeveritare dhe ato të pavarura, tregohen indiferente dhe nuk punojnë në sistem, me partneret e natyrshëm, për ta luftuar atë.

Analiza vjetore e KLSH-së për vitin 2014 na ndihmoi të nxjerrim përgjegjësitë tona, na ndihmoi shumë dhe këtu qëndroi risia e tretë e kësaj analize, këndvështrimi, gjykimet dhe këshillat e partnereve tanë të shoqërisë civile. Eksperienca, dijet, sinqeriteti dhe pavarësia e plotë e mendimit të shumë personaliteteve të shoqërisë civile, një pjesë e të cilëve ishin të pranishëm, ishin pasqyra më profesionale, ku mund të shihemi për çfarë kemi arritur, ku i kemi dobësitë dhe si mund të përmirësohemi në të ardhmen. Kjo ishte edhe arsyeja që e zhvilluam këtë analizë vjetore pa politikanë dhe mesazhet e tyre. Sikurse e ka theksuar Prof. Dr. Omer Stringa: "*Mirëqeverisja e institucioneve publike kërkon angazhim të vazhdueshëm dhe bashkëpunim strategjik të aktorëve kryesore. Zbatimi i sistemeve të vlerësimit të performancës së secilit aktor në mireqeverisjen publike, identifikimi paraprak dhe dakordësia mbi treguesit ku bazohet matja e performancës së institucioneve, është e një rëndësie parësorë në nxitjen e institucioneve që të përqendrojnë energjitë dhe resurset e tyre në përmbushjen me eficiencë të objektivave afatgjatë*".

Përqasja "IntoSAINT"

Kontributi në rritjen e llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë së administrimit të fondeve publike, KLSH nuk mund ta realizojë, pa qenë një institucion model në kërkimin e llogarisë brenda stafit të tij. Nga ana tjetër, për institucionet publike në botën demokratike, dhënia e llogarisë dhe transparenca nuk mund dhe nuk duhet të jenë agjitprop!

Ja përse kjo analizë u zhvillua në frymën e kërkesave të integritetit dhe Programit të Vetëvlerësimit "IntoSAINT" të Gjykatës Holandeze të Auditimit, i njohur dhe i pranuar që nga viti 2011 nga organizata jone INTOSAI. Auditimi i integritetit, si për institucionin e SAI-t, ashtu dhe për institucionet që auditon, është një sfidë e rëndësishme dhe thelbësore e të gjitha SAI-ve sot në botë.

Integriteti nuk është një koncept i thjeshtë për t'u përcaktuar. Shumë përkufizime mbivendosen dhe përcaktime të dallueshme përdoren. Integriteti i referohet virtytit, moskorruptimit dhe gjendjes së të qenit i papërlyer.

Nga viti 2012, kur KLSH u njoh me programin IntoSAINT, zbatimi i tij u vendos në qendër të vëmendjes tonë. Periudha deri në fund të vitit 2013 ishte për ne periudhë e njohjes më të thelluar të Programit dhe të vlerave të tij.

Si SAI ndajmë plotësisht opinionin e Nismës për Zhvillim të INTOSAI-t (IDI), se *"Sjellja etike e SAI-t dhe e punonjësve të tij përbën gurin e themelit për një funksionim të mirë të tij.*

Që një SAI të udhëheqë sipas shembullit dhe të sjellë vlera dhe dobi tek qytetarët, nuk mjafton vetëm që të miratojë kodin e duhur të etikës, por gjithashtu të vendosë zbatimin me rigorozitet të tij dhe të ketë një kuadër rregullator, i cili duhet t'i detyrojë punonjësit të zbatojnë etikën në praktikë".

Bazuar në këto kërkesa dhe punë paraprake të komunitetit të INTOSAI-t, gjatë vitit 2013, KLSH u pranua anëtar i Task Forcës për Auditimin dhe Etikën të Organizatës Evropiane të Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAI). KLSH, nëpërmjet anëtarësimit dhe pjesëmarrjes aktive në këtë strukturë, synon instalimin dhe funksionimin e një infrastrukture efektive etike në institucion, por nga ana tjetër, si SAI do të ndërmarrim misione auditimi mbi rregullshmërinë dhe eficiencën e Etikës dhe Integritetit në institucionet publike, duke punuar që lufta kundër korrupsionit dhe politikat për instalimin e një sistemi efektiv të integritetit, të jenë pjesë e menaxhimit të institucioneve publike.

Në qershor 2013, KLSH u anëtarësua në Grupin për Rishikimin e ISSAI 30- Kodi i Etikës, një nismë e Këshillit Mbikëqyrës të Komitetit të Standardeve Profesionale të INTOSAI-t.

Në Kongresin INCOSAI XXI, mbajtur në Pekin në 21-26 Tetor 2013, Gjykata Holandeze e Auditimit raportoi për përhapjen e metodës IntoSAINT në shumë SAI në botë. Kongresi konkludoi se është krijuar një bazë e fortë solide, mbi të cilën INTOSAI mund të ndërtojë mekanizmin e duhur për t'i mundësuar SAI-eve të udhëheqin sipas shembullit, për të realizuar integritetin e plotë. Në një linjë me rekomandimet e Kongresit, gjatë vitit 2015, KLSH do të ndërmarrë një auditim vetëvlerësimi të integritetit, duke përdorur programin IntoSAINT.

Jemi të ndërgjegjshëm për problematikat e integritetit në KLSH dhe se mbetet shumë punë për të realizuar integritetin e plotë në institucion. Gjatë këtyre tre viteve, 2012-2014 jemi përpjekur me mbikëqyrje dhe monitorim, që në institucion të mos rezultojnë incidente të karakterit korruptiv apo shkelje ndaj integritetit. Nxitja e integritetit ishte në fokus të veprimtarisë menaxhuese. Sipas këshillave dhe orientimeve të personalitetit të auditimit suprem evropian, Prof. Dr. Recai Akyel, President i Gjykatës së Llogarive të Turqisë, është zbatuar në praktike filozofia e menaxhimit "Tone at the top", duke promovuar integritetin nën parimin e "udhëheqjes nëpërmjet shembullit".

Gjatë vitit 2014, u synua që të arrihet një ekuilibër midis parandalimit të shkeljeve dhe marrjes së masave ndëshkimore nga njëra anë dhe inkurajimit të vlerave të integritetit, nga ana tjetër. Në lidhje me masat ndëshkimore, veprimtaria institucionale u përqendrua në drejtim të zbulimit, hetimit dhe ndëshkimit të shkeljeve. Dua te theksoj me forcë se gjatë tri viteve të fundit, në KLSH është çrrënjosur praktika e mosndëshkueshmërisë dhe për çdo shkelje të integritetit, të zbuluar dhe hetuar, janë marrë masa ndëshkimore deri në ndjekje penale për ish audituesë. Kjo praktikë është ndjekur rigorozisht, pasi

mosndëshkueshmëria sjell dëme të pariparueshme për institucionin e KLSH-së dhe humbjen e besueshmërisë institucionale në përgjithësi dhe të besimit të publikut në veçanti. Nëse një shkelje e integritetit kalon pa u ndëshkuar, kjo sjell automatikisht demotivimin e anëtarëve të tjerë me moral të shëndetshëm të stafit të KLSH-së.

Në vitin 2012, nga ankesat e dërguara nga qytetarët, KLSH kallëzoi penalisht dy punonjës të tij. Gjatë vitit 2013, KLSH kalezoi në Prokurori 4 auditues të tij, të akuzuar për veprën penale të "Shpërdorimit të detyrës" dhe "Falsifikimit të dokumenteve", si dhe largoi nga institucioni një numër audituesish të gjetur në shkelje të integritetit. Për vitin 2014, KLSH largoi nga puna 4 auditues për çështje të integritetit.

Me synim instalimin dhe zhvillimin më tej të një kulture të re organizative, gjatë dy viteve 2013 dhe 2014, u nxorën udhëzime lidhur me komunikimin e drejtpërdrejtë për përmirësimin e punës audituese dhe rritjen e zbatimit të standardeve të INTOSAI-t. Kam kërkuar në mënyrë periodike takim të drejtpërdrejtë me audituesit, për t'i nxitur ata të luajnë rolin e "bilbilfryrësit (whistle-blower)", për të dhënë mendime për përmirësimin e strukturave dhe të komunikimit vertikal të dyanshëm të menaxhimit me audituesit.

Në nëntor të vitit 2014, u krijua një strukturë e veçantë, Sektori i Etikës dhe Integritetit, pjesë e Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Etikës. Brenda këtij sektori, u krijua Komisioni i Integritetit, i cili ka përgjegjësi si strategjike dhe menaxheriale, duke qenë përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kërkesave të kodit etik, komunikimin rreth çështjeve të etikës, trajnimin për etikën dhe integritetin, kryerjen e këshillimeve dhe zgjidhjen e dilemave të etikës dhe integritetit, si dhe ka kompetenca hetimi dhe kontrolli në rastet e sinjalizimeve për thyerjen e rregullave të integritetit, etikës dhe standardeve.

Bazuar në kërkesat e ISSAI 30, si dhe në gjetjet e Grupit të Punës për Rishikimin e ISSAI 30, të kryesuar nga NIK-u polak, si dhe në eksperiencën me Kodin Etik të GAO-s amerikane, kemi hartuar dhe miratuar një dokument të ri, Kodin Etik të KLSH- së, i cili reflekton praktikat më të mira të fushës. Jemi të ndërgjegjshëm për rrugën e gjatë dhe të vështirë që na pret përpara, kur bëhet fjalë për sfidën e sigurimit të integritetit të plotë të institucionit.

Rezultatet e Punës

Për vitin 2014, KLSH kreu 160 auditime, nga 153 auditime të vitit 2013, ose ***4.8 përqind*** më shumë. Për vitin 2014, KLSH zbuloi dëm ekonomik ndaj Buxhetit të Shtetit në nivelin ***11.2 miliardë lekë*** (ose rreth 80 milionë euro), ***duke kërkuar shpërblimin e dëmit, pra arkëtimin në Buxhet të 98.9 përqind të tyre***. Dëmi

ekonomik i zbuluar në tri vitet, 2012, 2013 dhe 2014 është rreth 3.8 herë më i madh se vlera e dëmit të zbuluar në tre vitet, 2009, 2010 dhe 2011 të marra së bashku.

Treguesi i eficiences së institucionit është 38 lekë të zbuluar si Dëm Ekonomik ndaj Buxhetit të Shtetit dhe kërkuar për arkëtim, për çdo lek të harxhuar nga KLSH gjatë vitit 2014, gjë që dëshmon për dobinë e lartë të aktivitetit auditues. Krahasuar në vite, mesatarja e treguesit të eficiencës së institucionit për tre vitet 2012-2014 është 2.6 herë më e lartë se mesatarja e tre viteve 2009-2011. ***KLSH gjatë vitit 2014 propozoi disa ndryshime të rëndësishme kushtetuese dhe ligjore.***

Së pari: Me synim promovimin e qëndrueshmërise dhe besueshmërië së financave publike, si dhe vlerësimin e planifikimit dhe performancës fiskale, të projeksioneve makroekonomike dhe parashikimeve buxhetore, rekomanduam ***krijimin e një Këshilli Fiskal me statusin e një autoriteti të pavarur ndaj Qeverisë***, i cili duhet ti raportojë Kuvendit, të kryej oponenca të politikave fiskale, pa ndikime të politikës dhe që të jenë thellësisht teknike dhe të pavarura.

Së dyti: Duke patur parasysh situatën e brishtë makroekonomike të vendit, në optikën e uljes së nivelit të borxhit publik, si dhe trajektoren e borxhit publik ndaj PBB gjatë viteve të fundit, rekomanduam që ***Ministria e Financave të hartojë një kuadër rregullator fiskal, i cili duhet të synojë reduktimin e nivelit të borxhit publik në një periudhë të përcaktuar kohore dhe sigurimin e një qëndrueshmërie afatgjatë të borxhit publik***.

U përsërit për të dytin vit rradhazi rekomandimi që ***Ministria e Financës të paraqesë në Kuvend një nismë ligjore për vendosjen në Kushtetutë dhe në Ligjin "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të treguesit të borxhit publik ndaj PBB-së, në nivelin tavan 60 %, dhe arritjen e këtij niveli në terma afatgjatë.***

Së treti: Me synim arritjen e pritshmërie në planifikimin e buxhetimit të integruar dhe eficient të shpenzimeve publike, rritjen e përgjegjshmërisë ne nivel menaxherial, përmirësimin dhe rritjen e transparencës së raportimit financiar të qeverisë, forcimin e kontrollit të brendshëm në sektorin publik dhe mbikëqyrjen efektive parlamentare, institucioni rekomandoi që ***gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e KLSH-së të jenë pjesë përbërëse dhe të skedulohen në Planin e Veprimit dhe në aktivitet kryesore, në kuadrin e implementimit të strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020.***

Së katërti: U kërkua përcaktimi në Ligjin Organik të Buxhetit përdorimi i të ardhurave nga privatizimi, 50 përqind për uljen e borxhit publik dhe 20 përqind për dëmshpërblimin e ish të përndjekurve politikë.

Po ashtu, rekomanduam ***hartimin e një ligji që të trajtojë në mënyrë të plotë rastet e përgjegjësive materiale të të punësuarve në sektorin publik, me qëllim parandalimin e dukurive që nxisin dëmtimin e fondeve dhe aseteve publike***. U kërkua saktësia e evidentimit të shpenzimeve kapitale me financim të huaj. Është kërkuar që të jetë Kuvendi ai që do të përcaktojë përdorimin e Fondit të Kontingjences, si dhe sa herë që përdoret Fondi Rezerve i Këshillit të Ministrave, kjo të bëhet me miratimin paraprak të Ministrit të Financave, për të shmangur prekjen e tij pa kriter, sa herë që kjo kërkohet nga dikastere të veçanta. Gjithashtu rekomandua ***krijimi i një Komiteti Auditimi, në varësi të dyfishtë nga Kryeministri dhe Ministri i Financave, i cili do të sigurojë një nivel pavarësie të strukturës shumë të rëndësishme të auditimit të brendshëm***, etj..

Duke zbatuar objektivin tonë strategjik të përmirësimit të qeverisjes, nëpërmjet thellimit të luftës kundër korrupsionit, për shkelje të dispozitave ligjore në fuqi, me pasojë shpërdorimin e fondeve publike dhe dëmtimin e pronës publike, ***KLSH bëri 41 kallëzime penale ndaj 149 punonjësve, përgjithësisht nëpunës të lartë dhe të mesëm të administratës***.

Sfidat tona kryesore në përmbushjen e misionit tonë kushtetues janë dy:

- ✓ modernizimi i KLSH;
- ✓ rritja e kontributit në mirëqeverisje, nëpërmjet thellimit të luftës kundër korrupsionit.

Modernizimi i institucionit mund të realizohet i plotë vetëm duke respektuar rigorozisht në punën tonë standardet ndërkombëtare të INTOSAI-t. Për këtë kishim nevojë për një ligj themeltar të ri, të cilin na e kishin rekomanduar fuqimisht dhe në vijimësi Progres-Raportet e Bashkimit Evropian që nga viti 2008 e deri në vitin 2013. Në bashkëpunim me DG-Budget dhe SIGMA-n, u paraqit në nëntor 2012 draft-ligjin e ri. Gjatë vitit 2014, duhet të veçoj dialogun në Parlament dhe seancat maratonë në Komisionet e Kuvendit, ku evidentoj bashkëpunimi me deputetet e Komisionit për Ekonominë dhe Financat. Kuvendi miratoi ligjin në nëntor 2014, ligj që u kthye nga Presidenti i Republikës për korrigjim për nenin 23. Ligji i Ri ka hyrë përfundimisht në fuqi në 6 shkurt 2015.

Ky ligj shënon shkëputjen përfundimtare të KLSH-së nga kontrollet e tipit inspektim financiar, i mundëson institucionit dhënien e opinionit për pasqyrat financiare të enteve të audituara dhe realizon profilizimin e tij si një institucion modern evropian i auditimit suprem publik, i cili e bazon aktivitetin e tij tërësisht në standardet e INTOSAI-t dhe moton e kësaj organizate "*Experentia mutua Omnibus prodest- Eksperienca e përbashkët u shërben të gjithëve*".

Viti 2014 ishte viti i përfundimit të procedurës së përzgjedhjes së partnereve të KLSH në Projektin e Binjakëzimit **"*Për Forcimin e kapaciteteve të Auditimit të Jashtëm*"**, në kuadër të asistencës së BE-së për Shqipërinë, nëpërmjet Instrumentit të Parazgjerimit, IPA 2013, me vlerë 2.11 milionë euro, pas një aplikimi dyvjeçar nga institucioni ynë.

Partnerët e KLSH-së në projekt janë Zyra Kombëtare e Auditimit(NIK) e Polonisë dhe SAI i Kroacisë, të dyja këto institucione të auditimit suprem shumë të zhvilluara dhe me përvojë të madhe pune e bashkëpunimi.

Projekti për KLSH është ndër 7 projektet e përzgjedhur nga BE në vitet 2013 dhe 2014, për t'u implementuar në mënyrë të decentralizuar nga institucionet e shtetit shqiptar. Zbatimi i tij nis në tetor të vitit 2015, për një periudhë dyvjeçare deri në tetor 2017. Projekti i binjakëzimit do ta ndihmojë KLSH jo vetëm të rrisë kapacitetet e tij audituese, por edhe do të shërbejë si një mjet i fuqishëm për arritjen e objektivave themelore të Strategjisë së zhvillimit të institucionit 2013- 2017, tashmë e rishikuar për periudhën 2015-2017.

Drejtimet Strategjike të realizuara

Gjatë vitit 2014, puna jonë u orientua në përmbushjen e ***drejtimit të dytë strategjik të INTOSAI-t dhe EUROSAI-t*** "***Zbatimit të standardeve profesionale ISSAI"***, i cili përmbahet dhe në Strategjinë e KLSH, 2013-2017. Institucioni forcoi kapacitetet audituese, nëpërmjet një procesi të vazhdueshëm kualifikimi, kryerjes së trajnimeve të thelluara dhe gërshetimit të ngritjes arsimore me veprimtarinë praktike audituese. Struktura e punonjësve ka vijuar të ndryshojë, jo thjesht në favor të stafit audites me arsim të lartë, por dhe të stafit me kualifikime profesionale, akademike dhe grada shkencore, si dhe me kualifikim në fusha të dyta ekspertize. Çdo audites i KLSH u trajnua mesatarisht për 26 ditë gjatë vitit 2014, ose mbi trefishin e viteve 2009, 2010 dhe 2011, të marra së bashku. Pra, tashmë kemi një tregues të qëndrueshëm në trajnime.

Në tre vitet e fundit 2012-2014, institucioni ndryshoi thellësisht koncept dhe politike në drejtim të zhvillimit të burimeve të veta njerëzore. KLSH është investuar tërësisht dhe pa kthim mbrapa, drejt shtimit dhe rritjes cilësore të kapaciteteve të tij audituese, duke tërhequr në staf personalitete nga profesorati i ekonomikut dhe jurisprudencës, duke nxitur audituesit e rinj të shtojnë dijet shkencore dhe duke i bashkërenduar me audituesit më përvojë, të cilët edhe ata nga ana e tyre testohen dhe motivehen për ngritje në karrierë. Nga një institucion i disa viteve me parë praktikisht pa trajnim të audituesve të vet, KLSH u kthye në një SAI me tregues perëndimore trajnimi të stafit. Gjatë vitit të kaluar, KLSH materializoi me shumë kontributin e tij në Programin "3i, Iniciativa e Implementimit të ISSAI-ve". Grupi i punës i institucionit, me mbështetjen e SIGMA-s,

plotësoi të gjitha detyrimet që rrjedhin nga kjo marrëveshje me Institutin e Zhvillimit të INTOSAI-t(IDI) dhe EUROSAI-t.

Në zbatim të drejtimit të tij strategjik si dhe ***të drejtimit të tretë strategjik të INTOSAI-t dhe EUROSAI-t "Për shkëmbimin e njohurive dhe të përvojës me partneret (ku përfshihen SAI-t partnere, shoqëria civile dhe publiku***)", KLSH konsolidoi bashkëpunimin me partneret e deritashëm vendas dhe të huaj, të tilla si SAI-e, shoqata profesionale brenda dhe jashtë vendit, organizata të shoqërisë civile dhe mediat. Zgjerimi i bashkëpunimit konsistoi gjithashtu edhe me nënshkrimin e marrëveshje të reja.

Si KLSH, bashkëpunimin me shoqatat profesionale dhe shoqërinë civile e ngritëm në një nivel të ri, të produkteve të përbashkëta dhe partneriteti të plotë. Nëse në dy vitet e para të marrëdhënieve kontraktuale me to, 2012-2013, shkëmbyem informacione, duke thelluar njohjen reciproke, gjatë vitit 2014, u realizuan projekte konkrete bashkëpunimi me disa prej OJF-ve dhe organizatave të profesionistëve të fushës dër të cilat do të përmendim:

- "Kontrolli i cilësisë në të ftohtë", nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit;
- "Realizimi i transparencës dhe komunikimit të KLSH-së me publikun dhe qytetarët", nga Lëvizja Evropiane, Shqipëri;
- "Kontrolli i procesit të rekrutimit të stafit të KLSH-se", nga Instituti "G&G Group";
- "Analiza e impaktit të shkrimeve të audituesve të KLSH-së në shtypin e shkruar", nga botuesi i Gazetës "Ekonomia"

Të gjitha këto projekte i konsideruam si Mini Peer Review, pra rishikime mes kolegësh, në parapërgatitje të një "Peer Review" me një SAI partner nga Evropa, që e kemi kërkuar gjatë vitit 2014 dhe do ta kryejmë gjatë këtij viti. Projektet nxorën produkte konkrete, ku u evidentuan përveç arritjeve dhe mangësitë e dobësitë e institucionit tone. Të gjitha rekomandimet e dhëna nga këto organizata do t'i shikojmë gjatë këtij viti me prioritet, me qëllim përmirësimin e punës në të ardhmen.

Vitin e kaluar, një arritje në marrëdhëniet e institucionit me botën akademike, profesoratin shqiptar dhe partnerët e huaj e shënoi ***Konferenca e Tretë Shkencore e KLSH, me temë "Auditimi kombëtar në shërbim të qeverisjes kombëtare",*** e zhvilluar në Tirane më datat 29-30 tetor 2014. Ajo realizoi avokatinë e plotë të profesionit të financierit publik, kontabilistit dhe audituesit publik suprem, duke përcjellë mesazhin se pa financierë, kontabilistë dhe auditues të përgatitur mirë dhe me integritet të lartë, qeverisja e vendit humbet shumë në llogaridhënie, transparencë, efektivitet dhe eficiencë. Për herë të parë në Shqipëri, konferenca hapi një debat të

rëndësishëm, atë të analizës së riskut për auditimin publik. Sikurse e theksoi Prof. Dr. Skënder Osmani, *"Baza e të dhënave është themelore për njësimin e riskut. Duhet të përqendrohemi në analizën e riskut në sektorë të ndryshëm ekonomiko-socialë, si në burimet energjetike, drejtësi, financë, arsim, minerale, shëndetësi, rend, mjedis, etj. Duhet të shikojmë mundësinë për ngritjen e një institucioni që të merret me standardet e burimeve njerëzore, natyrore, energjisë, mineraleve, etj, duke përfshirë rezervat, klasifikimin e tyre e deri në analizën e riskut, shfrytëzimin e rezervave, kontratat, etj. Në funksionimin e këtij institucioni duhet pasur parasysh edhe përvoja e vendeve të tjera".*

Prof. Dr. Jorgji Bollano bëri në konference një propozim interesant. Ai kërkoi që *"Të bëhet një riklasifikim në rritje i kufijve të njësive ekonomike që ligjërisht i nënshtrohen detyrimit për t'u audituar".*

Duke realizuar parimet dhe orientimet e standardeve te INTOSAI-t për realizimin e një transparencë të plotë me publikun dhe mediat, si dhe objektivin e tij strategjik për komunikimin, KLSH arriti gradualisht gjatë vitit 2014, që të gjashtëfishojë praninë e tij me informacion dhe mesazhe në median e shkruar dhe të katërfishojë prezencën e tij në median audiovizive, krahasuar me vitin 2010. Gjatë 2014-ës, shtypi i shkruar pasqyroi raportet dhe njoftimet e KLSH-së për shtyp me 867 artikuj, njoftime, editorialë dhe komente analitike, përkundrejt 690 gjithësej përgjatë vitit 2013, ose 26% më shumë.

Gjatë vitit 2014 u realizuan 14 botimet e reja të KLSH-së, të cilat variojnë nga publikime informuese për raportet vjetore të institucionit dhe marrëdhëniet me Kuvendin, tek botimet shkencore për standardet e INTOSAI-t, për udhëzuesit e auditimeve të ndryshme, etj.Këto botime iu shtuan kolanes së 21 titujve të botimeve të viteve 2012-2013.

Gjatë vitit të kaluar, institucioni rriti praninë në median e shkruar të vendit, duke bashkëpunuar me gazetat me 134 shkrime të shkruara nga 51 audituesë të KLSHsë, përkundrejt 124 shkrimeve të 42 audituesve në vitit 2013. Faqja Web e KLSH-së ka informacione të përditësuara për planet dhe raportet e auditimeve, raportin e aktivitetit te KLSHsë, standardet e auditimit, bazën ligjore, raportet e KLSH-së për zbatimin e buxhetit të shtetit, strukturën, botimet, aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, etj.

KLSH është shumë e hapur edhe ndaj ankesave të qytetarëve, të cilat na adresohen me postë të zakonshme ose elektronike. Këto letër-ankesa të qytetarëve, u administruan me profesionalizëm nga punonjësit e KLSH-së në funksion të tematikës që trajtojnë dhe qytetarët morën në çdo rast përgjigje për shqetësimin e ngritur, me përjashtim të rasteve kur çështjet e ngritura nuk ishin kompetencë e KLSH-së. Kontrolli i Lartë i Shtetit trajtoi gjatë 2014, 394 letra dhe ankesa, për probleme të ndryshme, nga të cilat 170 rezultuan ishin jashtë kompetencave dhe juridiksionit të institucionit. Nga 224 kërkesa dhe ankesa në kompetencë të KLSH, 121 prej tyre u verifikuan dhe iu dha përgjigja përkatëse.

Konkluzion

Parë në tërësi, viti 2014 ishte për institucionin e KLSH një vit konsolidimi dhe qëndrueshmërie në reformat e nisura që në vitin 2012. Cilësia e rritur e auditimeve dhe rekomandimeve tona, shtimi i ndjeshëm i numrit të auditimeve të performancës, kontributi në përmirësimin e qeverisjes nëpërmjet shtimit të kallëzimeve penale, investimi në një ligj të ri modern dhe në një projekt ambicioz binjakëzimi, të financuar nga Bashkimi Evropian, ishin rrugët e duhura realizimin plotësisht të misionin tonë kushtetues dhe sipas standardeve të INTOSAI-t, atë të rritjes së llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë se institucioneve që auditojmë.

VENDIMMARRJA DHE TEKNOLOGJIA INTELIGJENTE

nga Revista Shkencore "Auditimi Publik", Nr. 11, viti 2015

Punim i përbashkët me Prof.Dr.Skender Osmani, Fakulteti Gjeologji Miniera

Rritja e shkallës së projektizimit, e cilësisë së projekteve, reformave, kontratave, e digjitalizimit, informatizimit, matematizimit, zvogëlimit të riskut, si dhe të efektivitetit të vendimmarrjes është me rëndësi për të rritur ritmet e zhvillimit dhe të investimeve.

Abstrakt

Vendi ynë ka një prapambetje në shumë fusha, në të cilat historikisht kanë ndikuar shumë faktorë si strategjitë e brendshme e të jashtme, sistemi shoqëror, struktura, niveli i zhvillimit të tij, burimet njerëzore e natyrore, investimet financiare e të informacionit, teknologjitë e ndryshme (metodat, mjetet dhe teknikat) në energji, industri, burimet minerare, bujqësi,etj., ndër këto edhe projektet kryesore të zhvillimit dhe vendimmarrjet me risqet përkatëse, veçanërisht ato me karakter të theksuar politik, para dhe pas demokracisë.

Vendimmarrja është shpirti i një projekti, aktiviteti, procesi, etj. Në këtë vështrim, në punim jepen disa konsiderata për këto çështje:

1. Vendimmarrjen ;

2. Procesin e vendimmarrjes;

3. Qeverisjen, politikat dhe vendimmarrjen;

4. Problemet fazi me shumë kritere;

5. Teknologjinë inteligjente në vendimmarrje;

6. Sistemet eksperte;

7. Literaturën.

Duke pasur parasysh nivelin e prapambetjes së theksuar të vendimmarrjes mbi bazën e teknologjisë inteligjente në vendin tonë dhe zhvillimet e ritmet shumë të vrullshme të saj në shumë fusha, veçanërisht në dekadat e fundit të saj, në punim shtrohet për diskutim problemi i raportit të vendimmarrjes politike, shtetërore dhe i asaj që përftohet nga teknologjia inteligjente, në fushën e projekteve, e në perspektivë dhe në aktivitete të tjera të burimeve njerëzore, me qëllim që të kapet sado pak koha e humbur në sistemet

inteligjente artificiale të vendimmarrjes, sistemet eksperte, teknologjitë e metodat stokastike, fazistike për optimizimin e projekteve.

Në punim tregohet që investimi në fushën e trurit (p.sh., në arsim) dhe në inteligjencën artificiale (teknologjitë e informacionit) janë nga më të rëndësishmet në menaxhimin e projekteve e në zhvillimin perspektiv të vendit.

Fjalët kyçe: **vendimmarrje, projekt, inteligjencë artificiale, sistem, ekspert, qeverisje, politikë, optimizim, problem, kritere, kushte, programim, stokastik, fazi.**

1. Vendimmarrja

Çdo njeri në jetën e tij në familje, punë e shoqëri realizon qëllime të caktuara nëpërmjet veprimtarive (mendore, fizike) që ai kryen në mjedise të ndryshme. Qëllimi është bashkëudhëtar i përjetshëm i njeriut, pa të jeta nuk ka kuptim. Për realizimin e tij ai merr vendimet e duhura. Më poshtë do të paraqiten disa konsiderata për vendimmarrjet që lindin nga strategji "kolektive" e në mënyrë të veçantë, ato në menaxhimin e projekteve, vendeve të punës, etj.

Marrja e vendimit është një proces i rëndësishëm, por edhe kompleks, veçanërisht kur ngërthen "konflikte" si p.sh: një problem në të cilën vendimi ka të bëjë me fitimin, koston, fuqinë punëtore, sepse "disa" mund të vënë në plan të parë fitimin, "të tjerët" fuqinë punëtore, etj. Natyrisht që marrja e vendimit bëhet më e komplikuar kur preferencat individuale përbëjnë grupime që duhet të plotësohen në tërësinë e një vendimi.

Më poshtë do të konsiderojmë marrjen e një vendimi të thjeshtë, mbi bazën e zgjidhjes së një problemi, d.m.th të një pohimi "jepet-kërkohet", që mund të merret me metoda të ndryshme të karakterit logjik, matematik, informatik etj, Në mënyrë të përgjithshme përmendim kalimthi që:

1. Aktualisht, vendimet janë më të komplikuara se më parë sepse numri i alternativave që "disponohen" është më i madh.

2. Kostoja e bërjes së gabimeve është më e madhe, sepse operacionet (proceset) janë më komplekse, si në drejtimin vertikal ashtu dhe horizontal.

3. Ndryshimet e mjedisit d.m.th (të elementeve e të bashkëlidhjeve të tyre) janë të vazhdueshme e për rrjedhojë edhe pasiguritë dhe risqet e tyre. Kjo situatë vështirëson vendimmarrjn e shpejtë s dhe në mënyra më efektive.

Problemet me marrje vendimi mund të grupohen në mënyrë të ndryshme p.sh, në probleme të strukturuara mirë ose të pastrukturuara. Në përgjithësi ekonomia jonë është e pastrukturuar që nga burimet e informacionit, teknologjitë e matjes së të dhënave,

metodikat e grumbullimit të të dhënave, seleksionimit, trajtimit, etj. Problemet me mungesë informacioni mund të jenë gjysmë të strukturuara ose keq të strukturuara. Zgjidhjet më të mira ose të kënaqshme përftohen me metoda standarde, për problemet e strukturuara, p.sh me modele matematikore standarde.

Në përgjithësi për zgjidhjen e problemeve të pa strukturuara ose fazi, nuk mund të zbatohen metoda standarde. Në këto probleme intuita njerëzore shpesh herë është dhe mund të jetë bazë për marrjen e vendimeve.

Probleme të pastrukturuara mund të jenë edhe ato që planifikohen për treguesit themelorë të një projekti me të dhëna jo të plota, ose ato që përmbajnë kërkime, studime e zhvillime ende të pa konsoliduara dhe jo të sakta. Problemet quhen gjysmë të strukturuara, sepse përmbajnë njëherësh elemente të strukturuara dhe elementë (grupime) jo të strukturuar. Shpesh- herë zgjidhjet e tyre përftohen në përgjithësi me metoda, procedura ose modele jo standarde, me gjykime (intuita) njerëzore, analogji, etj.

Çdo organizatë, në veprimtarinë e saj qëllimet i realizon, duke përdorur burimet e saj njerëzore, natyrore, teknologjike, financiare ose ekonomike. Këto inpute ajo i shndërron në outpute me anë të funksioneve menaxheriale që fillojnë me identifikimin e problemit, përcaktimin e të dhënave e që vijojnë me parashikimin e treguesve themelorë, planifikimin, organizimin, drejtimin, kontrollin, etj.

Për këto funksione, çdo menaxher në mënyrë të vazhdueshme në procesin përkatës të marrjes së vendimit (për alternativën me të mirë), ka parasysh gjithmonë pyetjet e baballarëve të menaxhimit: çfarë është ky aktivitet, pse bëhet aktiviteti, si do të realizohet, kur do të realizohet, ku dhe me çfarë. Këto vendime mund të merren në nivele të ulta (kryesisht individë) ose nivele të larta. Marrja e vendimit bëhet më e komplikuar kur preferencat individuale përbëjnë "grupime" që duhet të plotësohen në tërësinë e një vendimi.

2. Procesi i vendimmarrjes

Vendimmarrja në radhë të parë është një proces i përzgjedhjes së alternativës më të mirë. Përzgjedhja nuk do të thotë "zgjidhje për zbatim", ajo mund të jetë e tillë vetëm në qoftë se miratohet nga vendimmarrësi. Një proces vendimmarrje ka katër faza, të cilat janë:

1. faza Inteligjente;

2. faza e Projektimit

3. faza e Përzgjedhjes;

4. faza e zbatimit.

Në fazën inteligjente bëjnë pjesë:

a) identifikimi i problemit;

b) përcaktimi i të dhënave;

c) analiza e kërkesave.

Në fazën e projektimit bëhet:

a) formulimi i modelit;

b) gjenerimi i alternativave;

c) përcaktimi i kritereve.

Në fazën e përzgjedhjes realizohet:

a) vlerësimi i alternativave;

b) analiza e rezultateve;

c) zgjidhja e modelit.

Në fazën e zbatimit shqyrtohet suksesi apo dështimi i zgjidhjes.

Literatura e vendimmarrjes përmban teori të ndryshme. Gjithsesi në kuadrin teorik të tyre po veçojmë nëntë hapa. Në një kuptim praktik ato mund të zvogëlohen ose reduktohen.

Hapi 1: *Identifikimi i problemit* (të vendimit)

Në këtë hap parashikohet kuptimi i mirë i problemit në hipoteza të caktuara, kushtet kufitare, fillestare, etj, dhe njëherësh përgatitet formulimi i problemit.

Mirëfilltazi karakteri inteligjent i këtij procesi vazhdon edhe në hapin e dytë.

Hapi 2: A*naliza e kërkesave*

Kërkesat janë kushte që duhet të plotësohen nga zgjidhja, pak më ndryshe ato përcaktojnë zgjidhjen e pranueshme nga bashkësia e zgjidhjeve të mundshme. Këto kërkesa "lindin" nga të dhënat, analiza e tyre, pohimet, lidhjet logjike, etj, që parashikohen në strukturën e problemit, nga kushtet fillestare, kufitare, kushtet statike dhe dinamike.

Hapi 3: *Përcaktimi i qëllimeve dhe objektivave*

Në këtë hap e deri në hapin e gjashtë përfshihet faza e projektimit. Në mënyrë specifike në këtë hap identifikohen objektivat dhe qëllimet. Qëllimet shprehen nga pohime që synohen të realizohen, pak më ndryshe ato janë rezultate (vlera) që do të përftohen. Në

përgjithësi qëllimi dhe objektivi janë kuptime jo të njëjta, megjithatë në aspektin matematik qëllimet janë objektiva, në dallim nga kërkesat që janë kushte. Objektivat jo gjithmonë kanë të njëjtën rëndësi, p.sh. disa janë absolutisht të nevojshme, të tjerat jo. Kujtojmë që objektivat mund të jenë edhe konfliktuale dhe realizimi i tyre varet nga situatat praktike konkrete të problemit.

Hapi 4: *Gjenerimi i alternativave*

Objektivat përcaktojnë gjenerimin e alternativave të cilat nga ana e tyre duhet të plotësojnë kërkesat. Në qoftë se numri i alternativave të mundshme është i fundmë, atëherë ne mund të kontrollojmë ato një nga një për plotësimin e kërkesave. Alternativat që nuk i plotësojnë këto kërkesa përjashtohen dhe kësisoj formohet lista e alternativave, nga e cila përcaktohet alternativa më e mirë. Në qoftë se numri i alternativave është i pafundmë, shqyrtimi i tyre realizohet në kompjuter me metoda matematikore për përmbushjen e kërkesave.

Hapi 5: *Përcaktimi i kritereve në qoftë se është e nevojshme*

Zgjidhja e alternativës më të mirë bëhet nga vlerësimi i alternativës sipas kritereve (shiko pikën 7). Mund të kemi disa kritere për të krahasuar alternativën dhe për të bërë dallimin ndërmjet tyre.

Hapi 6: *Përzgjedhja e metodës ose mjetit të marrjes së vendimit.*

Përgjithësisht ka disa metoda për zgjidhjen e një problemi që lidhet me vendimmarrjen. Seleksionimi i një metode të përshtatshme varet nga problemi konkret dhe preferencat e vendimmarrësit. Disa metoda janë më të preferueshme se të tjerat për një problem të veçantë, veçanërisht kur ato janë të thjeshta dhe japin rezultate të mira. Por problemet komplekse mund të kërkojnë metoda komplekse. P.sh në qoftë se vendimi do të merret në grup dhe terma gjuhësore mund të përdoren për të shprehur preferencat individuale, atëherë procesi i hierarkisë analitike fazi (AHP) mund të jetë i përshtatshëm.

Hapi 7: *Zgjedhja e metodës* me të cilën do të bëhet vlerësimi i alternativave e më pas renditja e këtyre alternativave ose zgjedhja e nënbashkësive të alternativave që janë më premtuese.

Hapi 8: *Në qoftë se në alternativën e zgjedhur nuk ka rrjedhime kundërshtuese, atëherë zgjidhja konsiderohet e kryer*. Sidoqoftë alternativat e zgjedhura nga metoda e marrjes së vendimit duhet të vlerësohet në përputhje me kërkesat dhe qëllimet e problemit. Mund të ndodh që akti i vendimmarrjes të mos vihet në zbatim ose për probleme komplekse mund të lindë nevoja që vendimmarrësi të shtojë qëllime ose kërkesa të tjera në modelin e vendimit.

3. Qeverisja, Politika dhe Vendimmarrja.

Rëndom kur diskutohet për qeverisjen dhe menaxhimin, e kur secila prej tyre konsiderohet një bashkësi procesesh për arritjen (realizimin optimal) e një qëllimi të caktuar shtrohet pyetja: a ka ndonjë gjë të përbashkët qeverisja me menaxhimin? Në literaturë si për menaxhimin edhe për qeverisjen ka përkufizime të ndryshme dhe ky fakt vështirëson përgjigjen e pyetjes së mësipërme.

Gjithsesi, po konsiderojmë një prej këtyre përkufizimeve: qeverisja është një veprimtari që ka të bëjë me strukturën, funksionet, proceset, e organizimin, në mënyrë që të arrihen objektivat e parashikuara në një program në mënyrë inkluzive (gjithëpërfshirëse), transparente dhe të përgjegjshme,etj. Gjithashtu po supozojmë që qeverisja ka disa strategji, qëllime (objektiva), objekte, (kategori). Ajo është një bashkësi procesesh që realizohen në mënyra të ndryshme nga individë që në thelb mund të ndryshojnë, përmirësojnë e zhvillojnë mendimet për aktivitetet, projektet, etj., e për rrjedhojë edhe vendimet për realizimin e qëllimeve të parashikuara në programin e qeverisjes.

Në këtë këndvështrim, qeverisja është një mënyrë menaxhimi ashtu siç është menaxhimi në industri, energji, financë, biznes apo në një veprimtari prodhuese malli e shërbimi. Megjithatë, qeverisja ka funksionet e veta specifike të cilat mund të jenë të ndryshme, p.sh., qeverisja lokale, qendrore e një organizate politike, publike, të pavarur, etj.

Në kushtet e hipotezave të konsideruara del që në thelb të qeverisjes janë kuptimet themelore teorike të menaxhimit, qëllime, strategji, alternativa, projekte, integrim, optimizim, risk, e të zbatimeve të tyre (projekti që në trajtë të thjeshtuar e në gjuhën e zakonshme mund të paraqitet edhe në trajten e nje programi, planifikimi veprimtarish, etj).

Përmendim që edhe pse ndryshimi ndërmjet menaxhimit dhe qeverisjes në kuptimin rigoroz del jashte qëllimit tonë, disa funksione të qeverisjes si p.sh., drejtimet strategjike, mbikqyrja e menaxhimi, pjesmarrja e palëve të interesit, menaxhimi i rriskut, menaxhimi i konflikteve, auditimi dhe përparimi, tregojnë se ky ndryshim është jo i fortë, ose siç thuhet, ky kufi nuk është i ashpër dhe i thellë ("The boundary betëeen governance and management is not hard and fast").

Me këtë rast kujtojmë që pohimi se *"menaxhimi është i afërt me qeverisjen"* ka qenë një nga principet themelore të argumentimit të hapjes së degës së menaxhinimit për studentët në Fakultetin Gjeologji-Minera në vitin 2000, ku thuhej që ky institucion do t'i sherbejë përgatitjes së menaxherëve, drejtuesve të projekteve,vendimarrësve të institucioneve dhe qeveritarëve të shumë niveleve.

Kur shqyrton qeverisjen, natyrshëm lind për diskutim edhe "problemi" i hierarkisë qeveritare dhe i vendimmarrjeve përkatëse. Sidoqoftë, mendojmë që ky në thelb ndjek

të njëjtat parime si ai i herarkisë menaxheriale, d.m.th hierarkia qeveritare përcaktohet nga strategjia e kryesore, nënstrategjinë e nivelit te parë, të dytë, etj., megjithëse për hierarkinë menaxheriale ka në literaturë përcaktime të ndryshme, madje jo rrallë herë edhe jo të argumentuara.

Duke pasur parasysh që politika është elementi themelor i qeverisjes natyrshëm lind pyetja e lidhjes së politikës me menaxhimin. Për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetje, që në krye të herës shfaqen ngërce që "kanë nisur" që në kohët e lashta kur p.sh Aristoteli shprehej se *"njeriu është një kafshë politike, politika është art i qeverisjes"* e që vazhdojnë deri në përkufizimet e sotme.

Megjithatë po ndalemi pak sa tek politika më teper në aspektin e vendimmarrjes, sepse kjo është një çështje e ndjeshme shoqërore, pavarësisht nga mëdyshjet që ndeshen në literaturë për veti, përcaktime apo funksione të tilla, si p.sh., politika është procesi që ka të bëjë me pyetjet çfarë, kur dhe si; politika është arti i qeverisjes; politika është çështje publike;politika është kompromis dhe konsensus; politika është fuqi, fuqia të korrupton dhe fuqia absolute të korrupton absolutisht ose politika është vendimarrje, agjendë, kontroll, etj. Gjithashtu politika është alokim publik vlerash, zgjidhje konflikti, konkurencë ndërmjet individëve e grupeve, shteteve sipas interesave të tyre, etj. Gjithsesi duke pasur parasysh përkufizimet e dhëna për menaxhimin, që në fillimet e demokracisë është shkruar që politika në një kuptim është shkencë (dije e nivelit të lartë) madje:

Limiti i Politikës =shkencë = menaxhim

Politika tenton në shkence, por asnjëherë ajo nuk e arrin atë në një kohë të caktuar. Më tepër në trajtë të pashtjelluar dhe koncize, formula tregon që vendimmarrja , thelbi i çdo politike, është dhe bëhet gjithnjë me shkencore dhe vetë politika është veprimtari shkencore optimale. Shkurt, ajo është projekt që menaxhohet.

Limiti i paraqitur më sipër dhe shembulli ilustrues për zhvillimin e kompjuterave në punimin tregojnë që kuptimi i shtetit, politikes (projektit) së tij mund e do të ndryshojë me kohën (p.sh. kemi mendimin që cilësia dhe vlera e votës individuale do të zvogëlohen relativisht me kohën e në raport me vlerën e kritereve shkencore gjithnjë e me rigoroze e të përgjithshëm).

Falë zhvillimit të teknologjisë moderne, politika (projekti) do të përgatitet, zhvillohet dhe vlerësohet në sferën e shkencës e të zbatimit të saj, në strukturate klasave abstrakte virtuale, etj., në bazat e dhënave me përmasa shumë të mëdha (ëarehouse) etj. Ajo ndoshta do të jetë një politike e grupimeve shkencore që konkurrojnë me projekte "fitues" në komunitete lokale, kombëtare ose rajonale dhe që marrin përsipër zbatimin dhe zhvillimin e tyre.

E nëse është kështu, d.m.th hipoteza është "reale" dhe politika "synon e orientohet drejt projektit", ne duhet të bëjmë të gjitha përpjekjet për transformimin politik të shoqërisë, për transformimin e saj mbi bazë projekti që qeveritari, menaxheri, drejtuesi i projektit ose politikani, të ketë formim të dallueshëm në fushën e shkencës dhe të zbatimit të projektit që drejton /menaxhon.

Por klasa politike është në vijën e parë për ushtrimin politikës (vendimmarrjes, të projektit të qeverisjes), ndaj lind pyetja: çfarë zhvillimi do të ketë në të ardhmen? Duhet të përmendim që në literaturë, veçanërisht sot në kohën e krizave për partitë politike në pushtet ka edhe mendime e qëndrime të tjera jo pak pesimiste, skeptike, afërsisht deri mohuese. P.sh., ka mjaft raste kur zhvillimi i partive politike përshkruhet me nota të zymta ose pesimiste.

Kësisoj, partitë politike janë në krizë dhe jashtë mode. Ato janë klasa që interesohen vetëm për veten e tyre. Sot është e natyrshme të shtrohet pyetja nëse ekziston një jetë politike në botë? Partitë politike janë gjithmonë e më pak të afta të kenë funksione përfaqësuese. Epoka e partive ka kaluar, megjithatë partitë politike lozin një rol të konsiderueshëm në menaxhimin e demokracisë dhe roli i tyre procedural mbetet i rëndësishëm si më parë.

Një rrugë në të cilën partitë mund të sigurojnë ekzistencën e tyre në të ardhmen është të përballojnë e të punojnë në rrethanat që ndryshojnë, të kërkojnë të forcojnë legjitimitetin në demokraci duke snuar të jenë gjithëpërfshirëse, transparente dhe të përgjegjshme.

Në vendin tonë ndonjëherë këto simptoma mund të duket aty këtu, megjithatë duhet të shtojmë që në vitet e fundit ka një kuptim më të drejtë të projektit e menaxhimit të tij nga politikanë dhe drejtuesit administrativ, falë përvojës dhe karrierës politike e administrative, se sa përgatitjes teorike në fushën e menaxhimit të projekteve.

Një fakt tjetër që bie në sy është që në këto 5-10 vitet e fundit politika në pushtet ka rritur artikulimin ndaj projekteve, megjithëse hera herës duke e zëvendësuar fjalën e thjeshtë "projekt" me program politik ose projekt politik. Shtrohet pyetja: si do jetë ecuria e vendimmarrjes politike që përbën aktivitetin kryesor të partive?

Mendojmë se edhe për disa kohë për ekzistencën dhe zhvillimin e partive politike është i nevojshëm ose i shëndetshëm qëndrimi i drejtë ndaj menaxhimit, strategjisë, projektit dhe zbatimit e zhvillimit të gjithanshëm e të pandërprerë të tyre. Themi kështu sepse, mbas një kohe andej nga fundi i këtij shekulli projektet "nga fillimi deri në fund" do të përgatitet nga teknologjitë e informacionit.

Në kuadrin e menaxhimit, hipoteza se politika është "ekzekutim i projektit" e afron funksionin e politikës me kërkesën që politika duhet të jetë avangarde në " prodhimin e

saj konkret". Jo rrallë herë, në kushtet e vendit tonë, politika i është larguar këtij funksioni, veçanërisht kur ndeshesh me pyetje të tilla si: Çfarë ka bërë e po prodhon politika? Cili është produkti i saj? Cila është vlera e saj, sasia, cilësia dhe qëndrueshmëria?Cili është niveli shkencor, karakteri optimal apo riskui saj? Cili është niveli "teknologjik" me të cilin përgatitet ky produkt? Cila është përgatitja e backgoundit të politikës? A është politika shembull në shoqëri që të jetë e integruar, konkurruese, bashkërenduese dhe motivuese në realizimin e strategjive të vendit? Cili është niveli shkencor i politikës apo përpjekjet e saj për rritjen e nivelit ?

Shkurt, politika do të jetë një veprimtari e grupimeve të ndryshme shoqërore, civile, intelektuale, shkencore etj, që do të konkurrojnë me projekte fitues në komunitete lokale, kombëtare ose regjionale dhe që marrin përsipër zbatimin e tyre.

Nga kjo pikëpamje konkurrenca politike mund të fashitet apo shuhet, përkundrejt asaj shkencore që vazhdimisht do të ndryshojë, madje sipas një funksioni rritës. E nëse është kështu, d.m.th hipoteza që i referohemi është "reale", ne duhet të bëjmë të gjitha përpjekjet, për zhvillimin e shoqërisë mbi bazë projekti, që politikani i sotshëm të ketë formim të dallueshëm në fushën e dijeve, studimit e kërkimit shkencor dhe atë të zbatimit të projektit që ai drejton. Sot është e vështirë të mendohet që vendimmarrësi, menaxheri ose politikani të punojë e aq më pak të drejtojë pa projekt.

Kohët e fundit ka një kuptim me të drejtë të projektit dhe menaxhimit të tij nga politikanë e drejtues projekti. Kjo është e nevojshme por nuk mjafton, të paktën kur nuk kemi një strategji shkencore e aq më pak një politike të tillë të aplikuar të mbështetur në këtë strategji. Duke pasur parasysh kritikat që bëhen sot për politikën,veçanërisht aktualisht në kohën e krizës, menaxhimi e projekti në përgjithësi mund e duhet të forcojnë ekzistencën dhe zhvillimin e shëndetshëm të saj në të ardhmen.

Natyrisht e ardhmja e partive politike është një çështje studimore (qe del jashtë këtij punimi) me rendësi të veçantë, sepse lidhet me shtetin dhe drejtimin e tij, e kjo i përket në mënyrë të veçantë institucioneve studimore, akademike që merren me to, vetë partive e grupeve të interesit, etj.

Një nga fuqitë dhe pushtetet "*me të fortë*" të politikës është vendimmarrja për strategjitë ose projektet dhe vendet e punës. Edhe në këto aspekte teknologjia inteligjente IT, ICT, sistemet ekspert po "*ndërhyjnë*" gjithnjë e më tepër në *vendimmarrjet politike* e po bëhen jo në pak *raste konsultues e konkurrentë seriozë me të*, aq sa synojnë ta mënjanojnë ose ta shmangin atë. Natyrisht perspektiva e projektizimit, metodave të reja shkencore veçanërisht në zbatimet matematike do të sjellë edhe ndryshime të tjera.

Sot jemi dëshmitarë të marrjes së vendimeve për pranimin e studentëve me programe kompjuterike (aktivitet i filluar që në 1975), i zhvillimit të disiplinave të ndryshme (matematikore, menaxheriale, programuese etj.) vendimmarrëse në auditorët universitarë apo për projekte të ndryshme me shumë variante (p.sh. projekti i vb Gorisht 1975-1978). Me këtë rast kujtojmë që në inaugurimin e Departamentit të Informatikës në Universitet është paraqitur një sistem modest ekspert, një program i thjeshtë, për të propaganduar politikisht disa vepra.

Pavarësisht nga niveli i përmbajtjes së theksuar të zhvillimit të vendimmarrjes mbi bazën e teknologjisë inteligjente në vendin tonë, duke pasur parasysh zhvillimet shumë të vrullshme të teknologjisë së informacionit në shumë fusha si dhe rezultatet e saj veçanërisht në dy dekadat e fundit lind pyetja: Cili do të jetë raporti i vendimmarrjes politike dhe i asaj që përftohet nga teknologjia inteligjente e informacionit (nga programet logjike, matematiko-informatike, sistemet ekspert, etj.,) në mënyrë të veçantë për problemet komplekse të burimeve njerëzore, hierarkike, strukturat e tyre, vendet e punës etj., që përmbajnë shumë kritere, nënkritere, kushte, baza të dhënash me përmasa të mëdha ?

4. *Probleme fazi me shumë kritere*

Problemi i marrjes së vendimit mund të jetë mjaft kompleks, p.sh., kur vendimi përmban disa kritere, probleme(MCDM) ose shumë kritere fazi (FMCDM, "fuzzy multy criterion decision making"). Zgjidhjet për këto këto probleme nuk janë të lehta si p.sh. **auditimi fazi optimal me shumë kritere; performance, efektivitet, eficiencë etj.,** apo vendimmarrje politike me interesa grupesh.

Po supozojmë që një Universitet planifikon ti japë një çmim një akademiku që do të ketë performancën më të lartë në tre aspekte, që janë: mësimi, puna kërkimore shkencore dhe shërbimi.

Çdo aspekt vlerësohet mbi bazën e kritereve përkatës dhe secili nga këto kritere ka shkallë të ndryshme vlerësimi, madje secili mund të përmbajë disa nënkritere. Kuptohet që çdo akademik aplikant i Universitetit mund të jetë një aplikant i mundshëm. Për këtë qëllim ngrihet një Komitet Ekspertësh, gjykimet e vlerësimit e të cilit po i supozojmë fazi. Shkurt, problemi i mësipërm është një FMCDM (fuzzy multy criteria decision making) që ka një hierarki kriteresh në të cilin përfshihen:

A. Mësimi

1. Zhvillimi i orës së mësimit përfshi mësimet e reja, përditësimin e atyre të mëparshëm etj; Përcaktimi i metodave të mësimit (metoda e probleme të reja);

2. Ngarkesa mësimore totale;

3. Performanca e studentit në praktika mësimore, vende të reja pune etj;

4. Rezultati i vlerësimit të studentit.

B. Puna kërkimore shkencore

5. Numri i granteve të fituar;

6. Sasia e parave të granteve;

7. Numri i publikimeve shkencore;

8. Cilësia e publikimeve (tekste , artikuj, revista);

9. Formimi i studentëve të aktivizuar në punë kërkimore.

C. Shërbime të ndryshme

10. Shërbime në universitet (fakultet, departament, laborator, administratë);

11. Shërbime në shoqërinë profesionale (botues revistash, lektor i ftuar në konferenca);

12. Shërbime në komunitet (konsultime teknike, ekspert në politika publicke, agjenci qeveritare).

Sipas kësaj hierarkie kriteresh, Komiteti i Eksperteve është në gjendje të bëjë vlerësimin e performancës së aplikantëve d.m.th përcakton shkallen e rëndësisë së kriterit në lidhje me qëllimin, bashkësinë e termave gramatikor (i mire, shumë i mirë) të paraqitur me numra fazi trekëndor, për vendosjen e peshave për të tre aspektet dhe 13 kriteret.

Në vijim të procedurës, në një tabele vendosen termat gjuhësor të nevojshëm dhe numrat fazi trekëndor për çdo kandidat. Në fund, duke pasur parasysh shkallën e rëndësisë të kritereve dhe rezultateve, Komiteti i Eksperteve përdor Metodën FMDCM dhe tregon rezultatin më të lartë të aplikantit që është marrë nga zbatimi i saj.

Ky problem i kandidatit ka pika të përbashkëta, që po i quajmë kritere të vendit të punës (një e pushtetarit apo kandidati tjetër që synon këtë vend punë). Historikisht vendimmarrja për pozicionet e pushtetarëve ka pasur në shumicën e rasteve karakter politik, si në kohën e diktaturës, ashtu edhe pas saj, për të cilat janë luajtur shumë karta e në mënyrë të veçantë me atë të demokracisë dhe të votës së lirë popullore.

Madje, kjo dukuri vazhdon edhe sot e kësaj dite, e përzier me probleme korrupsioni, klientelizmi, nepotizmi apo klanizmi. Kjo ndërlikohet kur sistemi i drejtësisë nuk është në lartësinë e detyrave që ka dhe që nuk mund t'i bëjë ballë në përgjithësi luftës kundër korrupsionit, blerjes me para të votës, vendit të pushtetarit, etj. Në këto rrethana në disa punime të mëparshme është ngritur problemi i vendit të punës së pushtetarit, ministrit, deputetit etj., që ai të fitohet jo vetëm më vote, por edhe mbi bazë të kritereve

profesionale, rezultateve në punë dhe arritjeve që janë me peshë në zhvillimin shoqëror e individual.

Në fushën e zgjidhjes optimale të projekteve, vendimmarrja e mirëfilltë politike nuk ka pasur përgjithësisht ndonjë kontribut dhe gjatë kohë kur ajo e ka parë të arsyeshme i është drejtuar për zgjidhje optimale të projekteve shoqërisë civile të specialisteve, institucioneve shtetërore ku ato punojnë etj. Duhet përmendur që jo pak herë politika jonë kombëtare ka shfaqur dobësi të pajustifikueshme me përgatitjen e dobët në fushën e teknologjisë së informacionit e përdorimit të saj, të strategjive e optimizimit të tyre, të projekteve me variante të energjisë, infrastrukturës, riskut, programimit, etj.

Për të treguar prapambetjen relative të politikes, ne po përmendim që lënda e programimit në Universitet është futur në vitet 1974-75, ndërkohë që vendosja e kompjuterëve në sallën e Kuvendit ka ndodhur vitet e fundit, fakt ky që mund ta rendisë këtë institucion ndoshta të fundit në Evropë, pa përmendur veprimtaritë e tjera me e-projektet, e-aktivitetet në vende të ndryshme të Evropës dhe vendet fqinje .

P.sh. gjatë viteve 80 në një vend të Evropës shtrohej pyetja: a duhet lideri i parë i vendit të dinte kompjuter për vendin e punës së tij ose në një konferencë botërore një lider tjetër shkonte me robot në krah për të shpjeguar të rejat e arritura në këtë fushë, ndërkohë që politika jonë ishte shumë larg këtyre "objekteve". Po i përmendim këto për të treguar sado pak, që politika duhet të jetë shumë më afër zhvillimeve të shkencës në përgjithësitë dhe teknologjive të reja të informacionit. Që vendimmarrja e saj të jetë efektive dhe e bazuar në zhvillimet e shkencës në mënyrë që të pështpejtohen ritmet për mënjanimin e boshllëqeve dhe të metave për vendin e punës së një pushtetari, a mund dhe duhet të marrim në konsideratë edhe vendimin e kompjuterit për performancën e kandidatit në fjalë? Natyrisht, duhet të fillojmë të mendojmë mirë dhe të veprojmë fort për këtë problem, në mënyrë të ngjashme siç kemi bërë për listat e rezultateve të kandidatëve për në universitet.

Problemi natyrisht është shumë më i gjerë dhe i prekshëm, kur mendon vendimmarrje më të komplikuara si p.sh për aktivitete të ndryshme qeveritare, shtetërore, të Kontrollit të Lartë të Shtetit, të institucioneve arsimore, shëndetësore, për vendet e punës apo rikualifikim të mësuesit, punonjësit të shëndetësisë dhe të administratës. Përmendim që mjaft nga këto probleme vazhdojnë të trajtohen e zgjidhen në mënyrë subjektive, politike, etj dhe jo me programe, sisteme ekspertë ose metoda optimizmi.

Teknologjia inteligjente, inteligjenca artificiale etj., me arritjet e parashikuara mendohet (që nga vitet 2080, do të përgatisë, ndoshta edhe të zgjidhë, çdo projekt në botë, sado i madh dhe i sofistikuar që të jetë ai.

Në këto rrethana e hipoteza, menjëherë lind një pyetje me interes: në qoftë se projektet do të zgjidhen nga kjo teknologji, po vendimmarrjen për zbatimin e tyre kush do ta bëjë? Ose ndryshe: a do të mund të arrijë kjo teknologji inteligjente (artificiale) të fitojë në çdo lojë "të tanishme" vendimmarrëse politike, shtetërore, publikeapo çdo vendim ekspertësh ashtu siç ndodhi në fund të shekullit të kaluar, kur kjo teknologji ia doli me sukses edhe në lojën e shahut me kampionin e botës Gasparov".

Më pas, kur mendon se sistemet ekspert në fushën e auditimit filluan të përdoren në SHBA rreth viteve '80 heinformohesh për sukseset jo aq të propaganduara në "informatizimin" e vendimmarrjes në përgjithësi në shumë projekte e fusha shtohet pyetja: a nuk duhet të bëjmë shumë më tepër në kuadrin e reformave p.sh në arsimin e lartë? A nuk është reforma për zhvillimin e dhe intelektualizimin e trurit natyror e artificial një nga reformat më të rëndësishme në fushën e investimeve të përgjithshme?

Ky është një motiv ndoshta për të treguar edhe ndonjë shembull në këtë drejtim (psh Estonia). Jo më pak shqetësues është fakti i nivelit të projektizimit në vendin tonë, në vendimmarrjet përkatëse në institucionet qeveritare, ekzekutiv, legjislativ, në Kontrollin e Shtetit, etj. apo në trajtimin e reformave "plot shprese e perspektive" që kryhen jo rrallë herë pa projekte e baza të dhënash, metodash të sofistikuara matematike dhe informatike, hera herës me përgatitje mediokre të politikës, vendimmarrje jo racionale (nuk ka mundësi që i njëjti problem nga dy kampe të ndryshëm të ketë zgjidhje "të kundërta") dhe pa aktivizimin e konsultimin e mirëfilltë me specialistët përkatës të departamenteve apo njësive akademike.

Një herë që duke bërë fjalë për vendimmarrjen me teknologji inteligjente dikush u shpreh se, mesa po kuptoj për disa dekada të ardhshme politika e sotme do të jetë pothuajse jashtë vendimmarrjes, sepse çdo individ përpara se të ketë vendin e punës, d.m.th "të vendoset për të" do të peshohet në kompjuter njëlloj siç bëhet për vendimmarrjet me kandidatët e radhën e tyre për të drejtat e studimit universitar, pasuniversitar, etj.

5. Teknologjia inteligjente në vendimmarrje

Aktualisht teknologjia kompjuterike IT, ICT dhe në përgjithësi teknologjia inteligjente me metodat dhe sistemet e tyre mund të ndihmojnë në marrjen e vendimit në shumë aspekte:

Së pari: sistemi i kompjuterizuar apo i inteligjencës artificiale i lejon vendimmarrësit të performojnë me shpejtësi shumë të madhe një numër të madh llogaritjesh, siç janë modelet e optimizimit kompleks, të cilët mund të përdoren në situata reale emergjente që kërkojnë vendime në kohë shumë të shkurtër.

Së dyti: Shumë probleme të vendimmarrjes përmbajnë të dhëna të vendosura në baza të ndryshme apo mega baza dhe në ëebsite jashtë organizimit që konsiderojmë. Gjithashtu të dhënat mund të jenë të llojeve të ndryshme të tillës si tinguj apo grafikë dhe me lidhje komplekse ndërmjet tyre. Nga kjo pikëpamje, teknologjia e informacionit mund të bëjë të mundur kërkimin, rezervimin dhe transmetimin e të dhënave të nevojshme me shpejtësi dhe në mënyrë ekonomike për marrjen e vendimit.

Së treti: teknologjia kompjuterike mund të ndihmojë në zvogëlimin e riskut të gabimeve njerëzore dhe të përmirësojë besueshmërinë e vendimmarrjes.

Së katërti: teknologjia inteligjente (ITT), mund të përmirësojë cilësinë e marrjes së vendimit.

Duke përdorur këtë teknikë, marrësit e vendimit mund të kuptojnë më mirë natyrën e problemit, kanë më tepër mundësi të arrin në konsidaretë më shumë alternativa dhe të vlerësojnë ndikimet e ndryshme nga faktorë të ndryshëm të rastit, me të dhëna jo të plota e të sakta.

Njëherësh, teknologjia e informacionit mund të zvogëlojë koston e vendimit, po kështu bën të mundur që anëtarët e grupit të vendimmarrjes të jenë nga vende të ndryshme dhe në sajë të sistemeve në web, "të mblidhen" virtualisht për vendimet përkatëse.

Kuptohet që shumë teknika të mbështetjes së vendimit në teknologjitë e kompjuterizuara mund të jenë më të mira në problemet e vendimit të strukturuar se në ato gjysmë të strukturuar ose të pastrukturuar. Për problemet e vendimit gjysmë të strukturuar, teknologjia kompjuterike mund të përmirësojë cilësinë e informacionit në të cilën bazohet vendimmarrja, jo vetëm për një zgjidhje të vetme, por për një bashkësi alternativash.

6. Sistemet eksperte

Në dy dekadat e fundit ka një zhvillim shumë të vrullshëm të teknologjisë së informacionit, komunikimit, inteligjencës artificiale dhe zbatimit të metodave përkatëse të vendimmarrjes. Historikisht metodat dhe algoritmet e tyre (veçanërisht në kërkimin operacional ose menaxhimit pas luftës së dytë botërore) kanë qenë të përqendruara në optimizimin matematik, si p.sh: programimi linear dhe jo linear. Me kalimin e kohës problemet e optimizimit u komplikuan p.sh, u rrit numri i funksioneve të qëllimit, kriteret dhe rrethanat e së bashku me to edhe vështirësitë.

Krahas këtyre lindi nevoja e vendimmarrjes në kushte kur problemet duhet të zgjidheshin në kushte stokastike, më pas madje edhe me të dhëna e informacione jo të plota, të papërcaktuara, të pasigurta, fazi, etj. Kështu lindi teoria e bashkësive dhe e logjikës fazi që këto dy dekadat e fundit ka një zhvillim të përgjithshëm dhe zbatime

fillestare të ndjeshme, kjo edhe në vendimmarrjen individuale apo me bazë grupi në shumë fusha.

Kuptohet që vendimmarrjet që i referohen zgjidhjeve të problemeve me metoda të optimizimit deterministike, stokastike ose fazi, mbështeten në logjikën klasike (0,1) dhe fazi (segment). Shkurt ato janë metoda racionale dhe prej nga edhe vendimmarrja merr emrin racionale dhe nuk bëhet për interesa njerëzish, dëshira apo preferenca specifike. Aktorët kryesorë të ekipit të sistemit ekspert janë:

- eksperti i fushës;
- inxhinieri i njohurive;
- programuesi;
- menaxheri i projektit;
- përdoruesi (ose kolauduesi).

Eksperti i fushës është personi i aftë me njohuri dhe shprehi për zgjidhjen e problemit në një fushë specifike. Ai zotëron ekspertizën më të lartë në zonën e dhënë. Ekspertiza e tij merret nga sistemi, pra komunikon njohuritë e tij, merr pjesë në zhvillimin e sistemit ekspert dhe angazhohet për mjaft kohë në projektin e sistemit. Ai është aktori më i rëndësishëm, ekspert i sistemit ekspert. Inxhinieri i njohurive është person i aftë që projekton, ndërton dhe teston sistemin ekspert.

Inxhinieri i njohurive është personi i aftë për të projektuar, ndërtuar dhe testuat sistemin ekspert. Ai bashkëpunon me ekspertin e fushës për të marrë informacion se cili është problemi i veçantë që do të zgjidhet. Inxhinieri përcakton metodat e arsyetimit që ekspertët përdorin për lidhjen e fakteve dhe rregullave dhe vendos sesi ato do të paraqiten në sistemin ekspert. Pra, ai zgjedh softëaret e sistemit ekspert dhe grupet për programimin e tyre. Gjithashtu, ai është përgjegjës për testimin, revizionimin dhe integrimin e sistemit ekspert në "platformën" e punës.

Programuesi është personi që përgjigjet për programimin, d.m.th. për njohuritë e fushës me terma që i kupton sistemi kompjuterik. Ai duhet të ketë shprehi në fushat simbolike të AI si LIST, PROLOG, OPSS, etj dhe eksperienca në zbatimet e guaskave të sistemeve ekspertë. Ai gjithashtu duhet të njohë gjuhët e programimit C, FORTRAN, C++, etj.

Menaxheri i projektit është lideri i ekipit të sistemit ekspert dhe përgjegjës për vënien në punë. Ai bashkëpunon, udhëzon dhe drejton të gjithë aktorët e ekipit: ekspertin, inxhinierin e njohurive, programuesin dhe përdoruesin.

Kolauduesi (end user) është personi që vendos në punë sistemin ekspert Ai duhet të jetë jo vetëm person i besuar në performancë, por edhe të ndihet "rehat" në përdorimin e tij, njëlloj sikur ai të ishte përdoruesi i ardhshëm i tij. Pra, projektimi e kolaudimi i

sistemit ekspert është themelor për suksesin e projektit, që këtej dhe kontributi i kolauduesit.

Një sistem ekspert ndërtohet për të realizuar një performancë në nivelin e një eksperti njerëzor në një fushë të ngushtë të specializuar. Karakteristika më e rëndësishme e një sistemi ekspert është performanca me cilësi të lartë. Sado i shpejtë të jetë sistemi ekspert, përdoruesi nuk është i kënaqur kur rezultati është i gabuar.

Një tjetër karakteristikë e rëndësishme është shpejtësia e zgjidhjes. Sado e saktë të jetë një diagnozë, vendimmarrje ose zgjidhje, ajo nuk vlen kur situata është emergjente, p.sh. i sëmuri vdes, uzina shpërthen, etj. Sistemet ekspertë zbatojnë heuristikën për të drejtuar arsyetimin, d.m.th. zvogëlojnë hapsirën e fushës për kërkimin e zgjidhjes.

Edhe kapaciteti shpjegues, sipas të cilit sistemi ekspert mund të rishikojë arsyetimin dhe të shpjegojë vendimmarrjen është një tjetër arritje. Sistemi ekspert përdor arsyetimin simbolik kur zgjidh një problem. Simbolet përdoren për të paraqitur tipe të ndryshëm të njohurive, si fakte, koncepte dhe rregulla.

A mundet të gabojë sistemi ekspert?

Natyrisht që po, pavarësisht se ne mbështetemi shumë herë në zgjidhjet e tyre, por gabime edhe mund të ndodhin, prandaj duhet të jemi vigjilentë dhe të kujdesshëm.

Konkluzion

Rritja e shkallës së projektizimit, e cilësisë së projekteve, reformave, kontratave, e digjitalizimit, informatizimit, matematizimit, zvogëlimit të riskut, etj, si dhe efektivitetit të vendimmarrjes është me rëndësi të rriten ritmet e zhvillimit dhe të investimeve që në fushën e trurit aktualisht mendojmë se janë një të një rëndësie parësore.

Literatura

1. *R.E. Bellman, L.A. Zadeh. Decision making in a fuzzy environment. Management science 1970, USA;*
2. *J. Liu, G. Zhang, d. Ruan F. Ëu Multi objective group Deciosion making . Imperial College 2007;*
3. *R. Fuller, Fuzzy reasoning and Fuzzy optimisation ,Turku Center for Computer Sciences 1998 Finland;*
4. *H. J. Zimmerman Fuzzy set theory and its application, Fourth edition Springer science 2001;*
5. *K.H. Lee First course on Fuzzy theory and applications. Springer 2005;*
6. *M. Negnewitsky . Artificial inteligence Second edition2005.Edinburgh UK; R. Kalman What is sytem theory .OO!1K1985 Kp_LE_en.doc (internet);*
7. *G. Bojadziev, M.Bojadziev. Fuzzy logic for Business Financeand Mangement, Second Edition, 2005 London;*

8. *D. Molodtsov Soft Set Theory First Results, Computing Center of the Russian Academy of Sciences, Pergamon Computers and Mathematics with Applications 37 (1999), Russia;*
9. *Y Çelik, S Yamak. Fuzzy soft set theory applied to medical,diagnosis using fuzzy arithmetic operations, Journal of Inequalities and Applications 2013,Turkey;*
10. *J.Bencina.Fuzzy decision tree as decision making, Framework in the Public Secto. University of Ljubjana,2011. Slovenia N. Fenton, Ë. Ëang, Risk and confidenece anakysis for fuzzy multycriteria decision making Elsevier 2006,UK;*
11. *H. Borzecka Multy criteriia decision making using preference relations. Operations research and decisions, Nr 13 Warsaw,Poland;*
12. *B. Leskaj Mirëqeverisja paradigma e re në administrimin publik. Revista Auditimi publik 2013, Tiranë;*
13. *B. Leskaj Performanca e KLSH 2012 drejt një institucioni modern auditimi publik, Revista Auditimi publik 2013, Tiranë;*
14. *S. Osmani, B. Leskaj. Zvogëlimi i Riskut , një potencial i mundshëm i zhvillimit të vendit. Konferenca e IV-të Shkencore e KLSH-së "Auditimi Kombëtar në shërbim të Qeverisjes Kombëtare", 2014, Tiranë;*
15. *S. Osmani Algol me zbatime 1977, Tiranë;*
16. *S.Osmani Optimizimi, Vëll 1,2,3. 2008- 2009, Tiranë; S. Osmani Programe dhe projekte C++ Pjesa 2 2006, Tiranë;*
17. *S. Osmani Hyrje ne stokastike, 2012, Tiranë;*
18. *S. Osmani Fazistika (Dorëshkrim për botim) 2015, Tiranë;*
19. *S.Osmani Metodat matematike në menaxhim 2004, Tiranë; S. Osmani Konsiderata Mbi optimizimin e burimeve dhe politikën kombëtare, 1991, Tiranë.*

ALSAI INNOVATIVE APPROACHES IN CONNECTING WITH CITIZENS- QASJET INOVATIVE TË KLSH NË LIDHJEN ME QYTETARËT

nga Revista "INTOSAI Journal", Nr. 21, shtator-dhjetor 2014

I. Being aware of the importance of innovation, Albania's Supreme Audit Institution (ALSAI) is seeking new and innovative approaches to communicate the results of its audits to people. In addition to its press releases, which have gained in form and are now more understandable and showing public opinion appeal, ALSAI developed in the last two years quite a new approach to communicate with people.

In 2013, 33 senior executives and auditors of ALSAI were contacted by the Chairman and the group of advisors on public relations, advised and stimulated to prepare articles for Albanian written media. The first contacts and talks saw resistance from managers and skilled auditors, as they were feeling hesitant and said they don't have experience at all to deal with the media.

With the time and the work done by ALSAI Chairman and the communication sector people, it was possible to convince them on the force of their audit findings and the benefit if they go public. They understood the importance of explaining their recommendations by themselves. They started to prepare materials. First the materials were badly drafted, were very long and containing a lot of technical phrases, difficult for the public to understand.

The senior executives and auditors were oriented to shorten and simplify their articles, using a reader's friendly language. With the time, they understood the requirements of "going public" and improved their writing.

Over the last year, ALSAI senior executives and auditors have written in Albanian newspapers and magazines more than 100 articles on theoretical and practical aspects of the audit. They have brought their experience on certain sensitive issues of audit to citizens, such as the problems and opportunities for improvement of service in State companies of utilities (electric power generation and distribution, water supply, railways), etc.

Their presence in the Albanian press is a novelty for the institution and the Albanian society as a whole. The approach continued to be successful in the first nine months of 2014. There are more than 90 published articles, editorials, analyses, etc, during this period. The topics on which the auditors gave their ideas and opinions by the writing, are diverse and affect all important and vital issues of public administration and performance of public institutions. They range from writing on public accountability, integrity, governance and increased transparency, to the possibilities of increasing tax

revenues, the problems of local government administration and levy of local taxes, the synergy to be created among institutions and the civil society, in the fight against corruption, the innovation and rationale for performance audits, the latest findings in financial audits, in public procurement, the impressive findings and recommendations of environmental audits, etc.

The ALSAI editorials have stimulated reaction in related blogs that newspapers manage. The majority of comments from readers appreciate the posed problems and the measures ALSAI auditors have proposed to improve the situation in different audited fields and institutions.

The "public article writers" inside ALSAI have increased from last year, as other more experienced auditors and new auditors have joined and have come with ideas and the wish to present them to the public. ALSAI management thought to stimulate further such an approach, by preparing ALSAI publications with selection of best articles and editorials.

The most important thing in this approach, is that the auditors and managers see the benefit out of their engagement in the written media and do wish to continue. They feel well when people they know approach them and congratulate with them on the published article. Some auditors say that after reading some blogs on the contents of their articles, they have been stimulated to write more on the same topic, or write on another important theme.

With time, senior executives and auditors gained confidence in their abilities and have now inside them "the ferment" to contribute improving governance in the country, through their permanent presence in the Albanian press.

The wide range of public administration management and development issues dwelt in press articles demonstrates responsibility and commitment of SAI auditors to help, first and foremost the citizens, with full information and presenting real problems of public administration in our country. It also conveys important messages for public decision-makers that read newspapers and see from another angle the proposed measures and recommendations for improvement.

ALSAI senior management thanks all SAI executives and auditors that during 2013-2014 took from their precious time and had the courage to go on national media with their ideas and messages, providing an important contribution in informing and sensitizing the citizens and the public opinion of the country on issues of good governance and fight against fraud and mismanagement.

II. During 2012-2014 ALSAI, conscious that good governance can be reached only through creating synergy between various actors of society, has built working

relationships and cooperation with eight from civil society most active organizations in the fight against corruption and for more transparency in public administration. In signing cooperation agreements with these CS units, ALSAI has aimed to exchange information and strengthen the contribution of both partners in relation to transparency and accountability. Civil society organizations have served to channel citizens' participation, becoming conduits of their voice and proposing concrete topics for audit. Professionals of these organizations were also part of the audit groups, where they brought their expertise in the areas that they are profiled. A lot of CS experts served also as lecturers in different ALSAI staff training, with the aim of increasing their audit capacity, especially in the field of environment protection.

III. ALSAI has established cooperation relations with the three nation-wide associations of professionals, mainly in the field of accounting. This collaboration has brought its evident contribution to capacity building and professional knowledge of ALSAI staff, through training and consultation with their experts. Professionals of these organizations have brought a concrete help with their values and skilled expertise in accounting and auditing of public funds.

As a result of this cooperation, for the first time, during 2012-2014 ALSAI organized its annual scientific conference on audit themes, aiming to apply scientific research to promote the progress and effectiveness of the institution. Cooperation with professional associations but also with partner SAIs, such as the Polish NIK, the Court of Audit of Slovenia, the Court of Accounts of Turkey, brought an added value to the conference, where highest representatives of these institutions contributed with their studies and presentations. Valuable presentations also came from European Commissions' DG-Budget, from SIGMA and the European Court of Auditors.

KREU VI.

Diskutime në Analizat Vjetore të KLSH dhe të ZKA të Kosovës

- Të largojmë auditimin nga hija e gjobëvënësit, *Analiza Vjetore e vitit 2011*
- Dituria në Auditim, armë për mbrojtjen e pavarësisë institucionale, *Analiza e 6-mujorit të parë të vitit 2012*
- Cilësi në Auditim do të thotë të fitosh besimin e qytetarëve, *Analiza Vjetore e vitit 2012*
- KLSH si institucion që përmirëson menaxhimin publik të parave të shqiptarëve, *Analiza Vjetore e vitit 2013*
- Auditimi Kombëtar, në shërbim të qeverisjes kombëtare, *Analiza Vjetore e vitit 2014*
- Të ndryshosh për mirë opinionin publik mbi një shërbim apo veprim shtetëror, ke ndryshuar për mirë qeverinë, *Analiza Vjetore e vitit 2015*
- Konferenca e IV-t e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës, *Analiza Vjetore, korrik 2012*
- Konferenca e V-të e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës, *Analiza Vjetore, korrik 2013*
- Diskutim në Konferencën e VI-të të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës, *Analiza Vjetore, korrik 2014*
- Diskutim në Konferencën e VII-të e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës, *Analiza Vjetore, korrik 2015*

TË LARGOJMË AUDITIMIN NGA HIJA E GJOBËVËNËSIT

Analiza e KLSH për vitin 2011

Analiza vjetore për vitin 2011 është zhvilluar në sallën e Pallatit të Kongreseve më datë 20.01.2012

Të nderuar bashkëpunëtorë të KLSH,

Të nderuar përfaqësues të medias!

Pas zhvillimit gjatë javës të analizave të departamenteve, sot jemi mbledhur për të zhvilluar analizën vjetore të Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2011. Vitin që sapo përfundoi, duke respektuar punën e të gjithë audituesve të KLSH-së, e vlerësoj si një vit pune në zbatim të rekomandimeve të Rezolutës së 2 qershorit 2011 të Kuvendit të Shqipërisë dhe të objektivave të Planit të tij Strategjik të Zhvillimit, 2009-2012. Gjatë këtij viti, KLSH ka kryer 152 auditime, ku janë konstatuar shkelje financiare me dëm të konsiderueshëm ekonomik dhe ka rekomanduar shpërblimin e këtij dëmi ekonomik në nivel të lartë financiar në arkën e Shtetit. Janë propozuar 1,605 masa korrigjuese administrative, nga të cilat 1,108 janë zbatuar. Nga 720 masa disiplinore dhe administrative të rekomanduara, janë zbatuar 536 prej tyre. Përgjithësisht më duhet të pohoj se janë masa relativisht të lehta. Gjithashtu, KLSH ka kryer kallëzim penal gjatë vitit 2011 pranë organeve të Prokurorisë në 6 raste dhe për 13 persona.

Pak! Shumë pak! Dobët për të gjithë ne.

Vlerësoj se stafi i institucionit është përpjekur të zbatojë Rregulloren e tij të Brendshme, Standardet e Kontrollit të KLSH, metodikat, Manualet e Auditimit Financiar e të Performancës dhe Kodin Etik, si dhe është përpjekur, por pa ia arritur, për implementimin e standardeve të përditësuara të INTOSAI-t.

Më pas, z. Robert Gjini, Drejtor i Përgjithshëm i KLSH do t'ju paraqesë një raport më të plotë rreth veprimtarisë së kryer nga institucioni i KLSH gjatë vitit 2011. Gjithashtu, Drejtorët e Departamenteve do të realizojnë një përmbledhje jo vetëm të punës njëvjeçare, por edhe të analizës së zhvilluar në departamente. Kryeaudituesit dhe audituesit besoj do të flasin në këtë analizë.

Është e natyrshme dhe frytdhënëse që puna e të shkuarës të analizohet me realizëm dhe objektivitet, duke vlerësuar dhe marrë me vete në të ardhmen kontributet dhe produktet më cilësore, të cilat nuk kanë munguar në KLSH. Kjo strukturë e auditimit më të lartë

ekonomiko-financiar të Shtetit ka qenë drejtuar përgjatë dy dekadave të fundit nga personalitete të jetës politike dhe ekonomike të vendit, si zotërinjtë Alfred Karamuço, Ylli Memisha, Blerim Çela, Mustafa Kërçuku dhe Robert Çeku, të cilët gjej rastin t'i falenderoj për kontributin e dhënë. Dua të falenderoj po ashtu në mënyrë të veçantë anëtarët e Panelit Drejtues të kësaj Analize Vjetore, audituesit e nderuar të KLSH: Zyra Kepi, Rustem Tare, Fatos Gjyrezi, Rasim Hoxha, Bashkim Spahia dhe Irena Kokona, të cilët në gjithë këto vite kanë kontribuar për institucionin dhe në këtë vit janë në përmbyllje të kontributit të tyre, për arsye moshe.

Mirëpo, mbi të gjitha duhen evidentuar edhe mangësitë apo mosrealizimet, me qëllim që projektimi i të ardhmes të përfshijë plotësimin e mangësive dhe përmirësimin cilësor të punës.

Megjithë përpjekjet e stafit për të realizuar planin e auditimeve dhe detyrat e vëna në sasi, jemi të ndërgjegjshëm se cilësia e punës ka lënë për të dëshiruar. Audituesit në jo pak raste janë mjaftuar me dokumentacionet e ofruara nga subjektet e audituara dhe ka munguar vullneti ose aftësia profesionale për zbulimin e mashtrimit financiar dhe korrupsionit. Auditimet më tepër janë kryer formale dhe sa për të plotësuar numrin. ***Kjo është dhe arsyeja kryesore e një numri shumë të ulët të kallëzimeve penale për vitin e kaluar, numër i cili duhet theksuar se në vijimësi ka qenë i ulët gjatë viteve të fundit.***

Bashkëpunimi me organet e Prokurorisë në ndjekjen e kallëzimeve penale nuk ka qenë në nivelin e kërkuar, megjithëse kemi një marrëveshje ndërmjet dy institucioneve, të nënshkruar në vitin 2005, e cila ende nuk është bërë efektive, për pasojë të punës sonë të dobët dhe nënvleftësimit apo injorimit të Prokurorisë.

Po ashtu, me shqetësim duhet të konsiderohet fakti se niveli i realizimit të rekomandimeve të KLSH për shpërblimin e dëmit të konstatuar në organet tatimore dhe doganore ka një përqindje mjaft të ulët (vetëm 9 përqind), ose nga 183 milionë lekë rekomanduar për shpërblim të dëmit, janë nxjerrë urdhrat përkatës për vetëm 16 milionë lekë. Ne do t'i analizojmë më mire këto raporte, duke qenë institucioni më i lartë i auditimit ekonomiko-financiar, por asnjëherë duke tejkaluar kompetencat tona, për të audituar subjektet private.

Duke vlerësuar punën gjatë vitit 2011, analizat vjetore të departamenteve në këtë muaj të parë të vitit 2012 dhe përpjekjet e shumta në auditimet e kryera prej jush dhe në raportimet e dhëna, më duhet të pohoj se kemi ende shumë për të bërë, për të qenë konform standardeve ndërkombëtare të auditimit, sidomos me Strategjinë e INTOSAI-t për vitet në vazhdim (2011-2016), të titulluar "*Për promovimin e përgjegjshmërisë, transparencës*

dhe qeverisjes së mirë". Kjo strategji, e miratuar në Kongresin e INTOSAI-t në Johanesburg në vitin 2010 përmban objektivin e "*Vazhdimit të luftës ndaj korrupsionit*".

Ky vit është viti pararendës i 60 vjetorit të themelimit të INTOSAI-t dhe në këtë vigjilje, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara shpalli më 22 dhjetor 2011 Rezolutën e saj *"Për promovimin e efiçiencës, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës së administratës publike duke fuqizuar institucionet e auditimit suprem"*, në pikën 5 të s cilës theksohet se "*Asambleja inkurajon shtetet anëtare dhe institucionet përkatëse të Kombeve të Bashkuara që të vazhdojnë dhe të intensifikojnë bashkëpunimin e tyre, duke përfshirë në ngritjen e kapaciteteve INTOSAI-n, në mënyrë që të promovohet qeverisja e mirë, duke siguruar efiçiencë, përgjegjshmëri, efektivitet dhe transparencë nëpërmjet forcimit të institucioneve përgjegjëse të kontrollit*[91]*"*.

Krahas rekomandimit të sipërcituar të INTOSAI-t dhe Rezolutës së Kombeve të Bashkuara, orientim për sinergjizimin e përpjekjeve tona për parandalimin e korrupsionit, ndëshkimin e tij apo për propozimet për përmirësime aktesh ligjore e nënligjore do të përbëjë dhe Strategjia Ndërsektoriale e Qeverisë Berisha e *Parandalimit, Luftës kundër Korrupsionit dhe e Qeverisjes Transparente 2008-2013*. Referuar kësaj Strategjie, dua të citoj*: "Shkëmbimi i informacionit jo vetëm ndërmjet agjensive të zbatimit të ligjit, por të çdo organi shtetëror që luan rol dhe ka përgjegjësi në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, i cili synon shkëmbimin e informacionit jo si pjesë e detyrimit dhe përgjegjësisë ligjore e institucionale të zakonshme, por mbi baza funksionale, proaktive dhe me periodicitet më të shpejtë* [92]*"*.

Pra, nuk mund të pretendojmë se po luftojmë me efektivitet korrupsionin, kur propozojmë rekomandime për raste që auditues të veçantë zbulojnë shitje asetesh pa tituj pronësie në një njësi vendore, ose shkelje të ligjeve të urbanistikës, ose përçmim në pjesëmarrjen në tendera, etj dhe nuk propozojmë largimin nga puna të personit shkaktar përgjegjës dhe kallëzimin në Prokurori. Përmenda këto raste, por të tilla ka shumë.

Kemi kërkuar sinergjizim veprimesh me institucionet e tjera që luftojnë korrupsionin. Ne duhet ta denoncojmë korrupsionin edhe kur ai është në një njësi vendore që drejtohet nga socialistët apo demokratët, edhe kur është ushtruar në institucione qendrore, pra në çdo vend dhe në çdo kohë.

Ne do të kërkojmë riaktivizimin potencial të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Financave, Prokurorisë, Shërbimit Informativ Shtetëror, Inspektoratit të Deklarimit të Pasurive dhe KLSH, me synim maksimizimin e

[91] Rezoluta A/66/209, faqe 1

[92] Strategjia Ndërsektoriale faqe 22, paragrafi 3-të

dobisë së vlerave të saj për çdo departament. Do të punojmë për një bashkëpunim intensiv me Departamentin e Antikorrupsionit në Këshillin e Ministrave dhe për një rivendosje të marrëdhënieve me Prokurorinë, të shkëputura prej disa vitesh.

Dua të tërheq vëmendjen se shumë shpejt do të rregullohen orientimet e Rregullores së Brendshme të Institucionit të cilat bien ndesh me përcaktimet dhe rregullat e Manualeve të Auditimit Financiar dhe të Auditimit të Performancës. Auditimet e performancës së subjekteve nën auditim kanë filluar të praktikohen 2-3 vitet e fundit dhe kanë qenë formale. Këto auditime nuk janë ushtruar dhe përgatitur sipas kërkesave të Manualit përkatës. Filozofia e re ku duhet të orientohemi është përqendrimi i punës mbi të gjitha tek auditimet e performancës, krahas fuqizimit të auditimeve financiare. Për këto të fundit duhen shfrytëzuar dhe audituesit e brendshëm të subjekteve nën auditim.

Të gjithë duhet të kuptojmë se, nuk ka auditim pa ndëshkim. **Është e rëndësishme që ne të largojmë hijen e audituesit gjobëvënës dhe të atij që abuzon me detyrën**. Deri tani janë shumë pak masat për largimin nga puna të personave shkaktarë, përgjegjës të dëmeve të konstatuara. Konstatimet dhe masat e propozuara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit duhet të jenë të efektshme dhe të ndihen në publik. Ne duhet të heqim dorë nga zbulimi i vjedhjeve hipotetike, që s'ekzistojnë, për faktin se këto "zbulime" tonat i shërbejnë mbulimit të korrupsionit të vërtetë. Duhet të rifreskohet praktika e dërgimit të evidencave të sakta pranë DAP për masat administrative dhe disiplinore të propozuara, në mënyrë që persona të implikuar në shkaktimin e dëmit të mos lëvizin lirisht në administratën shtetërore. Dëshirës pozitive dhe vullnetit të mirë të Kryeministrit, të shprehur në Urdhrin Nr. 70 të vitit 2006 *"Për zbatimin e masave të propozuara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit"*, ne duhet t'i përgjigjemi me denoncimin e çdo shkeljeje. Një libër gri për nëpunësit abuzues ne do ta dorëzojmë çdo vit pranë Departamentit të Administratës Publike, institucioneve qendrore dhe më gjerë. Fund i këtij muaji do të jetë afati për shkeljet e konstatuara gjatë vitit 2011.

Pavarësia dhe integriteti i institucionit duhet të na bëjë të ndërgjegjshëm se korrupsioni nuk ka ngjyrë, nuk është as i kuq, as blu, por është i zi.

Konstatoj se brënda strukturave të brendshme të KLSH-së mungon koordinimi në nivelin e duhur. Ka ndodhur që në një subjekt nën auditim të shkojë një grup auditimi i njërës drejtori dhe pas disa muajsh një grup tjetër nga një departament tjetër, duke ia ulur seriozitetin dhe imazhin e institucionit. Informacioni për auditimet e kryera dhe rezultatet e marra nuk qarkullon elektronikisht mes departamenteve dhe shumë pak punonjës kanë njohuri të mjaftueshme për atë çfarë ndodh në departamentin fqinj.

Programet e sotme të teknologjisë së informacionit në auditimin e financave publike dhe doganave e tatimeve duhet të përpunohen dhe implementohen nga ne. Dihet që shërbimi online për tatimpaguesit nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, të cilat për ne janë objekt auditimi, ka disa vite që funksionon. Këtij zhvillimi KLSH nuk i është përgjigjur. Çdo departament auditimi tek ne duhet të përgatitet për të filluar auditimet që përdorin programet e teknologjisë së informacionit, ku më i njohuri dhe që përdoret nga SAI-t homologe është programi "IDEA", të cilin KLSH e disponon, por nuk e përdor. Duhet të marrim dhe të përvetësojmë programe të tjera të kohës, si "Oracle" dhe ato që përdorin institucionet e Thesarit, doganat, tatimet dhe institucionet e tjera.

Do të fuqizojmë cilësinë e veprimtarisë audituese dhe të përgatitjes së raportimeve, përfshirë rekomandimet për zbatim, duke organizuar kontrollin e cilësisë brenda departamenteve të auditimit, si hallkë e parë në ngritjen e cilësisë së punës së stafit. Dijet e stafit për auditimin e performancës janë ende shumë të kufizuara dhe trajnimet e fundit janë zhvilluar përpara dy viteve. Do të realizojmë një planifikim shkencor të auditimit, si atij financiar, por sidomos të atij të performancës dhe për këtë do te bashkëpunojmë me partnerë nga brenda vendit, si Instituti i Kontabilistëve të Autorizuar - IEKA, por edhe me strukturat e BE-së, si SIGMA-s dhe ECA-s. Deri tani kemi marrë shumë pak ekspertizë nga jashtë institucionit dhe edhe kur e kemi marrë, kjo ka ndodhur në mënyrë sporadike.

Sfida jonë për vitet në vijim do të jetë partneriteti me Gjykatën Europiane të Audituesve. Do të synojmë të marrim pjesë në programet e tyre të auditimit për vendet që aspirojnë anëtarësimin në Bashkimin Evropian dhe që përfitojnë nga programet e asistencës së BE-së, përfshirë vendin tonë. Për thellimin e dijeve në auditimin e performancës, do të vazhdojmë partneritetin me institucione homologe që na kanë ndihmuar në të kaluaren, si Zyra Kombëtare e Auditimit e Britanisë së Madhe apo Gjykata Holandeze e Auditimit, por njëkohësisht duke kërkuar partneritet edhe nga institucioni homolog gjerman, suedez apo i vendeve të tjera të fuqishme të EUROSAI-t.

Ne do të nisim të kryejmë auditime të performancës për kreditë që strukturat publike qendrore dhe vendore marrin nga institucione dhe organizata të huaja, duke parë tendencën në rritje të këtyre financimeve për ekonominë dhe shërbimet publike të vendit. Vlerësimi i performancës së kredive kërkon dije të zgjeruara dhe specifike dhe për këtë do të kryejmë trajnimet e duhura.

Hapja e institucionit ndaj praktikave më të mira ndërkombëtare të auditimit të jashtëm, të përditësuara në çdo kongres të fundit të INTOSAI-t dhe respektimi i orientimeve të MSA-së të Shqipërisë me Bashkimin Evropian (Neni 90-të i MSA) kërkon vlerësim dhe studim maksimal nga ne. Kjo detyrë dhe sfidë bëhet akoma dhe më e rëndësishme për

fatet e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm të vendit, sidomos në ditët tona të përjetimit të krizës në Eurozonë, kur disiplina buxhetore dhe financiare e administrimit publik është bërë përparësi absolute për përballimin e pasojave të kësaj krize. Një nga rolet qëndrore në mbajtjen e kësaj disipline dhe në miradministrimin financiar publik e ka pikërisht Kontrolli i Lartë i Shtetit, si institucioni më i lartë i auditimit ekonomiko-financiar të vendit.

Për të qenë të aftë për ta kryer këtë detyrë, dua t'ju kujtoj shtatë parimet e jetës publike të përcaktuara nga Lordi Nolan, një nga reformatorët e administratës publike në Britaninë e Madhe për mbajtësit e pozicioneve zyrtare, dhe pikërisht:

1. Vetëmohimin;
2. Integritetin;
3. Objektivitetin;
4. Llogaridhënien;
5. Të qenit i hapur;
6. Ndershmërinë;
7. Mbështetja për Lidership.

Këto parime të vitit 1994 janë derivuar më tej nga shumë institucione kombëtare e ndërkombëtare auditimi, përfshirë INTOSAI-n dhe EUROSAI-n.

Ne vitit 2012 e filluam duke analizuar gjerësisht punën e departamenteve, arritjet, mosarritjet, dobësitë tonat dhe të partnerëve tanë e të institucioneve të tjera në Shqipëri. Gjatë kësaj jave takimesh me secilin prej jush në analizën vjetore të drejtorive përkatëse, kemi mundur të ridimensionojmë objektivat tona si auditues të lartë dhe të dimë se ç'kërkohet nga ne. Këtë vit i kemi kryer ndoshta për herë të parë këto takime krejtësisht të hapura. Përfaqësuesit e medias dhe të shoqërisë civile janë ftuar të qëndrojnë në ballafaqimet tona dhe të na njohin e kuptojnë deri në fund, me mundësitë, dobësitë dhe përparësitë tona, duke qenë kështu si në një libër të hapur. E kemi kërkuar dhe gjithnjë do ta kërkojmë këtë partneritet me median dhe shoqërinë civile, pse janë aleatët tanë më të vlefshëm për të ndërgjegjësuar publikun dhe nëpërmjet tij vendimmarrësit publikë për rolin dhe detyrat tona në të ardhmen. Programi i veprimtarisë i KLSH-së për vitin që sapo kemi hyrë, synon tejkalimin e mangësive të cituara më sipër dhe fuqizimin e mëtejshëm të rezultateve dhe arritjeve të derisotme të institucionit.

Në vijim po përqendrohem në disa nga drejtimet më kryesore, ku mendoj se duhet të intensifikojmë punën për shndërrimin e KLSH-së në një strukturë profesionale që përdor në mënyrë ekonomike burimet e saj dhe që funksionon me efiçiencë dhe

efektivitet, drejtime të cilat ia kam paraqitur në fund të vitit të kaluar Komisionit për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë dhe që janë thelluar më tej pas konsultimeve të deritanishme me ju. Më konkretisht:

1. Vizion koherent për KLSH-n, mbi bazën e eksperiencave më të mira të vendeve të BE-së dhe respektimit rigoroz të standardeve ndërkombëtare të auditimit të INTOSAI-t.

2. Thellim i realizimit të misionit të KLSH-së në luftën kundër korrupsionit dhe abuzimeve në administrimin e pronës publike. Ky obligim do të jetë përparësia jonë madhore gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimeve për këtë vit dhe në vijimësi.

3. Përmirësim i metodologjisë së auditimit, duke kthyer vëmendjen tek auditimi i performancës dhe auditimi i certifikimit të pasqyrave financiare, krahas rritjes së efiçiencës së auditimit financiar.

4. Realizim i sinergjizimit të politikave dhe veprimeve me strukturat e tjera shtetërore të së njëjtës fushë, si me Departamentin e Antikorrupsionit pranë Kryeministrisë, me Njësinë Qëndrore të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, me Drejtorinë e Inspektimit Financiar Publik pranë Ministrisë së Financave dhe, në veçanti me organet e Prokurorisë, duke ruajtur pavarësinë e KLSH-së si organi më i lartë i auditimit ekonomiko-financiar.

5. Komunikim dhe ndërveprim me Kuvendin, Qeverinë dhe partnerë të tjerë institucionalë, sidomos intensifikim i konsultimeve me Komisionin për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë për përafrimet strategjike të KLSH-së 2013-2018, në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimit ndaj Kuvendit, si një detyrim kushtetues. Brenda gjysmës së dytë të këtij viti, do të përgatisim Planin Afatmesëm Strategjik të Zhvillimit të institucionit për vitet 2013-2015.

6. Programim dhe konsolidim i bashkëpunimit me ekspertët universitarë dhe akademikë të auditimit të financave publike, si dhe me organizata profesionale të kontabilitetit dhe të fushave të tjera të ekonomisë. Unë sapo vij në këtë analizë pas një takimi të vyer me profesorin gjerman, ekspertin e financave publike Hans Ditrich Wenzel.

7. Intensifikimi i bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare të auditimit si INTOSAI dhe EUROSAI, me institucionet e larta të auditimit të BE-së, si SIGMA dhe Gjykata Europiane e Audituesve, me institucionet homologe të vendeve të BE-së dhe të rajonit dhe në veçanti me Zyrën e Audituesit të Përgjithshëm të Kosovës.

8. Zhvillim i burimeve njerëzore të KLSH-së në nivelin e parametrave të kërkuar nga institucionet ndërkombëtare të auditimit dhe në përputhje me sfidat integruese të vendit. Në këtë kontekst, do të përshtaten më mirë cilësitë profesionale dhe aftësitë e

secilit punonjës, me strukturën organike të institucionit, duke bashkuar apo krijuar struktura të reja (si për shembull Vendimi i ditëve të para në ushtrimin e detyrës sime për krijimin e Drejtorisë për Kërkimin, Zhvillimin dhe Kontrollin e Brendshëm), të afta të përballojnë sfidat e kohës dhe kërkesat e standardeve të miratuara nga INTOSAI. Do të ketë rritje cilësore dhe të numrit të audituesve të trajnuar brenda dhe jashtë institucionit, mbi bazën e listës së nevojave reale të stafit për ngritjen profesionale dhe të kërkesave të shtruara për institucionet supreme të kontrollit në Rezolutën e Kombeve të Bashkuara të datës 22 dhjetor 2011 dhe kërkesave në Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit të Shqipërisë me BE.

9. Ngritje e kapaciteteve të nevojshme për parandalimin dhe zbulimin e krimit ekonomik në teknologjinë e informacionit. Qeverisja elektronike po fiton gjithnjë e më shumë terren në administrimin e pasurisë publike dhe ofrimin e shërbimeve publike në Shqipëri dhe është e kuptueshme që përdorimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit të shoqërohet edhe me forma të reja të krimit ekonomik. Kjo është edhe një nga sfidat më të rëndësishme të KLSH-së në një periudhë afatshkurtër.

10. Përmirësim i transparencës në marrëdhëniet me publikun, nëpërmjet një partneriteti të gjerë me median dhe me organizatat jofitimprurëse të interesuara për bashkëpunim. Vend të veçantë do të zërë partneriteti i KLSH-së me shoqërinë civile të angazhuar në luftën për parandalimin e mashtrimit financiar dhe korrupsionit.

Në përgjigje të ndjeshmërisë dhe pritshmërisë së publikut, kam realizuar me shkresën zyrtare Nr. 92 datë 19.01.2012 dorëheqjen nga imuniteti si Kryetar i KLSH-së.

Në mbyllje dua të jap mesazhin se do të punojmë për një institucion të lartë auditimi që siguron një komunitet të angazhua,r që ka interes ta mbajë përgjegjëse qeverisjen qendrore dhe vendore. Për këtë do të fuqizojmë rolin e pazëvendësueshëm kushtetues të KLSH-së si institucioni kryesor ekonomiko-financiar, për ekonominë dhe shoqërinë tonë, me detyrë auditimin e miradministrimit të pronës publike dhe shëndoshjen e financave publike, duke i shërbyer me devotshmëri Kuvendit dhe duke rritur pjesëmarrjen e opinionit publik në realizimin e Buxhetit te Shtetit dhe të auditimit në tërësi.

Ju faleminderit për vëmendjen dhe angazhimin tuaj!

DITURIA NË AUDITIM, ARMË PËR MBROJTJEN E PAVARËSISË INSTITUCIONALE

Analiza e KLSH-së për 6-mujorin e parë të vitit 2012

Analiza për 6-mujorin e parë të vitit 2012 është zhvilluar më datat 30, 31 korrik dhe 1 gusht në ambientet e Hotel Vlora Internacional, në qytetin e Vlorës, në respekt të qytetit të pavarësisë dhe 100-vjetorit të shtetit të parë shqiptar.

"Ne do ta forcojmë pavarësinë tonë me një armë që askush s'do guxonte të na e merrte: diturinë mbi auditimin, që na pajis me ide ose mendime të pavarura dhe analizë"

Terence Nombembe, President i INTOSAI-t

Kontrolli i Lartë i Shtetit fiton tërësisht pavarësinë, profesionalizmin dhe efiçiencën në punën e tij, në rast se zbaton me rigorozitet korpusin kushtetues e ligjor në vend si dhe standardet e përditësuara të organizatës ndërkombëtare INTOSAI, e cila bashkon prej tashmë 60 vitesh institucione të auditimit më të lartë publik nga 191 vende të botës. Më 23 dhjetor 2011, në ditën e parë të punës, si Kryetar i KLSH punova me stafin e institucionit platformën drejtuese që kisha paraqitur në nëntor përpara Komisionit për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit. Themelin e kësaj platforme e përbën respektimi i standardeve të përditësuara të INTOSAI-t, standardeve ISSAI. Në vijimësi, në KLSH është kërkuar një respektim konkret i këtyre standardeve, jo thjesht me fjalë dhe deklarata për një realitet i cili duhet të shtrihet kapilar në çdo ditë pune të secilit auditues. Rezultatet e kësaj kërkese duken tani, kur ka kaluar më shumë se një gjysmë viti nga nisja e zbatimit të këtij programi koherent për institucionin.

Çfarë ka arritur KLSH në periudhën janar-qershor të këtij viti?

Së pari, treguesit e performancës së institucionit flasin për një rritje cilësore në raport me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Gjatë periudhës janar-qershor 2012, KLSH, në auditimet e zhvilluara në institucionet qendrore dhe vendore mbi veprimtaritë disavjeçare të tyre:

1. ka zbuluar një dëm ekonomik ndaj Shtetit në masën 3,664,788,000 Lekë, ose 36,6 milionë dollarë;
2. ka konstatuar shkelje financiare me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituara në shumën 1,447,104,000 Lekë;

3. dëmi ekonomik dhe ndikimi negativ financiar i zbuluar nga KLSH arrijnë në shumën totale 5,111,892,000 Lekë, ose rreth 50 milionë dollarë, ku përfshihen edhe institucionet fiskale, shoqëritë tregtare ku Shteti ka mbi 50 përqind të aksioneve, etj.;
4. ka dhënë 2,113 rekomandime ose 29 përqind më shumë se e njëjta periudhë një vit më parë;
5. ka rekomanduar 489 masa disiplinore, ose 86 përqind më shumë se periudha janar-qershor 2011;
6. ka rekomanduar 1,137 masa organizative, ose 24 përqind më shumë;
7. ka kryer 18 kallëzime penale për konsumimin e veprës penale të shpërdorimit të detyrës dhe shkeljes së barazisë në tendera publike, shifër kjo afërsisht e barabartë me numrin e kallëzimeve të bëra në tre vitet e fundit 2009-2011, të marra së bashku;
8. institucioni ka arritur një stad të ri të reflektimit ndaj publikut. Vetëm letra nga populli janë trajtuar 165 dhe janë shqyrtuar 127 si kompetencë e KLSH (73 përfunduar, 54 në proces);
9. KLSH ka rritur transparencën dhe bashkëpunimin me shoqërinë civile. Artikujt në median e shkruar dhe sekuencat filmike për gjashtëmujorin e parë të këtij viti janë si numër të barabarta me artikujt dhe sekuencat e gjithë vitit të kaluar;
10. Nga 2.1 ditë trajnimi në vit që kishte çdo audites i KLSH gjatë vitit të kaluar, deri tani ka 6 ditë trajnime për audituesit e vjetër dhe për nëpunësit e rinj 13 ditë trajnime në 6 muaj.

Së dyti, është rritur përgjegjësia, transparenca, thellësia dhe profesionalizmi i auditimeve të kryera.

Gjetjet e auditimeve të zhvilluara gjatë vitit të kaluar dhe që përfunduan si raportim në këtë vit, apo të filluara këtë vit, janë parë nga institucioni në këndvështrimin e një përgjegjësie më të madhe ndaj interesave të miradministrimit të fondeve dhe pronës publike dhe pritshmërisë së qytetarëve dhe taksapaguesve shqiptar. Raportimet e KLSH për mangësitë në performancën dhe shkeljet e konstatuara në institucione të tilla si Porti Detar Vlorë, Drejtoria e Përgjithshme e Hekurudhave, Drejtoria Qendrore dhe disa drejtori rajonale të ALUIZNI-t, në KESH, OST, në METE për koncesionet në fushën e kromit, bakrit dhe hidroenergjitikës, në disa ministri për përdorimin e shpenzimeve buxhetore për spote publicitare, festa dhe ngjarje kulturore e solemne, në disa bashki apo komuna të vendit, etj., kanë sensibilizuar opinionin publik dhe goditur antikulturën e mosndëshkueshmërisë së zyrtarëve të mesëm e të lartë të Shtetit, dukuri

kjo shumë e dëmshme që po përhapet në vend. Rekomandimet e propozuara nga KLSH kanë rritur frymën e kërkesës së llogarisë ndaj performancës së ulët të institucioneve publike dhe pritshmërive të qytetarëve për një luftë më efektive ndaj korrupsionit. Tematikat e auditimeve të përzgjedhura këtë vit mbulojnë institucionet dhe aktivitetet kryesore të Shtetit. E veçanta e tyre është përzgjedhja mbi bazën e metodës së analizës së riskut, në veçanti të përpunuar nga standardet ISSAI 1315 për "*Identifikimin e risqeve të keqdeklarimeve materiale"* dhe ISSAI 1330 për *"Përgjigjet e audituesit ndaj risqeve të vlerësuara"*. Një analizë më e thelluar e vlerësimit të riskut i ka dhënë dhe do t'i japë në vijimësi mundësi KLSH-së të përqendrohet në agjencitë dhe ndërmarrjet publike me një ekspozim më të lartë ndaj dukurive abuzive dhe korruptive, duke rritur forcën goditëse dhe parandaluese të institucionit ndaj korrupsionit.

Në tërësi, institucioni ka punuar mirë dhe ka patur ritëm në kryerjen e auditimeve, edhe pse jo të gjithë audituesit kanë patur intensitet të plotë pune dhe kanë marrë pjesë në më shumë se një auditim gjatë kësaj kohe. Janë përfunduar gjithsej 91 auditime, ndërsa 14 janë përfunduar por janë ende pa u evaduar dhe 21 të tjera janë në proces, nga 154 auditime të parashikuara për gjithë vitin. KLSH ka dhënë 25 propozime për ndryshime apo përmirësime në legjislacion ose 10 përqind më pak se sa e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Ky rezultat duhet të na bëjë të reflektojmë dhe dëshmon se ende mungon në shumicën e ekipeve tona të auditimit këndvështrimi i plotë për institucionin që auditojnë, për lidhjet e tij me strukturat superiore ose vartëse dhe për pozicionin që ka dhe rolin që luan në administratën shtetërore. Në auditimet tona ende shohin më tepër përputhshmërinë me ligjet dhe rregulloret përkatëse të veprimtarisë së departamenteve dhe sektorëve të veçantë të entit që auditojnë, se sa funksionimin e tij në sistem dhe rezultatet në bazë të këtij funksionimi.

Në programimin efikas të auditimeve për këtë vit, kanë ndihmuar analizat e thelluara për veprimtarinë e institucionit përgjatë vitit 2011 nga secili departament auditimi, drejtori dhe në nivel institucioni, që KLSH zhvilloi në janar 2012. Këto analiza u kërkua të zhvilloheshin nën prizmin e problematikës së mprehtë të hasur nga çdo departament apo drejtori e KLSH-së, me pjesëmarrjen e të gjithë punonjësve. Ndoshta për herë të parë, analizat në nivel departamenti u realizuan në praninë e mediave dhe të përfaqësuesve të shoqërisë civile. Ky proces ndihmoi stafin e institucionit të përcaktonte më qartë problemet dhe rrugët për zgjidhjen e tyre.

Në ndihmë të audituesve dhe për informim të plotë e transparent të publikut, institucioni ka përgatitur edicionin e parë të kolanës "Botime KLSH", me titull "KLSH: Raporti Vjetor 2011". Botimi përmban informacion të detajuar për auditimet e kryera gjatë vitit 2011, si dhe analizat e zgjeruara për performancën e vitit 2011, me raportime

dhe diskutime të hapura. Gjetjet dhe sugjerimet nga këto raportime dhe diskutime kanë përbërë bazën për planifikimin e auditimeve të institucionit gjatë këtij viti.

Një ndihmë për audituesve, për të parë të reflektuar punën e tyre të deritanishme dhe orientimet për përmirësim ka qenë edhe përgatitja dhe dërgimi në Kuvend i raportit *"Mbi veprimtarinë e KLSH të vitit 2011",* në mars 2012. Raporti, krahas përshkrimit të performancës së institucionit, ishte një përgjigje ndaj rekomandimeve shumë të vlefshme të Kuvendit në Rezolutën e tij të datës 2 qershor 2011 për aktivitetin e institucionit.

Rezultatet e KLSH u panë në këndvështrimin e zbatimit të këtyre rekomandimeve, por edhe në këndvështrimin kritik të një performance të dobët të realizuar nga institucioni, sidomos në luftën kundër korrupsionit (shumë pak kallëzime penale për në Prokurori), në auditimet e performancës dhe në trajnimin e audituesve për fitimin e shprehive të auditimit modern. Kjo, në bazë të orientimeve të Nenit 17 të ISSAI 1, pika 1në të cilën përcaktohet se: "*raportet (e institucioneve të larta të kontrollit) duhet të prezantojnë faktet dhe vlerësimin e tyre në një mënyrë objektive dhe të qartë"*[93].

Sërish, në ndihmë të audituesve dhe për informim të plotë e transparent të publikut, institucioni ka përgatitur edicionin e dytë te kolanës "*Botime KLSH",* me titull *"KLSH dhe Kuvendi*". Botimi përmban informacion të detajuar për prezantimin e Raportit Vjetor të KLSH-së 2011 në Komisionin për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit dhe në seancën plenare të Kuvendit. Ai i sjell të plota diskutimet e deputetëve në Komision dhe në seancë plenare. Shumica e diskutime janë me shumë vlera, që e orientojnë drejt audituesin. Detyrimi për të publikuar eksperiencat e fituara, krahas detyrimit kushtetues të KLSH-së për t'i raportuar Kuvendit dhe publikut, buron dhe nga standardi ISSAI 20 i standardeve të INTOSAI-t, i cili rendit ndër Parimet Themelore të punës së një institucioni të auditimit të lartë (SAI*):" SAI-t komunikojnë në kohë dhe gjerësisht për aktivitetet e tyre dhe rezultatet e auditimeve nëpërmjet medias, publikimeve të ndryshme, faqeve të internetit dhe mjeteve të tjera të komunikimit masiv* [94]**"** .

Në rritjen e cilësisë së auditimit ka ndikuar edhe rishikimi i rregullores së organizimit dhe funksionimit të KLSH-së, të përfunduar në prill të këtij viti. Ajo u harmonizua më së miri me dispozitat ligjore në fuqi, me ndryshimet në strukturën e KLSH-së dhe në pritje të amendamenteve të ligjit integral të institucionit. Rregullorja e përditësuar u mundësoi audituesve dokumente auditimi më koherente dhe më të plota, lehtësoi komunikimin vertikal dhe horizontal mes departamenteve, drejtorive dhe sektorëve, si

[93] Deklarata e Limës, faqe 12.

[94] ISSAI 20, Parimi

dhe rriti intensitetin e komunikimit dhe ndërveprimit mes këtyre strukturave. Ajo unifikoi imazhin e institucionit në korrespondencën e jashtme dhe të brendshme të tij. Rregullorja është përgatitur duke respektuar modelin e rregullores së Gjykatës Europiane të Audituesve, institucionit që auditon buxhetin dhe zbatimin e fondeve të BE-së.

Së treti, është thelluar realizimi i misionit të KLSH-së në luftë kundër korrupsionit dhe abuzimeve në administrimin e fondeve dhe pronës publike. Në bazë të Deklaratës së Simpoziumit të 20-të të INTOSAI-t dhe Kombeve të Bashkuara, të zhvilluar në Vjenë në shkurt 2009 me temë "*INTOSAI partner aktiv në rrjetin ndërkombëtar antikorrupsion",* konkluzionet e të cilit ishin se "*korrupsioni është një problem mbetës dhe global që kërcënon financat publike, rendin ligjor dhe prosperitetin social"* dhe që *"riafirmojmë me forcë Deklaratën e Meksikos që thekson rëndësinë e institucioneve supreme të auditimit të pavarura dhe profesionale si parakusht themelor për një auditim efektiv ndaj qeverisjes dhe për një parandalim efektiv të mashtrimit financiar, korrupsionit dhe keqmenaxhimit"*, si dhe të Strategjisë Ndërsektoriale të Parandalimit, Luftës kundër Korrupsionit dhe Qeverisjes Transparente 2008-2013, e cila thekson *"përcaktimin strategjik të mjeteve të duhura ligjore e institucionale për të siguruar zbulimin e efektshëm të personave të dyshuar të përfshirë për vepra korruptive dhe garantuar përgjegjësinë e autorëve të veprimeve korruptive* [95]*"*.

Duke përcjellë konstatimin dhe shqetësimin e INTOSAI-t, si dhe orientimin e Qeverise, duke konsideruar pritshmëritë e qytetareve dhe të opinionit publik shqiptar, KLSH realizoi aktivitetet e mëposhtme:

1) Në shkurt 2012 nënshkroi Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, e cila ka shumë rëndësi, për faktin se nëse të dyja strukturat publike bashkëpunojnë dhe ndërveprojnë në mënyrë të institucionalizuar, ato rrisin efiçiencën e masave të propozuara kundër administratorëve publikë të korruptuar apo në konflikt interesi, dhe nga ana tjetër, zgjerojnë spektrin e kontrolleve dhe investigimeve. Në bazë të Marrëveshjes, KLSH e informon në kohën e duhur dhe tërësisht Inspektoratin e Lartë për rastet e prokurimeve publike dhe kontratave administrative kur dyshohet se janë nxjerrë në kushtet e konfliktit të interesit, ndërsa Inspektorati i Lartë, sa herë konstaton praktika abuzive, korruptive apo arbitrare nga ana e zyrtarëve të cilët janë subjekt i ligjit të tij, informon KLSH-n të ushtrojë auditimet e tij. Marrëveshja po funksionon. Lista e funksionarëve të kapur me shkelje financiare e procedurale i shkon në kohe reale ILDKP nga KLSH dhe i jep indicie të mjaftueshme këtij institucioni për të hetuar dhe për të ngarkuar me

[95] Kapitulli i Dytë i Strategjisë, miratuar me VKM Nr. 1561 dt. 03.10.2008, fq 3.

përgjegjësi penale edhe personat e lidhur me zyrtarët deklarues të pasurisë. Marrëveshja realisht krijon lehtësira të mëdha për shkëmbimin e informacionit në një kohë shumë të shpejtë, duke siguruar efektivitet të lartë në punën e KLSH-së dhe ILDKP-s dhe forcë goditëse më të madhe ndaj korrupsionit dhe zyrtareve të korruptuar. Institucioni i dërgon rregullisht informacion ILDKP.

2) Në mars 2012, KLSH nënshkroi Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Autoritetin e Konkurrencës, për rastet kur gjatë auditimeve të tij konstatohen praktika të administratës publike, ose kontrata administrative si prokurime, ankande, koncesione etj., që mund të ndikojnë negativisht në shkallën e konkurrencës. Ndërsa Autoriteti i Konkurrencës njofton institucionin në përfundim të kontrolleve apo hetimeve të tij, në rast zbulimi të praktikave abuzive apo arbitrare që cenojnë interesat pasurore të shtetit. Në maj, Autoriteti i Konkurrencës, në koordinim me Agjencinë e Prokurimeve Publike zhvilloi një seminar trajnues për Prokurimet Publike Elektronike, ku u ftuan edhe auditues të KLSH-së, të cilët fituan një eksperience të vyer.

3) Në prill 2012, KLSH nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me 6 nga shoqatat më aktive të shoqërisë civile që luftojnë korrupsionin dhe kërkojnë rritjen e transparencës së institucioneve publike të vendit, dhe pikërisht me Transparency Internacional në Shqipëri, me Lëvizjen Alternativa Civile, me Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë, me Institutin e Studimeve Bashkëkohore, me Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim dhe me Lëvizjen Evropiane Shqipëri. Në bazë të marrëveshjeve, institucioni dhe shoqatat marrin përsipër të hartojnë projekte të përbashkëta për luftën kundër korrupsionit dhe rritjen e transparencës të institucioneve shtetërore. Shoqatat do ta ndihmojnë me ekspertizë KLSH-n gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimeve. Sikurse thekson me forcë pika 2 e Nenit 11 të Deklaratës së Limës, "*Në masën që gjetjet e institucionit suprem të auditimit nuk dalin si gjykime ligjërisht të vlefshme dhe të zbatueshme, ky institucion duhet të fuqizohet të takohet me autoritetin shtetëror përgjegjës për marrjen e masave të nevojshme dhe t'i kërkojë këtij partneri të pranojë përgjegjësinë* [96]". Është kjo sjellje dhe kjo përgjegjësi që e shtyn KLSH te kërkojë tek të gjithë institucionet e tjera shtetërore dhe civile partneritet në luftën kundër korrupsionit.
4) Në qershor 2012, KLSH nënshkroi një Marrëveshje Bashkëpunimi me Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm. Më 20 korrik 2012, 18 juriste dhe auditues të KLSH morën pjesë në një seminar trajnimi me specialistë të Prokurorisë. Si KLSH dhe

[96] ISSAI 1, faqe 8

Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm ranë dakord të përgatisin një manual për të përmirësuar cilësinë e kallëzimeve penale dhe për të zhdërvjelltësuar procedurat e trajtimit të tyre nga Prokuroria.

KLSH, sikurse është agjent i Kuvendit për miradministrimin e pronës dhe financave publike, është gati të shërbejë edhe si agjent i Prokurorisë për denoncimin e krimit ekonomik me pronën shtetërore. Ne na e mundësojnë këtë pozicion në radhë të parë standardet ndërkombëtare të auditimit të INTOSAI-t dhe pikërisht standardi 1240, i cili flet për përgjegjësitë e audituesit në lidhje me korrupsionin dhe mashtrimin financiar në auditimet e deklaratave financiare. Po ashtu, Kongresi i fundit i INTOSAI-t në Johanesburg të Afrikës së Jugut në nëntor 2010, në rezolutën e tij ka theksuar se *"Institucionet e auditimit më të lartë publik duhet të çojnë më tej luftën kundër korrupsionit"*.

Në raport me institucionet brenda vendit, si një ndihmë e strategjisë së tij institucionale është edhe Strategjia Anti-Korrupsion 2008-2013 e qeverisë Berisha, e cila kërkon një bashkëpunim më të ngushtë të institucioneve kryesore që e luftojnë korrupsionin, të bazuar në angazhime të përbashkëta të institucionalizuar dhe pikërisht: *"Shkëmbimin e informacionit, jo vetëm ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit, por të çdo organi shtetëror që luan rol dhe ka përgjegjësi në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, i cili synon shkëmbimin e informacionit jo si pjesë e detyrimit dhe përgjegjësisë ligjore e institucionale të zakonshme, por mbi baza funksionale, proaktive dhe me periodicitet më të shpejtë* [97] *"*

Në këtë kuadër, KLSH i dërgon kallëzimet e tij penale në Prokurori mbi bazën e Nenit 281 të Kodit të Procedurës Penale, i cili i mundëson nëpunësit publik ta denoncojë krimin ekonomik. Këtë krim e argumentojmë në bazë të Nenit 248 të Kodit Penal për rastet e shpërdorimit të detyrës si funksionar publik dhe në bazë të Nenit 258 të Kodit Penal për rastet e shkeljes së barazisë të pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike.

KLSH nuk e mendon dhe as nuk do të ndërhyjë në punët e Prokurorisë, por kërkon që hapi i parë, mbas vlerësimit të cilësisë së kallëzimit të tij, të jetë pezullimi nga ushtrimi i së drejtës publike i nëpunësit publik të denoncuar prej Kodit Penal, në bazë të Nenit 22, pika 2 a të Ligjit për Statusin e Nëpunësit Civil. Ka ndodhur në të kaluarën që KLSH-n ka paditur funksionarë të shtetit në Prokurori dhe institucione të ndryshme i kanë emëruar më vonë drejtues këta të paditur. Kur garantohet cilësia e kallëzimit të tij, mund të shikohet mundësia nga organi i Akuzës që për personat e denoncuar nga KLSH të kërkohet masa e arrestit shtëpiak, atëherë kur për këto raste e parashikon ligji. Kjo, për vetë faktin se kur personi lihet në gjendje të lirë dhe akoma më tepër, vazhdon detyrën në kushtet e mëparshme, ai ose ajo mund të dëmtojë provat.

[97] Strategjia Ndërsektoriale e Parandalimit, Luftës kundër Korrupsionit dhe Qeverisjes Transparente, 2008-2013, f. 16.

Lufta kundër korrupsionit dhe sidomos efekti parandalues i saj ka një anë morale shumë të rëndësishme. Ndëshkimi moral i rasteve të dyshuara që përmbajnë indicie të mjaftueshme rrit ndjeshëm forcën parandaluese ndaj korrupsionit. Është krijuar tashmë opinioni gati si bindje se zyrtarët e lartë dhe ata të mesëm të Shtetit i kalojnë pa u lagur situatat abuzive me interesat dhe pronën publike dhe këtë bindje KLSH ka mundësinë ta përmbysë. Duhet të luftojmë anti-kulturën e pandëshkueshmërisë që po instalohet në administratën tonë. Ajo i bën institucionet shtetërore që ta pranojnë abuzimin dhe korrupsionin si një e keqe e domosdoshme, duke ulur kundërveprimin e tyre.

KLSH do të përpiqet të jetë efektiv në përgatitjen e kallëzimeve penale. Juristë dhe audituesë me përvojë të institucionit kanë kryer një seminar trajnues të përbashkët me prokurorët e Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm më datën 20 korrik. KLSH do të intensifikojë kontaktet dhe aktivitetet e përbashkëta me këtë Zyrë, për të rritur aftësinë e juristëve dhe audituesve të tij për identifikimin e saktë të shkeljeve që përbëjnë vepër penale në fushën e administrimit të fondeve publike, administrimit të pronës publike dhe privatizimit të saj. Do të marrë masa për të qenë sa më objektiv dhe profesional në rastet e kallëzimeve të tij penale, por nga Prokuroria ka kërkuar që procesi i hetimeve paraprake, i ushtrimit të ndjekjes penale si dhe i ngritjes dhe përfaqësimit të akuzës të bëhet brenda një afati kohor më të shkurtër, për arsye se shpesh zgjatja e hetimit ul ndjeshëm vlerën reale të denoncimit të kryer.

Së katërti, është përmirësuar metodologjia e auditimit, duke u përpjekur për të kthyer vëmendjen në auditimin e performancës, krahas rritjes së efiçiencës së auditimit financiar. Ky objektiv paraqitet afatgjatë, por në periudhën janar-qershor 2012 përmirësimi metodologjik u pasqyrua në aktivitetet e mëposhtme:

a) U përkthyen në shqip parimet kryesore të auditimit të performancës (ISSAI 3100), si dhe udhëzimi përkatës. Këto materiale bazë ndihmojnë efektivisht audituesit e performancës në KLSH;

b) U hartuan formularët standardë për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare të njësive të audituara dhe krijimin e lehtësive për përdorimin e tyre;

c) U përmirësuan (nëpërmjet miratimit të Rregullores së përditësuar) përmbajtja dhe forma e dokumenteve të auditimit, duke filluar nga shkresa për nisjen e tij deri tek Projekt-Raporti dhe Raporti përfundimtar i auditimit;

d) U vendos në çdo program auditimi vlerësimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të njësisë që auditohet;

e) Nisi puna për përditësimin e manualeve të auditimit financiar, të auditimit të performancës dhe të standardeve të brendshme të institucionit, bazuar në Nenin 13,

pika 2 e ISSAI 1*: "Është në dobi të Institucionit më të Lartë të Auditimit që të përgatisë manuale auditimi në ndihmë të audituesve të vet* [98]*"* , punë e cila po vijon me intensitet.

Së pesti, është përmirësuar struktura e KLSH, për t'ju përgjigjur kërkesave të kohës dhe rritjes cilësore të veprimtarisë audituese. Për të realizuar këtë objektiv, institucioni:

a) krijoi sektorin e Auditimit të Buxhetit Qendror në Departamentin e Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm;

b) krijoi Departamentin e ri të Kërkimit Shkencor, Zhvillimit dhe Teknologjisë së Informacionit, për të nxitur asimilimin e njohurive bashkohore mbi auditimin publik, rritjen efektive të kapaciteteve të audituesve të institucionit, përgatitjen e manualeve, broshurave dhe dokumentacionit shtesë informativ ndihmues për audituesit, zhvillimin e mendimit profesional në KLSH dhe zgjerimin e qasjes së punës së institucionit me projekte zhvillimore;

c) plotësoi çdo Departament auditimi me nga 2 juristë të përgatitur;

d) rekrutoi staf të ri mbi bazën e Standardeve ISSAI, *"Në rekrutimin e stafit për Institucionet më të Larta të Auditimit, vëmendja e duhur i duhet kushtuar njohurive mbi mesataren dhe eksperiencës profesionale të kandidatëve* [99]*"*. Ky rekrutim në KLSH u zhvillua me procedura transparente dhe testim paraprak të aftësive me shkrim dhe me intervistë verbale me kandidatët për vendet vakante të punës, të shpallura për një kohë të arsyeshme në website të KLSH dhe në gazetat me qarkullim kombëtar.

Stafi i ri është në provë dhe nuk do të ketë asnjë tolerim, nëse nuk përvetëson standardet e INTOSAI-t. KLSH do të forcojë programin e trajnimeve në institucion, duke krijuar Sektorin e Trajnimeve, një strukturë brenda Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Metodologjisë, e cila bëhet operative në muajin shtator 2012.

Së gjashti, KLSH ka nisur realizimin e sinergjizimit të politikave dhe veprimeve me strukturat e tjera shtetërore të së njëjtës fushë apo të ngjashme në vend. Duke u bazuar në Standardin ISSAI, 9150 të INTOSAI-t*:"Koordinimi dhe bashkëpunimi mes Institucioneve të Auditimit Suprem dhe audituesve të brendshëm në sektorin publik"*, në maj 2012 institucioni lidhi një marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Financave, për koordinimin e punës me Njësinë Qendrore të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm dhe me Drejtorinë e Inspektimit Financiar Publik në këtë ministri. Strukturat e Njësisë Qendrore të Harmonizimit po bashkëpunojnë me KLSH-n dhe kanë kryer deri tani disa seminare

[98] Deklarata e Limës, faqe 9

[99] Deklarata e Limës, faqe 9

njohës dhe trajnues për audituesit e institucionit. Marrëveshja parashikon komunikimin e ndërsjelltë të planeve dhe strategjive të auditimit, dokumentimin e proceseve operacionale dhe sistemeve të enteve të audituara, zhvillimin dhe kryerjen e procedurave të koordinuara të auditimit; si dhe investigimin e përbashkët të rasteve të dyshuara si mashtrim financiar apo korrupsion. Në 24 korrik, drejtuesit e Njësisë Qendrore të Harmonizimit në Ministrinë e Financave, të Drejtorisë së Menaxhimit Financiar dhe të Inspektimit Financiar prezantuan strukturat e tyre dhe lidhjet me auditimin e jashtëm suprem, në një seminar nismëtar të organizuar nga SIGMA në Tiranë, në kuadrin e Programit të saj për Mbështetjen e KLSH-së. Këto prezantime i ndihmuan mbi 50 auditues të KLSH të pranishëm në seminar, për të identifikuar më qartë drejtimet e bashkëpunimit midis auditimit të jashtëm dhe auditimit te brendshëm, për shmangien e dublimeve dhe uljen e kostos së auditimit.

Së shtati, KLSH ka rritur ndjeshëm kapacitetet e stafit të tij në kryerjen e auditimeve cilësore dhe efiçiente.

Në bazë të nenit 14, pika 1 e ISSAI 1, *"Anëtarët e stafit auditues të SAI-t duhet të kenë kualifikimet dhe integritetin moral të kërkuar për të plotësuar detyrat e tyre*[100]*"*. Për ne ka qenë e qartë se rritja e kapaciteteve të KLSH-së në auditim është pavarësia reale e tij. Kështu, sa më i pavarur të jetë ky institucion jetik për ruajtjen e parasë publike, aq më mirë luftohet korrupsioni dhe parandalohet ai.

Për të përmbushur këtë objektiv:

- Institucioni nxori një Urdhër që numri i ditëve të trajnimit të audituesve dhe punonjësve me përvojë të shkonte në 10 ditë në vit(deri në fund të 2011-ës ishte 2.1 ditë trajnimi, ndër më të ulëtit në rajon si tregues), ndërsa për personelin e ri në 25 ditë trajnimi në vit;
- Intensifikuam programin e trajnimeve të brendshme në KLSH, sipas një plani temash auditimi të përcaktuar mirë dhe të organizuar nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe e Metodologjisë me ekspertë tanë. KLSH ka shfrytëzuar tërësisht mundësitë e krijuara nga trajnues të tjerë publikë dhe privatë në vend, si dhe jashtë vendit, si Instituti i Trajnimeve të Administratës Publike (ITAP) në vend, Autoriteti i Konkurrencës i Shqipërisë, por edhe Qendra për Ekselencë në Financë(CEF) në Slloveni, Seminari i SIGMA për sigurimin e cilësisë në Pragë, Rrjeti i SAI-t të vendeve kandidate apo aspirante për në BE, i mbështetur nga SIGMA dhe Gjykata Evropiane e Audituesve, rrjeti PEM-PAL (inicialet në anglisht për Menaxhimi i Shpenzimeve Publike dhe i Mësimit të Asistuar nga Kolegë), etj. Si rezultat, gjatë

[100] Deklarata e Limës, faqe 9

periudhës janar-qershor 2012, treguesi i ditëve të trajnimit për audituesi praktikisht **është shtatëfishuar në krahasim me të njëjtën periudhë një vit më parë, në mesatarisht 6.2 ditë trajnimi në vit për punonjësit me përvojë dhe 12.7 ditë trajnimi për audituesit dhe specialistët e rinj të KLSH**.

- KLSH ka kryer në vijimësi gjatë gjashtëmujorit të parë testime me shkrim për vlerësimin e aftësive profesionale të kryeaudituesve dhe të audituesve të tij. Tezat janë përgatitur nga komisione *ad-hoc* vlerësimi, në përbërje të të cilëve janë drejtuesit e lartë të institucionit dhe audituesit më me përvojë dhe më të trajnuar ndër vite. Për të gjithë audituesit që duan të rriten në gradë dhe karrierë, mjafton një kërkesë e tyre dhe ata kalojnë në sprovën e testimit për gradën që kanë kërkuar;
- Sikurse është përmendur më lart, mbi 50 audituesi të KLSH-së, ose gati gjysma e kapaciteteve tona audituese u trajnuan në datat 24-25 korrik në një seminar dyditor të organizuar dhe me ekspertë të SIGMA-s. Ata u njohën me zhvillimet e fundit në strukturat e auditimit të brendshëm, menaxhimit dhe inspektimit financiar, me përvojën nga autoriteti portugez i auditimit, me përvojën e pasur të Gjykatës holandeze të Auditimit në kryerjen e auditimeve të performancës, si dhe me konceptet dhe qasjet kryesore në auditimin financiar, të përputhshmërisë dhe të IT. Ky aktivitet ishte preludi i një sërë trajnimesh intensive njëjavore që do të zhvillohen me ekspertë të SIGMA-s gjatë muajve shtator, tetor dhe dhjetor të këtij viti;
- Po ashtu, në datat 2-5 korrik 14 audituesi të KLSH-së u trajnuan për një javë në Varshavë, pranë Zyrës Kombëtare të Auditimit (NIK) të Polonisë për auditimin e performancës.
- Rritjes së kapaciteteve audituese i shërben pa dyshim edhe revista shkencore në çdo katër muaj "Audituesi Publik", numri i parë i së cilës është gati dhe pret vetëm përshëndetjet dhe opinionet e personaliteteve të auditimit suprem publik në Evropë, si z. Jacek Jezierski, Presidenti i NIK-ut polak dhe z. Joop Vrolijk, ekspert i lartë i SIGMA-s për financat publike. Revista po realizohet në bashkëpunim me akademikë të njohur të fushës, me lëvrues të shkencës së financave publike dhe jurisprudencës në vendin tonë dhe me ekspertë të auditimit në institucione qendrore publike. Ajo do të jetë një forum i mendimit më të përparuar akademik dhe shkencor të vendit në auditimin publik, por edhe një arenë e debatit të shëndetshëm profesional për zgjedhjet e strukturave drejtuese dhe përqasjet e auditimeve të brendshme dhe të jashtme që kryhen në auditimin publik shqiptar. Revista do të promovojë auditimin e performancës, të integritetit dhe të përputhshmërisë, që konsiderohen si ndër më të rëndësishmet sot në botë në auditimin publik. Krahas eksperiencave nga vendi, ajo do të shërbejë edhe si burim informacioni dhe platformë e ideve dhe praktikave të reja të auditimit më të lartë, që

lançojnë periodikisht organizata si INTOSAI dhe EUROSAI, por edhe SAI të veçanta që ndodhen në pararojë të mendimit shkencor.

Së treti, institucioni ka intensifikuar bashkëpunimin me organizatat ndërkombëtare si INTOSAI dhe EUROSAI, me programe dhe struktura të BE-së, si SIGMA-s dhe Gjykata Europiane e Audituesve, me institucionet homologe të auditimit të vendeve të BE-së, të vendeve të rajonit, me Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës dhe me organizata të tjera ndërkombëtare.

Duke u bazuar në moton e INTOSAI-t *"Eksperienca e përbashkët u shërben të gjithëve"*, por edhe në Nenin 15, pikat 1 dhe 3 të ISSAI 1, dhe përkatësisht *"Shkëmbimi ndërkombëtar i ideve, eksperiencës dhe i informacionit shërben si një mjet i mirë ndihmues për institucionet supreme të auditimit për të përmbushur detyrat e tyre"* dhe *"Është e dëshirueshme të shtohen dhe intensifikohen këto përpjekje dhe aktivitete (bashkëpunimi ndërkombëtar). Zhvillimi i një terminologjie uniforme të auditimit të qeverisjes, bazuar në ligje krahasuese, është e një rëndësie parësore* [101]*"* institucioni i KLSH-së :

a) Nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi me Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës në shkurt 2012. Kjo marrëveshje ishte e veçantë, jo vetëm pse lidhi dy institucione shqiptare të auditimit suprem, por sepse në krye të Zyrës kosovare të Audituesit të Përgjithshëm qëndron një nga personalitetet më të larta të auditimit publik në Evropë, zoti Lars Lage Olofsson. Marrëveshja parashikon trajnime dhe shkëmbim eksperience mes të dyja institucioneve, si dhe unifikimin e terminologjisë së auditimit në gjuhën shqipe. Janë përkthyer rreth 120 faqe të Shënimeve të Praktikës së standardeve të fushës ISSAI për auditimin financiar, të cilat do të orientojnë më mirë audituesit e të dyja vendeve në respektimin e standardeve ndërkombëtare të INTOSAI gjatë punës së tyre konkrete. Në datat 10-13 korrik 2012 drejtues dhe auditues të KLSH morën pjesë në konferencën vjetore të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës në Pejë dhe në një seminar përmbyllës me konsulencë nga SAI suedez, i zhvilluar në Prishtinë, duke fituar eksperiencë për organizimin e aktiviteteve të tilla dhe në Shqipëri;

b) Në prill 2012 KLSH nënshkroi një Marrëveshje Bashkëpunimi me Gjykatën e Auditimit të Sllovenisë. Kjo marrëveshje u përgatit në bazë të parimeve të përbashkëta të respektit, besimit dhe bashkëpunimit dypalësh të Organizatës së INTOSAI-t, si edhe të Organizatës Europiane të Institucioneve të Auditimit Suprem, EUROSAI. Ajo përfshin shkëmbimin e mësimeve të nxjerra, sikundër trajnimin e audituesve dhe këshillimin mbi metodat e auditimit. Dokumenti i

[101] Deklarata e Limës, faqe 9

nënshkruar është shumë i rëndësishëm për KLSH-në. Institucioni Suprem i Auditimit në Slloveni është modern, një ndër institucionet më profesionale në Evropë. Nëpërmjet mbështetjes së parashikuar në marrëveshje, KLSH dhe Gjykata e Auditimit e Sllovenisë do të shkëmbejnë eksperiencë në auditimin financiar, atë të përputhshmërisë dhe të performancës, si dhe në certifikimin e deklaratave financiare. Po ashtu do të eksplorojmë mundësitë për të përgatitur projekte të përbashkëta, për të forcuar kapacitetet e KLSH në planifikimin strategjik dhe përdorimin e teknikave të auditimit modern.

c) Në maj 2012, KLSH nënshkroi marrëveshjen e bashkëpunimit me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Polonisë (NIK). Kjo zyrë është një institucion suprem auditimi mjaft i zhvilluar dhe i madh, me mbi 1700 auditues. Presidenti i saj, z. Jacek Jezierski përfaqëson ndër figurat më aktive të INTOSAI-t dhe sidomos të EUROSAI-t, pasi deri në fund të vitit 2011 ka qenë gjithashtu presidenti i radhës i organizatës evropiane të institucioneve të auditimit suprem. Sikurse u përmend më lart, në javën e parë të korrikut 2012, 14 auditues me përvojë dhe të rinj me perspektivë nga KLSH u trajnuan për auditimin e performancës në Poloni. Morën një eksperiencë të çmuar në përzgjedhjen e tematikave të auditimeve të performancës, në vendosjen e kritereve për secilin auditim në këtë fushë, në përdorimin e metodave bashkëkohore për mbledhjen e një informacioni sa më të besuar dhe të përditësuar rreth performancës së entit që auditohet, etj., të cilën do ta prezantojnë edhe në këtë analizë gjashtëmujore. Kjo eksperiencë e fituar, së bashku me atë që do të marrim nga SIGMA në shtator të këtij viti, do ta ndihmojë shumë KLSH në të ardhmen e afërt, në planifikimin dhe kryerjen e auditimeve intensive të performancës, që masin rezultatet e shumë institucioneve të rëndësishme apo të kryerjes së investimeve publike në degë jetike të ekonomisë së vendit, në këndvështrimin e përdorimit me ekonomi, efektivitet dhe efiçiencë të parasë publike të vënë në dispozicion. Aktivitetet e trajnimit dhe të shkëmbimit të eksperiencës do të vijojnë në vjeshtën e këtij viti si në Tiranë dhe në Varshavë, në fushën e luftës kundër korrupsionit dhe mashtrimit financiar, në auditimin e IT, në auditimet e përbashkëta, etj.;

d) Gjykata e Llogarive e Turqisë dhe Zyra e Auditimit Suprem e Kroacisë, institucione me traditë në auditimin suprem publik, të kontaktuara nga KLSH, kanë shprehur interesimin e tyre për lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionin dhe pritet nënshkrimi i këtyre marrëveshjeve në gjysmën e dytë të këtij viti;

e) KLSH ka intensifikuar marrëdhëniet me programin SIGMA të BE-së, duke përgatitur me këtë program Projektin e Aktiviteteve Urëlidhëse 2012 *"SIGMA në mbështetje të KLSH-së",* deri në fitimin e një projekti binjakëzimi IPA 2013 nga ana e

KLSH. Aktiviteti i parë në formën e një seminari nismëtar u zhvilluar në korrik 2012 në Tiranë, ku u trajnuan mbi 55 auditues dhe drejtues të KLSH-së në temat e zhvillimeve në auditimin e brendshëm, në menaxhimin financiar dhe në inspektimin financiar në vend, të funksionimit të autoritetit të auditimit, i cili do të ngrihet edhe në Shqipëri në kuadrin e perspektivës së marrjes së statusit të vendit kandidat për në BE (u shfrytëzua eksperienca e suksesshme portugeze). Seminari trajtoi edhe auditimin financiar dhe atë të përputhshmërisë, auditimin e performancës dhe të IT, në një përpjekje për të hedhur bazat për një trajnim të thelluar dhe tërësor për këto tema në muajt në vijim nga eksperte të SIGMA-s. Dhe pikërisht, në muajt shtator, tetor dhe dhjetor parashikohen trajnime njëjavore të drejtuesve dhe audituesve të institucionit, përkatësisht për auditimin e performancës, auditimin financiar dhe të përputhshmërisë, si dhe për auditimin e IT. Gjatë kohës së kryerjes së trajnimeve, ekspertet e SIGMA-s do të asistojnë drejtuesit e KLSH për draftimin e planit të zhvillimit strategjik 2013-2016 të institucionit. SIGMA parashikon po ashtu t'i kërkojë DG-Budget në Bruksel vazhdimin e mbështetjes për KLSH edhe për vitin 2013;

f) Institucioni ka vendosur raporte të rregullta komunikimi dhe shkëmbimi idesh me Zyrën e Përhershme të Bankës Botërore në Shqipëri. Nga ana e drejtueses së kësaj Zyre, zj. Ksenya Lvovski është shprehur dëshira për mbështetje konkrete për KLSH;

g) KLSH ka aplikuar pranë Delegacionit të Komisionit Evropian në Shqipëri për realizimin e një projekti binjakëzimi në kuadër të fondeve IPA 2013, për të ngritur kapacitetet e tij audituese në nivelin e kërkesave të standardeve të përditësuara të INTOSAI. Aplikimi ynë është vlerësuar lart nga ekspertët e delegacionit të BE në Shqipëri, është mbështetur nga Qeveria Shqiptare dhe informatat paraprake janë që KLSH do të arrijë të sigurojë mbështetje nga fondet IPA 2013;

h) Në qershor 2012, erdhi në Tiranë një mision vlerësimi nga Zyra Kombëtare e Auditimit e Suedisë. Misioni do të japë në vjeshtë 2012 vlerësimin e tij, nga ku pritet që KLSH të përfitojë një marrëveshje partneriteti dhe asistence nga Zyra Kombëtare e Auditimit e Suedisë. Konsideratat e para të shprehura nga Misioni janë shumë pozitive.

Së nënti, KLSH po përpiqet të rrisë aftësitë e stafit të KLSH në përdorimin e teknologjisë së informacionit, për të fuqizuar kapacitetet e institucionit në zbulimin dhe parandalimin e krimit ekonomik në IT. Është ende në fillim. Ky objektiv është shumë koherent në zhvillimet e sotme, kur qeverisja elektronike ka marrë përparësi dhe është shtrirë bindshëm në të gjitha sferat e veprimtarisë publike. Për ta realizuar atë, KLSH:

1. Ka përfunduar shërbimin e komunikimit elektronik në sistem brenda institucionit, duke :
   - ngritur dhe konfiguruar një server me programin Ëindoës 2000;
   - instaluar programi MDaemon v10. për postën elektronike dhe konfiguruar të gjithë përdoruesit;
   - hartuar rregulloren e komunikimit elektronik në KLSH;
   - ngritur librin e adresave për postën elektronike të KLSH me domain ....@klsh.org
2. Ka përgatitur materialin trajnues dhe zhvilluar trajnim me të gjitha departamentet e drejtoritë mbi programin e auditimit IDEA, program i cili përdoret nga SAI-t e zhvilluara, për rritjen e cilësisë e uljen e kostos së auditimit;
3. Ka përfunduar përzgjedhjen, zbatimin dhe marrjen në dorëzim të programit të legjislacionit shqiptar Alba-Lex, prodhim i kompanisë DATATECH për server me shërbim për gjithë rrjetin kompjuterik të KLSH-së. Sot çdo auditues mund të kërkojë dhe sigurojë aktet ligjore e nënligjore në formë elektronike;
4. Ka përfunduar zgjedhjen, përshtatjen dhe instalimin e programit të menaxhimit të burimeve njerëzore të KLSH-së.

Së fundi, institucioni ka përmirësuar ndjeshëm transparencën dhe komunikimin me publikun dhe me qytetarin, nëpërmjet një partneriteti të gjerë me mediat dhe shoqatat jo-fitimprurëse të interesuara për bashkëpunim, por dhe në raportet me qytetarët e thjeshtë denoncues dhe që ankohen.

Ky objektiv ka qenë në vëmendjen absolute të KLSH-së, për të realizuar misionin e tij kushtetues, të informimit me përparësi dhe me transparencë të plotë të publikut, si dhe në zbatim të standardit bazë të INTOSAI-t, ISSAI 20, i cili thekson se:*" SAI-t komunikojnë në kohë dhe gjerësisht për aktivitetet e tyre dhe rezultatet e auditimeve nëpërmjet medias, faqeve në internet dhe mjeteve të tjera të komunikimit masiv [102]".*

Për realizimin e objektivit, KLSH:

a) hartoi një udhëzues të veçantë për procedurën që duhet të ndiqet për pranimin e shpejtë, shqyrtimin efiçient dhe mënyrën e zgjidhjes së problemeve të ngritura në letrat e dërguara nga qytetarët. Në hartimin e Udhëzuesit u shfrytëzua përvoja e institucioneve të tjera, si Këshilli i Ministrave, Avokati i Popullit, etj. Gjatë këtij 6-mujori, institucionit i kanë ardhur 165 letra dhe ankesa për probleme të ndryshme,

[102] ISSAI 20, parimi 8

nga të cilat 38 ishin jashtë kompetencave të tij. Nga 127 kërkesa dhe ankime në kompetencë të KLSH, 73 prej tyre janë verifikuar dhe u është dhënë përgjigjja përkatëse, ndërsa 54 janë në vazhdim të verifikimit.

b) u zhvilluan në praninë e gazetarëve analizat vjetore 2011 të departamenteve të KLSH. Ato patën jehonë edhe në shtypin e ditës.

c) i ka komunikuar mediave në vijimësi rezultatet e auditimeve, me transparencë të plotë dhe pa konsiderata hipotetike për abuzimet dhe vjedhjet e mundshme të pronës shtetërore. Kontaktet dhe komunikimi me mediat janë rritur ndjeshëm. Vetëm në periudhën janar-qershor 2012 u transmetuan për KLSH rreth 204 sekuenca filmike, edicione informative apo kronika të ndryshme televizive, ose më shumë se dy herë numrin e kronikave të realizuara gjatë periudhës janar-qershor 2011. Janë botuar 278 artikuj në median e shkruar, ndërkohë që për të gjithë vitin 2011 ata kanë qenë vetëm 280.

d) nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me gjashtë nga organizatat jofitimprurëse (OJF) më të spikatura të vendit në luftën kundër korrupsionit dhe për rritjen e transparencës (aktivitet i përmendur dhe me sipër). Marrëveshjet u lidhën nën moton e organizatës ndërkombëtare të institucioneve supreme të kontrollit, INTOSAI *"Eksperienca e përbashkët i shërben të gjithëve"* dhe synojnë kontribute dhe aktivitete të përbashkëta të KLSH-së dhe shoqatave, si vrojtime, prognoza dhe studime të përbashkëta, pjesëmarrje reciproke në workshop-e, simpoziume, konferenca, etj për luftën ndaj korrupsionit, parandalimin e tij dhe rritjen e transparencës së institucioneve publike. Me këto marrëveshje është realizuar Parimi 9 themelor i SAI-t në standardin bazë ISSAI 20, i cili kërkon nga SAI-t *"Përdorimin e këshillës dhe ekspertizës së jashtme të pavarur për të rritur cilësinë dhe besueshmërinë e punës së SAI-t"*.

Shtrohet pyetja**: Çfarë do të bëjë KLSH në gjysmën e dytë të këtij viti?**

Së pari, institucioni ka marrë komentet dhe sugjerimet përfundimtare nga SIGMA dhe Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit të Komisionit të BE, për rishikimin dhe bërjen e amendimeve në Ligjin Organik të KLSH. Këto komente na orientuan më drejtë se ku duhet ndërhyrë në ligjin aktual, për të fuqizuar të drejtat kushtetuese, për të zgjeruar fushën e auditimeve financiare me certifikimin e llogarive financiare, si dhe për të rritur nivelin e zbatimit të rekomandimeve tona. Nëpërmjet amendimeve që kemi përgatitur rregullohen në mënyrë përfundimtare pavarësia e institucionit, konceptimi modern i të drejtave dhe detyrave të KLSH-së, rritja e kapaciteteve administrative, saktësimi i së drejtës së KLSH-së të auditojë fondet e akorduara nga BE për Shqipërinë deri tek përdoruesi i fundit dhe saktësimi i së drejtës të çertifikojë llogaritë financiare. Në

qershor 2012 Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit të Komisionit të BE dërgoi dhe dy sugjerime të fundit dhe rikonfirmoi mbështetjen e saj për draft-ligjin, duke u shprehur se varianti i fundit është "*....më i strukturuar dhe frazeologjia e sjellë më pranë standardeve të INTOSAI-t* [103]". Me marrjen dhe të miratimit përfundimtar nga ana e SIGMA-s, do të dërgojmë draft-ligjin me amendimet në Kuvend në vjeshtë të këtij viti. Ky aksion ligjbërës do të na krijojë hapësira më të mëdha për të plotësuar më me efiçiencë misionin tonë kushtetues,

Së dyti, me SIGMA-n është biseduar për të koordinuar një program të gjerë plotësues trajnimi, ku ndihma e institucioneve të larta të auditimit si Zyra Kombëtare e Auditimit e Suedisë, NIK i Polonisë, Gjykata e Auditimit e Sllovenisë do të inkuadrohet natyrshëm në mbështetjen e fortë që vetë SIGMA do t'i japë KLSH-së ,jo vetëm për gjysmën e dytë të këtij viti, por edhe përgjatë gjithë vitit 2013, deri në nisjen e projektit të binjakëzimit me fondet IPA 2013, i cili pritet të fillojë në vitin 2014. Këto trajnime do të thellojnë dhe plotësojnë dijet e audituesve tanë për auditimin e mirëfilltë financiar dhe të përputhshmërisë, për auditimin aq të nevojshëm e parësor të performancës, për auditimin e integritetit dhe anti-korrupsion, si dhe për përdorimin e gjerë të mjeteve të IT dhe të auditimit të IT, sidomos për procedurat e prokurimeve publike, aktivitetit tatimor e doganor, etj.

Së treti, ekspertët e SIGMA do të orientojnë dhe drejtojnë KLSH gjatë gjithë gjysmës së dytë të vitit në përgatitjen e Planit të tij strategjik të Zhvillimit 2013-2016, i cili do të bazohet në përqendrimin e punës audituese drejt auditimit të performancës, në thellimin e auditimit financiar dhe të pajtueshmërisë, si dhe në intensifikimin e luftës kundër korrupsionit dhe për parandalimin e tij, duke punuar në sistem me të gjithë partnerët shtetërorë dhe të shoqërisë civile.

[103] Nga letra e z. Robert Gielisse, Kryetar i Njësisë së Buxhetit të DG-Budget, drejtuar KLSH-së më datën 29 qershor 2012.

CILËSI NË AUDITIM DO TË THOTË TË FITOSH BESIMIN E QYTETARËVE

Analiza e KLSH për vitin 2012[104]

Analiza vjetore për vitin 2012 është zhvilluar në sallën e Hotel Internacional Tirana më datë 30.01.2013 me pjesëmarrjen e Presidentit të Republikës, SH.T.Z. Bujar Nishani, Prokurorit të Përgjithshëm, z. Adriatik Llalla, Audituesit të Përgjithshëm të Kosovës, z. Lars Lage Olofsson, z. Joop Vrolijk, Këshilltar i Lartë i SIGMA, zj. Klodjana Cankja, Drejtore e Agjencisë së Prokurimeve Publike, si dhe profesorë të financave publike dhe përfaqësues të shoqërisë civile nga organizata aktive në luftën kundër korrupsionit dhe për transparencë në administrimin publik.

I nderuar Zoti Nishani, President i Republikës,

I nderuar zoti Olofsson, Auditor i Përgjithshëm i Kosovës,

I nderuar zoti Llalla, Prokuror i Përgjithshëm,

Të nderuar përfaqësues nga shoqëria civile,

Të nderuar kolegë audites!

Transparenca dhe llogaridhënia janë dy parimet kryesore të qeverisjes së mirë në sektorin publik dhe përgjegjësia jonë si SAI, si institucioni më i lartë i auditimit të

[104] Raportin e zgjeruar të veprimtarisë së KLSH, mbajtur nga Kryetari, Bujar Leskaj, e gjeni në adresën www.klsh.org.al/ Raporti Vjetor i Performancës 2012

jashtëm publik është që të kontribuojmë në transparencën dhe llogaridhënien e menaxhimit të fondeve publike. Këtë kontribut e kemi pasur në fokus të çdo auditimi. **Gjatë vitit 2012 kemi realizuar 177 auditime nga 153 të planifikuara dhe kemi përfunduar plotësisht 158 auditime.**

Çështja kryesore dhe më e rëndësishme për ne është të mbajmë një cilësi të lartë në aktivitetet e auditimit dhe ta ruajmë këtë cilësi, në mënyrë që të drejtohemi nga shembujt e mirë.

Si institucion i auditimit të jashtëm, KLSH duhet t'i përmbahet standardeve të cilësisë dhe në të njëjtën kohë audituesit e tij duhet të mbajnë flamurin e pavarësisë, objektivitetit, skepticizmit profesional dhe llogaridhënies ndaj publikut, duke kryer punë cilësore auditimi.

Gjatë auditimeve të kryera në vitin 2012 (me periudhe 2-3 vjeçare aktiviteti të entit që auditohet), **kemi vërejtur parregullsi dhe shkelje financiare në të ardhurat e mbledhura dhe në shpenzimet e kryera nga entet publike të audituara, institucione të pushtetit qendror dhe vendor, me dëm ndaj Buxhetit të Shtetit në shumën 13, 522, 392, 000 lekë, ose 97.3 milion euro. Institucioni ka rekomanduar që kjo shumë të zhdëmtohet në masën 100 përqind.**

Ne si SAI kemi shumë palë të interesuara në realizimin e misionit tonë: qytetarët, Parlamentin, entet e audituara dhe organizatat e shoqërisë civile. Besimi i palëve të interesuara për një SAI do të thotë besim i Parlamentit dhe publikut në përgjithësi, për rezultatet e e punës së tij. Është e rëndësishme që puna e KLSH-së të mbetet relevante, e besueshme dhe e dobishme për palët e interesuara, veçanërisht për Kuvendin. Misioni ynë është informimi i publikut dhe i Kuvendit të Shqipërisë në lidhje me përgjegjshmërinë e qeverisë dhe të enteve të tjera publike për përdorimin e burimeve publike sipas ligjit, me ekonomicitet, efektivitet dhe efiçiencë dhe nxitja e kësaj përgjegjshmërie në të gjithë sektorin publik, në përputhje me praktikat më të mira të BE-së, me standardet ndërkombëtare të INTOSAI-t dhe me ndjeshmërinë popullore për shtimin e luftës kundër korrupsionit. Në sektorin privat, aftësia e një kompanie për të ndërtuar dhe për të ruajtur besimin e aktorëve të saj është shumë e rëndësishme për biznesin. Kjo ndodh edhe për institucionet publike. Për KLSH-në, si një institucion publik që punon në emër të Kuvendit, aftësia për të krijuar besimin në palët e interesuara është e një rëndësie vendimtare.

Kemi zbuluar shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në perfomancën e subjekteve të audituara, në shumën e përgjithshme 1, 842, 998, 000 lekë, ose 13.2 milion euro.

Shkeljet financiare janë vërejtur kryesisht **në prokurimet publike,** në **shitjen dhe dhënien me qira të pasurisë shtetërore, në urbanistikë, në shpenzimet operative, në doganat, në tatimet e taksat, etj.**

Integriteti i menaxhimit të auditimit paraqitet shumë i rëndësishëm për ne, në drejtim të rritjes së besimit të palëve të interesuara. Qytetarët duan të dinë se si shpenzohen fondet publike nga institucionet publike dhe se si institucionet i kryejnë detyrat e tyre. SAI punon si një ndërmjetës në këtë kontekst, auditon institucionet dhe raporton në lidhje me llogaritë dhe transaksionet e tyre në Parlament dhe tek qytetarët. Integriteti i menaxhimit të auditimit nënkupton kryerjen e këtyre auditimeve me staf kompetent dhe të pavarur, i cili përdor një kod sjelljeje të mirëprovuar dhe i kryen auditimet në përputhje me ligjet dhe standardet profesionale të INTOSAI-t. Pra, duhen përmbushur disa kushte për të siguruar integritetin e menaxhimit të auditimit: audituesit duhet të jenë të kualifikuar, kodi i etikës duhet të jetë i qartë, procedurat e auditimit duhet të jenë të hapura dhe të mirëpërcaktuara, lidershipi i SAI-t duhet të sigurohet që monitorimi për të vlerësuar procesin e auditimit dhe raportet e auditimit është i rregullt.

Në bazë të standardit ISSAI 20, "*...përgjegjshmëria për SAI-n qëndron në përgjegjësinë e treguar për planifikimin dhe kryerjen e punës së tij audituese, duke përdorur metodologjitë dhe standardet e duhura për të siguruar llogaridhënien dhe transparencën mbi aktivitetet publike, duke përmbushur përgjegjësitë e tij në mënyrë të plotë dhe objektive* [105]". Në kontekstin e përgjegjshmërisë, proceset e punës, aktivitetet dhe produktet duhet të jenë transparente dhe SAI-t duhet të komunikojnë hapur me aktorët e tyre. Përgjegjësia ndahet në përgjegjësinë e lidershipit dhe të stafit të një SAI. Përafrimi i njohur në literaturën botërore me shprehjen "Tone at the top"(theksi në majë) ka të bëjë me përgjegjësitë e lidershipit për të siguruar cilësinë e produkteve apo shërbimeve që ofron institucioni. Termi është përcaktuar nga IFAC si vijon: "*Standardi i vendosur nga lidershipi i një organizatë, në të cilin është matur performanca, kultura brenda së cilës veprojnë anëtarët e organizatës, mënyra e veprimit e vendosur nga lidershipi, pavarësisht strategjive të dokumentuara për drejtimin dhe politikat është forca që drejton profesionistët individualë, dora e padukshme që drejton pavarësisht rregulloreve* [106]".

Ne si KLSH jemi përgjegjës për auditimin e institucioneve publike dhe shqyrtimin e llogarive, pasqyrave financiare dhe strukturës së auditimit të brendshëm të tyre, duke bërë sugjerime në mënyrë që ato të kontribuojnë në mirëqeverisjen e sektorit publik.

Po vetë funksionet e SAI-t dhe cilësia e veprimtarisë së tij? Sigurisht, si një institucion i jashtëm audites, KLSH duhet të jetë shembull për ofrimin e një pune cilësore. Sikurse

[105] ISSAI 20, botim i vitit 2010, fq. 3

[106] IFAC, Komiteti i Audituesve Ndërkombëtarë, botim i vitit 2007, fq. 8

përmendet në raportin e EUROSAI-t, "*cilësia është e nevojshme si për punën profesionale të SAI-t, ashtu dhe për administrimin e tij* [107]".

Siç thuhet në Raportin e Komitetit të Audituesve Ndërkombëtarë, "*kultura brenda SAI-ve është çelësi për auditime cilësore, pasi ajo krijon një mjedis ku arritja e cilësisë në çdo aspekt të procesit të auditimit vlerësohet dhe shpërblehet. Brenda SAI-t arritja e cilësisë është shumë më e domosdoshme se në institucionet e tjera, për vetë rolin që SAI ka si gjykues i punës së të tjerëve"*[108]. Për këtë arsye ruajtja e një niveli të caktuar të cilësisë bëhet gjithnjë e më e rëndësishme për SAI-t. Reputacioni ynë bazohet në cilësinë e prodhimit tonë.

Jemi të përqendruar për sigurimin e nivelit të duhur të llogaridhënies dhe të cilësisë në auditim, duke zbatuar rekomandimin e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë për "*Kryerjen e auditimeve për përdorimin e fondeve të Buxhetit të Shtetit, si dhe fondeve të projekteve të financuara nga BE-ja e nga institucionet financiare ndërkombëtare me objektivitet, profesionalizëm, cilësi dhe efektivitet të lartë*"**.**

Si KLSH, kemi sjellë në vitin 2012 **58 propozime për përmirësim të legjislacionit**, nga të cilat 15 janë zbatuar tashmë, ndërsa 24 janë në proces zbatimi. Kemi rekomanduar **2194 masa organizative**, nga të cilat janë zbatuar **1659 ose 76 përqind** e tyre.

Kemi rekomanduar **1221 masa disiplinore dhe administrative**, nga të cilat **802 ose 66 përqind** janë realizuar që gjatë këtij viti. Duhet të pohojmë se, ndërsa në përmbushjen e rekomandimeve tona për masat organizative, ato disiplinore dhe administrative kemi nivel të mirë zbatueshmërie, masat për largime nga puna të punonjësve të gjetur me shkelje janë në nivel shumë të ulët. Ky mosrealizim ka ardhur nga toleranca jonë dhe nga serioziteti i pakët i enteve të audituara në ndëshkimin e shkelësve të ligjit brenda stafit të tyre. Na del një detyrë e rëndësishme për këtë vit, që të ngremë në një nivel të pranueshëm këtë tregues shumë të rëndësishëm për kulturën e ndëshkueshmërisë në administratën publike.

Ekziston një perceptim negativ i publikut në lidhje me nivelin aktual të korrupsionit në administratën publike. Ky perceptim vjen nga moszbulimi dhe mosndëshkimi i korrupsionit në nivel të mjaftueshëm nga ana e organeve shtetërore përgjegjëse për ta luftuar këtë dukuri. Në këtë këndvështrim, mirëqeverisja është antidoti më i mirë ndaj korrupsionit. Fondi Monetar Ndërkombëtar është shprehur se "*të promovosh mirëqeverisjen në të gjitha aspektet e saj, duke siguruar sundimin e ligjit, duke përmirësuar efiçiencën dhe përgjegjësinë*

[107] Raporti i Grupit të Punës së EUROSAI-t, botim i vitit 2010, fq. 8

[108] Raporti i Grupit të punës së EUROSAI-t, botim i vitit 2010, fq. 7

e sektorit publik dhe duke luftuar korrupsionin, janë elementë thelbësorë të një kuadri ku ekonomitë mund të prosperojnë [109]".

Mendoj se gjithnjë duhet të mbajmë parasysh fjalët e çmuara të Sekretares së Shtetit, Hilari Klinton në adresimin e saj në Kuvendin e Shqipërisë. *"Është gjithmonë e rëndësishme t'i kujtojmë vetes se konsolidimi i demokracisë kërkon më shumë se vetëm zgjedhje. Kërkon studim logjik. Kërkon institucione të forta ... Kërkon që qeveria të jetë e hapur në mënyrë që njerëzit të na pyesin ne menaxherëve të llogarive publike. Unë kërkoj me ngulm që ju të përballeni me problemin që ndikon në kaq shumë demokraci sot në botë, pikërisht me korrupsionin ... Kjo është një luftë që secili vend duhet ta kryejë dhe të fitojë në të gjithë botën, sepse korrupsioni është një kancer që gërryen shoqëritë ... Zhdukja e korrupsionit kërkon përpjekje të pandalshme dhe një angazhim të përbashkët"*.

Si KLSH gjatë vitit 2012 kemi kryer **40 kallëzime penale për 125 punonjës** të administratës shtetërore të niveleve të ndryshme, ose 2 herë më shumë kallëzime nga sa institucioni ka bërë në tre vitet 2009-2011 të marra së bashku.

Puna jonë shkon në sinkron me Strategjinë Ndërsektoriale të Parandalimit, Luftës kundër Korrupsionit dhe Qeverisjes Transparente 2008-2013 të qeverisë Berisha, e cila kërkon një bashkëpunim më të ngushtë të institucioneve kryesore që e luftojnë korrupsionin, të bazuar në angazhime të përbashkëta të institucionalizuara.

Është vërejtur botërisht se rritja e përgjegjësisë së menaxherëve publikë ndikon menjëherë në uljen e korrupsionit. Gjatë vitit të kaluar, jemi përpjekur të krijojmë sinergji për mirëqeverisjen, duke bashkëpunuar në sistem me institucionet e tjera shtetërore. Në mars 2012, nënshkruam marrëveshjen e bashkëpunimit me Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive të funksionarëve të lartë të shtetit dhe me Autoritetin Shqiptar të Konkurrencës, me synimin zbulimit të çdo rasti pasurimi të shpejtë të funksionarëve publikë, si dhe të rasteve të prishjes së konkurrencës në tenderat dhe ankandet shtetërore. Në qershor 2012 nënshkruam marrëveshjen e bashkëpunimit me Prokurorinë e Përgjithshme. Nga kallëzimet e institucionit vetëm në muajin Dhjetor 2012, institucioni i Prokurorisë ka nisur hetimet për 35 punonjës publikë të kapur me shkelje nga KLSH në bashkitë Vlorë, Sarandë, Himarë, Pogradec dhe Përmet, si dhe në Ndërmarrjen e Ujësjellës-Kanalizimeve Mat. Kjo është parësore në ndërgjegjësimin e strukturave dhe enteve publike për përgjegjësitë që ato kanë në administrimin e pronës shtetërore. Bashkëpunimi efiçient i institucioneve si KLSH dhe Prokuroria e Shtetit në zbulimin dhe hetimin e abuzimeve me pronën shtetërore prodhon përgjegjshmëri. Një shkallë më e lartë përgjegjësie ndaj disiplinës së rreptë

[109] Udhëzues, "Qasja e FMN-së në promovimin e mirëqeverisjes dhe në luftën ndaj korrupsionit", ribotim i vitit 2011, fq. 18

financiare dhe detyrave të tjera publike ul korrupsionin. Nga ana tjetër, sfida jonë kryesore, modernizimi i institucionit, realizohet duke koordinuar si duhet punën me institucionet e tjera. Në përmbushje të objektivit të platformës strategjike të institucionit të caktuar në dhjetor 2011, kemi siguruar bashkëpunim profesional me Institutin e Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA) dhe me Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit.

Në maj 2012 kemi iniciuar marrëveshjen e bashkëpunimit me Ministrinë e Financave, sidomos me strukturat e saj të auditimit të brendshëm. Kjo marrëveshje është në veprim dhe do të realizohet e plotë gjatë këtij viti në objektivat e saj kryesore, në bazë të standardeve ISSAI 9150 dhe 1240. Ndajmë mendimin që forcimi i kapaciteteve të auditimit, si atij të brendshëm dhe të jashtëm publik, është rruga e duhur për të mbështetur maksimalisht rritjen e përgjegjshmërisë, transparencës dhe ndershmërisë në qeverisje.

Përmirësimi i qeverisjes duke luftuar korrupsionin dhe antikulturën e pandëshkueshmërisë, nëpërmjet transparencës së plotë dhe funksionale me publikun, ka përbërë një nga përparësitë e veprimtarisë sonë gjatë vitit të shkuar. Ai është njëkohësisht shprehje e filozofisë dhe qasjes sonë për të vendosur në plan të parë interesat e qytetarit. Kemi trajtuar **358 letra dhe ankesa nga qytetarët** për probleme të ndryshme, nga të cilat **111 i kemi konstatuar jashtë kompetencave dhe juridiksionit të KLSH,** kurse nga **247 kërkesa dhe ankime** në kompetencë të institucionit, **171** prej tyre i kemi verifikuar dhe u kemi dhënë përgjigjen përkatëse. **76** letra të qytetarëve janë në vijim të verifikimit.

Për rritjen e transparencës dhe efiçiencës në auditim, KLSH ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me disa nga OJF-të më të spikatura në promovimin e transparencës në administratën publike dhe në luftën kundër korrupsionit, dhe konkretisht me Transparency Internacional në Shqipëri, me lëvizjen Alternativa Civile, me Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë, me Institutin e Studimeve Bashkëkohore, me Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim, me Lëvizjen Evropiane Shqipëri dhe me Institutin "G&G Group". Këto nuk janë marrëveshje vetëm për numër. Marrëveshjet shprehin filozofinë e punës sonë, realizimin e veprimtarisë me ekonomicitet, efektivitet dhe eficiencë, duke realizuar sinergji me këto bashkëpunime. Nga OJF-të kërkojmë jo vetëm bashkëpunim për transparencë, por edhe të marrin pjesë aktive në auditimet tona dhe të na auditojnë ne.

Në zbatim të parimit 8-të të ISSAI 20 për komunikimin aktiv të një SAI nëpërmjet publikimeve, gjatë vitit 2012 institucioni përgatiti dhe botoi *"KLSH-Analiza Vjetore 2011", "KLSH në Kuvend", "KLSH- Analiza 6-mujore 2012", "EUROSAI dhe SAI-t Evropiane", "Standardet ISSAI 1, 10, 11, 20, 30, 40, 100 dhe 200", "Historiku i KLSH",* dy

numra të revistës shkencore *"Auditimi Publik"* dhe *Manualin e përditësuar të Auditimit të Performancës*. Me rastin e 100 Vjetorit të Pavarësisë KLSH më datën 28 dhjetor 2012, zhvilloi Konferencën e tij të parë Shkencore, duke ju referuar historikut të institucionit dhe punës shumëvjeçare të të gjithë personave që kanë kontribuar për ngritjen dhe mbarëvajtjen e tij në periudha kohore të ndryshme. Konferencë e këtij viti dhe në vitet në vijim synon të kthehet në një traditë dhe një forum qasjesh e eksperiencash auditimi, si për auditimin e jashtëm dhe atë të brendshëm publik, duke sjellë edhe përvojën audituese të institucioneve homologe të zhvilluara në rajon dhe më gjerë.

Puna në sistem për mirëqeverisjen, përgjegjësia jonë për transparencë dhe llogaridhënie mbartin në vetvete një përgjegjësi ligjore, profesionale dhe morale tepër të lartë. Për të qenë sa më efektivë dhe për të modernizuar kapacitetet tona audituese dhe gjithë aktivitetin, në zbatim dhe të rekomandimit të Progres-Raportit 2012 të BE-së për Shqipërinë, i cili ka nënvizuar se: "*Auditimi i jashtëm duhet të vijë në nivel me standardet e INTOSAI-t*", gjatë vitit 2012 plotësuam përgatitjen e draft-amendimeve të ligjit organik të KLSH, në bashkëpunim intensiv me Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në BE, DG-Budget dhe me SIGMA. Gjatë ditëve të para të Nëntorit 2012 organizuam katër tryeza pune me pedagogë të Universitetit Shtetëror të Tiranës dhe ekspertëve të njohur ligjorë, kontabël dhe të financave publike, si dhe me përfaqësues të shoqërisë civile dhe të mediave. Në këto tryeza mori pjesë dhe një Drejtor Njësie në DG-Budget. Nga tryezat rezultuan sugjerime të vlefshme që u reflektuan në draftin përfundimtar të Projekt-Ligjit me Amendimet, i dorëzuar Kuvendit të Shqipërisë më 30 nëntor 2012. Sipas DG-Budget projekt-ligji është "*tërësisht në përputhje me standardet* e *INTOSAI-t*". Amendimet sjellin një konceptim modern të të drejtave dhe detyrave të KLSH. Ato do të ndihmojnë në rritjen e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të tij, në rritjen e kapaciteteve administrative, në saktësimin e së drejtës së KLSH-së të auditojë fondet e akorduara nga BE për Shqipërinë deri tek përdoruesi i fundit dhe në saktësimin e së drejtës të çertifikojë llogaritë financiare të enteve të audituara. Ne besojmë se Kuvendi si gjithmonë do të na mbështesë. Për më tepër, vetë Rezoluta e Kombeve të Bashkuara e 22 Dhjetorit 2011 *"Për nxitjen e efiçiencës, përgjegjshmërisë, efektivitetit dhe transparencës së administratës publike duke fuqizuar institucionet supreme të auditimit"* i inkurajon Shtetet Anëtare të OKB-së dhe parlamentet e tyre "*të mbështesin SAI-t të kryejnë detyrat e tyre në mënyrë objektive dhe efektive, duke qenë të pavarura nga subjekti i audituar dhe të mbrojtura nga ndikimet e jashtme*". U drejtohem te gjithë zotërinjve deputetë të Kuvendit që të shqyrtojnë amendimet e ligjit të KLSH, sepse nëpërmjet tyre përmirësohet qeverisja dhe rritet ndjenja e përgjegjësisë e llogaridhënia në administratën publike.

Jemi të bindur se ndikimi ynë në mirëqeverisjen publike është tërësisht në funksion të nivelit të kapaciteteve tona. Gjatë vitit 2012, kemi rekrutuar sipas të gjitha rregullave të punësimit në administratën publike shumë punonjës të rinj, ndër të cilët katër me

gradën shkencore Doktor i Shkencave dhe tetë me nivel pasuniversitar të Programit Master. Kemi parë si mjetin kryesor të forcimit të kapaciteteve audituese të institucionit trajnimet intensive të stafit, si atij me përvojë edhe atij të ri, në përvetësimin e standardeve të INTOSAI-t. Duke filluar nga muaji shkurt 2012 e në vijim kemi lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe të zhvilluara të auditimit më të lartë publik, si Zyra e Audituesit të Përgjithshëm të Kosovës, Zyra Kombëtare e Auditimit (NIK) e Polonisë, Gjykata e Auditimit e Sllovenisë, Gjykata e Llogarive e Turqisë dhe Institucioni i Auditimit Shtetëror të Kroacisë. Si rezultat i zbatimit të këtyre marrëveshjeve, gjatë vitit 2012 u trajnuan jashtë shtetit një numër audituesish të KLSH i barabartë me numrin e punonjësve të institucionit të dërguar jashtë gjatë shtatë viteve 2004-2011 të marra së bashku. Në gjysmën e dytë të vitit 2012 realizuam me ekspertë të SIGMA-s në Tiranë një program intensiv trajnimesh për auditimin e performancës, auditimin financiar dhe auditimin e teknologjisë së informacionit, program të cilin do ta vijojmë edhe këtë vit. Vitin 2012 e mbyllëm me një tregues **19.4 ditë trajnimi** për audites në KLSH, nga vetëm 2.1 ditë trajnimi në vit për audites, që kishim trashëguar nga viti 2011. Ky tregues i sotëm është në nivel me treguesit e ditëve të trajnimit në vit të institucioneve të auditimit suprem më të zhvilluara në kontinent.

Në Projekt-Idenë e paraqitur më datë 14 Dhjetor 2011 në Komisionin e Ekonomisë dhe të Financës së Kuvendit, si kandidat i nominuar nga Presidenti i Republikës, theksova se: "*KLSH është përpara një sfide të fortë për ta përqendruar punën tek auditimi i performancës, pse ai i shërben vlerësimit të përgjegjshmërisë publike. Përqendrimi i vëmendjes tek auditimi i performancës do të jetë ndër shtyllat kryesore të planit të ri strategjik 2013-2016 të institucionit*". Gjatë vitit 2012, katërfishuam numrin e auditimeve të performancës, në krahasim me një vit më parë (duke u nisur nga një bazë shumë e dobët) dhe përditësuam Manualin e Auditimit të Performancës, që ai t'u shërbejë më konkretisht audituesve tanë. Në shtator 2012, institucioni ngriti Departamentin e Auditimit të Performancës, me në krye një nga studiuesit më premtues të makroekonomisë shqiptare dhe Doktor i Shkencave në financat publike, si dhe me 16 audites ndër ata më me përvojë në KLSH dhe audites të rinj me perspektivë të qartë për ngritje profesionale.

Me qëllim përmirësimin e metodologjisë së auditimit dhe raportimeve tona, ngritëm në shkurt 2012 Departamentin e Kërkimit Shkencor, Zhvillimit dhe Teknologjisë së Informacionit. Gjatë vitit 2012 institucioni aplikoi dhe fitoi një projekt binjakëzimi për zhvillimin e metodologjisë dhe kapaciteteve të tij audituese, në kuadër të financimeve IPA 2012, me vlerë 2.11 milionë euro, i cili do të bëhet veprues në fund të këtij viti. Falënderojmë me këtë rast Delegacionin e BE-së në Tiranë, Ministrinë e Integrimit dhe DG-Budget për mbështetjen e dhënë, pas 4 vitesh që institucioni nuk kishte përfituar asnjë asistencë teknike nga donatorë të huaj.

Në tërësi, gjykoj se masat e marra dhe puna e kryer gjatë vitit 2012 na lejojnë të jemi ambiciozë në objektivat tona për vitin në vijim. Në bashkëpunim me ekspertë të SIGMA-s, kemi përgatitur Planin e Zhvillimit Strategjik të KLSH-së për vitet 2013-2016, i cili përmban këto objektiva kryesorë:

- përmirësimin e bazës ligjore dhe rregullatore të KLSH-së, në përputhje me standardet e INTOSAI-t dhe praktikat më të mira evropiane;
- përmirësimin e metodologjisë dhe rritjen e cilësisë së auditimit;
- përmirësimin e cilësisë dhe shtimin e numrit të auditimeve të performancës, krahas konsolidimit të auditimeve të përputhshmërisë dhe atyre financiarë;
- sigurimin e mirëqeverisjes;
- rritjen e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies për një menaxhim të shëndoshë financiar.

Gjatë këtij viti, objektivat tona parësore do të jenë: bashkëpunimi i gjerë dhe i thellë me Kuvendin e Shqipërisë, me Institucionin e Presidencës, me Qeverinë dhe me të gjithë partnerët tanë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar Bashkëpunimi me këto institucione është për ne garanci e plotë në suksesin e objektivave dhe përpjekjeve tona në vitin e ardhshëm. Ne besojmë fort në punën në sistem për përmirësimin e qeverisjes, rritjen e përgjegjësisë dhe të llogaridhënies së institucioneve publike. Ndaj bindjen që rezultatet nuk do të mungojnë dhe vitin e ardhshëm. Rezultatet pozitive janë të sigurt nëse vullneti dhe predispozicioni juj të nderuar kolegë auditues, për rritjen e kapaciteteve tuaja profesionale, por edhe vullneti dhe predispozicioni për bashkëpunim i të gjitha institucioneve shtetërore dhe i gjithë aktorëve të tjerë të përfshirë, do të jenë në nivelin e duhur.

Ju faleminderit!

KLSH, SI INSTITUCION QË PËRMIRËSON MENAXHIMIN PUBLIK TË PARAVE TË SHQIPTARËVE

Analiza e KLSH për vitin 2013[110]

Analiza vjetore për vitin 2013 është zhvilluar në sallën e Hotel Internacional Tirana më datë 28.01.2014 me pjesëmarrjen e SH.T.Z. Bujar Nishani, President i Republikës, z. Ettore Sequi, Ambasador i Bashkimit Evropian në Shqipëri, z. Robert Wilton, zv. Ambasador i Pranisë së OSBE-së në Shqipëri, z. Adriatik Llalla, Prokuror i Përgjithshëm, zj. Majlinda Bregu, Kryetare e Komisionit të Integrimit të Kuvendit, Prof. Dr. Anastas Angjeli, Sekretar i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit, Ndihmës Auditorit të Përgjithshëm të ZAP Kosovë, z. Ibrahim Gjylderen, si dhe disa personalitete të botës akademike, shoqërisë civile dhe mediave.

I nderuar President i Republikës,

I nderuar Zoti Ambasador i BE,

I nderuar Zoti Prokuror i Përgjithshëm,

I nderuar Zoti Zv.Ambasador i OSBE,

Të nderuar deputetë dhe përfaqësues të shoqërisë civile, Kolegë auditues.

Gjatë vitit të kaluar, realizimin e misionit tonë auditues e kemi parë në dy kolona kryesore, në Strategjinë e Zhvillimit të KLSH 2013-2017, (2013-a ishte viti i parë i zbatimit të saj), si dhe në moton e Kongresit INCOSAI XXI të INTOSAI, të zhvilluar në Pekin në tetor 2013, që **auditimi kombëtar të vihet në shërbim të qeverisjes kombëtare, për përmirësimin e menaxhimit publik financiar të vendit**.

[110] Raportin e zgjeruar të veprimtarisë së KLSH, mbajtur nga Kryetari Bujar Leskaj e gjeni në adresën www.klsh.org.al/ Raporti Vjetor i Performancës 2013

Gjatë vitit 2013, zbatimi i qëllimit strategjik të KLSH "Kapacitetet audituese" i njëjtë me **objektivin e parë të Strategjisë së INTOSAI-t 2011-2016 dhe Strategjisë së EUROSAI-t 2011-2017**, ka nënkuptuar auditime në sasi dhe cilësi.

Për vitin 2013, nga 147 auditime të planifikuara, KLSH ka kryer 164 auditime, ose 11 përqind më shumë, nga të cilat 153 auditime janë përfunduar dhe evaduar plotësisht, ndërsa 11 janë në fazën e evadimit.

Nga auditimet e vitit 2013, KLSH ka zbuluar parregullsi dhe shkelje financiare (në të ardhurat publike dhe shpenzimet e kryera) në nivelin **15. 1 miliardë lekë (ose rreth 108 milionë euro),** duke kërkuar shpërblimin e dëmit, pra arkëtimin **në 99.9 përqind të tyre**. Dëmi ekonomik i zbuluar në të vitet 2012 dhe 2013, është rreth **dy herë më i madh** se vlera e dëmit të zbuluar në vitet 2009, 2010 dhe 2011, të marra së bashku. Pjesa më e madhe e dëmit të zbuluar është nga shitja e pasurisë, dhënia e objekteve me qira dhe e pasurive publike me koncesion.

Krahas zbulimeve me dëm ekonomik, gjatë vitit 2013, KLSH ka konstatuar shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituara, në nivelin e 4, 4 miliardë lekëve (mbi 31 milionë euro), ose 2.5 miliardë lekë më shumë nga shkeljet e konstatuara gjatë vitit 2012.

Analiza e të dhënave tregon se në vitin 2013, institucioni ka rekomanduar më shumë përmirësime ligjore, sesa masa organizative, ngaqë impakti i një përmirësimi ligjor është më i prekshëm në gjithë sistemin e menaxhimit të fondeve publike dhe e tejkalon vlerën e masës organizative të nivelit të një subjekti.

KLSH ka propozuar disa ndryshime të rëndësishme kushtetuese dhe ligjore. *Së pari,* ka kërkuar ***vendosjen e kufirit të Borxhit Publik në Kushtetutë (propozim i paraqitur në dy vite rresht nga auditimi i zbatimit të Buxhetit faktik të Shtetit për vitin 2011 dhe 2012), duke rekomanduar që Ministria e Financave të ngrejë një grup pune me ekspertët më të mirë të fushës, për përgatitjen dhe paraqitjen e një nisme ligjore për fiksimin në Kushtetutë të treguesit të borxhit publik ndaj PBB-së.***

Së dyti, nga auditimi i performancës për ndarjen administrative, të kryer në muajt shkurt-tetor 2013, ka rekomanduar ***ndërhyrjen në ligjin për Pushtetin Vendor, për reduktimin e ndjeshëm të numrit të bashkive dhe komunave, për një shërbim më cilësor ndaj komunitetit, por në respekt maksimal jo vetëm të konsensusit politik mes partive, por edhe të atij social, kulturor dhe historik të zonave të ndryshme të vendit, sipas kërkesave të Kushtetutës, Neni 108/2.***

Së treti, Institucioni ka rekomanduar ***saktësimin dhe shqyrtimin me realizëm të gjendjes së borxheve që Buxheti i Shtetit ka ndaj sipërmarrësve private, si dhe përcaktimin e masave për të lehtësuar sa të jetë e mundur sipërmarrjen private nga gjendja e vështirë ku ndodhet***.

KLSH ka rritur propozimin e masave disiplinore, në mënyrë që çdo punonjës publik të jetë përgjegjës për atë që merr përsipër të realizojë me punën e tij. Kemi kërkuar **marrjen e 1161 masave disiplinore dhe administrative**, të cilat në masën rreth 75 përqind janë zbatuar, por tek masat për largim nga puna vërejmë një zbatueshmëri më të ulet, 38-50 përqind.

Në përputhje me objektivin e tij strategjik për përmirësimin e qeverisjes, nëpërmjet thellimit të luftës kundër korrupsionit, institucioni gjatë vitit 2013, për shkelje të dispozitave ligjore në fuqi, me pasojë shpërdorimin e fondeve publike dhe dëmtimin e pronës publike, **KLSH ka bërë 38 kallëzime penale ndaj 94 punonjësve publik, kryesisht nëpunës të lartë dhe të mesëm të administratës**.

Nga një analizë në vite, numri i kallëzimeve penale gjatë harkut kohor të viteve 2012 dhe 2013 është rreth katër herë më shumë se kallëzimet penale të kryera në vitet 2009, 2010 dhe 2011 të marra së bashku. Kallëzimet penale vetëm për vitin 2013 janë dy herë më shumë se në tre vitet 2009, 2010 dhe 2011, të marra së bashku.

Bashkëpunimi me Prokurorinë ka njohur rritje dhe konsolidim gjatë vitit të kaluar, në krahasim me vitin 2012, ndërsa nuk ka krahasim me mungesën e bashkëpunimit gjatë viteve 2009, 2010 dhe 2011. Për përmbushjen e rekomandimeve të KLSH nga institucionet e audituara, një rol tepër të rëndësishëm ka luajtur **Urdhri i Kryeministrit nr. 70, datë 18.04.2006** 'Për masat në zbatim të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, ..., në institucionet në varësi të Kryeministrit a të Ministrave', i cili shpreh

vullnetin institucional të qeverisë, për marrjen në konsideratë të rekomandimeve dhe propozimeve tona për marrjen e masave të ndryshme, me efekt parandalues e ndëshkues ndaj abuzimit dhe korrupsionit.

Me ndryshimet e reja në qeverisjen e vendit, e shikojmë të domosdoshëm që ky Urdhër **të përmirësohet dhe të ripërtërihet nga qeveria e sotme**, në kuadër të ridimensionimit dhe rikonceptimit të frontit të luftës ndërinstitucionale kundër korrupsionit. Ai mund të rikonceptohet, pse jo, edhe **në formën e një marrëveshjeje bashkëpunimi**, ku të transmetohet qartazi vullneti institucional për forcimin e kulturës së ndëshkueshmërisë, ndaj abuzuesve me pronën dhe fondet publike, veçanërisht largimin nga detyra të atyre drejtuesve të rangut të mesëm dhe të lartë, që rezultojnë me shkelje.

Gjatë vitit 2013, kemi përqendruar punën në përmbushjen e **drejtimit të dytë strategjik të INTOSAI-t dhe EUROSAI-t, zbatimi i standardeve profesionale ISSAI**, i cili përmbahet dhe në Strategjinë e KLSH-s 2013-2017.

Gjatë vitit 2013, KLSH ka forcuar kapaciteteve audituese, nëpërmjet një procesi të vazhdueshëm kualifikimi, kryerjes së trajnimeve të thelluara dhe gërshetimit të ngritjes arsimore me veprimtarinë praktike audituese. Struktura e punonjësve ka vijuar të ndryshojë, jo vetëm thjesht në favor të stafit auditues me arsim të lartë, por dhe të stafit me kualifikime profesionale, akademike dhe grada shkencore, si dhe me kualifikim në fusha të dyta ekspertize. Çdo auditues i KLSH u trajnua për 22 ditë gjatë vitit të kaluar, ose sa trefishi i viteve 2009, 2010 dhe 2011 të marra së bashku.

Në vitin 2013 u trajnuan 120 punonjës jashtë vendit, duke arritur një mesatare trajnimi, 5,3 ditë trajnimi jashtë vendit për person. Në dy vitet e fundit, institucioni ka ndryshuar koncept në investimin në kapacitetet audituese. Nga një institucion i disa viteve më parë praktikisht pa trajnim, është kthyer në SAI me tregues perëndimorë trajnimi.

Gjatë vitit të shkuar, KLSH aplikoi dhe u pranua anëtar i Task Forcës për Auditimin dhe Etikën i Organizatës Europiane të Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAI), duke punuar për të ndërmarrë misione auditimi mbi rregullshmërinë dhe eficiencën e Etikës dhe Integritetit në institucionet publike, duke konsideruar që lufta kundër korrupsionit dhe politikat për instalimin e një sistemi efektiv të integritetit, të jenë pjesë e menaxhimit të këtyre institucioneve.

Në Mars 2013, KLSH nënshkroi Marrëveshjen e Angazhimit me përfaqësues të IDI-t dhe EUROSAI-t për programin *"3i, Iniciativa e Implementimit te ISSAI-ve".* Me mbështetjen e SIGMA është ngritur grupi i punës, duke plotësuar të gjitha detyrimet që rrjedhin nga kjo marrëveshje.

I përqendruar për të realizuar edhe drejtimin e tretë strategjik të INTOSAI-t dhe EUROSAI-t për shkëmbimin e njohurive dhe të përvojës me partneret, institucioni gjatë vitit të kaluar njohu një partneritet në rritje me institucionet vendase dhe të huaja.

Audituesit e KLSH-së vlerësojnë së tepërmi dhe falënderojnë institucionin e Presidentit të Republikës për ndihmën e dhënë në këto dy vite, 2012 dhe 2013, për kuptimin, ndjeshmërinë e tij të thellë dhe përkrahjen pa rezerva ndaj misionit dhe vlerave që shpalos auditimi publik suprem.

Në zbatim të Rezolutës A66 të Asamblesë së Kombeve të Bashkuara të datës 22 dhjetor 2011 '*Promovimi i efiçiencës, llogaridhënies, efektivitetit dhe transparencës së administratës publike, duke fuqizuar institucionet supreme të auditimit*', KLSH si agjent i Kuvendit për sigurimin e miradministrimit të fondeve publike, ka realizuar një bashkëpunim efikas me Parlamentin. Institucioni falënderon Kryetarin e Kuvendit dhe Kryetarin e Komisionit për Ekonominë dhe Financat, për mbështetjen financiare të dhënë KLSH, e cila, dhe pse modeste, garanton funksionimin normal të aktivitetit tonë audituesi.

I jemi mirënjohës Kuvendit që, me kërkesë të KLSH-së, po i siguron institucionit për auditimin e fondeve të tij, një audituesi të jashtëm të pavarur, si dhe për mbështetjen për miratimin gjatë këtij viti në vijim, të amendimeve të ligjit të tij. Në nëntor të vitit 2012, në bashkëpunim me DG-Budget të Komisionit Evropian dhe SIGMA-n, KLSH përgatiti dhe dërgoi në Kuvend për miratim amendimet e ligjit organik, të cilat e modernizojnë institucionin, rrisin gamën e auditimeve dhe e sjellin aktivitetin e KLSH-së në përputhje të plotë me standardet e INTOSAI-t.

KLSH falënderon po ashtu Delegacionin e BE-së në Tiranë, për ndihmesën e tij në fitimin e Projektit të Binjakëzimit, në vlerën prej 2.1 milion Euro, të propozuar nga KLSH në kuadër të fondeve IPA 2013. Falënderojmë ish-Kryeministrin Berisha për mbështetjen e dhënë për këtë projekt, si dhe Kryeministrin dhe qeverinë e sotme për mundësimin e kësaj mbështetjeje, në momentin e finalizimit të projektit, për të cilin KLSH ka punuar dhe lobuar që nga fillimi i vitit 2012 e deri më sot.

Gjatë vitit 2013, KLSH konsolidoi zbatimin e marrëveshjeve të nënshkruara gjatë vitit 2012 dhe nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me Fakultetin e Gjeologji-Minierave të Universitetit Politeknik të Tiranës, me Shoqatën e Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës, me Institutin për Studime Publike dhe Ligjore dhe me gazetën 'Ekonomia'.

KLSH vlerëson efektivitetin e lartë të marrëveshjeve me SAI-t partnere gjatë vitit 2012, si me SAI-n polak, turk dhe slloven, të cilat mundësuan trajnime shumë cilësore të audituesve shqiptarë në këto institucione modern auditimi. Në vitin 2013, krahas përfundimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me Gjykatën Austriake të Auditimit, me Institucionin Shtetëror të Auditimit të Malit të Zi, me Zyrën e Auditimit të Institucioneve të Bosnjës dhe Hercegovinës dhe me SAI-n e Maqedonisë. KLSH nisi negociata për përfundimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe me SAI-t e Greqisë, Bullgarisë dhe Serbisë, duke synuar fuqizimin e një rrjeti të vendeve të Evropës Juglindore të institucioneve më të larta të auditimit, nën shembullin dhe eksperiencën e rrjeteve të ngjashme të krijuara në Evropë.

Duke jetësuar **drejtimin e katërt strategjik të INTOSAI-t dhe EUROSAI-t për menaxhim në përputhje me parimet e komunikimit transparent**, KLSH ka intensifikuar marrëdhëniet me publikun dhe qytetarët, duke i sjellë në një nivel të paarritur dhe të pa konceptuar më parë. Ky vit është i treti radhazi, në të cilin analizat vjetore në nivel departamenti auditimi zhvillohen krejtësisht të hapura, në prani të përfaqësuesve të medias, përgjatë disa ditëve dhe finalizohen me analizën e përgjithshme.

Pas një përmbysje reale të marrëdhënieve formale dhe hipotetike me qytetarin dhe median, të vërejtura në vitet 2009, 2010 dhe 2011, gjatë vitit 2013 institucioni ka **trajtuar 401 letra dhe ankesa** nga qytetarët, për probleme të ndryshme, në krahasim me një numër të papërfillshëm të letrave dhe ankesave të trajtuara në vitin 2011.

Krahas shtimit të vrullshëm të pranisë së rezultateve dhe gjetjeve të auditimeve të institucionit në median e shkruar dhe elektronike, të vërejtur edhe gjatë vitit 2012, risi e vitit 2013 ishte angazhimi i 42 punonjësve të KLSH, kryesisht kryeauditues dhe auditues të lartë, në përgatitjen dhe botimin e mbi 140 shkrimeve, analizave dhe opinioneve, në

të gjitha gazetat e vendit. Me këtë rast, falënderojmë të gjitha mediat që i rezervuan, me mirëdashje dhe profesionalizëm, hapësirë nismës së tyre.

Në vitet 2012 dhe 2013, në zbatim të standardeve ISSAI për publikimin e gjetjeve dhe referencave të SAI-ve, institucioni ka botuar 22 tituj librash profesionale, udhëzues auditimi, si dhe me karakter informativ dhe historik. Personalitete të financave dhe auditimit publik kombëtar dhe ndërkombëtar kanë dhënë një kontribut cilësor me studime dhe artikuj për revistën "Auditimi Publik", e njohur si botim shkencor nga Ministria e Arsimit dhe ndërkombëtarisht me numrin identifikues ISSN. Botimet kanë ndihmuar, duke e bërë më transparente të gjithë veprimtarinë e KLSH-së dhe duke ndikuar në rritjen e kapaciteteve audituese. Ndër botimet e vitit 2013 mund të përmendim: *"Udhezuesi i Auditimit Financiar (ISSAI 1000-2999)", "Udhëzuesi i Auditimit të Përputhshmërisë (ISSAI 4000-4200)"* dhe *"Standardet e Auditimit te Borxhit Publik (ISSAI 5410-5440)"*.

Gjatë vitit 0013, në ambientet e KLSH, kemi përuruar një mini-ekspozitë me foto, dokumente dhe botime nga historiku 89 vjeçar i KLSH, e cila pasurohet në vijimësi.

Në nëntor 2013, KLSH mori pjesë me një stendë modeste, në Panairin e Librit në Tiranë, ku ekspozoi 17 titujt e librave të botuar deri atëherë, ndërsa në dhjetor organizoi në Tiranë **Konferencën e dytë shkencore**, me temë "Roli i Institucioneve Supreme të Auditimit për një menaxhim financiar të përgjegjshëm me sfidat e sotme", ku morën pjesë rreth 120 pjesëmarrës nga SAI-t e zhvilluara partnere të KLSH dhe nga SAI-t e rajonit, përfaqësues të institucioneve të tjera shtetërore, të botës akademike, të shoqatave të profesionistëve të fushës, të shoqërisë civile dhe mediave, audites nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, etj.

Gjetjet e auditimeve të KLSH-së gjatë vitit 2013, krahasuar me fondet në dispozicion nga Buxheti për funksionimin e institucionit, kanë rritur treguesin e dobishmërisë dhe efektivitetit të institucionit, tregues ky i përdorur gjerësisht nga institucionet moderne të auditimit suprem.

Për vitin 2013, për **një lek** të harxhuar nga KLSH, institucioni ka theksuar dhe kërkuar shpërblimin e dëmit ekonomik **për 52.4 lekë**, nga 17 lekë të kërkuara për çdo lek shpenzim, në dy vitet e marra së bashku, 2010 (6 lekë) dhe 2011 (28 lekë). Shifrat flasin vetë.

Sikurse e ka theksuar Deklarata e Pekinit e Kongresit INCOSAI XXI, "*SAI-t do të vazhdojnë t'i shërbejnë shoqërisë dhe publikut, duke promovuar zhvillimin e qëndrueshëm dhe përmirësimin e qeverisjes kombëtare, forcimin e demokracisë, përmirësimin e shtetit ligjor, duke luftuar korrupsionin, ruajtur sigurinë kombëtare dhe duke nxitur reformë*".

Në këtë frymë dhe mision, ne do të japim kontributin tonë si KLSH, për punën në sistem, ku përfshihen: Qeveria, Opozita, Kuvendi dhe Institucionet e Pavarura dhe Shoqëria Civile e Mediat, për përmirësimin e qeverisjes dhe rritjen e përgjegjësisë dhe llogaridhënies së institucioneve publike.

Viti 2014 do të konsolidojë objektivat e vendosura në Strategjinë e KLSH-së 2013-2017 dhe në Planin e saj të Veprimit.

Ju faleminderit!

AUDITIMI KOMBËTAR, NË SHËRBIM TË QEVERISJES KOMBËTARE

Analiza e KLSH-së për vitin 2014[111]

Analiza vjetore për vitin 2014 është zhvilluar në mjediset e Universitetit publik "Ismail Qemali" të Vlorës, më datë 26-27.01.2015 me pjesëmarrjen e shumë përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe organizatave profesionale të fushës, partnerë të KLSH-së, si Prof. Dr. Jorgji Bollano, Prof. Dr. Skënder Osmani, Prof. Ass.Dr. Sazan Guri, z.Gledis Gjipali, etj., si dhe analistë dhe publicistë të njohur, si z.Artur Çani, z.Mitro Çela, z. Ago Nezha dhe gazetarë të qytetit të Vlorës.

Të nderuar partnerë të ftuar, të nderuar pedagogë dhe studentë të Universitetit "Ismail Qemali",

Të nderuar kolegë auditues!

Me lejoni të theksoj se kjo analizë vjetore e Kontrollit të Lartë të Shtetit zhvillohet jo pa qëllim në mjediset e një prej universiteteve publike të vendit, me tradita dhe cilësi mësimdhënieje, që mban emrin e themeluesit dhe burrit më të madh të kombit shqiptar, Ismail Qemalit. Mjedisi akademik gjeneron ide, përqasje dhe metodika pune me shumë vlerë për auditimin suprem kombëtar. Falënderoj Profesoratin e Universitetit që na pranoi në mjediset e tij dhe së bashku me shumë studentë të tij është pjesë integrale e analizës sonë.

Kjo përbën risinë e parë të përqasjes sonë për të njohur më mirë punën që kemi kryer gjatë vitit të shkuar edhe si një pjesë përbërëse e standardeve të INTOSAI-t (ISSAI 1, Deklarata e Limës, neni 12, *"Opinioni i Ekspertit dhe e Drejta për Konsultim:bashkëpunimi me ambientet akademike").*

Risinë e dytë e përbën fakti që po e kryejmë këtë analizë në frymën e kërkesave të

[111] Raportin e zgjeruar të veprimtarisë së KLSH, mbajtur nga Kryetari Bujar Leskaj e gjeni në adresën www.klsh.org.al/ Raporti Vjetor i Performancës 2014

integritetit dhe Programit të Vetëvlerësimit "IntoSAINT" të Gjykatës Holandeze të Auditimit, program i cili po zbatohet gjerësisht këto dy vitet e fundit nga dhjetëra institucione supreme të auditimit(SAI) në Evropë dhe në të gjithë botën, për të matur rezultatet e punës së tyre me grilën e integritetit të përcaktuar nga Gjykata Holandeze e Auditimit, duke synuar rritjen e llogaridhënies dhe transparencës së vetë institucionit. Ne, si Audituese supreme publike, kemi përgjegjësi të madhe përpara qytetarëve, Kuvendit dhe Kushtetutës. Jo thjesht të deklarojmë arritjet, por duhet të shikojmë thelle brenda vetes, për të zbuluar mangësitë dhe dobësitë që kemi, për t'i shmangur ato në të ardhmen dhe përmirësuar në vijimësi performancën tonë.

Kur përmirësojmë punën tonë, jemi të ndërgjegjshëm se rritet kontributi ndaj një çështjeje themelore për fatet e demokracisë tek ne: MIREQEVERISJA. Qeverisja përmirësohet kur luftohet me efektshmëri korrupsioni. Perceptimi i qytetarëve dhe përfundimet e sondazheve, vrojtimeve dhe studimeve të partnerëve tanë ndërkombëtare tregojnë se korrupsioni është ende mjaft i përhapur dhe galopant në Shqipëri. Në këto kushte, asnjë institucion publik nuk duhet të mburret, por të ndihet përgjegjës për këtë situate. Korrupsioni është një ndërtim pa leje, që legalizohet kur, institucionet qeveritare dhe ato të pavarura, tregohemi indiferente dhe nuk punojmë në sistem, me partneret tanë të natyrshëm, për ta luftuar atë.

Me këtë përgjegjësi e zhvillojmë analizën vjetore të KLSH-së për vitin 2014. Për të nxjerrë përgjegjësitë tona, na ndihmojnë shumë dhe këtu qëndron risia e tretë e kësaj analize, këndvështrimi, gjykimet dhe këshillat e partnerëve tanë të shoqërisë civile. Eksperienca, dijet, sinqeriteti dhe pavarësia e plote e mendimit të shume personaliteteve të shoqërisë civile, një pjesë e të cilëve janë edhe sot këtu me ne dhe i falënderojmë, përbejnë pasqyrën me profesionale ku mund të shihemi për çfarë kemi arritur, ku i kemi dobësitë dhe si mund të përmirësohemi në të ardhmen. Kjo është edhe arsyeja që po e zhvillojmë këtë analize vjetore pa politikanë dhe mesazhet e tyre. Sikurse e ka theksuar Prof. Dr. Omer Stringa: "*Mirëqeverisja e institucioneve publike kërkon angazhim të vazhdueshëm dhe bashkëpunim strategjik të aktorëve kryesore. Zbatimi i sistemeve të vlerësimit të performancës së secilit aktor në mirëqeverisjen publike, identifikimi paraprak dhe dakordësia mbi treguesit ku bazohet matja e performancës së institucioneve është e një rëndësie parësorë në nxitjen e institucioneve që të përqendrojnë energjitë dhe resurset e tyre në përmbushjen me efektivitet të objektivave afatgjate*".

A. Përqasja "IntoSAINT"

Kontributi në rritjen e llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë së administrimit të fondeve publike, nuk mund të realizohet nga KLSH, pa qenë një institucion model në kërkimin e llogarisë brenda stafit të tij. Nga ana tjetër, për institucionet publike në botën demokratike, dhënia e llogarisë dhe transparenca nuk mund dhe nuk duhet të jenë agjitprop!

Ja perse kjo analizë zhvillohet në frymën e kërkesave të integritetit dhe Programit te Vetëvlerësimit "IntoSAINT" të Gjykatës Holandeze të Auditimit, i njohur dhe i pranuar që nga viti 2011 nga organizata INTOSAI. Auditimi i integritetit, si për SAI-t, ashtu dhe për institucionet që auditon, është një sfidë e rëndësishme dhe thelbësore e të gjitha SAI-ve sot në botë. Integriteti nuk është një koncept i thjeshtë për t'u përcaktuar. Shumë përkufizime mbivendosen dhe përcaktime të dallueshme përdoren. Integriteti i referohet virtytit, moskorruptimit dhe gjendjes së të qenit i papërlyer.

Nga viti 2012, kur ne, si KLSH, u njohëm me programin IntoSAINT dhe vendosëm zbatimin e tij në qendër të vëmendjes sonë. Periudha deri në fund të vitit 2013 ishte për ne periudhë e njohjes më të thelluar të Programit dhe të vlerave të tij.

Si SAI ndajmë plotësisht opinionin e Nismës për Zhvillim të INTOSAI -t (IDI), se "*Sjellja etike e SAI-t dhe e punonjësve të tij përbën gurin e themelit për një funksionim të mirë të SAI -t. Që një SAI të udhëheqë sipas shembullit dhe të sjellë vlera dhe dobi tek qytetarët, nuk mjafton vetëm të miratojë kodin e duhur të etikës, por gjithashtu të vendosë zbatimin me rigorozitet të tij dhe të ketë një kuadër rregullator, i cili t'i detyrojë punonjësit të zbatojnë etikën në praktikë*" .

Bazuar në këto kërkesa dhe punë paraprake të komunitetit të INTOSAI-t, gjatë vitit 2013, KLSH u pranua anëtar i Task Forcës për Auditimin dhe Etikës së Organizatës Europiane të Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAI). KLSH, nëpërmjet anëtarësimit dhe pjesëmarrjes aktive në këtë strukturë, synon instalimin dhe funksionimin e një infrastrukture efektive etike në institucion. Nga ana tjetër, si SAI do të ndërmarrim misione auditimi mbi rregullshmërinë dhe efiçiencën e Etikës dhe Integritetit në institucionet publike, duke punuar që lufta kundër korrupsionit dhe politikat për instalimin e një sistemi efektiv të integritetit, të jenë pjesë e menaxhimit të institucioneve publike.

Në qershor 2013, KLSH u anëtarësua në Grupin për Rishikimin e ISSAI 30- Kodi i Etikës, një nismë e Këshillit Mbikëqyrës të Komitetit të Standardeve Profesionale të INTOSAI -t.

Në Kongresin INCOSAI XXI, mbajtur në Pekin në 21 -26 Tetor 2013, Gjykata Holandeze e Auditimit raportoi për përhapjen e metodës IntoSAINT në shumë SAI në botë. Kongresi konkludoi se një bazë e fortë solide është krijuar, mbi të cilën INTOSAI mund të ndërtojë mekanizmin e duhur për t'i mundësuar SAI -t të udhëheqin sipas shembullit, për të realizuar integritetin e plotë. Në një linje me rekomandimet e Kongresit, gjatë vitit 2015, KLSH do të ndërmarrë një auditim vetëvlerësimi të integritetit, duke përdorur programin IntoSAINT.

Ne jemi të ndërgjegjshëm për problematikat e integritetit në KLSH dhe se ngelet shumë punë për të realizuar integritetin e plotë në institucion. Gjatë këtyre viteve 2012-2014,

jemi përpjekur me mbikëqyrje dhe monitorim, që në institucion të mos rezultojnë incidente të karakterit korruptim apo shkelje ndaj integritetit. Nxitja e integritetit ka qenë në fokus të veprimtarisë menaxhuese. Sipas këshillave dhe orientimeve të personalitetit të auditimit suprem evropian, Prof. Dr. Recai Akyel, President i Gjykatës së Llogarive të Turqisë, kemi zbatuar në praktikë filozofinë e menaxhimit "Tone at the top", duke promovuar integritetin nën parimin e *"udhëheqjes nëpërmjet shembullit"*.

Gjatë vitit 2014, kemi synuar arritjen e një ekuilibër midis parandalimit të shkeljeve dhe marrjes së masave ndëshkimore nga njëra anë dhe inkurajimit të vlerave të integritetit, nga ana tjetër. Në lidhje me masat ndëshkimore veprimtaria institucionale është përqendruar në drejtim të zbulimit, hetimit dhe ndëshkimit të shkeljeve. Dua të theksoj me forcë se gjatë tre viteve të fundit, në KLSH është çrrënjosur praktika e mosndëshkueshmërisë dhe për çdo shkelje të integritetit, të zbuluar dhe hetuar, janë ndërmarrë masa ndëshkimore deri në ndjekje penale për ish audituesë. Kjo praktike është ndjekur rigorozisht, pasi mosndëshkueshmëria sjell dëme të pariparueshme për institucionin e KLSH-së, humbjen e kredibilitetit institucional në përgjithësi dhe të besimit të publikut në veçanti.

Nëse një shkelje e integritetit kalon pa u ndëshkuar, kjo sjell automatikisht demotivimin e anëtarëve të tjerë me moral të shëndetshëm të stafit të KLSH-së. Në vitin 2012, nga ankesat e dërguara nga qytetarët, KLSH ka kallëzuar penalisht dy punonjës të tij. Gjatë vitit 2013, KLSH ka kallëzuar në Prokurori 4 audituesë të tij, të akuzuar për veprën penale të "Shpërdorimit të detyrës" dhe "Falsifikimit të dokumenteve", si dhe ka larguar nga institucioni një numër audituesish të gjetur në shkelje të integritetit. Për vitin 2014, KLSH ka larguar nga puna 4 audituesë për çështje të integritetit. Me synim instalimin dhe zhvillimin më tej të një kulture të re organizative, gjatë dy viteve 2013 dhe 2014, kemi nxjerrë udhëzime lidhur me komunikimin e drejtpërdrejtë për përmirësimin e punës audituese dhe rritjen e zbatimit të standardeve të INTOSAI-t. Kam kërkuar, në mënyrë periodike, takim të drejtpërdrejtë me audituesit, për t'i nxitur ata të luajnë rolin e *"bilbil – fryrësit (whistle-blower)",* për të dhënë mendime për përmirësimin e strukturave dhe të komunikimit vertikal të dyanshëm të menaxhimit me audituesit.

Në nëntor të vitit 2014, krijuam një strukturë të veçantë, Sektorin e Etikes dhe Integritetit, pjesë e Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Etikës. Brenda këtij sektori, krijuam Komisionin e Integritetit, i cili ka përgjegjësi si strategjike dhe menaxheriale, duke qenë përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kërkesave të kodit etik, komunikimin rreth çështjeve të etikës, trajnimin për etiken dhe integritetin, kryerjen e këshillimeve dhe zgjidhjen e dilemave të etikes dhe integritetit, si dhe ka kompetenca hetimi dhe kontrolli në rastet e sinjalizimeve për thyerjen e rregullave të integritetit, etikes dhe standardeve.

Bazuar në kërkesat e ISSAI 30, si dhe në gjetjet e Grupit të Punës për Rishikimin e ISSAI 30, të kryesuar nga NIK-u polak, si dhe në eksperiencën me Kodin Etik të GAO-s amerikane, institucion të cilin do të kem nderin ta vizitoj në shkurt të këtij viti, do të hartojmë gjatë këtij viti një dokument të ri të Kodit Etik për KLSH, i cili do të reflektojë praktikat më të mira të fushës.

Jemi të ndërgjegjshëm për rrugën e gjatë dhe të vështirë që na pret përpara, kur bëhet fjalë për sfidën e sigurimit të integritetit të plotë të institucionit. Nuk mund të kënaqemi me atë çka kemi bërë dhe të flemë mbi dafina.

B. Rezultatet e Punës

Për vitin 2014, KLSH ka kryer 160 auditime, nga 153 auditime të kryera në vitin 2013, ose **4.8 përqind** më shumë. Për vitin 2014, KLSH ka zbuluar dëm ekonomik ndaj Buxhetit të Shtetit në nivelin 11.2 **miliardë lekë(ose rreth 80 milionë euro),** duke kërkuar shpërblimin e demit, pra arkëtimin në Buxhet të 98.9 **përqind të tyre**. Demi ekonomik i zbuluar në vitet 2012, 2013 dhe 2014, është rreth **3.8 herë më i madh** se vlera e dëmit të zbuluar në vitet 2009, 2010 dhe 2011, të marra së bashku.

Treguesi i efiçiencës së institucionit është **38 lekë** të zbuluar si Dem Ekonomik ndaj Buxhetit të Shtetit dhe ka kërkuar për arkëtim, për çdo lek të harxhuar nga KLSH gjatë vitit 2014, gjë që dëshmon për dobinë e lartë të aktivitetit auditues. Krahasuar në vite, mesatarja e treguesit të efiçiencës së institucionit për vitet 2012-2014 është **2.6 herë më e lartë** se mesatarja e viteve 2009-2011.

KLSH gjatë vitit 2014 ka propozuar disa ndryshime të rëndësishme kushtetuese dhe ligjore.

Së pari, me synim promovimin e qëndrueshmërisë dhe kredibilitetit të financave publike, si dhe vlerësimin e planifikimit dhe performancës fiskale, të projeksioneve makroekonomike dhe parashikimeve buxhetore, kemi rekomanduar **krijimin e një Këshilli Fiskal me statusin e një autoriteti të pavarur** ndaj Qeverisë, i cili i raporton Kuvendit, për të kryer oponenca të politikave fiskale, pa ndikime të politikës dhe që të jenë thellësisht teknike dhe të pavarura.

Së dyti, duke patur parasysh situatën e brishtë makroekonomike të vendit, në optikën e uljes së nivelit të borxhit publik, si dhe trajektoren e borxhit publik ndaj PBB gjatë viteve të fundit, kemi rekomanduar që Ministria e Financave **të hartojë një kuadër rregullat or fiskal**, i cili të synojë reduktimin e nivelit të borxhit publik në një periudhë të përcaktuar kohore dhe sigurimin e një qëndrueshmërie afatgjatë të borxhit publik. Kemi **përsëritur për të dytin vit radhazi** rekomandimin që Ministria e Financës të paraqesë në Kuvend një nismë ligjore për vendosjen në Kushtetutë dhe në Ligjin *"Për*

menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të treguesit të borxhit publik ndaj PBB-së, **në nivelin tavan 60 %,** dhe arritjen e këtij niveli në terma afatgjatë.

Së treti, me synim arritjen e pritshmërive në planifikimin e buxhetimit të integruar dhe efiçient të shpenzimeve publike, rritjen e përgjegjshmërisë në nivel menaxherial, përmirësimin dhe rritjen e transparencës së raportimit financiar të qeverisë, forcimin e kontrollit të brendshëm në sektorin publik dhe mbikëqyrjen efektive parlamentare, institucioni ka rekomanduar që **gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e KLSH-së të jenë pjesë përbërëse dhe të skedulohen në Planin e Veprimit** dhe në aktivitet kryesore, në kuadrin e implementimit të strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020.

Së katërti, kemi kërkuar përcaktimin në Ligjin Organik të Buxhetit **të përdorimit të të ardhurave nga privatizimi, 50 përqind për uljen e borxhit publik dhe 20 përqind për dëmshpërblimin e ish të përndjekurve politikë**.

Po ashtu, kemi rekomanduar hartimin e një ligji që të trajtojë në mënyrë të plotë rastet e përgjegjësive materiale të të punësuarve në sektorin publik, me qëllim parandalimin e dukurive që nxisin dëmtimin e fondeve dhe aseteve publike,. Gjithashtu kemi kërkuar saktësinë e evidentimit të shpenzimeve kapitale me financim të huaj. Kemi kërkuar që të jetë Kuvendi ai që do të përcaktojë përdorimin e Fondit të Kontingjencës, si dhe sa herë që përdoret Fondi Rezervë i Këshillit të Ministrave. Kjo gjë duhet të bëhet me miratimin paraprak të Ministrit të Financave, për të shmangur prekjen e tij pa kriter, sa herë që kjo kërkohet nga dikastere të veçanta. KLSH ka rekomanduar krijimin e një Komiteti Auditimi, në varësi të dyfishtë nga Kryeministri dhe Ministri i Financave, i cili do të siguronte një nivel pavarësie të strukturës shumë të rëndësishme të auditimit të brendshëm, etj.

Duke zbatuar objektivin tonë strategjik të përmirësimit të qeverisjes, nëpërmjet thellimit të luftës kundër korrupsionit, për shkelje të dispozitave ligjore në fuqi, me pasojë shpërdorimin e fondeve publike dhe dëmtimin e pronës publike**,** kemi bërë 41 kallëzime penale ndaj 149 punonjësve, përgjithësisht nëpunës të lartë dhe të mesëm të administratës. Sfidat tona kryesore në përmbushjen e misionit tonë kushtetues janë dy: modernizimi i KLSH dhe rritja e kontributit në mirëqeverisje, nëpërmjet thellimit të luftës kundër korrupsionit.

Modernizimi i institucionit mund të realizohet i plotë vetëm duke respektuar rigorozisht, në punën tonë, standardet ndërkombëtare të fushës, standardet e INTOSAI-t. Për këtë kishim nevoje për një ligj themeltar të ri, të cilin na e kishin rekomanduar fuqimisht dhe në vijimësi Progres-Raportet e Bashkimit Evropian që nga viti 2008 e deri në vitin 2013. Në bashkëpunim me DG-Budget dhe SIGMA-n,

paraqitëm që në nëntor 2012 draft-ligjin e ri. Gjatë vitit 2014, veçoj dialogun në Parlament dhe seancat maratonë në Komisionet e Kuvendit, ku evidentoj bashkëpunimin me deputetet e Komisionit të Ekonomisë. Kuvendi miratoi ligjin në nëntor 2014, ligj që u kthye nga Presidenti i Republikës për korrigjimin e nenit 23. Brenda janarit 2015, ky ligj do të miratohet përfundimisht dhe do të dekretohet. Ky ligj shënon shkëputjen përfundimtare të KLSH-së nga kontrollet e tipit inspektim financiar, i mundëson institucionit dhënien e opinionit për pasqyrat financiare të enteve të audituara dhe realizon profilizimin e tij si një institucion modern evropian i auditimit suprem publik, i cili e bazon tërësisht aktivitetin e tij në standardet e INTOSAI-t dhe moton e kësaj organizate *"Experentia mutua Omnibus prodest- Eksperienca e përbashkët u shërben të gjithëve"*. Sipas z. Robert Gielisse, këshilltar kryesor i Drejtorit të Përgjithshëm të DG-Budget, "*Strategjia e re e zgjerimit të Bashkimit Evropian e vendos në vijën e parë qeverisjen ekonomike. KLSH si Auditues i Jashtëm publik, është gur-themeltar i përmirësimit të qeverisjes ekonomike në vendin tuaj dhe ligji i ri, po të miratohet tërësisht në përputhje me standardet INTOSAI, ia mundëson KLSH-së këtë rol* [112]".

Viti 2014 ishte viti i përfundimit të procedurës së përzgjedhjes së partnerëve të KLSH-së në Projektin e Binjakëzimit ***"Për Forcimin e kapaciteteve të Auditimit të Jashtëm",*** në kuadër të asistencës së BE-së për Shqipërinë, nëpërmjet Instrumentit të Para-zgjerimit, IPA 2013, me vlerë 2.11 milionë euro, pas një aplikimi dyvjeçar nga institucioni ynë.

Partnerët e KLSH-së në Projekt janë përzgjedhur Zyra Kombëtare e Auditimit e Polonisë dhe SAI i Kroacisë, të dyja këto institucione të auditimit suprem shumë të zhvilluara dhe me përvojë të madhe pune e bashkëpunimi.

Projekti për KLSH-në është ndër 7 projektet e përzgjedhur nga BE në vitet 2013 dhe 2014, për t'u implementuar në mënyrë të decentralizuar nga institucionet e shtetit shqiptar. Zbatimi i tij nis në maj të vitit 2015, për një periudhë dyvjeçare deri në maj 2017. Projekti i binjakëzimit do ta ndihmojë KLSH jo vetëm të rrisë kapacitetet e tij audituese, por edhe do të shërbejë si një mjet i fuqishëm për arritjen e objektivave themelore të Strategjisë së zhvillimit të institucionit 2013-2017.

C. Drejtimet Strategjike të realizuara

Gjatë vitit 2014, kemi orientuar dhe më shumë punën në përmbushjen e ***drejtimit të dytë strategjik të INTOSAI-t dhe EUROSAI-t, zbatimit të standardeve profesionale ISSAI,*** i cili përmbahet dhe në Strategjinë e KLSH-së 2013-2017.

[112] Nga fjala e z. Robert Gielisse në Konferencën e III-të Shkencore të KLSH-së

Institucioni ka forcuar kapacitetet audituese, nëpërmjet një procesi të vazhdueshëm kualifikimi, kryerjes së trajnimeve të thelluara dhe gërshetimit të ngritjes arsimore me veprimtarinë praktike audituese. Struktura e punonjësve ka vijuar të ndryshojë, jo vetëm thjesht në favor të stafit auditues me arsim të lartë, por dhe të stafit me kualifikime profesionale, akademike dhe grada shkencore, si dhe me kualifikim në fusha të dyta ekspertize. Çdo auditues i KLSH-së u trajnua mesatarisht për **26 ditë** gjatë vitit 2014, ose mbi trefishin e viteve 2009, 2010 dhe 2011, të marra së bashku. Pra, tashme kemi një tregues të qëndrueshëm në trajnime.

Në tre vitet e fundit, 2012-2014 institucioni ka ndryshuar thellësisht koncept dhe politikë në drejtim të zhvillimit të burimeve të veta njerëzore. KLSH është investuar tërësisht dhe pa kthim mbrapa, drejt shtimit dhe rritjes cilësore të kapaciteteve të tij audituese, duke tërhequr në staf personalitete nga profesorati i ekonomikut dhe jurisprudencës, duke nxitur audituesit e rinj të shtojnë dijet shkencore dhe duke i bashkërenduar me audituesit me përvojë, të cilët ata nga ana e tyre testohen dhe motivohen për ngritje në karriere. Nga një institucion i disa viteve më parë praktikisht pa trajnim të audituesve të vet, është kthyer në SAI me tregues perëndimore trajnimi të stafit.

Gjatë vitit të kaluar, KLSH materializoi më shumë kontributin e tij në Programin "3i, Iniciativa e Implementimit të ISSAI-ve". Grupi i punës i institucionit, me mbështetjen e SIGMA-s, ka plotësuar të gjitha detyrimet që rrjedhin nga kjo marrëveshje me Institutin e Zhvillimit të INTOSAI-t (IDI) dhe EUROSAI-t.

Në zbatim të drejtimit të tij strategjik si dhe të drejtimit të tretë strategjik të INTOSAI-t dhe EUROSAI-t për shkëmbimin e njohurive dhe të përvojës me partneret (ku përfshihen SAI-t partnere, shoqëria civile dhe publiku), KLSH ka konsoliduar bashkëpunimin me partnerët e deritashëm vendas dhe të huaj, si SAI, shoqata profesionale brenda dhe jashtë vendit, organizata të shoqërisë civile dhe media, por dhe ka zgjeruar bashkëpunimin, duke lidhur marrëveshje të reja.

Si KLSH, bashkëpunimin me shoqatat profesionale dhe shoqërinë civile e kemi ngritur në një nivel te ri, të produkteve të përbashkëta dhe partneriteti të plotë. Nëse në dy vitet e para të marrëdhënieve kontraktuake me to, 2012-2013, kemi shkëmbyer informacione, duke thelluar njohjen reciproke, gjatë vitit 2014, kemi realizuar projekte konkrete bashkëpunimi me disa prej OJF-ve dhe organizatave të profesionistëve të fushës në këto drejtime:

- "Kontrolli i Cilësisë në të ftohtë", nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit;
- "Realizimi i transparencës dhe komunikimit të KLSH -së me publikun dhe qytetarët", nga Lëvizja Evropiane, Shqipëri;

- "Kontrolli i Procesit të rekrutimit të stafit të KLSH -së", nga Instituti "G&G Group";
- "Analiza e impaktit të shkrimeve të Audituesve të KLSH-së në shtypin e shkruar", nga botuesi i Gazetës "Ekonomia".

Përfaqësuesit kryesore të këtyre organizatave partnere të KLSH-së do të japin sot vlerësimet e tyre për bashkëpunimin e realizuar.

Të gjitha këto projekte i kemi konsideruar si *Mini Peer Review,* pra rishikime mes kolegësh, në parapërgatitje të një "Peer Review" me një SAI partner nga Europa, që e kemi kërkuar gjatë vitit 2014 dhe do ta kryejmë gjatë këtij viti. Projektet kanë nxjerrë produkte konkrete, ku janë evidentuar përveç arritjeve, dhe mangësitë e dobësitë e institucionit tone. Të gjitha rekomandimet e dhëna nga këto organizata do t'i shikojmë gjatë këtij viti me prioritet, me qëllim përmirësimin e punës në të ardhmen.

Vitin e kaluar, një arritje në marrëdhëniet e institucionit me botën akademike, profesoratin shqiptar dhe partnerët e huaj e shënoi Konferenca e Tretë Shkencore e KLSH-së, me teme "***Auditimi kombëtar në shërbim të qeverisjes kombëtare"***, e zhvilluar në Tiranë më datat 29-30 tetor 2014. Ajo realizoi avokatinë e plotë të profesionit të financierit publik, kontabilistit dhe audituesit publik suprem, duke përcjellë mesazhin se pa financierë, kontabilistë dhe auditues të përgatitur mirë dhe me integritet të lartë, qeverisja e vendit humbet shumë në llogaridhënie, transparencë, efektivitet dhe efiçiencës. Për herë të parë në Shqipëri, konferenca hapi një debat të rëndësishëm, atë të analizës së riskut për auditimin publik. Sikurse e theksoi Prof. Dr. Skënder Osmani, "*Baza e të dhënave është themelore për njehsimin e riskut. Duhet të përqendrohemi në analizën e riskut në sektorë të ndryshëm ekonomiko-socialë, si në burimet energjetike, drejtësi, financë arsim, minerale, shëndetësi, rend, mjedis, etj. Duhet të shikojmë mundësinë për ngritjen e një institucioni që të merret me standardet e burimeve njerëzore, natyrore, energjisë, mineraleve, etj., duke përfshirë rezervat, klasifikimin e tyre e deri në analizën e riskut, shfrytëzimin e rezervave, kontratat, etj. Në funksionimin e këtij institucioni duhet patur parasysh edhe përvoja e vendeve të tjera*".

Prof. Dr. Jorgji Bollano bëri në konferencë një propozim interesant. Ai kërkoi që "*Të bëhet një riklasifikim në rritje i kufijve të njësive ekonomike që ligjërisht i nënshtrohen detyrimit për t'u audituar".*

Duke realizuar parimet dhe orientimet e standardeve të INTOSAI-t për realizimin e një transparencë të plotë me publikun dhe mediat, si dhe objektivin e tij strategjik për komunikimin, KLSH ka rritur gradualisht, duke arritur në fund të vitit 2014 që të gjashtëfishojë praninë e tij me informacion dhe mesazhe në median e shkruar dhe të katërfishojë prezencën e tij në median audiovizive, krahasuar me vitin 2010. Gjatë 2014,

shtypi i shkruar ka pasqyruar raportet dhe njoftimet e KLSH-së për shtyp në 867 artikuj, njoftime, editorialë dhe komente analitike, përkundrejt 690 gjithsej përgjatë vitit 2013, ose 26% më shumë.

14 botimet e reja të KLSH-së për vitin 2014, të cilat variojnë nga publikime informuese për raportet vjetore të institucionit dhe marrëdhëniet me Kuvendin, tek botimet shkencore për standardet e INTOSAI-t, për udhëzuesit e auditimeve të ndryshme, etj., i shtohen kolonës së 21 titujve të botimeve të viteve 2012-2013.

Gjatë vitit të shkuar, institucioni ka rritur praninë në median e shkruar të vendit, duke bashkëpunuar me gazetat me 134 shkrime, të shkruara nga 51 audituesë të KLSH-së, përkundrejt 124 shkrimeve të 42 audituesve të vitit 2013.

Faqja Web e KLSH-së ka informacione të përditësuara për planet dhe raportet e Auditimeve, raportin e aktivitetit të KLSH-së, standardet e auditimit, bazën ligjore, raportet e KLSH -së për zbatimin e buxhetit të shtetit, strukturën, botimet, aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, etj.

KLSH është shumë e hapur edhe ndaj ankesave të qytetarëve, të cilat na adresohen me postë të zakonshme ose elektronike. Këto letër-ankesa të qytetarëve, administrohen me profesionalizëm nga punonjësit e KLSH-së në funksion të tematikës që trajtojnë dhe qytetarët marrin në çdo rast përgjigje për shqetësimin e ngritur, me përjashtim të rasteve kur çështjet e ngritura nuk janë kompetencë e KLSH-së. Kontrolli i Lartë i Shtetit ka trajtuar gjatë 2014, 394 letra dhe ankesa**,** për probleme të ndryshme, nga të cilat 170 rezultuan jashtë kompetencave dhe juridiksionit të institucionit. Nga 224 kërkesa dhe ankesa në kompetencë të KLSH-së, 121 prej tyre janë verifikuar dhe u është dhënë përgjigja përkatëse, ndërsa 103 janë në procesin e verifikimit.

Konkluzion

Parë në tërësi, viti 2014 ka përbërë për institucionin e KLSH-së një vit konsolidimi dhe qëndrueshmërie të reformave të nisura që në vitin 2012. Cilësia e rritur e auditimeve dhe rekomandimeve tona, shtimi i ndjeshëm i numrit të auditimeve të performancës, kontributi në përmirësimin e qeverisjes nëpërmjet shtimit të kallëzimeve penale, investimi në një ligj të ri modern dhe në një projekt ambicioz binjakëzimi, të financuar nga Bashkimi Evropian, janë rrugët e duhura për të realizuar plotësisht misionin tonë kushtetues dhe sipas standardeve të INTOSAI-t, atë të rritjes së llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë së institucioneve që auditojmë.

Të nderuar të ftuar, të nderuar auditues,

Bazuar në punën e bërë dhe konsolidimin e reformave që kemi nisur, duke pasur parasysh shtimin e ndikimit dhe të rolit të SAI-ve në botë, të konfirmuar nga Rezoluta e dytë A/69/228 e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara të datës 19 dhjetor 2014, duke synuar realizimin e plotë të programit IntoSAINT për KLSH, jemi të bindur se ky vit 2015 do të jetë viti i zbatimit të ligjit të ri dhe i përsosjes së mënyrës së organizimit dhe drejtimit të institucionit, për të përçuar praktikat më të mira të institucioneve simotra evropiane ne këto fusha.

Qëndrueshmëria në ecurinë e reformave do të na sjellë rezultate më të larta në përmirësimin e qeverisjes kombëtare, në sinergji dhe bashkëpunim të plotë me qytetarin, Kuvendin, shoqatat profesioniste dhe shoqërinë civile. Ju faleminderit!

TË NDRYSHOSH PËR MIRË OPINIONIN PUBLIK MBI NJË SHËRBIM APO VEPRIM SHTETËROR, KE NDRYSHUAR PËR MIRË QEVERINË

Analiza e KLSH-së për vitin 2015[113]

Analiza vjetore për vitin 2015 është zhvilluar në sallën "UNESCO" të Muzeut Historik Kombëtar, më datë 01.02.2016. Kjo analizë erdhi në përfundim të analizave të departamenteve të auditimit që u zhvilluan në fund të vitit 2015 në Universitetet Publike në rrethe të ndryshme të vendit si në Universitetin "Aleksandër Xhuvani", në Elbasan, në Universitetin "Ismail Qemali" në Vlorë, në Universitetin "Luigj Gurakuqi" Shkodër dhe në Universitetin e Tiranës. Pjesëmarrës në Analizë ishin Presidenti i Republikës së Shqipërisë SH.T.Z. Bujar Nishani, Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri, Z.Donald Lu, Kryetari i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave në Kuvendin e Shqipërisë, z.Erion Braçe, Prokurori i Përgjithshëm, z.Adriatik Llalla, Avokati i Popullit, z.Igli Totozani, Ministri i Drejtësisë, z.Ylli Manjani; Inspektor i Përgjithshëm i ILDKPKI, z.Shkëlqim Ganaj, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z.Gent Sejko, Kryetari i Autoritetit të Konkurrencës, znj.Lindita Lati, deputetë të Kuvendit të Shaipërisë. eti.

Në këtë periudhë[114] shumë delikate të rritjes ekonomike të vendit dhe të përpjekjeve të mbarë shoqërisë sonë, të ndihmuar nga aleatët tanë strategjikë, për të rritur përgjegjshmërinë e qeverisjes publike, si institucion suprem i auditimit, si SAI, detyrimin tonë e shohim jo ndaj partive politike, por ndaj qytetarit dhe Kuvendit, me misionin, forcën dhe moralin që na ka dhënë

[113] Raportin e zgjeruar të veprimtarisë së KLSH, mbajtur nga Kryetari Bujar Leskaj e gjeni në adresën www.klsh.org.al/ Raporti Vjetor i Performancës 2015

[114] Shënim: Pavarësisht se ky aktivitet i KLSH-së është zhvilluar në shkurt të vitit 2016, është përfshirë në këtë botim për arsye se kjo Analizë Vjetore i takon veprimtarisë së institucionit gjatë vitit 2015.

Kushtetuta, për të kthyer besimin publik ndaj qeverisjes. Në përcjelljen me vërtetësi të gjetjeve, rekomandimeve dhe mesazheve nga auditimet e KLSH-së të vitit 2015, por edhe të viteve të mëparshme falënderojmë të gjitha mediat e vendit, aleatin tonë të përhershëm dhe ndër më kryesorët.

Shumëkush mund të pyesë se përse rekomandimet e KLSH-së do të mund të rrisin besimin e qytetarit tek qeverisja publike. Përgjigjen për këtë e jep Dr. Jozef Moser, Sekretari i Përgjithshëm i INTOSAI-t, i cili thekson se: "*Institucionet supreme të auditimit, mund të shfrytëzojnë plotësisht potencialin e tyre për të kontribuar në qeverisjen e mirë publike vetëm nëse, duke u bazuar në punën e tyre të auditimit, ata gjithashtu angazhohen në veprimtari këshillimore dhe ofrojnë rekomandime specifike për subjektet e audituara dhe për vendim-marrësit*".

Ndër rekomandimet më kryesore që kemi dhënë vitin e shkuar, përmendim:

- Marrjen e nismës ligjore për ngritjen e një Këshilli Fiskal, i cili të gëzojë statusin e një institucioni publik të pavarur dhe të këtë një pavarësi operacionale të qartë e rigoroze nga politika. Një rekomandim të tillë e dha në janar 2016 edhe Fondi Monetar Ndërkombëtar, në Raportin e tij "Country Report" Nr. 16/5 për Vlerësimin e Transparencës Fiskale. Besojmë se një strukturë e tillë e pavarur dhe profesionale do të ndihmonte për një qëndrueshmëri dhe besueshmëri të financave publike, për të përmirësuar planifikimin e treguesve makroekonomikë dhe të parashikimeve buxhetore, duke konsideruar me vëmendjen e duhur risqet fiskale që kalon vendi.
- Për të tretin vit në vijimësi, kemi rekomanduar që Ministria e Financës të paraqesë në Kuvend një nismë ligjore për vendosjen në Kushtetutë dhe në Ligjin *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* të treguesit të borxhit publik ndaj PBB-së, në nivelin tavan 60 % dhe arritjen e këtij niveli të shtrirë në kohë, në terma afatgjatë.
- Në kushtet e përgjegjësisë financiare të ulët të zyrtarëve publikë, i kemi rekomanduar Kuvendit për të dytin vit në vijimësi hartimin e Ligjit *"Për përgjegjësinë materiale",* në të cilin të trajtohet përgjegjësia financiare e punonjësve të njësive publike për dëmet ekonomike të shkaktuara qëllimisht apo nga neglizhenca, gjatë ose në lidhje me kryerjen e detyrave zyrtare. Mungesën e theksuar të përgjegjshmërisë financiare në vend e evidentoi edhe Progres-Raporti i Bashkimit Evropian i vitit 2015. Jemi të sigurt se me hapat për realizimin e plotë të reformës në drejtësi, kjo përgjegjësi do të shtohet, pasi reforma duhet të vijojë edhe në këtë drejtim.
- Me qëllim rritjen e cilësisë dhe profesionalizmit të informacionit financiar dhe fiskal, duke synuar uljen e risqeve fiskale, kemi kërkuar që të ngrihet një sektor i veçantë, brenda Drejtorisë së Thesarit në Ministrinë e Financave, i cili të mundësojë

përshtatjen e pasqyrave të nxjerra nga sistemi i integruar në formën e Pasqyrave të Konsoliduara të Shtetit. Ky sektor duhet të ketë si funksion edhe kontrollin e saktësisë së pasqyrave të përgatitura nga institucionet publike, për ta vënë nën monitorim dhe kontroll profesional këtë proces të rëndësishëm. Pak muaj më vonë, në janar 2016, FMN në Raportin e tij për Vlerësimin e Transparencës Fiskale në Shqipëri udhëzoi unifikimin e raportimit financiar dhe fiskal.

- Duke pasur parasysh vlerat e pozicionimit të SAI-t si këshilltar për qeverisjen, kemi kërkuar që privatizimi i Albpetrol të realizohet, duke ftuar kompani me potenciale dhe kredenciale të larta profesionale nga aleatët strategjikë të vendit tonë (veçanërisht ato me traditë të konsoliduar në sektorin e naftës, si SHBA, Mbretëria e Bashkuar apo Gjermania).

Kemi rekomanduar po ashtu që të ringrihet Instituti i Kërkimeve të Naftës, si një institut shkencor, i cili të mbështesë të gjitha vendimmarrjet për zhvillimet e sektorit të hidrokarbureve në vendin tonë dhe të bashkëpunojë me Kuvendin dhe Qeverinë për hartimin e strategjive afatmesme dhe afatgjata në këtë sektor.

Kemi rekomanduar ngritjen e një komisioni *ad-hoc* të pavarur, me ekspertë teknikë dhe ekonomikë, i cili të mund të vlerësojë realisht dhe saktësisht dëmin nga aktiviteti nën administrimin e CEZ a.s., si edhe mundësinë më të mirë për një rimëkëmbje të OSHEE-së mbi baza të monitorimit të kujdesshëm të të gjithë treguesve.

Kemi kërkuar një disiplinë të fortë financiare dhe një kontroll të vazhdueshëm nga Kuvendi, për çdo investim dhe vendimmarrje strategjike për OSHEE-në, dhe për efekt të kësaj disipline, kemi kallëzuar penalisht ndonjë anëtar të Qeverisë apo drejtues të lartë institucioni për vendimmarrje në dëm të theksuar të Buxhetit të Shtetit. Edhe pse jemi anatemuar nga segmente të politikës, i qëndrojmë pikë për pikë gjetjeve dhe rekomandimeve tona në sektorin energjetik dhe faktet e kohëve të fundit na kanë dhënë të drejtë ne. Jemi të hapur për raportim në Kuvend për këtë çeshtje.

Gjatë vitit 2015, kemi përfunduar dhe evaduar 158 auditime, nga të cilat auditimet e përputhshmërisë dhe ato të performancës shënuan rritje përkatësisht me 50% dhe 25%, në krahasim me një vit më parë.

Kemi zbuluar parregullsi dhe shkelje financiare, në të ardhurat dhe në shpenzimet e kryera, me dëm ekonomik të përgjithshëm në shumën totale prej 125,8 miliardë lekë ose 919.9 milionë euro, nga të cilat janë rekomanduar për zhdëmtim 428 milionë euro. Shkeljet e disiplinës financiare me ndikim negativ në perfomancën e subjekteve të audituara, kanë qenë në shumën e përgjithshme 35,3 miliardë lekë ose 257.7 milionë euro. Këto shkelje financiare përgjithësisht i përkasin periudhave 2013-2015 dhe pjesërisht periudhës kohore 2011-2013. Dëmi ekonomik i zbuluar nga KLSH për

periudhën 2012-2015 është 8 herë më i madh se vlera e dëmit të zbuluar për periudhën e katër viteve 2008-2011.

Këto janë shifra që duhet të na ndërgjegjësojnë për sfidat e mëdha që na presin në disiplinimin e financave publike dhe harxhimin me ekonomicitet, efektshmëri dhe efiçiencë të parasë së taksapaguesve shqiptarë.

Presidenti i Republikës z. Bujar Nishani dhe Ambasadori i SHBA-së në Shqipëri z. Donald Lu, në Analizën Vjetore 2015 të KLSH-së

Krahas rritjes së forcës këshilluese, ne duhet të japim llogari për çdo lek të harxhuar nga veprimtaria jonë. Për vitin 2015, për çdo një lek të shpenzuar për institucionin e KLSH, janë kërkuar për t'u zhdëmtuar në Buxhetin e Shtetit 180 Lekë, ose në vlerë totale 58,7 miliardë lekë, apo 428.4 milionë euro, ndërkohë që në vitin 2010 institucioni kërkonte për çdo lek të harxhuar 10.4 lekë zhdëmtim. Kujtoj që në llogaritje nuk është përfshirë dëmi ekonomik prej 479 milionë euro të marrëveshjes së lidhur nga MEI për zgjidhjen me mirëkuptim të mosmarrëveshjeve me CEZ A.s. Ky tregues tregon qartë dobinë e auditimeve të KLSH-së. Krahasuar në vite, mesatarja e treguesit të efiçiencës (dobishmërisë) së institucionit për katër vitet 2012-2015 është 4.2 herë më e lartë se mesatarja e katër viteve 2008-2011. Shprehur ndryshe, në katër vitet e fundit, për çdo lek të taksapaguesit shqiptar që harxhohet për KLSH-n kemi zbuluar dhe kërkuar për zhdëmtim dhe arkëtim në Buxhet mbi 4 herë më shumë fonde se sa në katër vitet 2008-2011.

Të ndërgjegjshëm për pozicionin dhe rolin tonë, kur ka ardhur koha më shumë se kurrë të shihemi të gjithë si në pasqyrë përpara opinionit publik, si institucione publike (ndoshta duke përdorur instrumentin e vetëvlerësimit IntoSAINT, të cilin kemi dy vjet që e zbatojmë në KLSH), mendojmë se duhet të punojmë shumë më tepër, sidomos me përpjekjet për të luftuar anti-kulturën e pandëshkueshmërisë, për të kontribuar modestisht në reformën tërësore në sistemin e drejtësisë, e cila nuk do të kishte ardhur

në stadin e sotëm të realizimit, pa investimin dhe kontributin e Ambasadorit të SHBA në Shqipëri, z. Donald Lu, të cilin në emër të audituesve të KLSH-së e falënderojmë në mënyrë të veçantë për këtë kontribut.

Jemi po ashtu të ndërgjegjshëm, të kontribuojmë dhe në sfidën kryesore të shoqërisë shqiptare sot, luftën kundër korrupsionit. Krahasuar me periudhën katërvjeçare 2008-2011, kallëzimet penale të KLSH të katër viteve 2012-2015 janë rritur me 3.2 herë. Por, shqetësim kryesor për ne është niveli i ulët i zbatueshmërisë së masave të propozuara nga KLSH për largim nga detyra apo nga shërbimi civil për zyrtarë të lartë të Shtetit të denoncuar si të korruptuar apo abuzues me interesat publike dhe për këtë do të paraqesim pranë komisioneve të Kuvendit listat e këtyre zyrtarëve të lartë që ende mbahen në administratën shtetërore.

Ndjekja sistematike e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së ka qenë një shqetësim i përhershëm i Bashkimit Evropian, i shprehur me forcë edhe në të dy Progres-Raportet e fundit për Shqipërinë të viteve 2014 dhe 2015. Dua të theksoj se edhe gjatë vitit 2015, kemi gjetur mirëkuptim dhe kemi marrë mbështetjen e duhur nga Komisioni i Kuvendit për Ekonominë dhe Financat.

Në përshëndetjen e tij drejtuar KLSH-së në 90 vjetorin e krijimit në maj 2015, Auditori i Përgjithshëm i Zyrës së Auditimit Qeveritar të SHBA-së, z. Gene L. Dodaro theksoi se: "*Institucionet Supreme të Auditimit janë vitalë për të ndihmuar përmirësimin e performancës së qeverisë, për të arritur më shumë transparencë, si dhe për të siguruar përgjegjshmëri në kontekstin e sfidave aktuale... Ata sot janë pozicionuar si kurrë më parë, për të bërë diferencën... Ne nuk bëjmë politika. Ato i ka Kongresi. Ne auditojmë realizimin e politikave dhe programeve të Qeverisë*".

Auditimet e performancës së KLSH në vitet 2012-2015 kane njohur zhvillim sasior dhe cilësor, duke u rritur mbi 2,5 herë në krahasim me periudhën 2008-2011 si numër auditimesh dhe afro 4 herë si numër institucionesh publike të mbuluara me auditim. Gjatë vitit 2015, kemi realizuar 12 auditime performance, në një kohë kur nuk kishim asnjë auditim të tillë në vitin 2011. Fokusi ynë për këtë vit është përqendrimi i auditimeve të performancës kryesisht në marrëveshjet koncesionare, në partneritetet publik-privat dhe në performancën e borxhit publik, me synim shëndoshjen e mëtejshme të financave publike dhe uljen e risqeve fiskale të vendit.

Viti 2015 ka qenë viti i parë i zbatimit të ligjit të ri integral të KLSH-së, viti i konsolidimit të progresit të institucionit drejt një trupe auditimi tërësisht të pavarur, kurajoze dhe të përkushtuar për përmirësimin e qeverisjes publike, e cila zbaton me rigorozitet standardet ndërkombëtare ISSAI.

Krahas përparësive, jemi të ndërgjegjshëm edhe për dobësitë tona. Kështu, ende nuk kemi arritur të japim opinion për pasqyrat financiare të Shtetit.

Mbi bazën e treguesve të plotësuar të performancës së një SAI, të sigurtë në ndihmën dhe mbështetjen e Institucionit të Presidentit, të Kuvendit dhe të gjitha strukturave të tjera publike dhe të shoqërisë civile e qytetarëve, si dhe të aleatëve tanë strategjikë SHBA dhe BE, e shohim me besim të plotë punën tonë në të ardhmen.

Presidenti Abraham Linkoln, një ndër etërit e demokracisë amerikane, ka thënë: "*Administratori i Shtetit, kur është i përgjegjshëm, ka me vete publikun. Qeverisja jonë qëndron si në pasqyrë, përpara opinionit publik. Cilido administrator që mund të ndryshojë për mirë opinionin publik mbi një shërbim apo veprim shtetëror që ka kryer, ka ndryshuar për mirë qeverinë* [115]" Detyra jonë si shërbestarë të publikut është të kontribuojmë të gjithë për mirëqeverisjen.

Ju faleminderit!

[115] Fjalim i mbajtur në Çikago, 10 dhjetor 1856

KONFERENCA E IV-të E ZYRËS SË AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM TË KOSOVËS

Analiza Vjetore, korrik 2012

Në foto: *Armend Zemaj-Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike të Kosovës, Fjoralba Kokonozi-Sylaj-ZAP, Lage Olofsson – ZAP dhe Bujar Leskaj – KLSH*

Konferenca e IV-të Vjetore e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës(ZAP) u zhvillua në datat 10-11korrik 2012, në Pejë të Kosovës. Në të morën pjesë anëtarë të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike të Kuvendi i Kosovës, përfaqësues nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë dhe nga KIPRED, si dhe një grup audituesish nga KLSH.

Në përshëndetjen e tij në këtë Konferencë, Kryetari i KLSH, z.Bujar Leskaj, u ndal në reformat e nisura nga institucioni suprem i auditimit publik i Shqipërisë, të cilat po zhvillohen nën moton e INTOSAI-t "Common Experience benefits all (Nga Eksperienca e përbashkët u shërben të gjithëve", si dhe në perspektivën e bashkëpunimit mes dy institucioneve shqiptare të auditimit suprem të Kosovës dhe Shqipërisë dhe në aktivitetet e para të përbashkëta të nisura tashmë, të cilat janë mjaft premtuese.

KONFERENCA E V-të E ZYRËS SË AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM TË KOSOVËS

Analiza Vjetore, korrik 2013

Në foto: *Plan nga dita e dytë e punimeve të Konferencës Vjetore të ZAP*

Konferenca e V-të Vjetore e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës u zhvillua në datat 3-5 korrik 2013, në Ohër të Maqedonisë. Në të morën pjesë anëtarë të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike nga Kuvendi i Kosovës, përfaqësues nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë dhe Zyra Kombëtare e Auditimit të Britanisë së Madhe përfaqësues nga Shoqata e Kontabilistëve të Certifikuar dhe Audituesve të Kosovës, si dhe një grup audituesish nga KLSH.

Në përshëndetjen e tij në këtë Konferencë, Kryetari i KLSH-së, z.Bujar Leskaj, u ndal në punën e institucionit suprem të auditimit publik të Shqipërisë në rritjen e cilësisë së auditimeve, gjetjeve dhe rekomandimeve te tyre, si dhe në përvetësimin e ISSAI-ve.

DISKUTIM NË KONFERENCËN E VI-të TË ZYRËS SË AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM TË KOSOVËS

Analiza Vjetore, korrik 2014

Konferenca e VI-të Vjetore e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës u zhvillua në Tiranë në datat data 9-11 korrik 2014. Në Konferencë morën pjesë përfaqësues nga Kuvendi i Kosovës, partnerë nga shoqëria civile dhe mediat, si dhe një grup audituesish nga KLSH

I nderuar z. Olofsson, Auditues i Përgjithshëm i Kosovës,

Të nderuar kolegë auditues të Kosovës,

Të nderuar pjesëmarrës,

Konferenca e Gjashtë Vjetore e ZAP-t të Kosovës, përbën pa dyshim një arritje të qenësishme të institucionit Tuaj. Raporti juaj i Performancës për vitin 2013 flet qartë se mbulimi i auditimit suprem shtetëror tanimë është më gjithëpërfshirës. Treguesit e punës suaj për sezonin auditues 2013-2014, nxjerrin në pah rritjen e cilësisë së auditimit dhe të ndikimit të rekomandimeve të ZAP Kosove, si rrjedhojë e qasjes dhe fokusit të pavarur në punën tuaj audituese.

Sikurse e përcakton z. Olofsson në Raportin e Performancës ZAP 2013, misioni Juaj është që të bëheni një institucion publik i auditimit të jashtëm, i cili i zbaton plotësisht dhe në mënyrë të qëndrueshme në sektorin publik, standardet e auditimit të pranuara ndërkombëtarisht dhe praktikat më të mira Evropiane.

Gjatë vitit 2013 dhe deri tani, Ju keni mbulim më të mirë me auditim të aktivitetit të institucioneve shtetërore të Kosovës, keni rritur cilësinë e auditimeve dhe raportimeve tuaja, duke ja nënshtruar rigorozisht ato Sistemit Tuaj për Menaxhimin e Cilësisë, i cili bazohet në standardet e INTOSAI-t për menaxhimin e cilësisë, keni rritur nivelin e zbatueshmërisë të rekomandimeve tuaja nga entet e audituara, etj.

Ju, si auditues të jashtëm të sektorit publik të Kosovës, jeni përkushtuar në një zhvillim të vazhdueshëm të kapaciteteve tuaja dhe ndryshimeve pozitive, për të përmbushur nevojat, kërkesat dhe pritshmëritë e reja të menaxhimit publik në Kosovë. Ju keni punuar me efektivitet me partnerët dhe kolegët Tuaj ndërkombëtare, në kuadër të kontekstit të veçorive dhe nevojave specifike të auditimit suprem në Kosovë. Cilësia dhe rezultatet e punës suaj janë vlerësuar nga partnerët Tuaj ndërkombëtarë, sidomos nga Zyra e Auditimit Kombëtar (SNAO) e Suedisë, duke u prezantuar denjësisht dhe me një ndikim në rritje të ZAP Kosovë në komunitetin e auditimit suprem. Pjesëmarrja e ZAP-it në Kongresin e IX-të të EUROSAI-t zhvilluar në Holandë flet për këtë fakt.

Personalisht, do të më mbetet në kujtesë data 13 shkurt 2012. Unë kisha më pak se dy muaj në detyrën e Kryetarit të KLSH-së, kur pata kënaqësinë e veçantë të takoj një personalitet të auditimit suprem publik në Evropë, z.Lars Lage Olofsson, në cilësinë e Audituesit të Përgjithshëm të Kosovës. Së bashku me z. Olofsson nënshkruam marrëveshjen e bashkëpunimit mes KLSH dhe ZAP Kosovë. Për mua ishte marrëveshja e parë e bashkëpunimit e institucionit që drejtoja, me partnerë jashtë kufijve të vendit dhe ishte shumë domethënëse që ajo bëhej me Zyrën e Audituesit të Përgjithshëm të Kosovës. Marrëveshja ka pasur impakt pozitiv, audituesit e të dy institucioneve kanë marrë pjesë në konferencat vjetore respektive, në takimet e përbashkëta dhe trajnimet me partnerët ndërkombëtarë, sidomos me Zyrën e Auditimit Kombëtar (SNAO) të Suedisë, etj. Së bashku kemi përkthyer ne shqip dhe botuar gjatë vitit 2013 Shënimet Praktike të Standardeve ISSAI të auditimit financiar ISSAI 1000-2999. Këto shënime orientojnë saktë audituesit tanë në sfidat e punës së përditshme për një auditim financiar sa më të plotë dhe cilësor.

Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit dhe nën moton e INTOSAI-t "*Experentia Mutua Omnibus Prodes*t", një ndër aktivitetet e përbashkëta, është edhe auditimi paralel "Mbi sigurinë rrugore ", aktualisht në fazën përfundimtare të tij, i mbështetur edhe nga SNAO suedeze. Nga kjo eksperiencë pozitive duhet të marrim shtysë për të realizuar në të ardhmen edhe auditime të përbashkëta, në fusha me interes reciprok, nga të dy SAI-t tona.

Duke perifrazuar një thënie të z.Olofsson në vitet 2000, ...ne duhet të jemi agjentë të ndryshimit dhe jo spirancë që tërhiqemi zvarrë.. ne duhet të udhëheqim përmes shembullit dhe të jemi referencë pozitive për institucionet e tjera në Shqipëri dhe Kosovë. Ne duhet të ndryshojmë dhe ritmi i ndryshimit dhe i bashkëpunimit tonë duhet të jenë në progresion gjeometrik dhe jo në progresion aritmetik, në mënyrë që të thellojmë bashkëpunimin. Bashkëpunimi ynë ka qenë i mirë, por jo i shkëlqyer dhe ka vend për përmirësim. Ne duhet të kalojmë në bashkëpunime konkrete mes Departamenteve, trajnimeve të përbashkëta dhe ndoshta ka ardhur momenti që të kalojmë edhe testime të përbashkëta për të njehsuar dijet tona.

Strategjia e KLSH-së 2013-2017 është në vitin e saj të dytë të aplikimit dhe strategjia e ZAP-it, 2014-2020 në vitin e parë të saj. Kemi plotësisht mundësinë që për vitet në vijim në planet tona konkrete të zbatimit të strategjive respektive të integrojmë aktivitetet tona të përbashkëta.

Ju propozoj zyrtarisht që në strategjinë që po përgatisni për ZAP-in, 2014-2020, të vendosni si çështje të veçantë bashkëpunimin me Kontrollin e Lartë të Shtetit të Shqipërisë.

Performanca e KLSH 2013/2014

Zoti Terrence Nombembe, ish-Auditues i Përgjithshëm i SAI-t të Afrikës së Jugut dhe ish-Kryetar i Bordit Drejtues të INTOSAI-t ka theksuar për SAI-t "...është koha për të shkëlqyer dhe ne do të shkëlqejmë..." dhe duke ju referuar gjithashtu shprehjes së Mit'hat Frashërit "...në punë kije lavdi të jesh shërbestar...", ne, në KLSH po punojmë me moton "është koha për të shërbyer dhe ne do të shërbejmë".

1. Auditimet, kallëzimet penale dhe dobia e institucionit

Me lejoni t'ju paraqes një ekspoze të përgjithshme mbi aktivitetin e KLSH-së për vitin 2013. Ky vit, nga këndvështrimi i veprimtarisë audituese, përbën për KLSH një vit arritjesh dhe ndryshimesh institucionale. Hapat reformues, të ndërmarrë gjatë vitit 2012, në përputhje të plotë me kërkesat e standardeve ndërkombëtare ISSAI, i dhanë frytet në vëllimin dhe cilësinë e auditimeve, aktiviteti primar i institucionit. Si institucion suprem auditimi(SAI), nga 147 auditime të planifikuara, vitin e kaluar përfunduam 164 auditime, ose 11 përqind më shumë. Zbuluam parregullsi dhe shkelje financiare në nivelin e 12,5 miliardëve lekë në të ardhurat e Buxhetit dhe 2,6 miliardë lekë në shpenzimet e kryera, me dëm efektiv të përgjithshëm, të konstatuar në vlerën 15,1 miliardë lekë, ose rreth 108 milionë euro. Kemi rekomanduar shpërblimin e këtij dëmi në masën 99,9%. Dëmi ekonomik i zbuluar nga KLSH në të dy vitet 2012 dhe 2013, është rreth dy herë më i madh se vlera e dëmit të zbuluar prej institucionit në tre vitet 2009, 2010 dhe 2011, të marra së bashku.

Krahas zbulimeve me dëm ekonomik, gjatë vitit 2013, si KLSH kemi konstatuar shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e institucioneve të audituara, në nivelin e 4, 4 miliardë lekëve (mbi 31 milionë euro), ose 2.5 miliardë lekë më shumë nga shkeljet e konstatuara gjatë vitit 2012. Institucioni ka bërë 38 kallëzime penale ndaj 94 punonjësve publikë, kryesisht nëpunës të lartë dhe të mesëm të administratës. Numri i kallëzimeve penale gjatë viteve 2012 dhe 2013 është rreth katër herë më shumë se kallëzimet penale të kryera në tre vitet e marra së bashku, 2009, 2010 dhe 2011.

Për vitin 2013, treguesi i dobisë së rezultateve të auditimit(raporti i shpenzimeve të një SAI me fondet e kërkuara për zhdëmtim nga demi i konstatuar në Buxhetin e Shtetit) , i përdorur gjerësisht nga institucionet moderne të auditimit, rezulton se për çdo 1 lek të shpenzuar për institucionin e KLSH-së, janë kërkuar për t'u zhdëmtuar 52.3 lekë.

Gjatë viteve 2009-2011, për 1 lek të shpenzuar nga buxheti i shtetit, KLSH ka kërkuar për zhdëmtim 21 lekë, ndërsa për vitet 2012 dhe 2013 për çdo 1 lek të shpenzuar, kemi kërkuar për zhdëmtim 52 lekë ose rreth 31 lekë më shumë. Ne po vazhdojmë të ecim me hapa jo të shpejtë por të sigurt drejt Auditimeve të Performancës.

2. Bashkëpunimi me komunitetin ndërkombëtar të auditimit

Në vijimësi të misionit të formuluar në Deklaratën e Pekinit të Kongresit të XXI-të INTOSAI-t, që "SAI-t do të vazhdojnë t'i shërbejnë shoqërisë dhe publikut, duke promovuar zhvillimin e qëndrueshëm dhe përmirësimin e qeverisjes kombëtare, forcimin e demokracisë, përmirësimin e shtetit ligjor, duke luftuar korrupsionin, ruajtur sigurinë kombëtare dhe duke nxitur reforma", në përfundim të auditimeve tona, kemi rekomanduar më shumë përmirësime ligjore, sesa masa organizative, duke qenë se impakti i një përmirësimi ligjor është më i prekshëm në të gjithë sistemin e menaxhimit të fondeve publike dhe e tejkalon vlerën e masës organizative të nivelit të një institucioni të audituar.

Gjatë vitit 2013, KLSH aplikoi dhe u pranua anëtar i Task Forcës së Organizatës Evropiane të Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAI) "Mbi auditimin e etikës". Nëpërmjet anëtarësimit dhe pjesëmarrjes aktive në këtë organizëm, institucioni synon instalimin dhe funksionimin e një infrastrukture efektive etike në vetë KLSH-në, dhe, nga ana tjetër, do të ndërmarrë misione auditimi mbi rregullaritetin dhe efiçencën e Etikës dhe Integritetit në institucionet publike, duke konsideruar që lufta kundër korrupsionit dhe politikat për instalimin e një sistemi efektiv të integritetit të jenë pjesë e menaxhimit të institucioneve publike. Nëpërmjet aplikimit të Instrumentit të vetëvlerësimit të integritetit INTOSAINT në KLSH si dhe Anëtarësimit në Task Forcën e EUROSAI-it "Mbi Auditimin e Etikës", institucioni synon të forcojë infrastrukturën etike si brenda vetes, ashtu dhe të promovojë integritetin dhe etikën në institucionet e sektorit publik, duke "udhëhequr nëpërmjet shembullit".

KLSH, duke vlerësuar rëndësinë e sjelljes etike në Institucionet Supreme të Auditimit dhe në Institucionet e tjera publike, paraqiti kërkesën për të qenë pjese e Grupi të Punës të INTOSAI-t për Rishikimin e ISSAI 30 dhe Kryetari i këtij Grupi, z.Jezierski ka njoftuar zyrtarisht se KLSH është pranuar si anëtar i këtij grupi, krahas SAI-ve të pesë vendeve: Polonisë, Indonezisë, Portugalisë, Mbretërisë së Bashkuar dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kontrolli i Lartë i Shtetit do të japë kontributin e tij në këtë drejtim, duke bashkëpunuar ngushtësisht me pesë SAI-et e tjera, me qëllim përmirësimin dhe përshtatjen me ndryshimet e kohës të Kodit të Etikës.

KLSH në fillim të vitit 2013 finalizoi në bashkëpunim me SIGMA, Strategjinë e Zhvillimit të Institucionit 2013- 2017. Viti 2013, reflektoi gjithashtu, konsolidimin e dy departamenteve të krijuara gjatë vitit 2012, të Departamentit të Auditimit të Performancës dhe Departamentit të Kërkimor Shkencor, të cilët nga pikëpamja strukturore përbëjnë shtyllat e modernizimit të institucionit. Ndryshimet strukturore reflektuan edhe zhvendosjen e një pjese të punonjësve që kryenin funksione administrative mbështetëse në fuqizimin dhe shtimin e "trupës audituese", në dobi të

veprimtarisë kryesore institucionale, që është veprimtaria audituese. Së shpejti, Departamenti i Kërkimit Shkencor për të përmbushur më mire nevojat e institucionit mund të përfshijë brenda tij edhe metodologjinë dhe të ketë një emërtesë të re Departamenti i Standardeve dhe Metodologjisë.

Një prej mesazheve të dala nga Kongresi i fundit i EUROSAI-t është edhe mundësia primare që kanë SAI-t për t'u ngritur mbi hapat e bërë tashmë në konsolidimin e bashkëpunimit brenda EUROSAI-t, si ndërmjet strukturave të ndryshme ashtu edhe ndërmjet SAI-ve, duke shkëmbyer inovacionet përkatëse në përfitim të të gjithëve.

Viti 2013, është gjithashtu edhe viti i konsolidimit të marrëdhënieve të KLSH-së me institucionet ndërkombëtare të auditimit si INTOSAI dhe EUROSAI, ku KLSH është anëtar aktiv.

Ky vit u karakterizua nga pjesëmarrja aktive e KLSH-së në programin "3i". Në Mars të vitit 2013 KLSH ka nënshkruar Marrëveshjen e Angazhimit me përfaqësues të IDI-t dhe EUROSAI-t për Programin "3i", Iniciativa e Implementimit të ISSAI-ve dhe është ngritur grupi i punës me mbështetjen e SIGMA-s duke plotësuar të gjitha detyrimet që rrjedhin nga kjo marrëveshje. Aktualisht, KLSH vazhdon bashkëpunimin e ngushtë me IDI-n duke qenë prezente në programet e tij si ai mbi Auditimin e IT dhe aplikimin në programin mbi Thirrjen Globale të IDI-t, për t'u zbatuar në vitin 2015.

Gjatë vitit 2013, krahas përfundimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me Gjykatën Austriake të Auditimit, me Institucionin Shtetëror të Auditimit të Malit të Zi, me Zyrën e Auditimit të Institucioneve të Bosnjës dhe Hercegovinës dhe me SAI-n e Maqedonisë, KLSH nisi negociata për përfundimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe me SAI-t e Greqisë, Bullgarisë dhe Serbisë, duke synuar fuqizimin e një rrjeti të vendeve të Evropës Juglindore të institucioneve më të larta të auditimit, nën shembullin dhe eksperiencën e rrjeteve të ngjashme të krijuara në Evropë. Si shembull kemi marrë marrëveshjen e parë me ju në fillimet e vitit 2012 dhe marrëveshjet e tjera te nënshkruara brenda vitit 2012 me SAI-n polak, kroat, slloven dhe turk.

KLSH, gjatë vitit 2013 ka vijuar në një marrëdhënie intensive me SIGMA-n, ekspertët e së cilës e kanë mbështetur institucionin me programe trajnimi, në fusha trajnimi me interes të lartë, si auditimi financiar, auditimi i përputhshmërisë, auditimi i performancës, auditimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit, etj. Po ashtu vlen për t'u theksuar partneriteti i vendosur mes KLSH-së dhe DG-Budget, si dhe në tërësi me Delegacionin e BE-së në Shqipëri.

Viti 2013 shënoi dhe fillimin e një praktike risi për KLSH-në, duke qenë vend organizator për zhvillimin e eventeve të ndryshme si konferenca apo seminare. Në këtë kuadër po përmend dy aktivitete të zhvilluara:

a-Seminari i zhvilluar në Tiranë, mbi "Vijimësinë e Bashkëpunimit rajonal për Auditimin e Performancës" organizuar nga TAIEX si dhe Grupi i Punës për Aktivitetet e Përbashkëta në Auditim.

b-Konferenca e II-të shkencore e KLSH-së, e organizuar me mbështetjen e SIGMA-s me temë "Roli i Institucioneve Supreme të Auditimit në Menaxhimin e Përgjegjshëm Publik përballë sfidave aktuale", zhvilluar në datat 12-13 dhjetor 2013. Konferenca e dytë Shkencore u organizua me mbështetjen edhe të Programit SIGMA. Kjo Konferencë e dytë, i hapi rrugën Konferencës së tretë Shkencore të KLSH-së, e cila do të zhvillohet në fund të muajit tetor 2014 dhe do të ketë si temë kryesore një nga temat më të rëndësishme trajtuar në Kongresin e INCOSAI-t 2013, "Auditimi Kombëtar dhe Qeverisja Kombëtare". Unë ju ftoj zyrtarisht, Ju të nderuar Auditues dhe Drejtues të ZAP të merrni pjesë në këtë Konferencë, duke shpresuar që të jeni shumë më tepër se në vitin 2013.

Po kështu, në aktivitetin e organizuar nga Gjykata Evropiane e Llogarive në bashkëpunim me SIGMA-n në Nëntor të vitit 2013 në Mal të Zi, KLSH ndërmori iniciativën që për vitin 2014, të organizojë Konferencën rajonale mbi "Auditimin bazuar në limitin e materialitetit dhe kampionimin" si dhe për dy konferenca të tjera të ishte bashkë-organizatore me SAI-t e Malit të Zi dhe të Serbisë.

1. Transparenca dhe bashkëpunimi me qytetarin

Në Kongresin e XIX të INTOSAI-it, u krijuar Grupi i Punës për Udhëzuesin e vlerave dhe dobive të SAI-t, i cili përgatiti Udhëzuesin përkatës. Në komunikimin me qytetarin, duke jetësuar drejtimin strategjik të INTOSAI-t dhe EUROSAI-t për menaxhim në përputhje me parimet e komunikimit transparent, KLSH ka intensifikuar marrëdhëniet me publikun dhe qytetarët, duke i sjelle në një nivel të paarritur dhe të pa konceptuar më parë. Ne e dimë se SAI –t japin kontribut në shoqëritë e vendeve të tyre duke ndihmuar në llogaridhënien, integritetin dhe transparencën e qeverisë. Këto kontribute janë maksimale kur SAI-t janë në gjendje të komunikojnë vlerën e rolit të tyre në qeverisje si dhe rezultatet e punës së tyre tek qytetarët dhe palët e tjera të interesuara. Viti 2013, është i treti radhazi, ku analizat vjetore në nivel departamenti auditimi zhvillohen krejtësisht të hapura, në prani të përfaqësuesve të medias, përgjatë disa ditëve dhe finalizohen me analizën e përgjithshme. Gjatë vitit 2013, institucioni ka trajtuar 401 letra dhe ankesa nga qytetarët, për probleme të ndryshme, në krahasim me një numër të papërfillshëm të letrave dhe ankesave të trajtuara në vitin 2011. Krahas shtimit të vrullshëm të pranisë së rezultateve dhe gjetjeve të auditimeve të institucionit në median e shkruar dhe elektronike, të vërejtur edhe gjatë vitit 2012, risi e vitit 2013 ishte angazhimi i 42 punonjësve të KLSH, kryesisht kryeauditues dhe auditues të lartë, në përgatitjen dhe botimin e mbi 140 shkrimeve, analizave dhe opinioneve, në të gjitha

gazetat e vendit, të cilat u përmblodhën në një botim të veçantë, i cili do të vazhdojë të botohet edhe në vitet e ardhshme.

Komunikimi efektiv me qytetarët dhe palët e interesit do t'i vinte më së miri në ndihmë, niveli i lartë i transparencës dhe besueshmëria e SAI-t. Dy janë principet kryesore te SAI-t:

- Përdorimi i instrumenteve për komunikim të jashtëm
- Qasje ndërveprimi konstante me qytetarët

Në zbatim të parimit 8-të të ISSAI 20 për komunikimin aktiv e profesional të një SAI nëpërmjet publikimeve, gjatë vitit 2013, institucioni ka vijuar punën e nisur në vitin 2012 dhe 10 botimeve të realizuara gjatë vitit 2012, i janë shtuar edhe 12 botimet e vitit 2013. Seria e botimeve të KLSH-së ka arritur në 21 tituj në fund të vitit 2013 dhe gjatë gjashtë mujorit të parë të 2014 është punuar me të njëjtin ritëm dhe duke ruajtur cilësinë e botimeve. Kam kënaqësinë të evidentoj faktin që botimet e KLSH-së kanë arritur në 25 dhe deri në fund të vitit do të kenë tejkaluar numrin 30.

Në këtë drejtim personalitete të shquara të financave dhe auditimit publik, përfaqësues të botës akademike kanë dhënë gjithashtu një kontribut cilësor, sidomos për revistën shkencore "Auditimi Publik". Ne mirëpresim punimet tuaja në këtë revistë shkencore të Auditimit Publik. Botimet kanë ndihmuar, duke e bërë më transparente të gjithë veprimtarinë e KLSH-së dhe duke ndikuar në rritjen e kapaciteteve audituese, sidomos botimet e vitit 2013 si "Udhëzuesi i Auditimit Financiar (ISSAI 1000-2999)", "Udhëzuesi i Auditimit të Përputhshmërisë (ISSAI 4000-4200)" dhe "Standardet e Auditimit të Borxhit Publik (ISSAI 5410-5440)".

Gjatë vitit 2013, KLSH ka vijuar intensifikimin e përpjekjeve të tij të komunikimit. Kjo rezultoi në rritjen e vëmendjes së medias për raportet e auditimit dhe për institucionin në tërësi, treguesit e prezencës tonë në media tregojnë 2 ose 3-fishim në raport me vitet e kaluara.

Në këtë frymë transparence dhe mision komunikimi, ne do të japim në vijimësi kontributin tonë si KLSH, në punën në sistem për përmirësimin e qeverisjes dhe rritjen e përgjegjësisë dhe llogaridhënies se institucioneve publike.

Rritja e kapaciteteve audituese

Në Deklaratën e Pekinit të Kongresit XXI të INTOSAI-t, theksohet se: "INTOSAI njeh se është e rëndësishme që metodat e auditimit të SAI-ve të bazohen në njohuritë teknike dhe shkencore aktuale dhe që audituesit të kenë kualifikime të përshtatshme si dhe integritet moral". Në vitin 2010, INTOSAI identifikoi kuadrin e implementimit të Standardeve Ndërkombëtare për SAI-et (ISSAI-et) si një përparësi strategjike në të

ardhmen dhe ne po përpiqemi të përdorim ISSAI-t si një kornizë referuese. Gjatë vitit 2013, KLSH ka forcuar kapacitetet audituese, nëpërmjet një procesi të vazhdueshëm kualifikimi, kryerjes së trajnimeve të thelluara dhe gërshetimit të ngritjes arsimore me veprimtarinë praktike audituese. Struktura e punonjësve ka vijuar të ndryshojë, jo vetëm thjesht në favor të stafit auditues me arsim të lartë, por dhe të stafit me kualifikime profesionale, akademike dhe grada shkencore, si dhe me kualifikim në fusha të dyta ekspertize.

Ne jemi përpjekur të orientohemi drejt menaxhimit të ndryshimeve; rregullimit institucional; mjedisit të auditimeve dhe vlerësimit të burimeve; të gjitha këto të lidhura dhe me qëllimin e mirë të zbatimit të nivelit 4 të standardeve të ISSAI-ve.

Çdo pjesëtar i stafit në KLSH u trajnua vitin e kaluar për më shumë se 22 ditë gjatë vitit. Ky tregues, po të krahasohet me vitet 2009, 2010 dhe 2011, gjatë të cilave janë kryer respektivisht 2, 3.1 dhe 2.1 ditë trajnimi/punonjës në vit, rezulton 10 herë më i lartë se i viteve 2009, 2010 dhe 2011 ose 5-fishi i të dy viteve të fundit të marra së bashku.

Organizimi i trajnimeve dhe vizitave studimore në institucionet homologe dhe organizma të tjerë profesionalë ndërkombëtarë vijuan të jenë një element i fuqishëm që ndikuan ndjeshëm në arritjet e trajnimeve për vitin 2013. U trajnuan 120 punonjës jashtë vendit, duke arritur një mesatare trajnimi 5,3 ditë trajnimi jashtë vendit për punonjës. Në dy vitet e fundit dhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2014, institucioni ka ndryshuar koncept në investimin për kapacitetet audituese. Nga një institucion i disa viteve më parë praktikisht pa trajnim, është kthyer në SAI me tregues perëndimorë trajnimi.

Në funksion të objektivit strategjik të Ndërtimit të Kapaciteteve, KLSH aplikoi pranë Delegacionit të BE-së në Tiranë dhe fitoi Projektit të Binjakëzimit, në kuadër të fondeve IPA 2013, me temë "Forcimi i kapaciteteve të Auditimit të Jashtëm", në vlerën prej 2.11 milion Euro. Ky projekt nis ne muajin nëntor të këtij viti dhe ka për qëllim forcimin e kapaciteteve audituese dhe nëpërmjet këtij projekti pritet rritja e performancës së auditimit përmes forcimit të kapaciteteve institucionale të KLSH, rritja e kapaciteteve të auditimit, zhvillimi dhe zbatimi i metodologjive moderne të auditimit, zhvillimi dhe kualifikimi i burimeve njerëzore, përmirësimi i raporteve të auditimit, metodologjisë dhe gjithashtu përmirësimi i skemave për ndjekjen e rekomandimeve të KLSH-së. Paralelisht ne po tentojmë të fillojmë një proces "Peer Review"(rishikim mes kolegësh mes SAI- ve të vendeve të BE-së). Ne duam të arrijmë të matim performancën tonë dhe të kontrollojmë udhëzimet që mund të bien ndesh me standardet ndërkombëtare, referuar Kornizës së ISSAI-ve :

Niveli 1, Parimet bazë. ISSAI 1, Deklarata e Limës, Ndërtimi institucional.

Niveli 2, ISSAI 10-99, Kushtet paraprake për funksionimin e SAI-ve.

Niveli 3, ISSAI 100-999, Parimet Themelore të Auditimit.

Niveli 4, ISSAI 1000-5999,Udhëzimet e Auditimit.

Për periudhën e parë të vitit 2014, KLSH po përvijon të ecë me modelin e dy viteve të fundit, por duke rritur në vazhdimësi cilësinë e punës në auditim. Nga 53 auditime të planifikuara për evadim, ka ushtruar dhe ka përgatitur 79 auditime, në të cilat përfshihen auditime të përputhshmërisë, auditime financiare, tematike dhe performance. Nga këto auditime 36 janë të përfunduara, 13 janë të përfunduara por të paevaduara dhe 30 janë në proces auditimi.

Gjithashtu, KLSH ka bërë për periudhën janar-qershor 2014, 15 kallëzime penale, duke ndihmuar ne luftën kundër korrupsionit, me qëllim përmirësimin e qeverisjes së vendit. Megjithëse, në kuadër të dy viteve e gjysmë janë 100 kallëzime, unë përpiqem të mos e shkëpus vëmendjen nga qëllimi kryesor, modernizimi i institucionit.

Në kuadër të rritjes së transparencës dhe të komunikimit me publikun e gjerë, KLSH ka trajtuar 143 letra dhe ankesa dhe u ka dhënë përgjigje 47 prej tyre, ndërsa 50 janë në proces verifikimi. Pjesa tjetër ka qenë jashtë kompetencave të KLSH-së. Shqetësimet e qytetarëve janë të adresuar më së shumti në fusha delikate si prokurimi publik, privatizimet dhe kthimi i pronave, tatim-taksave, doganave, etj.

Programi Vjetor i Trajnimit për stafin e KLSH për vitin 2014 parashikon një tërësi veprimtarish trajnimi të siguruara nga burime të brendshme dhe të jashtme, por që kanë një synim, të krijojnë impakt dhe vlerë tek audituesit pjesëmarrës. Për këtë qëllim, janë zhvilluar trajnime, të cilat i përgjigjen kërkesave sipas programit të trajnimit por dhe të momentit duke kombinuar plotësimin e nevojave për periudhën vjetore por njëkohësisht dhe afatshkurtra.

Në kuadër të zbatimit të orientimeve të Kongresit të IX të EUROSAI-t, të zhvilluar në qershor 2014 në Holandë, veprimtaria e KLSH-së për 2013, qoftë nga pikëpamja strukturore apo edhe vizive, reflekton standardet dhe praktikat më të mira të raportimit dhe i referohet modeleve të ndjekura nga SAI-t analoge Evropiane duke përdorur instrumentet e të dhënave të vizualizuara si foto, imazhe, info-grafike, etj. Sot gjithnjë e më tepër kërkohet nga organizatat publike thjeshtësimi i mesazheve të përcjella dhe vizualizimi i informacionit më tepër sesa analizimi i tij.

Nevoja për të ndryshuar e për të sjellë vazhdimisht ide të reja apo produkte inovative është domosdoshmëri dhe e vetmja masë parandaluese që mund të shmangë rutinën dhe te sjelle risi.

Në të ardhmen, përpara institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit shtrohet sfida që jo vetëm të jetë në një linjë me zhvillimet e inovacionet e shoqërisë në përgjithësi dhe

sektorin publik në veçanti, por të synojë që të mbajë dhe zhvillojë një kulturë inovative jo vetëm gjatë ushtrimit të veprimtarisë institucionale, por të jetë një institucion nxitës dhe katalizator për inovacionin edhe për institucionet e tjera në sektorin publik. Një kulturë inovative për bashkëpunimin duhet të na karakterizojë ne si KLSH dhe ju si Institucion Suprem Auditimi në Kosovë.

Të nderuar auditues të Kosovës,

Sikurse është përmendur edhe nga z. Olofsson, ambicia Juaj për këtë vit është që mësimet e nxjerra nga zbatimi i strategjisë ekzistuese te zhvillimit të ZAP Kosovë të çojnë në projektimin e një strategjie të re të zhvillimit korporativ të ZAP 2014-2020 dhe të një plani të ri veprimi.

Ndaj me z. Olofsson bindjen e thellë se kjo Konferencë do të jetë një forum për ndërveprim dhe do të sigurojë një platformë për të gjithë Ju, por edhe për ne si auditues të KLSH-së, për shkëmbimin e njohurive, ideve dhe përvojave dhe identifikimin e zgjedhjeve për sfidat ekzistuese.

Duke Ju uruar suksese në Konferencën Tuaj!

DISKUTIM NË KONFERENCËN E VII-të TË ZYRËS SË AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM TË KOSOVËS

Analiza Vjetore, korrik 2015

Konferenca e VII-të Vjetore e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës u zhvillua në datat 9 dhe 10 korrik 2015 në Prishtinë. Në Konferencë ishin të pranishëm përfaqësues nga Kuvendi i Kosovës, nga qeveria, partnerë nga shoqëria civile dhe mediat, partnerë ndërkombëtarë nga Institucionet Supreme të Auditimit të Suedisë dhe Malit të Zi, si dhe një grup audituesish nga KLSH.

I nderuar z. Artan Venhari, Zv. Auditor i Përgjithshëm i Zyrës së Auditimit të Kosovës,

I nderuar z. Ali Sadria, Zv.Kryetar i Komisionit të Mbikëqyrjes Financiare,

I nderuar z. Nikola Kovacevic, anëtar i Senatit të Gjykatës së Malit të Zi,

I nderuar z. Lage Olofsson, mësues i audituesve në Kosovë, Shqipëri dhe në shumë vende të botës,

Të dashur kolegë!

Për mua pjesëmarrja në Konferencën e VII-të institucionit Tuaj është një kënaqësi e dyfishtë. E para, pasi më jepet mundësia që cilësinë e Kryetarit të KLSH-së të prezantoj arritjet tona dhe të pres vërejtjet dhe sugjerimet tuaja. E dyta dhe çka është më e rëndësishme është se ne vijmë këtu me një grup prej 15 audituesish të vjetër dhe të rinj në institucionin tonë, me përvojë dhe pa përvojë. Ne vijmë këtu me dëshirën e mirë për të shkëmbyer mendime dhe opinione si dhe për të mësuar nga njëri-tjetri.

Si dy Institucione Supreme Auditimi Europiane, natyrisht veprimtaria jonë ashtu si edhe puna juaj mbështetet në katër kolonat e Strategjisë të EUROSAI 2011-2017, të cilat janë:

- ngritja e kapaciteteve;
- standardet profesionale;
- shkëmbimi i përvojave dhe eksperiencave mbi bazën e motos, *"Experientia Mutua Omnibus Prodest"*;
- menaxhimi i institucionit mbi bazën e parimeve të qeverisjes së mirë.

Viti 2014 për Kontrollin e Lartë të Shtetit mund të konsiderohet si viti i konsolidimit të reformës institucionale në përmbushje të objektivit kushtetues dhe ligjor të sigurimit të llogaridhënies publike.

Gjatë veprimtarisë audituese të këtij viti KLSH reflektoi më së miri dhe është edhe vetë produkt i ndryshimeve të thella rrënjësore në drejtim të implementimit të kërkesave të standardeve ndërkombëtare të auditimit gjatë ushtrimit të auditimit. Gjatë këtyre viteve Organizata e Kombeve të Bashkuara nën lobimin e INTOSAI-t ka miratuar dy rezoluta për Institucionet Supreme të Auditimit, të cilat janë një armë e rëndësishme në punën tonë. Në përcjelljen e rezolutës së dytë të datës 19 dhjetor 2014, Sekretari i Përgjithshëm i INTOSAI-t dhe Presidenti i Gjykatës Austriake të Auditimit, Dr. Josef Moser shkruan "*Ju si SAI mund të ngrini diskutime se si Institucionet Supreme të Auditimit mund të ndihmojnë në progresin e auditimit, kundrejt qëllimeve kombëtare dhe të japin ide se si të matet suksesi, si dhe të identifikojnë dhe nëse ka vend për përmirësim. Për këtë ju kërkoj të intensifikoni përpjekjet për të nxitur qeveritë të rrisin pavarësinë e Institucioneve Supreme të Auditimit dhe të synojnë përfshirjen e tyre në monitorimin e zbatimeve dhe qëllimeve në nivele kombëtare, rajonale dhe globale*".

Këtë mesazh të Sekretarit të Përgjithshëm të INTOSAI-t, ne jemi përpjekur ta përkthejmë në implementimin e plotë të reformave institucionale në institucionin tonë. Këto reforma të kanë synuar:

- Modernizimin e institucionit në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit;
- Ndërmarrja e politikave efektive për promovimin e një kulture etike dhe me integritet në institucionin e KLSH-së;
- Implementimin e një strategjie të re komunikimi, duke vendosur në themel të saj transparencën dhe llogaridhënien;
- Menaxhimin efektiv dhe efiçient të burimeve njerëzore të KLSH ;
- Forcimin e kapaciteteve institucionale.
- Treguesi më i saktë mendoj unë është dobishmëria e një institucioni, pra sa lekë janë zbuluar për çdo lek të shpenzuar.

Nga një analizë krahasuese konstatohet se: për tre vitet 2009-2010-2011, për **1 lek** të shpenzuar nga buxheti i shtetit janë kërkuar mesatarisht për zhdëmtim 27 **lekë ,** ndërsa për dy vitet 2012 ,2013, janë kërkuar 52 **lekë** . Për vitin 2014 dhe 6 mujori 2015 për çdo **1 lek** të shpenzuar është kërkuar për zhdëmtim 78 **lekë**.



Në kolonën e fundit paraqiten treguesin për gjashtë mujorin e vitit 2015. Pra, në drejtim të efektivitetit ne kemi një ecuri shumë të mirë po ta krahasojmë me vitet 2008, 2009, 2010, 2011, duke krijuar kështu një stabilitet në fushën tonë.



Në përgjithësi, shifrat e auditimeve që zhvillon KLSH në gjithë këto vite vërtiten rreth 150, 160 auditime në vit. Ky numër auditimesh, shpërndahet në auditime financiare, auditime përputhshmërie, auditime performance dhe duke reduktuar kështu numrin e auditimeve tematike, krijojnë bazën për këto gjetje.



LLOJET DHE SHIFRAT E AUDITIMEVE 2014

Në vitin 2014 KLSH, nga 139 auditime të planifikuara, ka përfunduar dhe evaduar 160 auditime. Për 8 mujorin parë të 2015, nga 86 auditime të planifikuara për auditim, ka ushtruar dhe ka siguruar me përgatitjen e materialeve për 83 auditime, nga të cilat 71 janë të përfunduara e të evaduar dhe 74 janë të përfunduar si proces auditimi në subjekt, por të patrajtuara.

Struktura e auditimeve

Nr	AUDITIME	2013	2014	8 /2015
1	Auditime përputhshmërie (legjislacionit dhe rregullsimtarie)	118	131	60
2	Auditime financiare	21	12	1
3	Auditime performance	6	8	8
4	Auditim i ri matik	8	9	7
Total		153	160	71

Sërish dua t'i referohem Sekretarit të Përgjithshëm të INTOSAI-t, Dr. Josef Moser i cili në Simpoziumi i vitit 2013 të zhvilluar në Vjenë shprehet se " *Auditimet dhe këshillimet nga SAI janë dy anë të së njëjtës monedhë. Institucionet Supreme të Auditimit mund dhe duhet të rrokin mundësitë që qytetarët të angazhohen, duke shfrytëzuar potencialin e tyre të plotë në përpjekjet për përmirësimin e qeverisjes së mirë publike, vetëm nëse ata zhvillojnë një qasje zhvillimi në bazë të punës së tyre audituese, e cila ofron rekomandime specifike si për subjektet e audituara, ashtu edhe për menaxherët qeveritarë, rekomandime të cilat mund të zbatohen praktikisht në sferat e tyre përkatëse të veprimit"*

Në rast se i referohemi shifrave të auditimeve dhe bëjmë një krahasim midis vitit 2013 dhe 2014, duket qartë që ne kemi një progres të ngadaltë, por gjithsesi është progres në auditimet e performancës.

Kur unë e fillova detyrën tre vite e gjysmë më parë, vendosa si sfidë fillimin e auditimeve të performancës. Përvoja jonë në këtë fushë praktikisht ishte zero. Mbas një procesi binjakëzimi 2 vjeçar në vitet 2006- 2007 nga KLSH nuk ishin kryer më auditime performance.

KLSH në këtë drejtim ka ecur me hapa të ngadaltë por të sigurt. Siç shihet dhe në tabelën më poshtë në 2013 janë kryer 6 auditime performance, në 2014 janë kryer 8 auditime dhe në 2015 pretendojmë të kryejmë 10 auditime performance. Pra numri i auditimeve të performancës, të cilat ishin 6 në vitin 2013 dhe pritet të shkojë 10 në vitin 2015. Në tabelën më poshtë paraqiten institucionet e audituara ku padyshim numrin qendror e zënë Ministritë, institucionet qendrore dhe njësitë e qeverisjes vendore.

Gjatë vitit 2014, në 160 auditime të evaduara sipas planit, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka arritur të zbulojmë një dëm ekonomik prej rreth ***91 043 935*** $ ose ***11 198 404 000 lekë***. Vetëm në këtë 6 mujor, ne kemi zbuluar një dëm ekonomik prej ***135,700,000 $*** ose ***16,691,052,000 lekë.***

Në tabelën në poshtë paraqitet struktura e dëmit ekonomik për vitin 2014. Kolona e fundit e tabelës jep të dhënat për gjashtë mujorin e parë të vitit 2015.



Natyrisht shifrat nuk janë qëllim në vetvete, por për mendimin tim janë treguesi më i mirë i punës. Shifrat konkrete të dala nga puna audituese e Institucionit Suprem të Auditimit i japin Kuvendit dhe taksapaguesve një panoramë të qartë për përdorimin me

ekonomicitet, efiçiencë dhe efektivitet të fondeve publike.

Ne e kemi ndarë dëmin ekonomik sipas fushave dhe gjetjet kryesore të auditimeve dhe vijë tashmë tek rekomandimet. Natyrisht rëndësia kryesore e një Institucioni Suprem Auditimi është tek rekomandimet dhe sa këto rekomandime pranohen nga ai subjekt që ai auditon. Detyra jonë natyrisht është të luftojmë deri në fund për zbatimin e rekomandimeve. Ne përgjithësisht dëmin ekonomik të zbuluar e rekomandojmë tërësisht në masën 99% për tu zhdëmtuar. Natyrisht këtu ka shumë për të bërë, pasi zhdëmtimi i dëmit është pjesë e shqyrtimit administrativ nga subjekti dhe e shqyrtimit nga organet e gjyqësorit.

Megjithatë ne përpiqemi të jemi konsistent dhe rekomandimet tona janë edhe rekomandime përmirësime në fushën ligjore, rekomandime në fushat administrative dhe atë disiplinore, etj. Kështu, KLSH ka propozuar 82 ndryshime legjislacioni në vitin 2013, 88 ndryshime në vitin 2014 dhe në këtë gjashtë mujor kemi propozuar 19 ndryshime legjislacioni. Të dhënat tona kemi përfshirë gjithashtu edhe kallëzimet penale, por do të vazhdoj këtu për të dhënë një panoramë për rekomandimet. Po të shikoni dhe të krahasojmë treguesit e periudhës 2008-2011 me periudhën 2012-2014 në të gjitha kemi ndryshime të konsiderueshme. P.sh me blu ne kemi propozim për ndryshime legjislacioni, kjo duke krahasuar me periudhën e katër viteve me 3 vite. Me të kuqe janë markuar propozimet të tjera.



Ndër rekomandimet kryesore që ne kemi dhënë dhe që mendoj se janë me interes të auditorit e unë jam i hapur t'i trajtojmë dhe më vonë në bisedat që do të zhvillojmë në tryezat e punës me audituesit është dhe rekomandimi për borxhin publik.

Sa i përket borxhit publik, i cili është një problem madhor dhe shqetësues për të gjitha ekonomitë e vendeve si Shqipëria dhe Kosova apo dhe vendeve me më shumë traditë (përvoja e hidhur Greke flet shume në këtë drejtim), ne kemi propozuar që sipas përvojës polake të vendoset në Kushtetutë kufizimi i borxhit publik në masën 60 % të GDP. Në Shqipëri, në këto vite borxhi publik ka lëvizur shumë dhe tani mund të ketë kaluar deri tek 70 %. Ky borxh 5 ose 6 vite më parë ishte në kufijtë e 60 % . Megjithatë, kjo nuk duhet të na pengojë ne që të vazhdojmë të insistojmë që brenda një 5 vjeçari apo 10 vjeçari borxhi të kalojë në këto parametra. Borxhi publik është një rrezik i madh për financat publike në të ardhmen.

Rekomandimi i dytë që ne i kemi dhënë Kuvendit të Shqipërisë është rekomandimi për ngritjen e një Këshilli Fiskal, i cili duhet të gëzojë statusin e një institucioni publik të pavarur dhe që duhet të ketë pavarësi rigoroze dhe shumë strikte nga politika. Natyrisht, ky Këshill Fiskal do të jetë i zgjedhur nga Kuvendi, do ketë përfaqësues të Qeverisë dhe do të jetë mbi palët.

Një rekomandim tjetër që i kemi dhënë Kuvendit për gjatë këtyre dy viteve e insistojmë në vazhdim (përpara se të vija këtu kam firmosur sërish një shkresë) është rekomandimi që Kuvendi duhet të ndërmarrë nismën për hartimin e Ligjit për Përgjegjësinë Materiale. Për të gjithë nëpunësit e administratës publike të nivelit të mesën, të lartë, shumë të lartë dhe titullarët e institucioneve duhet të ketë një ligj që ata të përgjigjen jo vetëm penalisht, por të përgjigjen dhe materialisht. Pra ligji duhet të trajtojë në mënyrë eksplicite këto përgjegjësi të nëpunësve të administratës. Këto përgjegjësi trajtohen edhen sot, por janë shumë të shpërndara dhe është shumë e vështirë për ne. Zbatimi i këtyre rekomandimeve paraqitet i vështirë.

Përveç të tjerave, ne përpiqemi të propozojmë edhe masa me karakter organizativ e masa me karakter disiplinore dhe tek masat disiplinore dua të ngre një shqetësim.

Përgjithësisht masat tona administrative dhe disiplinore zbatohen ne kufijtë 65-70% dhe ky është një tregues i kënaqshëm për sa i përket masës disiplinore "largim nga detyra" . Por për drejtuesit e nivelit të lartë zbatimi i kësaj mase shumë i ulët, pra është në nivelin 20-30 %.

Kjo tregon që gradualisht në vendet tona sa më lart ngjitesh, aq më shumë instalohet kultura e pandëshkueshmërisë. Të gjithë konstatojmë se në përfundim të një auditimi, kur subjektet përcjellin informacionin për zbatimin e rekomandimeve, evidentohet qartë se për nëpunësit e thjeshtë janë zbatuar masat, është zbatuar largimi nga detyra, kurse

drejtuesi më i lartë, ai që ka dhënë dhe urdhrat, nuk cenohet, nuk preket. Madje, ndonjëherë këta drejtues edhe kur ne bëjmë kallëzim penal, duke qenë se nuk kanë firmosur nuk i përcjellim në prokurori.

Pavarësisht trysnive apo sfidave që ne kemi nga të gjitha anët, ne jemi në ecjen tonë midis Scylla and Charybdis, ndaj duhet t'i qëndrojmë besnik parimit themelor të auditimit: Audituesi jep opinionin e tij të pavarur e profesional vetëm mbi ato që janë të shkruara. Ai nuk merret me fjalë, nuk merret me thashetheme. Ashtu siç e theksojnë dhe standardet, audituesi duhet të karakterizohet nga skepticizmi profesional, por audituesi nuk duhet të abuzojë me detyrën.

Pikërisht kjo është një nga arsyet që ne në institucionin tonë kemi vënë theksin tek auditimi i të integritetit, sipas metodës IntoSAINT që ka zhvilluar Gjykata Holandeze e Auditimit. Ne shikojmë këtu në tabele numrin e kallëzimeve penale dhe po të shikoni nga viti 2008 deri në vitin 2011 kemi një numër të ulët kallëzimesh penale. Në rast se ne krahasojmë periudhën 2012-2014 me 4 vitet e mëparshme konstatohet se kemi një numër 2,2 herë më të lartë të subjekteve të kallëzuara penalisht nga ana jonë dhe 2,7 herë më shumë persona.

Për 6 mujorin e parë të vitit 2015 ne kemi 26 kallëzime penale, çka dëshmon punën intensive dhe profesionale të audituesve tanë për zbulimin e rasteve korruptive dhe abuzive të shpërdorimit të parasë publike.



Këtu dua të theksoj diçka mjaft të rëndësishme. Institucionet Supreme të Auditimit si në Shqipëri ashtu dhe në Kosovë e kanë detyrë të kryejnë kallëzimet penale. Vendet tona janë shumë të ndjeshme ndaj korrupsionit dhe korrupsioni nuk ka ngjyrë. Ai nuk është as i kuq as blu, d.m.th nuk i përket asnjë partie. I përket asaj pjese të administratës së korruptuar apo asaj pjese të politikës së lartë të korruptuar që nga ana jonë si Institucione Supreme Auditimi, duhet luftuar, pasi në këtë mënyrë ne kontribuojmë në thellimin e llogaridhënies. Pastaj kuptohet që kjo është detyrë funksionale e institucioneve të tjera dhe me ligj është Prokuroria që duhet ta vazhdojë ndjekjen e çdo rasti. Detyra jonë është të vendosim bashkëpunim të drejtë, konstruktive dhe të hapur me Prokurorinë si institucion përgjegjës për ndjekjen e kallëzimeve tona, por natyrisht dhe ajo me aktorët e tjerë si Kuvendi, taksapaguesit, shoqërinë civile, etj.

Një rëndësi e veçantë në institucionin tonë i është dhënë edhe shqyrtimit të cilësisë në të ftohtë. Ne e organizojmë këtë dy herë në vit në institucionin tonë, por edhe gjatë gjithë periudhës vjetore, pra riauditojmë ose kontrollojmë në të ftohtë rreth 20% të dosjeve tona të auditimit. Ky kontroll është larg çdo pasioni apo larg çdo mase represive ndaj audituesve. Ky është një kontroll për të përmirësuar punën tonë audituese.

Më poshtë dëshiroj të theksoj disa gjëra që i takojnë menaxhimit institucional.

Ashtu si struktura e ZAP-it edhe struktura e KLSH-së modeste. Megjithatë, duke pasur parasysh që ne duhet të jemi institucione që duhet të udhëheqim përmes shembullit, numri i nëpunësve në institucionin tonë është një numër i pranueshëm. Stafi i Kontrollit të Lartë të Shtetit përbëhet nga 170 audituesdhe punonjës, nga të cilët mbi 80%, pra 140 janë audituesnë procese auditimi.



Ne i kemi të ndara departamentet në departamente sipas përmbajtjes së punës. Këtë vit ne krijuam një Departament të Politikave të Auditimit dhe mendoj në këtë departament të përfshij Drejtorinë e Trajnimeve dhe të Standardeve, kemi përfshirë Drejtorinë e Marrëdhënieve me Jashtë dhe të Botimit, si dhe Drejtorinë Juridike. Këto ditë jemi duke menduar që Drejtorinë Juridike dhe të Kontrollit të Cilësisë ta kalojmë në një nivel më të lartë dhe ta kemi një nga departamentet kryesorë të institucionit për të bërë riverifikim e rikonkroll të auditimeve dhe mendoj që kështu ne do të thellojmë rezultatet tona.

Ne jemi përpjekur gjatë këtyre viteve dhe të thellojmë investimet, jo vetëm në resurse nëpërmjet rekrutimeve të personelit me një ose dy fakultete apo të zotë. Megjithatë, unë këtu duhet të them që unë nuk jam i kënaqur me audituesit e rinj që kam marrë dhe prej tyre duhet ende shumë punë. Nuk e di se sa auditues të rinj janë rekrutuar këto 2 ose 3 vjet tek ju, por unë dua t'iu theksoj se *"Auditues pa punuar nuk bëhesh. Mund të kesh mbaruar mirë studimet universitare, por në rast se nuk punon, nuk mund të bëhesh auditues i suksesshëm. Në rast se një audituesi të vjetër i mjafton koha 8 orarshe, audituesi i ri duhet të shpenzojë përveç atyre orëve edhe 4 orë për lexime dhe thellime në fusha të caktuara"*.

Një ndër komponentët thelbësor të ngritjes së kapaciteteve institucionale të një SAI është dhe rritja dhe konsolidimi i njohurive të stafit lidhur me standardet e pranuara ndërkombëtarisht të auditimit dhe standarde të tjera që i shërbejnë punës audituese.

Për këtë mund të themi se në këto tre vite ne kemi bërë një përmbysje sa i përket konceptit të trajnimit të stafit, duke kaluar tashmë në konceptin e edukimit të vazhdueshëm profesional. Gjatë periudhës 2012-2014 ne kemi arritur një mesatare me mbi 22 ditë trajnimi në vit, nga 2-3 ditë trajnimi që ne kishim për çdo punonjës në vitet e mëparshme.

Për rritjen e kapaciteteve profesionale të punonjësve janë përzgjedhur nga ne disa forma trajnimi. Kështu, ne kemi zhvilluar trajnime brenda institucionit tonë ku referuesit kanë qenë auditues me përvojë, trajnime në partneritet me institucionet supreme të auditimit dhe trajnime në bashkëpunim me përfaqësues të profesoratit të Shqipërisë.

62% të trajnimeve të kryera e përbëjnë trajnimet brenda institucionit, 18% janë trajnime nga institucione të tjera brenda vendit dhe trajnimet jashtë vendit janë masën mbi 10 %. Nga 140 auditues, 86 auditues të KLSH çdo vit trajnohen jashtë vendit. Kështu, ata janë trajnuar jashtë vendit për 3 ditë, 1 javë, 10 ditë ose më shumë.

Për sa i përket trajnimeve, kjo është një fushë që ne si SAI duhet të shfrytëzojmë shumë moton e INTOSAI *"Experientia Mutua Omnibus Prodest*". Ne duhet të kërkojmë bashkëpunim dhe duhet të jemi të hapur, pasi ka Institucione Supreme Auditimi shumë dashamirëse ndaj shqiptarëve në përgjithësi.

Përgjithësisht të gjitha SAI-et kanë një bashkëpunim të mirë ndërmjet njëri-tjetrit, që e tejkalon disa herë bashkëpunimin në fushën e politikës. Ne si shqiptarë të Shqipërisë dhe si shqiptarë të Kosovës, si institucione respektive të dy shteteve shqiptare kemi shumë dashamirës dhe këtu mund të përmendim Institucionin Suprem të Suedisë, të Polonisë, të Turqisë, të Austrisë, të Gjermanisë apo dhe të rajonit, ku duhet përmendur SAI i Kroacisë, Malit të Zi etj.

Në ceremoninë që zhvilluam me rastin e 90 vjetorit të institucionit tonë, ne patëm një përshëndetje të veçantë nga Audituesi i Përgjithshëm i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Gene L. Dodaro. Unë kam pasur fatin ta takoj dhe në Amerikë në një vizitë zyrtare dhe ne siç shihni tek stenda e botimeve të ekspozuara kemi përkthyer dhe standardet e auditimit të qeverisë amerikane, të cilat unë mendoj janë me mjaft interes për t'u lexuar.

Por z. Dodaro në përshëndetjen që na dërgonte, theksonte se " *Unë e di se Kontrolli i Lartë i Shtetit e ka të qartë rëndësinë e INTOSAI-t për anëtarët e tij dhe auditimin e qeverive në të ardhmen. Si një organizatë autonome, e pavarur dhe jo politike, INTOSAI ofron vendin ku SAI-et mund të punojnë së bashku dhe të ndajnë eksperiencat e tyre. Këto eksperienca variojnë nga strategjitë e bazuara në mësimet e mësuar, deri tek praktikat më të mira".* Në këtë drejtim të dyja institucionet tona duhet të angazhohen me pjesëmarrjen në këto forume ndërkombëtare dhe unë mendoj që punën e mirë që ka bërë z. Olofsson, z. Venhari së bashku me drejtuesit e rinj të ZAP-it do ta çojë më përpara, në mënyrë që ZAP i Kosovës të anëtarësohet në INTOSAI dhe në EUROSAI dhe të mos jetë me status vëzhguesi. Gjithashtu edhe në këtë periudhë duhet të përfitojmë sa më shumë nga projektet e ndryshme.

Dëshiroj të theksoj që në këto tre vite e gjysmë ne kemi arritur një kolanë botimesh prej 35-40 botimesh. Ne i kemi prezantuar botimet tona këtu dhe janë botime në të cilat ne kemi prezantuar analizat tona, janë përkthyer standardet e auditimit, janë botime në të cilat ne kemi përkthyer standarde të SAI-ve moderne, siç është SAI më prestigjioz në botë, GAO amerikane, është një botim special për 60 vjetorin e INTOSAI-t që ne e përkthyem dhe janë manualet për auditimin financiar, të pajtueshmërisë, të mjedisit dhe të borxhit publik. Secili nga ju që ka interes për këto botime, mund ti gjejë ato dhe në faqen web të KLSH-së, por ne do tua përcjellim dhe në rrugë elektronike cilindo botim për të cilin ju keni interes.

Ne botojmë gjithashtu edhe një revistë të auditimimit publik. Unë përfitoj nga rasti të përsëris kërkesën time dhe pres bashkëpunimin me ju. Tashmë është në proces numri i 10 i kësaj reviste që ne botojmë çdo katër muaj në shqip dhe në anglisht. Është për të ardhur keq që ne kemi vetëm një botim nga zyra juaj. Unë jam shumë i hapur dhe ju mund të sillni botime në grup, të sjellin drejtuesit e lartë, të sjellin audituesit që janë me

grada ose pa grada shkencore dhe është i mirëpritur bashkëpunimi me audituesit tanë.

Në revistën tonë ka shkruar Presidenti i Malit të Zi, Audituesi i Përgjithshëm i Kroacisë, Presidenti i Gjykatës Austriake të Auditimit, Presidenti i Gjykatës Turke. Në këtë revistë shkruajnë dhe specialistë të ndryshëm të këtyre SAI-ve.

Bashkëpunimin me ju e pres dhe në Konferencën e IV Shkencore. Ne kemi zhvilluar deri tani tre Konferenca Shkencore. Madje tema e Konferencës së tretë ishte "Auditimi kombëtar në shërbim të qeverisjes kombëtare".

Në dy konferenca ka kontribuar edhe z. Olofsson, të cilin përfitoj nga rasti ta falënderoj për këtë dhe jo vetëm për këtë. Në konferencën që do të organizojmë këtë vit tema kryesore do të jetë analiza e riskut, ndaj do ta mirëprisja një kontribut zyrtar tuajin z. Artan dhe të audituesve me përvojë. Është shumë e rëndësishme për të dy institucionet që ne të diskutojmë, të japim përvojën dhe rekomandimet tona për auditimin e riskut si një nga elementët kyç për kryerjen e një auditimi të suksesshëm.

Gjithashtu ne jemi përpjekur dhe po mbajmë një ritëm mjaft të mirë me prezencën tonë në media, duke e konsideruar median aleaten tonë më të fortë. Gjatë vitit 2014, 50 audites kanë publikuar 134 shkrime në median e shkruar, nga 128 shkrime të publikuara në vitin 2013. Këto shkrime ne i përmbledhim në një botim 6 mujor "Audituesit e KLSH-së në shtypin e shkruara".

Këtu do më lejoni të citoj atë që Presidenti i Gjykatës Turke të Llogarive, z. Akyel e ka theksuar në një konferencë të EUROSAI-t dhe të OLACEF-it i cili shprehet se "*Transparenca dhe llogaridhënia janë dy parime kryesore të qeverisjes së mirë në sektorin publik dhe përgjegjësia kryesore e SAI-eve është të kontribuojnë në transparencën dhe llogaridhënien e menaxhimit të fondeve publike. Për të përmbushur këtë përgjegjësi një SAI duhet të kryej auditime të cilësisë së lartë dhe të prodhojë raporte cilësore auditimi. Kjo është mënyra e vetme që një SAI të mund të fitojë dhe të mbajë lart kredibilitetin dhe besimin*".

Ndërsa z. Dodaro, Audituesi i Përgjithshëm i GAO-s në përshëndetjen drejtuar KLSH-së thekson se "*Ne besojmë tërësisht në transparencën, në i idenë se qytetarët duhet të jenë të informuar sa më shumë të jetë e mundur mbi rezultatet e performancës së qeverisë. Sipas mendimit tim të kuptuarit nga publiku dhe mbështetja e tij do të jenë thelbësore në adresimin e politikave të vështira që shtrihen përpara nesh".*

Së fundi, dua të theksoj që ne kemi dy vite që jemi përpjekur dhe këtë vit, pra në vitin 2014 zhvilluam analizën tonë mbështetur mbi metodën IntoSAINT, përvojë e Gjykatës Holandeze të Auditimit mbi auditimin e integritetit të institucionit. Ne jemi të bindur se, për Institucione Auditimi si ne dhe si ju (pasi ne kemi të njëjtën problematikë), forcimi i integritetit dhe auditimi i integritetit brenda institucionit është një parakusht shumë i rëndësishëm për rritjen e kredibilitetit dhe është një kusht i nevojshëm që ti të kesh

mundësi të auditosh integritetin dhe në institucione të tjera publike. Ne jemi të vendosur të vazhdojmë me metodën e IntoSAINT-it dhe kemi publikuar dy botime mbi këtë metodë, botime të cilat ju mund ti përdorni.

Dua ta mbyll fjalën time me dy-tre konsiderata që nuk janë vetëm të pozicionit si Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit, por janë dhe konsiderata personale.

Unë kur vij në Prishtinë ndihem më mirë se në Tiranë. Unë jam nga Vlora dhe këtu ndihem njësoj si në Vlorë, më duket sikur vij në qytetin tim të lindjes. Ne jemi dy qytetet e Pavarësisë, pra dhe Prishtina dhe Vlora.

Në rast se ne do ta gjykojmë njëri-tjetrin mbi bazën e bashkëpunimeve që ne kemi si dy institucione të pavarura të dy shteteve të pavarura, natyrisht që ne jemi të kënaqur. E kemi intensifikuar marrëveshjen, të cilën unë e kam nënshkruar sapo kam filluar detyrën me z. Olofsson në shkurt të vitit 2012 kur unë nuk kisha as 2 muaj në detyrë.

Në rast se do të flasim si dy institucione të të njëjtit kombi, si dy institucione të njerëzve të një gjaku, secili nga ne, duke filluar nga unë dhe drejtuesi juaj, kemi shumë për të bërë.

Ne duhet ti intensifikojmë marrëdhëniet me njëri-tjetrin, të cilat duhet të shtrihen jo vetëm në shkëmbimin e përvojave më të mira dhe kryerjen e trajnimeve, por ajo çka është më e rëndësishme është kryerje e një numri më të madh të auditimeve të përbashkëta dhe auditimeve paralele. Institucionet tona tashmë kanë një përvojën e mirë dhe frutdhënëse të krijuar nga kryerja e auditimeve paralele. Kjo përvojë duhet të shërbejë si pikënisje dhe për kryerjen e auditimeve të përbashkëta për fusha sensitive, të cilat janë të ndjeshme dhe ndikojnë në jetën e qytetarëve të dy vendeve tona. Bashkëpunimi midis institucioneve tona mund të intensifikohet veçanërisht në kryerjen e auditimeve të përbashkëta në fushën e performancës. Jam i bindur se rezultatet e auditimeve përbashkëta, do ti shërbejnë identifikimit të mangësive dhe hartimit të politikave në të mirë në ndihmë të përmirësimit të jetës së qytetarëve tanë.

Ju keni një fat të mirë. Këtu tek ju SNAO suedeze po punon dhe po e ndihmon shumë ZAP-in e Kosovës. Edhe tek ne deri diku, megjithëse kur i ftojmë në konferenca dhe përvjetorë, na mungojnë. Këtu tek ju SNAO këta kanë bërë shumë punë dhe të cilat duhen vlerësuar.

Ideja është që ne të përfitojmë më të mirën nga bashkëpunimi me këto institucione moderne dhe të krijojmë një bashkëpunim e një koordinim të tillë që nesër të jemi në gjendje të ecim dhe të vazhdojmë vetë rrugën për modernizimin dhe konsolidimin e institucioneve tona.

Bashkëpunimi midis KLSH-së dhe ZAP-it duhet të konsistojë në hartimin e një strategjie të përbashkët dhe një plani veprimi, që të fillojmë me kryerjen e një numër auditimesh të përbashkëta dhe nga viti në vit ne ta intensifikojmë atë. Është e rëndësishme të theksohet se në radhë të parë ne duhet të përmirësojmë cilësinë e këtyre auditimeve dhe pastaj ti rrisim ato numër.

Ky është dhe një nga objektivat madhor që ne kemi si Institucion Suprem Auditimi në Shqipëri. Konsolidimi i auditimeve financiare dhe të rregullshmërisë, shtimi i numrit dhe rritja e vazhdueshme e cilësisë në auditimet e performancës do të jetë në fokusin e veprimtarive audituese të KLSH për vitet e ardhshme. Krijimi i kapaciteteve për auditimin financiar, vijueshmëria e forcimit të kapaciteteve për auditimet IT në entet e sektorit publik si dhe zhvillimi i infrastrukturës dhe mjeteve të IT gjatë procesit auditues, janë objektivat në të cilat do të përqendrohet menaxhimi ynë institucional.

Qëllim madhor për Kontrollin e Lartë të Shtetit mbetet dhënia e kontributit për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies, të cilat i shërbejnë përmirësimit të mirëqeverisjes dhe luftës pa kompromis kundër korrupsionit.

Ju faleminderit!

KREU VII.

Prezantime dhe kumtesa në Konferenca Shkencore

- Konferenca e I-rë Shkencore "87 vjet KLSH në 100 vjet Shtet shqiptar", *28 dhjetor 2012*
- Konferenca e II-të Shkencore "Roli i SAI-ve për një menaxhim publik të përgjegjshëm në sfidat e sotme", *12-13 dhjetor 2013*
- Profil mbi menaxhimin e sistemit të kontrollit të integritetit në KLSH gjatë periudhës 2012-2013
- Konferenca e III-të Shkencore "Auditimi Kombëtar në shërbim të Qeverisjes Kombëtare", *29-30 tetor 2014*
- Zvogëlimi i riskut: një potencial i mundshëm i zhvillimit të vendit

KONFERENCA E I-RË SHKENCORE "87 VJET KLSH NË 100 VJET SHTET SHQIPTAR"

Konferenca e Parë Shkencore u zhvillua në datën 28.12.2012 në sallën e Hotel Internacional Tirana me pjesëmarrjen e të ftuarve: deputetit Kosta Barka, ish-kryetarit të KLSH-së z. Mustafa Kërçuku, As. Prof. Dr. Lindita Lati, Kryetare e Autoritetit të Konkurrencës (AKK), Prof. Dr. Jorgji Bollano, Kryetar i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit(KKK), z. Sazan Guri, Kryetar i Institutit "G&G Group", zj. Blerta Selenica drejtore e Departamentit të Administratës Publike (DAP), zj. Klodiana Cankja, drejtore e Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) dhe drejtori i Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA), Prof. Dr. Hysen Çela.

Të nderuar pjesëmarrës,

Ndihem i privilegjuar që në mbyllje të këtij viti Jubilar të 100 vjetorit të Shtetit tonë të pavarur, sot Kontrolli i Lartë i Shtetit organizon Konferencën e tij të parë shkencore vjetore, të përqendruar në evidentimin e vlerave të historisë së institucionit dhe të punës shumë-vjeçare të të gjithë punonjësve që kanë kontribuar me përkushtim për ngritjen dhe mbarëvajtjen e tij në periudha kohore të ndryshme.

Hedhja e shikimit nga historia na ndihmon të kuptojmë jo vetëm rrënjët nga vijmë dhe bazën e krijuar, por edhe vlerat dhe forcat që mbartim me vete në përballimin e sfidave të së ardhmes. Këto vlera ia vlen t'ia shpalosim jo vetëm vetes, por edhe opinionit dhe perceptimit qytetar, i cili pret shumë nga ne. Për këtë arsye jemi duke finalizuar historikun e KLSH-së, një fibër që këto ditë del nga shtypshkronja dhe do t'i vihet në dispozicion mediave dhe qytetarit.

Prezantimet që do të vijojnë në këtë konferencë do t'ju mundësojnë të shikoni mënyrën se si ka lindur KLSH, ky institucion jetik për mbrojtjen e interesave të qytetareve dhe Kuvendit në administrimin e parasë publike. Do të kuptoni format që ai ka marrë në rrjedha të ndryshme të historisë së shtetit shqiptar, mungesën e plotë të pavarësisë dhe deformimin gjatë diktaturës, zhvillimet e vrullshme në periudhën e tranzicionit 1992 e deri më sot, si dhe përpjekjet e punonjësve të tij profesionistë për të realizuar një mëvetësi funksionale, pavarësisht nga kornizat e kohës.

Si institucion i pavarur, nëpërmjet këtij aktiviteti dëshirojmë të krijojmë traditën e mirë të vlerësimit të veprimtarisë institucionale, duke kontribuar në kulturën e vlerave dhe të përgjegjësise publike në vend, për t'ia kundërvënë anti-kulturës së pandëshkueshmërise,

por edhe duke shpresuar që kjo traditë të ndiqet nga institucionet e tjera publike të pavarura dhe të pasurohet vit pas viti.

Punimet e kësaj konference do të mbyllen me nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit mes KLSH dhe Agjencisë së Prokurimit Publik, Departamentit të Administratës Publike, Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar, Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit dhe Institutit "G&G Group".

Kontrolli i Lartë i Shtetit është në proces reformimi dhe këto marrëveshje janë thelbësore për institucionin, sepse mundësojnë kalimin e tij të natyrshëm nga veprimtari bazuar në standarde të përgjithshme në veprimtari bazuar në respektimin e plotë të standardeve profesionale të INTOSAI-t, si dhe në bashkëpunimin me partnere profesionale që do të na ndihmojnë për t'u orientuar më mirë në sfidat e ardhshme, që janë modernizimi i Institucionit dhe thellimi i luftës kundër korrupsionit dhe për parandalimin e tij.

Jemi të bindur se të tillë partner do t'i gjejmë në Institutin e Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA), apo edhe në Agjencinë e Prokurimeve Publike, sikurse i kemi gjetur gjatë këtij viti në bashkëpunimin e frytshëm me Autoritetin e Konkurrencës apo me ILDKP-në. Thellimi i orientimit drejt dhe i respektimit të standardeve të fushës është thelbësor për ne. Kjo na ka shtyrë që në fillim të kërkojmë rikthimin e vëmendjes tek auditimi i performancës, krahas konsolidimit të auditimit financiar dhe të përputhshmërisë.

Qëllimi ynë është që të jemi një institucion modern i auditimit publik më të lartë, që mbështetet në standardet e INTOSAI-t dhe që ecën përpara sipas motos së kësaj organizate *"Eksperienca e përbashkët u shërben të gjithëve",* duke u bazuar në eksperiencat ndërkombëtare të institucioneve homologe, por pa dyshim edhe në eksperiencën shumë vjeçare të vetë Institucionit dhe në burimet e tij njerëzore cilësore në vite. Ndajmë bindjen që dhe në kohën e teknologjisë së informacionit, kapitali njerëzor bën dallimin dhe diferencën e institucioneve të suksesshme. Prandaj dhe investimi ynë parësor dhe thelbësor është dhe mbetet rritja e kapaciteteve audituese të audituesve tanë. Brenda vitit 2012 kemi dërguar audites për trajnim jashtë vendit në një numër të barabartë me atë që institucioni ynë ka çuar në këto shtatë vitet, 2004-2011 të marra së bashku. Rritja e kapaciteteve profesionale dhe e integrietit të audituesit më të lartë publik do të jenë konstante të vëmendjes dhe veprimtarisë sonë në vitet që vijnë. Marrëveshjet që kemi nënshkruar gjatë këtij viti me institucionet homologe si SAI polak, slloven, turk e kroat do te jenë operacionale në vitet në vijim dhe do të pasohen nga marrëveshje të tjera që do të nënshkruajmë me SAI të tjera të zhvilluara, nga ku mund të marrim eksperience të vyer dhe të fitojmë shprehitë që na duhen.

Konferencat e ardhshme vjetore do të përqendrohen pikërisht në zbatimin e standardeve të INTOSAI-t në punën tonë, në qasjen e eksperiencave me homologet tanë, duke sjellë risi dhe përsiatje nga eksperiencat e huaja, por dhe duke marrë më të mirën e traditës sonë dhe të auditimeve të suksesshme që kryejmë sot.

Le t'i lejojmë kujtesës historike të KLSH-së, historikut të denjë të këtij institucioni të na drejtojë në rritjen e vetëdijes dhe përgjegjësisë ndaj rolit tonë dhe sfidave që kemi përpara.

Ju faleminderit dhe Ju uroj punë te mbarë!

KONFERENCA E II SHKENCORE "ROLI I SAI-ve PËR NJË MENAXHIM PUBLIK TË PËRGJEGJSHËM NË SFIDAT E SOTME"

Konferenca e Dytë Shkencore u zhvillua në datat 12-13.12.2013 në sallën e Hotel Internacional Tirana. Në këtë konferencë pjesëmarrës ishin z. Ilir Meta, Kryetar i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, përfaqësues të SAI-ve partnere dhe bashkëpunëtorë të huaj, si Zyra Kombëtare e Auditimit (NIK) të Polonisë, Gjykata Turke e Llogarive, Zyra e Audituesit të Përgjithshëm të Kosovës, Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë, Gjykata Evropiane e Audituesve, Institucioni Shtetëror i Auditimit të Malit të Zi, Zyra Shtetërore e Auditimit të Maqedonisë, SAI i Rumanisë, i Bosnje Hercegovinës, Shoqata e Kontabilistëve të Certifikuar të Kosovës, këshilltarë të lartë të programit SIGMA, përfaqësues të institucioneve donatore në vend, të institucioneve te tjera shtetërore, të botës akademike, të shoqatave të profesionistëve të fushës, të shoqërisë civile dhe mediave, auditues nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. etj.

Kjo Konferencë Vjetore Shkencore e Kontrollit të Lartë të Shtetit vjen e dyta, pas Konferencës së Parë të dhjetorit 2012, të titulluar "87 vjet KLSH në 100 vite Shtet Shqiptar", e cila u përqendrua në historikun dhe vlerat e shpalosura në kohë të institucionit tonë kushtetues.

Rëndësia e aktiviteteve të tilla për komunitetin auditues të vendit dhe më gjerë buron nga standardet e INTOSAI-t, nga Deklarata e Limës, nga standardi ISSAI 20, parimet 7 dhe 8, si dhe nga Drejtimi i Dytë Strategjik i INTOSAI-t për ndërtimin institucional të kapaciteteve.

Institucionet supreme të auditimit (SAI-t) kanë nevojë të shkëmbejnë mendime për gjetjet e auditimeve të tyre, të ndajnë metodologjitë e përparuara dhe të përfitojnë nga inovacioni në teknikat dhe qasjet audituese të njëri-tjetrit. Kërkimi i aplikuar shkencor në auditimin publik e ndihmon pikërisht këtë nevojë të SAI-ve për progres dhe efektivitet të shtuar.

E veçanta e kësaj Konference është tema e saj, që përbën kryefjalën e menaxhimit publik në ditët tona dhe që kërkon shëndoshjen dhe rritjen e përgjegjësisë së financave publike. Sikurse e ka theksuar Deklarata e Pekinit e datës 26 tetor 2013 e Kongresit të XXI të INTOSAI-t, "*Auditimi kombëtar duhet të vihet në shërbim të qeverisjes kombëtare për përmirësimin e menaxhimit publik financiar*". Duke pasur një lidhje të ngushtë korelative me qeverisjen kombëtare, auditimi kombëtar është një forcë e rëndësishme në demokraci dhe në shtetin e së drejtës, për mbrojtjen e interesit publik, duke raportuar mbi përdorimin e burimeve publike dhe promovuar zbatimin e ligjit dhe të rregulloreve.

Si SAI, ne kemi përgjegjësinë dhe shansin që të përpiqemi të jemi kampionë të së vërtetës, ndershmërisë dhe integritetit në jetën publike. Sikurse e rekomandon edhe Deklarata e Pekinit e Kongresit të XXI të INTOSAI-t, ne mund dhe duhet të luajmë rolin e sistemit imunitar për qeverisjen publike. Vetëm duke e pranuar këtë sfidë dhe kryer këtë rol parësor, ne do te jemi në gjendje të vazhdojmë të kontribuojmë për të ruajtur demokracinë dhe shtetin ligjor, duke promovuar administrim dhe një qeverisje të ndershme e të pastër, duke mbajtur rregull ligjor, duke zbuluar paligjshmërinë, duke kufizuar abuzimet me pushtetin nëpërmjet mbikëqyrjes efektive të pushtetit publik. Në shumë raste veprojmë si këshilltarë, duke luajtur një rol konstruktiv, nëpërmjet sugjerimeve për përmirësime në sistemin ligjor. Si SAI, mund të ndihmojmë fortë në ndërtimin e komunikimit dhe besimit midis sektorit publik dhe qytetarëve, duke promovuar qeverisje të hapur dhe bërë të mundur që qytetarët të marrin pjesë në mënyre aktive në proceset e vendimmarrjes publike.

Sikurse e ka shprehur një personalitet evropian i auditimit suprem publik, z. Jacek Jezierski, ish President i Zyrës së Lartë Polake të Auditimit (NIK), në përshëndetjen e tij për Revistën Shkencore të KLSH "Auditimi Publik": "*Ne, SAI-t e pavarura, duhet të punojmë shumë dhe të vëzhgojmë nga afër qeveritë, në mënyrë që të jemi në gjendje të ofrojmë informacion të besueshëm dhe rekomandime për parlamentet tanë dhe për publikun. Kështu, sigurojmë një shtet më të mirë*".

Me këtë përgjegjësi të qartë, jemi përpjekur gjatë këtyre dy viteve të realizojmë objektivat tona strategjike, në përputhje me Planin e Zhvillimit Strategjik të INTOSAI-t, 2011-2017 dhe Planit tonë Strategjik 2013-2017. Ato janë ndërtimi i kapaciteteve të plota për kryerjen e auditimeve cilësore të përputhshmërisë, auditimeve financiare dhe të performancës, si dhe kontributi për qeverisjen e mirë publike, duke luftuar me përparësi abuzimet me pronën shtetërore dhe mashtrimet financiare.

Sikundër është theksuar me forcë nga Deklarata e Pekinit e Tetorit 2013 nga të gjitha institucionet supreme të auditimit, edhe ne si KLSH besojmë se auditimi kombëtar luan një rol të rëndësishëm në promovimin e performancës së qeverisë, veçanërisht përmes rritjes së ekonomicitetit, efektivitetit dhe efiçiencës së përdorimit të fondeve publike, përmirësimit të mekanizmit operacional të organizatave qeveritare, promovimit të integritetit, përgjegjshmërisë dhe transparencës së administratës, si dhe promovimit të praktikave më të mira të sektorit publik, duke shkëmbyer eksperienca, metoda dhe informacion.

Për të krahasuar punën që kemi bërë me standardet dhe eksperiencat e mira të SAI-ve Evropiane, për të realizuar shkëmbimin e këtyre eksperiencave të punës dhe të informacionit, një objektiv ky që buron nga Strategjia e INTOSAI-t dhe standardet e fushës, për tu përgatitur me një përqasje sa më profesionale ndaj sfidave të sotme për

shëndoshjen e financave publike, menduam të organizojmë këtë konferencë shkencore vjetore të institucionit, të përqendruar në rolin tonë si SAI për sigurimin e një menaxhimi publik të përgjegjshëm.

Mesazhe qendrore të Konferencës do të jenë ato të kumtesës nga përfaqësuesi i Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit të Komisionit Europian *"Për përgjegjshmërinë menaxheriale si parakusht për qeverisje të mirë dhe lehtësirat parësore për ofruesit e sigurimit të përdorimit të fondeve publike"*, të kumtesës së përfaqësuesit të Gjykatës Europiane te Audituesve *"Për rëndësinë e rritjes së rolit mbikëqyrës mbi financat shtetërore të auditimit publik, në kontekstin e krizës ekonomike botërore"*.

Eksperienca mjaft pozitive dhe me vlerë për ne do të vijnë nga kumtesat e përfaqësuesve të SAI-t partnerë të Gjykatës së Llogarive të Turqisë, të Zyrës Kombëtare të Auditimit-NIK të Polonisë, të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Suedisë, të Zyrës së Audituesit të Përgjithshëm të Kosovës, të Zyrës Shtetërore të Auditimit të Maqedonisë, si dhe të përfaqësuesve të SIGMA-s, për rolin e standardeve ISSAI në përmbushjen e rolit tonë, për auditimin e rregullave fiskale, për dobitë dhe modalitetet e bashkëpunimit mes audituesve të brendshëm dhe të jashtëm të sektorit publik, për metodën e re të kampionimit në auditimin e fondeve të BE, etj.

Ide dhe sugjerime tejet të vlefshme për punën tonë në mbikëqyrjen e financave publike do të na vijnë nga kumtesat e përfaqësuesve të Autoritetit Shqiptar të Konkurrencës, Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar, Këshillit Kombëtar të Kontablitetit.

Ne si auditues të KLSH, jemi përgatitur të sjellim eksperiencat dhe përqasjet tona në veprimtarinë audituese të kohëve të fundit, me shpresë se do të marrim prej jush sugjerime për përmirësimin e punës sonë.

Më lejoni një falënderim të veçantë për SIGMA-n, për këshilltarin e saj të lartë z. Joop Vrolijk dhe ndihmën modeste financiare që SIGMA dhe, duke iu bashkuar nismës sonë në organizimin e këtij aktiviteti, si dhe për mbështetjen cilësore në vijimësi që ky program i OSBE-së dhe BE-së i jep Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Duke ju falënderuar të gjithëve për praninë Tuaj dhe kontributet e vyera në formën e kumtesave të përgatitura dhe diskutimeve të mëtejshme, ndaj me Ju besimin e plotë në diskutimet konstruktive dhe rezultatet e kësaj konference.

Ju faleminderit!

Konkluzionet dhe rekomandimet e Konferencës së Dytë Shkencore:

1) Vetëm auditimitet e pavarura dhe profesionale mund të kontribuojnë në mbajtjen e qëndrueshmërisë afatmesme dhe afatgjatë të financave publike, në mbrojtje të interesit publik dhe forcimit të qeverisjes kombëtare;
2) Thellimi në analizën e riskut në planin vjetor të auditimeve dhe marrja e informacionit nga burime të ndryshme, përfshirë dhe shoqërinë civile dhe mediat, ndihmon në përzgjedhjen efikase të subjekteve dhe tematikave për auditimin vjetor;
3) Llogaridhënia menaxheriale, si përbërës thelbësor i mirëqeverisjes dhe vendosja e "tone at the top", mund të sigurohen nëpërmjet transparencës së plotë të veprimtarisë menaxheriale, delegimit të kompetencave dhe marrjes në këmbim të informacionit;
4) Forcimi i rolit mbikqyrës të auditimit publik suprem mbi financat shtetërore mund të realizohet me efektshmëri duke zbatuar në praktikë ISSAI-t e auditimit financiar, të përputhshmërisë dhe të performancës, në përshtatje të plotë me kushtet e vendit;
5) Rritja e cilësisë së auditimeve të rregullave fiskale kontribuon në mirëfunksionimin e skemës së rregullatorit financiar në vend;
6) Përballimi i sfidave të sotme në auditimin publik lehtësohet dukshëm nga një bashkëpunim konkret dhe në vijimësi i audituesve të brendshëm me audituesit e jashtëm, duke synuar ngritjen e këtij bashkëpunimi deri në nivelin e auditimeve të përbashkëta;
7) Instrumenti i INTOSAINT i vetëvlerësimit ndihmon rritjen e integritetit të SAI-t dhe forcon besueshmërinë e tij në publik, prandaj ai duhet të përdoret më shpesh nga SAI-t;
8) Procesi i integrimit në BE kërkon njohjen e metodikave bashkëkohore të auditimit të fondeve të BE-së;
9) Në kushtet e reja të krijuara, duhet të rrisim përdorimin e mjeteve jo-konvencionale të politikës sonë audituese, duke bashkëpunuar më ngushtë dhe gjerësisht me botën akademike, shoqërinë civile, dhe organizatat profesionale të fushës;
10) Bashkëpunim konkret dhe efikas të strukturave shtetërore me institucione të tjera të angazhuara, në mënyrë që KLSH të garantojë progresin e enteve të audituara drejt zhvillimit të qëndrueshëm, një koncept që evolon vazhdimisht për shkak të integrimit të çështjeve me karakter social, ekonomik dhe mjedisor;
11) Norma ligjore e riskut dhe vlerësimi i tij në projekte e çdo aktivitet ekonomiko-financiar janë kusht i domosdoshëm i auditimit të tyre;
12) Raportet fiskale duhet të ofrojnë një asqyrë të plotë, relevante, në kohë dhe të besueshëm të pozicionit financiar dhe performancës së qeverive;

Kodi i Transparencës Fiskale do t'ju mundësoë vendeve aplikuese të tij një panoramë të qartë mbi praktikat e rpaortimit fiskal të tyre, duke i krahasuar ato me standardet ndërkombëtare dhe vendet e tjera.

PROFIL MBI MENAXHIMIN E SISTEMIT TË KONTROLLIT TË INTEGRITETIT NË KLSH GJATË PERIUDHËS 2012-2013

Kumtesë në bashkë-autorësi me zj. Luljeta Nano, Sekretare e Përgjithshme e KLSH,
Konferenca e Dytë Shkencore e KLSH

Integriteti i Institucionit Suprem të Auditimit është element thelbësor dhe parakusht që ky institucion të konsiderohet i besueshëm.

KLSH luan një rol kritik në promovimin e menaxhimit të shëndoshë të financave publike, në funksion të një qeverisje transparente dhe të përgjegjshme.

Hapat e ndërmarra deri tani nga KLSH, drejt modernizimit dhe me një vizion të ri, kane synuar një rol proaktiv për rritjen e përgjegjshmërisë dhe besueshmërinë së publikut ndaj qeverisjes.

Menaxhimi i fondeve publike është çështje besimi dhe në shoqëritë demokratike publiku kërkon transparencë, integritet dhe kompetencë prej institucioneve që ushtrojnë funksione publike.

E parë në këtë këndvështrim, Integriteti është parakusht **për autoritetin e institucioneve publike dhe besimin publik.**

Një institucion publik që nuk ka integritet e humb besimin e publikut dhe përfundimisht autoritetin e tij.

Çfarë masash ka marre KLSH në drejtim te instalimit dhe ngritjes se sistemeve efektive të integritetit:

ISSAI 1: (Deklarata e Limës; neni 14.1) kërkon që stafi i SAI-ve duhet të vlerësohet bazuar në profesionalizmin, kualifikimet **dhe integritetin moral** në mënyrë që të sigurohet që ata të mund të kryejnë plotësisht detyrat e tyre.

ISSAI 20 : (Përgjegjësitë e SAI-it) i kushton vëmendje të veçantë përgjegjshmërisë dhe transparencës, si një element i qeverisjes së mirë të SAI-t.

Në kuadër të përmbushjes së objektivit per modernizimin e institucionit gjatë dy viteteve të fundit KLSH, ka ndërmarrë hapa konkrete dhe një sërë iniciativash për instalimin në institucionin e KLSH-së të një **<u>infrastrukture efektive</u>** etike dhe me integritet.

1-Në fokus të politikave të ndjekura nga Kryetari është patur parasysh që masat e ndërmarra për instalimin e një sistemi efektiv të integritetit të jenë të vazhdueshme, pjesë e menaxhimit të përditshëm të institucionit të KLSH-së dhe jo politika të përkohshme *ad-hoc*, me impakt krijimin e një ambienti jo korruptiv dhe implementimin e një kulture etike dhe me integritet.

Problematikat e Integritetit në KLSH, nuk janë trajtuar si një projekt, sepse projekti përfundon dhe nuk është i vazhdueshëm por Integriteti është konsideruar si një **komponent standard i përditshëm** dhe i prekshëm nga të gjithë audituesit.

Mund të thuhet se mbikëqyrja dhe monitorimi që të mos rezultojnë incidente të karakterit korruptiv apo shkelje ndaj integritetit **është ngulitur dhe "gdhendur"** tashmë në veprimtarinë e përditshme të KLSH-së.

Promovimi i integritetit ka qenë në fokus të veprimtarisë menaxhuese.

Në këtë drejtim merr rëndësi aspekti praktik i filozofisë së menaxhimit i "Tone at the top" pasi promovimi i integritetit të KLSH-së është kryer nën parimin e "udhëheqjes nëpërmjet shembullit".

Nga ana tjetër politikat e integritetit janë implementuar duke shpenzuar një pjesë të konsiderueshme të fondeve buxhetore në këtë drejtim (Ngritja e strukturës së auditimit dhe investigimit, apo e komunikimit, trajnime brenda dhe jashtë vendit, botime etj)

Politikat e integritetit në KLSH kanë qenë të tilla që të arrihej një ekuilibër midis parandalimit të shkeljeve dhe marrjes së masave ndëshkimore nga njëra anë dhe inkurajimit të integritetit nga ana tjetër.

Në drejtim të marrjes së masave ndëshkimore veprimtaria institucionale është përqendruar në drejtim të zbulimit, hetimit dhe ndëshkimit të shkeljeve.

Mund të konfirmohet që gjatë dy viteve të fundit në Institucionin e KLSH-së **është çrrënjosur praktika e mosndëshkueshmërisë** dhe për çdo shkelje të integritetit të zbuluar dhe hetuar janë ndërmarrë masa ndëshkimore deri në ndjekje penale.

Kjo praktikë është ndjekur pasi mosndëshkueshmëria sjell dëme të pariparueshme për institucionin e KLSH-së dhe humbjen e kredibilitetit institucionale në përgjithësi dhe të besimit të publikut në veçanti.

Nëse një shkelje e integritetit kalon pa u ndëshkuar, kjo sjell automatikisht demotivimin e anëtarëve të tjerë me moral të shëndetshëm të stafit të KLSH-së . Gjatë kësaj periudhe dy vjeçare është ndjekur politika "Tolerancë zero" ndaj shkeljeve të integritetit në këndvështrimin që nëse shkeljet nuk korrigjohen dhe ndëshkohen, ato bëhen të rrezikshme dhe "bumerang" për institucionin.

2-Kudo në botë vitet e fundit është ndërmarrë iniciativa për promovimin etikës dhe integritetit në sektorin publik. Në këtë kuadër KLSH i është bashkuar iniciativës së ndërmarrë nga Gjykata Holandeze e Auditimit për kryerjen e vetëvlerësimit të integritetit duke parashikuar hapa konkrete edhe në planin strategjik të KLSH-së 2013-2017, i cili do të synojë në testimin e sistemit të integritetit, evidentimin e fushave

vulnerabël dhe me risk si dhe hartimin e planit të masave që do të merren për forcimin e sistemit të etikës si dhe përmirësimin e menaxhimit të integritetit në KLSH.

3-Gjatë vitit 2013, u pranua anëtare e Task Forcës e Organizatës Europiane të Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAI) "Mbi auditimin e etikës".

KLSH nëpërmjet anëtarësimit dhe pjesëmarrjes aktive në këtë organizëm, synon nga njëra anë, në instalimin dhe funksionimin e një infrastrukture efektive etike në vetë institucionin e KLSH-së dhe nga ana tjetër, do të ndërmarrë misione auditimi mbi rregullaritetin dhe efiçiencën e Etikës dhe Integritetit në institucionet publike, duke konsideruar që lufta kundër korrupsionit dhe politikat për instalimin e një sistemi efektiv të integritetit të jenë pjesë e menaxhimit të institucioneve publike.

Nëpërmjet aplikimit të Instrumentit të vetëvlerësimit të integritetit në institucionin e KLSH-së si dhe Anëtarësimit në Task Forcën e EUROSAI-it "Mbi Auditimin e Etikës" KLSH synon <u>që të forcojë infrastrukturën etike</u> brenda vetë institucionit, dhe në këtë mënyrë të promovojë integritetin dhe etikën në institucionet e sektorit publik, duke "udhëhequr nëpërmjet shembullit".

Nëpërmjet kësaj politike do të tentohet drejt parandalimit të akteve korruptive nën parimin **<u>"më mirë të parandalosh se sa të shpenzosh për dëmin e shkaktuar"</u>** duke balancuar marrjen e masave në rastin e shkeljeve të integritetit dhe masave të cilat do të synojnë në parandalimin e tyre.

4-Po kështu me synim instalimin dhe zhvillimin më tej <u>të një kulture të re organizative</u> doli udhëzimi i Kryetarit nr. 3, date 18.06.2013 "Komunikim i drejtpërdrejtë për përmirësimin e punës audituese dhe rritjen e zbatimit të standardeve INTOSAI në KLSH" udhëzim i cili reflekton dhe është dëshmi e ndjekjes se praktikave më të mira të fushës, duke krijuar në këtë mënyrë hapësira konkrete të mjaftueshme për shprehjen e "kriticizmit pozitiv" nga poshtë lart apo dhënien e mendimeve sugjerimeve për përmirësimin e punës në institucion.

Kjo ishte një **<u>praktikë risi</u>** mjaft demokratike (gjithëpërfshirëse) aplikuar për herë të parë në institucionin e KLSH-së, dhe rezultoi se një pjesë e mirë e stafit të KLSH u tregua aktive në dhënien e mendimeve dhe sugjerimeve.

Nxjerrja e këtij udhëzimi ishte një "mjet " efektiv për promovimin e integritetit pasi çelësi për promovimin e integritetit përmes kulturës organizative është komunikimi.

Nëpërmjet këtij udhëzimi realisht u inkurajuan punonjësit e KLSH-së për diskutimin e problemeve, vlerësimin e menaxhimit apo edhe sugjerimin e mendimeve të ndryshme.

Nga ana tjetër kjo praktikë reflektoi edhe zbatimin e kërkesave të një prej Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI nr. 41 "Analiza e boshllëqeve" që synon përmirësimin e menaxhimit të institucionit.

5- Krijimi i një strukturë të veçantë në fillim të vitit 2012 e cila është

përgjegjëse për investigimin e shkeljeve ndaj integritetit është një masë më efekte parandaluese në drejtim të forcimit të sistemit të kontrollit të integritetit ne KLSH dhe reflekton më së miri një nga parimet themelore të INTOSAINT që është **"më mirë të parandalosh se sa të shpenzosh për dëmin e shkaktuar".**

Si rezultat i funksionimit të kësaj strukture gjatë vitit 2013 u dërguan për ndjekje të mëtejshme nga organi i Prokurorisë shkeljet e rezultuara për katër punonjës (auditues) si dhe janë dhënë një sërë masash disiplinore ndaj audituesve si një përgjigje e menjëhershme ndaj shkeljeve të integritetit të këtyre punonjësve.

6-Në Rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të institucionit, rregullore e cila reflekton kërkesat dhe standardet më të mira të fushës janë sanksionuar procedura të cilat tentojnë konsolidimin dhe forcimin e sistemit të kontrollit të integritetit të punonjësve gjatë veprimtarisë audituese. Përmendim këtu të drejtën e kryerjes së investigimeve edhe gjatë procesit auditues në vartësi kjo të sinjalizimeve të ndryshme për shkelje të integritetit nga ana e audituesve pra ekziston protokolli i investigimit të shkeljeve të integritetit.

-Po kështu në këtë rregullore janë përcaktuar qartë rregullat dhe procedurat që do të ndiqen për verifikimin e ndjekjen e ankesave dhe sinjalizimeve nga publiku apo palët e treta. Për më tepër, që në fillim të vitit 2012 është ngritur një strukturë e veçantë që merret me ndjekjen e letrave të popullit si dhe ekziston një procedurë monitorimi dhe raportimi periodik tek Kryetari i KLSH-së në lidhje me funksionimin efektiv të sistemit të ndjekjes së ankesave.

7-Një aspekt tjetër për instalimin e një sistemi funksional të kontrollit të integritetit është edhe menaxhimi efektiv i burimeve njerëzore të institucionit.

Në drejtim të rekrutimit, procedurave te përzgjedhjes dhe punësimit referuar kritereve dhe standarteve, KLSH duhet të veprojë dhe të zbatojë procedura që të mos marrin "mollë të kalbura", apo punonjës të pandershëm, kur punësohet personel i ri. Përvoja tregon se sjellja e papërshtatshme nga një person shkakton sjellje të ngjashme nga të tjerët (efekt domino). Një person i tillë **paraqet një kërcënim serioz** për integritetin e KLSH-së.

Për këtë arsye janë instaluar dhe funksionojnë procedura punësimi dhe të nxitjes së karrierës mbi baza konkurrimi dhe përzgjedhjeje por edhe bazuar në kriteret e

plotësimit rigoroz të kërkesave në lidhje me performancën dhe integritetin në përvojën e mëparshme të punonjësve.

8-Kodi Etik i KLSH-së . Bazuar në kërkesat e ISSAI 30 KLSH ka hartuar disponon dhe zhvillon një Kod Profesional të Etikës që reflekton praktikat më të mira dhe trajton çështjet e :

- besimit, konfidencës dhe kredibilitetit (ISSAI 30, kapitulli 1)
- integritetit (ISSAI 30, kapitulli 2)
- pavarësisë, objektivitetit, paanshmërisë (politike), neutralitetit, shmangien e konfliktit të interesave (ISSAI 30, kapitulli 3; ISSAI 200/2.1-2.32)
- sekretit profesional (ISSAI 30, kapitulli 4)
- kujdesin e duhur profesional dhe ushtrimin e kompetencave (ISSAI 30, kapitulli 5; ISSAI 200/2.1, 2,33-2,46) etj.

Strategjia për krijimin e një ambienti me integritet në KLSH ka ndjekur hapat e mëposhtme:

-së pari, u hartua kuadri rregullator (Rregullorja e organizimit dhe funksionimit të KLSH-së, urdhra dhe udhëzime etj) .

-së dyti, është vijuar me imponimin dhe implementimin e rregullave, procedurave dhe udhëzimeve. Janë kryer trajnime intensive që kanë synuar edukimin e punonjësve me frymën e standardeve dhe vlerave morale.

-së treti, është proceduar me kontrollin, investigimin dhe ndëshkimin e sjelljeve të papranueshme të integritetit .

9-Transparenca e Institucionit të KLSH-së në marrëdhënie me publikun.

Në zbatim të ISSAI 20: "Parimet e transparencës dhe llogaridhënies" KLSH ka synuar që nëpërmjet transparencës së veprimtarisë së aktivitetit institucional të sigurojë dhe ti japë publikut një garanci dhe një transparencë të plotë në lidhje me menaxhimin e sistemit të integritetit në KLSH.

Këtij qëllimi i kanë shërbyer publikimet në internet të raporteve të performancës institucionale, publikimit të analizave vjetore dhe periodike te veprimtarisë së KLSH-së, publikimit të masave te marra për kallëzimet penale ndaj audituesve që kanë rezultuar me shkelje të integritetit, apo aktiviteteve të trajnimit dhe forcimit të kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe të gjitha masave të cilat synojnë për instalimin e një infrastrukture etike efektive në institucionin e KLSH-së.

KONFERENCA E III-të SHKENCORE E "AUDITIMI KOMBËTAR NË SHËRBIM TË QEVERISJES KOMBËTARE"

Konferenca e Tretë Shkencore u zhvillua në datat 29-30.10.2014 në sallën e Hotel Internacional Tirana. Në këtë konferencë pjesëmarrës ishin: Presidenti i Republikës, SHTZ. Bujar Nishani; Ambasadori i SHBA-së, zoti Aleksander Arvizu; Deputeti i Parlamentit Europian, Igor Sholtes; Këshilltari Kryesor i Drejtorit të Përgjithshëm të DG-Budget dhe Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Komisionin Europian, z. Robert Gielisse; Presidentë të SAI-ve të Kroacisë, Ivan Klesiç dhe Malit të Zi, Milan Daboviç; Deputetë të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Prof. Dr. Anastas Angjeli dhe Edmond Spaho; përfaqësues nga bota akademike, nga profesorati i Universitetit Shtetëror të Tiranës, studiues dhe lëvrues të auditimit dhe të financave publike; përfaqësues nga institucionet supreme të auditimit të Polonisë, Austrisë, Kroacisë, Turqisë, Kosovës dhe Malit te Zi; përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit e Komisionit Europian(DG-Budget), nga përfaqësitë diplomatike në Shqipëri, nga shoqëria civile, si dhe auditues të KLSH-së.

Të nderuar pjesëmarrës,

sikurse theksohet në Deklaratën e Pekinit e Kongresit të XXI të INTOSAI-t *"Auditimi kombëtar duhet të vihet në shërbim të qeverisjes kombëtare për përmirësimin e menaxhimit publik financiar",* kemi menduar që këtë orientim themelor të organizatës botërore të institucioneve të auditimit të jashtëm publik, ta vendosim si temën dhe mesazhin qendror të Konferencës sonë të Tretë Shkencore.

Në Kongresin e fundit të INTOSAI-t, institucionet supreme të auditimit (SAI-t) kanë pranuar se qeverisja kombëtare efektive është faktori kryesor për ruajtjen e një zhvillimi ekonomik të qëndrueshëm dhe të progresit social të një vendi, për përmirësimin e jetës së qytetarëve. INCOSAI XXI theksoi se, duke pasur një lidhje të ngushte korelative me qeverisjen kombëtare, auditimi kombëtar është një forcë e rëndësishme në demokraci dhe në shtetin e së drejtës, për mbrojtjen e interesit publik, duke raportuar mbi përdorimin e burimeve publike dhe promovuar zbatimin e ligjit dhe të rregulloreve.

Në këtë mision besojmë se qëndron dobia e forumit tonë për këtë vit, në bazë dhe të standardit ISSAI 12, në të cilin theksohet se "*Shkalla në të cilën një institucion suprem i auditimit është në gjendje të bëjë ndryshim në jetën e qytetarëve varet nga roli i tij në forcimin e përgjegjshmërisë, transparencës dhe integritetit të qeverisë dhe të sektorit publik*".

Më lejoni të falënderoj SAI-t partnere të Polonisë (NIK), të Turqisë, Kroacisë dhe në veçanti Presidentet e këtyre SAI-ve, Ish-Presidentin e NIK, z.Jezierski dhe Presidentin e sotëm z.Kwiatkowski, zv.Presidentin z.Kutyla, Presidentin e Gjykatës Turke të Llogarive, z. Akyel, Presidentin e SAI-t kroat z. Klesiç dhe Presidentin e Senatit të SAI-t të Malit të Zi, z. Daboviç, si për praninë e tyre dhe kumtesat në Konferencë, ashtu edhe për kontributin e qenësishëm dhe bujar që kanë dhënë në ngritjen e kapaciteteve profesionale të audituesve të KLSH-së, nëpërmjet trajnimeve të shumta, të organizuara nga ekspertët e tyre në Varshavë, Ankara dhe Zagreb për auditimin financiar, auditimin e performances, auditimin e teknologjisë së informacionit, të prokurimeve publike, etj.

Falënderoj po ashtu Eurodeputetin, z. Soltes, për praninë e tij sot në Konference dhe për kontributin për ngritjen e dijeve të audituesve shqiptare, në cilësinë e Presidentit të Gjykatës së Auditimit të Sllovenisë.

Më lejoni të falënderoj, në mënyrë të veçantë Këshilltarin Kryesor të Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit të Komisionit Evropian (DG-Budget) dhe Drejtor i Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, z. Gielisse, për bashkëdrejtimin e kësaj konference dhe për kumtesat e tij shumë cilësore të këtyre dy viteve të fundit në këtë konferencë, por edhe për ndihmesën e jashtëzakonshme që ka dhënë në pajisjen e KLSH-së me një ligj të ri modern, tërësisht në përputhje me standardet e INTOSAI-t.

Konferenca shkencore e KLSH-së njohu një ecuri në rritje, duke qenë në vitin e parë të saj në dhjetor 2012, një aktivitet kushtuar historikut të institucionit, me rastin e 100 vjetorit të shtetit shqiptar. Në vitin e dytë, në 2013-ën, konferenca iu kushtua rolit të institucioneve supreme të auditimit për një menaxhim financiar të përgjegjshëm në sfidat e sotme, për të ardhur sot me temën qendrore të auditimit kombëtar në shërbim të qeverisjes kombëtare. Bashkëpunimi i realizuar mes audituesve të KLSH-së dhe eksperteve të SAI-ve partnere, të Gjykatës Europiane të Audituesve si dhe me përfaqësuesit e botës akademike dhe profesionale shqiptare, vërteton dobinë e motos së organizatës së institucioneve të auditimit të jashtëm publik, INTOSAI "*Experentia mutua omnibus prodest*".

Si institucione supreme të auditimit, SAI-t, sikurse e rekomandon edhe Deklarata e Pekinit, mund dhe duhet të luajë rolin e sistemit imunitar për qeverisjen publike kombëtare. Vetëm duke e pranuar këtë sfidë dhe përmbushur këtë rol parësor, ne do të jemi në gjendje të vazhdojmë të kontribuojmë për të ruajtur demokracinë dhe shtetin ligjor, duke promovuar administrim dhe një qeverisje të ndershme dhe të pastër, duke zbuluar paligjshmërinë, duke kufizuar abuzimet me pushtetin, nëpërmjet mbikëqyrjes së rreptë të pushtetit publik. Në shumë raste veprojmë si këshilltarë, duke luajtur një rol konstruktiv nëpërmjet sugjerimeve për përmirësime në sistemin ligjor, nëpërmjet

auditimeve të performances. Si SAI, mund të ndihmojmë fort në ndërtimin e komunikimit dhe besimit midis sektorit publik dhe qytetarëve, duke promovuar qeverisje të hapur dhe bërë të mundur që qytetarët të marrin pjesë në mënyrë aktive në proceset e vendimmarrjes publike.

Me këto përgjegjësi, jemi përpjekur gjatë këtyre tre viteve të zbatojmë objektivat tona strategjike, në përputhje me Planin e Zhvillimit Strategjik të INTOSAI-t, 2011-2017. Këto objektiva janë: ndërtimi i kapaciteteve të plota për kryerjen e auditimeve cilësore, të përputhshmërisë, financiare dhe të performances, si dhe kontributi në mirëqeverisjen publike, duke luftuar me përparësi abuzimet me pronën shtetërore, mashtrimet financiare dhe korrupsionin.

Të nderuar pjesëmarrës në Konferencë,

si kudo në komunitetin e INTOSAI-t dhe në EUROSAI-t edhe ne besojmë se auditimi kombëtar luan një rol të rëndësishëm në promovimin e performancës së qeverisjes kombëtare, veçanërisht përmes rritjes së ekonomicitetit, efektivitetit dhe efiçiencës së përdorimit të fondeve publike, përmirësimit të mekanizmit operacional të organizatave qeveritare, promovimit të integritetit, përgjegjshmërisë dhe transparencës së administratës, si dhe promovimit të praktikave më të mira të sektorit publik, duke shkëmbyer eksperienca, metoda dhe informacion.

Për të krahasuar punën që kemi bërë me standardet e INTOSAI-t dhe me eksperiencat e mira të SAI-ve evropiane, për të realizuar shkëmbimin e këtyre eksperiencave të qasjeve në auditim dhe në përdorimin e informacionit, një objektiv ky që buron nga Strategjia e INTOSAI-t dhe standardet ISSAI të fushës, për tu përgatitur me një qasje sa më profesionale ndaj sfidave të sotme për shëndoshjen e financave publike, menduam të organizojmë këtë konferencë të tretë shkencore vjetore, të përqendruar në rolin dhe përgjegjësinë tonë si SAI në përmirësimin e qeverisjes kombëtare.

Me këtë rast, me lejoni të falënderoj edhe personalitetet e kontabilitetit, financave publike dhe profesoratit shqiptar, si Prof. Dr. Skënder Osmani, Prof. Dr. Omer Stringa, Prof. Dr. Jorgji Bollano, Prof. Ass. Dr.Sazan Guri, Prof. Ass. Dr. Hysen Çela, Prof. Dr. Aurela Anastasi, Prof. Dr. Vjollca Karapici dhe Prof. Dr. Lindita Lati, për kontributet e tyre.

E veçanta tjetër e Konferencës sonë të tretë është se kemi mesazhin dhe ndihmën e Sekretarit të Përgjithshëm të INTOSAI-t, Dr. Josef Moser. Konferencat e ardhshme, mendojmë ta organizojmë me mbështetjen dhe bashkëpunimin e strukturave drejtuese të INTOSAI-t dhe EUROSAI-t, për të pasur më shumë kontribute nga SAI-t partnere dhe për të zgjeruar shkëmbimin e eksperiencave.

Gjatë këtyre dy ditëve të Konferencës, prezantimet e studimeve, vrojtimeve dhe kumtesave cilësore, të përgatitura nga ekspertë ndërkombëtare të auditimit publik të jashtëm dhe nga ekspertë vendas të financave publike, kontabilitetit dhe auditimit, jam i bindur se do të ndihmojnë audituesit tanë dhe jo vetëm ata, por edhe vendimmarrësit e administratës sonë publike, të gjejnë rrugët e duhura për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm të financave publike dhe ekonomisë së vendit, drejt përmirësimit të ndjeshëm të qeverisjes kombëtare dhe shërbimeve publike ndaj qytetarit.

Së fundmi, dëshiroj të theksoj dhe të falënderoj paraprakisht Presidentin e Republikës së Shqipërisë, SH.T.Z. Bujar Nishani, Ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri, z. Aleksandër Arvizu, Kryetarin e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, z.Robert Wilton, të cilët do të marrin pjesë në punimet e kësaj Konference në ditën e dytë të zhvillimit të punimeve të saj, duke vlerësuar rëndësinë që ka Kontrolli i Lartë i Shtetit si institucion i pavarur kushtetues. Duke Ju uruar të gjithëve punë të mbarë!

Ju faleminderit!

Konkluzionet dhe rekomandimet e Konferencës së Tretë Shkencore:

Nga të 27 kumtesat e paraqitura, u konstatua se përmirësimi i cilësisë së menaxhimit të financave publike, si një mjet për të optimizuar arritjen e objektivave kombëtare të zhvillimit strategjik, është një sfidë kyçe në shumë vende. Duke përmirësuar proçeset dhe institucionet buxhetore, cilësia e financave publike rritet. Efiçienca, efektiviteti dhe transparenca janë tre objektivat themelore të buxhetimit modern. Rregullat fiskale, planet dhe kornizat afat-mesme dhe buxhetimi i performancës kanë provuar të jenë efektivë në arritjen e këtyre objektivave. Institucionet Supreme të Auditimit mund të nxisin më tej përmirësimin e jetesës së njerëzve, duke ndihmuar për të siguruar që fondet dhe projektet publike që kanë të bëjnë me jetesën e tyre, të jenë nën mbikëqyrje të rreptë dhe të arrijnë efektin e dëshiruar.

Institucionet Supreme të Auditimit munden po ashtu të kontribuojnë në efiçiencën qeveritare, me mbikëqyrjen dhe vlerësimin e aktiviteteve qeveritare dhe zbulimin e mangësive në qeverisjen dhe kontrollin kombëtar. Ato mund të luajnë një rol të rëndësishëm në luftimin e korrupsionit dhe parandalimin e mashtrimeve financiare, duke ruajtur interesat kombëtare, nëpërmjet sigurimit të informacionit objektiv, të 438 besueshëm dhe në kohë, për të zbuluar risqet në funksionimin ekonomik dhe social kombëtar.

1) Baza e të dhënave është themelore për njehsimin e riskut. Konferenca e ardhshme shkencore e KLSH duhet të përqendrohet në analizën e riskut për auditimin në sektorë

të ndryshëm ekonomiko-sociale, si në burimet energjetike, drejtësi, financë, arsim, shëndetësi, rend, mjedis, etj,.

2) Të shikohet mundësia për ngritjen e një institucioni që të merret me standardet e burimeve njerëzore, natyrore, energjisë, mineraleve, etj, duke përfshirë rezervat, klasifikimin, etj deri në analizën e riskut, shfrytëzimin e tyre, kontratat, etj. Në funksionimin e këtij institucioni duhet pasur parasysh edhe përvoja e vendeve të tjera.

3) Lufta ndaj ekonomisë informale kërkon përdorimin e instrumenteve të përshtatshme dhe përpjekje të përbashkëta jo vetëm të qeverisë e rregullatorëve, por edhe të kontabilistëve dhe audituesve, të cilët luajnë rolin e ndërmjetësuesit midis bizneseve dhe autoriteteve të shtetit dhe publikut në përgjithësi.

4) Formalizmi i ekonomisë lidhet ngushtë me vendosjen dhe zbatimin e sistemeve tatimore efektive stabile, që kanë në themel drejtësinë në përcaktimin të detyrimeve, trajtimin e pa diferencuar të bizneseve dhe mbajnë mirë parasysh si kërkesat lokale ashtu edhe ato ndërkombëtare.

5) Sektori publik duhet të adoptojë për raportimin financiar parimin e të drejtave e detyrimeve të konstatuara, pasi kjo i shërben mirëqeverisjes, transparencës e përgjegjshmërisë dhe rritjes së besimit publik.

6) Strategjia e re e Zgjerimit e Bashkimit Evropian e vendos ne vijën e pare Qeverisjen Ekonomike dhe KLSH si Auditues i Jashtëm publik, është gur themeltar i përmirësimit të qeverisjes ekonomike.

7) Audituesit e KLSH dhe të IEKA, duhet jo vetëm të njohin raportet e njëri-tjetrit por dhe ti shfrytëzojnë ato, duke i konsideruar si informacione plotësuese shumë të vlefshme.

8) Me qëllim që të ulet kosto e shërbimit të auditimit për subjektet publike, ky shërbim të kryhet vetëm nga KLSH, brenda të cilit të organizohet një njësi e posaçme me njerëz të aftë profesionalisht. Ky rregullim do të siguronte jo vetëm besueshmërinë e certifikimit të pasqyrave financiare, por dhe cilësinë e punës.

9) Të bëhet një riklasifikim në rritje i kufijve të njësive ekonomike që ligjërisht i nënshtrohen detyrimit për t'u audituar.

10) Zhvillimi i mekanizmave dhe procedurave që lehtësojnë punën e secilit prej aktorëve ne auditimin e jashtëm publik. Planifikimi i veprimtarisë dhe aktiviteteve, ndërtimi i strategjive të qarta dhe realiste, si dhe ndërtimi dhe zbatimi me rigorozitet i proçeseve dhe kontrolleve ndihmojnë institucionet të përqendrojnë energjitë dhe resurset në përmbushjen me efektivitet të objektivave afatgjatë. Kjo mundëson që audituesit me

punën e tyre të sjellin vlerë të shtuar në funksion të arritjes së objektivave të institucioneve publike.

11) Mirëqeverisja e institucioneve publike kërkon angazhim të vazhdueshëm dhe bashkëpunim strategjik të aktorëve kryesorë. Zbatimi i sistemeve të vlerësimit të performancës së secilit aktor në mirëqeverisjen publike, identifikimi paraprak dhe dakortësia mbi treguesit ku bazohet matja e performancës së institucioneve është e një rëndësie parësorë në nxitjen e institucioneve që të përqendrojnë energjitë dhe resurset e tyre në përmbushjen me efektivitet të objektivave afatgjatë.

12) Forcimi i kuadrit rregullator ligjor të shërbimeve sociale kërkon me forcë hartimin e akteve nënligjore dhe administrative në zbatimin e marrëdhënieve midis autoritetit kontraktor dhe subjektit të kontraktuar.

13) KLSH, në linjë me zhvillimet e inovacionet e shoqërisë në përgjithësi dhe sektorin publik në veçanti, të synojë që të mbajë dhe zhvillojë një kulture inovative jo vetëm gjatë ushtrimit të veprimtarisë institucionale por të jetë një institucion nxitës dhe katalizator për inovacionin edhe për institucionet e tjera në sektorin publik.

14) Auditimi i performances është kërkim i mirëfilltë shkencor, dhe për rrjedhojë duhet konceptuar e strukturuar si i tillë, në drejtim të metodologjisë.

15) Kontrolli i Lartë i Shtetit do të vijojë traditën e mirë të këtyre tre viteve të fundit dhe do të organizojë gjatë gjysmës së dytë të vitit 2015, Konferenca e IV-t Shkencore të tij që do të ketë si temë kryesore Auditimin e riskut në sektorët e ekonomisë publike.

ZVOGËLIMI I RISKUT: NJË POTENCIAL I MUNDSHËM I ZHVILLIMIT TË VENDIT

Kumtesë në bashkë-autorësi me Prof. Dr. Skënder Osmani,

Konferenca e III-të Shkencore e KLSH

Jeta është risk. **Çdo veprimtari njerëzore duhet të jetë sa më e sigurt dhe optimale**

Abstrakt

Teoria e analizës së riskut është mjaft e gjerë dhe në përgjithësi jo aq e njohur nga qarqet publike. Kësisoj në punim është synuar që shumë informacione e ide të Analizës së Riskut "t'i largohen teorisë", mundësisht të jenë në princip të kuptueshme dhe të zbatueshme (veçanërisht për sistemet ekonomike). Çdo sistem (institucion, projekt, reformë, kontratë, etj) është një strukturë që ka disa objekte (shiko më poshtë): p.sh: objektin fillestar ose inputet, objektin e proceseve , ose procesorin , objektin final ose outputet(produktet) etj. Qëllimi i çdo sistemi është *produkti optimal dhe siguria e tij* d.m.th. sistemi duhet të realizojë kritere të caktuara: prodhim maksimal me kosto minimale, kohë të limituar, njëherësh risk minimal etj

Në çdo veprimtari njerëzore risku është bashkëshoqërues i përhershëm i saj, d.m.th. një barrierë, pengesë etj sepse ngërthen humbje, dëme, rreziqe etj. Identifikimi i riskut: objektet me risk, proceset, faktorët etj., janë instrumente që ndihmojnë në zvogëlimin e riskut e sigurinë. Në këtë këndvështrim në punim trajtohen çështjet e mëposhtme:

1. Hyrje;
2. Objekti, identifikimi i riskut;
3. Proceset me risk;
4. Faktorët e riskut, siguria;
5. Individi, Ligji për riskun;
6. Vlerësimi i riskut;
7. Reforma e arsimit të lartë dhe risku;
8. Reforma administrative territoriale;
9. Reforma e Përgjithshme (Go to Growth) dhe bazat e të dhënave;
10. Komunikimi, koha, risku;
11. Pasuria Kombëtare dhe risku.

Në fund jepen disa konsiderata, në të cilat theksohet që *identifikimi i objekteve me risk,(krahas vlerësimit të riskut dhe menaxhimit të tij, që veçse ceken në punim) është një problem madhor dhe i rëndësishëm, një mundësi e zhvillimit në çdo "qelizë" të jetës së vendit.*

1. Hyrje

Shqipëria ka prapambetje që ngërthen risk relativisht të madh

Krizat e kohëve të fundit në shumë vende të botës kanë pasqyruar mjaft shqetësime dhe dilema serioze për zhvillimin e ekonomisë [1] deri edhe në botëkuptime regresive me karakter lokal, regjional etj si në qarqe publike e politike, por dhe në ato studimore, shkencore etj.

Në vendin tonë, në shumë institucione, veçanërisht në median e shkruar, elektronike, në diskutime akademike etj., janë pasqyruar situatat e vështira energjitike, financiare, mjedisore etj., madje ka patur edhe raste kur ata kanë reflektuar një frymë pesimiste p.sh:

A do të bëhet ndonjëherë Shqipëria? Sa e pasur është ajo dhe si shpjegohet prapambetja dhe niveli relativisht i lartë i varfërisë? Po pabarazia ekonomike me miliarderë e milionerë që kanë në dorë një përqindje shumë të madhe të pasurisë? Si ka mundësi që duke filluar nga koha e çlirimit e deri më sot, Shqipëria, në shumë tregues qendror, renditet në fund të listës së vendeve europiane?

Pyetjet e mësipërme për çështjen e krizave, apo a do të bëhet Shqipëria? etj,, kanë në thelb problemin e zhvillimit, përmasat, ritmet, qëndrueshmërinë dhe perspektivën, sigurinë dhe riskun.

Çdo veprimtari njerëzore ka një qëllim i cili mishërohet në praktikë nga një "projekt", që ka një produkt ose output me vlera ekonomike (sasi, cilësi, kohë, performancë optimale etj).

Krahas këtyre vlerave, shoqëria është gjithmonë e interesuar që produkti të jetë "sa më i sigurt" d.m.th. të ketë një standard që të përjashtojë humbjet, dëmet, rreziqet, krizat, prishjet, epidemitë, përmbytjet, tërmetet, katastrofat etj. Në një kuptim më rigoroz produkti duhet të jetë të jetë optimal dhe pa risk. Problemi i optimalitetit del jashtë qëllimit të dhënë. Më poshtë po kufizohemi *vetëm te kuptimi i riskut.* Por ç'është risku ? Ky është një kuptim matematik që mund të përkufizohet në mënyra të ndryshme që zënë fill në teorinë e probabilitetit (statistikës), teorinë fuzzy, etj.

Për thjeshtësi riskun në një veprimtari njerëzore po e konsiderojmë si mundësi për të humbur ose për t'u dëmtuar nga produkti që do të realizojë veprimtaria. Pak më ndryshe, risku në çdo veprimtari ka lidhje me humbjen, dëmtimin, rreziqet e produktit që do të realizohet në të ardhmen. Që këtej:

-së pari, rrënjët e riskut duhen kërkuar tek veprimtaria njerëzore (për thjeshtësi dukuritë natyrore nuk po i konsiderojmë : tërmetet, cunamet, përmbytjet etj).

- së dyti, meqenëse kjo veprimtari "do të kryhet në të ardhmen" dhe shoqërohet me humbje, dëmtim, rrezik nga produkti, risku duhet të parashikohen, vlerësohen njëherësh edhe masat për kufizimin e zvogëlimin e tij. Meqenëse çdo veprimtari njerëzore është një "ndryshim , atëherë rrënjët e riskut duhen kërkuar pikërisht në këtë ndryshim (më saktë tek ndryshimi i vetisë, atributit etj.) .

2. Objekti. Identifikimi i riskut

Njeriu është objekti dhe faktori numër 1 i riskut

Siç dihet, gjendja është një veti apo atribut i caktuar, ndërsa ndryshimin e gjendjes e thërrasim proces. Një bashkësi vetish do ta quajmë objekt, ndërsa gjendjen e ndryshuar të tij do ta quajmë zhvillim (ky mund të jetë pozitiv ose negativ). Në gjuhën e zakonshme, fjala zhvillim nënkupton progres ose zhvillim pozitiv, ndërsa zhvillimi negativ quhet regres.

Proceset janë deterministike ose të rastit. Çdo proces i rastit ka riskun përkatës. Që këtej kur flasim për identifikim të riskut, duhet të përcaktojmë

-procesin që e ngërthen këtë risk;

-objektin në të cilin zhvillohet proçesi (ndodh ndryshimi);

- faktorët që çojnë në këtë ndryshim.

Në literaturë ka raste kur identifikimi i riskut quhet analiza cilësore e riskut. Në përgjithësi, analiza e riskut përmban edhe vlerësimin e tij dhe menaxhimin e riskut(shiko më poshtë).

Për identifikimin e objekteve me risk po shqyrtojmë një shembull të thjeshtë menaxhimi nga një veprimtari ekonomike (projekt, reformë, kontratë, praktikë, eksperiment, model, teknologji, etj.)



Fig.1 Skemë e thjeshtuar menaxhimi

Në këtë skemë dallojmë këto objekte kryesore:

1. Inputet(Burimet);
2. Infrastruktura hyrëse;
3. Proçesimi (përpunimi i burimeve);

4. Infrastruktura dalëse;
5. Logjistika e realizimit të produktit (outputi).

Në çdo njërin nga objektet ndodh një proces me riskun përkatës. Në tërësinë e saj kjo skemë është vetë një objekt, sepse përbëhet nga një bashkësi objektesh (bashkim)dhe lidhjet përkatëse (struktura). Kjo bashkësi mund të jetë një fabrikë, uzinë, universitet, një njësi pune, industriale, bujqësore, turistike, infrastrukturore, administrative, shoqërore, politike etj.(Në këtë skemë edhe lidhjet e objekteve janë vetë objekte me risk).

2. Proceset me risk

Proceset janë themeli i riskut

Në skemë objektet janë të çfarëdoshëm, megjithatë për konkretizim të mëtejshëm po supozojmë që ato(objektet) janë elementët e një universiteti, p.sh. inputet janë studentët.

Këta regjistrohen në sekretari (infrastruktura hyrëse), në vijim ato pajisen me dije në auditore, laboratore, praktika etj (ose ndryshe proçesohen) dhe pasi përfundon cikli i proçesimit (përfundimi i studimeve) ato dalin në shoqëri si një output i gatshëm për të filluar punën si specialiste. Siç vërehet zhvillimi ka një numër të fundmë (pesë) proçesesh. Kjo është bërë për thjeshtësi sepse realisht ky numër është shumë i madh, madje ka grupe proçesesh që përsëriten nga koha në kohë (ditë, javë etj).

Këto procese mund të jenë deterministike (të sigurta) ose stokastike (të pasigurta) që varen nga faktorë të rastit. P.sh. regjistrimi i studentit në sekretari është vetëm një mundësi sepse ai mund të mos realizohet nëse ai nuk ka një nga dokumentet, ose mungon sekretarja, më tej nuk punon programi i kompjuterit, ose studenti nuk paraqitet në kohën e duhur. Natyrisht që çdo njëri nga proceset paraqet të paktën një ndryshim të gjendjes. Kjo e fundit përcaktohet nga një informacion i njohur më parë (të dhëna, njohuri, praktika, dije etj). Ky informacion është i domosdoshëm për të kuptuar në thelb procesin dhe vlerësimin e tij.

P.sh. në qoftë se pyesim për proçesin e regjistrimit të studentëve dhe marrim përgjigjen "që regjistrimi i tyre është i *mirë*," nuk jemi të sigurt që janë regjistruar të gjithë studentët. Ndryshe qëndron puna kur përgjigjja mund të ishte: "u regjistruan 30% e studentëve". Në rastin e parë proçesi i regjistrimit është i pasigurt, (pasiguria është e papërcaktuar d.m.th. është fuzzy), ndërsa në rastin e dytë proçesi është i sigurt (deterministik) sepse janë regjistruar 30 %.

Në një rast të tretë, kur njihet paraprakisht ligji probalitar i regjistrimit të studentëve,(p.sh. nga të dhëna eksperimentale), mund të përcaktohet probabiliteti që numri i studentëve të regjistruar të jetë një vlerë e caktuar p.sh. 75% ose një interval

p.sh. 50-80%. Kuptohet që për të përcaktuar këto probabilitete, proçesi i regjistrimit është strukturuar, analizuar e përcaktuar më parë mbi bazën e të dhënave, situatave etj që varen nga faktorët e rastit: p.sh. predispozita e studentit, koha, transporti, plotësimi e sigurimi i dokumenteve, gjendja financiare, shëndetësore).

Nga sa më sipër, del që *për të identifikuar riskun është paraprakisht e nevojshme* që të përcaktohet :***a)objekti ose aseti b) procesi c) faktorët e riskut***. Me marrëveshje këto tre elemente se bashku do t'i quajmë hapësira e objektit me risk ose thjesht ***objekt me risk***.

Kuptimi i objektit me risk (asete, procese, faktorë) jo shpesh herë haset si i tillë. Për shembull, në literaturë [6]) flitet për asete me risk, ose në raste te tjera vetëm për procese te rastit. Përfshirja e këtij kuptimi në këtë shkrim është bërë me qellim, sepse na duket më konkret, p.sh. mund të flasësh kur nevojitet për hapësirë gjeometrike, diversitet risku, vlerë humbje ose dëmtim, madje riskun vetë mund ta përkufizosh si "variabël rasti" të përcaktuar në hapësirën objekt që shqyrtojmë etj. Po kështu kuptimi objekt me risk mund të çojë në zgjerimin e tij teorik në trajtën e "kategorive me risk" [28]. Kjo është thjesht një hipotezë që kërkon një studim në të ardhmen) duke u mbështetur në aksionometrinë, hipotezat dhe pohimet e teorisë së kategorive.

Gjithashtu objekti me risk mendojmë se është një kuptim praktik në ndërmarrjen e studimeve të ndryshme për analizën e riskut. P.sh. në qoftë se shqyrtohet risku ne hapjen e një vendi pune p.sh. "Inxhinier risku" atëherë për trajtimin e riskut të këtij vendi pune, objekti njeri dhe procesi i përgatitjes së tij janë konkretë dhe shihen në simbiozë. Këto dy elementë janë në unitet. Më tej përgatitja është e lidhur me faktorin kohë, nivelin aktual të specialistëve konkurrues, nivelin e shkollave të larta që përgatisin specialistë të "Analizës së riskut", teknologjitë përkatëse, kurrikula, literatura në vendin tonë, stafin akademik, burimet financiare, etj. Duke i analizuar të gjithë këta faktorë mund të arrihet në përfundimin që vendi i punës që kërkohet të hapet mund të jetë me risk të madh ose të vogël (cilësimet i madh ose i vogël janë kuptime nga teoria fuzzy).

Kuptohet që për një vlerësim sasior të riskut të rastit që shqyrtojmë, kërkohen informacione të tjera. Sido që të jetë, del në pah menjëherë që ***identifikimi i objekteve me risk është hapi i parë i analizës së riskut, por nuk është vlerësimi i riskut (ky realizohet menjëherë pas identifikimit)***.

Në një analizë risku të një sistemi *pyetja e parë që bëhet është : cilat janë situatat, faktorët që bartin risk, pasojat që ato eventualisht mund të sjellin (dëmtime, dëme, rreziqe, kriza, paqëndrueshmëri , korrupsion, trafiqe të paligjshme, krime, etj.) dhe që këtej edhe masat përkatëse.*

3-4. Faktorët e riskut. Siguria

Mënjanimi faktorëve të riskut, një potencial sigurie

Përmbajtja e riskut dhe karakteri i tij (probabiliteti , humbjet ,dëmi etj.) janë specifika të procesit e për rrjedhojë çdo analizë risku përcaktohet nga fusha e studimit. Krahas karakterit të përgjithshëm (objekte, procese, faktorë, dëmtim, etj) ka karakter specifik, në mënyrë të veçantë në studimin dhe vlerësimin e proçeseve të rastit, të faktorëve, sigurisë dhe masave mbrojtëse për evitimin, kufizimin apo zvogëlimin e riskut (shkurt në menaxhimin e riskut).

Kuptohet që prapambetja në një fushë shoqërore, strategji, drejtësi, reforma, rend, diplomaci, media, arsim, politikë, shkencë etj., ose inxhinierike(energji minerale, burime ujore e hidroenergjike, ICT) ose financiare (tregu, tregu informal, biznes, vende pune, buxhet), banka të nivelit të II-të (sistem fiskal, pensione, kredi, hua kontrata) etj., si rregull karakterizohet nga një risk relativisht i konsiderueshëm dhe për rrjedhim ***reduktimi i riskut: kufizimi, mënjanimi apo eliminimi i faktorëve që e prodhojnë atë janë njëherësh potenciale zhvillimi***.

Këto faktorë që mund të jenë shëndetësorë, teknikë, financiarë, mjedisorë, biologjikë, komunikues, informacione, etj., çojnë në realizimin e sigurisë të proceseve përkatëse që njihet me emrin sigurimi shëndetësor, teknik, financiar etj. Që këtej, ***një nga synimet themelore të analizës së riskut është rritja e sigurisë së veprimtarisë njerëzore***(në çdo fushë e objekt të saj me anë të masave që" propozohen" prej saj.(Natyrisht që për sigurinë kombëtare ka institucione të posaçme dhe ky kuptim është më i përgjithshëm se ai që përmendëm më sipër).

5. Individi. Ligji për riskun

Individi drejtues me kriter risku minimal

Në çdo veprimtari, faktori njeri (individi) është numri 1 (i parë) i ideimit të saj (strategjia, alternativat, projekti, zbatimi, outputi, marketingu) -shiko më poshtë-, po kështu është përsëri njeriu ai që identifikon objektet me risk, bën vlerësimin e riskut e menaxhimin e tij. Që këtej, ***risku i vetë individit është themelor në zhvillimin e veprimtarisë dhe në sigurinë (pasigurinë e saj).***

Përmendim kalimthi që risku i individit, veçanërisht paaftësia profesionale në pozicionet drejtuese në strukturat e larta politike shtetërore, administrative, akademike, universitare, etj ka ndikuar negativisht në zhvillimet e veprimtarive përkatëse. Po kështu, në disa raste edhe mungesa e strategjive shkencore në fushën e burimeve energjitike, buxhetit, vendeve të punës, të vlerësimit të aseteve, pronave publike , private e legalizimit të tyre, etj.

Nga kjo pikëpamje, parandalimi, kufizimi apo mënjanimi i riskut në një vendimmarrje "jo të përshtatshme" për zhvillimin e një projekti, reforme, kontrate etj., është një vlerë e rritur e suksesit të veprimtarisë. Sot po flitet gjithnjë e më tepër për individin e riskun e tij ekzekutiv, shëndetësor, mendor, njohës logjik, arsyetues, psikik, jo më pak për riskun profesionalo-shkencor, shoqëror etj. ***Që këtej, në kushtet konkrete të zhvillimit të vendit, përzgjedhja e individit në drejtimin e një veprimtarie merr një theks dhe rëndësi të veçantë***.

Individi në pozicione të larta drejtuese (Qeveri, Parlament etj.) zgjidhet mbi bazën e votës që sanksionohet në Kushtetutën e vendit Natyrisht ajo është shprehje e demokracisë. Sot njihet teorikisht dhe praktikisht vendi dhe roli i drejtuesit në zhvillimin dhe përparimin e shoqërisë njerëzore, në mënjanimin e riskut por dhe në prodhimin e tij.

Ka sektorë strategjikë siç është energjia shëndetësia, arsimi, legjislativi, rendi etj., që në pozicione drejtuese kërkohet edhe një përgatitje e shëndetshme profesionale jo vetëm e drejtuesit më të lartë por edhe e bashkëpunëtorëve të tij më të ngushtë, p.sh. këshilltarët etj. Kuptohet që vota e popullit është kriter, por a mjafton kjo?

Në kontekstin e mësipërm natyrisht që do të ishte më e dobishme të vepronte edhe kriteri profesional i spikatur, pak më thjeshtë jo çfarëdo deputeti mund të vendoset në karrigen e Ministrit apo në një pozicion të ngjashëm. Historikisht, në Ministrinë e Energjisë asnjë ministër mendoj se nuk ka qenë me "profesionin e duhur". Kjo natyrisht e rrit riskun e objektit "karrige Ministri" dhe akoma me tepër " karrige e sistemit të energjisë" . Risk ka patur kur edhe në situacione të tjera: p.sh. jo rrallë herë në pozicione më të ulëta se Ministri janë vendosur titullarë me profil të largët, etj., ose gjate 20 viteve lidhjet e këtij Dikasteri pothuajse kanë munguar me Departamentin e Burimeve të Energjisë në Fakultetin e Gjeologjisë, i cili para 1990 ka qenë lider në projektet e naftës dhe sot e kësaj dite nuk është pyetur as për "ash, as për balash"). Më tej, kur logoja e këtij Departamenti u vendos nga viti 1998 në dikasterin përkatës, fjala energji mungonte në logo e vetëm pas disa viteve u vendos në këtë dikaster pas fjalëve ekonomi e tregti!! Po kështu ka patur drejtues që problemin e energjisë e kanë konsideruar të mbyllur. Ndërsa sot del që energjia është problem i shumë i dikastereve!!! ***Pra në pozicione drejtuese strategjike të shoqërisë, kërkohet jo vetëm votë popullore, por edhe kritere të forta(të integritetit profesional, shkencor, etj).***

Aktualisht ne nuk kemi një ligj për riskun. Përmendim kalimthi që mungesa e nismës ligjore për vlerësimin e riskut e veçanërisht në fushën e investimeve, projekteve, kontratave, reformave, infrastrukturës, burimeve energjike, minerare, pasurive tokësore (e detare), mbrojtjes së mjedisit, i ka sjellë dëme jo të vogla ekonomisë në energji, infrastrukturë, naftë, minerale, bujqësi, turizëm etj.

Megjithëse propozimi për këtë nismë (ligji) është bërë që me hapjen e seksionit të Menaxhimit në vitin 2000 në Fakultetin e Gjeologjisë, sot e kësaj dite ky problem mbetet juridikisht i hapur. Pra ligji për riskun është tejet i domosdoshëm, për t'u miratuar qoftë edhe në mënyrë të pjesshme për fusha më të rëndësishme e që kanë investime të larta dhe risk të madh.

Ligji për riskun është një standard dhe promotor që do të rrisë efektivitetin e investimeve.

6. Vlerësimi i riskut

Vlerësimi i riskut: një instrument diagnostikues i zhvillimit të vendit

Identifikimi i objekteve me risk në një sistem është vetëm kusht i nevojshëm i analizës së riskut. Vlerësimi i riskut është hapi më i vështirë dhe më i rëndësishëm i analizës së risku. Megjithëse ky subjekt del jashtë qëllimit të vënë, po përmendim kalimthi disa konsiderata të thjeshta.

Vlerësimi i riskut ka në themel teori të ndryshme si probabilitet, stokastikë, procese rasti, teori fuzzy etj. Ky vlerësim mund të bëhet me instrument të ndryshëm matematikorë, si p.sh. integrale, ekuacione diferenciale stokastike, etj., të zbatuara në mënyra të ndryshme, p.sh.:

a) për çdo objekt në veçanti (në mënyrë lokale) përfshi paraprakisht vete studimin e objektit;

b) për tërë sistemin (në mënyrë integrale ose globale).

Për konkretizim, për të vlerësuar riskun në një zonë të ndotur, d.m.th. vlerën e ndotësit ose siç thuhet pritjen e tij, mundet që zona në fjalë të ndahet në nënzona elementare (elemente të fundme) dhe më pas pritja e ndotësit të llogaritet në çdo element (nënzonë). Pastaj, për nënzonat që tejkalojnë masën e ndotësit sipas kritereve të caktuar, përcaktohen objektet me risk tashmë të vlerësuar si dhe ndikimi i faktorëve të ndryshëm në vlerën e riskut, përmirësimin e tij, masat etj.

Vlerësimi i riskut është një proces i vështirë që kushtëzohet nga shumë faktorë. Më poshtë po përmendim disa prej tyre:

- Lloji i procesit: i thjeshtë, i përbërë, i përzier, parësor, joparësor, homogjen, jo-homogjen, etj;
- Dinamika e procesit në hapësirë me një e shumë përmasa, kohë, etj;
- Tipi i objektit ku ndodh procesi pikësor, jo pikësor, homogjen, jo homogjen, i vazhdueshëm ose jo, izotrop, anizotrop, etj;

- Natyra e informacionit, të dhënat, lloji, saktësia, vëllimi e cilësia, struktura etj. Bazat e të dhënave, magazinat e të dhënave, etj;
- Metodikat e matjes, instrumentet e matjes, gabimet e matjes, et;j
- Metodikat e grumbullimit, seleksionimit dhe trajtimit të të dhënave;
- Modeli dhe metodikat matematikore, informatika, analiza e ndjeshmërisë, statistikë, fuzzy, metoda e kontrollit, rrjetat e Bejesit, etj.

Vlerësimi i riskut është i rëndësishëm në çdo fushë, por interes të veçantë paraqet ai në fushën e projekteve "strategjike" që lidhen me investime të konsiderueshme. Njehsimi i riskut dhe sigurisë "optimale" të investimeve është një problem kompleks, në zgjidhjen e të cilit marrin pjesë dhe zbatohen një bashkësi disiplinash matematikore, inxhinierike, financiare, modelim, metoda numerike, informatike, etj. Gjithashtu teori investimi, teori portofoli, inxhinieri financiare, statistikë, optimizim, ekuacione diferenciale stokastike, programim matematik, menaxhim shkencor e shumë disiplina të tjera që kushtëzohen nga specifikat e projektit, strategjia, alternativat, objektivat, zbatimi, dinamika e tyre, etj.

Kujtojmë që në analizën e riskut elementi i tretë është menaxhimi i riskut që në vetvete është një projekt. Meqenëse edhe reformat (që do të trajtohen më poshtë) janë projekte, po paraqesim një vështrim të shkurtër menaxherial.

Vitet e fundit në vendin tonë janë ndërmarrë disa reforma për një zhvillim sa me të qëndrueshëm e efektiv të vendit, p.sh. reforma në arsimin e lartë dhe reforma administrative territoriale. Reforma si një veprimtari njerëzore ka si synim realizimin në praktikë të një qëllimi të caktuar. Pra reforma ka një strategji(bashkësia e alternativave për të realizuar qëllimin), çdo alternativë ka objektivat e saj (më saktë objektet përkatëse së bashku me kushtet, kufizimet, situatat etj.) të domosdoshme, etj. Nga bashkësia e alternativave, sipas kërkesave të caktuara, zgjidhet alternativa më e mirë, d.m.th. ajo optimale dhe me riskun më të vogël(më saktë optimale stokastike apo fuzzy). Më pas, kjo alternative hartohet në mënyrë të detajuar dhe zbatohet në praktikë. Në këtë alternativë që e quajmë projekt, gjejnë përgjigje pyetjet: kush e kryen aktivitetin, pse ai kryhet, e më tej, si, me çfarë, kur, ku, cila është kosto, periudha e zbatimit të tij, e kështu me radhë deri në pyetjen: sa e sigurt është gjithë veprimtaria që analizohet, ose ndryshe cili është risku i veprimtarisë? Pra çdo reformë është projekt (madje dhe vetë menaxhimi i riskut) dhe produkti i saj duhet të jetë optimal.

Meqenëse aktualisht reformat janë në rendin e ditës, po paraqesim më poshtë disa konsiderata për riskun e tyre.

7. Reforma e arsimit të lartë dhe risku

Reforma e arsimit të lartë: shpresë e madhe me risk shumë të madh

Si në shumë reforma të mëparshme edhe në reformën e arsimit të lartë dhe në atë administrative – territoriale, në punimet përkatëse mungojnë të paktën fjalët kyçe të një projekti (gjë që cenon optimalitetin dhe riskun e veprimtarisë). Po ndalemi paksa në këtë çështje.

Nëse në vijim, pranohet si përkufizim "marrëveshja" për strategjinë e reformës (bashkësia e alternativave në nivelin më të lartë të mendimit) del që strategjia e çdo reforme është objekt pune i institucioneve studimore, kërkimore etj., sepse ato merren edhe me idetë e mendimet e nivelit të lartë, që ngërthen strategjia.

Kësisoj, në rastin e reformës së arsimit të lartë "pronarë" të strategjisë së saj në radhë të parë duhet te konsiderohen departamentet, fakultetet, institutet, akademitë, kolegjet, organizatat jo qeveritare me lektorë specialistë, etj. Pak më ndryshe, politika dhe vendimi i saj për realizimin e reformës vjen pas strategjisë. Kjo është arsyeja, që në diskutimin e statusit të arsimit të lartë në vitin 1992. etj., është kërkuar publikisht në mbledhjet përkatëse në mënyrë të shtjelluar pavarësia e arsimit të lartë nga politika:

Strategjia e para, politika e dyta, (First to mind, second to action)

Në hipotezën që reforma është projekt, analiza, studimi dhe realizimi i saj (i reformës), duhet të ndjekë në përgjithë si në aspektin menaxherial, kuptimet (fjalët kyçe, etj.), principet, pohimet, instrumentat, metodat etj. të një projekti, pra edhe të analizës së riskut me karakter cilësor (objekte me risk).

Çdo departament ka një strategji të caktuar të aktivitetit të tij mësimor-shkencor, e për rrjedhim projektin përkatës. Që këtej, projekti i reformës së arsimit te lartë është bashkimi (unioni) i të gjithë projekteve universitarë të departamenteve që bëjnë pjesë në sistemin e arsimit të lartë.

Projekti i reformës është objekt me risk (objekt, proces, faktor), pra reforma është një bashkësi (union) objektesh, procesesh, faktorësh që duhet të evidentohen të paktën cilësisht përpara fillimit të procesit të përgjithshëm të reformës. Këtu bëjnë pjesë inputet, studimet , pedagogët, personeli, teknologjitë, burime të tjera: të informacionit , burimet financiare, etj., metodat e instrumentet për laboratorë, praktika, lëndë ekzistuese, lëndë te reja, e shumë asete të tjera që mund të jenë specifike për departamentin. Krahas këtyre, në projektin e çdo departamenti bëjnë pjesë edhe proceset mësimore didaktike, shkencore, aplikative etj., në auditorë, laboratorë, praktika mësimore, detyra e projekte kursi, punë të pavarur kërkimore, punime sipas kontratave, etj.

Përveç këtyre mund të parashikohen edhe procese suplementare mësimore me studentët që vijnë rishtazi në universitetet kur niveli i formimit të tyre nuk do ti përgjigjet kërkesave të departamenteve, po kështu ndoshta me kurset e reja të doktoraturave të ardhshme, etj. Gjithashtu mund të dalin situata të paparashikuara me fondet financiare suplementare, etj.

Duke patur parasysh numrin e departamenteve të sistemit të arsimit të lartë , numrin e planeve mësimore dhe dhjetar lëndë mësimore (kurrikula) që bëjnë pjesë në to, numrin e objekteve, proceseve, faktorëve në një lëndë e cila në vetvete është projekt me riskun përkatës (cilësor dhe sasior) duket që risku i reformës arsimore të paktën nga ana cilësore është i konsiderueshëm. Kjo është arsyeja pse kemi theksuar: ***reforma e arsimit të lartë: "shpresa e madhe dhe risku i konsiderueshëm".***

Vlerësimi i riskut të paktën cilësor (objekte, procese, fakte) kërkon një studim të hollësishëm e specifik për çdo projekt te departamenteve. Në këtë vështrim, po përmendim që:

- Mungesa e kuptimit të riskut dhe shumë koncepteve kyçe të menaxhimit si në raportin e parë ashtu dhe në të dytin të reformës së arsimit të lartë, është një mundësi risku për zbatimin e reformës, të paktën në kohë;

- Mos formulimi i saktë i strategjisë së reformës, problemet themelore, çfarë jepet, kërkohet dhe si mendohet të përftohet zgjidhja, cili do të jetë outputi i projektit të reformës, më pas cilat do të jenë variantet e zgjidhjeve, afatet, etj., të gjitha këto janë premisa që mund të sjellin risqe. P.sh, nëse nuk përkufizohet saktë, në mënyrë të përgjithshme produkti i projektit, mund të ngrihen pyetje specifike "pa përgjigje". P.sh, cili do të jetë niveli i specialistit të ardhshëm të departamentit X në Politeknik, në qoftë se ky "produkt nuk përcaktohet"?;

- Me tej, një risk tjetër lind kur bëhet një krahasim financiar për shpenzimet e investimet që bëhen për përgatitjen e një specialisti jashtë shtetit, te themi 600 USD për student dhe aludohet që po të investojmë këtë shumë edhe ne mund të arrijmë një rezultat të tillë, pa marrë në konsideratë përgatitjen jo të mirë të "inputeve tona": student, pedagogë, përvojë universitare, infrastrukturë, etj shkurt te ndryshimi jo i vogël i objekteve analoge të një universiteti tonë me një të huaj.

Në qoftë se dëshirojmë që pas 8-10 vjetësh studentët që përfundojnë studimet tek ne të krahasohen me ata të një universiteti europian, për cilën kohë flasim: për të sotmen apo për të ardhmen e Universitetit Europian që ka bërë një zhvillim të konsiderueshëm gjatë kohës që do të krahasohemi? Duke mos marrë në konsideratë vlerën kohore të

zhvillimit të vendeve të tjera në strukturë dhe në përmbajtje, lind një risk tjetër për mangësi të njohurive tona.

Në fakultetet inxhinjerike etj., një risk jo i vogël mund të lindë nga futja e lëndëve të reja të karakterit matematik, informativ, teknologjik etj., ose nga ndryshimi thelbësor i raportit të lëndëve ekzistuese me lëndë të reja. Edhe sikur të mos ketë risk, kjo do të jetë një detyrë e vështirë, në raste të caktuara edhe mjaft e vështirë

Përvoja personale e disa kolegëve ka treguar që lëndë të reja futen me shumë vështirësi në procesin mësimor. Ka patur raste që lëndë të reja janë futur në planin mësimor dhe vetëm pas disa vitesh, p.sh. 7-8 vjet janë konsoliduar. Ose lënda e informatikës në një fakultet është futur që me 1974, megjithatë përvetësimi i lëndës nga studentët dhe përgatitja e programeve në kompjuter mendojmë se mesatarisht nuk është i kënaqshëm.

Po kështu edhe në lëndë të tjera, p.sh., analiza e riskut. Artikulli i parë në këtë subjekt është shkruar diku nga vitet 1997-98, leksionet e para filluan në 2003, kursi i plotë nga vitet 2008-2010 e sot e kësaj dite si lëndë e plotë nuk është futur ende në kursin pasuniversitar të Doktoraturës (përmendim kalimthi që një kurs të pjesshëm kemi zhvilluar edhe me punonjës të KLSH para një viti). Përveç kësaj, duket që lëndët e reja, me karakter teknologjik do të duan edhe investime jo të vogla financiare. Risku financiar në reformën e arsimit të lartë të paktën në inxhinieri duket mjaft i lartë kur shikon sado pak investimet e të tjerëve.

Përveç këtyre, ka edhe risqe të tjera që lidhen në radhë të parë me gjeneratën e re të Profesoriatit që do të jetë baza e përgatitjes së reformës, po kështu niveli i bazës (financiare) nga shteti apo nga studentët, mungesa e vendeve të punës për specialitetet e ardhshme ose ndryshimi shumë i shpejtë i natyrës së vendeve të punës dhe amortizimi i parakohshëm i disa profileve të vendeve të punës, gjithashtu niveli i korrupsionit dhe i drejtësisë, natyra informale e tregut, sistemi arsimor jo i qëndrueshëm dhe transparent etj.

Pavarësisht nga këto, për një përshpejtim efektiv të reformës, përgatitja e bazës së të dhënave (ndoshta edhe i magazinave të tyre, i informacioneve të nevojshme për studimin paraprak të skemës së projektit të departamentit dhe më pas të vetë projektit) është një sfidë që duhet ta nisim sa më shpejt që të jetë e mundur, duke u mbështetur në përvojën e Departamenteve, përvojën analoge të huaj, literaturën e specialitetit, etj.

Reforma e arsimit të lartë bart edhe risqe të tjera që i referohen jo vetëm objekteve, por edhe sistemit. Konkretisht ky risk ka filluar të ndjehet që tani me heqjen e licensave të disa universiteteve private, etj. Nga ana tjetër studentët e universiteteve private që duhet të regjistrohen në ato publike por që nuk plotësojnë një apo disa kritere, janë një tjetër pengesë në mbarëvajtjen e arsimit të lartë, shkurt një risk i shtuar i tij.

Sikurse kemi përmendur edhe më sipër, për një strukturim sa më të mirë të reformës është i domosdoshëm studimi paraprak ose i fizibilitetit, që mbështetet në një bazë të dhënash rigoroze dhe të shumanshme që kanë dalë nga analiza e veprimtarisë së institucionit dhe nga përvoja e tij në një periudhe të caktuar. Një studim i tillë do të rrisë efektivitetin e projektit, sepse do të mundësojë zvogëlimin e riskut dhe menaxhimin e tij.

8. Reforma administrative territoriale

Baza e përgjithshme e të dhënave dhe optimaliteti, kushte themelore të reformës

Më poshtë japim disa konsiderata risku edhe për reformën administrative territoriale (për të cilën janë bërë studime të veçanta e së shpejti do të fillojë zbatimi i saj, i mirëpritur dhe efektiv) që për mendimin tonë është një " problem i hapur " kur bëhet fjalë për një zhvillim të mëtejshëm në perspektivë.

Një nga parimet themelore të reformës ka qenë funksionaliteti, i cili është zbatuar edhe në reforma të ngjashme të vendeve të tjera të Europës. Ky parim duket se është parë kryesisht në aspektin administrative territorial, duke synuar një lloj "optimizmi" kryesisht administrativ, që rezulton në "fitimet financiare" nga analiza e dy ose tre varianteve. Këto variante janë shqyrtuar në kuptimin e zonës funksionale, por me sa dimë, në to nuk cilësohet ndonjë zbatim matematik apo informatik, etj. E kjo vështirë se mund të bëhej në qoftë se ndarja në zona do të mbështetej në kuptimin jo të shtjelluar të zonës funksionale administrative.

Dhe ja pse. Mendojmë që zona funksionale nënkupton një bashkësi sistemesh që procesojnë burime njerëzore, administro (struktura) njësi mjekësore, shkollore etj, burime financiare (taksa, rroga , shpenzime , investime etj), burime ekonomike (energji , ujera, ndotje urbane, toka, pyje, infrastruktura rrugore, ndërtimore , hidraulike, elektrike, elektronike, etj.) Nëse një zonë funksionale nuk "kompozohet" me sistemet apo nënsistemet përbërës, as që mund të bëhet fjalë për një optimizim të administratës e të territorit në përgjithësi.

Për sa kohë vlen kjo ndarje dhe pse ? Përsëri ky problem dhe zgjidhja e tij "ngec" edhe tek mungesa e bazave të të dhënave. Dhe kjo ndodh jo sepse ato ekzistojnë dhe aktorët nuk i marrin në konsideratë, por sepse ato në përgjithësi nuk ekzistojnë ose nuk janë krijuar mirëfilli për problemin që shtrohet dhe për këtë duhet punuar shumë, duhet investuar. Që këtej del se problemi i ndarjes administrative është i hapur me prirje drejt kalimit në zona më të mëdha, më kompakte, me struktura më të spikatura të modeluara në aspektin matematik, informatik, statik etj. Kuptohet që mungesa e bazave të të dhënave është risk (mungesë informacioni që e thellon pasurimin e tij), pra risk mbi risk.

9. Reforma drejt zhvillimit "Go to Growth" dhe baza e të dhënave

Jo vetëm me reforma të pjesshme (madje boll me të tilla!)

Vendet e Europës Perëndimore e Qendrore, madje edhe shumë të tjera të Europës Juglindore, kanë përfunduar shumë nga reformat strukturore në fushën e arsimit, ndarjes territoriale etj., madje shumë vite më parë. Aktualisht ato kanë strategji të përgjithshme zhvillimi për burimet njerëzore, teknologji të reja, komunikime e aktivitete elektronike në qeverisje, biznes, arsim, etj

Kuptohet që në këtë mes jemi mbrapa, në shumë tregues cilësorë dhe sasiorë ekonomikë, socialë, etj. Në disa drejtime nuk krahasohemi as dhe me vendet fqinje (ka punime që vendin tonë e fusin në një listë me emra vendesh në Afrikë e Oqeani), jo më pastaj me disa vende të Evropës Perëndimore, p.sh. me Danimarkën, Estoninë, etj. Natyrisht që bëjmë mirë të ndërtojmë strategji për reforma specifike lokale, siç janë këto që po ndërmarrim, por çështja mund të shtrohet në një plan më të gjerë, d.m.th duhet të përgatitemi jo vetëm për reforma specifike, por paralelisht edhe për një reformë të përgjithshme zhvillimi, ashtu siç kanë bërë shumë vende të Europës Perëndimore e Qendrore që nga viti 2005.

Kjo reformë që njihet me emrin e përgjithshëm "Go to Growth" (Drejt Zhvillimit), nga pikëpamja e informacionit përmban bazat e të dhënave të përgjithshme e specifike, strukturat e tyre, platforma të komunikimit elektronik e te aktiviteteve, metodat e ndryshme të teknologjive të informacionit, metoda të tjera të përparuara programimi, vlerësim të rrjeteve, etj. Në këtë kontekst, mund të lindë mendimi " ***jo vetëm me reforma të pjesshme, madje ndoshta boll me to".***

Natyrisht që shumë hapa zhvillimi të vendit nuk mund të kapërcehen (se duam Ne !!) e aq më pak të digjen. Megjithatë askush nuk na "pengon" që të veprojmë fort dhe me shpejtësi për ndërtimin shkencor të bazave, magazinave të të dhënave në fusha të ndryshme të ekonomisë. Është e vërtetë që funksionaliteti i çdo sistemi " nis nga e dhëna", d.m.th ekzistenca dhe zhvillimi i një shteti të fortë përcaktohet nga natyra, struktura e bazave të të dhënave dhe e përdorimit demokratik të tyre. Po aq e vërtetë është që dobësitë e shtetit tonë janë jo më pak të ndjeshme dhe me pasoja jo të vogla negative kur informacioni i mësipërm nuk është i plotë, për mos me thënë që në shumë fusha është i mangët.

Që puna paralele me atë të reformave specifike mund e duhet të nisë për një reformë integrale zhvillimi, po rimarrim për konkretizim përsëri shembullin e reformës territoriale administrative. Kjo sikurse çdo reformë tjetër, është një aktivitet shkencor i mbështetur në strategjinë përkatëse, madje matematikisht optimal ose afërsisht i tillë, që të parashikojë treguesit themelorë të zhvillimit të zonës së shoqërisë (së bashku me

riskun përkatës) për një interval kohe 10-15 vjet. Shumë nga këto probleme janë edhe të vështira për t'u përballuar, por kjo është një sfidë e radhës kur më parë të jetë siguruar sasia e informacionit të nevojshëm e të mjaftueshëm (jo vetëm demografik, administrativ, apo i ndonjë lloji tjetër të pjesshëm), por ekonomik, financiar, teknologjik, mjedisor, etj. e në radhë të parë të jetë i ndërtuar modeli i zhvillimit të zonës, komunës apo qarkut.

Të gjitha këto për fatin jo të mirë (përgjithësisht) ne nuk i kemi, e për t'i siguruar ato kërkohet kohë pune e madhe. Për shembull, prej kohësh flitet për një model të zhvillimit optimal të vendit, i cili të paktën matematikisht, nuk është i përcaktuar qoftë në trajtën eksperimentale. Për të gjitha këto kërkohet kohë, përpjekje e punë e madhe.

Akoma më e vështirë është sfida nëse për reformën e zhvillimit synohet të ndërtohet një algoritëm optimizimi, i cili, krahas bazave të të dhënave "specifike" etj., kërkon dhe përgatitjet e nevojshme matematike, informatike, programuese, etj. Duke ju referuar përsëri reformës administrative, bazave të të dhënave ekzistuese, për të ardhmen do të duhet të shtohen edhe shumë struktura të tjera të të gjithë pasurive të zonës për çdo sistem e nënstrukturat e tij, që mundësojnë ndërtimin e një modeli matematik të zhvillimit të përgjithshëm madje optimal stokastik (me variante që shtrihen jo vetëm brenda zonës por edhe jashtë saj).

Vështirë se me variantet ekzistuese të reformës së ndarjes territoriale, Shqipëria për 10 vjet do të jetë po aq e "copëtuar" siç propozohet ndarja ekzistuese, kur përveç të tjerave, struktura të sistemeve të ndryshme mund të kenë zhvillime tashmë të reja (tregu i punës, mallrave, sistemi i arsimit, kulturës, struktura demografike e turistike të mëdha, rrjete transporti kompakte, madje demografi të ndryshuara nga vendet e punës, etj. Çështja është që në të ardhmen të mos braktisim struktura të vogla "se dalin jo efektive", e për këtë qëllim, t'i prishim ato se duam të ndërtojmë struktura të mëdha Europiane.

Pavarësisht nga kjo, puna për një reformë të përgjithshme zhvillimi të vendit e shoqërisë duhet të nisë sepse zhvillimi i plotë është më efektiv dhe më me pak risk. Ai është më i qëndrueshëm, i integrueshëm dhe me perspektivë se të gjitha zhvillimet e pjesshme, ai e përcakton më mirë strategjinë kombëtare dhe integritetin e saj në atë Europiane. Natyrisht kjo sfidë "Go to Growth" kërkon "me ngulm" institucionin përkatës që në fillimet e tij mund të jetë ai i Strategjisë Kombëtare , i cili që në fillim të synojë edhe përgatitjen për reformën "Go to Growth", madje pse jo edhe atë psikologjike, me referencën "Boll më me reforma të pjesshme!"

10. Komunikimi, koha, risku.

Si në çdo proces, edhe në komunikim, koha është një investim, një variabël i fortë dhe i qenësishëm i prodhimit të riskut

Në përgjithësi shoqëria jonë ka shumë humbje (risqe), në ndonjë rast këto kalojnë si pa u ndjerë, por kur shqyrtohen me kujdes, del që ato duhet të vlerësohen mirë. Dihet që faktori kohë është themelor në "prodhimin" e risqeve në çdo projekt, madje jo vetëm këtu. Në komunikime të ndryshme, biseda, fjalime , intervista, diskutime, veprimtari mediatike, akademike, etj., ka raste që koha e humbur kalon pa u ndjerë, madje është e gjatë.

Kështu janë disa nga konstatimet, replikat, bisedat politike etj. që kanë zgjatur e kanë mbërthyer opinionin publik me muaj e muaj ("sa të shkurton jetën"), p.sh., projekti i mbikalimit të Zogut të Zi, diskutimi për taksat , kohet e fundit edhe për reformat. Të vjen keq që në shumë situata të tilla nuk formulohet problemi, çfarë jepet, çfarë kërkohet, alternativat, argumentimi, metodat e zgjidhjes, rezultatet, zbatimi, interpretimi, risku, eventualisht revizionimi, etj.

Mangësi të tilla ka edhe në materialet e reformave, ose ka raste kur palët politike akuzojnë njëra-tjetrën e akuza vazhdon pa shkuar në drejtësi. Kujt i shërbejnë qëndrime e veprime të tilla ? E raste të tilla ka me thes (pra edhe humbje, risqe) jo vetëm në politikë, por edhe në fusha të tjera. Konstatimi publik për një çështje është një vlerë, por kur ai nuk të çon në zgjidhje dhe në rezultatin praktik(zbatues), është "vlerë pa vlerë". Shkurt, shoqëria jonë prodhon risk me tepri në komunikim dhe kjo është një barrierë që përveç humbjeve të largon më tepër nga Standardet Europiane që janë synim i shpejtë i shoqërisë sonë.

11. Pasuria kombëtare dhe risku

Pasuria kombëtare duhet të jetë me risk minimal

Kur bëhet fjalë për zhvillimin ekonomik të vendit, mendja menjëherë të shkon tek sistemi ekonomik, tek pasuritë kombëtare, burimet njerëzore, burimet natyrore, burimet energjitike, mineralet e dobishëm, burimet bujqësore, bregdetare (ujore e nënujore), burimet turistike, pozicioni i lakmueshëm gjeografiko – strategjik, brezi mesdhetar, flora, fauna, klima etj. Pasuria Kombëtare është baza e ekonomike e Shtetit. Nëse sistemi ekonomik nuk shkon mirë , arsyet duhen kërkuar tek përmbajtja, d.m.th tek çdo nënsistem (burimet, proceset , faktorët, infrastrukturat) ose edhe në strukturën e sistemit, d.m.th. tek bashkësia e lidhjeve të nënsistemeve. Prej këtej del se faktorët themelorë në zhvillimin e Sistemit Ekonomik Kombëtar që kanë ndikim individual ose edhe të kombinuar janë :

1. Tërësia e inputeve të sistemit që me marrëveshje po e quajmë Pasuri Kombëtare , me të gjitha burimet njerëzore, natyrore, etj., infrastrukturat, teknologjia, instrumentet e metodat, proceset përkatëse, shkurt tërësia e objekteve të sistemit;
2. Bashkësia e të gjitha nënstrukturave të Sistemit (administrative, politike , juridike, të rendit, të mbrojtjes, shëndetësore, arsimore, financiare, ekonomike, mjedisore, kulturore, etj.

Nëse për një rast do të mendonim që Pasuria Kombëtare nuk ka qenë e mjaftueshme për një zhvillim normal të vendit (këtë kuptim po e pranojmë me marrëveshje apriori) lindin menjëherë këto nënpyetje :

e para ky mos zhvillim "i takon" burimeve njerëzore dhe përgatitjes së gjithanshme shoqërore, profesionale, shkencore , kulturore, etj?

e dyta , apo pjesës tjetër të pasurisë kombëtare sikurse janë burimet natyrore, enegjitike , burimet bujqësore, financiare?

e treta, apo veprimit të përbashkët të dy nënfaktorëve të marrë së bashku ?

Natyrisht, këto çështje nuk janë të lehta për t'u diskutuar e aq më pak nëse kërkohet të bëhet një vlerësim cilësor dhe sasior, përfshi këtu dhe vlerësimin e riskut. Nëqoftëse do pranohej pohimi që Pasuria (burimet) Kombëtare dhe dinamika e tyre janë bazë e politikës shtetërore , del se vlerësimi i këtyre burimeve është kusht imperativ zhvillimi , pak më ndryshe, kusht i nevojshëm i hartimit të Strategjisë Kombëtare. Që këtej del nevoja e dy institucioneve: i atij të Vlerësimit të Pasurisë Kombëtare dhe të Strategjisë Kombëtare.

Kur flasim për institucionin e strategjisë kjo nuk do të thotë që vendi nuk ka strategji, përkundrazi, ai ecën e zhvillohet sipas një strategjie (ka një institucion që merret me planifikimin e strategjisë !) e cila është më tepër afatshkurtër, në mjaft raste në nivel jo të mirë shkencor, hera-herës me interesa politike.

Për më tepër, në dijeninë tonë, kjo strategji bëhet në shumë raste pa pjesëmarrjen e departamenteve, universiteteve, qendrave kërkimore shkencore e akademike të interesuara, etj. Ky problem është ngritur shpesh herë (veçanërisht pas vitit 2000) por ka ardhur koha që politika t'i japë mundësinë edhe hapësirën e mjaftueshme institucioneve mësimore e shkencore, "pronareve" të ligjshme të strategjive, që të punojnë për hartimin e ligjeve në çdo fushë ku ata ushtrojnë aktivitetin përkatës.

Natyrisht strategjia nuk ka pavarësi absolute nga politika, si për fondet e projekteve e një sërë treguesish të tjerë menaxherialë. Pra, kur flasim për pavarësi të strategjisë nga politika në radhë të parë mendohet që studimi dhe hartimi i saj për degën përkatëse të bëhet nga institucionet shkencore, departamentet, specialistët përkatës, etj.

Nuk mund të ketë strategji kombëtare (në kuptimin e mirëfilltë të kësaj fjale) pra vlerësim të pasurisë kombëtare e të riskut të saj. Pasuria kombëtare është një nga çështjet me të rëndësishme të çdo vendi dhe për vlerësimin e saj ka institucione, agjenci dhe mjaft organizma të tjerë, madje jo vetëm me karakter lokal, por edhe më gjerë. Meqenëse kjo çështje del jashtë qëllimit të vënë, më poshtë po paraqesim vetëm disa konsiderata të pjesshme në fushën e energjisë, naftës e mineraleve të dobishme.

Dihet që prej vitesh sektori i energjisë (elektrike) ka patur shqetësime serioze, veçanërisht në transmetimin e saj dhe të humbjeve në rrjet. Edhe sot e kësaj dite, ky sektor është deficitar, p.sh. në likuidimin e pagesave. Dihet nga menaxhimi i riskut që kur risku nuk "preket seriozisht " (monitorohet, menaxhohet), atëherë, ai mund të shtohet, aq sa mund të sjellë prapambetje të mëdha, deri edhe në kriza. Pra në këtë veprimtari me shumë risk kanë ndikuar për vite me radhë shumë aktorë brenda dikasterit përkatës, i cili ka qenë njëherësh edhe "prodhues" i riskut, por edhe "kontrollues e vlerësues" i tij (konflikt interesi!). Përveç këtyre, humbje (risqe) ka patur edhe në miniera, hidroenergji, etj.

P.sh., dhënia e licencave pa kriter në minierat e kromit ka sjellë një fragmentarizëm të nxjerrjes së mineralit, humbje të tij nga shfrytëzimi, rezerva të mbetura të panxjerrshme, etj. Dikasteri përkatës ka qenë i interesuar për rritjen e prodhimit të kromit dhe njëherësh ka qenë përgjegjës për kontrollin, vlerësimin e rezervave dhe të riskut. Përsëri konflikt interesi. Probleme të ngjashme ka patur edhe në hidroenergji, për licencat që janë dhënë hera herës në kushte të pastudiuara, veçanërisht në aspektin hidrodinamik, mjedisor, etj. Shfrytëzimi jo racional i energjisë hidrodinamike të pellgut ujëmbajtës ul efektivitetin, shkurt rrit humbjet (riskun). Edhe në këtë rast i njëjti problem: prodhohet risku dhe vlerësohet nga i njëjti institucion. Akoma më tej.

Siç dihet, kontrata e Albpetrolit për shitjen e tij (në një vlerë mbi 800 milionë euro) u përgatit "me nxitim" dhe u menaxhua nga vetë Dikasteri ku ai bën pjesë. Përsëri "prodhimi i riskut dhe vlerësimi i tij" brenda të njëjtit dikaster, madje i shoqëruar me probleme kapitale, siç janë rezervat, puset , teknologjitë, etj. Shqetësime analoge lindin edhe në llogaritjen e rezervave të mineraleve të dobishme të tjera, shoqëruesve të tjerë, të dinamikës së shfrytëzimit që zbatohet dhe të efektivitetit të tyre, veçanërisht në kompanitë private, etj.

Këta shembuj dhe të tjerë si këta, që lidhen me pasurinë shtetërore, konkretisht me rezervat e mineraleve të dobishme, me përkufizimin e tyre, klasifikimin shfrytëzimin e deri në njehsimin e riskut etj, duket se shtrojnë nevojën e një institucioni shtetëror të pavarur i cili të përgjigjet për standardizimin e burimeve dhe mineraleve ashtu siç e kanë edhe shtete të tjera. Përmendim që standardizimi i burimeve minerale, rezervave dhe riskut të tyre sipas standardeve bashkëkohore, do të kërkojë investime veçanërisht në

teknologjitë e matjeve, kontrollit të metodikave përkatëse që do të përdoren për këtë qëllim.

Çështja e sigurimit të informacionit të nevojshëm dhe e të dhënave përkatëse nuk është thjesht një problem që shfaqet vetëm në llogaritjen e rezervave e standardeve të tjera, por në çdo studim , projekt , reformë etj. Në shumë universitete shikon shkrimin "e dhëna është informacion, informacioni është njohuri, njohuria është dije". E thënë ndryshe, funksionaliteti kudo, (por edhe i Shtetit), fillon nga e dhëna (çdo funksion përcaktohet nga të dhënat e fushës së tij).

Baza e të dhënave është themelore edhe për njehsimin e riskut , pa këtë bazë dhe cilësitë përkatëse të saj as që mund të bëhet fjalë për njehsimin e riskut kudo qoftë . Më sipër kur u pohua që reforma e arsimit të lartë ka risk të madh, në mënyrë të heshtur u kalua fakti që ka një risk që i ka rrënjët në mungesën e bazave të nevojshme të të dhënave për projektet përkatëse të të gjithë departamenteve dhe të zbatimit të tyre .

Me sa dimë, problemi i bazave të të dhënave ekziston në shumë e shumë sektorë të ekonomisë dhe në çdo qelizë të jetës shoqërore (individ , familje , komunitet, etj.) dhe është një ndër faktorët kryesorë që ndikon në përmirësimin e zhvillimit të tyre

12. Konsiderata të përgjithshme

Shqipëria ka risk relativisht të madh që është një problem i gjithanshëm kombëtar

1. Jeta është risk. Çdo veprimtari njerëzore (mendore, fizike) ka risk.
2. Individi është burimi, objekti dhe faktori Nr.1 i prodhimit, vlerësimit dhe menaxhimit të riskut.
3. Koha është investim, njëherësh një variabël e "fortë" e prodhimit të riskut.
4. Meqenëse individi (njeriu) është strumbullari i riskut, kërkohet një përgatitje e spikatur e tij menaxheriale, veçanërisht kur ai është në pozita drejtuese (pavarësisht nga niveli i hierarkisë).
5. Analiza e Riskut është një instrument diagnostikues dhe potencial i mundshëm zhvillimi. Reforma në drejtësi shton shanset e rritjes së këtij potenciali..
6. Analiza e Riskut në projekt është një standard europian dhe si e tillë ajo duhet të parashikohet si një normë ligjore. Ligji për riskun duhet të veprojë në çdo fushë dhe me përparësi në fushat strategjike ku alokohen investime të rëndësishme.

7. Baza e të dhënave është themelore edhe për njehsimin e riskut. Pa këtë bazë dhe cilësitë përkatëse të saj, as që mund të bëhet fjalë për njehsimin e riskut kudo qoftë ai.
8. Në fushën studimore e aplikative të Analizës së Riskut është e ndjeshme mungesa e specialistëve. Që këtej , ngritja e kurseve të kualifikimit për specialistët dhe hartimi i kurrikulave përkatëse në nivel studenti, masteri dhe doktorature, sigurimi i literaturës përkatëse dhe përfitimi nga përvoja e huaj janë një nevojë e ndjeshme për shumë sektorë si energji, gjeologji, financë mbrojtje mjedisi, inxhinjeri, matematikë, etj.
9. Meqenëse vendi ynë në shumë sektorë ka prapambetje dhe risk të madh (korrupsioni, krimi i organizuar, trafikimi, kohë me "bollëk", padrejtësi në pronat, etj.), pabarazi të theksuar shoqërore, varfëri, mungesa e vendeve të punës, papunësia (veçanërisht në radhët e të rinjve), mangësi në strategji e modele zhvillimi, dobësi ekonomike në sektorë strategjikë, si energji, miniera, arsim, shëndetësi, mbrojtje mjedisi, etj., këto e bëjnë të domosdoshëm që sa më shpejt të bëhet të paktën identifikimi i objekteve me risk dhe njëherësh edhe marrja e masave përkatëse për menaxhimin eventual të riskut (kufizimin dhe zvogëlimin e tij).
10. Kjo veprimtari paraprakisht mund të kërkojë fillimisht realizimin e një formulari që mund t'i dërgohet dikastereve, bashkive , komunave, etj. dhe më pas me përgjigjet dhe informacionet përkatëse, të hartohet një material me problemet më të rëndësishme të analizës së riskut, për institucionet e mësipërme, i cili mund të dërgohet në organin përkatës shtetëror për vendimet respektive.
11. Në një kohë të përshtatshme mund të fillojë edhe përgatitja e organizimi i një Konference Kombëtare për problemet e riskut në sektorë të ndryshëm ekonomikë e shoqërorë, p.sh. në atë të burimeve energjitike, drejtësisë, financës, arsimit, mineraleve, shëndetësisë, rendit, mjedisit, etj.
12. Të shikohet mundësia për ngritjen e një institucioni që të merret me standardet e burimeve njerëzore, natyrore, energjitike, mineraleve, etj., duke përfshirë rezervat, klasifikimin, etj., deri në analizën e riskut, shfrytëzimin e tyre, kontratat, import – eksportin. Në ndërtimin e këtij institucioni, duhet patur mirë parasysh edhe përvoja e vendeve të tjera.
13. Shumë institucione europiane, agjenci, kompani, kabinete dhe dikastere kanë specialistë të mirëfilltë që përgjigjen juridikisht (me firmë të tyre) për analizën e riskut në projekte (kontrata, reforma etj.) . Edhe në vendin tonë duhen bërë përgatitjet që të kemi specialistë të tillë, deri në institucionet më të larta të qeverisë. Në institucione të rëndësishme mund të ngrihen edhe grupe të veçanta për auditimin e riskut të projekteve strategjike.

14. Paralelisht me reformat specifike, mund e duhet të fillojë puna për hartimin e një strategjie për zhvillimin e gjithanshëm të ekonomisë(GO TO GROWTH) dhe ndërtimin e bazave të të dhënave në të gjithë sistemet e ekonomisë, duke parashikuar fondet përkatëse financiare (deri në Buxhetin e Shtetit).
15. Çdo reformë është projekt. Për të rritur efektivitetin e reformës së arsimit të lartë dhe për të zvogëluar riskun e konsiderueshëm të saj, fillimi i punës për hartimin e projekteve paraprake nga departamentet përkatës, në bazë të kritereve dhe standardeve të kërkuara nga Komisioni i Arsimit të Lartë, është një nevojë e dorës së parë.
16. Reforma e ndarjes administrative territoriale është një problem i hapur zhvillimi, e cila në vazhdimësi duhet të pasurohet me bazat e të dhënave të reja, struktura e modele që do të bënin të mundur optimizmin e zhvillimit deri edhe në zgjerimin eventual të ndarjeve, në qoftë se kjo del nga studimi i modeleve matematiko-ekonomike, financiare, etj. Në një plan më të përgjithshëm, studimi dhe ndërtimi i modelit të zhvillimit makroekonomik- matematik të vendit është një nevojë e ngutshme.
17. Risku karakterizon çdo veprimtari që kryen njeriu në shoqëri, ekonomi, politikë, arsim, shkencë, shëndetësi, rend, turizëm , infrastrukturë, etj. Çdo risk është specifik, dmth ka natyrën e tij: përmasat, densitetin (i lartë, i mesëm, i ulët), ndikimin, masën e humbjeve (dëmtimeve), etj. Risku në sistem përcaktohet nga natyra e proceseve, objekteve dhe struktura (infrastruktura). P.sh., në qoftë se në një sistem risku është i lartë, p.sh., në atë politik, atëherë ai duhet kërkuar në objektin individ, parti etj., dhe njëherësh në strukturën e nënstrukturën përkatëse që lidhin këto objekte, si statute, dokumente, norma ligjore, etj. Pak më ndryshe, për të menaxhuar riskun në sistem, duhet bërë menaxhimi i proceseve, eventualisht në objekte ose/edhe në strukturat përkatëse. I njëjti problem edhe në sisteme të tjera: në arsim, drejtësi, etj. Kjo do të thotë që në reforma të caktuara, ndryshimet në sistem mund të jenë thelbësore, ndërkohë që në objekte mund të mos bëhen ndryshime të qenësishme. P.sh., në qoftë se shtrohet pyetja që haset në tekste: Sa ministra duhet të ketë Kabineti Qeveritar?. Këtu problem i sistemit është "më tepër" strukturor se sa i objekteve që do të përmbajë Kabineti Qeveritar.
18. Vlerësimi i riskut është një problem që përcaktohet nga hapësirat përkatëse dhe kushtet e tyre që po i quajmë, (si në matematikë) kushte fillestare dhe kufitare. Kushti më i parë fillestar është transparenca, etj., ndërsa kushti kufitar është "prekja", kanosja, cenimi (threat) i kushteve fillestare. Pak më ndryshe, drejtësia dhe zbatimi i saj janë kushte të domosdoshëm për vlerësimin e riskut dhe njëherësh edhe për penalitetin eventual.

Nga ana tjetër, risku është masë që karakterizon një proces të caktuar i cili "ndodh" në objekt si rezultat i veprimit të faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm. Pra, risku gjithmonë i referohet objektit me risk, i cili është hapi i parë i Analizës së Riskut. Natyrisht, ky identifikim në fazën e parë nuk është matematik, etj. (sepse nuk është bërë vlerësimi), por është praktik, vizual, intuitiv, eksperimental, perspektiv, induktiv, arsyetues, etj. Kuptohet që kur identifikimi i objekteve me risk mund të bëhet në rruge jo matematikore, vizuale, eksperimentale, etj., atëherë ai mund të jetë instrument plotësues i dobishëm për hapat e mëtejshëm të analizës së riskut dhe të zbatimit të saj.

19. Në natyrë e shoqëri, objektet janë të lidhur dhe bashkëveprojnë me njeri tjetrin. Nga ky bashkëveprim lindin ndryshime, risqe, etj. P.sh., në një varg objektesh, nga veprimi i objektit të parë mund të lindë "një risk në objektin e dytë" dhe ky i fundit vepron dhe " shkakton" një risk në objektin e tretë, e kështu me radhë. Formohet në këtë mënyrë një varg risqesh të kushtëzuar (që kanë në themel probabilitetin me kushte) ose ndryshe një zinxhir risqesh (probabilitetesh). Mund të ndodhë që risk pas risku, këto të kalojnë në " rezonancë", aq sa dëmi final të jetë i konsiderueshëm. Që këtej shprehja e popullit: "*po filloj e keqja hapi derën"* .
20. Në jetë, për këto "lojëra me risqe" duhet bërë kujdes veçanërisht kur pasojat janë të ndjeshme, sepse shoqërohen me humbje deri në kriza, në të kundërt nëse ato mënjanohen, mund të sjellin potanciale zhvillimi. Në marrëdhëniet ekonomike ndërmjet dy shteteve (Shqipëri–Kosovë), lojëra kontradiktore mund të sjellë dëme të dyanshme, ndërsa loja e bashkëpunimit përfitime të dyanshme. Pra politikat diplomatike ose politika në përgjithësi mund të bëhet instrument zhvillimi, ose barrierë e tij. Kuptohet që në raste të tilla, krahas kujdesit e hetimit të gjithanshëm të objekteve me risk, ka rëndësi koha, shpejtësia e vendimeve dhe realizimi i tyre.

21. Në bashkësinë e shumëllojshmërisë së risqeve ka edhe *risqe të heshtur, pasivë, etj* por që me kalimin e kohës bëhen shumë *aktivë*. Sipas planit rregullues prishen disa ndërtesa sepse janë të paligjshme. Zbatohet ligji dhe natyrisht bëhet mirë. Në qytet apo njësi të vogla ku papunësia është e madhe, kjo rritet edhe më tej, më pas njerëzit e papunë kanë shanse të riskojnë duke u marrë me veprimtari të tjera të paligjshme, ku grupe të caktuara mund të formojnë struktura të paligjshme më të mëdha. Pra mënjanimi i një risku mund të "pjellë" një risk të ri që në kushte të caktuara mund të bëhet më i rrezikshëm se i pari.
Në një rrethanë të tillë, ç'duhet të bëjmë? Pa tjetër që zbatimi i ligjit nuk diskutohet, veçse në qoftë se situata pret, në zonat e prishura nuk do të bëhet asnjë ndërhyrje e re, etj., mundet që zbatimi i ligjit të bëhet me pak vonesë, që

njerëzit mund ta shfrytëzojnë këtë kohë për t'u sistemuar, për të gjetur punë, etj. Në literaturë, shtimi i papunësisë, veçanërisht për moshat e reja është aq i rrezikshëm sa mund të kalojë në krizë.

22. Risqe " të heshtura" ndodhin edhe në rotacionet politike, akademike, etj., ose kur probleme shtrohen në auditorë të Universitetit, p.sh. ai i reformave dhe nuk i dëgjon njeri. Partia në pushtet, apo stafi akademik drejtues premton në një projekt infrastrukture (rruge), në fakultet për një punim(veprimtari) tjetër. Më pas nis puna për projektet(veprimtaritë) në fjalë. Pastaj kryhet rotacioni dhe fillojnë veprimtari të tjera, që i lënë në një anë projektet e mëparshëm, sepse nisin projekte të rinj. Mund të ndodhë që rotacioni të argumentojë "ndryshimin" e ri, por në qofte se jo , kjo do të thotë që risqet në projektet e lëna në qetësi flenë, shumohen e për rrjedhim vazhdojnë humbjet nga investimet tashmë të kryera. Që këtej del se rotacionet politike(akademike) që nuk parashikojnë vazhdimin e politikave të përshtatshme, efektive e perspektive, mbi bazë të një strategjie kombëtare, e cila vepron për shumë vite, shoqërohen edhe me risqe. E që të mos ndodhë kjo duhet të kemi norma ligjore. nuk duhet lejuar që, pa argument, objekti i nisur "të flejë i papërfunduar" e për këtë të mos i gjendet shkaktari.

23. Risku në Shqipëri është aq i madh sa për studimin e tij do të duheshin punime të tëra, veçanërisht në sektorë të rëndësishëm ekonomikë, ndoshta jo vetëm për objektet por edhe për sistemet përkatës(Shpesh diskutohet që "fajin e ka sistemi"). Kjo është arsyeja pse në ballinën(kopertinën) e tekstit *"Optimizimi Hyrje ne Stokastike", është* shkruar:

"Shqipëria ka prapambetje (të mëdha), ka risk të konsiderueshëm" .
Ndryshe, risku është një problem i gjithanshëm kombëtar.

Literatura

1. World Bank (2014)

Risk and Opportunity. Managing Risk for Development

2.*European Commission (2012)*

Europe 2020. Europes Growth Strategy. Brussels , BELGIQUE

3.*A practical guide to risk assessment* pvc. Com /us/grc (2008)

4.Threat and Hazard. Identification and Risk Assement Guide (2013)

http://www.dhs.goc/xlibrary/asset/rma-astrategig--national-risk-assesment/ppde.pdg

5.L. Stetner (20011) Introduction to risk theory and Mathematical finance Polish Academy Science, Ëarsav ,POLAND

6.M.Capinski, T.Zastavniak (2003)

Mathematics for Finance An Introduetion to Financial Engineering, Springer , GERMANY

7.H.J. Zimmermann(1996) *Fuzzy set theory and its application* Kluwer. London/UK

8. Data warehouse tutorial www. Tutorials point.com/dwh/dwh_tutorial.pdf

9. Canadian Institute oh Mining, Metallurgy and Petroleum (2000)

CIM Standarts of Mineral Recources and Reserve, CANADA

10. *G.A.Hilton. Defining Risk. Financial Anakysis Journal Boston USA*

11.A.Ghencea, iI.Ghiger(2010) Data Base optimizing services . Data Base Systems Journal , Bucharest ROMANIA.

11/1 *A.*Matei, C. Savulescu. E-Government in Balcan.Comparative study.National school of political Studies and Public administration. Bucharest , ROMANIA

12. (1990) M. Bars C. Wells. Category theory for Computer Science nNeë York USA

13.*Project Risk Analysis and Management*, APM , UK

14.SPE (2008) Petroleum Resource Management System(internet)

15.*Risk Management Concepts and Methods* (2008). www .clasif.asso.fr

16.Risk Assesment of Pipeline Protection (DNV) ,2010 (internet)

17.Ministri për heshtje vendore (2014)*Reforma administrative territorial.Kriteret teknike per ndarjen e re administrative – territorial ,* Tirne

18.Komisoni për arsimin e lartë dhe kërkim shkencor (2014)

Raporti I dhe Raporti përfundimtar 2. Për reformimin e arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor, Tirane

19.*The National Security Strategy of the Republic of Albania*

20 B.Leskaj(2013).. Mirëqeverisja –Paradigma e re ne administrimin Publik. Revista Auditimi Publik Nr 5.Tiranë

21.S.Osmani (1999)*Disa konsiderata mbi analizën e riskut në investimet e naftës,* Nafta Shqiptare , (Ekonomia) Nr4, Patos, Fier.

22.S.Osmani (2012)*Optimizimi : Hyrje në Stokastike.* Pjesa e tretë. Shtëpia Botuese Filara, Tiranë

23.S.Osmani (2008)*Optimizimi : Programimi linear me zgjerime. Pjesa e parë*. Shtëpia Botuese Pegi Tiranë

24.*S.Osmani. S.Sukaj Dh.Gjovreku, N.Koja, N.Kodheli.(2003) Disa Konsiderata për strategjinë e vendit tonë dhe zhvillimin e qëndrueshëm Konferenca Italo-Shqiptare,* Tiranë

25 S.Osmani (2013)Imazhe dhe vizione për projektizimin.Quo Vadis ? Revista Auditimi Publik Nr 5, Tirane

26.S.Osmani P.Hoxha (2012)*Management , Strategy and Project. Leadership, Leader and Manager* , International Conference, GCMM Aucland , NEW ZELAND

27.S.Osmani, F.Kazazi, M.Lakrori, B.Nepravishta (1983, 1984)Matja dhe kontrolli i proceseve teknologjike, vol 1,2 Tirane

28.S.Osmani(2014)A view on Management and Category Theory

Intenational Conference: Informations Systems and Technology Innovation. Tirane, Albania

29.S.Osmani (2014)*Një vështrim menaxherial për reformat.(*Kumtesë me pedagogë dhe pasuniversitarë. Fakulteti Gjeologji-Miniera. Tiranë

30.S.Osmani (2004) Modele matematike në menaxhim, Shtëpia Botuese PEGI, Tiranë

KREU VIII.

KLSH, shtëpi e librit,Universitet për audituesit e rinj, partner i shoqatave profesionale të fushës

- Promovimi i botimeve të KLSH-së në Bibliotekën Kombëtare, 2013
- Një frymë e re mes audituesve jo-publikë dhe audituesve më të lartë publikë
- Veprimtaria e KLSH përmes "lenteve" të të drejtave të njeriut
- Seminar i Departamentit të Auditimit të Performancës
- Konferenca Young KLSH "Unë, KLSH dhe EUROSAI"
- Kongresi i III-të i Shoqatës së Kontabilistëve dhe Financierëve të Shqipërisë
- Hyrjet në botimet e KLSH *(Përmbledhje e parathënieve nga disa prej 51 titujve të Kolanës së Botimeve KLSH 2012-2015)*

PROMOVIMI I BOTIMEVE TË KLSH-së NË BIBLIOTEKËN KOMBËTARE

Me rastin e Ditës Botërore të Librit, KLSH, në bashkëpunim me Bibliotekën Kombëtare organizoi më 20 prill 2013 në Sallën Amerikane të kësaj Biblioteke promovimin e 10 librave të tij për standardet e fushës INTOSAI, për historikun e institucionit, marrëdhëniet e KLSH me Kuvendin, analizat e rezultateve të tij dhe tre numrat e vitit 2012 të revistës shkencore periodike "Auditimi Publik".

Të pranishëm në këtë aktivitet ishin Drejtori i Bibliotekës Kombëtare, z. Aurel Plasari, ekspertë të njohur të shkencave të kontabilitetit dhe auditimit, profesorë të Universitetit Shtetëror të Tiranës, përfaqësues të shoqërisë civile dhe të institucioneve të tjera shtetërore partnere me KLSH.

I nderuar z.Aurel Plasari,

Të nderuar akademikë,

Të nderuar kolegë auditues

Promovimi i botimeve të KLSH-së merr kuptim të veçantë sepse realizohet në një institucion ndër më të shquarit në sistemin e kulturës si Biblioteka Kombëtare dhe në një ditë të veçantë, në Ditën e Librit.

Biblioteka Kombëtare dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit janë të dyja institucione me rëndësi për demokracinë, të vendosura në themelin e shtetit shqiptar. Ngritja e tyre që në gjenezën e shtetit shqiptar dëshmon qartë për rolin e tyre si institucione shtet-ndërtuese. Një demokraci ka nevojë për qeverisje të mirë, po aq sa ka nevojë edhe për zhvillim kulturor. Nuk mund të kemi qeverisje të mirë pa një zhvillim kulturor ashtu siç nuk mund të kemi zhvillim kulturor pa qeverisje të mirë, e cila në vetvete është kultura që i kundërvihet anti-kulturës së pandëshkueshmërisë dhe korrupsionit.

Një shoqëri demokratike dhe e përparuar nuk kërkon thjesht marrëdhëniet individ-libër, por kërkon kalimin në një instancë më të lartë, mes institucionit dhe librit. Në kushtet e Shqipërisë, ku korrupsioni përbën një nga sfidat më të mëdha për vendin, lidhja e institucioneve me librin është pjesë integrale e luftës kundër korrupsionit. Dukshëm, binomi mirëqeverisje-kulturë është i pandashëm dhe për të ruajtur këtë ligjësi lipset afrimi i institucioneve shtetërore me librin, këtë "institucion" kulturor.

Për Kontrollin e Lartë të Shtetit, arti i të shkruarit ka një rëndësi jetike për institucionit. KLSH e reflekton veprimtarinë e saj në raportet e auditimit, të cilat në vetvete përbëjnë një libërth. Sigurisht, ato nuk janë letërsi e as trill, porse një kronikë e një ndodhie, një ngjarjeje. Personazhi ynë kryesor është interesi publik, fondet publike të shqiptarëve dhe raporti në vetvete është narratori që zbardh ato personazhe negative si korrupsioni që cenojnë interesat e shqiptarëve. Në këtë këndvështrim, roli i audituesit merr tiparet edhe të një shkrimtari, pasi mënyra e të shkruarit të raportit ka aq rëndësi sa vetë evidencat. Këtë marrëdhënie KLSH është e vendosur ta harlis në një dimension tjetër, ku institucioni do të shërbejë si një shtëpi e librit. Botimet e KLSH-së janë zbatim i detyrimeve ndërkombëtare të angazhimit të institucioneve të auditit edhe në fushën e botimeve të dokumentacionit për t'i mundësuar aksesin në to një auditori sa më të gjerë. Kjo kolanë, e cila do të pasurohet nga viti në vit, do të pasqyrojë reformat që ka nisur KLSH për të thelluar auditimin financiar dhe për të kthyer vëmendjen tek auditimi i performancës, për të luftuar korrupsionin dhe për ta parandaluar atë.

Sot promovojmë historinë e KLSH-së e cila në fakt nuk është historia e vetëm një institucioni, por histori e angazhimit shqiptar për shtet-ndërtim. Kujtesa institucionale e një organi kushtetues është e një rëndësie parësore për të lexuar drejt vlerat dhe kontributin e tij përgjatë viteve, por edhe gabimet dhe momentet e kthimeve prapa. Një analizë e tillë në dritën e fakteve të plota i shërben institucionit kushtetues për të kuptuar qartë pozicionin e tij në shoqëri, por edhe opinionit publik dhe qytetarëve për të peshuar si duhet misionin dhe realizimin e tij nga ky institucion.

Një botim mbi historikun e Kontrollit të Lartë të Shtetit, i cili u krijua si strukturë e plotë vetëm 13 vjet pas lindjes së shtetit shqiptar, ashtu si çdo botim tjetër për kujtesën e institucioneve të ngjashme përcaktuese në funksionimin e demokracisë dhe te shtetit ligjor në një vend, ofron avantazhe në disa rrafshe.

Së pari, ndërgjegjëson punonjësit e tij për vlerat e institucionit të shtrira në vite dhe të vyera për rolin kushtetues që ai ka, por edhe për përgjegjësinë që çdo auditues mbart kur përfaqëson institucionin me punën, sjelljen dhe rezultatet e tij.

Së dyti, si copëz historie, historiku jo vetëm shfaqet mjaft i dobishëm për cilindo qytetar që kërkon të njohë evoluimin në vite të institucioneve tona, por edhe për ata që duan të kontribuojnë në rritjen e cilësisë dhe efektivitetit të këtyre institucioneve.

Njëlloj, kujtesa historike i shërben po ashtu pasurimit të dijeve të brezit të ri, të përqendruar në këtë drejtim falë interesave didaktiko-shkollore apo studimore. Së fundmi, ajo kontribuon në pasurimin e asaj kulture ligjore dhe institucionale që duhet të kenë së pari vendim-marrësit publikë, por edhe çdo qytetar shqiptar i përgjegjshëm, i

interesuar për shtetin dhe mënyrën e funksionimit të tij. Formësimi i kulturës së institucioneve tona shtetërore me vlerat dhe përgjegjësitë e tyre përbën një prej objektivave të rëndësishëm të projektit të evropianizimit të administratës shqiptare, të forcimit të shtetit ligjor dhe punës për një qeverisje të mirë. Baza nga ku ngjizet kjo kulturë e domosdoshme është rrafshi njohës dhe historik i institucioneve përgjegjëse për konkretizimin e reformave të vendosjes së shtetit ligjor.

Vështrimi nga historia është një vështrim nga e ardhmja. Historia na kujton destinacionin se ku duhet të jemi, Bashkimi Europian. Kontrolli i Lartë i Shtetit, si një organ kushtetues dhe me rëndësi madhore në mbrojtjen e interesit publik, ka një rol për të luajtur në rrugëtimit e Shqipërisë drejt BE-së. Për procesin e integrimit lypset një qeverisje e mirë dhe KLSH do të angazhohet me formatin europian të auditimit, atë të performancës, për t'u ofruar shqiptarëve më shumë transparencë dhe llogaridhënie mbi fondet publike. "Udhëzues i Auditimit të Performancës: ISSAI 3000-3100" është një botim që reflekton këtë angazhim të ri të KLSH-së. Përmbajtja e këtij manuali është guri i parë i themelit në ngrehinën e re të auditimit të performancës në Kontrollin e Lartë të Shtetit. I realizuar përmes Grupit të Punës INTOSAI, manuali përfaqëson punën e përbashkët të shumë Institucioneve Supreme Audituese, të cilat kanë sjellë në të eksperiencën dhe karakteristikat përkatëse.

Një qeverisje e mirë shprehet përmes një performance të mirë dhe vendet e zhvilluara perëndimore e kanë kthyer fokusin e tyre pikërisht tek auditet e performancës. Dekadat e fundit kanë qenë dëshmitare të ndryshimeve të thella ekonomike, sociale, politike, klimatike e demografike. Lëvizjet e popullsisë, ndryshimi i moshës mesatare të saj, rritja e kufizimeve në energji, burime ekonomike e monetare, kërkesat për rritje të vazhdueshme të mirëqenies, etj., të gjitha këto kanë rritur ndërgjegjësimin e publikut për aktivitetin ekonomik qeveritar. Të amplifikuara edhe nga kriza e viteve të fundit, performanca është bërë sot një çështje e të gjithëve, qofshin këta punonjës të sektorit privat apo atij publik. Pikërisht për këto arsye, në secilin prej vendeve të sipër-përmendura, këto lloj auditesh zënë rreth 30-40% të punës audituese.

Auditimi i performancës duhet shndërruar në një nga shtyllat e zhvillimit dhe modernizimit të KLSH-së. Institucioni ynë është përpara një sfide të fortë për ta përqendruar punën tek auditi i performancës, pse ai i shërben vlerësimit të përgjegjshmërisë publike. Ky manual do të zbatohet jo thjesht si procedurë, por do të konceptohet si një filozofi e të menduarit dhe vepruarit nga i gjithë stafi i KLSH-së. Një filozofi pune që konsideron se auditimi nuk është një qëllim në vetvete, por në radhë të parë një instrument parandalimi, instrument korrigjimi dhe këshillimi për institucionin që auditohet.

Në përfundim, më lejoni të theksoj se plejada e dhjetë botimeve që po promovojmë sot si "EUROSAI" (Institucionet Supreme Europiane të Auditimit), "Historiku i Kontrollit të Lartë të Shtetit", "Standardet e Auditimit INTOSAI" (ISSAI), Revista "Auditimi Publik" Nr. 1, 2 dhe 3, "Udhëzuesi i Auditimit të Performancës", "KLSH Analiza Vjetore 2011" , "KLSH në Kuvend 2011" dhe "KLSH Analiza Gjashtëmujore Janar-Qershor 2012", shënon një etapë të re për KLSH, një fillim të ri për modernizimin e institucionit. Këto botime u vijnë në ndihmë jo vetëm audituesve në punën e tyre, por edhe qytetarit dhe vendim-marrësve publikë, për të kuptuar rolin thelbësor të auditimit suprem në përdorimin me ekonomicitet, efektivitet dhe efiçiencë të parasë publike, e cila buron pikërisht nga kontributet e qytetarëve tatimpagues. Ato përmbajnë një këshillim profesional, si dhe komunikim me publikun dhe Parlamentin dhe me palët e tjera të interesit, profesionistet apo qytetarët e angazhuar në shoqërinë civile". Nëpërmjet tyre, ne rrisim transparencën dhe llogaridhënien tonë si institucion pasi besimi i qytetarëve është burimi i pavarësisë sonë si institucion kushtetues.

NJË FRYMË E RE NË MARRËDHËNIET MES AUDITUESVE JO-PUBLIKË DHE AUDITUESVE MË TË LARTË PUBLIKË

Fjala në Konferencën e Federatës së Audituesve Publikë të Certifikuar të Mesdheut (Federation of Mediterranean Certified Public Accountants), të zhvilluar në Tiranë në 4 nëntor 2013.

I nderuar z. Agoumi President i FCM,

I nderuar z. Ambasador Sequi,

I nderuar z. Çela President i IEKA-s,

Të nderuar të ftuar dhe anëtarë të IEKA-s,

Me lejoni t'Ju përshëndes dhe t'Ju uroj për këtë konferencë të XII të FCM, shumë të rëndësishme për Ju dhe zhvillimin e auditimit profesional jo-publik në Shqipëri dhe në rajonin e Mesdheut.

Me shumë mirënjohje, do të doja te nderonim të gjithë së bashku kontributin e vyer të dhënë që në fillesat e IEKA-s nga Prof. Baki Berberi dhe Prof. Kosta Nika, personalitetet e shquara të auditimit e kontabilitetit në vend. Puna e tyre dhe ajo e Prof. Jorgji Bollanos etj., solli lindjen dhe konsolidimin e IEKA-s, duke siguruar një bazë të mirë për zhvillimin e sotëm të tij dhe sfidat që i ka adresuar vetes, për kontributin në mbikëqyrjen publike përmes auditimit dhe kontrollin e cilësisë. Dëshiroj të theksoj dhe të vlerësoj po ashtu nivelin e lartë profesional të sotëm të anëtarëve të IEKA dhe në veçanti të Kryetarit të tij, z. Hysen Çela, i shquar për integritetin, etikën dhe standardet e larta.

Mbi bazën e Nenit 12 të Deklaratës së Limës, Kushtetutës së institucioneve supreme të auditimit dhe të standardit ISSAI 1620 "Përdorimi i Punës së një Eksperti të Audituesit" të organizatës INTOSAI, Kontrolli i Lartë i Shtetit lidhi vitin e kaluar një marrëveshje bashkëpunimi me IEKA-n, duke i hapur rrugën një fryme të re në marrëdhëniet mes armatës së audituesve jo-publikë me audituesit më të lartë publikë, nëpërmjet trajnimeve, workshopeve, seminareve dhe konferencave, si dhe aktiviteteve të tjera të përbashkëta që kemi zhvilluar dhe do të zhvillojmë në të ardhmen.

Në vijim të nismës sonë të zbatimit të paketës më të fundit të INTOSAI-t, të quajtur "INTO-SAINT", ose auditimi i integritetit të institucionit, nëpërmjet një mekanizmi vetë-vlerësues, duke patur parasysh historinë tashmë 16 vjeçare të IEKA-s, faktin që ky

institucion shumë vite më parë e ka audituar KLSH dhe ekspertizën e pasur të mbledhur gjatë këtyre viteve nga anëtarët e tij, si dhe integritetin e lartë të drejtuesit të tij të sotëm, në cilësinë e Kryetarit të KLSH- së ftoj zyrtarisht IEKA-n të auditojë llogaritë e Kontrollit të Lartë të Shtetit për periudhën dyvjeçare që drejtohet prej meje. Auditimi i IEKA-s , duke përmbushur detyrimin tonë ligjor dhe profesional për t'u audituar nga një institucion i pavarur i fushës, do të përbënte një vlerë të shtuar të pazëvendësueshme për KLSH-në, duke qenë se në 10 vitet e fundit institucioni nuk është audituar nga audituesi të jashtëm.

I nderuar z. Çela dhe anëtarë të IEKA-s,Anëtarësimi dhe kontributi juaj në Federatën Ndërkombëtare të Kontabilisteve(IFAC), aktivitetet e shumta të zhvilluara prej jush, si dhe kjo Konferencë, po kontribuojnë në rritjen e imazhit të institucionit dhe në zgjerimin e bashkëpunimit të tij me institucionet simotra në Evropë e më gjerë. Realiteti i sotëm i parë edhe nën këndvështrimin e Konferencës suaj për rritjen e rolit të audituesit në mbrojtjen e interesit publik, kërkon prej institucioneve tona, prej audituesve dhe ekspertëve tanë të bëhen përpjekje maksimale për të ngritur profesionalizmin përgjegjësinë dhe llogaridhënien në nivele të reja, duke zbatuar standardet e duhura të mbikëqyrjes publike dhe të kontrollit të cilësisë, të shprehura në standardet ISA te IFAC dhe ISSAI të INTOSAI dhe të theksojmë bashkëpunimin mes nesh nën moton e INTOSAI-t "*Experentia mutua omibus prodest* (Eksperienca e përbashkët u shërben të gjithëve)". Dhe në përfundim dua t'Ju kujtoj misionin e organizatës IFAC e cila është krijuar në vitin 1977; çka Ju duhet të keni në qendër të vëmendjes:

"T'i shërbejë interesit publik, të vazhdojë të forcojë profesionin kontabël në mbarë botën dhe të kontribuojë për zhvillimin e ekonomive të forta ndërkombëtare përmes hartimit dhe nxitjes së zbatimit të standardeve profesionale të një cilësie të lartë, shtytjes më tej të konvergjencës së këtyre standardeve dhe duke u shprehur qartë për çdo çështje me interes publik ku ekspertiza e profesionistit është më se e nevojshme."

Ju faleminderit!

VEPRIMTARIA E KLSH-SË PËRMES "LENTEVE" TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

Fjala në Mbledhjen e Tetë të Shoqatës së Ombudsmanëve të Mesdheut, mbajtur në Tiranë, më 26-27 Qershor 2014

I nderuar Z. Totozani,

Të nderuar pjesëmarrës,

Dëshiroj para së gjithash t'Ju falënderoj për ftesën tuaj për këtë takim të tetë të Shoqatës së Avokatëve të Popullit të Mesdheut dhe t'Ju uroj suksese në punimet e kësaj Konference, që e konsideroj shumë të rëndësishme për zhvillimin e kulturës së mbrojtjes së plotë të të drejtave të njeriut në viset tona mesdhetare dhe të dobishme edhe për institucionin që unë drejtoj.

Mendoj se partneriteti midisi dy institucioneve të pavarura kushtetuese, si ai i Avokatit të Popullit dhe i Kontrollit të Lartë të Shtetit, lind natyrshëm, mbi bazën e misionit kushtetues që këto institucione publike kanë. Me Kushtetute dhe ligj integral të veçantë, Avokati i Popullit mbron zbatimin e të drejtave të njeriut në aktivitetin publik të institucioneve shtetërore, ndërsa KLSH mbron interesat e taksapaguesve shqiptare në përdorimin e fondeve publike nga institucionet publike, duke u siguruar që ky përdorim fondesh të jetë ligjor, i rregullt dhe të përdoret me ekonomicitet, efektiv dhe efiçient. Institucioni i Avokatit të Popullit dhe ai i Kontrollit të Lartë të Shtetit janë dy institucione të cilat ekzistojnë dhe parashikohen në kushtetutën e çdo vendi demokratik në botë. Arma kryesore që çdo kushtetutë u ka dhënë institucioneve tona është pavarësia e tyre institucionale.

Me lejoni të theksoj se sot veprimtaria e Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI-ve, ku bën pjesë dhe KLSH) po shtrihet gjithnjë e më tepër në fusha të reja dhe në terrene të paeksploruara më parë.

SAI duhet t'i kushtojë rëndësi të veçantë grupeve më vulnerabël të popullsisë, duke vënë theksin në temat e auditimit me natyrë social-ekonomike, në përfitim dhe në të mirë të anëtarëve më të dobët të shoqërisë. Në kohët e demokracisë moderne, Institucionet Supreme të Auditimit duhet të ndjehen përgjegjës edhe për mbrojtjen e demokracisë dhe të drejtave të njeriut. Në këtë kuadër, SAI duhet të promovojë dinjitetin njerëzor, liritë dhe të drejtat e njeriut, në përputhje me konventat ndërkombëtare ku janë përcaktuar ato. Ky nuk është vetëm një veprim që synon të realizojë një ideal të caktuar, por është një kauzë që synon të mbështesë të drejtat që burojnë nga Kushtetuta dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, të cilat mbartin me vete një sërë detyrimesh

ligjore. Ky është një realitet normativ dhe ka ndikimin e tij në mënyrën se si autoritetet shtetërore duhet të ushtrojnë veprimtarinë e tyre.

Për këto arsye, veprimtaria e një Institucioni Suprem Auditimi, pra dhe e KLSH, duhet të përfshijë ne vijimësi çështjet që lidhen me të drejtat e njeriut. Përgjatë rrugës së kryerjes së një auditimi, është e nevojshme të kryhet një ekzaminim i aktivitetit të pushtetit ekzekutiv nëpërmjet lenteve të të drejtave të njeriut, pasi ato sigurohen nga Kushtetuta e vendit dhe Konventat Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut. Ky ekzaminim duhet të plotësojë, por jo të zëvendësojë, auditimet e zakonshme mbi rregullshmërinë, ligjshmërinë dhe performancen e veprimtarisë shtetërore, dhe mendoj që duhet të zhvillohet në konsulencë pse jo edhe nën udhëheqjen e Avokatit të popullit

Ne si SAI kemi disa avantazhe unike përsa i takon ekzaminimit të programeve qeveritare që përfshijnë zbatimin e të drejtave të njeriut:

•Një Institucion Suprem Auditimi kryen një planifikim paraprak të planit të auditimit dhe është vetë ai që vendos mbi synimet dhe objektivat e auditimeve që do të zhvillohen;

•Në këtë kontekst, ne ndryshojmë nga pushteti gjyqësor, i cili është zakonisht pasiv dhe ndërmerr veprime, vetëm kur para tij paraqitet një apelim mbi çështje të caktuara;

•KLSH ka mundësinë dhe aftësinë për të patur një pamje më të qartë dhe të plotë në lidhje me përmbushjen e objektivave të Ekzekutivit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, siç mund të paraqitet për shembull në programet e rritjes së mirëqenies së popullsisë apo grupeve vulnerabël;

•Ne si SAI mund të përcaktojmë "*a priori*" se cilat fusha kanë nevojë për një vëmendje më të kujdesshme dhe më urgjente se të tjerat.

•Në të njëjtën kohë, mund të ndërmarrim shqyrtime afat-gjata, sistematike dhe te zgjeruara të institucione që auditojmë;

•Për më tepër, si SAI kemi mundësinë të ndërmarrim një proces të gjatë dhe gjithëpërfshirës, për sa i takon ecurisë së rekomandimeve të auditimeve tona.

Kjo mundësi është veçanërisht e rëndësishme kur bëhet fjalë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, pasi proceset ku përfshihet realizimi i të drejtave të njeriut nëpërmjet programeve qeveritare, sidomos atyre me natyrë social-ekonomike, kërkojnë një kohë të gjatë për t'u realizuar dhe shtrojnë domosdoshmërinë për reforma të gjera. Në përgjithësi, aspektet normative të të drejtave të njeriut, tek ne, si ne të gjithë botën, mbrohen nga autoritetet qeveritare. Eksperienca e jona dhe e përbotshme e

organizatave INTOSAI dhe EUROSAI, lidhur me auditimet ku është përfshirë dhe zbatimi i të drejtave të njeriut, studimi dhe ndjekja me vëmendje e punës së palodhur të institucionit të Avokatit të popullit ka treguar se ekzistojnë boshllëqe dhe mospërputhje midis normave qeveritare ose shtetërore të vendosura dhe zbatimit të tyre në realitetin e përditshëm. E gjithë shoqëria dhe në veçanti ne si KLSH, duhet të japim ndihmesën tonë në mbushjen e këtyre boshllëqeve dhe në reduktimin e diferencave që ekzistojnë ndërmjet asaj se çfarë është e shkruar në letër në programin qeveritar dhe asaj që rezulton të zbatohet realisht.

Fushat e përgjithshme që lidhen me të drejtat e njeriut, në të cilat mund të përfshihet KLSH si një Institucion Suprem Auditimi, gjithnjë në konsultim të plotë me

Institucionin e Avokatit të Popullit janë të shumta. Ato kanë të bëjnë kryesisht me:
•E drejta për dinjitet njerëzor;
•E drejta e pronës;
•E drejta për barazi gjinore;
•E drejta e privatësisë;
•Të drejtat e barabarta për punësim;
•Të drejtat e fëmijëve;
•Të drejtat bazë jetësore;
•Të drejta të tjera civile;
•Të drejta të tjera me karakter social-ekonomik.

Zbatimi i të drejtave të njeriut duhet të interpretohet, duke përdorur qasje të orientuara drejt një qëllimi apo objektivi të caktuar. Kjo metodë interpretuese e të drejtave të njeriut, synon të lidhë tekstin përkatës ligjor të shkruar me objektivat sociale të nënkuptuara në të. Ky interpretim duhet të jetë pragmatist dhe duhet të reflektojë pikëpamjet, synimet apo objektivat afat-gjata të shoqërisë. Në këtë interpretim, mund të kryhet krahasimi midis legjislacionit vendas shqiptar dhe atij ndërkombëtar, për të shqyrtuar nëse ato shkojnë në të njëjtën linjë, ose jo. Kjo mund të kryhet, p.sh., nëpërmjet një auditimi performance të përbashkët të KLSH dhe Institucionit të Avokatit të Popullit lidhur me praninë e mjaftueshme dhe zbatueshmërinë e drejtave të njeriut në legjislacionin aktual të vendit.

KLSH si Institucion Suprem i Auditimit, në cilësinë e strukturës mbikëqyrëse dhe audituese, duhet të japë sigurinë se të drejtat kushtetuese të njeriut respektohen ashtu siç duhet. Në këtë aspekt, Ne si SAI kemi një tjetër avantazh: atë të dhënies së rekomandimeve për përmirësime ligjore për Parlamentin, në rast se konstatojmë mospërputhje të Kushtetutës apo legjislacionit dytësor, me normat ndërkombëtare ligjore në fushën e të drejtave të njeriut.
Shkeljet e të drejtave kushtetuese të njeriut mund të jenë të shumta. Shteti duhet të

ndërtoj një sistem që siguron se të drejtat e njeriut mbrohen nga shkelja e tyre prej autoriteteve shtetërore. Në këtë drejtim, ne si SAI mund të na vijë në ndihmë funksioni që kryejmë në shqyrtimin nëse veprimet e subjekteve të audituara janë kryer në përputhje me kuadrin rregullator përkatës. Ky funksion i yni na jep mundësinë të vlerësojmë nëse të drejtat e njeriut mbrohen ashtu siç duhet. Si SAI mund të shqyrtojmë veprimtarinë e subjekteve të audituara, nën dritën e kufizimeve të mundshme, për sa i takon të drejtave të njeriut. Këto kufizime mund të jenë pjesë e të drejtave "civile" kushtetuese, si e drejta e fjalës së lirë dhe e barazisë, ose e të drejtave "sociale" kushtetuese, si e drejta e pronësisë, e drejta për të pasur edukim dhe shërbim shëndetësor, etj...

Një nga politikat tona si SAI në të ardhmen do të jetë që në konsultim me Avokatin e Popullit të përfshijmë elementë që lidhen me të drejtat e njeriut në sa më shumë auditime që të jetë e mundur.

Konkretisht, mund të auditojmë zbatimin e së drejtës së barazisë gjinore - përfaqësimit të femrave në pozicione drejtuese në sektorin publik. Përpjekjet për barazi gjinore janë në qendër të lëvizjeve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut kudo në botë. Kuadri rregullativ i hartuar nga Qeveria për të parandaluar diskriminimet gjinore është shumë i gjerë, por pak i zbatueshëm në praktikë. Ekzistojnë shumë pengesa, disa prej të cilave të padukshme, që pengojnë implementimin e plotë të konceptit të barazisë gjinore, sidomos në vendet e punës së administratës publike. Barriera të padukshme nxisin një sjellje të tillë paragjykuese dhe pengojnë femrat, të cilat zotërojnë kualifikimet e nevojshme, të arrijnë pozicione drejtuese. Megjithëse më shumë se gjysma e punonjësve të shërbimit civil janë femra, vetëm një numër shumë i vogël prej tyre mbajnë pozicione të larta drejtuese apo menaxhuese brenda administratës shtetërore.

Mund dhe duhet të auditojmë zbatimin e së drejtës për dinjitet njerëzor në Programet dhe aktivitetet qeveritare që promovojnë sigurinë ushqimore. Të drejtat e njeriut nuk janë konceptuar vetëm për ata që kanë një mirëqenie të caktuar, por edhe për shtresën më të varfër, e cila duhet të gëzojë të njëjtin dinjitet njerëzor. Ky auditim do të adresojë një nga të drejtat bazë më elementare të ekzistencës dhe do të synojë të mbrojë të drejtat e pjesës më vulnerabël të shoqërisë. Edhe pse tek ne ekziston një kuadër rregullativ në këtë fushë (Ligji mbi Ushqimin), duhet parë sa efektive është politika qeveritare për Sigurinë Ushqimore. Siguria ushqimore duhet të promovohet dhe forcohet më tej, jo vetëm për familjet në nevojë të cilat nuk kanë mundësi të blejnë produktet e shtrenjta cilësore, por edhe për shoqërinë në tërësi, pasi çdo njeri ka të drejtën të ketë një mirëqenie të caktuar, brenda kufijve të pranueshëm.

Si përfundim, do të shprehesha se si Avokati i Popullit, ashtu dhe ne si KLSH, kemi shume pika të përbashkëta dhe kemi nevojën të bashkërendojmë veprimet tona, duke parë një potencial evident bashkëpunimi. Duke vlerësuar dhe respektuar punën dhe veprimtarinë konkrete të Avokatit të Popullit të Shqipërisë, ndoshta do të ishte më mirë që ky potencial të institucionalizohej këtej e tutje, në formën e një Marrëveshjeje afatgjatë Bashkëpunimi mes të dy institucioneve tona.

Ju faleminderit!

SEMINAR I DEPARTAMENTIT TË AUDITIMIT TË PERFORMANCËS[116]

Ky seminar u zhvillua më datën 20.04.2015 në bashkëpunim me Universitetin "Aleksandër Xhuvani" Elbasan me pjesëmarrës deputetët e këtij qarku zj. Evis Kushi dhe z. Aqif Rakipi, rektori i Universitetit Prof. Dr. Liman Varoshi, drejtues dhe auditues të departamenteve të KLSH-së, pedagogë dhe studentë të këtij universiteti, ekspertë të jashtëm të KLSH-së të angazhuar në auditimet e performances, media dhe të ftuar të tjerë.

Ky seminar pune që zhvillohet sot në këtë universitet tempull të dijes do të na shërbejë ne, si Institucion Suprem Auditimi për të fokusuar punën tonë në këto lloj auditimesh. Bota demokratike, Europa në të cilën ne dëshirojmë të shkojmë, këto lloj auditimesh ka mbi 25 vjet që i zhvillon dhe janë këto auditime që i japin Institucioneve Supreme të Auditimit një fytyrë tjetër, fytyrën qytetare, fytyrën kërkimore shkencore të rekomandimit, atë pamje pra, që duan institucionet shqiptare dhe që përpiqen të gjithë të arrijnë.

Qasja ndaj konceptit të auditimit të performancës mund të sintetizohet më mirë në atë përkufizim që kanë bërë standardet ndërkombëtare të auditimit dhe konkretisht ISSAI 3000 dhe 3100: "*Auditimi i performancës është një shqyrtim i pavarur i efiçiencës dhe efektivitetit të sipërmarrjes qeveritare, programeve dhe organizmave të saj me fokus të veçantë ekonomicitetin dhe me synim përmirësimin".* Ky është në fakt edhe përkufizimi që Ligji i ri "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit" e ka sanksionuar në nenin 13 të tij, ligj i cili u miratua pas dy vite punë dhe përpjekje nga ana e institucionit tonë.

Auditimi i performancës mbështetet mbi vendimet e marra ose objektivat e përcaktuara nga legjislacioni dhe mund të kryhet për të gjithë spektrin e sektorit publik. Ai dallon nga auditimet standarde dhe ato të ligjshmërisë sepse është më fleksibël në përzgjedhjen e subjekteve, objekteve, metodave dhe dhënien e opinionit. Nga vetë natyra e tij, ky lloj auditimi ndërthur metoda investigative me ato shkencore të kërkimit dhe të përpunimit të informacionit, operon mbi baza të larmishme dijesh dhe eksperiencash, është më i hapur ndaj gjykimeve dhe interpretimeve dhe nuk kryhet sipas një protokolli standard

[116] *Në tetor 2013, me rastin e njëvjetorit të krijimit te Departamentit të Performances në KLSH, në mjediset e Pallatit të Kongreseve Tiranë u zhvillua Seminari i Parë Kombëtar i Departamentit të Performances, ku merrnin pjesë përfaqësues nga shoqatat profesionale të fushës, nga shoqëria civile dhe mediat.*

paraprak. Është kusht vital për këtë lloj auditimi që të aplikohen perspektiva të ndryshme, e për rrjedhojë edhe audituesit duhet të vijnë nga sfera të ndryshme të aktivitetit njerëzor.

Auditimi i performancës është një nga mënyrat kryesore nëpërmjet të cilit taksapaguesit, financierët, vendimmarrësit, ekzekutuesit, media dhe shoqëria në përgjithësi ushtrojnë kontroll dhe nxjerrin përfundime mbi mënyrën sesi kryhen punët dhe si arrihen rezultatet. Kriteret e këtij lloj auditimi janë të shumta dhe mund të përmendim vlerën e shtuar, zinxhirët kompleksë të politikave, praninë e risqeve, ndërhyrjes strukturore, emergjenca sociale, materialiteti financiar, vizibiliteti i programit, mundësia për auditime të tjera, etj.

Auditimi i performancës, ashtu si edhe llojet e tjera të audtimit nuk ka si synim të kritikojë sipërmarrjet qeveritare apo as të ndërhyjë në politikat qeveritare. Duke evidentuar shkaqet, proceset, funksionet, kapitalin njerëzor dhe financiar të përfshirë në kryerjen e punëve qeveritare, ky lloj auditimi synon korrektimet e duhura, aplikimin e teknikave më të fundit shkencore, përmirësimin e 3E-ve të famshme dhe tek e fundit rritjen e mirëqenies sociale përmes aktivitetit ekonomik publik. Auditimi i performancës në vetvete është një formë modernizimi si për atë që auditohet ashtu edhe për atë që auditon.

Por cilat janë shtyllat kryesore mbi të cilat mbështetet auditimi i performancës? Të gjitha programet dhe sipërmarrjet qeveritare dhe pjesa më e madhe e proceseve që ato gjenerojnë munden të paktën teorikisht të analizohen nën lupën e një formule që përshkruan sesi ato lëvizin nga një pozicion në tjetrin, duke shfrytëzuar burime të ndryshme me qëllim arritjen e objektivave të caktuara. Në auditimin e performancës formula që synon mbarëvajtjen e punëve mbështetet mbi dy shtylla kryesore që realizohen duke iu dhënë përgjigje dy pyetjeve: a po bëhen gjërat siç duhen? Dhe e dyta, a po bëhen gjerat që duhen?

Pyetja e parë, a po bëhen gjërat siç duhen, kryesisht fokuson ofertuesin e shërbimit dhe adreson problemin, nëse vendimet e ndërmarra zbatohen siç duhet. Kjo pyetje zakonisht shoqërohet me perspektivë normative, që do të thotë audituesi kërkon të dijë nëse zbatuesi i procesit i është përmbajtur rregullave dhe kërkesave. Me qëllim zgjerimin e analizës, pyetja mund të shtrihet edhe mbi aktin nëse aktivitetet e realizuara janë ato të duhura, duke marrë të mirëqenë që proceset e përzgjedhura janë të mira. Deri në këtë fazë të procesit, auditimi i performancës, fokusohet kryesisht mbi ekonomicitetin dhe efiçiencën e operacioneve në aspektin mikro. Përgjigja e kësaj pyetje është klasike në këtë auditim, në atë që ne auditojmë në zbatimin e politikave po nuk hartojmë politika.

Ndërsa pyetja e dytë, a po bëhen gjërat që duhen, i referohet efektivitetin ose ndikimit në shoqëri. Në fakt, pyetja mund edhe të nënkuptojë se një sipërmarrje qeveritare ose një masë e përzgjedhur për të arritur një objektiv specifik, po i ekspozohet riskut që të kontestohet nga audituesi. Një audituesi performance, p.sh. mund të zbulojë një masë që është infektive dhe jo në përputhje me objektivat, por në momentin që audituesi fillon të dyshojë nëse vetë përkushtimi publik është ose jo i arritshëm, ai ose ajo duhet të tregojë kujdes për të mos tejkaluar kornizat e punës së vet duke shkelur kufirin dhe duke u futur në territorin politik. Ky është një risk, ndaj të cilit, për të qenë të sinqertë, ne si Institucion Suprem Auditimi, rrezikohemi në punën tonë dhe përpiqemi të jemi të kujdesshëm në çdo moment.

Nga sa më sipër, mund të konkludojmë se ekzistojnë dy qasje madhore që ky auditim mund të aplikojë mbi administratën publike, një qasje menaxheriale, dhe një qasje më e plotë, qasje integrale. E para fokusohet kryesisht mbi ekonomicitetin dhe efiçiencën, pra mbi punën menaxheriale dhe jo funksionin politik-bërës. Praktikuese e kësaj qasjeje është Zyra e Auditorit të Britanisë së Madhe. Qasje tjetër fokusohet edhe mbi efektivitetin dhe për pasojë auditon edhe pjesën e vendosjes së objektivave dhe formulimit të planeve, politikave, për ti realizuar ato. Një qasje e tillë gjendet në Institucionet Supreme të Auditimit të Holandës dhe Suedisë.

Pavarësisht llojit të qasjes së aplikuar, auditimi i performancës është një proces i mirëfilltë kërkimi e studimi. Synimi parësor është lëvrimi i transparencës për aktivitetin ekonomik/ publik dhe ky synim mund të arrihet vetëm me metodologji të saktë për të arritur tek e vërteta. Ashtu sikurse kërkohet nga subjektet e audituara të performojnë në punën e tyre, edhe auditimi i performancës duhet të jetë një proces i strukturuar optimalisht për të arritur objektivin e tij.

Një auditim performance që nuk mbështetet mbi vlerësimin e nevojave të publikut, nuk specifikon qartë objektivat e tij për ti shërbyer këtyre nevojave, nuk përzgjedh inputet e duhura, nuk përdor metodat e përshtatshme audituese dhe vlerësimit të riskut, sigurisht që nuk do të gjenerojë transparencë, madje më keq akoma, do ta deformojë atë.

Performanca e vetë auditimit të performancës është po aq e rëndësishme sa dhe vetë koncepti i auditimit të performancës. Performanca e auditimeve të performancës në KLSH: Unë përmenda dy shembuj nga Institucione Supreme Auditimi të Britanisë së Madhe dhe të Holandës, për arsye se vite më parë, në vitin 2004-2005, institucioni ynë ka patur proces binjakëzimi dhe në vitet 2007- 2008 janë bërë përpjekjet nga projekti i fituar nga KLSH në 2004, për të implementuar këtë lloj auditimi dhe në rast se ne do të vazhdonim me ritmet që nisi apo eci projekti, natyrisht që ne sot do flisnim shumë më

ndryshe dhe pjesa dërmuese e opinionit publik do të ishte familjarizuar me konceptin e auditimit të performancës. Por, për fat të keq kjo nuk ndodhi në vitet 2009-2010-2011.

Dhe çfarë rëndësie ka kjo? Kjo ka rëndësi që ne e përmendim për të reflektuar, ne e përmendim si fakt që ne si institucion suprem auditimi të mos shkëputemi asnjëherë nga auditimi i performancës dhe në rast se ne themi që sfida jonë madhore është modernizimi i institucionit, ky modernizim nuk arrihet në rast se ne nuk vendosim zhvillimin e auditimit të performancës, numrin e auditimeve të performancës, cilësinë e tyre në fokusin tonë kryesor.

Në këtë periudhë, 2012-2013-2014, ne jemi përpjekur dhe kemi realizuar disa auditime performance të cilat janë përqendruar në këto fusha: reformat qeveritare, projektet, shërbimet sociale ekonomike, projektet infrastrukturore, projektet mjedisore energjetike, si dhe projektet social-kulturore. Ecuria e auditimeve të performancës, natyrisht ka ardhur në rritje, si në terma të cilësisë, ashtu edhe të sasisë. Po kështu, Departamenti i Auditimit të Performancës ka njohur arritje të tjera e konkretisht: Arritja kryesore është që koncepti i auditimit të performancës u fut në ligjin organik të Kontrollit të Lartë të Shtetit datuar në 27 nëntor 2014. Deri në këtë vit, në i zhvillonim projektet pilote, auditimet në mirëkuptim edhe me subjektet e audituara.

Mandati ligjor, tashmë konsolidon vizionin për një KLSH moderne të barabartë me institucionet supreme të auditimit më të zhvilluara në rajon dhe në Europë. Departamenti i Auditimit të Performancës gjeneroi Manualin e Auditimit të Performancës mbështetur në eksperiencat më të mira në këtë fushë. U plotësua aspekti teknik i vlerësimit të performancës, me përshtatjen e indikatorëve të performancës sipas eksperiencës së NAO-s Britanike. Trajnimet intensive të audituesve të performancës, ashtu si të grihë audituesve të KLSH-së, kanë vijuar brenda dhe jashtë vendit.

Megjithatë, problematika të ndryshme vazhdojnë të ndeshen dhe ne kemi të paktën mbi një vit e gjysmë që kemi orientuar punën tonë, veprimtarinë tonë, apo edhe shfaqjet tona publike mbështetur mbi IntoSAINT, mbi metodën e vetëvlerësimit. Dhe në këtë drejtim, gjithnjë e më tepër, ne do të shikojmë veten me sy kritik. Vetëm duke e parë veten, departamentet e institucionit me sy kritik, ne mund të përmirësohemi më tepër në të ardhmen. Në këtë drejtim, unë në cilësinë e Kryetarit, kam konstatuar disa problematika që ekzistojnë në Departamentin e Auditimit të Performancës. Kështu:

- Auditimet ende nuk specifikojnë qartë se cilës "E", ekonomicitet, efiçiencë dhe efektivitet i adresohen, si në nivel programi ashtu edhe në nivel projekt-raporti e raporti;
- Audituesit nuk i përdorin me efektivitet të gjitha njohuritë që marrin nga trajnimet e ndryshme brenda e jashtë vendit;

- Metodologjia e përdorur është intuitive, e vakët, përgjithësisht ka një mungesë dëshirë për t'u përmirësuar në këtë drejtim, për të ecur me ritmin që ne kërkojmë si drejtues, edhe unë në veçanti dhe Drejtori i Departamentit;
- Programet e auditimit nuk bëjnë një analizë të mirëfilltë të risqeve dhe nuk e strukturojnë auditimin sipas një analize, p.sh. SWOT, për të identifikuar dobësitë, fuqitë, mundësitë e ndryshme në auditim;
- Gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet nuk janë rrjedhojë e njëra-tjetrës, dhe janë të padetajuara në linja veprimi apo rrugë përmirësimi;
- Formulimi gjuhësor dhe strukturor vazhdon të mbetet jo i kënaqshëm, defekt i gjithë administratës sonë;
- Impakti në palët e interesit duhet të jetë më i fortë dhe më i vazhdueshëm. Ky është edhe një nga qëllimet kryesore, krahas atij të parit për bashkëpunimet që ne kemi me ambientet akademike, i zhvillimit të këtij seminari në këtë universitet të nderuar.
- Menaxhimi i kohës së punës dhe i detyrave sipas fazave përkatëse audituese, është larg optimales;
- Përgjithësisht ekziston një keqperceptim midis audituesve të performancës, se auditimi i performancës është vetëm për këshilla dhe sugjerime. Natyrisht kjo është ideja dhe qëllimi kryesor i këtij auditimi, por nuk do të thotë që në këtë auditim nuk duhet të japim dhe rekomandime apo të nxjerrim përgjegjës për keqmenaxhim fondesh apo për mospërdorim të mirë strukturash, kohë etj.

Do të përmend rekomandimet, mesazhet e disa prej auditimeve kryesore që ne kemi zhvilluar përgjatë viteve 2013-2014, kam përzgjedhur disa auditime *të rëndësishme:*

Censusi 2011

Mesazhi i auditimit: "*Pavarësisht punës së mirë në realizimin e objektivave kryesorë dhe vështirësive të hasura, nisur nga kompleksiteti i procesit të Census 2011, regjistrimi i popullsisë dhe i banesave nuk ka mbuluar të gjithë zonën e regjistrimit të Republikës së Shqipërisë si dhe nuk ka qenë i orientuar në përqasjen e kosto-efektivitet".*

Shërbimi ushqimor spitalor

Mesazhi i auditimit: "*Ofrimi i shërbimit të ushqimit në spitalet e qytetit të Tiranës, lë për të dëshiruar në drejtim të planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të tij".*

Ndarja administrative territoriale në Republikën e Shqipërisë

Mesazhi i auditimit: "*Ndarja aktuale administrative territoriale ka sjellë ngadalësim në zhvillimin vendor dhe varësinë e njësive vendore ndaj të ardhurave të buxhetit të shtetit. Shqipërisë i nevojiten një ndarje e re administrative territoriale, duke u bazuar në kritere të qarta me synim rritjen e efiçiencës*

dhe efektivitetit të njësive qendrore e vendore në realizimin e objektivave për rritjen e shërbimeve në mënyrë sa më cilësore për komunitetin". Kjo ndarje u bë pasi përkonte edhe me politikat e mazhorancës dhe të opozitës, pavarësisht mosdakortësisë për disa probleme që nuk janë në sferën tonë.

Shërbimi parashkollor

Mesazhi i auditimit: "*Edhe pse është bërë shumë në drejtim të hartimit të standardeve sasiore dhe cilësore përkujdesja ndaj fëmijëve të kopshteve dhe çerdheve nuk është e mjaftueshme".*

Menaxhimi i pajisjeve mjekësore në QSUT "Nënë Tereza"

Mesazhi i auditimit: "*QSUT nuk mban dokumentacion të plotë dhe të saktë për pajisjet në zotërim, nuk bën një planifikim të kujdesshëm për blerjen dhe vënien në funksionim të pajisjeve të reja që kapin vlera monetare shumë të mëdha".*

Performanca e Radio Televizionit Shqiptar, Projekti i Dixhitalizimit të TVSH-së

Mesazhi i auditimit: "*Parimisht RTSH është në gjendje të garantojë mbarëvajtjen e kalimit në transmetimet dixhitale, por konkretisht suksesi i kësaj ndërmarrjeje varet nga kryerja e një reforme thelbësore në pothuajse të gjitha aspektet organizative të saj".*

Siguria Rrugore

Ky është një auditim, në të cilin kemi pasur në konsideratë ISSAI 5200 dhe e kemi realizuar në bashkëpunim me Zyrën e Audituesit të Përgjithshëm të Kosovës dhe Zyrën e Audituesit të Përgjithshëm të Suedisë. Mesazhi i auditimit: "*Edhe pse është bërë shumë në drejtim të politikave dhe legjislacionit, ato duhet të adresohen kryesisht në hartimin e standardeve, në dhënien e lejeve të drejtimit ku ka vend për përmirësime të mëtejshme për faktin se siguria rrugore, përsëri mbetet një shqetësim serioz".*

Infrastruktura e Shërbimit Bibliotekar Kombëtar

Mesazhi i auditimit: "*Biblioteka Kombëtare dhe Shërbimi Bibliotekar në bashkëpunim me Qeverinë Shqiptare dhe pushtetin vendor të krijojnë një qasje të re në vlerësimin e librit dhe shërbimit qytetar, me synim ruajtjen e kulturës kombëtare dhe rritjen e vetë edukimit të tij".* Në këtë auditim, veç sa më sipër, kemi dhënë edhe disa rekomandime të tjera një nga të cilët është: *"Të gjitha ambientet e Pallatit të Kulturës duhet t'i kthehen Bibliotekës Kombëtare*".

Performanca e KESH, Liberalizimi i tregut të energjisë elektrike

Mesazhi i auditimit: "*Ngarkimi me funksionin e prodhuesit publik të energjisë, garantimi i blerjes së energjisë së prodhuar nga HEC-et e dhëna me koncesion si dhe ndërtimi i marrëdhënieve kontraktuale me çmime të rregulluara, të diktuara ose nga ERE ose nga Qeveria në marrëveshjet koncensionare, sigurimi i importit, i blerjes së energjisë elektrike për llogari të CEZ Shpërndarje,*

aktualisht OSHEE, jo vetëm që e kanë denatyruar funksionin themelor të një shoqërie publike, sigurimin e fitimit dhe rritjen e efektivitetit, por e kanë zhytur atë në detyrime financiare ndaj klientëve, duke e bërë domosdoshmëri ndryshimin e mënyrës së funksionimit, administrimit nëpërmjet ndarjes së përgjegjësive, prodhimin nga blerja, importin, ose blerja nga HEC-et e dhëna me koncesion, si dhe hapjen e tregut të energjisë elektrike të cilat do të reflektohen në cilësinë dhe koston e energjisë elektrike të konsumatorëve'.

Të tjera auditime të performancës do të prezantohen nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit, përgjithësisht nga audituesit e Departamentit të Auditimit të Performancës.

Unë ju falënderoj për vëmendjen me të cilën dëgjuat fjalën time.

KONFERENCA YOUNG KLSH "UNË, KLSH DHE EUROSAI"

Kjo Konferencë, si pjesë e Analizës Vjetore 2015, u zhvillua në një nga sallat e Universiteti Politeknik të Tiranës më datën 02.02.2016, dhe u është dedikuar audituesve të rinj, të cilët nën moton e konferencës së I-rë dhe të II-të, të Young EUROSAI me temë qendrore "SAI&Unë" zhvilluan konferencën:

Kontributi, Inovacioni nën moton: "Unë, KLSH dhe EUROSAI ".

Të dashur kolegë audituesë të rinj!

Më 26 qershor 2015, në fjalën e tij përpara trupës së programit Master në Auditimin Publik për audituesit e rinj të Gjykatës Austriake të Auditimit (ACA), dr. Josef Moser, Sekretar i përgjithshëm i INTOSAI-t dhe President i ACA theksoi: '*Në sajë të audituesve tanë jemi aty ku kemi arritur sot: punonjësit tanë janë aseti ynë më i madh. Ekspertiza dhe angazhimi i tyre përbëjnë bazat e performancës së një SAI. Për këtë arsye, një nga prioritetet tona kryesore në procesin e përzgjedhjes së audituesve të rinj është për të siguruar që ata të kenë kualifikimet e nevojshme. Megjithatë, si rezultat i globalizimit dhe përparimeve në shkencë dhe biznes, audituesit ballafaqohen vazhdimisht me sfida të reja dhe çështje pak të njohura lidhur me metodat, standardet dhe procedurat e auditimit. Në këtë sfond, është me rëndësi jetike për ti pajisur audituesit e rinj me trajnime sistematike dhe për të shkëmbyer njohuri dhe eksperienca me audituesit më me përvojë dhe me ekspertë të institucioneve të tjera'.*[117]

Si KLSH investimin për rritjen e kapaciteteve profesionale të stafit tonë, sidomos të atij më të ri, e kemi mbajtur gjithnjë parasysh. Në platformën për Zhvillimin Strategjik të Institucionit, të datës 14 dhjetor 2011, paraqitur përpara Komisionit për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit, kam theksuar se institucioni është përballë sfidës së: '***përmirësimit të metodologjisë së auditimit, duke kthyer vëmendjen tek auditimit i performancës, krahas rritjes së efiçiencës së auditimit financiar'***.

Sfidat që po hasim sot, ashtu sikurse e cilëson Dr. Moser, nuk mund t'i përballojmë pa siguruar vijimësinë e kapaciteteve profesionale nga audituesit më të vjetër tek ata më të rinj, duke u përshtatur me të rejat e fundit të globalizimit, teknologjisë së informacionit dhe botës së internetit.

[117] Dr. Josef Moser, fjala përpara studentëve të Programit Master në Auditimin Publik, në Vjenë, 29 qershor 2015, https://executiveacademy.at/de/news/detail/auditors-need-to-be-better-trained-than-auditees/

Duke ndjekur orientimin strategjik të EUOSAI-t për ndërtimin e kapaciteteve audituese, KLSH, me një program shumë ambicioz trajnimesh brenda dhe jashtë vendit, arriti që në këto katër vite të rrisë me dhjetë herë numrin e ditëve të trajnimit në vit për audituesi, nga 2.1 ditë në vitin 2011, në mesatarisht 22 ditë në vit, për katër vitet 2012-2015, ky i fundit i ngjashëm me atë të SAI-ve të zhvilluara.

Kemi rritur treguesit e ndërtimit të kapaciteteve tona audituese, por kemi ende shumë për të bërë që dijet dhe ekspertiza e audituesve më të vjetër të kalojnë tek ata më të rinj. Ju ftoj dhe ju, kolegë audituesi të rinj, të bashkëpunoni më shumë me kolegët tuaj më me përvojë dhe me stazh të gjatë pune në KLSH, të mos ngurroni t'u bëni pyetje të vazhdueshme dhe të kërkoni të ndani kohën e punës me ta. Askush nuk mund t'i dijë të gjitha dhe më shumë, vetëm pse përdor laptopin apo është gjithnjë i lidhur në internet me celularin e tij. Njohja e vërtetë kërkon dije të zhvilluara në praktikën e përditshme audituese.

Gjykoj se ju janë ofruar të gjitha mundësitë që të përfitoni sa më shumë prej audituesve më të vjetër dhe më me eksperiencë. Mos i humbisni këto mundësi. Pse të jeni ju të parët që do të ngelni mbrapa me kohën, me gjithë moshën e re!

Në zbatim të orientimit të dytë strategjik të EUROSAI-t për promovimin dhe lehtësimin e zbatimit të Standardeve Profesionale ISSAI, ndërsa trashëgonim një mjedis auditimi ku deri në fund të vitit 2011 për standardet profesionale ISSAI flitej shumë pak dhe njiheshin e përmendeshin nga audituesi që në KLSH mund të numëroheshin me gishtat e njërës dorë, të katër nivelet e standardeve ISSAI, duke siguruar një njohje të gjerë të tyre nga audituesit, si ata me përvojë, ashtu edhe ata të rinj. Sikurse e dini, rregulli në KLSH është që çdo audituesi i ri bën 25 ditë në vit trajnim, ku kryesisht njihet me standardet ISSAI dhe mënyrën e zbatimit të tyre në praktikën audituese.

Këto standard kërkojnë me insistim shkëmbimin e njohurive. Që nga Konferenca e para 'Young EUROSAI', mbajtur në Roterdam të Holandës, në nëntor të vitit 2013 dhe deri në atë të dytë në Izrael, në nëntor 2015, rrjeti i audituesve të rinj në lëvizjen 'Young EUROSAI' ka ecur bindshëm. Audituesit e rinj në të gjithë Europën kanë filluar një praktikë të vazhdueshme të shkëmbimit të ndërsjelltë të njohurive dhe informacionit. Në këtë traditë, ne si KLSH në punën e audituesve të rinj duhet të përqendrohemi në ngritjen e kapaciteteve audituese. Kjo është sfida juaj parësore, sa personale aq edhe e institucionit. Çdo audituesi i lartë, kryeaudituesi dhe drejtor në KLSH ka nën monitorim një audituesi të ri, për një periudhë të caktuar. Një organizim i tillë pune ju ndihmon ju audituesit e rinj të integroheni më shpejt, të ulni riskun e gabimeve, duke nxitur frymën e bashkëpunimit dhe krijimin e një klime profesionale dhe dashamirëse pune. Si

instiucion do të bëjmë maksimumin për t'ju siguruar akses të plotë në informacion dhe mundësi ngritje në karrierën tuaj, por gjithçka varet nga angazhimi juaj në punën e përditshme, nga librat që lexoni dhe programet Master të kualifikimit që kryeni. Po në zbatim të orientimit të dytë strategjik të EUROSAI-t për Promovimin dhe lehtësimin e zbatimit të Standardeve Profesionale ISSAI, nga kolana e 51 botimeve të KLSH për vitet 2012-2015, veçoj librat 'Standardet e Auditimit INTOSAI', 'Manuali i Auditimit të Performancës', 'Udhëzuesi i Auditimit Financiar (1000-2999)', 'Udhëzues për Auditimin e Përputhshmërisë', 'Raportimi i Auditimit-Guidë', 'Standardet e Auditimit të Borxhit Publik (5410-5440)', 'Standardet INTOSAI për mjedisin', 'Etika në SAI dhe në Institucionet e tjera Publike', 'Manuali i Vetëvlerësimit të Integritetit për Institucionet Supreme të Auditimit (IntoSAINT)', 'ISSAI 5220 dhe Kodi i Transparencës Fiskale', 'Standardet e GAO's', 'Indikatorët e Performancës', 'Manuali i Departamentit të Auditimit të Performancës', 'Manuali i Auditimit të IT'. Të gjitha këto botime jo vetëm ju zgjerojnë dijet dhe njohuritë bazë të profesionit, po ju japin edhe të rejat e fundit në botën e standardeve ISSAI, e cila është gjithnjë në përditësim të vazhdueshëm.

Konstatoj me shqetësim një pjesëmarrje shumë të vakët tuajën në Klubin e Librit të KLSH. Ju për shkak të moshës së re, nevojës për të mësuar gjëra të reja dhe investimit për të ardhmen tuaj, duhet të keni etjen e pashuar për dije, për të lexuar dhe mësuar më shumë. Vetëm duke lexuar më shumë dhe pa pushim, duke përvetësuar standardet profesionale, mund të keni sukses në testimet që zhvillojmë për rivlerësimin e njohurive dhe ngritjen në detyrë, të cilat, sikurse e dini, do të jenë të vazhdueshme.

Duke marrë eksperiencën e vyer të një organizate si INTOSAI, në bazë të motos së INTOSAI-t 'Eksperienca e përbashkët u shërben të gjithëve', por edhe moton e Kongresit të IX-të, të EUROSAI-t 'Ku ishte hera e fundit që kemi bërë diçka për herë të parë?', në zbatim të orientimit të katërt strategjik të EUROSAI-t për Qeverisjen dhe Komunikimin, dua të ndalem në dy risi të KLSH, botimet dhe prezenca në median e shkruar të vendit, të audituesve të tij.

Botimet e KLSH për vitet 2012-2015 vijën në realizim të misionit kushtetues të institucionit për të informuar publikun dhe Kuvendin, si dhe në zbatim të standardeve profesionale ISSAI mbi komunikimin në kohë dhe gjerësisht të SAI-ve nëpërmjet mediave, faqeve të internetit dhe mjeteve të tjera. Mbi të gjitha, ato ndihmojnë forcimin e kapaciteteve tona audituese. Kush mund të më thotë nëse i ka lexuar të gjitha librat e kolanës 'Botime KLSH'? Sa janë ata mes jush, që të paktën librat e standardeve të profesionit të audituesit brenda kësaj kolane, t'i kenë lexuar nga faqja në faqe, duke nënvizuar pjesët më të rëndësishme për dijet e tyre?

Titujt e botimeve të KLSH-së në këto katër vite janë vërtet mbresëlënëse, si për larmishmërinë e temave, ashtu dhe për sasinë e informacionit që përmbajnë si për lexuesit e fushës së auditimit dhe të ekonomisë, ashtu edhe për lexuesin e thjeshtë të interesuar për fushën e auditimit.

Botimet, në kompleksin integral të tyre, përbëjnë një risi për KLSH-në në veçanti, por edhe për institucionet shtetërorë në përgjithësi, duke qenë dëshmi të ecjes drejt modernizimit dhe profesionalizmit për institucionin. Ato variojnë nga libra për historikun e KLSH-së, publikime informuese për raportet vjetore të institucionit dhe marrëdhëniet me Kuvendin, tek botimet shkencore për standardet INTOSAI, për udhëzuesit e auditimeve të ndryshme, si ai financiar, i performancës, i përputhshmërisë, integritetit dhe raportimet për auditimet.

Në kolanën e botimeve të KLSH-së bën pjesë dhe një grup botimesh (katër tituj deri tani) krejt i veçantë, *'Audituesit e KLSH-së në median e shkruar'*, referuar vitit 2013, 2014 dhe gjysmës së parë të vitit 2015. Artikujt, analizat dhe editorialet e audituesve të KLSH-së të botuara në shtypin e shkruar periodik përbëjnë pa dyshim një vlerë të shtuar jo vetëm të publicistikës shqiptare, në këndvështrimin e profesionit të audituesit. Këto botime kontribuojnë jo vetëm në krijimin e një historie dinamike të institucionit me një frymë që i shërben një transparence më të madhe me publikun, por synojnë njëkohësisht dhe rritjen e kompetencës profesionale të nëpunësve të institucionit nëpërmjet vendosjes në një plan tjetër të nëpunësit auditues të këtij institucioni përballë të audituarve. Këto shkrime nuk janë botuar si *qëllim në vetvete* por si mjet për të tërhequr në këtë rrugë dhe nëpunësit e institucioneve të çdo niveli të administratës shtetërore, duke i shërbyer kështu jo vetëm evidentimit të nëpunësve të përgjegjshëm, por edhe kalimit në një fazë tjetër të luftës ndaj korrupsionit, për të kontribuar gjithnjë e më shumë dhe në drejtim të ndryshimit të perceptimit të publikut për nëpunësit, por edhe për institucionet publike në tërësi. Perceptimi i publikut vazhdon të mbetet një problem serioz që kërkon punë dhe vetëm punë intelektuale, të shoqëruar me shpalosje integriteti të vetë nëpunësve të institucioneve, si e vetmja rrugë për të pretenduar rezultatin. Nga KLSH kjo konceptohet si një sfidë që po realizohet dhe preket ditë pas dite. Shembulli është dhënë, tashmë mbetet vetëm për t'u ndjekur. Ju ftoj për një prani më të shpeshtë tuajën në median e shkruar të vendit. Kemi disa shembuj të mirë audituesish të rinj që shkruajnë me kurajo dhe cilësi. Po këta janë ende shumë të paktë. Konsiderojeni si një sfidë tuajën personale brenda sfidës së institucionit, praninë tuaj të shtuar në median shqiptare. Është detyrë e çdo drejtuesi të administratës të çdo rangu qoftë, që të nxisë e inkurajojë nëpunësit që drejton me qëllim që ata ta ndjejnë veten si nëpunës dinjitozë të këtij Shteti që kontribuojnë për modernizimin e tij dhe luftën kundër korrupsionit.

Sfida jonë e përbashkët dhe madhore është modernizimi i mëtejshëm i aktivitetit tonë të auditimit, në mënyrë që praktikat e mira të ofruara nga EUROSAI dhe lëvizja 'Young EUROSAI' të na orientojnë, duke ndihmuar vendin me një auditim sa më profesional, për progres real në rrugën e tij të anëtarësimit në BE, në përputhje të plotë me mandatin tonë kushtetues si KLSH dhe me pritshmëritë e qytetarëve dhe Kuvendit të Shqipërisë.

Ju faleminderit!

KONGRESI I III-të I SHOQATËS SË KONTABILISTËVE DHE FINANCIERËVE TË SHQIPERISË

Ky Kongres u zhvillua më datën 15.11.2014 në Pallatin e Brigadave Tiranë. me pjesëmarrjen e profesorëve të financave publike, profesionistëve të fushës si dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile.

Të nderuar miq,

Të respektuar kolegë!

E prita me shumë kënaqësi ftesën për të marrë pjesë në punimet e Kongresit tuaj të tretë. Kontrolli i Lartë i Shtetit që drejtoj, e sheh bashkëpunimin me profesionistët e kontabilitetit dhe të financës, të sektorit publik dhe privat, si domosdoshmërinë e plotësimit të misionit të tij ligjor dhe si një partneritet të vazhdueshëm. Materia e misionit tonë buron nga duart dhe nga angazhimet tuaja.

Shoqata e Kontabilistëve dhe Financierëve të Shqipërisë është një zë i fuqishëm në mjedisin shqiptar. Unë konstatoj me kënaqësi se në këtë mjedis, profesionistët flasin me respekt dhe me vlerësime të larta për shoqatën tuaj, për organizimin dhe funksionimin e saj. Me gjithë vështirësitë që kemi si shoqëri dhe si ekonomi, me gjithë vështirësitë që konstatojmë në zbatimin e ligjeve të ndryshme për administrimin ekonomik dhe financiar, me gjithë mungesën shpesh herë të kulturës së punës në drejtim dhe në vendimmarrje, më duhet të nënvizoj se veprimtarinë e Shoqatës së Kontabilistëve dhe të Financierëve të Shqipërisë e shoh me shumë optimizëm, për tre arsye kryesore:

Së pari, sepse shoqata juaj është e hapur, ka spektër të gjerë anëtarësie dhe u jep shans për karrierë profesionale të gjithë profesionistëve, në radhë të parë të rinjve që janë të talentuar. E kam parë dhe ndjerë këtë prirje gjatë kohës kur punoja si pedagog i financave në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës. Kultivimi tek të rinjtë i disiplinës dhe etikës profesionale, i korrektesës dhe pasionit për profesionin e bukur të financierit dhe të kontabilistit është një premisë e shëndetshme për të pasur në të ardhmen ekspertë, kontabilistë, por edhe njerëz të aftë që do të marrin përsipër fatet e vendit, të ekonomisë, të shtetit dhe të biznesit. Nga njëra anë shoqatat janë një motor i fuqishëm profesional, por nga ana tjetër edhe një trampolinë nga ku kërcejnë dhe promovohen të talentuarit. Nuk mund të ketë shtetarë të mirë, pa pasur profesionistë të mirë. Shifra që mësova sot për anëtarësinë tuaj në Shoqatë, është mbresëlënëse.

Sinqerisht, komplimentet e mia për punën e palodhur që bëjnë drejtuesit dhe profesionistët që e drejtojnë këtë shoqatë, në veçanti personalitetit të financave publike në vend, Prof. Dr. Sherif Bundo.

Së dyti, shoqata është burim i pashtershëm i mundësive të trajnimit dhe rritjes profesionale. Ka një diferencë të madhe midis kontabilitetit të aplikuar dhe kontabilitetit të librave. Praktika sjell me dhjetëra shembuj që tregojnë se të njëjtat ligje interpretohen dhe zbatohen në mënyra të ndryshme, ndonjëherë me diferenca të mëdha. Po kështu, duhet pranuar se në fushën e zbatimit të ligjeve fiskale ka mjaft për të dëshiruar. Në shumë ndërmarrje gjen probleme serioze lidhur me evidencën kontabël të aktiveve afatgjata, të rezervave materiale dhe inventarëve, të respektimit dhe ekzekutimit të rregullave të përgjegjësisë materiale dhe monetare. Praktikat dhe standardet kontabël kanë një dinamizëm të madh dhe po kështu shumë shpejt ndryshojnë edhe procedurat dhe shkallët tatimore. Në këtë mori informacioni të shpejtë, një profesionist i mirë është i përditësuar vetëm kur është në kontakte të vazhdueshme me Shoqatën. Stafi trajnues i shoqatës suaj është pjesë edhe e bashkëpunëtorëve të Kontrollit të Lartë të Shtetit. E shoh shoqatën si një Akademi profesionale. Sigurisht që mund të bëhet edhe më shumë.

Së treti, në vendin tonë është bërë e modës që njerëzit të vrapojnë pas interesit, pas parasë, pas miqësive. Shoqata kultivon solidaritetin, bashkëpunimin, mirëkuptimin dhe predispozicionin për ta parë kolegun si konsulent, si këshilltar. Kemi nevojë edhe për vlera të tilla.

Të dashur kolegë,

Ndihem shumë mirë midis Jush. Jam i gatshëm, si Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit, që ta angazhojë KLSH-në si institucion, në mënyrë që të rritet aktiviteti i Shoqatave të Kontabilistëve, të shtohet veprimtaria dhe të dëgjohet më shumë zëri i profesionistëve të kontabilitetit dhe të financës. Njerëzit punëtorë nuk bërtasin, nuk shkelin rregullin, zbatojnë më mirë ligjin, respektojnë më mirë shoqërinë.

Me lejoni t'ju bëj me dije se si KLSH, në bazë të standardeve ndërkombëtare të auditimit suprem të INTOSAI-t dhe të praktikave të mira evropiane, kemi marrë nismën të zhvillojmë auditimin e integritetit, që bazohet në rregullat dhe kodin e etikës, si për institucionet që auditojmë, ashtu dhe për veten tonë. Këtë e bëjmë për të rritur përgjegjshmërinë dhe transparencën e qeverisjes publike dhe besoj se kjo shkon në një linjë me orientimet e Kongresit tuaj për rritjen e përgjegjshmërisë dhe rolit të kontabilistit në ekonominë dhe shoqërinë shqiptare.

Jemi gati të ndajmë eksperiencat e kësaj qasjeje që kemi zgjedhur, me eksperiencën e aktiviteteve dhe ekspertëve të Shoqatës suaj, mbi bazën e motos së INTOSAI-t *"Experentia mutua Omnibus prodest - Eksperienca e përbashkët u shërben të gjithëve*".

Me këtë rast, ju ftoj Ju si Shoqatë që të lidhim një marrëveshje bashkëpunimi me ne si KLSH. Dua të theksoj se marrëveshjet e partneritetit dhe bashkëpunimit me struktura të tjera profesionale të fushës, si me Institutin e Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA) dhe me Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit po ecin mjaft mirë, me kontribute reciproke dhe aktivitete të përbashkëta.

Jam i bindur se marrëveshja e KLSH-së me Shoqatën e Kontabilistëve dhe Financierëve të Shqipërisë do t'i ndihmojë të dyja institucionet tona të fitojnë në eksperienca dhe qasje të reja në raportimin financiar dhe në auditim.

Ftoj ekspertet e Shoqatës suaj të japin mendimet dhe gjetjet e tyre të vlefshme në faqet e revistës tonë shkencore "Auditimi Publik", një forum ku bashkëpunojnë shumë personalitete të auditimit dhe kontabilitetit të vendit dhe të huaja.

Duke ju uruar suksese në punët e Kongresit dhe në performancën në vijimësi të Shoqatës suaj,

Ju faleminderit!

HYRJET NË BOTIMET E KLSH[118]

Parathënie e librit "Historiku i Kontrollit të Lartë të Shtetit 1925-2012"

Botim i vitit 2012

Një botim mbi historikun e Kontrollit të Lartë të Shtetit, i cili u krijua si strukturë e plotë vetëm 13 vjet pas lindjes së shtetit shqiptar, ashtu si çdo botim tjetër për kujtesën e institucioneve të ngjashme përcaktuese në funksionimin e demokracisë dhe te shtetit ligjor në një vend, ofron avantazhe në disa rrafshe.

Së pari, ndërgjegjëson punonjësit e tij për vlerat e institucionit të shtrira në vite dhe të vyera për rolin kushtetues që ai ka, por edhe për përgjegjësinë që çdo auditues mbart kur përfaqëson institucionin me punën, sjelljen dhe rezultatet e tij.

Së dyti, si copëz historie, historiku jo vetëm shfaqet mjaft i dobishëm për cilindo qytetar që kërkon të njohë evoluimin në vite të institucioneve tona, por edhe për ata që duan të kontribuojnë në rritjen e cilësisë dhe efektivitetit të këtyre institucioneve.

Njëlloj, kujtesa historike i shërben po ashtu pasurimit të dijeve të brezit të ri, të përqendruar në këtë drejtim falë interesave didaktiko-shkollore apo studimore. Së fundmi, ajo kontribuon në pasurimin e asaj kulture ligjore dhe institucionale që duhet të kenë së pari vendim-marrësit publikë, por edhe çdo qytetar shqiptar i përgjegjshëm, i interesuar për shtetin dhe mënyrën e funksionimit të tij. Formësimi i kulturës së institucioneve tona shtetërore me vlerat dhe përgjegjësitë e tyre përbën një prej objektivave të rëndësishëm të projektit të evropianizimit të administratës shqiptare, të forcimit të shtetit ligjor dhe punës për një qeverisje të mirë.

[118] Përmbledhje e parathënieve të disa prej titujve të Kolanës së Botimeve KLSH 2012-2015

Baza nga ku ngjizet kjo kulturë e domosdoshme është rrafshi njohës dhe historik i institucioneve përgjegjëse për konkretizimin e reformave të vendosjes së shtetit ligjor.

Historiku i KLSH mundëson të shikohen fillesat e këtij institucioni suprem të auditimit, jetik për mbrojtjen e interesave të qytetarëve dhe të Kuvendit në administrimin e parasë publike. Shikohen format që ai ka marrë në rrjedha të ndryshme të historisë së shtetit shqiptar, mungesa 6 Historiku i Kontrollit të Lartë të Shtetit e plotë të pavarësisë dhe deformimi gjatë diktaturës, zhvillimet e vrullshme në periudhën e tranzicionit 1992 e deri më sot, si dhe përpjekjet e punonjësve të tij profesioniste për të realizuar një mëvetësi funksionale, pavarësisht nga kornizat e kohës.

Me vlerësimin maksimal qytetar, stafi i sotëm i KLSH përulet përpara figurave dhe personaliteteve që kanë drejtuar këtë institucion, veçanërisht në vitet 1925-1944, si Kol Thaçi, Lac Gera, Llambi Aleksi, Lame Kareco, Eqerem Libohova, Xhafer Ypi, Rrok Gera, Fejzi Alizoti, Izedin Beshiri dhe të tjerë më tej.

Vlerësojmë po ashtu punën reformuese të kryer nga Dr. Blerim Çela, ish-Kryetar i KLSH në vitet 1992-1997 dhe Mustafa Kërçuku ish-Kryetar në vitet 1997-2004, si dhe kontributin e ish-kryetarëve Zydi Pepa, Ylli Memisha, Alfred Karamuço e Robert Çeku, ish-kryetar deri në vitin 2011.

Në veçanti për mua ky libër vjen si një respekt dhe vlerësim për të gjithë ata punonjës e audituesë punëtorë, të ndershëm, korrektë dhe të aftë profesionalisht që kanë shërbyer në Institucionin më të Lartë të Auditimit Publik në Shqipëri nga viti 1925 e deri më sot.

Si institucion i pavarur, nëpërmjet këtij botimi dëshirojmë të krijojmë traditën e mirë të vlerësimit institucional të veprimtarisë, duke kontribuar në kulturën e vlerave dhe të përgjegjësisë publike në vend, për t'ia kundërvënë "kulturës" së harresës.

BUJAR LESKAJ

Parathënie e librit "KLSH në Kuvend 2011"

Botim i vitit 2012

Edicioni i dytë i kolanës "Botime KLSH" me titull "KLSH në Kuvend" përmban informacion të detajuar për prezantimin e Raportit Vjetor të KLSH 2011 në Komisionin për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit dhe në seancën plenare të Kuvendit. Ai i sjell të plota diskutimet e deputetëve në Komision dhe në seancë plenare lidhur me raportin dhe veprimtarinë e institucionit në tërësi.

Detyrimi për të publikuar eksperiencat e fituara, krahas detyrimit kushtetues për KLSH për t'i raportuar Kuvendit dhe publikut, buron dhe nga standardi bazë ISSAI 20 i standardeve të INTOSAI, i cili rendit ndër Parimet themelore të punës së një institucioni të auditimit më të lartë (SAI):" SAI-t komunikojnë në kohë dhe gjerësisht për aktivitetet e tyre dhe rezultatet e auditimeve nëpërmjet medias, publikimeve të ndryshme, faqeve në internet dhe mjeteve të tjera të komunikimit masiv" (ISSAI 20, Parimi 8).

Edicioni "Botime KLSH: KLSH në Kuvend" mbyllet me Rezolutën e Kuvendit për KLSH të datës 26 prill 2012, e cila afirmon mbështetjen e plote të organit suprem ligjvënës të vendit për KLSH dhe shtron detyra për të ardhmen.

BUJAR LESKAJ

Parathënie e librit "KLSH Analiza vjetore 2011"

Botim i vitit 2012

Në realizim të misionit të tij kushtetues për të informuar Kuvendin dhe publikun dhe në bazë të Deklaratës së Limës (ISSAI 1) të vitit 1977, e konsideruar Kushtetuta e Institucioneve të Auditimit më të Lartë, e cila shprehet se"Institucioni i Auditimit më të Lartë duhet të ketë fuqi dhe të drejta të raportojë dhe publikojë gjetjet e tij të rëndësishme dhe të veçanta gjatë gjithë vitit", Kontrolli i Lartë i Shtetit nis një kolanë botimesh KLSH. Kjo kolanë vjetore, e cila do të pasurohet nga viti në vit, do të pasqyrojë reformat që ka nisur KLSH për të thelluar auditimin financiar dhe kthyer vëmendjen tek auditimi i performancës, punën e stafit të tij për të luftuar në sistem korrupsionin dhe për ta parandaluar atë. Nga ana tjetër, kolana do ta njohë audituesin dhe publikun e gjerë me institucionet evropiane të auditimit suprem dhe me standardet e përditësuara të INTOSAI-t. Edicioni i parë i kolanës "KLSH: Raporti Vjetor 2011" përmban informacion të detajuar për auditimet e kryera gjatë vitit 2011, si dhe një analizë pune të kryer në prani të medias dhe të shoqërisë civile, nga departamentet e auditimit të KLSH, me raportime dhe diskutime të hapura. "Experentia mutua omnibus prodest" është moto e organizatës që përmbledh 191 institucione më të larta të auditimit në botë dhe kryefjala e bashkëpunimit mes këtyre institucioneve me njeri-tjetrin dhe me partnerët e tyre të natyrshëm publikë në vendet përkatëse. Kjo moto do të na udhëheqë ne në punën tonë. Gjetjet dhe sugjerimet nga raportimet dhe diskutime e këtij libri përbëjnë bazën për planifikimin e auditimeve të institucionit gjatë këtij viti dhe në vitet në vijim.

BUJAR LESKAJ

Parathënie e librit "Standardet e Auditimit INTOSAI"

Botim i vitit 2012

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në zbatim të motos së INTOSAI, organizatës së institucioneve të auditimit suprem *"Experentia mutual omnibus prodest (Eksperienca e përbashkët u shërben të gjithëve)*" sjell me këtë botim në vëmendje të sektorit publik si dhe të publikut, një pjesë të standardeve ndërkombëtare të profesionit, Standardet e Auditimit të INTOSAI. Në Projekt-Idenë e paraqitur në Dhjetor 2011 pranë Komisionit për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë theksova: "*Në punën e tij, KLSH mund dhe duhet të pasqyrojë pesë parimet kryesore të një qeverisje të mirë: transparencën, përgjegjshmërinë, efikasitetin, pjesëmarrjen dhe koherencën në veprime. Për ta kryer këtë, KLSH mund dhe duhet të realizojë zbatimin më fuqimisht të standardeve ndërkombëtare të auditimit, si dhe Deklaratat më të fundit të miratuara nga INTOSAI në dy kongreset e saj në Meksiko 2007 dhe në Afrikën e Jugut 2010, duke thelluar përmbajtjen e Deklaratës së Limës të vitit 1997".*

Kur flasim për institucione të konsoliduar kemi parasysh vetëm ato institucione që zbatojnë standardet e fushës së tyre, të pranuara ndërkombëtarisht. "Ne, *SAI-t e pavarura, duhet të punojmë shumë dhe të vëzhgojmë nga afër qeveritë, në mënyrë që të jemi në gjendje të ofrojmë informacion të besueshëm dhe rekomandime për parlamentet tanë dhe për publikun, në përputhje me standardet ndërkombëtare të INTOSAI".*

Standardet INTOSAI të auditimit kanë rëndësi themelore për ne si KLSH, si pjesë integrale e përpjekjeve për rritjen e dijeve profesionale të institucionit. Në shkrimin e tij në Revistën "INTOSAI Journal", z. Terence Nombembe, President I INTOSAI-t dhe Auditues i Përgjithshëm i Afrikës së Jugut përmend se "*Ne do ta forcojmë pavarësinë tonë me*

një armë që askush s'do guxonte të na e merrte: diturinë mbi auditimin, që na pajis me ide ose mendime të pavarura dhe analizë".

Rëndësinë e standardeve profesionale të audititmit suprem publik e thekson edhe Rezoluta e Organizatës së Kombeve të Bashkuara të datës 22 dhjetor 2011 për rritjen e eficiencës së këtyre institucioneve. Sipas Rezolutës, *"Vendet anëtare të Kombeve të Bashkuara theksojnë vlerësimin e tyre për punën e INTOSAI për promovimin e një eficience, përgjegjshmërie, efektiviteti dhe transparence më të madhe në qasjen e duhur dhe përdorimin e burimeve publike në përfitim të qytetarëve. Rezoluta po ashtu shpreh vlerësim për Deklaratat e Meksikos dhe të Limës dhe i nxit vendet anëtare që të aplikojnë, në përputhje me strukturat e tyre institucioale kombëtare, parimet e vendosura në këto deklarata".* Ajo fton parlamentet dhe qeveritë e vendeve anëtare të OKB-së të bashkërendojnë punën dhe të mbështesin institucionet e auditimit publik supreme të vendeve të tyre, në përputhje me Deklaratat dhe standardet e pranuara botërisht. Kjo është arsyeja pse kjo Rezolutë është përfshirë në këtë botim.

Standardet e INTOSAI, të quajtura ndryshe ISSAI, janë përgatitur dhe botuar nga Komiteti i Standardeve të Auditimit i INTOSAI në qershor 1992. Kodi i Etikës i INTOSAI është miratuar në Kongresin e XVI-të të INCOSAI mbajtur në Montevideo në vitin 1998. Këto standardetë auditimit u rikonstruktuan më pas dhe në formatin e tyre aktual, së bashku me kodin e Etikës , janë miratuar nga Kongresi XVII-të i INTOSAI në Seul 2001.

Standardet e Auditimit INTOSAI përmbajnë postulatet themelore dhe parimet për kryerjen e punës se auditimit nga institucionet supreme të auditimit (SAI). Ndërsa është përgjegjësi e secilit SAI për të gjykuar shkallën në të cilën standardet janë në përputhje me arritjen e mandatit të tij, duke konsideruar rrethanat kushtetuese ligjore dhe të tjera të SAI-t. Njëri prej parimeve të përmbajtura në Kodin e Etikës të INTOSAI përcakton se detyrimi i audituesit suprem është të aplikojë standardet ndërkombëtarisht të pranuara të auditimit, pra standardet INTOSAI (ISSAI). ISSAI-t përbëhen nga katër nivele: nga Parimet Themelore, Standardet e Përgjithshme, Standardet e Fushës dhe Standardet e Raportimit.

Parimet themelore janë supozimet themelore, parimet logjike dhe kërkesat e nevojshme të dizajnuara për të mbështetur zhvillimin e standardeve të auditimit. Ata janë të dizajnuara për t'i shërbyer audituesit në formulimin e mendimeve dhe gjykimeve të tij/saj në raportet që përgatit, sidomos në rastet kur ka standard specifike që zbatohen. Çdo SAI duhet të konsiderojë përputhjen me Standardet e Auditimit të INTOSAI në të gjitha çështjet të cilat trajtohen në auditime, edhe pse kjo varet dhe nga kushtet lokale të plotësimit të mandatit të vet të veçantë të auditimit si SAI.

Në bazë të Parimeve Themelore qëndron Deklarat e Limës për Udhëzimet mbi Parimet e Auditimit e tetorit 1977, miratuar në kongresin e IX-të të INCOSAI në lima të Perusë. Deklarata e Limës konsiderohet si Magna Carta (Kushtetuta) e auditimit publik suprem. Parimet e përmbajtura në Deklaratë nuk kanë kohë dhe janë vlera themelore. Suksesi i

Deklaratës i dedikohet faktit që përmbledh një listë objektivash dhe çështjesh për auditimin suprem publik, duke ngelur në të njëjtën kohë domethënëse dhe koncize, e lehtë për t'u përdorur dhe me një gjuhë të qartë. Edhe pse institucioni ynë ishte pjesë e organizatës INTOSAI që nga viti 1984, Deklarata i Limës vendos parimet themelore, Deklarata e Meksikos mbi Pavarësinë e SAI-t, e miratuar në Kongresin XIX-të të INTOSAI në vitin 2007, forcon pavarësinë e institucioneve më të larta të auditimit. Ajo prezanton tetë parimet themelore për Pavarësinë, të cilat burojnë nga fryma e Deklaratës së Limës, si një kërkesë thelbësore për të siguruar efektivitetin dhe eficiencën e auditimit suprem të sektorit publik.

Çdo SAI duhet të krijojë një politikë të tijin, në të cilën standardet INTOSAI duhet të respektohen në kryerjen e llojeve të ndryshme të auditimit, për të siguruar që puna audituese dhe produktet e auditimit (gjetjet, raportet, rekomandimet) të jenë të cilësisë më të lartë.

Standardet e përgjithshme merren me nivelin dhe kualifikimet e audituesit ose të institucionit të auditimit, në mënyrë që ata të mund të kryejnë detyrat që lidhen me fushën e standardeve dhe raportimit në mënyrë kompetente dhe efektive. Ato trajtojnë çështje të tilla si rekrutimin e audituesve, trajnimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore të SAI-t, ofrimin e udhëzimeve të përshtatshme, planifikimin dhe mbikëqyrjen e kontrolleve të brendshme, si dhe rishikimin e efikasitetit dhe efektivitetit të standardeve dhe procedurave të brendshme të SAI-t.

Standardet e Fushës janë të dizajnuara për të krijuar kornizën për zhvillimin dhe menaxhimin e punës së auditimit. Ato kanë të bëjnë me nevojën për të planifikuar, shqyrtuar, mbikëqyrur, studiuar dhe vlerësuar kontrollin e brendshëm, si dhe ofrojnë këshilla dhe udhëzime mbi auditimin e rregullsisë, provat e auditimit dhe analizën e pasqyrave financiare. Standardet e fushës nëpërmjet udhëzimeve të hollësishme sigurojnë një kornizë reference për audituesin.

Standardet e Raportimit trajtojnë mendimin zyrtar të audituesit dhe ofrojnë udhëzime në lidhje me formatin e raportimit dhe opinionet e shprehura.Standardet gjithashtu i referohen raporteve të tjera që audituesi mund të bëjë, të tilla si raporti për auditimin e rregullsisë dhe të performancës. Theksi i standardeve të raportimit është ofrimi i një kornize të nevojshme, brenda të cilës audituesit duhet të përmbushin përgjegjësitë e tyre të raportimit. Si rezultat, këto standarde nuk përmbajnë shkallën e detajuar që gjendet në Standardet përkatëse Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (IFAC).

Standardet INTOSAI, sidomos Shënimet Praktike (këto shënime do të trajtohen në mënyrë të detajuar në një botim të dytë të KLSH për Standardet INTOSAI) të tyre bazohen në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, pse auditimi si në sektorin privat

ashtu dhe në sektorin publik është një shkencë e konsoliduar dhe IFAC ka bërë një pune të lavdërueshme në unifikimin e ISA-ve.

Megjithatë, roli dhe përgjegjësitë e një audituesi suprem publik ndryshojnë mjaft nga ato të një audituesi të sektorit privat. Këto ndryshime vijnë si nga përgjegjësitë specifike të SAI-ve, ashtu dhe nga konteksti i ndryshëm në drejtim të legjislacionit dhe llogaridhënies brenda të cilit vepron një SAI.

Ky botim shihet dhe në funksion të përmbushjes së detyrimeve të katër objektivave themelorë të Strategjisë së EUROSAI 2011-2017:

1. *"Ndërtimi i kapaciteteve;*
2. *Standardet profesionale;*
3. *Shkëmbimi i njohurive dhe eksperiencave dhe*
4. *Menaxhimi në përputhje me parimet e qeverisjes së mirë dhe komunikimit efektiv"*

KLSH shpreson që botime të tilla t'i vijnë në ndihmë jo vetëm audituesve në punën e tyre, por edhe qytetarit dhe vendim-marrësve publikë për të kuptuar rolin thelbësor të auditimit suprem në përdorimin me ekonomicitet, efektivitet dhe eficiencë të parasë publike, e cila buron pikërisht nga kontributet e qytetarëve-taksapagues.

Çdo sugjerim për përmirësime në këtë fushë e mirëpres në adresën:bleskaj@klsh.org.al

BUJAR LESKAJ

Parathënie e librit "Institucionet Supreme Europiane të Auditimit (EUROSAI)"

Botim i vitit 2012

Ky botim, pjesë e kolanës "Botime KLSH-2012 " jep informacion për mënyrën e organizimit dhe funksionet e institucioneve supreme të auditimit të të gjitha vendeve evropiane, si dhe të Gjykatës Evropiane të Audituesve, organit më të lartë auditues të Bashkimit Evropian. Libri prezanton organizatën EUROSAI (European Organization of the Supreme Audit Institutions - Organizata Europiane e Institucioneve më të Larta të Auditimit), komunitetin e institucioneve supreme të auditimit (SAI), ku SAI-t zhvillojnë kongrese, konferenca dhe aktivitete të tjera trajnimi e shkëmbimi reciprok eksperiencash, nën moton e INTOSAI-t "Experentia mutua omnibus prodest" (Eksperienca e përbashkët u shërben të gjithëve). Rezoluta e miratuar në Kongresin e 6-të të EUROSAI në Bon, Gjermani në vitin 2005, në pikën 2 të saj kërkon "...rritjen e njohjes reciproke dhe shkëmbimit profesional mes SAI-ve.

Komiteti i trajnimeve të EUROSAI do të publikojë materiale njohëse dhe do të çojë më tej bashkëpunimin EUROSAI-Instituti i Zhvillimit i INTOSAI, si dhe do të lehtësojë bashkëpunimin mes SAI-ve të rajonit. Ky botim i KLSH është kontribut dhe në zbatim të kësaj kërkese të EUROSAI. Misioni i EUROSAI është të rrisë zhvillimin profesional dhe institucional të anëtarëve të organizatës. Vizioni i tij është kontributi në përmirësimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e auditimit në sektorin publik të rajonit. Në bazë të standardeve INTOSAI (veçojmë nenin 15 të Deklaratës së Limës, kushtetuta e institucioneve supreme të auditimit publik) 6 KLSH - EUROSAI dhe Institucionet

Supreme Europiane të Auditimit dhe motos së INTOSAI, KLSH përgjatë vitit 2012 ka vendosur kontakte intensive dhe nënshkruar marrëveshje me një numër institucionesh homologe, si Gjykata e Auditimit e Sllovenisë, Zyra Kombëtare e Auditimit e Polonisë, Gjykata e Llogarive e Turqisë, Institucioni Shtetëror i Auditimit të Kroacisë dhe Zyra e Audituesit të Përgjithshëm të Kosovës. KLSH synon me këtë bashkëpunim trajnime efektive të stafit auditues dhe kryerjen në të ardhmen të auditimeve të përbashkëta apo paralele në rajon, për ngritjen e kapaciteteve të audituesve dhe realizimin e integrimit evropian dhe standardeve të BE-së edhe në fushën e auditimit më të lartë publik. Ngritja e kapaciteteve audituese shton pavarësinë tonë, sikurse shprehet z. Terence Nombembe, President i INTOSAI-t dhe Auditor i Përgjithshëm i Afrikës së Jugut, "Ne do ta forcojmë pavarësinë tonë me një armë që askush s'do guxonte të na e merrte: diturinë mbi auditimin, që na pajis me ide ose mendime të pavarura dhe analizë", thënie të cilën e citova kur paraqita platformën e zhvillimit të KLSH në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit në dhjetor 2011, si kandidat për Kryetar i nominuar nga Presidenti i Republikës. Të vetëdijshëm për trashëgiminë e përbashkët kulturore të Evropës dhe të bindur për domosdoshmërinë në efektivitetin e auditimit publik, këtë libër e përgatitëm duke ju drejtuar jo vetëm audituesve të brendshëm dhe të jashtëm të vendit, por edhe menaxherëve publikë dhe qytetarëve të interesuar për zhvillimin e komunitetit të auditimit suprem në kontinent, si mburoja e fundit dhe tejet profesionale për mbrojtjen e interesave ekonomike dhe shoqërore të taksapaguesve në realizimin e mirëqeverisjes e të përdorimit të fondeve publike me ekonomicitet, efiçiencë dhe efektivitet.

BUJAR LESKAJ

Parathënie e librit "Udhëzuesi i Auditimit Financiar (1000-2999)"

Botim i vitit 2013



Zyra e Audituesit të Përgjithshëm të Kosovës dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit, me botimin «Udhëzues i Auditimit Financiar (Shënimet Praktike)" sjellin në shqip përpara audituesit shqiptar një punë rreth 12 vjeçare të komunitetit ndërkombëtar të auditimit suprem, për të vendosur rregulla të qarta në auditimin financiar. Janë 38 shënime praktike për zbatimin e Standardeve të Auditimit Suprem ISSAI 1000- 2999, të njohura dhe të pranuara ndërkombëtarisht. Këto shënime orientojnë saktë audituesin tonë në sfidat e punës së përditshme për një auditim financiar sa më të plotë dhe cilësor. Që në fund të shekullit të kaluar, institucionet supreme të auditimit publik(SAI), anëtarë të INTOSAI, shprehën nevojën për një udhëzues më të fortë dhe të detajuar që t'i mbështesë audituesit në punën e tyre. Në vitin 2001, Kongresi i 17-të i INTOSAI-t në Seul i dha Komitetit të Standardeve të Auditimit detyrën për ta plotësuar këtë nevojë, duke u mbështetur tek standardet e auditimit të njohura globalisht dhe të zhvilluara nga organizatat e tjera profesionale. Në vitin 2002, Bordi Qeverisës i INTOSAI miratoi një projekt për të plotësuar nevojat e SAI-ve anëtarë në auditimin financiar. INTOSAI nisi bashkëpunimin me Federatën Ndërkombëtare të Kontabilisteve (IFAC), bashkëpunim i cili prodhoi pjesën më voluminoze të nivelit të katërt të standardeve të INTOSAI (Udhëzuesit e Auditimit). Që nga ajo kohë, të 38 standardet e auditimit financiar dhe shënimet praktike të tyre janë pjesërisht riparë dhe rinovuar në çdo Kongres të INTOSAIt, duke qenë pjesë e pandare dhe reference e përhershme e punës profesionale të audituesve publike kudo në botë. Shënimet janë pjese jo vetëm e nismës me të rëndësishme standardberese të INTOSAI-t në historinë e

tij të derisotme, por përbejnë edhe një hartë të plotë e të detajuar ku audituesi mund të orientoje punën e tij, nga planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare, identifikimi dhe vlerësimi i risqeve të anomalive materiale, e deri tek kontrolli i cilësisë për një auditim të pasqyrave financiare. Sjellja e tyre në gjuhën shqipe është frut i Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes Zyrës së Audituesit të Përgjithshëm të Kosovës dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit, lidhur në shkurt të vitit 2012. Procesi ka gjetur mbështetjen e plotë dhe angazhimin personal të Audituesit të Përgjithshëm të Kosovës, zotit Lars Lage Olofsson, një personalitet i shquar i auditimit publik evropian e me gjere. Nen drejtimin e z. Olofsson, Zyra e Audituesit të Përgjithshëm të Kosovës (ZAP) ka kryer në katër vitet e fundit një transformim të plotë, duke shtuar me here numrin e auditimeve të saj financiare, duke rinovuar stafin dhe rritur ndjeshëm cilësinë e punës audituese, sipas standardeve të INTOSAI-t. Kjo Zyre ka fituar besimin e palëve të interesit në Kosove, përfshirë dhe komunitetin ndërkombërtar dhe agjensitë ndërkombëtare të zhvillimit të pranishme atje. Në fund të nëntorit 2011, në platformën që paraqita përpara Komisionit të Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit, në cilësinë e kandidatit të nominuar nga Presidenti i Republikës për Kryetar të Kontrollit të Lartë të Shtetit, theksova orientimin e ardhshëm të KLSHsë për konsolidimin e auditimit financiar, në përputhje me kërkesat e standardeve ndërkombëtare të INTOSAI-t, përmirësimin e komunikimit dhe transparencës, nëpërmjet botimeve shkencore dhe pranisë së shtuar në media, si dhe intensifikimin e bashkëpunimit me institucionet homologe të auditimit të vendeve të BE-së, të vendeve të rajonit dhe në veçanti, me Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës. Shënimet praktike në shqip të standardeve ndërkombëtare të auditimit financiar ISSAI 1000-2999 janë pune e përbashkët e stafeve të ZAP dhe KLSH, për t'i sjelle audituesit shqiptar referencën me të plotë dhe orientimin me të saktë të praktikave të mira e të suksesshme të komunitetit ndërkombëtar (rreth 90 Institucione Supreme të Auditimit kane kontribuar në përgatitjen e Udhëzuesit). Në botimet e deritanishme të KLSH-së, një vend të rendesishem zënë « Standartet e Auditimit INTOSAI » (ISSAI 10, 20, 30, 40, 100, 200, 300, 400) për shkak të rolit të padiskutueshëm qe ka zbatimi i tyre në konsolidimin e Institucionit dhe në rritjen e dijeve profesionale të audituesve të tij. Botimi i këtyre standarteve përputhet me synimin kryesor strategjik të KLSH për vitet 2013-2017, modernizimin e tij, me qellim qe veprimtaria e institucionit të jetë në përputhje të plotë me standardet INTOSAI dhe me objektivat e Strategjisë për Zhvillim të EUROSAI 2011-2017. Një nga objektivat e planit të Zhvillimit Strategjik të Institucionit është edhe përmirësimi i cilësisë dhe shtimi i numrit të auditimeve të performancës. Këtij qëllimi i shërben edhe botimi nga KLSH i librit "Udhëzues i Auditimit të Performances, ISSAI 3000-3100". Auditimi i performancës në KLSH po konsolidohet me tej, duke rritur numrin e auditimeve të realizuara dhe zgjerimin e tematikes së përzgjedhur. Ky lloj auditimi do të jetë një nga dy aktivitetet me të rëndësishme në gjithë veprimtarinë e institucionit. KLSH, në këtë drejtim po ndjek

trendin e SAI-ve të vendeve të zhvilluara për t'i dhënë prioritet Auditimit të Performances, duke vlerësuar këtë lloj auditimi si një nga mënyrat kryesore përmes të cilit sigurohet përdorimi i fondeve publike me ekonomicitet, efiçiencë dhe efektivitet. Parathënie ISSAI 1000 - 2999 Udhëzues i Auditimit Financiar Paralalelisht me « Udhezuesin e Auditimit Financiar », KLSH po boton në bashkëpunim dhe me ndihmën e SIGMA edhe « Udhëzuesin për Auditimin e Perputhshmerise ». Me këtë botim, KLSH arrin shifrën e 15 botimeve, brenda një harku kohor prej një viti e gjysem. E gjithë kolana e botimeve të KLSH-së i shërben rritjes së transparencës dhe llogaridhënies, duke bërë një hap të rëndësishëm sasior dhe cilësor në kontributin ndaj mirëqeverisjes, përmes bërjes publike dhe transparente të të gjithë veprimtarisë së tij dhe rritjes së kapaciteteve në fushën e auditimit publik. KLSH falenderon në mënyrë të veçantë z. Lars Lage Olofsson për kontributin e tij në realizimin e këtij botimi, si dhe të gjithë ata auditues të Kosovës dhe të Shqipërisë qe punuan me përkushtim e cilësi për përkthimin e « Shënimeve Praktike të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit Financiar », nen frymën dhe moton e INTOSAI-t « Experentia Mutua Omnibus Prodest (Eksperienca e përbashkët u shërben të gjithëve) ».

BUJAR LESKAJ



Parathënie e librit "Udhëzuesi i Auditimit të Përputhshmërisë

Botim i vitit 2013

Auditimi i përputhshmërisë, krahas auditimit financiar dhe auditimit të performancës, është ndër auditimet bazë të shkencës së auditimit suprem publik. Ai promovon transparencën, me anë të përgatitjes së raporteve të besueshme nëse fondet publike janë shpenzuar, si dhe menaxhimi dhe proceset publike janë kryer në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Ky auditim kontribuon në përmirësimin e transparencës së ndarjes së përgjegjësisë brenda shtetit. Auditimi i përputhshmërisë promovon llogaridhënien, duke raportuar devijimet dhe kundërvajtjet nga ligjet dhe rregulloret, në mënyrë që veprimet korrigjuese të mund të ndërmerren dhe ata që i kanë kryer këto shkelje të mbajnë përgjegjësi për veprimet e tyre. Auditimi i përputhshmërisë promovon administrim të mire publik, si duke treguar dobësitë dhe devijimet nga ligjet dhe rregulloret, ashtu dhe duke vlerësuar pasurinë publike, aty ku ligjet e duhura dhe rregulloret janë të pamjaftueshme, ose kur ka boshllëqe të dukshme në legjislacion.

Mashtrimi financiar dhe korrupsioni janë, për nga natyra e tyre, elementë që minojnë transparencën, përgjegjshmërinë dhe administrimin e mirë publik. Prandaj dhe auditimi i përputhshmërisë promovon qeverisjen e mirë, duke adresuar rrezikun e mashtrimit financiar në lidhje me përputhshmërinë e ligjeve dhe rregullave të administratës publike. INTOSAI, organizata ndërkombëtare e institucioneve supreme të auditimit (SAI), në vitet e fundit ka punuar gjatë dhe me përkushtim për përgatitjen e standardeve të auditimit të përputhshmërisë, nëpërmjet Komitetit të saj të Standardeve Profesionale.

Në Kongresin e 20-të të INTOSAI në Johanesburg 6 ISSAI 4000 - 4200 Udhëzues për Auditimin e Përputhshmërisë të Afrikës së Jugut, në tetor 2010, organizata miratoi standardin ISSAI 4000, që jep parimet e përgjithshme që duhet të ndiqen në kryerjen e auditimit të përputhshmërisë, si dhe Standardin 4200, i cili paraqet orientimet kryesore për kryerjen e auditimit të përputhshmërisë, i lidhur me auditimin e pasqyrave financiare (auditimin financiar). Të dyja këto standarde përbëjnë Udhëzuesin e Auditimit të Përputhshmërisë, që Kontrolli i Lartë i Shtetit e prezanton me këtë botim tek audituesit e tij dhe audituesit publikë të brendshëm. Libri orienton me saktësi dhe hollësi audituesit e sektorit publik, duke përshkruar kapitujt e mëposhtëm:

• Konsiderata fillestare (objektivat që duhen arritur, konsideratat etike, kontrollin e cilësisë, etj.)
• Planifikimi dhe dizenjimi i një auditimit të përputhshmërisë (identifikimi i palëve të përfshira, baza ligjore, kriteret e auditimit dhe strategjia, materialiteti, vlerësimi i riskut, etj.);
• Kryerja e auditimeve të përputhshmërisë (mbledhja e provave, dokumentacioni i komunikimit etj.);
• Vlerësimi i provave dhe formulimi i konkluzioneve;
• Raportimi (raportet e auditimit, proceset vijuese);

Udhëzimi përfundon me shembuj që ilustrojnë konceptet e rregullsisë dhe pronësisë në auditimet e përputhshmërisë. Kontrolli i Lartë i Shtetit, në praktikën e tij të punës, ka kryer në vijimësi auditime të përputhshmërisë, duke i gërshetuar me auditimet financiare të tij.

Gjatë viteve të fundit, ai i ka konsoliduar këto auditime, duke rritur gamën dhe numrin e rekomandimeve për përmirësime ligjore dhe rregullative, krahas rritjes së përqindjes së zbatimit të rekomandimeve të tij për ndërhyrjet në sistemet e menaxhimit të fondeve buxhetore. Ky botim do të ndihmojë në rritjen e cilësisë së auditimeve të përputhshmërisë që institucioni do të zhvillojë në të ardhmen, si dhe të gjetjeve dhe rekomandimeve të raporteve të tij të auditimit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit falënderon programin SIGMA të OECD dhe Bashkimit Evropian, në veçanti Këshilltarin e Lartë të SIGMA, z. Joop Vrolijk, për ndihmën thelbësore të dhënë në përgatitjen dhe botimin e këtij libri (përkthimi 7 i botimit në shqip është kryer nga SIGMA), por edhe për asistencën e vyer teknike të ofruar bujarisht për KLSH-në gjatë më shumë se një dekade.

KLSH vlerëson sidomos ndihmën e pandërprerë, veçanërisht gjatë këtyre dy viteve të fundit, me këshillimet shumë cilësore ndaj drejtuesve të tij, me trajnimet për auditimin e

performancës, auditimin financiar, auditimin e prokurimeve publike, auditimin e teknologjisë së informacionit, etj, ku shumica e audituesve të institucionit ka marrë pjesë dhe ka përfituar shumë. Botimi "Udhëzuesi i Auditimit të Përputhshmërisë" do t'i ndihmojë në praktikë audituesit e KLSH-së dhe audituesit e brendshëm publikë, duke i orientuar më mirë dhe më saktë në kryerjen e auditimeve të përputhshmërisë dhe ato financiare. Ai i shtohet serisë së botimeve KLSH 2012-2013, ku spikasin ndër të tjera, "Udhëzuesi i Shënimeve Praktike të Auditimit Financiar ISSAI 1000- 2999", libri "Standardet e Auditimit INTOSAI (ISSAI 10, 20, 30, 40, 100, 200, 300, 400)" si dhe "Udhëzuesi i Auditimit të Performancës ISSAI 3000- 3100", Revista Shkencore "Auditimi Publik" me 5 numrat e saj, etj

BUJAR LESKAJ

Parathënie e librit "Raportimi i Auditimit-Guidë"

Botim i vitit 2013

Të nderuar lexues !

Në serinë e publikimeve shkencore dhe profesionale që ka ndërmarrë Kontrolli i Lartë i Shtetit në këto vite të fundit, është radha të paraqesim përpara Jush të nderuar lexues "Raportimin e auditimit" me autor, ekspertin e jashtëm të këtij institucioni z. Gjon Ndreja. Ky publikim është një mbështetje e rëndësishme në kuadër të reformës institucionale për transformimin e institucionit në linjë me standardet dhe praktikat e mira të BE-së. Një varg publikimesh me karakter profesional janë realizuar në këtë periudhë me kontributin e ekspertëve të KLSH-së dhe të huaj, me qëllim për t'a përqasur veprimtarimnë e këtij institucioni me thelbin e misionit të tij që konsiston në nxitjen e përgjegjshmërisë së qeverisë dhe të menaxherëve publikë për përdorimin me efektivitet, eficensë dhe ekonomicitet të kontributit të taksapaguesve.

Duke pasur parasysh këtë mision, autori, bazuar në një literaturë të gjerë profesionale dhe shkencore si dhe në praktikat e mira të vendeve të BE, ka sjellë në këtë punim disa rregulla dhe praktika, se si rezultatet e auditimit duhet t'u komunikohen palëve të interesuara që janë, Kuvendi i Shqipërisë, Qeveria, menaxherët publikë por edhe publiku i gjërë, me qëllim që ata të përmirësojnë performancën e burimeve publike. Përpjekja e autorit për të unifikuar mënyrën se si rezultatet e auditimit komunikohen te palët e interesuara është një instrument i rëndësishëm që krijon mundësinë Gjon Ndreja e përcjelljes së mesazhit të auditimit në mënyrën e duhur dhe ndikon drejpërdrejt efektivitetin e proçesit të auditimit. Raportimi i auditimit është faza e fundit, shumë e rëndësishme në procesin e auditimit. Shpesh me të drejtë thonë, ashtu si e nënvizon dhe

autori se "një auditues është aq i mirë sa raporti që ai shkruan" dhe fjala është të shkruash një raport bazuar në këto rregulla e standarde.

Në këtë kuadër, prezantimi i kërkesave të INTOSAI-t për shkrimin e raporteve të auditimit dhe unifikimin e praktikave për strukturën e tyre, i jep mundësi lexuesve të kuptojnë lehtësisht përmbajtjen e këtyre raporteve dhe i orienton audituesit në praktikën e shkrimit të tyre. Publikimi ka vlerën e një udhëzuesi praktik por mbështetet në kritere shkencore për shkrimin e raporteve dhe përfshin si kërkesat e standardeve dhe praktikave të mira, ashtu edhe obligimet ligjore që rrjedhin nga Kushtetuta e Shqipërisë dhe ligji "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit" në lidhje me procesin e raportimit të auditimit. Ai pretendon t'u shërbejë si audituesve që shkruajnë raportet, menaxherëve të auditimit në të gjitha nivelet, ashtu edhe përdoruesve të këtyre raporteve. Audituesit kanë për qëllim që me anë të raporteve që shkruajnë të ndikojnë përdoruesit në vendimmarrjet e tyre, por edhe përdoruesit e raporteve nga ana e tyre, kërkojnë nga audituesit mesazhe të qarta se çfarë ka ndodhur dhe si ata duhet të ndryshojnë. Shkrimi i raporteve është një punë që kërkon kujdes dhe njohuri të thella profesionale dhe me të drejtë autori ka nënvizuar në këtë publikim nëpërmjet sentencës së njohur se: "Raporti që lexohet me lehtësi , është i vështirë për t'u shkruar dhe raporti që shkruhet lehtë është i vështirë për t'u lexuar". Formulimi i rekomandimeve është një çështje kyçe e raportimit të auditimit.

Në fund të fundit rekomandimet janë sinteza ku pasqyrohen objektivat e auditimit dhe gjykohet për mundësinë e arritjes së qëllimeve të auditimit. Qëllimi i auditimit është të ndikojë menaxherët publikë të përmirësojnë punën e tyre në drejtim të përdorimit të burimeve publike sipas ligjit por edhe me efektivitet, eficensë dhe ekonomicitet. Ajo që me të drejtë theksohet në këtë Raportimi i auditimit - Guidë punim, është përcaktimi i një pozicioni të qartë të audituesit në raport me rekomandimet. Rekomandimet sipas autorit duhet të jenë të tilla që të krijojnë impakte pozitive në zhvillimin e proceseve që ndikojnë objektivat dhe të përfshijnë çështje themelore dhe horizontale, impakti i të cilave shtrihet në mënyrë kapilare.Nga ana tjetër audituesit nëpërmjet rekomandimeve nuk japin zgjidhje konkrete të çështjeve, pasi kjo është përgjegjësi e menaxhimit, por i nxitin menaxherët të japin zgjidhjet e duhura me qëllim që objektivat të arrihen me kosto efektive.

Kërkesa të tjera shumë të rëndësishme që synojnë përmirësimin e komunikimit të rezultateve të auditimit janë edhe strukturimi i raporteve, qartësia dhe thjeshtësia e tyre, gjuha dhe struktura e fjalive, në mënyrë që mesazhi i auditimit të përcillet pa pengesa te të gjitha palët e interesuara, përfshirë edhe publikun e gjerë. Kjo nuk është vetëm një kërkesë estetike por ndikon drejpërdrejt në përcjelljen e qartë të mesazhit, pa të cilin nuk mund të mendohet për realizimin e objektivave të auditimit. Duke e falënderuar autorin

për këtë kontribut me ndikim në zhvillimin institucional të KLSH-së, është rasti të shpreh angazhimin tim për të vazhduar me vendosmëri rrugën drejt modernizimit të këtij institucioni dhe të ftoj e të inkurajoj të gjithë bashkëpunëtorët e tjerë potencialë për të kontribuar më tej në këtë objektiv të vështirë dhe të rëndësishëm, për ta vënë institucionin tërësisht në funksion të interesave të publikut.

BUJAR LESKAJ

Parathënie e librit "Standardet e Auditimit të Borxhit Publik (5410-5440)"

Botim i vitit 2013

Në Shqipëri është i dukshëm fenomeni i ngadalësimit të rritjes ekonomike jo vetëm si pasojë e krizës ekonomike e financiare globale e theksuar veçanërisht nga ajo e dy fqinjëve kryesorë, Greqia dhe Italia, por gjykojmë se ka edhe një sërë faktorësh që lidhen me shkaqe të brendshme ekonomike dhe politike. Nga faktorët e brendshëm më kryesor që ndikon këtë ngadalësim është edhe niveli i lartë i borxhit publik në raport me produktin e brendshëm bruto, shoqëruar me një nivel që mbetet shqetësues i të ashtuquajturave 'kredi të këqija' në bankat e nivelit të dytë.

Në teoritë e financave publike, instrumenti i borxhit publik është parë si një amortizator i rëndësishëm i valëve goditëse që sjellin krizat ekonomike, por edhe si stimulues i dinamikave zhvilluese në çastin kur shoqëria kupton se potenciali zhvillues është në një nivel më të lartë krahasuar me mundësitë. Skenari shqiptar i referohet aspektit të dytë duke kërkuar dinamikë zhvillimi mbështetur në instrument borxhi të brendshëm dhe të jashtëm. Por tani ndodhemi para faktit që Shqipëria nuk ka më mundësi rritjeje të borxhit publik që të sjellë efektet e dëshiruara të përfitimit prej tij në drejtim të rritjes ekonomike, prandaj ajo që synohet është vetëm të tentohet përdorimi i kujdesshëm i tij si amortizues i krizës potenciale. Menaxhimi i kujdesshëm i borxhit publik, si proces i vendosjes dhe zbatimit të një strategjie për menaxhimin e borxhit të qeverisë, për të arritur sasinë e kërkuar të financimit, duke siguruar arritjen e objektivave të saj për rrezikun dhe koston, si dhe duke kontribuar në arritjen e një tregu efikas për letrat me vlerë të qeverisë, është objektivi më imediat. Ky fakt thekson nevojën për rritjen e ndjeshmërisë dhe përgjegjshmërisë së të gjithë strukturave kombëtare apo dhe ndërkombëtare, si të qeverisjes, ashtu edhe të auditimit, në drejtim të problematikës të menaxhimit të borxhit publik. Në kuptimin ekonomik auditimi i hollësishëm i borxhit publik evidenton origjinën e borxhit dhe bën të mundur vlerësimin e llojit të borxhit, faktin nëse është kontraktuar për qëllime të shërbimeve publike apo është rezultat i spekulimeve dhe marrëveshjeve korruptive, me qëllime

përfitimi politik ose ekonomik. Kontrolli i Lartë i Shtetit në funksion të këtij misioni por edhe si pjesë të detyrave të tij funksionale në raportimin e buxheteve faktike vjetore, ka bërë pjesë të raportimeve të veta edhe zbatimin e kufijve të përcaktuar në ligj për borxhin publik, zbatimin e strategjive të hartuara nga qeveria mbi borxhin si dhe menaxhimi i borxhit në tërësi duke e konsideruar me rëndësi auditimin me standarde të menaxhimit të borxhit publik dhe duke dhënë, sidomos në dy vitet e fundit, rekomandime në pamje të parë të forta por tejet të dobishme dhe të rëndësishme për atë që do të sillte viti 2013 dhe e ardhmja e afërt. Si një Institucion Suprem Auditimi me vizion të qartë drejt të ardhmes kërkojmë të ndihmojmë dhe inkurajojmë menaxhimin dhe raportimin e drejtë të borxhit publik dhe për të pasur një qasje drejt praktikave më të mira, kemi sjellë këtë përmbledhje të standardeve të INTOSAI-t, (ISSAI 5410, ISSAI 5411, ISSAI 5421, ISSAI 5422, ISSAI 5440) duke synuar jo vetëm ngritjen e kapaciteteve profesionale tona që merren me problemet e borxhit publik, por edhe rritjen e transparencës lidhur me praktikat që do të udhëheqin punën tonë në auditimin e borxhit publik shtetëror. Kjo kolanë standardesh auditimi lidhur me menaxhimin e borxhit publik vjen në një moment kur ndjeshmëria qeveritare dhe qytetare, lidhur me borxhin shtetëror, është bërë fjala e ditës. Nëpërmjet kësaj përmbledhje standardesh (ISSAI) synojmë ofrimin e një seti të plotë konceptesh dhe treguesish ekonomik, financiar dhe buxhetor, të cilat mund të përdoren në vlerësimet e operacioneve lidhur me menaxhimin e borxhit publik. Një aspekt i rëndësishëm është inkurajimi i publikimit të raporteve dhe dhënia e shpjegimeve sa më të plota që ndikojnë në menaxhimin e borxhit publik në mënyrë sa më efektive. Përmbledhja synon përmirësimin dhe rritjen e profesionalizmit të punës së audituesve të Institucionit Suprem të Auditimit, duke siguruar një kuadër të përgjithshëm dhe të përdorshëm për qasje sa më të përshtatshme në auditimin e borxhit publik, duke ofruar edhe aspekte të kryerjes së testeve të pavarura të auditimit. Gjithsesi, vlerat e kësaj përmbledhje i kalojnë konturet e Institucioneve Supreme të Auditimt dhe mund t'i shërbejnë një audience më të gjerë lexuesish të interesuar për menaxhimin e drejtë të borxhit publik shtetëror. Duke shpresuar se ndihmojmë në njohjen më të thellë të koncepteve të lidhura me auditimin e borxhit publik dhe menaxhimin e tij, urojmë një lexim të këndshëm dhe mirëpresim çdo sugjerim dhe koment në adresën bleskaj@klsh.org.al, mendime që do t'i shërbejnë përsosjes së punës tonë në funksion të mirëmanaxhimit të financave publike në Shqipëri dhe realizimin e misionit tonë kryesor.

BUJAR LESKAJ

Parathënie e librit "Audituesit e KLSH në shtypin e përditshëm"

Vëllimi I, Botim i vitit 2013

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në realizim të misionit të tij kushtetues për të informuar opinionin publik dhe Kuvendin, si dhe në bazë të standardeve profesionale INTOSAI, përkatësisht të Deklaratës së Limës (ISSAI 1, Neni 16, pika 2), dhe të Standardit ISSAI 20 "*Parimet e Transparencës dhe të Përgjegjshmërisë*", Parimi i 8-të, mbi komunikimin në kohë dhe gjerësisht të institucioneve supreme të auditimit nëpërmjet mediave, faqeve në internet dhe mjeteve të tjera, sjell në vëmendjen e lexuesit këtë botim, me shkrime, analiza dhe vrojtime nga drejtuesit dhe audituesit e lartë të institucionit.

Dalja e tyre në median e shkruar të vendit gjatë vitit 2013 përbën një risi për institucionin. Audituesit më me përvojë dhe audites të rinj me ide janë nxitur dhe inkurajuar të shkruajnë në faqet e gazetave dhe revistave mendimet e tyre mbi gjetjet, rekomandimet dhe sygjerimet nga auditimet që kanë kryer.

Temat me të cilat audituesit dhanë sprovat e tyre janë nga më të larmishmet dhe prekin që të gjitha çështje të rëndësishme dhe vitale të administrimit publik dhe të performancës së institucioneve publike. Ato variojnë nga shkrime për llogaridhënien publike, integritetin e qeverisjes dhe rritjen e transparencës, në mundësitë e rritjes së të ardhrurave nga taksat, probelme të administrimit të pushtetit vendor dhe taksave vendore, përparësitë në luftën kundër korrupsionit, risi dhe përsiatje për auditimet e performancës, auditimet financiare, të prokurimeve publike, të shoqërive publike, në auditimet mjedisore, etj.

Kjo gamë e gjerë çështjesh të zhvillimit të shoqërisë dhe ekonomisë shqiptare dëshmon përgjegjësinë dhe përkushtimin e audituesve të KLSH për të ndihmuar, në rradhë të parë qytetarin, me informacion të plotë dhe paraqitjen e problematikës reale të administrimit publik tek ne, por edhe vendimmarësit e institucioneve kryesore të Shtetit me propozime për rrugëdaljet e mundshme.

Për të informuar publikun, dhe njëkohësisht ndihmuar audituesit në punën e tyre, gjatë dy viteve 2012-2013, KLSH përgatiti dhe botoi librat: "KLSH-analiza vjetore 2011", "KLSH në Kuvend", "KLSH-analiza e gjashtëmujorit të parë 2012", "EUROSAI dhe SAI-t Europiane", "Standardet Ndërkombëtare ISSAI" (1, 10, 11, 20, 30, 40, 100 dhe 200), "Historiku i KLSH", pesë edicione të revistës shkencore katërmujore "Auditimi Publik", "Udhëzuesi i Auditimit të Performancës", "KLSH-analiza vjetore 2012", "Performanca ALSAI 2012 (shqip/anglisht)", "Udhëzuesi i Auditimit të Përputhshmërisë", "Raportimi i Auditimit-Guidë", "Standardet e Auditimit të Borxhit Publik (ISSAI 5410-5440)", "Plani Strategjik (KLSH 2013-2017), "Konferenca e Dytë Shkencore e KLSH", dhe "60 vjet INTOSAI-nga Lima në Pekin".

Drejtuesit dhe audituesit e lartë të KLSH e nisën fillimisht bashkëpunimin e tyre personal me mediat, me një ndroje të natyrshme nga mungesa e eksperiencës, por me kalimin e kohës, fituan besim në mundësitë e tyre dhe tani kanë "tharrmin"e duhur për të kontribuar për përmirësimin e qeverisjes edhe nëpërmje pranisë së tyre të përhershme në shtyp.

Shkrimet e tyre janë një numër më i madh se artikujt e përmbajtur në këtë libër, i cili prezanton një përzgjedhje të tyre. Ky botim përbën vëllimin e parë të përmbledhjes me shkrime nga audituesit e KLSH. Ndaj bindjen se shkrimet në vitet e ardhshme do të jenë më të shumta, më cilësore, me problematika të qarta dhe zgjidhje të ofruara për secilën problematikë.

Dua të falenderoj, me këtë rast, të gjithë audituesit e KLSH që, gjatë këtij viti, morën kohën e çmuar nga aktiviteti i tyre auditues dhe kurajon të dalin në mediat e vendit me idetë dhe mesazhet e tyre, duke dhënë një kontribut të patjetërsueshëm në informimin dhe sensibilizimin e opinionin publik të vendit për çështjet e mirëqeverisjes së vendit.

Falenderoj dhe të gjitha mediat e shkruara për gadishmërinë e tyre për tí mirëpritur shkrimet e audituesve të KLSH dhe vëmendjen e profesionalizmin në botimin e tyre.

BUJAR LESKAJ

Parathënie e librit "Konferenca e II-të Shkencore e KLSH-së"

Botim i vitit 2013

Në mbyllje të vitit 2013, Kontrolli i Lartë i Shtetit u fokusua në një drejtim tjetër të punës së tij, atë të kërkimit shkencor, nëpërmjet organizimit të Konferencës së Dytë Shkencore me temë "*Roli i Institucioneve Supreme të Auditimit për një menaxhim publik të përgjegjshëm në sfidat e sotme*". Ky aktivitet erdhi pas Konferencës së Parë Shkencore të KLSH, në dhjetor 2012, të titulluar "77 vjet KLSH në 100 vite Shtet Shqiptar", e cila u përqëndrua në historikun dhe evoluimin në vite të këtij institucionit të rëndësishëm kushtetues.

Konferencën e nderuan me praninë e tyre rreth 120 pjesëmarrës nga SAI-t (Institucione Supreme të Auditimit) partnere dhe bashkëpunëtorët e huaj, këshilltarë të lartë të programit SIGMA, përfaqësues të institucioneve të tjera shtetërore, të botës akademike, të shoqatave të profesionistëve të fushës, të shoqërisë civile dhe mediave, auditues nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, etj.

Një moment i veçantë në zhvillimin e punimeve të konferencës ishte edhe fjala përshëndetëse e Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë, z. Ilir Meta, i cili nënvizoi rëndësinë e kësaj konference por njëkohësisht edhe rëndësinë e posaçme që ka institucioni kushtetues i Kontrollit të Lartë të Shtetit, i cili është "…*pjesë e pandarë e sfidës madhore për të garantuar për sot dhe për nesër akoma më shumë një qeverisje transparente e të përgjegjshme dhe për luftën kundër korrupsionit me qëllim instalimin e plotë të sundimit efektiv të ligjit në vendin tonë. Për Shqipërinë kjo është një sfidë që duhet vetëm të fitohet dhe kam besim të plotë që do ta fitojmë të gjithë së bashku*".

Gjtithashtu, z. Meta theksoi se "…*bashkëpunimi ndërinstitucional është një faktor kyç dhe çelës i suksesit për forcimin e sundimit të ligjit, për rritjen e mëtejshme të transparencës dhe thellimin e mirëqeverisjes dhe sidomos, për të garantuar ndëshkimin e paligjshmërisë. Ndaj, njoh dhe përshëndes kontributin në rritje që jep KLSH-së në këtë drejtim dhe kërkrkoj një bashkëpunim në rritje dhe angazhim edhe më të fortë e efektiv të gjitha hallkave ligj-zbatuese dhe të sistemit të drejtësisë".*

Në Konferencë u trajtuan gjatë dy ditëve 27 tema nga përfaqësues të SAI-ve, të bashkëpunëtoreve të huaj, vendas dhe nga audituesë të KLSH-së dhe u përqendruan në këto drejtime kryesore:

- *Rëndësia e rritjes së rolit mbikëqyrës mbi financat e Shtetit të auditimit publik, parë në këndvështrimin edhe të kontekstit të krizës ekonomike mbarëbotërore.*
- *Transparenca dhe cilësia e informacionit për publikun si kushte të domosdoshme për forcimin e disiplinës financiare në sektorin publik.*
- *Ndërveprimi i auditimit të jashtëm me auditimin e brendshëm publik në funksion të mirëadministrimit dhe qeverisjes më të mirë .*
- *Këshillimi dhe rritja e cilësisë audituese përmes auditimeve të performancës;*

Punimet shumë interesante, parë në këndvështrimin e eksperiencave të ndryshme dhe të faktorëve dhe aktorëve që lidhen me punën e SAI-ve i dhanë Konferencës nivel shkencor, interes dhe ngjallën debat.

Në konferencë u theksua nevoja që kanë Institucionet supreme të auditimit (SAI-t) që të shkëmbejnë mendime për gjetjet e auditimeve të tyre, të ndajnë metodologjinë e përparuara dhe të përfitojnë nga inovacioni në teknikat dhe përafrimet audituese të njëri-tjetrit. Kërkimi i aplikuar shkencor në auditimin publik e ndihmon pikërisht këtë nevojë të SAI-ve për progress dhe efikasitet të shtuar.

Ngjallën interes kumtesat e përfaqësuesit të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit të Komisionit Evropian për "Përgjegjshmërinë menaxheriale si parakusht për qeverisje të mirë dhe faktor kryesor për sigurimin e përdorimit të foneve publike" dhe të përfaqësuesit të Gjykatës Evropiane të Audituesve për "Rëndësinë e rritjes së rolit mbikëqyrës mbi financat shtetërore të auditimit publik, në kontekstin e krizës ekonomike botërore".

Vlerë të shtuar për këtë konference ishin edhe kumtesat e përfaqësuesve nga SAI-t partnere të Zyrës Kombëtare të Auditimit-NIK të Polonisë, të Gjykatës së Llogarive të Turqisë, të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Suedisë, të Zyrës së Audituesit të

Përghithshëm të Kosovës, të Zyrës Shtetërore të Auditimit të Maqedonisë dhe veçanërisht të përfaqësuesve të SIGMA, etj.

Punimet e audituesve të KLSH-së në bashkëpunim me përfaqësues të botës akademike dhe të profesionistëve të kontabilitetit dhe të auditimit në vend sollën një panoramë origjinale të realitetit të sotëm shqiptar në fushën e auditimit dhe më gjerë.

Mesazhi më i rëndësishëm që Konferenca përçoi ishte që auditimi kombëtar duhet të vihet në shërbim të qeverisjes kombëtare, për përmirësimin e menaxhimit publik financiar të vendit.

Organizimi i konferencave shkencore të KLSH-së është edhe pjesë e zbatimit të Strategjisë së institucionit për periudhën 2013-2017, ndër objektivat e së cilës janë "Rritja e kapaciteteve audituese dhe e cilësisë së auditimit", ku theksohet: *….KLSH do të organizojë, duke filluar nga viti 2013, konferencën shkencore vjetore "Për auditimin e jashtëm publik në Shqipëri", dhe "Rritja e ndikimit përmes Komunikimit dhe Bashkëpunimit".* Rritja e kapaciteteve audituese dhe e cilësisë së auditimit bazohet edhe në bashkëpunimin me SAI-t partnere dhe me botën akademike e organizatat profesionale të fushës, bashkëpunim që u realizua më së miri përgjatë kësaj conference.

Tema dhe mesazhet qëndrore të këtij aktiviteti përkuan me rekomandimet e Kongresit të Pekinit të INTOSAI-t, INCOSAI XXI, në tetor 2013, mbi forcimin e kontributeve kombëtare dhe ndërkombëtare të INTOSAI-t dhe SAI-ve të vendeve të ndryshme për promovimin e qëndrueshmërisë së financave publike. Njëlloj si Kongresi i fundit I INTOSAI-t, konferenca dha mesazhin se menaxhimi i shëndoshë i financave publike dhe politikat financiare të përshtatshme japin një kontribut të rëndësishëm në krijimin dhe mbajtjen e një klime financiare të favorshme. Në një linjë me INCOSAI XXI, Konferenca e KLSH kërkoi një harmonizim të kornizave të raportimit financiar në sektorin public, duke dhënë më tepër transparencë në lidhje me veprimtaritë e qeverisë, në veçanti për sa i përket borxhit publik.

Punimet e Konferencës treguan edhe njëherë në praktikë suksesin dhe koherencën e motos së INTOSAI-it "*Experentia mutual omnibus prodest (Eksperienca e Përbashkët u shërben të gjithëve).*

Konferenca e dytë Shkencore u organizua nga KLSH, me mbështetjen e Programit SIGMA përmes një ndihme modeste financiare dhe mbi të gjitha ekspertizës së z. Joop Vrolijk, Këshilltar I SIGMA-s.

Një falënderim i veçantë për z. Robert Gielisse, Drejtor Njesie në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit (DG-Budget) të Komisionit Evropian, i cili nderoi

Konferencën me praninë dhe diskutimin e tij interesant, si dhe për z. Joop Vrolijk dhe z. Jacek Jezierski, të cilët pranuan propozimin tim dhe ishin bashkë-drejtues të kësaj konference shkencore.

Dëshiroj të falënderoj së fundmi të gjithë referuesit dhe bashkëpunëtorët e tyre nga fusha akademike, pjesëmarrësit dhe veçanërisht ata që ndihmuan financiarisht për realizimin e konferencës si edhe stafin ndihmës për kontributin që dhanë në realizimin me sukses të saj.

Me bindje të thellë, tashmë mund të pohoj që Kontrolli i Lartë i Shtetit, do të vazhdojë punën e nisur në këto dy vite dhe në vjeshtë të viti 2014 do të zhvillojë punimet Konferenca e tretë Shkencore e KLSH-së. Sikurse theksoi z. Gielisse dhe bashkëdrejtuesit e Konferencës, *ky aktivitet mposhti muret e skpeticizmit nga mungesa e përvojës së SAI-t shqiptar dhe konturoi vlera shkencore në kumtesat që prezantoi dhe diskutimet ndaj gjetjeve dhe mesazheve të tyre.*

BUJAR LESKAJ

Parathënie e librit "Plani Strategjik KLSH 2013-2017, INTOSAI 2011-2016, EUROSAI 2011-2017"

Botim i vitit 2013

Dr Josef Moser, Presidenti i Gjykatës Austriak të Auditimit dhe Sekretar i Përgjithshëm i INTOSAI, në fjalën e tij në Simpoziumin e 21-të të Përbashkët OKB- INTOSAI për Auditimin e Qeverisë, të mbajtur në Vjenë më 13-15 korrik 2011, theksoi se "Strategjitë e qarta i ndihmojnë SAI-t për të luajtur një rol themelor në ruajtjen e parimeve të qeverisjes së mirë, transparencës dhe llogaridhënies, në mënyrë të veçantë në promovimin e efektivitetit të sektorit publik ... Si SAI, ne do të njihemi për punën tonë, vetëm nëse arrijnë të komunikojmë në mënyrë të qartë te qytetarët atë që ne bëjmë dhe vlerën e shtuar që ne gjenerojmë për Shtetin dhe shoqërinë, në mënyrë që ne të perceptohemi si institucione strategjike të domosdoshme, që i shërbejmë interesave të qytetarëve". Arsyeja e përgatitjes së këtij botimi qëndron tek roli dhe misioni gati i njëjtë që kanë institucionet supreme të auditimit publik (SAI). Ky rol dhe mision është thelbësor për fatet e mirëqeverisjes publike kudo në botë. Ne si Kontroll i Lartë i Shtetit, si institucioni suprem i auditimit publik (SAI) në vend, kemi përgatitur dhe po realizojmë, me ndihmën e ekspertëve të SIGMA(të cilët i falënderojmë, në mënyrë të veçantë z. Joop Vrolijk) Planin Strategjik të Zhvillimit 2013-2017. Ky plan është në linjë me misionin, vizionin, qëllimet strategjike dhe vlerat e Planit të Zhvillimit Strategjik 2011-2016 të INTOSAI dhe 2011-2017 të EUROSAI. Lidhja e objektivave të zhvillimit të këtyre dy komuniteteve ndërkombëtare(njëri komunitet botëror dhe tjetri evropian) të auditimit publik suprem me objektivat tona është organike. Një lidhje strukturore(si grupi i njëjtë i gjakut), e fortë, shumë e veçantë, që buron nga misioni i SAI-ve, për përmirësimin e qeverisjes publike, nepermjet rritjes se llogaridhënies dhe transparences. Si çdo institucion tjetër suprem auditimi që kërkon të zhvillohet, ne si KLSH ndajmë të njëjtat vlera, aspirata dhe synime me SAI-t partnere dhe me komunitetet e zhvilluara të



SAI-ve. Ato janë Bashkëpunimi, Gjithëpërfshirja, Rinovimi, Profesionalizmi, Integriteti dhe Kredibiliteti.

Në linjë me Deklaratën e Pekinit të datës 26 tetor 2013 të Kongresit të XXI të INTOSAI, që thekson se "Auditimi kombëtar duhet të vihet në shërbim të qeverisjes kombëtare për përmirësimin e menaxhimit publik financiar", objektivat Nr. 1 strategjik i INTOSAI dhe ai Nr. 2 i EUROSAI, që janë zhvillimi i standardeve profesionale ISSAI, përshtaten dhe realizohen tek strategjia ALSAI me objektivat 2, 3 dhe 4. Ato janë Rritja e kapaciteteve audituese dhe e cilësisë së auditimit(2), Përmirësimi i cilësisë dhe shtimi i numrit të auditimeve të performancës(3) dhe Zhvillimi dhe konsolidimi i auditimeve të Teknologjisë së Informacionit dhe përdorimi i TI në auditim(4). Objektivi i tretë strategjik si i INTOSAI dhe EUROSAI, "Shkëmbimi i njohurive", si dhe objektivi i katërt i ALSAI "Qeverisja dhe komunikimi", janë të pasqyruara në objektivin e 6-të të ALSAI, "Rritja e ndikimit të KLSH përmes Komunikimit dhe Bashkëpunimit". Një ide qëndrore i lidh si strategjitë INTOSAI dhe EUROSAI, ashtu dhe strategjinë e KLSH dhe ajo është moto e INTOSAI:"Experentia Mutua Omnibus Prodest (Eksperienca e përbashkët u shërben të gjithëve)". Nga kjo moto burojnë të gjitha nismat strategjike të KLSH, të orientuara dhe nga rekomandimi i Progres Raportit 2013 të BE-së për Shqipërinë, ku theksohet se "auditimi i jashtëm duhet të vijë në linjë me standardet INTOSAI". Duam të veçojmë Objektivin tonë të pestë, edhe pse ai mbështetet në mesazhet dhe idetë qëndrore të Kongresit të XXI të INTOSAI në Pekin në tetor 2013, për përmirësimin e qeverisjes publike. Ky objektiv, "Rritja e kontributit të KLSH për qeverisjen e mirë, nëpërmjet luftës kundër korrupsionit", është disi specifik, ngaqë merr në konsideratë pritshmëritë e qytetarëve shqiptarë për të luftuar korrupsionin dhe anti-kulturën e pandëshkueshmërisë tek ne. Misioni i ALSAI është "Informimi i publikut dhe i Kuvendit të Shqipërisë në lidhje me përdorimin e burimeve me ekonomicitet, efektivitet dhe efiçiencë nga pushteti qëndror dhe lokal dhe nga njësi të tjera publike, si dhe nxitja e përgjegjeshmërisë në të gjithë sektorin publik, në përputhje me praktikat më të mira të BE dhe me standartet ndërkombëtare të INTOSAI, duke kontribuar për qeverisjen e mirë, nëpërmjet luftës kundër korrupsionit". Ky mision mund të realizohet në praktikë vetëm duke unifikuar orientimet strategjike të EUROSAI, INTOSAI dhe të vetë ALSAI.

BUJAR LESKAJ

Parathënie e librit "60 vjet INTOSAI, 50 vjet Sekretariati i Përgjithshëm"

Botim i vitit 2014

Organizata e institucioneve supreme të auditimit, INTOSAI është struktura e dytë ndërkombëtare më e madhe, pas Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), me 192 SAI(Institucione Supreme të Auditimit) anëtare dhe 5 SAI të asociuara. Që nga themelimi në vitin 1953, në zbatim të motos së saj *"Experientia Mutua Omnibus Prodest"* (Eksperienca e përbashkët u shërben të gjithëve), INTOSAI ka shkëmbyer dije dhe ka nxitur bashkëpunimin me SAI-ve anëtare, duke iu përmbajtur vlerave themelore të institucioneve të auditimit më të lartë publik, si, pavarësia, integriteti, profesionalizmi,besueshmëria,përfshirja, bashkëpunimi dhe inovacioni.

INTOSAI është ndërtuar dhe funksionon si një organizatë e përhershme profesionale, autonome, e pavarur dhe jopolitike e institucioneve supreme të auditimit dhe i përfaqëson ato në raportet me OKB, me organizatat e tjera ndërkombëtare dhe me donatorët ndërkombëtarë. Ajo ka marrëveshje me 22 institucione donatore dhe përgatit e lançon programe e thirrje për projekte zhvillimi dhe ndërtimi kapacitetesh për të gjitha SAI-t kudo në botë. E organizuar për të funksionuar si në nivel botëror ashtu dhe rajonal, INTOSAI ka gjashtë struktura rajonale, ndër të cilat nga më kryesoret është EUROSAI, organizata evropiane e institucioneve supreme të auditimit. INTOSAI e bazon aktivitetin e saj të përditshëm tek Sekretariati i Përgjithshëm, me seli në Vjenë, nga viti 1963 dhe i merr vendimet kryesore, nëpërmjet Kongresit të saj, të quajtur INCOSAI, i cili mblidhet çdo tre vjet.



Në këto 61 vite ekzistence, INTOSAI ka organizuar 21 kongrese dhe me qindra forume, simpoziume të përbashkëta me OKB-në, workshope, seminare dhe aktivitete të tjera rajonale e planetare, që lidhen me ndërtimin dhe zhvillimin e kapaciteteve

audituese, si dhe ka pasur arritje të shumta përsa i përket pavarësisë, rritjes së kompetencave, efiçiencës dhe qëndrueshmërisë së SAI-ve.

Që nga viti 1992, organizata ka përgatitur dhe publikuar një gamë të gjerë standardesh, udhëzuesish dhe praktikash më të mira, të quajtura ISSAI, të cilat i kanë ndihmuar dhe i ndihmojnë në praktike SAI-t në të gjithë botën, për të rritur pavarësinë, forcuar identitetin dhe shtuar kapacitetet e tyre profesionale.

Ndër dokumentet themelore të INTOSAI-t janë Deklarata e Limës e vitit 1977, e quajtur ndryshe Magna Carta ose Kushtetuta e institucioneve supreme të auditimit dhe Deklarata e Meksikos e vitit 2007 për forcimin e pavarësisë së SAI-ve.

Që nga viti 2004, INTOSAI ka përgatitur dhe implementuar dy plane strategjike zhvillimi 2005-2010 dhe 2011-2016, duke përcaktuar qëllime strategjike, vlera dhe prioritete, si dhe duke fituar besimin dhe vlerësimin e SAI-ve, për sa i përket çështjeve të planifikimit strategjik, diversifikimit të strukturës organizative dhe rritjes se kapaciteteve audituese nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencave më të mira.

INTOSAI ka rritur njohjen ndërkombëtare nëpërmjet Rezolutës A/ 66/209 të datës 22 dhjetor 2011 të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së. Në këtë rezolutë, Asambleja vlerësoi punën e bërë nga INTOSAI në promovimin më të madh të efektivitetit, përgjegjshmërisë, transparencës dhe përdorimin e burimeve publike me efektivitet dhe eficiencë për të mirën e qytetarëve, njohu parimet e pavarësisë të përcaktuara në deklaratat e Limës dhe Meksikos, si dhe inkurajoi shtetet anëtare dhe parlamentet e tyre që të zbatojnë parimet e përmbajtura në këto Deklarata, në përputhje me strukturën kombëtare institucionale.

Në fushën e menaxhimit publik, kjo organizatë po tërheq gjithnjë e më tepër vëmendjen e grupeve të shumta të interesit, në radhë të parë të institucioneve ndërkombëtare si OKB, FMN, Banka Botërore, Banka Evropiane për Rindërtim e Zhvillim, etj, duke u kthyer në një organizëm "standard-bërës" shumë i nevojshëm dhe një lojtar shumë i rëndësishëm në përmirësimin e qeverisjes kombëtare dhe rregullave të auditimit ndërkombëtar.
Në zbatim të Planit Strategjik të Zhvillimit 2011-2016, INTOSAI po promovon përmirësime të vazhdueshme mes anëtarëve të saj, duke inkurajuar bashkëpunimin intensiv mes tyre (Objektivi 3), si dhe duke studiuar fusha dhe metodologji të reja auditimi, përmes strukturës së saj shumë të rëndësishme, Institutit të Zhvillimit (IDI). Me krizën mbarë botërore financiare dhe ekonomike, SAI-t dhe vetë INTOSAI po përballen me kërkesa në rritje të grupeve të interesit dhe me çështje të reja auditimi, që kërkojnë që metodologjitë audituese të ndryshojnë me shpejtësi. Çështje të tilla si zhvillimi i qëndrueshëm i financave publike, qeverisja kombëtare, siguria kombëtare,

pjesëmarrja qytetare, evoluimi i politikave, rregulloret e sistemit financiar, si dhe auditimi investigativ janë kthyer në sfidat dhe objektivat më të reja për SAI-t dhe organizatën e tyre.

Përmes përgatitjes së standardeve profesionale, ngritjes së kapaciteteve institucionale dhe shkëmbimit intensiv të njohurive, INTOSAI, krahas garancisë së rritjes së pavarësisë së SAI-ve anëtare, ka ofruar dhe po ofron një kontribut jetik për promovimin e qeverisjes së mirë, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies dhe luftimin e korrupsionit, duke kontribuar në shërbime më të mira ndaj qytetarëve dhe forcimin e besimit të publikut në qeverisjen publike.

KLSH është anëtare e INTOSAI-t nga viti 1984 dhe mbas vitit 1992, ka marrë pjesë në të gjitha aktivitetet kryesore të organizatës, duke u kthyer në anëtar aktiv i strukturës së saj rajonale, EUROSAI-t. Ky aktivitet ka ardhur në rritje gjatë tri viteve të fundit, ku KLSH është përfaqësuar në grupet e punës të EUROSAI-t, duke dhënë kontributin e tij modest.

Gjatë periudhës 2012-2014, në përputhje me objektivat themelorë të Strategjisë së Zhvillimit të KLSH 2013-2017, aktiviteti auditues i institucionit ka synuar zbatimin e plotë të standardeve profesionale të INTOSAI-t, si nëpërmjet trajnimeve intensive brenda dhe jashtë vendit, me ekspertë të njohur të huaj e vendas, ashtu dhe me botimin e 30 librave për auditimin suprem, duke përshtatur në shqip përmbledhje të ISSAI-ve kryesore, duke përkthyer dhe përshtatur udhëzues për auditimin e performancës, shënimet praktike të auditimit financiar, standardet ISSAI për auditimin e borxhit publik, standardet ISSAI për auditimin mjedisor, etj.

Krahas këtyre botimeve profesionale, KLSH ka botuar në kolanën e tij librin "EUROSAI", që prezanton Organizatën Europiane të Institucioneve më të Larta të Auditimit, duke dhënë profile për secilin nga 50 SAI-t evropiane, si dhe librin "Historiku i Kontrollit të Lartë të Shtetit", ku evidentohen fillesat e Institucionit Suprem të Auditimit në Shqipëri nga viti 1925, si dhe format që ai ka marrë në rrjedha të ndryshme të historisë së shtetit shqiptar, duke vlerësuar të gjithë ata që ndihmuan në formësimin e institucionit si një institucion bazë i shtetit shqiptar.

BUJAR LESKAJ

Parathënie e librit "KLSH Analiza vjetore 2013"

Botim i vitit 2014

Në bazë të Deklaratës së Limës (Kushtetuta e Institucioneve Supreme të Auditimit), Neni 16, Pika 1 dhe të ISSAI 8 " Mbi Transparencën dhe Përgjegjshmërinë", Parimet 7 dhe 8, si dhe në realizim të Misionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, i përcaktuar qartë në Strategjinë e tij të Zhvillimit 2013-2017, si…"*Informimi i publikut dhe i Kuvendit të Shqipërisë në lidhje me përdorimin e burimeve me ekonomicitet, efektivitet dhe eficiencë, nga pushteti qendror, local dhe nga njësi të tjera publike, si dhe nxitja e përgjegjshmërisë në të gjithë sektorin publik, në përputhje me praktikat më të mira të BE dhe me standardet ndërkombëtare të INTOSAI, duke kontribuar për qeverisjen e mirë, nëpërmjet luftës kundër korrupsionit*", KLSH paraqet përpara lexuesit këtë botim të ri.

Në përputhje të plotë me standardet INTOSAI dhe misionin e tij, KLSH e mbështet veprimtarinë, ndër të tjera, në parimin e transparencës, duke bërë të njohura për publikun e gjerë raportet e tij të auditimit, gjithnjë në përputhje me ligjin dhe rregullat, me bindjen më të plotë se transparenca i shërben publikut dhe rrit besimin e tij ndaj institucionit të KLSH. Kjo transparencë, mundëson nga ana tjetër, edhe monitorimin e veprimtarisë së KLSH-së nga publiku, si edhe rritjen e besimit të publikut ndaj qeverisjes.

Në këtë qasje të re ndaj publikut, KLSH ka botuar analizën e veprimtarisë së tij në dy vitet e fundit dhe po vijon traditën dhe stadardin e krijuar, duke i sjellë lexuesit shqiptar botimin e 23-të në kolanën e botimeve të KLSH-së, "*KLSH, Analiza vjetore, 2013".*

Është viti i tretë që KLSH zhvillon në këtë format analizën e veprimtarisë së tij, duke bërë një bilanc të aktivitetit njëvjeçar, duke vlerësuar atë që është arritur, evidentimin e

mangësive, reflektimin mbi to, si dhe kryerjen e analizave, me qëllim përmirësimin e punës në të ardhmen. Dua të nënvizoj faktin se vijmë në këtë analizë mbasi në çdo Departament dhe Drejtori kemi zhvilluar analiza të plota dhe konstruktive, me prezencë të grupeve të interest.

Dëshiroj të falënderoj personalitetet e jetës politike dhe publike shqiptare që vlerësuan aktivitetin dhe na nderuan me pjesëmarrjen e tyre: Presidentin e Republikës së Shqipërisë, SH.T.Z. Bujar Nishani; Ambasadorin e BE,SH.T.Z Ettore Sequi; Prokurorin e Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë, Z. Adriatik Llalla; Kryetaren e Komisionit për Integrimin Europian në Kuvendin e Shqipërisë, znj. Majlinda Bregu; Zv. Ambasadorin e OSBE, SH.T.Z. Robert Willton, Sekretarin e Komisionin për Ekonominë dhe Financat në Kuvendin e Shqipërisë, Prof. Dr. Anastas Angjeli, deputetë, përfaqësues të shoqërisë civile, etj. Mesazhet e përcjella prej tyre kanë rëndësi parësore për KLSH, jo vetëm për vlerësimin, përkrahjen dhe inkurajimin e audituesve të tij, por edhe për rekomandimet e vyera që do ti vlejnë përmirësimit të punës së institucionit në të ardhmen.

Viti 2013 ka qenë vit i konsolidimit të arritjeve të nisura në vitin 2012 dhe vit në të cilin institucioni ka marrë fizionominë e një institucioni modern me qasje evropiane.

Për këto arritje, falenderimi im shkon natyrshëm tek të gjithë audituesit dhe punonjësit e Kontrollit të Lartë të Shtetit, të cilët me punën e përkushtuar dhe profesionalizmin e tyre kanë bërë të mundur përmbushjen e objektivave dhe realizimin e detyrave të vitit 2013.

BUJAR LESKAJ

Parathënie e librit "Revista Ndërkombëtare e Auditimit të Jashtëm Publik"

Botim i vitit 2014

Ky botim, Revista Ndërkombëtare e Auditimit të Jashtëm Publik, Janar 2014, volumi 41, Nr.1, vjen pranë jush si pjesë e kolanës së botimeve të KLSH-së, të cilat kanë arritur në 25 përgjatë viteve 2012, 2013 dhe gjysmës së parë të vitit 2014. Këto botime përfshijnë kryesisht botimin e standardeve të ndryshme që lidhen me veprimtarinë e KLSH-së, konferencat shkencore të realizuara dhe Revista "Auditimi Publik", deri tani në edicionin e shtatë të saj.



Në bazë të standardit ISSAI 20, Parimi 8 për komunikimin me publikun dhe në publik të informacionit dhe gjetjeve të institucioneve supreme të auditimit (SAI-ve), KLSH publikon këtë botim të numrit special të Revistës Ndërkombëtare të INTOSAI Journal of Government Auditing, janar 2014. Ky edicion special i revistës, i kushtohet tërësisht punimeve dhe mesazheve qendrore të Kongresit INCOSAI XXI të tetorit 2013 në Pekin, Kinë. INCOSAI XXI konsiderohet një nga kongreset më të rëndësishëm të komunitetit të institucioneve të auditimit të jashtëm publik, pas atij të Limës në 1977 dhe të Meksikos në vitin 2007, duke evidentuar edhe një herë rëndësinë e motos së INTOSAI- Me shpërthimin e krizës globale ekonomike dhe financiare të vitit 2009, roli i SAI-ve në shëndoshjen dhe qëndrueshmërinë e financave publike të vendeve të tyre mori përmasa të reja. Po ashtu, përgjegjësia e SAI-ve dhe pritshmëritë e qytetarëve ndaj kontributeve të tyre janë sot më të mëdha. Kongresi dhe mesazhi qendror i tyre është se, SAI-t me auditimet e tyre duhet të vihen në shërbim të qeverisjes kombëtare.

Botimi përfshin intervistat e Presidentit të ri të INTOSAI-t, Liu Jayi, Auditues i Përgjithshëm i Kinës dhe ish-Presidentit të INTOSAI-t, z. Terence Nombembe, Auditues i Përgjithshëm i Afrikës së Jugut, të përqëndruara në vlerat që shpalosin SAI-t dhe INTOSAI, si dhe në të ardhmen e rolit të tyre në raport me qëndrueshmërinë e financave publike të çdo vendi, me OKB-në, me komunitetin ndërkombëtar të donatorëve, etj. Ai përmban Deklaratën e Pekinit, një nga dokumentet më të rëndësishëm të auditimit të jashtëm publik botëror, që përbën një orientim dhe program të plotë për çdo SAI modern sot, si dhe raportimet për aktivitetet e Komiteteve dhe Nënkomiteteve të Përhershëm të INTOSAI-t, të grupeve të tij të punës, arritjeve të tyre dhe problematikave të hasura e sfidave për të ardhmen.

Numri Special i revistës së INTOSAI- vjen tani në formatin e tij në shqip, jo vetëm për komunitetin e audituesve publikë të Shqipërisë, por edhe për çdo qytetar që dëshiron të dijë më shumë për rolin dhe sfidat e sotme të institucioneve kushtetuese që japin garancinë e përdorimit të fondeve publike- institucioneve supreme të auditimit, SAI-ve.

Qytetari pret sot më shumë përgjegjshmëri dhe angazhim nga institucionet publike, përballë pasojave të krizës ekonomike dhe financiare botërore. SAI-t dhe organizata e tyre botërore INTOSAI, janë të gatshme të përballen me këtë pritshmëri dhe sfidë dhe ky botim i sjellë në vëmendje të lexuesit shqiptar nga KLSH, e dokumenton më së miri këtë.

BUJAR LESKAJ

Parathënie e librit "Udhëzues për Auditimin e Mjedisit"[119]

Botim i vitit 2014

Gjatë 20 viteve të fundit, vetëdija globale, por edhe lokale në lidhje me çështjet mjedisore është rritur me shpejtësi, madje me theks të veçantë në çështje të tilla si degradimi i tokës, ndotja e ujit, ndotja e ajrit, mbi-peshkimi, shkatërrimi i shtresës së ozonit, shkatërrimi i pyjeve nga shirat acid dhe ngrohja globale. Rritja e njohurive dhe përvojës për çështjet mjedisore gjatë kësaj periudhe, kanë çuar në ri-konceptimin e rolit dhe përgjegjësive të SAI-ve. Nga ana tjetër, shumica e problemeve mjedisore kanë karakter edhe ndërkufitar. Shpesh ato kapërcejnë kufijtë kombëtarë, si për shembull cilësia e ujit në lumenjtë kryesorë, rezervatet e peshkut, mbi-peshkimi dhe gjurmimi i krimit mjedisor. Pra, problemet e mësipërme mjedisore janë sa probleme lokale, po aq edhe globale.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, si organ Kushtetutes është hallka më e rëndësishme në Shqipëri për vetë faktin se është një institucion publik i pavarur, i cili po ushtron dhe kontrollon perfomanca të caktuara mjedisore apo si janë realizuar objektivat e përcaktuara në punën e tyre, në të gjitha institucionet e linjës të pushtetit qendror dhe vendor. Ndaj dhe jo pa qëllim, sillen në shqip botimet e përkthyera të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 5110, 5120, 5130 e 5140, në të cilat trajtohen respektivisht çështje të mëdha mjedisore si Auditimi i Performancës së Mjedisit, Auditimi i Mjedisit dhe i Rregullshmërisë, Zhvillimi i Qëndrueshëm dhe Roli i Institucioneve Supreme të Auditimit, si dhe Auditimet Mjedisore të Marrëveshjeve Ndërkombëtare, që

[119] Kjo parathënie është përgatitur në bashkëpunim me Prof. As. Dr. Sazan Guri

sot duhet të jetë pjesë e punës së çdo audituesi në këtë Institucion.

Këto botime na ofrojnë qasje dhe shembuj ndërkombëtarë, sesi një auditues, në kontekstin e auditimit të performancës së një subjekti që zbaton programet dhe aktivitetet e Qeverisë për mjedisin, të preokupohet dhe të kryejë në kushtet e vendit Auditimin e Sistemeve të Menaxhimit të Mjedisit.

Aktualisht, auditimi mjedisor shtron para gjithë audituesve të KLSH një sfidë të veçantë, duke i përgatitur ata për të përmirësuar e zhvilluar teknika dhe metodologji të reja në zbërthim të çështjeve, të cilat janë lënë pas dore më parë, dhe që sot nga KLSH-ja ato kanë marrë kuptim, siç janë: Iniciativat për të parandaluar ose zvogëluar dëmet në mjedis; Ruajtja e burimeve të rinovueshme dhe jo të rinovueshme; Pasojat e shkeljeve të ligjeve dhe rregulloreve mjedisore, si dhe Pasojat e përgjegjësisë së deleguar nga shteti.

Në fakt, sikundër paraqesin katër ISSAI-t e këtij botimi, vetë KLSH-ja me risitë e saj, këto vitet e fundit ka mundur të realizojë Auditime të Performancës së veprimtarive mjedisore, ku audituesi të caktuar janë bërë pjesë e filozofisë për të inkurajuar subjektet e audituara në mënyrë të tillë që të raportojnë paanshmërisht në performancën e tyre mjedisore. Një aspekt tjetër që na mësojnë këto botime, si dhe eksperienca e fituar deri më tash është kushtimi i vëmendjes që duhet të shoqërojë një auditues ndaj dëmit mjedisor apo mënyrave të restaurimit të tij. Këto koncepte për KLSH përkufizohen si standarde të reja që lidhen me mjedisin. Nga ana tjetër, me anë të këtyre botimeve, që njëherazi përkojnë me frymën aktuale të KLSH, mësojmë se një perfomancë mjedisore nënkupton edhe llogaritjen aktuale të kostove të saj apo të vlerës reale të dëmeve në natyrë, si dhe përfitimet që vijnë prej kësaj perfomance. Ndaj dhe KLSH ndodhet pranë procesit të adoptimit të politikave dhe procedurave për të rekrutuar personel me kualifikime të përshtatshme.

Në fund të çdo auditimi, sipas standardeve ndërkombëtare të auditimit, audituesit duhet të arrijnë të përgatisin një raport ose opinion të shkruar, duke përcaktuar gjetjet në formë të përshtatshme, me përmbajtje të lehtë për t'u kuptuar, të qarta, të pavarura, objektive, të drejta dhe konstruktive, ku informacioni mbështetet nga evidenca kompetente dhe relevante auditimi (siç janë rastet e Perfomancës Mjedisore e Menaxhimitt të Mbetjeve në Bashkinë e Fierit, Menaxhimi i Pyjeve në Drejtorinë e Tiranës, Perfomanca Mjedisore në AKM, Tiranë, etj.).

Nga vetë aktiviteti i KLSH, sot, dhe nga vetë këto botime kupton sesi çështjet e mjedisit mund të adresohen brenda auditimit të rregullshmërisë, dhe sesi mund të aplikohen si duhet standardet profesionale të kontabilitetit. Ndaj, dhe audituesi duhet të gjej metoda dhe praktika, ku mund të ndërmarrë kontrolle mjedisore për të kryer auditime rregullshmërie (financiare dhe përputhshmërie) ose auditime performance, siç janë të përcaktuara në Standardet e Auditimit INTOSAI. Erdhi koha, në mos ka kaluar, që Audituesi duhet të marrë

në konsideratë kostot aktuale dhe potenciale, si dhe ndikimet e tyre në çështjet mjedisore. Por, gjatë kryerjes së auditimeve të mjedisit, del e nevojshme përcaktimi i kritereve teknike, sipas të cilave do të bëhet kontrolli i performancës së një subjekti të caktuar, të cilat e mundësojnë audituesin të përcaktojë, nëse subjekti raportues ka njohur, vlerësuar dhe raportuar kostot mjedisore, detyrimet dhe asetet. Janë këto kritere që e bëjnë audituesin të kontrollojë e të raportojë mbi rëndësinë e treguesve të perfomancës, nëse ai realisht reflekton një detyrim statutor apo një objektiv performance apo mbi kuptueshmërinë e tyre nëse treguesit e perfomancës janë të pagabueshëm dhe llogjika/arsyeja e tij, është e dallueshme dhe identifikueshme dhe/ose serioziteti i treguesve të performances, nëse përfaqëson në mënyrë të drejtë, një karakteristikë matëse të performancës së një funksioni apo rezultati.

Sigurisht që problemet me mjedisin, as në botë e as në vendin tonë, nuk mund të zgjidhen menjëherë, dhe as gradualisht vetëm nga veprimtaria e Audituesve. Megjithatë, rolit të tyre i kushtohet besim, pasi ata janë një hallkë e rëndësishme në këtë zgjidhje. Roli i tyre, sikundër po shfaqet në auditimet e viteve të fundit të perfomancës së problemeve mjedisore, është t'i përgjigjet pritshmërive të qytetarëve, duke ofruar informacione dhe verifikime të pavarura, të besueshme dhe objektive, mbi ndikimet që kanë veprimtaritë e agjencive publike në mjedis. Auditimi i veprimtarive mjedisore financiare, i jep mundësi audituesit të shpreh një opinion, nëse këto dokumente janë përgatitur në përputhje me kuadrin e raportimit financiar. Ai gjithashtu tregon sesi "aspektet materiale" mund të lidhen direkt me kostot mjedisore, detyrimet, ndikimet dhe rezultatet. Në këtë kontekst, auditimi të tilla, kërkojnë që audituesi të marrë në konsideratë çështjet mjedisore, si pjesë e auditimit të rregullshmërisë. Veç kësaj, audituesi duhet të jetë edhe në dijeni të zhvillimeve të vazhdueshme, si për shembull njohja e aseteve mjedisore. Ata duhet të kërkojnë mundësi inkurajimi që klientët e tyre të fokusohen drejt praktikave më të mira - si për shembull, përgatitja e Raporteve Mjedisore. Auditimi i veprimtarive mjedisore financiare përbën sfidë tjetër të audituesve, sepse ato mund të kenë ndikim mbi dokumentet financiare. Gjithsesi, ndikimet në mjedis, nuk janë domosdoshmërisht të kufizuara vetëm në një periudhë të caktuar dhe mund të lind nevoja që edhe të projektohen. Për këtë arsye, audituesve mund t'iu nevojitet të zhvillojnë një metodologji për të shqyrtuar ndikimin e aktiviteteve mbi çështjet mjedisore, ndoshta për periudha më të gjata se viti kontabël. Por, ajo që bën të orientohet lehtë një auditues është mbështetja në konceptin mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm, ku çdo aktivitet ekonomiko-industrial ruan standartet ekonomiko-sociale, kënaq nevojat e brezave dhe nuk dëmton mjedisin. Një aspekt tjetër i audituesve, jo vetëm shqiptar është edhe bashkëpunimi i tyre në Auditimin Ndërkombëtar të Mjedisit, të cilat mund të kryhen, si auditime përputhshmërie ose si

auditime performance. Titujt e botimeve të KLSH-së në këto tre vitet e fundit janë vërtet impresionues (deri tani 30 botime), si për larmishmërinë e temave, ashtu dhe për sasinë e informacionit që përmbajnë si për lexuesit e fushës së auditimit dhe të ekonomisë, ashtu edhe për lexuesin e thjeshtë të interesuar për fushën e auditimit.

Të gjitha botimet e KLSH-se i shërbejnë së pari forcimit të kapaciteteve të institucionit, rritjes së *transparencës dhe llogaridhënies,* duke bërë një hap të rëndësishëm sasior dhe cilësor në kontributin ndaj mirëqeverisjes, përmes bërjes publike dhe transparente të të gjithë veprimtarisë së tij dhe thellimit të implementimit të standardeve profesionale.

Botimet, në kompleksin integral të tyre, përbëjnë një risi për KLSH-në në veçanti, por edhe për institucionet shtetërore në përgjithësi, duke qenë dëshmi të ecjes drejt modernizimit dhe profesionalizmit për KLSH-në. Ato variojnë nga libra për historikun e KLSH-së, publikime informuese për raportet vjetore të institucionit dhe marrëdhëniet me Kuvendin, tek botimet shkencore për standardet INTOSAI, për udhëzuesit e auditimeve të ndryshme, si ai financiar, i performancës, i përputhshmërisë, integritetit dhe raportimet për auditimet. Nëpërmjet këtyre publikimeve, lexuesi kupton botën e auditimit publik suprem, standardet që e qeverisin këtë disiplinë shkencore, historinë e institucionit kushtetues të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe gjetjet e rekomandimet kryesore në raportimet e tij periodike në Kuvend, etj.

Si përfundim, këto botime nuk janë thjesht botime të KLSH, por janë pjesë integruese qytetare dhe civile për çdo njeri dhe punonjës të administratës, i cili do t'i duhet të jetë garues, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në shoqëritë moderne, drejt të cilave aspirojmë të bëhemi pjesë. Nëpërmjet zbatimit në një të ardhme shumë të afërt të auditimeve të perfomancës mjedisore në KLSH, synohet që të forcohet infrastruktura e kontrollit të vlerave dhe dëmeve mjedisore, dhe në këtë mënyrë të promovojmë integritetin dhe etikën në te gjitha institucionet e sektorit publik, duke "udhëhequr nëpërmjet shembullit". Sa më shumë auditime për një perfomancë të mirë mjedisore aq më e shëndetshme është një shoqëri.

BUJAR LESKAJ

Parathënie e librit "Forcimi i Infrastrukturës Etike në SAI dhe Auditimi i Etikës në Sektorin Publik"

Botim i vitit 2014

Kontributi për fuqizimin e përgjegjshmërisë, transparencës dhe integritetit të qeverisë dhe njësive të tjera të sektorit publik është një mision themelor i institucioneve të auditimit të jashtëm shtetëror (SAI). SAI-t e kryejnë këtë mision, duke siguruar në radhë të parë një nivel të lartë të përgjegjshmërisë publike, transparencës dhe integritetit të audituesve të tyre dhe, duke e kërkuar këtë nivel në institucionet që auditojnë. Një institucion me etikë dhe integritet të lartë shërben si një barrierë shumë e efektshme ndaj përhapjes së korrupsionit.

Bazuar në Deklaratën e Limës (ISSAI 1), në ISSAI 12 "Vlera dhe përfitimet e SAI-ve: të bësh diferencën në jetët e qytetarëve", ne ISSAI 20 "Parimet e Transparencës dhe të Llogaridhënies", në ISSAI 21 "Parimet e Transparencës dhe te Llogaridhënies dhe Praktikat e Mira" dhe në ISSAI 30 "Kodi i Etikës", KLSH ka përkthyer dhe përgatitur për lexuesin e informuar (audituesit publikë dhe privatë të vendit) botimin "Forcimi i infrastrukturës etike në Institucionet Supreme të Auditimit dhe Auditimi i Etikës në sektorin publik". Ky botim përmbledh katër broshura të EUROSAI-t, të përgatitura nga Grupit i Punës (Task Force) i tij për Auditimin dhe Etikën, me synim reflektimin e aktiviteteve të Grupit, si Seminari mbi sfidat e auditimit të Etikës, i zhvilluar në shtator 2013 në Luksemburg, Takimi i Katërt i Grupit në janar 2014 në Lisbonë, Portugali, me 32 SAI evropiane pjesëmarrëse në një anketim lidhur me etikën e SAI-ve, si dhe Takimi i Pestë i zhvilluar në Polana Brasov, Rumani për diskutimin dhe

miratimin e dy dokumenteve themelore të këtij auditimi. Botimi i sjell këto dy dokumente në formën e katër broshurave, që i lidh filli logjik i identifikimit të tendencave kryesore, qasjeve dhe pikave të forta në auditimin e Etikës, si për vetë SAI-n, ashtu dhe për institucionet publike që auditohen prej tij.

Pjesa e Parë e botimit titullohet "Mbështetje Institucioneve Supreme të Auditimit për forcimin e Infrastrukturës Etike". Ajo përmban tre broshurat e para, te titulluara: "Një vështrim i përgjithshëm i strategjive dhe praktikave etike të SAI-ve; "Menaxhimi i Etikës në Praktikë-analiza" dhe "Artikuj të SAI-ve për menaxhimin e Etikës". Si audituesë të jashtëm të pavarur të financave publike, SAI-t duhet të shihen nga të gjithë me një ndjenjë besimi, sigurie dhe kredibiliteti. Siç theksohet në Kodin e Etikës te INTOSAI-t, besueshmëria është thellësisht e bazuar në pavarësinë, paanshmërinë dhe integritetin moral të anëtarëve dhe audituesve të SAI-t, të cilët duhet të veprojnë në bazë të një kodi të qartë të vlerave dhe parimeve. Standardet e larta të integritetit dhe transparencës në punën e përditshme të SAI-t rrisin rolin e tij si institucion model për përgjegjshmërinë. Kjo është mjaft e rëndësishme për të zgjeruar rëndësinë dhe ndikimin e punës së SAI-t, në një kohë, kur është i nevojshëm rifitimi i besimit në institucionet publike, si një element kyç i kthimit të rritjes së qëndrueshme.

Botimi vijon me Pjesën e Dytë, e cila titullohet "Auditimi i Etikës në sektorin publik". Qëllimi është për të motivuar dhe inkurajuar SAI-in për të audituar etikën dhe / ose çështje të lidhura me etiken, duke e bërë atë një objektiv shumë te zakonshëm te auditimit te tij, dhe, në këtë mënyrë, duke hapur rrugën për të promovuar sjelljen etike dhe zhvillimin e kornizave të integritetit në organizatat publike.

Etika, integriteti dhe transparenca e zyrtarëve të shtetit dhe të punonjësve civilë, si dhe veprimet e tyre janë bërë një fokus në rritje i vëmendjes publike. Skandalet e shumta që lidhen me korrupsionin, paligjshmërinë ose mungesën e profesionalizmit, nxjerrin në pak rëndësinë e këtyre çështjeve në shumë vende. Reforma dhe modernizimi i administratës shtetërore dhe menaxhimit publik dhe rritja e demokratizimit dhe e hapjes së shoqërive, lejojnë dhe synojnë zhvillimin dhe forcimin e strukturave dhe menaxhimit të etikës në shërbimin civil. Etika rezulton të jetë një pjesë e kërkuar e qeverisjes publike dhe e performances se institucioneve shtetërore dhe, në rrethana të tilla, auditimi i Etikes është duke u bërë i rëndësishëm. Auditimi i SAI-t mund të jetë një instrument i vlefshëm për matjen e klimës etike apo respektimin e kodit të sjelljes të organizatës publike. SAI, gjithashtu, mund të shtoje vlera dhe për të kontribuar në përmirësimin e menaxhimit, kontrollit dhe qeverisjes së organizatës së audituar, nëpërmjet rekomandimeve funksionale dhe në kohë.

Duke audituar etikën ose çështjet e etikës, SAI mund të ndihmojë në rivendosjen e besimit në organizatat publike, besim i cënuar kohët e fundit, për shkak të krizës financiare dhe ekonomike. SAI-t kanë një rol të rëndësishëm në mbështetjen e institucioneve më të hapura dhe efektive të qeverisë, si dhe në përmbushjen e pritshmërive të qytetarëve që qeveritë të ofrojnë siguri se proceset vendim-marrëse në mënyrë efektive ndjekin interesin publik dhe janë të mbrojtura nga ndikimet. Disa vlera të rëndësishme të përbashkëta etike për sektorin publik janë:

• Integriteti dhe paanshmëria
• Promovimi i interesit publik
• Angazhimi në sistemin e administratës publike
• Llogaridhënia dhe transparenca.

Parimet etike janë vlerat etike të përkthyera në rregullat e sjelljes. Ato përcaktohen nga kodet e sjelljes apo të akteve të tjera dhe ato qeverisin sjelljen etike të punonjësit publik, duke e kufizuar atë. Disa nga parimet më të rëndësishme etike për sektorin publik janë:

• Kryerja e shërbimeve publike në mënyrë të paanshme
• Veprimi në përputhje me ligjin
• Shmangia e konfliktit të interesave
• Shmangia e klientelizmit, nepotizmit dhe forma të tjera të favorizim
• Refuzimi i dhuratave
• Respektimi i konfidencialitetit dhe të qënit diskret
• Kujdesi në menaxhimin e aseteve publike
• Kryerja e Detyrave dhe detyrimeve me ndërgjegje
• Kryerja e detyrave në kohë dhe në mënyrë efektive
• Parandalimi i abuzimit nga autoritetet
• Shpërblime të drejta ndaj punonjësve
• Respektimi i konfidencialitetit.

Sot, integriteti dhe etika e enteve qeveritare dhe e institucioneve të tjera publike të një vendi është kusht i pazëvendësueshëm për të siguruar mirëqeverisjen e atij vendi. SAI mund dhe duhet të shërbejë si matësi kryesor i nivelit të etikes dhe integritetit në qeverisjen publike, duke audituar plotësimin e vlerave dhe parimeve etike në institucionet që kontrollon. Nga ana tjetër, duke kryer një analizë të qartë të nivelit të integritetit dhe etikës brenda vetë institucionit, SAI fiton në imazhin dhe besimin e publikut tek ai.

Në tërësi, botimi ”Forcimi i infrastrukturës etike në SAI-t dhe Auditimi i Etikes në sektorin publik” jep një përmbledhje të zgjeruar të eksperiencave të shumë SAI-ve evropiane në auditimin e zbatimit të rregullave të etikës në institucionet që auditojnë, si

dhe shembuj të suksesshëm të kryerjes së vetëvlerësimit të integritetit brenda SAI-t, nëpërmjet instrumentit "INTOSAINT", të përgatitur nga Gjykata e Auditimit e Hollandës. Në vitin 2012, komuniteti i SAI-ve evropiane, EUROSAI krijoi Grupin e Punës (Task Forcën) për Auditimin dhe Etikën. Gjatë vitit 2013, KLSH aplikoi dhe u pranua anëtar i kësaj Task Force. Institucioni, nëpërmjet anëtarësimit dhe pjesëmarrjes aktive në këtë organizëm, synon, nga njëra anë, në instalimin dhe funksionimin e një infrastrukture efektive etike në vetë KLSH-në, dhe, nga ana tjetër, do të ndërmarrë misione auditimi mbi rregullsinë dhe efiçiencën e Etikës dhe Integritetit në institucionet publike që auditon, duke konsideruar që lufta kundër korrupsionit dhe politikat për instalimin e një sistemi efektiv të integritetit të jenë pjesë themelore e menaxhimit të institucioneve publike.Nëpërmjet zbatimit, në një të ardhme shumë të afërt, të Instrumentit të Vetëvlerësimit të integritetit "INTOSAINT" në KLSH, ne synojmë që të forcojmë infrastrukturën etike brenda vetë institucionit, dhe në këtë mënyrë, të promovojmë integritetin dhe etikën në te gjitha institucionet e sektorit publik duke "udhëhequr nëpërmjet shembullit". Së fundi, dua të sjell në vëmendjen Tuaj përcaktimin e Prof. Assoc. Dr. Recai Akyel, President i SAI-t Turk i cili ka cilësuar se: "Integriteti i menaxhimit të auditimit ka rëndësi parësore në rritjen e besimit të palëve të interesuara".

E theksoj se, në radhë të parë, KLSH përpiqet të jetë një institucion besimi. Nëpërmjet auditimeve të tij profesionale, ai ngjall besimin tek qytetari dhe Kuvendi, duke dhënë garancinë se fondet dhe asetet publike të vendit tonë janë përdorur me ekonomi, efektivitet dhe efiçiencë. Gjetjet dhe rekomandimet tona do t'i shërbejnë gjithnjë forcimit të mirëqeverisjes publike dhe do të jenë një "sy" profesional mbi integritetin e institucioneve që auditojmë, sikurse edhe botimi mbi auditimin e etikës që po ju paraqesim, është një udhërrëfyes në mjetet e vlerësimit të etikës qeverisëse.

BUJAR LESKAJ

Parathënie[120] e librit "IntoSAINT, Manuali i Vetëvlerësimit të Integritetit për Institucionet Supreme të Auditimit"

Botim i vitit 2014

Në kuadrin e përpjekjeve të bëra gjatë dekadave të fundit, në nivel global për zhvillimin e institucioneve, sistemeve dhe mekanizmave për promovimin e integritetit dhe parandalimin e korrupsionit në sektorin publik, KLSH i ofron trupave audituese të sektorit publik një botim mjaft specifik në fushën e auditimit, që ka të bëjë me metodologjinë e vetëvlerësimit të integritetit në Institucionet Supreme të Auditimit (INTOSAINT), konsideruar si një nga metodat inovative dhe të efektshme, me impakt rritjen e pritshmërive në zhvillimin e politikave të integritetit. Ky botim përmbledh në vetvete disa dokumente të rëndësishme, të cilat janë strukturuar në tre kapituj:

Kapitulli i pare dhe i dytë trajtojnë dokumentet baze të integritetit, ndërsa Kapitulli i tretë përfshin dokumente të lidhura ngushtësisht me mjedisin dhe çështjet e integritetit. Kapitullin i I-rë : Në dokumentet bazë përfshihen: 1. Manuali i instrumentit të vetëvlerësimit të integritetit në SAI, i cili është i përbërë nga dy pjesë: 1.a Parimet e metodologjisë, ku trajtohen konceptet e integritetit, vlerësimi i riskut etj. 1.b Udhërrëfyes për implementimin e kësaj metodologjie. Manuali i Vetëvlerësimit të Integritetit, i përgatitur nga Gjykata e Auditimit e Holandës, është një dokument esencial, i cili gjeneron informacion në aspektin teorik, nga pikëpamja e metodologjisë, por nga ana tjetër jep udhëzime edhe si të aplikohet në praktikë.

Vetëvlerësimi i integritetit në konceptin e përgjithshëm, është një instrument nëpërmjet të cilit organizatat vlerësojnë aspektet, procedurat, të cilat janë më vulnerabël dhe masat që duhet të merren ndaj shkeljeve të integritetit.

[120] Kjo Parathenie publikohet në formë të shkurtuar

Në Kongresin INTOSAI XXI, mbajtur në Pekin në 21-26 Tetor 2013, Gjykata Holandeze e Auditimit raportoi për përhapjen e kësaj metode kudo në botë. U konkludua se një bazë e fortë solide është krijuar tashmë, mbi të cilën INTOSAI mund të ndërtojë mekanizmin për t'i mundësuar Institucioneve Supreme të Auditimit të udhëheqin sipas shembullit, për integritetin.

Gjykata Holandeze e Auditimit i prezantoi INTOSAI-t një sërë rekomandimesh për ndërmarrjen e hapave, të cilat do të synonin ndër të tjera zhvendosjen e INTOSAINT në një nivel më të lartë tek INTOSAI, si për shembull, tek Komitetit i Ngritjes së Kapaciteteve.
INTOSAINT do të integrohet në rishikimet e ardhshme të ISSAI 30 (Kodit Etik) dhe kjo do të shërbejë si një pikënisje për shkëmbimin e eksperiencave në fushën e etikës dhe integritetit. Gjatë vitit 2015, KLSH do të ndërmarrë një auditim vetëvlerësimi të integritetit.

2. Dokumenti i gjeneruar nga Gjykata Holandeze e Auditimit "Mbi korrupsionin dhe integritetin" i cili është një dokument me vlera njohëse ne fushën e korrupsionit dhe integritetit. Ky dokument trajton konceptet e korrupsionit, promovimit te sjelljes së mirë ose integritetit. Mjaft interesant është trajtimi i ciklit jetësor të politikave kundër korrupsionit dhe modeli i ofruar dhe ndjekur nga Qeveria Holandeze në implementimin e një strategjie efektive të luftës kundër korrupsionit nëpërmjet stimulimit të një "klime etike dhe "kulture pozitive".

3. Nëpërmjet këtij botimi sjellim në vëmendje të lexuesve edhe përvojën e Kontrollit të Lartë të Shtetit në implementimin e metodologjisë INTOSAINT me titull "Profil i menaxhimit te Sistemit të Kontrollit të Integritetit në KLSH gjatë periudhës 2012-2014". KLSH është anëtar i Grupit për Rishikimin e ISSAI 30, Kodit të Etikës, një iniciativë kjo e ndërmarrë nga Këshilli Mbikëqyrës i Komitetit të Standardeve Profesionale (PCS) të INTOSAI-t në qershor 2013.

4. Krahas sa më sipër, në këtë botim kemi sjellë një material informativ për historikun e lindjes, zhvillimit dhe përhapjes së metodologjisë INTOSAINT.

Shpreh bindjen se ky botim do të shndërrohet në një instrument mjaft dobiprurës për të gjitha trupat audituese të sektorit publik dhe privat, por njëkohësisht ai i adresohet dhe target grupeve të tjera të interesit, si njësitë e sektorit publik dhe privat, institucionet akademike në vend, etj.

BUJAR LESKAJ

Parathënie e librit "ISSAI 5220 dhe Kodi i Transparences Fiskale"

Botim i vitit 2014

Në koherencë me Programin e BE-së të Mbështetjes së Buxhetit për Përmirësimin e Menaxhimit të Financave Publike dhe me reformat e kërkuara nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, në vendin tonë është kryer një progres i konsiderueshëm, ku një arritje të spikatur e përbën rritja e rolit të auditimit të jashtëm publik, me miratimin nga Kuvendi të Ligjit të ri organik për KLSH-në më 27 Nëntor 2014. Me fitimin e statusit të vendit kandidat dhe rritjen e fluksit të financimit nga Bashkimi Evropian për Shqipërinë, bëhet i domosdoshëm shtimi i efektshmërisë dhe cilësisë së auditimit të financimeve me pjesëmarrjen e fondeve publike dhe private (partneriteti privat/publik) dhe të koncesioneve, nga ana e institucionit suprem të auditimit (KLSH). Për të plotësuar këtë domosdoshmëri dhe në linjë me botimet e KLSH-së në vitet 2012, 2013 dhe 2014, i paraqesim lexuesit në një botim të përbashkët Standartin ISSAI 5220 "Udhëzime mbi praktikat më të mira të auditimit të financimit privat /publik dhe koncesioneve", Konkluzionet e Kongresit të VI të EUROSAI-t, viti 2005, " Mbi Auditimin e të Ardhurave Publikee", si dhe Kodin e Transparencës Fiskale të FMN-së.

Standarti ISSAI 5520 "Mbi praktikat më të mira të auditimit të financimit privat/publik dhe koncesioneve" është një produkt i Grupit të Punës, INCOSAI XVI, 1998. Qasja e re e financimit publik/privat dhe e koncesioneve përfaqëson një hap përpara nga prokurimi tradicional i aseteve, ku sektori publik paguan për ndërtimin ose zhvillimin e një aseti dhe më pas lidh kontrata të tjera për mirëmbajtjen e vazhdueshme dhe funksionimin e këtij aseti. Qasja e re është gjithashtu e ndryshme nga prokurimi tradicional, i cili përfshin vetëm dispozita parashikuese të shërbimeve. Në vend të kësaj, qasja e re e financimit publik/privat dhe e koncesioneve, përfshin ofrimin e shërbimeve në sektorin publik nga sektori privat, i cili merr gjithashtu përgjegjësinë për ndërtimin/zhvillimin dhe financimin e çdo aseti që nevojitet për ofrimin e shërbimit të kërkuar. Gjithashtu,

shërbimet e ofruara mund të shtrihen përtej shërbimeve mbështetëse, të cilat tradicionalisht sektori privat ka ofruar për sektorin 6 publik, si mirëmbajtjet e ndërtesave, të shërbimeve, ofrimi i të cilave në të kaluarën ka qenë përgjegjësi e sektorit publik, të tilla si sigurimi dhe menaxhimi i burgjeve, spitaleve dhe shkollave. Qëllimi i këtij udhëzimi është të ofrojë një kornizë tëplotë ligjore për ato institucione supreme auditimi(SAI) që do të duan të auditojnë këto marrëveshje, për të vendosur nëse sektori publik ka bërë marrëveshjen më të mirë të mundshme për taksapaguesit, duke rritur vlerën e parasë së taksapaguesve. Në funksion të këtij udhëzimi jepen 43 udhëzime të ndara në gjashtë seksione, që detajojnë mënyrën e auditimit të financimeve publik/privat dhe të koncesioneve.

Së dyti në këtë material është përfshirë përkthimi i Kodit të Transparencës Fiskale, Gusht 2014, i Fondit Monetar Ndërkombëtar. Në standartin e paraqitur nga ky kod kërkohet nga Audituesi Suprem i Jashtëm që të vlerësojë besueshmërinë e pasqyrave financiare dhe të dhënave fiskale të qeverive. Parimet e administrimit fiskal mbi të cilat ky Kod është bazuar janë: a. Raportimi Fiskal, ku kërkohet që raportet fiskale duhet të sigurojnë një pamje të besueshme, në kohë, të rëndësishëm dhe gjithëpërfshirëse të performancës e të pozicionit financiar të qeverisë. b. Parashikimin Fiskal dhe Buxhetimi, ku kërkohet që buxhetet dhe parashikimet fiskale të tyre duhet të sigurojnë një paraqitje të saktë të objektivave buxhetore dhe qëllimet e politikave të qeverisë dhe të jenë një projeksion i besueshëm, në kohë dhe gjithëpërfshirës i evolucionit të financave publike. c. Analiza e Riskut Fiskal dhe Menaxhimi, ku kërkohet nga Qeveritë që të bëjnë të ditur, të analizojnë dhe menaxhojnë riskun e financave publike dhe të sigurojnë koordinim efektiv të vendim marrjes fiskale për të gjithë sektorin publik. Secili parim sqarohet në tre nivele implementimi, në atë të Thjeshtë, të Mirë dhe në rastin e Avancuar. Në të tre skenarët e parashikuar nga ky kod, ai i Thjeshtë, i Mirë dhe i Avancuar, Audituesi Suprem i Jashtëm duhet të auditojë në mënyrë të plotë raportimet fiskale qeveritare dhe pasqyrat financiare të qeverisë, duke dhënë një opinion mbi besueshmërinë e tyre. Në skenarin më të avancuar, nga Audituesi Suprem kërkohet 7 të publikohet raporti i tij i auditimit mbi besueshmërinë e të dhënave fiskale dhe financiare, bazuar në Standartet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI-t). Pika 2.4 e Kodit, lidhur me kredibilitetin e parashikimit fiskal dhe buxhetimit, kërkon që "*Parashikimet ekonomike dhe fiskale të qeverisë dhe performanca e saj të jenë subjekt i vlerësimit të pavarur nga audituesit të jashtëm të pavarur, si faktor përcaktues në rritjen e transparencës fiskale, duke informuar publikun për performancën e qeverisë, jo vetëm përmes raportimit të Ministrit të Financave dhe qeverisë, por dhe përmes raportimit të audituesit të jashtëm të shtetit*". Në këtë botim përfshihet edhe Deklarata Përfundimtare e Kongresit të VI të EUROSAI të mbajtur në Bon nga data 30 Maj – 3 qershor 2005 "Mbi Auditimin e të Ardhurave Publike"

Kongresi i VI i EUROSAI-t, mori në konsideratë në mënyrë të detajuar një gamë çështjesh të rëndësishme dhe komplekse në shumë vende Europiane lidhur me punë e SAI-ve dhe rolin e tyre në financat publike. Kongresi rekomandoi që anëtarët e EUROSAI-t të inkurajohen që të rivlerësojnë strategjitë e tyre të përgjithshme për auditimin e të ardhurave, të ketë një auditim të koordinuar të subvencioneve të taksave që është i hapur për të gjithë anëtarët EUROSAI-t, dhe së fundi u shtrua domosdoshmëria e rritjes së rolit të auditimit të IT në auditimin e mashtrimit me të ardhurat publike. Ky konkluzion është në përputhje me Deklaratën e Limës, Miratuar në Kongresin e IX-të të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) më 1977. Deklarata thekson domosdoshmërinë e rritjes së rolit të institucioneve supreme të auditimit si një bazë për sigurimin e transparencës përmes rezultateve objektive dhe të pavarura të auditimeve. Në nenin 20 të Deklarates se Limes theksohet se "*Institucionet Supreme të Auditimit, kanë të drejtë të auditojnë mbledhjen e taksave dhe të shqyrtojnë dosjet individuale tatimore. Kontrollet tatimore janë kryesisht auditimi i ligjshmërisë dhe rregullshmërisë, megjithatë, në zbatim të ligjeve tatimore, Institucionet Supreme të Auditimit duhet të shqyrtojnë edhe sistemin dhe efektivitetin e mbledhjes së taksave, arritjen e objektivave të të ardhurave dhe sipas rastit, të propozojnë përmirësime në organin legjislativ*".

Indeksi ROSC (Reports on the Observance of Standards and Codes), që zhvillohet nga FMN, shpreh nivelin e transparencës fiskale të një vendi. Vihet re një korrelacion pozitiv mes indeksit të transparencës fiskale dhe Prodhimit të Brendshëm Bruto për Frymë si dhe përmirësim të raportit borxh publik/PBB: Grafiku tregon për një rritje të PBB-së për frymë me rritjen e indeksit ROSC, që mat transparencën fiskale. PBB për frymë Vendet e zhvilluara Vendet në zhvillim Idenksi ROSC 9 Botimi i kodit të transparencës së FMN-së dhe Deklarata e Kongresit të VI të EUROSAI shërbejnë si referencë e plotë për të rritur cilësinë e punës sonë audituese në drejtim të shtimit të transparencës, me efekt rritjen e vlerës së parasë publike të mbledhur nga organet fiskale. Zbatimi i standardit ISSAI 5520 ngre nivelin profesional të auditimit, në drejtim të mirëpërdorimit të kësaj paraje publike. Si KLSH, jemi të përkushtuar që auditimi i organeve fiskale, financimeve privat/publik dhe koncesioneve të jetë sa më cilësor, profesional dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit, me qëllim që të jemi në gjendje të përcaktojmë me vërtetësi dhe plotësi performancën e punës së punonjësit të Shtetit, duke dhënë rekomandimet tona për përmirësimin e kësaj performance.

BUJAR LESKAJ

Parathënie e librit "Audituesit e KLSH në shtypin e përditshëm"

Vëllimi II, Botim i vitit 2014

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në realizim të misionit të tij kushtetues për të informuar opinionin publik dhe Kuvendin, si dhe në bazë të standardeve profesionale INTOSAI, përkatësisht të Deklaratës së Limës (ISSAI 1, Neni 16, pika 2), dhe të Standardit ISSAI 20 "*Parimet e Transparencës dhe të Përgjegjshmërisë*", Parimi i 8-të, mbi komunikimin në kohë dhe gjerësisht të institucioneve supreme të auditimit nëpërmjet kanaleve të informacionit publik, sjell në vëmendjen e lexuesit këtë botim, me shkrime, analiza dhe vrojtime nga drejtuesit dhe audituesit e lartë të institucionit gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2014.

Dalja e tyre në median e shkruar të vendit gjatë vitit 2013 ishte pa dyshim një risi për institucionin. Vijimësia e kësaj risie që tashmë po shndërrohet në traditë është e qartë. Konstatohet madje ne shumicen e rasteve nje rritje te cilesise se prezantimit dhe gjuhes se perdorur nga audituesi. Shkrimet janë rritur ne numer gjithashtu, duke sjelle problematika të qarta dhe zgjidhje të ofruara për secilën problematikë.
Audituesit më me përvojë dhe auditues të rinj me ide janë serisht nxitur dhe inkurajuar të shkruajnë në faqet e gazetave dhe revistave mendimet e tyre mbi gjetjet, rekomandimet dhe sygjerimet nga auditimet që kanë kryer.
Temat me të cilat audituesit dhanë sprovat e tyre ne gjysmen e pare te vitit 2014 janë serisht nga më të larmishmet dhe prekin që të gjitha çështje të rëndësishme dhe vitale të administrimit publik dhe të performancës së institucioneve publike. Ato janë përqendruar në çështjet për llogaridhënien publike, integritetin e qeverisjes dhe rritjen e transparencës, respektimin e rregullave të etikës, problematikat e vjeljes së të ardhurave

nga tatimet dhe doganat, të administrimit të pushtetit vendor dhe taksave vendore, përparësitë në luftën kundër korrupsionit, risi dhe përsiatje për auditimin e Integritetit dhe te Etikes, të shoqërive publike, të auditimeve mjedisore, etj.

Shkrimet e drejtuesve dhe audituesve të KLSH janë një numër më i madh se ato të paraqitura në këtë libër, i cili prezanton një përzgjedhje të tyre. Ky botim përbën vëllimin e dytë të përmbledhjes me shkrime nga audituesit e KLSH.

Duke falenderuar të gjithë audituesit e KLSH që morën kohën nga aktiviteti i tyre auditues dhe me kurajo i dhanë në media idetë, analizat dhe mesazhet e tyre, shpreh bindjen se ky kontribut në informimin dhe sensibilimin e opinionin publik të vendit për çështjet e mirëqeverisjes së vendit, do të vijojë dhe më cilësor e intensiv në të ardhmen.

BUJAR LESKAJ

Parathënie e librit "Standardet e GAO-s"

Botim i vitit 2015

Kontrolli i Lartë i Shtetit po sjell në gjuhën shqipe për audituesit shqiptarë dhe për të gjithë të interesuarit e fushës së auditimit dhe të ekonomisë, një botim krejt të veçantë, "Standardet e Auditimit të Zyrës së Auditimit të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës (GAO) ". Ky botim është rishikim i Standardeve të Auditimit të Qeverisë realizuar në vitin 2011 dhe paraqet një version të modernizuar të standardeve në SHBA-ve, duke marrë në konsideratë ndryshimet e fundit në standardet e tjera të auditimit, përfshirë edhe standardet ndërkombëtare (ky rishikim zëvendëson rishikimin e 2007). Ai përmban ndryshime të mëdha nga rishikimi i 2007 që përforcojnë parimet e transparencës dhe llogaridhënies dhe që sigurojnë kuadrin për auditime me cilësi të lartë dhe me vlerë të shtuar.



Dëshiroj të falënderoj fillimisht z. Gene Dodaro, Kontrollor i Përgjithshëm i GAO-s, pa dashamirësinë dhe mirëkuptimin e të cilit ky botim nuk do të ishte realizuar. Zoti Dodaro miratoi pa hezitim kërkesën e KLSH-së për përkthimin e këtyre standardeve në gjuhën shqipe. Ky botim tejet profesional është i 38-ti në kolanën e botimeve të KLSH-së dhe po botohet në prag të festimit të përvjetorit të 90-të të krijimit të institucionit.

Kontrollori i Përgjithshëm i GAO-s, zoti Gene Dodaro na ka dërguar një mesazh përshëndetës për këtë ngjarje të rëndësishme për KLSH-në, nëpërmjet të cilit na inkurajon për punën që kemi bërë dhe thekson ndër të tjera rëndësinë e punës së SAI-ve

"....Me rastin e 90 vjetorit, dëshiroj të uroj të gjithë punonjësit e KLSH-së mbi rolin e rëndësishëm që institucioni juaj luan në promovimin e përgjegjshmërisë dhe qeverisjes së mirë. Institucionet Supreme të Auditimit janë vitalë për të ndihmuar përmirësimin e performancës së qeverisë, për të arritur më shumë transparencë, si dhe për të siguruar përgjegjshmëri në kontekstin e sfidave aktuale. Sipas mendimit tim, e ardhmja e auditimit të qeverisë është më e rëndësishme se kurrë. SAI-t si KLSH, dhe institucioni që unë drejtoj, kanë mundësi të jashtëzakonshme për të ndihmuar qeveritë e tyre të planifikojnë të ardhmen dhe të adresojnë çështje me interes për të gjithë".

Botimi i Standardeve të Auditimit të Qeverisë (Government Auditing Standards-GAS) vjen pas disa botimeve të tjera me karakter profesional që janë realizuar gjatë tre viteve të fundit nga KLSH, me qëllim për ta përqasur veprimtarinë e këtij institucioni me thelbin e misionit të tij që konsiston në nxitjen e përgjegjshmërisë së qeverisë dhe të menaxherëve publikë për përdorimin e parasë publike me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet, çka kërkon njohjen, respektimin dhe zbatimin me rigorozitet të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI.

Midis këtyre botimeve mund të veçojmë : «Standardet e Auditimit INTOSAI» (ISSAI 10, 20, 30, 40, 100, 200, 300, 400); "Udhëzuesi i Auditimit të Performancës, ISSAI 3000-3100". Auditimi i performancës në KLSH po konsolidohet më tej duke rritur numrin e auditimeve të realizuara dhe zgjerimin e tematikës së përzgjedhur.

Janë aktualisht në botim dy libra të tjerë që trajtojnë çështje të auditimit të Performancës,"Indikatorët e Performancës" dhe "Manuali i Departamentit të Auditimit të Performancës".

Në bashkëpunim me Zyrën e Audituesit të Përgjithshëm të Kosovës, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka botuar «Udhëzuesin e Auditimit Financiar (Shënimet Praktike)" dhe në bashkëpunim dhe me ndihmën e SIGMA's edhe «Udhëzuesin për Auditimin e Përputhshmërisë». Panorama e botimit të standardeve të auditimit plotësohet edhe më mirë me publikimin e "Standardeve të Auditimit te Borxhit Publik (5410-5440)", i cili synon përmirësimin dhe rritjen e profesionalizmit të punës së audituesve të KLSH-së, duke siguruar një kuadër të përgjithshëm dhe të përdorshëm, për qasje sa më të përshtatshme në auditimin e borxhit publik si edhe me "Standardet INTOSAI për mjedisin (ISSAI 5110-5140)", duke vlerësuar në këtë mënyrë rëndësinë që ka marrë zhvillimi i qëndrueshëm gjatë 20 viteve të fundit.

Revista Shkencore "Auditimi Publik", është arritja jonë kryesore dhe këtë muaj doli nga shtypshkronja numri 9 i saj. Revista po vazhdon me sukses sfidën e nisur si një revistë shkencore periodike 4-mujore në fushën e Auditimit Publik që botohet në gjuhën

shqipe dhe në gjuhën angleze. Në këtë Revistë kanë kontribuar me shkrimet e tyre personalitete të fushës së Ekonomisë nga vendi si dhe personalitete të njohura dhe me eksperiencë nga Institucionet Supreme të Auditimit (SAI) nga vende të rajonit e më gjerë, duke i dhënë "Auditimit Publik" një vlerë të shtuar dhe një përmasë rajonale, duke kontribuar në mbledhjen e mendimit të përparuar të profesionistëve të fushës së auditimit. Zbatimi i standardeve të INTOSAI-t në praktikë është shumë i rëndësishëm për ne dhe prioritet i punës së audituesve të KLSH-së. Rëndësia e tyre theksohet edhe në letrën e z. Dodaro, *"...INTOSAI ka luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin e standardeve ndërkombëtare të auditimit, dhe gjithashtu për të ndihmuar kombet nga e gjithë bota për të zbatuar këto standarde. Këto standarde kanë për qëllim të mbrojnë pavarësinë e SAI-ve dhe të ndihmojnë për realizimin e auditimeve efektive. Ata gjithashtu mbështesin anëtarët e INTOSAI-it në zhvillimin e qasjeve të tyre profesionale, bazuar në mandatet specifike të çdo vendi..."*

Në këtë botim, Standardet e Auditimit të Qeverisë(GAS) trajtohen në shtatë kapituj: Auditimi i qeverisjes, bazat dhe parimet e Etikës; standardet per përdorimin dhe aplikimin e GAGAS (General Accepted Government Auditing Standards); standardet e përgjithshme; standardet e auditimit financiar; standardet e angazhimeve për certifikim; standardet e punës në terren dhe standardet e raportimit për auditimin e performancës.

Leximi dhe përvetësimi i këtyre standardeve nga audituesit e KLSH-së do t'i ndihmojë ata në punën e tyre të përditshme për të realizuar auditime cilësore dhe do t'i orientojë për të kapërcyer sfidat e vështira me të cilat përballen audituesit. Të gjitha botimet tona, i shërbejnë së pari forcimit të kapaciteteve profesionale të institucionit, përmirësimit të metodologjisë së auditimit, rritjes së transparencës dhe llogaridhënies, duke bërë një hap të rëndësishëm sasior dhe cilësor në kontributin ndaj mirëqeverisjes, përmes bërjes publike dhe transparente të të gjithë veprimtarisë së tij dhe thellimit të zbatimit të standardeve profesionale.

Rëndësia e transparencës së punës së Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI) transmetohet edhe nëpërmjet mesazhit të z. Dodaro *"... GAO është gjithashtu e angazhuar për të bashkëpunuar ngushtësisht me publikun ne punën e saj. Ne besojmë fuqimisht tek transparenca, me idenë që qytetarët duhet të jenë të informuar sa më shumë të jetë e mundur në lidhje me performancën e qeverisë dhe rezultatet e saj. Sipas mendimit tim, të kuptuarit nga publiku dhe mbështetja e tij do të jenë jetike në adresimin e politikave të vështira që shtrohen përpara nesh ..."*.

Rritjes së kapaciteteve profesionale të audituesve të KLSH-së do t'i shërbejë edhe përkthimi në gjuhën shqipe i Standardeve të GAO-s, të cilat do të jenë referencë për kryerjen e auditimeve me cilësi të lartë, me kompetencë, integritet, objektivitet dhe pavarësi.

Në qershor të vitit 2004, vizitoi KLSH-në një personalitet i rëndësishëm, Kontrollori i Përgjithshëm i SHBA-së David M. Walker. Pas kësaj periudhe pati një shkëputje disa vjeçare në bashkëpunimin mes GAO-s dhe KLSH-së. Në këto tre vitet e fundit, kjo marrëdhënie po forcohet dhe po merr trajta konkrete bashkëpunimi dhe ne jemi të vendosur ta thellojmë edhe më shumë në të ardhmen, mbi bazën e motos së Institucioneve Supreme të Auditimit "*Experientia mutua omnibus prodest*", me dëshirën më të mirë për të mësuar dhe shkëmbyer eksperienca si anëtarë të INTOSAI-t, veçanërisht me Zyrën e Auditimit të Qeverisë së SHBA-së, si institucioni më modern i këtij komuniteti.

Kodi Etik i KLSH-së është rishikuar dhe në funksion të krijimit të një institucioni model që udhëheq nëpërmjet shembullit, KLSH ka përfshirë në këtë dokument dhe Kodin e Sjelljes dhe Udhëzuesit e Etikës të Gjykatës Europiane të Audituesve, duke shtuar sfidën e përshtatjes së Standardeve të GAO's që janë standardet e një Institucioni model, siç është GAO, për të gjitha Institucionet Supreme të Auditimit, anëtare të INTOSAI-t. Synimi dhe detyra jonë do të jenë që në të ardhmen t'i përshtatim dhe t'i aplikojmë si standarde të punës së audituesve të KLSH-së. Do të jetë pa dyshim një sfidë e vështirë, por jo e pamundur, që kërkon kohën e saj...

BUJAR LESKAJ



Parathënie e librit "KLSH Analiza Vjetore 2014"

Botim i vitit 2015

Kontrolli i Lartë i Shtetit, nëpërmjet veprimtarisë së tij audituese synon përdorimin me efektivitet, eficencë dhe ekonomicitet të fondeve publike, pronës publike dhe asaj shtetërore, zhvillimin e një sistemi të përshtatshëm të menaxhimit financiar, kryerjen si duhet të aktiviteteve administrative, si dhe informimin e publikut dhe Kuvendit të Shqipërisë nëpërmjet publikimit të raporteve të aktivitetit të tij.

Transparenca e aktivitetit të KLSH-së ndaj publikut është detyrim që rrjedh nga dispozitat e nenit 34, pika c e Ligjit nr. 154/2014 " Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të shtetit" në të cilën përcaktohet se *"Kontrolli i Lartë i Shtetit, në respekt të detyrimit të tij ligjor për informimin e publikut, siguron natyrën publike të punës së tij nëpërmjet:....c) konferencave për shtyp dhe metodave të tjera".*

Në këtë kuadër KLSH sjell tek lexuesit e interesuar për herë të katërt Analizën e Veprimtarisë së Institucionit, duke ju referuar aktivitetit të tij për vitin 2014. Ky botim është i 39-ti në kolanën e botimeve të KLSH (2012-2015).

Në këtë këndvështrim si dhe në kuadër të bashkëpunimit me stafet akademike të Universiteteve të vendit, Analiza Vjetore e Aktivitetit të KLSH-së për vitin 2014 u zhvillua në Universitetin " Ismail Qemali" në Vlorë si një nga universitetet me tradita dhe cilësi mësimdhënieje. Paraqitja e rezultateve të punës tonë në këtë universitet synoi tërheqjen e sugjerimeve dhe opinioneve të profesorëve të nderuar, pasi mjedisi akademik gjeneron ide, përqasje dhe metodika pune me shumë vlerë për punën audituese të KLSH.

KLSH i ka dhënë një rëndësi të veçantë dhe bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile, pasi ekspertiza e tyre e pavarur e ndihmon KLSH në përzgjedhjen e temave të

auditimit me ndjeshmëri të lartë për publikun dhe hartimin e rekomandimeve dhe raporteve për përmirësimin e performancës së institucioneve që auditohen.

Bashkëpunimi me këto organizata u konkretizua gjatë kësaj analize me paraqitjen e rezultateve të disa *Peer Review* (ekspertizë e pavarur midis partnerësh) që lidhen me aktivitetin e KLSH. Kështu në bashkëpunim me Këshillin Kombëtar të Kontabiliteti u realizua "Kontrolli i Cilësisë në të ftohtë" i dosjeve të auditimit të KLSH. Mjaft të vlefshëm dhe informues ishin dhe rezultatet e dala nga *Mini Peer Review* "Mbi zbatimin e ligjshmërisë në rekrutimin e stafit të KLSH-së",realizuar në bashkëpunim me Institutin G&G, "Realizimi i Transparencës dhe Komunikimit me publikun dhe qytetarët", realizuar në bashkëpunim me Lëvizjen Evropiane në Shqipëri dhe "Prezenca e audituesve të KLSH-së në shtypin e shkruar" realizuar në bashkëpunim me Gazetën "Ekonomia".

Kontributin për rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë së administrimit të fondeve publike, KLSH nuk mund ta realizojë pa qenë së pari një institucion model në kërkimin e mangësive brenda vetes.

Për një më vlerësim sa më objektiv dhe transparent të veprimtarisë së kryer gjatë vitit 2014, KLSH për herë të parë ka aplikuar për matjen e rezultateve dhe evidentimin e mangësive, kërkesat e integritetit dhe Programin e Vetëvlerësimit "IntoSAINT" të Gjykatës Holandeze të Auditimit, i njohur dhe i pranuar që nga viti 2011 nga organizata INTOSAI.

Programi i Vetëvlerësimit "IntoSAINT", i përkthyer në gjuhën shqipe, iu ofrua audituesve të KLSH-së dhe u përdor gjerësisht në analizën e aktivitetit të çdo departamenti.

Auditimi i integritetit, si për institucionet supreme të auditimit ashtu dhe për institucionet që auditohen, është një sfidë e rëndësishme dhe thelbësore. Vlerësimi objektiv i aktivitetit duke përdorur eksperiencat më të mira botërore i ndihmon institucionet të jenë më të përgjegjshme në përdorimin e parasë publike, përcaktimin më të qartë të objektiveve, hartimin e politikave që i shërbejnë rritjes së mirëqenies së qytetarëve dhe zhvillimit ekonomik të vendit.

Referuar të dhënave dhe statistikave, konstatohet qartë se në përfundim të vitit 2014 KLSH ka një konsolidim të rezultateve të punës së tij, duke ndihmuar ndjeshëm në përmirësimin e performancës së institucioneve qendrore dhe lokale, si dhe në luftën kundër rasteve të mashtrimit dhe korrupsionit.

Këto rezultate pozitive janë arritur me kontributin e të gjithë punonjësve, falë të cilit është bërë e mundur përmbushja e objektivave të vitit 2014.

Ne do të vazhdojmë të punojmë edhe gjate vitit 2015 për realizimin e objektivave te Strategjisë afat-mesme të KLSH-së për periudhën 2013-2017 (e cila është rishikuar për dy vitet e fundit 2015-2017), të cilat janë përcaktuar referuar katër objektivave themelore të Strategjisë së Zhvillimit 2011-2017 të EUROSAI-t:

1. Ngritja e kapaciteteve;
2. Standardet profesionale;
3. Shkëmbimi i njohurive dhe përvojës; dhe
4. Menaxhimi në përputhje me parimet e qeverisjes së mirë dhe efektive të komunikimit

KLSH do të vijojë edhe në të ardhmen të realizojë analizën e punës së institucionit nën frymën e INTOSAINT, në mënyrë që krahas arritjeve, të zbulojmë mangësitë dhe dobësitë brenda nesh duke përmirësuar së pari performancen tonë dhe duke qenë një institucion model edhe për institucionet e tjera publike në vend.

BUJAR LESKAJ

Parathënie e librit "Indikatorët e Performancës"

Botim i vitit 2015

"Pa standarde nuk mund të ketë një bazë logjike vendim-marrëse dhe vepruese". Materiali i përmbajtur në këtë guidë është hapi i parë në drejtim të formulimit të standardeve të performancës në organizatat e sektorit publik. I huazuar nga eksperienca britanike, udhëzuesi në vijim identifikon, përkufizon, shpjegon dhe ilustron grupet e indikatorëve të performancës përmes të cilëve një institucion publik mund të vlerësohet nga palët brenda dhe jashtë organizatës, si në një kontekst individual, ashtu edhe në një rrafsh më të gjerë sektorial, qoftë në një moment të vetëm kohe, ashtu edhe në perspektivë dinamike. Vlerësimi i performancës është sot një aspekt kyç i proceseve menaxheriale vendim-marrëse dhe ky vlerësim nuk mund të realizohet apo të raportohet e krahasohet, nëse më parë nuk specifikohet në terma cilësorë e sasiorë metrika parametrizuese e kësaj performance. Pikërisht këtij qëllimi i shërbejnë indikatorët e listuar këtu. Këta indikatorë janë kategorizuar sipas 7 klasave apo sferave tipike të aktivitetit të një organizate publike e konkretisht: 1. Prokurimi; 2. Komunikimi; 3. Financa; 4. Teknologjia e Informacionit; 5. Shërbimet Juridike; 6. Burimet Njerëzore; dhe 7. Shërbimet Mbështetëse.



Për secilën klasë indikatorësh jepet fillimisht fokusi i aktivitetit apo funksionit organizativ të cilin ato masin, aspektet apo dimensionet kyçe sipas të cilëve organizohet vlerësimi i performancës dhe më pas bëhet ndarja në indikatorë primarë e sekondarë, ku të parët adresojnë performancën e funksionit në nivel organizate, ndërsa të dytët në nivel njësie ofruese të shërbimit. Për secilin indikator në veçanti bëhet më pas një shtjellim i detajuar i logjikës së konceptimit dhe implementimit, si edhe i

ndikimit të pritshëm në sjelljen organizacionale. Indikatorët e listuar nuk synojnë të jenë shterrues në vlerësimin e performancës së një organizate publike dhe në fakt as nuk mund të jenë të tillë. Secila organizatë ka karakteristikat e veta që lidhen me sferën e aktivitetit, fazën ku ndodhet në ciklin e biznesit apo strategjisë, ekspertizës së stafit dhe stilit të lidershipit, kulturës organizative, etj, etj. Ajo që indikatorët e këtushëm synojnë të përçojnë është ideja e një strukture të unifikuar dhe parametrizuar të performancës, e cila, pavarësisht diferencave mes organizatave, shërben si një platformë prej nga spikasin praktikat më të mira, të cilat më pas mund të kthehen në standarde të mirëfillta performance për krejt aktivitetin e sektorit publik.

Ky udhëzues buron nga eksperienca e audituesve të Zyrës Kombëtare Audituese në Britaninë e Madhe dhe për rrjedhojë, indikatorët e filtruar këtu kanë natyrë praktike, empirike, pragmatike, pra tek e fundit anglo-saksone. Padyshim që çdo profesor ekonomie, jurisprudence, informatike apo edhe psikologjie do t'i shtonte secilës klasë me dhjetëra indikatorë të tjerë dhe janë të mirëpritur ta bëjnë këtë, por theksojmë se materiali ka referuar indikatorët më gjerësisht të përdorshëm në spektrin e larmishëm të institucioneve publike, duke iu përmbajtur frymës pragmatike dhe jo thjesht asaj akademike. Kjo guidë i shërben më së pari audituesve të performancës në Kontrollin e Lartë të Shtetit. Që në krye të herës, departamenti i auditimit të performancës ka identifikuar nevojën e indikatorëve jo thjesht ligjorë apo rregullativë, por mirëfilltazi të performancës, të cilët do i ndihmojnë audituesit të eksplorojnë me sukses këtë fushë të re auditimi, tashmë edhe të mandatuar me Ligjin e ri institucional. Ky material plotëson një boshllëk, të cilin nuk mund ta mbushnim gradualisht përmes eksperiencës, sepse do të humbisnim shumë kohë e mund dhe tek e fundit nuk është turp të modelohesh sipas më të mirit.

Së bashku me Udhëzuesin e Auditimit të Performancës ISSAI 3000 & 3100, konceptuar nga Zyra Kombëtare Suedeze e Auditimit, dhe Manualin e Departamentit të Performancës, strukturuar sipas modelit hollandez dhe slloven, kjo përmbledhje indikatorësh plotëson mozaikun metodologjik, aq të rëndësishëm në këtë lloj auditimi. Indikatorët e shtjelluar këtu iu vlejnë audituesve në fazën e dytë audituese, atë të terrenit, pasi kanë identifikuar problemin social, e kanë konvertuar atë në problem performance duke identifikuar aktorët dhe proceset, dhe pasi kanë formuluar pyetjet dhe nënpyetjet kryesore audituese. Në bazë të dokumenteve, pyetësorëve, intervistave apo burimeve të tjera të informacionit, audituesit mund të "ushqejnë" formulat e këtyre indikatorëve për të vlerësuar performancën dhe për t'i dhënë përgjigje hipotezës së ngritur me pyetjen kryesore audituese.

Ky material iu vlen gjithashtu audituesve të çdo institucioni publik, të cilët synojnë të dalin nga "guaska" e auditimit financiar dhe të hedhin hapin madhor drejt vlerësimit të

sistemit, proceseve, organizimit dhe çdo aspekti tjetër menaxherial. Në këtë drejtim, këta audituesjo vetëm do të ndihmonin organizatën e tyre për t'u përmirësuar, por do të fillonin të flisnin të njëjtën gjuhë performance edhe me audituesit e organizatave të tjera simotra apo audituesit e jashtëm publikë të performancës. Së fundmi, materiali mund të jetë me vlera për sferat akademike, kërkimore-shkencore apo edhe për taksapaguesit, të cilët kërkojnë të informohen dhe të kontribuojnë në sferën e transparencës dhe llogaridhënies publike. Tek e fundit "Eksperienca e përbashkët u shërben të gjithëve"

BUJAR LESKAJ

Parathënie e librit "Manuali i Departamentit të Auditimit të Performancës"

Botim i vitit 2015

Manuali i Departamentit të Auditimit të Performancës është dokumenti i dytë strategjik departamental pas Udhëzuesit të INTOSAI-t botuar në Dhjetor 2012 dhe i treti në rrafsh institucional, pas Planit Strategjik të KLSH-së, publikuar në Korrik 2013. Gjenerimi i këtij suporti empirik reflekton disa aspekte strategjike dhe konkretisht: 1. Vizionin dhe filozofinë e strukturave drejtuese për një KLSH moderne, bashkëkohore, shkencore, këshilluese, aktive në jetën sociale, ekonomike e mediatike të Shqipërisë. 2. Rolin dhe rëndësinë që auditimi i performancës ka në konsolidimin e këtij vizioni, të dokumentuara tashmë në Planin Strategjik Institucional 2013-2017, të projektuara me mençuri e largpamësi në Ligjin e ri për KLSH-në, nr. 154/2014, dt. 27.11.2014, dhe të nxjerra në pah e të theksuara vazhdimisht në marrëdhëniet me palët vendase dhe të huaja të interesit. 3. Eksperiencën tashmë mbi 2-vjeçare të audituesve tanë në këtë lloj auditimi, si edhe trajnimet e workshop-et e shumta në të cilat ata kanë marrë pjesë. 4. Rritjen dhe forcimin e mëtejshëm të këtij lloj auditimi, për të akumuluar dije e njohuri, asistuar agjencitë publike, rritur vlerën e parave të taksapaguesve dhe ndihmuar Kuvendin për një vendim-marrje të shëndetshme dhe transparente.

Ky manual i shërben jo vetëm audituesve të Departamentit të Performancës, por të gjithë kolegëve tanë të departamenteve apo drejtorive të tjera, të cilët kryejnë,

kontrollojnë, trajnojnë, rekrutojnë apo thjesht iu pëlqen të studiojnë mbi performancën brenda kuadrit tonë ligjor e rregullator. Në një kohë të dytë, kur auditimi i performancës të urbanizohet si koncept në administratën publike, manuali mund t'iu shërbejë edhe strukturave të auditimit të brendshëm që vendosin të angazhohen në këtë fushë sfiduese dhe realisht frytdhënëse. Manuali, përveç ekspertizës departamentale, u mbështet në dokumente të tilla të ngjashme nga SAI homologe, konkretisht nga SAI suedez, kanadez, anglez dhe më së shumti nga ai slloven (me këtë të fundit për shkak të ngjashmërive të mëdha në mentalitet, organizim dhe eksperiencë kohore). Referenca të shumta i bëhen në të Rregullores së Brendshme Institucionale, duke mos përsëritur ato që thuhen atje, por duke u fokusuar më tepër në aspektet profesionale sesa ato proceduriale. Sigurisht, manuali nuk mund të kuptohet nëse më parë nuk janë studiuar dhe kuptuar mirë Standardet 3000 & 3100 të Udhëzuesit të Auditimit të Performancës. Ky manual plotëson dhe adreson në një kontekst kombëtar ato që INTOSAI ka formuluar universalisht për të gjitha Institucionet Supreme të Auditimit. Ky dokument duhet trajtuar në çdo moment si një punë në proces, një qasje teorike dinamike ndaj një realiteti që si konstante të vet ka vetëm ndryshimin. Manuali është i hapur për të gjithë ata që kërkojnë ta përmirësojnë atë ose veten e tyre. Me miratimin e Rregullores së Re Institucionale, pasurimit të ekspertizës audituese, bashkëpunimit me qarqet akademike e profesionale brenda e jashtë vendit, manuali do të ndryshojë për të reflektuar progresin institucional. Gjithashtu, me përfundimin dhe miratimin e letrave të reja të punës, manuali do të plotësohet edhe më tej me bazë dokumentare standarde. Ndërkohë puna në departament po vazhdon për t'i bashkëlidhur këtij materiali teorik edhe setin e kritereve që NAO britanike ka filtruar si normativa për administratën publike.

BUJAR LESKAJ

Parathënie e librit" COBIT 4.1, Objektivat e kontrollit të Teknologjisë së Informacionit"

Botim i vitit 2015

Libri "Objektivat e Kontrollit për teknologjinë e Informacionit" (COBIT), që po ju sillet në dispozicion në gjuhën shqipe, së bashku me Manualin e Auditimit IT janë dy botime të rëndësishme të KLSH-së në fushën e Teknologjisë së Informacionit. Ky botim vjen i 42-ti në kolanën e botimeve të KLSH-së (2012-2015).

COBIT 4.1, botim i Organizatës ndërkombëtare të Auditimit dhe Kontrollit të Sistemeve të Informacionit, ISACA (Information Systems Audit and Control Association), është një strukturë e përdorur gjerësisht, e cila përmbledh rekomandimet, praktikat dhe metodat më të mira të vlerësimit për kontrollet e përgjithshme IT, si dhe për programet që zhvillohen në këto ambiente.

COBIT ka fituar statusin e "Biblës" në qarqet dhe organizatat e auditimit dhe të menaxhimit të Teknologjisë së Informacionit të mbarë botës. Aktualisht, ISACA, u shërben më tepër se 110,000 anëtarëve dhe profesionistëve, të cilët mbajnë certifikatat e saj.
Audituesit IT, menaxherët e biznesit dhe profesionistët në fushën e sigurimit të IT, me këtë botim, kanë në dorë një set të plotë të proceseve për menaxhimin e IT, objektivat përkatëse, masat e performancës dhe një model fillestar maturimi për përdorim të vazhdueshëm, të ndarë në katër fusha: planifikim – organizimi/disponimi – implementimi/ ofrimi – mbështetja/ monitorimi - vlerësimi;

Auditimi i IT, si një ndër fushat më të reja dhe më komplekse të auditimit, paraqitet me një numër të kufizuar standardesh e udhëzimesh, që përcaktojnë rregullat e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit. Botimi i këtij libri plotëson këtë boshllëk dhe është vazhdim i përpjekjeve për zbatimin e Auditimit IT në KLSH, duke e pajisur me dijet më të mira të praktikës botërore.

Ky botim dhe të tjera në vazhdim do të shërbejnë si mjete të fuqishme për shtimin e njohurive mbi menaxhimin dhe Auditimin e Teknologjive të Informacionit jo vetëm në KLSH, por kudo ku ato zbatohen.

BUJAR LESKAJ

Parathënie e librit "Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit"

Botim i vitit 2015

Manuali i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit është botimi i parë i serisë së botimeve të KLSH në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe është produkt i grupeve të punës së teknologjisë së Informacionit të EUROSAI-t (WGITA) si dhe Iniciativës për zhvillim të INTOSAI-t (IDI) për përcaktimin e rregullave e standardeve të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

Zhvillimi i teknologjive dhe përfshirja e sistemeve të informacionit në çdo qelizë të jetës, nxori në dritë domosdoshmërinë e auditimit të Teknologjisë së Informacionit, adoptimin e një metodologjie dhe qasje të drejtë për identifikimin e risqeve dhe minimizimin e tyre, dhënien e sigurisë së integritetit të të dhënave, zbulimit të abuzimeve dhe shkeljes së privatësisë, etj.



Auditimi i Teknologjisë së Informacionit (IT) është një ndër llojet me të reja të Auditimeve të Institucioneve Supreme të Auditimit dhe nënkupton një ekzaminim të zbatimit të sistemeve IT-së për të garantuar se ato përmbushin nevojat e subjektit, pa kompromentuar sigurinë, privatësinë, koston dhe elemente të tjera kritike të veprimtarisë së subjektit të audituar. Zanafilla e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit në KLSH nis më dhjetor 2011, kur si kandidat i nominuar nga Presidenti i Republikës me detyrën e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, paraqita pranë Komisionit për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë, Projekt-Ide-në për zhvillimin e KLSH-së ku në mënyrë të veçantë theksova: "Intensifikimi I përdorimit të metodave bashkëkohore të teknologjisë së informacionit do të jetë një nga instrumentet bazë të rritjes së performancës së punës së KLSH-së dhe do të lehtësojë kontrollet e kryqëzuara të transaksioneve financiare". Kjo ide u

konsolidua në planin strategjik të zhvillimit të KLSH-së, 2013-2017, dhe ka si objektiv Zhvillimin e Auditimit IT-së dhe përdorimin e Teknologjisë së Informacionit në punën audituese. Në realizimin e këtij plani ambicioz në strategji u përcaktuan aleatët tanë në hartimin e implementimin e metodologjive të auditimit të Teknologjisë së Informacionit ku vendin kryesor e zënë SIGMA, IDI dhe Institucionet homologe të Polonisë, Turqisë, Zyrës Federale të Auditimit të Zvicrës, Sllovenisë, Kroacisë etj, mbështetur në moton e INTOSAI-t "Experientia Mutua Omnibus Prodest" (Ekseperienca e përbashkët u shërben të gjithëve).

Ndihmesë në zhvillimet e IT-së dhe Auditimit të saj ka dhënë pjesëmarrja në takimet e projektit të WGITA për ITSA (Vetëvlerësimin e Teknologjisë së Informacionit) dhe ITASA (Vetëvlerësimit të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit) të kryesuara nga Zyra e Auditimit të Zvicrës. Produkt i këtij bashkëpunimi ishte kryerja e ITSA-s në tetor 2014 dhe zhvillimi i ITASA në KLSH brenda vitit 2015.

Në saj të politikave institucionale të ndjekura nga KLSH, nga viti 2012 e në vazhdim, Auditimi i Teknologjisë së Informacionit ka fituar kartën e qytetarisë (nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" datë 27.11.2014) dhe është në fazën e zbatimit të tij. Ky Manual është hartuar për të pajisur audituesit e jashtëm e të brendshëm të TI-së me udhëzime të detajuara mbi fushat e Auditimit të IT-së, duke nisur me identifikimin e zonave e mundshme të auditimit, identifikimin e risqeve dhe vlerësimin e tyre, hartimin i planit si dhe kryerjen e auditimit, gjithashtu ka informacione të vlefshme edhe për audituesit e fushave të tjera si dhe për personelin e njësive të IT-së. "Manuali i Auditimit të IT-së" është i 43-ti në kolanën e botimeve të KLSH-së (2012-2015) e vjen pas botimit të "Manualit të Auditimit të Performancës" dhe botimit të standardeve të tjera të auditimit si "Udhëzuesi i Auditimit të Përputhshmërisë", "Udhëzuesi i Shënimeve Praktike të Auditimit Financiar (ISSAI 1000-2999), "Standardet e Auditimit të INTOSAI-t" (ISSAI 10, 209 30, 40, 100, 200, 300, 400) si dhe "Udhëzuesi i Auditimit të Performancës" (ISSAI 3000-3100). Të gjitha këto botime do t"i ndihmojnë audituesit e KLSH-së në rritjen e cilësisë së auditimeve.

Ky dhe botime të tjera në vazhdim, do të shërbejnë si mjete të fuqishme në shtimin e njohurive rreth problemeve të auditimit të IT-së dhe implementimin e plotë edhe të këtij auditimi nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në Shqipëri.

BUJAR LESKAJ



Parathënie e librit "Audituesit e KLSH në shtypin e përditshëm"

Vëllimi III, Botim i vitit 2015

Kontrolli i Lartë i Shtetit vjen përpara lexuesit me vëllimin e III-të të botimit *"Audituesit e KLSH-së në median e shkruar",* i cili përkon me botimin e 44-të të kolanës së botimeve të KLSH-së.

Më një qasje të re ndaj komunikimit me publikun, referuar edhe standarteve Ndërkombëtare të Auditimit, sipas të cilëve ": .... *Një SAI i pavarur,efektiv dhe i besueshëm është një komponent thelbësor në një sistem demokratik, ku përgjegjshmëria, transparenca dhe integriteti janë pjesë e domosdoshme e një demokracie të qëndrueshme.... (ISSAI 12, "Vlerat dhe dobitë e SAI-ve-sjellja e ndryshimeve ne jetën e qytetarëve)*, KLSH ka rritur gradualisht transparencën e veprimtarisë së tij, duke arritur në fund të vitit 2014 që të gjashtëfishojë praninë e tij me informacion dhe mesazhe në median e shkruar dhe të katërfishojë prezencën e tij në median audiovizive, krahasuar me vitin 2010.



Një risi e padiskutueshme është edhe prezenca e audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit në shtypin e shkruar, të cilët nëpërmjet shkrimeve të tyre kanë bërë prezente për lexuesit problematikat e auditimeve në institucionet shtetërore, por edhe zhvillimet e institucionit, rritjen e kapaciteteve audituese të stafit nëpërmjet trajnimeve, etj. Gjatë 2014, ne kemi qenë prezentë pothuajse në të gjitha gazetat me 134 shkrime, të shkruara nga 51 audites të KLSH-së, shkrime të pasqyruara në volumin e II-të të botimit *"Audituesit e KLSH-së në median e shkruar"* (që i referohet gjashtë mujorit të parë të vitit 2014) dhe volumi i III-të që po paraqitet aktualisht përpara lexuesit që përmbledh shkrimet e audituesve të KLSH-së për periudhen e dytë të vitit 2014.

Artikujt, analizat dhe editorialet e audituesve të KLSH-së të botuara në shtypin e shkruar periodik përbëjnë pa dyshim një vlerë të shtuar në drejtim të komunikimit me qytetarët sepse mesazhet dhe problematikat e përcjella janë parë në këndvështrimin e profesionit të audituesit. Këto botime kanë kontribuar jo vetëm në sjeljen e një fryme të re që i shërben rritjes së transparencës, por synojnë njëkohësisht dhe rritjen e kompetencës profesionale të nëpunësve të institucionit nëpërmjet vendosjes në një plan tjetër të nëpunësit audites të këtij institucioni përballë të audituarve. Këto shkrime nuk janë botuar si *qëllim në vetvete* por si mjet për të tërhequr në këtë rrugë dhe nëpunësit e institucioneve të çdo niveli të administratës shtetërore, duke i shërbyer kështu jo vetëm evidentimit të nëpunësve të përgjegjshëm dhe të aftë por edhe evidentimit të punonjësve që shprehin publikisht me kurajo dhe dinjitet mendimet e tyre. Nga KLSH kjo konceptohet si një sfidë që po realizohet dhe preket ditë pas dite, nga më shumë audites, të cilët nuk druhen të përballen me profesionalizëm me debate dhe kundërshti lidhur me problematikat e ngritura prej tyre.

Institucioni ka qenë i pranishëm në media me anë të artikujve të ndryshëm problematikë, përgatitur nga drejtues apo audites me përvojë të KLSH-së, në mënyrë që të përcjellë në mënyrë të plotë dhe të qartë informacionin për publikun.

Në rritjen e transparencës dhe informimin e publikut një rol të pazëvendësueshëm kanë luajtur botimet e KLSH-së dhe shkrimet e audituesve të KLSH-së janë një mjet informimi më shumë për publikun dhe një tregues më shumë në lidhje me transparencën e institucionit.

Intensifikimi dhe rritja cilësore e komunikimit të KLSH-së ka sjellë rezultate, veçanërisht në rritjen e vëmendjes së medias për raportet e auditimit dhe për institucionin në tërësi, si edhe ne rritjen e besueshmërisë se qytetarëve ndaj institucionit.

KLSH, po përdor gjithnjë e më shumë mjetet moderne të komunikimit, komunikimin e thjeshte dhe konciz sepse sot është koha e përcjelljes së shpejtë dhe e vizualizimit të informacionit, por njëkohësisht do të ruajë komunikimin e drejtpërdrejtë të audituesve me qytetarët për të qenë më pranë tyre dhe për të përcjellë problematika konkrete të punës në terren. Për këtë arsye, audituesit e KLSH-së kanë vazhduar të jenë prezentë në median e shkruar edhe gjatë vitit 2015 (gjashtë mujorit të parë) dhe shkrimet e tyre të përmbledhura do të botohen brenda vitit 2015, ne botimin e IV-të të kësaj serie.

Viti 2014 ka qenë pa diskutim, vit i konsolidimit të arritjeve të nisura në vitin 2012 dhe vit në të cilin institucioni ka marre fizionominë e një institucioni modern me qasje evropiane.

Për këto arritje, falënderimi im shkon tek të gjithë drejtuesit, audituesit dhe punonjësit e

Kontrollit të Lartë të Shtetit, të cilët me punën e përkushtuar dhe profesionalizmin e tyre kanë bërë të mundur përmbushjen e objektivave ambicioze, duke ruajtuar pavarësinë dhe integritetin e tyre, duke qenë në të njëjtën kohë model edhe per institucione të tjera shtetërore veçanërisht në fushën e botimeve dhë të transparencës së veprimtarisë së institucionit.

BUJAR LESKAJ

Parathënie[121] e librit "Kodi i Etikës, Kodi i Sjelljes-ECA, ISSAI 30- Kodi i Etikës"

Botim i vitit 2015



Në bazë të Nenit 1 të ISSAI 1, Deklarata e Limës, të ISSAI 30 "Kodi i Etikës" të INTOSAI-t, të ISSAI 12 "Vlerat dhe Përfitimet e SAI-ve: të bësh diferencën në jetët e qytetarëve", Parimi 4, pika 3, të ISSAI 20 "Parimet e Transparencës dhe Përgjegjshmërisë", Parimi 2 dhe 4, si dhe të ligjit integral të KLSH Nr. 154/12 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", ju paraqesim këtë botim që përmbledh Kodin e Etikës të INTOSAI-t(ISSAI 30), Kodin e Etikës të Gjykatës Evropiane të Audituesve (ECA-institucioni suprem i auditimit i Bashkimit Europian) dhe Kodin e Etikës të KLSH.

Rregullat e moralit dhe etikës së punës audituese janë bazat e ngrehinës së një institucioni suprem auditimi. Sikurse shprehet Gene L. Dodaro, Audituesi i Përgjithshëm i SHBA-së "*Etika dhe integriteti janë kaq të rëndësishme për auditimin. Ato përbëjnë themelet e profesionit tonë ...Besueshmëria e GAO-s(SAI i SHBA-së) varet nga perceptimi - dhe realiteti- që puna jonë është kryer me integritet dhe bazuar në parimet etike....Si një agjenci e auditimit që mban agjencitë e tjera shtetërore të përgjegjshme, është thelbësore që njerëzit tanë të ruajnë standardet më të larta etike në punën dhe sjelljen e tyre*". (Nga fjala "Etika dhe Integriteti në Auditim: Një parakusht për Mirëqeverisjen", mbajtur në Konferencën vjetore të

[121] Kjo Parathenie publikohet në formë të shkurtuar

Shoqatës Amerikane për Administratën Publike "Leksione të Elliot Richardson", New Orleans, Louisiana, SHBA, më 17 mars 2013)

Japim për audituesit tanë, por edhe për audituesit publikë në tërësi dhe për lexuesin shqiptar, rregullat e etikës ashtu si kërkohen nga standardet ndërkombëtare të auditimit suprem publik(ISSAI-t), nëpërmjet Kodit të Etikes ISSAI 30 të organizatës INTOSAI, nëpërmjet Kodit të Etikës të SAI-t të Gjykatës Evropiane të Audituesve (ECA) të Bashkimit Evropian, ku ne synojmë të anëtarësohemi dhe jemi vend kandidat, si dhe nëpërmjet Kodit tonë të Etikës, të miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr 56 datë 30.04.2015, i cili reflekton tërësisht kërkesat dhe orientimet e dy kodeve të mësipërme, si dhe punën e bërë nga INTOSAI për përditësimin e ISSAI 30. Kemi vepruar kështu, pasi korniza etike e një SAI ka një vijueshmëri dhe bashkëveprim me komunitetin të cilit ai i përket dhe, sikurse theksohet në parathënien e ISSAI 30, "Kodi i Etikës i INTOSAI-t ka për qëllim të përbëjë një bazë për kodet kombëtare të etikës. Secili SAI ka përgjegjësinë për të siguruar që të gjithë audituesit e tij të njihen me vlerat dhe parimet e përfshira në Kodin e Etikës dhe të veprojnë në përputhje me to". Një Kod Etike në auditimin suprem publik, është një deklaratë e plotë e vlerave dhe parimeve të cilat duhet të udhëheqin punën e përditshme të audituesve. Vitor Calderia, Presidenti i Gjykatës Evropiane të Audituesve, në fjalën e tij në Konferencën "Përgjegjshmëria dhe auditimi publik", në Luksemburg, 14 tetor 2014, ka nënvizuar se "Në gjykimin tonë, përgjegjshmëria publike efektive është thelbësore për të siguruar legjitimitetin demokratik të Bashkimit Evropian në sytë e qytetarëve të tij.

Dhe ne besojmë se audituesit publikë, si audituesit e Gjykatës Evropiane të Auditorëve, luajnë një rol të rëndësishëm në sigurimin e këtij legjitimiteti, pasi ata veprojnë mbi bazën e etikës në auditimin suprem, pavarësisë, integritetit dhe paanshmërisë së mendimit të tyre audites dhe institucionit të tyre".

Kodi i Etikës i KLSH reflekton edhe objektivat e Strategjisë së Zhvillimit 2013-2017 të institucionit, e ripunuar për periudhën 2015-2017. Kemi instaluar një sistem efektiv të etikës dhe integritetit, i cili bazohet në parimin e udhëheqjes nëpërmjet shembullit, duke i ofruar publikut, Kuvendit dhe Ekzekutivit një strukturë kushtetuese mbikëqyrëse dhe kontrolluese të financave publike, e cila synon nivelet më të larta të përgjegjshmërisë dhe profesionalizmit, si dhe të qenurit një institucion model i integritetit.

Besimi absolut i Kuvendit dhe qytetarit në veprimtarinë e Kontrollit të Lartë të Shtetit mund të arrihet vetëm nga zbatimi me rigorozitet i kërkesave, vlerave dhe parimeve të Kodit Etik të INTOSAI-t ISSAI 30, të Kodit të Etikës së ECA-s dhe të Kodit të Etikës së Kontrollit të Lartë të Shtetit. Në Kodin e Etikës së KLSH-së për herë të parë, një sërë parimesh dhe vlerash janë trajtuar në një profil dhe optikë bashkëkohore dhe në një

frymë moderne, në reflektim edhe të sfidave me të cilat përballen audituesit publikë sot në nivel global.

Për periudhën dhe sfidat në vijim, zbatimi i standardeve, parimeve dhe vlerave të etikës, sikurse trajtuar në Kodin e Etikës ISSAI 30 të INTOSAI-t, në Kodin e Etikës të ECA-s së Bashkimit Evropian dhe në Kodin Etik të KLSH, do të vijojë të jetë përparësi absolute e veprimtarisë sonë menaxheriale, duke e konsideruar si një bazë solide referuese dhe një komponent kyç për të rritur besimin e publikut dhe Kuvendit ndaj KLSH, si një institucion evropian modern, model dhe efikas, i cili udhëheq nëpërmjet shembullit.

BUJAR LESKAJ

Parathënie e librit "Raporti vjetor i performancës 2014"

Botim i vitit 2015

Viti 2014 ka përfaqësuar për KLSH vitin e dytë të zbatimit të Strategjisë së tij të Zhvillimit 2013-2017, të bazuar në drejtimet kryesore strategjike të INTOSAI-t dhe EUROSAI-t, strategji e cila synon sjelljen e veprimtarisë audituese të institucionit në parametrat e institucioneve të zhvilluara simotra të Bashkimit Evropian, në respektim të plotë të mandatit kushtetues të KLSH dhe të pritshmërive të Kuvendit dhe qytetarëve.

Në tërësi, nisur nga sasia dhe cilësia e auditimeve të kryera, nga gjetjet dhe rekomandimet e dhëna, nga përpjekjet për të luftuar korrupsionin dhe abuzimin me fondet publike, viti 2014 përfaqëson vitin e konsolidimit të reformave të ndërmarra gjatë viteve 2012-2013 dhe vit në të cilin institucioni ka fituar ne mënyrë më të plotë fizionominë e një institucioni modern të auditimit suprem publik, me qasje evropiane.

Filozofia e re e punës ka synuar zbatimin rigoroz të standardeve profesionale të fushës ISSAI, duke realizuar shkëputjen përfundimtare të KLSH nga tradita shumëvjeçare e një strukture të orientuar për nga inspektimi financiar, në një trupë auditimi që kërkon shtimin e vlerës së parasë publike të shpenzuar për investime dhe shërbime ndaj qytetarëve, duke u përqendruar në auditimin e mirëfilltë financiar dhe në auditimin e performancës, pa harruar investimin në teknologji dhe në dijet për realizimin e auditimeve të teknologjisë së informacionit.

Auditimet tona për vitin 2014 janë përzgjedhur mbi bazën e analizës së riskut dhe kanë synuar rritjen e thellësisë së gjetjeve të auditimit dhe dobishmërisë së rekomandimeve,

duke e parë institucionin e audituar në funksionimin e tij në sistem. KLSH ka vënë theksin në plotësimin e rekomandimeve të auditimeve të mëparshme, duke kërkuar rritjen e nivelit të përgjegjshmërisë dhe transparencës së menaxhimit të institucioneve të audituara.

Në dhjetor 2014, në një kohë që përkon afërsisht me miratimin e Rezolutës së Dytë të Kombeve të Bashkuara, kushtuar forcimit dhe mbështetjes së institucioneve supreme të auditimit dhe organizatës së tyre INTOSAI, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin e ri organik të KLSH, tërësisht në përputhje me standardet e INTOSAI-t, duke zbatuar rekomandimet e Progres Raporteve të Bashkimit Evropian dhe duke i siguruar institucionit bazën për një modernizim të plotë të aktivitetit të tij audites.

Gjatë vitit 2014, KLSH ka rritur dhe konsoliduar më tej hapat e ndërmarrë në vitet 2012 dhe 2013 për një transparencë të plotë me publikun dhe qytetarët, nëpërmjet njoftimeve për shtyp, botimeve të tij, editorialeve të shkruara nga audituesit në shtypin shqiptar dhe realizimit të Konferencës së Tretë Shkencore për Auditimin Publik.

Institucioni ka konsoliduar bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë si DG-Budget, SIGMA dhe institucionet simotra evropiane, por edhe me profesoratin shqiptar, me organizatat profesionale të vendit dhe me shoqërinë civile, drejt një qasjeje të re gjithëpërfshirëse, ku këta partnerë, krahas aktiviteteve të përbashkëta, japin kontribut edhe në procesin e vetëvlerësimit të institucionit dhe në rritjen e integritetit të tij. KLSH ka përqafuar qasjen IntoSAINT të organizatës INTOSAI, të vetëvlerësimit të integritetit, duke synuar rritjen e integritetit jo vetëm brenda tij, por edhe kufizimin dhe parandalimin e korrupsionit në institucionet që ai auditon, nëpërmjet vetëvlerësimit të integritetit.

Viti 2014 shënoi edhe konsolidimin e investimit në kapacitetet audituese, duke qenë viti i tretë radhazi i arritjeve të treguesve perëndimorë në ditët e trajnimeve në vit për audites, nisur nga një bazë e papërfillshme e trashëguar nga vitet e mëparshme.

Të gjitha këto arritje dhe tregues janë vetëm fillimi i qasjes së re, për një auditim sa më cilësor, në shërbim të qytetarit, të orientuar drejt shëndoshjes së plotë të financave publike dhe rritjes së përgjegjshmërisë dhe transparencës në përdorimin e fondeve publike. Është siguruar një bazë e mirë për reformim të mëtejshëm, e konsoliduar gjatë vitit 2014, por për plotësimin e sfidave të mësipërme, KLSH ka nevojë për një bashkëpunim sa më efektiv me Kuvendin, me institucionet e tjera të pavarura që luftojnë për mirëqeverisjen publike dhe kundër korrupsionit, me Qeverinë, shoqërinë civile dhe qytetarin.

Falenderim i veçantë

Në cilësinë e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe në emër të të gjithë trupës së audituesve dhe punonjësve mbështetës në institucion, falenderoj në mënyrë të veçantë z. Erion Braçe, Kryetar i Komisionit të Kuvendit për Ekonominë dhe Financat, si dhe deputetët e të gjitha partive politike anëtarë të këtij Komisioni për ndihmën, mbështetjen dhe sugjerimet e tyre tejet të vlefshme në procesin e diskutimit dhe miratimit të ligjit të institucionit, si edhe mbështetjen dhe mirëkuptimin e treguar sa herë që KLSH ka raportuar në Komision gjatë vitit 2014 dhe 2015.

Kjo ndihmë dhe mbështetje e vyer, në linjë me kërkesat e dy Rezolutave të OKB-së të viteve 2011 dhe 2014, për forcimin dhe mbështetjen e institucioneve supreme të auditimit, krahas inkurajimit dhe nxitjes së audituesve për të rritur profesionalizmin e tyre dhe përpjekjet për të kontribuar më me efektshmëri në mirëqeverisjen publike dhe në thellimin e luftës ndaj korrupsionit, përbën vlerë për Kontrollin e Lartë të Shtetit në sfidat e viteve të ardhshme, që synojnë modernizimin e plotë, duke realizuar tërësisht objektivat e Strategjisë së Zhvillimit 2013-2017 të KLSH-së (rishikuar për periudhën 2015-2017), si dhe duke respektuar pritshmëritë e Kuvendit dhe të qytetarëve në misionin e tij kushtetues, si institucion suprem i auditimit publik në Shqipëri.

BUJAR LESKAJ

Parathënie e librit "90 vjet KLSH"

Botim i vitit 2015



Kujtesa institucionale e një organi kushtetues është e një rëndësie parësore për të lexuar drejt vlerat dhe kontributin e tij përgjatë viteve, por edhe gabimet dhe momentet e kthimeve prapa. Një analizë e tillë në dritën e fakteve të plota i shërben institucionit kushtetues për të kuptuar qartë pozicionin e tij në shoqëri, por edhe opinionit publik dhe qytetarëve për të peshuar si duhet misionin dhe realizimin e tij nga ky institucion.

Si KLSH, në 90-Vjetorin e krijimit të institucionit, duke iu referuar orientimit themelor të Kongresit të XXI-të, të INTOSAI-t, në tetor 2013 në Pekin, për vendosjen e auditimit kombëtar në shërbim të qeverisjes kombëtare, kemi kënaqësinë të sjellim tek lexuesit këtë përmbledhje të kumtesave, përshëndetjeve dhe aktiviteteve kryesore për kremtimin e këtij jubileu. Sikurse e theksoi Gene L. DODARO, Audituesi i Përgjithshëm i GAO-s amerikane në përshëndetjen e tij drejtuar KLSH në 90 Vjetorin e krijimit të saj, "*Institucionet Supreme të auditimit sot janë pozicionuar si kurrë më parë, për të bërë diferencën, jo vetëm për vendet e tyre, por në tërësi për të gjithë botën. Në nivel kombëtar, SAI-t ndihmojnë në përmirësimin e shërbimeve publike dhe ndihmojnë drejtuesit publikë të planifikojnë të ardhmen*".

Duke e parë veten në këtë mision, kemi kërkuar identitetin institucional, nëpërmjet dokumentimit dhe hedhjes dritë të plotë mbi historine e zhvillimit të KLSH, si një përgjegjësi për brezat që vijnë, por edhe një shërbim për qytetarin, opinionin publik dhe partnerët tanë vendas dhe të huaj.

Historiku i Kontrollit të Lartë të Shtetit lidhet ngushtë me shpalljen nga deputetët e Kuvendit Kushtetues më datë 21 janar 1925 të krijimit të Republikës Parlamentare Shqiptare. Pas miratimit të Statutit Themeltar të Republikës Shqiptare, Presidenti i Republikës, Ahmet Zogu më datë 20 maj 1925 firmosi Dekret- Ligjin " Mbi formimin e Këshillit Kontrollues", dekret që hyri në fuqi më datë 26 maj 1925. Ky këshill krijohej si organ kushtetues dhe nuk varej nga asnjë ministri.

Në vitet 1928-1939, vendi drejtohej nga një monarki institucionale. Me ligj të veçantë përcaktohej mënyra e organizimit dhe ushtrimit të veprimtarisë së institucionit të Kontrollit Shtetëror, mënyra e raportimit në Parlament dhe marrëdhëniet e tij me qeverinë e mbretin.

Në Gusht të vitit 1946 bëhet riorganizimi tërësor i organeve të kontrollit, si në formë edhe në përmbajtje. Me ligj të veçantë të Kuvendit Popullor krijohet Komisioni i Kontrollit të Shtetit, i cili ishte në përbërje të Qeverisë dhe në varësi të plotë prej saj (strukturë nën varësinë e ekzekutivit dhe të partisë-shtet), duke humbur pavarësinë dhe duke qenë në shërbim të politikës së shtetit totalitar.

Me vendosjen e pluralizmit në Shqipëri, me asistencën e BE u hartua projektligji "Për Shërbimin e Kontrollit të Shtetit", i cili u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë në 31 gusht 1992. Në këtë ligj sanksionohej se Shërbimi i Kontrollit të Shtetit ishte organi më i lartë i kontrollit ekonomiko-financiar dhe i pavarur nga qeveria.

Pavarësia e plotë, depolitizimi dhe departizimi i organit suprem të kontrollit u realizuan me miratimin e ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit" dhe më pas të ligjit themelor të Shtetit nr. 8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", pjesa e katërmbëdhjetë "Kontrolli i Lartë i Shtetit", nenet 162-165.

Në datën 27 nëntor 2014, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin e ri të KLSH-së, nr. 154/2014, "Mbi organizimin dhe funksionimin e KLSH", i cili hyri në fuqi në shkurt 2015. Ky ligj realizon profilizimin e KLSH-së si një institucion modern evropian i auditimit suprem publik, i cili e bazon aktivitetin e tij tërësisht në standardet ndërkombëtare të INTOSAI-t.

KLSH gjatë gjithë periudhës së pluralizmit ka vepruar në mënyrë të pavarur, duke gëzuar pavarësi dhe duke u përpjekur të bashkëpunojë me institucionet homologe dhe partnerët ndërkombëtare. Në pamundësi të përmendjes së të gjithë figurave të drejtuesve të KLSH ndër vite, do të veçoja personalitetet e ndritura, veçanërisht në vitet 1925-1944, si: Kol Thaçi, Lac Gera, Llambi Aleksi, Fejzi Alizoti, Lame Kareco, Eqerem

Libohova, Xhaferr Ypi, Rrok Gera, Izedin Beshiri dhe të tjerë. Dëshiroj gjithashtu të vlerësoj punën reformuese të kryetarëve të KLSH-së në vitet e demokracisë, z.Zyhdi Pepa, z.Ylli Memisha, z.Stefan Papagjoni, Prof. Dr. Blerim Çela, z.Mustafa Kërçuku, z.Robert Çeku, etj.

Dëshiroj të shpreh falënderimet e mia për të gjithë përfaqësuesit e Organizatave Evropiane dhe Ndërkombëtare të Auditimit, drejtuesit e SAI-ve partnere që morën pjesë në kremtimet e 90 vjetorit dhe në vecanti Presidentin e Gjykatës Evropiane të Audituesve, z. Vitor Manuel da SILVA CALDEIRA, Presidentin e Gjykatës Austriake të Auditimit dhe njëkohësisht Sekretar i Përgjithshëm i INTOSAIT, z.Josef MOSER, Zv/President i EUROSAI-t dhe President i Gjykatës së Llogarive të Turqisë, Prof. As. Dr. Recai AKYEL, etj.

Një falënderim i veçantë për Presidentin e Republikës SH.T.Z. Bujar NISHANI dhe personalitet e shtetit shqiptar që vlerësuan këtë përvjetor dhe na nderuan me pjesëmarrjen e tyre.

Së fundmi, me mirënjohje të thellë shpreh konsideratën, respektin dhe vlerësimin maksimal për të gjithë trupën e audituesve dhe stafin mbështetës, të cilët me integritet, korrektesë dhe profesionalizëm kanë kontribuar dhe shërbyer në këtë institucion gjatë gjithë kësaj periudhë 90- vjeçare, duke pasur dëshirën e madhe dhe bindjen se 100-Vjetori i krijimit të KLSH-së do ta gjej këtë institucion mes Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI-ve) të vendeve anëtare të BE-së.

BUJAR LESKAJ

Parathënie e librit "Audituesit e KLSH në shtypin e përditshëm"

Vëllimi IV, Botim i vitit 2015

Kontrolli i Lartë i Shtetit vjen përpara lexuesit me vëllimin e IV-t të botimit *"Audituesit e KLSH-së në median e shkruar",* i cili përmban një përzgjedhje të shkrimeve më të mira të audituesve të tij për periudhën janar-qershor 2015.

Për cilindo që ngre pyetjen "Përse audites profesionistë kërkojnë të komunikojnë me qytetarin nëpërmjet shtypit të përditshëm?", i përgjigjemi se e bëjmë të ndërgjegjshëm në detyrat dhe misionin tonë kushtetues për të informuar qytetarin për menaxhimin me ekonomicitet, efektshmëri dhe efiçience të fondeve dhe pronës publike. E bëjmë në zbatim të standardeve ndërkombëtare të auditimit suprem publik, ISSAI-ve dhe pikërisht të ISSAI 1, Deklarata e Limës, Neni 16 i saj "*Raportimi në Parlament dhe ndaj publikut të gjerë*", si dhe të ISSAI 12 *"Vlerat dhe dobitë e SAI-ve: të bësh ndryshimin në jetën e qytetarëve",* Parimi 4 *"Raportimi mbi rezultatet e auditimit, duke mundësuar publikun për të mbajtur qeverinë dhe subjektet e sektorit publik të përgjegjshëm".* Këto standarde na orientojnë si te jemi sa më të efektshëm në përcjelljen e informacionit për auditimet dhe gjetjet tona, jo vetëm për Kuvendin, agjentë të të cilit për ruajtjen dhe mirë menaxhimin e pronës publike ne si KLSH jemi, por edhe për publikun dhe qytetarin. Prandaj, krahas njoftimeve për shtyp për rezultatet e auditimeve, krahas botimeve të raporteve tona të performancës, kemi zgjedhur një qasje të thjeshtë dhe të drejtpërdrejtë, atë të komunikimit me qytetarin nëpërmjet shtypit të përditshëm shqiptar.

Gjatë periudhës 2012-2015, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka arritur të shumëfishojë praninë e tij në median audio vizive dhe atë të shkruar të vendit, krahasuar me vitet e mëparshme. Tani sfida është përçimi në publik i mesazheve për përmirësimin e qeverisjes publike dhe arritjen e mirëqeverisjes, duke përdorur edhe presionin pozitiv nga ana e qytetareve dhe shoqërisë civile.

Audituesi, si ai me eksperience ashtu dhe audituesi i ri në KLSH, kanë shumë për të thëne për qytetarin dhe opinionin publik. Për ketë kanë ndikuar, krahas punës dhe përkushtimit individual profesional, edhe trajnimet e shumta brenda dhe jashtë shtetit, të organizuara nga institucioni. Në këto trajnime çdo audites ka marre njohuri të gjera për standardet e fushës të organizatës INTOSAI, për teknikat audituese të përdorura nga institucionet simotra audituese ndër më të zhvilluarat në rajon dhe në Europë, si institucioni suprem i auditimit (SAI) i Polonisë, Turqisë, Kroacisë, Sllovenisë, por edhe pranë Gjykatës se Audituesve të Bashkimit Evropian. Në dijet dhe kompetencat e rritura të audituesit të KLSH ka ndihmuar edhe leximi i kolanës së botimeve KLSH, tashmë të arritur në 48 tituj, me libra për manualet e llojeve të ndryshme të auditimit, për profilet dhe historikun e SAI-ve evropiane, për raportet e performancës së institucionit për vitet 2012, 2013 dhe 2014, por edhe për historikun e tij, etj.

Të pajisur me një bagazh të tillë dijesh dhe njohurish profesionale, audituesit tanë kane rritur cilësinë e gjetjeve dhe rekomandimeve të tyre, krahas përmirësimit të mënyrës së raportimit të auditimit. Tani është një nevojë e përhershme për ta, që gjetjet dhe rekomandimet e tyre kryesore të mund t'i shtjellojnë me shkrime dhe analiza në shtypin e përditshëm. Nga blogjet mbi temat që kanë zgjedhur për të dalë në publicistiken shqiptare dhe mënyrën e shtrimit të problemeve dhe zgjidhjet që japin, audituesit marrin ide dhe shtytje për shkrime të tjera.

Është kjo arsyeja që vëllimi i IV-t i pranisë së audituesve të KLSH në shtypin e shkruar përmban gjithnjë e më shumë shkrime konkrete për problematikat që hasen më shpesh në jetën e përditshme të qytetarit që merr shërbime publike, por dhe që janë më të mprehtat, të evidentuara nga auditimet e vitit të kaluar dhe të këtij viti.

Kështu, në ketë botim gjen shkrime me tema si "Gropa e kasave fiskale", "Përse gjithë kjo "uri" për të marrë borxh?" ,"Korrupsioni"- Kështjelle rëre, dilemë mes fenomeneve të një vendi në zhvillim dhe gjenezës humane", "I lirë dhe i papunë nga këndvështrimi i një auditimi", 'Shteti është "roja i natës", "Si të bëhemi audites të teknologjisë së informacionit", "Problematika e projekteve me financime të huaja", "Konsolidimi i Pasqyrave Financiare në nivel kombëtar domosdoshmëri për Shqipërinë", "BE, KLSH dhe sfidat e prokurimit publik", "Menaxhimi i rrezikut të mashtrimit dhe roli i audituesve të jashtëm publikë", etj..

Artikujt, analizat dhe editorialet e audituesve të KLSH-së për gjysmën e parë të vitit 2015 janë shumë më konkrete dhe që prekin tema të ndjeshme për qytetarin. Ato, se bashku me qindra artikuj të botuar në shtypin e përditshëm përgjatë viteve 2013-2014, kontribuojnë në dy drejtime të rëndësishme. Së pari, shtojnë transparencën e performancës së institucioneve publike tek ne, pse sjellin problematika të para nga syri i

një audituesi profesionist, duke rritur shkallën e informacionit për qytetarin lidhur me veprimet dhe mosveprimet e institucionet më të rëndësishme të Shtetit dhe me shërbimet publike që ai merr prej tyre. Së dyti, i bëjnë këto institucione më përgjegjëse, duke rritur presionin pozitiv nga opinioni publik dhe qytetari për to.

Nga kjo qasje e re dhe kurajoze e audituesve të KLSH, gjatë këtyre tre viteve janar 2013-nëntor 2015, janë botuar mbi 360 shkrime, intervista, editoriale, analiza nga dhjetëra audituesë të institucionit (40 deri 50 audituesë çdo vit) në faqet e gazetave të qarkullimit kombëtar. Dua të falenderoj sidomos gazetat "Panorama", " Telegraf", "Koha Jonë", "Shqip", "Gazeta Shqiptare", "Sot", "Shqiptarja.com", "Tirana Observer" e shumë të tjera që hapën faqet e tyre për mendimet dhe propozimet e audituesve të KLSH, si për përmirësimin e punës sonë audituese, ashtu dhe për, çka është më e rëndësishme, përmirësimin e administrimit në shumë sektorë kyçë të ekonomisë dhe të administratës sonë publike.

Falenderoj në veçanti të gjithë ata gazetarë të këtyre mediave, për punën dhe përkushtimin e tyre në daljen dinjitoze përpara publikut shqiptar të ideve dhe sugjerimeve të audituesve tanë.

Gjykoj dhe shpresoj që shembulli i audituesve të KLSH-së të përcillet tek të gjithë punonjësit e përkushtuar në administratën tonë shtetërore, që t'u drejtohen mediave të pavarura, për të shprehur idetë e tyre lirshëm dhe me kurajo, pse do të kryenin një shërbim të jashtëzakonshëm për transparencën e qeverisjes së vendit.

Falënderimi i fundit dhe për ketë, jo me pak i rëndësishëm, shkon tek të gjithë audituesit, drejtuesit dhe punonjësit mbështetës të auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit, të cilët me punën e përkushtuar dhe profesionalizmin e tyre, bënë të mundur ketë kanal komunikimi të hapur dhe të drejtpërdrejtë me mediat dhe, nëpërmjet tyre me qytetarin, duke kontribuar në rritjen e transparencës dhe të përgjegjësisë së institucioneve tona publike.

BUJAR LESKAJ

KREU IX.

Partneritetet me Institucionet Supreme të Auditimit, me shoqërinë civile dhe me shoqatat profesionale të fushës

- Marrëveshjet e Bashkëpunimit me SAI-t homologë
- Marrëveshjet e Bashkëpunimit me shoqërinë civile
- Pjesëmarrja e SAI-ve në aktivitetet e zhvilluara nga KLSH
- Pjesëmarrja e Kryetarit të KLSH në aktivitetet ndërkombëtare
- Fjala e Kryetarit të KLSH në Këshillin e NIK
- Fjala e Kryetarit të KLSH në Gjykatën e Auditimit të Austrisë

MARRËVESHJET E BASHKËPUNIMIT ME SAI-t HOMOLOGË

KLSH dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës nënshkruajnë Marrëveshje Bashkëpunimi

14 shkurt 2012, Tiranë

Z. Bujar Leskaj dhe z. Lars Lage Olofsson, Auditor i Përgjithshëm i Kosovës, nënshkruajnë Marrëveshjen e Bashkëpunimit mes institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës.

Që me marrjen e detyrës si Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit, një nga prioritetet e KLSH ishte vendosja e një bashkëpunimi më të ngushtë ndërmjet institucionit të KLSH-së dhe Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës. Më 14 shkurt 2012, KLSH nënshkroi marrëveshjen parë të Bashkëpunimit me Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga z. Lars Lage Olofsson, Auditor i Përgjithshëm. Kjo marrëveshje konsiston në respektimin e reciprocitetit dhe bashkëpunimit të përbashkët dhe dobiprurës, si dhe në principet e implementuara nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve të Larta të Kontrollit (INTOSAI) dhe Organizata Europiane e Institucioneve të Larta të Kontrollit (EUROSAI). Në këtë marrëveshje shprehëm vullnetin tonë të përbashkët për të bashkëpunuar në zbatimin e plotë të standardeve ndërkombëtare të sektorit të auditimit publik dhe praktikave më të mira Europiane, shkëmbimin e eksperiencave në zhvillimin e institucioneve respektive, si dhe prezantimin e Fjalorit të Auditimit Publik Shqiptar të standardizuar.

Marrëveshja kurorëzoi fillimi i një procesi të ri në marrëdhëniet tona institucionale, si dhe çeli një faqe të re për të dy institucionet tona në konkretizimin dhe konsolidimin e raporteve të bashkëpunimit institucional.

Nën drejtimin e z.Olofsson, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm njohu një zhvillim të rëndësishëm duke dyfishuar buxhetin e saj dhe katërfishuar numrin e auditimeve. Z. Olofsson, si një personalitet i auditimit të financave publike, ka dhënë një kontribut të veçantë në monitorimin e vlerësimin institucionit të KLSH-së, në kuadër të mbështetjes së ofruar nga misioni vlerësues i SIGMA-s.

Z. Lars Lage Olofsson ka një meritë të veçantë në konkretizimin e marrëveshjes mes KLSH-së dhe ZAP-it, një bashkëpunim i cili është reflektuar në trajnime e vizita të

shkëmbimit të eksperiencave. Aktiviteti i parë që ndërmorëm ishte përkthimi në shqip nga të dyja institucionet të Shënimeve të Praktikës të nivelit të katërt të standardeve ISSAI, të cilat do të orientojnë më mirë audituesit tanë në respektimin e standardeve ndërkombëtare të INTOSAI, gjatë punës së tyre audituese.

Në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Kontrollit të Lartë të Shtetit të Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) të Kosovës, të lidhur në shkurt të këtij viti, me ftesë të Auditorit të Përgjithshëm z. Lars Lage Olofsson, një delegacion i nivelit të lartë të KLSH-së mori pjesë në Konferencën vjetore të ZAP, të zhvilluar në Pejë në datat 10-11 korrik 2012.

KLSH dhe Gjykata e Llogarive të Sllovenisë nënshkruajnë Marrëveshje Bashkëpunimi

25 prill 2012, Ljubjanë, Slloveni

Z. Bujar Leskaj dhe z. Igor Šoltes, President i Gjykatës së Llogarive të Sllovenisë, nënshkruajnë Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Gjykatës së Llogarive të Sllovenisë. Marrëveshja u nënshkrua në prani të ambasadorit të Republikës së Shqipërisë në Slloveni, z. Sandër Kovaçi.

Marrëveshja u përgatit në bazë të parimeve të përbashkëta të respektit, besimit dhe bashkëpunimit dypalësh të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve të Auditimit Suprem (INTOSAI) si edhe të Organizatës Europiane të Institucioneve të Auditimit Suprem (EUROSAI).

Në Deklaratën e Limës (Neni 15) theksohet se shkëmbimi ndërkombëtar i eksperiencës dhe i informacionit shërben si një mjet i mirë ndihmues për institucionet e kontrollit të lartë, për të përmbushur detyrën e tyre. Kjo përfshin shkëmbimin e mësimeve të nxjerra, sikundër trajnimin e audituesve dhe këshillimin mbi metodat e auditimit. Duke patur parasysh ndryshimet në kuadrin ligjor dhe ekonomik të secilit shtet, është e mundur të përdoret eksperienca e fituar nga të tjerët si bazë rritjen e efektivitetit dhe efiçiences së auditimit.

Dokumenti i nënshkruar është shumë i rëndësishëm për KLSH-në. Institucioni Suprem i Auditimit në Sllloveni është modern, një ndër institucionet më profesionale në Evropë.

Nëpërmjet mbështetjes së parashikuar në marrëveshje, KLSH dhe Gjykata e Llogarive e Sllovenisë kanë shkëmbyer eksperiencë në auditimin financiar, atë të përputhshmërisë dhe të performancës, si dhe në certifikimin e deklaratave financiare. Ata po ashtu do të eksplorojnë mundësitë për të përgatitur projekte të përbashkëta.

Marrëveshja e bashkëpunimit u konkretizua për herë të parë në tetor të 2012, ku më datat 15-17, Kryetari Leskaj vizitoi Sllovenině së bashku me një grup drejtuesish dhe audituesish të KLSH-së nga Departamenti i sapoformuar i Auditimit të Performancës, drejtuar nga z. Rinald Muça dhe drejtori i Drejtorisë Juridike, z. Ermal Yzeiraj, në kuadër të një trajnimi 5 ditor mbi Auditimin e Performancës.

Që prej vitit 2014, z.Igor Šoltes është Deputet i Parlamentit Evropian, Zv/Kryetar i Komisionit të Kontrollit të Buxhetit të këtij Parlamenti, anëtar i Komisionit të Tregut të Brendshëm dhe Mbrojtjes së Konsumatorit si edhe anëtar i Komisionit Parlamentar të Stabilizim-Asocimit BE-Shqipëri. Në këto cilësi, Z. Igor Šoltes ka vijuar të kontribuojë në forcimin e kapacitetet e KLSH, në planifikimin strategjik dhe përdorimin e teknikave të auditimit modern.

KLSH dhe Zyra Supreme e Auditimit të Polonisë nënshkruajnë Marrëveshje Bashkëpunimi

23 maj 2012, Varshavë, Poloni

Z. Bujar Leskaj nënshkroi një Marrëveshje Bashkëpunimi me homologun e tij, Presidentin e Zyrës polake të Auditimit Suprem (NIK), z. Jacek Jezierski. Marrëveshja prodhoi rivitalizim të marrëveshjes së mëparshme të viteve 2006-2009. Që në fillimet e punës së tij, zoti Jazierski në pozicionin e lartë të Presidentit të NIK, kishte dëshirën e promovimit të marrëdhënieve reciproke, të drejtpërdrejta dhe të hapura ndërmjet KLSH dhe NIK.

Marrëveshja u nënshkrua në prani të ambasadorit të Republikës së Shqipërisë në Poloni, z. Florent Çeliku dhe u përgatit në bazë të parimeve të përbashkëta të respektit, besimit dhe bashkëpunimit dypalësh të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve të Auditimit Suprem (INTOSAI) si edhe të Organizatës Europiane të Institucioneve të Auditimit Suprem (EUROSAI).

Dokumenti i nënshkruar është me shumë vlera për KLSH-në. Institucioni Suprem i Auditimit në Poloni është modern, një ndër institucionet më të mëdha dhe profesionale në Europë. Presidenti i tij z. Jezierski ka qenë deri në fund të vitit 2011 President i EUROSAI-t dhe përfaqëson një nga figurat më të njohura në komunitetin e auditimit suprem.

Që prej nënshkrimit të marrëveshjes, KLSH dhe Zyra e Auditimit Suprem e Polonisë kanë shkëmbyer eksperiencë në veprimtarinë e tyre audituese. Në fillim të korrikut 2012, një grup prej 10-15 audituesish nga KLSH u trajnuan për auditimin e performancës në Qendrën e Trajnimeve të NIK në Poloni, ndërsa në shtator ekspertë të metodologjisë anti-korrupsion të institucionit polak të auditimit erdhën për një aktivitet të përbashkët në Tiranë.

Në këto katër vite që prej nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit, NIK-u polak është shndërruar në një "Universitet" për audituesit e KLSH, ku për çdo vit organizohen trajnime për dhjetëra e dhjetëra auditues të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Zoti Jezierski ka mundësuar trajnimin e dhjetëra audituesve të KLSH-së në Poloni, të cilët nën përkujdesjen e tij dhe të stafit që ai drejton kanë kryer trajnime në fushën e Auditimit Financiar dhe të Auditimit të Performancës, duke përmirësuar dhe përforcuar ndjeshëm dijet e tyre në këto fusha dhe për rrjedhoje, duke sjellë rritjen e cilësisë së punës audituese të KLSH-së. Spikat kontributi i qenësishëm i z. Jezierski ne revistën shkencore të KLSH, me titull "Auditimi Publik", me shkrime dhe orientime cilësore për të ardhmen e revistës.

KLSH dhe Gjykata Turke e Llogarive nënshkruajnë Marrëveshje Bashkëpunimi

16 nëntor 2012, Ankara, Turqi

Z. Bujar Leskaj, Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit, nënshkroi një Marrëveshje Bashkëpunimi me homologun e tij, Presidentin e Gjykatës së Llogarive të Turqisë, z. Recai Akyel.

Gjykata Turke e Llogarive është një ndër institucionet më të mëdha dhe të zhvilluara të auditimit në Europë dhe për rrjedhojë, marrëveshja përbën një aset të rëndësishëm për KLSH.

Në bazë të marrëveshjes, KLSH dhe Gjykata e Llogarive e Turqisë do të shkëmbejnë eksperiencë në auditimin financiar, atë të përputhshmërisë dhe të performancës, si dhe në certifikimin e deklaratave financiare.

Marrëveshja filloi të konkretizohej shumë shpejt, ku në dhjetor 2012, një grup prej 15 audituesish nga KLSH u trajnuan në Ankara pranë Gjykatës Turke për auditimin e performancës dhe gjatë vitit 2013 u zhvilluan një sërë trajnimesh në Turqi. Vit pas viti, trajnimet nga Gjykata Turke e Llogarive kanë sjellë kualifikimin e dhjetëra audituesve të KLSH-së në Ankara, të cilët nën përkujdesjen e drejtpërdrejtë të Prof. Akyel, por edhe të një stafi të përkushtuar dhe të lektorëve profesionistë të Gjykatës Turke të Llogarive, janë trajnuar në fushën e Auditimit të Performancës, të Auditimit Financiar dhe të Auditimit të Prokurimeve Publike, duke përmirësuar dhe përforcuar ndjeshëm dijet e tyre në këto fusha dhe për rrjedhojë, duke kontribuar në rritjen e cilësisë së punës audituese të KLSH në tërësi. Në vijim të bashkëpunimit të suksesshëm dhe Marrëveshjes së Bashkëpunimit janë shkëmbyer vizita të nivelit të lartë. Kryetari i KLSH-së, më datat 11-13 shkurt 2014, zhvilloi një vizitë pune në Gjykatën e Llogarive të Turqisë, në Ankara. Gjatë qëndrimit në Turqi, bashkëpunimi i frytshëm KLSH-TCA solli nënshkrimin e një Marrëveshje Bashkëpunimi me Dr. Serdar Çam, President i TIKA, Agjencisë Turke për Zhvillim dhe Bashkëpunim.

KLSH dhe Gjykata Austriake e Auditimit nënshkruajnë Marrëveshje Bashkëpunimi

8 korrik 2013, Vjenë, Austri

Z. Bujar Leskaj, Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit, nënshkroi një Marrëveshje Bashkëpunimi me homologun e tij, Presidentin e Gjykatës Austriake të Auditimit, dhe njëkohësisht Sekretar i Përgjithshëm i INTOSAI, Dr. Josef Moser.

Institucioni Suprem i Auditimit i Austrisë, krahas traditave audituese 250 vjeçare, është ndër institucionet më moderne dhe profesionale në Europë. Presidenti i ti,j Dr. Josef Moser, përfaqëson një nga figurat më të njohura në komunitetin e auditimit suprem në botë.

KLSH dhe Gjykata e Auditimit e Austrisë po shkëmbejnë eksperiencë në veprimtarinë e tyre audituese, përmes vizitave të punës, trajnimeve për audituesit shqiptarë, mundësi për auditime të përbashkëta, etj.

Marrëveshja e bashkëpunimit me Gjykatën Austriake të Auditimit ka pasur një natyrë të dyfishtë, për shkak edhe të cilësisë së z. Josef Moser si Sekretar i Përgjithshëm i INTOSA-it, duke dhënë rezultate konkrete në konsolidimin ndërkombëtar të imazhit të KLSH-së, si një SAI me pjesëmarrje aktive në aktivitete dhe grupe pune të ndryshme të INTOSAI-t.

Në këto dy cilësi, z.Josef Moser ka një kontribut të spikatur në forcimin e kapaciteteve audituese të KLSH-së dhe në trajnimin e audituesve shqiptarë. Gjykata e Auditimit e Austrisë, një nga SAI-t më me tradita, më të zhvilluara dhe me kontribute të patjetërsueshme në komunitetin e INTOSAI-t, pranoi gjatë vitit 2015 që të ishte vlerësuesi i KLSH-së në procesin "Peer Review (Rishikim mes Kolegëve)".

Gjykata e Auditimit e Austrisë (GJAA) është një SAI që ka të gërshetuar në mënyrën më perfekte vlerat e traditës me qasjet moderne në auditim. Ajo zhvillon auditime cilësore si të përputhshmërisë, financiare, ashtu dhe të performancës dhe të teknologjisë së informacionit. GJAA mban selinë e "qeverisë" së organizatës së INTOSAI-t, Sekretariatit të saj të Përgjithshëm. Presidenti i Gjykatës Austriake të Auditimit është edhe Sekretari i Përgjithshëm i INTOSAI-t. Nga gjiri i ekspertëve dhe audituesve më me eksperiencë të SAI-t austriak kanë dalë shumë nisma dhe veprimtari me rëndësi parësore për komunitetin e INTOSAI-t. Gjykata e Auditimit ë Austrisë është e angazhuar në një bashkëpunim intensiv dypalësh me shumë SAI partnere në Evropë dhe në bote, si dhe kontribuon në grupet e punës më të rëndësishme të INTOSAI-t dhe EUROSAI-t.

KLSH dhe Institucioni Shtetëror i Auditimit i Malit të Zi nënshkruajnë Marrëveshje Bashkëpunimi

12 korrik 2013, Podgoricë, Mal i Zi

Z. Bujar Leskaj, Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit, nënshkroi një Marrëveshje Bashkëpunimi me homologun e tij malazez të Institucionit Shtetëror të Auditimit, z. Milan Dabović.

Marrëveshja e Bashkëpunimit u përgatit jo vetëm në respekt të parimeve të shkëmbimit të eksperiencave më të mira dhe njohurive ndërmjet palëve, nën moton e INTOSAI-t, "Eksperienca e përbashkët u shërben të gjithëve", por edhe në kuadrin e një bashkëpunimi më të ngushtë rajonal për dy vende fqinje.

Në këtë kuadër, u shkëmbyen informacione të vlefshme lidhur me aktivitetin audites institucional, duke pasqyruar llojet e ndryshme të auditimeve, fushat strategjike ku ato zhvillohen, rekomandimet e lëna, etj.

Një pikë e konsideruar me shumë rëndësi ishte rritja e cilësisë në kryerjen e auditimeve, ku veçanërisht në KLSH duke patur parasysh edhe rritjen domethënëse të numrit të trajnimeve të audituesve, kjo veçori është rritur ndjeshëm.

Impakti pozitiv i kësaj marrëveshje të përbashkët u materializohet shumë shpejt, nëpërmjet veprimeve të përbashkëta institucionale, shkëmbimit të vizitave të nivelit të lartë. Dr. Milan Dabovićit i është akorduar titulli "Qytetar Nderi" nga Qarku i Shkodrës dhe prej vitit 2013, nga nënshkrimi i marrëveshje së bashkëpunimit mes SAI-t të Malit të Zi dhe KLSH-së, z.Dabović, në nivel institucional, është treguar një partner me kontribute të vyera për Kontrollin e Lartë të Shtetit.

KLSH dhe Zyra e Auditimit të Institucioneve të Bosnjës dhe Hercegovinës nënshkruajnë Marrëveshje Bashkëpunimi

17 korrik 2013, Sarajevë, Bosnjë-Hercegovinë

Z. Bujar Leskaj, Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit, nënshkroi një Marrëveshje Bashkëpunimi me z. Milenko Sego, Audituesin e Përgjithshëm të Zyrës së Auditimit të Institucioneve të Bosnjës dhe Hercegovinës.

Nënshkrimi i kësaj marrëveshje i hap rrugën bashkëpunimit dhe ndërmarrjes së veprimeve të përbashkëta në nivel bilateral dhe ka rezultuar produktiv për të dy palët në shkëmbimin e eksperiencave në fushën e auditimit financiar apo të performancës, si dhe në fusha të tjera që paraqesin interes të dyanshëm. Në këtë kuadër, KLSH ftoi drejtuesit dhe audituesit e tjerë të këtij institucioni, për një bashkëpunim konkret në revistën shkencore "Auditimi Publik", që është e hapur edhe për shkrimet e tyre.

Shkëmbimi i ndërsjellët i eksperiencës dhe informacionit, që konkretizohet nëpërmjet këtyre Marrëveshjeve të Bashkëpunimit, reflekton ndryshimet në kuadrin ekonomik dhe ligjor të secilit vend, ndryshimet në strukturën dhe mënyrën sesi secili institucion funksionon, si dhe mundëson që të dyja palët të mund të bashkëpunojnë në çdo formë të përshtatshme për arritjen e objektivave të sipërpërmendura, duke organizuar takime me ekspertë, seminare mbi çështje kyçe në lidhje me kontrollin e financave publike, si dhe mund të kryejnë auditime paralele ose të përbashkëta, në fushat e përcaktuara me interes të përbashkët.

KLSH dhe Zyra Shtetërore e Auditimit të Republikës së Maqedonisë nënshkruajnë Marrëveshje Bashkëpunimi

27 nëntor 2013, Shkup, Maqedoni

Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Bujar Leskaj nënshkroi një Marrëveshje Bashkëpunimi me Audituesen e Përgjithshme të Zyrës Shtetërore të Auditimit të Republikës së Maqedonisë zj. Tanja Tanevska.

Marrëveshja e Bashkëpunimit është mjaft e rëndësishme jo vetëm në kuadrin e thellimit të bashkëpunimit të ndërsjellë në fushat përkatëse me interes të përbashkët, por edhe si vende fqinje që kanë aspirata të përbashkëta europiane.

Kjo Marrëveshje u përgatit dhe u nënshkrua jo vetëm në respekt të parimeve të shkëmbimit të eksperiencave dhe njohurive ndërmjet palëve nën moton e INTOSAI-t *"Experentia Mutua Omnibus Prodest"*, por edhe në frymën e një bashkëpunimi më të ngushtë për dy vende fqinjë, që mund të përfitojnë nga përvojat respektive, duke zhvilluar në të ardhmen, auditime apo projekte të përbashkëta, me qëllim arritjen e objektivave të vendosura në këtë marrëveshje.

Gjatë diskutimeve, u shkëmbyen informacione dhe u paraqit një ekspoze e përgjithshme historike dhe aktuale e KLSH-së dhe SAO-s maqedonase. Një rëndësi e veçantë iu kushtua marrëdhënieve ndër-institucionale që Institucionet supreme të auditimit krijojnë me institucionet e tjera kombëtare dhe në veçanti, me Parlamentet respektive dhe me organizata të shoqërisë civile apo mjediset akademike, me qëllim lehtësimin e punës dhe përftimin e sa më shumë njohurive. Gjithashtu, një vend me rëndësi zunë diskutimet lidhur me zhvillimet e bashkëpunimeve me SAI-t e tjerë homologë në rajon dhe më gjerë, ku arritjet e KLSH-së përgjatë këtyre dy viteve, në zhvillimin e trajnimeve dhe aktiviteteve audituese, u vlerësuan nga homologia maqedonase.

KLSH dhe Agjencia Turke për Zhvillim dhe Bashkëpunim nënshkruajnë Marrëveshje Bashkëpunimi

12 shkurt 2014, Ankara, Turqi



Z.Bujar Leskaj, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nënshkroi me Dr. Serdar Çam, President i TIKA-s, Agjencisë Turke për Zhvillim dhe Bashkëpunim një marrëveshje bashkëpunimi. Marrëveshja parashikon mbështetjen e TIKA-s për zhvillimin e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit në KLSH, nëpërmjet sigurimit të versionit të përditësuar të Programit kompjuterik të auditimit IDEA dhe trajnimit të audituesve të KLSH për përdorimin e këtij programi, sigurimit të pajisjeve të TI dhe zbatimit dixhital të sistemit të menaxhimit të auditimit. Për këtë komponent të fundit të marrëveshjes, është siguruar edhe ndihma e Gjykatës Turke të Llogarive, partner i KLSH.

MARRËVESHJET E BASHKËPUNIMIT ME SHOQËRINË CIVILE DHE SHOQATAT PROFESIONALE TË FUSHËS

KLSH dhe Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit nënshkruajnë Marrëveshje Bashkëpunimi

28 dhjetor 2012

Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z.Bujar Leskaj dhe Kryetari i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit (KKK), Prof. Dr. Jorgji Bollano nënshkruan një Marrëveshje Bashkëpunimi në prani edhe të përfaqësuesve të organeve mediatike. Në bazë të kësaj marrëveshje, palët marrin përsipër të bashkëpunojnë për organizimin e aktiviteteve të përbashkëta për t'i ofruar njeri-tjetrit shërbime të ekspertizës dhe trajnimit për fushat respektive të bashkëpunimit, në dobi të rritjes së cilësisë së auditimit financiar dhe të zgjerimit të ekspertizës së dhënë nga KKK. Marrëveshja ka rezultuar tepër produktive në funksion të rritjeve të kapaciteteve audituese në fushën e auditimit financiar.

KLSH dhe Instituti "G&G Group" nënshkruajnë Marrëveshje Bashkëpunimi

28 dhjetor 2012

Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z.Bujar Leskaj dhe Drejtori i Institutit "G&G Group", Prof. As. Sazan Guri nënshkruan një Marrëveshje Bashkëpunimi në prani edhe të përfaqësuesve të organeve mediatike. Instituti "G&G Group" merr përsipër të angazhojë ekspertë të tij, në aktivitete të përbashkëta me Kontrollin e Lartë të Shtetit, për konstatimin e rreziqeve mjedisore, parandalimin e tyre dhe lidhjen e çështjeve të mjedisit me ekonominë. KLSH, në rastin e konstatimit të shkeljeve gjatë auditimeve të kryera, propozon masat e nevojshme për përmirësimin e aktivitetit të subjekteve të ndryshme, në mënyrë që të minimizohet efekti

negativ që sjell aktiviteti i tyre në ndotjen e mjedisit. KLSH është pjesë e Grupit të Punës të EUROSAI-t mbi auditimin e mjedisit WGEA dhe marrëveshja me Institutin "G&G Group" është provuar dobiprurëse për auditimet mjedisore të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

KLSH dhe gjashtë OJF nënshkruajnë Marrëveshje Bashkëpunimi kundër korrupsionit

23 prill 2012

Më datën 23 Prill 2012, në ambientet e KLSH-së, u nënshkruan gjashtë marrëveshje bashkëpunimi mes KLSH-së dhe disa prej organizatave të pavarura (OJF) më të

spikatura të vendit në luftën kundër korrupsionit dhe rritjen e transparencës, përkatësisht me lëvizjen "Alternativa Civile", e drejtuar nga z. Mentor Kikia; me "Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë", e drejtuar nga z. Sami Neza; me "Institutin e Studimeve Bashkëkohore", i drejtuar nga z. Artan Hoxha, me "Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim", i drejtuar nga z. Sotiraq Hroni; me "Transparency Internacional në Shqipëri", drejtuar nga z. Lutfi Dervishi dhe me "Lëvizjen Evropiane Shqipëri", drejtuar nga z. Gledis Gjipali. Marrëveshjet lidhen nën moton e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve të Larta të Auditimit, INTOSAI, "Experentia mutual ominibus prodest" (Eksperienca e përbashkët u shërben të gjithëve). Marrëveshjet parashikojnë edhe mundësinë e shkrimit te projekteve të përbashkëta, apo aplikimit te tyre pranë donatoreve te interesuar, për forcimin real të luftës ndaj korrupsionit, luftë e cila mund të ketë sukses vetëm me punë të përbashkët në sistem.

KLSH dhe IEKA nënshkruajnë Marrëveshje Bashkëpunimi

28 dhjetor 2012

Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z.Bujar Leskaj dhe Presidenti i Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA), z. Hysen Çela nënshkruan një Marrëveshje Bashkëpunimi në prani dhe të përfaqësuesve të organeve mediatike. Në zbatim të kësaj marrëveshje, Kontrolli i Lartë i Shtetit merr përsipër të angazhojë staf dhe në bashkëpunim me Institutin e Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të realizojnë aktivitete të përbashkëta për të sjellë mendimin më të avancuar në fushën e auditimit financiar si edhe rritjen e cilësisë së punës së stafit të KLSH nëpërmjet ekspertizës së kualifikuar për auditimin e jashtëm në Republikën e Shqipërisë nga IEKA.

KLSH lidh Marrëveshje Bashkëpunimi me Fakultetin e Gjeologji-Minierave

17 qershor 2013

Prof. Dr. Përparim Hoxha, Dekan i Fakultetit të Gjeologji-Minierave të Universitetit Politeknik të Tiranës dhe Dr. Bujar Leskaj, Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet KLSH dhe Fakultetit. Prof. Hoxha theksoi rëndësinë që ka për profesoratin e Fakultetit bashkëpunimi me një institucion kushtetues si KLSH dhe u shpreh i gatshëm që i gjithë stafi shkencor të kontribuojë në përmirësimin e veprimtarisë audituese të KLSH në fusha specifike si dhe në trajnime të ndryshme për punonjësit e KLSH. Kryetari Leskaj falënderoi stafin akademik të Fakultetit për gatishmërinë e treguar, Dekanin Prof. Hoxha, si dhe Prof. Dr. Skënder Osmanin për nisjen e këtij bashkëpunimi konkret disa muaj më parë, përmes një cikli të plotë leksionesh mbi analizën e riskut. Për KLSH, kontributi i akademikëve dhe ekspertëve



universitarë është shumë i rëndësishëm, si në trajnimin dhe përgatitjen profesionale të audituesve, ashtu dhe në pjesëmarrjen e ekspertëve në analizën e riskut, përzgjedhjen e auditimeve apo edhe në auditim. Implementimi i marrëveshjes është reflektuar me trajnime, takime konsultative, pjesëmarrje të ekspertëve të Fakultetit në auditime, tryeza të rrumbullakta, workshope, seminare, etj., te cilat kanë rritur cilësinë e punës së KLSH dhe pjesëmarrjen e profesoratit të Fakultetit në kërkimin e aplikuar.

KLSH dhe SHKÇAK nënshkruajnë Marrëveshje Bashkëpunimi

13 shtator 2013

Në datën 13 shtator 2013, në ambientet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, u nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit mes KLSH-së dhe Shoqatës së Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (SHKÇAK). Në zbatim të kësaj Marrëveshjeje, KLSH është angazhuar në realizimin e aktiviteteve të ndryshme me SHKÇAK, të tilla si trajnime, takime konsultative, tryeza të rrumbullakëta, workshop-e, seminare etj, aktivitete këto që synojnë rritjen e kapaciteteve audituese të KLSH dhe pjesëmarrjen e SHKÇAK nëpërmjet ekspertizës së kualifikuar në trajnimet e ndryshme për auditimin e jashtëm në Republikën e Shqipërisë. Drejtorja Ekzekutive e SHKÇAK, zj. Ardiana Bunjaku vlerësoi këtë bashkëpunim, i cili do të luajë një rol të rëndësishëm jo vetëm për certifikim e Audituesve të KLSH në kuadër të programit për çertifikimin në Sektorin Publik, por edhe për vet zhvillimet cilësore e profesionale në SHKÇAK. Kjo marrëveshje është dëshmi konkrete e përvijimit të bashkëpunimit të KLSH me institucionet e Kosovës, ku vlen të përmendet bashkëpunimi shumë pozitiv me Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës.

KLSH dhe Instituti për Studime Publike dhe Ligjore nënshkruajnë Marrëveshje Bashkëpunimi

16 tetor 2013

Në datën 16 tetor 2013, në mjediset e Kontrollit të Lartë të Shtetit, u nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit mes KLSH dhe Institutit për Studime Publike dhe Ligjore (ISP&L).

Në zbatim të kësaj Marrëveshje, KLSH është angazhuar në realizimin e aktiviteteve të përbashkëta për të sjellë mendimin më të avancuar në fushën e njohjes së legjislacionit, mbi bazën dhe të eksperiencave konkrete duke promovuar specialistët e tij më të mirë, si dhe eksperiencat dhe ekspertizën cilësore të Institutit për Studime Publike dhe Ligjore në dhënie këshillimesh dhe koordinimin për vlerësimet e përputhshmërisë ligjore gjatë auditimeve të përputhshmërisë realizuar nga KLSH. Me lidhjen e kësaj marrëveshjeje, KLSH është në përmbushje të detyrave për ngritjen e kapaciteteve dhe rritjen e standardeve profesionale në auditim, nëpërmjet trajnimeve, workshopeve dhe aktiviteteve të tjera të përbashkëta. Zoti Gent Ibrahimi, Drejtori Ekzekutiv i ISP&L, nga ana e tij, vlerësoi bashkëpunimin dhe qasjen e re që ka KLSH ndaj Shoqërisë Civile, duke theksuar se ky bashkëpunim do të gjenerojë ide të reja dhe do të realizojë projekte të përbashkëta me qasje sistemike dhe shkencore.

KLSH nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me gazetën "Ekonomia"

27 nëntor 2013

Kontrolli i Lartë i Shtetit lidhi një marrëveshje bashkëpunimi me gazetën "Ekonomia". Gazeta ka më shumë se një dekadë kontribut e prani të përditshme në shtypin shqiptar dhe shquhet për pavarësi e cilësi të mendimit ekonomik. Me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes në ambientet e KLSH, Kryetari Bujar Leskaj u shpreh se kjo marrëveshje është e veçantë, për natyrën tërësisht profesionale të gazetës "Ekonomia", të orientuar në dhënien e informacionit dhe të përqasjeve për përmirësimin e menaxhimit të ekonomisë publike Gjatë 2013, 33 auditues të lartë dhe drejtues të institucionit kanë botuar mbi 100 shkrime në shtypin e përditshëm shqiptar dhe më shumë se gjysma e këtyre shkrimeve dhe analizave janë botuar nga gazeta "Ekonomia". Z. Kola theksoi angazhimin e KLSH me përgatitjen e artikujve profesionalë dhe adresimin e tyre tek gazeta, si ndër më të

rëndësishmit dhe voluminozët, ndër bashkëpunimet e deritanishëm të gazetës me institucionet kushtetuese. Marrëveshja ka rritur praninë së KLSH me artikuj dhe analiza pranë gazetës "Ekonomia".

KLSH dhe Shoqata e Bashkive të Shqipërisë nënshkruajnë Marrëveshje Bashkëpunimi

23 dhjetor 2013

Në datën 23 Dhjetor 2013 u nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit mes KLSH dhe Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë. Për Kontrollin e Lartë të Shtetit marrëveshja u

nënshkrua nga Sekretari i Përgjithshëm, znj. Luljeta Nano dhe për Shoqatën e Bashkive të Shqipërisë kjo marrëveshje u nënshkrua nga Drejtori Ekzekutiv, z. Fatos Hodaj. Në zbatim të kësaj Marrëveshje, KLSH do të angazhohet për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta që synojnë sjelljen e mendimit më të avancuar në fushën e standardeve ndërkombëtare të auditimit, rritjen e performancës së njësive të qeverisjes vendore dhe rritjen e cilësisë së punës së stafeve të këtyre njësive. Nëpërmjet realizimit të kësaj marrëveshje, KLSH është në përmbushje të detyrave për ngritjen e kapaciteteve dhe rritjen e standardeve profesionale, nëpërmjet trajnimeve, workshop-eve dhe aktiviteteve të tjera të përbashkëta. Drejtori Ekzekutiv i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë, z. Fatos Hodaj, nga ana e tij, vlerësoi bashkëpunimin me KLSH, duke theksuar se ky bashkëpunim do t'i shërbejë qëllimit të përbashkët, atij të përdorimit efektiv dhe të dobishëm të fondeve, mirë-administrimit financiar dhe zbatimit të ligjshmërisë në fushën ekonomike e financiare. Të dyja palët shprehën së fundmi vendosmërinë për zbatimin e kësaj marrëveshjeje si dhe besimin se një bashkëpunim i sinqertë të dy institucioneve do të japë rezultate konkrete në parandalimin e korrupsionit dhe në përmirësimin e qeverisjes.

KLSH dhe ISHSH nënshkruajnë Marrëveshje Bashkëpunimi

19 maj 2014

Në datën 19 maj 2014 u nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit mes KLSH dhe Institutit Shqiptar të Shkencave (ISHSH), i cili realizon në Shqipëri projektin Open Data Albania. Në zbatim të kësaj Marrëveshje, KLSH është angazhuar në shkëmbimin e të dhënave me interes reciprok, duke hapur edhe një dritare tjetër komunikimi me publikun me qëllim rritjen e transparencës dhe modernizimin e institucionit. Nëpërmjet këtij bashkëpunimi është krijuar mundësia e shfrytëzimit të të dhënave të ndryshme të publikuara nga Open Data Albania që është një projekt serioz dhe i vlerësuar si brenda ashtu edhe jashtë vendit për cilësinë e të dhënave dhe analizave që publikon e përgatit. Marrëveshja u nënshkrua nga Kryetari i KLSH-së, z.Bujar Leskaj dhe nga zj.Aranita Brahaj, Kryetare e Institutit Shqiptar të Shkencave.

KLSH dhe SHKFSH nënshkruajnë Marrëveshje Bashkëpunimi

24 nëntor 2014

Në datën 24 nëntor 2014 u nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit mes KLSH-së dhe Shoqatës së Kontabilistëve dhe Financierëve të Shqipërisë (SHKFSH). Në zbatim të kësaj Marrëveshje, KLSH është angazhuar në realizimin e aktiviteteve të ndryshme me SHKFSH të cilat kanë pasur në fokus rritjen e standardeve të auditimit financiar. Kryetari i SHKFSH, Prof.Dr. Sherif Bundo vlerësoi shumë bashkëpunimin me KLSH-në, në të cilin shikon shumë pika të përbashkëta me interes të dyanshëm dhe që përputhen me misionin dhe vizionin e KLSH-së. KLSH, theksoi z.Bundo, nuk është më një Bunker, por një institucion i hapur dhe transparent që bashkëpunon me shume OJF dhe organizata të profesionistëve të fushës me qëllim përmirësimin e qeverisjes. Në këtë takim morën pjesë edhe drejtues të KLSH-së dhe Prof.Dr. Agim Binaj i Shoqatës së Kontabilistëve dhe Financierëve të Shqipërisë.

KLSH dhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit nënshkruajnë Marrëveshje Bashkëpunimi

19 shkurt 2015

Në datën 19 shkurt 2015**,** në mjediset e Kontrollit të Lartë të Shtetit, u nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit mes KLSH-së dhe Komitetit Shqiptar të Helsinkit, përfaqësuar nga zj.Vjollca Meçaj, Drejtore Ekzekutive dhe z.Bujar Leskaj, Kryetar i KLSH-së. Në zbatim të kësaj Marrëveshje, KLSH shpreh vullnetin institucional për bashkëpunim me Komitetin Shqiptar të Helsinkit, si një prej OJF-ve më me eksperiencë, veçanërisht në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe më gjerë. Kryetari i KLSH-së theksoi faktin që bashkëpunimi do të jetë me veprimtari dhe projekte konkrete. KLSH ka qenë në vazhdimësi i hapur për bashkëpunime të tilla dhe ka eksperienca të mira në këtë drejtim dhe me OJF të tjera, kryesisht në tre vitet e fundit. Nënshkrimi i marrëveshjes me Komitetin Shqiptar të Helsinkit e plotëson këtë kuadër dhe është një vlerë më tepër në këtë drejtim sepse fusha e aktivitetit te këtyre organizatave është e ndryshme dhe plotësojnë në mënyrë të natyrshme njëra tjetrën. Nëpërmjet realizimit të kësaj marrëveshje, KLSH është në përmbushje të detyrave për ngritjen e kapaciteteve dhe rritjen e standardeve profesionale në auditim, nëpërmjet trajnimeve, workshop-eve dhe aktiviteteve të tjera të përbashkëta.

KLSH dhe QSHRT nënshkruajnë Marrëveshje Bashkëpunimi

20 prill 2015

Më datë 20 prill 2015, KLSH në bashkëpunim me Universitetin "Aleksandër Xhuvani" Elbasan zhvilloi në mjediset e bibliotekës së këtij Universiteti workshop-in me temë "Performanca e Auditimeve të Performancës". Gjatë punimeve të këtij workshop-i, në kuadër të partneritetit me shoqërinë civile, Kryetari i KLSH z. Bujar Leskaj ka nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit me OJF "Qendra Shqiptare e Rehabilitimit të Traumës dhe Torturës" të përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv z. Ardian Kati, duke theksuar se sfidat audituese të KLSH-së, mund të përmbushen në bashkëpunim me shoqërinë civile dhe organizata e specialistë të fushës. Në fjalën e tij përmbyllëse,

Kryetari i KLSH zoti Bujar Leskaj, pasi përcolli falënderimet për referuesit, rektoratin dhe pedagogët e Universitetit të Elbasanit, vuri theksin në nevojën dhe domosdoshmërinë e thellimit të bashkëpunimit me ekspertë të jashtëm në fushat e auditimit të performancës, në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së auditimeve për të përcjell tek publiku një mesazh të qartë dhe me gjuhen e duhur, duke ndikuar në këtë mënyrë në transparencën dhe llogaridhënien e administratës publike.

KLSH dhe OJQ-ja "Integrimi Urban" nënshkruajnë Marrëveshje Bashkëpunimi

1 tetor 2015

Në datën 1 tetor 2015, në mjediset e Kontrollit të Lartë të Shtetit, u nënshkrua

Marrëveshja e Bashkëpunimit mes KLSH-së dhe organizatës jo-fitim prurëse "Integrimit Urban", përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv i saj, z.Artur Çani. Nëpërmjet këtij bashkëpunimi është krijuar mundësia e shfrytëzimit të të dhënave të ndryshme të publikuara nga "Integrimi Urban", të cilat mund të shërbejnë si indicie për fillimin e auditimeve nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Kryetari i KLSH-së nënvizoi faktin që kjo marrëveshje kontribuon në forcimin e institucionit, në rritjen e transparencës së veprimtarisë së tij audituese me qëllim përmirësimin e qeverisjes, duke luftuar korrupsionin. Marrëveshja u nënshkrua nga Kryetari i KLSH-së, z.Bujar Leskaj dhe nga z. Artur Çani, Drejtor Ekzekutiv i organizatës "Integrimit Urban". Zoti Çani vlerësoi bashkëpunimin me KLSH, qasjen e re që ka KLSH ndaj Shoqërisë Civile dhe veçanërisht transparencën e këtij institucioni, i cili i ka dyert e hapura për gazetarët dhe për qytetarët, duke vënë në dispozicion të tyre informacionin e kërkuar. Zoti Çani, theksoi faktin që KLSH është një nga institucionet e pakta që ka besueshmëri dhe impakt pozitiv tek qytetarët, duke sensibilizuar opinionin publik për gjetjet e auditimeve të realizuara. Në ceremoninë e nënshkrimit të kësaj marrëveshje morën pjesë Drejtues dhe auditues të KLSH-së.

PJESËMARRJA E SAI-ve NË AKTIVITETET E ZHVILLUARA NGA KLSH

Vizitë zyrtare e Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës

15-16 shkurt 2012

Në datat 15-16 shkurt 2012, zhvilloi një vizitë zyrtare në Tiranë një delegacion i nivelit të lartë i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës, i kryesuar nga z. Lars Lage Olofsson, Auditor i Përgjithshëm i Kosovës dhe personalitet i auditimit ndërkombëtar.

Kjo vizitë u zhvillua në kuadër të bashkëpunimit dhe intensifikimit të marrëdhënieve bilaterale ndërmjet Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës. Gjatë takimit me homologun kosovar, Kryetari i KLSH-së, z.Leskaj e njohu z.Olofsson me një ekspoze të detajuar të hapave historike të zhvillimeve institucionale, ku një vend të veçantë zë dhe strategjia e mbështetur në projekt-idenë, në të cilën përfshihet vizioni koherent mbi modernizimin e institucionit të KLSH-së.

Z.Olofsson shprehu kënaqësinë që ndodhej në Tiranë dhe prezantoi etapat kryesore të veprimtarisë së Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës, e cila është në hapat e saj të parë dhe përpjekjet që po ndërmerren, si në rekrutimin e personelit auditues ashtu dhe në zbatimin e standardeve ndërkombëtare të auditimit. Z. Olofsson vlerësoi vizionin e ri të KLSH dhe punën që po zhvillohet në këtë institucion për përmirësimin e cilësisë së auditimeve financiare dhe për thellimin e vëmendjes ndaj auditimit të performancës, duke kërkuar një bashkëpunim të gjerë me institucionet e tjera të shtetit që luftojnë korrupsionin.

Kryetari i KLSH-së zhvilloi një takim me z.Michael Vaccaro, Këshilltar Kundër Korrupsionit në zyrën e OPDAT-it Tiranë

11 qershor 2012

Më datën 11.06.2012 Kryetari i Kontrollit të Shtetit z. Bujar Leskaj zhvilloi një takim pune me z. Michael Vaccaro, Këshilltar Ligjor Kundër Korrupsionit në zyrën e

OPDAT-it Tiranë. Takimi u bë me kërkesën e z. Bujar Leskaj dhe kishte për qëllim shkëmbimin e mendimeve për rritjen e luftës kundër korrupsionit. Në takim morën pjesë Kryetari i KLSH z Bujar Leskaj, Drejtori i Departamentit të Kërkimit Shkencor, Zhvillimit dhe Teknologjisë së Informacionit z. Fatos Çoçoli dhe ndërlidhësi i posaçëm i KLSH për NJPH z. Pjetër Beleshi.

Z.Leskaj çmoi shumë takimin me z.Michel Vaccaro në kuadër të detyrimeve për zbatimin e Memorandumit të Mirëkuptimit të vitit 2009 dhe mirëpret çdo vërejtje apo sugjerim për këto çështje duke shpresuar që OPDAT ta thellojë vëzhgimin dhe ndihmën ndaj institucionit. Z. Michael Vaccaro falënderoi z. Leskaj që i dha mundësinë ta njohë më nga afër këtë institucion shumë të rëndësishëm të auditimit të jashtëm. "Detyra ime si këshilltar ligjor pranë OPDAT-it është të ndihmoi Institucionet që janë të angazhuara në luftën kundër korrupsionit me qëllim që ky fenomen të dënohet sipas ligjeve në fuqi"- nënvizoi z.Vaccaro.

100 Vjetori i Pavarësisë së Shqipërisë

27-29 nëntor 2012

Me ftesë të Kryetarit të KLSH, morën pjesë në festimet e 100 Vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë delegacionet e institucioneve më të larta të auditimit të Sllovenisë, Kroacisë, Kosovës dhe Turqisë, të kryesuara përkatësisht nga: Dr. Igor Šoltes, President i Gjykatës së Llogarive të Sllovenisë; z. Ivan Klešić, Auditues i Përgjithshëm i Zyrës Shtetërore të Auditimit të Kroacisë; z. Lars Lage Olofsson,

Auditues i Përgjithshëm i Zyrës së Audituesit të Përgjithshëm të Kosovës; dhe z. Hiqmet Cavit Erdogan, Anëtar i Lartë i Dhomës së Gjykatës së Llogarive të Turqisë. Ndër aktivitetet më të rëndësishme dhe mbresëlënëse për të ftuarit e KLSH në qytetin e Vlorës ishte përurimi i Shtatores së Ismail Qemalit në prani të autoriteteve lokale dhe kombëtare të pranishëm aty për të nderuar kujtimin e patriotit të shquar shqiptar.

Në ditën e Pavarësisë, 28 Nëntor, homologët e KLSH ishin të ftuar nga Presidenti i Republikës SH.T.Z. Bujar Nishani, në Ceremoninë e Ngritjes së Flamurit në Sheshin e Flamurit në Vlorë.

Kryetari i KLSH-së zhvilloi një takim me përfaqësues të DG Budget

4 tetor 2012

Kryetari i KLSH, z. Bujar Leskaj zhvilloi një takim me Misionin Vlerësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit të Komisionit Evropian për mbarëvajtjen e financave publike të Shqipërisë, të kryesuar nga z. Robert Gielisse, Drejtor Njësie në DG-Budget.

Z. Leskaj e informoi misionin për hapat reformues të ndërmarra nga KLSH gjatë periudhës janar-shtator 2012, të përqendruar në rritjen e kapaciteteve audituese të institucionit, nëpërmjet trajnimeve intensive brenda dhe jashtë vendit, në thellimin e luftës kundër korrupsionit, nëpërmjet bashkëpunimit me institucionet publike si dhe me organizatat e shoqërisë civile, po ashtu dhe nëpërmjet shtimit të ndjeshëm të kallëzimeve penale për punonjësit e kapur në abuzim flagrant me fondet buxhetore. Ai e njohu Misionit e KE-së me përmbajtjen dhe risitë e Raportit për Zbatimin e Buxhetit të Konsoliduar të Shtetit për vitin 2011, që KLSH sapo kishte dorëzuar në Kuvendin e Shqipërisë.

Z. Gielisse falënderoi për ekspozenë dhe u tregua veçanërisht i interesuar për gjetjet dhe rekomandimet e KLSH ndaj strukturave të auditimit të brendshëm. Z. Gielisse sqaroi se progresi në menaxhimin e financave publike është në fokus të BE-së dhe përshëndeti Marrëveshjen e 8 majit 2012, të arritur mes KLSH dhe Ministrisë së Financave për bashkëpunimin mes dy strukturave të auditimit, atij suprem të jashtëm dhe auditimit të brendshëm.

Ai siguroi për mbështetjen në vijimësi të reformave të KLSH-së, nga ana e DG-Budget dhe u tregua i gatshëm që, kundrejt kërkesës nga KLSH, DG-Budget të këshillojë për hapat e mëtejshëm në drejtim të miratimit të një ligji të ri modern për KLSH.

Nënshkruhet Marrëveshja e Bashkëpunimit mes KLSH-së dhe Zyrës Shtetërore të Auditimit të Kroacisë

27 nëntor 2012

Më datë 27 nëntor 2012, duke zgjedhur qytetin e Vlorës në respekt të 100 vjetorit të pavarësisë, z. Bujar Leskaj, Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe z. Ivan Klešić, Auditues i Përgjithshëm i Zyrës Shtetërore të Auditimit të Kroacisë nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi.

Marrëveshja u përgatit në bazë të parimeve të respektit, besimit dhe bashkëpunimit

dypalësh të organizatës ndërkombëtare të institucioneve supreme të auditimit (INTOSAI) si edhe të organizatës europiane të institucioneve supreme të auditimit (EUROSAI), nën moton e INTOSAI-t "Eksperienca e përbashkët iu shërben të gjithëve". Ajo parashikon shkëmbimin e mësimeve të nxjerra nga aktiviteti auditues, trajnimin e audituesve dhe këshillimin mbi metodat e auditimit, duke përdorur eksperiencën e fituar nga të tjerët si bazë për rritjen e efektivitetit dhe efiçiences së auditimit. Dokumenti i nënshkruar është i rëndësishëm për KLSH-në, pasi Zyra Shtetërore e Auditimit e Kroacisë është një institucion i zhvilluar i auditimit suprem në rajon dhe më gjerë në Europë. Nëpërmjet mbështetjes së parashikuar në marrëveshje, KLSH dhe Zyra Shtetërore e Auditimit e Kroacisë do të shkëmbejnë eksperiencë në auditimin e performancës, në atë financiar, të përputhshmërisë dhe të teknologjisë së informacionit, si dhe në certifikimin e deklaratave financiare. Të pranishëm në nënshkrim ishin edhe delegacionet e institucioneve më të larta të auditimit të Sllovenisë, Kosovës dhe Turqisë, të cilat kishin ardhur me rastin e festimeve të 100 vjetorit të pavarësisë.

Takim i Kryetarit të KLSH-së me përfaqësues të DG-Enlargement dhe TAIEX

4 shtator 2013

Më datë 4 shtator 2013, Kryetari i KLSH-së, z. Bujar Leskaj priti në një takim drejtuesit dhe organizatorët e workshopit "Vijimësia e Bashkëpunimit Rajonal për Auditimin e Performancës", zotërinjtë Mose Apelblat, përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme të Zgjerimit pranë Komisionit Europian dhe Dragos Budulac, bashkëdrejtues i Grupit të Përbashkët të Punës për Aktivitetet e Auditimit. Ky takim, u mbajt në përfundim të punimeve të workshopit të organizuar nga TAIEX në Tiranë, më datë 3 shtator 2013, i cili u zhvillua me mbështetjen e plotë të z. Bujar Leskaj, Kryetar i KLSH-së.

Gjatë bisedës me bashkëdrejtuesit e këtij eventi, z. Leskaj shprehu kënaqësinë e mbarëvajtjes së workshop-it dhe gatishmërinë e tij për të kontribuar edhe në të ardhmen si Kryetar i KLSH-së në aktivitete të tilla që u shërbejnë të gjitha SAI-ve pjesëmarrëse në rritjen e cilësisë së punës së tyre audituese. Të gjitha materialet e këtij workshopi, do të botohen nga KLSH në serinë e botimeve KLSH 2013, për të bërë të mundur që të përdoren nga të gjithë audituesit. Zoti Leskaj paraqiti një kuadër të përgjithshëm të arritjeve të institucionit përgjatë kësaj periudhe 2-vjeçare, si edhe e vuri theksin tek vëmendja që po iu kushtohet tashmë edhe në KLSH, auditimeve të performancës, krahas llojeve të tjera të tyre.

Takimi i Kryetarit të KLSH-së, me Drejtues të Sektorit të Mbështetjes Makroekonomike në Ministrinë Zvicerane për Çështjet Ekonomike.

21 shkurt 2014

Më datë 21 shkurt 2014, Kryetari i KLSH-së, z.Bujar Leskaj priti në një takim pune zj. Rosmarie Schlup, Zv.Drejtuese e Sektorit të Mbështetjes Makroekonomike në Ministrinë Zvicerane për Çështjet Ekonomike (SECO) si dhe zj.Irene Frei, menaxhere për Shqipërinë, shoqëruar nga z.Eduart Rumani, Zyrtar për Programin Kombëtar pranë Kooperacionit Zviceran.

Gjatë bisedës, z.Leskaj i njohu përfaqësueset zvicerane me një ekspoze të përgjithshme të funksionimit dhe arritjeve, përgjatë 2 viteve të fundit në institucion. Në shkëmbimin e ideve dhe opinioneve, një diskutim i veçantë u zhvillua edhe lidhur me problematikën e Auditimit të Brendshëm në vend. Megjithë përmirësimet në kuadrin ligjor dhe në çertifikimin e audituesve, u theksua fakti i përpjekjeve që bëhen për të mos pasur mbivendosje gjatë punës audituese të KLSH-së me këtë sistem, si dhe lidhur me përmirësimet e domosdoshme për të cilat sistemi ka nevojë, problematikë kjo që theksohet në çdo auditim që KLSH kryen në subjekte të ndryshme. Z.Leskaj, u ofroi mundësinë për të patur një material të plotë, të nxjerrë nga auditimet e kryera nga KLSH, në mënyrë që të mund të krijohej një pasqyrë e qartë, lidhur me dobësitë e këtij sistemi. Ky kontribut i KLSH-së u prit me shumë interes nga përfaqësueset zvicerane si dhe u konsiderua si mjaft i vlefshëm.

90 vjetori i Kontrollit të Lartë të Shtetit

26 maj 2015

Në datën 26 maj 2015, në sallën e Seancave Plenare të Kuvendit të Shqipërisë, u zhvillua ceremonia e 90 vjetorit të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Ceremoninë e nderuan me pjesëmarrjen e tyre: z. Josef Moser, President i Gjykatë Austriake të Auditimit dhe njëkohësisht Sekretar i Përgjithshëm i INTOSAI-t; z.Vitor Caldeira, President i Gjykatës Evropiane të Audituesve; z. Recai Akyel, Zv/President i EUROSAI-t dhe President i Gjykatës Turke të Llogarive; z.Ivan Klesic, Auditues i Përgjithshëm i SAI-t Kroat; z.Milan Dabovic, President i SAI-t të Malit të Zi; z.Milenko Sego, Auditues i Përgjithshëm i SAI-t të Bosnjë dhe Hercegovinës; z.Radoslav Sretenovic, President i SAI-t të Serbisë; z. Wojciech Kutyła, Zv.President i NIK-ut Polak; z.Naser Ademi, zv.Auditues i Përgjithshëm i SAI-t të Maqedonisë; z. Cosmin Nicula, zv.President i SAI-t të Rumanisë; z.Artan Venhari, zv.Auditues i Përgjithshëm i ZAP-it të Kosovës; si dhe përfaqësues të institucioneve të rëndësishme të BE-së si z. Robert Gielisse, nga DG Budget dhe z. Joop Vrolijk, SIGMA.

Gjatë ceremonisë përshëndetën: Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, z.Ilir Metal Sekretar i Përgjithshëm i Presidencës në emër të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, z. Florjan Nuri; Presidenti i Gjykatës Europiane të Auditimit, Z. Vitor Manuel da Silva Caldeira; Presidenti i Gjykatës Austriake të Auditimit dhe njëkohësisht Sekretar i Përgjithshëm i INTOSAIT, Dr. Josef MOSER; zv/Presidenti i EUROSAI-t dhe Presidenti i Gjykatës së Llogarive të Turqisë, z.Recai Akyel; në emër të Kryetarit të Akademisë së Shkencave, z. Anastas Angjeli; në emër të Shoqata të Profesionistëve të fushës, z.Jorgji Bollano dhe në emër të ish-audituesve, z.Bashkim Spahija, me një përvojë 31 vjeçare në KLSH. Në emër të të gjithë brezave të drejtuesve dhe audituesve të KLSH-së, ceremoninë e mbylli Kryetari i KLSH-së, z. Bujar Leskaj.

Një përshëndetje krejt e veçantë për 90 Vjetorin e KLSH-së ishte ajo e z. Gene Dodaro, Kontrollorit të Përgjithshëm të Zyrës së Auditimit të Qeverisë së SHBA, i cili nëpërmjet një video mesazhi i përcolli stafit të KLSH-së urimet për 90 Vjetorin e institucionit.

Me rastin e këtij përvjetori të rëndësishëm për KLSH-në, Presidenti i Republikës, z. Bujar Nishani i akordoi, në një ceremoni të zhvilluar në mjediset e Presidencës, z. Vitor Manuel da Silva Caldeira, Presidentit të Gjykatës Evropiane të Audituesve, Titullin "Për Merita të Veçanta Civile" për ndihmën dhe kontributin e qenësishëm që ai ka dhënë për përparimin dhe modernizimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Presidenti i Republikës i akordoi gjithashtu Kryetarit të KLSH-së, z.Bujar Leskaj Titullin "Për Merita të Veçanta Civile" në vlerësim të vizionit të qartë e kontributit të çmuar në ndërmarrjen dhe administrimin e reformave institucionale drejt integrimit europian, të cilat synojnë shndërrimin dhe konsolidimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit në një institucion modern të auditimit të jashtëm publik në të njëjtën linjë me standardet ndërkombëtare të auditimit të INTOSAI-t si dhe në përputhje me praktikat më të mira të Bashkimit Evropian.

Gjatë zhvillimit të ceremonisë se 90 Vjetorit, ju akordua titulli "Për merita të veçanta Civile", z. Josef Moser Sekretar i Përgjithshëm i INTOSAI-t dhe President i Gjykatë Austriake të Auditimit me motivacionin "Për ndihmesë të qenësishme në përparimin e Institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit".

Në datën 26 maj, z.Vitor

Manuel da Silva Caldeira, President i Gjykatës Evropiane të Audituesve, iu dorëzua gjithashtu titulli "Honoris Causa", nga Rektori i Universitetit të Tiranës, Prof. Dr. Dhori Kule. Në ceremoninë e zhvilluar morën pjesë drejtues, pedagogë, studentë të këtij Universiteti, përfaqësuesit e SAI-ve homologe dhe audituesë të KLSH-së.

Takimi i Kryetarit të KLSH-së, z.Bujar Leskaj me përfaqësues të Gjykatës Evropiane të Audituesve, ECA dhe Delegacionit të BE-së në Tiranë

11 qershor 2015

Në datën 11 qershor 2015, z. Bujar Leskaj zhvilloi në Tiranë një takim me përfaqësues të Gjykatës Europiane të Audituesve ECA, përfaqësuar nga Dr.Szabolcs Fazakas, Drejtues i Drejtorisë për Dhomën 3 të kësaj Gjykate, z. Dennis Wernerus, asistent i drejtorit dhe audituesë në Dhomën 3, si dhe përfaqësuesi i Delegacionit të BE-së në Tiranë, z. Claus Lech. Takimi u zhvillua në kuadrin e misionit të ECA-s në Tiranë mbi Meta-Audit (auditim që bazohet në rezultatet e auditimeve të mëparshme), lidhur me Asistencën e para-zgjerimit në Ballkanin Perëndimor (IPA I dhe IPA II) dhe kishte për qëllim informimin mbi kuadrin e përgjithshëm organizativ dhe të funksionimit të KLSH-së, pas miratimit edhe të Ligjit të ri të institucionit, mandatin e KLSH-së, pavarësinë, burimet financiare dhe njerëzore, transparencën me publikun dhe grupet e interesit në lidhje me publikimin dhe shpërndarjen e raporteve të auditimit të KLSH-së, zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, rastet e zbuluara dhe të denoncuara në kuadrin e luftës ndaj korrupsionit dhe mashtrimit, etj.

Kryetari i KLSH Bujar Leskaj takohet me përfaqësues të Bankës Botërore për Prokurimet Publike

5 nëntor 2015

Më datë 05.11.2015, Kryetari i KLSH Z. Bujar Leskaj, zhvilloi një takim me delegacionin e Bankës Botërore në Shqipëri, kryesuar nga z. Majed M. El-Bayya, specialist i prokurimeve në Shërbimet Operacionale dhe Cilësinë e Prokurimeve. Z. El-Bayya paraqiti projektin më të fundit të Bankës Botërore në fushën e prokurimeve, qëllimi i të cilit është rishikimi i të gjithë sistemit të prokurimeve në Shqipëri, përfshirë edhe zbatimin e projekteve me asistencë e huaj. Ai theksoi rolin e rëndësishëm dhe të pazëvendësueshëm që KLSH ka në mbrojtjen e interesave të Shtetit në fushën e prokurimeve. Kryetari i KLSH-së theksoi se vlerëson kërkesën e Bankës Botërore që KLSH të kontribuojë, si institucioni më i lartë i auditimit të jashtëm publik në Republikën e Shqipërisë, në projektin e Bankës Botërore në fushën e prokurimeve, fushë e cila pavarësisht përpjekjeve pozitive të institucioneve shtetërore, mbetet ende një fushë me shumë risk dhe problematike për financat publike të Shtetit.

Banka Botërore sugjeroi që auditimet e KLSH në të ardhmen e afërt të përqendroheshin edhe më shumë në fushën e prokurimeve, për aspekte të veçanta të tyre, duke përdorur edhe qasjet dhe teknikat e auditimeve të performancës dhe të teknologjisë së informacionit në këtë fushë, por edhe në fusha të caktuara, si infrastruktura rrugore dhe investimet në ujësjellësa.
Në përfundim të këtij takimi, të dy palët shprehën gatishmërinë për të fuqizuar bashkëpunimin për realizimin me sukses të kësaj nisme tepër të rëndësishme të Bankës Botërore për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik në Shqipëri, gjë që ndikon ndjeshëm në përmirësimin e qeverisjes publike tek ne.

PJESËMARRJA E KRYETARIT TË KLSH NË AKTIVITETET NDËRKOMBËTARE

Kryetari i KLSH-së, z.Bujar Leskaj zhvilloi një takim me personalitetin e shquar të botës akademike gjermane Prof.Dr. Heinz-Dieter Wenzel

20 janar 2012, Gjermani

Kryetari i Institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, zoti Bujar Leskaj, në datën 20 janar 2012, zhvilloi një takim miqësor me Profesorin e shquar të Financave Publike pranë Universitetit të Bambergut në Gjermani dhe një sërë Universitetesh të tjera Europiane, Prof.Dr Heinz-Dieter Wenzel, i cili mban dhe titullin Doctor Honoris Causa nga Universiteti Publik i Tiranës dhe nga shumë universitete të tjera prestigjioze.

Kontributi i Profesor Wenzel do të jetë mjaft i vlefshëm për institucionin e KLSH, në rritjen e forcimin e marrëdhënieve në fushën e trajnimeve dhe specializimeve, ku në fokus të tyre do të jetë zgjerimi i bashkëpunimit me institucionin homolog të Landit të Bavarisë.

150 vjetori i Gjykatës Turke të Llogarive

29-30 maj 2012, Ankara

Me ftesë të Presidentit të Gjykatës së Llogarive të Turqisë, Prof. As. Dr. Recai Akyel, në datat 29-30 maj 2012 një delegacion i KLSH, i kryesuar nga Kryetari Bujar Leskaj mori pjesë në festimet e 150 vjetorit të kësaj Gjykate në Ankara. Pala turke shprehu interes të mbështesë KLSH-në dhe më tej, me nënshkrimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis dy institucioneve, më 16 nëntor 2012, auditues nga KLSH nisën të trajnohen në Qendrën e Trajnimeve të Gjykatës në Ankara për certifikimin e deklaratave financiare, për thellimin e auditimit financiar dhe për auditimin e IT.

Konferenca e VII-të e organizatave EUROSAI dhe OLACEFS

17-18 shtator 2012, Gjeorgji

Në datat 17-18 Shtator 2012 në Tbilisi, z. Bujar Leskaj mori pjesë në Konferencën e VII-të e organizatave EUROSAI dhe OLACEFS, e cila u zhvillua Gjeorgji, me temë "Roli i institucioneve supreme të auditimit në mirëqeverisjen e sektorit publik". Pjesëmarrës të kësaj konference ishin përfaqësues të 38 vendeve (delegacione të kryesuara nga Presidentët e organizatave supreme të auditimit) anëtarë të EUROSAI (organizata e Institucioneve Supreme të Auditimit të Europës) dhe OLACEFS (Organizata e Institucioneve Supreme të Auditimit të Amerikës Latine dhe Karaibeve).

Konferenca u fokusua në dy drejtime kryesore, në rritjen e besueshmërisë së palëve të interesuara, nëpërmjet auditimt të integritetit dhe përgjegjshmërisë menaxheriale e filozofisë dhe sjelljes së titullarit, si dhe në reformën e menaxhimit financiar publik, me tendencat dhe mësimet e nxjerra. Në përfundim të punimeve të këtij aktiviteti, të dy organizatat EUROSAI dhe OLACEFS dolën me një deklaratë të përbashkët, Deklarata e Tbilisit.

Simpoziumi i XXII-të i OKB/INTOSAI

5-7 mars 2012, Vjenë, Austri

Në Vjenë, në datat 5-7 mars 2013, z. Bujar Leskaj mori pjesë në Simpoziumin e 22-të i OKB/INTOSAI, i organizuar nga Sekretariati i Përgjithshëm i INTOSAI, në bashkëpunim me Departamentin e Kombeve të Bashkuara për Ekonominë dhe Çështjet sociale (UN-DESA).

Në Simpozium ishin më shumë se 150 pjesëmarrës nga 60 shtete të ndryshme dhe midis tyre më shumë se 40 Kryetarë të Institucioneve Supreme të Auditimit, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare (UN-DESA, UNODC, UNEP, OECD, GIZ).

Simpoziumin e nderuan me praninë e tyre përfaqësues të lartë nga Kombet e Bashkuara z.Wu Hongbo, Nën Sekretar i Përgjithshëm për Ekonominë dhe Çështjet Sociale; Kryetarja e Parlamentit Austriak zj. Barbara Prammer dhe Sekretari i Shtetit për Çështjet e Jashtme Dr. Reinhold Lopatka. Tema kryesore e simpoziumit ishte "Auditimi dhe Këshillimi nga Institucionet Supreme te Auditimit: Risqet dhe mundësitë, si edhe shanset e angazhimit qytetar", e cila u materializua nëpërmjet këtyre nën-temave: 1.Auditimi dhe këshillimi nga SAI-t: Kërkesat dhe mundësitë për auditimin e qeverisjes. 2.Risqet dhe mundësitë e auditimit dhe këshillimit nga SAI-t. 3.Efektiviteti dhe transparenca e auditimit dhe këshillimit nëpërmjet angazhimit qytetar. Delegacioni i KLSH-së i kryesuar nga z.Bujar Leskaj përbëhej nga Drejtori i Auditimit të Performancës z. Rinald Muça, Përgjegjësja e Sektorit të Kërkimit Shkencor dhe Zhvillimit znj. Irena Islami dhe Audituesja e Lartë znj. Keida Muça.

Kongresit të XXI-të i INTOSAI

22-26 tetor 2013, Pekin, Kinë

Më datat 22 deri 26 Tetor 2013, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Bujar Leskaj, mori pjesë në punimet e Kongresit të XXI-të i INTOSAI, organizatës ndërkombëtare të institucioneve supreme të auditimit(SAI), zhvilluar në Pekin, Kinë me pjesëmarrjen e 192 institucioneve supreme të auditimit, përfaqësuar nga më shumë se 600 delegatë nga të gjithë SAI-t anëtare të INTOSAI-t, te drejtuar nga Kryetaret e SAI-ve.

Deklarata e Pekinit përmbledh arritjet historike dhe përvojën themelore të 60 viteve të fundit, si dhe rezultatet e dy temave teknike. Aty shtjellohen rezultatet e punës, misionit, vlerave themelore, dhe vizionit të SAI-ve, si dhe zbulohen mënyrat, përmes të cilave INTOSAI po synon të bëhet një organizatë ndërkombëtare model për promovimin e qeverisjes globale. Për më tepër, aty riafirmohet rëndësia e adoptimit dhe zbatimit të planifikimit strategjik të konfirmuar edhe në vizionin e INTOSAI-t, si dhe vlerat thelbësore në këtë epokë të re të zhvillimit historik; aty vihet në dukje rëndësia e

shkëmbimit të përvojës, rritja e kapaciteteve, si dhe bashkëpunimi me donatorët; dhe paraqiten rezultatet e Grupit të Punës të INTOSAI-t mbi vlerat dhe dobitë e SAI-ve, së bashku me rezultatet e tjera.

Si dokumenti përmbledhës dhe përfundimtar i Kongresit të XXI-të i INTOSAI, Deklarata thekson se situata globale me të cilën institucionet supreme të auditimit përballen i çon ata drejt përmirësimit të qeverisjes kombëtare, duke intensifikuar mbikëqyrjen, rritjen e transparencës dhe të paanësisë, promovimin e performancës dhe intensifikimin e luftës kundër korrupsionit. Gjithashtu qëndrueshmëria afatgjatë e politikave financiare të shteteve është një element përbërës dhe parakusht për një mirëqeverisje efektive. Kjo qëndrueshmëri mund të arrihet nëpërmjet auditmit profesional dhe të pavarur, i cili është elementi kryesor i zinxhirit të auditimit të performancës së financave publike. Kjo Deklaratë, së bashku me dokumentet e tjera të miratuara nga kongreset e mëparshme (si Deklarata e Limës dhe e Meksikës) do të sigurojë udhëzime për zhvillimin e ardhshëm të INTOSAI-t dhe SAI-ve anëtare. SAI-t do të vazhdojnë të shërbejnë shoqërinë dhe publikun duke promovuar zhvillimin e qëndrueshëm dhe përmirësimin e mirëqeverisjes kombëtare, forcimin e demokracisë, përmirësimin e shtetit ligjor, duke luftuar korrupsionin, ruajtur sigurinë kombëtare dhe duke nxitur reforma. Falë kësaj deklarate, SAI-t duhet të orientohen drejt adoptimit të mjeteve dhe metodologjive audituese krijuese, duke marrë masa efektive për të rritur aftësitë e tyre, dhe për të kapërcyer sfidat e botës moderne.

Gjatë punimeve të Kongresit të 21-të të INCOSAI-t, z. Bujar Leskaj, Kryetar i KLSH zhvilloi ndër të tjera, një takim pune me z. Josef Moser, President i Gjykatës Austriake e Auditimit, njëkohësisht edhe Sekretar i Përgjithshëm i INTOSAI-t. Kryetari i KLSH u takua dhe me z. Gene Dodaro, Auditues i Përgjithshëm i Zyrës së Llogaridhënies Qeveritare(GAO) të SHBA, me të cilin diskutoi mundësitë e bashkëpunimit mes KLSH dhe GAO-s amerikane.

Delegacioni i KLSH-së i kryesuar nga Kryetari, z. Bujar Leskaj, përbëhej nga Drejtori i Përgjithshëm z. Kristaq Gjyli, Drejtore Departamenti znj. Albana Agolli dhe Drejtore Drejtorie znj. Edlira Sako.

Konferenca e IV e përbashkët EUROSAI/ ARABOSAI

16-18 prill 2013, Baku

Në datat 16-18 prill 2013, z. Bujar Leskaj, mori pjesë në Konferencën e IV e përbashkët EUROSAI/ ARABOSAI**,** e cila u zhvillua në Baku, Azerbajxhan. Në këtë konferencë morën pjesë 117 pjesëmarrës nga 52 shtete të ndryshme anëtare të EUROSAI-t dhe ARABOSAI-t.

Mes tyre kishte edhe Kryetarë të Institucioneve Supreme të Auditimit. Konferencën e nderuan me praninë e tyre z. Guilherme d'Olivera Martines, President i EUROSAI-t dhe njëherazi President i Gjykatës së Llogarive të Portugalisë, z. Ramon Alvarez de Miranda Garcia, Sekretar i Përgjithshëm i INTOSAI-t dhe President i Gjykatës së Llogarive të Spanjës, z. Antonius Broek, Koordinatori Rezident i Kombeve të Bashkuara, z. Osama Faquih, Kryetar i ARABOSAI-t, etj. Tema kryesore e konferencës ishte "Sfidat e reja për rritjen e kapaciteteve të SAI-ve", e ndarë në tre çështje: 1. Përgjegjësitë e Autoriteteve Publike Supreme që burojnë nga Sfidat e Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme A/66/209, 22 dhjetor 2011. 2. Roli i SAI-ve në arritjen e qëllimeve kombëtare të zhvillimit. 3. Rëndësia për të përcaktuar kufijtë dhe objektivat e kontrollit të jashtëm dhe të brendshëm në përmirësimin e menaxhimit publik financiar. Në ditën e fundit të Konferencës, pjesëmarrësit miratuan Deklaratën e Bakusë, e cila, ndër të tjera, konfirmon se: -Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së A/66/209, datë 22 dhjetor 2011 mbi "Promovimin e eficiencës, përgjegjshmëris, efektivitetit dhe transparencës së administratës publike, duke forcuar institucionet supreme të auditimit" është një mjet i fuqishëm që duhet të përdoret nga SAI-t në të gjithë botën për të promovuar qeverisjen e mirë publike, si dhe për të siguruar pavarësinë e tyre; -Sfidat e vazhdueshme për shkak të ndryshimeve të menjëhershme të mjedisit kërkojnë ngritjen e kapaciteteve të SAI-ve. Komunikimi efektiv ndërmjet SAI-ve të të njëjtit rajon, shkëmbimi i eksperiencave në përcaktimin e përgjegjësive për autoritetet supreme publike, si dhe shkëmbimi i praktikave më të mira shërbejnë për të përmirësuar rritjen e kapaciteteve të SAI-ve; -Përcaktimi i qartë i kontrollit të jashtëm publik krijon baza të shëndosha për një qeverisje të mirë gjatë zhvillimit të menaxhimit të financave publike. Delegacioni i KLSH-së, i kryesuar nga Kryetari z. Bujar Leskaj, përbëhej nga Kryeaudituesja Albana Agolli dhe Specialistja Dalina Demi.

Konferenca mbi Marrëdhëniet e Institucioneve Supreme të Auditimit dhe Parlamenteve Kombëtare

18-19 nëntor 2013, Budva, Mal i Zi

Në datat 18-19 nëntor 2013, z. Bujar Leskaj mori pjesë në Konferencën mbi Marrëdhëniet e Institucioneve Supreme të Auditimit dhe Parlamenteve Kombëtare të vendeve të rajonit, e cila u zhvillua në Budva, Mal të Zi. Objektivi i kësaj Konference ishte ndarja e përvojave, ndërtimi i marrëdhënieve konstruktive ndërmjet SAI-ve dhe parlamenteve, ku u diskutuan faktorët që ndikojnë në këto marrëdhënie, si dhe u hodh ideja e ndërtimit të një pakete me instrumente që mund të përdoren nga SAI-t dhe parlamentet kombëtare për të forcuar bashkëpunimin e tyre të ndërsjellë.

Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit mes EUROSAI dhe AFROSAI

31 janar 2014, Lisbonë, Portugali

Në datën 31 janar 2014, u organizua ceremonia e nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit mes EUROSAI dhe AFROSAI, në ambientet e veçanta të Muzeut të Artit të Lashtësisë, në Lisbonë. Ceremoninë e nderuan me pjesëmarrjen e tyre Sekretari i Përgjithshëm i AFROSAI dhe President i SAI-t të Kamerunit dhe President i SAI-it të Spanjës, z.Ramón Alvarez de Miranda, zj. Stuiveling, zv/Presidente e Parë e Bordit të EUROSAI-it, z.Recai Akyel, zv/President i Dytë i Bordit të EUROSAI-it dhe President i Gjykatës Turke të Llogarive. Ky Memorandum do të rrisë mundësitë e bashkëpunimit dhe do të forcojë marrëdhëniet midis EUROSAI dhe AFROSAI, duke thelluar shkëmbimin e eksperiencave dhe të njohurive midis SAI-ve të të dy kontinenteve.

Takimi i Grupit të Punës së Teknologjisë së Informacionit të EUROSAI

11-14 mars 2014, Potsdam, Gjermani

Një delegacion i kryesuar nga z. Bujar Leskaj, Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH), nga datat 11-14 Mars 2014, mori pjesë në Potsdam të Gjermanisë në punimet e Takimit të 9-të të **Grupit të Punës së Teknologjisë së Informacionit të EUROSAI dhe në Simpoziumin jubilar për Teknologjinë e Informacionit**, organizuar nga Gjykata e Auditimit e Gjermanisë, me rastin e 300 vjetorit të themelimit të saj. Nën

drejtimin e ekspertëve dhe menaxherëve të SAI-t të Zvicrës, Takimi i 9-të i Grupit të Punës së Teknologjisë së Informacionit të EUROSAI prezantoi procesin e vetëvlerësimit të gjendjes së SAI-ve të ndryshme në përdorimin e teknologjisë së informacionit. U mbajtën kumtesa mjaft të vlefshme për përmirësimin e komunikimit ndërmjet përdoruesve dhe T.I., për mësimet e nxjerra nga vetëvlerësimi i auditimit të T.I. në Turqi, për auditimet paralele në menaxhimin e borxhit publik (sistemet e informacionit), në prodhimin e pasaportave biometrike, në sistemin elektronik të trenave evropianë, si dhe u dhanë orientime konkrete për kryerjen e auditimeve të ardhshme paralele në T.I. Delegacioni i KLSH-së i kryesuar nga Kryetari, z.Bujar Leskaj, përbëhej nga z. Kozma Kondakçiu, përgjegjës i Njësisë së Teknologjisë së Informacionit dhe z. Fatos Çoçoli, ekspert i jashtëm.

150-vjetori i krijimit të Gjykatës Rumune të Llogarive

5-7 qershor 2014, Rumani

Në datat 5-7 qershor 2014, në Bukuresht u zhvilluan aktivitetet e organizuara me rastin e 150-vjetorit të krijimit të Gjykatës Rumune të Llogarive**.** Ceremonia kryesore e 150-vjetorit të krijimit të Gjykatës Rumune të Llogarive, u zhvillua në datë 6 qershor 2014, në hollin plenar të Dhomës së Deputetëve në Pallatin e Parlamentit. Në këtë ceremoni merrnin pjesë Presidenti i Rumanisë, z.Traian Basescu, Kryeministri i Rumanisë, z. Viktor Ponta,

Kryetari i Dhomës së Deputetëve, z. Valeriu Zgonea, Presidenti i Gjykatës së Audituesve, z.Nikolae Vacaroiu, Guvernatori i Bankës së Rumanisë, z.Mugur Isarescu, Patriarku i Kishës Ortodokse Rumune, Daniel, Kryetari i Bashkisë së Bukureshtit, z.Sorin Oprescu, si edhe ministra, senatorë dhe deputetë.

Kongresi i IX-të i Organizatës Europiane të Institucioneve Supreme të Auditimit, EUROSAI

16-19 qershor 2014, Hagë, Hollandë

Në datat 16 deri më 19 Qershor 2014, z. Bujar Leskaj mori pjesë në punimet e Kongresit të IX-të të Organizatës Europiane të Institucioneve Supreme të Auditimit, EUROSAI, i zhvilluar në Hagë me pjesëmarrjen e delegacioneve nga 50 Institucionet Supreme të Auditimit të Europës si dhe të ftuar të tjerë, ndër të cilët Gjykata Europiane e Llogarive, Organizata IDI dhe SIGMA.

Inovacioni ishte tema qëndrore e këtij Kongresi ishte "Kur ka qenë hera e fundit që ke bërë diçka për herë të parë?" me synimin për të kontribuar në përmirësimin e vazhdueshëm të auditimit publik. Në përmbushje të objektivave të tij, në këtë kongres diskutimet zyrtare u alternuan me paraqitje artistike dhe jo formale të njerëzve të suksesshëm nga bota e artit dhe biznesit. Delegacioni i KLSH-së, i kryesuar nga Kryetari, z.Bujar Leskaj, përbëhej nga Sekretarja e Përgjithshme znj. Luljeta Nano, Drejtore e Departamentit znj. Albana Agolli dhe Kryeauditueja znj. Evis Çela.

Komiteti i Kontaktit të Institucioneve Supreme të Auditimit të vendeve të BE-së

16-17 tetor 2014, Luksemburg

Në datat 16 – 17 tetor 2014, u zhvillua në Luksemburg takimi i Komitetit të Kontaktit të Institucioneve Supreme të Auditimit të vendeve të BE-së, nën drejtimin e Gjykatës Europiane të Audituesve, në kuadrin e 10 vjetorit të zgjerimit të Bashkimit Europian me 10 anëtarë të rinj në vitin 2004. Në këtë takim morën pjesë

përfaqësues të 28 vendeve anëtare të BE-së dhe të SAI-ve të vendeve kandidate dhe para kandidate, si edhe përfaqësues të SIGMA-s. U diskutua mundësia e monitorimit të zbatimit të Strategjisë Europiane 2014 – 2020, si dhe mbikëqyrja e bankave të vendeve të BE-së, ku Banka Qendrore Europiane do të luajë një rol të rëndësishëm. Në fund të punimeve Komiteti i Kontaktit arriti, ndër të tjera, përfundimet e mëposhtme: -Krijimi i një Task Force për forcimin e bashkëpunimit në Europë, qëllimi i së cilës do të jetë bashkëpunimi me i ngushtë dhe praktik në fushën e auditimit; -U inkurajuan vendet pjesëmarrëse që të marrin pjesë aktivisht në veprimtaritë e organizuara në kuadër të Rrjetit të Strategjisë Europiane të Auditimit 2020.

Takim zyrtar i Kryetarit të KLSH-së me Kontrollorin e Përgjithshëm të GAO-s

3 shkurt 2015, Washington

Në datën 3 shkurt 2015, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit të Shqipërisë, z. Bujar

Leskaj zhvilloi në Washington D.C një takim zyrtar pune me Kontrollorin e Përgjithshëm të GAO-s, (Zyra e Auditimit të Qeverisë e SHBA), z.Gene Dodaro. Z. Dodaro vlerësoi punën e bërë nga institucioni suprem i auditimit të Shqipërisë përgjatë këtyre tre viteve të fundit, veçanërisht në fushën e botimeve dhe sidomos me tetë numrat e revistës shkencore "Auditimi Publik" dhe botimin e standardeve të auditimit. Në këtë drejtim, z. Dodaro inkurajoi bashkëpunimin e mëtejshëm të Revistës shkencore "Auditimi Publik "me revistën "INTOSAI Journal" që botohet nga GAO për të gjithë komunitetin e Institucioneve Supreme të Auditimit. Z. Dodaro aprovoi me kënaqësi edhe përkthimin e Standardeve të Auditimit të Qeverisjes të GAO-s në gjuhën shqipe që njihen si "Libri i Verdhë", standarde të cilat zbatohen nga të gjithë qeveritë federale në SHBA. Zoti Dodaro konfirmoi edhe një herë mbështetjen e GAO-s për KLSH-në jo vetëm në kuadrin bilateral, por edhe nëpërmjet strukturave të tjera ndërkombëtare të komunitetit të auditimit, si IDI apo Komiteti i Donatorëve të INTOSAI-t. Gjatë zhvillimit të takimit, objekt i diskutimit ishte dhe përmbushja e objektivave të Institucioneve Supreme të Auditimit në drejtim të forcimit të etikes dhe integritetit, konsideruar si parime fondamentale dhe parakushte për sigurimin e besueshmërisë së këtyre institucioneve, si dhe promovimi i parimeve të mirëqeverisjes, transparencës dhe luftës kundër korrupsionit. GAO është ndër SAI-et më të zhvilluara dhe me peshë në komunitetin e INTOSAI-t, lider i zhvillimeve strategjike të komunitetit dhe një organizatë që udhëheqë nëpërmjet shembullit zhvillimin e auditimit suprem publik në

mbarë botën. Tradita, cilësia dhe pavarësia e GAO-s janë në nivelet më të larta të arritura nga një SAI. Për rrjedhojë, bashkëpunimi mes KLSH-së dhe GAO-s merr një rëndësi të veçantë dhe themelore për modernizimin dhe zhvillimin strategjik të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Simpoziumi i XXIII-të, organizuar nga Kombet e Bashkuara dhe INTOSAI

2-4 mars 201, Vjenë, Austri

Në datat 2-4 mars 2015, u zhvillua në Vjenë, Simpoziumi i XXIII-të, organizuar nga Kombet e Bashkuara dhe INTOSAI me temë: "Axhenda e zhvillimit të Kombeve të Bashkuara për periudhën pas 2015. Roli i Institucioneve Supreme të Auditimit për zhvillimin e qëndrueshëm". Çështja e parë që u trajtua lidhej me pritshmërinë që kanë parlamentet, qeveritë, Kombet e Bashkuara, organizatat e shoqërisë civile, donatorët, qytetarët etj, në lidhje me rolin që mund të luajnë Institucionet Supreme të Auditimit (SAI) në zhvillim e qëndrueshëm. U theksua rëndësia e forcimit të mekanizmave të mbikëqyrjes dhe e rolit të parlamenteve dhe rëndësia vitale që ka monitorimi, dhe raportimi në arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm. Çështja e dytë lidhej me parakushtet që duhet të plotësojnë SAI-et për t'u angazhuar në mënyrë efektive ne Axhendën e zhvillimit të Pas-2015, si pavarësia e SAI-ve, kapacitetet e nevojshme profesionale të SAI-ve për të audituar objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, mandatin e nevojshëm, etj. Delegacioni i KLSH-së i kryesuar nga Kryetari, z.Bujar Leskaj, përbëhej nga znj. Albana Agolli, Drejtore e Departamentit të Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit dhe znj. Irena Islami, Drejtore e Drejtorisë së Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

Kongresi i I-rë Ndërkombëtar mbi Prokurimin

23-24 prill 2015, Portoro, Slloveni

Më datat 23 dhe 24 Prill 2015, Kontrollit i Lartë i Shtetit, i përfaqësuar nga z. Bujar Leskaj, mori pjesë në Kongresin e I-rë Ndërkombëtare mbi Prokurimin, zhvilluar në Portoroz, Slloveni. Qëllimi kryesor i kongresit ishte mbështetja e zhvillimeve të deritanishme dhe atyre që priten të ndodhin në nivel Europian në fushën e prokurimit publik dhe atë të koncesioneve, duke u fokusuar

veçanërisht në shkëmbimin e ideve dhe praktikave më të mira të vendeve, njohjen e direktivave Europiane në fushën e prokurimit publik dhe koncensioneve, si dhe rregullimin dhe zhvillimin e sistemeve të prokurimit publik dhe koncesioneve në shtete të ndryshme.

Konferenca e VIII-të e përbashkët EUROSAI/OLACEFS

24-26 qershor 2015, Quito, Ekuador

Në datat 24-26 qershor, 2015 u zhvillua në Quito, Ekuador, Konferenca e 8-të e përbashkët EUROSAI/OLACEFS (Organizata Europiane e Institucioneve Supreme të Auditimit/Organizata e Institucioneve Supreme të Auditimit të vendeve të Amerikës Latine dhe Karaibeve). Në këtë event morën pjesë më shumë se 100 përfaqësues delegacionesh nga Europa, Amerika Latine dhe Karaibet, si edhe bashkëpunëtorë të tjerë të jashtëm nga institucione multilaterale.

Diskutimet dhe kontributet e SAI-ve gjatë ditëve të punimeve të Konferencës u fokusuan në dy temat kryesore: "Auditimet e koordinuara" dhe "Kontributet e SAI-ve në Mirë-Qeverisje". Këto dy tematika lidheshin me fusha të ndryshme të auditimit, si ngritja e kapaciteteve, etika, inovacioni, qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm, transparenca, "Open Data", ku formati i përcaktuar është ai i mini-konferencave apo organizimit në grupe pune ku do të diskutohen më gjerësisht dhe do të sillen eksperiencat respektive të SAI-ve mbi tematikat e lartpërmendura. Në përfundim të punimeve te Konferencës, dhanë përshtypjet e tyre përfaqësues të Sekretariatit të Përgjithshëm të INTOSAI-t, përfaqësues të GAO-s mbi revistën Auditimi i Jashtëm Publik i INTOSAI-t, si dhe përfaqësues të Sekretariateve të Përgjithshme të EUROSAI-t dhe OLACEFS.

Vizitë zyrtare e Kryetarit të KLSH-së në Zyrën Shtetërore të Auditimit të Kroacisë

27-28 korrik 2015, Kroaci

Më datat 27 – 28 korrik 2015, Kryetari i KLSH-së z. Bujar Leskaj zhvilloi një vizitë zyrtare dy ditore pranë Zyrës Shtetërore të Auditimit të Republikës së Kroacisë. Gjatë kësaj vizite, z. Leskaj u takua me Audituesin e Përgjithshëm të Kroacisë, z. Ivan Klesic, ku diskutuan për intensifikimin e marrëdhënieve dypalëshe. Gjithashtu, Kryetari i KLSH u takua edhe me drejtorët e departamenteve zj. Neda Rogosic, zj. Nada Neda, zj. Lidija Pernar, Asistent Audituese e Përgjithshme dhe z. Kord Kordic, Kryeaudites. Një nga produktet konkrete të këtij bashkëpunimi është pjesëmarrja e SAI-t kroat, së bashku me SAI-n e Polonisë, në zbatimin e Projektit të Binjakëzimit IPA 2013, i cili filloi zbatimin në mars 2016 dhe synon rritjen e kapaciteteve të trupës audituese të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Në vijim të kësaj vizite të shkurtër, delegacioni shqiptar, i shoqëruar nga Audituesi i Përgjithshëm i SAI-t Kroat dhe zj. Lidia Prenar, vizitoi selinë e Parlamentit kroat ku edhe u njoh me praktikat e punës, komunikimit dhe raportimit ndërinstitucional.

Vizitë zyrtare e Kryetarit të KLSH-së në Zyrën Supreme të Auditimit të Polonisë

21 tetor 2015, Varshavë, Poloni

Më 21 Tetor 2015, Kryetari i KLSH-së, Z. Bujar Leskaj, së bashku me një grup audituesish të KLSH-së takoi në **Varshavë Presidentin e NIK-ut Polak, z. Krzysztof Kwiatkowski.**

Në këtë takim, morën pjesë edhe dy personalitetet e shquara dhe miq të vjetër të KLSH-së, z. Wojciech Kutyla, Zv. President i NIK-ut Polak dhe z. Jacek Jezierski, ish-President i këtij institucioni.

Në takimin e zhvilluar në ambientet e zyrave qendrore të NIK-ut në Varshavë, Z. Kwiatkowski dhe Z. Leskaj diskutuan mbi çështjet aktuale të bashkëpunimit bilateral ndërmjet të dyja SAI-eve, duke vlerësuar rëndësinë e implementimit të afërt të Projektit të Binjakëzimit IPA mes dy institucioneve, i cili do të zgjasë 24 muaj dhe do të zhvillohet në bashkëpunim edhe me SAI-in Kroat.

Z. Kwiatkowski konfirmoi që ky Projekt Binjakëzimi dhe vetë bashkëpunimi i NIK-ut Polak me KLSH, janë një prioritet për të si President i NIK-ut Polak dhe për gjithë stafin e tij drejtues. NIK-u Polak në vlerësim të ecurisë së deritanishme të bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve do të vazhdojë të mbështesë programin e trajnimeve të audituesve të KLSH-së në Poloni, të zhvilluar tashmë me sukses gjatë këtyre tre viteve të fundit.

Konferenca e V-të e përbashkët EUROSAI-ARABOSAI

7-9 dhjetor 2015, Doha , Katar

Në datat 7-9 dhjetor 2015, në Doha, Katar u zhvillua Konferenca e V-të e përbashkët EUROSAI-ARABOSAI, në të cilën morën pjesë Institucione Supreme Auditimi (SAI) nga Europa dhe nga vendet Arabe, si dhe përfaqësues të Gjykatës Europiane të Audituesve (ECA), Zyrës së Audituesit të Përgjithshëm të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, drejtues të EUROSAI-t, ARABOSAI-t dhe të INTOSAI-t. Gjatë tre ditëve të zhvillimit të Konferencës, Kryetari i KLSH-së, z.Bujar Leskaj realizoi shumë takime pune, si me Kryetarin e Zyrës Shtetërore të Auditimit të Katarit, Sheik Bandar bin Mohammad bin Saoud Al Thani që ishte edhe mikpritësi dhe organizatori i kësaj Konference. Zoti Leskaj takoi gjithashtu shumë drejtues të SAI-ve Europiane dhe Arabe që morën pjesë në këtë Konferencë si z.Recai Akyel, President i Gjykates Turke të Llogarive, z.Ivan Klesiç, Kryetar i SAI-t Kroat, z. Adel Al Saravi, President i SAI-t të Kuvaitit, z.Naser Ademi, Zv/President i SAI-t të Maqedonisë, delegacionin e SAI-t Polak të kryesuar nga ish-Presidenti, z.Jacek Jezierski dhe përfaqësues të shumë SAI-ve të tjera. KLSH u përfaqësua në këtë konferencë nga një delegacion i kryesuar nga z.Bujar Leskaj, Kryetar i KLSH-së. Në përbërje të delegacionit ishin z.Ermal Yzeiraj, drejtor departamenti, zj.Albana Agolli, drejtore departamenti dhe zj.Irena Islami, drejtore drejtorie.

FJALA E KRYETARIT TË KLSH NË KËSHILLIN E NIK[122]

Këshilli i Institucionit Suprem të Auditimit në Poloni-NIK, zhvilloi në datat 12-14 maj 2014 sesionin e tij të radhës Varshavë. Kryetari i KLSH-së është i ftuari i parë në të gjithë historinë e NIK-t polak, i cili merr pjesë dhe mban fjalën e hapjes në një nga sesionet e këtij Këshilli. Këshilli i NIK është një strukturë e pavarur, e cila në përbërje të saj ka përveç anëtarëve të NIK-t edhe figura të shquara të botës akademike polake në fushat e drejtësisë dhe ekonomisë.

I nderuar z.President i Institucionit Suprem të Kontrollit të Polonisë, z. Kwiatkowski,

Të nderuar pjesëmarrës,

Është një privilegj për mua, të mbaj fjalën e hapjes përpara Jush në këtë sesion të Këshillit të NIK-ut, me pjesëmarrës anëtarë të NIK, akademikë të shquar polakë si dhe ekspertë në fushën e drejtësisë dhe ekonomisë.

Shpreh falënderimet e mia për ftesën e bërë nga z. Kwiatkowski, për privilegjin e madh me këtë mundësi që më dhatë, vlerësimin e lartë dhe respektin personal dhe institucional që kam për NIK, si një nga partnerët kryesorë të KLSH-së drejt rrugës së zhvillimit në përputhje të plotë me standardet e INTOSAI-t. Audituesit shqiptarë dhe KLSH, janë krenarë për sukseset e NIK-t polak në arenën ndërkombëtare dhe janë mirënjohës si dhe të inkurajuar nga të paturit një nga partnerët më të mirë të tyre, Institucionin Suprem të Auditimit të Polonisë, i cili ka dhënë ndihmën e tij të

[122] Nga të gjitha fjalët, përshëndetjet dhe prezantimet e Kryetarit në SAI-t homologe, janë përzgjedhur të botohen në këtë libër fjala e Kryetarit në SAI-n e Polonisë (NIK) dhe SAI-n e Austrisë (ACA), të cilat botohen me shkurtime nga origjinali.

pakushtëzuar për zhvillimin e qëndrueshëm dhe modernizimin e mëtejshëm të KLSH-së, gjatë vitit 2012 dhe në vijim.

Një nga faktorët e rëndësishëm në eksperiencën e NIK, ka qenë lufta ndaj mashtrimit në administratën publike. Ne, si KLSH, jemi mjaft të interesuar për të vazhduar dhe zgjeruar këtë eksperiencë të fituar nga NIK, në përsosjen e metodologjive të auditimit, zhvillimin e auditimeve të performancës kombinuar me ato financiare. Po ashtu, do të bëjmë përpjekjet maksimale në thellimin dhe vazhdimin e trajnimeve të audituesve shqiptarë në Poloni dhe aktiviteteve të përbashkëta.

Më lejoni të përshëndes punën e bërë nga ish-Presidenti Jezierski në arritjen e këtij bashkëpunimi të suksesshëm midis dy institucioneve tona, ku nëpërmjet këtij bashkëpunimi, KLSH dhe audituesit e saj kanë mësuar prej aktiviteteve të ndërsjella të zhvilluara deri më tani.

Ky është një vit i rëndësishëm për Poloninë, ku janë kremtuar 10 vjetori i anëtarësimit në BE dhe kanonizimi i një figure të shquar dhe vlerësuar në të gjithë botën si Ati i Shenjtë, Papa Gjon Pali II, Papa i parë që vizitoi Shqipërinë dhe së shpejti do të përkujtohet 25 vjetori i Solidarnos, si edhe 15 vjetori i anëtarësimit në NATO.

Viti 2014 shënon edhe 54 vjetorin e anëtarësimit të NIK-t në INTOSAI. NIK është dhe mbetet një nga SAI-t më aktivë duke zgjeruar njohuritë mbi standardet e auditimit dhe praktikat më të mira, ashtu si edhe duke shkëmbyer eksperiencat dhe arritjet e tij me shumë SAI të tjerë. NIK bashkëpunon me partnerët e tij brenda kuadrit të EUROSAI-t si dhe mbështet audituesit e Gjykatës Europiane të Llogarive në misionet e tyre në Poloni. Në vitin 2012, NIK u emërua si auditues i jashtëm i Organizatës Europiane për Kërkimin Nuklear për vitet 2013-2015 si dhe auditues i jashtëm i Këshillit të Europës, ku KLSH dha mbështetjen maksimale për kandidaturën e NIK.

Një vlerësim të madh kam për kontributin që jep Ambasadori i Republikës së Polonisë në Tiranë, z.Marek Jeziorski jo vetëm në aktivitete dhe pjesëmarrje të ndryshme, por edhe duke qenë prezent në median e shkruar shqiptare, ku artikulli më i fundit me titull, "Cilat ishin tiparet kryesore të aderimit të Polonisë në BE", është një mësim dhe shembull për të gjithë shqiptarët.

Në fund të kësaj fjale, më lejoni t'Ju shpreh edhe njëherë falënderimet e përzemërta për të gjithë mbështetjen nga ish-presidenti Jezierski dhe presidenti aktual, z.Kwiatkowski dhe vazhdimësinë e bashkëpunimit të suksesshëm ndërmjet dy institucioneve.

FJALA E KRYETARIT TË KLSH-së NË GJYKATËN E AUDITIMIT TË AUSTRISË

I nderuar Dr. Moser[123],

Të nderuar pjesëmarrës,

Së pari dëshiroj t'Ju falënderoj për mikpritjen dhe për rëndësinë që i dhatë bashkëpunimit me ALSAI, nëpërmjet finalizimit të shpejte të nënshkrimit të kësaj marrëveshje bashkëpunimi.

Gjykata Austriake e Auditimit ka një eksperience 250 vjeçare dhe një tradite të gjatë e shumë pozitive pune, nga e cila AlSAI do të përfitoje për t'u shndërruar në një SAI modern dhe për rritjen e mëtejshme të kapaciteteve profesionale të stafit të tij.

Është një nder i veçantë për mua sot, që po ju drejtohem Juve personalisht, në cilësinë e Kryetarit të Gjykatës Austriake të Auditimit dhe njëkohësisht të Sekretarit të Përgjithshëm të INTOSAI-t. Nënshkrimi i kësaj marrëveshje midis dy institucioneve tona, është një nga bashkëpunimet më cilësore të ALSAI-t dhe jam i bindur në impaktin pozitiv e strategjik që do të ketë zbatimi i saj.

Austria dhe Shqipëria kanë një bashkëpunim të hershëm që ka lënë gjurmë në historitë e dy vendeve tona, sidomos gjatë shekullit të XIX-të. Kjo traditë pozitive ka vazhduar edhe në ditët tona dhe investimet austriake në Shqipëri zënë një vend të rëndësishëm në ekonominë e vendit tonë, duke u renditur të tretat për nga pesha që zënë me 14% të stokut investues dhe me dinamikë në rritje;

[123] Fjala e mbajtur në Vjenë, Austri, më 8 korrik 2013, në takimin me Dr. Josef Moser, me rastin e nënshkrimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes Gjykatës së Auditimit të Austrisë dhe Kontrollit të Lartë të Shtetit.

këtu mjafton të përmendim një emër shumë domethënës,Reiffeisen Bank, apo kompanitë austriake Verbund dhe EVN qe po ndërtojnë hidrocentralin e Ashtes në Shqipëri, me një investim mbi 200 milion euro. Po kështu, eksportet shqiptare destinohen në masën 11% të tyre drejt Austrisë, duke u renditur kështu e 4-ta në partneret tanë tregtarë brenda BE-së.

Ju lutem më lejoni të bëj një përshkrim të shkurtër të asaj që ne si KLSH kemi bërë gjatë vitit të kaluar dhe gjysmës së parë të këtij viti. Që kur mora detyrën në dhjetor të vitit 2011, vizioni im ishte modernizimi i aktivitetit tone ne te gjithë spektrin e vet profesional.

1. **Baza është përmirësimi i legjislacionit, ligjit tonë organik**. Me ndihmën e SIGMA-s dhe DG-Budget, ne kemi përgatitur projekt-amendamentet për ligjin tonë. Ne e kemi sjellë atë plotësisht në përputhje me standardet e INTOSAI duke fuqizuar me shume Institucionin. Ne duhet të jemi në gjendje të certifikojmë edhe ligjërisht llogaritë financiare të audituara dhe të kryejmë auditimin e projekteve dhe programeve të financuara nga BE.

Kemi dërguar zyrtarisht draft-amendamentet e këtij ligji në Parlament në muajin nëntor 2012 dhe shpresoj qe Ligji do të miratohet brenda këtij viti, pas konstituimit te Parlamentit te ri (ne Shqipëri janë zhvilluar zgjedhjet legjislative ne 23 qershor te këtij viti).

2. Një tjetër mënyrë për të modernizuar KLSH-në, është dhe **rritja e kapaciteteve të stafit auditues**. Sfida jone ne këtë drejtim është shume dimensionale. Kapacitete tona duhen rritur në drejtim te cilësisë dhe sasisë, ne përputhje me llojet e reja te auditimit që po implementojme, duke unifikuar strukturën e punës, por pa cenuar diversitetin dhe krijueshmërinë e tyre. Një vend të rëndësishëm në vizionin tim për rritjen e kapaciteteve profesionale zënë trajnimet. Ato janë antidoti qe duhet t'u injektohet vazhdimisht audituesve për të mos rënë në pozita parazitizmi profesional. Nëse krahasojmë numrin e ditëve të trajnimit për audites mes dy viteve të fundit, në vitin 2012 ky numër është 9 herë më i lartë se në vitin 2011. Shifrat arritën në 19.4 ditë trajnim në vit për audites dhe në gjysmën e parë të vitit 2013, 10 ditë trajnimi për çdo audites.

2.a) Numri i audituesve të KLSH-së, që gjatë vitit 2012 kanë shkuar jashtë vendit për trajnime, është i barabartë me numrin e audituesve që kanë shkuar jashtë vendit në shtatë vitet e fundit 2004-2011 të marra së bashku. Ne kemi dërguar jashtë shtetit për eksperienca të reja vitin e kaluar, më shumë se gjysmën e audituesve tanë (69 audites) nga 2 deri në 7 ditë. Ne kemi vijuar punën me të njëjtat ritme në këtë drejtim dhe në qershor të këtij viti arritëm që çdo audites i KLSH të ketë shkuar të paktën një herë

jashtë vendit për trajnim. Vitin 2012 e mbyllëm me **19.4 ditë trajnimi** për auditues në KLSH (nga vetëm 2.1 ditë trajnimi në vit për auditues, që kishim trashëguar nga viti 2011). Për këtë vit deri në qershor jemi në nivelin e 10 ditëve të trajnimit për auditues. Audituesit e rinj kanë për detyre të trajnohen 25 ditë në vit dhe vitin e kaluar e kanë plotësuar këtë tregues. Me të njëjtin ritëm po trajnohen edhe këtë vit me trajnime të realizuara nga SIGMA, nga eksperte te institucioneve simotra, nga CEF, si dhe nga ekspertë vendas dhe të vetë KLSH-së.

2.b Me kërkesën tonë, në mars 2012, KLSH ka nisur një bashkëpunim intensiv me SIGMA-n. Ekspertët e SIGMA-s kanë trajnuar në Tiranë mbi 100 auditues në seminare te ndryshme, në fusha të ndryshme, si auditimi i performancën dhe financiar, i pajtueshmërisë dhe auditimi i TI. Mbështetja e SIGMA-s ka vazhduar edhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2013 me trajnime mbi auditimin e performancës dhe auditimin e prokurimeve publike (këtë muaj).

3) Me udhëzimin dhe mbështetjen e SIGMA-s, kemi përgatitur Planin e Zhvillimit Strategjik 2013-2017 për KLSH. Ai tashmë është në finalizim dhe reflekton katër objektivat strategjike të planit te zhvillimit 2011-2017 të EUROSAI-t. Ne synojmë të rrisim numrin dhe cilësinë e auditimeve të performancës dhe të fillojmë të konsolidojmë dhënien e opinioneve financiare në auditimet financiare. Plani ynë është ambicioz dhe ka nevojë për mbështetje nga partnerët.

4. Një tjetër mënyrë për të rritur kapacitetet tona në përputhje me standardet e INTOSAI, është dhe bashkëpunimi mes SAI-ve. Trajnimi i audituesve tanë është rezultat i marrëveshjeve të bashkëpunimit që kemi nënshkruar me SAI të ndryshëm.

Në prill të vitit 2012, unë kam nënshkruar një marrëveshje me Dr Igor Šoltes, Kryetar i Gjykatës së Auditimit të Sllovenisë dhe në shtator të këtij viti, disa auditues të KLSH u trajnuan në Ljubjanë. Ne nënshkruam një marrëveshje bashkëpunimi në muajin maj të vitit të kaluar, me Presidentin e NIK, Z.Jezierski. Gjatë vitit 2012 dhe në gjashtëmujorin e parë të vitit 2013, më shumë se 60 auditues të KLSH u trajnuan në Varshavë mbi auditimin e performancës, mbi certifikimin e llogarive dhe auditimin financiar.

Në nëntor 2012, ne nënshkruam në marrëveshje bashkëpunimi me Gjykatën Turke të Llogarive dhe mbi 80 auditues u trajnuan ne Ankara mbi auditimin e performances, atë financiar, të prokurimeve publike, si dhe mbi çështje të tjera mbi administratën publike.

5. I nderuar Dr Moser, që në momentin që u caktova kryetar i KLSH, kisha në mendje vetëm dy gjëra. E para ishte modernizimi i KLSH dhe e dyta si të thellojmë luftën kundër korrupsionit dhe përmirësimin e qeverisjes.

Unë kam përgatitur një platformë me objektivat strategjike, të cilat i kam paraqitur në Komisionin Parlamentar të Ekonomisë dhe Financave. Udhërrëfyesit e mi janë Kushtetuta e Shqipërisë, deklaratat e Lime-s dhe Meksikos dhe në përgjithësi parimet dhe standardet e INTOSAI-t.

Në maj të vitit të kaluar, ne kemi nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi të iniciuar nga ne, me Ministrinë e Financave të Republikës se Shqipërisë. Ne po shkëmbejnë informacionet mbi studimet dhe raportet, si dhe marrim pjesë në seanca trajnimi të përbashkëta.
Ne do të vazhdojmë në këtë rrugë, duke u përpjekur të shmangim mbivendosjen me strukturat e auditimit të brendshëm. Bashkëpunojmë me Auditimin e Brendshëm nëpërmjet këshillimeve të vazhdueshme, shkëmbimit të planeve të punës, zhvillimit të metodologjive, trajnimeve dhe kryerjes së veprimtarive të përbashkëta e deri në përdorimin e punës së Auditimit të Brendshëm, kur kjo punë cilësohet se është kryer në përputhje me standardet e fushes.

6. KLSH po mbështet qeverisjen e mirë dhe po lufton korrupsionin, duke punuar në një sistem institucionesh të pavarura publike, të interesuar për ta luftuar atë. Ne kemi nënshkruar marrëveshje me tre prej tyre (Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm, Autoriteti i Konkurrencës, Inspektorati i Larte i Kontrollit dhe Deklarimit të Pasurive të Zyrtarëve Publikë).

Ndajmë besimin se sfidat tona do të realizohen duke koordinuar si duhet punën me institucionet e tjera, publike dhe jo-publike të fushës. Kemi siguruar bashkëpunim profesional me Institutin e Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA) dhe me Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit, me të cilët kemi nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi, për të na ndihmuar në kryerjen e analizës së riskut në planifikimin e auditimeve, në rritjen e cilësisë gjatë procesit auditues dhe në raportimin cilësor të gjetjeve të auditimit. Gjatë këtij viti, nënshkruam një marrëveshje me Universitetin Politeknik të Tiranës dhe kemi një bashkëpunim shumë efikas me strukturat akademike të këtij Universiteti, duke trajnuar drejtuesit dhe audituesit tanë për tema të rëndësishme që do t'u vlejnë audituesve tanë në punën e tyre të përditshme.

Ne kemi nënshkruar marrëveshje me 6 organizata aktive të shoqërisë civile në Shqipëri, të cilat luftojnë korrupsionin dhe kërkojnë më shumë transparencë në menaxhimin publik. Ne mendojmë se kjo është mënyra më e mirë për të zbuluar dhe parandaluar korrupsionin.

Ne e kemi rritur ndjeshëm cilësinë dhe numrin e kallëzimeve që kemi dërguar në Prokurori, duke denoncuar ashpër abuzimin me asetet publike. Gjate vitit 2012 kemi kryer 40 kallëzime penale, pothuajse 2 herë më tepër se sa 3 vitet 2009-2011 të marra së bashku. Prokuroria ka nisur hetimet për të gjitha kallëzimet tona.

Edhe këtë vit luftën kundër korrupsionit dhe rritjen e përgjegjësisë në administratën tonë publike, e kemi vijuar me ritëm të njëjtë. Objektivi ynë nuk është të dërgojmë kallëzime në Prokurori, por të luftojmë kulturën e mos-ndëshkimit të zyrtarëve të lartë publikë.

7. Në ndihmë të rritjes së transparencës së punës së institucionit, informimit të stafit dhe për komunikimin me partneret në vend dhe jashtë tij, KLSH ka rritur ndjeshëm numrin e botimeve të tij. Kolana e botimeve tona, përveç 10 botimeve të vitit 2012 ("EUROSAI" -Institucionet Supreme Europiane të Auditimit), "Historiku i Kontrollit të Lartë të Shtetit", "Standardet e Auditimit INTOSAI" (ISSAI), Revista "Auditimi Publik" Nr. 1, 2 dhe 3,"Udhëzuesi i Auditimit të Performancës", "KLSH Analiza Vjetore 2011" , "KLSH në Kuvend 2011" dhe "KLSH Analiza Gjashtëmujore Janar-Qershor 2012"), këtë vit u pasurua me botimin "KLSH Analiza Vjetore 2012" dhe me numrin e katërt te revistës shkencore katërmujore "Auditimi Publik".

8. Në tetor të vitit të kaluar, themeluam departamentin e auditimit të performancës, me audituesë të angazhuar seriozisht në përballimin e sfidave që ofron realiteti shqiptar, përmbushjen e objektivave te departamentit dhe institucionit, krijimin e vlerës së shtuar për taksapaguesit dhe përmirësimin cilësor të shërbimeve publike, asistimin e vendim-marrjes legjislative dhe asaj ekzekutive, si edhe çuarjen përpara të këtij shërbimi të ri publik në Shqipëri, që është vetë auditimi i performancës. Ndër objektivat e këtij departamenti të ri, një pjesë e të cilave të reflektuara edhe në Planin Strategjik të Zhvillimit të institucionit përmenden: rritja e cilësisë dhe numrit të auditimeve të performancës me synim arritjen e parametrave të SAI-ve homologe lider në rajon e më gjerë, shtimi i kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturore për këtë lloj auditimi, përgatitja e manualit të performancës për KLSH-në dhe asistimin në formulimin e parametrave të performancës për sektorë të administratës publike, urbanizimin e konceptit të auditimit të performancës në krejt administratën publike, por edhe më tej në mjedise akademike, media, organizma profesionale, OJF e OJQ, etj., duke krijuar dhe zhvilluar kontakte me palët e interesuara, shtimin e vlerës së fondeve publike dhe rritjen e përgjegjshmërisë në menaxhimin e këtyre fondeve, sinergjizimin e punës me grupe interesi, ekspertë, konsulentë dhe kërkues shkencorë, etj.

Sot mund të them se kemi bërë progres në disa drejtime. Konkretisht kemi realizuar auditime cilësore performance me pjesëmarrjen e ekspertëve dhe kërkuesve shkencorë. Kemi përmirësuar strukturimin e punës sonë sipas standardeve INTOSAI, veçanërisht në drejtim të raportimit, kemi rritur prezencën në administratë përmes shtimit të numrit të auditimeve të performancës dhe jemi afruar me mediat duke bërë publikime apo

njoftime të ndryshme. Jemi duke punuar për manualin e departamentit të performancës, sikurse për treguesit e performancës që përmenda pak më lart.

9. Ne po punojmë qe aktiviteti ynë audituesi te jete ne përputhje me standardet INTOSAI të pranuara ndërkombëtarisht. Ky është një rekomandim i vendosur edhe nga Bashkimi Europian në Raportin e Komisionit te BE-së për Shqipërinë në vitin 2012 dhe jam i bindur se vendosja e plotë në linjë e punës sonë me standardet INTOSAI do t'i kontribuoje integrimit te Shqipërisë ne BE.

10. Dr. Moser,

Eksperienca juaj e gjate 250 vjeçare dhe cilësia e punës tuaj audituese është për ne një model shume i mire për tu ndjekur. Është një arritje e madhe për ne që po ndërtojmë bazat e bashkëpunimit tone për të ardhmen.

Ne jeni shume te interesuar të bashkëpunojmë dhe të gatshëm të investojmë kohë dhe forca për auditime të përbashkëta dhe për vizita në kuadër të shkëmbimit të eksperiencës.

Kjo marrëveshje është shumë e rëndësishme për ne. Unë jam i sigurt se ne do të diskutojmë mbi mundësitë për zbatimin e saj në kohën e duhur, me aktivitete konkrete të bazuara në moton e INTOSAI "Eksperienca e përbashkët u shërben te gjithëve". Përvoja e audituesve austriake do të jetë shumë e dobishme për audituesit tanë.

Më lejoni gjithashtu t'ju falënderoj ne emër te KLSH-se, për kontributin tuaj si Sekretar i Përgjithshëm i INTOSAI. Ne jemi të gatshëm të përdorin çdo mundësi për trajnime dhe vizita për shkëmbimin e përvojës për aktivitete që organizohen ose iniciohen nga INTOSAI. Ju lutem, te na përfshini ne këto aktivitete.

Më lejoni t'ju falënderoj edhe një herë për dëshirën e mire qe patet të bashkëpunoni me ne dhe për kontributin qe do të jepni në rritjen e kapaciteteve profesionale të audituesve tanë. Është një kënaqësi e madhe për mua që jam me ju dhe stafin tuaj sot.

Ju faleminderit!

NË VEND TË PASTHËNIES:

AMBICIA JONË- KLSH INSTITUCIONI MË I PËRGATITUR PËR INTEGRIM

(*Intervistë e z. Jacek Jezierski, Ish-President i Institucionit Suprem të Auditimit(NIK) të Polonisë, Këshilltar i Lartë i Presidentit të NIK, dhënë Televizionit Shqiptar*[104] *më 30 nëntor 2016*)

NIK është një institucion modern suprem i auditimit publik dhe një nga institucionet supreme të auditimit(SAI-t) më të mëdha në Europë. Pse keni mbështetur kaq intensivisht Kontrollin e Lartë të Shtetit, SAI-n e Shqipërisë, pas korrikut të vitit 2012, kur nënshkruat me të marrëveshjen e bashkëpunimit?

Kjo është politika jonë për të mbështetur një tjetër SAI në Evropë dhe në botë. Ajo i përshtatet në mënyrë të përkryer motos së organizatës sonë, INTOSAI, organizata ndërkombëtare për institucionet e larta të auditimit. Kjo moto thotë se "Nga përvoja e përbashkët pëtfitojnë të gjithë". Ne gjithmonë shohim një bashkëpunim të tillë si reciprokisht të dobishëm. Në atë kohë, në vitin 2012, kur u zgjodh Kryetari i ri i KLSH-së, ai erdhi në Poloni për të na vizituar. Ne e kemi nisur duke diskutuar për mënyrat e mundshme të bashkëpunimit. Ne, si Polonia dhe Shqipëria, tashmë jemi shtete të suksesshme me një histori mjaft të ngjashme. Ne gjithashtu dolëm nga një regjim komunist. Ai nuk ishte aq i egër si ky qe keni patur ju këtu në Shqipëri, por edhe ne kemi pasur shumë kufizime. Pra, kemi filluar gati nga e para qe t'i zhvillojmë të gjitha institucionet tona publike. Midis tyre, ne rindërtuam edhe institucionin suprem të auditimit, siç ishte para Luftës së Dytë Botërore, bazuar në traditat tona dhe përvojën e mirë të akumuluar.

[104] linku i intervistës: pjesa e parë: http://rtsh.al/ekonomia-qe-duam/; pjesa e dytë: http://rtsh.al/ekonomia-qe-duam/

Dhe tani, ne ndajmë përvojën tonë. Pra, kur z Bujar Leskaj erdhi në Varshavë, ai shprehu dëshirën e tij nëse do të mund ta fillonim bashkëpunimin konkret nëpërmjet shkëmbimit të përvojave dhe trajnimit të audituesve shqiptarë. Për fat të mirë, ne mundëm t'i përmbushim pritshmëritë e tij. Ne ishim në gjendje që të ftonim menjëherë pas nënshkrimit të marrëveshjes, një grup të parë me shumë auditues shqiptarë, për trajnim në Varshavë në qendrën tonë të trajnimeve. Ne u kemi paraqitur atyre qasjen tonë të auditimit modern, auditimit të performancës, auditimit financiar dhe auditimit të përputhshmërisë. Ishte shumë e bukur për të parë dhe unë kam qenë me të vërtetë shumë i impresionuar kur pashë sesi audituesit shqiptarë ishin të etur për të mësuar, për të ditur më shumë për zhvillimet e auditimit në Poloni dhe në vende të tjera, sepse ne arrijmë të mbledhim disa përvoja nga EUROSAI. Kështu ishte aktiviteti, takimi i parë. Që atëherë, kemi pasur disa ngjarje të tilla të trajnimit në Poloni dhe bashkëpunimi ynë është duke u zhvilluar shumë mirë, jo vetëm në platformën dypalëshe, por edhe në organizatën tonë europiane, në EUROSAI dhe në INTOSAI.

Si e gjeni partnerin tuaj, KLSH-në sot, katër vjet pasi ju filluat bashkëpunimin intensiv, pasi niset dhe plotësuat shumë aktivitete me të? A është zhvilluar ai si institucion më tutje? A duket më mirë sot se katër vjet më parë?

Po, absolutisht KLSH është një organizatë shumë më mirë e zhvilluar se katër vite më parë. Unë mund të shoh se gjatë këtyre viteve shumë është ndryshuar. Kjo padyshim ndodh falë angazhimit shumë të fortë të Kryetarit, i cili me të vërtetë dëshiron që kjo organizatë të bëhet një organizatë moderne europiane, duke përmbushur të gjitha standardet ndërkombëtare të fushës. Ne gjithashtu shohim një angazhim shumë të fortë të stafit këtu. KLSH nuk është një institucion shumë i madh në krahasim me ne. Ajo është shumë më e vogël, në krahasim me ne që jemi një vend i madh. Por ajo që unë shoh këtu është një përkushtim dhe angazhim i jashtëzakonshëm nga stafi. Ata duan të jenë auditues tejet të përgjegjshëm shtetërorë për këtë punë shumë të vështirë dhe sfiduese. Mund të them gjithashtu se Shqipëria është me të vërtetë zhvilluar shumë shpejt, në krahasim me të kaluarën. Pothuajse çdo herë që unë jam këtu, shoh ndryshime të shumta dhe të forta. Dhe e njëjta gjë, ndryshime të tilla shoh edhe këtu brenda, në KLSH. Ndryshime të shumta dhe të mira, në përmirësim, në të mirë të punës, duke shkuar sipas prirjeve dhe planeve strategjike të organizatës sonë ndërkombëtare, sipas pritshmërive të qytetarëve dhe shoqërive tona. Ne ndoshta do të flasim më vonë pak më shumë në lidhje me këtë.

Mund të them gjithashtu se unë shoh një organizim më transparent, më të hapur. Ka shumë njerëz mendjehapur këtu dhe ata janë duke u përpjekur për t'i shërbyer vendit.

Pse është Projekti i binjakëzimit IPA 2013 kaq i rëndësishëm për KLSH? Ju jeni ndër drejtuesit e konsorciumit që po ndihmon KLSH-në për të bërë ndryshime, për të vazhduar ndryshimin, siç thate ju. Pse kjo është e rëndësishme edhe për vendin tonë në tërësi, për financat publike këtu?

Programi IPA është një mjet i Bashkimit Europian për bashkëpunim me vendin i cili dëshiron të hyjë në Bashkimin Evropian dhe kjo i përshtatet shumë mirë politikës së jashtme të Bashkimit Evropian. Ky projekt është quajtur një projekt binjakëzimi, një qasje si një binjak, si një vëlla. Qëllimi i tij është që të takohet me të vëllanë, kështu që vendet të cilat ende nuk janë në Bashkimin Europian, të njohin më mirë qasjet dhe rregullat e tij. Po ashtu të njohin më mirë strukturat dhe institucionet e tij, për të mësuar nga njëri-tjetri. Pra, projekti IPA në këtë rast përqendrohet në forcimin e kapaciteteve të KLSH-së, për të transferuar disa njohuri në lidhje me auditimin e parave europiane. Shqipëria është një vend kandidat për Bashkimin Evropian, ka marrë shumë fonde të taksapaguesve evropiane. Dikush duhet t'i auditojë këto para. Për këtë vjen në ndihmë përvoja jonë shumë e mirë që nga koha kur Polonia ishte vend aderues në Bashkimin Europian, para vitit 2004, kur ne si institucion suprem auditimi, si NIK-u polak, ishim shumë të përfshirë në auditimin e parave evropiane. Ne kemi ndryshuar qasjen në përdorimin e këtyre parave. Në fillim, shumica e parave shpenzohej për atë që ne e kemi quajtur "Brigada Marriott", pra një shprehje, sipas linjës së hoteleve luksoze Marriot. Kjo do të thotë që disa ekspertë të huaj vinin në Poloni, në kuadër të projekteve dhe programeve te BE-së për të ndihmuar Poloninë. Ata vendoseshin në hotele të bukur e luksoze, shpenzonin shume para për të përgatitur disa raporte, por këto raporte nuk ishin me të vërtetë shumë të dobishëm për ne, për të ndryshuar gjendjen tonë. Pra, në përputhje me gjetjen dhe rekomandimet tona nga auditimet që kemi bërë për mënyrën si shpenzohej paraja e taksapaguesve evropianë të BE-së, shumica e parave tani është zhvendosur për investime reale, jo për përgatitjen e letrave pa vlerë.

Kështu që në me të vërtetë e inkurajuam KLSH-në nga fillimi që të përfshihej në auditimin e parave europiane të shpenzuara këtu në Shqipëri, por vetëm me qasjen më efektive, për të parë se si këto fonde janë përdorur këtu për të mirën e vendit.

Korrupsioni është një problem i madh i shoqërisë dhe i ekonomisë sonë dhe NIK është vendosur mirë me traditën dhe përvojën e tij në krye të SAI-ve Europiane në luftën kundër korrupsionit. A mundet projekti juaj të rrisë kapacitetet e audituesve të KLSH-së në zbulimin dhe luftimin më fort të korrupsionit?

Mendoj se SAI-t kanë një rol shumë të rëndësishëm për të luajtur në betejën anti-korrupsion. Ne nuk luftojmë kundër rasteve të veçanta të korrupsionit, sepse kjo lufte nuk është roli ynë parësor. Ajo është për institucionet e zbatimit të ligjit, por unë do të

thoja se qëllimi ynë është po ashtu i rëndësishëm. Ne jemi përgjegjës për sisteme më të mira, për përmirësimin e sistemeve të cilat parandalojnë korrupsionin. Ne në Poloni kemi përgatitur një paketë të plotë mjetesh dhe udhëzimesh se si duhet kryer auditimi lidhur me cenueshmërinë e institucioneve nga korrupsioni. Kjo ka ndodhur disa vjet më parë. Ne gjithashtu kemi përzgjedhur një qasje të tillë që në çdo auditim qe kemi bërë, ne kontrollojmë nëse institucioni që auditohet ka apo jo një sistem i cili e parandalon, nuk e lejon korrupsionin, pra nëse ky institucion ka një sistem të parandalimit sistematik të korrupsionit. Tani ne gjithashtu bashkë-kryesojmë një nga nën-grupet e INTOSAI-t, përgjegjës për zhvillimin e udhëzimeve sesi SAI-t duhet të kryejnë auditime në lidhje me çështjet e anti-korrupsionit.

Pra, ne kemi një përvojë të brendshme të zhvilluar për këto qasje dhe njerëz shumë të mirë të cilët janë të përfshirë personalisht në këtë punë në arenën ndërkombëtare. Ne jemi shumë të hapur për ta ndarë këtë përvojë me partnerët tanë, sepse korrupsioni është një problem për të gjithë botën. Disa vende janë shumë të suksesshëm në luftimin e tij, por ende kemi shumë vendeve demokratike, ku korrupsioni po kthehet mjaft fort. Pra, kjo luftë është një histori e pafundme. Të duhet gjithmonë të përshtatësh institucionet e tua, praktikat e tua dhe metodologjinë tënde për raste të reja të korrupsionit. Kjo gjë duhet bërë patjetër, pse vetëm kjo na bën si shtet, më të fortë.

Dy vjet më parë, Kuvendi i Shqipërisë miratoi një ligj të ri themelor të KLSH-së. A mendoni se projekti qe jeni duke drejtuar mund të ndihmojë KLSH-në për zbatimin sa më mirë të këtij ligji?

Po, një nga qëllimet tona këtu në Projektin IPA është për të shqyrtuar këtë ligj dhe në veçanti për të shqyrtuar rregullat e brendshme të funksionimit të KLSH-së, nëse ato me të vërtetë ndihmojnë zbatimin e ligjit të ri. Në mënyrë të veçantë, futjen e një qasjeje moderne në auditimin e performancës, auditimin financiar, auditimin e përputhshmërisë dhe gjithashtu, me një përqendrim të veçantë, auditimin e teknologjisë se informacionit. Pra, padyshim është një pjesë thelbësore të projektit dhe mund të them, pas disa muajve nga nisja e projektit dhe disa misioneve që ne kemi kryer këtu, se ligji i ri është me të vërtetë modern. Ai garanton pavarësinë e plotë të SAI-t shqiptar, përcakton qëllime shumë të mira zhvillimi për institucionin dhe jep udhëzimet për zhvillimin e ardhshëm të qëndrueshëm të KLSH-së. Tani jemi në fazën e përgatitjes së KLSH-së për të zbatuar të gjitha këto kërkesa të ligjit të ri. Pra, përfundimisht ligji është një bazë shumë e mirë për zhvillimin e ardhshëm të institucionit suprem të auditimit publik të Shqipërisë

Organizata "Transparency International" botoi kohët e fundit një raport për Shqipërinë duke pasur parasysh KLSH-në si një nga institucionet më të dalluara në luftën efektive kundër korrupsionit në vend, duke vlerësuar transparencën e

saj. A keni parë një lidhje midis progresit të deritanishëm të KLSH-së dhe aktivitetit tuaj në projekt, për ta mbështetur dhe për t'i siguruar KLSH-së një pozicion sa më transparent dhe rol efektiv në realizimin e një përgjegjësie më të madhe për administratën publike?

Së pari, më lejoni të them se unë kam qenë shumë i impresionuar kur kemi filluar punën tonë këtu, se sa tashmë e hapur dhe transparente është KLSH si SAI. Ajo ka zhvilluar mjete të ndryshme që të jetë në komunikim të përditshëm me shoqërinë dhe qytetarët. Më lejoni të them se institucioni supreme i auditimit i Polonisë, NIK-u polak është shqyrtuar, para anëtarësimit në BE, nga disa organizata të ndryshme europiane. Ne u vlerësuam si institucioni më i mirë publik në Poloni, i përgatitur për anëtarësim në Bashkimin Europian. Ambicia jonë këtu është për të përsëritur situatën për KLSH-në, që ai të jetë institucioni më i përgatitur për anëtarësim ne BE në Shqipëri. Unë jam tejet i bindur se kjo është e arritshme. KLSH është tashmë shumë e avancuar. Dhe pse është kjo transparencë aq e rëndësishme? Unë mendoj se veprimtarët tanë tradicionalë, për të gjithë SAI-t në botë, të paktën në vendet demokratike, si Parlamenti, Qeveria dhe institucionet e audituara, kanë ndryshuar pozicionet. Ata mbeten si aktorë kryesorë, por tani ne jemi zhvendosur drejt një qasjeje ku shoqëria, qytetarët dhe taksapaguesit janë duke marrë më shumë vëmendje dhe konsideratë. Unë mendoj se ata tani janë aktorët më të rëndësishëm. Ne po bëjmë punën tonë për ta, për shoqërinë tonë, për taksapaguesit tanë. Ne duhet të jenë transparente. Ne duhet të themi çdo gjë që jemi duke bërë.

Para së gjithash, ne po bëjmë punën tonë duke u financuar nga taksapaguesit. Ne vetë duhet të jenë të përgjegjshëm dhe transparente. Ne kemi nevojë për të provuar se paratë e tyre shpenzohen me mençuri nga ne dhe në mënyrë sa më efiçiente. Gjithashtu, ne duam të jemi syri i shoqërisë në auditimin e Qeverisë dhe se si qeveria i shpenzon paratë e qytetarëve tanë. Pra, komunikimi ynë tani, edhe në sajë të mjeteve moderne, si interneti dhe të gjitha këto media elektronike dhe sociale, na bën të jetë më i drejtpërdrejtë me shoqërinë. Disa vite më parë, në Poloni ne nuk mund të informonim qytetarët tanë për rezultatet e auditimit, përpara se sa të kalonin raportet tona të auditimit në Parlament. Tani ne e kemi ndryshuar këtë. Ne ndryshuam ligjin në përputhje me kushtet dhe zhvillimet. Tani shoqëria është edhe më e rëndësishme se sa aktorë të tjerë. Tani, kryetari i Zyrës sonë është i lirë për të publikuar çfarëdolloj informacioni në çdo fazë të auditimit. Varet nga ai, kur dhe çfarë ai dëshiron t'u thotë qytetarëve.

Tani është koha për projektin, që sikurse ju thatë, ka filluar disa muaj më parë, për të ofruar disa aktivitete dhe në të njëjtën kohë, për të parë se si do të zhvillohet ai për dy vitet e ardhshme. Në këtë projekt, ju si SAI polak jeni së bashku me institucionin shtetëror suprem të auditimit të Kroacisë, si partner më

i ri(junior partner) Si po shkon ky bashkëpunim deri tani? Cila është situata, e keni projektin me këmbën e mbarë?

Ne kemi një marrëveshje shumë të mirë. Në këtë marrëveshje të gjitha qëllimet dhe detyrat tona janë reflektuar në mënyrë të përsosur dhe në formën e tyre më konkrete. Ne gjithashtu e dimë tani se çfarë janë pritshmëritë. Kjo ka bërë ta kuptojmë më mirë projektin dhe punën e përbashkët.

Sikurse e thatë, ne jemi duke punuar këtu në një konsorcium me SAI-n kroat. Unë mendoj se kjo është mjaft e natyrshme. SAI kroat është një partner dhe mik i ngushtë i KLSH-së. Dhe gjithashtu dhe ne si NIK kemi një marrëdhënie të përsosur me të. Unë mund të them se në këtë treshe ne e kuptojmë njëri-tjetrin në mënyrë të përkryer. Të gjithë ne kemi përvoja të ngjashme, kur flasim për historinë e re, por edhe për zhvillimin e administratës sonë publike. Gjithsesi ata, kroatët janë të ndryshëm. Pak më të ndryshëm. Ne kemi dallime. Unë mendoj se ky konsorcium i kombinuar me Kroacinë është një zgjidhje e mirë. Natyrisht, ne e njihnim njëri-tjetrin shumë më përpara se të fillonim këtu. Ne i dinim miqtë tanë shqiptarë dhe kroatë. Ne tashmë jemi partnerë me ta në disa ngjarje dhe iniciativa në EUROSAI dhe INTOSAI. KLSH, SAI shqiptar është pjesë e një ekipi global ndërkombëtar përgjegjës për zhvillimin e një Kodi të ri të Etikës për të gjithë organizatën e INTOSAI-t që bashkon 192 SAI të botës. Ekipet kroate dhe shqiptare punojnë së bashku me ne në disa nga grupet e punës të INTOSAI-t. Pak ditë më parë ne u takuam në Shkup. Ky ishte takimi vjetor i grupit mjedisor të punës të EUROSAI-t. Pra, ne kemi shumë përvojë të përbashkët dhe e njohim mirë njëri-tjetrin. Kjo është një bazë shumë e mirë për këtë lloj projekti. Ne tashmë dimë se çfarë mund të presim nga njeri-tjetri dhe tani jemi të gatshëm të përqendrohemi në disa qëllime të caktuara.

Le të trajtojmë një pyetje pak të vështirë. Kur ne flasim për pikat e forta dhe të dobëta të një organizate që ju mbështesni, si e shihni ju KLSH-në, cilat janë pikat e forta dhe të dobëta të saj, vështirësitë që ju duhet të kapërceni?

Natyrisht kjo është një pyetje e vështirë. Ne jemi ende në fillim të projektit, por mund të them nga kjo perspektiv e shkurtër se padyshim një nga anët më të forta të KLSH-së që na jep mbështetje për të ardhmen dhe për të realizimin e objektivave të projektit, është angazhimi shumë i fortë i Kryetarit, i drejtuesve këtu. Kjo do të thotë se ai garanton të gjitha përpjekjet tona. Ky angazhim i drejtuesve e ndihmon të gjithë organizatën që të jetë e hapur për të gjitha rezultateve që vijnë nga projekti. Por gjithashtu, unë shoh këtu stafin e ri, i cili është shumë i etur për të mësuar dhe shumë i hapur për të rejat që vijnë nga EUROSAI, nga standardet tona të auditimit ISSAI, të cilat janë standardet e INTOSAI-t. Këto janë pikat e forta themelore: angazhimi i fuqishëm i drejtuesve, stafi mendjehapur dhe i etur për të mësuar. Sa për dobësitë, unë do të thoja disa mungesa të burimeve njerëzore këtu, sidomos kur e krahasojmë KLSH-në me një institucion të tillë të madh si ne, si NIK-un polak. Ne shohim se si njerëzit këtu duhet të luftojnë për të arritur disa nga qëllimet, duke qenë në të njëjtën kohë të ngarkuar me detyra në disa çështje të ndryshme. Është me të vërtetë shumë mbresëlënëse nga njëra anë, por ndonjëherë ne mendojmë që njerëzit këtu duhet nuk duhet të mbulojë çështje kaq

shumë të ndryshme. Dhe, sigurisht, që bashkëpunimi me ne për ta është ngarkesë pune shtesë. Dhe ne shohim se çdo herë që ne jemi këtu me misione, dhe ne jemi këtu çdo javë, nganjëherë me dy misione në javë, ne kërkojmë ndihmë, partneritet nga stafi këtu. Kjo është me të vërtetë një çështje e madhe për të përmbushur këto pritshmëri të projektit. Unë nuk do të thosha se kjo është një dobësi e vërtetë, por kjo është një sfidë për t'u marrë parasysh mirë në të ardhmen.

I nderuar President Jezierski, Ju përmendët në punën e kaluar të NIK auditimin e fondeve të BE-së. Duke qenë se Shqipëria është një vend kandidat i BE-së tani dhe se mbështetja e BE-së me programe vjen në rritje, si dhe që ligji i ri e mandaton KLSH-në për të audituar projektet dhe programet e financuara nga BE, sipas përvojës tuaj, çfarë do t'u këshillonit audituesve shqiptarë për të bërë, pasi ata nuk kanë pasur përvojë të ngjashme më parë? Mund të rrisë projekti juaj njohuritë dhe trajnimin e audituesve shqiptarë sesi të auditojnë projektet dhe programet me fonde të BE-së?

Para së gjithash, unë mendoj se për të qenë efikas në auditim, ju duhet të jeni i bazuar në standardet evropiane të auditimit. Për auditimin e jashtëm publik, standardet ndërkombëtare janë standardet e INTOSAI-t, ISSAI-t. Ne jemi duke punuar. Një nga qëllimet e këtij projekti IPA është të punojmë së bashku për të përmirësuar zbatimin e ISSAI-ve këtu. Kur Komisioni Evropian këtu do të shohë se auditimet këtu kryhen sipas standardeve të pranuara ndërkombëtarisht, atëhere ai do të jetë më i besueshëm dhe mund të mbështetet në këto auditime. Kur flasim për mënyrën se si dhe çfarë duhet të auditojmë në lidhje me shpenzimet e parave të BE-së, unë mendoj se ne duhet të fokusohemi në projekte të veçanta dhe duke u përpjekur për t'i vlerësuar ato, nëse janë të dobishme për vendin. Dhe ky është qëllimi ynë. Jo vetëm nëse të gjitha paratë janë shpenzuar apo jo, por edhe dhe pikë së pari, nëse ato janë shpenzuar me mençuri dhe me një qasje përfituese për vendin, për të ardhmen. Kjo është një nga çështjet kryesore sot në Poloni. Ne jemi vendi më efektiv kur flasim për thithjen e parave të BE-së. Ne absorbojmë pjesën më të madhe të fondeve të Bashkimit Evropian dhe kemi një eksperiencë më shumë se 10 vjeçare tashmë. Megjithatë, në krahasim me vendet e vjetra anëtare të BE-së, ne jemi duke marrë një pjesë të mirë të ndihmës së BE-së në Poloni. Dhe qëllimi ynë është që t'i përdorin këto para për projekte të tilla që mund të na sjellin një të ardhme më të mirë. Kjo do të thotë se ndihma nuk duhet të jepet vetëm për shpenzimet e përditshme, për subvencionimin e disa aktiviteteve, por për inovacion, për të mbështetur një ekonomi inovative, shoqëri të reja. Unë do të këshilloja KLSH-në, SAI-n shqiptar për t'u përqendruar në projektet më të rëndësishme. Çfarë dhe si duhet të jenë apo të veprojnë ata, në bazë të strategjisë kombëtare, çfarë lloj roli mund të luajë Shqipëria në të ardhmen në Bashkimin Europian. Ku janë pozicionet ku Shqipëria mund të jetë anëtari më i avancuar, apo edhe vendi kryesor zbatues në disa projekte. Sepse koncepti i Bashkimit Evropian është që ne të jemi duke marrë të gjitha përvojat e mira, praktikat nga të gjithë vendet anëtare. Dhe ne të përpiqemi të marrim përfitimet maksimale nga kjo ndihmë. Pra, çdo vend anëtar apo kandidat për në BE të sjellë diçka të veçantë. Dhe çdo vend ka diçka të veçantë për të ndarë me të tjerët.

Në punën tuaj të përditshme për projektin këtu, sikurse dhe ju e thatë, me nganjëherë edhe dy misione në javë në KLSH, në lodhjen, në përpjekjet tuaja, a shikoni të ketë progres apo ambicie nga stafi i KLSH-së, në atë që i përket auditimit të performancës? Siç e dini, përveç të qenit në ballë të luftës kundër korrupsionit, përvetësimeve dhe mashtrimit në administratën publike, një SAI duhet të përpiqet për të rritur rolin e vet këshillues për qeverinë dhe qytetarët, si për të përmirësuar shërbimet e ndryshme publike për qytetarët. Pra, e shihni ju një rol të mundshëm për projektin në rritjen e kapaciteteve të stafit të KLSH në auditimin e performancës?

Sigurisht, ne shohim këtu njerëz shumë ambiciozë të cilët janë të trajnuar shumë mirë dhe të pajisur me metodologji bashkëkohore dhe zgjidhjet moderne. I gjithë INTOSAI është gjithnjë e më shumë duke i kushtuar vëmendje auditimit të performancës, sepse ai të jep një përgjigje se si administratat tona publike duhet të shpenzojnë paratë e Shtetit në mënyrë sa më efektive dhe efiçiente. Çfarë lloj arritjesh ka administrata dhe me çfarë kosto? Sot kjo është më e rëndësishme se vetëm dhe thjesht kontabiliteti shtetëror. Kështu që unë shoh këtu një ekip të vogël të audituesve të performancës, por një grup shumë të avancuar, shumë ambicioz dhe mendoj se KLSH është në rrugën më të mirë për zhvillimin e mjeteve të mira dhe duke u përgatitur mirë për auditimin e performancës. Por sigurisht, kjo nuk është e lehtë. Kërkon shumë aftësi. Gjithashtu, kërkohet komunikim më i mirë me shoqërinë, me aktorët kryesorë, me Parlamentin dhe Qeverinë. Kjo, për shkak se treguesit në auditimin e performancës nuk janë përcaktuar aq mirë si, për shembull, në auditimin e përputhshmërisë, kur ju keni tregues të saktë dhe shumë të rreptë. Këtu, në auditimin e performances, ju keni nevojë për të zhvilluar, së bashku me institucionin që auditoni dhe Qeverinë, një set treguesish dhe vetë metodologjinë. Pra, ky auditim është më i vështirë, kërkon më shumë komunikim, më shumë transparencë, por edhe, në mendjen time, më shumë efiçience në fund të fundit.

Ne të gjithë jetojmë në një botë të dixhitalizuar me internet dhe media sociale. A mendoni se KLSH është e pozicionuar mirë, apo ka nevojë për më shumë pajisje, investime të njësisë së TI, auditime të TI dhe gjithashtu zhvillimin e një mënyrë të dixhitalizuar për kontrollin dhe auditimin e Qeverisë. Siç e dini, ne kemi një qeverisje elektronike të zhvilluar, projekte dhe tendara elektronikë në administratën tonë publike.

Një prej qëllimeve të Projektit IPA është përmirësimi i auditimit të teknologjisë së informacionit dhe mbështetjen e kësaj teknologjie në auditim. Nevojat për TI janë gjithmonë shumë të mëdha. Në shumicën e vendeve, në të gjitha vendet ku ne zbatojmë projekte, ne e shohim këtë. T'i plotësosh këto nevoja është gjithmonë shumë e vështirë. Kjo vlen si për nevojat e punonjësve të teknologjisë së informacionit, dhe për nevojat e audituesve. Bashkëpunimi dhe mirëkuptimi reciprok nuk është i lehtë. Ai ka nevojë për shumë kohë dhe sidomos më shumë përpjekje nga të dyja palët. Për njerëzit e TI, që të kuptojnë nevojat e audituesve dhe nga audituesit që të kuptojnë mjetet e TI, se si ato funksionojnë dhe se si ata mund të jenë përfitues. Ne kemi shumë përvojë në këtë drejtim, ndonjëherë një përvojë të keqe, e cila është edhe më e dobishme.

Sigurisht për të vepruar jo në atë mënyrë…

Pikërisht. Ne shohim këtu edhe ekipin e TI. Ekipi është i vogël këtu. Dhe kjo është një nga sfidat më të cilat KLSH duhet të përballet. Sepse padyshim teknologjia e informacionit është e ardhmja jonë. E gjithë bota e auditimit po bëhet gjithnjë e më e pajisur dhe e lidhur me TI. Ne nuk mund ta shmangim këtë. Ne nuk mund të rrinë me dosjet me letra!. Ne jemi vetëm duke punuar gjithnjë e më shumë në rrjet, në internet. Pra, TI duhet të përmirësohet këtu. Ajo ka nevojë për më shumë burime dhe më shumë trajnime. Por kjo është një sfidë për të gjithë ne. Ne ndoshta jemi në një fazë tjetër në Poloni, por sfida qëndron atje edhe para nesh. Ne jemi duke zhvilluar mjete të reja në INTOSAI. Ne po shohim dhe jemi duke ndërmarrë iniciativa shumë interesante. Pra, sipas motos sonë, ne mund të përfitojmë nga përvoja e të tjerëve dhe me siguri, ne duhet ta bëjmë këtë! Ne duhet të marrim sa më shumë që mund të asimilojmë.

Si e shihni, i nderuar z. President, KLSH-në pas dy vitesh, kohë kur projekti do të përfundojë? A keni (dhe sigurisht që po, e keni) një përfytyrim, perspektivë se si do të zhvillohen kapacitetet e audituesve të KLSH-së gjatë kësaj periudhe?

Unë mendoj se ne po flasim për dy detyra. Para së gjithash, është përmirësimi i vërtetë i komunikimit me shoqërinë. Mendoj se pas këtyre dy viteve, KLSH do të perceptohet edhe nga njerëzit këtu, nga qytetarët si një institucion modern i besueshëm. Kjo është gjëja më e rëndësishme. Qytetarët e Shqipërisë mund ta perceptojnë KLSH-në si pjesë e shoqërisë së tyre, si pjesë e Shtetit për të cilin ata kontribuojnë.

Kemi nevojë për një kulturë të njesuar administrative, e së njëjtës natyrë, të njëjtët njerëz të cilët mund t'u besojnë autoriteteve shtetërore. Kjo është edhe një nga detyrat për institucionin suprem të auditimit. Ai duhet të udhëheqë nëpërmjet shembullit për të ndryshuar për mirë institucionet e tjera publike. Kështu që, unë mendoj se KLSH ka një ndikim ndaj institucioneve të tjera. Ai mund të ndryshojë institucionet e tjera nëpërmjet auditimit, me gjetjet dhe rekomandimet e tij. Dhe një çështje tjetër është se si KLSH do të perceptohet nga partnerët e Bashkimit Europian. Unë jam mjaft i sigurt se partnerët e Bashkimit Evropian do ta shohin KLSH-në si një institucion i përgatitur mirë për të qenë një anëtar i Bashkimit Evropian. Çfarë do të thotë? Kjo do të thotë se KLSH do të përgatitet sipas standardeve tona ndërkombëtare, për të kryer auditimin e parave evropiane.

Kjo është shumë e rëndësishme, çfarë ju jeni duke thënë, sepse, siç e dini, ne kemi një linjë të mbështetjes nga Bashkimi Evropian për buxhetin e shtetit të Shqipërisë. Sidomos nga DG-Budget në Bruksel për reformën e menaxhimit të financave publike. Ka një strategji publike të menaxhimit financiar në vend 2014-2020. Një nga shtyllat e saj, shtylla e gjashtë është mbikëqyrja e reformave nga ana e auditimit të jashtëm publik, institucionit suprem të auditimit. Pra, ndoshta, duke ngritur kapacitetet e auditimit të KLSH-së , projekti mund të luajë një rol në këtë strategji, nuk jeni dakord?

Sigurisht, kjo është ajo që unë jam duke thënë. KLSH, si çdo SAI tjetër, po bëhet gjithnjë e më e rëndësishme në të gjithë strukturën e administratës publike. Ne mund t'i

referohemi edhe zhvillimeve të fundit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Në më pak se tre vjet, nga viti 2011 deri në vitin 2014, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi dy Rezoluta. Rezolutat janë në lidhje me promovimin e përgjegjshmërisë dhe transparencës së administratës publike në shtetet anëtare të OKB-së, duke forcuar institucionet supreme të auditimit. Pra, i gjithë progresi i administratës publike është perceptuar nga Kombet e Bashkuara, me këndvështrimin e pavarësisë së institucioneve supreme të auditimit. Madje edhe më shumë, një vit më parë, Kombet e Bashkuara miratuan Objektivat e reja të zhvillimit të qëndrueshëm për perspektivën e 15 viteve të ardhshme. Këto ishin një vazhdim i Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit që janë hartuar për periudhën 2000-2015. Disa nga treguesit nuk janë arritur në nivelet e parashikuara. Prandaj dhe Kombet e Bashkuara, në mënyrë shumë të zgjuar, janë mbështetur mbi mjetet e monitorimit të treguesve kryesorë. OKB zhvillon idenë se ne kemi nevojë për të monitoruar zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm në të gjitha vendet anëtare të Kombeve të Bashkuara. Një nga mjetet më të rëndësishme (unë nuk do të thosha i vetmi mjet i monitorimit), por patjetër ndër mjetet më të rëndësishëm, është institucioni suprem i auditimit. Ne jemi institucione të cilat mund të luajnë rolin e një institucioni monitorimi global, me auditimet tona, me gjetjet dhe rekomandimet qe japim.

Organizata jonë globale, INTOSAI ka zhvilluar tashmë disa udhëzime, duke reflektuar rëndësinë e rolit të institucioneve supreme të auditimit në arritjen e zbatimit të këtyre qëllimeve globale për të gjithë njerëzimin. Kongresi i ardhshëm i INTOSAI-t, i cili organizohet çdo tre vjet dhe do te mbahet në dhjetor të këtij viti, ka dy tema. Një prej këtyre temave është se si SAI-t mund të përfshihen në zbatimin e këtyre qëllimeve të zhvillimit të qëndrueshëm. Pra, roli i institucioneve tona në zhvillimin e përgjithshëm të njerëzimit po vjen duke u rritur. Dhe në vendin tuaj, kjo do të thotë se roli juaj tani perceptohet edhe më i rëndësishëm. Ne do të jemi kudo në botë. Ne do të jemi te përfshirë në zhvillimin e strategjive lokale. Auditimi i këtyre strategjive lokale, duke dhënë këshilla dhe rekomandime, është themelor. Në thelb, roli i SAI-ve bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm në zhvillimin e shoqërive tona.

Ndoshta ju keni parë se në Shqipëri ka shumë simpati dhe ndjenja miqësore për popullin polak, historinë dhe simbolet e tij. Duket se ne jemi shumë të ngjashëm për sa i përket dëshirës për liri, për të qenë të lirë dhe krenarë për historinë dhe traditat tona. A mendoni se kjo ndihmon edhe në projekt, fakti se ne jemi aq të ngjashëm dhe simpatia është aq spontane? Pra, kur ne punojmë së bashku ...

Pa asnjë dyshim kjo ndihmon shumë. Gjithmonë marrëdhëniet personale dhe të kuptuarit personal mbështet të gjitha zhvillimet në këtë projekt. Ju keni absolutisht të drejtë se kemi shumë gjëra të përbashkëta. Ne jemi kombe krenarë, pse kemi luftuar fort për pavarësinë tonë. Në historinë e kohëve të fundit, ne kemi arritje shumë të ngjashme dhe zhvillime shumë të ngjashme. Pra, ne mund ta kuptojmë më mirë njëri-tjetrin. Ne gjithashtu kuptojmë se zhvillimi ynë ndonjëherë nuk do të vijë shumë shpejt. Se ne kemi nevojë për kohë. Ne nuk jemi në gjendje për të ndryshuar çdo gjë brenda natës. Ne

kishim të njëjtën përvojë. Këto zhvillime nuk janë vetëm të kushtueshme. Ato jo vetëm që kanë nevojë për shumë investim, por edhe ne kemi nevojë për të ndryshuar mentalitetin tonë.

Nganjëherë, për njerëzit nga Perëndimi, është e vështirë për të kuptuar pse ne nuk po ndryshojmë me shpejtësi. Kur ne miratojmë ndryshimin, disa zgjidhje që bëjmë, ata pyesin: pse ju nuk do të ndryshoni menjëherë? Ne e kuptojmë se kjo nuk është aq e lehtë. Për shkak se ndryshimi ka nevojë për kohë, ai ka nevojë që ne të punojmë me popullin tonë, me njerezit tanë, për t'i bindur ata për të mirat e ndryshimit. Ajo që ishte një shok, tronditje për ne në Poloni, shpejt pasi u ndamë nga regjimi komunist, partia post-komuniste u zgjodh me zgjedhje të hapura dhe kishin shumicën. Ne nuk mund të kuptojmë se si ka ndodhur kjo. Por, ato janë reflektime të zhvillimit të shoqërive tona. Për shumë e shumë vite, ne kemi qenë të kufizuar deri në lirinë tonë të të shprehurit dhe në pothuajse çdo gjë. Kjo nuk është aq e lehtë për të pritur që një person i tillë të jetë dhe të veprojë krejtësisht i pavarur. Ne ishim duke u mbështetur në një lloj ndihme të gjithanshme nga shteti më parë. Qytetarët tanë ishin shumë të varfër, por ishin të mësuar me këtë ndihmë. Tani, në ekonominë e tregut të lirë, përvojat e tyre janë të ndryshme. Ne kemi horizonte shumë më të mëdha dhe mundësi, por edhe ne kemi përgjegjësitë tona. Pra, njerëzit nuk janë gjithmonë të përgatitur për këtë. Ndryshimi ka nevojë për kohë. Ndonjëherë, atij i nevojitet edhe koha e një gjeneratë të tërë për ta kuptuar si ndryshim. Dhe ne e kuptojmë popullin shqiptar. Unë mendoj se ne ju kuptojmë ju shumë mirë.

Dhe kjo është një pikë e fortë e projektit...

Po, është. Ju Shqiptarët jeni njerëz shumë të ndershëm, njerëz miqësorë. Kjo ndihmon, sepse gjithnjë e më shumë polakë po vijnë këtu. Jo vetëm si ne, për projektin, por edhe për të kaluar kohën këtu.

Si turistë. Kanë ardhur shumë polakë këtë verë…

Ne nuk do të vinim këtu vetëm për shkak se ju keni një natyrë të tillë të mrekullueshme, por vijmë edhe pse se ju jeni njerëz të tillë miqësorë. Ne duam të jemi së bashku me njerëz të tillë.

I nderuar President Jezierski. Ju faleminderit shumë nga zemra që ishit me ne sot në "Ekonomia që duam".

Ju faleminderit ju me të vërtetë. Kjo ishte një kënaqësi shumë e madhe për mua të flas këtu dhe të ndaj përvojën time për të thënë se shqiptarët janë një komb i madh, kështu që ishte një mundësi e jashtëzakonshme për mua. Faleminderit shumë!

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

RSH. Kontrolli i Lartë i Shtetit
4 vjet auditim i jashtëm publik: 2012-2015/RSH.
Kontrolli i Lartë i Shtetit; Përgatiti: Bujar Leskaj
Tiranë: KLSH 2016

862 f.; 165*235cm

ISBN: 978-9928-159-48-9

1. Administrimi publik 2. Financa publike 3. Kontrolli
4. Kontrolli i lartë i shtetit 5. Raporte

351.95:657.6(469.5)

ISBN: 978-9928-159-48-9

Seria: botime KLSH-11/2016/62

Kontrolli i Lartë i Shtetit
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr 3, Tiranë
Tel/Fax: 04228485, Tel: 04251267
website: www.klsh.org.al,
email: klsh@klsh.org.al